Associations in production or in economic activities is a tool in the hands of entrepreneurs to realize the ultimate goal - greater profit. But not always the freedom of entrepreneurship and competition have real auguries, for example multinational companies driven by a desire to dominate the economic, and therefore in the political sphere. Attempts to put a legal framework on the actions of monopolies, and thus reduce their dominance in theory is well established, in practice it hardly works so well. In Macedonia there is anti-trust laws, and the free market and entrepreneurship is protected by the Constitution, but the Commission for Protection of Competition has no competence (or simply cannot have) against the monopolistic policy of large multinational companies.

References

1. Avlijaš R, *Preduzetnistvo*. Univerzitet Singidunum. Beograd 2010.
2. Avlijaš R., *Preduzetništvo i menadžment malih i srednjih preduzeća*, Univerzitet Singidunum, Beograd, 2008.
3. Sir Adrian Cudbary, “*Global Corporate Governance Forum*”, World Bank, 2000.
4. Andrei Shleifer, Robert W. Vishny во *Survey of Corporate Governance*, The Journal of Finance, Juni 1997
5. **Балашов Ю.К. Мотивация и стимулирование персонала: основы построения системы стимулирования/ Ю.К. Балашов // Кадры предприятия. - 2009. - №1.**
6. **Бочарова Т. Как повысить конкурентоспособность организации? // Управление персоналом. - 2003. - №4.**
7. Bukljas I. *Subjekti i pravni poslovi unutaršnjeg imedjunarodnog prometa*, Zagreb, 1978g.
8. **Дукоски Саша. Право на конкуренција, Графомак, Кичево, 2014.**
9. **Дукоски Саша, Меѓународно трговско право, Графомак, Кичево, 2014,**
10. **Дукоски Саша, Трговско право, Графомак, Кичево, 2014.**
11. **Егоршин А.П. Основы управления персоналом: Учебное пособие для вузов. - 2-е изд., перераб. И доп. - М.: Инфра-М, 2006.**
12. Пис В. *Макроекономija*. Beograd.2010.
13. James D. Wolfensohn за *Financial Times*, 21 jun 1999
14. Jovasevic V. *Monopolски kapitalizam*, Rad. Beograd.1982.
15. **Кибанов А.Я. Основы управления персоналом: Учебник. - М.: ИНФРА-М, 2006.**
16. **Клунцингер Еуген. Основы на трговското право, Алумна, Скопје. 2012.**
17. **Кудрявцева Е.И. Проблемы управления персоналом на предприятиях и в организациях малого и среднего бизнеса/ Е.И. Кудрявцева // Управленческое консультирование. - 2007. - №4. - С.7**
18. **Марченко И. // Кадровик. Кадровый менеджмент. - 2007. - № 3**
19. **Пепељугоски В. Право на конкуренција-антимонополско право. Скопје. 2009**
20. **Семикова Н.С. Методы изучения социальной среды организации // Управление персоналом. - 2007. - №6. - С.11**
21. Stoner J., Freeman E., *Management*, Prentice Hall, Englewood Cliffs, NJ, 1989.
22. **Стрезовски С. За правната природа и видовите на здружувањето во стопанството на капиталистичките земји. Годишник на ПФ Скопје. 1971**
23. Sullivan, arthur; Steven M. Sheffrin (2003). „Economics: Principles in action“. Upper Saddle River, New Jersey 07458: Pearson Prentice Hall..
24. **Томпсон А.А., Стрикленд А. Дж. Стратегический менеджмент -М.: Издательское объединение “Юнити”, 1998.**
25. **Травин В.В., Дятлов В.А. Основы кадрового менеджмента. - М.: Дело, 1995.**
26. **Прирачник за корпоративно управување на македонските акционерски друштва; Скопје 2009.**
27. Section of Antitrust Law, American Bar Association, 2000 Annual Review of Antitrust Law developments.
28. **Устав на Република Македонија.**
29. **Закон за трговските друштва. Скопје. 2006.**
30. **Закон за заштита на конкуренцијата. Сл. РМ. 145/2010.**

Menaxhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe tarifave të privileguara në Republikën e Maqedonisë

Dr. Imer Zenku – Burimet natyrore dhe menaxhimi
SHA “ELEM”- Shkup, Filiali KXE “Oslomej”- Kërçovë

Abstrakt

Republika e Maqedonisë në fushën e energjetikës, edhe pse s'ka obligime të kuantifikuara, prapëseprapë si vend kandidat për anëtarësim në BE duhet që të përkushtohet, angazhohet dhe të ketë qasje më të organizuar drejt përmbushjes së obligimit të BE-së deri në vitin 2020, gjegjësisht sigurim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) në sasi prej 20% në konsumin e energjisë finale.

Nisur nga kjo, problematika e përpunuar është shumë specifike, e rëndësishme dhe aktuale për faktin se i trajton BRE, dhe në këtë kontekst kryesisht hulumtimi është bazuar drejt të dhënave të zgjedhura dhe të përpunuara me kujdes për prodhimtarinë e energjisë elektrike dhe pjesëmarrjen e BRE në atë prodhimtari në veçanti dhe në konsumin e energjisë në përgjithësi, e cila ka rol të rëndësishëm dhe ndikim direkt në përafrimin, arritjen dhe përmbushjen e objektivit të përcaktuar të çdo vendi veçmas, deri në vitin 2020, në kornizat e Bashkimit Europian dhe Republikës së Maqedonisë.

Në vazhdim, në punim rëndësi e veçant i është përkushtuar prodhimit të energjisë elektrike nga prodhues të privilegjuar, si dhe tarifave të privileguara (feed-in tariffs), të cilat i stimulojnë dhe nxisin investitorët potencial për ndërtim të centraleve të ndryshme të cilat shfrytëzojnë BRE të ndryshme, si hidrocentrale, centrale të erës dhe fotovoltaike dhe termocentrale të biomasës dhe biogazit për prodhim të energjisë elektrike nga BRE. Gjithashtu, është bërë edhe analizë krahasuese e tarifave të privileguara në kornizat e Bashkimit Europian dhe Republikës së Maqedonisë, si dhe në vendet fqinje.

Punimi është e një rëndësie të madhe ekonomike, energjetike, sociale dhe ekologjike, sepse shfrytëzimi i BRE, e në veçanti investimi në prodhimtarinë rritëse të energjisë elektrike nga BRE, ka ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi, zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik në tërësi, hapjen e vendeve të reja të punës, si dhe në zvogëlimin e emisionit të gazrave ndotës, e me atë edhe kënaqshmërinë dhe përmbushjen e standarteve më të rrepta ekologjike europiane për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor. E gjithë kjo, së bashku do të na mundësoj t'u bashkohemi vendeve bashkëkohore dhe teknologjikisht të përparuara në botë dhe të bëhemi pjesë e Bashkimit Europian.

Fjalë kyçe: prodhimi i energjisë elektrike, konsumi final i energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë, prodhues të privilegjuar, tarifa të privileguara.

Hyrje

Energjia elektrike është gjithësesi forma më fisnike dhe lloji kryesor i energjisë të cilën njerëzimi mësoi që t'a krijojë, kontrollojë dhe shfrytëzojë. E njëjta është faktor më i rëndësishëm dhe sot nuk mund që të paramendohet zhvillim shoqëroro-ekonomik i një vendi pa prodhim dhe shfrytëzim të energjisë elektrike. Ekonomizimi me të ka një histori më të gjatë se një shekull dhe ajo sështë veprimtari ekonomike e cila është në fazën e pjekurisë ose rënjes, por mu e kundërta, ajo veprimtari ka ardhmëri zhvillimore perspektive. Për këtë arsye, problematika e cila është përpunuar është mjaft aktuale për faktin që i trajton BRE, dhe në kontekst të asaj vëmendja në këtë punim kryesisht është përqëndruar drejt përpunimit të detajuar dhe praktik të energjisë elektrike nga BRE dhe tarifave të privileguara, si dhe menaxhimit të tyre në kornizat e Bashkimit Europian dhe Republikës së Maqedonisë. Bazuar në këtë, analiza në këtë punim është përmbledhur në katër pjesë dhe në fund, punimi përfundon me konkluzione.

Pjesëmarrja e BRE në prodhimtarinë e energjisë elektrike dhe në konsumin final të energjisë në BE-28

Pas zvogëlimit të papërfillshëm të neto prodhimtarisë totale të energjisë elektrike në vitin 2011 për (2.2%), në nivel të BE-28, e cila ishte 3129.2 (TWh), e njëjta mbeti gati e pandryshuar në vitin 2012, e

zvogluar për vetëm 0.1% në krahasim me vitin paraprak dhe kishte vlerën 3126.5 (TWh) (Tabela 1). Neto prodhimtari më të madhe të energjisë elektrike në periudhën referuese (2010-2012), kanë realizuar vendet anëtare të BE-28, Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe. Vendet e njëjta, kanë pasur edhe nivel më të lartë të neto prodhimitarisë së energjisë elektrike në vitin 2012, në neto prodhimitarinë e energjisë elektrike në BE-28, gjegjësisht pjesëmarrje prej (19.0%), (17.2%) dhe (11.1%), respektivisht.

Pjesëmarrja e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në prodhimitarinë e energjisë elektrike në BE-27 në vitin 2012 ishte 18.5%. E njëjta, nivel më të lartë, në mesin e vendeve anëtare në BE-28, gjegjësisht pjesëmarrje prej (64.5%) kishte në Latvi, Austri (63.8%), Suedi (53.5%) dhe Kroaci (53.0%), ndërsa pjesëmarrje prej (98.0%) kishte në Norvegji.

Obligimet të cilat vlejné për vendet anëtare të BE-së janë llogaritur në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes së BRE në konsumin total final të energjisë në vendin që shqyrtohet në vitin 2005, plus 5.5% për secilin anëtar dhe plus përqindje e caktuar në proporcion me bruto prodhimin vendor për banor (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2010, 91).

Tabela 1. Pjesëmarrja e BRE në prodhimitarinë e energjisë elektrike dhe në konsumin final të energjisë në BE-28 (Eurostat, 2014)

	Neto PEE 2010	Neto PEE 2011	Neto PEE 2012	Pjesm. në BE-28 2012	Pjesm.e EEBRE në PEE 2012	Pjesm.e EBRE në BKFE 2010	Pjesm.e EBRE në BKFE 2011	Pjesm.e EBRE në BKFE 2012	2020 Tar- get	S ₂₀₀₅
Vendet	1000 GWh	1000 GWh	1000 GWh	%	%	%	%	%	%	%
BE-28	3200.3	3129.2	3126.5	100		12.5	12.9	14.1	20	
BE-27					18.5				20	
EA-18	2277.9	2217.2	2216.3	70.9						
Belgjika	91.4	86.7	79.8	2.6	6.0	5.0	5.2	6.8	13	2.2
Bulgaria	42.2	45.8	42.9	1.4	14.0	14.4	14.6	16.3	16	9.4
R. Çeke	79.5	81.0	81.1	2.6	6.8	9.3	9.3	11.2	13	6.1
Dani- marka	36.9	33.6	29.2	0.9	36.0	22.6	24.0	26.0	30	17.0
Gjerma- nia	594.8	576.9	592.7	19.0	17.8	10.7	11.6	12.4	18	5.8
Estonia	11.7	11.7	10.5	0.3	4.5	24.6	25.6	25.8	25	18.0
Irlanda	27.4	26.4	26.5	0.8	19.0	5.6	6.6	7.2	16	3.1
Greqia	53.4	53.9	53.7	1.7	16.0	9.8	10.9	13.8	18	6.9
Spanja	291.0	283.3	286.6	9.2	30.0	13.8	13.2	14.3	20	8.7
Franca	545.0	535.1	539.2	17.2	15.0	12.7	11.3	13.4	23	10.3
Kroacia	13.6	10.4	10.2	0.3	53.0	14.3	15.4	16.8	20	12.6
Italia	290.7	291.4	287.8	9.2	22.0	10.6	12.3	13.5	17	5.2
Qipro	5.1	4.7	4.5	0.1	4.0	6.0	6.0	6.8	13	2.9
Latvia	6.1	5.6	5.7	0.2	64.5	32.5	33.5	35.8	40	32.6
Lituania	5.3	4.4	4.7	0.1	31.0	19.8	20.2	21.7	23	15.0

Luksemb.	4.6	3.7	3.8	0.1	33.0	2.9	2.9	3.1	11	0.9
Hungaria	34.6	33.5	32.3	1.0	3.0	8.6	9.1	9.6	13	4.3
Malta	2.0	2.1	2.2	0.1	0.0	0.4	0.7	1.4	10	0.0
Holanda	114.3	109.0	98.6	3.2	5.0	3.7	4.3	4.5	14	2.4
Austria	69.5	64.1	70.9	2.3	63.8	30.8	30.8	32.1	34	23.3
Polonia	143.4	148.8	147.6	4.7	11.0	9.3	10.4	11.0	15	7.2
Portugalia	52.8	51.1	45.3	1.4	40.0	24.2	24.5	24.6	31	20.5
Romania	55.9	56.5	53.7	1.7	24.0	23.2	21.2	22.9	24	17.8
Slovenia	15.4	15.0	14.7	0.5	28.0	19.2	19.4	20.2	25	16.0
Slovakia	25.4	26.1	26.1	0.8	17.0	9.0	10.3	10.4	14	6.7
Finlanda	77.2	70.4	67.7	2.2	26.0	32.4	32.7	34.3	38	28.5
Suedia	145.3	146.9	162.8	5.2	53.5	47.2	48.8	51.0	49	39.8
Britania	365.7	351.0	345.8	11.1	9.0	3.3	3.8	4.2	15	1.3
Norvegjia					98.0	61.2	64.6	64.5	67.5	58.2

Pjesëmarrja e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në bruto konsumin final të energjisë në BE-28 është zmadhuar nga 12.5% në vitin 2010 në 14.1% në vitin 2012 (Tabela 1). Kjo është dëshmi e progresit të qëndrueshëm drejt Europa 2020 objektivit prej 20%. E njëjta, nivel më të lartë në vitin 2012 në mesin e vendeve anëtare, gjegjësisht pjesëmarrje prej (51.0%) kishte në Suedi, Latvi (35.8%), Finlandë (34.3%), Austri (32.1%), Estoni (25.8%) e tjera, ndërsa në Maltë është vërejtur pjesëmarrje më e ulët (1.4%).

Për arritjen e pjesëmarrjes së kuantifikuar të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në bruto konsumin final të energjisë në BE-28 deri në vitin 2020 në krahasim me vitin 2012 është i nevojshëm zmadhim i pjesëmarrjes edhe për 5.9%. Për plotësimin e objektivit të njëjtë nevojë për zmadhim më të vogël, gjegjësisht nën 5.9% të pjesëmarrjes në krahasim me vitin 2012 kanë 17 vende, prej të cilave Romania edhe për 1.1%, Lituania 1.3%, Çekia 1.8%, Austria 1.9% e tjera. Nevojë për zmadhim më të madh, gjegjësisht mbi 5.9% kanë 8 vende, prej të cilave Britania e Madhe edhe për 10.8%, Franca 9.6%, Holanda 9.5%, Irlanda 8.8%, Malta 8.6% e tjera. Objektivin e kuantifikuar prej 49.0% 25.0% dhe 16.0% deri në vitin 2020, e kanë arritur respektivisht, Suedia me 51.0%, Estonia me 25.8% dhe Bullgaria me 16.3% në vitin 2012.

Pjesëmarrja e BRE në prodhimin e energjisë elektrike dhe në konsumin final të energjisë në Republikën e Maqedonisë

Prodhimtaria e energjisë elektrike nga BRE në Republikën e Maqedonisë në vitin 2013, është 1544 GWh (5559 TJ), gjegjësisht 26.0% në krahasim me prodhimtarinë vendore të energjisë elektrike, e cila është 5950 GWh (21420 TJ). Përqindje më e lartë e pjesëmarrjes në periudhën referuese (2010-2013) është arritur në vitin 2010 dhe atë 35.8%.

Sa i takon prodhimin të energjisë elektrike nga prodhues të privilegjuar, ato janë centrale elektrike të cilat shfrytëzojnë BRE të ndryshme për prodhim të energjisë elektrike dhe të cilat kanë fituar të drejtën për shitjen e asaj energjie elektrike me tarifa të privilegjuara.

Ky prodhim shkon përpjetë dhe nga viti në vit zmadhohet në mënyrë drastike. Kjo është si rezultat i zmadhimit të përditshëm të numrit të centraleve elektrike si dhe të fuqisë së instaluar. Kjo fuqi e instaluar tek prodhuesit e privilegjuar të energjisë elektrike nga 2799 kW në vitin 2010 arrin në 24528 kW në vitin 2013 (Mepso, 2014).

Regjistri i centraleve elektrike përfundimisht me 10.10.2014, për prodhim të energjisë elektrike nga

ana e prodhuesve të privilegjuar është dhënë në tabelën 2.

Tabela 2. Regjistri i centraleve për prodhim të energjisë elektrike nga BRE (AE në RM, 2014)

Lloji i centraleve	Fotovoltaike	Hydrocentrale të vogla
Numri i centraleve	73	33
Fuqia totale e instaluar (MW)	12.07	26.68
Prodhimi i planifikuar vjetor (MWh)	16205.65	104489

Edhe pse kemi prodhimtari rritëse të energjisë elektrike nga prodhues të privilegjuar, prapëseprapë përqindja e pjesëmarrjes së saj në prodhimtarinë e EE nga BRE si dhe në prodhimtarinë totale të EE është shumë e ulët dhe arrin vlerën 3.1% dhe 0.8% respektivisht, në vitin 2013. Gjithashtu edhe në konsumin total të EE si dhe në konsumin final të energjisë merr pjesë me numër jo të plotë përqindjeje, gjegjësisht 0.58% dhe 0.23% respektivisht, në vitin 2013 (Tabela 3).

Tabela 3. Burimet e ripërtëritshme të energjisë në periudhën referuese 2010-2013 [TJ] (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2013, 51; 58; 60)

Lloji i energjisë	2010	2011	2012	2013
	TJ	TJ	TJ	TJ
Prodhimtaria e EE nga PP	0	36	64.8	172.8
Prodhimtaria e EE nga BRE	8.730	5.144	3.943	5.559
Prodhimtaria totale e EE	24376	22799	23126	21420
Konsumi total i EE	29.490	32.466	32.001	29.587
Pjesëmarrja e EE nga PP në prodhimtarinë e EE nga BRE	0	0.7%	1.8%	3.1%
Pjesëmarrja e EE nga PP në prodhimtarinë totale të EE	0	0.16%	0.28%	0.80%
Pjesëmarrja e EE nga PP në konsumin total të EE	0	0.11%	0.20%	0.58%
Pjesëmarrja e EE nga BRE në prodhimtarinë totale të EE	35.8%	22.6%	17.1%	26.0%
Pjesëmarrja e EE nga BRE në konsumin total të EE	29.6%	15.5%	12.3%	18.8%
Energjia totale nga burime të ripërtëritshme	16.445	12.745	11.293	12.891
Konsumi total final i energjisë	76.631	78.127	80.664	74.844
Pjesëmarrja e energjisë nga BRE në konsumin final të energjisë	21.5%	16.3%	14.0%	17.2%
Pjesëmarrja e energjisë elektrike nga BRE në konsumin final të energjisë	11.4%	6.6%	4.9%	7.4%
Pjesëmarrja e EE nga PP në konsumin final të energjisë	0	0.05%	0.08%	0.23%

Është me rëndësi të cekim se në periudhën referuese 2010-2013, pjesëmarrja e energjisë nga burime të ripërtëritshme prej 17.2% në vitin 2013 e përbën pjesëmarrjen më të madhe në konsumin final të energjisë pas pjesëmarrjes prej 21.5% në vitin 2010. Gjithashtu edhe pjesëmarrja e energjisë elektrike nga BRE prej 7.4% në vitin 2013 e përbën pjesëmarrjen më të madhe pas pjesëmarrjes prej 11.4% në vitin 2010. Kjo tregon se prodhimtaria e zmadhuar e energjisë elektrike nga BRE drejtpërdrejt ndikon në zmadhimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme dhe pjesëmarrjen e saj në konsumin

final të energjisë.

Përqindja e pjesëmarrjes së BRE në konsumin total final të energjisë në Republikën e Maqedonisë, në bazë të vlerave mesatare reale, do të rritet prej 13.8% në vitin 2005 deri në 21% në vitin 2020. Sipas procedurës së miratuar për llogaritjen e përqindjes së synuar të pjesëmarrjes së BRE në konsumin total final të energjisë në vitin 2020 për vendet anëtare të BE, përqindja e synuar për Maqedoninë do të jetë 21% (Ministria e Ekonomisë, 2010, 11). Nga kjo, del se Maqedonia ka nevojë për rritjen e pjesëmarrjes edhe për 3.8% krahasuar me vitin 2013. Me këtë do të përmbushë njërin nga objektivat e Tregut të brendshëm të BE-së, të cilat do të duhet të realizohen deri në vitin 2020.

Për arritjen e këtij objekti dhe njëherit edhe zhvillim të BRE në periudhën deri në vitin 2020, investimet e parashikuara totale vlerësohen në rreth 1.5 miliardë euro (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2010, 115). Të njëjtat do të realizohen me investim të kompanisë për prodhim të energjisë elektrike SHA ELEM (260 milion euro), me partneritet publiko-privat (670 milion euro), nga koncesionerët (480 milion euro) dhe nga investitor privat (30 milion euro).

Në të vërtetë, në vitin 2020 përqindje të pjesëmarrjes prej 21% do të përbën energjia nga BRE (6699 GWh) në krahasim me konsumin final të energjisë (31850 GWh), ndërsa përqindja e pjesëmarrjes së energjisë elektrike nga BRE (2889 GWh) në krahasim me konsumin final të energjisë (31850 GWh) do të përbën 9.07%. Sa i takon përqindjes së pjesëmarrjes së BRE në prodhimtarinë e energjisë elektrike në vitin 2020 do të përbën 24.7% (Ministria e Ekonomisë, 2010, 140).

Analiza krahasuese e tarifave të privileguara në Bashkimin Europian dhe në vendet fqinje

Në këtë pjesë, tarifat e privileguara për energji të ripërtëritshme në Republikën e Maqedonisë krahasohen kundrejt tarifave të privileguara që i ofrojnë: 1) shtetet anëtare të BE-së dhe 2) shtetet fqinje si Bullgaria, Greqia, Serbia, Kroacia dhe Bosna dhe Hercegovina. Bullgaria dhe Greqia si shtete anëtare të BE-së, janë të kyçura në të dy rastet. Pesë shtete anëtare të BE-së, gjegjësisht Belgjika, Finlanda, Malta, Romania dhe Suedia, nuk ofrojnë tarifa të privileguara për energji të ripërtëritshme dhe për atë shkak janë të çkyçura dhe nuk janë të marrura parasysh në mesataren për shtetet anëtare të BE-së. Dizajni dhe normat e tarifave të privileguara, në Republikën e Maqedonisë janë në përputhshmëri me praktikën në shtetet e Europës dhe të regjionit (Tabela 4).

Tabela 4. Krahasimi i tarifave të privileguara për energji të ripërtëritshme (€/kWh) (Ministria e ekonomisë, 2011, 24)

Vendi	Hidro centrale	Centrale të erës	Solare FV	Biomasa	Biogaz
Mesatarja për shtetet anëtare të BE-së	9,1	10,2	35,8	10,5	10,7
Mesatarja për regjionin	6,7	8,3	38,3	10,1	10,6
Republika e Maqedonisë	10,1	8,9	26,0 – 30,0	9,0 – 11,0	13,0 – 15,0

Krejt me qëllim stimulimin e shfrytëzimit dhe investimit në zhvillimin e BRE, nga buxheti i Republikës së Maqedonisë do të ndahen mjete në vlerë të përgjithshme prej 6.000.000,00 denarë të cilat do të shfrytëzohen për kompensim të një pjese të shpenzimeve për sisteme kolektore diellore termike të blera dhe të instaluar tek familjet deri në 30%, por jo më shumë se 300 euro në kundërvlerë me denarë për familje për vitin 2014 (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2014, 30).

Analiza e tarifave të privileguara në Republikën e Maqedonisë

Sa u takon tarifave të privileguara të njëjtat kanë rëndësi të veçantë në stimulimin dhe nxitjen e investitorve të ndryshëm dhe paraqesin mjetin më efektiv për promovim të zhvillimit të teknologjive për energji të ripërtëritshme. Për këtë arsye, Republika e Maqedonisë u obligua të shfrytëzojë tarifa të privileguara krejt me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara në strategjinë e qeverisë për pjesëmarrje të energjisë së ripërtëritshme në prodhimtarinë e energjisë elektrike, e me atë edhe në

konsumin final të energjisë, që është edhe synimi parësorë i tarifave të privileguara.

Nga tabela 5 mund qartë të shihet se tarifat e privileguara për hidrocentrale në vitin 2013 kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me vitin 2011. E njëjta vërehet edhe tek centralet e erës, ndërsa tek centralet fotovoltaike kemi zvogëlim të dyfishtë të tarifave të privileguara. Por, nga ana tjetër, tek termocentralet e biomasës dhe biogazit kemi zmadhim të tarifave të privileguara. Tek të njëjtat në vitin 2013 kemi nga një tarifë të privileguar, në krahasim me vitin 2011 ku ka nga dy tarifa të privileguara. Blerja e energjisë së prodhuar elektrike nga prodhues të privilegjuar të energjisë elektrike me tarifa të privileguara ka ndikim në çmimin e energjisë elektrike të të gjithë konsumatorëve, sepse të njëjtit i kompenzojnë shpenzimet që janë rezultat i tarifave të privileguara, përmes çmimit mesatar të shitjes së energjisë elektrike për furnizim me energji elektrike.

Tabela 5. Tarifat e privileguara për centralet elektrike (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2011, 8-11; KRRE në RM, 2014)

Viti i sjelljes së vendimit	Fuqia e instaluar e centralit elektrik	Tarifa e privileguar (€/kWh)	Kohëzgjatja e tarifës së privileguar
Tarifa të privileguara për hidrocentrale			
2011	≤85.000 (kWh)	12	20 vjet
	> 85.000 dhe ≤170.000 (kWh)	8	
	> 170.000 dhe ≤350.000 (kWh)	6	
2013	> 350.000 dhe ≤7000.000 (kWh)	5	
	> 700.000 (kWh)	4.5	
Tarifa të privileguara për centrale fotovoltaike			
2011	≤50 (kW)	30	15 vjet
	> 50 (kW)	26	
2013	≤50 (kW)	16	
	> 50 (kW)	12	
Tarifa të privileguara për centrale të erës			
2011	≤50000 (kW)	8.9	20 vjet
2013	≤50000 (kW)		
Tarifa të privileguara për termocentrale të biomasës			
2011	≤1000 (kW)	11	15 vjet
	> 1000 (kW)	9	
2013	≤3000 (kW)	15	
Tarifa të privileguara për termocentrale të biogazit			
2011	≤500 (kW)	15	15 vjet
	> 500 (kW)	13	
2013		18	

Nga kjo, vlerësohet se në vitin 2015 tarifat e tashme të privileguara që aplikohen për nivelet e synuara të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme do të rezultojnë në zmadhim të tarifave për energji elektrike për shfrytëzuesit përfundimtarë në kornizat prej 1.2 deri në 2.8% për konsumatorët që janë të kyçur në sistemin shpërndarës (për konsumatorët familjarë) dhe nga 1.6 deri në 3.9% për konsumatorët që janë të kyçur direkt në sistemin transmetues, (për konsumatorët e mëdhenjë industrial). Kjo është ekuivalente me zmadhimin prej 0.36 deri në 0.65 euro në faturen mujore për energji elektrike të një familje tipike në vitin 2015 (Ministria e ekonomisë, 2011, 6).

Konkluzione

Nga përpunimi i detajuar dhe praktik i të dhënave të selektuara i bërë në punim, si dhe nga analiza e të dhënave dhe treguesit ekonomik, në lidhje me rëndësinë dhe ndikimin e BRE si dhe shfrytëzimin e tarifave të privilegjuara, mund të konstatojmë si vijon:

Neto prodhimitaria e energjisë elektrike nga BRE në BE-28 në periudhën 2002 dhe 2012 u zmadhua nga 13.0% në 20.5% (Eurostat, 2014). Respektivisht, u zmadhua edhe energjia nga burime të ripërtëritshme dhe pjesëmarrja e saj në konsumin final të energjisë dhe atë prej 12.5% në vitin 2010 në 14.1% në vitin 2012.

Shfrytëzimi i të gjitha burimeve të mundshme për investim në zhvillimin e BRE, krejt me qëllim përmirësimin e rezultateve në sektorin për prodhim të energjisë elektrike në veçanti dhe zhvillimin e sistemit elektroenergetik në përgjithësi, dhe njëherit zvogëlimin e varshmërisë importuese të vendit nga energjia elektrike dhe të deficitit tregtar. Krejt kjo së bashku, drejtpërdrejtë do të kontribuojë për zhvillim të ekonomisë vendore dhe në përgjithësi stabilitet makroekonomik të vendit.

Në kontekst të investimit në zhvillimin e BRE, Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet edhe në të ardhmen të vazhdojë me subvencionet për kolektorë solar.

Me pjesëmarrjen e zmadhuar të BRE në prodhimtarinë e energjisë elektrike, e me atë edhe në konsumin final të energjisë, Republika e Maqedonisë edhe pse s'ka obligime të kuantifikuara, do të japë kontribut të madh në përpjekjen globale për zvogëlimin e emisionit të gazrave ndotës dhe si vend kandidat për anëtarim në BE do të jetë e kyçur në këto përpjekje dhe objektiva të BE-së.

Republika e Maqedonisë duhet të vazhdojë me plotësimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për themelim të bashkësisë energjetike dhe kanë të bëjnë me BRE, konkurrencën, mjedisin jetësor, efikasitetin energjetik, si dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike.

Tarifat e privilegjuara për energji të ripërtëritshme aplikohen në një pjesë relativisht të vogël të konsumit final të energjisë në vend, por ato mund të kenë efekt material në çmimet për energji elektrike për shfrytëzuesit përfundimtarë, por nga ana tjetër efektet e këtilla janë plotësisht të arsyeshme sepse ato janë për shkak të përfitimeve për mjedisin jetësor dhe shëndetin dhe në pritjen se ato do të jenë të eliminuara gjatë kohës ashtu siç do të zhvillohen metodat prodhuese dhe efikasiteti i teknologjive për energji të ripërtëritshme.

Literatura

- AE në RM. (2014). *Regjistri i centraleve elektrike për prodhim të EE nga BRE*. http://www.ea.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=679&Itemid=124&lang=mk
- Eurostat. (2014). *Electricity production, consumption and market overview*. http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php?title=Electricity_production,_consumption_and_market_overview&oldid=182358
- Eurostat. (2014). *Share of energy from renewable sources*. Retrieved October 2014, from http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=nrg_ind_335a&lang=en
- KRRE në RM. (2014). *Çmimi - Burimet e ripërtëritshme*. Retrieved October 2014, from <http://www.erc.org.mk/pages.aspx?id=157>
- Mepso. (2014). *Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme*. Retrieved October 2014, from <http://mepso.com.mk/Details.aspx?categoryID=227>
- Ministria e ekonomisë. (2011). *Analiza krahasuese e tarifave të privilegjuara për energji të ripërtëritshme*. Shkup.
- Ministria e ekonomisë. (2010). *Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri më 2030*. Shkup.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë. (2013). Bilanci energjetik i Republikës së Maqedonisë për periudhën prej vitit 2014 deri më vitin 2018. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.185, 48-74*.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë. (2011). Dekreti mbi tarifat e privilegjuara për energji elektrike. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.176, 8-11*.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë. (2014). Programi për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për sisteme kolektore diellore termike të blera dhe të instaluar tek familjet për vitin 2014. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.7, 30-32*.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë. (2010). *Strategjia për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Republikën e Maqedonisë deri më 2020*. Shkup.
- SHA ELEM. (2012). *Plani i investimeve 2012-2017*. Shkup.

Pasojat e krizës financiare dhe recesionit global në ekonominë shqiptare

Prof.In. Alqi NAQELLARI
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Prof.Dr. Greta ANGJELI
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Msc. Vladimir MICI
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Abstrakt

Recesioni global u shfaq me karakteristikat e tij në mes të vitit 2008. Ai u parapri me krizën financiare që filloi në Europë, vijoi në USA dhe më vonë thaujse në të gjithë Lindjen e Lartë. Këto fenomene ndikuan direkt dhe indirekt në ekonominë botërore e për pasojë edhe në ekonominë shqiptare. Ky ndikim u pasqyrua thaujse në të gjithë treguesit makroekonomikë, monetar, fiskal, social etj. Kështu pas vitit 2008 e në vazhdimësi, në ekonominë shqiptare, kemi rënje të ritmit të rritjes ekonomike, mos ulje të normës së papunësisë, rënje të normës së inflacionit, thellim të borxhit publik, mospërmirësim të treguesve të Bilancit të Pagesave, përkeqësim të treguesve monetarë, etj. Në këtë material do analizohen pasojat e recesionit dhe të krizës globale në ekonominë shqiptare. Analiza do realizohet nën prizmin e dhënjes së përgjigjes të pyetjes. Në kushtet e recesionit dhe krizës globale në përkeqësimin e treguesve makroekonomik a kishte ndikim modeli ekonomik-financiar shqiptar i zbatuar dhe që vazhdon ende të zbatohet apo ishte thjesht ndikimi tërësisht i jashtëm? Konkluzioni është se krahas ndikimit të faktorëve të përmenduar më sipër, një nga faktorët kryesorë që ndikoi në rënjen e ekonomisë shqiptare ishte edhe modeli ekonomik-financiar i zbatuar në Shqipëri. Gjykohet se modeli ekonomik-financiar i zgjedhur është ajo ai i duhuri. Shqipërisë i nevojitet një model tjetër ekonomik-financiar ku të vlerësohet si duhet prona shtetërore mbi pasuritë kombëtare, në aspektin ekonomik, dhe Bursa në aspektin e modelit financiar. Në material rekomandohet që të rishtetëzohen sektorët strategjikë të ekonomisë, të krijohet institucioni i Bursës nga kapitali shtetëror, të shmangët përdorimi i valutës nga depozitat dhe kreditë si dhe të vlerësohet më shumë faktori njerëzor i brendshëm. Metodatat e perdorura janë ajo e përshkrimit, krahasimit, analizës dhe sintezës, metoda statistikore etj.

Fjalë kyçe. recesion, krizë financiare, rritje ekonomike, papunësi, inflacion

Hyrje

Ekonomia shqiptare në vitin 1990 filloi transformimin e saj, kthimin nga një ekonomi që bazohej tërësisht në pronën shtetërore mbi mjetet e prodhimit në një ekonomi që bazohej në pronën private mbi mjetet e prodhimit. Ky transformim që i thellë dhe i gjithëanshëm sepse përfshiu të gjitha degët dhe sektorët e ekonomisë, që nga pronësia mbi tokën e deri në sistemin financiar. Në këtë material ne do të analizojmë modelin ekonomik dhe atë financiar të lidhur me pasojat që dha kriza financiare dhe recesioni global në ekonominë shqiptare në vitet 2008 e në vijim. Këtë do ta bëjmë sepse pasojat në ekonominë shqiptare nuk janë thjesht pasoja të faktorëve të jashtëm por janë edhe pasoja të modelit të zgjedhur të organizimit të kësaj ekonomie. Kjo e dyta sipas analizave del që ka qenë një faktor më i rëndësishëm sesa faktori i huaj, prandaj propozohet përmirësimi i modelit ekonomik e financiar në mënyrë që edhe ekonomia shqiptare të arrijë të jetë një ekonomi e tipit europian.

Modeli ekonomik shqiptar pas viteve 90

Modeli ekonomik që u zgjodh të zbatohet në Shqipëri pas vitit 1990 u hartua dhe u zbatua nga qeveritë shqiptare të asaj periudhe me ndihmë të institucioneve financiare ndërkombëtare si BB, FMN etj. Ky model presupozonte një privatizim total të ish ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese krahas privatizimit të tokës dhe të banesave. Në model nuk u morën parasysh eksperiencat e vendeve të tjera për të ndërtuar një ekonomi mikse por u kalua në ekstrem duke kaluar në privatizimin total, që nga bankat dhe deri te ndërmarrjet strategjike si industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, minierat e kromit, bakrit, hidrocentralet e vegjël, etj, etj. Pasojat e këtij privatizimi janë dështimi i

KESH-it, i Albpetrolit dhe Armos, mosmirëmbajtja e minierave ekzistuese nëpërmjet investimeve dhe shkatërimi i tyre, shfrytëzimi i investimeve ekzistuese në kërkimet e naftës, shfrytëzimi me metoda të egra i burimeve egzistuese dhe dëmtimi i ambientit, marrja e rentave tepër të ulta nga këta sektorë, dhënja me koncesion e aeroportit të Rinasit, e hidrocentraleve, minierave, dhënja e monopoleve të pullave fiskale, ngjyrosësit të naftës, skanerit të doganave, kontrollit të automjeteve, llotarisë kombëtare etj, etj. Gjithë këto veprime i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomisë shqiptare. Vlerësimi i faktorit të huaj ka bërë që një pjesë e tenderave të ndërtimit të rrugëve ti fitojnë kompanitë e huaja duke bërë që të largohen nga Shqipëria me miliarda euro në një kohë që këto rrugë janë ndërtuar nga kompanitë shqiptare si nënkontratorë.

Modeli ekonomik tregoi se ishte një model i dështuar sepse nuk stimuloi ringritjen e ndërmarrjeve ekzistuese dhe krijimin e ndërmarrjeve të reja të mbështetur në faktorët ekonomik vendas. Ai është kryesisht një model konsumi i mbështetur në IHD-të, remitancat, shitjet e pasurisë shtetërore etj.

Modeli financiar i ekonomisë shqiptare pas viteve 90

Shqipëria trashëgoi nga sistemi i centralizuar një sistem bankar një nivelor dhe tërësisht me kapital shtetëror. Ky sistem u bë pengesë në zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë të cilët ishin futur në rrugën e privatizimit. Ndryshimi i sistemit financiar filloi pas vitit 1990. Në fund të vitit 1990, ndërrimi i sistemit politik në Shqipëri do të pasqyronte ndryshime thelbësore, një prej të cilve ishte kalimi i sistemit bankar nga një nivelor në një sistem dynivelor. Për pasojë, në 22 prill 1992, u krijua Banka e Shqipërisë nëpërmjet miratimit të ligjit nr.7559, "Për Bankën e Shqipërisë", i cili u rishikua më vonë sipas modeleve të vendeve perëndimore e rekomandimeve të organizmave ndërkombëtare¹. Filloi edhe ristrukturimi i nivelit të dytë nëpërmjet privatizimit të bankave ekzistuese dhe futjes së bankave me kapital të huaj.

Sot në Shqipëri kemi një sistem financiar bankar dhe jo bankar funksional. Në tregun financiar kemi Bankën Qëndrore, të nivelit të parë si dhe funksionojnë 16 banka të nivelit të dytë ose tregtare, 21 subjekte financiare jo bankare, 2 unione të kursim kreditit, 333 zyra të këmbimit valutor, shoqëri të kursim-kreditit 126, shoqëri sigurimesh 11 dhe fonde të pensioneve 3.² Pas 1990 funksiononin dy banka të nivelit të dytë Banka Kombëtare Tregëtare dhe Banka Tregëtare Agrare si dhe një agjensi kursimesh më vonë u kthye në Bankën e Kursimeve. Të dyja ishin tërësisht me kapital shtetëror. Në vitet në vijim u miratuan një sërë ligjesh dhe akte nën ligjore për futjen e kapitalit privat edhe në këtë sektor si dhe të fillonte procesi i privatizimit si në të gjithë sektorët e tjerë.

U synua për krijimin e një sistemi bankar efektiv:

Së pari, që të mund të thithte normalisht kursimet e popullatës dhe subjekteve të tjera ekonomike.

Së dyti, ti shpërndante këto kursime në destinacione kthim të sigurtë duke parë me precedencë sektorin e biznesit.

Së treti, të mund të siguronte kushte dhe mjete të nevojshme për kontrollin e funksionimit të tregut të kapitaleve.

Nëse u punua mirë në drejtim të sektorit financiar bankar, në format e tjera të organizimit të sistemit financiar nuk u punua si duhet. Tregu i sigurimeve, tregu i pensioneve, tregu i letrave me vlerë, ose bursa mbetën në hije dhe filluan të zhvillohen mjaftë vonë. Në Shqipëri edhe sot nuk ekziston Bursa. Teorikisht njihen dy modele të sistemit financiar³.

Modeli parë- predominon sistemi bankar.

Modeli i dytë- predominon tregu i kapitaleve. Në Shqipëri ashtu si edhe në shumë vende të Europës Lindore predominon modeli i parë, predominojnë Bankat ndërsa tregu i kapitaleve është pak i zhvilluar. Kjo edhe për faktin se në këtë fushë nuk kishte ndonjë eksperiencë konkrete nga sistemi i kaluar dhe në këtë mënyrë gjithë vëmëndja u përqëndrua në sektorin bankar. Modeli i dytë është karakteristik për vendet e zhvilluara perëndimore ku bursa është një nga furnizueset kryesore të ekonomisë me likuiditete, ndërsa bankat vijnë në vendin e dytë. Kjo ishte një arritje në atë periudhë

¹Banka e Shqipërisë. Faqja e Bankës së Shqipërisë

²Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2013, 62

³(Naqellari & Rushani, 2013,3-4)

kohe në mënyrë që edhe sistemi i privatizimit të sistemit bankar, krijimi i marrëdhënieve të reja në këtë sektor të mos mbetet mbrapa sektorëve të tjerë të prodhimit dhe të shërbimeve. Por këtu siç tregoi koha kemi katër difekte.

E para, që nuk u la asnjë Bankë Tregtare me kapital tërësisht shtetëror.

E dyta, që valuta, euro dhe dollari u pranuan si para zyrtare duke funksionuar në tregun e depozitave dhe kredive.

E treta, që kursi i këmbimit nuk u mbajt fiks dhe valuta të bëhej monopol i Bankës Qëndrore.

E katërta, që nuk u punua në drejtim të sektorit të tregjeve të kapitalave, në drejtim të bursave. Këto mangësi kanë sjellë edhe pasojat e tyre shumë negative në ecurinë e ekonomisë shqiptare. Treguesit që masin performancën e këtyre segmenteve janë: numri bankave, vlera e aktiveve që zënë aktivet e bankave të huaja në totalin e aktiveve gjithsej, vlera e kredive të sektorit privat, huatë e këqia ndaj totalit të huave të dhëna si dhe aksionet në përqindje ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Pas 20 vitesh shihet që në Shqipëri, duke përjashtuar Credinsin, thuajse të gjitha bankat janë me kapital të huaj dhe aktivet e tyre zënë pjesën më të madhe ndaj aktiveve gjithsej të sektorit bankar.

= Vlera e kredisë për sektorin privat është rritur por në një përqindje të ulët si ndaj PBB ashtu edhe ndaj totalit të kursimeve.

= Huatë e këqia prej 2008 që kanë qënë 1.5% ndaj totalit në 2014 zënë rreth 25% të totalit të kredive duke u bërë një shqetësim për ekonominë.

= Të vetmet instrumente financiare përfaqësuese të tregut të kapitaleve në Shqipëri janë Bonot e Thesarit, letrat me vlerë të borxhit të qeverisë shqiptare. Në Bursën e Tiranës nuk ka asnjë kompani të ketë listuar kapitalet e saj. Në këtë mënyrë i vetmi burim ushqimi për ekonominë mbeten bankat, ato kanë luajtur dhe luajnë rolin kryesor në rritjen dhe stabilitetin e ekonomisë shqiptare. Aktivet e bankave përbëjnë mbi 90% të aktiveve të tregut financiar dhe 60% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

= Qarkullimi i lirë i valutës ka bërë që të humbasi efekti i transmisionit të politikave monetare⁴. Banka Qëndrore e ka humbur rolin dhe rëndësinë e saj në kontrollin e plotë të tregut monetar. Ajo kontrollon vetëm lekun ndërsa valutat varen nga normat bazë të interesit të BQE-së dhe Fed-it Amerikan. Rreth 60% e kredive janë në valutë dhe vetëm rreth 40% në lekë, nga afro 50/50% që janë depozitat në lekë dhe valutë. Një pjesë e mirë e depozitave në lekë kalojnë në blerjen e Bonove të thesarit. Kjo është edhe arsyeja qënore e tyre ka rënë në 2%. Një pjesë e depozitave në valutë kalojnë jashtë vendit duke rritur presionin e zhvlerësimit të lekut.

Pasojat e recesionit global dhe të krizës financiare në dinamikën e treguesve kryesorë makroekonomik në periudhën e recesionit 2008-2013.

Kriza financiare dhe recesioni global filluan të transmetojnë efektet negative të tyre në ekonominë shqiptare që në vitin 2008 e në vijim. Kjo ka bërë që krahas faktorëve të tjerë të kemi një përkeqësim të përgjithshëm të treguesve ekonomiko-financiarë. Me poshtë kemi paraqitur një tabelë me disa nga treguesit kryesorë ekonomikë e financiar për vitet 2008-2013.

Tabela Nr. 1 Dinamika e disa treguesve kryesorë ekonomikë 2008-2013

Nr	Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013
1	IHD ml Euro	2,061.15	2,261.44	2,435.97	3,399.90		2,854.19
2	Remitanca ml Euro	833	781.3	689.8	664.5	675.3	543.8
3	Inflacioni %	2.2	3.5	3.6	1.7	2.4	1.9
4	Papunësia %	12.5	13.8	14.2	14.3	13.9	16.1
5	Rritja ekonomike %	7.5	3.4	3.7	2.5	1.6	0.4
6	Borxhi brendshëm mld lekë	400.5	415.0	407.4	438.6	470.4	520.8
7	Borxhi jashtëm mld lekë	195.4	267.5	308.0	333.9	357.6	363.9
8	Deficiti llog.korente. mLE	-1,381.2	-1,329.8	-1,018.6	-1,225.2	-978.0	-1,035.1

⁴(Naqellari, Hoti & Shaqiri, 2013, 27-40)

9	Kursi kembimit Leke/euro	122.8	132.1	137.8	140.3	139.0	140.3
10	Norma e Marrëveshjes së riblerjes njëjavore REPO, %	6.25	5.25	5	4.75	4	3
11	Rezervat në muaj importe	4.0	4.2	4.8	4.4	4.7	4.7
12	Depozita, mld lekë	619.9	662.4	785.2	875.2	930.7	950.1
13	Kredi, mld lekë	396.3	440.4	483.1	541.9	554.7	547.9
14	Të ardhura buxhetore mld lekë	291.2	299.0	324.7	330.5	330.4	327.2
15	Shpenzime buxhetore mld lekë	351.5	379.9	362.8	376.3	376.2	394.1
16	Deficiti buxhetor mld lekë	-60.3	-80.9	-38.0	-45.8	-45.9	-66.9
17	Hua standarte në % ndaj to- talit	88.31	81.74	79.44	73.61	68.91	68.8(66.9)
18	Hua të humbura në % ndaj totalit	1.23	2.7	3.98	5.67	7.7	11.45(12.28)
19	Raporti efikasitetit %	69.63	91.29	75.5	91.29	84.43	74.69(65.97)

Burimi të dhënave⁵.

Në këto vite që ekonomia shqiptare u përball me recesionin kemi një përqendrim të treguesve ekonomikë. Ranë ritmet e rritjes ekonomike. U rrit norma e papunësisë. Ranë ritmet e rritjes së të ardhurave buxhetore. Ra përqindja e investimeve në strukturën e shpenzimeve buxhetore. U rrit borxhi publik në përqindje ndaj PBB. U rrit borxhi publik i jashtëm në përqindje ndaj PBB. U thellua deficiti llogarisë korente. U ulën investimet e huaja direkte (IHD).

Vendet që nuk kanë bursa siç është Shqipëria janë të destinuara të mbeten pengje të bankave. Vini re nëse do kishim Bursë në Tiranë gjithë paratë e emigrantëve shqiptarë do kishin kaluar atje dhe nuk do shkonin në banka. Do kishim rishpërndarje dhe një shoqërim efektiv të kapitalit. Në bursë do ishin më eficientë si në rritjen ekonomike të ndërmarrjeve, në shoqërimin e kapitalit dhe në rishpërndarje të të mirave.

Mungesa e një burse që është tipike për Shqipërinë sepse të tilla ka në të gjithë vendet e Ballkanit krijon premisat për korupsion kur bëjmë fjalë për privatizimin e pronës publike. Në Bursë nuk ka miq dhe shokë për të favorizuar në procesin e privatizimit, fenomen ky që në Shqipëri ka qënë dhe është i dukshëm.

Kapitalizmi perëndimor nuk mund të konceptohet dot pa bursa. Roli i tyre shkon në përputhje të plotë me rolin e bankave, dhe kjo sepse bankat në perëndim nuk janë si bankat në Shqipëri sepse në perëndim egziston kapitali financiar dhe në këtë mënyrë bankat janë të lidhura me ndërmarrjet prodhuese në mënyrë integrale, të brendshme ku secila si banka ashtu dhe biznesi kanë përfaqësuesit e tyre të njëri tjetri dhe banka i shërben biznesit jo vetëm për të qarkulluar keshin por edhe si një menaxher dhe këshilltar i mirë i saj. Ajo e drejton biznesin dhe koordinon atë me njëri tjetrin.

Në Shqipëri nuk kemi fenomene të tilla sepse Bankat janë të shkëputura prej biznesit. Nëse një bankë falimenton nuk falimentojnë bizneset por ata që kanë depozitat e tyre në këtë bankë, apo nëse falimenton një biznes banka rezikon kreditë e pa kthyer dhe nuk ka probleme të tjera të brendshme. Këto janë dallime thelbësore midis sistemit financiar perëndimor dhe atij shqiptar.

Ishte pikërisht: mungesa e kapitalit financiar, mungesa e bursës, kreditë e pakta të dhëna, siguria e kredive e mbështetur me kolateral, efienca e shpërndarjes së importeve dhe eksporteve në qindra vende, lidhja e dobët e Shqipërisë me perëndimin, përdorimi i euros dhe dollarit si para ligjore në

⁵(Banka e Shqipërisë. Raporte Statistike, nëntor 2009, gusht 2010, dhjetor 2011, gusht 2014, 5, 14, 16, 17, 22, 28, 33, 34, 37, 38, 41, 43)

të gjitha tregjet shqiptare, dhe të tjerë faktorë bën që recesioni të mos ndjehej shumë në Shqipëri. Në Shqipëri ndër burimet kryesore të mbulimit të deficitit tregëtar janë dërgesat e emigrantëve që kanë shkuar mesatarisht 700 milionë euro në vit, ndërsa një nga burimet kryesore të mbulimit të deficitit buxhetor kanë qënë lekët dhe valuta e siguruar prej privatizimit të objekteve shtetërore. Shterimi i këtyre dy burimeve do të tregonte për saktësinë e reformave, modelit ekonomik dhe sistemit financiar që janë aplikur në Shqipëri pas vitit 1990.

Objekte shtetërore kanë mbetur shumë pak, vetëm hidrocentralet e mëdhenj sepse të gjithë të tjerët janë privatizuar. Një pjesë e emigrantëve po kthehet në Shqipëri ndërsa një pjesë e mirë e tyre janë stabilizuar në vendet ku janë vendosur. Kështu në një të ardhme jo të largët burimi i privatizimeve do jetë zero ndërsa burimi i dytë do rrudhet dukshëm dhe do jetë pa peshë. Në këtë periudhë do të shikohet efienca e atyre privatizimeve që janë bërë jo të menduara dhe të nxituara, shpejt e shpejt për të hequr qafe pronën shtetërore dhe pa parë se çfarë marrëdhënie do krijoheshin dhe se çfarë perspektive do ti krijohej ekonomisë shqiptare

Si duhet të jetë ekonomia shqiptare në të ardhmen?

Suksesi i modelit kërkon që zhvillimi ekonomik të ndikoj nëpërmirësimin e nivelit të zhvillimit social në vend. Për këtë duhet që modeli të mbështetet në disa prioritetë të politikave ekonomike, në transformime, në stabilitetin makroekonomik si dhe në një politikë dhe strategji afatgjatë.

Për të arritur modelin e kërkuar kërkohen ndryshime strukturore si garanci për suksesin e tij. Kur flasim për ndryshime strukturore nënkuptojmë strukturën e degëve të ekonomisë, cilat degë do të jenë prioritare që do mbështetet ekonomia dhe cilat do të jenë degë ndihmëse e plotësuese. Gjykohet se duhen vlerësuar në mënyrë prioritare tre faktorë kryesorë: administratë e kualifikuar, bursa e Tiranës dhe pasuritë mbi e nëntokësore.

Ekonomia shqiptare duhet të mbështetet në katër degë kryesore⁶.

I. Industri: -Industria nxjerrëse dhe përpunuese e mineraleve- Industria energjitike- Industria e naftës II. Bujqësi: -Bimët e arrave- Pemtari -Olivikulturë -Hortikulturë

III. Shërbime: -Turizëm, -Transport, -Posta- Telekomunikim dhe IV. Ndërtim.

I. Industria. Industria minerare ka filluar të ringrihet por akoma është në nivele të ulta në krahasim me mundësitë e mëdha që ka. Në këtë sektor vihen re një sërë mangësish të ardhura nga privatizimi i minierave. Në Shqipëri ka miniera të kromit, bakrit, hekurit, nikelit të boksideve etj, ndërsa nuk shfrytëzohet asnjë minierë qymyrgurore. Këto miniera janë privatizuar të gjitha dhe nuk ka asnjë me kapital shtetëror.

2- Industria energjitike dhe e naftës. E para në fushën hidro është më e konsoliduar ndërsa në fushën e Teceve ka akoma probleme. Duhet të frenohet privatizimi i Hidrocentraleve dhe nëse është bërë një veprim i tillë të anulohet. Duhet të shpejtohet ndërtimi i hidrocentraleve në proces në të kundërt tu anulohet licensa firmave kontratore.

Në fushën e karburanteve duhet një rishikim i të gjitha politikave të zbatuara deri tani, duhet të ruhet pronësia shtetërore në një sërë fusha të këtij sektori jetik për ekonominë tonë. Nëpërmjet tij duhet të bëhet edhe një politikë e kujdesëshme punësimi.

II. Bujqësia. Bujqësia shqiptare mbështetet përgjithësisht në bimët e arave, blegtori, vreshtari, hortikulturë, vitikulturë dhe akuakulturë. Të gjitha i përkasin sektorit privat. Cilat janë disa nga mungesat në prodhimin bujqësor? Në Shqipëri nuk ka Bankë Shtetërore Bujqësore, në Ministrinë e Bujqësisë nuk ka një drejtori të mekanikës bujqësore, mungojnë format e kooperimit të tipit të kooperativave bujqësore mbi bazë të pronës private mbi token, shoqatat e fermerëve, mungon shfrytëzimi i plotë i sipërfaqes së tokës me kultura bujqësore, etj.

Nëpërmjet zbatimit të politikave të posame për bujqësinë mund të arrihen⁷: rritja ekonomike, reduktimi i varfërisë, ngushtimi i pabarazise në të ardhura, ofrimi i sigurisë ushqimore, ofrimi i shërbimeve ndaj mjedisit, rënie e nivelit të çmimeve etj. Kjo është sfida kryesore dhe mundësia që i përket një modeli të ri ekonomik.

III. Shërbimet. Në fushën e shërbimeve duhet të marret parasysh që të ketë: shumëllojshmëri

⁶(Naqellari, Maliqi & Naqellari, 2012, 158- 162, 465, 475- 478)

⁷(MBU, 2007, XIV-XIX)

shërbimesh, transporti, tregtie, telekomunikimi, postare, financiare, bankare dhe jo bankare. Duhet të synohet që brenda 10 vjetëve Shqipëria mund të shndërohet në një qendër financiare të rëndësishme ballkanike edhe nëpërmjet çeljes së Bursës së Tiranës, themelimit të një Banke Bujqësore të nivelit të dytë me filiale të saja në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, në Greqi dhe në Itali.

Konkluzione

Sistemi bankar shqiptar nuk u prek shumë prej recesionit global dhe krizës financiare për një sërë arsyesh ndër të cilat përmendim:

- Nuk janë vendosur dhe konsoliduar marrëdhëniet kapitaliste në prodhim.
- Kemi një sistem financiar të prapambetur ku mungon kapitali financiar. Në Shqipëri nuk ekziston tregu i kapitaleve, nuk ekziston bursa.Ndërmarjet nuk e kanë kapitalin e tyre të listuar në bursë. Bursa lëviz ndërmarrjet, lëviz prodhimin, bursa lëviz vetë bankat.Recesioni global në ekonominë shqiptare ka pasur ndikime negative por ka pasur edhe ndikime pozitive për arsyet e përmendura në këtë material që më së shumti e theksojmë për llogari të prapambetjes së tregjeve dhe të sistemit të pa zhvilluar financiar.
- Nuk kemi kompani të fuqishme që të kenë falimentuar dhe të ndikojnë në sistemin bankar, ose nuk kemi ndonjë bankë të falimentuar dhe kjo të ndikojë në rënien e aksioneve të ndonjë ekonomie të madhe.
- Nuk kemi tregje kapitalesh, tregje tokash dhe tregje banesash, pra në përgjithësi në Shqipëri mungojnë ato tregje që provokojnë recesion ose tronditje në një sistem financiar modern të tipit europiano-perëndimor.
- Nëse në Shqipëri nuk kemi një rritje dhe zhvillim ekonomik tërësor të shënuar, ashtu si shumë vende të tjera të ngjashme me Shqipërinë, kjo vjen si pasojë edhe e Modelit Ekonomik të zbatuar në ekonominë shqiptare, model i cili ka treguar se është bërë pengesë për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Rekomandime

- Të krijohet një administratë moderne në bazë të parimit të meritokracisë. Të rritet administrata në numër dhe në cilësi duke i dhënë lirinë përkatëse.
- Të krijohet dhe të vihet në funksionim Bursa e Tiranës.
- Të kalohet nga Sistemi Financiar Bankar që sot është sundues në ekonominë shqiptare në një Sistem Financiar Dual Bursë-Bankë ashtu sikundër e kanë edhe vendet e zhvilluara. Nisiatore për këtë duhet të bëhet qeveria e Shqipërisë.
- Qeveria duhet të rishtetëzohë sektorët strategjikë të dhëna me koncesion ose të privatizuara.
- Të evidentohen të gjitha pasuritë nën dhe mbitokësore të Shqipërisë që janë në shfrytëzim, mënyra e shfrytëzimit të tyre dhe perspektiva e tyre. Të kryhet shtetëzimi i sektorëve dhe minierave strategjike. Të reduktohet në maksimum numri i Kompanive të licensuara.
- Shfrytëzimi i minierave të bëhet i studjuar dhe jo në mënyrë amatoreske. Të zbatohet motoja shfrytëzo- investo.
- Qeveria duhet të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm në fushën e investimeve, financiare në atë të mbrojtjes në punë, trajtimin të punonjësve dhe të mbrojtjes së ambientit.
- Të dhënat të bëhen transparente nëpërmjet publikimeve periodike.
- Të shikohet mundësia e kooperimit me minierat e Kosovës për të krijuar kompani të përbashkëta, me kapital dhe shfrytëzim të përbashkët. Si burim i të ardhurave fillesatre të shikohet sigurimi i tyre në Bursën e Prishtinës nëpërmjet shitjes së aksioneve.

Literatura

1. Banka e Shqipërisë. Raporti Statistikor (Dhjetor 2011). Shqipëri.
2. Banka e Shqipërisë. Raporti Statistikor (Gusht 2010). Shqipëri.
3. Banka e Shqipërisë. Raporti Statistikor (Nëntor 2009). Shqipëri.
4. Banka e Shqipërisë. Raporti Statistikor. (Gusht 2014). Shqipëri.
5. Naqellari, A. Maliqi, R. & Naqellari, A.(2012). “Recesioni global dhe ndikimi i tij në ekonominë shqiptare”. Monografi. Shqipëri.
6. Naqellari, A. Hoti, A. &Shaqiri, J. (2013). “ALBANIAN ECONOMIC MODEL FACING THE GLOBAL RECESSION” .Itali
7. Naqellari, A & Rushani, G.(2013). “Financial system and its impact on the Albanian economy”. Ulqin
8. Ministria e Bujqësisë. Strategjia sektoriale e Bujqësisë dhe e ushqimit 2007-2013. Shqipëri.
9. Banka e Shqipërisë. Raport Vjetor 2013. Shqipëri.

The Minimum Wage as an Instrument of Judicial and Economic Policy

Ph.D Candidate Artan Çela
Albanian Power Corporation

Abstract

Nowadays, the minimum wage remains a powerful and effective tool in support of employees' protection, used in the majority of EU countries. Minimum wage may be understood to mean "the minimum sum payable to a worker for work performed or services rendered, within a given period, whether calculated on the basis of time or output, which may not be reduced either by individual or collective agreement, which is guaranteed by law and which may be fixed in such a way as to cover the minimum needs of the worker and his or her family, in the light of national economic and social conditions. Minimum wage rates have to take into account both the need of workers, their families and economic factors. It constitutes a combination of different elements of political, social, economic and legal in both developing and developed countries. Changes in minimum wage affect a sufficient number of employees, becoming a vital instrument that supports the nominal wage. This article is positioned theoretically among the knowledge of historical periods, procedures and criteria concerning minimum wage. As always in a debate between different theoretical approaches, the empirical results are mixed depending on the theory used as a basis for the research, including ILO convention, recommendations, and EU labor standards (Directives). Empirical investigations in a large number of EU countries and historical periods show that the minimum wage can affect poverty, inflation and employment. The article concludes by identifying the need for more field research on minimum wage implementation and provides a wide array of legal solutions.

Keywords: minimum wage, unemployment, wage, poverty, industrial relations, labor law.

Hyrje

Jeta e individëve, ashtu siç edhe e gjithë kombeve, është një udhëtim me synim drejt ideale. Çështja e pagës minimale pasqyron një aspekt të rëndësishëm të këtij udhëtimi të njerëzimit. Kjo e drejtë, që u është njohur punëmarrësve në emër të dinjitetit të njeriut, si diçka që është e nevojshme për jetesën e tij, quhet pagë e jetesës (Raynaud, 1913, 1). Paga minimale është një instrument i tregut të punës, i cili gjen zbatim në pjesën më të madhe të shteteve. Një numër prej 116 shtetesh anëtare kanë ratifikuar një ose të dyja Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me përcaktimin e pagës minimale. Shumë shtete të tjera, edhe pse nuk kanë ratifikuar Konventat përkatëse, kanë vendosur një procedurë për caktimin e një page minimale. Rëndësia e këtij institucioni qartësohet edhe më tepër kur merret në konsideratë numri i madh i ankimeve që merr ONP nga anëtarët e tij në lidhje me zbatimin e pagës minimale. Në pamje të parë, duket se është e lehtë të përcaktosh pagën minimale si bazën e të gjithë pagave, dhe njëkohësisht, garancinë, që ata të marrin një nivel minimum pagese mbrojtëse. Megjithatë, realiteti është shumë më kompleks. Arsyeja e këtij kompleksiteti mund të shpjegohet me vetë sistemin e pagës minimale, si dhe me procedurat dhe kriteret për caktimin e pagës minimale (Eyraud & Saget, 2005, 1). Idea e një page minimale nuk është absolutisht e re, përkundrazi, ajo shfaqet shumë herët, shumë shekuj më parë. Debatet në lidhje me një pagë të drejtë dhe të mjaftueshme për ti siguruar jetesën punëmarrësit shfaqet që në shek.XIII – XIV. Në këtë kohë doktrina në lidhje me pagën nuk ishte gjë tjetër veçse një zbatim i teorisë së çmimit të drejtë në kontrata. Në një kuptim të përgjithshëm, parimi kryesor i doktrinës së çmimit të drejtë, është që në të gjitha kontratat duhet të mbizotërojë parimi i propozimit dhe i kundërpropozimit. Në atë kohë, parimi i pagës minimale korrespondonte me nevojat e ekzistencës së punëmarrësit dhe nevojave të tij. Në atë kohë, kjo problematikë shtrohej si një çështje morale (Raynaud, 1913, 1). Legjislacioni i parë që parashikonte pagën minimale duhet kërkuar në Australi. Në provincën e Viktorias, në vitin 1886, u miratua i pari ligj që bënte një përcaktim në lidhje me pagën minimale (Andrews, 1919, 23).

Procedurat për përcaktimin e pagës minimale

Është e paevitueshme të evidentojmë që është vërtet kompleksë kuptimi i procedurave për përcaktimin e pagës minimale kombëtare. Kjo pasi, qartësisht këto sisteme janë rezultat i mënyrës në të cilën paga minimale është zbatuar dhe zhvilluar përgjatë kohës. Sidoqoftë, dy faktorë, të pavarur nga njëri tjetri kanë luajtur një rol jetësor në vendosjen dhe evolucionin e këtyre procedurave, duke hedhur njëkohësisht dritë mbi kompleksitetin e këtij sistemi. Këto faktorë, stadi i negociatave kolektive dhe përdorimi nga qeveritë të pagës minimale përcaktohen si një mjet për politika ekonomike. Duhet thënë që, kur negocimi kolektiv është më pak i zhvilluar, influenca e pagës minimale ligjore do të jetë më e fuqishme. Në të njëjtën mënyrë, përdorimi intensivë i pagës minimale nga qeveria, me qëllim realizimin e politikave të ndryshme ekonomike, në mënyrë të natyrshme do të zvogëlojë rolin e negociatave kolektive në lidhje me pagën. Tipet kryesore të procedurave të përcaktimit të pagës minimale janë :

Tarifa në nivel kombëtar ose rajonal, e vendosur nga organi tripalësh i shtetit. Kjo është metoda e përdorur më gjerësisht. Janë 68 shtetet të cila zbatojnë një tarifë page kombëtare ose rajonale. Ky sistem konsiderohet gjithashtu si më i drejti. Në shtetet që i përkasin kësaj kategorie, një tarifë page bazë, e njëjtë, është vendosur për të gjithë ekonominë ose rajonin, dhe një autoritet publik luan rolin drejtues, shpesh duke marr edhe vendimin përfundimtar. Kjo kategori ka dy nënkategori: shtetet të cilat zbatojnë një tarifë të vetme kombëtare, dhe ato të cilat zbatojnë tarifatat rajonale. Ekzistojnë një numër arsyesh të zbatimit të një tarife page minimale, të përcaktuara nga rajoni, ndër të cilat, më e rëndësishmja ka të bëjë me strukturën administrative dhe politike të vendit. Kjo metodë, zakonisht përdoret në sistemet federale, ku një shtet i vetëm ose rajon, ka një lloj autonomie. Një tjetër faktor i rëndësishëm në zbatimin e kësaj nënkategorie, lidhet me diferencën e standarteve të jetesës që ekzistojnë midis rajoneve, si shkak i të ardhurave që ato kanë pasur. Zbatimi i këtij sistemi ka edhe efektet e veta negative. Ndjekja e kësaj praktike, mund të jetë një faktor i cili kontribuon në shpopullimin e rajoneve më të pafavorizuara, duke bërë që popullsia e tyre të zhvendoset në rajonet e mbipopulluara në të cilat zbatohet një tarifë e pagës minimale me e lartë.

Tarifatat e shumëfishta të vendosura nga autoritetet publike. Fillimisht, duhet thënë që, kjo është metoda e dytë më e përdorur. Kështu sipas këtij sistemi, tarifatat e shumëfishta minimale përcaktohen nën autoritetin e qeverisë ose komitetit trepalësh në përputhje me sektorin dhe profesionin. Përgjithësisht ky sistem kombinohet me negocimin kolektiv për përcaktimin e minimumit të pagës, për sektorët që kanë një organizim të mirë të organizatave të punës. Natyra e përcaktimit të pagës minimale, fillon të ndryshojë kur fillon përdorimi i tarifave të ndryshme. Paga minimale e përcaktuar nga sektori, profesioni, ose edhe nga niveli hierarkik për çdo sektor, lidhen në mënyrë të drejtë me polikat aktuale të pagës të zbatuar nga çdo sipërmarrje. Në këtë kuptim, paga minimale lëviz nga thjesht sigurimi i një baze pagese për punëmarrësit më të rrezikuar, në influencimin ose edhe përcaktimin e politikave në lidhje me pagën në nivel sipërmarrje. Ky sistem më shumë se sa një rregullore minimale, është një metodë aktuale e përcaktimit të pagës. Në një kuptim më ekstrem, ky sistem bëhet një zëvendësues i negociatave kolektive. Ndryshimi midis një tarife të vetme dhe tarifave të shumëfishta mund të bëhet edhe duke u bazuar në mënyrat e ndryshme në të cilat pagat minimale janë përdorur nga shteti; për të mbrojtur punëmarrësit më të pambrojtur, ose të vendosjes së tarifave aktuale të pagës në sektore ose sipërmarrje. Evidentojmë që, shtetet të cilat zbatojnë një tarifë page minimale të shumëfishtë të vendosur nga një autoritet publik, mund të kenë gjithashtu një variacion rajonal ose kombëtar.

Tarifë unike kombëtare e vendosur nëpërmjet negocimit kolektiv. Janë të paktë ato shtete të cilët zbatojnë një tarifë të vetme kombëtare, të përcaktuar nëpërmjet negocimit kolektiv. Ashtu si në shtetet ku tarifa e vetme kombëtare përcaktohet nga qeveria, në këtë kategori tarifa e vetme kombëtare përcaktohet nga marrëveshjet e arritura në nivel sektori dhe sipërmarrje. Në të vërtetë, marrëveshjet e arritura nga negocimet kolektive në nivel sektori apo sipërmarrje, qendrojnë pas sistemit ligjor që lidhet me pagën minimale.

Tarifatat e shumëfishta të vendosura nëpërmjet negocimit kolektiv. Në shtetet pa një sistem të centralizuar për përcaktimin e pagës minimale, ky rol realizohet nga marrëveshjet sektoriale. Është pikërisht sistemi i marrëveshjeve kolektive që ndërton sistemin e përcaktimit të pagës minimale.

Ky model gjen zbatim në shtete të ndryshme europiane. Pyetja që ngrihet në këto raste është nëse kjo metodë përbën vërtet pagë minimale. Bazuar në Konventat e ILO-s, përgjigja do të jetë po. Kështu, konventat përcaktojnë që është rol i autoritetit kompetent dhe partnerëve social që përcaktojnë se cilët punëmarrës kërkojnë mbrojtje dhe si ti sigurohet kjo mbrojtje. Gjithashtu, edhe nga një pikëpamje ekonomike, përsëri përgjigja e kësaj pyetje do të ishte pozitive, pasi paga e cila përcaktohet nëpërmjet një marrëveshje kolektive, nuk mund të bjerë poshtë atyre niveleve minimale. Problematika që lidhet me aplikimin e këtij modeli, qendron tek faktin se edhe pse marrëveshjet kolektive përfshijnë një numër të madh punëmarrësish, përsëri do të këtë një numër të vogël punëmarrësish, të cilët nuk do jenë subjekt i marrëveshjeve kolektive, të cilët gjithashtu nuk do të mbulohen nga paga minimale. E vetmja mënyrë për të siguruar një mbulim sa më të gjërë, është që shteti nëpërmjet forcës së ligjit të zgjerojë zbatimin e marrëveshjeve kolektive të detyrueshme. Një tjetër problem në lidhje me këtë model ka të bëjë me faktin që një numër marrëveshjes kolektive vendosin paga shumë të ulta. Kjo lidhet kryesisht me mungesën e fuqisë së punëmarrësve për një negocim efektiv (Eyraud & Saget, 2005, 5-12).

Kriteret për përcaktimin e pagës minimale

Në shumë raste legjislacioni përcakton kriteret e ndryshme që duhen të merren parasysh nga autoritetet përgjegjëse për përcaktimin e pagës minimale. Këto kriteret mund të grupohen në dy kategori. Të parat, kanë më shumë një natyrë sociale dhe adresohen kryesisht tek nevojat kryesore të punëmarrësit, ndërsa të dytat, kanë një orientim më shumë ekonomike të fokusuar në orientimin ekonomik të shteteve. Në këtë pjesë, në mënyrë të shkurtër dhe përmbledhëse do të trajtojmë kriteret kryesore dhe më të zbatuara, të cilat merren parasysh në përcaktimin e pagës minimale. Kriteret më të përmendura janë inflacioni, kostoja e jetesës, të ndjekura nga kushtet e përgjithshme ekonomike dhe nivelit të pagave. Më pas gjenden nevojat e punëmarrësve, produktiviteti, tarifat e punësimit, dhe në fund, kapaciteti i sipërmarrjes për të paguar sigurimin e të mirave sociale. Megjithatë, duket se dy prej këtyre kriterëve, nevojat e punëmarrësit dhe kapaciteti i sipërmarrjes për të paguar, janë edhe kriteret bazë për përcaktimin e pagës minimale që prej funksionimit të pagës minimale. Në disa vende, nevojat e punëmarrësve dhe të familjeve të tyre vlerësohen si pjesë e kriterëve më frekvente se inflacioni dhe kostoja e jetesës. Kjo nënkupton që në shumë vende, paga minimale duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që niveli i inflacionit mos të ketë një efekt negative tek punëmarrësit. Nga ana tjetër, kapaciteti i sipërmarrjes për të paguar, duhet marrë gjithashtu në konsideratë kur përmenden produktiviteti dhe kushtet e përgjithshme ekonomike. Të dhënat e ILO-s tregojnë që, të njëjtat kriteret mund të përdoren në mënyra të ndryshme. Nëse legjislacioni i një shteti i lidh të ardhurat e pensionit ose pagesat e papunësisë me nivelin e pagës minimale, atëherë autoritetet duhet të marrin në konsideratë efektet që çdo rregullim i pagës minimale do të ketë në këto të ardhura. Është e rëndësishme që të sigurohet që, çdo vendim i marrë, të mos ketë ndikim negative në buxhetin e sigurimeve sociale. I njëjti rregull vlen edhe për inflacionin. Në Irlandë, autoriteti kompetent duhet të sigurohet që çdo rritje në nivelin e pagës minimale, nuk do të ketë një efekt përcaktues në inflacion.

Kriteri i politikës sociale, lidhet ngushtësisht me nevojat e punëmarrësve dhe familjeve të tyre, si dhe me koston e jetesës. Në fakt, paga minimale nuk është krijuar për të qënë një instrument i politikave në lidhje me pagën, fillimisht ajo ka qënë një mjet i krijuar për të mbrojtur punëmarrësit e pambrojtur. Një tjetër faktor i politikave sociale në lidhje me pagën minimale, është pabarazia e pagave. Nëse një rritje e pagave të ulta, nuk do të përputhej me një rritje e ngjashme tek pagat më të larta, atëherë hierarkia e pagave do të ngushtohet automatikisht. Të njëjtin efekt do të kishte edhe rritja e pagës minimale. Nga ana tjetër, paga minimale mund të luajë gjithashtu një rol aktiv në luftimin e pagave diskriminuese. Kështu, në mënyrë të padiskutuar ka më shumë femra sesa meshkuj në punët më pak të paguara. Kështu çdo rritje e pagës minimale do të kishte një efekt pozitiv tek ato, duke zvogëluar pabarazitë e pagave në favor të tyre.

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër, kriteret për përcaktimin e pagës minimale në të shumtën e rasteve kanë një natyrë ekonomike. Pagat, dhe në veçanti pagat minimale, janë njëkohësisht kosto dhe e ardhur. Kështu nga një këndvështrim ekonomik, paga minimale influencon në tre parametra

makroekonomikë: kërkesën, punësimin dhe inflacionin. Një rritje e pagës minimale në mënyrë të natyrshme do të nxiste kërkesën në dy mënyra. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë, nëpërmjet rritjes së pagave më të ulta, dhe në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet efektit që ajo do të kishte në të gjithë sistemin e hierarkisë së pagave nëpërmjet rritjes së pagave. Në këtë mënyrë, nëse kjo rritje nuk do të jetë inflacionare, paga minimale do të kishte një efekt pozitiv në zhvillim, i cili do të rezultojë në punësim më të lartë.

Në lidhje me efektet që ka paga minimale mbi nivelin e punësimit, miti që ekzistonte deri në vitin 1990, sipas së cilit pagat minimale krijojnë papunësi, u hodh poshtë nëpërmjet studimeve të cilat treguan se, paga minimale ka një efekt fare të vogël në punësim, ose ka një efekt pozitiv në vëndet e zhvilluara. Sidoqoftë, në praktikë, autoritetet tentojnë t'i konsiderojnë pagat minimale si një kosto prodhimi. Ky këndvështrim, inkurajon aspektet negative të pagës minimale duke rritur stresin tek punëmarrësit. Është e nevojshme të evidentojmë që, në shumë vende, paga minimale ka gjetur zbatim shumë përpara se punësimi dhe papunësia të bëhesh çështja më e madhe ekonomike dhe politike.

Për sa i përket pagës minimale dhe inflacioni duhet evidentuar se një pagë minimale rrit mbrojtjen e rrogëtarëve me paga të ulta nga inflacioni, por njëkohësisht nëpërmjet efektit të saj në pagat dhe deficitin publik, ajo rrezikon shpejtimin e spiralit inflacionar duke prekur koston e pagës dhe duke vendosur presion mbi kërkesën e përgjithshme. Kjo është pikërisht arsyeja pse qeveritë i kushtojnë një kujdes të madh këtij kriteri. Edhe pse në teori nuk duhet të ekzistojë një lidhje midis pagës minimale dhe hierarkisë së pagave, në praktikë, rritja e pagës minimale prek gjithë skemën e pagave. Kjo ndodh për shkak se paga minimale konsiderohet pika e referencës për të gjitha pagat. Pikërisht, ky efekt që paga minimale mund të ketë tek pagat, mund të shpjegojë rolin e saj si një metodë antiinflacion (Eyraud, 2005, 29-66).

Konkluzione

Nuk ka asgjë më të thjeshtë në pamje të parë, dhe asgjë më të vështirë dhe komplekse në realitet se sa problematika që shoqëron pagën minimale. Dhe sigurisht që, ndërthurja e elementëve të ndryshëm politikë, socialë, ekonomikë, ligjorë, nuk e bën më të thjeshtë këtë proces. Paga minimale ka qënë gjithmonë një temë e debatit për shkak të diferencave që ekzistojnë në pikpamjet e ndryshme politike dhe ekonomike. Megjithatë, përveç këtyre debateve, një sërë përfundimesh të rëndësishme mund të derivojnë nga analiza e këtij punimi. Ky punim përfaqëson një përpjekje për t'iu afruar konceptit të pagës minimale, nëpërmjet njohjes të procedurave, kriterëve teorike në përcaktimin e pagës minimale si dhe, të lidhjes dhe ndikimit që ekziston midis pagës minimale, punësimit dhe inflacionit. Paga minimale, para së gjithash duhet të kuptohet si një mjet mbrojtës në krah të punëmarrësve më të pambrojtur dhe familjeve të tyre, duke i siguruar atyre standartet e jetesës. Kjo përbën edhe objektivën kryesore të pagës minimale. Por, sigurisht që, paga minimale nuk është vetëm kaq, ajo ishte dhe është, etaloni matës për të gjithë hierarkinë e pagave të një vendi. Ky fakt bën që askush, as ata individë, të cilët përfitojnë paga shumë herë më të larta se paga minimale, nuk duhet dhe nuk mund të jenë indiferentë ndaj politikave që ndiqen në përcaktimin e pagës minimale. Kjo vjen pikërisht si rrjedhojë e lidhjes së fortë dhe të pashmangshme që ekziston midis pagës minimale dhe elementëve socialë dhe ekonomikë, që merren parasysh në përcaktimin e saj. Kështu, në përputhje me situatën socialë-ekonomike që mbizotëron, një vend mund të përdorë instrumentin e pagës minimale për të luftuar inflacionin, të rrisë punësimin, të inkurajojë një shpërndarje më të barabartë të të ardhurave, të luftojë varfërinë. Kjo prirje vihet re edhe në hapsirën e BE kur është fjala për lëvizjen e lirë dhe unifikimin e normave (Teysie, 2013, 105, 195, 351). Duke marrë parasysh elementet pozitivë dhe ato negativë që shoqërojnë pagën minimale, mund të thuhet që, ekzistenca e saj në një shoqëri të caktuar, në një kohë të caktuar, është një tregues i qartë dhe i pakundërshtueshëm i stadit të zhvillimit dhe mirëqënies së një vendi. Përfundimisht ky artikull evidenton nevojën për më shumë kërkime në zbatimin e pagës minimale si dhe nevojën që ajo të rregullohet në mënyrë të vazhdueshme, të paktën në përputhje me ndryshimet e inflacionit.

Bibliografi

- Bernard, T. (2013). Droit europeen du travail.Paris.
- ILO. (2014). Minimum wage system. Geneva, Switzerland.
- Raynaud, B. (1913).Vers le salaire minimum. Librairie de la Societe du Recueil Sirey.
- Andrews, J. (1919).Labor problems and labor legislation. American Association For Labor Legislation.
- Eyroud, F. & Saget,C. (2005). The fundamentals of minimum wage fixing. International Labour Office Geneva.

Negociatat e vështira të vendeve në zhvillim përsa I përket marrëveshjeve tregtare brenda OBT

Elvis Xhori
Shlp Logos

Abstrakt

Ky punim propozon një analizë kohore të evolucionit të pozitës së vendeve në zhvillim brenda GATT / OBT-së, duke u përpjekur për të nxjerrë në pah çështjet që mund të çojnë në besimin se rezultatet e arritura duken të zbalancuara në sfavor të tyre. Kjo mund të jetë për shkak të asimetrisë në aftësitë teknike, në fuqinë negociuese dhe në kostot e zbatimit që e bëjnë të vështirë për të marrë rezultate të favorshme për zhvillimin. Paraqiten në detaje rezultatet e negociatave të Dohas dhe zhvillimin e negociimeve post-Doha duke theksuar dështimin e Konferencës së Kankunit. Një vëmendje e vecante i vihet në procesin e vështirë të vendeve në zhvillim në raundin aktual të negociatave, duke rishqyrtuar horizontin kohor nga 'Uruguay Round' deri në konferencën e Kankunit. Një theks i veçantë është rezervuar negociatave të vështira dhe të rëndësishme të vendeve në zhvillim, duke ju referuar në vecanti bujqësisë.

Fjalë kyçe: GATT, OBT, Doha round, NAMA, G20.

Hyrje

Duke vënë në dukje vështirësitë e konsiderueshme për të negociuar, duke iu referuar në mënyrë të veçantë mbledhjeve të vitit 2008, duhet të theksohet se për të përfunduar Raundin e Dohas, do ishte e nevojshme arritja e një marrëveshje mbi modalitetet. Pascal Lamy, Drejtor i Përgjithshëm i OBT-së, ka kërkuar nga krerët e grupeve të ndryshme negociatore për të prodhuar, "dokumentët", që do të diskutohen më vonë në takimin e Komitetit Negociator të Tregtisë, organin më të lartë të negociatave të OBT-së. Kesaj kërkesë i është dhënë menjëherë rëndësi, edhe pse, në fillim, ajo ende nuk ishte e qartë nëse këto dokumente ishin projekt tekstet e vërtetë të rregullave, apo raporte të thjeshta për gjendjen e negociatave.

Shumë vende, përfshirë Shtetet e Bashkuara, ata menjëherë e kundërshtuan për të prodhuar tekste të reja draft negociuese, të cilat sipas mendimit të tyre do të kishin qenë një lëvizje joproduktive duke pasur parasysh divergjencën e vazhdueshme ndërmjet pozicioneve të ndryshme. Në të njëjtën kohë, gjatë të ashtuquajturave konfesionale (negociatat dypalëshe ndërmjet Lamit dhe disa delegacioneve kryesore), nuk kishte vend për një kompromis të mundshëm. Prandaj nuk ishte një vendim i papritur nga Lamy për tu limituar thjesht në disa pika të gjendjes aktuale të Raundit të Dohas, pa propozuar një projekt përditësimit të rregullave. Bëhet fjalë për qindra faqe të shkruara nga kryetarët e grupeve të ndryshme negociatore, të cilat mbulojnë të gjitha fushat nën negociata, por nuk përmbajnë asnjë surprizë.

Diskutime

Për sa i përket bujqësisë, kryetari i grupit negociator, ambasadori David Walker i Zelandës së Re, këmbënguli në përfitimet e sqarimit teknik (sqarimin e teksteve negociuese, i cili është projekt i modaliteteve të dhjetorit 2008), si dhe modelet e të dhënave (përgatitja e strukturës që do të ndjekin angazhimet e vendeve të veçanta).

Në fakt, këto janë dy aktivitetet e vetme që mund të kryhen në mungesë të përparimit të negociatave. Walker bëri thirrje për të ardhur keq (e pakëndshme) të mos propozojnë tekste të reja negociuese megjithë intensifikimin e negociatave gjatë dy viteve të fundit dhe ka treguar nëntë pika të cilat mbeten të hapura në fushën e bujqësisë:

(A) kutia blu për të cilën puna teknike ka përfunduar deri tani, dhe është e nevojshme një marrëveshje në nivel politik;

(B) subvencionet në sektorin e pambukut, pavarësisht nga konsultimet e vazhdueshme për momentin

nuk vihet re një zgjidhje e përbashkët;

(C) produktet të ndjeshme për të cilën Japonia dhe Kanadaja janë në kërkim për një fleksibilitet shtesë;

(D), aftësia për të ruajtur përjashtime nga mbulimi (ose vendosja e një kufiri të sipërm të normave, pas zbatimit të formulës së reduktimit) edhe jashtë e produkteve të ndjeshme;

(E) krijimin e TRQ, ose krijimi i kuotave të reja të importit në tarifa të reduktuara;

(F) thjeshtëzimin tarifor (konvertimi i tarifave më të komplikuar në ekuivalentin me një vlerë të caktuar), për të cilat, pavarësisht nga përparimet e shumta në nivel teknik ende nuk është në gjëndje të hartohet një tekst i ri negociues;

(G) produkte të veçanta;

(H) Mekanizëm Special Mbrojtje, ose aftësia për të përballuar për të rritur tarifën, si pasojë e çmimeve të ulëta apo të rritjes së volumeve të importit (një temë përgjegjëse e kolapsit të bisedimeve në korrik 2008);

(I) produktet tropikale (për të cilat vendet në zhvillim kanë nevojë për qasje më të madhe në treg), si marrëveshja për tarifën e importit të BE-së për bananet duhet ende për t'u pranuar në nivel multilateral.

Përsa i përket negociatave për një regjistër shumëpalësh për treguesit gjeografikë për verërat dhe pijet, kryetari i grupit negociator, ambasadori i Zambia Darlington Mwape, thekson se drafti aktual ofron një bazë të mirë për diskutim, por gjithashtu tregon se ende mbeten shumë pika për t'u zgjidhur. Zona më e diskutueshme të Doha Round, është aksesin në treg për produktet industriale (non-agricultural market acces, NAMA), në veçanti në lidhje me të ashtuquajturat "nisma" për të reduktuar ose eliminuar tarifën për të tërë sektorët (të tilla si makineri industriale, kimike, makineri elektrike dhe elektronike), dhe konkretisht në pjesëmarrjen e vendeve në zhvillim si Brazili, Kina, India.

Shtetet e Bashkuara në veçanti insistojnë se që të ketë një ndikim të rëndësishëm në tregtinë botërore, është e nevojshme që këto vende në zhvillim dhe rritje të shpejtë në thelb të marrin pjesë në këtë mekanizëm. Nga ana e tyre, Kina, India dhe Brazili kërkojnë nga ana tjetër një pjesëmarrje vullnetare, dhe ankohen se reformat bujqësore e ndërmarra nga vendet e pasura nuk përfaqësojnë të njëjtën monedhë. Një propozim i fundit i BE-së për të mbyllur hendekun në negociatat Nama nuk duket se mjafton për tani për të zvogëluar distancat që Lamy kohët e fundit i quajti të pakalueshme (pakapërcyeshëm). Në këtë pikë, duke humbur afatin përfundimtar, në disa komentatorë filloi të dalë idea e një të ashtë-quajtur "Plan B", i cili do të jetë për të përfunduar raundin me një lloj marrëveshje në një numër të kufizuar të temave më pak të diskutueshme (si lehtësimin e tregtisë), duke lënë jashtë bujqësinë dhe Nama, dhe pastaj duke braktisur idenë e një impenjimi të vetëm.

Sipas disave, "Plani B", do të shmangë dështimin e Raundit të Dohas, dhe të gjithë sistemit shumëpalësh të OBT-së. Është e vërtetë se, për momentin, mbetet e vështirë për të vlerësuar praktikabilitetin, duke pasur parasysh se dhe zgjedhja e temave "pa problem" mund të jetë çdo gjë, por jo e thjeshtë. Deri më tani, asnjë vend anëtar i OBT nuk është shprehur hapur në favor të kësaj mundësie.

Perfundime

Një skenar i mundshëm do të ishte një lloj i pezullimit të përkohshëm të Raundit; por disa komentues vënë në dukje se si kjo mund të bëjë të pamundur çdo marrëveshje deri në 2020.

Midis të tjerash, është disi paradoksale që blloku i negociatave aktuale janë shkaktuar nga një temë merkantiliste, si reduktimet tarifore në sektorin e mallrave industriale. Kërkesat për qasje më të madhe të tregut nga ana e vendeve të zhvilluara, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, në vendet me ekonomi në zhvillim si Brazili, India dhe Kina janë të ngjarë të rrezikojë rezultatin e Raundit Prandaj është e nevojshme një përpjekje nga udhëheqësit e botës të njohin rëndësinë e Raundit të Dohas për të gjithë sistemin e tregtisë globale

Ndërsa negociatat tregtare janë duke luftuar për të vazhduar, në fakt, shumë njerëz kanë theksuar rolin vendimtar të OBT-së në administrimin e rregullave ekzistuese shumëpalëshe të tregtisë, mekanizmin për zgjidhjen e kontesteve, aktivitetin e monitorimit të politikave tregtare të vendeve anëtare. Prandaj, në qoftë se një dështim i negociatave nuk përfshin humbjen e besimit në OBT, si e

tillë, ajo është gjithashtu e vërtetë se në mënyrë të pashmangshme do të dobësonte rolin e saj.

Nevoja për të përfunduar Raundin të Dohas është një temë e marrë edhe në raportin e fundit mbi paqëndrueshmërinë e çmimeve të ushqimit të përgatitur nga grupi ndërkombëtar të ekspertëve të ushqimit për takimin e parë të ministrave të bujqësisë të G20.

Në SSM, janë bërë disa përparime. Ajo është e parregullt, është e brishtë, kurrë nuk ka qenë e konsoliduar në një strukturë të vetme. Të gjitha përpjekjet informale të mëparshme kanë dështuar. Pra, kjo është hera e parë që kjo strukturë të veçantë e ka parë dritën e ditës. Nuk është, pra, e gatshme për t'u përfshirë në tekstin vetë, sepse ajo absolutisht nuk është testuar. Duket qarte të jetë ende çështje të pazgjdhura që do të adresohen përsëri në të ardhmen.

Pastaj është pambuku. Këtu kemi, së paku ri-themeluar një dialog të mirë dhe një ndjenjë e besimit që ishte dëmtuar rëndë nga ngjarjet në fund të korrikut. Gjithashtu ka pasur një vizion të fortë dhe të përbashkët për numrat që duhen copëtuar në mënyrë që të merret një vendim përfundimtar.

Mbetet fakti se, mundemi vetëm të theksojme që asnjë nuk e di se si kjo marrëveshje do të rezultojë në të ardhmen.

Kohët e fundit, në takimin “mini-ministorr”, e cila u mbajt në Paris më 26 maj në periferi të një takimi të OECD, e cila u ndoq nga disa anëtarë të OBT u arrit një marrëveshje e gjerë mbi angazhimin për të përfunduar Raundin të Dohas me një impenjim të vetëm.

Literatura

Baldwin and Evenett ,www.voxeu.org/index.php?q=node/6435, 2011 .

Bridges, «Agriculture: A Blaque Check Bitterly Contested», www.ictds.org , 6, luglio-agosto 2003a.

Bridges, «Daily Update on the Fifth Wto Ministerial Conference», www.ictds.org , settembre 2003c.

Bridges, «Trade Bio Res», www.ictds.org , 3, 16, settembre 2003b.

Dell'Aquila C., M. Kuiper, Which Road to Liberalisation: A First Assessment of the EuroMed Association Agreements, paper presentato al I Workshop dell'European Network of Agricultural and Rural Policy Research Institutes, Capri, Italia, 22-23 giugno, 2003, documento on line, (<http://www.enarpri.org/>), 2003.

Diaz-Bonilla E., M. Thomas, S. Robinson, C. Cattaneo, Food Security and Trade Negotiations in the World Trade Organization: a Cluster Analysis of Country Groups, Trade and Macroeconomics Division (Discussion Paper n. 59), International Food Policy Research Institute, Washington, documento on line (<http://www.ifpri.org>), Dicembre 2000.

Diaz-Bonilla E., S. Robinson, M. Thomas, S. Robinson, Trade liberalisation, WTO and Food Security, Trade and Macroeconomics Division, International Food Policy Research Institute, Washington, documento on line (<http://www.ifpri.org>), Ottobre (2001).

Diaz-Bonilla E., S. Robinson, M. Thomas, Y. Yahoma, WTO, Agriculture and Developing Countries, Trade and Macroeconomics Division, International Food Policy Research Institute, Washington, documento on line (<http://www.ifpri.org>), Marzo 2001.

European Commission, European Policy to support Rural Development, Policy Orientation Paper, DG Development, documento on line, (<http://europa.eu.int/>), febbraio 2000a.

Evenett ,www.voxeu.org/index.php?q=node/6423, 2011.

FAO, ROA Project Analytical Framework to Document the Roles of Agriculture in Developing Countries: Overall Approach and Concepts of Studying the Roles of Agriculture, documento on-line (<http://www.fao.org/es/esa/roa/ROA-e/Project-e.htm>), 2001 .

Gallezot J., Real access to the EU's agricultural market, working paper, INRA, 24 luglio 2003.

ICTSD, www.ictsd.org/i/news/bridgesweekly/106224/, 2011.

ICTSD, Doha Round Briefing Series, www.ictds.org , 1, febbraio 2003a.

ICTSD, Doha Round Briefing Series, www.ictds.org , 2, agosto 2003b

OECD, The Doha Development Agenda: Welfare Gains from Further Multilateral Trade Liberalisation with Respect to Tariff, documento on line(www.oecd.org), 2003.

Santisio C., Improving the governance of European foreign aid. Development cooperation as an element of foreign policy, CEPS working document n.189, documento on line, (<http://shop.ceps.be>), 2002.

Valdes A., “Supply-based Food Security at the National Level”, in Socio-economic Analysis and Policy Implications of the Roles of Agriculture in Developing Countries, Theoretical Notes, FAO ROA Project, documento on-line (www.fao.org/es/esa/roa), 2002

WTO, www.wto.org/TN/AG/W/4/Rev.4 Committee on Agriculture Special Session (6 December 2008).

WTO www.wto.org TN/AG/W/6 Committee on Agriculture Special Session (6 December 2008).
WTO, http://www.wto.org/english/thewto_e/minist_e/min03_e/min03_e.htm , 2003c.
WTO, http://www.wto.org/english/tratop_e/agric_e/negoti_e.htm , 2003b.
WTO, http://www.wto.org/english/tratop_e/dda_e/dda_e.htm , 2003a.
WTO, Market Access Conditions for Least Developed Countries: Note by the Secretariat, Document no. WT/LDC/SWG/IF/14, Ginevra, 2001.
WTO, www.wto.org/english/tratop_e/dda_e/chair_texts11_e/chairtexts11_e.htm, 2011.

Roli i Politikave Fiskale në Kosovë

Msc.Anida Haliti
Universiteti AAB, Prishtinë
Msc.Ass.Enisa Haliti
Universiteti AAB, Prishtinë

Abstrakt

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave fiskale, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)¹ në atë kohë Autoriteti Qendror Fiskal (AQF) është themeluar më 17 janar 2000, nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut. Mendoj që krijimi i autoritetit tatimor, të quajtur AQF, dhe reformimi i mëtutjeshëm në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) është bërë në norma dhe standard ndërkombëtare. Legjislacioni tatimor i Kosovës është pranuar si nga FMN-ja ashtu edhe nga Komisioni Evropian, si legjislacion transparent dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare.² ATK ofron shërbime profesionale transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve, në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve dhe siguron zbatim të drejtë dhe të njëjloshëm, si dhe mundëson fuqizimin e ligjeve tatimore, me qëllim që të mblihdhen të hyra për buxhetin e Kosovës në një mënyrë efikase dhe me kosto të ulët.³

Fjalë kyce: Administrata Tatimore e Kosovës, Autoriteti Qendror Fiskal, Kosova, Shërbimet.

Hyrje

Tatimet që zbatohen në Kosovë

Tatimet që zbatohen në Kosovë janë: Tatimi në të Ardhura Personale, Tatimi në Vlerën e Shtuar, Tatimi në Fitim në të Ardhurat e Korporatës.

Tatimi i Paragjykuar

Në kuadër të Tatimit të Paragjykimeve kemi dy zhvillime, ai i vitit 2000 dhe tatimi i paragjykuar i unifikuar. Tatimi i Paragjykuar është tatimi i parë gjithëpërfshirës i aplikuar në Kosovën e pasluftës. I njëjti filloi së aplikuari nga data 1 korrik 2000 dhe aplikohet për të gjitha bizneset të cilat ushtornin aktivitet ekonomik në Kosovë, gjegjësisht që krijojnë të hyra. Aplikohet në të hyrat e gjithëmbarshme me normën 3% mbi kuotën fikse prej 15,000 DM, varësisht prej vendndodhjes së zonave A, B apo C, e pastaj mbi këtë qarkullim është aplikuar norma 3% në qarkullim. Tatimi i Paragjykimeve⁴, identifikon bizneset, bën klasifikimin e pagesës së tatimit të paragjykuar, duke bërë kategorizimin e zonave në A, B dhe C.

Tatimi në të Ardhura Personale

Tatimi në të Ardhura Personale⁵ është përmbledhje e Tatimit të Paragjykuar, Tatimit në Paga dhe

¹(Drejtor i parë i ATK-së ishte ndërkombëtar, I punësuar nga një kontraktues I USAID-it. Nga tetori I vitit 2001 deri në shkurt të vitit 2003, kishte bashkëdrejtore, një nga USAID-I dhe një vendor që ndanin rolin e drejtorit. Më 18 shkurt 2003 autoritetet për Administratën Tatimore u bart nga UNMIK-U te Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe mori detyrat e Drejtorit të ATK-së një vendor. Që nga ajo kohë, ATK ka funksionuar si një organizatë autonome, e menaxhuar krejtësisht nga banorët të Kosovës, me këshillime dhe ndihmën e organizatave ndërkombëtare në rradhë të parë USAID-I, BE dhe FMN).

²(www.atk-ks.org faqja kryesore, legjislacioni, maj 2013).

³(Publikimet e ATK mbi arritjen e administratës tatimore të Kosovës dhe vizioni I saj maj 2013, Prishtinë: www.atk-ks.org).

⁴(Të punësuarit e ATK-së identifikonin bizneset dhe u lëshonin nga një numer të përkohëshëm bizneseve deri në momentin e regjistrimit të tyre në Ministrinë e Tregtisë, sipas Rregullores nr.2001\40, ndryshimi I rregullores së UNMIK-ut nr.2000\26 mbi themelimin e Tatimit të Paragjykuar, Përfaqësuesi Special I Sekretarit të Përgjithshëm, neni 1, korrik, 2001).

⁵(Ka filluar së aplikuari nga periudha 2002 dhe është administruar nga Rregullorja 2002\4, "Tatimi mbi të Ardhura Personale në Kosovë", I cili tatim ka pasur objekt të taturjes vetëm të ardhurat e të punësuarve, mirëpo koncepti I këti tatimi që nga 01.01.2005 ka ndryshuar, kur ky tatuim, I ashtëquajtur Tatimi në të Ardhura Personale, në vete ka përfshirë profile të të ardhurave duke mos kufizuar vetëm në paga)

i Kontributeve Pensionale. Ky tatim në fillim ka pasur objekt të tatushëm vetëm të ardhurat e të punësuarve, ndërsa pas vitit 2005 ka ndryshuar dhe në vete ka përfshirë profile tjera të të ardhurave. Të ardhurat që i nënstrohen këtij tatimi janë: Pagat, aktivitetet afariste, qiratë, shfrytëzimi i pronës së paprejshme, interesi, fitimet kapitale që rezultojnë nga një rritje apo ulje në vlerën e aksioneve, fitimet kapitale që rezultojnë nga një shitje me këste të një pasurie kapitale, lotaritë e tjera të fatit. Pra, të gjitha të ardhurat e tjera që rrisin vlerën neto të tatimpaguesit.⁶ Shkalla Tatimore në paga deri në vitin 2009 ishte më e lartë ndërsa pas vitit 2009 ajo ndryshon për të mirë.

Tatimi në Vlerë Të Shtuar – TVSH

Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) obligon çdo konsumator të paguaj këtë tatim, ndërsa ndërmarrëjet janë përgjegjëse për deklarimin e pagesës të Tatimit të Vlerës së Shtuar në baza mujore.

TVSH filloi të aplikohet:

- Nga 01.07.2001 për tatimpaguesit që kishin xhiro mbi 200,000 DM. Fillimisht TVSH-ja administrohej nga rregullorja 2001\11 dhe Rregullorja 2002\17:
- Nga 01.08.2002 limiti I TVSH-së ra në 50.000:
- Nga viti 2009 është bërë ngritja e normës tatimore nga 15% në 16%, e rregulluar sipas Ligjit mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.¹² Ky ligj u bë i zbatueshëm nga 01.08.2010.

Tatimi ne Fitim

Tatimi në Fitim ka filluar të aplikohet më 2002. Sipas rregullores 2002\3 (“Mbi Tatimin në Fitim”), subjekt i tatuarjes kanë qenë tatimpaguesit me qarkullim vjetor më tepër se 100,000 euro apo me asete të përgjithshme me vlerë mbi 50,000 euro.

Që nga viti 2008 janë bërë një numër i të arriturave kyce, të cilat kanë rezultuar në disa përmirësime të mjedisit të biznesit për NVM-të në Kosovë për shkak të uljes së shkallës tatimore nga 20% në 10% për tatimin në fitim në kombinim me përmirësimin e zbatimit të tyre. Zgjerimi i bazës tatimore dhe një riorganizim më i madh dhe më efikas i procesit të arketimit të tatimeve ka ndikuar që të hyrat tatimore të rriten dukshëm.⁷

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

Ky tatim zbatohet te personat juridikë dhe korporatat. Norma e tatuarjes për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës në vitin 2005 ishte 20%. Ky tatim në vitin 2009 u reduktua në 10%, sipas Ligjit nr.03\L për Tatimin në të Ardhura të Korporatës dhe aplikohet e njëjta normë tatimore edhe me Ligjin e ri nr.03\L-162 për të Ardhurat e Korporatës.⁸

Krahasimi i normave tatimore të Kosovës me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së

Ngarkesa tatimore në Kosovë është 26% për shumicën e të mirave material – paisjeve. Kjo ngarkesë në krahasim me vendet e tjeram ranohet në nivel mesatar. Ngarkesa e përgjithshme tatimore që duhet të paguhet menjëherë në kufi nuk është favorshme për përkrahjen e investimeve. Tatimet dallojnë në bazë të formës së biznesit dhe të qarkullimit vjetor. Administrata Tatimore aplikon tri regjime kryesore të tatimeve. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) dhe Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP).

⁶(Ligji 03 L\114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, Më 1 janar të vitit 2010 në fuqi ka hyrë Ligji nr. 03\L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Ligji nr. 03\L-197 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03\L-146)

⁷(Misioni I Administratës së Përkohshme në Kosovë (shkurt 2002), Rregullorja mbi Tatimin në Fitim në Kosovë, Prishtinë, faqe 3).

⁸(Misioni I Administratës së Përkohshme në Kosovë (dhjetor 2004), Rregullorja mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Prishtinë, faqe 4).

Tabela 1. Normat e tatimit në Kosovë krahasuar me disa shtete

Tatimi	Norma e tatimit në Kosovë	Norma e tatimit në Shqipëri	Norma e tatimit në Mal të Zi	Norma e tatimit në Maqedoni
Tatimi në fitim për korporata	Normë fikse 10%	Normë fikse 10%	Normë fikse 9 %	Normë fikse 10%
Tatimi në të Ardhura Personale	0%: deri në 960 euro\vitë 4%: prej 960 dhe 3000 euro\vitë 8%: prej 3000 dhe 5400 euro\vitë 10%: mbi 5400 euro\vitë	Normë fikse 10%	Normë fikse 12%	Normë fikse 10%
TVSH	Norma standard 16%	Norma standard 20%	Norma standard 17% Norma e ulët 7% Norma zero 0%	Norma standard 18% Norma e ulët 5%

Burimi: të dhënat nga Ministrinë e Financave të shteteve përkatëse

- **Tatimi në të ardhurat e korporatave (TAK)** në Kosovë paguhet cdo tre muaj, varësisht nga qarukillimi vjetor. Norma e tatimit në korporata me qarkullim vjetor mbi 50,000 është 10%. Ndërsa regjimi tatimor i Malit të Zi është bërë më konkurrues në të gjithë Evropën. Kjo normë tatimore për fitimin e korporatave-kompanive që operojnë në Mal të Zi mundëson jo vetëm një ambient miqësor për biznes, por edhe një barrë të ulët tatimore.

- **Tatimi mbi të ardhura personale (TAP).** Ky tatim në Kosovë aplikohet në të ardhurat nga paga, biznesi, qiraja, interesi, pasuria e patundshme etj. Normat tatimore të tatimit në të ardhura personale nga paga janë progressive, duke u buzuar në lartësinë e pagës së fituar dhe kjo është nga 0% deri në 10%. Ky lloj tatimi paguhet nga të gjitha bizneset individuale me qarkullim vjetor më pak se 100,000 euro. Ndërsa, mbi të ardhurat personale në Shqipëri dhe në Maqedoni është 10%, kurse në Mal të Zi është më i lartë dhe shënon 12%.

Përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e llogarive për kursimin e personit është Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Ky tatim obligon të punësuarin dhe punëdhënësin të kontribuojnë në financimin e pensioneve të punësuarit më normë prej 5% të pagës nga ana e të punësuarit dhe 5% nga ana e punëdhënësit.

- **Tatimi mbi Vlerës e Shtuar (TVSH).** Tatimi kryesor në Kosovë është Tatimi mbi Vlerën e Stuar (TVSH-ja), që paguhet për mallra dhe shërbime. Norma e këtij tatimi është fikse prej 16% për të gjitha mallrat, pa marrë parasyshë origjinën e tyre dhe 0% për mallrat të cilat i dedikohen eksportit. Bizneset që kanë qarkullim vjetor prej 50.000 euro duhet të regjistrohen për TVSH. Sa i përket importit, periudha për pagesën e TVSH-së është 6 muaj dhe kjo mblidhet në kufijtë e Kosovës.

- TVSH në Kosovë nuk ka ndionjë dallim të madh krahasuar me vendet e rajonit. Në Kosovë është 17%, ndërsa më e lartë është në Serbi dhe Maqedoni me 18%, në Shqipëri 20% dhe në Kroaci 23%. TVSH në Kosovë krahasuar me disa nga vendet BE-së ka dallim të madh. Vetëm Qiproja ka normë të TVSH-së më të ulët se Kosva, Spanja ka normë të njejtë tatimore, teksa të gjitha vendet e tjera kanë TVSH më të lartë.

Literatura

www.atk-ks.org. (Maj 2013). Faqja kryesore. Legjislacioni, Prishtinë

Rregullorja e UNMIK-ut. (2001). nr.2001\35. Prishtinë.

Ligji 03 L\114 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar, Më 1 janar të vitit (2010) në fuqi ka hyrë Ligji nr.03\L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Ligji nr.03\L-197 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03\L-146.

Misioni I Administratës së Përkohshme në Kosovë (shkurt 2002), Rregullorja mbi Tatimin në Fitim në Kosovë, Prishtinë, faqe 3.

Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë (dhjetor 2004), Rregullorja mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Prishtinë, faqe 4.

Anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe Përfitimet e Saj

Ph.D Cand. Gëzim Jusufi
Universiteti i Prishtinës
Ph.D Cand. Artan Ramaj
Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakt

Republika e Kosovës është e përkushtuar për liberalizimin e tregtisë. Pjesëmarrja në mekanizmat rajonal dhe më gjerë për lehtësimin e tregtisë ka qenë dhe është një nga objektivat kryesore të politikave institucionale të Kosovës. Bashkëpunimi dhe koherenca midis të gjithë akterëve relevantë që e përbëjnë sistemin e tregtisë në Kosovë është i nevojshëm, në mënyrë që të arrihet deri te liberalizimi gradual i tregtisë dhe anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) ka luajtur një rol të rëndësishëm në liberalizimin e tregtisë botërore. Anëtarësimi i Kosovës në OBT është një proces shumë kompleks dhe multidimensional. Ky anëtarësim do të siguronte liberalizimin multilateral sepse Kosova do të ketë qasje në tregun global. Përmes këtij punimi, fillimisht do të ipen të dhëna bazë për ekonominë Kosovare, për OBT-në, pastaj do të shtjellohet problematika e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë dhe përfitimet e një vendi të vogël siç është Kosova nga ky anëtarësim, si dhe në fund do të ipen rekomandimet në formë të përfundimit për gjithë këtë proces.

Fjalët kyçe: Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Kosova, procesi i anëtarësimit, liberalizimi i tregtisë, përfitimet.

Hyrje

Vendet e vogla sikurse Kosova nuk do ta kenë vëmendjen e madhe të botës tregtare nga partnerët e mëdhenjë dhe me ndikim. Bota e unifikuar e tregtisë ende ka nevojë për të bërë një rreth edhe më të gjerë dhe për t'i përfshirë të gjitha vendet në mënyrë që të zhvillohet një sistem tregtar me përfitime për të gjitha shtetet.

Kosova si një treg i vogël, por i vlefshëm për fqinjët e saj, duhet të bëjë shumë për të zhvilluar dhe kënaqur qytetarët e saj dhe nevojat e konsumatorëve. Aktualisht është e vështirë për të arritur një nivel të lartë të zhvillimit, por ende çdo hap i vogël drejtë zhvillimit do të jetë i vlefshëm dhe do të mundësojë që sistemi ekonomik të funksionojë më mirë. Tregtia dhe prodhimi mund të ndihmojnë Kosovën të fitojë pavarësinë e saj të plotë. Aktualisht në Organizatën Botërore të Tregtisë bëjnë pjesë 160 vende të botës, kurse disa të tjera janë në proces të anëtarësimit.

Edhe pse disa çështje të tilla si fitimi i ulëses në OKB paraqesin problem për anëtarësimin e Kosovës në OBT, padyshim ka arsye të mira për Kosovën që t'i bashkangjitet OBT-së dhe kjo është koha e duhur për të investuar në këtë proces të rëndësishëm në të ardhmen në mënyrë që anëtarësimi të jetë sa më i shpejtë. Gjithashtu për shkak të vështirësive që sjellin pesë vendet e BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, si dhe refuzimi i pranimi të Kosovës me të drejta të plota nga vendet tjera të fuqishme, siç janë Kina, Brazili dhe India, anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në OBT nuk është proces i lehtë.

Qëllimi i këtij punimi është elaborimi i çështjes së anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë, problematikës së anëtarësimit në këtë organizatë, përfitimet që do t'i ketë Kosova nga ky anëtarësim dhe nxjerrja e rekomandimeve bazuar në rezultatet e këtij punimi. Ky punim është përgaditur duke përdorur të dhëna sekondare, të cilat janë siguruar nga institucionet e ndryshme qeveritare të Kosovës, si Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Punëve të Jashtme. Pastaj nga hulumtime të ndryshme të natyrës ekonomike dhe tregtare të hulumtuesëve të huaj dhe vendor, nga qasjet e ndryshme në web faqet e institucioneve relevante, etj.

Vështrim i përgjithshëm mbi ekonominë Kosovare

Kosova ka një ekonomi të re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste e dirigjuar në një ekonomi të hapur të tregut, e cila transformimin e saj të thellë e ka përjetuar pas vitit 1999 me çlirimin e Kosovës nga Serbia. E ndodhur në Evropën Juglindore ekonomia e Kosovës është bërë pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaftë të gjerë. (Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës. Qasur në <http://www.mfa-ks.net/?page=1,119>, 2014).

Ekonomia e Kosovës gjatë viteve të fundit u ndikua nga një grup i zhvillimeve të brendshme dhe të përcaktuesve të jashtëm që paraqesin sfida për rritjen e saj të qëndrueshme. Gjatë vitit 2012, ka pasur një rritje 2.5% të GDP-së, e cila përfaqëson një rënie në krahasim me rritjen e vitit 2011 prej 4.4%. Kjo rënie në rritje kryesisht i atribuohet rënies së investimeve të huaja direkte (IHD). Në të vërtetë, në mes të vitit 2012 dhe 2013, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka raportuar një rënie në bruto formimin e kapitalit prej 8.7%, të shkaktuar kryesisht nga një rënie në investimet e huaja direkte.

Përveç kësaj, për shkak të një rënieje në kërkesën dhe çmimet për eksportet kryesore të Kosovës, eksporti i mallrave u tkurr prej 324 milion € në vitin 2011, në 287 milion € në vitin 2012. Kjo rënie prej 11.6% u kompensua në mënyrë të pabarabartë përmes një ndryshimi pozitiv vjetor në eksportin e shërbimeve që u rrit për 2.68%. Norma e importeve ka pësuar një rënie, sepse importi i mallrave ra 1% dhe importi i shërbimeve 18.1%, të cilat ndihmuan që Kosova të përmirësoj deficitin e saj tregtar, edhe pse ky deficit mbetet në nivelin -35,1% në vitin 2012, ndërsa në vitin 2011 ishte 37.6%. (Shaipi, Krasniqi, Mati, Gashi, 2014, 8).


Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish komparative siç janë: popullsia e re dhe mjaftë mirë e kualifikuar, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-së dhe në atë të Bashkimit Evropian. Kosova përveç se është anëtare e CEFTA-së, në qershor të vitit 2009 është anëtarësuar edhe në FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe BB (Banka Botërore) dhe aspiron në mekanizma tjerë të fuqishëm ekonomiko-financiar si BERZH, Organizata botërore e Tregtisë OBT etj. (Ministria e Integritimit Evropian e Kosovës. Qasur në <http://www.mei-ks.net/?page=1,236,518>, 2014).

Shkëmbimet tregtare të Kosovës


Kosova është anëtare e CEFTA-s që nga viti 2007, një marrëveshje rajonale e tregtisë së lirë, së bashku me Serbinë dhe Bosnje Hercegovinën- vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ndërsa organizata nxit bashkëpunimin tregtar mes vendeve, ajo gjithashtu promovon agjendën e BE-së përmes bashkëpunimit rajonal. Në vitin 2008, për shkak të shpalljes së pavarësisë, Kosova u përball me një situatë të embargos kur Serbia dhe Bosnja Hercegovina nuk i njohën dokumentet e Kosovës, duke e detyruar Kosovën të ndërmarrë masa hakmarrëse për importet serbe. Edhe pse çështja u zgjidh, lëvizja e mallrave në të gjithë vendet anëtare të CEFTA-s ka rinisur, pasi eksportet brenda CEFTA-s përbënin shumën prej 51.500.000 € në gjysmën e parë të vitit 2013, ku Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia përbëjnë një të tretën e eksporteve të Kosovës. (Shaipi, Krasniqi, Mati, Gashi, 2014, 9)

Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës mbeten vendet e Bashkimit Evropian (BE-së) dhe ato të rajonit (anëtare të CEFTA-së). Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së në vitin 2010, ishin 44.7% të totalit të përgjithshëm, që krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 3.71%. Eksport drejt vendeve të CEFTA-së ishin 24.1% të vlerës totale, krahasuar me vitin paraprak kanë pasur një ulje prej 25.39%, kurse eksportet drejt vendeve të tjera përfshijnë 31.2% të vlerës së përgjithshme.

Eksportet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010;



Importet e Kosovës sipas grupit të vendeve për vitin 2010;



Partnerët kryesor të Kosovës në eksport dhe import

Kosova importon prej vendeve të Bashkimit Evropian pjesën më të madhe të automjeteve, makinerive dhe pajisjeve, produktet e duhanit, të naftës, materiale ndërtimi, produkte ushqimore etj. Eksportet e Kosovës në tregun e BE-27, dëshmojnë një nivel të ulët të konkurrencës, për faktin se përbëhen kryesisht nga mbeturinat e metaleve të ndryshme dhe në masë më të kufizuar nga disa prodhime industriale si feronikeli, materialet e ndërtimit, prodhimet e drurit etj.

Nr.	Vendet	Eksporti (000) €	Pjesëmarrja në total %	Importi (000) €	Pjesëmarrja në total %
1.	Italia	80.193	27.1	100.603	4.7
2.	Shqipëria	30.841	10.4	69.714	3.2
3.	Maqedonia	26.308	8.9	319.313	14.8
4.	Zvicra	17.786	6.0	20.981	1.0
5.	Gjermania	15.587	5.3	280.617	13.0
6.	Kina	14.779	5.0	135.406	6.3
7.	Serbia	3.941	1.3	260.471	12.1

Ndonëse mbi 3/4 e tregtisë së Kosovës është e orientuar drejt vendeve të CEFTA-s dhe atyre të BE-27, Kosova ka shkëmbime tregtare me pjesën më të madhe të vendeve të botës, kryesisht në drejtim të importeve. Ndër këto vlen të përmenden Turqia, nga e cila importohet rreth 7% e vlerës së përgjithshme të importeve dhe Kina, prej se cilës Kosova importon rreth 6.3% të importeve të përgjithshme ndërsa edhe eksportet drejt këtij vendi të largët aziatik përfshijnë 5% të totalit të përgjithshëm të eksporteve kosovare. (Ministria e Integritimit Evropian e Kosovës. Qasur në <http://www.mei-ks.net/?page=1,236,518>, 2014).

Problematika e anëtarësimit të Kosovës në OBT

Organizata Botërore e Tregtisë (shk. OBT / anglisht: World Trade Organization; shk. angl. WTO) është një organizatë ndërkombëtare me qendër në Gjenevë të Zvicrës, e cila merret me nxitjen dhe vënien në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve tregtare ndërkombëtare. OBT u themelua në vitin 1994 kur vendet anëtare të GATT-it firmosën një pakt të ri tregtar. OBT u krijua për të zëvendësuar

GATT-in. OBT filloi punë më 1 janar 1995. GATT-i dhe OBT-ja bashkëjetuan deri në Dhjetor 1995 kur vendet antare të GATT-it u mbledhën për herë të fundit.

Edhe pse OBT-ja zëvendësoi GATT-in, marrëveshjet tregtare të arritura në kuadër të tij deri më 1994 janë pjesë e Marrëveshjes së OBT-së. OBT e zgjeroi kuadrin e GATT-t duke përfshirë edhe tregtinë e shërbimeve dhe mbrojtjen e pronës intelektuale. OBT është gjithashtu një organizatë e strukturuar në mënyrë formale rregullat e të cilës janë të detyrueshme për zbatim nga vendet anëtare. Organizata përfaqëson edhe një trupë gjykuese në tregtinë ndërkombëtare. Vendet anëtare mund ti referojnë mosmarrëveshjet e tyre para një paneli arbitrazhi të përbërë nga zyrtarë të OBT. Më tej ekziston edhe një trupë apelimi ku vendet anëtare mund të apelojnë vendimet e arbitrazhit. Vendimet e apelit janë të formës së prerë. (Organizata Botërore e Tregtisë. Qasur në http://sq.wikipedia.org/wiki/Organizata_Bot%C3%ABrore_e_Tregtis%C3%AB, 2014).

Si një vend jo anëtar i OKB-së Kosova do të ketë një status të veçantë në negociata me OBT-në, e që me siguri ky do të përcaktohet kryesisht nga BE-ja sepse Kosova është në sferën e saj të interesit. Marrëveshjet multilaterale për anëtarësim në OBT-në, në këtë rast do të përcaktohen kryesisht nga negociatat me BE-në.

Për fat të keq një treg i vogël me një shoqëri të varfër konsumatore nuk mundëson shumë konkurrencë dhe investime. Çështjet pronësore janë një faktor i rëndësishëm në pengimin e investimeve të mëdha si dhe gjendja politike e cila është në të vërtetë duke u përmirësuar ngadalë. Tani në këtë proces të anëtarësimit e vetmja gjë madhore që duhet përmbushur, e që nuk është specifike vetëm për Kosovën, është lufta kundër ekonomisë informale, produkteve të falsifikuara dhe importeve të paligjshme të të gjitha llojeve. (Attila, 2014, 1-3).

Kosova në këtë proces ka një rrugë që duhet të ndiqen në mënyrë që të bëhet anëtare, e ngjashme me përvojën e Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Prandaj përvoja e tyre mund të jetë e vlefshme për Kosovën sepse tregjet e këtyre vendeve janë të ngjashme dhe kanë një gamë shumë të ngjashme të produkteve që i ofrojnë në treg. Aktualisht legjislacioni i Kosovës është në përputhje me rregullat e BE-së, mirëpo nuk është bërë shumë lidhur me legjislacionin që ka të bëjë me anëtarësimin në OBT. Mirëpo në disa pika të legjislacionit kosovar që kanë synim aplikimin e rregullave të BE-së, mund të gjenden disa rregulla që janë në harmoni me OBT-në. Shembull Ligji Kosovar mbi tregtinë e jashtme. Ky ligj ka mjaftë ngjajshmëri me rregullat dhe ligjet e OBT-së.¹

Sistemi i transportit parqet sfida në procesin e anëtarësimit në OBT. Edhe në raportin e Bankës Botërore të vitit 2013 për Kosovën kjo çështje paraqitet kështu: "Sistemi i transportit është i pamjaftueshëm për të bërë biznes dhe joadekuat për nevojat tregtare si dhe i papajftueshëm krahasuar me standardet evropiane. Si një vend pa dalje në det, ekonomia e Kosovës është e varur në transportin rrugor të përshtatshëm dhe integrimin e tij në rrjetet transportuese të shteteve fqinje. Megjithatë kohëve të fundit janë bërë përparime të dukshme në infrastrukturë rrugore, shembull ndërtimi i autostradës Tiranë-Prishtinë. (The World bank in Kosovo, Country snapshot 2013, 9).

Përfitimet e Kosovës nga ky anëtarësim

Duke ditur se anëtarësimi në BE dhe OBT do t'i sjellë Kosovës investime të reja, do të ndihmojë në krijimin e ndërmarrjeve të reja vendore dhe në zhdukjen e monopoleve nga tregu, njëkohësisht ky anëtarësim do të mundësojë krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të cilësisë së ushqimit dhe shumë përfitime të tjera për konsumatorët.

Një nga kërkesat më të rëndësishme të OBT-së për Kosovën do të jetë ngritja dhe forcimi i institucioneve. Sistemi i administratës publike duhet të vendoset në baza të forta dhe të qëndrueshme, të gjitha institucionet duhet të punojnë në një sistem ku do të jetë lehtë për t'u parë dhe parashikuar se çfarë duhet të bëhet për të arritur rezultate të caktuara. Zhvillimi institucional është një nga prioritetet për Kosovën dhe ajo me siguri do të bazohet në standardet e BE-së dhe kërkesat e ardhshme të OBT-së.

Përfitim shumë i rëndësishëm për Kosovën do të mund të jetë zbatimi i nenit 3 të OBT-së i cili shpjegon funksionet e OBT-së. Dy funksionet më me ndikim janë forumi për negociata ndërmjet anëtarëve dhe mekanizmi për rishikimin e politikave tregtare. Forumi do të ndihmojë krijimin e

¹Ligji mbi tregtinë e jashtme të Kosovës, 04/L-048, 2011.

një vendi të sistematizuar për diskutime dhe mundësimin e qasejes në çështjet apo problemet të lidhura me tregtinë në atë nivel që tregtia të mund të jetë më efektive. Vendosija e re dhe ndryshimi i politikave tregtare është gjithashtu një çështje e rëndësishme pasi ajo do të ndihmojë të gjitha palët të kenë një rol dhe të respektojnë të drejtat e të gjithëve. (WORLD TRADE ORGANIZATION. Qasur në http://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/legal_e.htm, 2014).

Mekanizmi i OBT-së ua mundëson vendeve më pak të zhvilluara anëtare që të participojnë apo veprojnë në aktivitetet e OBT-së sipas kapacitetit të tyre financiar. Shembull, kur të bëhen ndryshime në sistemin tregtar palët tregtare respektojnë nevojat e shteteve më pak të zhvilluara dhe bëjnë disa justifikime. Vendet që i përkasin sistemit dhe nuk janë në gjendje për të akomoduar standardet e larta u ipen disa lloj dokumentesh të heqjes dorë dhe prap respektohen dhe ndihmohen në mënyrë që të zhvillohen dhe paraprakisht të përparohen me gjithë sistemin në të cilin në të vërtetë përfitojnë të gjithë. (http://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/legal_e.htm accessed on 24 March 2014).

Sfidë tejet e rëndë për Kosovën paraqet edhe integriteti teritorial i saj. Mund të thuhet se Kosova ka arritur bashkimin e saj doganor dhe është gati për të zbatuar atë tani në tërë territorin e saj. Hapat e parë tashmë janë duke u bërë dhe çështja më problematike e kufirit me Serbinë në veri të Kosovës, do të funksionojë në bashkëpunim me Serbinë, duke respektuar rregullat e Kosovës me disa përfitime për komunitetet lokale në veri të Kosovës. (Attila, 2014, 16-17).

Përfitimet që do t'i ketë Kosova nga ky anëtarësim mund të përmledhen në këto tri pika si vijon:

- Kërkesat për anëtarësim në OBT rezultojnë në fuqizimin gjithëpërfshirës të politikave dhe institucioneve të vendit;

- Anëtarësimi në OBT siguron qasje në tregjet kryesore botërore. Kosova si vend në tranzicion do të përfitonte nga klauzola e Kombit Më Të Favorizuar. Ky status do të thotë trajtim të barabarte ose jo-diskriminues nga vendet anëtare të OBT-së. Çka do të thotë kjo? Nëse një vend anëtar i ofron preferenca një vendi tjetër anëtar atëherë këto preferenca do të aplikohen edhe për pjesën tjetër të vendeve anëtare (në këtë rast edhe për Kosovën). Ky trajtim ka shumë implikime për marrëdhëniet brenda ekonomisë nacionale të vendit anëtar dhe pozitën e tij në tregun e huaj. Ky koncept është gurthemel i politikave të OBT-së;

- Anëtarësimi mundëson qasje në mekanizmin për zgjidhjen e kontesteve. Për Kosovën si vend i vogël ky mekanizëm është me rëndësi të veçantë.

OBT ka luajtur një rol të rëndësishëm në liberalizimin e tregtisë botërore. Megjithatë, heqja e barrierave tarifore si rezultat i negociatave brenda OBT-së ka shkaktuar shfaqjen e një kategorie të re të pengesave, që janë, barrierat jo-tarifore. Këto bariera në të shumtën e rasteve e pengojnë tregtinë ndërkombëtare më tepër se barrierat tarifore. Kjo ndodh për shkak se rregullat e OBT-së nuk janë saktësisht specifike në këtë kontekst, duke lejuar vendet që t'i aplikojnë ato. Prandaj, Kosova do ta shijojë liberalizimin e mëtejshëm (përfshirë anëtarësimin në OBT) në kontekst të shumë faktorëve të tjerë ashtu që të përfitojë më së shumti nga procesi. (Republika e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Politika Tregtare e Kosovës, 2009, 23-24)

Përfundime

Përgatitjet për anëtarësim të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë, kanë filluar vite më parë, mirëpo, Kosova ka ngecur në këtë drejtim. Statusi i pazgjidhur politik, ekonomia e brishtë, institucionet e brishta dhe resurset e pamjaftueshme për t'u marr me çështjen e anëtarësimit ishin disa nga barrierat që shkaktuan dhe ende shkaktajnë ngecje në procesin e anëtarësimit të Kosovës në OBT. Kosova do të ketë përfitime nga ky anëtarësim, mirëpo si duhet të argumentohen pohimet e lartëshënuara në mënyrë që opinioni Kosovar të jetë pro anëtarësimit në OBT, e cila përceptohet si organizatë e themeluar nga korporatat më të mëdha në botë të mbështetura dhe stimuluar edhe nga qeveria amerikane dhe vendet më të industrializuara të botës. Anëtarësimi në OBT do të rezultonte me fuqizimin e institucioneve dhe politikave vendore. Kosova si anëtare e OBT-së

do të duhet të aplikojë rregullat, kodet, politikat dhe aktet e kësaj organizate. Këto elemente kanë për qëllim rregullimin e funksionimit të tregtisë në përgjithësi. Andaj Kosova me institucionet aktuale ku shkalla e korrupsionit është mjaftë e lartë dhe me nënpunës e ekspertë joadekuat nuk mundet të aplikojë politikat e OBT-së. Andaj kjo praktikë duhet të ndryshojë. Kështuqë vetëvetiu synimi për anëtarësim në OBT do të detyronte qeveritarët që ta ndërrojnë mendësinë aktuale nëpër këto institucione nëse vërtetë synojnë anëtarësimin në këtë organizatë. Kosova do të përfitonte nga klauzola e kombit më të favorizuar. Ky do të ishte një përfitim mjaftë i madh i Kosovës sepse kjo paraqet masë mbrojtëse për produktet Kosovare. Përderisa aktualisht produktet kosovare nuk mbrohen aspak apo nuk janë të subvencionuara, me anë të kësaj klauzole do të kishin mburojë në tregjet ndërkombëtare, prodhuesit kosovar nuk do të diskriminoheshin sepse do të trajtoheshin njësoj sikurse prodhuesit Maqedonas, Bullgar, Serb e Malazes në tregun ndërkombëtar. Anëtarësimi mundëson qasje në mekanizmin për zgjidhjen e kontesteve. Produktet kosovare konkretisht prodhuesit vendor që nga periudha e pasluftës janë ballafaquar me bllokada të ndryshme nga shtetet fqinjë, duke filluar nga Serbia, Maqedonia, Shqipëria, Bosnia e Hercegovina e shumë shtete tjera. Edhe pse Kosova është anëtare e Marrëveshjes CEFTA së bashku me Serbinë e Bosnie Hercegovinën, këto shtete bllokojnë eksportin e produkteve Kosovare në këto shtete dhe më gjerë. Si rezultatet i mosmarrëveshjeve të ndryshme tregtare me prapavijë politike, prodhuesit Kosovar nuk po mundën të eksportojnë në tregjet ndërkombëtare. Andaj anëtarësimi në OBT do të ofronte mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve tregtare ndërmjet Kosovës dhe shteteve të ndryshme të cilat vënë bllokada të paarsyeshme ndaj produkteve Kosovare. Dëshën apo nuk deshën këto shtete duhet t'i respektojnë produktet e Kosovës si vend anëtar i OBT-së, ngase janë mekanizmat mbrojtës të cilat do të zgjidhnin kontestet mes Kosovës e shteteve tjera anëtare.

Literature

- Shaipi, K. Krasniqi, B. Mati, B. Gashi, E. 2014, (2014), Investors' Perceptions of Kosovo's Business Environment, Survey with current and potential investors, *International Finance Corporation*, 8-9.
- Attila, Nagy. (2014) Constitutional studies of free trade and political economy, Kosovo as a future member of the WTO. *LLM International Business Law*, 1-17.
- Ligji mbi tregtinë e jashtme të Kosovës, 04/L-048, 2011.
- The World bank in Kosovo. (2013), *Country snapshot*.
- Republika e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, *Politika Tregtare e Kosovës*, (2009).
http://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/legal_e.htm accessed on 24 March 2013;
<http://www.mfa-ks.net>;
<http://www.mei-ks.net>;
http://sq.wikipedia.org/wiki/Organizata_Bot%C3%ABrore_e_Tregtis%C3%AB.

Rritja e eksporteve, një sfidë për realitetin shqiptar

PhD Candidate Alma Delija
PhD Candidate Aldona Mrruku (Minga)
Universiteti Bujqësor i Tiranës

Abstrakt

Në kuadrin e politikës ekonomike në vënd, zhvillimi i eksporteve konsiderohet si një faktor kyç për përmirësimin e treguesve mikro dhe makroekonomik, veçanërisht nga pikëpamja e përmirësimit të bilancit tregtar dhe e krijimit të vëndeve të reja të punës. Nisur nga avantazhet konkurruese të Shqipërisë - në veçanti fuqinë punëtore të arsimuar dhe me kosto të ulët, afërsinë me tregjet evropiane, rimëkëmbjen e tregjeve rajonale, burimet natyrore, politikat mjaft liberale tregtare si dhe potencialin e pashfrytëzuar në bujqësi, industrinë ushqimore dhe sektorin e minierave - zëvendësimi i importeve nga eksportet, pritet të luajë një rol përherë e më vendimtarë në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Shqipërisë. Në ditët e sotme është tepër e vështirë të diferencosh tregjet financiare vendase me ato ndërkombëtare. Është e pamundur të imagjinohet funksionimi i një ekonomie të izoluar nga të tjerat, nga tregu ndërkombëtar i të mirave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit. Eksperienca botërore bën të qartë rëndësinë që ka tregtia e jashtme në zhvillimin e një vëndi si forcë shtytëse në ekonominë e re botërore. Në këtë univers sfidash dhe zhvillimesh "shpërthyesë", Shqipëria përpiqet të bëjë ndryshimet e saj ekonomike dhe strukturore në përshtatshmëri me këtë linjë zhvillimesh. Sot duken qartë përpjekjet reale që po bëhen për të rindërtuar ekonominë e tregut në vëndin tonë dhe për orientimin e sistemit tonë ekonomik drejt tregtisë së lirë. Në këtë epokë të globalizimit, ne përballemi me sfida të dyfishta të zhvillimit, atë të rritjes ekonomike dhe nxitjes së eksporteve. Kërkimi ka si qëllim sjelljen e fakteve dhe evidencave mbi ecurinë e eksporteve shqiptare duke u fokusuar në identifikimin e indikatorëve për rritjen dhe promovimin e eksporteve si një ndër sfidat e ekonomisë shqiptare.

Fjalët çelës: Eksport, Promovim, Avantazhe Konkurruese, Kapacitete, Agrobiznes.

Hyrje

Bota ekonomike është duke ja lënë historisë ekonomitë nacionale relativisht të izoluarat prej njëra-tjetrës nga barrierat e shumta në tregtinë dhe investimet ndërkufitare, nga distancat, diferencat kombëtare dhe sistemet e kulturës dhe të biznesit.

Në ditët e sotme është tepër e vështirë të diferencosh tregjet financiare vendase me ato ndërkombëtare. Është e pamundur të imagjinohet funksionimi i një ekonomie të izoluar nga të tjerat, nga tregu ndërkombëtar i të mirave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit. Eksperienca botërore bën të qartë rëndësinë që ka tregtia e jashtme në zhvillimin e një vëndi si forcë shtytëse në ekonominë e re botërore. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, vëndi ynë ka realizuar reforma të fuqishme strukturore në fushën e tregtisë duke shënuar ndryshime progresive në funksion të stabilitetit ekonomik.

Edhe pse vitet e fundit vërehet një rritje e lehtë ekonomike, sërish Shqipëria listohet e fundit për nga niveli i varfërisë, me një bilanc tregtar negativ, me mungesën e infrastrukturës bazike, duke mos ofruar mundësi në nxitjen e biznesit dhe investimeve, si dhe mbështetjes për inovacion. Tashmë ne përballemi me sfidën e rritjes së aftësisë konkurruese në tregun ndërkombëtar dhe me synimin për hyrjen në Bashkimin Europian.

Vështrimi kritik i literaturës mbi tregtinë ndërkombëtare

Vëndet angazhohen në tregtinë ndërkombëtare për dy qëllime kryesore:

Së *pari*, për të mundësuar përfitimin nga epërsia e vëndeve të tjera, duke ndikuar në një efektivitet më të lartë dhe në një ekonomi globale më të fuqishme; Së *dyti*, pasi ato tentojnë për të arritur ekonomitë e shkallës në prodhim, duke u fokusuar në prodhimin e asaj të mire si rezultat i specializimit. Modelet e tregtisë ndërkombëtare kanë evoluar me kalimin e kohës, duke na ofruar implikime dhe standarte të reja mbi tregtinë dhe përfitimet e saj. Kështu, mund të përmendim një nga modelet më të thjeshta modelin Rikardian, ku evidentohet se ndryshimet mes vëndeve i japin jetë tregtisë dhe përfitimeve

prej asaj, duke zhvilluar teorinë e avantazheve krahasuese. Në këtë model, puna është i vetmi faktor prodhimi dhe vëndet ndryshojnë vetëm nga produktiviteti i punës në industri.

Doktrina e epërsisë krahasuese e Rikardos le të hapur problemin pse një vënd i caktuar është relativisht më eficientë në prodhimin e produkteve të dhëna. Kjo u argumentua nga Heckscher dhe Ohlin ('Teoria Heckscher-Ohlin') se vëndet do të prirën të specializohen në prodhimin e atyre të mirave që përdorin në mënyrë intensive faktorët që ato zotërojnë me shumicë.

Evoluimi i tregtisë ndërkombëtare, i ka hapur rrugë zhvillimit të teorive alternative mbi tregtinë. Në kuadrin e këtyre zhvillimeve, përmendim teorinë e ciklit të jetës së produktit, e cila shpjegon dinamikën e avantazheve krahasuese, kalimin e tyre nga një vënd në tjetrin, mbi bazën e ndryshimit të faktorëve përcaktues të vet këtyre avantazheve (shterimit të një prej faktorëve dhe aktivizimit të një faktori tjetër).

Me qëllim shpjegimin e këtyre realiteteve, ekonomistët prezantuan idenë e 'kërkesës për varietete' dhe më pas të ashtuquajturat teori të reja tregtare të cilat ofrojnë fuqi më të madhe shpjeguese, por gjithashtu edhe justifikime për ndërhyrje politike për subvencione për industritë konkurruese. Kontribut të mëtejshëm në modelimin e tregtisë ndërkombëtare ka dhënë Armington (1969). Ai sugjeroi një zgjidhje të problemeve të modelimit të tregtisë, në një model me shumë sektorë, për të mira të caktuara. Teza se tregtia e lirë ka siguruar prosperitetin dhe rritjen e një vëndi apo dhe të botës në tërësi, duke lejuar çdo vënd të mbledhë përfitime nga specializimi, qëndron si një tezë e diskutueshme. Ndonëse korrelacioni ndërmjet rritjes dhe tregtisë është i fortë, por kjo nuk nënkupton detyrimisht shkaktimin, pra nëse tregtia shkakton rritjen apo rritja e kërkesës shkakton tregtinë.

Një tjetër dimension kritik i teorisë së tregtisë dhe politikave tregtare është diferenca fundamentale midis ekonomive të botës të zhvilluar dhe në zhvillim.

Si përfundim mund të cilësojmë se ekziston një diversitet i madh në literaturë mbi tregtinë, liberalizimin tregtar, dhe efektet në të ardhurat. Çështja kryesore që ngrihet në këto postulate teorike është se si duhet të ndërveprojnë tregtia dhe zhvillimi ekonomik.

Ecuria e zhvillimit ekonomik në shqipëri

Vitet e para të tranzicionit e përballën ekonominë shqiptare me sfida dhe ndryshime të fuqishme. Ekonomia shqiptare ishte e mbyllur në guackën e saj, duke penguar vlerësimin dhe rivlerësimin e saj në tregun botëror. Mungesat e shumta në treg për produktet e nevojës së parë, sistemet e racionimit, fiksimi i çmimit në nivele të planifikuara, alokimi i centralizuar dhe joeficientë i burimeve ishin disa nga tiparet e ekonomisë së centralizuar. Ndërkohë, që në një ekonomi tregu zhvillimi ekonomik orientohet nëpërmjet konkurrencës dhe sigurimit të avantazheve krahasuese me jashtë. Për ekonominë shqiptare, tepër delikate dhe të sapoorientuar nga tregu, identifikimi i sektorëve që do të përbënin bazën e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë, si dhe adaptimi i politikave mbështetëse zhvillimore të tyre përbënin prioritet absolut. Dy linjat kryesore në të cilën do të mbështetej reforma në tregtinë e jashtme ishin privatizimi i ekonomisë dhe hapja e ekonomisë tonë ndaj tregut ndërkombëtar. Edhe pse nivelet e tregtisë për Shqipërinë kanë ndjekur një trend pozitiv rritës, përsëri ato mbeten të ulëta, krahasuar me vëndet e tjera të rajonit. Ritmi i rritjes së flukseve tregtare ka qënë herë pas here i ç'rregullt, duke reflektuar në këtë mënyrë zhvillimet kryesore në ekonominë vëndase si dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm ndërkombëtar si dhe rajonal. Duket qartasi, që eksportet kanë përmirësuar kontributin e tyre në flukset tregtare, por sërish ato qëndrojnë larg vlerës së importeve. Ndikimi i eksporteve në volumin tregtar mbetet ende shumë i vogël, edhe pse në disa periudha vihet re se rritja e eksporteve është më e madhe se rritja e importeve.

Defiçiti i vazhdueshëm tregtar ka shoqëruar zhvillimet në tregtinë e jashtme. Si rrjedhojë e këtij fenomeni, fuqia blerëse ka qënë relativisht e lartë, kryesisht për shkak të remitancave të ardhura në tregun vëndas. Ekonomia shqiptare, si një ekonomi e hapur, bëhet gjithnjë e më shumë e ekspozuar dhe e ndikuar jo vetëm nga faktorët të brendshëm por edhe nga faktorët e jashtëm ekonomikë, të cilët e vendosin atë në pozitat e përballjes me një konkurrencë të fortë nga tregu ndërkombëtar. Tashmë ekonomia e vëndit tonë është bërë pjesë përbërëse e nismave për liberalizimin dhe lehtësimin e tregtisë në nivel rajonal. Pjesëmarrja aktive në këto nisma shton mundësitë e ekonomisë sonë për

t'u specializuar dhe njëkohësisht kërkon angazhime në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve. Por, duke qenë se ekonomia shqiptare ndodhet ende në stadin e ekonomive në zhvillim dhe ristrukturim, del si domosdoshmëri shfrytëzimi i burimeve dhe avantazheve krahasuese që ajo ka në raport me ekonomitë e rajonit.

Ecuria dhe nxitja e eksporteve shqiptare

Ecuria e rritjes së eksporteve vitet e fundit është një tregues mjaft pozitiv i rigjallërimit dhe fuqizimit të ekonomisë vëndase. Për këtë arsye shikohet me një vëmendje të veçantë, jo vetëm për faktin se bilanci tregtar rezulton negativ në tërë këtë periudhë tranzicioni drejt ekonomisë së tregut, por edhe për prespektivën e një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë së vëndit. Niveli i vlerave të eksportit dhe gamës së artikujve që eksportohen është një ndër treguesit kryesorë që shpreh shkallën e rritjes ekonomike dhe nivelin e konkurrueshmërisë së saj, në raport jo vetëm me ekonomitë e vendeve të rajonit, por edhe në shkallë më globale.

Në vitet e para të tranzicionit, eksportet kanë qënë të dominuara nga prodhimi i brëndshëm dhe pas vitit 1998 kemi një rritje të eksportit nga përpunimi aktiv. Gjatë viteve 2002-2006, eksportet janë karakterizuar nga një trend pozitiv rritës çka nënkupton dhe përmirësimin dhe rigjallërimin e shumë sektorëve të ekonomisë vëndase. Sigurisht, që kjo rritje reflekton edhe një nga efektet që mund të ketë dhënë zbatimi i marrëveshjes së tregtisë së lirë (MTL) mes vëndeve të rajonit, e cila i ka dhënë shtysë marrëdhënieve tregtare ndërajonale dhe sidomos nxitjes së eksporteve si një nga objektivat kryesore të kësaj marrëveshjeje.

Ekonomia shqiptare u karakterizua nga një rritje relativisht e dobët ekonomike gjatë vitit 2012, si pasojë e pasigurive të larta, e kushteve të shtrënguara të financimit dhe e kërkesës së dobët agregate¹. Ndërkohë që pozicioni i jashtëm ekonomik shfaqet në një situatë më të përmirësuar duke u karakterizuar nga një ngushtim i deficitit tregtar dhe rritjes së flukseve hyrës të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte. Raportit i deficitit të llogarisë korrente ndaj PBB-së shënoi vlerën 9.2% për nëntëmuorin e parë të vitit 2012. Kërkesa e ulët e brëndshme dhe zëvendësimi i mallrave të huaja me to ndikuan në rënien e importeve. Ndërkohë eksportet vijuan rritjen, megjithëse me norma më të ulëta se dy vite më parë.

Pavarësisht ritmit të rritjes, eksportet shënojnë nivele ende të ulëta, sidomos krahasuar me importet. Kjo ka sjellë shqetësime për ekonominë tonë dhe preokupim për të gjetur fusha dhe hapësira për rritjen e eksporteve. Nga ana tjetër, importet janë pjesë e zhvillimit ekonomik por dominimi i tyre dëshmon dobësinë e ofertës vëndase, edhe pse ato përbushin boshllëkun dhe kapërcimin e krizave afatshkurtra në vënd.

Tregu shqiptar përsa i përket treguesit të konkurrueshmërisë klasifikohet në vëndet me konkurrueshmëri të ulët. Kjo ka shërbyer si pengesë për shfrytëzimin e lehtësive që sjellin MTL-të për eksportin e mallrave në rajon.

Rritja e promovimi i eksporteve

Pavarësisht nga sa më sipër, fakti që vëndi ka mundur të eksportoje me sukses disa produkte, është një provë që tregon se ekziston një potencial i përgjithshëm për eksport dhe mund të ngrihet një bazë mbi të cilën mund të bëhen përpjekje për të përmirësuar dhe për të zgjeruar bazën e eksportit. Bilanci tregtar i Shqipërisë vazhdon të jetë negativ, si pasojë e nivelit të ulët të eksporteve. Eksporti i brëndshëm zë një peshë shumë të vogël dhe përfaqësohet kryesisht nga produkte bujqësore. Ekonomia shqiptare nuk ka shfrytëzuar si duhet kapacitetet e brëndshme, kjo edhe për shkak të krizës energjitike e cila ka ndikim të rëndësishëm në rentabilitetin e të gjithë sektorëve të ekonomisë. Aktualisht, në nivelin e ulët të eksporteve ndikojnë edhe shumë faktorë, disa prej të cilëve mund të përmëndim:

↳ Mbizotërimi i punishteve të vogla, kryesisht me pajisje të vjetra të cilat kanë vetëm rëndësi lokale apo rajonale dhe që nuk mund të përbushin lehtësisht kërkesat e tregjeve të Bashkimit

¹Raporti i Bankës së Shqipërisë 2012

European nga pikëpamja e cilësisë dhe higjienës.

↳ Mbizotërimi i njërive prodhuese shumë të vogla bujqësore dhe të pashfrytëzuara, të cilat kanë një potencial të vogël prodhues për treg. Këto njësi kanë vështirësi për marrjen e një kredie për të mundësuar zgjerimin dhe blerjen e mjeteve të tjera për intensifikimin e përdorimit të tokës.

↳ Mungesa e standartizimit të produkteve dhe mungesa e markave të prodhimit vendas.

↳ Shkatërrimi i pjesës më të madhe të strukturave të mëparshme ekzistuese dhe kapaciteteve prodhuese, me përjashtim vetëm të industrisë tekstile, të veshjeve dhe këpucëve.

↳ Shumë drejtues nuk kanë njohuri të mjaftueshme për metodat moderne të drejtimit, pasi ata janë thjesht të orientuar nga prodhimi dhe u mungojnë njohuritë veçanërisht në fushën e marketingut.

↳ Mungesë e infrastrukturës dhe marketing i dobët për përmirësimin e imazhit për zhvillimin turistik të vëndit.

↳ Mungesë informacioni mbi burimet e furnizimit të teknologjive të përshtatshme; pamjaftueshmëria e infrastrukturës për furnizimin me lëndë të para për tregtimin e produkteve dhe përpunimin e tyre.

↳ Vështirësia e grumbullimit të prodhuesve të vegjël, me qëllim grumbullimin e sasive të mjaftueshme për t'i përpunuar për treg dhe për t'i eksportuar ato.

↳ Mungesa e kontakteve të komunitetit të biznesit me partnerë potencial në tregjet e huaja dhe vështirësitë që kanë drejtuesit për të udhëtuar drejt vëndeve me të cilat synohet tregtia.

Sigurisht, që impulse kryesore për rritjen ekonomike do të vijnë nga sektori privat, i cili kontribuon fuqishëm në progresin ekonomik duke u cilësuar edhe si shtylla kurrizore e ekonomisë kombëtare. Por për shumë arsye dhe problematikave që shfaq, sektori privat ende nuk është i aftë për shfrytëzimin e avantazheve konkurruese të Shqipërisë pavarësisht nga mundësia që ofron liberalizimi në praktikë i sistemit të kontrollit shtetëror.

Në sektorin bujqësor është i domosdoshëm përmirësimi i prodhimit bujqësor në sasi dhe thellësi. Për këtë, duhet të modernizohen metodat në bujqësi dhe të paraqiten metoda të reja si bujqësia organike. Kjo kërkon ndërmarrjen e veprimtarive të tilla, të cilat do të rrisnin mundësinë e veprimeve me tokën. Gjithashtu, do të lehtësonin investimet në nivel ekonomie bujqësore, të cilat synojnë përmirësimin e intensifikimit të përdorimit të tokës dhe të produktivitetit të saj, do të përmirësonin njohuritë dhe aftësitë e fermerëve si dhe dëshirën e tyre për të hyrë në marrëdhënie kontraktore ose për të formuar grupe për tregtimin dhe furnizimin me lëndë të para.

Në sektorët jobujqësor, mund të nevojitet nxitja e investimeve, duke patur si qëllim modernizimin e njërive prodhuese. Duhet të freskohen njohuritë teknike dhe ato të marketingut, të formulohet një strategji e veçantë si dhe të krijohet një infrastrukturë e tillë, që të krijoj mundësinë për përmirësimin e shërbimeve.

Një faktor që pengon zhvillimin në të gjithë sektorët është izolimi relativ i prodhuesve dhe i drejtuesve të kompanive shqiptare nga tregjet e synuara. Ndaj, do të duhej mbështetja dhe orientimi i drejtuesve të kompanive shqiptare drejt vëndeve dhe tregjeve të synuara, mbledhja e informacionit për kushtet e tregjeve dhe krijimi i idesë mbi kërkesat e tyre në mënyrë që të prodhojnë bazuar mbi ato kritere.

Është përgjegjësi dhe kompetencë e qeverisë, që të ndërtojë një klimë solide konkurruese për biznesin, të konsolidojë institucionet e tregut, sigurinë e infrastrukturës bazë dhe të inkurajojë teknologjitë inovative dhe kulturën e re ekonomike.

Konkluzione

↳ Nxitja e eksporteve është një mekanizëm shumë i fuqishëm i rregullimeve strukturore, që ka efektin e tij në bilancin e pagesave. Në kuadrin e politikës ekonomike në vënd, zhvillimi i eksporteve konsiderohet si një faktor kyç për përmirësimin e treguesve makroekonomik, veçanërisht nga pikëpamja e përmirësimit të bilancit tregtar dhe e krijimit të vëndeve të punës.

↳ Për përballimin ndaj sfidave të reja të ekonomisë vendase në kushtet e globalizimit, treguesi i drejtpërdrejt i aftësisë konkurruese të ekonomisë në tregjet ndërkombëtare mbetet eksporti.

↳ Ndjekja e politikave promovuese të vëndit dhe potencialeve që ai zotëron; identifikimi

i avantazheve konkurruese dhe zhvillimi i tyre; tërheqja e investitorëve të huaj në vënd mund të jetë një mënyrë racionale për zhvillimin e potencialeve ekzistuese të eksportit, për sigurimin e kapaciteteve të reja të tij, për sigurimin e hyrjes së menjëhershme në treg dhe për krijimin e avantazheve konkurruese dinamike.

📖 Në sektorin bujqësor, qëllim imediat është përmirësimi i prodhimit bujqësor në sasi dhe cilësi. Përmirësimi i infrastrukturës moderne të fermave dhe shtimi i prodhimeve organike. Lehtësimi i investimeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të tokës në përdorim, përmirësimi të njohurive dhe aftësive të fermerëve si dhe nxitja e iniciativës për të formuar grupe për mbledhjen e prodhimeve të tyre dhe për furnizimin me inpute.

📖 Ekzistenca e strategjisë së zhvillimit të eksporteve dhe të strukturës përkatëse për implementimin e saj.

📖 Rritja e aftësisë kredituese nga sistemi financiar bankar drejt sektorit të bujqësisë dhe agroindustrisë.

Rekomandime

Për t'i shërbyer punës së mëtejshme në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar, shumë struktura të qeverisë dhe të biznesit duhet të arrijnë:

~ Të evidentojnë prodhuesit dhe grosistët që merren me eksportimin e prodhimeve të ndryshme të vëndit.

~ Të evidentojnë produktet që janë potencialisht të eksportueshme, por që ende nuk kanë arritur të gjejnë tregje.

~ Të evidentojnë produktet dhe prodhuesit vëndas që kanë nevojë për mbrojtje ndaj importimit të këtyre produkteve. Të evidentojnë produktet që mund të hiqen nga importi, të cilat ekonomia jonë mund t'i prodhojë vet.

~ Të sigurojnë informacionin e nevojshëm mbi çmimet, kërkesat, kompanitë dhe mbi rregullat e tregjeve të jashtme.

~ Të bashkëpunojnë në ngritjen e një institucioni / agjensie për nxitjen e eksporteve, i/e cili/a do të koordinojë aktivitetet vëndase në kooperim me ato të huajat, me qëllim përfshirjen dhe bashkëpunimin e ngushtë midis të gjithë aktorëve, me synim përfitimin nga qëndrimet plotësuese dhe nga efektet e sinergjisë.

~

Literatura

Balassa. (1978). *“Exports and Economic Growth. Further Evidence”*. Development Economics.

E Helpman, P. K. (1985). *“Market structure and foreign trade: Increasing returns, imperfect competition and the international economy”*.

EF Heckscher, B. O. (1991). *The Mit Press “Heckscher-Ohlin trade theory”*.

GM Grossman, E. h. (1991). *“Quality ladders in the theory of growth”*.

WS Jung, P. M. (1985). *“Exports, growth and causality in developing countries”*. *Journal of development economics* .

IHD - Potencializmi i ekonomisë shqiptare

PhD Candidate Aldona Mrruku (Minga)

PhD Candidate Alma Delija

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Abstrakt

Shqipëria është vend me potenciale të mëdha për të tërhequr investimet e huaja direkte, të cilat do të rrisnin së tepërmi mundësitë e saj për një zhvillim të metejshtëm. IHD-të përbëjnë një element shumë të rëndësishëm duke dhënë impakt të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike, për të cilën vendi ynë ka shumë nevojë. Impakti i tyre i drejtpërdrejtë do të ishte në krijimin e vendeve të reja të punës, në transferimin e shpejtë të inovacioneve teknologjike, të mënyrave bashkëkohore të manaxhimit etj, të cilat do të ktheheshin në një burim shumë të vlefshëm e shumë të rëndësishëm nëse mund të përmirësoheshin më tej kushtet për tërheqjen e tyre. Në këtë punim do të trajtoj ecurinë e IHD-ve në Shqipëri dhe masat që duhet të marrë qeveria për përvetësimin e modeleve më të mira në tërheqjen e tyre, në mënyrë që të mos mbetemi pas vendeve të tjera të rajonit të cilat kanë vite me radhë që realizojnë përfitime nga këto flukse hyrëse. Një prezantim i kuadrit teorik të IHD me karakteristikat dhe përfitimet nga IHD-të. Gjithashtu, do të përshkruhen strategjitë dhe politikat për potencializimin e tyre, projektet që do të zbatohen dhe ecuria e bizneseve të huaja që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri. Do të trajtohet pozicioni i Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera, arsyet pse vendi ynë paraqitet më dobët sesa ato në një kohë që në aspekte të përgjithshme shfaq shumë interes për të huajt. Gjithashtu do të trajtojmë të ardhmen e këtyre investimeve në vendin tonë.

Fjalët çelës: IHD- Investimet e Huaja Direkte; Avantazhe Konkurruese; Produktivitet; Inovacion.

Hyrje

Investimet e huaja direkte janë një komponentë i rëndësishëm i rrjedhjes kapitale në globalizimin financiar. Nëpërmjet literaturës së gjërë, gjejmë që IHD-ja është një nga kanalet më të rëndësishme nëpërmjet të cilës financimi ndërkombëtar sjell përfitim ekonomisë (Prasad and others, 2003). Në shumë nga studimet gjejmë të dhëna në mbështetje të përfitimeve si një efekt pozitivë në rritjen e “rrjedhjes” në teknologji. IHD është forma më pak e paqëndrueshme e rrjedhjeve kapitale duke i bërë kështu vëndet më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve të vullshëm të rrjedhjeve. (Kose and others, 2006). Pavarësisht kësaj, shumë vende i konsiderojnë tërheqëse. IHD, si elemente të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. IHD-të kanë një ndikim të madh mbi treguesit kryesorë makroekonomike si për shembull, mbi prodhimin e brëndshëm bruto, bilancin e pagesave dhe mbi punësimin.

IHD-të në ekonomitë në tranzicion të këtyre vëndeve është studiuar shpesh kohët e fundit si për risinë e tij si fenomen ashtu edhe për rëndësinë e tij në rritjen dhe zhvillimin e rajonit.

Eshtë pranuar prej kohësh që përfitimet që sjell IHD për këto vëndet, janë të rëndësishme e përfshijnë prurjen e teknologjive e njohurive të reja në firmat vëndase, “rrjedhjet” e produktivitetit (spillovers), rritje të konkurrencës, si dhe rritjen e mëtejshme të aksesit për eksporte jashtë vëndit. Për më tëpër, IHD është një mënyrë e preferuar e financimit të deficitit korent (i cili është mjaft i lartë në vëndet në tranzicion), meqenëse flukset e IHD nuk krijojnë borxh. Kështu, pavarësisht disa efekteve negative që IHD mund të ketë në vëndet pritëse, për vëndet e Evropës Qëndrore e Lindore është konsideruar si një burim shumë i rëndësishëm për të ndihmuar rindërtimin dhe tranzicionin e tyre në një ekonomi tregu.

Investimet e huaja direkte në Shqipëri kanë qënë një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike, duke ndryshuar gjatë viteve si në formë ashtu dhe në shifra. Megjithatë, Shqipëria është një ndër vëndet më pak të zhvilluara të rajonit, duke shënuar tërheqjen më të vogël të IHD-ve gjatë viteve të tranzicionit.

Rishikimi i literaturës

Sipas përkufizimeve të FMN(1993), Investimi i Huaj Direkt reflekton synimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt) në një njesi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt). Koncepti i “interesit të qëndrueshëm” nënkupton ekzistencën e një marrëdhënieje afatgjatë midis investitorit direkt dhe ndërmarrjes, si dhe të një ndikimi të konsiderueshëm të investitorit në administrimin e procesit të vendim marrjes në ndërmarrje. Investimi direkt përfshin transaksionin fillestar midis dy njësive si edhe të gjitha transaksionet pasuese midis tyre.

Botimi i pestë i Manualit të Statistikave të Bilancit të Pagesave (FMN 1993), përcakton si investitor direkt zotëruesin e 10 % ose të më shumë aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votuese të një kompanie në një vend, duke qënë rezident në një ekonomi tjetër. Gjithsesi, ky përcaktim nuk e bën të qartë dallimin mes Investimit të Huaj Direkt e Investimit të Huaj të Portofolit. Në këtë kuadër, Moosa (2002), argumenton se “Karakteristika e përbashkët e përkufizimeve të IHD-së qëndron në termat si “kontroll” dhe “fuqi vendosese”, të cilat përfaqësojnë tiparin kryesor që dallon IHD-të nga investimet e portofolit, mëqë investitori i portofolit nuk kërkon kontroll mbi ndërmarrjen.” Përgjithësisht, një minimum prej 10 % i mbajtjes së aksioneve, konsiderohet të lejohet aksionerët e huaj të ushtrojnë një influencë të konsiderueshme mbi ndërmarrjen, nese do të zgjidhnin ta bënin.

Tipet e IHD-së

Është e rëndësishme të evidentohen dallimet mes tipeve të ndryshme të IHD-së dhe kompanive investuese, në mënyrë që të jenë më të qarta arsyet për të cilat një kompani vendos të investojë në një vend të caktuar. Autore të ndryshëm i kanë klasifikuar IHD-të sipas pikëpamjeve të ndryshme. Sipas Dunning (1993) identifikoi katër kategori kryesore të investitorëve të huaj, të cilat janë përdorur më pas nga shumë studiues të tjerë në analizat e tyre:

1. Kërkuesi i rëndimentit: motivohet në investimet e tij nga përparësitë e thjeshta të drejtimit të aktiviteteve të shpërndara gjeografikisht (ekonomitë e shkallës dhe diversifikimi i rrezikut). Qëllimi është përfitimi nga përparësitë që mund të ofrojnë ndryshimin në koston e faktorëve të prodhimit, kultura, marrëveshjet institucionale, sistemet ekonomike e politike dhe strukturat e tregut.
2. Kërkuesit e tregut: motivohen nga dëshira për të hyrë në tregjet e vendit pritës ose vendeve fqinjë me të (tregjet rajonale).
3. Kërkuesi i burimeve: ndërmerr një investim të huaj direkt për të përfutur burime/pasuri specifike që janë të disponueshme në vendin pritës me një kosto më të ulët. Këto mund të jenë: burime fizike me kosto më të ulët e siguri oferte; forcë pune e aftë ose gjysmë e aftë, por e lirë dhe e motivuar; mundësi teknologjike si dhe ekspertizë administrimi ose marketingu e aftësi organizuese.
4. Kërkuesi i aseteve: strategjike hyn në një investim të huaj direkt me qëllim përfitimin e një aseti të rëndësishëm, që i përmirëson atij pozicionin konkurrues në treg. Në praktikë ka një ndërthurje midis këtyre kategorive, që e bën të vështirë vendosjen e një kompanie në një kategori të vetme.

IHD-të dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e një vendi

a) Një investim i huaj direkt në ekonominë e një vendi jep efekte direkte dhe indirekte jo vetëm në strukturën teknike të prodhimit por edhe në atë të manaxhimit dhe organizimit të aktivitetit që ajo ndërmerr.

b) Investimet e huaja direkte duhen konsideruar si një penetrim i huaj në cdo instancë të ekonomisë si në planin teknologjik ashtu dhe në atë organizativ. Mbi të gjitha IHD-të kanë një aftësi ristrukturuese dhe ky është kanali kryesor nëpërmjet të cilit përçohen efektet në rritjen e zhvillimit ekonomik.

- c) IHD-të influencojnë në rritjen e punësimit, që ndikon drejtpërdrejt në uljen e papunësisë në vend.
- d) Ka efekte pozitive në treguesit makroekonomik sepse rrit mirëqënien e një vendi. Ndikon në rritjen e të ardhurave buxhetore nëpërmjet rritjes së tatimeve dhe zvogëlimit të nevojës së subvencioneve për shërbimet publike.
- e) Investitorët e huaj kanë avantazhe teknologjike, financiare, manaxheriale për një transformim më të thellë dhe më të shpejtë se sa ata vendas në sektorin ku ato investojnë. Nxitin në zhvillimin social dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. IHD-të kanë efekte më të mira për zhvillim të qëndrueshëm në krahasim me huatë në formën e kredive për shkak të përfshirjes direkte të investuesit në manaxhim dhe reduktim të ngarkesës me borxhe.

Kuadri ligjor aktual për investimet e huaja

Aktualisht një ligj i ri dhe pikërisht ai me Nr. 10303 i datës 15.07.2010 i miratuar nga parlamenti shqiptar shpall krijimin e Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), që është caktuar si agjencia kombëtare për promovimin e investimeve (IPA) dhe do të jetë një aktor shumë i rëndësishëm për thithjen e investimeve të huaja direkte në vend.

Sipas këtij ligji, qeveria shqiptare i ka akorduar kësaj agjencie këto detyra:

- të lehtësojë dhe mbështesë investimet direkte në Shqipëri përmes identifikimit dhe nxitjes të mundësive për investime, duke ofruar shërbime dhe mbështetje për investitorët ekzistues dhe potencialë;
- të rrisë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, si edhe të teknologjive që ato përdorin, duke ofruar mekanizma për të rritur kapacitetet e tyre teknike dhe rritjen e aftësive profesionale;
- të nxisë dhe mbështesë eksportin e mallrave dhe shërbimeve, duke garantuar shërbime mbështetëse dhe asistencë financiare për kompanitë eksportuese dhe për nxitjen e eksporteve.

Efektiviteti për thithjen e investimeve të huaja

Masat që e bëjnë më efektive një politikë të nxitjes së investimeve të huaja janë:

- ✓ rritja e efikasitetit të institucioneve,
- ✓ thjeshtimi i praktikave administrative,
- ✓ krijimi i një regjimi stabil fiskal,

Masa të cilat realisht mund të ulin koston e investimit. Në nxitjen e investimeve të huaja, qeveria luan një rol parësor në hartimin e një kuadri ligjor, institucional dhe rregullator.

Konkurrenca dhe krahasimi në rajon për investimet e huaja

Në përgjithësi vendet e rajonit, po adoptojnë politika të nxitjes së investimeve të huaja të cilat lidhen me liberalizim të mëtejshëm dhe masa promovimi. Kjo ka bërë që ndaj këtij treguesi, të rritet konkurrenca ndërmjet vendeve të rajonit. Megjithatë, roli i politikës për nxitjen e investimeve të huaja, nuk duhet të lihet vetëm me lehtësira fiskale. Investimet e huaja direkte janë një faktor kyç për rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e konkurrueshmërisë dhe prodhimtarisë në tregjet e vendit. IHD sjellin teknologji më të përparuar, njohuri dhe menaxhim si dhe kontakte me klientë të huaj, dhe bëjnë të mundur që ekonomia e vendit të përfitojë nga bollëku i saj në fuqi të aftë punëtore, gjë që duket se ekziston edhe në Shqipëri.

Shqipëria është një vend me potenciale të shumta për investitorët e huaj, por është e rëndësishme të theksojmë faktin se ajo ka nevojë të përmirësojë ndjeshëm performancën e saj. Investimet e huaja direkte janë një element kyç për arritjen e këtij objekti. Fluksi i investimeve të huaja direkte në Shqipëri është më i ulët krahasur me vendet e tjera të rajonit të cilat me përjashtim të Bullgarisë dhe Rumanisë nuk shquhen për tërheqjen e IHD-ve, përveçse në fushën e privatizimeve. Përsa i përket interesit në Ballkan deri tani në raport më të mirë paraqiten Rumania, Kroacia dhe Bullgaria. Situata jo e qetë në Ballkanin Perëndimor është reflektuar dhe në nivelin e investimeve të huaja në këto vende. Megjithëse flukset e investimeve të huaja në Shqipëri kanë qënë në rritje të vazhdueshme, ato

mbeten në nivele shumë të ulëta nëse i krahasojmë me rajonin, kjo si pasojë e:

- Një trashëgimie negative të dëmtimit të rëndë të klimës së biznesit.
- Korrupsionit të përhapur.
- Dobësive rregullatore.
- Riskut të përceptuar ekonomik dhe politik të vendit.

Përfitimet e mundshme të shqipërisë nga IHD-të.

Përfitimet më të mëdha të vendeve pritëse, të marra nga investimet e huaja janë:

- Përfitim teknologjie të avancuar
- Eksperiencë dhe njohuri në manaxhim
- Mundësi për përdorim optimal të burimeve njerëzore
- Krijimi i vendeve të reja të punës që ndikon në uljen e papunësisë
- Diversifikimi i shitjeve të produktit në mënyrë ndërkombëtare
- Nxitja e inovacionit dhe rritja e kërkim zhvillimit
- Rritja e produktivitetit si pasojë e lindjes së konkurrencës.
- Përmirësim i infrastrukturës vendase.
- Mundësi për partnership me firmat e huaja.

Për shumë IHD është besuar se ata kanë kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit pritës. Janë disa elemente që përcaktojnë tendencën e investimeve të huaja në vende të ndryshme kundër më kryesoret janë :

1. Madhësia e tregut dhe ritmet e rritjes së bashku me burimet natyrore
2. Rëndësia e vendodhjes gjeografike
3. Ecuria e privatizimit
4. Ndjeshmëria e IHD-ve ndaj politikave dhe ambjentit të biznesit

Shkaqet e nivelit të ulët të IHD-ve në shqipëri vijnë si rezultat:

Zonat ku janë të përqëndruara IHD-të janë zona më të ardhura të larta dhe infrastrukturë të zhvilluar, ndërsa në qytetet e tjera ato janë tepër të kufizuara.

Shkaqet e një niveli të ulët të IHD-ve janë:

- ❖ Problemi i imazhit është një drejtim ku do të përqëndrohet puna në të ardhmen për të siguruar një ndryshim të shpejtë të imazhit për Shqipërinë në vendet e huaja.
- ❖ Problemet dhe konfliktet e IHD me pronësinë mbi tokën, proçedurat burokratike për rregjistrimin e të drejtave të pronësisë, për aprovimin dhe dhënien e lejeve të ndërtimit kanë krijuar gjithmonë një barrierë për investimet e huaja.
- ❖ Proçesit të ngadalshëm të privatizimeve, ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha të shtetit në sektorët industriale me intensitet të lartë kapitali, dhe sektorëve strategjike si energjia, telekomunikacioni.
- ❖ Mungesa e efikasitetit dhe kostoja e lartë e infrastrukturës (transport, energji, ujë) si dhe mungesa e parqeve industriale për IHD-të të orientuara nga eksporti dhe turizmi. Ndonëse ekziston një ligj që lejon krijimin e zonave të lira dhe parqeve industriale deri tani në Shqipëri nuk është krijuar ndonjë zonë e lirë apo park industrial.
- ❖ Pamjaftueshmëri e shërbimeve financiare, bankare dhe jobankare (nivel i ulët i kreditimit, cilësi e ulët e shërbimeve financiare për tregëti ndërkombëtare, shkalla e lartë e interesit, kërkesat e larta për kolateral, shërbimet e kompanive të sigurimit, etj).
- ❖ Infrastruktura e dobët konkretisht në sistemin e transportit, energjitikës dhe ujësjellësit. Të gjitha problemet që ekzistojnë në këto sektorë, ndikojnë në rritjen e koston së operimit në vendin tonë.

Politikat dhe drejtimet strategjike në fushën e IHD-ve në shqipëri

Investimet e huaja të deritanishme janë orientuar në ato sektorë të cilët për vete karakteristikat

e tregut dhe të tranzicionit në Shqipëri mund të ofronin mundësi më të mëdha në rikthimin e investimeve dhe kontrollin e risqeve të këtij tregu. Vendi ynë është në garë me vendet e rajonit përse i përket thithjes së këtyre investimeve të huaja direkte. Politikat e nxitjes së investimeve të huaja direkte në Shqipëri do të ndikojnë në rritjen e shkallës së punësimit.

Disa nga këto politika që do të ndiqen në vendin tonë janë:

➤ Politikat për Fuqizimin e Integritimit Tregtar. Shtylla kryesore e strategjisë afatmesme të Shqipërisë duhet të jetë zbatimi i politikave për fuqizimin e tregtisë bashkëpunim më të madh me BE, 1) zbatimi i plotë i MSA me BE dhe 2) zbatimi i plotë i Marrëveshjeve të Shqipërisë për Tregtinë e Lirë me vendet fqinjë të Evropës Jug-Lindore;

➤ Politikat mbështetëse në fushën e investimeve, do të vazhdojnë të thellohen në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit, infrastrukturës fizike, shërbimet utilitare, si dhe përmirësim i vazhdueshëm i kuadrit rregullator që ndikon në reduktimin e kostos së investimit në Shqipëri.

➤ Industritë e reja në kushtet e një konkurrence gjithnjë e më të hapur do të lindin nga inovacionet teknologjike, nga lindja e nevojave të reja të konsumatorëve ose nga ndryshime të tjera ekonomike dhe strategjike që ngrenë një produkt të ri ose një shërbim të ri në nivelin e një mundësie biznesi potencialisht të ndjeshëm.

During the recent years the operational structure for the implementation of the pre-accession assistance in the rural development field has been created and strengthened. Considerable training has been provided for the staff, mainly through the technical assistance projects and the use of TAIEX. The institutional and the legal framework of the food safety system has been updated. Two mass vaccination campaigns were conducted, the one against brucellosis in small ruminants, which has reduced the spread of the disease, and the vaccination against rabies which has reduced the risk of further spread of the disease, not only in Albania but also in the neighboring countries.

The issues of food safety, veterinary and phytosanitary policy will be addressed through the actions for the first period under the IPA II programme (2014-2017). The sector wide approach will be applied, if the condition allows it.

Funding arrangements

The reform and the capacity building process will be supported by: the twinning, the services and possible supplies contracts. The grants contracts can be used to support other services. The support can also be achieved through indirect management by other organizations. IPA II multi-year support in the rural development field will be provided through the funding arrangements under the Rural Development Programme (IPARD), once the program becomes operational. IPARD management

is carried out through indirect management from Albania.

Risks

The risks associated with the politically sensitive and the available resources as well as the mitigation measures through the monitoring and reporting development, should be also applied to this sector. In addition, the risks related to the delays in the implementation of the property rights reforms affect the development of the land markets, which will lead to restrictions on obtaining loans as well as on the development of agriculture and rural areas.

Due to the low awareness of the society and of the economic operators mainly in the agri-food sector regarding the environment and the safety standards, the acceptance of the reforms is jeopardized. The increasing awareness of the sensitive issues on the economic and the cultural context, would be a possible answer to address this risk.

Conclusions

Regional differences in accordance with the resources, the geographical location, the infrastructure, the climate should be taken into consideration when making strategic decisions.

Generating income by the women and the young entrepreneurs in rural areas requires: (i) the development of the activities that support the youth's involvement in these areas with the activities which generate income, as well as (ii) increasing the professional qualification opportunities for their integration into the economic life.

Accelerating the pace of poverty reduction requires well coordinated programmes in accordance with the approaches of the integrated rural development and the balanced regional development, the focus of which is the target group (especially the youth and the women). Since the agriculture is the main activity of these areas, the regional and the rural development policies need to coordinate better the regional measures and to continue to support the efficiency growth of this sector as well as the farm incomes growth.

Also, the various public institutions as well as the development programs need to work towards the better liaison between the value chain actors, in order to improve the flow of goods as well as a more balanced distribution of benefits between chain actors

Bibliography

http://ec.europa.eu/enlargement/instruments/funding-by-country/albania/index_en.htm
<http://www.fao.org/docrep/015/i2119e/i2119e00.pdf>
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/financial_assistance/ipa/2014/231-2014_ipa-2-reg.pdf
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_albania_2011_2013_en.pdf
<http://www.bujqesia.gov.al/>

Liberalizimi i sigurimit të detyrueshëm motorrik – kërkesë e tregut apo plotësim kriteri

Prof As. Dr. Gentiana Sharku – Fakulteti i Ekonomisë, UT

Dr. Etleva Bajrami - Fakulteti i Ekonomisë, UT

Abstrakt

Shoqëritë e sigurimit janë përgjegjëse për një pjesë të konsiderueshme të kursimeve të qytetarëve, të cilat kanalizohen në sistemin financiar nëpërmjet kontratave të sigurimit. Kontrata e sigurimit përmban premtimin e shoqërisë së sigurimit për të paguar dëmin në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar. Pra në këtë rast konsumatori ble një premtim për tu mbajtur në të ardhmen nga shitësi – shoqëria e sigurimit. Për këtë arsye mund të themi që sigurimi është një produkt i paprekshëm, “defekti” i të cilit mund të zbulohet nga konsumatori atëhere kur është shumë vonë – pasi ka bërë kërkesën për dëmshpërblim dhe shoqëria e sigurimit mund të mos ketë likuiditete të mjaftueshme për të kryer pagesat e dëmshpërblimeve. Kjo përbën një nga arsyet se pse shoqëritë e sigurimit duhet të mbikqyren nga shteti. Rregullimi i tregut të sigurimeve përfshin të gjitha aspektet e veprimit të shoqërive të sigurimit, duke filluar nga krijimi deri tek likuidimi i saj. Një nga çështjet e rregulluara nga shteti është edhe përcaktimi i primit, që është çmimi që paguajnë qytetarët për policën e sigurimit.

Në një treg të konkurrencës së lirë, çmimi për një produkt përcaktohet nga kërkesa dhe oferta. Por për vet natyrën e veçantë të sigurimit, konkurrenca jo gjithmonë vepron në avantazh të konsumatorit dhe shpesh qeveritë janë të detyruara të zëvendësojnë konkurrencën e pakontrolluar me rregullimin e çmimeve. Çështja që duhet të zgjidhin rregullatorët është se sa liri duhet tu japin shoqërive të sigurimit në përcaktimin e çmimit. Në Shqipëri që në vitin 2011 tregu i sigurimit motorrik të detyrueshëm është liberalizuar për sa i përket lirisë së shoqërive të sigurimit në përcaktimin e primit. A përbën liberalizimi një veprim të parakohshëm për tregun tonë të sigurimeve? Kësaj pyetje do mundohemi ti japim përgjigje nëpërmjet këtij punimi, duke analizuar efektet e liberalizimit në çmimin e policave të sigurimit, volumin e tregut të sigurimeve, raportin e dëmit dhe eksperiencën e vendeve të zhvilluara dhe të rajonit.

Hyrje

Liberalizimi i tregut të sigurimeve është pjesë e procesit të liberalizimit të ekonomisë shqiptare që ka filluar menjëherë pas rënies së diktaturës dhe hapjes së Shqipërisë me vendet e tjera. Krahas liberalizimit të tregtisë, lëvizjes së lirë të njerëzve është kryer edhe liberalizimi i sektorit financiar, pjesë përbërëse e të cilit është edhe tregu i sigurimeve. Tregu i sigurimeve ka pësuar zhvillime të rëndësishme vetëm pas liberalizimit të tij në vitin 1999. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë i orientuar drejt sigurimit të detyrueshëm, veçanërisht atij motorrik. Gjatë kësaj periudhe situata në tregun e sigurimeve është paraqitur mjaft kaotike dhe problematike, zgjidhjen e së cilës rregullatori dhe ligjvënësit në bashkëpunim me asistencën e huaj, janë përpjekur ta gjejnë nëpërmjet liberalizimit të plotë të këtij tregu. Por fjala “liberalizim” nuk duhet të keqkuptohet. Liberalizim nuk nënkupton heqje dorë nga rregullimi i tregut, por nënkupton procesin gjatë të cilit qeveria duhet të ndërmarrë veprime për të lëvizur drejt një tregu liberal.

Përse duhet rregulluar tregu i sigurimeve?

Në përgjithësi me rregullim të një subjekti, tregu apo industrie kuptojmë “një ligj, një VKM, një udhëzim apo rregullore të lëshuar nga autoriteti rregullator”. Ndryshe mund të themi se rregullatori vendos rregullat me të cilat luhet “një lojë”. Si në çdo treg, edhe në tregun e sigurimeve rregullat kanë për qëllim kufizimin e lirive të njëjës palë me qëllim krijimin e lirive për palën tjetër (palët e tjera). Për shembull shoqëritë e sigurimit duhet ti miratojnë paraprakisht kontratat e sigurimit tek Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) që është subjekti që mbikqyr tregun e sigurimeve në Shqipëri. Ky kufizim lirie që u imponohet shoqërive të sigurimit krijon liri për konsumatorët, që të mos dëmtohen nga blerja e policave me kushte të pafavorshme.

Qëllimi kryesor i rregullimit të tregut të sigurimeve është mbrojtja e interesave të konsumatorit – të të siguruarit në këtë rast. Sigurimi është një produkt me natyrë të veçantë. Ai është një produkt i paprekshëm dhe defekti i tij mund të zbulohet shumë vonë – vetëm pasi ka ndodhur dëmi dhe i siguruari të ketë paraqitur kërkesën për dëmshpërblim. I siguruari nëpërmjet policës së sigurimit ble një premtim nga shoqëria e sigurimit që pritet të mbahet në të ardhmen, në rast se i siguruari pëson dëm financiar. Në këtë rast nuk vlen premtimi, por gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit, sepse për konsumatorin rëndësi ka se sa shpejt dhe drejtë do të dëmshpërblehet nga shoqëria e sigurimit në rast ndodhjes së dëmit. Por një konsumator tipik e ka të pamundur të vlerësojë individualisht aftësinë paguese të një shoqërie sigurimi. Për këtë arsye një nga detyrat e AMF është monitorimi i aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit. Aftësi paguese nënkupton mundësinë e një shoqërie sigurimi për të shlyer detyrimet në kohë – pra për të vlerësuar drejt kërkesat për dëmshpërblim që i paraqiten nga të siguruarit dhe të kryejë pagesat e tyre sa më shpejt. Burimi kryesor i të ardhurave për një shoqëri sigurimi janë primet që arkëton nga të siguruarit. Primi është çmimi i sigurimit. Në një treg të konkurrencës së lirë, çmimi për një produkt përcaktohet në bazë të kërkesës dhe ofertës për të. Kushtet e konkurrencës së lirë janë vështirë të realizohen në tregun e sigurimeve, ku veçanërisht problem i asimetrisë së informacionit është shumë i dukshëm. Për këtë arsye konkurrenca e lirë në rastin e tregut të sigurimeve, jo gjithmonë punon në favor të konsumatorit. Kjo edhe për faktin se siguresit duhet ti vendosin çmimet e tyre përpara se kostot të jenë plotësisht të njohura. Ndryshe nga bizneset e tjera, një siguresi i duhet të presë shumë vite që të njoh saktësisht koston e sigurimit. Nëse një siguresi i mbivlerëson kostot e veta shoqëria do të ketë fitime; por konsumatorit i duhet të paguajë një çmim relativisht të lartë. Nëse siguresi i nënvlerëson kostot, atëhere shoqëria do të gjendet në paaftësi paguese. Për konsumatorin do të ishte edhe më keq nëse i blinte policat me çmim të ulët dhe shoqëria e sigurimit nuk do e mbante premtimin për dëmshpërblim sepse nuk do të kishte mjete financiare për të likuiduar të dëmtuarit. Një konsumator i cili nuk këshillohet nga një ekspert i fushës, nuk mund të jepte një gjykim të drejtë mbi mjaftueshmërinë e tarifave të primit. Për të kontrolluar konkurrencën e “pandershme” një nga alternativat është rregullimi ligjor i tarifave të primit. Çështja që shtrohet para rregullatorit është: Sa liri duhet tu jepet shoqërive të sigurimit në përcaktimin e çmimit?

Përse duhet liberalizuar tregu i sigurimeve?

Liberalizimi i tregut shqiptar të sigurimeve mund të shihet në dy drejtime: si proces i hapjes drejt tregut privat të sigurimeve dhe si proces i globalizimit, një tendencë kjo që ka përfshirë një pjesë të madhe të vendeve në Evropë dhe botë.

Sikurse edhe sektorët e tjerë financiarë apo ekonomikë në Shqipëri, edhe tregu i sigurimeve ishte një treg i monopolizuar nga shteti. Por ndryshe nga sektori bankar, ku shteti e humbi pozicionin e tij monopolistik menjëherë që në vitin 1991 me krijimin e bankës së parë Italo-Shqiptare (joint-venture), në tregun e sigurimeve shteti vazhdoi të kishte pronësi të vetme mbi të vetmen shoqëri sigurimesh INSIG edhe për tetë vjet të tjera, pas krijimit të saj. Vetëm në vitin 1999 kemi liçensimin e dy shoqërive të para private të sigurimit. Sigma dhe Sigal. Në vitet në vazhdim u liçensuan edhe tetë shoqëri sigurimi jo-jete dhe dy shoqëri sigurimi jete.

Edhe pjesmarrja e kapitalit të huaj në tregun e sigurimeve është shumë e vonuar. Nëse në sektorin bankar hyri, siç e përmendëm më lart, që në vitin 1991, në tregun e sigurimeve hyri në vitin 2007 me pjesmarrjen në tregun shqiptar të sigurimeve të Asipis Group, Uniqa Group dhe Vienna Insurance Group. Deri në vitin 2013 kapitali i huaj përbënte 63,28 përqind të totalit të kapitalit të tregut të sigurimeve.

Edhe sot, nëse sektori bankar është privatizuar plotësisht, kompania e vetme e sigurimeve shtetërore nuk është privatizuar ende, duke i lënë shtetit një pjesëmarrje 2,44 përqind në terma të kapitalit aksionar të investuar në tregun e sigurimeve.

Gjithsesi edhe tregu i sigurimeve, me ndryshimet që kanë ndodhur në ekonomi pas viteve nëntëdhjetë, ka filluar rrugën e gjatë drejt liberalizimit të tij.

Treg liberal sigurimesh quhet ai treg në të cilin është tregu që përcakton se :

- kush duhet të shesë sigurim;
- çfarë produktesh duhet të shiten;
- si duhet të shiten produktet; dhe
- me çfarë çmimi duhet të shiten produktet,

duke lejuar vetëm disa ndërhyrje ekonomikisht të justifikueshme të qeverisë (Skipper 2000).

Që me ligjin nr. 9267 të vitit 2007, të shfuqizuar më pas me ligjin nr. 52 të dates 22.05.2014, tregu i sigurimeve në Shqipëri nuk imponon dallime lidhur me strukturën dhe pronësinë midis shoqërive të sigurimit me kapital vendas dhe atyre me kapital të huaj. Në këtë drejtim tregu i sigurimeve është njësoj i hapur edhe për investitorët e huaj.

Shoqëritë e sigurimit kanë të drejtën e pajisjes me licensë nga AMF, për çfarëdo klase rreziku që dëshirojnë të sigurojnë, por vetëm pasi plotësojnë detyrimin ligjor të fondit të garancisë.

Shoqëritë e sigurimit hartojnë policat e tyre individuale të sigurimit, të hartuara sipas politikës dhe filozofisë që ndjek secila shoqëri sigurimi për plotësimin e nevojave të klientëve të saj. Atyre nuk u imponohet shitja e një kontrate të hartuar nga AMF. Por atyre u kërkohet që kontratat e sigurimit që shesin të miratohen paraprakisht nga AMF – detyrim që përdoret në interes të të siguruarit. Për shkak të shkallës së lartë të ndërlkueshmërisë së ndërtimit të kontratave të sigurimit dhe disa njohurive specifike që duhet të kenë, të siguruarit e kanë të vështirë të kuptojnë gjuhën e kontratave të sigurimit.

Së fundi që tregu i sigurimeve të jetë liberal, sipas Skipper, duhet të jenë shoqëritë e sigurimit që të vendosin çmimin me të cilin duhet ti shesin produktet në treg. Në vitin 2011 thuhet se është kryer liberalizimin i plotë i tregut të sigurimeve në Shqipëri sepse në këtë vit, me ligjin nr. 10455 u vendos që çmimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik të përcaktohet nga tregu, sikurse ishte vendosur edhe për llojet e tjera të sigurimit. Ky liberalizim i çmimeve në tregun e sigurimeve është bërë në kohën e duhur, të kërkuar nga tregu, apo është një veprim i parakohshëm? A ka rregulluar liberalizimi problemet me të cilat ndeshet tregu i sigurimit të detyrueshëm motorrik në Shqipëri?

Zhvillimi dhe problemet e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorrik

Shoqëritë e sigurimit në Shqipëri licensohen për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit për një rrezik të veçantë, për një klasë rreziku apo edhe disa klasa rreziqesh. Në Shqipëri operojnë tetë shoqëri sigurimi jo jete, dy nga të cilat (Insig dhe Sigal) janë licensuar për të ushtruar aktivitetin në 15 klasa sigurimi, katër prej tyre ushtrojnë aktivitetin në 14 klasa sigurimi, një në 13 klasa dhe një vetëm në 10 klasa sigurimi. Vihet re fakti se të gjitha shoqëritë e sigurimit janë licensuar për klasën e dhjetë që përfshin sigurimin e detyrueshëm motorrik. Kjo është e kuptueshme sepse shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri pjesën më të madhe të primeve (më shumë se gjysmën), që përbën burimin kryesor të të ardhurave për to, e arkëtojnë nga shitja e policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik.

Tabela 1.1 Tregues të zhvillimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorrik (mijë lekë)

	2010	2011	2012	2013
Totali i primeve të shkruar bruto nga akt. sig.	8.207.485	8.335.740	8.949.777	8.535.427
Totali i primeve të shkruar bruto të sig. jo jetë	7.303.020	7.251.260	8.041.200	7.521.570
Totali i pr. të shkruar bruto të sig. det. mot.	4.242.526	3.727.115	4.557.691	3.865.795
% ndaj primeve të sig. jo jetë	58%	51%	57%	51%
% ndaj totalit të primeve të sig.	52%	45%	51%	45%
Nr. Kontratave - klasa 10	412.364	444.710	471.955	498.323
Primi mesatar për kontratë	10.288	8.381	9.657	7.758

Meqënëse në këtë punim, do shqyrtojmë liberalizimin lidhur me çmimin e sigurimit të detyrueshëm, do të përqëndrohemi në mënyrën e përcaktimit të çmimit të sigurimit, pra primit. Sigurimi i detyrueshëm motorrik është sigurim përgjegjësie ndaj palëve të treta, i njohur shkurtimisht me inicialet MTPL (motor third part liability). Në sigurimin e përgjegjësive motorrike ndaj palëve të treta përfshihen tre lloje policash sigurimi: MTPL e brendshme, Kartoni jeshil dhe Sigurimi kufitar.

Tabela 1.2 Përbërja e portofolit të MTPL në termat e primeve të shkruar bruto (mijë lekë)

	2010	2011	2012	2013
MTPL	4.242.526	3.727.115	4.577.691	3.865.795
MTPL e brendshme	2.932.985	2.205.176	3.369.914	2.743.565
Kartoni jeshil	896.273	1.102.217	688.197	723.852
Kufitare	413.268	419.722	519.580	398.377

Burimi: Buletini statistikor, AMF

Siç vihet re edhe nga Tabela 2.1 pjesa më e madhe e primeve (në vitin 2013 është 71 përqind) arkëtohet nga policat e sigurimit të detyrueshëm motorrik për mjetet motorrike që qarkullojnë brenda territorit shqiptar. Ndryshe nga llojet e tjera të sigurimeve, sigurimi i përgjegjësive i drejtuesit/pronarit të mjetit motorrik, për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta rregullohet me një ligj të veçantë, ligjin nr. 10 067 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Ky ligj, që ka hyrë në fuqi në datën 12.02.2009 (i ndryshuar me ligjin nr. 10455, siç do e shpjegojmë në vazhdim) përcaktonte se primi i pastër i sigurimit të detyrueshëm motorrik përcaktohet nga Ministri i Financave. Primi i pastër quhet pjesa e primit që paguhet nga i siguruari (primi bruto) që shkon për mbulimin e dëmshpërblimeve që paguan shoqëria e sigurimit. Shpenzimet për dëmshpërblime përbëjnë zërin kryesor të shpenzimeve të një shoqërie sigurimi, por nuk janë të vetmet. Shoqëria e sigurimit duhet të bëjë edhe disa shpenzime shtesë për marrjen në sigurim dhe shpenzime administrative që të kryejë funksionet e saj. Nga ana tjetër si biznes i krijuar me qëllim fitimi, duhet të sigurojë edhe fitim për aksionerët e saj. Të gjithë këto elemente shtesë i shtohen primit të pastër për të arritur tek primi bruto që duhet të paguajë i siguruari. Me rregulloren nr. 622/1 të AMF ishte përcaktuar një kufi tavan të kësaj shtese – deri 25 përqind të primit bruto. Pra në këtë mënyrë përcaktohej një kufi dysheme për primin e pastër që lidhet me kërkesën që primi të jetë i mjaftueshëm, dhe një kufi tavan për shpenzimet e tjera dhe fitimin që lidhet me kërkesën që primi nuk duhet të jetë shumë i lartë, i papërbalueshëm nga qytetarët. Në këtë mënyrë, u imponohej shoqërive të sigurimit, një prim minimal bruto me të cilin duhet të shiteshin policat e sigurimit. Në fakt, nuk ndodhi kështu. Shoqëritë e sigurimit, veçanërisht shoqëritë e reja të sigurimit, për të fituar pjesë të tregut, filluan të shisnin policat e sigurimit nën këtë çmim, që do të thotë se me siguri ato nuk do të kishin mjete të mjaftueshme financiare për të paguar dëmshpërblimet. Një dukuri e tillë duket qartë po të vërejmë raportin dëme/prime, i cili është shumë i ulët në krahasim me kufirin minimal të tij të përcaktuar nga testet IRIS (treguesit e paralajmërimit të hershëm të aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit).

Tabela 1.3 Të dhëna nga llogaria teknike: Sigurimi MTPL e brendshme

	2009	2010	2011	2012	2013
Raporti dëme prime	32,17%	35,81	61,66	44,71	58,41
Raporti i shpenzimeve të marrjes në sigurim	22,57	21,72	24,2	21,61	31,55
Raporti i shpenzimeve administrative	37,63	37,64	42,24	28,25	54,96

Në kushtet kur sipas statistikave 27% e automjeteve kanë qenë të pasiguruara, raporti dëme/prime duhet të ishte edhe më i lartë nga ai i kërkuari. Në të vërtetë është më i ulët, që do të thotë që ose shoqëritë e sigurimeve sigurojnë drejtues automjeteve me risk ulët (që nuk pësojnë dëme) ose nuk kryejnë pagesa të drejta të dëmshpërblimeve.

Sigurisht i takonte Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të kontrollonte zbatimin e ligjit, pra primin me të cilin shiteshin policat e sigurimit të detyrueshëm në treg. Për shkak të trendit në ulje të primit me të cilin shiteshin policat e sigurimit të detyrueshëm, në bashkëpunim me Bankën Botërore, u vendos të kalohej nga një kontroll i plotë mbi çmimin në liberalizimin e plotë të tij. Për këtë arsye, në vitin 2011, u aprovua Ligji nr. 10455, datë 21.07.2011, sipas të cilit u lejua që primi i sigurimit të detyrueshëm të vendosej lirisht nga kërkesa dhe oferta në treg, pra nga shoqëritë e sigurimit. Autoriteti, në funksion të mbikqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit kërkonte aprovimin paraprak të tarifave dhe krijimin e nivelit minimal të rezervave teknike të mbajtura nga shoqëritë e sigurimit.

Mbikqyrjen e aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit, AMF do e bënte jo drejtëpërdrejtë nëpërmjet kontrollit të primeve, por nëpërmjet kontrollit të rezervave (provigjoneve) teknike. Rezervat teknike tregojnë detyrimet që ka shoqëria e sigurimit ndaj policëmbajtësve dhe përfituesve të tyre. Duke kërkuar një nivel minimal të rezervave teknike, AMF sigurohet për aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit. Në këtë mënyrë u plotësua edhe kërkesa e katërt për liberalizimin e plotë të tregut të sigurimeve dhe në kuadrin e plotësimit dhe përshtatjes së legjislacionit tonë me atë të BE, u përmbush edhe kriteri i liberalizimit të çmimit të të gjitha policave të sigurimit. Por liberalizimi i çmimit të policave të sigurimit solli një çrregullim të vërtetë të tregut. Primit u luhatën shumë brenda një periudhe të shkurtër kohe, madje në vitin 2013 primi përgjysmohej apo dyfishohej brenda javës. Siç shihet nga tabela 1.3, primi mesatar i arkëtuar për një kontratë sigurimi MTPL, në vitin 2012 është rritur në krahasim me një vit më parë, por në vitin 2013 është ulur përsëri, por gjithnjë duke qëndruar nën primin mesatar të vitit 2010. Një nga kriteret që sistemi i primeve të jetë optimal, është që duhet të jetë i qëndrueshëm, të paktën brenda një periudhe të caktuar kohe. Është e natyrshme që me kalimin e kohës të rritet për të pasqyruar edhe rritjen e riskut për shkak të rritjes së trafikut. Madje shpesh rritja dhe ulja e primit bëhej me marrëveshje midis shoqërive të sigurimit, dukuri kjo që vazhdon edhe në ditët e sotme, pavarësisht hetimeve dhe masave që janë marrë nga Autoriteti i Konkurrencës kundër kufizimeve të konkurrencës së lirë në tregun e sigurimeve (i cili ka konstatuar se 96,9% e primeve të raportuar nga AMF për muajin janar 2014 janë arkëtuar vetëm nëpërmjet sistemit të administruar nga shoqëria Star Broker). Pavarësisht luhatjes së primeve, nuk është arritur rritja e dëshirueshme e tyre. Tarifat e primit të zbatuara nga shoqëritë shqiptare të sigurimit akoma mbeten në nivele shumë më të ulta krahasuar me ato në rajon, siç tregohet në Tabelën 1.4.

Tabela 1.4 Primi mesatar i sigurimit të detyrueshëm motorrik (euro)

	2011	2012	2013
Kosove	106	137	134
Mal i Zi	160	165	-
Maqedoni	117	90	88
Shqipëri	60	70	55

Burimi: www.xprimm.com

Në këtë moment shtrohet pyetja nëse AMF do ta ketë më të lehtë të monitorojë nivelin e rezervës teknike apo të monitoronte çmimin e shitjes së policave të sigurimit në treg, veçanërisht në kohën e sotme kur kërkohet pagesa e primeve në banka dhe deklarim online i policave të sigurimit të detyrueshëm? Ndoshta liberalizimi ka qenë i inxituar? Përgjigjen kësaj pyetje mund ta japim nëse

shohim edhe eksperiencën e vendeve të tjera. Italia ka liberalizuar tarifatat e primit të sigurimeve motorrike vetëm në vitin 1994, pas qindra vitesh histori sigurimesh. Vendet e rajonit si Maqedonia, Mali i zi, Serbia dhe Bosnja Herzegovina akoma nuk e kanë liberalizuar çmimin e policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik, të cilat pavarësisht se nuk kanë një treg të zhvilluar sigurimesh, kanë tregues më të mirë se tregu shqiptar i sigurimeve. Kjo duket qartë nga raporti i dëmeve dhe shpenzimeve i paraqitur Tabelën 1.5 për vendet e rajonit. Përveç Serbisë, për të cilën treguesit i përkasin vitit 2012, për vendet e tjera treguesit i përkasin vitit 2013. Për Shqipërinë ka një ndryshim të vogël midis shifrave të paraqitura në Tabelën 1.5 dhe atyre të paraqitura në Tabelën 1.3 për shkak të burimeve të ndryshme të të dhënave. Gjithsesi raporti i shpenzimeve për shoqëritë shqiptare të sigurimit është raporti më i lartë nga të gjitha vendet e rajonit, ndërkohë që kufiri maksimal i tij sipas treguesve IRIS duhet të jetë 50%.

Tabela 1.5 Raporti i dëmeve dhe shpenzimeve për tregun e sigurimit MTPL në rajon

	Maqedoni	Mali i zi	B. & Herz.	Shqipëri	Serbi
Raporti dëme prime	52,50%	35,00%	30,00%	59,40%	67,20%
Raporti i shpenzimeve	51,70%	50,00%	46,00%	78,80%	43,90%
Raporti i kombinuar	104,20%	85,00%	76,00%	138,20%	111,10%

Burimi: The international Insurance Forum, Instanbul, 2014

Në vend të liberalizimit të shpejtë të çmimit të sigurimit, do të ishte më mirë që përpjekjet për rregullimin e problemeve në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik të drejtoheshin drejt sistemit bonus-malus, sistem të cilin vendet e tjera në rajon (përveç Malit të zi) e kanë vënë në zbatim prej kohësh (Maqedonia në vitin 2006, Serbia në vitin 2011). Sistemi bonus-malus përcakton një prim të pastër bazë i cili ullet dhe rritet në varësi të riskut të drejtuesit të mjetit motorrik. Ka mbi dy vjet që ka përfunduar projekti i sistemit bonus-malus me Bankën Botërore, por ende nuk është vënë në zbatim. Duke u nisur edhe nga përvoja e vendeve të tjera, mendojmë se do të ishte më mirë vendosja e primit të pastër dysheme dhe aplikimi mbi të i sistemit bonus malus. Në këtë mënyrë reduktohet problem i zgjedhjes së pafavorshme, sepse secili i siguruar paguan çmimin që i takon dhe njëkohësisht përbën një sistem nxitës për uljen e numrit të dëmeve dhe kërkesave për dëmshpërblim.

Përfundime

Liberalizimi është një proces që zgjat në kohë dhe nuk mund të arrihet vetëm me aprovimin e ligjeve apo marrëveshjeve midis rregullatorit dhe shoqërive të sigurimit apo edhe institucioneve ndërkombëtare. Ai duhet të ecë paralelisht me nevojën dhe potencialet e tregut - pra duhet të diktohet nga tregu dhe jo nga kërkesa e institucioneve ndërkombëtare. Liberalizimi i tregut të sigurimeve nuk solli efektet e dëshiruara në treg: rritjen e numrit të makinave të siguruar, rritjen e pagesave të dëmshpërblimit nga shoqëritë e sigurimit, uljen e çmimit të sigurimit dhe qëndrueshmëri të tregut të sigurimeve. Në kushtet kur sigurimi i detyrueshëm motorrik, në shumicën e rasteve blihet vetëm se jemi të detyruar ta blejmë, në interes të të siguruarve që kërkojnë ti blejnë policat me çmim sa më të ulët, do të ishte zbatimi i sistemit bonus-malus, ku secili do të paguante për riskun që paraqet. Në kushtet e deklarimit online të policave të sigurimit dhe të pagesave bankare të primit, do të ishte më mirë rivendosja e çmimit minimal të detyrueshëm të sigurimit, pasi në këto kushte të reja AMF do ta ketë më të lehtë kontrollin e aftësisë paguese drejtëpërdrejtë nëpërmjet verifikimit të primit.

Literatura

- Autoriteti i konkurrencës, *Vendim Nr. 310*, datë 31.01.2014
- AMF, *Raporti vjetor* 2010, 2011, 2012, 2013
- AMF, *Buletini Statistikor*, 2010, 2011, 2012, 2013
- Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”
- Ligji nr. 10067, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”
- Ligi nr. 10 455, datë 21.07.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10067, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- AMF, Rregullore nr. 622/1, *Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta*”
- Harold D. Skipper, Jr. C.V. Starr, J. Mack Robinson (2000), *Liberalisation of insurance markets: issues and concerns*.
- Raportimi vjetor i kryetares së AMF në KEF në Kuvendin e Shqipërisë, prill 2014 “*Veprimtaria e AMF gjatë vitit 2013*”.
- Klime Proposki, (2014), *Prons and cons for the MTPL Tariiffs liberalization in the challenging environment of a soft pricing and highly competitive market*, IIF, Istanbul
- James L. Athearn, S. Travis Pritchett, Joan T. Schmit, 1989, *Risk and Insuranc*”, sixth edition,.
- Harrington Niehaus (2004), *Risk management and insurance*, second edition,

Investment and Business Development Strategy in Albania

Msc. PhD Process Armalda Recic
Rajonal manager of consumer loan , Credins Bank

Abstract

The strategy of development of business and the investment 2013-2020, document constitutes the basis for the identification and implementation of national policies for promoting business and investment for the period 2013-2020. The document is designed as a continuation and an expansion of the predicted policy for the period 2007 - 2013, and is designed on the basis of findings (conclusions) and achieved after a detailed analysis of indicators and needs identified during the period 2007-2013.

The strategy is in compliance with the main documents of the European Commission in the field of promoting business and investment, and as such it has on its focus of one of the main priorities of the EU for the period 2013-2020, growth and competitiveness of the domestic industry economy.

The mission of the Strategy is to ensure a sustainable economic growth, improving productivity and competitiveness of local business, through dynamic development of entrepreneurs and growth competitiveness skills, encouraging local and foreign investment by reducing as much legacy and administrative barriers in the field of business, promotion and diversification of domestic exports, as well as the preservation of natural , human and financial resources.

Since internal resources are limited, the strategy aims to set out measures for each product to easily convert into little projects to be accepted by donors. This creates the opportunity to work in the development and implementation of priority projects predicted in this strategy.

Referring to the above, the existence of a Business Development Strategy in Albania is important, but not sufficient. In this paper I want to analyze the objectives of the strategy above, highlighting how the objectives of the strategy are implemented and how the strategy is implemented in general. In this analyze I would like to point the problems encountered in the implementation of the objectives, highlighting conclusions and concrete recommendations.

Since internal resources are limited, the strategy aims to set out measures for each product to easily convert into little projects to be accepted by donors. This creates the opportunity to work in the development and implementation of priority projects predicted in this strategy.

Key words : Business development, strategy vision, strategy objectives, competitive advantages, sustainable economic growth,

Albanian and macroeconomics indicators in recent years

Albania managed to avoid recession maintaining positive growth rates despite exposure to the effects of the global economic crisis. Growth rate of Gross Domestic Product (GDP) after the peak of 7.5% in 2008, there was a gradual decline reaching average growth rate of 3.3% in 2009-2011.¹ GDP /capital in 2012 was 475 thousand (or 3,415 euros), and increased to about 26.7 percent, compared to 375.2 thousand (or 3056 Euros) in 2008. The Albanian economy has been growing steadily in the region compared with the average over the past five years, as a consequence of fiscal and monetary policies undertaken during the period 2009-2012. As seen from Table 1 below, in 2012, Albania is the only country which appeared with positive growth of GDP.

Table 1: Annual GDP growth of Western Balkan countries in 2009-2012 (in %)

	2009	2010	2011	2012
Shqipëria	3.3	3.5	3.0	1.6
Bosnja & Hercegovina	-2.9	1.4	1.0	na

¹Financial Stability Report of second half-year – Bank of Albania

Maqedonia	-0.9	2.9	2.8	-0.3
Mali i Zi	-5.7	2.5	3.2	-0.5
Kosova	2.9	3.2	4.5	na
Serbia	-3.5	1.0	1.6	-1.7
EJL6	-1.8	2.2	-0.6	-0.5

Economic Report of Southeast Europe, 2012, World Bank

Since 2008, Albania has managed to maintain a B+ level, in the assessment conducted by Moody's and Standard & Poor's², taking the best estimate regarding the economic performance in the region countries.

The growth rate³ of GDP for the period 2008 - 2012 has been reduced from 7.5 % to about 1.5%. ¾ nominal growth for this period comes from the rising level of the public debt .

It looks similar trend for 2013 in which economic growth is forecast by Moody's 1.7 % , according to IMF 1.8 % , according to EBRD 1.8 % .

The situation is serious and in fiscal indicators . For the first time in the 20 years from 2010 to 2012 , public revenues have been raised about 325-330 billion leke, despite initial forecast of the 2013 budget level was 360 billion leke .

Consequently , total revenues as a percentage of GDP declined from 26.6 % in 2010 into 23 % at the end of 2013 . A lack of income has led to uncontrolled growth of public debt , which reaches 64 % of GDP .

Business development strategy 2007-2013

One of the main strategies adopted by Albanian government as part of economic development and integration in the EU is business development. Macroeconomic indicators identified in the case above show a sustainable economic growth but in the last year growth rates are declining.

Is it considered this macroeconomic analysis in the strategy of the business development and what are the results achieved by this strategy implementation?

This issue and other matters related to the objectives of the strategy will be analysed in the following areas.

The main aim of strategy has been and remains the creation of a stable state-business and creating an environment for the implementation of investment and export policies , which occupies a special place in promoting innovative technologies. Strategy for investment and business development is incorporated and is an integral part of the National Strategy for Development and Integration from 2007 to 2013.

The strategy aims to contribute and support one of the central objectives of the Government Programme 2006 - 2009: securing a sustainable economic growth in the long-term. Based on this mission, the strategy has identified a number of priority measures among which were the creation of a competitive economy and increase the productivity of the economy, the dynamic development of entrepreneurship in Albania, encouraging investment in general and in particular foreign investment as well as a better exploitation of natural, human and financial resources.

Seen from a different angle and in the context of analyzing the results achieved during the period 2007 - 2009, it is concluded that the implementation of this strategy has been a complex and interconnected closely with the implementation of reforms and other sectorial strategies provided within the NSDI.

According to the World Bank report "Doing Business 2010", is estimated that Albania has made a big progress towards reducing administrative barriers for the entry and the exit of a business from the market. In 2009 Albania is ranked 82 nd (out of 183 countries analyzed in the report), while in

²World Bank Report No.3 for Southeast Europe

³www.turizmi.gov.al

2007 the country was ranked at 136 th (and 86 th place in 2008).

Analysis of some of the objectives of business development strategy and investment 2007 – 2013

One of the main objectives of the Business Strategy Development and Investment (SBDI) is “Sustainable business by improving the business climate.” Performance indicators that measure the target for the year 2007-2009 are as follows:

1. Number of days to register a new business decreased from 5 days on 2007 , into one day on 2008 and 2009
2. Number of days for starting a new business is decreased by 36 days in 2007 into 7 days on 2008 and only 5 days on 2009.
3. The number of procedural steps on opening a new business is decreased from 10 steps in 2007 , on 5 steps in 2008 and 2009.

A comprehensive reform is undertaken to reduce the administrative barriers to enter and exit the businesses from the market. According to Doing Business 2010, in the facilities for doing business, in 2009, Albania is ranked 82 (out of 183 countries), rising above 4 places compared to 2008 when it was ranked 86th and 54 places compared to 2007 when it was ranked 136th .All the practices are reformed for the entry and exit of businessis from the market . A key element of the reform is the creation of the National Centre for Business Registration, NRC. NRC, which functions as a one stop shop business registration done within a day, at a minimum cost of 100 leks (0.81 Euro)Reducing the time associated with opening a new business efforts, the number of days required to start a business from 36 days in 2007 are reduced to 7 days in 2008 and in five days in 2009. This is made possible through out national delivery service NRC , extending its services to the structures of local government in various municipalities across the country and the simplification of requirements and documentation needed for business registration. Currently are open windows in 29 municipalities and 2 chambers of commerce and industry.Regarding the reduction of procedures for starting a new business: (i) the registration process has transformed itself from a mixed process (judicial and administrative) in a totally administrative process, (ii) the registration is done in a single day, with only one step , near the beneficiaries, (iii) with the opening of the National Licensing Center the number of procedural steps for opening a new business is reduced from 10 steps in 2007 to only 5 steps in 2008.

Dynamic actions to improve the business climate, the creation of a regulatory and institutional framework for simplifying and reducing the cost of business registration and licensing, through the opening and operation of one-stop-shop as NRC and NLC, as a significant improvement of the provisions of public services it has a significant effect on promoting of doing business in Albania.

Increasing of direct foreign investment.. The objective of the strategy is measured by the indicators following below:

1. The increase in the percentage of FDI: In 2007 direct foreign investment increased by 74% compared with the previous year, in 2008 increased by 49% compared with the previous year and in 2009 increased by 4.6 % compared to the previous year..
2. FDI as a percentage of GDP has increased from 6.2% in 2007 into 7.7% in 2008 and 7.9% in 2009

What are the achievements of this objective ?

It is estimated that the majority of inflows of foreign investments has come from investments in the energy sector, investments in hydrocarbon operations and oil fields, in the cement industry, in the financial sector, in the fields of telecommunication ect.

An⁴ important contribution in the growing of FDI has been the privatization of strategic sectors. On average in the last 3 years from 2007 to 2009, they have contributed about 23% of FDI inflows in the country. Among strategic privatizations carried out in the period 2007-2009 are: privatization of Albtelecom (76% share) by Calik Enerji Telekomünikasyon for 120 million euros, the sale of state shares 12.6% of AMC Greek telecommunications group for 48.2 million Euro COSMOTE, privatization of ARMO company consortium “the Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises

⁴www.mete.gov.al

SA, Mercuria Energy Group Limited” in the amount of 128 million Euros for the 85% stake and in 2009 the privatization of power distribution operator DSO by Czech company CEZ (76% share) in the amount of 102 million euros.

Membership with full rights of Albania in NATO has brought consequently increase foreign investment.

Following the analysis above we should judge which is the Investment impact ?

Referring to the question above in the analysis of the objectives, can be seen that with the state budget funds in an amount of 293 million leks (2007-2009) has enabled the development of promotional activities to improve the business climate in Albania, which has enabled the growth of foreign investment in large measure. With funds from the state budget of 49 million euros per period 2007-2009 is an assessment of about 200 concessions mainly in the energy field, but also in other areas. Another important element in the growth of foreign investment has been the continuous improvement of the country’s infrastructure, also conducted by state budget funds. As generally happens a very important factor to be analyzed is what are the obstacles that have impeded the realization of the goals on 100% especially that investment growth flows ?

One of the most important factors inhibiting the growth of foreign investment for the years 2008 - 2009 has been the global economic crisis, which has caused a decline in economic growth and mainly in foreign investment. An important factor of the collapse of investment has been and remains the problem of ownership.

From foreign investors is found to be a limiting factor the time that takes for all types of permits and licenses to be processed. For this purpose albinvest is being transformed into a –one-stop-shop for foreign investors

The internationalization of Albanian businesses through measures to promote exports and increase the economy’s competitiveness in the regional and the European Union market. Key measurable indicators for this objective are as follows⁵

1. The percentage exports increase : In 2007 exports grew by 25.6%, compared with the previous year, and in 2008 with 15.8% compared to the previous year and in 2009 was down by - 8,3% compared with the previous year.

2. Increasing the contribute exports on GDP, from 9,9% in 2007, to 10.4 % in 2008 and 9 % in 2009.

3. Increase in exports percentage of goods only from domestic production (Made in Albania): In 2007, Made in Albania exports increased by 42% compared with the previous year, in 2008 increased by 38.2% compared with previous year and in 2009 was down by -16% compared with the previous year.

4. Percentage Ratio of exports “ Made in Albania / Foreign Production made in Albania “ has changed from 34/66% in 2007, into 40/60% in 2008 and 37/63% in 2009.

Referring to the above indicators analyzed in the framework of the strategy monitoring has noted that annual comparisons (comparison with previous year) have an increase in all measurable indicators of the target but is this a sufficient analyse ? Another factor that must be analyzed is the investment measure realized in the framework of the implementation of this objective strategy.

One of the ways of investment in this area is the establishment of the Credit Guarantee Fund for Export in the value of 200 million Leke for 6 years . Since 2007 it has become possible that businesses meeting these conditions and criteria set out in the decision of the Council of Ministers can benefit from loans obtained from commercial banks , with a view to increasing production of goods “ Made in Albania “ , as well as growth of exports of these products .

Also , the Albanian Competition Fund amounted to 75 million leke during 2007-2009 helped in enhancing the competitiveness of SMEs and their capacity to export abroad.

The obstacles to a further realization of indicators are identified : (i) Failure of Credit Guarantee Fund for Export , as a consequence the failure of the conditions and criteria of the Councils of Ministers from the business itself ; (ii) Lack of funds from the state budget to increase to the extent required for Albanian Competitiveness Fund .

⁵Indicators Analyse, Monitoring raport METE

Conclusions

Analysis of the above indicators to some of the objectives of the business development strategy and investment that is developed for the period 2007-2009 . For this reason the existing data for this period are not preliminary but are consolidated. In such cases generally in developing countries and currently in Albania is seen that the institution which is responsible for the strategy development and monitoring has not set up a system for the collection and processing of data. The data that generally is analyzed refers to different studies of international institutions such as the OECD and not data processed by the responsible institution.

Seen in the light in which the analyse of the objectives strategy is realised for the period 2007-2009, this analysis gives an overview of the achievements of the strategy by comparing the current year previous to that, but is this analyse enough?

I recommend that the objectives of the analysed strategy should not only be concluded for the accomplishment year after year. It is very important that you examined annually the strategy implementation and its target for the current year. Seen in this light if we refer to the first objective of the strategy it should analyze in relation to what is expected for this objective to realize at the end of the period covered by the strategy which is compared with 2013 .

Analysing the implementation of the strategy objectives is a very important element. The conclusions drawn from the analysis of assessment results indicators for the period 2007 - 2009 should form the basis for mid-term review of the strategy, which the improvements that will be made, is expected to better address the new problems faced by business development and investment in Albania.

References

- www. ekonomia.gov.al
<http://www.fraserinstitute.org/research-news/research/display.aspx?id=16613>
<http://www.heritage.org/index/explore>
<http://reports.weforum.org/global-competitiveness-2011-2012>
http://www.oecd.org/pages/0,3417,en_35424885_37776794_1_1_1_1_1,00.html
Slater SF. & Narver JC. (1993) Product-market strategy and Performance: An analysis of the Miles and Snow Strategy types. *European Journal of Marketing* 27(10)
Porter ME (1980) *Competitive strategy*, New York, The Free Press
Pitts RA & Lei D (2006) *Strategic Management: Building and sustaining competitive advantage*. Mason, Thomson.
Miles RE, Snow CC, Meyer AD & Coleman HJ (1978) Organizational strategy, structure and process. *The academy of Management Review* 3
Investment and business development strategy 2007-2013
The European Commission, Europe 2020, http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm
Financial Stability raport for second-half year 2012- Bank of Albania
World Bank raport no.3 for Southeast Europe Choprar, Sunil, and Meindl, Peter, *Supply Chain Management Strategy, Planning, and Operation*. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall. 2001.
Chung, Kee Ho, and Kim, Young H., "Inventory Management under Uncertainty: A Financial Theory of the Transactions Motive." *Managerial and Decision Economics*. v10, n4 (December 1989) 291-98
Doz Y & Kosonen M (2008) *Fast Strategy: How strategic agility will help you stay ahead of the game*. Harlow, Wharton School Publishing.
Valentin EK (2001) SWOT analysis from a resource-based view. *Journal of Marketing Theory and Practice* 2: 54-63.
Thompson JL (1993) *Strategic management: awareness and change*. New York, Chapman & Hall.
Introduction. Oxford, Blackwell Publishing
Johnson G & Scholes K (1993b) *Exploring corporate strategy –text and cases*. Cambridge, Prentice Hall International
Glaister KW & Falshaw JR (1999) Strategic planning: still going strong? *Long Range . Planning* 32(1)
Barczak G (1995) New product strategy, structure, process and performance in the telecommunication industry. *The Journal of Product Innovation Management* 12

Qeverisja e korporatës si një dimension i vendimarrjes etike. Rasti i Elbasan Cement Factory sh. p. k

Loreta Bebi
Universiteti “Aleksandër Xhuvani”

Elma Zeneli
Elbasan Cement Factory sh. p. k,

Abstrakt

Praktikat më të mira të qeverisjes së korporatave mund t'i ndihmojnë kompanitë në Shqipëri të rrisin eficiencën, mbrojtjen e të drejtave të aksionerëve, të përmirësojnë aksesimin e tyre në tregjet ndërkombëtare të kapitalit dhe të orientojnë kompaninë drejt vendimarrjes etike. Qëllimi i vlerësimit të një sistemi të tillë është zhvillimi i një baze të qëndrueshme për të vlerësuar implementimin e praktikave dhe parimeve më të mira të qeverisjes së korporatës në Shqipëri dhe për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes së korporatës. Struktura e Scorecard përfshin kritere kyçe, që përfshijnë standartet e hartuara nga OECD në lidhje me qeverisjen e korporatës të ndara në gjashtë seksione të ndryshme, ku secili prej tyre përfshin një grup të caktuar pyetjesh në lidhje me secilin nga parimet e qeverisjes së korporatës. Ky studim ka për qëllim që, duke përdorur Balance Scorecard në lidhje me qeverisjen e korporatës të analizojë implementimin e këtyre praktikave në një nga kompanitë më të rëndësishme në qytetin e Elbasanit, Elbasan Cement Factory (ECF) dhe në bazë të rezultatit të marrë të vlerësojë procesin e vendimarrjes etike në këtë kompani. Metodologjia e përdorur do të bazohet në pyetësorë dhe intervista me aktorët kryesorë të përfshirë në qeverisjen e ECF. Rezultatet që do të merren janë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes së korporatës dhe mund të përdoren për të bërë krahasime midis vendeve të rajonit.

Fjalë Kyçe: qeverisja e korporatës, vendimarrja etike, Scorecard, performance, ECF

Hyrje

Implementimi i mekanizmave të Qeverisjes së Korporatës po përhapet në mbarë botën si një koncept i ri manaxhimi, i cili po mirëpritet si nga kompanitë ashtu edhe nga qeveritë. Vendet me një shkallë të lartë të zhvillimit financiar, me likuiditet më të madh në tregjet e tyre të aksioneve, me risk ekonomik më të ulët dhe me më pak korrupsion në sistemet e tyre politike kanë mundësi të tërheqin më tepër investitorë të fuqishëm, të kenë norma më të larta të rritjes ekonomike. (Claessens dhe Djankov, 1999, 498-513; Bruno dhe Claessens, 2010, 461-482). Në këtë këndvështrim ia vlen të përmendet që një kulturë e bazuar në parimet e Qeverisjes së Korporatës është e rëndësishme jo vetëm për të përmirësuar performancën afatgjatë të një kompanie, por edhe procesin e vendimarrjes etike të drejtuesve të saj, elemente këto që në tërësi sigurojnë përfitime për shoqërinë në tërësi. Në ekonomitë në tranzicion, sfida e Qeverisjes së Korporatës është krijimi i një ambjenti, në të cilin aksionerët dhe manaxherët të inkurajohen për të synuar performancë afatgjatë sa më të lartë dhe një proces vendimarrje etike. Duke u nisur nga një sfond i tillë, ky punim, nëpërmjet aplikimit të një metode Balance Scorecard, ka për qëllim të analizojë qeverisjen korporative në një nga kompanitë më të rëndësishme në qytetin e Elbasanit dhe në bazë të rezultateve të marra të argumentojë lidhje pozitive që ekziston midis Qeverisjes së Korporatës, performancës së kompanisë dhe procesit të vendimarrjes etike.

Ndikimi i qeverisjes korporative në vendimarrjen etike

Qeverisja e Korporatës ka të bëjë me sistemin nëpërmjet të cilit kompanitë drejtohen dhe kontrollohen. Sikurse dëshmojnë edhe kërkimet empirike, kompanitë të cilat përdorin metoda të mira të Qeverisjes së Korporatës zakonisht performojnë më mirë në krahasim me kompani të tjera të cilat nuk i përdorin praktika të tilla. Kjo, për vetë faktin se, nëpërmjet mekanizmave të

përmirësuar të drejtimit dhe kontrollit, kompetencat shpërndahen më mirë dhe i gjithë procesi i vendimarrjes në tërësi drejtohet më mirë. Në të njëjtën kohë kompanitë që qeverisen mirë tërheqin më shumë investitorë duke qenë se janë më të besueshme. Qeverisja e mirë çon drejt performancës së mirë duke krijuar një sistem transparent dhe të hapur pasi ajo përmirëson komunikimin dhe thyen pengesat sistematike të rrjedhës së informacionit. Qeverisja e mirë mundëson vendimarrje të bazuar në të dhëna duke reduktuar riskun dhe mundësinë e marrjes së vendimeve joetike. Në tërësinë e çështjeve, që përfshin Qeverisja e Korporatës dy prej dimensioneve të saj luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e vendimarrjes etike. Dimensioi i parë i që ndikon drejtpërsëdrejti në procesin e vendimarrjes etike është roli i bordit drejtues. Bordi drejtues mban përgjegjësinë themelore për suksesin apo dështimin e firmës të cilën drejton e në të njëjtën kohë edhe për etikën e vendimeve të marra prej saj. Kërkimet dhe vërtetimet praktike dëshmojnë se bordi drejtues shumë rrallë, për të mos thënë asnjëherë, nuk performon funksionin e drejtimit. Ai është monitoruesi kryesor i vendimeve të marra nga pjesa më e madhe e udhëheqësve të kompanisë. Në ditët e sotme drejtuesit po zgjidhen gjithnjë e më tepër në bazë të aftësive, kompetencave dhe ekspertizës së tyre për të sjellë perspektiva të reja në lidhje me diskutimet strategjike. Dimensioi i dytë i cili ka ndikim të drejtpërdrejt në procesin e vendimarrjes etike është sistemi i shpërblimit të drejtuesve, i cili vlerëson shkallën në të cilën vlerësimi ekzekutiv lidhet me performancën. Çështja në lidhje me sistemin e kompensimit është e vështirë, por shumë e rëndësishme për bordin drejtues por edhe për palët e tjera të interesit, duke qenë se ajo mund të ndikojë reputacionin e krijuar nga një kompani e në të njëjtën kohë edhe nga palët e interesit.

Përmbledhja e literaturës dhe sfondi teorik

Sikurse theksohet nga (Denis, 2001, 191-212), edhe pse termi Qeverisje e Korporatës ka jo më tepër se sa 25 vjet që është zbuluar, ky term është bërë tashmë i njohur në fjalorin modern të biznesit, përdoret gjërësisht nga akademikët dhe shtypi i përditshëm. Duhet theksuar se termi i Qeverisjes së Korporatës ende nuk ka një përkufizim konkret dhe definitive, ndoshta për shkak të faktit se ai përfshin një numër të madh fenomenesh ekonomike. Kjo vihet re edhe nga fakti që autorë të ndryshëm kanë përdorur përkufizime të ndryshme në lidhje me këtë term duke u nisur nga fusha e tyre e interesit. Ky fenomen nuk ka gjasa të ndryshojë në të ardhmen, kështu që mënyra më e mirë për të përkufizuar këtë koncept mund të jetë listimi i disa përkufizimeve të ndryshme në lidhje me termin. (Yuksel, 2008, 101-111). Nderkohe që, Qeverisja e Korporatës ka të bëjë me përfshirjen e një sërë marrëdhëniesh midis manaxhimit të kompanisë, bordit të saj, pronarëve dhe palëve të tjera të interesit (OECD, 2004). Qeverisja e Korporatës gjithashtu siguron strukturën nëpërmjet së cilës vendosen objektivat e një kompanie dhe përcakton rrugët për arritjen e këtyre objektivave dhe për monitorimin e performancës. (Shleifer dhe Vishny, 1997) thekson se Qeverisja e Korporatës ka të bëjë me mënyrat me të cilat financuesit e korporatës sigurohen për të marrë kthimin e pritur nga investimi i tyre. (Denis dhe McConell, 2003, 1-36) dhe (Hutchinson dhe Gul, 2004, 595-614) mbrojnë faktin se Qeverisja e Korporatës shihet si një mekanizëm esencial, që ndihmon kompaninë për të arritur objektivat e saj dhe, që monitorimi i performancës është një faktor kyç në këtë proces. Në këtë kuptim, Qeverisja e Korporatës duket sikur lidhet si me pronarët dhe aspektet e brendshme të kompanisë, si për shembull kontrolli ashtu edhe me aspektet e jashtme, sic janë stakeholderat e saj. Për më tepër, është gjërësisht e njohur se praktikatat e Qeverisjes së Korporatës nuk janë standarte, nuk ka një masë për të gjithë, pra këto praktika nuk mund të aplikohen njëjloj në të gjitha situatat dhe juridiksionet.

Zyrtarizimi i praktikave të Qeverisjes së Korporatës nuk është vetëm një mënyrë shpëtimi e botës së sotme por një strategji për prosperitet. Eficiencia me të cilën investohet kapital për prodhimin e të mirave dhe shërbimeve është kritike për mirëqenien e një ekonomie (Denis, 2001, 191-212). Praktikatat efektive të Qeverisjes së Korporatës mundësojnë një përdorim më eficient të burimeve brenda kompanisë dhe ekonomisë njëkohësisht, dhe gjithashtu asistojnë firmat dhe ekonomitë në tërheqjen e investimeve kapitale me kosto të ulët duke rritur besueshmërinë e investitorëve vendas dhe të huaj.

Qeverisja e Korporatës mund të luajë një rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e kompanive dhe

ndërkombëtarizimin e tyre. Qeverisja e Korporatës parandalon korrupsionin dhe keq manaxhimin duke promovuar vlerat kryesore të tregut në shoqërite demokratike. Nga ky këndvështrim, duket bindëse të supozohet që Qeverisja e Korporatës është e rëndësishme jo vetëm në vendet e zhvilluara, por gjithnjë e më tepër në vendet në zhvillim siç është Shqipëria.

Shqipëria është padyshim një nga rastet më të vecanta jo vetëm për nga madhësia dhe pozicioni, por gjithashtu edhe për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe vectorive që lidhen me të. Ashtu sikurse shumë vende të tjera komuniste, Shqipëria ka ndjekur rrugën e saj të zhvillimit drejt ekonomisë së tregut. Duke qenë se për një periudhë dyzet e pesë vjeçare vendi ynë ka qenë nën sundimin e një planifikimi të centralizuar, i cili gjatë kësaj periudhe ka zëvendësuar cdo lloj mekanizmi të tregut, procesi i transformimit drejt ekonomisë së tregut ka qenë tejet sfidues dhe i vështirë për vendin tonë. Privatizimi i ndërmarrjeve, reformat ekonomike, zhvillimi dhe implementimi i kuadrit ligjor në lidhje me privatizimin janë shoqëruar me një sërë problemesh. Në vendin tonë dominojnë bizneset e vogla të cilat përbëjnë rreth 80% të tërësisë së tij dhe biznesi familjar është tepër i zhvilluar. Tregu i aksioneve nuk ekziston ndërkohë që Bursa e Tiranës, e krijuar më 1996 nuk funksionon. Kjo është arsyeja pse në vendin tonë nuk ka kompani të listuara, ekuilibrat nuk janë të qartë dhe investitorët e huaj nuk gjejnë ura të përshtatshme bashkëpunimi. Në grupin e shoqërive aksionere në Shqipëri dominojnë shoqëritë me pronësi familjare, të cilat nuk qenë të afta të shndërrohen në shoqëri të mëdha dhe të fuqishme krahasuar me vendet e rajonit. Ka disa kompani të cilat kanë implementuar parimet e Qeverisjes së Korporatës, kryesisht bankat dhe disa kompani të mëdha të cilat i kanë marrë rezultatet e saj. Aktualisht Shqipëria ka Kodin e Qeverisjes së Korporatës, i cili është hartuar me ndihmën e autoriteteve Zvicriane. Zvicra ka mbështetur hartimin dhe përmirësimin e Qeverisjes Korporative të kompanive private dhe bankave në vendet e Ballkanit Perëndimor që prej vitit 2006. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Privatizimit ka aprovuar Parimet e Qeverisjes Korporative për Shoqëritë Aksionere të Palistuara në Bursë, të cilat ndihmojnë kompanitë në biznesin e tyre. Sistemi Qeverisjes së Korporatës në Shqipëri rregullohet nga Ligji Nr. 9901 "Mbi shoqëritë tregtare dhe sipërmarrjen" i aprovuar nga Parlamenti në 14 prill 2008, i cili zëvendësoi ligjin ekzistues. Ky ligj rregullon sipërmarrjen e individëve dhe kompanive tregtare. Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ky ligj i lejon shoqëritë aksionere të zgjedhin midis sistemit njëstresor dhe atij dytësor, dhe nuk përcakton si një detyrim ligjor implementimin e praktikave të Qeverisjes së Korporatës nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.

Metoda e Scorecard

Kompanitë me praktika të forta të Qeverisjes së Korporatës kanë arritur vlera të larta tregu. Gjithsesi edhe për kompanitë të cilat i kanë implementuar këto praktika është e nevojshme dhe e domosdoshme ekzistenca e një mënyre për të matur nivelin e implementimit dhe monitorimit të Qeverisjes së Korporatës. Një mënyrë matje e saj është Scorecard i Qeverisjes Korporative. Kjo metodë u hartua dhe u zbatua për herë të parë në Gjermani në fund të viteve "90 pasi kompanitë shtetërore u privatizuan dhe një sërë kompanish të fuqishme falimentuan. Në fillim të viteve 2000, kjo metodë u pa si një zgjidhje për investitorët dhe analistët, të cilët siguruan një mjet për të vlerësuar dhe matur Qeverisjen e Korporatës të një kompanie, gjë që do ti ndihmonte ato në marrjen e vendimeve të investimit.

Scorecard i Qeverisjes Korporative është hartuar për të trajtuar çështje të rëndësishme specifike për ambjentin ku operon kompania, duke iu referuar edhe Kodit të Qeverisjes Korporative të atij vendi. Nuk ka një strukturë dhe përmbajtje të vetme të kësaj metode që t'i përshtatet të gjitha kompanive sepse, adaptimi lokal është çelësi kryesor i efektshmërisë së saj.

Scorecard i Qeverisjes Korporative duhet t'i mundësojë përdoruesve një vlerësim të shpejtë dhe sistematik të parimeve dhe praktikave të Qeverisjes Korporative. Gjithashtu, kriteret e përfshira në vlerësim duhet të përputhen domosdoshmërisht me Kodin Kombëtar të Qeverisjes Korporative, nëse shteti në fjalë e ka një të tillë ose me parimet ndërkombëtare të Qeverisjes Korporative, të cilat ky shtet ndjek. Këto kriteret mund të përfshijnë çështje, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e pronarëve dhe barazinë e trajtimit të tyre, përgjegjësitë e bordit drejtues, auditimin dhe kontrollin e brendshëm etj. Për secilën nga këto çështje, hartohen disa pyetje për të përcaktuar nivelin e përbushjes së tyre,

i cili përcakton pikët e performancës për çdo kriter të vecantë. Kalkulimet në lidhje me pikët e secilës kategori dhe në lidhje me rezultatin e përgjithshëm bëhen automatikisht në programin MS-Excel.

Aktualisht, Shqipëria ka miratuar një Kod të Qeverisjes së Korporatave për kompanitë jo të listuara në Dhjetor 2011 dhe është zhvilluar dhe një Scorecard në Shtator 2013 në bazë të këtij Kodi. Ky Scorecard është hartuar në përputhje të plotë dhe në harmoni me Kodin e Qeverisjes së Korporatave duke marrë në konsideratë të gjitha karakteristikat e kompanive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë.

Ky model i Scorecard u përdor në rastin studimor për të vlerësuar nivelin e Qeverisjes së korporatës në Elbasan Cement Factory sh. p. k. Arsyeja kryesore e zgjedhjes së kësaj kompanie lidhet me faktin që ajo gëzon statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën ligji në fuqi nuk e detyron të implementojë dhe të ndjekë parimet e Qeverisjes Korporative. Për këtë arsye drejtuesit e saj pranuan që të ndajnë me ne një pjesë të konsiderueshme të informacionit të tyre konfidencial në lidhje me drejtimin e kompanisë. Në të njëjtën kohë drejtori aktual i kompanisë e pa zbatimin e një praktike të tillë të vlefshme për tu zbatuar vazhdimisht me qëllim arritjen e një qeverisje më të mirë, e cila do ta ndihmonte shumë kompaninë në moment të tilla të vështira të cilat ajo po përjeton.

Analiza e rezultateve nga zbatimi i Scorecard

Rezultati përfundimtar i Scorecard për të vlerësuar implementimin e standarteve dhe praktikave më të mira të Qeverisjes së Korporatës së ECF sh. p. k janë si vijon:

- Çështjet e aksionerëve 53%
- Praktikave e bordit 38%
- Sistemi i shpërblimeve 38%
- Angazhimi për Qeverisje Korporative 48%
- Kontrolli i mjedisit 65%
- Qeverisja e familjes 45%
- **REZULTATI PERFUNDIMTAR 48%**

Çështjet e aksionerëve – Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve zgjat disa minuta. Çështjet nuk përfshijnë politikën komerciale të korporatës ose çështjet e shpërblimit apo shkarkimit të drejtorëve, të cilat nuk janë të aplikueshme në ECF. Nuk ka dialog midis kompanisë dhe aksionerëve dhe nuk ekzistojnë dokumenta të cilat bëjnë transparente marrëdhëniet e këtij lloji.

Angazhimi për qeverisje korporative – Përdoren aktet nënligjore, pronarët kanë përcaktuar administratorët, të cilët kanë përgjegjësi për vendimarrjen dhe kanë fuqi ekzekutive për të ngurtësuar kontratat e kompanisë. Një administrator mund të delegojë fuqi të limituara tek një individ tjetër të aprovuar nga pronarët. Përfshirja e stakeholderave në vendimarrje është e limituar. Punonjësit përfaqësohen nga sindikata, por nuk përfshihen në vendimarrje. Kompania ka tolerance zero ndaj praktikave joetike të biznesit, por kjo duhet të konkretizohet me një kod të shkruar.

Praktikat e bordit – Administratorët janë të lidhur ngushtë me pronarët, planifikimi strategjik bëhet në nivel grupi nga pronarët dhe administratorët janë përgjegjës për manaxhimin e implementimit të strategjisë për të cilën është rënë dakord. Nuk ka bord drejtues, pronarët mblidhen herë pas here sipa nevojave, kryesisht për të autorizuar kredi apo për çështje tjera të cilat kanë nevojë për aprovimin e tyre. Nuk ka asnjë dokument, në të cilin të shprehen përgjegjësitë e bordit. Politikën në lidhje me strategjinë e kompanisë nuk janë të përcaktuara mirë gjë e cila krijon probleme për manaxhimin. Nuk ka ura bashkëpunimi midis pronarëve dhe administratorëve.

Kontrolli i mjedisit – Ekzistojnë procedurat të brendshme të mira bazuar në sistemin e manaxhimit ISO, të cilat rishikohen dhe përmirësohen herë pas here sipas kërkesave.

Shpërblimet – Në kompani asnjë individ nuk ka të drejtë për të vendosur mbi shpërblimin e tij. Grupi nuk ka një manaxher të burimeve njerezore dhe nuk ka udhëzues të qartë për shpërblimin e manaxhimit të lartë.

Qeverisja e familjes – Kompania ka të përfshirë në manaxhimin e lartë të saj disa anetarë të njëjtës familje, por në lidhje me kriteret dhe procedurat që ajo duhet të kishte implementuar në kushte të tilla nuk ka asnjë evidencë, nuk ka ndonjë dokument të shkruar në lidhje me këtë çështje dhe nga

drejtuesi i kompanise besohet se procedura të tilla nuk ekzistojnë në nivel grupi.

Përfundime

Lidhja pozitive midis Qeverisjes së Korporatës, vendimarrjes etike dhe performancës së njësisë ekonomike është vërtetuar nga një numër i konsiderueshëm kërkimesh empirike. Rasti studimor i marrë në konsideratë në këtë punim është edhe një rast më tepër që i shtohet këtyre evidencave. Sikurse del në pah edhe në pjesët e mësipërme, Qeverisja e Korporatës është një element vital për një kompani, është çelësi kryesor, i cili i ndihmon kompanitë të ngjisin shkallët e suksesit. Proçesi i vendimarrjes etike është një proçes delikat, i cili varet në një masë të konsiderueshme nga roli i bordit drejtues së një kompanie dhe nga sistemi i shpërblimit të drejtuesve, dy elemente këto të rëndësishëm të Qeverisjes së Korporatës. Pra implementimi i praktikave më të mira të qeverisjes së korporatës mundëson një proçes vendimarrje etik dhe në përputhje me të gjithë parametrat e nevojshëm. Në rastin e ECF, pas vlerësimit të implementimit të parimeve të qeverisjes së korporatës nëpërmjet Scorecard, vihet re që vlerësimi i përgjithshëm arrin në nivelin 48%, nën minimumin 65%. Ky rezultat reflekton edhe performancën jo të kënaqshme që prej disa vitesh rresht të kësaj kompanie dhe në të njëjtën kohë edhe të proçesit të vendimarrjes etike, për të cilin drejtori aktual i saj është i pakënaqur. Edhe pse e drejtuar nga investitorë të huaj, të cilët besohet se kane një njohje me të thelle të konceptit të qeverisjes së korporatës, ECF nuk ka implementuar as praktikat më thelbësore në lidhje me këtë koncept. Kompania, edhe pse nuk është e detyruar nga ligji, ka nevojë të fokusohet më tepër drejt Qeverisjes së mirë të Korporatës, duke përfshirë në këtë proçes diskutime me të gjitha palët e interesit për të arritur një rezultat të kënaqshëm. Fokusimi më tepër drejt Qeverisjes së Korporatës do ta ndihmojë kompaninë në përmirësimin e performancës së saj. Gjithashtu i rekomandojmë ECF përdorimin e Scorecard për vlerësimin e vazhdueshëm të Qeverisjes së Korporatës, metodë kjo e cila nuk ka kosto implementimi, lejon vetëvlerësimin pa qenë nevoja e të tretëve duke identifikuar të gjitha pikat e dobta për të cilat mund të merren masa për përmirësim.

AAaThe scorecard:

Referenca

- Denis, D. (2001) "Twenty-five years of corporate governance research. . . and counting", Review of Financial Economics, Vol. 10, No. 3.
- Bruno, V dhe Claessens, S. (2010) "Corporate governance and regulation: can there be too much of a good thing?", Journal of Financial Intermediation, Vol. 19, No. 4.
- Claessens, S. dhe Dajnkov, S. (1999) "Ownership concentration and corporate performance in the Czech Republic", Journal of Comparative Economics, Vol. 27, No. 3.
- Denis, D and McConell, J. (2003) "International corporate governance", Journal of Financial and Quantitative Analysis, Vol. 38, No. 1.
- Hutchinson, M. & Gul, F. (2004) "Investment opportunity set, corporate governance practises and firm performance", Journal of Corporate Finance, Vol. 10, No. 4.
- Gillan, S. (2006) "Recent developments in corporate governance: an overview", Journal of Corporate Finance, Vol. 12, No. 3, pp. 381-402.
- OECD, (2004), OECD Principles of Corporate Governance, Organisation for Economic Cooperation and Development, Paris
- Shleifer A. & Vishny, R W. (1997). A Survey of Corporate Governance, The Journal of Finance, Vol. LII, No. 2. June 1997.
- Yuksel, C. (2008) "Recent developments of corporate governance in the global economy and new Turkish commercila draft law reforms", Journal of International Commercial the Law and Technology, Vol. 3, no. 2.

Social Cohesion Policy, A Developing Impact in the Multidimensional Sciences of the Scientific Research

Dr. Eda Bezhani
Univesitety of 'Aleksandër Moisiu' Durrës
Faculty of Business

Abstract

The purpose of this scientific paper is to provide information on economic and social effects of science and research in society. It discusses on the indicators and the approaches to examine the economic importance of the research and provides an overview of the effects of different elements. The final objective is to increase the contribution of Research, Development and Innovation on economic growth and on future jobs – on the creation of the good quality jobs especially for the youth. The good macroeconomics policies and the structural reforms remain to be a priority, but different countries should also promote the strategy for Research, Development and Innovation to increase the productivity and the exports. The studies show that the new companies in the Western Balkans have increased 15 percent faster in sales and 8 percent productivity increment than the non-innovative companies. For all these reasons, different countries believe that this is the moment for action. The new policy of social cohesion means that the regions and the members of the European Union should orient the EU investment in the key areas for growth and future jobs.

Keywords: Social cohesion, development, scientific research, innovation.

Introduction

Our assessment of the investment importance in the basic scientific research has increased steadily. Although it is difficult to determine the amount of the direct social and economic benefits provided by the scientific research. It focuses on the indicators and the approaches to examine the economic importance of research and to provide an overview of the effects of different things. The final objective is to increase the contribution of the Research, Development and Innovation (R&D and Innovation) on the economic growth and on the future jobs - good-quality jobs especially for the young people, which is a segment of the population in the Western Balkans affected by the high percentage of the unemployment. The governments of the Western Balkan countries, such as Albania, Bosnia and Herzegovina, Croatia, Kosovo, the former Yugoslav Republic of Macedonia, Montenegro and Serbia, are aiming the expenditure to reach 1.5% of the Gross Domestic Product in the region by 2020 for R&D and Innovation. This is an ambitious goal, but it is as ambitious as the expenditure one reaching 3% for the same purpose, provided in the Treaty of Lisbon and confirmed in Europe 2020 strategy, which should be seen as a signaling mechanism. The countries are fully aware of their fiscal constraints and plan to work towards the gradual realization of this goal. E.g. the countries of each region have pledged to try to get 200 million Euros, as a fund setting out of the region for the period 2014-2020. The third priority is the establishment of the regional cooperation in the policy making and the implementation of the programme as a complementary aspect of the national initiatives of the Western Balkan countries. The economic factors, as well as the common history and the heritage are in favor of the regional cooperation. The geographical factors play an important role for the countries that have shared the same climate and soil. By working together the countries of each region expect to create a political coalition of policymakers through a positive pressure on each other that can promote the implementation of the proper reforms at the national level. For more, the regional programs are likely to be more stable and meritocratic, avoiding fragmentation, extra things and improving the cost effectiveness. In exchange it should increase their capacity to attract foreign funds. The soundness of the macroeconomic policies and the structural reforms continue to be a priority, but countries should also promote the strategy for R&D and Innovation to increase

the productivity and the exports. The studies show that the new companies in the Western Balkans have increased 15 percent faster in the sales and 8 percent higher in the productivity than the non-innovative companies. For all these reasons, the countries of each region believe that this is the moment for action.

The new policy of social cohesion means that the regions and the members of the European Union should orient the EU investments in four key areas for the economic growth and future jobs:

- Research and Innovation
- Information and Communication Technology (ICT)
- Improving the competitiveness of small and medium enterprises (SMEs)
- Support towards a low-carbon economy

Supporting the research and the innovation of the policies and of the cohesion are nearly 25% of the EU structural funds (approximately 86 billion Euros) have been invested in research and innovation. Another investment to the amount of 53600000000 Euros have been invested for the cohesion policy and is taken through the EU special programs to finance the research and the innovation projects ‘Seventh Framework Programme for Research’ and ‘Innovation and Competitiveness Framework Programme’, which are the ancestors of ‘Horizon 2020’.

Horizon 2020 is the financial instrument for implementing the Innovation Union, a Europe 2020 initiative which aims to secure the Europe’s global competitiveness.

This program has as the main challenge to stabilize the financial and economic system for taking measures to create economic opportunities, international cooperation, which is the key to addressing the many objectives. Horizon 2020 is built on Three Pillars:

Excellent Science Base	Industrial Leadership	Societal Challenges
<ul style="list-style-type: none"> • ERC: Excellent basic research • Marie Curie: Excellent training and mobility • Future Emerging Technologies • Research Infrastructure 	<ul style="list-style-type: none"> • ICT • Nanotechnologies • Biotechnologies • Space • Advanced manufacturing and processing • Advanced materials 	<ul style="list-style-type: none"> • Health and demographic change • Sustainable agriculture and bio-economy • Clean energy • Transport • Climate Action & Ressource efficiency • Inklusive, innovative und reflective societies • Secure societies

Excellent Science base

The first pillar includes instruments that were also part of FP7. The funding of Marie Curie Actions and of the ERC will increase. The Future and Emerging Technologies are currently part of the Cooperation Topic ‘ICT’ and Science Infrastructures are currently funded under the Capacities. The goal of this pillar: Strengthening of the Europe’s Basic Research.

Industrial leadership

Also the second pillar includes topics that were already part of FP7 but in the next framework the main focus here will be the market oriented. The goals are the innovations, which shall strengthen the Europe’s position versus the competitors such as the USA, China and Japan. This pillar will include new funding instruments such as prizes for innovations, access to risk finance and pre-commercial procurement. In this pillar research organizations will not be in the driving seat. But they will be important project partners.

The goal of this pillar: More (private) investment in research and innovation

Societal Challenges

These challenges mirror the Europe 2020 Strategy of the European Commission. Whereas the 7th framework funded research disciplines, Horizon 2020 will rather fund the answering of specific research questions inside these 7 challenges. Social sciences and economics are horizontal topics, which will be funded in all the seven challenges. In particular topics of the social sciences and humanities will be called in the seventh challenge.

This program will be funded through direct financial contribution through grants, in order to finance a project/call. The first calls deadline will be from March 2014. In 2014 there have been about 64 calls.

After a competition an award (the recognition for achievement in the project or incentive bonuses) is given as a financial contribution through the prices.

The supply with the assets, the performance of the works or the relevant payment for the provision of services, financial instruments such as the equity of the pre-financing; loans; warranty; other instruments is provided through the procurement.

Researchers

Commission of the European Communities countries, under the Treaty which established the European Community, pursuant to its Article 165, which states:

Commission considered necessary the creation of a European Space Research, as the backbone of the future Community actions in this field, in order to strengthen and to structure the European policy for the scientific research. The Lisbon European Council has set the target to the Community, that by 2010 the economy be developed on the knowledge based, more competitive and dynamic in the world. The Council has addressed issues related to the profession and the career of the researchers within the European Research Area in the Resolution of 10 November 2003 and has welcomed in particular the Commission's intention to work towards the development of a European Charter for the Researchers and a Code of Conduct for the Recruitment of Researchers. The risk identified for lack of researchers¹, especially in key disciplines, will present a serious risk for the innovative power of the EU, the legacy of knowledge and the productivity growth in the near future and may hinder the achievement of the Lisbon and Barcelona objectives. Consequently, Europe needs to significantly improve its ability to attract researchers and strengthen the participation of women researchers, who will help to create the necessary conditions for sustainable careers and interesting for them in R-D ²(Research and Development)

The existence of sufficient human resources and well-developed in R-D are the foundation of the progress in the scientific knowledge, the technological progress, improving the quality of life, ensuring the welfare of European citizens and strengthening the competitiveness in Europe. New instruments for the career development of the researchers, contributing in this way to improve the career prospects should be introduced and be implemented.

The existence of the prospects for a better and more visible career also contributes to create a positive attitude of the public towards the profession of the researcher, and thus encouraging more young people to embrace a career in research. The main purpose of this political Recommendation is to contribute to the development of an attractive European stable labor market for the researchers in which the basic conditions allow recruiting and retaining high quality researchers in the environments that favor an effective work and productivity. All the forms of mobility as part of a comprehensive policy of R-D at national, regional and institutional level should be encouraged. The value of all forms of mobility should be fully recognized in the career assessment and the career advancement systems for the researchers, thus guaranteeing that this kind of experience will positively affect their professional development. Developing a stable career and the movement researchers policies

¹COM (2003) 226 the final and SEC (2003) 489 , dated 30.04.2003.

²SEC (2005) 260.

from the European Union, should be considered taking into account the situation in developing countries and regions within and outside Europe, in order to strengthen research capacity within the European Union should not affect on the disadvantages of the countries or the regions less developed. The society must more fully assess the responsibilities and the professionalism that researchers demonstrate in performing their duties at various stages of their careers and their roles as knowledge workers, leaders, project coordinator, managers, supervisors, leaders, career counselor or science communicators.

Conclusions

The structural reforms continue to be a priority, but the countries should also promote the strategy for R&D and Innovation to increase the productivity and the exports.

Different programs have as main challenge the stabilization of financial and economic system to take measures to create economic opportunities, international cooperation, which is the key to addressing to many objectives.

The existence of sufficient human resources and well-developed in R-D are the foundation of the progress in the scientific knowledge, the technological progress, improving the quality of life, ensuring the welfare of European citizens and strengthening competitiveness in Europe.

Bibliography

<http://www.csus.edu/indiv/y/yangy/145Ch1.htm>

<http://www.oecd.org/science/inno/researchanddevelopmentstatisticsrds.htm>

<http://www.cfr.org/innovation/promoting-innovation-through-rd/p29403>

<http://www.siemens.com/innovation/en/about-research-and-development.htm>

<http://www.airliquide.com/en/company/innovation/research-the-driver-of-innovation.html>

<http://www.wipo.int/patent-law/en/developments/research.html>

<https://www.gov.uk/government/policies/investing-in-research-development-and-innovation>

<http://www.siemens.com/innovation/en/>

Analiza e faktorëvetë tregut të banesave me anë të modeleve empirike, rasti i Shqipërisë

Prof. Assoc. Dr. Dorina Kripa
Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Msc. Llesh Lleshaj
Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Kriza financiare e vitit 2008, e cila preku thuhet të gjithë ekonominë botërore, duke filluar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Evropë e më tej, tregoi se frenimi i rritjes së çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe më pas rënia, si dhe përkeqësimi i cilësisë së kredisë hipotekore për kredimarrës jociësorë, shkaktuan probleme jo vetëm në këtë treg, por edhe në tregjet e tjera financiare, të cilat për shkak të kompleksitetit dhe mungesës së transparencës së instrumenteve financiare të krijuara së fundmi, lidheshin ngushtë me ecurinë e kredive në këtë sektor.

Për shkak të këtyre zhvillimeve të fundit, si dhe për shkak të rolit që luan strehimi në shoqëritë moderne, fokusi i punimit tonë janë çmimet e banesave. Banesat kënaqin nevojat e njerëzve për strehim; aktivitetet në tregun e banesave përbëjnë një pjesë të rëndësishme të PBB-së të një vendi dhe shpenzimeve familjare; si dhe banesat përbëjnë aktivin kryesor dhe huaja hipotekore përbën detyrimin kryesor të familjeve në shumë vende të zhvilluara. Prandaj luhatjet në çmimet e shtëpive, të cilat ndikojnë në mirëqenien e familjeve dhe aftësinë e tyre për të marrë hua dhe për të bërë investime rezidenciale, mund të kenë pasoja të rëndësishme makroekonomike. Duke u bazuar në llogaritje të mëparshme të një indeksi të çmimit të banesave në Shqipëri, si dhe në bazë të rishikimit të literaturës në lidhje me faktorët kryesorë që ndikojnë në ecurinë e çmimit të banesave, jemi përpjekur të sjellim në këtë punim modele ekonometrike që shpjegojnë fortësinë dhe kahun e ndikimit të këtyre faktorëve në çmimin e banesave. Rezultatet tregojnë se disa faktorë që literaturat i konsiderojnë të rëndësishëm në vendet e tjera, në vendin tonë dalin statistikisht jo të rëndësishëm. Kjo shpjegohet me disekuilibrat në tregun e banesave kundrejt indikatorëve makroekonomikë, që rezultojnë nga analizat empirike të modeleve të regresionit me shumë ndryshore të testuar në këtë punim, për vendin tonë.

Fjalët kyç: indeksi i çmimit të banesave, faktorë makroekonomikë, analizë ekonometrike.

Hyrje


Termi pasuri të paluajtshme, përmban në vetvete shumë elementë si: troje, apartamente, vila, objekte industriale, dyqane etj, por në këtë trajtim jemi fokusuar vetëm në tregun e banesave, duke presupozuar se edhe elementët e tjerë, shfaqin të njëjtat karakteristika dhe ecuri në këtë treg. Në tregun shqiptar, tregu i pasurive të paluajtshme klasifikohet si më poshtë¹:

- Ndërtesa
- Ndërtime për banim
- Ndërtesa të tjera (hotele, ndërtesa tregtare, ndërtesa industriale, ndërtesa të tjera)
- Ndërtime inxhinierike
- Infrastruktura e transportit
- Rrugë e autostrada
- Linjat e ujësjellësit, elektrike dhe telekomunikacionit
- Ndërtime komplekse në kantieret industriale
- Punime të tjera inxhinierike

Nga llogaritjet që kemi kryer në bazë të të dhënave të publikuara të INSTAT, 2014, mesatarisht ndërtesat rezidenciale përbëjnë afërsisht 90% të totalit të ndërtimeve. Kjo është një tjetër arsye që

¹Përkufizimi i Pasurisë së Paluajtshme dhe i tregut të tyre gjendet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 141, 142. Por ne po sjellim edhe klasifikimin e tregut sipas raportimeve të INSTAT, meqënëse i jemi referuar kryesisht të dhënave të këtij institucioni.

justifikon zgjedhjen tonë për të përfaqësuar tregun shqiptar të pasurive të paluajtshme me ndërtesat për banim.



Burimi: INSTAT, 2014

Figura 1. Ndërtimet e reja sipas llojit të ndërtimit në milion lekë

Figura 1 ilustron se ç'pjesë të ndërtimeve totale zënë dy nëngrupet kryesore: ndërtesat dhe ndërtimet inxhinierike, dhe pjesën që zë zëri kryesor: ndërtesat për banim. Prandaj në vijim, do përdorim termin pasuri të paluajtshme, duke nënkuptuar banesat.

1. Rishikim literature

Pasuritë e paluajtshme kanë qënë gjithmonë një nga çështjet më të përfolura në botën ekonomike dhe kjo për shkak të kompleksitetit që shfaq kjo formë investimi dhe të rëndësisë së lidhjeve të ngushta me shumë aspekte social-ekonomike të një shoqërie. Ky kompleksitet thellohet më shumë në kushtet e vendit tonë ku informaliteti, veçanërisht në këtë sektor, është i theksuar dhe vështirësisht i matshëm. Mungesa e informacionit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, ka bërë që përpjekjet e shumë faktorëve pjesëmarrës në tregun e pasurive të paluajtshme, të mos bashkëveprojnë ende midis tyre, për të rezultuar në një listë apo indeks çmimesh të pasurive të paluajtshme. Kështu përmendim përpjekjet e Bankës së Shqipërisë, e cila nisur nga rëndësia e pasurive të paluajtshme si pjesë e rëndësishme e kolateraleve të bankave tregtare, në bashkëpunim me INSTAT ka ndërmarrë një vrotim pranë agjensive të pasurive të paluajtshme dhe investitorëve të ndërtimit në nivel kombëtar, nisur nga viti 2013. Këto përpjekje janë vazhdim të llogaritjes së mëparshme të indeksit të çmimit të banesave dhe të qerave për Tiranën (Raporti i Stabilitetit Financiar, 2014).

Vlejnë të përmenden dhe studimet e kryera nga agjensitë e pasurive të paluajtshme në Shqipëri, si për shembull agjensia Inf'93, Century 21, etj. Por këto studime janë rajonale dhe jo të gërshetuara në nivel kombëtar. Prandaj nuk mund të përdoren për të nxjerrë një informacion të plotë mbi ecurinë e çmimeve në të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe për një periudhë kohe të vazhdueshme. Prandaj në punimin tonë, si variabël të varur do të marrim një indeks të çmimit të banesave dhe si variabla të pavarur faktorët kryesorë që ndikojnë këtë indeks:

Indeksi i çmimit të banesave: Për të analizuar në nivel kombëtar çmimin e banesave dhe lidhjen me treguesit makroekonomikë në vend, do të bazohemi në një studim të mëparshëm mbi çmimet e banesave për të gjithë Shqipërinë (Kripa dhe Kufo, 2013).

Të dhënat për të ndërtuar këtë indeks janë marrë nga vlerësues të pavarur të një institucioni bankar. Është analizuar çmimi i një kampioni prej 99 shtëpi në të gjithë Shqipërinë sipas rajoneve. Është nxjerrë çmimi mesatar në euro si mesatare e çmimit total të shtëpive pjesëtuar me sipërfaqen totale (në rastet që kemi më shumë se një shtëpi). Ky çmim në indeks është shumëzuar me peshën specifike të numrit të shtëpive në totalin e të dhënave dhe është përcaktuar një çmim i ri për indeksin. Indeksi ka si vit bazë vitin 2007, dhe është vrotuar ecuria e tij në përqindje.

Çmimet e shtëpive janë dhënë nga vlerësues të pavarur për ecurinë e tyre vjetore. Vetem 1 nga 5

çmimet ndër vite që ata kanë dhënë i përket një vlerësimi që kanë bërë për institucionin bankar, 4 çmimet e tjera ndër vite janë përcaktuar për të njëjtin objekt me të njëjtat karakteristika sipas kushteve të tregut nga i njëjti vlerësues. Ky indeks shpreh kërkesën në tregun e banesave, i cili është i ndikuar nga: kriza botërore, politikat e huadhënies së bankave, mungesën e likuiditetit në sektorin e ndërtimeve, dhe mungesën e likuiditetit të individëve. Prandaj tendenca e këtij indeksi konsiderohet si një sjellje normale e tregut.

Faktorët kryesorë që shkaktojnë lëvizjet në tregun e banesave: Ekziston një literaturë e gjerë në lidhje me faktorët e ndryshëm që ndikojnë tregun kombëtar të pasurive të paluajtshme. Këta faktorë ndikojnë ofertën dhe kërkesën, duke përcaktuar në këtë mënyrë çmimin e pasurive të paluajtshme (FTI Consulting, 2012, faqe 17-22). Tregjet e banesave shihen më tepër si tregje lokale. Si rrjedhojë rritja në stokun e shtëpive mund të vijë si pasojë e ndikimit në periudhë afatshkurtër të një sërë faktorësh: gjatësia e planifikimit dhe fazave të ndërtimit, ekzistenca e skemave për planifikimin e tokës. Kjo tregon që faktorët kombëtarë çojnë në diferenca të rëndësishme midis vendeve përsa i përket dinamikës së çmimeve. Nisur nga kushtet e vendit tonë, vështirësitë në matjen e treguesve ekonomikë, mikro dhe makro, po përmendim ata faktorë kryesorë të cilët do të na shërbejnë dhe në modelin tonë.

- **Ekonomia:** Një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në vlerën e pasurive të paluajtshme është mirëqenia e përgjithshme e ekonomisë. Kjo mirëqenie matet nëpërmjet indikatorëve të ekonomisë, si PBB, punësimi, aktiviteti prodhues, çmimet e mallrave, etj. Në përgjithësi, kur ekonomia është e ngadaltë, i tillë është dhe tregu i pasurive të paluajtshme. Megjithatë, ciklet e ekonomisë mund të kenë efekte të ndryshme për lloje të ndryshme të pasurive të paluajtshme. Kërkesa për shtëpi varet nga të ardhurat. Në kushtet e një rritjeje ekonomike dhe të ardhurash në rritje, njerëzit do të jenë në gjendje të shpenzojnë më shumë për shtëpi e si rezultat çmimi rritet.

- **Politikat e Qeverisë:** Ndërhyrja e qeverisë në tregun e pasurive të paluajtshme është në një masë të konsiderueshme dhe në disa fusha, por kryesisht në aspektin legjislativ dhe administrativ. Ekzistenca e institucioneve që mbrojnë dhe veprojnë mbi të drejtën e pronësisë është një domosdoshmëri për mbarëvajtjen e tregut të pasurive të paluajtshme. Lejet e ndërtimit, problemet e legalizimit, mungesa e planeve rregulluese janë disa nga vështirësitë me të cilat ballafaqohet tregu. Nëse këto institucione do të i realizonin funksionet dhe detyrat në mënyrën e duhur, impakti i tyre në tregun e pasurive të paluajtshme do të ishte shumë pozitiv pasi nuk do ekzistonin ndërçmimet dhe do të kishim një gjallërim të tregut si nga ana e kërkesës dhe nga ana e ofertës. Si rrjedhojë, mirëfunksionimi i tregut të pasurive të paluajtshme do të ishte një faktor ndikues edhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte përveç investitorëve vendas. Por të tillë faktorë janë të vështirë për t'u matur dhe për t'u përdorur nga pikëpamja cilësore.

- **Normat e interesit:** Normat e interesit gjithashtu kanë një ndikim të madh në tregjet e pasurive të paluajtshme. Ndryshimet në normat e interesit mund të ndikojnë në masë të madhe aftësinë e një personi për të blerë një pronë rezidenciale. Nëse normat e interesit janë në rënie dhe shpenzimet e shërbimit të huave hipotekore mbahen brenda kufijve të buxheteve familjare, kjo gjë zakonisht rrit kërkesën për pasuri të paluajtshme. Vlen të theksojmë dallimin midis vendeve me norma të ndryshueshme të interesit (kupagesat janë më të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normave afatshkurtra të interesit, si Britani e Madhe) dhe vendeve ku dominojnë kontratat me norma fikse të interesit (si USA dhe shumë vende të Evropës). Ndërsa normat e larta të interesit nxisin më shumë qeramarrjen në krahasim me blerjen e banesave.

- **Remitancat:** Në Shqipëri remitancat janë një faktor shtytës kritik për kërkesën e brendshme. Si ekonomi, Shqipëria ka një varësi të lartë nga remitancat e emigrantëve jashtë vendit, në vitin 2013 ato zinin 6.23% të PBB-së, që shënojnë edhe nivelin më të ulët historik të tyre. Nëse shikojmë këtë raport në përqindje të remitancave ndaj PBB-së nga viti në vit ka një rënie duke filluar që nga vitet 2006-2007. Të dhënat nga Banka e Shqipërisë tregojnë për këtë rënie të vazhdueshme të remitancave. Gjatë 2010-s, dërgesat e emigrantëve u tkurrën në 696 milionë euro, ose 11% më pak se sa një vit më parë. Kjo rënie ishte edhe më e madhe se në vitin 2009, kohë e pikut të krizës ekonomike botërore. Një e dhënë shqetësuese që del nga vrojtimi i Institutit Agenda është se edhe ato dërgesa që vijnë nga emigrantët, nuk shkojnë më për investime, apo për një formë tjetër përdorimi afatgjatë, por kanë si destinacion ushqimin. Në këto kushte remitancat e reduktuara japin kontributin e tyre në thellimin

e krizës së ndërtimit.

- *Paga mesatare:* Në punimin tonë niveli i pagës mesatare është një tregues agregat sipas gjithë nivelit të aktiviteteve në ekonominë shqiptare (privat dhe publik), të publikuar nga INSTAT, 2014. Ky tregues është një faktor demografik dhe potencial i blerjeve njëherësh, për tregun e banesave në vendin tonë.

- *Kosto e ndërtimit:* Në formën e variablit në punimin tonë kosto e ndërtimit është bazuar në publikimet e indeksit të kushtimit të ndërtimit nga INSTAT, një indeks i cili kompozohet nga kosto direkte në ndërtim (kosto materiale, shpenzime paga, kosto makineri, kosto transporti, shpenzime energjie, etj.) dhe kosto indirekte ose plotësuese. Po sipas publikimeve të INSTAT çmimi i materialeve të ndërtimit ka pësuar një rritje e vit pas viti, kjo do të thotë një rritje të vlerës së këtij indeksi duke ndikuar direkt në vetë çmimin e banesave.

- *Norma e bonove të thesarit:* Në vendin tonë norma e bonove të thesarit me maturitet 12 muaj përfaqëson kuotën bazë nga ku indekskohet çdo normë interesi kredie apo depozite në bankat e nivelit të dytë. Kjo do të thotë që kjo normë konsiderohet edhe si zanafilla e ndryshimit të interesit të kredive edhe për kreditë individuale afatgjatë, të cilat mbi 90% të rasteve janë për blerje banese. Që në fillim të vitit 2012 e në vazhdim kjo normë ka shënuar ulje të ndjeshme ndërkohë norma e interesit të kredive në tregun bankar nuk e ka reflektuar këtë ulje; ajo pothuajse ka mbetur në nivele të qëndrueshme (Banka e Shqipërisë, 2014). Kjo tregon edhe faktin që në analizat tona të modeleve ekonometrike në vijim të punimit, norma e bonove të thesarit nuk është statistikisht e rëndësishme dhe interes dhe rëndësi statistikore ka norma e interesit të kredive.

- *Kursi i këmbimit:* Sipas raporteve të brendshme të bankave të nivelit të dytë si: Raiffeisen Bank, BKT, Credins Bank, etj, kreditë e akorduara për blerje të banesave që iu bëhen individëve nuk janë në monedhën kombëtare Lekë, në shumicën e rasteve ato janë në monedhën Euro, por ka edhe në Dollarë. Duke qenë se dominohet nga monedha euro shitja e banesave, kursi Euro/Lekë do të ketë një ndikim të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave reale për të gjithë ata blerës që të ardhurat e tyre mujore i kanë në Lekë. Sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë nga 2006-2010, kursi Euro/Lekë ka patur një rritje të ndjeshme ndërkohë në vijim ka ruajtur një qëndrueshmëri brenda intervalit 138 – 140, që do të thotë monedha jonë është zhvlerësuar vazhdimisht në raport me monedhën Euro duke i kushtuar blerësve shqiptarë me të ardhura në Lekë.

2. Metodologjia

Në këtë punim do të shpalosim teknikën dhe analizën e ndërtimit të modeleve të regresionit linear ose logaritmik në vlerësimin e lidhjes së disa variablave të pavarur me natyrë makroekonomike me variablin e varur indeksi i çmimit të banesave. Pra analiza do të fillojë me gjetjen e lidhjeve të rëndësishme statistikore të modeleve:

$$y = b_0 + b_1 * x_1 + b_2 * x_2 + \dots + b_n * x_n +$$

Në këtë formë modeli linear kemi shënuar:

y = variabli i varur (në punimin tonë kemi vetëm një variabël të pavarur i cili është indeksi i çmimit të banesave në Shqipëri).

x_i = variabli i pavarur për $i = 1, 2, \dots, n$ dhe secili prej tyre është një vektor me vlera kohore me periodicitet vit, (në punimin tonë numri i elementëve të çdo vektori është 8 vrojtime, nga viti 2006 – 2013).

b_i = parametrat e modelit, ose koeficientët e variablave të pavarur në model, për $i = 1, 2, \dots, n$ (në analizën tonë regressive ndryshimi i variablit të varur Δy shpjegohet në lidhje me këto koeficientë bi, në kushtet “*ceteris paribus*”).

= quhet mbetja e regresionit, ose termi i gabimit, është i vetmi variabël që nuk parashikohet dhe ai duhet të jetë stokastik.

Për të bërë vlerësimin e parametrave b_i , do të përdoret metoda e zakonshme e katrorëve më të vegjël (Christopher Dougherty, 2007). Por që ky vlerësim të shërbejë për të nxjerrë përfundime me besueshmëri të lartë statistikore, në mungesë të të dhënave me numër të madh vlerësimesh, nuk mund të flitet as për Teoremën Qëndrore Limite dhe as për Ligjin e Numrave të Mëdhenj. Prandaj në këtë punim do të bazohemi në të gjitha supozimet bazë të Teoremës Gauss-Markov (Alexander

Ludëig dhe Klaus Schmidt, 2010). Sipas kësaj teoreme që një një model regresioni të jetë më i miri statistikisht dhe i dobishëm për analiza ekonomike duhet të përmbushen disa kushte:

Kushti i parë: modeli duhet të jetë linear ose logaritmik që të zbatohet metoda e katrorëve më të vegjël. Lineariteti duhet të jetë sipas parametrave b_i .

Kushti i dytë: modeli duhet ta ketë të përcaktuar në mënyrë të vetme parametrin b_0 (i quajtur ordinata në origjinë). Kjo do të thotë që pritja matematikore e mbetjeve është $E(\epsilon_i) = 0$.

Kushti i tretë: modeli duhet ta ketë variancën e mbetjeve konstante d.m.th nuk duhet të ketë heteroskedasticitet sepse parametrat bi janë të zhvendosur, pra statistikisht pranohen kur ata në të vërtetë duhet të hidhen poshtë. Kjo do të thotë që varianca e mbetjeve $V(\epsilon_i) = E(\epsilon_i^2) = konstante$.

Kushti i katërt: modeli duhet të mos jetë në kushte të autokorrelacionit të mbetjeve, d.m.th ecuria kohore e mbetjeve duhet të jetë rastësore dhe jo e shpjeguar nga vlerat paraardhëse, pra duhet që

kovarianca $Cov(\epsilon_i, \epsilon_j) = 0$ për çdo $i \neq j$.

Kushti i pestë: modeli nuk duhet të ketë multikolinearitet, d.m.th korrelacion të rëndësishëm statistikor midis variablave të pavarur x_i ndërmjet tyre ose variablave dhe mbetjeve ϵ_i së modelit, për çdo $i = 1, 2, \dots, n$.

Duke u plotësuar me radhë të gjithë këto kushte modeli është i zhveshur nga të gjitha shmangiet dhe rastësitë e pavlerësueshme të tij duke bërë që metoda e zakonshme e katrorëve më të vegjël të jetë teknika më e mirë shpjeguese dhe interpretuese, d.m.th minimizohet çdo term gabimi:

Me y_i shënohet vlera e vrojtuar realisht e variablit të varur dhe me vlera që merret e variablit y nga regresioni.

3. Analiza empirike e rezultateve

Analiza jonë bazohet në një seri kohore të dhënash me vektor kohe 8 vite, nga 2006 në 2013. Gjithashtu në këtë analizë regresioni janë analizuar dy modele njëri plotësisht elastik i trajtës logaritmik dhe tjetri model linear, me nga 3 variabla të pavarur në shqyrtim të secilin. Kompozimi i variablave në model dhe përshkrimi i tyre si dhe burimi i informacionit janë të pasqyruar në tabelën 1 në vijim:

Tabela 1. Emërtimi dhe përshkrimi i variablave të modeluar.

Variabla e varur dhe të pavarur		Modeli I	Modeli II
Variabli i varur	Përshkrimi dhe burimi i informacionit		
ICB = indeksi i çmimit të banesave	Ky indeks është bazuar në 99 kampione të shpërndara në gjithë qytetet e republikës së Shqipërisë. Burimi i informacionit vlerësime të ekspertëve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, 2013.	✓	✓
Variablat e pavarur:			
IKN = indeksi i kushtimit të ndërtimit	Ky indeks përfaqëson koston e ndërtimit në Shqipëri, këtu në indeks janë të përfshira të gjitha llojet e kostove të drejtpërdrejta dhe plotësuese. Burimi i informacionit, INSTAT, 2014.	✓	✗
INT = norma e interesit të kredive	Kjo normë interesi është një tregues agregat i kredive të akorduara për bizneset dhe individët. Burimi i informacionit, Banka Botërore, 2014.	✗	✓
R/PBB = përqindja e remitancave në raport me PBB	Ky tregues shpreh raportin e vlerës së transfertave nga remitancat mbi prodhimin e përgjithshëm bruto në Shqipëri. Burimi i informacionit, Banka Botërore, 2014.	✓	✗

TBN = Treguesi i besimit të ndërtimit	Është një tregues agregat i derivuar nga shumë vlerësime cilësore perceptimi mbi ecurinë e: çmimeve, gjendjes financiare të bizneseve dhe individëve, nivelit të investimeve, rritjes ekonomike, etj. Pikëzimi është nga -100 në +100. Burimi i informacionit, Banka e Shqipërisë, 2014.	✗	✓
EUR/ALL = kursi i këmbimit valutor Euro/Lekë	Ky tregues shpreh vlerësimin ose zhvlerësimin e monedhës kombëtare kundrejt monedhës Euro. Tregu i banesave ka çmimin në Euro ndërsa të ardhurat e shqiptarëve në Lekë, luhatja e kursit ka ndikim ekonomik mbi fuqinë blerëse. Burimi i informacionit, Banka e Shqipërisë, 2014.	✓	✗
PM = paga mesatare	Niveli i pagës mesatare sipas gjithë nivelit të aktiviteteve në ekonominë shqiptare (privat dhe publik). Burimi i informacionit, IN-STAT, 2014.	✗	✓

Shënim: Me ù është shënuar variabli i cili nuk përfshihet në model, ndërsa më ü është shënuar variabli i përfshirë në model.

Bazuar në këtë tabelë përshkruese të variablave kemi arritur të zbulojmë dy modele të dobishme ekonomikisht që të analizohen. Modelet janë si vijon:

$$\text{Modeli I: } \log(ICB) = b_0 + b_1 * \log(IKN) + b_2 * \log(R/PBB) + b_3 * \log(EUR/ALL) + \dots$$

$$\text{Modeli II: } ICB = b_0 + b_1 * INT + b_2 * TBN + b_3 * PM + \dots$$

Që këto dy modele të merren për analizë të lidhjeve midis variablave, në tabelën 2 është pasqyruar vlerësimi i parametrave të modeleve dhe rëndësia statistikore e tyre. Gjithashtu modeli është testuar për rëndësinë statistikore me testin-F dhe testin-t:

Tabela 2. Rezultatet e rëndësisë statistikore të parametrave të modeleve.

Variablat	Modeli I	Modeli II
Variabli i varur	$\log(ICB)$	ICB
Variablat e pavarur:		
b_0 = ordinata në origjinë.	-45.39638*	-29.68543
IKN	9.046711*	✗
INT	✗	6.895920*
R/PBB	0.535174*	✗
TBN	✗	-0.691224*
EUR/ALL	1.515784*	✗
PM	✗	0.001907*
Koeficienti i përcaktueshmërisë i korrigjuar R^2	98.80%	96.28%

Burimi: Llogaritje në Eviews nga autorët.

Shenja “*” tregon që rëndësia statistikore e koeficientëve të regresit nga testi-t është e besueshme me mbi 95% siguri dhe po me besueshmëri mbi 95% siguri janë statistikisht të rëndësishëm të dy modelet me testin-F.

Nga tabela 2 më lart shikohet që të dy modelet janë statistikisht të rëndësishëm dhe po statistikisht të rëndësishëm janë të gjithë parametrat e variablave të varur në model. Dukshëm shikohet një shpjegueshmëri e madhe e lidhjes së variablave të pavarur me atë të varur në secilin model.

Modeli i parë është një model logaritmik i plotë ose elastik i plotë, kështu që me ndryshimin në një njësi të indeksit të kushtimit të ndërtimit (IKN) do të sjellë ndryshim me 9.05% në indeksin e çmimit të banesave (ICB), kur variablat e tjerë mbahen të pandryshuar. Kontributin më të vogël në model e ka variabli Remitanca/PBB (R/PBB) që me rritjen me një përqind të këtij raporti do të sjellë rritjen e indeksit të çmimit të banesave (ICB) me 0.54%. Nga ana tjetër edhe kursi i këmbimit e jep efektin e tij më çmimin e banesave me 1.52% sa herë që monedha Euro vlerësohet me një njësi në

raport me monedhën Lekë. Përfundimisht themi se të tre këto variabla të pavarur kanë një lidhje të qëndrueshme dhe pozitive me indeksin e çmimit të banesave në vendin tonë.

Kurse modeli i dytë është një model linear regresioni, kështu që me ndryshimin me një njësi të secilit nga variablat e pavarur në kushte të faktorëve të tjerë konstant, do të kemi një ndryshim të indeksit të çmimit të banesave (ICB) me vlerën e b_i -vë përkatëse. Efektin më të madh në vlerë absolute e ka ndryshimi me një njësi i normës së interesit (INT) ndërsa atë më të vogël e ka ndryshimi me një njësi i pagës mesatare (PM), (kjo masë ndryshimi lidhet edhe me shkalla e matjes së variablit të pavarur). Ndërsa me dy variablat në fjalë ekziston një lidhje pozitive e indeksit të çmimit të banesave (ICB), me variablin treguesi i besimit të ndërtimit (TBN) lidhja është negative, kjo sepse vlerat e këtij treguesi nga 2009 e në vijim ka vlera negative me pikëzim të lartë zbritës.

Është interesant fakti që lidhja e variablave me kahun e ndikimit të tyre në indeksin e çmimit të banesave në të dy modelet regresion e ruan logjikën e postulateve ekonomike në tërësi por ka vend për analizë në shkallën e fortësisë së lidhjeve në veçanti midis variablave.

Megjithatë si rezultat i një serie të shkurtër të dhënash në kohë që kemi arritur të grumbullojmë në punimin tonë, dhe që modelet të jenë të eficient dhe të dobishëm në gjykimet ekonomike të fortësisë së lidhjes së variablave midis tyre, në vijim kemi përmbledhur disa teste ekonometrike që analizojnë në detaj kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme të teoremës së Gauss-Markov, për të na bindur mbi saktësinë statistikore të rezultateve të modeleve.

Tabela 3. Rezultatet e testeve ekonometrike, kushtet e Gauss-Markov.

Emërtimi i testit ekonometrik	Përshkrimi	Rezultati, Modeli I	Rezultati, Modeli II
Forma funksionale, Testi-RESET	Tregon nëse forma e modelit është e duhura (d.m.th lineare apo logaritmike)	Janë të vlefshëm si forma lineare ashtu edhe logaritmike.	Janë të vlefshëm si forma lineare ashtu dhe ajo gjysëm logaritmike si edhe logaritmike.
Multikolineriteti, testi-VIF	Korrelacioni midis variablave të pavarur të përfshirë në model.	Ka multikolineritet (duke qenë statistikisht të rëndësishëm variablat nuk kemi bërë eliminimin e asnjërit).	Ka multikolineritet (duke qenë statistikisht të rëndësishëm variablat nuk kemi bërë eliminimin e asnjërit).
Heteroskedasticitet, testi-White	Lidhja konstante e variancës së mbetjeve të modelit me popullimin e të dhënave.	Nuk ka heteroskedasticitet (është vetë forma funksionale logaritmike që e ka eliminuar atë).	Nuk ka heteroskedasticitet
Autokorrelacion, testi-LM	Korrelacioni serial i variablave të pavarur dhe mbetjeve të modelit.	Nuk ka autokorrelacion deri me kontroll dy hapa, d.m.th lag(2).	Nuk ka autokorrelacion deri me kontroll dy hapa, d.m.th lag(2).
Shpërndarja normale e mbetjeve, Jarque-Bera test	Testohet nëse mbetjet e modelit janë me shpërndarje normale ose jo.	Mbetjet kanë shpërndarje normale.	Mbetjet kanë shpërndarje normale.
Lidhja shkakore, Testi-Granger Causality	Testohet lidhja shkakore e ndikimit të viteve parardhëse të variablave në rezultatin e vitit aktual të modelit.	Analiza është me lag(2). log(IKN) shkakton log(ICB) dhe anasjelltas. Log(ICB) shkakton log(R/GDP) dhe anasjelltas Log(ICB) shkakton log(EUR/ALL) dhe jo anasjelltas.	Asnjëri nga variablat nuk shkakton tjetrin deri me lag (2).

Burimi: Llogaritje në Eviews nga autorët.

Tabela 3 më lart, tregon që supozimet e teoremës Gauss-Markov plotësohen nga modelet tona dhe

vlerësimet e marra në parametrat e regresioneve përfaqësojnë rezultate të pazhvendosuar, efçente dhe të besueshme në analizat që rrjedhin nga modelet. Duhet të theksojmë që i vetmi kriter i cili nuk plotësohet në gjithë variablat e pavarur është multikolineariteti ose jo pavarësia e plotë e variablave shpjegues, d.m.th variablat e të dy modeleve janë të korreluar njëri me tjetrin duke e rritur artificialisht koeficientin e përcaktueshmërisë, por meqenëse secili nga variablat e përfshirë në model është statistiki i rëndësishëm i kemi mbajtur në model, pasi dobia shpjeguese kuptimore ekonomike e tyre është thelbërre në interpretimin e rezultateve.

Për të parë lidhjen dhe dinamikën ndikuese të variablave njëri me tjetrin me gjurmë kërkimi deri në dy vite retrospektivë, është përdorur testimi i lidhjeve shkaktësore “Granger” (Ibrahimaj dhe Mattarocci, 2013). Sipas modelit të parë testi Granger nuk na ndihmon të kuptojmë shenjën dhe fortësinë shkaktësore midis variablave $\log(ICB)$, $\log(INK)$ dhe $\log(R/PBB)$. Arsyeja bazë se pse variabli i pavarur INK dhe variabli i pavarur R/PBB nuk shkaktojnë variablin e varur ICB dhe anasjelltas, lidhet me faktin që INK dhe R/PBB janë të korreluara fort dhe negativisht midis tyre, (gjë që u shprehëm më lart për ekzistencën e multikolinearitetit). Për modelin e parë kemi zbuluar një kah të pambulluar të testit shkaktësor Granger midis variablave $\log(ICB)$ dhe variablave $\log(EUR/ALL)$, d.m.th $\log(ICB)$ shkakton $\log(EUR/ALL)$ dhe jo anasjelltas me lag(2), pra dy vite. Ndërsa për modelin e dytë dinamika e ndikimit shkaktësor Granger midis variablave nuk ekziston.

Duke qenë se kemi një seri kohore vlerash me vektor me 8 elementë gjithsej nuk mund të flitet për kointegrim të variablave midis tyre, gjë që do të ishte me shumë interes të analizohej edhe lidhja afatgjatë e dinamikës së variablave si e ndikojnë njëri-tjetrin dhe cila mund të ishte prirja ndikuese në ekonomi.

4. Konkluzione

Luhatjet e çmimit të banesave ndikojnë në mirëqenien e familjeve dhe aftësinë e tyre për të marrë hua dhe për të bërë investime rezidenciale, të cilat mund të kenë pasojë të rëndësishme makroekonomike. Nga ana tjetër interesi mbi çmimet e shtëpive, motivohet jo vetëm nga zhvillimet e fundit në vendin tonë, por edhe me rolin që luan strehimi në shoqëritë moderne. Ishin këto konstatime të logjikës ekonomike që na nxitën të vlerësojmë faktorët ndikues të çmimit të banesave. Pasuritë e paluajtshme kanë qënë gjithmonë një nga çështjet më të përfolura në botën ekonomike dhe kjo për shkak të kompleksitetit që shfaq kjo formë investimi dhe të rëndësisë së lidhjeve të ngushta me shumë aspekte social-ekonomike të një shoqërie. Nga ana tjetër sipas publikimeve të zyrtare në vend për periudhën 2004-2012, peshën më të madhe të ndërtimeve e zënë ndërtimet për banim.

Ky punim u bazua në llogaritjet të mëparshme të një indeksi të çmimit të banesave në Shqipëri, i cili u derivua nga analiza vlerësuese të institucioneve bankare dhe ekspertëve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme për një kampion me 99 shtëpi në gjithë qytetet e Shqipërisë. Duke filluar llogaritjet e tij që në vitin 2006 deri në 2013, në analizën tonë të modeleve ekonometrike ky indeks u përdor si variabël i varur. Ndërsa variabla të pavarur janë analizuar shumë tregues makroekonomikë prej të cilëve vetëm 6 rezultuan statistiki të rëndësishëm në dy modele ekonometrike.

Sipas analizave empirike u vu re se indeksi i çmimit të banesave është një variabël i cili ka një korrelacion pozitiv dhe statistiki të rëndësishëm me: kostot e ndërtimit, normat e interesit të kredive, nivelin e remitancave në raport me prodhimin e përgjithshëm bruto, kursin e këmbimit Euro/Lekë dhe nivelin e pagës mesatare. Ndërsa paraqet lidhje me korrelacion negativ dhe statistiki të rëndësishme me variablin e pavarur cilësor “treguesi i besimit të ndërtimit”, kjo sepse që pas vitit 2008 ky tregues ka shënuar vlera me pikëzim në rënie. Në analizën tonë përveç korrelacionit të variablave midis tyre kemi analizuar edhe ndikimet elastike ose jo në indeksin e çmimit të banesave. Gjithashtu për të parë lidhjen dhe dinamikën ndikuese të variablave njëri me tjetrin me gjurmë kërkimi deri në dy vite retrospektivë, është përdorur testimi i lidhjeve shkaktësore “Granger” nga i cili nuk tregohet se e kaluara nuk ka ndikim në lidhjet e tashme të variablave (në disa raste e përligjur kjo me ekzistencën e korrelacionit në vetë variablat e pavarur të modelit).

Në shumicën e lidhjeve statistiki të rëndësishëm faktorët ekonomikë e ruajnë lidhjen logjike të ndikimit të tyre në çmimin e banesave. Këta faktorë të analizuar si variabla ndikojnë ofertën dhe kërkesën për banesa, duke përcaktuar në këtë mënyrë çmimin e tyre. Kjo tregon që faktorët kombëtarë çojnë në diferenca të rëndësishme midis vendeve përsa i përket dinamikës së çmimeve

të banesave. Megjithatë si rezultat i serive kohore me vektor vlerash me 8 elementë gjithsej nuk mund të flitet për kointegrim të variablave midis tyre, gjë që do të thotë se mund të analizohej lidhja afatgjatë e dinamikës së variablave si e ndikojnë njëri-tjetrin dhe cila mund të ishte prirja ndikuese në ekonomi në tërësi.

Gjithsesi sic e theksuam dhe më parë, ecuria e çmimeve të banesave varet shumë nga karakteristikat e vendit. Kështu, edhe pse niveli i remitancave dhe i normave të interesit ka ardhur në rënie, kjo nuk ka ndikuar në rënie të indeksit të çmimeve të banesave. Ky indeks ruan një stabilitet, që shpjegohet edhe me vendndodhjen e Shqipërisë në Ballkan, vendet e të cilit në përgjithësi raportojnë nivele më të larta çmimesh të banesave.

Objektiv i kërkimeve shkencore të mëtejshme do të jenë analiza më e detajuar e secilit faktor mikro dhe makroekonomik, afatshkurtër dhe afatgjatë, në çmimin e banesave. Po kështu do tentohet në vlerësimin e ndikimit që ka përfshirja e pasurive të paluajtshme në portofol.

Bibliografia

- [1] Agnello L., Schuknecht L. (2011). Booms and busts in housing markets: Determinants and implications.
- [2] Alexander Ludwig and Klaus Schmidt (2010). Gauss–Markov Loss Prediction in a Linear Model.
- [3] Banka e Shqipërisë (2013). Raporti i Stabilitetit Financiar.
- [4] Banka Botërore, publikime.
- [5] Christopher Dougherty (2007). Introduction to Econometrics. Third edition, Oxford press.
- [6] Delina Ibrahimaj, Gianluca Mattarocci (2013). Sektori i ndërtimit dhe tregu i pasurive të paluajtshme: Evidenca nga Shqipëria. Buletimi i Bankës së Shqipërisë.
- [7] Dorina Kripa, Andromahi Kufo, Alban Korbi (2013), 'Is there a bubble in the albanian housing market?'
- [8] Dorina Kripa (2013). Cikël leksionesh: 'Drejtimi i Pasurive të Paluajtshme'.
- [9] Dorina Kripa (2011). 'Shkaqet e krizës financiare 2008', referim shkencor.
- [10] FTI Consulting (2012). Report: A study on understanding supply constraints in the housing market.
- [11] INSTAT, publikime.
- [12] J. Isotalo (2007). Linear estimation and prediction in the general Gauss-Markov model. Academic dissertation.
- [13] Naude, W. (2009), "The financial Crisis of 2008 and the Developing Countries", UNU - WIDER.

Qëndrueshmëria e reformës së sistemit pensional ne Kosovë

Mr. Sc. Shaqiri Nexhmedin- Kandidat për Doktorant
Universiteti Europian i Tiranës- Tiranë

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është pasqyrimi i gjendjes kualitative të qëndrueshmërisë së sistemit pensional në Kosovë dhe faktorët kushtëzues të tij (bartësit, ambienti, infrastruktura dhe procesi). Studimi do të fokusohet në tipin dhe strukturën e modelit (konceptin bazë) të sistemit pensional në Kosovë, krahasuar me sistemet e ngjajshme, me synim të krahasimit të përparësive, dobësive, përshtatshmërie dhe të rreziqeve. Vlerësimi i gjendjes së qëndrueshmërisë ekonomike të sistemit pensional, do të bëhet përmes analizimit të; tipareve të sistemit pensional,tributeve përbërëse, elementeve dhe të funksionalitetit të sistemit pensional. Pyetja kërkimore e studimit është: *Sa ndikon reforma e sistemit pensional në Kosovë, në qëndrueshmërinë e tij?* Për të i dhënë përgjigje këeaj pyetje, do të shfrytëzohen njohuritë teorike mbi qëndrueshmërinë e sistemit pensional,teoritë mbi stabilitetin financiar dhe teoritë mbi të drejtat themelore të njeriut, që rregullojnë të drejtën mbi punën, pronën dhe pensionin. Për të studjuar problematikën e qëndrueshmërisë dhe të stabilitetit financiar të sistemit pensional, do të përdoren metodat; kuantitative, kualitative, analitike dhe empirike. Studimi i qëndrueshmërisë do të bëhet përmes analizimit të shkaqeve, faktorëve kyç, elementeve apo objekteve të studimit,tributeve të objekteve të studimit, relacioneve apo lidhjeve, dhe të funksionaliteti të sistemit pensional. Nga ky studim synojmë që të përfitojmë rezultatet të cilat reprodukojnë; konstatimin e gjendjes kualitative të ekuilibrit, stabilitetit dhe të qëndrueshmërisë së sistemit pensional, situatat e ndryshme të qëndrueshmërisë, dobisë e sistemit pensional, kufizimet, kontrollin, qeverisjen, vendosjen, menaxhimin e rreziqeve, etj. Do të bëhet vlerësimi kritik mbi pasojat e qëndrueshmërisë së sistemit pensional në Kosovë, të cilat konsistojnë në; reflektimet e qëndrueshmërisë në natyrën e strukturës së stabilitetit financiar dhe në trendin e zhvillimit të mëtejshëm të qëndrueshmërisë. Gjatë studimit do të analizohet ndikimi i qëndrueshmërisë së sistemit pensional në sistemin makroekonomik dhe reflektimi i tij në stabilitetin socio-ekonomik. Në fund do të nxirren përfundimet mbi kualitetin e qëndrueshmërisë së sistemit pensional në Kosovë, sfidat, menaxhimi i qëndrueshmërisë, ruajtja e gjendjes ekzistuese, përmirësimet e nevojshme.

Fjalë kyçe: Modeli, sistemi pensional, reforma, qëndrueshmëria, stabiliteti socio- ekonomik, natyra strukturore, trendi i zhvillimit, sfidat, përmirësimet e vazhdueshme.

Hyrje

Koncepti i ekonomisë së tregut të lirë e parashtron nevojën për adaptim sa më efikas të ekonomisë së vendit, në funksion të lirisë së operateve në treg. Zhvillimi ekonomik ne Kosovë ka për synim që të ndërtohet veçmas, përmes promovimit të konceptit të lirisë dhe të demokracisë politike. Derisa liria nënkupton mundësinë e veprimit të çdo kujt që të përcaktohet për një zgjedhje pa e pengur dikend tjetër, atëhere ajo e obligon njëherit gjithë secilin që të respektojë çdo pjesmarrës në shoqëri. Ngo kjo rezulton se, demokracia është formë liberale e qeverisjes me popull, nga populli, për popullin në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes përfaqësuesve që ndikojnë në organizimin e shoqërisë, duke minimizuar rreziqet që vijnë nga dora e forte e nje individi apo grupi politik. Pra, demokracia është sistemi më i përshtatshëm për të mbrojtur të drejtat natyrale të njeriut, gjegjesisht lirinë e njerëzve dhe i parandalon abuzimet në politikë, shoqëri dhe ekonomi. Liria¹ nxitë *interesin e të gjithëve* për organizimin e jetës ekonomike, e cila krijon dobinë shoqërore, që rezulton nga bashkëveprimi i shoqërisë në përgjithësi, duke korrigjuar mënyrën e veprimit të personave të ngarkuar me përgjegjësi shoqërore. Pra, në kushtet e ekonomisë së liberalizimit të tregut dhe të krijimit të mundësive për të hyre lirshem në treg nën kushtet e konkurrencës së lirë, është zhvilluar koncepti i vetëqëndrueshmërisë ekonomike, të sistemit pensional në Kosovë, duke krijuar politika të përshtatshme me legjislacion adekuat, të cilat kane ndikuar në zhvillimin e sistemit ekonomik, i cili ka imponuar nevojën për funksionim të duhur të mekanizmave rregullues

¹Milton Friedman “Kapitalizmi dhe Liria”është botuar së pari here, në vitin 1962

të tregut, nga ana e shtetit. Andaj, vetëqëndrueshmëria e sistemit pensional, është një nga cilësitë e pavarësisë së sistemit pensional, i cili mund të sigurojë ekzistencën e vet dhe mund të mirëmbahet vet në të ardhmen, pa ndihmën e dikujt nga jashtë. Vetëqëndrueshmëria e sistemit pensional, garanton një shkallë më të lartë të kualitetit të ekzistencës, sidomos kur sistemi pensional arrinë shkallë e lartë të efikasitetit dhe të efikasitetit të veprimit, në mënyrë që të shmangë varësinë e vet nga jashtë². Bazuar në teoritë mbi ekonominë e tregut të lirë, të cilat trajtojnë tregjet spontane, të cilat i plotësojnë nevojat e konsumatorëve mbi baze të doktrinës “Laissez faire”, ku bëhet shkëmbimi i lirë i mallërave dhe realizimi i fitimeve, mbi principin e vetëqëndrueshmërisë, i bënë subjektet ekonomike në treg më konkurruese. Vetëqëndrueshmëria e sistemit pensional në Kosovë, është ndërtuar mbi këto komponenta; potencialin demografik (numrin e popullsisë, strukturën gjinore, migrimin e popullsisë, numrin e të punësuarve si pagues të kontributeve, numrin e përfituesve të pensioneve, shkallën e vdekshmërisë, etj.) kornizës ligjore e rregullative të sistemit pensional, modelin e qeverisjes, investimet e aseteve të fondeve pensionale, sistemin e teknologjisë informative, stabilitetin makrofinanciar të vendit, ambientin e qëndrueshëm socio-politik, stabilitetin politik, nivelin e zhvillimit ekonomik, etj.

Përshkrimi teorik i sistemit pensional

Lidhur me funksionimin e skemave pensionale në Botë ndërlidhen shumë teori, /të cilat trajtojnë modelet bazë, siç janë;³

Modeli i sistemit PYGO- të punësuarit paguajnë kontribute sot, në mënyrë që personat e vjetër që i kanë mbushur vitet për pensionim të përfitojnë pension sot.

Modeli i Amerikës Latine apo i modelit i OECD- në të cilin punëtorët vendosin se si do të investohen kontributet e kursimeve të tyre, ndërsa sipas modelit të OECD⁴ punëtorët apo sindikatat vendosin mënyrën e përfaqësimit dhe të kontrollit të investimeve strategjike në ndonjë entitet apo fond financiar.

Modeli Suedez- bazohet në llogaritë e imagjinuara të punëtorëve të mbeshtetura në llogaritë e fondeve reale nga kursimet dhe investimet e tyre. Plani i Kontributeve të imagjinuara është një plan i kredituar individual i punëtorit, që përmbanë kontributet e kursyera plus interesi.⁵

Ndërlidhmëria e teorisë të skemave pensionale me problematiken e funksionimit praktik të skemave pensionale, përqendrohen në; analizën e ndjeshmërisë së funksionimit të skemave pensionale, evoluimin e skemave pensionale, mënyrën e rregullimit ligjor dhe të kompleksitetit sofistikut të skemave pensionale, modelet e sistemit pensional, qëndrueshmërinë e skemave pensionale, llogaritjen e kostos së zbatimit dhe të arsyeshmërisë socio-ekonomike, matjen e shpenzimeve buxhetore, mënyrën e organizimit të fondeve financiare, politikëbërjen, menaxhimin, investimet, kapitalizimet, benefitet/ pensionet, zbutjen e varfërisë, stabilitetin socio-ekonomik, vlerësimin e transparencës, zhvillimin e dialogut dhe të komunikimit, etj. Reforma e sistemit pensional në Kosovë, shmangë përfundimisht sistemin pensional i cili zhvillohej mbi “Parimin e Solidaritetit”, ndërsa sendërton sistemin pensional në bazë të parimit të “Vetëqëndrueshmërisë”.⁶

²John Gubbels was an independent pensions consultant at the time of the Kosovo pension reform. David Snelbecker is Senior Vice President of The Services Group (TSG). Lena Zezulin, a pensions lawyer, is a Senior Legal Consultant with TSG. All three authors played a significant role in designing and implementing the new pension system in Kosovo. John Gubbels served as the Acting Director of the KPST in its first year of operation.

³Chlon-Dominczak. “Funded Pensions in Transition Economies in Europe and Central Asia: Design and Experience.” International Federation of Pension Funds Association (FIAP) and World Bank, 2003.

⁴Organisation for Economic Co-operation and Development. Pensions at a Glance – Public Policies across OECD Countries 2005 Edition.

⁵Holzmann, Robert and Hinz, Richard. Old-Age Income Support in the Twenty-first Century: An International Perspective on Pension Systems and Reform. The World Bank, February 18, 2005.

⁶John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin “The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons, April 2007

Reforma e sistemit pensional në Kosovë

Reforma e sistemit pensional në Kosovë, ishte nje proces i ndërlidhur me zhvillimet ekonomike në Kosovë, bazuar në nevojat për sforcimin e stabilitetit financiar.⁷ Aspektet e përqendrimit të rëformës së sistemit pensional në Kosovë, janë konceptuar mbi bazë të;

Aspektit parametrik- në vete përmbanë; ndryshimin e shkallës së kontributeve varësisht nga shkalla e mesatares së të ardhurave personale në Kosovë, ndryshimin e moshës së pensionimit krahasuar me kushtet e pensionimit në sistemin PYGO, indeksimin e investimeve te fondeve pensionale mbi kushtet e tregut të konkurrencës së lirë, normën e kthimit apo të kapitalizimeve të investimeve sipas kapaciteteve investuese të portfoliove individuale.

Aspekti paradigmatic- në vete përmbanë; ndryshimet e standardizuara në tërë sistemin pensional, ndërtimin e konceptit të vetqëndrueshmërisë të bazuar në parimet e tregtisë së lirë, disejnimin e sistemit pensional me kontributet e definuara dhe me portfolio personale të definuar për të blerë pension, rrjedhshmëri stabile të pensioneve kualitative dhe gjithëpërfshirëse, ndikim në stabilitetin financiar makroekonomik, zbutje te varfërisë, etj.

Reforma e sistemit pensional në Kosovë është bazuar edhe në burimet e kufizuara financiare-buxhetore për pensione, qe janë pasojë e: nivelit të zhvillimit te ulët ekonomik, normës së lartë të papunësisë, nivelit te theksuar te varfërisë dhe te shkaterrimeve te luftës. Shkeputja nga sistemi i vjetër i pensioneve të modelit PYGO ishte bërë për dy arsye; shthurja e sistemit të vjetër shtetëror (politiko-ekonomik) të ish RSFJ, ishin krijuar rrethana vështirësuese për të vazhduar me sistemin e vjetër pensional te RSFJ, si dhe ishin krijuar rrethana vështirësuese në ndërtimin e sistemit të ri të Pensioneve në Kosovë si dhe ishin zhvilluar dryshime te sistemit të ri shtetëror në Kosovë. Tendenca e Kosovës për integrim në Unionin European dhe në institucionet e ndryshme ndërkombëtare, nevoja për ndërprerjen e vazhdimësisë së sistemit të vjetër i cili kishte filluar të degjenerohej (sepse shkalla e pensioneve ishte më e lartë se sa të hyrat nga kontributet pensionale), kishte ndodhur ndërprerja e pensioneve të pensionisteve kosovar nga ana e Republikës se Serbisë në mënyrë të dhunëshme dhe të njëanëshme, si dhe ishte bllokuar Fondi i vjetër pensional i Kosovës nga ana e Serbisë.

Baza konceptuale e ndërtimit të sistemit pensional në Kosovë

Baza konceptuale e ndërtimit të sistemit pensional në Kosovë, mbeshket në; respektimin e të drejtave themelore universale të njeriut, respektimin e të drejtës së pronës- pensioneve, zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve që ndërlidhen me mbështetjen sociale në Kosovë, vetqëndrueshmërinë ekonomike të sistemit pensional (me të hyra nga kontributet e definuara individuale dhe me kosto efektive, që shperndanë kostot dhe perfitimet, në mënyrë të barabartë nga investimet), stabilitetin makroekonomik, praktikat e evoluimit të skemave pensionale, në Botë, system me skeme pensionale që shmangë rreziqet e panevojëshme financiare si dhe rreziqet socio- politike.⁸ Dizajnimi apo modelimi i strukturës së sistemit pensional në Kosovë është bërë mbi bazen konceptuale e cila në vete përmbanë cilësitë e modelit, mënyren e rregullimit ligjor dhe kornizen e akteve tjera normative të cilat e bëjnë këtë sistem funksional, të qëndrueshëm dhe të sigurtë.

Reforma e sistemit pensional në Kosovë është me model shumë shtyllor, e cila përmbanë në vete:

⁷Palacios , R. and A. Sluchynsky. "Social Pensions Part I: Their Role in the Overall Pension System." World Bank Pension Reform Primer, 2006.

⁸Chlon-Dominczak. "Funded Pensions in Transition Economies in Europe and Central Asia: Design and Experience." International Federation of Pension Funds Association (FIAP) and World Bank, 2003.

1. **Fonde financiare**
 - a) Fonde të kusimeve të detyrueshme⁹
 - b) Fonde të kursimeve vullnetare apo suplementare
2. **Jo fonde financiare/ vije buxhetore¹⁰**
 - a) Pensione bazë
 - b) Pensione suplementare nga përvoja në punë

Dizajnimi i strukturës së sistemit peansional është bazuar në modelet e skemave pensionale të cilat janë dëshmuar si të vetëqëndrueshme, si për shembull tipi i skemave pensionale në vendet e Amerikës Latine, kryesisht në Çile¹¹, të cilat kanë shërbyer si model i arsyeshëm ekonomik-social. Premtimet bazë të modelit të ri të sistemit pensional në Kosovë, kanë qenë të bazuara në stabilitetin e skemave pensionale, definimin e portfoliove individuale me status juridik të pronave individuale, qëndrueshmërinë e sistemit pensional, etj.¹² Vështiresitë e adaptimit të modelit të ri të sistemit pensional janë paraqitur në ndërtimitin e modelit të skemave pensionale, kompletimin e kornizës ligjore të skemave pensionale dhe të garantimit të tyre, promovimin e sistemit pensional, ngritjen dhe zhvillimin e operimeve financiare, mirëmbajtjen e sistemit pensional dhe përmiresimin e vazhdueshëm.

Skemat pensionale në Kosovë

Përcaktimi i strukturës së skemave pensionale në kuadër të sistemit pensional në Kosovë e paraqet modelin e sistemit pensional. Skemat pensionale në Kosovë përbajnë dy Fonde pensionale (Fondi pensional me kontribute të detyrueshme pensionale dhe Fondi pensional me kontribute vullnetare) dhe një Vijë buxhetore pensionale. Këto skema pensionale janë ndërtuar mbi bazë të zotërimit të praktikave të sukseshme mbi qeverisjen e fondeve pensionale dhe të teorive mbi skemat pensionale.¹³ Ngritja e kapaciteteve të fondeve pensionale është bërë mbi bazen e potencialeve të kontributorëve; si të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, të lartësisë së pagave, të lartësisë së përqindjes së kontributeve, periudhës së kontribuimit në fondin pensional, periudhës së investimeve, periudhës së përfitimeve të anuiteteve pensionale, etj. Pra, vetqëndrueshmëria financiare e bazuar në rrjedhën e kontributeve dhe në normën e kthimit të saj nga investimet, si dhe pjesëmarrja financiare e pozicionit të pensioneve të durueshme për buxhetin e shtetit, e bëjnë sistemin pensional stabil dhe të qëndrueshëm. Qëndrueshmëria e sistemit pensional pasqyron mjaftueshmerinë e kapitalit apo të aseteve. krahasuar me shpenzimet totale dhe me tërheqjet e anuiteteve, që njëherit e pasqyron cilësinë e aseteve, profitabilitetin apo kapitalizimin, likuiditetin, sensitivitetin ndaj riskut, shëndetshmërinë financiare, etj. Pjesa dërrmuese e aseteve të sistemit pensional menaxhohet nga Fondi pensional-“Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK)”. Mjetet nën menaxhim të TKPK, në fund të periudhës së tremujorit të trete të vitit 2014, tejkaluan shifrën €1,038 miliardë, ndërsa pjesa rritur e mjeteve nën menaxhim ishte ndikuar më shumë nga kontributet e reja (€33 mln) dhe pjesa tjetër nga kthimi nga investimet (€14 mln). Në anën tjetër Fondi pensional i TKPK shpagoi pensione në shumë prej €3.04 mln, ndalesat për tarifën menaxhuese ishte €1.36 mln dhe refondimet ishin €0.12 mln, duke iu zbritur kështu mjeteve nën menaxhim rreth €4.53 mln, ndërsa shuma prej 0.6 % e totalit të mejeveve financiare nën menaxhim, menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).¹⁴

⁹Anusic, Zoran. “Administrative Charges of Private Mandatory Pension Funds.” Presentation for ILO Tripartite Conference on “Recent Developments on Pension Restructuring in Central and Eastern Europe.” Budapest, December 2004. Some information in this presentation comes from Anton Dobronogov and Mamta Murthi, “Administrative Fees and Costs of Mandatory Private Pensions in Transition Economies,” JPEF, March 2005.

¹⁰Carmichael, Jeffrey and Palacios, Robert. “A Framework for Public Pension Fund Management.” Paper presented to 2nd Public Pension Fund Management Conference. World Bank, Washington, DC, May 5-7, 2003.

¹¹Pension Systems in Latin America: Concepts and Measurements of Coverage by Rafael Rofman and Leonardo Lucchetti, November 2006 (online only)

¹²Pension System Reforms by Anita M. Schwarz, September 2006 (online only)

¹³Social Pensions Part I: Their Role in the Overall Pension System by Robert Palacios and Oleksiy Sluchynsky, May 2006 (online only)

¹⁴See www.kpst.org/English/Documentet/ for Annual Reports

Operimet me skemat pensionale në Kosovë

Operimet me skemat pensionale në Kosovë zhvillohen mbi bazë të zbatimit të politikave të cilat kanë të bëjnë me; mënyren e procesimit të dhënave mbi derdhjen e kontributeve pensionale në fondin pensional, grumbullimin e kontributeve të kursimeve pensionale në fondin pensional, pajtimin e të dhënave në mes të partnerëve mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave (Të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës dhe Fondit Pensional), ruajtjen e mjeteve pensionale, investimin e mjeteve pensionale, menaxhimin e kostos së investimeve dhe të kostos së operimeve, etj.

Mbledhja e kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale bëhet në bazë të Ligjit mbi pensionet, i cili e ka rregulluar mënyren obligative të pageses së kontributeve, si të punëdhënësve të cilët kontribuojnë në llogaritë individuale të punësuarve, ashtu edhe të punësuarve të cilët kontribuojnë në llogaritë të tyre personale. Mjete të kontributeve të grumbulluara në Fondet Pensionale ruhen dhe investohen deri në momentin e pagesës së anuiteteve pensionale.

Stabiliteti financiar i skemave pensionale

Teoritë më të njohura mbi stabilitetin financiar janë; Teoria e Vlerave Neto Pozitive nga Bernanke dhe Gertler në vitin 1990, e cila shërben për të matur gjendjen, ndjeshmërinë financiare të një situatë financiare apo shëndetshmërinë financiare e cila ndryshon krahasuar me planet e parashikuara. Lëvizja relative e aseteve të skemave pensionale mund të paraqesi ulje apo rritje, si dhe shkakton lëvizje të shpenzimeve, duke u ulur apo duke u ngritur ato, ashtu që performanca e operimeve të përgjithëshme e paraqet shkallën e stabilitetit të skemes pensionale në përgjithësi.

Teoriticiënt tjetër i teorisë së stabilitetit financiar është Crockett (1997), i cili e kishte definuar jostabilitetin financiar, duke e studiuar ndërtimin e strukturës së performances ekonomike. Ai kryesisht e shpjegon teorinë e stabilitetit financiar duke u bazuar në ndikimet të cilat mund të kenë fluktuacione të çmimeve të pasurive financiare apo nga aftësia e ndërmjetësuesve financiar për të përmbushur obligimet e tyre kontraktuale. Gjithashtu edhe Mishkini (1999) duke u fokusuar në rolin e informatave asimetrike e kishte definuar teorinë e tij mbi stabilitetin financiar. Ai e shpjegon stabilitetin financiar si një perputhje të efciences së sistemit financiar të fondit financiar gjatë alokimeve financiare, përmes mënyrave të zgjedhura të përmirësimit të rrjedhave pozitive në raport me rrezikun moral. Lidhur me teorite e stabilitetit financiar kishin dhënë mendim Bernanke dhe Gertler (2000), duke e definuar stabilitetin financiar, si një sinonim me të cilin ndërtohet qëndrueshmëria e çmimeve të pasurive, në kushte normale të funksionimit të tregut si dhe në kushtet e ndonjë permbysjeje të papritshme apo përmes “përdorimit të dhunës” në formë “aksidentale”. Me problematikën e stabilitetit financiar është marrur edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (2003), i cili në një mënyrë fokusohet në tipet e ndryshme të nderhyrjeve në sistemin financiar, duke u marrur me periudhat e paqëndrueshmërisë financiare që do të jenë periudha të ndërprerjeve të rënda të tregut financiar, sepse aftësitë e sistemit ofrojnë shërbime të pagesave sipas çmimeve të transferimit të rrezikut dhe të alokimit të likudimit të kredive i cili tregohet se është i paaftë dhe për pasojë qon në një reduktim të aktivitetit real.

Stabiliteti financiar në kontekstin teorik të Sistemit Pensional në Kosovë përqendrohet në parimet themelore të cilat i bëjnë të qëndrueshme këto sisteme, siç janë: garantimi i lirisë individuale, garantimi i drejtësisë sociale, definimi i të hyrave apo kontributeve pensionale në portfoliot individuale, mbajtja e mjeteve pensionale në mënyrë të sigurtë dhe me kosto të ulët menaxhuese, investimi i mjeteve pensionale në bazë të parimeve mbi kthimet maksimale me rrezik minimal. Teoria konzervative e investimeve të mjeteve financiare paraqet siguri të fondit pensional, sepse shumëllojshmëria apo diversifiteti i investimeve të ulët shkallën e rrezikut të zhvlerësimit të aseteve investuese, ndërsa investimi në klasët e ndryshme të aseteve dhe në derivatet e tyre, mundëson realizim të fitimit maksimal në përputhje me sigurinë e fondit pensional dhe ruajtjen e likuiditetit adekuat. Menaxhimi i mjeteve pensionale me efciencë të lartë, ruajtja e kualitetit të mjeteve pensionale përmes sigurimit të mjeteve dhe masave mbrojtëse, transparenca e vazhdueshme e

mjeteve pensionale, raportimet mbi gjendjen e mjeteve pensionale dhe auditimet, mbikqyrja permanente e mjeteve pensionale nga ana e autoritetit rregullativ, përgjegjshmëria dhe ndershmëria e organeve politikëbërëse, profesionaliteti i menaxhuesve të mjeteve pensionale, që të gjitha këto komponenta e bëjnë sistemin pensional më stabil.

Gjithashtu stabiliteti financiar i sistemit pensional në Kosovë kushtezohet nga faktorët makroekonomik të stabilitetit financiar, siç janë; popullsia, punësimi, konsumi, resurset natyrore, rritja ekonomike, prodhimi, investimet, këmbimi tregtar, eksporti, bilanci i pagesave, korniza politike, qeverisja, instrumentet e politikave ekonomike, koordinimi i politikave të brendëshme makroekonomike, potenciali financiar, oferta monetare, tatimet, shpenzimet qeveritare, rregullatori i BQK, inflacioni, çmimet, te ardhurat, likuiditeti financiar, rreziqet e stabilitetit financiar.¹⁵

Ekulibrat e modelit të sistemit pensional në Kosovë

Raporti në mes të hyrave financiare nga kontributet pensionale e te këthimeve nga investimet në relacion me shpagimet e anuiteteve dhe të shpenzimeve operacionale e te shpenzimeve të tjera, si dhe ndikimet makroekonomike te vendit dhe ndikimet e jashtme financiare, paraqesin shkallën e ekuilibrit të sistemit pensional në Kosovë.

Për të mbajtur shkallën e ekuilibrit sa më stabile, Bordi Qeverisë i skemave pensionale vendos mbi disejnimin e politikave të cilat i rregullojnë kufijtë e investimeve në klasët e asetëve financiare dhe të derivateve të tyre me qëllim të investimit të sasisë prej 40% të mjeteve nën menaxhim me shkallë të lartë të rrezikut (në instrumente që tregtojnë ekskluzivisht në aksione) dhe 60% me rrezikshmëri të ulët (në instrumente me kthim absolut), si dhe kujdeset për shpagimin e anuiteteve pensionale të pronarëve të portfoliove individuale të pensioneve.

Pra, ¹⁶Bordi Qeverisë vlerëson se duhet të ketë kujdesë në rregullimin e ekuilibrit midis interesave të kontribuesve që së shpejti do të dalin në pension, të cilët kanë shumë pak mundësi që të durojnë tolerancën për investime me rrezik të lartë dhe atyre që kanë mundësi që të durojnë investimet me rrezik të lartë deri në pensionim. Andaj për të mbajtur ekuilibrin e skemes pensionale është me rëndësi aplikimi i strategjisë e cila kontribon në balancimin e të hyrave të vazhdueshme të kontributeve pensionale të cilat investohen me shkallë relativisht konzervative të rrezikut në periudha afatgjate dhe shpagimeve te anuiteteve pensionale sipas periudhave të përshtatshme ligjore. Bordi Qeverisë i skemes pensionale e ka për detyrë të bën baraspeshimin e funksionimit te skemave pensionale, duke i marrur parasysh këto çështje dhe mban qëndrim të bazuar mbi parimin e investimeve të kujdesshme për kthimet e mundshme nga tregjet e kapitalit financiar. Kështu investimet në aksione të cilat menaxhohen në mënyrë pasive synojnë të gjenerojnë kthimin në investim më të lartë, ndërkohë që investimet në instrumentet me kthim absolut të cilat menaxhohen në mënyrë aktive synojnë ta stabilizojnë performancën investuese të Fondit të TKPK-së. Mbi ekuilibrimin janë dhënë shumë teori, të cilat kanë pasur per qëllim të perkufizojne qëndrueshmërinë e ekuilibrit ekonomiko-social të sistemit pensional, duke përcaktuar komponentet e bartësve të modelit të ekuilibruar te cilat shërbejnë për llogaritjen e “pikës kritike” apo te “pikës së qendres së rëndesës së modelit”, të cilat bazohen në studimin statik dhe dinamik të operimeve të fondeve pensionale me kontributet pensionale në tregun e investimeve ndërkombëtare dhe në administrimin e tyre. Ekuilibri i fondeve pensionale varet nga sistemi makroekonomik i Kosovës dhe nga ndikimet e levizjeve në tregun ndërkombëtar të kapitalit financiar. Diagrami i stabilitetit statik dhe dinamik i sistemit pensional i paraqet kurbat e qendrave te modelit, nga të cilat mund të interpretohen momentet vepruese të modelit të sistemit pensional, duke përcaktuar pikat e qëndrueshmërisë së kurbes, apo te vetqëndrueshmërisë apo të stabilitetit financiar.¹⁷ Pozicioni i kurbes së ekuilibrit e cila paraqet gjendje te anuar te sistemit pensional, interpretohet si moment i rrezikut apo mundësi për rrenim

¹⁵Before an equilibrium is reached when pension investments flow back into the country to pay benefits.

¹⁶Cerin P. 2002a. Communication in corporate environmental reports. Corporate Social Responsibility and Environmental Management 9(1): 46–66.

¹⁷Risk and Vulnerability Considerations in Poverty Analysis: Recent Advances and Future Directions by Carlo Cafiero and Renos Vakis, October 2006

të qendrueshmërisë së sistemit pensional. Varësia e diagramit të stabilitetit të sistemit pensional përqëndrohet në performancën e modelit dhe në kapacitetet e tipit të skemës pensionale e cila mund të evoluon në ruajtjen e pozicionit të qendrës nën ndikimin e makrosistemit ekonomik në Kosovë, në bazë të madhësisë së saj, krahasuar me fuqinë makroekonomike të vendit. Pra, aktualisht sistemi pensional në Kosovë disponon me shume te asetete financiare të përafërta me buxhetin e Kosovës, kështu që mund të konkludohet se demonstrimi i këtij modeli të skemave pensionale në Kosovë ka reprodukuar zhvillim kualitativ të fondeve pensionale dhe situata të ekuilibruara financiare apo qendrueshmeri solide ekonomiko-sociale.

¹⁸Qëndrueshmëria e sistemit pensional

Sistemi pensional në Kosovë është komponentë e rëndesishme e ndërtimit të qendrueshmërisë së sistemit financiar dhe të atij makroekonomik në Kosovë. Qëndrueshmëria e sistemit pensional në Kosovë, rezulton nga modeli i avancuar i cili është komponuar nga teoritë më të avancuara boterore dhe me praktikatat më të mira botërore të funksionimit të skemave pensionale. Komponentat statike të vetqendrueshmërisë ekonomike të skemave pensionale në Kosovë, të cilat në vete përmbajnë asetet e fondeve pensionale të krijuara nga rrjedhat e kontributeve pensionale dhe kthimet nga investimet si dhe pozicionet buxhetore- publike, i përbëjnë elementet kyçe të kualitetit të sistemit pensional. Natyra e komponentave të skemave pensionale, të cilat përmbajnë në vete; të hyrat nga kontributet pensionale mandatore, private apo vullnetare dhe publike, si dhe komponentat e shpenzimeve operacionale, investive si dhe të shpenzimeve tjera administrative, bëjnë që sistemi pensional të përmbajë komponenta kualitative dhe të qëndrueshme. Sistemi pensional bëhet edhe më kualitativ, kur këtyre komponentave iu shtohen edhe principet e qeverisjes dhe të menaxhimit¹⁹ të skemave pensionale, të cilat e rregullojnë funksionalizimin e qëndrueshëm të skemave pensionale në Kosovë. Bazuar në modelin e skemës pensionale, duhet të bëhet modeli i sistemit të Teknologjisë Informative për përpunimin e të dhënave, sepse roli i sistemit të Teknologjisë Informative është kyç në funksionimin efikas të skemave pensionale, i cili bënë futjen e të dhënave në sistem si dhe përpunimin e tyre, të cilat e paraqesin peshën apo efektin ekonomik në diagram gjatë levizjeve kohore. Andaj, sistemi i teknologjisë informative e paraqet komponentën më të ndieshme të qendrueshmërisë së sistemit pensional. Pra, konfigurimi i komponentave përbërëse të skemave pensionale paraqesin faktorët kyç, të cilët duhet të jenë në gjendje për të përballuar kushtet e ngarkimit dhe të shkarkimit, duke ruajtur stabilitetin dhe ekuilibrin e skemave pensionale.

Konkluzionet

Sistemi pensional në Kosovë karakterizohet si sistem; i shëndoshë, me shkallë të lartë të qëndrueshmërisë, me mundësi të përmirëimit të vazhdueshëm, model i bazuar kryesisht në konceptin e vetëzhvillimit apo të vetëfinancimit, që përmbushë kërkesën për zhvillim të sistemit pensional dhe stabilitet socio- ekonomik, i garantuar nga mënyra e qeverisjes etike e profesionale dhe me përgjësje fiduciare e me përvojë për të administruar llogaritë individuale pensionale, si rregullator i përshtatshëm i cili mundëson përfitimin e pensioneve nga të gjitha grupet e popullsisë rezidente të Kosovës, pa ndonjë formë të diskriminimit.

Me ndryshimin e Ligjit mbi pensionet në Kosovë krahasuar me Rregulloren 2001/35, vërehet se pozita e anëtarëve të Bordit Qeverisës të Fondit Pensional është xhveshur nga disa kritere të përzgjedhjes, të cilat e mbronin atë nga ndikimet polititike, kështu që mund të konkludojmë se është dëmtuar kualiteti i statusit të kandidatëve profesional për këto pozita, duke lënë hapësirë për manipulime dhe keqpërdorime të detyrës për qëllime të shterrjes së agjendave politike apo përfitimeve personale, që mund ta e lëndojë sistemin pensional. Planet e kontributeve të definuara me kontribute individuale,

¹⁸Central Bank of Hungary. "The Sustainability of the Hungarian Pension System: A Reassessment," Occasional Papers, No. 40, 2005.

¹⁹Turner. R.K., (1993), Sustainability: Principles and practice, in R. K. Turner (Ed.), Sustainable Environmental Economics and Management: Principles and Practice, London: Belhaven Press.

pasqyrojnë vlerën e pronës individuale. Kontributet e definuara te fondeve pensionale gjate investimeve indeksohen dhe sjellin normë të definuar të kthimi të portfoliove individuale dhe ato gjithëherë janë likuide. Portfoliot individuale të kontributorëve pensional në Kosovë, aktualisht nuk sigurojnë blerje të pensioneve, por ato iu shpërndahen atyre në formë aniutetesh të shterrëshme. Te këto fonde, kostoja e mirëmbajtjes së portfoliove individuale nga ana e fondeve pensionale është më e ulët se sa norma e kthimit. Në vitin 2009 nuk ishte aprovuar Raporti i vitit 2008 nga ana e Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, që përfshinte zhvillimet e investimeve të Trustit të Kursimeve Pensionale në tregjet e kapitalit financiar, ku ishin investuar 256.3 milion euro, të cilat ishin zhvlerësuar apo kishin pësuar rënie vjetore prej 10.4 përqind, si rezultat i krizës financiare globale dhe të shkaqeve të tjera financiare (me q`rast nuk ishte adresuar pergjegjesia e anetareve te Bordit Qeverises te TKPK). Për mos aprovimin e raportit vjetor të TKPK, nuk janë ndërmarrur masa të përgjegjësishë ndaj anëtarëve të Bordit Qeverisës, apo ndonjë masë tjetër e përmirësimit. Në Kosovë nuk ekziston ndonje rregullore e cila rregullon matshmërine apo kapacitetet e përgjegjësishë së anëtarëve të Bordeve Qeverisëse të Fondeve Pensionale. Skemat pensionale në Kosovë aplikojnë politika transparente dhe të kujdeseshme, ashtu që të mund të mbikqyren lehtë dhe në mënyrë të shumëfishtë operimet e tyre. Transparenca e skemave pensionale e rritë shkallen e sigurisë së operimit të tyre dhe e bënë sistemin pensional të parashikueshëm rreth zhvillimit të proceseve ekonomike e sociale në Kosovë.

Referencat

1. Blake David, Pension Schemes and Pension Funds in the United Kingdom, Oxford University Press, 2nd Edition, forthcoming
2. Canadian Pension Supervisory Authorities (july 2003), Pension plan governance guidelines and self-assessment questionnaire.
3. Chong, A., & Lopes-de Silanes, F. (2007). Investor Protection and Corporate Governance: Firm-Level Evidence Across Latin America.. Stanford University Press. Du Plessis, J. J., Hargovan, A., & Bagaric, M. (2011). Principles of Contemporary Corporate Governance. Oxford University Press.
4. Cui, J, F de Jong, and E. Ponds (2006). Intergenerational risk sharing within funded pension schemes. Netspar.
5. Code of the Dutch Pension Funds
6. Estelle James nga Banka Boterore & Sarah Brooks nga Duke University (2002), "The Political Economy of Structural Pension Reform" published in Course on Pension Reform 2nd Generation & Implementation Issues" Volume II, Warsaw, Poland, by World Bank Institute.
7. Estelle James (World Bank) and Sarah Brooks (Duke University); The political Economy of Structural Pension Reform
8. Fondi i kursimeve pensionale të Kosovës 'Raporti Vjetor (2012), Prishtinë, 2013
9. Fondi i kursimeve pensionale të Kosovës 'Raporti Vjetor (2013), Prishtinë, 2014
10. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) "Manuali i investimeve", Prishtine, 1 nëntor 2013
11. Goltz Felix, Schröder David "Hedge Fund Transparency: Where Do We Stand?"
12. Hereijgers Patrick (2013-012), "How to Measure and Apply Risk Preferences in the Second Pension Pillar, MSc Thesis, Tilburg University
13. IMF Republika e Kosovës (2013)- Raporti i stafit për konsultimet artikulli IV, 28 Qershor 2013
14. International Monetary Fund (2013), "Republika e Kosovës - Raporti i stafit për konsultimet- Artikulli IV 2013, Problemet kyçe
15. Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillim të politikave (maj 2011)- Menaxhimi publik: Analizë e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura- Prishtinë, Kërkime politike 2011/06.
16. Izenkova Assel (2012), "Measures to Improve the Transparency of Pension Systems in Crisis Management", International Conference on Economics, Business Innovation IPEDR vol.38 (2012) © (2012) IACSIT Press, Singapore
17. Jack Brennan: Chairman & CEO (2002), The Vanguard Group with Marta McCave ,, Straight talk on Investing" John Wiley & Sons, Inc. Hoboken New Jersey, USA
18. John Rogers- Director (1995), Investment Service, NAPF Guide; Investment Management Trustees' Pocket Guide, Launched in UK
19. Kahneman, D. and A. Tversky (1984). Choices, values and frames. American psychologist 39,

341{350.

20. Kopits George and Craig Jon (January 1998),“Transparency in Government Operations”- International Monetary Fund, Washington DC.
Actually ,since October 2005, a declared priority of the Government of Albanian (GoA) has been the improvement of the legal framework, which impacts on business climate, through the establishment of a Regulatory Reform Task Force. Regulatory Reform is based on the principle of eliminating bureaucracy, barriers and subjectivity through the simplification of the existing regulatory framework and creation of a longer-term and sustainable system designed to raise the quality of legislation.

The European Union Progress Reports have called for further efforts from Albania to establish a system for Regulatory Impact Assessment to assessments conducted on the progress of Regulatory Reform in the field of business registration, licensing, etc.,

Knowing that the quality of regulations is vital to the economic capability and well-being of a country, in this paper will present the actual status of RIA implementing from Albanian Government emphasizes the weakness and positivity's of government in this process, presenting at the same time the best practice of RIA system implementation. During the analyses the process of RIA implementing we would like to introduce in this paper a different structure procedure for implemented RIA in Albania.

Keywords: Impact Assessment, regulatory reform, cost benefit analyses, small business, decision.

Hyrje

Ne jemi të gjithë dëshmitarë që Shqipëria po bën hapa të rëndësishme për të qënë anëtare e BE. Por për këtë nuk mjafton vetëm dëshira dhe vullneti politik por duhet shumë punë, ndryshime të rëndësishme përshtatje me rregullat dhe procedurat europiane në të gjitha fushat, qofshin ato në fushat politike, ekonomike, shëndetësore, mjedisore apo sociale.

Për të realizuar këto obligime qeverisë Shqiptari i duhet të përballet me një set reformash dhe rregullimesh të domosdoshme të cilat krijojnë klimë të përshtashme rregullatore jo vetëm për institucionalistët në vendimarrjen e tyre por në të njejtën kohë krijojnë lehtësira dhe klimë të përshtatshme për subjektet e ndryshme private dhe shtetërore për të operuar në fushat e ndryshme të ekonomisë, industrisë shëndetësisë etj.

Në këtë përballje të qeverisë Shqiptare me reformën rregullatore të nevojshme del e rëndësishme edhe vlerësimi i impaktit të reformës rregullatore. Një instrument proceduarial i rëndësishëm që bën të mundur vlerësimin e impaktit të reformës rregullatore apo të politikave të ndërmarra nga ana qeverisë është Vlerësimi I Impaktit Rregullator RIA(Regulatori Impact Assesment). Por cfarë është RIA.? Sot, RIA është përceptuar në përgjithësi (OECD 2009, fq 12-14; Kirkpatrick & Parker, 2007a), si një *instrument* sistematik dhe *procesi* i vlerësimit ex-ante të rregullimeve (ligjeve , politikave pogramave) para se ky rregullim të jetë propozuar. RIA nuk është një zëvendësim i vendimarrjes politike, por një instrument që ndihmon në marrjen vendime të informuara. Procedura e RIA-s parashikon përfshirjen e një procesi të fortë të konsultimeve me të gjitha palët e interesuara,

integrimi sistematik i instrumentit në procesin e vendim-marrjes dhe gjithashtu duke ndërtuar një proces të vlerësimit nga vetë RIA për të siguruar feedback në dobi të saj. Për të krijuar një pamje më të mirë të diapazonit të qëllimit të “rregullimit më të mirë” për të cilin është “themeluar” RIA duhet të shikohet në chek listën e ndjekur nga OECD lidhur me vendimarrjen rregullatore që nga viti 1995 si :- A është përcaktuar saktë probemi?;-A është veprimi I qeverisë që mendon të ndermarrë i justifikuar ?;-A është “ rregullimi” veprimi më i mirë që mund të ndërmerret Qeveria?;- A ekziston një bazë legjislative për “rregullimin” ?- Cili është niveli actual i Qeverisë për të ndërmerret këtë veprim?;- A justifikojnë përfitimet koston që duhet të ndërmerren në këtë rast ?;- A është transparent efekti I këtij veprimi në shoqëri ?;- A është rregullimi I qartë, konsistent, gjithpërfshirës , dhe që u jep mundësi të përdoret apo shfrytëzohet nga përdoruesit ?;- A kanë të gjithë partitë e interesit shanse për të prezantuar pikëpamjen e tyre për këtë “rregullim”?;- Si do të arrihet përputhshmëria me aktorët e interesit ?

Vlerësimi I Ndikimit Rregullator është një mjet që informon vendimarrjen në sektorin publik. Punonjësit e administratës publike duhet të sigurojnë që aktet ligjore plotësojnë nevojat e shoqërisë, hartohen dhe zbatohen në mënyrë efektive dhe eficiente. Vlerësimi ekonomik I ndikimit rregullator kërkon veçanërisht për të përcaktuar se cilat veprime të qeverisë sigurojnë përfitime neto më të mëdha për vendin në tërësi dhe jo vetëm për nëngrupe specifike përfituar nga një ligj apo politikë (p.sh. fermerëve, sindikatat, punëtorët e qeverisë). Kjo gjë bën të mundur që politikbërësit të marrin në konsideratë nëse vendi do të jetë më mirë “me ose pa” këtë ligj , ndryshim të ligjit apo te një politike. Pyetja e parë që duhet përgjigjur është nëse ekziston një nevojë ekonomike për rregullimin e identifikuar. Referuar në sa më sipër, në këtë artikull do të paraqiten hapat e ndërmarra nga Qeveria shqiptare për implementimin e sistemit të RIA-s në Shqipëri, duke treguar anët pozitive dhe negative të implementimit të saj në Shqipëri. Gjithashtu do të prezantojmë vendet më me eksperiencë në implementimin e sistemit të RIA-s, të cilat duhet të jenë në fokus të shqipërisë gjatë implementimit të RIA-s.

Historia e RIA-s

Shumë më tepër rreth RIA është thënë nga historia e saj, historia e RIA flet vetë. Kjo është ajo çfarë është trajtuar në këtë seksion duke filluar me dy pionierët kryesore të RIA, Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe duke vazhduar me internacionalizimin e konceptit.

Fillimet e RIA ne USA . Rrënjët e para të Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ mund të gjurmohet prapa në SHBA-në e viteve 1970-ës nën administrimin e Nixon kur kompanitë amerikane filluan të ankohen për koston kryesisht të rregullimit të mjedisit. Një program më transparent i vlerësimit të ndikimit fillestarë u prezantua nëpërmjet Urdhërit Ekzekutiv 11,821 nga Presidenti Ford i cili kërkonte nga të gjitha agjencitë që të kryenin Vlerësime të Impaktit të Inflacionit përpara krijimit të rregullores së re. Kjo ishte një reagim ndaj stagflacionit që goditi SHBA në gjysmën e parë të 1970-ës. Për mbarëvajtjen e punës në këtë kohë u themelua një Këshill mbi Pagën dhe Stabilitetin e Çmimeve për të monitoruar nëse Vlerësimet ishin kryer saktë dhe nëse jo, i cili mund të propozonte që të mos miratohej një rregullore.

RIA në formën e sotme aktuale u krijua në thelb nga presidenti Regan në vitin 1981 nëpërmjet Urdhrit Ekzekutiv 12,291. Ky urdhër mandatoi agjencitë për të nxjerrë vetëm rregullore përfitimet të cilave do të ishin më të mëdha se koston që do të vlerësoheshin nga Analiza e Impaktit Rregullator. RIA duhet të përmbajë përshkrimin dhe mundësisht koston dhe përfitimet, shpërndarjen e tyre dhe opsionet alternative të arritjes së qëllimit rregullator. Mbikëqyrja iu dha Zyrës së Menaxhimit dhe të Buxhetit (ZMB). Gjatë administratës së presidentit Bush Sr. fokusi u kthye më shumë në konkurrencën e firmave amerikane por në përgjithësi gjithçka tjetër pervec fokusit qëndroi njësoj. Në këtë kohë shpërtheu një mosmarrëveshje institucionale. U argumentua nga demokratët, disa ekonomistë dhe të tjerë që ZMB ka shumë pushtet mbi procesin rregullator dhe mund të ndalojë çdo rregullore.

Presidenti Clinton bëri disa ndryshime në RIA nëpërmjet Urdhrit Ekzekutiv 12,866. Presidenti hoqi të drejtën e vetos nga ana e ZMB ndaj ndonjë rregulloreje dhe gjithashtu bëri subjekt të RIA vetëm rregulloret me ndikim më të lartë se 100 milionë dollarë në vit gjë që lejoi vlerësim superior të më pak rregulloreve (më pak se gjysma). Ajo gjithashtu ripërcaktoi qëllimin e dëshiruar nga ‘më shumë

përfitime sesa kosto' në 'përfitimeve që justifikojnë shpenzimet'. Modeli më vonë u ndryshua paksa nga Presidenti Bush Jr. Disa prej këtyre ndryshimeve janë revokuar më vonë nga Presidenti Obama (Harrington, Heinzerling, dhe Morgenstern, 2009, f. 10). ***Ne mund të shohim se në SHBA, në djepin e RIA-s, implementimi i RIA-s ka kaluar nëpër një proces mjaft të gjatë zhvillimi. Ajo që është e dallueshme që në fillim të RIA-s është që në themel të saj është parimi i ekonomisë së mirëqenies dhe në zemrën e saj qëndron analiza kosto-përfitim.***

RIA në UK. Vendlindja e dytë e RIA është Mbretëria e Bashkuar. Implementimi i parë u krye në 1986 gjatë administratës Thatcher në kontekstin e përpjekjeve për liberalizimin e kësaj administrate. Ajo u mbiquajt Vlerësim I Përputhjes së Kostos (CCA) të rregullores së propozuar dhe ishte de facto e përqëndruar vetëm në pengesat administrative me të cilat përballeshin bizneset. Për ti monitoruar, u ngrit një njësi shtetërore e quajtur Njësia e Ndërmarrjeve dhe Liberalizimit, më vonë mbajti emrin Njësia e Liberalizimit. Gjatë administratës së John Major, objekti i vlerësimit të ndikimit u zgjerua. U krijuan shtatë njësi të reja në vitin 1992, por përpjekjet qenë mjaft të pasuksesshme.

Përsëri, pas këtyre fillimeve, në vitin 1998 u zhvillua një RIA pothuajse si kjo e sotme në kohën kur kryeministër ishte Tony Blair. Në këtë stad RIA përfshinte një analizë kosto-përfitim dhe gjetjen e opsioneve më të mundshme rregullatore, përfshirë opsionin 'zero'. Njësia e Liberalizimit u reformuar dhe u ndryshua në Njësinë e Ndikimit Rregullator (NNR). Brënda RIA u krijua Task Force e Rregullimit të Përmirsuar (më vonë Komisioni i Rregullimit të Përmirsuar) e cila filloi të vlerësonte përpjekjet e RIA dhe të mbledh dhe vërë në dukje praktikatat e mira. Në vitin 2001 u miratua një Akt Reforme Rregullator i cili shkante më tej kryesisht në çështjen e pasojave të pasvlerësimit të rregullimit ekzistues.

Në vitin 2005 u iniciua një Plan Veprimi Rregullorë të Përmirsuar dhe ambicioz. Nëpërmjet tij filloi një ndryshim të madh me një qasje më shumë me orientim-rreziku në vlerësimin rregullator, i cili kishte për qëllim reduktimin e mëtejshëm të barrës administrative. Sipas këtij plani rregullorja duhet të vijë vetëm kur ajo të ishte me të vërtetë e nevojshme dhe duhet të jetë në përpjesëtim me rrezikun e barrës së imponuar. Gjithashtu plani inicioi një nismë të re ku bizneset mund të sugjerojnë vetë rregulloret që ata i perceptojnë si tepër të rënda. Që nga viti 2006 Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar tërësisht të gjitha proceset RIA dhe duke lëshuar rregullisht raporte me rezultatet e këtij vlerësimi. Nga njëra anë historia e RIA në Mbretërinë e Bashkuar është pak më e shkurtër, por nga ana tjetër ajo sigurisht që është shumë më interesante për shumicën e vendeve Europiane për shkak të karakteristikave shumë më të përbashkëta në formën e qeverisjes me Britaninë e Madhe sesa me SHBA. Ne mund të shohim se RIA e Mbretërisë së Bashkuar shtrin historinë e saj paralele më së shumti me fokus kryesor kryesisht në reduktimin e pengesave administrative ndaj firmave.

RIA në vendet e OECD. Një nga botimet e para mbi këtë temë në zhvillim është p.sh. OECD (1993), ku është përshkruar dizenjimi dhe përdorimi i listave të kontrollit për të siguruar cilësi rregullative në vende të ndryshme të OECD-së. OECD ka vazhduar me përpjekjet e saj dhe në vitin 1997 ajo filloi të përdorë zyrtarisht termat Analiza e Ndikimit Rregullativ ose Vlerësim. Në të njëjtin vit OECD gjithashtu realizoi përmbledhjen e parë të praktikave më të mira në RIA (OECD, 1997a) ku përcaktohet se çfarë është RIA, cilat janë objektivat e saj kryesore dhe është përmbledhur çfarë kishte arritur secili vend. Sipas S. Jacobs (2006, fq. 5) rreth 15 prej 30 vendeve anëtare të OECD-së miratuan kërkesat formale të përdorimit të RIA gjatë përgatitjes së rregullores që nga viti 2000. Kjo i mundësoi OECD për të vazhduar në analizën e mëtejshme të gjendjes së RIA në ato vende. P.sh. në vitin 2004 ajo nxorri në përdorim Inventarin RIA (OECD, 2004) i cili ishte një pasqyrë e madhe përshkruese se çfarë lloji analize RIA përmban në çdo vend, çfarë rregullimi mbulon, sa publike është RIA, çfarë lloji kontrolli cilësie është realizuar në vend apo si është vlerësuar rreziku. Në vitin 2005, OECD publikoi Parimet Udhëzuese për Cilësinë Rregullatore dhe Funksionimin i cili ishte një tjetër dokument i shkurtër për politikë-bërësit e anëtarëve të saj (OECD, 2005). Kryesisht shqetësimi i pafund i OECD-së për 'rregullimi të përmirsuar' dhe në veçanti për Vlerësim të Ndikimit Rregullator ka ndihmuar për të përhapur këtë 'markë' dhe ide në lidhje me përmbajtjen e saj në botë dhe e bëri atë një fenomen global. Përsëri, ashtu si tregon S. Jacobs (2006, fq. 5), në fund të viteve 2000 tashmë 23 nga 30 vendet anëtare të OECD-së dhe 8 jo-OECD kishtin zbatuar një formë të RIA. Kjo tregon se RIA ka qenë e suksesshme të paktën në tërheqjen e vëmendjes së shumë qeverive.

RIA në Bashkimin Europian. Një tjetër lojtar kryesor që nuk duhet të harrohet kur flasim për

historinë e RIA është Bashkimi Evropian. Sistemi i parë i vlerësimit të ndikimit të rregullave Evropiane u krijua nën Presidencën e Mbretërisë së Bashkuar në vitin 1986. Ai u quajt Vlerësimi i Ndikimit të Biznesit dhe u paralelizua me vijat e qasjes Britanike me qëllimin kryesisht për të reduktuar barrën që mbartnin bizneset. Ka pasur edhe dy lloje të tjera, Vlerësimet e Ndikimit në Qëndrueshmërinë dhe Shënimet e ndikimit. Por të gjitha këto analiza nuk janë përdorur aspak sistematikisht dhe vlerësimi ishte shumë i fragmentuar.

Në mund të themi se (në atë kohë tashmë) BE-ja me të vërtetë u hodh në valën e 'rregullimit të përmirësuar' vetëm në fillim të shekullit të 21-të. Në vitin 2001, Grupi Mandelkern për Rregullim të Përmirësuar, të cilit iu dha mandati në vitin 2000 në bazë të Rezolutës së Strasburgut në përmirësimin e cilësisë së rregullores, lëshoi një raport me një plan veprimi brenda të cilit deri në qershor 2002 duhet të themelohej një formë e re e Vlerësimit të Ndikimit të Integruar (VNI) në nivel Evropian dhe të përdoret në të gjithë legjislacionet me efekt të mundshëm rregullator. Modeli erdhi në fuqi në vitin 2003 dhe përfshin jo vetëm analiza të ndikimit ekonomik, por edhe ndikimeve sociale dhe mjedisore. Për më tepër, disa rregullore duhet të kajonë nëpërmjet një analize edhe më të thellë, Vlerësimi të Ndikimit të Zgjeruar. Nga 2005 VNI mbulon të gjitha propozimet legjislative të Komisionit Evropian dhe në të njëjtin vit edhe ndryshimet substanciale nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian janë bërë subjekt i vlerësimit të ndikimit. Ky është një informacion interesant në lidhje me temën e kësaj teze. Për ta përmbledhur, pasi u injektua në nivel Evropian nga Britania e Madhe, RIA më në fund mori rrugën e vet për në BE në mënyrë masive. Ajo përfshin jo vetëm vlerësimin e ndikimeve ekonomike, por edhe llojet e tjera të ndikimeve të tilla si ato mjedisore.

Statusi i RIA-s në Shqipëri

Në vitin 2003 me miratimin e ligjit nr. 9000 cdo ligj apo Vendim I Këshillit të ministrave duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me një relacion shpjegues, relacioni i cili tashmë është një pjesë e qënësishme e hartimit të ligjeve apo akteve nënligjore. Relacioni përmban synimet dhe objektivat e projekt aktit, një shpjegim mbi mënyrën se si projekt-akti lidhet me strategjinë zhvillimore të vendit dhe me objektivat e politikave të qeverisë, të vendit dhe me objektivat e politikave të qeverisë, vlerësimi i përfitimeve të mundshme, kostos ekonomike dhe nivelit të efektivitetit; problemet që lidhen me zbatimin e këtij akti ligjor; përputhshmëria me ligjet ekzistuese dhe harmonizimi me legjislacionin e BEsë; informacion rreth palëve dhe institucioneve që u konsultuan dhe që kontribuan në procesin e hartimit të projekt-aktit; specifikime mbi institucionet dhe/ose organet që janë përgjegjës për zbatimin e aktit ligjor.

Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, i vitit 2003 parashikon që projektakti të shoqërohet nga një Vlerësim Buxhetor, i cili përfshin: shumën totale të shpenzimeve vjetore për zbatimin e aktit ligjor; Analizën e shpenzimeve buxhetore për tre vitet e para të zbatimit; Një indikacion rreth caktimit buxhetor, kur përdoren fonde publike. Çdo Ministri që propozon legjislacion të ri është i detyruar t'ua përcjellë projektligjin (së bashku me Relacionin Shpjegues dhe Vlerësimin Buxhetor) për opinion Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Integritimit Evropian. Projektligji i dërgohet gjithashtu ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në rastin e një përmbajtje domethënëse ekonomike, dhe çfarëdolloj Ministrie tjetër kur projekt-akti gjykohet të lidhet me sferën e përgjegjësive së Ministrisë përkatëse. Projektligji rishikohet duke iu përgjigjur komenteve të marra nga Ministrinë dhe më pas i përcillet nga ana e Ministrisë propozuese Sekretarit të Përgjithshëm pranë Këshillit të Ministrave (Departamentit të Legjislacionit dhe Koordinimit). Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave mund t'ia kthejë projekt-aktin Ministrisë propozuese para kalimit të tij në Komitetin Ndërmnistror.

Në kuadër të RIA, me amendimin e bërë në vitin 2010 ndaj Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, të datës 28 gusht 2003, i ndryshuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 201, i datës 29.03.2006 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 4, i datës 07.01.2009, Relacioni Shpjegues dhe Vlerësimi Buxhetor duhet të përgatiten duke përdorur një format standard. Format i ri për Relacionin Shpjegues, i orientuar ndaj RIA-s, përfaqëson një system embrionik të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator për Shqipërinë.

Por aktualisht sot nuk kemi zhvillime të reja në lidhje me RIA-n, përpjekjet për një përjasje

embrionale me RIA-n në Shqipëri u realizuan në kuadër të projektit BERIS të Bankës Botërore. Referuar proceduarave të RIA-s sensit të thellë analitik që duhet për të mundësuar implementimin e RIA-s gjykojmë se Shqipëria ka mungesa në kapacitete të afata në fushën e analizave në departamentet ligjore të cilët të jenë të aftë të përballojnë implementimin e RIA-s.

Gjithashtu referuar çek listës së RIA në pikën 6 të saj kërkohet identifikimi i kostove dhe përfitimeve të ndryshimeve të propozuara. Por për të arritur këtë duhet që vendimarrësit të jenë të përgatitur për identifikimin e kostove dhe përfitimeve dhe të jenë të aftë për të paraqitur një bilanc të qartë të kostove dhe përfitimeve që gjeneron nderhyrja (politika apo legjislacioni) i propozuar, gjë e cila mungon në Shqipëri.

Në këtë kontekst për të bërë më të qartë këtë fakt kam kryer një anketim me punonjës në departamentet vendimarrëse në 10 institucione vendimarrëse Shqiptare. Synimi i anketimit ishte mbledhja e informacionit lidhur me njohuritë rreth RIA-s në përgjithësi në nivele të ndryshme vendimarrëse, dhe në vecanti mbi informimin dhe njohuritë e tyre për metodat e vlerësimit të kostove dhe përfitimeve të shkaktuar si rezultat i rregullimeve. Nga anketimi rezultoi se 60 % e të pyeturve nuk kishin informacion për RIA-n, 25 % ishin të mirinformuar për RIA-n dhe 15% e tyre kishin dëgjuar të flitet për RIA-n.

Lidhur me pyetjen se cilat janë metodat kryesore të vlerësimit të ndikimit të impaktit të reformës rregullore nga vrojtimi konkludohet se 40 % e tyre njohin metodën e analizës kosto përfitim (CBA) dhe për metodat e tjera të vlerësimit të ndikimit rregullator kjo përqindje ishte shumë e vogël. Referuar në sa është përshkruar mësipër si dhe vrojtimit të realizuar në kuadër të një informimi paraprak konkludojmë sa më poshtë :

Konkluzione dhe rekomandime

-RIA është një instrument shumë i rëndësishëm që ndihmon vendimarrësit për të adresuar politikën dhe legjislacionin e nevojshme për Shqipërinë duke e konsideruar si një metodologji e cila përmirëson cilësinë e ligjeve dhe sistemit rregullator në Shqipëri.

-Sic është bërë e ditur mësipër Shqipëria ka mungesë kapacitetesh për analizat e ndikimit rregullator (për të implementuar RIA-n), kështu që implementimi i saj në formën RIA full është e veshtirë, prandaj është mëse e evidente që në statusin aktual në të cilën Shqipëria ndodhet dhe referuar implementimit të RIA-s light është vendimi i duhur i marë nga qeveria Shqiptare.

- Duke vlerësuar faktin që RIA ka startuar në Shqipëri në një fazë embrionale pavarësisht stanjacionit të momentit do të gjykonin si të drejtë dhe të nevojshme që paralelisht me zhvillimin e instrumentit të RIA-s të punohet për aftësimin e kapaciteteve në fushën e analizave.

- Implementimi i RIA-s në Shqipëri duhet të realizohet nga një institucion i specializuar duke ju referuar sistemit të UK së implementimit të RIA-s, kjo për arsye si të veshtirësive financiare ashtu dhe nga pikpamja kohore (deri sa të aftësohen kapacitetet analizuese në departamentet vendimarrëse për kryerjen e analizave të impaktit rregullator).

-Shqipëria për rregullime (ligje, politika apo programe) të cilat kanë një impact në një spektër të gjërë dhe me një kosto të lartë domosdoshmërisht duhet të ndjekë procedurën e RIA-s pasi Shqipëria nuk ka më kohë për të humbur....

References

OECD (2005), OECD Guiding Principles for Regulatory Quality and Performance.

Jacobzone.S, Chang-Won Choi, &Claire Miguët. (2007) , “Indicators of Regulatory Management Systems”, OECD Working Papers on Public Governance, No. 4.

OECD (1997), The OECD Report on Regulatory Reform: Synthesis.

OECD,(2004).Regulatory Governance in South East European Countries - Progress and Challenge, Regulatory Governance Initiative of the Investment Compact,

OECD (2004) Regulatory Performance: Ex-Post Evaluation of Regulatory Tools and Institutions.

OECD (2005), OECD Reviews of Regulatory Reform, Regulatory Reform in Russia,

OECD . (2011), Reviews of Regulatory Reform - Background Document on Regulatory Reform in OECD

Countries.

OECD.(April 2008), Measuring Regulatory Quality. Policy Brief.

OECD. (January 2007), Cutting Red Tape: National Strategies. Policy Brief

OECD.(1995). Recommendation of the Council of the OECD on Improving the Quality of Government Regulation. OCDE/GD

OECD Headquarters.(18-19 October 2001), Best Practices in OECD Countries. Paris,

OECD. (2007),SME Policy Index .Report on the Implementation of the European Charter for Small Enterprises in the Western Balkans prepared by the European Commission Directorate General for Enterprise and Industry and the OECD Investment Compact for South East Europe

SIGMA.(6 June 2007),Regulatory Management Capacities of Member States of the European Union, Paper No. 42.

OECD.(2008),Building an Institutional Framework for Regulatory Impact Analysis (RIA): Guidance for Policy Makers. Version 1.1.

OECD.(2004), Regulatory Impact Analysis (RIA) Inventory. Note by the Secretariat GOV/PGC/RD.

Burimet e informacionit rreth destinacioneve turistike shqiptare për turistët vendas dhe të huaj

Evis Kushi

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”
Elbasan, Albania

Enkela Caca

Departamenti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave të Natyrës,
Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Albania

Abstract

Ky punim thekson rëndësinë e informacionit në industrinë e turizmit dhe fokusohet në analizën e burimeve të informacionit për destinacionet turistike shqiptare. Duke përdorur të dhënat e një anketimi drejtuar një numri të gjerë turistësh vendas dhe të huaj në zonën e hoteleve bregdetare, studimi tregon që burimet më të vlerësuara janë vizitat e mëparshme dhe miqtë/thashethemet. Ndërsa publiciteti, agjencitë turistike dhe Interneti përfaqësojnë një burim që nuk shfrytëzohet shumë nga turistët. Vecanërisht agjencitë turistike nuk operojnë mirë në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera në rajon. Punimi ofron disa rekomandime me vlerë për aktorë të ndryshëm në industrinë e turizmit në Shqipëri.

Fjalët kyçe: Burime informacioni, destinacione turistike shqiptare, anketim.

Hyrje

Vetëm pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri në 1991, turizmi është konsideruar si një shancet më të mira të vendit për zhvillim ekonomik. Ashtu sikurse në vendet e tjera mesdhetare, turizmi në Shqipëri është një ndër industritë më të rëndësishme dhe sektori i hoteleve bregdetare përfaqëson sektorin më të zhvilluar në këtë industri. Megjithatë, mungesa e informacionit ose informacioni jo i plotë është një tipar i rëndësishëm në tregun e turizmit sepse produkti turistik konsiderohet si një grupim i gjerë komponentësh, të cilët integrojnë elementë fizikë, shërbime dhe informacion. Që nga studimi i Akerlof (1970), shumë studiues vërtetojnë në mënyrë teorike dhe empirike që mungesa e informacionit ul cilësinë dhe rrit çmimet mesatare të produkteve, duke theksuar kështu rëndësinë e ekzistencës së burimeve të ndryshme të informacionit në treg.

Edhe pse gjatë dy dekadave të fundit në Shqipëri studiuesit i kanë kushtuar një interes të veçantë industrisë së turizmit, duket qartë që mungojnë studimet lidhur me burimet e informacionit në këtë industri, dhe sidomos vlerësimin e tyre nga turistët vendas dhe të huaj. Prandaj, rëndësia e trajtimit të kësaj çështjeje dhe mungesa aktuale e kërkimeve të tilla përbëjnë llogjikën dhe kontributin kryesor të këtij punimi. Qëllimi kryesor i tij është jo vetëm të analizojë vlerësimin e burimeve të informacionit nga turistët vendas dhe të huaj në destinacionet turistike shqiptare, por gjithashtu të ofrojë rekomandime me vlerë për aktorë të ndryshëm në industrinë e turizmit në Shqipëri.

Punimi është organizuar në këtë mënyrë: Seksioni 2 diskuton shkurtimisht bazën teorike të tij duke shpjeguar rëndësinë e informacionit në industrinë e turizmit në përgjithësi. Seksioni 3 paraqet metodologjinë e kërkimit dhe grumbullimin e të dhënave ndërsa Seksioni 4 diskuton rezultatet. Seksioni 5 përshkruan përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit.

Rëndësia e informacionit në industrinë e turizmit

Në përgjithësi, shumica e studiuesve në fushën e ekonomiksit të informacionit pranojnë se informacioni jo i plotë dhe i vonuar sjell pasiguri e cila shfaqet në dy dimensione, çmim dhe cilësi.

Për shembull, Carlton dhe Perloff (2004) tregojnë se në tregjet ku informacioni nuk është i plotë ka gjithmonë inefiçenca që nënkuptojnë se nivelet e cilësisë janë shumë të ulta. Një arsye për këtë është se firmat nuk mund të arrijnë përfitimet maksimale nga shitja e një produkti me cilësi të lartë. Kjo është shpjeguar fillimisht në studimin e Akerlof në vitin (1970), i cili argumenton se kur një shitës ofron një produkt me cilësi relativisht të lartë, cilësia mesatare në treg rritet. Prandaj blerësit, që nuk kanë informacion për të gjithë produktet individuale, janë gati të paguajnë më tepër për të gjithë produktet në treg. Kjo do të thotë se shitësi i cilësisë së lartë i ndan përfitimet e produktit të tij me shitësit e produkteve me cilësi të ulët duke e rritur çmimin mesatar për të gjithë produktet. Kjo është arsyeja që në këto raste firmat nuk dëshirojnë të prodhojnë dhe të shesin një produkt të cilësisë së lartë.

Vecanërisht në lidhje me turizmin, Caccamo dhe Solonandrasana (2001) argumentojnë se kjo është një industri ku duket qartë që sasia e informacionit dhe mënyra si paraqitet ai ka një ndikim të lartë në vendimin e turistëve. Roli strategjik i informacionit në fushën e turizmit mund të kuptohet më qartë duke konsideruar tre aspekte të rëndësishme të përcatimit të “produktit turistik”.

Së pari, produkti turistik është një kombinim produktesh pasi ai përbëhet nga një tërësi karakteristikash të tilla si vendi, transporti, akomodimi, objekte tërheqëse dhe shërbime shtesë. Secili nga këta komponentë përbën një burim potencial për mungesë ose pamjaftueshmëri informacioni. *Së dyti*, produkti turistik është një produkt “eksperience”, që do të thotë se turistët nuk mund të vlerësojnë cilësinë përpara se ta konsumojnë një produkt të tillë dhe ata as nuk mund të shijojnë një mostër të produktit. Kështu, sikurse sugjeron edhe Nelson (1974), turistët kanë mundësi vetëm të studiojnë informacionin turistik të disponueshëm dhe të përpiqen të vlerësojnë cilësinë. Megjithatë, cilësia është një karakteristikë subjektive dhe problemi i pasigurisë për cilësinë është më i madh se problemi i pasigurisë për çmimet. Nga njëra anë, informacioni në lidhje me cilësinë është në përgjithësi më i kushtueshëm për t’u siguruar dhe, nga ana tjetër, publiciteti nuk është burim i besueshëm. Gjithashtu, përvetësimi i informacionit strategjik është rezultat i eksperiencës së akumuluar nga turistët, e cila nënkupton konsumin e akumuluar turistik. Në këtë kontekst, publiciteti dhe burimet e tjera të informacionit, si mjet informimi, mund të kenë vlerë vetëm për turistët krejtësisht të paimformuar.

Së treti, produkti turistik është një aktivitet i lokalizuar dhe jo gjithmonë një turist e di vendndodhjen e saktë të tij. Ai mund të jetë një vend historik, një park natyror, një restorant, një hotel apo një motel, etj. Përderisa konsumatorët në përgjithësi ndeshin plot burime informacioni, firmat duhet të sinjalizojnë ekzistencën e tyre, dhe jo vetëm për t’u diferencuar (ky është roli i markës), por për të informuar konsumatorët rreth vendndodhjes së tyre brenda hapësirës shumëdimensionale (hapësirë informative dhe gjeografike).

Në rastin e industrisë së turizmit, përveç problemeve që lidhen me cilësinë dhe çmimet, Keane (1996, 1997) shpjegon se mungesa e informacionit midis vizitorëve mund të shkaktojë edhe humbje të destinacionit turistik në luftën me konkurrencën. Kur destinacioni turistik reagon ndaj rritjeve në numrin e turistëve lind një problem që quhet “moral hazard”. Kur numri i turistëve është i lartë, reputacioni mund të mos konsiderohet i rëndësishëm dhe për pasojë ofruet të ndryshëm kanë një stimul për të reduktuar cilësinë sepse mendojnë se kjo nuk do të ndikojë ndjeshëm në numrin e turistëve. Efektet e reputacionit, që shfaqen në rastet kur cilësia zbulohet vetëm pas konsumit të një të mire, mund të jenë të kufizuara nëse turistët kanë motivime eksperimentale dhe preferojnë gjithmonë destinacione të reja dhe të pazakonta për pushimet e tyre.

Për të shmangur sa më shumë problemet e mësipërme, studiuesit¹ sugjerojnë se disa nga burimet kryesore të informacionit për turistët janë: publiciteti në media të ndryshme, agjencitë turistike, miqtë, thashethemet, vizitat e mëparshme, Interneti, etj. Ky punim synon të analizojë këto burime në rastin e Shqipërisë dhe të identifikojë burimet më të vlerësuara nga turistët vendas dhe të huaj.

¹Stigler (1961), Carlton dhe Perloff (2004), Caserta dhe Russo (2002), Corfu dhe Azevedo (2007), Wiig (2004), etj.

Metodologjia e kërkimit dhe grumbullimi i të dhënave

Një analizë e thelluar në industrinë e turizmit sigurisht varet nga sasia dhe cilësia e të dhënave, të cilat mund të minimizojnë rrezikun e politikave të pasuksesshme. Megjithatë, Organizata Botërore e Turizmit është e ndërgjegjshme për kufizimet që hasen në statistikat e turizmit për shkak të mungesës apo pamjaftueshmërisë së të dhënave dhe burimeve të informacionit në nivel kombëtar. Në Shqipëri kjo situatë është akoma më problematike. Përveç pamjaftueshmërisë së statistikave bazë të turizmit, literatura në këtë fushë është e varfër. Ekziston një numër i kufizuar studimesh për turizmin në përgjithësi dhe vetëm pak prej tyre ofrojnë informacion në lidhje me vlerësimin e burimeve të informacionit nga turistët. Për këtë arsye, ky punim shfrytëzon kryesisht të dhëna parësore të grumbulluara nëpërmjet një pyetsori drejtuar turistëve të akomoduar në hotelet bregdetare të Durrësit gjatë sezonit turistik të verës 2014. Studimi përqëndrohet pikërisht në sektorin e hoteleve bregdetare sepse, siç u theksua në Seksionin 1, ai përfaqëson sektorin më të zhvilluar në industrinë e turizmit. Gjithashtu, për shkak të kohës dhe burimeve financiare të kufizuara për këtë kërkim, anketimi mbulon vetëm zonën e Durrësit, e cila sipas të dhënave në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (2014) dhe Istituti i Statistikës (2014), përfaqëson destinacionin më të madh bregdetar turistik në Shqipëri përsa i takon sektorit të hoteleve. Ky segment përfshin një bregdet prej 6 km të gjatë, 150-180 m të gjerë dhe vetëm 39 km larg nga Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë.


Duke marrë në konsideratë vështirësitë që hasen përgjithësisht gjatë grumbullimit të të dhënave parësore, u pa e nevojshme ndërmarrja e një studimi pilot në zonë. Qëllimet kryesore të këtij studimi pilot ishin vlerësimi i fizibilitetit të grumbullimit të informacionit të nevojshëm, maksimizimi i besueshmërisë së të dhënave dhe hartimi i pyetsorit. Ky proces ndihmoi për t'u ndërgjegjësuar rreth ndonjë rreziku të mundshëm dhe për të marrë masat e nevojshme përpara realizimit të studimit. Anketimi u krye nga një ekip i kualifikuar i cili u trajnuar si përpara ashtu edhe pas studimit pilot me qëllim që të siguroheshin karakteristikat e nevojshme të intervistuesve dhe familiariteti me këtë studim.

Gjatë studimit u bënë përpjekje për të identifikuar madhësinë e zgjedhjes që mund të përfaqësonte sa më mirë popullatën e turistëve në zonën dhe periudhën e marrë në shqyrtim. Metodatat e përdorura për këtë qëllim janë Formula e Optimizimit të Madhësisë së Mostrës (Sample Size Optimisation formula) nga MaCorr (2006) dhe Quota Sample nga Brace (2004) dhe Cameron dhe Trivedi (2005). Gjatë anketimit u morën masa që pyetsori të drejtohej kryefamiljarit apo blerësit kryesor të familjes apo grupit. Ata u intervistuan në vendin e akomodimit (në hotel) ose tek pikat e zgjedhura brenda zonës së plazhit. Përfundimisht, numri total i turistëve të intervistuar rezultoi 230 dhe të dhënat e grumbulluara përbëjnë informacionin më të mirë të mundshëm për të arritur objektivat e këtij studimi.

Diskutimi i rezultateve

Vitet e fundit, Shqipëria dhe sidomos bregdeti i Adriatikut, pjesa kryesore e të cilit është zona e Durrësit, konsiderohet si një nga destinacionet më të preferuara për turistët me kombësi shqiptare nga Kosova e Maqedonia si dhe turistët shqiptarë që punojnë e jetojnë jashtë vendit dhe dëshirojnë të kalojnë pushimet me familjet ose miqtë e tyre. Të dhënat e marra nga MZHUT (2014), që mbështeten gjithashtu edhe nga statistikat e Bankës së Shqipërisë tregojnë që rreth 50 përqind e turistëve që vijnë në Shqipëri janë nga këto shtete fqinjë. Prandaj, këta turistë "të huaj" pritet të përfaqësojnë një përqindje të lartë të numrit total të turistëve në zonën e Durrësit. Analiza e pyetsorit e konfirmon këtë nëpërmjet të dhënave në Figurën 1, e cila paraqet përqindjen e turistëve sipas vendit të tyre të rezidencës. Rezultatet tregojnë që turistët vendas përbëjnë rreth 44 përqind ndërsa turistët e huaj përfaqësojnë shumicën e turistëve të përhirë në anketim (rreth 56 përqind), ku rreth 33 përqind vijnë nga Kosova, 18 përqind nga Maqedonia dhe pjesa tjetër nga Mali i Zi ose vende të tjera ku jetojnë dhe punojnë emigrantë shqiptarë.


Figura 1. Shpërndarja e turistëve sipas vendit të rezidencës



Në industrinë e turizmit, vendi i rezidencës të turistëve mund të jetë një tregues i mirë i sasisë apo cilësisë së informacionit, në kuptimin që vendasit konsiderohen në përgjithësi të jenë të informuar më shumë dhe më mirë se të huajt. Megjithatë, shqiptarët vendas mund të mos konsiderohen të mirëinformuar në rastet kur nuk kanë informacionin e kërkuar, sepse ata mund të mos jenë plotësisht të familjarizuar me zonën dhe hotelet në të. Nga ana tjetër, disa turistë të huaj mund ta kenë vizituar edhe më parë zonën apo hotelin ku janë akomoduar momentalisht dhe kjo i ndihmon ata që të kenë informacion më të saktë për karakteristikat dhe/ose çmimin e hoteleve. Prandaj vizitat e mëparshme mund të jenë një karakteristikë dalluese më e mirë sesa vendi i rezidencës për sa i takon sasisë apo cilësisë së informacionit që kanë turistët përpara marrjes së vendimit.

Të dhënat e këtij studimi tregojnë gjithashtu që turistët mund të informohen edhe nga burime të tjera, si për shembull agjencitë turistike, miqtë, publiciteti, etj. Fillimisht, është e nevojshme të theksohen: së pari, dobësitë që ekzistojnë në Shqipëri në lidhje me manaxhimin dhe shpërndarjen e informacionit për turizmin, sidomos për sektorin e hoteleve bregdetare; dhe së dyti, mungesa e marketingut dhe burimeve apo institucioneve të tjera të nevojshme informative. Zyrtarë ekzistues turistike janë ndërmjetës të dobët midis turistëve dhe destinacionit të tyre. Kjo dobësi përfaqëson një problem të rëndësishëm për zhvillimin e industrisë së turizmit në Shqipëri. Rezultatet e anketimit e reflektojnë qartë këtë situatë. Figura 2 paraqet përqindjen e turistëve sipas burimit të informacionit që ata kanë mbi hotelet. Shumica e turistëve të anketuar deklarojnë se janë informuar nëpërmjet vizitave të mëparshme (rreth 36 përqind) apo miqve e thashethemeve (rreth 27 përqind). Një numër i konsiderueshëm studimesh (për shembull, Revista Barclays, 1997 dhe Stokes et al., 1997) argumentojnë që thashethemet janë një burim kryesor informacioni sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat sipas të dhënave të INSTAT (2008) dominojnë ekonominë shqiptare. Gjithashtu, Caserta dhe Russo (2002) e kanë analizuar teorikisht mekanizmin e thashethemeve në lidhje me informacionin, ndërsa Stokes dhe Lomax (2001) e kanë mbështetur empirikisht këtë hipotezë në sektorin e hoteleve të pushimeve duke u bazuar në intervista ballë për ballë dhe anketime në hotelet angleze për një rast studimi konkret.

Figura 2. Shpërndarja e turistëve sipas burimit të informacionit (në %)




Rreth 23 përqind e turistëve të anketuar deklarojnë se janë informuar nëpërmjet agjencive turistike apo Internetit, përkatësisht 15 përqind dhe 8 përqind, dhe vetëm 12 përqind që mbeten janë informuar nëpërmjet publicitetit (në TV, radio apo shtyp). Kategoria e fundit (Të tjerë) merr në konsideratë rastet ku zgjedhja e hotelit nga turistët është e rastësishme. Megjithatë, kjo përqindje është shumë e ulët dhe sugjeron që njerëzit gjithmonë përpiqen të gjejnë informacione përpara se të marrin vendimet e tyre.

Me qëllim që të krahasojmë sjelljen e turistëve vendas dhe të huaj ndaj burimeve të ndryshme të informacionit, Figura 3 paraqet shpërndarjen e turistëve sipas burimit të informacionit dhe vendit të rezidencës. Rezultate reflektojnë disa karakteristika të vecanta sociale të turistëve vendas të cilat janë trashëguar nga dekadat e kaluara. Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri, njerëzit filluan të mos kenë më besim tek shteti dhe institucionet publike. Vakuumi i krijuar nga mungesa e institucioneve dhe ligjeve bazë për funksionimin e tyre rezultoi në një mjedis kaotik dhe lehtësoi përhapjen e korrupsionit. Ligjet dhe rregullat që filluan të krijohen u përdorën nga disa burokratë për të siguruar përfitime personale. Kjo situatë, e cila është tipike për periudhat tranzitore në vende të ndryshme, e dëmtoi shumë besimin e njerëzve në institucionet formale (Nivet, 2004, p. 14).² Marrëdhëniet ndërpersonale u shndërruan gradualisht në një burim të rëndësishëm informacioni për shumë produkte dhe shërbimë (duke përfshirë edhe pushimet). Kjo mund të shpjegojë edhe arsyen pse turistët vendas besojnë më pak se turistët e huaj në agjencitë turistike (10 përqind për turistët vendas dhe 20 përqind për të huajt). Kjo mund të tregojë gjithashtu që agjencitë turistike janë më pak eficient brenda Shqipërisë krahasuar me shtete të tjera në rajon. Nga ana tjetër, kjo përqindje e ulët e agjencive turistike si një burim informacioni mund të reflektojë një tjetër fenomen të shfaqur këto vitet e fundit në lidhje me turizmin në Shqipëri. Shifrat tregojnë që një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kanë filluar të preferojnë destinacione të tjera turistike jashtë Shqipërisë, kryesisht në Mesdhe (për shembull, Turqia, Egjipti dhe Greqia). Prandaj, duke parë këtë tendencë, agjencitë turistike shqiptare janë fokusuar më shumë në marketingun e paketave të huaja turistike sesa në promovimin e turizmit brenda vendit. Figura 3 tregon gjithashtu se një pjesë e konsiderueshme e turistëve të huaj të anketuar (rreth 47 përqind) e kanë vizituar edhe më parë këtë hotel.

²Eksperiencia e shumë vendeve ish-komuniste tregon që midis besimit dhe korrupsionit ekziston një lidhje e fortë negative (Rothstein, 2000).


Figura 3. Lidhja midis burimit të informacionit dhe vendit të rezidencës (në %)



Përveç kësaj, rezultatet e anketimit tregojnë një përqindje relativisht më të lartë të turistëve, çmimi i të cilëve është përcaktuar nga një agjenci turistike, krahasuar me vetëm 15 përqind që ishin informuar nga ky burim informacioni (Figura 2). Kjo mund të shpjegohet me faktin se turistët preferojnë të gjejnë informacion nga burime të tjera, sic u diskutua më sipër, por ata ka mundësi të shfrytëzojnë agjencitë për të rezervuar hotelin dhe për të rregulluar çmimet e tyre. Ky rezultat tregon që agjencitë mund të shërbejnë si ndërmjetës midis turistëve dhe hoteleve, por ata nuk sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm mbi hotelet apo zonat.

Sikurse pritej, Figura 4 tregon që rastet kur çmimet ndërmjetësohen nga agjencitë janë më të shumta për turistët e huaj, vecanërisht për ata nga Mali i Zi ku rreth 62 përqind e çmimeve janë përcaktuar dhe ndërmjetësuar nga agjencitë. Ky rezultat mund të reflektojë një industri turizmi më të zhvilluar në Malin e Zi, ku strukturat ndërmjetësuese mund të jenë më eficiente sesa në Shqipëri. Me të vërtetë, sipas studimeve që analizojnë industrinë e turizmit në rajonin e Ballkanit sugjerojnë se Mali i Zi (pas Kroacisë), dhe me disa kufizime Maqedonia, njihen si destinacione me një potencial të konsiderueshëm dhe perspektiva të mira përsa i takon zhvillimit të turizmit në të ardhmen. Vecanërisht, Mali i Zi (bashkë me Bullgarinë) ofron një produkt turistik të cilësisë së mesme, ndërsa destinacione të tjera në Ballkan, duke përfshirë edhe Shqipërinë, konsiderohen si destinacione të një cilësie të ulët. Për rrjedhojë, analiza sugjeron që agjencitë turistike në Shqipëri nuk operojnë shumë mirë krahasuar me shtete të tjera në rajon dhe kanë nevojë të përmirësojnë aktivitetet e tyre me qëllim që të sigurojnë më tepër informacion dhe ndërmjetësim si për turistët ashtu edhe për hotelet.

Figura 4. Shpërndarja e turistëve sipas agjencive dhe vendit të rezidencës (në %)



Përfundime dhe rekomandime

Sic u theksua që në fillim të këtij punimi, një objektiv i rëndësishëm i tij është të ofrojë rekomandime për aktorë të ndryshëm në industrinë e turizmit në Shqipëri. Rekomandimet dhe politikat e përshtatshme në lidhje me burimet e informacionit mund ti ndihmojnë këta aktorë që të marrin vendimet e duhura dhe të realizojnë objektivat e tyre. Gjithashtu ato mund të kontribuojnë si në rritjen e numrit të vizitorëve të huaj ashtu edhe në nxitjen e interesit të shqiptarëve vendas që i shpenzojnë paratë e tyre në destinacione të tjera turistike jashtë vendit.

Analiza e të dhënave tregoi që përqindja e turistëve të huaj në anketim ishte rreth 56 përqind. Megjithatë, ka një përqindje të lartë (rreth 36 përqind) turistësh që e kanë vizituar edhe më parë zonën apo hotelin ku janë akomoduar dhe këto vizita të mëparshme mund të jenë një burim më i mirë informacioni për cilësinë dhe/apo çmimet e hoteleve. Rezultatet statistikore tregojnë se një tjetër burim i rëndësishëm informacioni janë miqtë/thashethemet, ndërsa publiciteti, agjencitë turistike dhe Interneti përfaqësojnë një burim që shfrytëzohet më pak nga turistët. Sidomos agjencitë turistike në Shqipëri janë më pak efçente në krahasim me shtetet e tjera në rajon. Ato mund të shërbejnë si ndërmjetës midis turistëve dhe hoteleve, por ato nuk sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm rreth hoteleve apo zonave. Prandaj, ato duhet të përmirësojnë aktivitetet e tyre me qëllim që të ofrojnë më tepër informacion dhe ndërmjetësim si për turistët ashtu edhe për hotelet. Ky rekomandim mund ti drejtohet edhe më gjerë të gjithë strukturave ndërmjetësuese në Shqipëri për zhvillimin e aktiviteteve të tyre publicitare. Gjithashtu, mungesa në përgjithësi e marketingut nga institucionet përkatëse përbën një problem madhor për zhvillimin e industrisë së turizmit në Shqipëri. Kjo thekson nevojën për të ndërmarrë fushata të rëndësishme që e promovojnë Shqipërinë si një destinacion turistik interesant në Mesdhe. Institucionet qeveritare duhet të përpunojnë dhe koordinojnë politika dhe strategji që çojnë në përmbushjen e këtij objektiivi

Së fundi, ky punim zbulon një tjetër mangësi në industrinë e turizmit që ka të bëjë me mungesën e të dhënave dhe studimeve në lidhje me burimet e informacionit. Kjo thekson nevojën për më tepër informacion, statistika, analiza dhe kërkim tregu nga institucionet përkatëse, si për shembull MZHUT, INSTAT, pedagogët universitarë dhe institucione të tjera qeveritare ose statistikore.

Referenca:

- Akerlof, G. (1970), The Market for Lemons: Qualitative Uncertainty and the Market Mechanism, *Quarterly Journal of Economics*, 84 (3): 488-500
- Barclays Review (1997), *Marketing and the Small Firm*, May, Barclays Bank PLC, London
- Brace, I. (2004), *Questionnaire Design: How to Plan, Structure, and Write Survey Material for Effective Market Research*, Kogan Page Limited, London
- Cacomo, J. and Solonandrasana, B. (2001), Tourism Activities and Price Differences: Imperfect Information and Asymmetric Competition, *28th Annual Conference of the European Association for Research in Industrial Economics*, 30 August - 2 September 2001, Dublin (Irlande)
- Cameron, A. and Trivedi, P. (2005), *Microeconometrics: Methods and Applications*, Cambridge University Press, New York
- Carlton, D. and Perloff, J. (2004b), *Modern Industrial Organization*, 4th edition, Addison-Wesley, London
- Caserta, S. and Russo, A. (2002), More Means Worse: Asymmetric Information, Spatial Displacement and Sustainable Heritage Tourism, *Journal of Cultural Economics*, 26 (4): 245-260
- Corfu, A. and Azevedo, S. (2007), Some Applications of the Web as an Information Tool in the Tourism Industry, *Amfiteatru Economic*, 9 (21): 19-24
- Heusinger, M. (2005), The Market Potential of Berat as Tourism Destination: Preliminary Analysis for Regional Tourism Policies, *Co-PLAN - Institute for Habitat Development*, URL <http://www.lokdoks.regio-berater.de/comment-on-tourism-dev.pdf>
- Instituti i Statistikës (2014), URL <http://www.instat.gov.al/>
- Keane, M. (1996), Sustaining Quality in Tourism Destinations: An Economic Model with an Application,

Applied Economics, 28 (12): 1545-1553

Keane, M. (1997), Quality and Pricing in Tourism destinations, *Annals of Tourism Research*, 24 (1): 117-130

MaCorr (2006), Sample Size Optimization, URL http://www.macorr.com/ss_methodology.htm

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (2014), URL <http://www.turizmi.gov.al/>

Mullai, N. (2005), Tourism Development - A Catalyst for Economic Growth in Albania, *Albanian Export Promotion Agency Contributed Paper*, Executive Forum on National Export Strategies: Export of Services: Hype of High Potential? Implications for Strategy-Makers, 5-8 October 2005, Montreux, Switzerland

Nelson, P. (1974), Advertising as Information, *Journal of Political Economy*, 82 (4): 729-754

Nivet, J. (2004), Corporate and public governances in transition: the limits of property rights and the significance of legal institutions, *European Journal of Comparative Economics*, 1 (2): 3-21

Rothstein, B. (2000), Trust, Social Dilemmas, and Collective Memories: On the Rise and Decline of the Swedish Model, *Journal of Theoretical Politics*, 12 (4): 477-501

Stigler, G. (1961), The Economics of Information, *Journal of Political Economy*, 69 (3): 213-225

Stokes, D. and Lomax, W. (2001), Taking Control of Word-of-Mouth Marketing: The Case of an Entrepreneurial Hotelier, *Kingston Business School Occasional Paper Series*, No. 44, Kingston Business School, London

Stokes, D., Fitchew, S. and Blackburn, R. (1997), Marketing in Small Firms: A Conceptual Approach, *Report to the Royal Mail*, Small Business Research Centre, Kingston University, Kingston-upon-Thames

Wiig, A. (2004), Risk and Disintermediation in Tourism, *CMI Working Paper*, No. 6, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, Bergen

Free Trade Agreement's economic aspects and impacts The case of Albania

Daniela Lika
Marsida Vishkurti

Abstract

Free trade was seen as the means by which the European countries devastated by war, would rise up again. It was also seen as a means of peace, because countries with strong trade ties had less motives of conflict with each other. Free trade agreements (FTAs) were born out of the desire to increase people's welfare and make them feel more comfortable and in power. But still today many questions are asked regarding the effect of these free trade agreements. These questions were the driving motive that inspired us to write this paper

Key words: Free trade, Free Trade Agreement, Foreign

Introduction

After the end of the Second World War many countries understood that by fighting they would ultimately harm themselves more than gain any benefit. They understood that collaboration is the means by which they could benefit more than any other thing. They also realized that trade was one of the key tools to achieve higher welfare levels of their societies. This was the principle behind the 1956 agreement in Italy that was the beginning of the formation of the nowadays European Union (EU). The purpose of this paper is show what FTAs are and what is their role in the economic life of societies. This will be done by assessing the general principles of a FTA and their role in economic life. More particularly, this paper has the intention to show in its final part what has been the impact that FTAs have had on the Albanian economy since their enforcement. This is done by assessing the main ideas in macroeconomics regarding their influence and impact on selected economic indicators of a country's economy. Thus, the 'general theory' part will serve as a basis for the subsequent analysis of the impacts in the local Albanian economy of the FTAs this country has in force.

The methodology used in this paper will be that of literary review of Albanian authors related to the FTA issue combined with a graphical presentation from empirical data of the effects FTAs have had on Albania. In the first chapter of the paper we have presented the main aspects of free trade agreements, focusing on the main definitions related to the topic and on the FTAs objectives. The second chapter focuses more on analyzing the relation between FTAs and selected economic indicators. The final chapter is dedicated to Albania and its FTAs.

1. Main aspects of FTAs

As shown in the introduction part this paper aims at showing some aspects of the free trade agreements and their impact on selected economic indicators. We have tried to deal with the most important aspects of free trade agreements. In order to better understand the issue we have first to define some basic concepts regarding the issue. These definitions are necessary in order to understand the scope and objectives of free trade agreements.

1.1. Main definitions related to the topic

The first definition must be that of free trade. It is defined as the flowing of goods and services across countries without barriers of any type (Bhagwati, 2002: p.5). Its aim is to provide quality and affordable goods and services to the markets of the countries that participate in free trade. For this reason we apply free trade agreements between various (two or more) parties. By definition, a free trade agreement is an agreement between countries that seeks to increase the level of free trade (World Trade Organization, 2009). This begins by creating special tax, tariff and regulations that can

reduce barriers. A FTA can also come with a guarantee of an investment in one country by another, such as foreign direct investment. It is a form of economic integration. In order to achieve this, these countries need to eliminate any type of barrier regarding trade. Trade barriers are considered to be any sort of government imposed restriction on the free international exchange of goods or services. They are generally classified as (1) import policies reflected in tariffs and other import charges, quotas, import licensing, customs practices, (2) standards, testing, labeling, and various types of certification, (3) direct procurement by government, (4) subsidies for local exporters, (5) lack of copyright protection, (6) restrictions on franchising, licensing, technology transfer, (7) restrictions on foreign direct investment, etc.

A free trade agreement simply encourages trade between two or more countries to establish a free trade area where commerce in goods and services can be conducted across their common borders, without tariffs or hindrances but (in contrast to a common market) capital or labor may (not) move freely. Also, member countries usually impose a uniform tariff (called common external tariff) on trade with non-member countries.

FTAs generate a free trade area which is considered to be a geographical area formed by the national boundaries of two or more countries belonging to a free trade agreement (World Trade Organization, 2009). The European Union or the countries signatories of NAFTA are examples of such free trade area.

1.2. Main objectives

The next steps are to show which the objectives of a free trade agreement are. There are two types of objectives for FTAs, general objectives and specific objectives. General objectives relate to a theoretical framework in general terms of the FTAs. They are common to all the FTAs existing in the world. Instead, specific objectives are the ones set by different countries in relation to each other. In this paper we will talk about the general objectives of a FTA and will not discuss specific objectives because we have not treated any specific FTA.

The scope of FTAs is the gradual reduction (until total removal) of tariffs and barrier regarding trade between the participating countries (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136).

Some important general objectives are as follows:

1. The primary objective is the enhancement of economic collaboration between countries with the aim of increasing the living standards through increase of real income per capita;
2. A second objective is the increase of production and employment rates;
3. Then, gradual elimination of any sort of barrier for trade;
4. Creating equal opportunities of investment and competition for the companies of all countries involved in the FTA; (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136).

As we can see the objectives of a FTA are very important for each individual residing in the countries member of the FTA. They have a heavy influence in our daily lives, on income, employment and consumption. On the next chapter we will treat this influence that FTAs have on our lives by assessing their influence on the economic indicators.

2. FTAs impact on selected economic indicators

The free trade agreements (FTA) have certainly an impact on the economic indicators of a country, being that direct or indirect influence (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136). This impact varies according to the political and economical conditions of each country implemented. For example, developed countries take a different approach on their implementation and the effects FTAs have on them are quite different from the effects on developing countries. One of the reasons for differences in effects is the timeframe on which they are implemented. The longer the timeframe of implementation of a FTA, the more differs it in results. Developing countries need more time to implement the FTAs than developed ones, because they need to make more preparations. Also, the shorter the period of implementation, the more difficult is to make an assessment of its impact. Every economy needs a

certain period of time (a maturity timeframe) in order to react and adapt to a FTA.

Since different authors pretend that it is still early to make a proper analysis of the empirical effects of the FTA (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136), in this short analysis we will make a theoretical sketch of the impacts a FTA can have on a developing economy like that of Albania.

One thing FTAs directly impact is the volume of international trade (foreign trade) of a country, specifically its import and export of different products and services (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136). Trade deficit is the difference between the volume of export and import products. If a country imports more than it exports than it is considered to have a trade deficit. The wider the margin between the volumes of the two, the bigger is the trade deficit which translates in problems for the economy.

But, in macroeconomic theory, FTAs can make a country benefit from tariff reduction and so it can increase its volume of exports. If this export increase is associated with a decrease in imports than the trade deficit would also decrease. This decrease in imports volume could come due to an increase in domestic production of the imported products or their substitutes (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136).

Prices are another area where FTAs can have a positive or negative impact. Imported products can be raw materials or finished goods. The removal of tariffs and barriers leads to a lower cost for the local businesses importing raw materials, which in consequence would mean a lower market price for their finished products. This is one of the major positive impacts on prices. On the other hand, we must admit that increase in exports could result with negative consequences if the production capacity of an economy does not also increase. This is because firms will focus on exporting its products and offer less in the domestic market. Assuming that demand will remain constant, this would result in a decline in offer, which means an increase in prices (inflation).

FTAs also have an impact on the level of competitiveness between local and international businesses. If the quality of products imported is higher, the domestic firms would have to raise their standard and quality of production. This would benefit the consumer with better quality products (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136). The business firms will have to make difficult choices. Either they will have to lower their costs, mainly by cutting down the size of their work force, or invest in new technology and production techniques. But if the domestic businesses could not keep up with the required investments in technology and other techniques required for making their products competitive, they will have no choice but to shut down. This means that the level of unemployment will rise. This is a negative consequence that FTAs have on the domestic economy of a country.

At the same time, the market's extension makes the domestic environment more attractive for the foreigners and stimulates them to invest more and more in the hosting country. The new enterprises provide better employment opportunities for local workers causing in this way the reduction of unemployment.

Another important area of impact from FTAs is the state revenues. The state budget relies heavily on tariffs and taxes. FTAs reduce, up to abolishing, tariffs for imported products and even for exported ones, thus impacting negatively the state revenues (Kola, Teka, 2002: pp. 127-136).

As we realize from this analysis, FTAs may have positive or negative impacts on economic indicators. That is why there are pros and cons regarding the application FTAs.

3. The case of Albania

The Stabilization and Association process of the Western Balkan countries with the European Union is the final step into total integration into the Union. For this reason, regional integration in trade is a logical step in the future integration to the EU market in particular, and through that, to the world markets. The EU itself is an example of various regional integrations that joined to form a bigger whole. This experience demonstrated over the years that huge gains derive from establishing tight trade links with neighbors, in particular through the creation of a vast and efficient regional market. This was the reasoning behind the bilateral free trade agreements that Albanian signed with its neighbors and with the European Union. An important piece of this puzzle was the membership in the World Trade Organization (WTO) that for Albania became reality in September 2000. At the

time, this was commented as a further enhancement of regional and European trade ties for the country. Regional integration was an objective that Albanian could not have afforded to miss.

3.1. Trade liberalization in Albania

Trade liberalization and facilitation was the kernel for a positive regional integration. Trade liberalization is also essential for economic development. As we have tried to show before it is a prerequisite for foreign direct investments, which are a driving force for economic development. In theory, exposure to foreign competition leads domestic industries to become more efficient and competitive reduces the cost of key inputs and will develop incentives to invest in research and development to become more competitive (Mancellari, 2005). Another factor is that openness to imports influences the decrease costs for consumers and increases the variety and quality of the goods available on the market. Overall, trade openness is assumed to increase the welfare of the population (Krueger, Obstfeld, 2003: p.3).

During the last decade Albania made great efforts toward trade liberalization, by opening up the national borders. It signed its first free trade agreement in 1998. Walking on the footsteps of other countries, Albania is trying to open its market to the world but so far the effect of trade liberalization is not being the one the country hoped they would be.

Since 1998 Albania has signed and enforced FTAs with 8 regional countries. These are bilateral free trade agreements with Macedonia, Bulgaria, Romania, Serbia & Montenegro (at the time), Turkey, Croatia and Moldova. Whereas a free trade agreement between Albania and EU was incorporated into the Stability-Association Agreement enforced since 2006.

As far as disadvantages are concerned, the main challenge of FTA posed to the national economy is increased competition in the market. This situation may lead up to bankruptcy for firms which cannot survive such competition. Nonetheless, despite of such short term challenges and costs, in the long term FTA make possible the re-allocation of resources into more effective uses.

“If a company is not able to face competition it should not shield itself behind protectionist measures enforced from the government because there are a string of negative effects as follows:


1. There is no allocation of investment into the best possible projects;
2. Consumers are penalized through lower quality of products and services;
3. It is a constraint on economic growth which needs wider market opportunities”

(Mancellari, 2005).

3.2. Problems of the Albanian economy

Below we are providing a graphical demonstration of the ongoing of the trade flow since 1999.

Figure 1. Development in time of trade flows in million lek since 1999



Source: Instat (2008), author calculations.

The graphic reflects some positive effects of Albania’s regional bilateral FTAs, as can be read from the general trend of increasing exports and imports. This results with a higher trade volume

which means that Albanian exchanges with other countries has risen. This occurrence leads to rise of competitiveness in goods and services, better quality of products, decrease in prices for the consumers and also attraction of foreign direct investments.

Although the exports have risen, the trade deficit is still high, which means that Albanian products are not preferred in the international market. In the same time we may say that the high level of imports is because of the fact that the Albanian economy does not have the ability to fulfill the domestic needs.

There are also other factors which affect the amount of imports and exports such as remittances etc, but they are not focus of our paper.

Some reasons why the FTAs may not have generated positive impacts on the Albanian economy are as follows:

1. As a country with a low level of openness prior to 1998, Albania adopted liberalization politics very fast perhaps faster than it should have.
2. It pursued an accelerated price liberalization policy, abolished the state monopoly over foreign trade, and introduced convertibility of domestic currency (Mancellari, 2005).
3. Albania fulfilled its obligations from the WTO membership concerning the elimination of custom duties on certain products, such as: alcoholic beverages, wood products, paper products, furniture and various toys at a bound rate of zero percent without countermeasures to protect a fragile home business environment. Albanian companies were not ready to compete when the market opened to foreign products which were cheaper and of a better quality but crashed internal production. Based on old technology producers couldn't produce an amount of product that could supply home demand and the amount of product was also of a lower quality than the import products. Also, being "new" at competing only with the product (because the price was almost the same) Albanian producers weren't able to manage the resources correctly neglecting comparative advantages for certain products.
4. Since there were no created institution to monitor the market, monitoring the demand and supply of different goods and services home producers were slow in their reaction towards the market.

5. Conclusions

The scope of Free Trade Agreements is the gradual reduction (until total removal) of tariffs and barrier regarding trade between the participating countries. The end result of this process is the creation of free trade areas. These agreements are very important to enhance the cooperation between countries in order to raise national welfare of these countries. They may have a positive or negative impact on economic indicators such as unemployment rate, inflation, trade balance.

Free trade agreements have impacts even in other economic indicators such as GDP, Foreign trade investments, purchasing power, etc. Nevertheless these were not focus of this paper due to analysis limitation. Protectionism and openness index are not focus of this paper too. Certainly they are a motivation for subsequent paper.

As Albania's primer goal is European Integration, economy is one of the key factors that can accelerate this process or delay it. Even though Albania has made steps forward by signing many free trade agreements with regional and European countries, the country continues to have a trade deficit which may be a consequence of many reasons. Some of them may be: low level of openness, accelerated price liberalization policy, low level of competitiveness of the Albanian products etc. Home products still feel threatened by the quality and the quantity of foreign products, asking many times for protectionist measures.

Despite these inconveniences Albania shows also positives signs regarding FTAs, such as higher trade volume as a consequence of increasing exports and imports. This means that the country has forced its cooperation with partner countries.

There are lot of ways to improve the economic performance of trade between Albania and other countries. What we have to do is to start producing and trading according to our comparative advantage.

6. References

- BHAGWATI, JAGDISH (2002): *Free trade today*. Princeton: Princeton University Press, p. 5.
- INSTAT (2008): *Flows of goods in foreign trade*. Url: http://www.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Treguesit%20Ekonomik/Tregtia%20%20e%20jashtme/TRI%20%202008_NEW/t1.xls, accessed: 07.02.2010
- KOLA, TONIN & TEKA, SOANA (2002): "Free Trade Agreements: Costs and Benefits" *Conference of the Central Bank*, 2(3), pp. 127-136.
- KRUEGMAN, PAUL & OBSTFELD, MAURICE (2003): *International economics: Theory and Policy*. Toronto: Pearson education press, p. 3.
- MANCELLARI, AHMET (2005): *Trade Liberalization and Free Trade Agreements*. Url: <http://www.albic.net/Eng/a3business/ftaalbaniaguide1.php>, accessed: 09.01.2010
- WTO (2009): *Regional trade agreements*. Url: http://www.wto.org/english/tratop_e/region_e/region_e.htm. Retrieved 2009-08-16, accessed: 09.01.2010

Parashikimi i dënimit me burgim të përjetshëm në Kodin Penal të Republikës së Kosovës- argumentet mbështetëse dhe kundërshtuese

Dr. Azem Hajdari
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Abstrakt

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2013, përmes zgjidhjeve të tij, krahasuar këtë me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (2004), ka instaluar ndryshime të shumta dhe të llojeve të ndryshme. Këto ndryshime, në shumë aspekte, vlerësohen të jenë vërtetëpërmbajtësore. Ato manifestojnë shtrirje në të tri shtyllat e tij: veprat penale, përgjegjësinë penale dhe sanksionet penale. Këto ndryshime (secila në vete) kanë ngjallur debate të shumta në shkencën e të drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore. Për vetë natyrën e tij, ky artikull do të fokusohet në trajtimin e vetëm disa aspekteve të dënimit me burgim të përjetshëm, si dënimi më i rëndë që mund të shqiptohet kryerësve të veprave penale në Kosovë. Në këtë aspekt, këtu do të trajtohet çështja e nocionit të dënimit me burgim të përjetshëm, karakteristikat e këtij dënimi, argumentet që mbështesin parashikimin e këtij dënimi në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (këtu e tutje KPRK) dhe argumentet që e kundërshtojnë faktin e parashikimit të tij. Më në fund, në këtë artikull do të prezantohen përfundimet lidhur me këtë tematikë dhe referencat. Gjatë përgatitjes së këtij artikulli është përdorur metoda juridike historike, metoda dogmatike, metoda e krahasimit etj.

Fjalët kyçe: dënim, përjetshëm, kryerës, përgjegjësi, vepër penale.

Hyrje

Në mesin e ndryshimeve të shumta që KPRK ka futur në sistemin juridik të vendit bën pjesë edhe dënimi me burgim të përjetshëm. Ky dënim tashmë paraqet llojin më të rëndë të dënimit të cilin gjykatat kompetente mund t'ua shqiptojnë kryerësve të veprave penale të rënda, të kryera në rrethana veçanërisht rënduese, ose që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda. Me parashikimin e dënimit me burgim të përjetshëm ligdhënësi largoi nga sistemi juridik i Kosovës dënimin me burgim afatgjatë. Për këtë çështje në teorinë e të drejtës penale vazhdojnë të zhvillohen debate të shumta, sa mbështetëse po aq edhe kundërshtuese. Dënimi me burgim të përjetshëm ndërthet në veten e tij, të thuash, të gjitha karakteristikat që i manifestojnë edhe llojet tjera të dënimeve, por ai, siç do të shihet më poshtë, i manifeston edhe disa karakteristika specifike. Edhe në lidhje me këtë dënim, në teorinë e të drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore aktualisht po zhvillohen debate të shumta. Nga ato debate ka shumë zëra që mbështesin, por edhe të atillë që kundërshtojnë parashikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Për disa nga argumentet e tilla bëhet fjalë në kuadër të këtij artikulli të shkurtër.

1. Kuptimi i dënimit me burgim të përjetshëm

Marrë në përgjithësi, dënimi me burgim konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes (lirisë së qarkullimit) kryerësit të veprës penale për një kohë të caktuar (Salihu, 2012, 142), që mund të manifestoj shtrirje kohore të ndryshme.¹ Vështruar në këtë kuptim, dënimi me burgim të përjetshëm,² konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes kryerësit të veprës penale për tërë kohëzgjatjen e jetës së tij.

Dënimi me burgim të përjetshëm është dënim kryesor që mund të shqiptohet vetëm nëse shprehimisht

¹Marrja e lirisë së lëvizjes, si një e drejtë fundamentale e njeriut, i atribuohet çdo lloji të dënimit me burgim i cili mund t'i shqiptohet kryerësit të veprës penale. I tillë mund të jetë dënimi me burgim, dënimi me burgim afatgjatë dhe dënimi me burgim të përjetshëm.

²Dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi më i rëndë që parashihet me KPRK. Ky dënim është risi e këtij Kodi që konsiderohet të jetë rrjedhojë e abrogimit të dënimit me burgim afatgjatë.

është parashikuar me ligj (Shala, 2013, 157). Në KPRK, dënimi me burgim të përjetshëm është paraparë për format më të rënda të veprave penale të kryera me dashje, në rrethana veçanërisht të rënda ose që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda (Salihu, 2012, 443 – 444).

Nga ajo që u theksua më lart, mund të konkludohet lirshëm se dënimi me burgim të përjetshëm është dënim kryesor që konsiston në marrjen e përhershme të lirisë së lëvizjes kryerësit të dënuar të veprës penale të rëndë për të cilën shprehimisht është parashikuar me ligj.

2. Disa nga karakteristikat e dënimit me burgim të përjetshëm

Dënimin me burgim të përjetshëm e determinojnë disa karakteristika. Ato janë karakteristika që hasen te të gjitha llojet e dënimeve dhe karakteristika që i atribuohen vetëm këtij lloji të dënimit. Në grupin e parë të karakteristikave bëjnë pjesë:

1. Efekti personal i dënimit. Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëmduhet të godas vetëm kryerësin e veprës penale, e jo edhe personat e tjerë.³

2. Karakterihuman i dënimit.Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëm nuk duhet tëparaqesë mundim dhe përbuzje të kryerësit të veprës penale, si dhe nukduhet të shkaktojë dëmtimin e shëndetit të tij.

3. Legjitimiteti i dënimit. Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëmduhet tëshqiptohet nga gjykata vetëm për rastet që konsiderohen të domosdoshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe për përmirësimin e fajtorit (Krahaso: Salihu, 2012, 424).

4. Njëllojshmëria e goditjes sëkryerësve të veprave penale. Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëmduhet tëmanifestoj pasoja tënjëjta ndaj kryerësve tëveprave penale, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, fetare, racore, politike, sociale etj.

5. Proporcionaliteti i dënimit me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë penale të kryerësit. Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëmduhet tëshqiptohet vetëm në rastet e veprave penale të rënda, që kanë shkaktuar pasoja të rënda dhe të cilat janë kryer në rrethana veçanërisht të rënda.

6. Mëvetësia e shqiptimit të dënimit.Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëm duhet tëmund të shqiptohet si dënim i vetëm, pavarësisht faktit se për ndonjëvepër penale mund të jetë parashikuar mundësia e shqiptimit edhe të ndonjë dënimi tjetër.

7. Revokueshmëria e dënimit. Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëm duhet të mund të abrogohet për situatat kur konstatohet se dënimi i tillëështë shqiptuar në kundërshtim me ligjin, për shkak të lajthimit të gjykatës apo të provave të rreme.

8. Përmirësueshmëria e dënimit. Kjo do të thotë se dënimi me burgim të përjetshëm duhet të mund të ndryshohet në rastet kur konstatohet se ai është shqiptuar në kundërshtim me ligjin, për shembull për shkak të dëshmisë së rreme. Ndryshimi mund të ketë të bëjë psh., me situatat kur një aktgjykim dënues, sipas mjeteve juridike, ndërrohet me një aktgjykim lirues.

Krahas karakteristikave të përbashkëta, dënimi me burgim të përjetshëm manifeston edhe disa karakteristika të ashtuquajtura të veçanta. Të tilla karakteristika, konform nenin 44 të KPRK,⁴ konsiderohen:

1. Dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar vetëm për vepra penale shumë të rënda (Elezi I. Kaqupi S. Haxhia M., 1999, 211), të kryera në rrethana veçanërisht rënduese dhe që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda (Salihu, Zhitija, Hasani, 2014, 195). Edhe pse KPRK këtu nuk e specifikimin formën e fajit, konsideroj se që të mund të shqiptohet ky lloj dënimi kryerësi duhet të ketë kryer veprën e tillë të rëndë me dashje.

2. Dënimi me burgim të përjetshëm në asnjë rast (pavarësisht llojit të veprës penale të kryer, rrethanave të kryerjes dhe pasojave të shkaktuara) nuk është parashikuar si dënim i vetëm. Vështruar

³ Në të vërtetë, përkundër faktit që dënimi duhet të godasë vetëm kryerësin e veprës penale, pothuajse çdo dënim në një formë dhe masë, godet edhe personat tjerë, sidomos anëtarët e familjes dhe të afërmit tjerë të fajtorit. Këtu është fjala për goditje në aspektin material, psikologjik etj.

⁴Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Ai ka zëvendësuar Kodin Penal të Përkohshëm të Kosovës të vitit 2004.

në këtë kontekst, mund të thuhet lirshëm se dënimi me burgim të përjetshëm në të gjitha rastet parashihet vetëm në mënyrë alternative me dënimin me burgim. Në këtë mënyrë i lejohet mundësia gjykatës që, në varësi të rrethanave që e karakterizojnë çdo rast, të orientohet në shqiptimin e njërit apo llojit tjetër të dënimit (Hajdari, 2014, 187).

3. Meqë dënimi me burgim të përjetshëm është paraparë dhe mund të shqiptohet vetëm për veprat penale jashtëzakonisht të rënda, në mënyrë që ky dënim të ruaj ashpërsinë, represionin e domosdoshëm, në KPRK është paraparë që kryerësit të veprës penale, lirimi me kusht mund t'i jepet vetëm pasi ai të ketë mbajtur 40 vjet të këtij dënimi (Hajdari, 2014, 187 - 188).

4. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet dhe personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Kjo zgjidhje ka si qëllim mbrojtjen e personave madhor të rinj dhe personave që lëngojnë nga sëmundjet psikike me efekt zvogëlimin e aftësisë mendore nga kanosja e këtij dënimi. Kjo zgjidhje është bërë për shkak të disa specifikave që i karakterizojnë këta persona, për shkak të të cilave ata gëzojnë mbrojtje edhe në shtetet tjera me demokraci të avancuar (Hajdari, 2014, 188).

3. Argumentet mbështetëse dhe kundërshtuese të parashikimit të dënimit me burgim të përjetshëm në Kosovë

Siç u theksua më lart, KPRK instaloi në sistemin tonë juridik dënimin me burgim të përjetshëm. Parashikimi i këtij dënimi në këtë Kod ka ngjallur debate të shumta me shtrirje të gjerë, por kryesisht të natyrës profesionale. Debatet e tilla në veçanti janë përqendruar nëelaborim të argumenteve mbështetëse dhe kundërshtuese të parashikimit të këtij lloji të dënimit me burgim në Republikën e Kosovës. Në këtë aspekt, në vazhdim të këtij artikulli do të bëhet përpjekje që trajtohen disa nga argumentet e tilla.

3.1. Disa nga argumentet që mbështesin parashikimin e dënimit me burgim të përjetshëm në Kosovë

Argumentet që mbështesin futjen e dënimit me burgim të përjetshëm në kuadër të sistemit juridik të Kosovës janë të llojllojshme. Argumentet e tilla vijnë nga radhët e juristëve, filozofëve, psikologëve, mjekëve etj. Në vazhdim të këtij artikulli do të trajtohen tri argumente të kësaj natyre.

3.1.1. Nevoja e mbrojtjes së shoqërisë nga personat që kryejnë vepra penale jashtëzakonisht të rënda

Ekziston një bindje e një pjese të opinionin publik dhe profesional të Kosovës se në mungesë të dënimit me vdekje, dënimi me burgim të përjetshëm paraqet masën më të përshtatshme me të cilën shoqëria mund të mbrohet nga individët që kryejnë vepra penale jashtëzakonisht të rënda. Në këtë aspekt, theksohet se dënimi me burgim të përjetshëm është mjeti më se i domosdoshëm i mbrojtjes nga kriminelët e tillë.

Rrjedhimisht, pjesa e opinionit publik dhe profesional që mbështet parashikimin e dënimit me burgim të përjetshëm në Kosovë, konsiderojnë se ky lloj dënimi është masë e domosdoshme për veprat penale jashtëzakonisht të rënda për të cilat sanksionet tjera janë joefikase. Sipas tyre, përderisa Kosova vazhdon të përballet me krime të tillamakabre vendi do ta ketë nevojë imediate çështjen e parashikimit në legjislacionin e tij të dënimit me burgim të përjetshëm (Mulliqi, 2014, fq.1).

3.1.2. Nevoja e frikësimit të kryerësve të veprave penale

Marrë në përgjithësi, konsiderohet se pas dënimit me vdekje, dënimi me burgim të përjetshëm është lloji i dënimeve që ushtron efektin më të madh frikësues ndaj personave që kryejnë vepra penale. Këtë mendim e aprovon edhe një pjesë e opinionit publik e profesional të Kosovës. Së këndejmi, kjo pjesë e opinionit e vlerëson më se të nevojshëm këtë dënim si një masë që efektikon në aspektin

frikësuesndaj kryerësve potencial të veprave penale jashtëzakonisht të rënda. Ata vlerësojnë se kryerësi, si çdo person tjetër, nuk është armik i jetës së tij, për më tepër ai e donë jetën e tij, lirinë e lëvizjes dhe për më tepër shfrytëzimin e rezultateve të krimit të tij. Në fakt, kryerësit e veprave penale e kanë të vështirë të pajtohen që tërë jetën e tyre ta kalojnë prapa grilave. Në këtë aspekt, sipas tyre dënimi me burgim të përjetshëm paraqitet si faktor i rëndësishëm i preventivës speciale dhe gjenerale në lidhje me kriminalitetin e tillë.

3.1.3.Përkrahja e dënimit me burgim të përjetshëm nga shumica e popullsisë

Ndonëse nuk është zhvilluar ndonjësondazh i kuptimit të zgjeruar, ekziston një përshtypje se dënimin me burgim të përjetshëm e përkrah shtesa më e gjerë e popullsisë së Kosovës. Kjo mbështetje argumentohet me faktin se një dënim të tillë ata e konsiderojnë si garanci të tyre juridike. Vlerësoj se kjo përkrahje mund të jetë rrjedhojë e niveleve relativisht të larta të manifestimit të krimit në shoqërinë Kosovare në këto dhjetë vitet e fundit, sidomos të krimeve të rënda.

Rrjedhimisht, është e pritshme që nëçdo shoqëri ku krimi shënon shkallë të lartë të manifestimit të tij, të ketë edhe ide që mbështesin ashpërsimin e politikave ndëshkimore, qoftë edhe në aspekt të parashikimit të dënimeve më të rënda, përfshirë dënimin me burgim të përjetshëm. Jashtë këtij vlerësimikonsideroj se nuk mund të trajtohet përkrahja eventuale qëmund t'i jep opinionin publik dhe profesional çështjes së parashikimit të dënimit me burgim të përjetshëm në KPRK.

3.2.Disa nga argumentet që kundërshtojnë parashikimin e dënimit me burgim të përjetshëm në Kosovë

Krahas argumenteve që mbështesin parashikimin e dënimit me burgim të përjetshëm në sistemin juridik të Kosovës, ekzistojnë edhe argumente që kundërshtojnë një fakt të tillë. Në vazhdim të këtij artikulli do tëelaborohen disa nga argumentet e tilla.

3.2.1.Marrja e përjetshme e lirisë së lëvizjes personit të dënuar

Liria e lëvizjes është një e drejtë elementare e njeriut. Kjo e drejtëefektonnë mundësinë e realizimit edhe të shumë të drejtave tjera të njeriut, që konsiderohen fundamentale për një jetë normale. Vështruar në këtë aspekt, marrja e lirisë së lëvizjes në kohëzgjatje të përhershme të personit të dënuar reflekton drejtpërdrejtë në pamundësinë, përkatësisht reduktimin e mundësive të realizimit të shumë të drejtave që vlerësohen të një rëndësie tëveçantë për çdo njeri.

Rrjedhimisht, marrja e lirisë së lëvizjes në kohëzgjatje të përhershme personit të dënuar konsiderohet në kundërshtim me konceptet në të cilat janë ndërtuar shoqëritë bashkëkohore dhe procedurat penale brenda tyre. Liria e lëvizjes është ngushtësisht e lidhur me të drejtën për jetë, ashtuqë këtë të drejtë në kuptimin e marrjes së përhershme të saj nuk ka të drejtë askush t'ia marr askujt. Vështruar në këtë koncept dënimi me burgim të përjetshëm nuk vlerësohet i lejuar.

3.2.2.Padrejtshtëria dhe johumaniteti

Dënimi me burgim të përjetshëm konsiderohet i padrejtë dhe johuman edhe atëherë kur ai u shqiptohet kryerësve të veprave penale shumë të rënda, të kryera në rrethana veçanërisht rënduese dhe që shkaktojnë pasoja të mëdha. Kjo për faktin se ky lloj dënimi, në masë të madhe, demotivon përmirësimin e personit të dënuar, që në shoqëritë bashkëkohore është mision i çdo sanksioni penal. Në favor të argumentit se dënimi me burgim tëpërjetshëmështë i padrejtë dhe johuman, përveçdemotivimit të kryerësit për risocializim, qëndron edhe fakti se pasojat e këtij dënimi, më shumë se tëçdo lloj tjetër të dënimit efektojnë edhe te personat tjerë të afërt të personit të dënuar.

3.2.3.Përmbajtja enjë doze relativisht tëlartë tëhakmarrjes sëshoqërisëndaj kryerësve të veprave penale

Është e qartë se çdo dënim, pavarësisht misionit që ka në përmirësimin e kryerësit të veprës penale,përmban në vetën e tij një dozëmë të vogël apo më tëmadhe tëhakmarrjessë shoqërisë ndaj personit të dënuar. Vështruar në këtë aspekt, dënimi me burgim të përjetshëm gjithsesi përfaqëson

atë lloj dënimi që në vendin tonë përmban nivelin më të lartë të hakmarrjes. Kjo për faktin se personit të dënuar i merrret përgjithmonë liria e lëvizjes, si një e drejtëfundamentale e njeriut. Rrjedhimisht, me marrjen e kësaj të drejte personit të dënuar në mënyrë të përhershme, shteti mëton t'ia bëjë të qartë kryerësit të veprës penale se për veprën e kryer do të pësojë konsekuenca, madje për tërë jetën e tij. Marrja e lirisë së lëvizjes për kohë të përhershme të personit të dënuar nuk ka emërues më të fuqishëm se sa të përcaktuarit e saj si një hakmarrje e shtetit për krimin që ai e ka kryer. Elementet tjera gjithsesi janë prezentë, por me fuqi patjetër më të vogël argumentuese.

3.2.4. Rënia ndesh me qëllimin e dënimit

Nëse do t'i bëhej një analizë e thuktë dënimit me burgim të përjetshëm, lehtësisht do të mund të nxirret konstatimi se ky lloj dënimi, në masë bukur të lartë, bie ndesh me qëllimin e dënimit, përkatësisht me qëllimin e prevenmtivës individuale, që kryerësi i veprës penale të përmirësohet dhe në të ardhmen të mos kryej veprë penale.

Konstatimi i lartcekur mbështetet në faktin se te shumica e kryerësve të veprave penale ndaj të cilëve shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm është e pritshme të manifestohet shkallë më e lartë apo më e ultë e demotivimit në aspektin e përkushtimit të tyre për përmirësim- risocializim.

3.2.5. Mungesa e efektit të zvogëlimit të kriminalitetit

Përvojat e shumë vendeve që kanë hequr dënimin me vdekje dhe në legjislacionet e tyre penale nuk e kanë parashikuar dënimin me burgim të përjetshëm dëshmojnë se numri i veprave penale në ato vende nuk është më i madh se sa te vendet të cilat në legjislacionet e tyre e kanë parashikuar këtë lloj dënimi.

Konstatimi i lartcekur gjen mbështetje edhe sa i përket rastit të Kosovës. Të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes të ciklave pasqyrohet gjendja e kriminalitetit në vend dëshmojnë se pas një viti të parashikimit të dënimit me burgim të përjetshëm nuk vërehet asnjë tendencë e zvogëlimit të veprave penale.⁵

3.2.6. Të qenit në kundërshtim me të drejtat e njeriut

Sipas shumë konstatimeve, me të cilat akordohem plotësisht, dënimi me burgim të përjetshëm, në masë të konsiderueshme, bie ndesh me të drejtat e njeriut. Këtë fakt e ka deklaruar edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në korrik të vitit 2013, duke vendosur për kërkesën e tre britanikëve që vuanin dënimin me burgim të përjetshëm për kryerje të veprës penale të vrasjes, ka konstatuar se dënimi me burgim të përjetshëm, sidomos kur ai shqiptohet pa mundësinë e rishikimit është në kundërshtim me të drejtat e njeriut.⁶

Në fakt, dënimi me burgim të përjetshëm mund të trajtohet të jetë në kundërshtim me të drejtat e njeriut edhe nga fakti se ai, në parim, konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes kryerësit të veprës penale për tërë jetën e tij. Meqenëse liria e lëvizjes është një e drejtëfundamentale e njeriut, nga e cila varet realizimi edhe i shumë të drejtave të tjeratë njeriut, marrja e saj në mënyrë të përhershme vlerësohet se pashmangshëm bie ndesh me të drejtat e njeriut.

Përfundimi

Nga rezultatet modeste të këtij artikulli mund të nxirren këto përfundime:

Dënimi me burgim të përjetshëm është dënim kryesor që konsiston në marrjen e përhershme të lirisë së lëvizjes kryerësit të dënuar të veprës penale të rëndë për të cilën shprehimisht është parashikuar me ligj.

Dënimet përgjithësisht, përfshirë dënimin me burgim të përjetshëm manifestojnë disa karakteristika të përbashkëta. Të tilla konsiderohen: karakteri personal, human, legjitim, proporcional, i ndarë, i

⁵Burimi: http://kgjk-ks.org/repository/images/RAPORTI_STATISTIKOR_GJASHEMUJORIT_TE_2014_MBI_PUNEN_GJYKATAVE_241144.pdf.

⁶Burimi: <http://www.telegrafi.com/lajme/strasburg-burgu-i-perjetshem-kunder-te-drejtave-te-njeriut-4-15182.html>.

revokueshëm, i përmirësueshëm etj., i dënimeve.

Dënimi me burgim të përjetshëm manifeston këto karakteristika të ashtuquajtura të veçanta: ai është parashikuar vetëm për vepra penale shumë të rënda, të kryera në rrethana veçanërisht rënduese dhe që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda; ai në asnjë rast (për asnjë vepër penale) nuk është parashikuar si dënim i vetëm, por së bashku me dënimin me burgim; lirimi me kusht në rastet e këtij dënimi mund të jepet vetëm pasi kryerësi të ketë mbajtur 40 vjet të këtij dënimi dhe ky dënim nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet dhe personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Si argumente që mbështesin dënimin me burgim të përjetshëm konsiderohen: nevoja e mbrojtjes së shoqërisë nga kryerësit që kryejnë vepra penale jashtëzakonisht të rënda; nevoja e frikësimit të kryerësve të veprave penale dhe përkrahja e dënimit me burgim të përjetshëm nga shumica e popullsisë.

Si argumente që kundërshtojnë dënimin me burgim të përjetshëm konsiderohen: efekti i tij në marrjen përjetësisht të lirisë së lëvizjes të kryerësit të dënuar të veprës penale; efekti negativ i tij në karakterin human që duhet ta ketë dënim, efekti relativisht i lartë hakmarrësi shoqërisë që përmes tij ajo e manifestonndaj kryerësit të veprës penale; ndeshja me qëllimin e dënimit; joefektiviteti i tij në zvogëlimin e kriminalitetit dhe rënia ndesh e tij me segmentin e të drejtave të njeriut.

Referencat

Elezi, I. Kaqupi, S. Haxhia, M. (1999), Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Hajdari, A. (2014), Disa nga risitë që i përmban Kodi Penal i Republikës së Kosovës në lidhje me dënimet, Punim i prezantuar në Konferencën "Menaxhimi kulturor i turizmit në Kosovë dhe Shqipëri", Pejë.

Mulliqi, S. (2014), A duhet të zbatohet dënimi me burgim të përjetshëm apo dënimi me vdekje për kriminelët, <http://www.Revistadrini.com/2014/08/a-duhet-te-zbatohet-denimi-me-burg-te-perjetshem-apo-denimi-me-vdekje-per-kriminelet/>.

Salihu, I. Zhitija, I. Hasani, F. (2014), Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Prishtinë.

Salihu, I. (2012), E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë.

Shala, A. (2013), Hyrje në të drejtën Penale, Gjilan.

http://kgjk-ks.org/repository/images/RAPORTI_STATISTIKOR_GJASHEMUJORIT_TE_2014_MBI_PUNEN_GJYKATAVE_241144.pdf;

<http://www.telegrafi.com/lajme/strasburg-burgu-i-perjetshem-kunder-te-drejtave-te-njeriut-4-15182.html>.

Alternativat e dënimit me burgim dhe probleme të aspektit teoriko – praktik

Drnt. Jonida Skëndaj
Albanian University

Abstrakt

Legjislacioni penal ashtu sikurse çdo legjislacion dhe çdo fushë e veçantë e jetës po njej zhvillime të rëndësishme që i dikton koha dhe zhvillimi i shoqërisë. Modernizimi ka përfshirë të gjitha aspektet e shoqërisë. Jetojmë në kohë të tilla ku, parashikimi i lirisë, të drejtave të njeriut dhe garantimi i tyre përbëjnë një nga qëllimet kryesore të legjislacioneve bashkëkohore. Kjo tendencë e përgjithshme reflektohet në legjislacionin që rregullon të gjitha fushat e jetës dhe kuptohet që kjo tendencë do të reflektohet edhe në legjislacionin penal si një aspekt i veçantë i tij. Sanksionet penale janë një nga çështjet themelore të së drejtës penale, këto janë edhe pjesa më dinamike e kësaj dege të së drejtës. Rrjedhimisht, gjatë historisë së të drejtës penale ndryshimet më të shpeshta dhe më të mëdha janë shprehur në këtë fushë.

Midis rekomandimeve të shumta të Këshillit të Europës në fushën e drejtësisë nuk mungojnë edhe rekomandimet në këtë drejtim, kështu në rekomandimin nr (92) 16, parashikohen masat dhe sanksionet në interes të publikut, si dhe këshillohen vendet anëtare të Këshillit të Europës, për një zbatim më të gjerë të këtyre sanksioneve, në kuadrin e përafritimit të politikës penale midis vendeve të ndryshme Europiane, në funksion të arritjes së standarteve që kërkon pjesëmarrja në familjen e madhe europiane për të cilën shqiptarët aspirojnë prej kohësh. Duke parë rëndësinë, domozdoshmërinë, por edhe kurioziteti për të njohur institute të reja në këtë fushë, mora përsipër që me këtë punim të trajtoj qëllimin , konceptin dhe karakteristikat e alternativave të dënimit me burgim, instituteve të veçanta që parashikon kodi ynë penal në kreun e VII, për një kuptim sa më të mirë të tyre në funksion të një zbatimi më eficient, duke trajtuar problemet që dalin në teori, në praktikën gjyqësore dhe gjatë ekzekutimit të këtyre sanksioneve penale.

Fjalë kyçe: alternativat, dënime, sanksione, praktika gjyqësore, të drejtat e njeriut

Hyrje

Që nga fillesat e qytetërimit dhe deri në kohët moderne, mënyra e reagimit ndaj sjelljeve dhe veprimeve që çenojnë liritë, vlerat dhe normat më vitale të individëve, grupeve dhe shoqërive të caktuara, pra reagimi ndaj krimit ka evoluar dhe ka ecur drejt përsosmërisë. Reagimi ndaj krimit gjatë historisë ka njohur dy forma reagimin privat dhe reagimin publik, por ajo që na intereson në këtë trajtim është ky i fundit, ku lufta kundër kriminalitetit intuitualizohet dhe reagimi ndaj manifestimeve kriminale bëhet detyrë e zyrtarëve dhe e institucioneve të specializuara shtetërore. Dënimi ka njohur zhvillime të rëndësishme që prej krijimit të shteteve të para dhe deri në ditët e sotme.

Përfaqësuesit e shkollave pozitiviste italiane dhe shkollave sociologjike dhe lëvizjeve të ndryshme kanë insistuar në faktin se sjellja kriminale është ndikuar nga faktorë individualë dhe socialë të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e autorit të veprës penale. Bashkë me evoluimin e konceptit mbi dënimin kanë evoluar edhe teoritë mbi qëllimin e dënimit të cilat janë:

1. Teoritë absolute mbi qëllimin e dënimit. Sipas kësaj teorie qëllimi i vetëm i dënimit është hakmarrja, kthimi i të keqes që kanë bërë autorët e veprës penale me një të keqe të njëjtë ose më të madhe. E pra këto teori e shohin dënimin si qëllim në vetvete dhe bazohen tek teoria e drejtësisë absolute.
2. Teoritë relative mbi qëllimin e dënimit. Thelbi i këtyre teorive qëndron në faktin që dënimi është i domozdoshëm dhe i dobishëm për mbrojtjen e shoqërisë dhe ai nuk qëndron në hakmarrjen dhe shpërgimin për atë që ka ndodhur, por në parandalimin e sjelljeve kriminale.
3. Teoritë bashkëkohore. Sipas teorive më bashkëkohore, dënimi ka për qëllim pengimin e veprimeve të rrezikshme shoqërore dhe riedukimin e kryerësve të veprave penale që ata në të ardhmen mos të kryejnë veprime të tilla. Po ashtu, dënimi ka për qëllim që të ndikojë në mënyrë

edukative në qytetarë të tjerë që të mos kryejnë vepra penale. Sipas teorive më të reja lidhur me qëllimin e dënimit, insistohet që qëllimi ekskluziv i dënimeve të jetë parandalimi dhe asgjë tjetër. Sipas këtyre pikpamjeve, në plan të parë vendoset risocializimi i të dënuarve dhe aftësimi i tyre për jetë normale në një ambient të caktuar shoqëror (Muçi, 2007 , 235)

Kuptimi i alternativave të dënimit me burgim

Një aspekt i veçantë i modernizimit të legjislacionit penal shqiptar do të konsideroheshin “Alternativat e dënimit me burgim”, jo sepse përbejnë një risi në legjislacionin shqiptar, por sepse ato paraqesin një domozdoshmëri duke patur parasysh që në kushtet e reja social-ekonomike që po kalon bota dhe vendi ynë, një ndryshim i rëndësishëm i konceptit ka qënë kalimi nga regjimet që synonin në mënyrë të veçantë për të ndikuar në mënyrën dhe sjelljet e të burgosurve, drejt modeleve të inkurajimit dhe të zhvillimit të aftësive shoqërore e cilësive personale, që do të përmirësojnë prespektivat për një riintegrim të suksesshëm. Për një zbatim sa më korrekt dhe më efikas, gjithmonë është e domosdoshme dhe e rëndësishme të kuptohet thelbi i nocionit. Në Kodin Penal aktual, që kur u miratua në 27.01.1995, në kreun e VII të tij janë parashikuar “alternativat e dënimit me burgim”. Ndër këto ishin: copëzimi i dënimit me burgim (neni 58 i KP); pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim (neni 59,63 i KP); lirimi para kohe me kusht (neni 64, i ndryshuar me ligjin Nr. 8733, datë 24.01.2001). Në teorinë e së drejtës penale bashkëkohore dhe në ligjet penale të shteteve demokratike, dënimeve alternative u kushtohet rëndësi dhe vend i posaçëm. Aktualisht politika penale e shumë vendeve europiane u jep përparësi dënimeve alternative me burgim, për karakterin e tyre edukativ, demokratik, shoqëror dhe humanitar që ato kanë. Për këto arsye edhe shteti ynë nga përvoja e zbatimit të tyre dhe nga ajo ndërkombëtare ka miratuar në Kuvendin e Shqipërisë, reformën me ligjin e ri Nr. 10023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal“, ku vendin kryesor e zenë dënimet alternative (Ligji, nr. 10023, 2008).

Në disa nene të tjera bëhen disa shtesa e ndryshime të diktuar nga politika kriminale e shtetit tonë. Si burim bazë për këto shtesa e ndryshime në tërësi kanë shërbyer kodet penale të disa shteteve (Itali, Gjermani, Spanje, Britani e Madhe e deri tek Kodi Penal i Republikës së Kosovës), rekomandimet e Këshillit të Europës, si dhe mendimet teoriko-juridike të vendit e të huaja. Duke bërë një analizë të thjeshtë gramatikore të vetë titullit të kreut, të krijohet përshtypja se bëhet fjalë për të gjitha dënimet e tjera përveç dënimit me burgim, duke përfshirë këtu dënimet me gjobë, dënimet plotësuese si dhe çdo sanksion tjetër të parashikuar nga legjislacioni penal në luftën kundër kriminalitetit që nuk është dënim me burgim. Por duke analizuar me kujdes dispozitat e këtij kreu arrin në konkluzionin se interpretimi gramatikor i titullit të kreut të çon në një përfundim të gabuar. Lind pyetja, çfarë janë alternativat e dënimit me burgim? Janë dënime? janë sanksione penale? janë sanksione në interes të komunitetit? apo do të ishte më mirë që sipas kodit penal aktual ti konsideronim alternativa të ekzekutimit të dënimit me burgim?

Megjithëse në shumë aspekte alternativat e dënimit me burgim kanë shumë të përbashkëta me dënimin, duke patur parasysh dispozitat konkrete në kodin penal këto nuk mund të konsiderohen dënime për disa arsye:

1. Gjykata kur vendos të aplikohet njëri prej neneve të alternativave, pasi vendos dënimin dhe vetëm në qoftë se vendos dënim me burgim, në raste të caktuara në bazë të kritereve ligjore dhe bindjes së saj të brëndshme urdhëron që ky dënim të ekzekutohet në një nga mënyrat e parashikuara nga nenet 58, 59 dhe 63 të K. Penal. Pra ajo nuk vendos një dënim të ri, por urdhëron mënyrën sesi do të ekzekutohet dënimi me burgim (Elezi, 2009 , 283-297).
2. Alternativat nuk jepen për atë çfarë ka bërë personi si ndëshkim, por për shkak të individualitetit të rastit të ardhur për gjykim duke patur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të ulët të veprës, rrethanave të kryerjes, autorit dhe të cilësive personale të tij, gjykata vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme dërgimi i personit në burg (ekzekutimi sipas mënyrës tradicionale), pasi kjo nuk do të shërbente qëllimit të dënimit në rastin konkret, por të ekzekutohet në një prej mënyrave të parashikuara në kreun e VII të Kodit penal.
3. Gjithashtu në legjislacionin tonë penal ashtu si dhe në legjislacione të shteteve të tjera si Italia, Gjermania, Anglia etj, alternativat e dënimit me burgim konsiderohen si përfitime ose privilegje pra

si shprehje e parimit të humanizmit, gjë e cila nuk mund të thuhet për dënimet pasi ato nuk mund të konsiderohen kurrësi përfitime. Duhet thënë se koncepti i sanksionit penal është një koncept më i gjerë që e përfshin në vetvete edhe konceptin e dënimeve dhe masave. Kështu sanksioni penal përkufizohet si: “Tërësia e masave ndëshkuese që jepen nga gjykata me procedurën e përcaktuar me ligj ndaj autorit të veprës penale, i cili kryen një veprim ose mosveprim që është në kundërshtim me ligjin, me qëllim mbrojtjen e shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti”. Pra sanksioni përfshin të gjitha llojet e masave të karakterit parandalues, ndëshkues, edukues etj, të cilat merr shteti për të parandaluar dhe luftuar kriminalitetin.

Elementët dhe karakteristikat e alternativave të dënimit me burgim, në raport me karakteristikat e dënimit

Alternativat e dënimit me burgim kanë karakteristika të përbashkëta dhe të veçanta me dënimin penal:

Ashtu sikurse dënimi edhe alternativat zbatohen vetëm ndaj personave fajtorë që kryejnë vepra penale. Parimi “Nulla poena sine lege”. Ashtu sikundër nuk mund të zbatohet një dënim penal që nuk është parashikuar në ligj, nuk mund të aplikohet një alternativë (sanksion në interes të komunitetit) e parashikuar në ligj.

Nëpërmjet dënimit shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe shoqërisë, edhe qëllimi i alternativave pak a shumë është i njëjtë, por duhet thënë se në ndryshim nga dënimi, këtu të bie në sy karakteri i theksuar humanitar i këtyre dispozitave që i mëshon më shumë idesë së mënyrës sesi duhet të trajtohen të dënuarit si një qenie humane. Pra qëllimi i mësipërm mund të arrihet së pari duke i mbrojtur të dënuarit nga shprehjet kriminale (Elezi, 2010, 243).

Ashtu sikurse dënimi edhe alternativat janë në diskrecionin e gjykatës për të vendosur ose jo në lidhje me aplikimin e tyre. Por në ndryshim nga dënimi, diskrecioni i gjykatës në rastin e alternativave është më i gjerë, për faktin se në rast se një person do të konsiderohet fajtor nga gjykata, ndaj tij do të jepet patjetër një dënim, diskrecioni në këtë rast qëndron vetëm në përcaktimin e llojit ose të masës në varësi të dispozitës konkrete, ndërsa në rastin e alternativave është plotësisht në diskrecionin e gjykatës të vendosë jo vetëm llojin e alternativës por edhe nëse do ti aplikojë ose jo, megjithëse rasti konkret mund ti plotësojë të gjitha kushtet që kërkon dispozita ligjore.

Gjykata si në rastin e zbatimit të alternativave edhe në rastin e caktimit të dënimit zbaton të njëjtat parime, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe autorit, shkallën e fajit dhe rethanat rënduese dhe lehtësuese duke pasur parasysh parimin e individualizimit të dënimit, por në rastin e aplikimit të alternativave duhet që rrezikshmëria shoqërore e veprës dhe autorit të jetë e ulët, shkalla e fajit të lehtë dhe të dominojnë rethanat lehtësuese.

Probleme të aspektit teorik

Në pamje të parë kur lexon dispozitat e kreut të VII të Kodit Penal, për alternativat e dënimit me burgim, duket sikur gjithçka është e qartë dhe nuk ka asnjë problem në kuptimin, formulimin dhe aplikimin e tyre, por duke i analizuar me hollësi dhe në kontekstin e legjislacionit në tërësi dhe qëllimit të tyre, në brëndësi të tyre vihet re se ka mangësi, që mbase nuk kanë dalë në pah edhe për faktin se këto dispozita nuk kanë gjetur aplikim të gjerë në praktikë. Për tu paraprirë këtyre problemeve që praktika mund ti nxjerrë në të ardhmen duke shpresuar që këto të gjejnë një aplikim më të gjerë, do të trajtoj disa aspekte që mund të ndihmojnë edhe në një kuptim më të mirë dhe një zbatim më efikas të këtyre dispozitave.

Personat ndaj të cilëve aplikohen alternativat do të konsiderohen të rehabilituar apo jo pas ekzekutimit të tyre?

Instituti i rehabilitimit i parashikuar në Kodin Penal aktual, shpreh parimin se çdo qenie njerëzore vazhdimisht evoluon, vetëkorrigjohet e ndryshon, si në marrëdhënie me njerëzit e tjerë, por edhe në relacion me shoqërinë dhe institucionet e saj. Me rehabilitim në kuptimin e përgjithshëm do të kuptohet rivendosja e të drejtave të mëparshme personit të dënuar, pasi të jenë plotësuar kushtet e

përcaktuara në ligj (Elezi, Kaçupi & Haxhia, 2012, 326).

Nga ana e vet rehabilitimi ndahet në: rehabilitim ligjor, i cili ka të bëjë me rastin kur rehabilitimi bëhet automatikisht për personat që pas vuajtjes së dënimit dhe që gjatë afatit ligjor të parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal, nuk kryejnë veprë tjetër penale dhe rehabilitim gjyqësor i cili realizohet vetëm mbi bazën e vendimit të gjykatës, me kërkesën e subjekteve që legjitimohen dhe me kalimin e afatit të provës gjatë të cilës nuk duhet të ketë kryer veprë tjetër penale (Muçi, 2007, 366). Pra ky institut përcakton një afat kohor me kalimin e të cilit pa konsumuar vepra të tjera penale, personi konsiderohet i padënuar. Është e rëndësishme të theksohet se ky afat fillon menjëherë pas vuajtjes së dënimit. Në lidhje me alternativat, nëse do të merrnim në konsideratë gjysmëlininë, problemi se kur fillon afati i rehabilitimit dhe në cilin moment personat do të konsiderohen të rehabilituar varet nga momenti i vuajtjes së dënimit dhe nga masa e dënimit. Në këtë rast periudha e rehabilitimit fillon kur personi fillon të vuajë burgimin me gjysmëlini dhe afati për rehabilitimin varet nga masa e dënimit që është vendosur për të.

Problemi qëndron në rastin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik. Pasi në nenin 63/6 të Kodit Penal, parashikohet "*Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqënë*". Duke patur parasysh këtë paragraf të krijohet përshtypja se është e qartë dhe s'ka sesi të jetë ndryshe, që në përfundim të kushtit ose të punës, personi i dënuar të konsiderohet i rehabilituar. Afati i provës për personin që i është pezulluar ekzekutimi i vendimit dhe afati i provës që kalon personi për tu konsideruar i rehabilituar janë dy gjëra të ndryshme. Është e vërtetë që afati i provës për pezullimin në vetvete ka edhe qëllime rehabilituese sikurse dënimi në vetvete, por personi në këtë rast nuk gëzon të njëjtin status me personin që e ka vuajtur dënimin, pasi ky i fundit nuk gëzon asnjë kufizim tjetër, përveç faktit që dëshmia e penaltetit jepet si i dënuar. Ndërsa personi të cilit i është pezulluar ekzekutimi i vendimit, përveç këtij fakti gjatë afatit të provës mund ti kufizohen edhe liritë dhe të drejtat e tij nëpërmjet masave dhe detyrimeve të parashikuara nga nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal (Ligji nr.8331, 1998).

Probleme të aspektit praktik

Dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë alternativat e dënimit me burgim, kanë mjaft probleme gjatë aplikimit të tyre në praktikë. Kjo situatë ka qënë më problematike para krijimit të infrastrukturës së përshtatshme për mbikqyrjen e alternativave të dënimit. Por problemi më i madh në lidhje me to ka qënë ekzekutimi i tyre në praktikë dhe sidomos, mosparashikimi me ligj konform rekomandimeve të Këshillit të Europës i një autoriteti që do të mbikqyrte dhe kontrollonte ekzekutimin e alternativave, madje do të ndihmonte edhe gjykatën ose prokurorinë në individualizimin e alternativës më të përshtatshme përpara se gjykata të ketë dhënë vendimin. Nga studimi i modeleve të ndryshme vihet re se organet me funksione mbikqyrëse siç është Shërbimi i Provës, më shumë se nga karakteri represiv karakterizohen nga humanizmi dhe kanë më tepër karakter social. Pasi vetëm nëpërmjet një trajtimi të kujdeshëm dhe të individualizuar për çdo person, mund të arrihet qëllimi për një rikthim të suksesshëm në shoqëri dhe rifutja në jetën normale pa etiketime, pa stigmatizime (Hysi, 2010, 404-405). Prandaj organe të tilla në vetvete përveç juristëve duhet të përbëhen edhe nga punonjës socialë dhe psikologë që të asistojnë me mbështetje psikologjike dhe shpirtërore për këta persona. Termi "mbikqyrje" është një koncept më i gjerë se kontrolli dhe përveç veprimeve që ndërmerren që shkelësit e ligjit të përmbushin ndonjë kusht ose detyrim të imponuar, i referohet edhe aktiviteteve ndihmëse të kryera në emër të autoritetit zbatues që kanë si qëllim të mbajnë shkelësit e ligjit në shoqëri (Këshilli i Europës, 2007). Pra në qoftë se do të kërkojmë një aplikim më të madh të alternativave të dënimit me burgim së pari duhet të sigurohet zbatimi i tyre real në praktikë dhe autoriteti mbikqyrës, duhet të asistojë të gjithë shkelësit e ligjit ndaj të cilëve aplikohen alternativat e dënimit me burgim. Në këtë mënyrë autoriteti mbikqyrës duhet të ushtrojë punën e tij me rigorozitet dhe kjo do të lehtësonte punën e gjykatave dhe prokurorive, të cilat do të njiheshin me raporte të herëpashërshme për shkelësin e ligjit, për gjëndjen psiko-emocionale, ekonomike, familjare, shoqërore, personalitetin dhe karakterin e tij përpara se të jepej vendimi gjyqësor. Problem tjetër që vihet re nga praktika është edhe mosarsyetueshmëria si duhet e vendimeve të gjykatave në rastet e aplikimit të alternativave të dënimit. Kështu gjyqtarët në rastet kur aplikojnë një

prej alternativave nuk ndalen në trajtimin e hollësishëm të rrethanave, fakteve, shkaqeve, analizën e personalitetit të të pandehurit që iu krijon atyre bindjen se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet vetëm nëpërmjet aplikimit të alternativave. Kështu p.sh në vendimin Nr 169, datë 18.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë ku vendoset aplikimi i pezullimit, gjykatat mjaftohen në arsyetimin e vendimit me vetëm një fjali: në caktimin e llojit dhe masës së dënimit gjykata ka parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer dhe të autorit, pendimin e tij të thellë të parashikuar si rrethanë lehtësuese nga neni 48/“ç“ i Kodit penal (Gjykata e Rrethit Gjyqësor , 2002). Kjo bën që tek personat që lexojnë një vendim të tillë të egzistojë dyshimi nëse personi konkret e meriton një përfitim të tillë dhe kjo sjell paragjykimin e gjyqtarëve që aplikojnë alternativat, humbjen e besimit tek ata dhe tek organet e drejtësisë në përgjithësi, një gjë e cila është mjaft e vështirë dhe do të kërkojë kohë për tu rikuperuar.

Përfundime

Alternativat e dënimit me burgim të parashikuara në kreun e VII të Kodit Penal, si një strategji ere në luftën kundër kriminalitetit dhe parandalimit të tij përbëjnë një rast unik duke e parë në raport edhe me legjislacionet e tjera. Kjo jo vetëm për faktin se ato parashikohen të gjitha në një kapitull të veçantë, por edhe për faktin se ato aplikohen vetëm ndaj dënimit me burgim dhe nuk parashikohen si dënime sikurse në disa legjislacione të tjera, por si mënyra ekzekutimi të ndryshme nga ajo tradicionale e vuajtjes në qeli.

Pra, duke u nisur nga fakti se parimi i individualizimit të dënimit është një parim që karakterizon edhe procesin e ekzekutimit të dënimeve penale, për individë me rrezikshmëri të ulët shoqërore të veprës penale, gjykata me kërkesën e palëve apo edhe kryesisht mund të vendosë për aplikimin e një prej alternativave të dënimit me burgim të parashikuara në Kodin penal. Në këtë kontekst në qoftë se do ti qëndrojmë besnik karakterit unik të alternativave, do të ishte më e përshtatshme që titulli i kreut të VII, të ndryshonte nga “Alternativat e dënimit me burgim” me “Alternativat e ekzekutimit të dënimit me burgim”.

Dënimi me burgim edhe pse është i nevojshëm, në shumë raste ku përfshihen autorë të dhunshëm, ky dënim nuk është zgjidhja e duhur për çdo rast, as për parandalimin e krimit dhe as për riintegrimin social të të dënuarve. Për më tepër sistemi i burgjeve po kalon sfida të shumta për shkak të mbipopullimit apo infrastrukturës së vjetëruar dhe si rrjedhojë, të dënuarit me burgim jetojnë në kushte të mjerueshme të cilat mund të kenë një ndikim negativ për gjendjen e tyre fizike dhe atë mendore, dhe pengojnë përgatitjen e tyre arsimore dhe profesionale, duke ndikuar kështu në mundësitë e tyre për një jetë normale në komunitet në të ardhmen. Një dënim i gjatë me burgim ka ndikim edhe në jetën familjare dhe punën e një personi. Sanksionet penale më të përdorshme duhet të jenë të një natyre jo me burgim (të ndryshme nga burgimi), prandaj në këtë drejtim na vjen në ndihmë aplikimi i alternativave të dënimit me burgim.

Zbatimi i dënimeve alternative në praktikë duhet të njohë rritje, jo vetëm sepse dënimet alternative u japin mundësinë autorëve të veprave penale për riintegrim dhe rehabilitim në shoqëri që të rifillojnë më shpejt jetën në komunitet, por nga ana tjetër kontrollojnë dhe ndëshkon autorët e veprave penale duke vepruar si mburojë për komunitetin. Sigurisht për të arritur rezultate të kënaqshme, duhet të veprohet në bashkëpunim me shërbimet sociale dhe të mirëqënies për të nxitur dhe rritur mundësinë e përfshirjes në shoqëri.

Referenca

- Elezi, I. (2010), “Zhvillimi historik i mendimit juridik shqiptar”, SHBLU, Tiranë, 243.
Elezi, I. (2009), “Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal”, ERIK, Tiranë, 283-297.
Elezi, I. Kaçupi, S. & Haxhia, M. (2012), “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Kumi, Tiranë, 326.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor, nr.169. (2002), Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
Hysi, V. (2010), “Kriminologjia”, Kristalina-KH, Tiranë, 404-405.
Këshilli i Europës. (2007), Rekomandim i Këshillit të Europës Nr (96) 12, “Masat dhe sanksionet në interes të

komunitetit”.

Ligji nr.8331. (1998), “Për egzekutimin e dënimeve penale” në Republikën e Shqipërisë, Tiranë.

Ligji, nr. 10023. (2008), “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal”.

Muçi, SH. (2007), “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme, Dudaj, Tiranë, 235.

Muçi, Sh. (2007), E drejta Penale (pjesa e përgjithshme), Dudaj, Tiranë, 366.

Përgjegjësia ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave njerëzore

Dr. Luljeta Kodra
Universiteti Mesdhetar

Abstrakt

Mbrojtja e të drejtave njerëzore është çështje ndërkombëtare. Komuniteti ndërkombëtar në vijimësi ka bërë përpjekje për të siguruar respektimin e të drejtave njerëzore në vendet ku kryhen shkelje masive dhe sistematike të të drejtave, të cilat përbëjnë rrezik për paqen. Përpjekje të tilla po bëhen edhe ndaj organizatës më të rrezikshme terroriste sot në botë - ISIS.

Një nga mënyrat që komuniteti ndërkombëtar ka përdorur për respektimin e të drejtave njerëzore, në vendet ku qeveria ka qenë e paaftë të ndalojë shkeljet e rënda të të drejtave njerëzore, ose ajo vetë ka qenë përgjegjëse për shkeljen e tyre, ka qenë përgjegjësia për të mbrojtur. Por, që përgjegjësia për të mbrojtur të jetë efektive dhe të përdoret thjesht për motive humanitare, ajo duhet vendosur brenda një kornize ligjore.

Arrija e konsensusit ndërkombëtar, së pari në aspektin ligjor, do të lehtësonte mundësinë e komunitetit ndërkombëtar për të vepruar në situatën e shkeljeve njerëzore nga ISIS. Pavarësisht nevojës dhe rëndësisë së madhe që paraqet justifikimi ligjor preciz i ndërhyrjes, si dhe pikëpyetjeve të mëdha që ka ngritur kjo ndërhyrje, një gjë është e qartë: Në realitetin e vështirë të kërcënimit që paraqet ISIS për civilët, interesat e qeverive të shteteve ku ndërhyhet, interesat e koalicionit kundër ISIS dhe mbrojtja e popullsisë nga genocidi dhe barbarizmat e tjera masive, janë përkohësisht të bashkërenduara.

Fati i shumë njerëzve varet në mënyrën se si komuniteti ndërkombëtar do të reagojë dhe do të zgjidhë çështjen e kërcënimit që vjen nga ISIS. Domsodoshmëria e reagimit ndërkombëtar buron nga fakti se organizata po kryen veprime terroriste dhe se për më tepër një përpjekje për të zgjidhur çështjen në mënyrë paqësore do t'i jepte mundësi ISIS të konsolidojë përpjekjet e saj dhe të përgatisë sulme të tjera. Në këtë luftë ndaj së keqes, të gjitha vendet duhet të marrin masa të plota, jo vetëm për të përballuar këtë rrezik brenda vendit, por edhe për të kontribuar në rrafshin ndërkombëtar.

Fjalët çelës: Komunitet ndërkombëtar, krizë humanitare, përgjegjësi për të mbrojtur, ISIS, ndërhyrje humanitare.

Hyrje

Tashmë është e qartë se ISIS përbën një rrezik gjithnjë e më të pranishëm, si në rrafshin rajonal, ashtu dhe në atë global. Ajo është përcaktuar së fundmi si organizata më e rrezikshme terroriste, më e afta nga të gjitha grupet terroriste si në përgatitjen strategjike, ashtu edhe atë taktike, me njëideologji krejt të qartë dhe shumë e përgatitur dhe e trajnuar ushtarakisht.

Ky grup që kohët e fundit e ka quajtur veten thjesht “shtet islamik” dhe është drejtuar nga një ushtarak si Al-Baghdadi ka ekzistuar nën emra të ndryshëm dhe nën maska të ndryshme, që në fillim të viteve '90 (Coleman, 2014, 3). Shteti Islamik i ka rrënjët e veta te organizata famëkeqe e Al-Kaedës e cila kur ishte në kulmin e aktivitetit të saj qeveriste bashkë me talebanët pjesën më të madhe të Afganistanit. ISIS realisht ka tejkaluar në mizori, organizim dhe kontroll efektiv të territorit edhe vetë organizatën nga e ka prejardhjen. Historia e ISIS është historia e asaj se si terrorizmi modern ka evoluar nga një ideal fetar dhe politik në një kult vdekjeje. ISIS gjeti njëmjedis të përshtatshëm për t'u krijuar sepse rajoni ku ajo u krijua ofron një territor shumë pjellor për lindjen e grupeve terroriste, radikale dhe ekstremiste.

ISIS e ka bazën e saj në Siri, ku kontrollon zona të mëdha.¹ Në 10 qershor 2014 ekstremistët Suni morën Mosulin, qytetin e dytë më të madh të Irakut (Coleman, 2014, 5). Këta militantë Suni që e quajtën veten “shtet islamik” IS, tani kërcënojnë të pushtojnë Irakun dhe Sirinë. Numri i tyre është rritur shumë dhe rreth gjysma janë luftëtarë të huaj. Mes tyre fatkeqësisht ka edhe shqiptarë, që kanë shkuar t'u bashkëngjiten radhëve të kësaj organizate pas predikimeve keqdashëse të elementëve ekstremistë që qëllimisht përdorin injorancën, mungesën e kulturës fetare dhe varfërinë për të bindur

¹ [Jurist - The Use of Force Against ISIS](http://jurist.org), jurist.org

shumë njerëz që t'i bashkohen një xhihadi, i cili vetëm po merr më qafë individë dhe familje të tëra. ISIS, që e quan veten një shtet islamik, ka treguar shumë herë tashmë qëllimet e tij barbare, duke postuar video me prerje kokash dhe duke kërcënuar vazhdimisht (Mullen, 2014, 6). Imazhe të gazetareve dhe punonjësve të organizatave humanitare perëndimore me koka të prera, qindra forca irakiene të sigurisë të torturuara dhe të ekzekutuara, shumë fatkeqësi civile dhe shumë të plagosur, mijëra kristianë që largohen nga paniku pasi u është dhënë ultimatumi të largohen, të konvertohen në myslimanë, ose të paguajnë një taksë, në të kundërt ata rrezikojnë të eliminohen, pëdhunime dhe ekzekutime veçanërisht të atyre që kundërshtojnë ISIS dhe ideologjinë e saj (Coleman, 2014, 8). Deri vonë, sulmet e ISIS përqëndroheshin në Siri, ku kontrollonin zona të mëdha territoriale, burime natyrore dhe armësh, por aktivistët dhe armatimi i ISIS filluan të kalojnë kufirin e Irakut. Organizata e ISIS ka gjithashtu qëllime të gjera ndërkombëtare. Ajo ndihmohet në arritjen e qëllimeve të tij nga burimet e shumta financiare që janë më të bollshme se të cilësdo organizate tjetër terroriste që historia ka njohur, nga përdorimi efektiv i medias alternative dhe rrjeteve sociale (Nguyen, 2014, 11). Këto janë arsyet kryesore që e bëjnë ISIS sot një nga kërcënimet me prezente për rajonin, por edhe për mbarë globin.

Shqetësues është edhe fakti se gjysma e aktivistëve të organizatës vijnë nga vendet europiane dhe muxhahedinë të tjerë, të cilët mund të kthehen në burim terrorizmi dhe në vendet e origjinës si dhe që po rritet numri i fëmijëve të rekrutuar që po përdoren si ushtarë.

Reagimi diplomatik ndërkombëtar

Duke u nxitur nga situata e krijuar nga veprimet e ISIS dhe rrezikshmëria që organizata paraqet, si dhe për shkak të mendimit të gjithëpranuar se ISIS paraqet një kërcënim të përbashkët që duhet luftuar me mjete të përbashkëta, partnerët perëndimorë (SHBA, Britani e Madhe, Gjermani, Francë, Itali e të tjerë), kanë shprehur vullnetin për t'iu kundërvënë asaj me masa konkrete. Masat përfshijnë ndryshimet në legjislacionin e brendshëm penal të shteteve, gjurmimin dhe penalizimin e financuesve të organizatës, krijimin e partneriteteve të përshtatshme për të luftuar këtë kërcënim të përbashkët dhe për të fuqizuar kurdët, duke shkuar deri te mundësia e ndërhyrjes ushtarake, e cila ka qenë fillimisht sporadike dhe nga ajri.

Shumë kombe të përfshira në organizata të tilla si: Lidhja Arabe, Bashkimi Europian dhe OKB u mbledhën në një konferencë kryeqytetin francez dhe e cilësuan ISIS si një kërcënim për komunitetin ndërkombëtar. Ata ranë dakord "të sigurojnë që keqbërësit të sillen para drejtësisë" (Mullen, 2014, 10). Duke përmbledhur konkluzionet e këtij takimi, qeveria franceze pohoi se "pjesëmarrësit kanë rënë dakord që të ndërmarrin kundër ISIS çdo masë të nevojshme, përfshirë edhe mbështetjen ushtarake, në përputhje me nevojat e shprehura nga autoritetet e Irakut, në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe pa rrezikuar sigurinë civile".

Si SHBA, ashtu edhe Kombet e Bashkuara i kanë dënuar veprimet e ISIS. Kombet e Bashkuara lëshuan një deklaratë të fortë lidhur me krimet kundër njerëzimit që po ndodhin në rajon: "Anëtarët e Këshillit të Sigurimit pohuan se sulmet e shumëpërhapura dhe sistematike të drejtuara kundër një popullsie civile, për shkak të përkatësisë së saj etnike ose bindjeve fetare, mund të përbëjnë një krim kundër njerëzimit, gjë për të cilën ata që janë përgjegjës duhet të mbajnë përgjegjësi (Hulse, 2014, 15).

Presidenti Barack Obama ka pohuar se SHBA "do të drejtojnë një koalicion të gjerë për të përmbysur këtë kërcënim terrorist" dhe se sulmet ajrore amerikane kundër ISIS do të zgjerohen nga Iraku në Siri (Mullen, 2014, 2). Sipas SHBA, afër 60 kombe kanë rënë dakord që të kontribuojnë në luftën kundër ISIS, i cili kontrollon zona të mëdha në Irakun verior dhe Siri. Disa kombe kanë ofruar ndihmë në vendosje trupash në tokë. Franca ndërkohë ka filluar fluturimet e rikonicionit mbi Irak. Presidenti francez Hollande ka deklaruar se "nuk kanë kohë për të humbur" në përpjekjet ndërkombëtare kundër ISIS. Britania gjithashtu ka rënë dakord që të ndihmojë forcat kurde, të mbështesë qeverinë e Irakut, të vazhdojë zbatimin e ndihmës humanitare dhe të koordinojë në Kombet e Bashkuara luftën kundër ISIS.

Kancelarja gjermane Angela Merkel e mbrojti vendimin e qeverisë së saj për t'iu dërguar armë kurdëve që luftojnë militantët e shtetit islamik në Irak, duke thënë në parlament se ky grup paraqet një kërcënim të madh për sigurinë në Gjermani dhe Europë (Barkin, 2014, 2). Destabilizimi i një

rajoni të gjerë ndikon edhe mbi Gjermaninë dhe Europën. Në këtë situatë aktuale krize, armët gjermane po shpërndahen me qëllim që të influencohet kriza, të ndihmohet një partner dhe të parandalohet një rrezik (Barkin, 2014, 4).

Pjesa më e madhe e gjermanëve besojnë se qeveria nuk duhet t'u dërgojë armë luftuesve kurdë, pavarësisht barbarizmave të kryera, për shkak se armët mund të përfundojnë në duart e xhihadistëve dhe për shkak se Gjermania mund të bëhet shënjestër e tyre nëse ndërhyt. Por, pohon Merkel, Gjermania ka përgjegjësi të ndërhyjë për të parandaluar një katastrofë humanitare në Irak, për shkak të evidencës së spastrimit etnik që po bëjnë luftuesit e Shtetit Islamik. Jemi të përgjegjshëm për rrezikun e kësaj mbështetjeje që po japim, por gjithashtu e pyesim veten rreth rrezikut akut që vjen nga ISIS në qoftë se ne nuk shpërndajmë armë.

Shqipëria e ka ndihmuar qeverinë irakiene nëpërmjet dërgimit të armatimeve dhe municioneve si dhe ka ndërmarrë masa për të dekurajuar fenomenin e luftëtarëve të huaj. Ajo që në muajin gusht 2014 ka filluar t'u dërgojë armë kurdëve, nëpërmjet ndihmës së sistemeve perëndimore të transportit ajror (Wordsworth, 2014, 21) dhe madje Shqipëria është përgëzuar edhe nga SHBA për furnizimin me armë. Sipas shefit të diplomacisë shqiptare, angazhimi në furnizimin me armë dhe municione të luftëtarëve kundër ISIS nuk paraqet rrezik të brendshëm për Shqipërinë. Ajo që po ndodh nuk është një fenomen shqiptar dhe as ballkanik që do të thotë se nuk është Ballkani burim luftëtarësh të rinj. Rreziku i vetëm mund të jenë si për ne ashtu dhe për vendet e tjera të Ballkanit kthimi i luftëtarëve të huaj në vendet e tyre të origjinës.²

Ligjshmëria e aksionit ndërkombëtar

Komente të shumta janë bërë mbi ligjshmërinë e sulmeve ajrore në Siri. Disa pretendojnë se janë sulme të paligjshme, për shkak se nuk janë autorizuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe sepse nuk janë akte vetëmbrojtëse duke qenë se ISIS nuk paraqet kërcënim për SHBA. Por këto pikëpamje bazohen në një kuptim të gabuar të qëllimit të vetëmbrojtjes të sanksionuar në Kartën e OKB.

Neni 51 i Kartës garanton të drejtën e brendshme të shtetit për vetëmbrojtje individuale ose kolektive. Kjo nënkupton që qeveria e Irakut ka të drejtë të përdorë forcën për të mbrojtur veten nga sulmet e ISIS, por edhe shtetet e tjera kanë të drejtë të asistojnë. Iraku faktikisht ka ndërmarrë masa për të luftuar ISIS brenda territorit të tij. Mungesa e një kërcënimi direkt ndaj SHBA ose ndaj aleatëve të saj nuk e bën të pavlefshme vetëmbrojtjen në formën e ndërhyrjes, sepse veprimet kundër ISIS në Irak dhe Siri janë kryesisht një përgjigje mbrojtëse ndaj agresionit të armatosur të kësaj organizate (Bellamy, 2014, 33).

Iraku si një shtet sovran ka të drejtë të kërkojë asistencë nga shtetet e tjera. Ndërhyrja nga ana e shteteve të tjera nuk çënon integritetin territorial të Irakut ose pavarësinë politike aq më tepër që lideri i rajonit kurdistan të Irakut ka kërkuar që të intensifikohen goditjet ajrore të SHBA, duke thënë se ata do të mirëpresin luftues të huaj.

Po t'i referohemi Sirisë, aktualisht asaj i mungon aftësia për të shpërbërë ISIS. Përdorimi i forcës në territorin sirian, pa pëlqimin e qeverisë siriane, në pamje të parë do të çënonte integritetin e saj territorial dhe do të shkëlqente nenin 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara mbi rregullat e përdorimit të forcës sipas OKB-së. Është e qartë që duhet të kërkohet pëlqimi nga qeveria siriane përpara se të ndërmerren aksione në territorin e saj, megjithëse duke qenë se Siria nuk ka aftësi të luftojë vetëm kundër ISIS, çdo refuzim nga ana e saj do të ishte i paarsyeshëm dhe nevojja për aksion ndërkombëtar e pashmangshme. Faktikisht nga pohimet e qeverisë siriane dhe nga veprimet e saj rezultojnë që misioni kundër ISIS gëzon pëlqimin e kësaj qeverie. Qeveria siriane jo vetëm që ka ofruar pëlqimin zyrtarisht, por ajo gjithashtu ka bashkëpunuar me drejtuesit e SHBA, duke vënë në dispozicion mbrojtjen e saj ajrore në zonat përkatëse ku po kryhen operacionet (Bellamy, 2014, 35).

Kur politikëbërësit diskutojnë mbi opsionet e tyre të zgjidhjes së konfliktit, është thelbësore që ato të arsyetojnë mbi faktin nëse po zbatojnë rregullat e duhura ligjore ndërkombëtare mbi bazën e të cilave po orientohet përdorimi i forcës në aksionin ushtarak kundër ISIS në Irak dhe në Siri.³

² www.puneteshashtme.gov.al/.

³ [JURIST - The Use of Force Against ISIS](http://www.jurist.org/), jurist.org

Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara parashikon: “Asgjë në Kartë nuk mund të pengojë të drejtën e vetëmbrojtjes individuale ose kolektive kur ndodh një sulm”.⁴ Por, dihet gjithashtu se për të zbatuar të drejtën e vetëmbrojtjes duhet të ekzistojë një sulm aktual ose i afërt kundër një shteti si dhe kundërpërgjigja e armatosur duhet të jetë e domosdoshme dhe proporcionale me sulmin. Pyetja e parë që mund të ngrihet në këtë rast është, nëse kemi të bëjmë me një sulm që siç theksuam më lart duhet të jetë sulm në vazhdim ose në rrezik potencial.

Duke u nisur nga hipoteza e provuar tashmë se ISIS ka kryer sulme, gjithsesi duhet që të ekzistojë nevoja ose domosdoshmëria për Irakun dhe aleatët e tij që të kenë të drejtë të përdorin forcën. Në rastin aktual, domosdoshmëria e kundërpërgjigjes buron nga fakti se një sulm po ndodh. Për më tepër një përpjekje për të zgjidhur çështjen në mënyrë paqësore do t'i jepte mundësi ISIS të konsolidonte përpjekjet e saj dhe të përgatiste sulme të tjera.

Lidhur me kushtin tjetër, sipas të cilit çdo përgjigje mbrojtëse duhet të jetë proporcionale, sulmet ajrore kundër bazave, asetëve dhe personelit të ISIS brenda territorit sirian dhe atij irakien nuk duhet të jenë jashtë proporcioneve të sulmeve të ISIS.⁵ Objektivi i aksionit duhet të jetë i arsyeshëm dhe aksioni vetë nuk duhet të shkojë përtej asaj çfarë është e nevojshme për të arritur objektivin me qëllimin e arsyeshëm të zvogëlimit të aftësive të ISIS.

Pikëpyetjet qëka ngritur ndërhyrja

Gjithë rrjedha e ngjarjeve ka ngritur çështje të vështira rreth shkallës në të cilën SHBA dhe aleatët e saj po mbështesin në mënyrë aktive në Siri një rregjim që është përgjegjës për krime barbare të panumurta kundër popullsisë së tij. Ky është një problem i veçantë që lidhet me përpjekjet për të zbatuar “Përgjegjësinë për të Mbrojtur”, duke qënë se ky aksion që drejtohet kundër fuqisë së ISIS, në njëfarë mënyre mbështet rregjimin sirian (Bellamy, 2014, 40). Pra, është e qartë që aksioni amerikan mund të shoqërohet me rreziqe potenciale në kuptimin që për shkak të mbështetjes amerikane që po merr në këtë luftë kundër ISIS, si dhe për shkak të faktit se po lejohet angazhimi i forcave të shumta siriane, rregjimi sirian do të jetë i lirë të angazhojë burime më të mëdha në fushatën e tij kundër Ushtrisë së Lirë Siriane. Pavarësisht kësaj, realiteti i vështirë i kërcënimit që paraqet ISIS për civilët, interesat e qeverisë siriane, interesat e koalicionit të udhëhequr nga SHBA dhe nevoja e mbrojtjes së popullsisë nga genocidi dhe barbarizmat e tjera masive janë përkohësisht të bashkërenduara.

Nga ana tjetër, shfaqja e Kalifatit - një shteti islamik dhe veprimet kriminale që shoqëruan lindjen e këtij shteti, ngritën të tjera çështje të rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare, siç janë: koncepti i shtetit, njohja e shtetit, përgjegjësia për të mbrojtur dhe e drejta e përdorimit të forcës (Coleman, 2014, 5).

Një objektivi shumë i rëndësishëm për ISIS është pasja e një “shteti”. Dihet tashmë që Abu Bakr al-Baghdadi, njoftoi krijimin e shtetit islamik, të një kalifati. Ky njoftim ngriti çështje të rëndësishme lidhur me atë se si është formuar ky shtet. Një përkufizim i shtetit mund të gjendet në nenin 1 të konventës së Montevideo-s. Konventa e Montevideos, Uruguaj “Mbi të drejtat dhe detyrat e shteteve”, e nënshkruar në 26 dhjetor 1933 gjatë konferencës së shtatë ndërkombëtare të Shteteve Amerikane, kodifikoi teorinë deklarative të njohjes së shtetit. Konventa u nënshkrua nga 19 shtete. Tre nga shtetet nënshkruese e pranuan këtë konventë me disa rezerva jo shumë të rëndësishme. Këto shtete ishin Brazili, Perua dhe Shtetet e Bashkuara. Kriteret e “Montevideos” janë pranuar përgjithësisht si një bazë normative e përshtatshme për përkufizimin e shtetit. Katër kriteret ose katër karakteristikat që duhet të ketë një shtet për t’u konsideruar subjekt i të drejtës ndërkombëtare dhe për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare si i barabartë në të drejta dhe detyrime me shtetet e tjera janë: një popullsi permanente, një territor i përcaktuar, një qeveri e aftë për të drejtuar popullsinë në bazë të një sistemi juridik të caktuar dhe sovraniteti.

Çfarë nënkupton në të vërtetë njohja e shtetit? A vendos ajo për ekzistencën e shtetit, apo është më tepër një proces diplomatik, apo një kërkesë e zakonshme për të siguruar respektimin e vlerave dhe normave të të drejtave njerëzore, apo një proces që siguron se shtete e reja do të ekzistojnë në

⁴Chapter VII: Action with Respect to Threats to the Peace, Breaches of the Peace, and Acts of Aggression, article 51, <http://www.un.org>

⁵[JURIST - The Use of Force Against ISIS](http://www.jurist.org), jurist.org

harmoni me komunitetin ndërkombëtar?

Traktatet ndërkombëtare, si dhe akademikët e kanë njohur rëndësinë e lidhjes që ka njohja ndërkombëtare e një shteti në ekzistencën e këtij shteti. Sipas konceptit deklarativ të njohjes së shtetit, shteti ekziston pavarësisht nëse njihet apo jo prej shteteve të tjera. Shteti ekziston faktikisht që në çastin e lindjes së tij. Njohja ndërkombëtare e “konstaton”, e “deklaron” faktin e lindjes. Pra, shteti i krijuar rishtaz i gëzon atributet e subjektit të së drejtës ndërkombëtare edhe pa njohjen nga ana e shteteve të tjera. Njohja ndërkombëtare shërben për t'i dhënë mundësi shtetit që t'i ushtrojë efektivisht këto të drejta, në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare (Puto, 2012, 130).

Teorikisht një kalifat përfaqëson një shtet sovran të të gjithë besimit mysliman, që drejtohet nga një kalif mbi bazën e ligjit islamik, të quajtur ndryshe “sherihati”. Çfarë nënkupton kjo për kushtet e sotme? A mund të përshtatet kalifati brenda strukturës ekzistuese politiko-ligjore të komunitetit të sotëm ndërkombëtar? A mundet që një shtet që imponon një rregjim joligjor që injoron të drejtat e njeriut, ta konsiderojë veten “ligjor”?

Një tjetër pikëpyetje e rëndësishme në kushtet kur ISIS po vazhdon të kryejë krime lufte dhe me qëllim po kërcënon dhe vret civilë, po përze grupet minoritare dhe po rekruton ushtarë fëmijë në luftën e tij për një kalifat në rajon është ajo nëse duhet që të kërkojmë njëmbështetje ligjore për zbatimin e “Përgjegjësisë për të Mbrojtur” në Irak (Ferguson, 2014, 11). Megjithëse disa përfaqësues të “Përgjegjësisë për të Mbrojtur”, besojnë se është shumë herët të zbatohet parimi i fundit, ai i ndërhyrjes ushtarake, nuk është shpejt të diskutohet parimi si një i tërë, veçanërisht aspekti i tij më i rëndësishëm, parandalimi (Hulse, 2014, 8).

Komuniteti botëror ka një mundësi të dalë nga frika e përhershme që ka për opsionin parandalues dhe të merret me çështjen e Irakut, përpara se ai të bëhet një tjetër Siri. Përgjegjësia për të mbrojtur është më shumë se ndërhyrje ushtarake. Ajo implikon parandalimin, ndërtimin e paqes dhe diplomacinë. Krijuesit e “Përgjegjësisë për të Mbrojtur” pretendojnë se ekziston një rrezik ekstrem nëqoftëse ajo keqpërdoret, sepse dëmtohet aftësia e komunitetit ndërkombëtar për të zbatuar çfarëdolloj ndërhyrje të ligjshme. Një shembull aktual i keqpërdorimit mund të jetë pohimi i Presidentit rus Putin i përgjegjësisë së tij për të mbrojtur të gjithë rusët në Ukrainë (Hulse, 2014, 11). Ky keqpërdorim flagrant nuk është vetëm një rrezik për sovranitetin e shtetit, por edhe për të ardhmen legjitime të parimit.

Konkluzione

Edhe pse Iraku ka të drejtë të vetëmbrohet kundër sulmeve të kryera nga ISIS, kërkesat strikte të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit i venë limite qëllimit të zbatimit të përgjigjes. Iraku ka gjithashtu të drejtë të kërkojë asistencë nga aleatët si SHBA, duke e transformuar aksionin në vetëmbrojtje kolektive. Aksionet sulmuese duhet t'i raportohen Këshillit të Sigurimit, siç kërkon neni 51 i kartës.

Pavarësisht nevojës dhe rëndësisë së madhe që paraqet justifikimi ligjor preciz i aksionit amerikan, me skenat kaotike në Kobane, është shumë e vështirë të ngrihen pikëpyetje rreth goditjeve ajrore të udhëhequra nga SHBA dhe të drejtës së zbatimit në këtë rast të Përgjegjësisë për të Mbrojtur si dhe përmbushjes së qëllimit të saj.

Ndërhyrja ushtarake, e udhëhequr nga SHBA, ka justifikim ligjor të mjaftueshëm dhe ka dhënë e po jep një kontribut direkt në mbrojtjen e popullsisë në Siri nga genocidi dhe barbarizmat masive. Sulmet ajrore po mbështesin përpjekje të shumta në tokë për të zbrapsur ISIS dhe për të mbrojtur popullsinë civile kurde. Aksioni amerikan dhe i aleatëve mund të konsiderohet në një këndvështrim si një përgjigje ose reagim edhe më i vogël nga sa nevojitet. Ai motivohet nga një shumëllojshmëri shkaqesh, njëri prej të cilëve është përgjegjësia për të mbrojtur dhe mund të mbartë me vete rreziqe për një kohë të gjatë.

Me kalimin e kohës mund të ndodhë që të provohet se ndërhyrja ishte e dobët si ndërhyrje, por gjithsesi ajo dha ndihmën e saj. Duke dobësuar forcat e ISIS, goditjet ajrore kanë mbështetur përpjekjet kurde për të mbrojtur veten dhe i kanë dhënë civilëve më shumë kohë për t'u larguar nga skenat e kimit. Koha për zgjedhje perfekte është akoma e largët. Fati i shumë njerëzve varet në mënyrën se si komuniteti ndërkombëtar do reagojë dhe do zgjidhë çështjen e kërcënimit që vjen

nga ISIS.

Procesi që i paraprin dërgimit të forcave nga vende të ndryshme të botës për t'iu bashkuar organizatës famëkeqe është një proces që duhet gjurmuar, identifikuar dhe penalizuar nga legjislacionet e brendshme të shteteve, si dhe të merren masa shtesë për t'u mbrojtur nga penetrimi i elementëve ekstremistë dhe propagandave ekstremiste që kanë mundësi të influencojnë tek njerëzit.

Nëse e drejta ndërkombëtare do të vazhdojë të ketë kredibilitet në shekullin e 21-të, ajo duhet të jetë në gjendje të përballet në mënyrë dinjitoze me sfidat që paraqiten nga ISIS.

Literatura

1. [Barkin, N.](#) (2014). Defending arming of Kurds, Merkel calls Islamic State a threat to Europe, BERLIN, Reuters
2. [Bellamy, A.](#) (2014). Aiding Iraqis Meets Responsibility to Protect and Could Lead to Common Ground on Syria, <http://theglobalobservatory.org>
3. [Bellamy, A.](#) (2014). Legality, Legitimacy, and Human Protection: International Intervention Against ISIS in Syria, theglobalobservatory.org
4. Chapter VII: Action with Respect to Threats to the Peace, Breaches of the Peace, and Acts of Aggression, article 51, <http://www.un.org>
5. [Coleman, A.](#) (2014). The Islamic State and international law: an ideological rollercoaster?, Rochester, NY : Social Science Research Network.
6. [Ferguson, T.](#) (2014). State Sovereignty and the Responsibility to Protect, Chandler-Gilbert Community College, MUNFW 65th Session Sixth Committee
7. [Hulse, C.](#) (2014). The "Responsibility to Protect" Is Buried in Iraq, <http://fpif.org>
8. [JURIST - The Use of Force Against ISIS](#), jurist.org
9. [Mullen, J.](#) (2014). [What's the world going to do about ISIS?](http://www.cnn.com), www.cnn.com
10. [Nguyen, Th.](#) (2014). Measures to Eliminate International Terrorism, Mesa Community College, MUNFW 65th Session, Sixth Committee
11. [Puto, A.](#) (2012). E drejta ndërkombëtare publike.
12. [Wordsworth, A.](#) (2014) Anti-ISIS coalition has mobilized up to 62 nations and groups, National Post
13. www.punetejashtme.gov.al/.

Të drejtat e njeriut dhe evoluimi i sovraniteti të shteti

Mr.sc. Petrit Nimani¹ Ph.D.c ; Ma.sc. Alban Maliqi² ; Altin Tara³

Abstrakt

Evolvimi i pushteteve shtetore nga sistemet autoritare, diktatoriale në demokraci ka bërë që të ndryshojnë edhe disa parime, të cilat ishin me një farë mënyre si statike rreth sovranitetit të shtetit. Pikërisht shekulli XX ishte vendimtar dhe u kriju një praktikë e re e cila bëri që këto parime statike të kohës të lëkundën dhe të ecet përpara në avansimin e të drejtave të njeriut, duke vlersuar më shumë se asnjëher më parë ato. Krijimi i Organizatave regjionale dhe atyre ndërkombëtare ishte një kapitull i ri në historinë e njerzimit dhe shtetit. Organizata e Kombeve të Bashkuara ishte një kthesë e madhe për njerëzimin dhe për demokracinë në botë, pasi që u krijuan disa parakushte të cilat rezultuan të jenë të suksesshme në kufizimin e të drejtave të shtetit pikërisht në fushën më të rëndësishme siç është fusha e të drejtave të njeriut. Në punimin tonë ne do të mundohem që ta shpjegojm hollsisht se si ka evoluar sovraniteti i shtetit që nga Paqja e Vestfalit e deri në ditët e sotme. Ne do të ngrisim shumë hipoteza dhe do të mundohem ti japim përgjigje çdo dileme rreth sovranitetit të shtetit dhe evoluimit në kohën moderne. Intervenimi Humanitar Ndërkombëtar është një shpikje e re e cila ndërroj rrjedhën e njerëzimit dhe filluan të trajtohen problemet në mënyr më humane nga bashkësia ndërkombëtare. Në të kaluarën shtetet kishin të drejtën ekskluzive për trajtimin e të drejtave të njeriut duke u thirrur në sovranitet e tyre, ndërsa sotë kem mekanizma mbishtetrorë në gjykimin se si shtetet rrespektojnë të drejtat e qytetarëve të vetë. Ne do të ngrehim shumë dilema dhe pyetje rreth sovranitetit të shtetit. Cilët janë kufijet e sovranitetit të shtetit? Pse njerzimi u trondit si pasoj e keqpërdorimit të sovranitetit të shtetit nga shtete të caktuara? Cilat ishin pasojat që shkaktoi mungesa e një institucioni mbikombëtar? Sa ndikoi pozitivisht krijimi i Organizatave Mbikombëtare dhe Univerzale? Gjithashtu një çështje e cila nuk duhet injoruar është edhe globalizmi një çështje e cila është shumë aktuale dhe shumë e rëndësishme për shoqërin. Këto dhe shumë çështje do ti trajtojm në punimin tonë shkencor.

Fjalët Kyçe: Sovraniteti i Shtetit, Intervenimi Humanitar Ndërkombëtar, Organizatat Ndërkombëtare (OKB, NATO, BE), Globalizmi, Demokracia etj.

Hyrje

Sovraniteti i shtetit daton shumë heret që nga viti 1517 kur Martin Lutern shkroi 95 tezat e tij në Wittenberg,⁴ pastaj në vitin 1555 Paqja e Augsburgëve, Paqja në mes të Ferdit dhe Ligës Shmall Kall⁵

¹Mr.Sc. Petrit NIMANI, Ph.D. Can. Ligjerues në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe në Kolegjin "Biznesi"

²Ma.sc. Alban MALIQI, Asisten ne Fakultetin Juridik ne Kolegjin "Biznesi"

³Altin Tara, Student

⁴Encyclopedia- **Martin Luterni** me 31 tetor 1517 kishte publikuar në derën e Kishës Kalaja në Witenberg letrën me 95 tezat e tij. Luterni nuk ishte kundër Kishës por ai kundërshtonte Kishën por kundërshtonte praktikën shkencore që propagandonte Kisha. Kështu që ai vendosi ti publikoi 95 tezat e tij dhe këto teza u përhapën brenda një kohe të shkurtër në tërë Evropën dhe ato gjetën mbështetje.

⁵Encyclopedia- **Paqja Augsburg dhe Liga Shmall Kall** ,Paqja Augsburg ishte një Traktat midis Charles V dhe forcave të Ligës Shmall Kall – një aleancë e Princave Luternian. Më 25 shtator 1555 në qytetin perandorak Augsburg zyrtarisht përfundoi lufta fetare ndërmjet dy grupeve dhe u bë ndarja ligjore e Krishterizmit të përhershëm në kuadër të Perandoris së Shenjët Romake. Paqja e vendosur mbi parimin **cuius regio, eius religio principle** (regjioni i kujt, feja e tij), i lejoi krerët e Selisë së Shenjët për të zgjedhur Luterianizmin ose Katolicizmin, u lejonte subjekteve, qytetarëve të cilët nuk pajtoheshin me zgjidhjen e princit të tyre u jepej një periudhë në të cilën ata ishin të lirë të emigrojnë në ajone të ndryshme në të cilat feja e tyre e dëshiruar ishte pranuar. Traktati i negociuar në emër të Charle's nga Ferdinandi vëllai i tij i dha statusin zyrtar Luternizmit brenda territoreve të Perandorisë së Shenjët Romake. Pra Paqja Augsburg ishte një bazë e përherëshme ligjore për egzistencën e Luternianizmit, dhe përmes Traktatit të Paqes arritën marrveshjen që Luternianizmi të egzistoj brenda Perandoris së Shenjët Romake. Dhe këtu përfundoi lufta 50 vjeqare. Paqja Augsburg shpëtoi Peran-

dhe në vitin 1648 Paqja e Vestfalisë⁶, marrëveshje formale që u nënshkrua për përfundimin e luftës 30 vjeqare, njëkohësisht ky është gurthemeli i konceptit të sovranitetit shtetëror⁷.

Sovraniteti për herë të parë, si term u formulua nga Zhan Bodin (Boudin 1530-1596), teoricien politik dhe këshilltar juridik i monarkisë franceze. Me fjalën sovranitet ai **nënkuptonte autoritetin më të lartë** (suprem) të qeverisjes së popullsisë dhe të **ushtrimit të pushtetit sovran** (të padiskutueshëm) si bazë themelore të çdo shteti. Një kuptim i tillë është në thelb të atij togfjalëshi që u quajt **sovranitet i brendëshëm**.⁸

Në shek. XVIII, me Revolucionin Francez u pranua nocioni i **sovranitetit të kombit**

Nocioni evolvoi deri në kuptimin më modern të tij të bazuar në ligje dhe fakte reale, dhe njihet si **sovraniteti ligjor. Më vonë, nocioni i sovranitetit të brendshëm** u plotësua edhe me **sovranitetin e jashtëm**.⁹

Koncepti i shtetit është që t'i mbroj qytetarët dhe t'u ofroj siguri nga agresionet e jashtëme dhe të siguroj që aktivitetet ekonomike të vazhdojnë. Ky është koncepti i **Minimalistëve**.

Koncepti me i gjerë thotë se shteti duhet të siguroj të mira për qytetarët siç janë: të drejtat e njeriut, edukimi dhe shëndetësia.¹⁰

Sovraniteti është njëri ndër elementet më të kontestuara të shtetit sepse që nga themelimi deri në ditët e sotme vazhdimisht ka qenë i atakuar nga veprimet e ndryshme të shteteve tjera dhe Organizatat Ndërkombëtare. Pra sovraniteti është i domosdoshëm për funksionimin e një shteti dhe vetëm sovraniteti e bënë një shtet të pavarur në aspektin e brendëshëm dhe të jashtëm për veprimet e tij.

Në fillim në sistemet e vjetra karakterizoheshin me kompetenca të shumëta ku autoriteti ishte i përqendruar mbi perandorët dhe prifterinjët, fuqia e kohës kishte dominim në shoqëri dhe në politike, më vonë u zbehën dhe fuqia kaloi mbi politikën.

Dalja në sken e sistemit shtetëror ndodhi nga dy faktorë kryesor: **kapitali dhe forca**.¹¹

Rritja ekonomike kishte nevojë për një burokraci qendrore që do të duhej t'i mblidhete taksat dhe kjo krijoi nevojën për krijimin e një force mbrojtëse siç është ushtria që mund të fuste në fuqi ligjet¹².

Nga Paqja e Vestfalisë si gurëthemel i sovranitetit shtetëror dolën dy lloje të sovranitetit: Sovraniteti i **jashtëm** dhe sovraniteti i **brendshëm**, kështu i përshkruan Hdeley Bull¹³.

Sovraniteti i brendshëm është kapaciteti i autoriteteve shtetërore për të qeverisur brenda kufive të tij. Sovraniteti i jashtëm vjen nga njohjet apo nga mirëkuptimet nga shtetet tjera për të drejtën e doin nga konflikte serioze të brendëshme për më shumë se 50 vjet. Ajo gjithashtu ka forcuar fuqinë e sunduesit territorial. Bavaria (Gjermania) kishte dal nga shek. XVI si një vend i ndarë fetar.

⁶Prof.Dr. Enver Hasani në librin e tij Vetvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavis. fq – 57 **Paqja e Vestfalisë 1648**, shënon pikën e nisjs për zhvillimin e sistemeve të shteteve moderne. Që nga kjo kohë e deri në revolucionet respektive amerikane dhe franceze, shoqëria ndërkombëtare u poq për të dal në fazën e shteteve kombe, ashtu siç i njohim sot. Në të njejtën kohë, studiuesit përgaditën edhe kuadrin mendor të këtij tipi modern të vetëvendosjes. Ajo përfshinte jo vetëm konceptin e shtetit komb, por edhe sferën e të drejtave njerzore individuale. Vetëvendosja në këtë kohë ishte rrjedhoj logjike e këtyre dy aspekteve të veprimtaris mendore, pra, e njohjes së të drejtave njerzore individuale dhe idesë mbi shtetin komb.

⁷Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq-186

⁸Filo Llambro: Historia për sistemet e qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003 fq - 16

⁹Po aty fq- 16

¹⁰Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.fq-107

¹¹Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq - 128

¹²Richmond, Oliver P., and Jason Franks. Liberal Peace Transitions: Between Statebuilding and Peacebuilding. Edinburgh: Edinburgh UP, 2009. fq-341

¹³www.britannica.com **Hdeley Bull** në vitin 1977 botoi veprën e tij Shoqëria Anarkike. Në këtë vepër Bull argumenton se: Pavarsisht nga karakteri anarkik në arenën ndërkombëtare ajo karakterizohet nga formimi i një sistemi jo vetëm të shteteve por një shoqëri të shteteve. Kërkesat e tij për një Etnitet të quajtur Shtet janë: se ato duhet të pretendojnë Sovranitetin mbi një grup të njerëzve në një territor të caktuar dhe se ai territor duhet të ketë një Qeveri. Sipas tij një sistem I shteteve mund të egzistoj pa qenë një shoqëri e shteteve.

pavarësisë dhe jo interferencës së një shteti tjetër.¹⁴

Sovraniteti i jashtëm shërbente për përcaktimin e vendit të komb-shtetit, e mardhëniet me shtetet tjera, e pozicionit në arenën botërore dhe mbi të gjitha në ç'masë njihet dhe pranohet nga shtetet tjera dhe organizmat me karakter ndërkombëtar. Ky tip i sovranitetit njihet edhe si **sovranitet kombëtar**.¹⁵

Megjithatë Paqja e Vestfalisë sot nuk mund të shikohet si një dokument që garanton dhe siguron sovranitetin e jashtëm shtetëror sepse njohja e sovranitetit të jashtëm nga shtetet tjera atëherë do të nënkuptohej që nuk duhet të ketë ndërhyrje legjitime në aktivitetet e një shteti tjetër.

Por është fakt që nga viti 1648 deri në vitin 1815 numri i shteteve u zvogëlua, pasi që shtetet e mëdha i absorbonin shtetet e vogëla.¹⁶

Shekulli i XVIII dhe veçanërisht shekulli i XIX u karakterizuan me daljen e shteteve nacionale duke zbatuar principe **cuius regio, eius relegio principle** (regjioni i kujt, feja e tij), që nënkupton respektimin e teritorit të një populli, këto principe datojnë që nga Ausburgët në vitin 1555¹⁷.

Në fakt shtetet më të fuqishme europiane e injoruan në masë të madhe nocionin e vetëvendosjes dhe sovranitetit e pacenushmërisë teritoriale, veçanërisht në kërkesat e tyre koloniale përmes okupimeve të egra e që nuk i'u referuan okupimit përmes **Cedimit** apo **Terra Nullis**.¹⁸

Në fund të shek. XVIII një numër i faktorëve ndikoi që nacionalizmi të bëhet një forcë në marrdhëniet ndërkombëtare si p.sh., ilimunizmi, zhvillimi i shtypit në shek.XVIII, Revolucioni Francez 1789 që ishte një kërkesë për të drejtën e popullit për të zgjedhur qeverinë e tyre dhe refuzimin e perandorive si njësi politike¹⁹.

Revolucioni Francez ishte një katalizator që mohonte iden e monarkut si një bartës kryesor i sovranitetit dhe favorizonin sovranitetin popullor. Nga ajo kohë shteti shihej si shërbëtor i popullit. Ky ishte edhe një zhvillim tjetër apo një shfaqje e re e shteteve nacionaliste ku sovraniteti u bë qëllim kryesor i kombeve.

Idea e Vetëvendosjes filloi të artikulohej nga Lufta e Parë Botërore të cilën e përkrahi edhe presidenti amerikan Wudrow Wilson.²⁰

Wilson në vitin 1933 në Konferencën e Shtatë Internacionale të shteteve amerikane në Montevideo, SHBA-të u pajtuan që të mos ndërhyjë në punët e brendshme të shteteve Latino-Amerikane.

Konventa e Montevideos solli edhe një grup kriteresh për shtetësin të cilat u bënë standarde univerzale²¹. Neni 1 i konventës së Montevideos e vitit 1933 thotë që shtetet si persona të së drejtës

¹⁴Prof.Dr. Enver Hasani në librin e tij Vetvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavis. fq - 59

¹⁵Filo Llambro: Historia për sistemet e qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003 fq - 16

¹⁶Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.fq-127

¹⁷Paris, Roland, and Timothy D. Sisk. The Dilemmas of Statebuilding: Confronting the Contradictions of Post-war Peace Operations. London: Routledge, 2009. fq-162

¹⁸Gruda, Zejnullah, E drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë,2003. fq, 148; **Terra Nullis** është lloj I Okupimit paqësor dhe njihet në të drejtën ndërkombëtare që nënkuptohet si tokë e askujt dhe shtetet përmes marrvëshjeve ndërkombëtare mund që ta marrin nënë sovranitetin e tyre këtë tokë. Mirëpo ky territor duhet të siguroar që nuk është nën sovranitetin e asnjë shteti.

¹⁹Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq-253

²⁰Encyclopedia -**Woodrow Wilson** nga viti 1913 deri në vitin 1921 ishte President I SHBA-ve. Wilson në vitin 1919 mori çmimin Nobel për Paqe. Presidenti Wilson gëzon respekt të madh tek populli shqipëtar për rezistencën që bëri ndaj mos coptimit të mëtejshëm të Shqipëris dhe njohjen e pavarësisë së saj. Ai ishte një Liberal dhe një kundështar I madh I luftës dhe kontriboi shumë ne formimin e Lidhjes së Kombeve. Ai dha një kontribut në Traktatin e Varsajës duke kontribuar në paqe me 14 pikat e tij të famëshme.

²¹Gruda, Zejnullah, Manual Diplomatik, Prishtinë , 2009, fq 30. **Konventa mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve (Montevideo, 1933)** e lidhur midis shteteve amerikane, në nenin 1 përcakton se shteti si subjekt I së drejtës ndërkombëtare duhet të ketë : a) Popullësin e përherëshme, b) territorin e caktuar, c) qeverin, dhe ç) aftësin për të hyrë në marrdhënie me shtetet tjera. Këto kushte i kanë përmendur edhe Projekti i Institutit

ndërkombëtare duhet të kenë këto elemente:

a) popullësin e përherëshme, b) teritorin e definuar, c) qeverin, d) kapacitete për të hyrë në mardhënie me shtetet tjera²².

Këto elemente merren si bazë edhe në ditët e sotme për të njohur një shtet të ri, si shtet të pavarur dhe sovran.

Sipas të drejtës ndërkombëtare elementi kryesor i shtetit është sovraniteti, vërtet çdo shtet në gjendje normale duhet patjetër të ketë sovranitetin e plotë shtetërorë që mund të jetë si palë në marrdhëniet ndërkombëtare.

Në të kaluarën jo të gjitha shtetet kishin sovranitet të plotë shtetëror në këtë grup të shteteve hynë: shtetet që kanë qenë nën suzeremin ose nën protektorat të ndonjë shteti tjetër, gjithashtu edhe shtete që bjënë pjesë në federat nuk kanë sovranitet të plotë shtetëror.

Nga pikëpamja e shkallës së sovranitetit të tyre shpesh shtetet janë ndarë në shtete sovraane dhe gjysmësovraane, mirëpo ka autorë që e hedhin poshtë këtë ndarje të sovranitetit dhe thonë se shteti ose është sovran ose nuk është sovran.²³

Disa autorë e quajnë sovranitetin si një të keqe që është burim i të gjitha të kqijave në arenën ndërkombëtare, si „armiku i egër në paqen ndërkombëtare”, si „armiku i egër i paqes në kohën tonë”²⁴.

Sovraniteti shtetëror tashmë është një çështje e debatueshme në komunitetin ndërkombëtar. Dihet rëndësia e sovranitetit shtetëror në krijimin e kushteve brenda një vendi, sipas gjykimit të qeverisë së atij vendi. Mirëpo, konfliktet e brendshme shkaktojnë po aq plagë dhe shkatërrime sa edhe konfliktet midis shteteve.

Mund të thuhet se luftërat civile sjellin më shumë vuajtje se luftërat ndërkombëtare, për shkak të urrejtjes dhe egërsisë së tyre. Kjo ndodh sepse në një luftë civile kundërshtarët e njohin mirë njëri-tjetrin.²⁵

Pikëpamjen më të skajshme për sovranitetin e ka shprehur autori amerikan M. Adler me këto fjalë „shkaku i vetëm i luftrave është anarkia. Anarkia lind kudo që njerëzit apo kombet përpiqen të jetojnë së bashku, pa hequr dorë nga sovraniteti. Sovraniteti i kombit dhe anarkia janë dy gjëra të pandara, çmimi që paguhet për sovranitet është lufta.”²⁶

Sovraniteti shtetëror daton qysh në kohëra të herëshme, mirëpo gjatë gjithë kohës sovraniteti pësoi ndryshime duke kalu nëpër faza të ndryshme, si: Paqja e Augsburgëve, Revolucioni Borgjez Francez, Paqja e Vestfalisë dhe pikërisht kjo paqe vendos themelet e sovranitetit të shtetit modern. Në këtë drejtim ka kontribuuar gjithashtu edhe Konventa e Montevideo-s duke përcaktuar çartë elementet e shtetit, të cilat elemente edhe sot janë bazë për njohjen e një shteti të pavarur.

Sovraniteti është elementi kryesor i shtetit, një shtet në kushte normale duhet ta ushtron sovranitetin mbi teritorin e vet pa asnjë ndërhyrje nga jashtë. Kohën e fundit kem pa qartë se po ripërcaktohet sovraniteti i shtetit nga faktor të ndryshëm si psh: të drejtat e njeriut, terrorizmi, globalizmi, zhvillimi ekonomik etj

Vëshhtërsit e ruajtjes së sovranitetit shtetëror

Jemi dëshmitar të asaj se sot në botën moderne dhe në Rëndin e ri Botëror dhe me zhvillimin e globalizmit, krijimit të Organizatave dhe institucioneve tjera ndërkombëtare, sovraniteti shtetëror po zbehet dita e ditës, sepse një pjesë e konsiderueshme e sovranitetit kalon nëpër intucionet apo në organizatat nërkombëtare.

Në këso bote, konceptet stabilizuese të sovranitetit shtetëror, të unitetit territorial dhe të mos

Amerikan i së Drejtës Ndërkombëtare (1926) dhe Projekti I Komisionit Interamerikan I Juristëve (1927).

²²Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.fq-103

²³Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010 fq.106

²⁴Po aty, fq.108

²⁵Hans Peter Gasser, E drejta Ndërkombëtare Humanitare, Dhjetor 2000, f.26

²⁶M. Adler: Ordering International Politics: Identity, Crisis and Representational Force. fq, 287

ndërhyrjes janë dëmtuar shumë, gjë që na le në një pozitë më pak të parashikueshme.

Një nga elementet më të rëndësishme të nocionit të sovranitetit është edhe sovraniteti territorial, që do të thotë se pushteti më i lartë dhe i pa ndarë i një shteti mbi territorin e tij. Çdo akt (i një anshë) që cenon pushtetin ekzekutiv të një shteti mbi territorin e tij, është një shkelje e së drejtës ndërkombëtare.²⁷

Parimi i sovranitetit territorial kërkon që asnjë shtet të mos tentoi të kryej akte juridiksioni në territorin e një shteti tjetër. Në këtë kuptim është shkelje e sovranitetit shtetëror nëse një shtet tenton që të dërgoi agjent në një shtet tjetër për kapjen apo arrestimin e ndonjë individ, i cili konsiderohet se ka kryer ndonjë veprë kriminale në shtetin tjetër.

Fundja, vetë identiteti i shtetit kombëtar - njësisë bërthamë të sistemit klasik, Vestfalez po sfidohet nga ato popullata etnike që nuk janë më të gatëshme që t'i pranojnë kufijtë shtetëror të cilët i konsiderojnë të padrejtë.²⁸

Organizatat Ndërkombëtare përmes mekanizmave dhe legjislacionit në fuqi mund të obligojnë shtetet dhe institucionet shtetërore që të sillen sipas të drejtës ndërkombëtare dhe në raport me rezolutat dhe Kartën e OKB –së pasi që me nënshkrimin e Kartës së OKB-së e drejta ndërkombëtare është në eperësi ndaj të drejtës së brendëshme dhe se shtetet janë të obliguara t'i zbatojnë këto dokumente që dalin nga vendet anëtare demokratike të këtyre Organizatave.

Kuptohet që çdo shtet ka të drejtë të zgjedh vetë, në mënyrë të pavarur, qështjen nëse duhet apo jo të hyjë në organizata ndërkombëtare apo të hyjë në marrveshje ndërkombëtare me shtete tjera.

Secili shtet është sovran në zgjidhjen e kësaj qështje, mirëpo me hyrjen e shtetit në këto instanca ndërkombëtare për shtetin krijohet detyra dhe përgjegjësi, ku shteti nuk mund t'i shmanget këtyre përgjegjësisë. Shkelja ose heqja dorë nga detyrimet që ka marrë një shtet në arenën ndërkombëtare, nuk mund të justifikohet me pretekstin e sovranitetit të tij.

Sovraniteti nuk duhet të nënkuptohet në asnjë mënyrë nuk do të thotë të cenohen normat e së drejtës ndërkombëtare e as të merren nëpër këmbë interesat e të tjerëve²⁹.

Me qenë se shteti është akter kryesor në politikën ndërkombëtare, atëherë duhet të krijohet një frymë bashkëpunimi në mes shteteve dhe në raport me organizatat ndërkombëtare në mënyrë që të jenë më të përgjegjshme ndaj veprimeve të tyre e mos të fshihen pas sovranitetit shtetëror në veprimet e tyre kundër ligjore.

Rastet me të shpeshta të fshehjes pas sovranitetit ndodh tek federatat ku njësit federative nuk i japin llogari bashkësisë ndërkombëtare por federata është ajo që në mënyrë të pamvarur përfaqëson apo bartë sovranitetin e shteteve përbërëse.³⁰

E drejta e Sovranitetit si e drejtë absolute, ka qenë e përkrahur rregullisht nga shtetet imperialiste me qëllim që të shërbej si arsytim për veprimet e tyre që kanë në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare dhe të një rendi ndërkombëtar dhe objektivisht ka hapur mundësin e mohimit të së drejtës ndërkombëtare dhe një rendi ndërkombëtar.³¹

Sovraniteti paraqitet si fenomen i së kaluarës, i cili e ka humbë vlerën në ditët e sotme me krijimin

²⁷Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010 fq - 107

²⁸Weller, Marc:Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës Për Pavarësi. Prishtinë: Përktheu nga origjinali anglisht Flaka Suroi, Koha, 2009 fq- 204

²⁹Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq - 179

³⁰Gruda, Zejnullah: E drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, 2009, fq. 124, Hell, A,W: Tratise on International Law, Salihu, Kurtesh: E Drejta Kushtetuese, Prishtinë, 2004. **Federata** është trajtë e shtetit të përbërë e cila paraqet një lidhje shumë më të ngushtë në mes shteteve. Federata është bashkësi e më shumë njësisive (shteteve, vendeve) dhe krijohet me akt publik të brendëshëm.(Kushtetut). Federata të tilla kemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u krijuan si federat me kushtetutën e vitit 1787. Bashkimi Sovjetik u krijua si federat në dhjetor të vitit 1922, Zvicra është federat nga viti 1848, gjithashtu ishte edhe ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavis ku pjesë përbërëse e saj ishte edhe Kosova. Karakteristik të Federatave është se pjesët përbërëse të federatës bartin një pjesë të sovranitetit ndërsa përfaqësimin e jashtëm dhe Sovranitetin në aspektin ndërkombëtar e bartë federata.

³¹Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom

e organizatave ndërkombëtare, me shtimin e konsiderueshëm të lidhjeve midis popujve dhe të vendeve me shtimin e ndërvartësis shteteve, kjo është e diskutueshme nëse sovraniteti është pengesë kryesore për një rend më humanë në botë. Këto raste në të cilat shpërthyen në vitet 1990 protesta më e madhe morale, gjenocidit të Ruandës në vitin 1994 dhe masakrën në Srebrenicë në vitin 1995, çoi shumë të bëjë thirrje për një ndryshim në statusin e sovranitetit. Është e paqartë, megjithatë, se çfarë ndikojnë sovranitetin ushtrohet në të dyja këto raste.

Bën thirrje për një zvogëlimi të sovranitetit në dritën e këtyre incidenteve, do të kishte kuptim vetëm nëse aktorët e jashtëm nuk ka ndërhyrë, sepse ata nuk duan të thyejnë ligjin ndërkombëtar. Kjo, megjithatë, nuk ishte rasti. Reagimi i paefektshëm i bashkësisë ndërkombëtare për të dyja rastet që rrjedhin ndoshta nga mungesa e interesit dhe vullnetit në emër të atyre me kapacitet për të ndërhyrë sesa ndonjë angazhim të drejtën ndërkombëtare.

Kodifikimin e barazisë sovrane dhe paprekshmërinë në Kartën e OKB-së ka qenë duke konceptuar si një zhvillim progresiv për aq sa ajo përbënte një mjet me të cilin të drejtat më parë pothuajse ekskluzivisht janë gëzuar nga fuqitë perëndimore.

Ndryshimet e Sovranitetit Shtetëror në kohën moderne

Me zhvillimin dhe krijimin e organizatave ndërkombëtare dhe regjionale, sovraniteti i shtetit po bartet në këto organizata dhe se këto organizata kanë qasje mbi shtetin dhe luajnë një rol jashtëzakonisht të madh dhe të rëndësishëm në sovranitetin e shteteve.

Ishin disa faktorë relevant që ndikuan në përcaktimin dhe ndryshimin e sovranitetit të shtetit në kohën moderne siç janë: të drejtat e njeriut, zhillimi ekonomik dhe terrorizmi, faktorë të cilët ndikuan që sovraniteti shtetëror të pësojë ndryshime thelbësor në kohën moderne.

Sovraniteti shtetëror është me interes të madh për studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe është subjekt i diskutimeve të shumëta. Natyra e tij është vendosur në zemër të sistemit gjeo-politik. Natyra e sovranitetit shtetëror ka ndryshuar në periudhën pas Luftës së Ftohtë për të pasqyruar një shoqërie në ndryshim global dhe se kjo është për të mirën e politikës globale dhe qytetarëve.³²

Në vitet e 90-ta ishim dëshmitarë të një debati të fuqishëm për kuptimin e fjalës sovranitet.

Akterët ndërkombëtar përfshir Sekretarin e OKB-së si dhe disa qeveri dhe institucione nërkombëtare si Këshilli i Sigurimit i OKB-së të cilët ishin protagonist kryesor të një debati i cili përfshinte autorizimin e Këshillit të Sigurimit për përdorimin e forcës së armatosur në disa raste ku popullsia vuante shumë nga mizorit e shteteve të tyre³³.

Së fundi globalizimi edhe pse ka ndryshuar natyrën e sovranitetit shtetëror pas Luftës së Ftohtë, duke u fokusuar në lëvizje nga një statisticien në sistemin policentrik të qeverisjes globale dhe ndikimin gërryes se kjo ka pasur në konceptet tradicionale të sovranitetit të shtetit në çështjet financiare dhe ushtarake. Duke bërë kështu që të theksojë se sovranitetin shtetëror ka ndryshuar me të vërtetë në periudhën pas Luftës së Ftohtë dhe se ky ndryshim ka provuar të jetë pozitiv.

Jemi dëshmitar të kohës se e dehta ndërkombëtare ka evoluar dhe sot jemi në një situat të re, por nuk jemi ithëtar të asaj se duhet të braktisim diskursin e sovranitetit në mënyrë që të përceptojnë dhe konceptojnë këto ndryshime që po ndodhin çdo ditë.

Mund të devijonim natyrën bashkëkohore ndërkombëtare dhe shoqërinë politike, në qoftë se ne supozojmë se një e drejtë kushtetuese me qëllime kozmopolite ligjore³⁴ tashmë ekziston, e cila ka

dom (2003 fq - 186

³²Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy. : Princeton UP, 1999 fq, 142

³³Weller, Marc:Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës Për Pavarësi. Prishtinë: Përktheu nga origjinali anglisht Flaka Suroi, Koha, 2009, fq- 206

³⁴Encyclopedia **Kazmopolitanizmi** është ideologji që deklaroi se I gjithë njerëzimi I takon një komuniteti të vetëm, mundësisht duke u bauer në vlerat morale të përbashkëta. Kozmopolitanizmi është në kontrast me teorit komunitare, në veçanti me ideologjit e patriotizmit dhe nacionalizmit. Kozmopolitanizmi mund të imponoj llojet e qeverive globale apo ajo mund vetëm t'i referohet mardhënieve morale, ekonomike, dhe politike midis shteteve apo individëve me kombësi të ndryshme. Kozmopolitizmi është teori borgjeze reaksionare, që përpjet të shuaj veçorit e ndjenjat kombëtare, duke quajtur për atëdhe gjoja gjithë botën, duke përçmuar vlerat

zëvendësuar ose duhet zëvendësuar të drejtën ndërkombëtare dhe parimet e saj kryesore të barazisë sovrane, territoriale, integritetit dhe mosndërhyrjes si dhe juridiksionin e brendshëm, nëse ne interpretojmë doktrinën në zhvillim “Ndërhyrja humanitare” si zbatim i kësaj të drejte, do të jemi në rrezik duke bërë rolin e perandorëve për projekte perandorake.

Argumenti kryesor që ne sot përballemi ndaj një zgjidhje është se: ne ose mund të zgjedhim për të forcuar të drejtën ndërkombëtare duke e rifreskuar atë, duke e bërë eksplicite konceptin e sovranitetit mbi të cilin është bazuar dhe tani duke treguar se kjo është në përputhje me parimet e kozmopolit të natyrshëm dhe të drejtat e njeriut, ose ne mund të braktisim parimin e barazisë sovrane dhe rregullat aktuale të së drejtës ndërkombëtare për hir të drejtave të njeriut, duke hequr dorë nga një pengesë e rëndësishme në përhapjen e projekteve perandorake dhe përpjekjet rajonale.³⁵

Shoqëria e shteteve e ngulitur brenda institucioneve ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare, të cilat kanë gjithashtu rëndësinë e elementeve kozmopolite dhe primeve ligjore mbi të cilat mbëhtetet diskursi i transnationalizmit dhe qeverisjes demokratike.

Kjo qasje e kozmopolit ligjor është e ndërlikuar potencialisht nga një projekt radikal i dallueshëm nga perandori dhe fuqia, deri tek demokratizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe implementimi në praktik të drejtës ndërkombëtare bashkohore. Kjo kërkon forcimin e institucioneve mbikombëtare, reforma ligjore formale dhe krijimin e një rregullative globale e ligjore që mbron si sovranitetin dhe barazinë e shteteve në bazë të një rishikimi të konceptit të sovranitetit dhe të drejtave të njeriut.

Sipas teoricienëve ligjor, drejtësia pa sovranitet shtetëror është paradoksi për reformimin dhe demokratizimin e sovranitetit të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët kanë konfiguruar brenda një bote efektive institucionet ndërkombëtare dhe të një të drejtë të përditësuar ndërkombëtare, për lindjen e një “sundimi të ligjit” global dhe përbën një pjesë të rëndësishme të një projekti për perandori gjithë botërore të një sistemi.³⁶ Pa një rregull globale që mbron sovranitetin, si dhe të drejtat e njeriut, çdo diskutim për të drejtën e “kozopolit”, veçanërisht dhe mbi të drejtën e supozuar për të ndërhyrë ushtarakisht për të mbrojtur të drejtat e njeriut, është e natyrshme të dyshojmë.

Për Schmitt³⁷ dhe pasuesit e tij bashkëkohore, çdo version të së drejtës ndërkombëtare artikulumit univerzal, parimet, dhe çdo formë të mundshme kozmopolitizmit, shuma për formalizëm të zbrazët, utopizmit të papërgjegjshme, dhe një grup i platitudes moraliste cinike përdoret që t'i mbulojnë ofertat, fuqinë e një superfuqie ose të një fuqie të madhe kundër disa të dobta.

Kemi dëgjuar për shumë kohë se sovraniteti shtetëror është jo i rëndësishëm, karakteri ndërkombëtar i “rreziqeve”, nga problemet ekologjike deri tek terrorizmi, përfshirë dhe armët e shkatërrimit masiv, thekson mungesën e dukshme të kontrollit të kombit modern mbi territorin e vet, kufijtë dhe rreziqet që ballafaqohen qytetarët e tij.

Për më tepër, vendimet kryesore politike dhe ligjore janë duke u bërë përtej fushëveprimit të legjislativave kombëtare. Një shumëllojshmëri rrjetesh organizatash mbikombëtare, transnacionale “Autoritete globale private” dhe trans-shtetërore janë duke u angazhuar në rregullimin dhe zbatimin e bërë duke anashkaluar shtetin.³⁸

Vërtetë shkëputja e dukshme e ligjit nga territorialiteti i shtetit sugjeron se kjo e fundit ka humbur anën ligjore të saj, si dhe sovranitetin politik. Ky rregull risi i së drejtes ka nxitur

e mëdha të kulturave e të traditave kombëtare dhe duke u mohuar popujve të drejtën për të jetuar të lirë e të pavarur në emër gjoja të „bashkësisë së njerëzve të gjithë botës”, të shtetit „botëror”, me qëllim që të përligj nënshtrimin e sundimin e popujve.

³⁵Hehir, Aidan. Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society Hardcover, 2008 fq -162

³⁶Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy. : Princeton UP, 1999

³⁷www.stahlshmidt-inc.com Oliver Jan Shmitt lindi në Basel me 15 shkurt 1973. Është anëtar i Akademisë së Shkencave Austriake.Shmitt shkroi për Skënderbeun dhe bëri një biografi kritike rrëth jetës së tij.

³⁸Kuqi, Hajredin and Bilalli,Asllan: E Drejta Ndërkombëtare Private: Prishtinë, 2009 **Autoritete globale private** janë Kompani ndërkombëtare që fushveprimaria e tyre shtrihet në shumë shtete dhe janë ndikues të mëdhenjë në politikat e shteteve si dhe te organizatave ndërkombëtare. Rastin e fundit kem Britanin e Madhe e cila paralajmëoi tërheqjen nga Bashkimi Evropian dhe bizneset dhe kompanit menjeher reagues kundër kësaj ideje.

daljen nga një grup i kërkesave në lidhje me transformimin e së drejtës ndërkombëtare. Nëse ligji po shmanget nga monopoli i shtetëve, atëherë pamjet standarde të drejtës ndërkombëtare si ligj që shtetet bëjnë nëpërmjet traktateve, ose miratimi përmes praktikës së gjatë (custom), atëherë duhet të rishikohet sistemi ndërkombëtar i të drejtës. Shfaqja e të drejtave të njeriut bazohet në konsensus dhe me sa duket kjo nënkupton ligjin global kozmopolitan të vullnetit të shtetëve dhe të traktatëve të tyre ndërkombëtare. Teoricienët ligjor janë shtuar në kohën e fundit për t'u përballur me sfidat që sot preokopohet njerëzimi dhe shtetet. Idetë për pluralizëm ligjor dhe kushtetues, konstitucionalizmi shoqëror-social, rrjetet transnacionale qeveritare, kozmopolitizmi i të drejtave të njeriut zbatohen nga ndërhyrja humanitare dhe kështu me radhë janë të gjitha përpjekjet për të kuptuar rendin e ri botëror ligjor që është duke u shfaqur para syve tonë. Ideja e përgjithshme është se bota po përjeton një lëvizje të ligjit kozmopolit, të cilit ne nuk do të i kuptojmë ose s'do jemi në gjendje për të ndikuar në to, në qoftë se ne nuk braktisin diskursin e sërëvjetruar dhe tashme të pa zbatueshëm të sovranitetit shtetëror. Debatet nga ky këndvështrim janë rreth kuptimit të rendit të ri botëror. Pavarësisht dallimeve të tyre, ajo që duket e qartë për ata që kërkojnë të ndihmojnë kozmopolitizmin ligjor është se bisedat rreth sovranitetit dhe format e vjetra të drejtës ndërkombëtare publike bazohen në paradigmen e sovranitetit Vestfalian dhe të të gjitha ligjet ndërkombëtare.

Cenimi i Sovranitetit Shtetëror si pasojë e Intervenimeve Humanitar

Koha po e dëshmon se është shumë e nevojshme dhe imediate që të ripërcaktohet funksioni i sovranitetit shtetëror duke pasqyruar se me zhvillimin e demokracisë, bashkësia ndërkombëtare ka filluar të ndërgjegjësohet dhe të drejtat e njeriut t'i ketë primare dhe të garantojë ato në çdo shtet dhe në çdo kohë, ku në rastet e fundit është dëshmuar se është një gardian i mbrojtjes së tyre.

Përderisa shtete të ndryshme fshiheshin pas sovranitetit të tyre, në ditët e sotme ka filluar që kjo fshehje pas petkut të sovranitetit të zbehet, sepse bashkësia ndërkombëtare dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare janë bërë ruajtëse të paqes dhe sigurisë globale, duke i kushtuar një rëndësi të madhe të drejtave dhe lirive të njeriut.³⁹

Intervenimi Humanitar përkufizohet rregullisht si përzjerje e dhunëshme në punët e shtetit tjetër, me qëllim që të ruhet ose të ndërrohet gjendja ekzistuese.

Gjithashtu ekziston edhe parimi i mos-intervenimit që mbështetet në parimin e sovranitetit dhe të vetëvendosjes të cilat janë përgjithsisht të pranuar në të drejtën ndërkombëtare, por këto parime të sovranitetit nuk mund të shërbejnë më si mbrojtje nga jashtë dhe kjo mund të rrezikojë në qoftë se shtetet nuk përmirësojnë veprimet dhe trajtimin ç'njerëzor ndaj qytetarëve të vet.

Sipas të drejtës ndërkombëtare çdo popull dhe çdo shtet ka të drejtë ta bëjë rregullimin e brenëdshëm pa presionin e asnjë shteti tjetër por me kusht që t'i respektojnë parimet dhe normat që dalin nga e drejta ndërkombëtare si dhe rezolutat e organizatave ndërkombëtare.

Shtetet mund të caktojnë dhe ta përmirësojnë statusin e vet politik, ekonomik dhe ideologjik, lirisht dhe pa kurrëfar presioni ose përdorimi të forcës nga shtetet e tjera.

Ndërsa sipas disa autorëve të cilët ende edhe në ditët e sotme mbrojnë qëndrimin e tyre se sovraniteti i shtetit është i paprekshëm dhe sipas tyre çdo veprim, me të cilin cenohet parimi i sovranitetit dhe i vetëvendosjes është veprim që bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe si i tillë është dhe merret si keqpërdorim i forcës.⁴⁰

Ata ende nuk po mund të pajtohen se e drejta ndërkombëtare duke përfshi edhe sovranitetin shtetëror ka pësuar ndryshime pas intervenimeve humanitare dhe pas zhvillimit ekonomik dhe të drejtave të njeriut që detyrimisht kanë marrë një karakter ndërkombëtar.

Intervenimi Humanitar ishte zgjidhja e vetme për të penguar mizorit shkatërrimtare të diktatorëve dhe pamundësimin e arritjes së qëllimeve të tyre që të qëndrojnë në pushtet duke i shtyp paknaqësit e njerëzve.

³⁹Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, "E drejta ndërkombëtare humanitare", Ed. Pedone, dhjetor 2000, f.q. 127

⁴⁰Gruda, Zejnullah. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Prishtinë, 2003 fq -97

Një rritje e shpejtë në ndërhyrjen humanitare dhe ndikimi i saj mbi sovranitetin shtetëror, duke përfshirë lëvizje larg nga nocioni realist i sovranitetit shtetëror në një pozicion gjithnjë e më moral e nxitur nga një lëvizje në rritje globale të shoqërisë civile si dhe një përkushtim dhe një siguri të ofruar nga NATO⁴¹ siç ishte rasti i intervenimit në Kosovë dhe së fundi në Libi, dëshmuar edhe njëherë se të drejtat e njeriut kishin një trajtim të veçantë nga bota demokratike.

Ishin të neveritëshme ngjarjet që ndodhën në këto vende prandaj u desh që të gjindet një bazë ligjore, të parandalohen këto mizori, dhe të krijohet një bazë ligjore e cila do të shërbej edhe për rastet e tjera si dhe do të jetë një vetëdijesim për shtetet me sisteme autoritare.

Shtetet sovrane ligjërisht janë të barabarta-”aktorë” në skenën ndërkombëtare, duke mos pranuar asnjë autoritet, brenda dhe jashtë. Shtetet kanë të drejtën e vetëmbrojtjes dhe atë të mosndërhyrjes nga shtetet e tjera sipas autorit Brown. Ai citon se është i gabuar supozimi se natyra e sovranitetit shtetëror nuk ka ndryshuar me kalimin e kohës, por atributet kryesore të Paqes së Vestfalisë duhet të mbeten po aq të rëndësishme edhe sot, duke pas parasysh se janë të kodifikuara në kuadër të Kartës së Kombeve të Bashkuara, neni 2 (1) duke deklaruar se “Organizimi është i bazuar në parimin e barazisë sovrane të të gjithë anëtarëve të tij “(Kombet e Bashkuara).

Qëllimi i krijimit të organizatave ndërkombëtare ishte pikërisht që një pjesë e sovranitetit shtetëror të bartet në këto organizata, shtetet anëtare janë të obliguara t’i përmbushin detyrat dhe detyrimet që dalin nga rezolutat që nxirren në këto organizata.

Stephen Krasner shpjegon se ekzistojnë tri mënyra të cilat përdorin termin e sovranitetit, së pari sovraniteti i të qenurit në familje e cila ka të bëjë me përbërjen dhe efektivitetin e autoritetit publik brenda shtetit. Së dyti, sovraniteti ndërvarësisë, efektivitetin dhe aftësinë e shtetit për të vëzhguar dhe monitoruar se çfarë po vjen dhe si do të dalë nga kufijtë e tij, sovraniteti ligjor ndërkombëtar, është njohja nga shtetet, të gjitha shtetet e reja që ekzistojnë dhe statusi i tyre duhet të jetë Sovran.⁴² Fundi i Luftës së Ftohtë bëri drejtuesin e pushtetit “hegjeonist të ri botëror”, Shtetet e Bashkuara dhe Presidenti George Bush, bëri që të çojë botën e re unipolare me vizionin e tij të një “Rendit të Ri Botëror”. Megjithatë Lufta e Ftohtë ka mbetur në prag të saj, shtetet e dobëta dhe të dështuara që shtrihen nga Afrika e Veriut, Ballkani, Lindja e Mesme në Azinë Jugore”, përveç që nuk kanë lëvizur nga të qenurit ndër-shtetëror, ato edhe sot vazhdojnë të influencohen nga ish gupimet e mëdha shtetërore.⁴³

Fundi i Luftës së Ftohtë i lejoj Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të përmbushur veprimtarin e tij, pa besnikëri ideologjike dhe arsyetimin e Luftës së Ftohtë, si luftë strategjike që ndikoj në vendimin e saj.

Theksuar nga fakti se gjatë viteve 1990 Këshilli i Sigurimit autorizoi rreth 40 misione paqeruajtëse, këto misione patën për qëllim ndërmjetësimin ndërmjet shteteve ndërluftuese dhe në kontributin e tyre për paqe dhe shtet ndërtim. Deri në fund të Luftës së Ftohtë shtetet kishin mbajtur një qëndrim realist, duke preferuar të zgjidhin trazira të brendshme pa ndërhyrje të jashtme, por kjo ishte për të ndryshuar vetëdijen në rritje globale të krimeve kundër njerëzimit dhe detyrimin moral të sistemit ndërkombëtar për të vepruar pavarësisht nga sovranitetit shtetëror.

Ky entuziazëm për mbrojtjen e popujve të drejtave të njeriut, një morali të përbashkët global dhe integrimin e tij në skenën politike globale, është theksuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Boutros Boutros-Ghali i cili në vitin 1992 tha se “koha për sovranitet absolut dhe ekskluzive megjithatë ka kaluar”⁴⁴. Teoria e tij asnjëherë nuk u shoqërua me realitetin.

Organizatave ndërkombëtare kanë një përgjegjësi për të mbrojtur qytetarët e shteteve të tjera sovrane

⁴¹Encyclopedia **Aleanca Veriatlantike NATO** është Organizatë regjionale e cila u formua më 4 prill 1949 në Washington D.C. Në fillim kishte 10 anëtar ndërsa sot kjo organizatë numëron 28 shtete anëtare. Qëllimi i themelimit të kësaj organizate ishte mbrojtja e Evropës Përendimore nga rreziku që i kanosej nga BRSS-ja, dhe sot lirisht mund të konsiderohet fuqia më e madhe ushtarake në rruzullin tokësor.

⁴²Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy,: Princeton UP, 1999 fq - 138

⁴³Hehir, Aidan. Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society Hardcover, 2008 fq -190

⁴⁴Encyclopedia **Boutros Boutros Ghali** ishte sekretari i gjashtë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara nga janari i vitit 1992 deri në dhjetor të vitit 1996. Gjatë mandatit të tij si Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara

nga e keqja, kjo u bë e përhapur në epokën pas Luftës së Ftohtë, me një rritje të retorikës së të drejtave të njeriut. Kjo u ndikua nga një zhvillim "Global i Shoqërisë Civile" e frymëzuar nga kozmopolitanizmi dhe nocionin e tij për një komunitet botëror të qytetarëve të barabartë, për ndarjen e një morali të vetëm. Kjo rritje në një shoqëri globale civile sinjalizoi një lëvizje larg nga nocioni i sovranitetit realist, interes shtetëror dhe jo-ndërhyrje, për një pikëpamje njerëzore, normative ku të drejtat në të cilat të drejtat e individit lënë mënjane ato të shtetit. Në këtë pikë, mos lejimi i shprehjes dhe gëzimit të të drejtave elementare të qytetarëve nga ana e shtetit nënkupton shkelje esenciale të të drejtave të njeriut. Autorë të tillë si Thomas Weiss⁴⁵ kanë pohuar se diskursi normativ ishte aq i suksesshëm në respektimin e të drejtave të njeriut së bashku me katër karakteristikat e sovranitetit të territorit të shtetit, autoritetit dhe respektimi të të drejtave të popullsisë.⁴⁶

Kombet e Bashkuara u përgjigjën siç duhet duke futur rezoluta që përshkruajnë reagimin ndërkombëtar dhe ndërhyrjen humanitare. Rezoluta A/RES/60/1 tregon se në qoftë se një shtet nuk arrin të mbrojë qytetarët e tij atëherë bashkësia ndërkombëtare, me miratimin e Këshillit të Sigurimit, do të ndër marrë veprime kolektive, në një kohë caktuar dhe në mënyrë vendimtare.

Ndërhyrja në Kosovë nga NATO (1999) pa një rezolutë të Këshillit të Sigurimit, venë në pah theksin e efektit që ndërhyrja ishte humanitare në sistemin ndërkombëtar, duke çuar në nocionin e moralit dhe duke zëvendësuar ligjin ndërkombëtar.⁴⁷ Shoqëruar me parimin e një shteti, kjo thekson degradim të ngadaltë ndryshimin e konceptit Vestfalian dhe sovranitetin ndërkombëtar ligjor dhe të drejtën e mosndërhyrjes kur të përballen me një epokë globale në ndryshim politik. Kjo është për ruajtjen e njerëzimit dhe mund të konsiderohet si levizje pozitive në të drejtën ndërkombëtare.

Si rezultat i një shkelje të ndërvarësisë familje dhe sovranitetit Vestfalian, reflektohet edhe nga komentet e Kombeve të Bashkuara, nga ish Sekretari i Përgjithshëm Kofi Anan i cili ka thënë: "sovranitetit shtetëror, në kuptimin e tij më themelore, është duke u ripërcaktuar nga forcat e globalizimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar" (Kombet e Bashkuara, 1999). Kjo lëvizje drejt një pozite shumë më pluraliste e njohur se ka pasur shumë aktorë në skenën botërore që mund të ndikojnë në ndryshime të politikës botërore. Këto përfshijnë qeveritë, kompanitë transnacionale (TNCs), të tilla si Microsoft, organizatat ndërqeveritare (ONQ), të tilla si Kombet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, si dhe ndërkombëtare jo-qeveritare (OJQ ndërkombëtare), të tilla si Amnesty International, Paqë e Gjelbër e tjera. Të gjitha këto kanë ndikuar në mendimin politik dhe vendim-marrës në disa probleme në mes të aktorëve ndërkombëtar.

Kjo rezultoi me Bashkimin Evropian në mënyrë efektive në menaxhimin e ekonomive të këtyre shteteve sovraane, zgjedhja e udhëheqësve nga qytetarët evropian në kundërshtim me parimin e sovranitetit të brendshëm, ndërkombëtar ligjor dhe Vestfalian.⁴⁸

Një tjetër efekt i globalizimit mbi sovranitetin shtetëror ka qenë natyra e ndryshimit të zhvillimit të luftrave, që nga konfliktet ndërmjet shteteve brenda territoreve të përcaktuara, të konflikteve midis shteteve sovraane dhe ideologjive të organizatave terroriste të nxitura nga kultura të tilla siç është Al Kaida.

Më parë shumica e organizatave terroriste janë vendosur në një shtet të vetëm. Tani grupet terroriste kanë anëtarë që rrjedhin nga shoqëritë e gjithë botes dhe veprojnë globalisht. Shkaku i levizjeve të tilla terroriste mendohet nga disa studiues, të jenë përhapja e idealeve perëndimore liberale dhe materializmi saj, e cila nga ana tjetër ka lënë disa ndjenja, kultura të tjera të kërcënuara, duke besuar se e vetmja mënyrë për të ruajtur kulturën e tyre është përmes përdorimit të dhunës. Kjo ka çuar

ndodhën disa ngjarje, kriza Botërore si : shpërbërja e Jugosllavisë dhe gjenocidi në Ruandë.

⁴⁵ www.alibris.com **Thomas Weiss** është profesor i Shkencave Politike në City University of New York, dhe drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare. Ai ishte redaktor dhe autor i më se 35 titujsh të ndryshëm rreth çasjeve Multilaterale Shkencore për Paqen dhe Sigurinë Ndërkombëtare, Intervenimin Humanitar dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

⁴⁶ Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq - 43

⁴⁷ Kombet e Bashkuara Asambleja e Përgjithshme, 2005: A/RES/60/1

⁴⁸ Paris, Roland, and Timothy D. Sisk. The Dilemmas of Statebuilding: Confronting the Contradictions of Post-war Peace Operations. London: Routledge, 2009, fq 126

në një ndryshim në mënyrë që grupet terroriste luftarake të unifkohen dhe në një “bashkim” të sovranitetit për të mirën e përbashkët, duke shfrytëzuar edhe strukturat të inteligjencës.

Si i tillë koncepti Vestfalian, ndërvarësisë dhe sovraniteti ligjor ndërkombëtar të jetë në gjendje për tu përballuar me këtë kërcënim të ri global organizatat janë të detyruara për të përshtatur një mënyrë pozitive për sigurinë e qytetarëve global.⁴⁹

Në mënyrë që të bëjë këtë, nocioni i sovranitetit shtetëror në fund të Luftës së Ftohtë u shqyrtua, në veçanti ai Vestfalian. Ndërvarësia dhe sovraniteti juridik ndërkombëtar, e ndjekur nga gjeopolitik e efektit të përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ndikimin e saj në sovranitetin shtetëror. Pastaj shqyrtimi i ndikimit në rritjen e retorikës së të drejtave të njeriut, nëpërmjet një zhvillim të Shoqërisë Civile Globale dhe ndikimi i saj mbi sovranitetin shtetëror. Ndikimi i globalizimit ka sjellur ndryshim në sovranitetin shtetëror, përkatësisht një sistem ekonomik global dhe kërcënim të ri terrorist. Duke pasur parasysh të gjitha këto, mund të shihet se natyra e sovranitetit ka ndryshuar në mënyrë pozitive, në kuptimin që është e nevojshme në një botë të globalizuar të mbajë llogari për shtetet sovraane që nuk mbrojnë qytetarët e tyre dhe të ndërhyjë kur ka shkeleje të drejtave elementare të garantuara me konventa ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

E gjithë kjo për të garantuar një botë ku vlerat e mirëfillta morale zënë vend në shtetet, kombët dhe shoqërin globale, e cila sa vjen e formësohet si shqëri demokratike.

Shteti si subjekt në të drejtën ndërkombëtare ka detyra dhe detyrime kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u nisur nga obligimet që ka ndaj qytetarëve të vetë, e deri tek obligimet që ka ndaj bashkësis dhe organizatave ndërkombëtare.

Paprekshmëria e sovranitetit absolut të shtetit, ka krijuar një siguri (pasiguri tek qytetarët në shtete autoritare) të madhe dhe një vetëbesim duke kry veprime të ndryshme (të liga) dhe duke mos njoft asnjë autoritet tjetër më të lartë. Ngjarjet shokuese të cilat shokuan tërë njerëzimin vun në lëvizje bashkësin ndërkombëtare duke kërkuar një zgjidhje për tu ardhë në ndihmë viktimave të krimit.

Zgjidhja ishte intervenimi humanitar, kjo ishte baza ligjore që u gjind për të shpëtuar jetërat e njerëzve të pafajshëm. Me të drejtë qeveria e Britanis së Madhe deklaroi se tashmë është kriju një bazë ligjore e cila do të shërbejë edhe për raste tjera në të ardhmen. Pra me paraqitjen e intervenimit humanitar, sovraniteti i shtetit nuk mund të jetë absolut apo i paprekshëm. Intervenimi Humanitar përkufizohet si intervenim i shteteve në një shtet tjetër për ndërrimin e gjendjes egzistuese.

Të drejtat e njeriut tashmë kanë marr një karakter ndërkombëtar dhe nuk mund të trajtohen si çështje të brendëshme të shteteve, përgjegjësi e bashkësis dhe organizatave ndërkombëtare, prandaj sovraniteti i shtetit nuk përbën precedent për sulme nga jashtë për ndërrimin e gjendjes ekzistuese.

Humbja e Sovranitetit dhe krijimi i shteteve të reja

Shfaqja e luftrave dhe e problemeve të ndryshme që sot po ndodhin në botë, po shpie deri tek zbehja e sovranitetit shtetëror dhe deri tek krijimi i shteteve të reja që po dalin si pasoj e luftrave apo e vullnetit të një pjese të qytetarëve.

Krijimi i shteteve të reja vie si rezultat i shprehjes së drejtës së Vetëvendosjes dhe si pasoj e mos përmbushjeve të detyrimeve ndërkombëtare nga shtete me theks të veçant ruajtja dhe kultivimi i të drejtave të njeriut⁵⁰.

Sovraniteti është monopol i shtetit që përmes forcës fizike realizon qëllimet e pushtetit shtetëror, me vet faktin se ky monopol i forcës fizike shuhet ose dobësohet deri në atë shkallë sa që nuk është

⁴⁹Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom 2003 fq - 186

⁵⁰Prof.Dr. Enver Hasani në librin e tij Vetvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavis. **E drejta e Vetëvendosjes** është e drejtë e cila parashikohet edhe në Kartën e OKB-së. Ajo përcakton mardhëniet midis Kombeve që bazohet mbi respektimin dhe parimin e barazisë dhe të drejtën e Vetëvendosjes. Në nenin 1 paragrafi 2 të Kartës së OKB-së parashihet që të gjithë popujt kanë të drejtë të vetëvendosin, ata mund të vendosin për statusin e vetë politit, zhvillimin ekonomik, kulturor dhe social. Një gjë të tillë e parashih edhe Akti Final I vitit 1975 që u vendos në Konferencën për Siguri dhe Bahkëpunim në Evropë gjithashtu egziston edhe Deklarata e Mos-ndërhyrjes dhe Interferencave në punët e brendëshme të shteteve.

në gjendje që të kontrolloj situatatën faktike apo pushtetin brenda hapësirës përkatëse, humbë legjitimitetin e vet shtetëror.

Mënyra tjetër e pushimit të sovranitetit shtetëror në teorinë e shtetit dhe së drejtës, e cila konsiderohet si mundësi origjinale e të cilën e gjejm edhe në teorinë e së kaluarës historike madje që nga Roma e vjetër është Okupimi.⁵¹

Okupimi⁵² **nënkupton jo vetëm përmbyshjen dhe shuarjen e Sovranitetit shtetëror, por edhe nënshtrimin e popullit vendas duke krijuar strukturat shtetërore në tërë hapësirën e okupuar**⁵³. Bota moderne nuk e njeh pushtetin apo autoritetin e një shteti në një vend në qoftëse ai territor është okupuar dhe se kjo gjendje konsiderohet si gjendje e përkohëshme sepse këtyre institucioneve nuk i binden popullata e okupuar, dhe kjo gjendje e këtillë nuk mund të gjejë perkahje ndërkombëtare në aspektin formalo-juridik.

Krijimi i federatave dhe i konfederatave bëri zëvendësimin e sovranitetit shtetëror nga federata apo të themi se federata është bartëse e sovranitetit shtetëror, ndërsa anëtarët gëzojnë njëfarë lloj autonomie brenda për brenda territorit të vetë por vendimet e rëndësishme merren në kuadër të federatës.

Bashkimi Evropian është një lloj sui generis i federatës ku me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës⁵⁴ institucionet e Bashkimit Evropian bartin të gjitha përgjegjësitë në të gjitha fushat sa i përket vendimëarrjes ndërsa institucionet kombëtare bëjnë implementimin si dhe japin ndihmën e tyre këshilluese ndaj institucioneve të BE-së.

Federatat si ajo e Jugosllavis dhe e Bashkimit Sovjetik ishin federata që centralizuan të gjithë pushtetin në qendër dhe kishin një sistem komunist dhe bëri që për një kohë jo shumë të gjatë të shuhen dhe të pamvarësohen shumë shtete si pasojë e shpërbërjes së këtyre federatave.

Rasti i fundit ishte Kosova, e cila ishte njësi federative që kishte statutin e autonomis në federatë, por pasi që popullit shqipëtar të Kosovës iu bënë shumë padrejtësi iu shkëlën të drejtat më elementare si dhe iu ndalua çdo formë e shkollimit dhe e avansimit të shoqëris, rezultoi që të krijohet një ushtri guerile e që me kalimin e kohës u njohë nga bashkësia ndërkombëtare si një ushtri çlirimtare, që shënoi fillimin e një fundi të një padrejtësie dhe një gjenocidi që u bë ndaj një populli të pambrojtur. Serbia me 10 Qershor 1999 u tërhoq nga Kosova me forcat e saj, sipas Rezolutës 1244 në Kosovë u vendosën trupat e KFOR-it nën mandatin e Këshillit Sigurimit të OKB-së dhe kjo ishte një fazë kalimtare deri në përcaktimin e statusit politik të Kosovës.

Bibliografia **Burimet Primare**

Hasani, Enver. Vetëvendosja, Integriteti Territorial Dhe Stabiliteti Ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavisë. Prishtinë: Buzuku, 2003

Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003)

⁵¹Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinë , fq. 29.

⁵²Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinëë fq – 29 **Okupimi** nënkupton jo vetëm përmbyshjen dhe shuarjen e Sovranitetit shtetëror, por edhe nënshtrimin e popullit vendas duke krijuar strukturat e shtetërore në tërë hapësirën e okupuar.

⁵³Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinëë fq - 29

⁵⁴Reka, Blerim; Sylja, Ylber. “Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian”. Tetovë. 2007, fq. 13 **Traktati i Libonës** është traktati i fundit i Bashkimit Evropian i cili në BE sjell shumë ndryshime të mëdha ndërsa disa prej tyre janë: perfunimi i funksionimit të sistemit tri shtyllësh, përfaqësuesin për Politikë të Jashtëme të BE-së, mundëin e zgjeimit të BE-së, Presidentin e BE-së, mënyren e marrjes së vendimeve brenda institucioneve të BE-së etj. Vlen të theksohet se ky Traktat pati shumë kundështime nga qytetarët dhe shtetet e BE-së dhe përfundimisht me 1 dhjetor 2009 hyri në fuqi dhe presidenti Çek pati deklaruar se Sovraniteti i shtetit Çek mori fund përfundimisht.

- Filo Llambro: Historia për sistemet e qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003
- Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.
- Richmond, Oliver P., and Jason Franks. Liberal Peace Transitions: Between Statebuilding and Peacebuilding. Edinburgh: Edinburgh UP, 2009
- Paris, Roland, and Timothy D. Sisk. The Dilemmas of Statebuilding: Confronting the Contradictions of Postwar Peace Operations. London: Routledge, 2009
- Gruda, Zejnullah, E drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, 2003
- Gruda, Zejnullah, Manual Diplomatik, Prishtinë , 2009
- Hans Peter Gasser, E drejta Ndërkombëtare Humanitare, Dhjetor 2000
- M. Adler: Ordening International Politics: Identity, Crisis and Reprerentational Force.
- Weller, Marc: Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës Për Pavarësi. Prishtinë: Përktheu nga origjinali anglisht Flaka Suroi, Koha, 2009
- Gruda, Zejnullah: E drejta Ndërkombëtar Publike, Prishtinë, 2009
- Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy. : Princeton UP, 1999
- Hehir, Aidan. Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society Hardcover, 2008
- Kuqi, Hajredin and Bilalli, Asllan: E Drejta Ndërkombëtare Private: Prishtinë, 2009
- Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, “ E drejta ndërkombëtare humanitare”, Ed. Pedone, dhjetor 2000
- Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinë
- Reka, Blerim; Syla, Ylber. “Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian”. Tetovë. 200

Burimet nga Interneti

- www.Encyclopedia.com
- www.britannica.com
- www.stahlshmidt-inc.com
- www.alibris.com

Natural resource management in the 21st century, economic problem solving Kosovo

Afrim Selimaj , Adem Dreshaj
University “Haxhi Zeka” Peja, Kosovo

Abstract

Most population growth increasingly growing standard of living is also increasing demand for use of natural resources. Responsible government should be coordinated better, use and management of natural resources in the region overall. Sustainability in public health, environmental protection and the economy are key factors for uncontrolled exploitation of natural resources.

Use resources must be planned carefully and take measures to prevent adverse effects in the case of environmental pollution. Almost all natural resources such as mineral water planet occurred in underground layer, adaptability term conservation of resources is threatened by uncontrolled exploration. Pollution resources from non-Point Pollution from both agriculture and industry and other sources are water aquifer depletion of resources due to withdrawals of groundwater and groundwater recharge in excess mining and mineral exploration without conscious.

Mineral fuels and local water can then be used for high social, ecological, or economic or saved for the future. Climate change global warming caused by carbon dioxide emissions, the use of natural resources in an uncontrolled manner are difficult to predict in time and space.

Keywords: *natural resource management, underground storage, Non-Point Pollution - and sustainability.*

Introduction

High level of economic development increases the high standard of living, will promote an increase in demand for natural resources use, the uncontrolled exploitation of natural resources will have enormous increase in solid waste. At the same time, there will be increasing demand more water for industry and agricultural economy irrigation will be needed to meet growing demands for food for the population.

Also, more demand for natural resources use would be detrimental to the environment, such concerns will be as aquatic life, wildlife, housing, recreational value, scenic values and habitats. This will require intensive management of natural resources and international cooperation will be necessary.

Although most of natural resources occurred in underground layers . Underground natural resources will be used more in the future, and therefore should be protected against irrational spending. The growing population and increasing demands for resources are an uncertainty about future society is great uncertainty about how climate will change, how it will be affected by human activities increased emissions of CO₂ and other gases emissions, and other pollutants such as weakening of the ozone layer by nitrous oxide from economic activities.

There is still no agreement among scientists as, and when, the climate will change, and what changes will occur in the future. The main conclusions so far seems to be that climate change (natural and anthropogenic), likely, to be unpredictable on a local and global scale.

Management of natural resources must be flexible in order to be able to cope with changes in the availability and demand for natural resources, companies must call for integrated resource management, where all stakeholders must be involved in the process the decision.

Historical approach requires not only the management of natural resource supplies, but also manage the demand for natural resources (eg water conservation, coal, minerals and water transfers and returns using higher quality economic), management, recycle and reuse resources in the economy. Conflict resolution , public involvement, public health, environmental and ecological aspects, socio-

cultural, aspects of storage (long-term effects of storage, or natural resources “banking”).

The challenges of society to control the exploitation of natural resources

Natural resources form support systems vital for human life, which includes everything from energy, land, water, atmosphere, wetlands, forests, wildlife and fishing. Unfortunately the use of natural resources in an uncontrolled manner, feeds a form of contempt and arrogance of environmental, which only becomes clear when serious environmental problems arise. From environmental pollution early impact sensitive beings as fish and continuing threats to increased temperatures twin in the atmosphere and raising sea levels by melting glaciers.

The scientific community is trying to interfere with the understanding and tracking resources to the seriousness of the problem of exploitation of natural resources by our societies and to promote the development of solutions and policies for the implementation of environmental laws, better management of natural resources. In most cases, we must first understand that in fact there is a problem, and the problem is complex and dynamic due to causing negative effects and characteristics of materials, can be made any significant progress towards the development of solutions and implementation of environmental management regimes.

Traditionally, scientists have worked within a system time to begin the search for funding projects and continue through the rational use of natural resources.

At the same time, many scientists want to play a clearer and well defined in developing policies for the use of natural resources, but it often comes only after activation laws and research achievements. Anything that can open this traditional process and speed communication between scientists, and environmental policy makers, promises not only to improve the ability of the scientific community to respond to problems of natural resource management, but also to improve awareness to our wide array of natural resource systems. These are potential gains for the rational use of natural resources and long term. In my opinion, the speed of the application of laws , geographical distribution, and expansion of communication in between communities and monitoring of natural resource exploration.

Natural resources have become a problem society on a global scale, with its format to open access to a large extent and to expand activity in not only the number of items that may be involved in scientific investigation and debate rational, to take seriously the way to expose and rigorously presented arguments, evidence, and understanding good use.

At the same time, resources will seek to attract a wide range of species for traditional use science and studied the negative effects of excessive exploration, including those that focus on policy and research ideas speculative. Exploitation of natural resources also required the publication of special issues that focus on topics of importance.

Exploitation of natural resources to become a center for scientists, policy makers, non-governmental organizations, and individuals who are concerned with the use of natural resources and control management, but management realized with sufficient information and a spirit of inquiry scientific.

Creating legal principles for natural resources mining

Proposals for guiding principles for the creation of modern and sustainable arrangements for the management of mineral resources . Principles are particularly important for large projects to meet the new realities and the socio-economic and geopolitical 21st century, along with meeting the needs continuous, long-term investments that are essential for large-scale mining projects. In 2000 major changes were made in the global mining sector and have started to become even applying legislation in Kosovo.

Decades of a long-term downward trend in prices of metals and minerals, ranging in prices in 2004 rose more sharply in real terms and, despite some subsequent volatility and cyclicity, they have stayed high to create a return important for owners of existing mines.

Aspiration for which, along with a sense that the owners of financial and capital needed for mining have been getting a lot of great benefit commodity prices on high quality, has made the company to

wait for the revised conditions in which existing mines are operating, in which existing exploration and development projects are progressing and under which future activities will get big. Since the birth of the industrial mining in order to set, in general, mining legislation is to provide the framework for investors and markets needs to consume minerals and utilization control, which aims to provide security and stability for the use of controlled mining. Investors in mining enterprises are exposed to risks technical, logistical, economic and political-established major investment property that typically take a long time to settle and gain a return required and environmental preservation. This is especially the case for projects made that require large investments in transport and facilities that are often of interest and value beyond the mining company and therefore attract other capacity requirements that could use. It is also predictable that the investment will be hindered where such conditions do not exist. In the modern context, the demand for metals and minerals was quite predictable until the early 2000s.

Extensions or upgrades to existing operations, and / or the development of several new operations with particular economic, were sufficient to meet demand. Economy of the mining industry were generally challenging for investors, and economic realities of the industry often gave little hope realistic or minerals that possess the power to nations to achieve many of their minerals.

Principles for the form of a stable, due to the expectations of the host countries and the strength it is not enough for a mining agreement to be designed only to attract and facilitate investment by securing clear and safe to satisfy investors. Host countries and other stakeholders expect more to address modern realities, it is proposed to good management of mineral resources three main principles for a lasting agreement mining management:

- Establish a discussion and mutually agreeing on the objectives of each party;
- Establish an economic balance within which the company will operate, the conditions will be adjusted to convert the balance of the enterprise;
- In the formation of the agreement, draw the scheme of public, private, modern partner agreements.

The traditional approach embodies the essence of the agreement and the purpose detailed in clauses which seek to throw stone towards dealing with decades of future mining operation, while those provisions are established in the context of the time. They are agreed, or indeed, if we look at recent precedents for the context, profoundly changing socio-economic and geopolitical decades. Consequently, this traditional approach seeks to create an agreement that in reality, to ensure a sustainable and long-term stability in other words, it will not provide a lasting agreement.

It required an approach which balances the concerns of modern and evolving investment in the dynamic socio-economic and socio-political, avoiding the dangers too broad, limited a deal. The main goal is to create an arrangement that minimizes disruption of negotiations opportunities are costly to all concerned. The goal is an agreement that will be stable and predictable in the long term. Legislators propose concepts draw on proven and powerful from other sectors (particularly public-private infrastructure) and which in certain substances, actually reflect what is happening in the international sphere, the mining sector in recent times about major projects. To create modern and sustainable agreement mining, a sound principle is to put aside the consideration of legal pure mechanics. Instead, the parties must begin with a detailed environment mutually agreed objectives of each for his company and the deal, according to a joint assessment. Subsequent detailed mechanics of the agreement will be based on those objectives that will head the agreement and be a stable reference in future behavior and his balance.

The agreement should also bring a current and / or development of local laws and relevant precedents of international mining sector (useful precedents from other sectors such as infrastructure and energy).

One condition is that the local law is especially important in civil law jurisdictions, which is not possible for contractual parties to agree to the terms if these conditions are either contrary to or not allowable under public order provisions derived from authoritative laws or state laws.

In general, it is the interest of all parties to the terms and conditions as much as possible, as the prevailing conditions are usually compared to specific sector conditions. The latter very often prove to be controversial with a range of stakeholders and therefore ultimately unreliable and / or

difficult reputation. For a mining agreement to be sustainable it must be seen that would meet the objectives of both parties (and, as noted, which should correspond to the legal system of the country with the simple rates of well tested by the industry.

Guiding principles for sustainable settlement

Different countries worldwide are demanding more results which are complex and engaging with different layers of state for guiding principles. Basically, be sustainable mining agreements that must be perceived in the life of the agreement 'goal-based' with conditions that support these goals in terms 'based' simple reach agreement .For this character sustainable mining agreement, a value of the model is a modern construct agreements (PPP) is used to give concessions to public infrastructure. These agreements for long term investments in public infrastructure provide the investor to make a return required over the decades, in clear principles and legal equality.

These related undertakings are sustainable and acceptable to a wider public in the long time. They are basically a tune consensus that early in the impressive economic and financial parameters for the project based on a case agreeing and be transparent for business.

This ensures that the main objectives and basic conditions remain satisfied throughout the life of the enterprise. Typically, a successful PPP arrangement of this nature will be determined by starting the objectives and fundamental rights and obligations of both parties, including key economic and environmental standards. This is more than a clause, although the accuracy of such a clause could be a valuable construct together with the concept of PPP. The aim is to provide an objective statement of purpose real deal, agreements entire legal mechanism facilitates enterprise agreement that can be created and applied in practice.

In this way the agreement is strong and the subject of risk is lower than in a traditional arrangement limited by its provisions detailed and defined in a moment of time. While the PPP concept may sound like a radical step for a development agreement for mining activities, it is actually being created implicitly new substance contemporary talks mining agreements.

Concepts that is easy to translate the applicable provisions or regulations such as difficulty, the right to economic equality, the special rights of the state where the public interest is at stake, special rights of the private investor when the sovereign rights are caused, a guarantee of fair and effective compensation. Limitation of speculative profits balanced by various guarantees to make reasonable profit over the life of the enterprise, simplifying the process of permits, tax and customs clearing up clear procedures for land use, transparency of accounts, etc.

Mines essentially involve multiple investments and large, dangerous conditions and a long time. Consequently, simplicity, clarity and security of key terms of investment are essential for trouble-free treatment under conditions changed significantly, and without complex negotiations. Those who invest money in developing skills and very reasonable to expect and require that clarity and certainty for business.

On the other side of this, investors are in a strong position to demand of its people will receive equal benefits from resource use throughout the life of the enterprise. These benefits include a perception equal to the transformation of development of a country. Both of these perspectives are especially important when new mining developments of today could be the product of economies, scale and successful achievements of the sector in recent decades.

Mining projects include new infrastructure poorly developed regions; the company is better conceived as a partnership and mutual benefit. Mining agreements to be a stable arrangement that will not undergo fundamental review and re negotiation over the years and potentially decades of existence, it needs to create a framework for understanding and sustainable process that can accommodate and respond to safe and potentially important changes in circumstances, while at the same time implementation of rights and obligations.

Kosovo's water resources and reuse

Water reuse planning is becoming increasingly important with for two reasons. One is that the discharge of wastewater into surface waters is becoming increasingly difficult cleaning is expensive. Treatment requirements are more stringent to protect water quality receiver for aquatic life, recreation and users in terms of gaining power.

The second reason is that municipal wastewater is often an important water resource that can be used for a number of purposes, especially in water-scarce areas. Reuse is required (non-potable) for purposes such as agricultural irrigation and urban use, industrial use as (cooling), increasing the quality of the environment (wetlands, wildlife refuges, habitat), fire fighting, dust control, and washing toilets. This requires treatment so that it meets the quality requirements of intentional use. To invest in adequate infrastructure such as storage tanks, ducts, and pipes and dual distribution systems are needed so that different water qualities can be transported to different destinations.

All these are important aspects of the reuse of water, especially where the public is directly affected. Treatment plant processes for reuse unlimited (non-potable) primary and secondary treatment followed by tertiary treatment consisting of process decantation, sand filtration and disinfection (chlorine or ultraviolet radiation) to ensure that it is free water flow and prior treatment not have pathogens (viruses, bacteria and parasites). Can then be used for agricultural irrigation, urban parks irrigation, fire fighting, washing toilets, industrial uses, as well as other purposes tertiary treatment is relatively high and expensive technology are feasible.

The recommendations of the World Health Organization for wastewater treatment

World Health Organization has developed guidelines that are based on epidemiological analysis documented disease. Epidemiological studies have shown that the use of treated water with chemicals have been applied in the use of cleaning, use for irrigation of crops greatly reduces health risks compared with untreated sewage:

- Treatment of wastewater for potable reuse Direct requires advanced processes that include the removal of nitrogen and phosphorus (nitrification / denitrification and precipitation lime);
- Removal of organic compositions as activated carbon (carbon absorption);
- Removal inorganic compositions and bacterial pathogens;
- The process of filtration (Micro - filtration and reverse osmosis), and disinfection;
- Even when all these steps are used and water treatment meets all drinking water standards can be used for daily needs.

Conclusions

The proposed approach to sustainable agreement for aquatic natural resources and mining for large mining projects is to create agreement whose terms are established in different forms mutually agreed on the main objectives and be part of national and international agreement. With these agreements, the world significantly increase and better manage economic development, socio-economic and geopolitical balance, the terms of separate agreements occasionally reordered to reflect changing conditions, but always within the framework of the founding objectives and parameters which include key economic standards and reports providing an easy reference to deal with possible changes.

In this way deals can be more durable than traditional forms of mining agreement, the balance of which arose from specific and detailed provisions and clauses which reflect the conditions of the day or prior periods. Civil society and political empowerment has many resources to achieve their needs, which, p.sh, sovereign power of governments to impose their will, together with negotiating power they have in a competitive world for natural resources.

External support agencies and pressure groups prepared to emphasize the inequality they perceive the balance of power and profitability that existed until recent years. Increased empowerment of

society wishes to reflect accurately the changing environment in which it is wise to think about a different concept of an agreement for the management of natural resources.

To search a comprehensive grand, with accompanying social responsibility (CSR) and corporate obligations, but rather to establish a cooperation mutually agreed purposes, the common value on one side a goal and right to earn money on the other side a goal and right to a fair balance economic and achieve development results.

Respective goals will have other obligations to flex compromise in such circumstances that the goals of each may be equally stable. In fact the agreement natural resources becomes its heart an agreement on 'goals based' with conditions that support these goals and not just in 'terms based on' the deal:

- Under an agreement based goals, the terms can be adjusted from time to time to maintain a mutually acceptable balance.
- Population growth and climate change will pose serious demands safe water sources in the future.
- Principles of integrated natural resource management and international cooperation will be necessary to develop sustainable systems and to prevent agricultural ecological disasters.
- Good management of natural resources must be integrated to other resources clean.
- Management practices, that the actions of a user group will affect the interests of natural resources to other parties.
- More research should be done to ensure clean natural resources.
- Sources be based on sound science and Engineering, regions local, national, and international efforts, cooperation, and the costs are necessary to meet the food and water in the future.
- Demand stable, peaceful environment.

Literature

1. De Oliveira, CR, Lombardy, AT & WF Jardim. Copper Naturally occurring organic complexation by meter: A model multiligand. Chem. Spec. Bloavail, 7, 125 (1995).
2. Smith, RM & Martell, AE, Critical Stability constants. Plenum Press, New York. (1981).
3. Herning, JG & Morel, FMM Kinetics of trace metal complexation: METALS roles of alkaline- earth. Environm. Sci Technol., 22.1469. (1988).
4. KNOCH, W. WASSERVERSORGUNG, Abwasserreinigung und ABFALLENTSORGUNG, VCH, Weinheim, New York, 557. (1994).
5. Çullaj Allqi, instrumental methods of chemical analysis. University Book Publishing House Tirana. (232-237). (2004).
6. Thomas, R. Beginner's Guide to ICP-MS. Parts I-XI. URL: <http://www.spectroscopymag.com/>.
7. Korca White, chemical analysis of water, donation MASHTK & Ostrich, Pristina, 71-121. (2003).
8. Petz, B. Osnovne statistička method za nematematičare, IV izdanje NAKLADA slap, Zagreb,, 63 (2002) ..
9. Decorative Dreshaj Adem Masters 2009 physico-chemical characterization of the White Drin water.
10. Dreshaj Adem "Managing product quality and Environmental Impacts on Business Products", Peja 2014.
11. A.H. Weerts, Analytical models for chemical transport on the subsurface Environment, Wageningen Agricultural University, Department of Water Resources, Wageningen, The Netherlands, 1994
12. b. S. Mathur. The Pollution of Water Resources Waste due to rural industrial, Chemistry and Chemical Engineering Department of the Indian Institute of Technology, Delhi, India, 2005
13. B GSkakalsky, Study of anthropogenic influence on water quality in rivers Some of the Baltic Sea Basin, State Hydrological Institute, 2nd line, 199053, Leningrad, USSR, 1981.
14. BMZ ed: Environmental Handbook: Documentation on Monitoring and Evaluation Impacts (Vol.I-III). Vieweg, Leverkusen 1995
15. Bratli LJ: Classification of the Environmental Quality of Freshwater in Norway: Hydrological and limnological Aspects of lake monitoring. Heinonen et al. John Wiley & Sons Ltd. 2000
16. Brebbia, CASKerget, P. (1984), "Problems using Diffusion-convection boundary elements", in Laible, JP, Brebbia, CA, Gray, W., Pinder, G. (Eds), finite Elements in Water Resources V, Springer-Verlag, Berlin, pp.74768.
17. C. P. Kumar, Groundwater flow models, Scientist 'E1', National Institute of Hydrology, Roorkee - 247667 (Uttaranchal), 2003.

Premisa subjektive, që stimulojnë veprimtarinë kriminale tek të miturit

Dr. Lindita Durmishi
Psikologji Juridike
Universiteti "A.Xhuvani"

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi shkencor është përqëndruar në zbulimin e premisave subjektive, që stimulojnë veprimtarinë kriminale tek fëmijët e mitur, specifike për ndikimin negativ të rrethit të afërm shoqëror mbi adoleshentët shkelës të ligjit. Pervijuar nga pervoja e rasteve konkrete të ndjekura dhe prurjet në leme të psikologjisë së sjelljes devijantemund të pohojmë se ndikim gjithmonë ka ekzistuar, por ka ndryshuar parametrat dhe intensitetin e tij gjatë periudhave të ndryshme, si rezultat i zhvillimeve të reja në kuader të marrëdhënieve sociale dhe praktikave sociale.

"Baticat dhe zbaticat" në shfaqjet kriminale të adoleshentëve në një numer të konsiderueshem rastesh janë kushtezuar nga situatat konkrete sociale, në të cilat ato kanë qenë të shtyrë të realizojnë aspiratat e tyre të pavetëdijshme ndaj veterealizimit dhe vetëvendosjes. Vështirësitë e lindura i kanë penguar jo vetëm të arrijnë më të mirën për veten, por dhe të angazhohen në tërheqje, të cilat realisht i kundërvihen socializimit.

Ndër breza dhe tradicionalisht rrethi social ka dhënë dhe ka rritur "fëmijë të vështirë", të cilët, pas kësaj, u është dashur të përmirësohen dhe riedukohen, por dhe shumë shpesh të dënohen nga ky rreth social.

Përveç trajtimit teorik, që prek sfondin konceptual të analizës dhe interpretimit të realitetit konkret, referuar sjelljeve kriminale, jemi bazuar dhe në rastet konkrete të vezhguara dhe të ndjekura në mjedise të ndryshme për të arritur në refleksione dhe perfundime të rëndësishme që ngacmojnë me shume dhe zhvillojnë debatin e specialistëve dhe të jospécialistëve të fushave të psikologjisë kriminale e devijante, si dhe të aktoreve të tjera për sugjerime konkrete jo thjesht institucionale por me karakter praktik.

Si perfunim, zbulimi i premisave subjektive që i referohen sjelljeve devijante na ofrojnë një mundësi të madhe në përmirësimin dhe eliminimin e ketyre sjelljeve kriminale për të perfutur një brez të shëndoshe psikologjikisht, të socializueshem, e si rezultat një shoqëri me vlera morale, edukative e qytetare.

Key words: *negative impact, relative social circle, minors, teenagers, lawbreakers, socialization, upbringing.*

Hyrje

E drejta për jetë është një e drejtë e patjetërsueshme e njeriut, e çmuar për të, po aq sa edhe për Shtetin, i cili ka detyrimin të sigurojë mjetet për realizimin sa më efektiv të saj.

Sistemi i drejtësisë penale në Shqipëri është i bazuar kryesisht të aplikimi i dënimit me burgim, me një numër të pakët alternativash të tjera dënimi. Modeli i dënimeve ka tendencë drejt burgimit, me masa të gjata të këtij dënimit, dhe ku mbipopullimi është një problem serioz. Duke ndjekur rekomandimet që theksohen në një sërë instrumentesh ndërkombëtarë, autoritetet shqiptare kanë treguar angazhimin e tyre drejt krijimit të mundësive për një zbatim në rritje të alternativave të dënimit me burgim, me qëllim që të reduktohet mbipopullimi në burgje, kostot dhe efektet negative të burgimit të panevojshëm.

Ekziston një nevojë e njohur për të zhvilluar një shërbim kombëtar të provës për të mbikëqyruar të dënuarit në komunitet. Gjithashtu, ekziston edhe një nevojë për të shkuar drejt dënimeve të individualizuara, të cilat kërkojnë më shumë informacion mbi të dënuarit që mund të paraqiten në gjykatë për të kërkuar zbatimin e sanksioneve komunitare në vend të burgimit. Në 27 nëntor 2008 u miratua baza ligjore që mundësoi krijimin e Shërbimit të Provës në Shqipëri. Krijimi i shërbimit të provës, i cili mund të përgatisë raporte dhe të ofrojë mbikëqyrje të planifikuar në komunitet, është një hap përpara në reformën e sistemit të drejtësisë penale. Ka shumë gjasa që funksionimi i këtij shërbimi të ri, të inkurajojë gjyqtarët për të dhënë më shumë dënime alternative.

Pa mohuar rolin e shoqërisë, shkollës, medias dhe mikromjedisit, një nga metodat më të efektshme për parandalimin e veprimeve antisociale të adoleshentëve është ndërtimi i urave të komunikimit

të prindit, edukatorit apo kujdestarit me adoleshentin. E theksojmë këtë, jo për të ndëshkuar ata prindër që u kanë ndodhur ngjarje negative, përkundrazi për t'i ngushëlluar, por për të ndërgjegjësuar çdo prind apo kujdestar se padija, neglizhenca, besimi i tepruar apo indiferenca në ndërtimin e marrëdhënieve me fëmijën adoleshent, një ditë mund t'u kushtojë shtrenjtë. Dhe ky mund të jetë kushdo.

Specialistët, që punojnë në fushën e së drejtës penale – procedurale dhe psikologjinë juridike, shpesh theksojnë, se ky qëndrim i tyre është i ndikuar nga roli shumë i madh i prirjeve dhe qëndrimeve të të miturve – shkelës të ligjit. Krijimi i situatave psikike shpejtojnë dhe lehtësojnë realizimin e angazhimeve konkrete kriminale.

Ndikimi negativ i rrethit të ngushtë shoqëror mbi të miturit – shkelës të ligjit, kryesisht realizohet në dy mënyra:

- ◆ Nëpërmjet ndryshimeve në statusin social të individit, të cilat në shumicën e rasteve çojnë në çrregullime serioze në socializimin e tij;

- ◆ Nëpërmjet ndryshimeve në drejtimin e individit, në sistemin e tij të vlerave, si dhe nëpërmjet formimit të prirjeve dhe qëndrimeve.

Vetë ndryshimet, siç theksojnë psikologët, që kanë kryer studime mbi këtë problem, fillojnë gjatë periudhës së pubertetit dhe thellohen e komplikohen gjatë periudhës së adoleshencës dhe rinisë së hershme. Kryesisht atëherë ndodh ndikimi stimulus i interesave kriminale, i prirjeve dhe sjelljeve kriminale. (Grigorov, 1973, 26).

Prirjet dhe sjelljet kriminale të të miturve, fillojnë të luajnë një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm në motivimin e angazhimeve të tyre kriminale, por dhe për ambientimin e qëndrueshëm me mënyrën e jetës së krimit. Specialistët theksojnë, se një gjë e tillë është stimul i rëndësishëm për një pjesë prej tyre që të angazhohen dhe me formimin e grupeve kriminale. Nëpërmjet kësaj veprimtarie, ata aktivisht kërkojnë mundësi për realizimin me sukses të skenës kriminale (Grigorov, 1975, 27). Aktualiteti i këtij problemi shkencor në psikologjinë juridike lidhet si me hetimin dhe ndjekjen penale të individëve të mitur, që kanë kryer krime, ashtu dhe me realizimin e punës preventive dhe profilaktike me ta.

Ndodh kështu, mbasi faktorët e përcaktuar psikik luajnë rolin kryesor në motivimin e akteve të tyre kriminale dhe përshtatjen e tyre ndaj bashkësive kriminale dhe mënyrës së jetës kriminale.

Përveç prirjeve dhe qëndrimeve, shumë i madh është roli stimulus dhe i çrregullimeve emocionale, të cilat shoqërojnë jetën e përditshme të një pjese të të miturve – shkelës të ligjit. Nën ndikimin e tyre, ata bëhen jo vetëm të papërmbytur, por dhe më agresiv, duke shkaktuar situata kritike dhe konfliktuale shumë më lehtë angazhohen në kryerjen e veprimeve agresive dhe krimeve kundër individit.

Shpjegimi praktik i ndikimit të këtyre faktorëve nga organet hetimore dhe gjyqësore pothuaj kërkohet gjithnjë në rastet e veprave penale nga të miturit – shkelës të ligjit të përdoret ndihma e specializuar e psikologëve. Madje, në disa shtete europiane, pikërisht për këtë arsye, ekspertiza juridiko - psikologjike është pranuar si e detyrueshme si për organet e hetimit, ashtu dhe për organet gjyqësore.

Kjo metodë normative është rregulluar dhe për praktikën ligjore në Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Shqipërisë (KPP në R. e Shqipërisë, neni.36 dhe 361, 2001 i azhurnuar).

Realisht kjo ndikoj që dhe në këtë studim ti kushtohet një vëmendje e veçantë ndikimit stimulus negativ të çrregullimeve emocionale, prirjeve kriminale dhe qëndrimeve të të miturve, të cilët shpejtojnë dhe lehtësojnë angazhimin e tyre në shkeljen e ligjit.

Të rinjtë përjetojnë më fort largimin nga të dashurit dhe braktisjen nga prindërit. Xhon Stajnbeg e ka përshkruar bukur një gjë të tillë në romanin “Në lindje të Parajsës”: “Për një fëmijë nuk ka gjë më të tmerrshme, se sa mos ta duash, ta neveritësh, për atë është tmerr, nga i cili dridhet... Me zbulimin vjen zemërimi, që ke qenë i përbuzur dhe ai shpesh stimulon dhe prirjen për krime ... Një fëmijë që i refuzohet dashuria, drejt së cilës synon, shkelmon macen dhe maskon fajin e tij të përjetshëm; një tjetër niset të nënshtroi botën. Dhe gjithnjë vazhdon fajin, hakmarrja dhe fajin e ri” (Stajnbeg, 1986, 45).

Nga studimet e kryera shkencore është konstatuar, se devijimi mund të lindë dhe nga konkurrenca e prindërve në dashurinë ndaj fëmijëve. Në një situatë të tillë ata shpesh përdorin metoda

antipedagogjike, siç janë rryshfeti, përkëdhelja, gënjeshtria. Fëmijët në familje të tilla rriten me ndjenja të ndara besimi dhe dualitet të përhershëm. Ata mësojnë të manipulojnë të tjerët dhe t'i përdorin, të thurin intriga, të grabisin, të spiunojnë dhe të merren me thashetheme. Mësojnë të jetojnë në një botë, ku ndershmëria është pengesë, ndërsa çiltërsia – barrierë, një botë që nxitë dhe favorizon sjelljen psikopate.

Në psikologjinë e sjelljes devijuese dhe në psikologjinë kriminale diferencohen disa situata tipike, tek të cilat çrregullimi i marrëdhënieve emocionale me prindërit çon në kryerjen e veprimeve devijuese joedukative nga të miturit:

- ◆ **Prindërit superemocional** – bërtasin, zihen, flasin shpejt dhe për shkakun më të vogël mund të shpërthejnë. Një shpërthim i tillë emocional është një pengesë serioze në formimin normal social të fëmijëve;

- ◆ **Prindërit me përkujdesje maksimale** demonstrojnë një kujdes të tepruar për gjërat më të vogla në jetën e fëmijëve. Ata nuk mund çlirohen nga një frikë e vazhdueshme për tu bërë të zotët e vetes. Në një situatë të tillë fëmija rritet, por nuk formohet nga ana logjike dhe sociale. Ai nuk përvetëson aftësitë elementare shoqërore dhe nuk është në gjendje të marrë vendime të pavarura. Në tërësi vështirësohet adaptimi i tij në jetë dhe krijohet mundësi për devijime të ndryshme;

- ◆ **Prindër “infantil”** – ata vetë kërkojnë të marrin ndihmë dhe siguri nga pasardhësi i tij. Një gjë e tillë i ngarkon fëmijët. Tek ata krijohet një shqetësim i madh, dhe ky mund të reflektohet në mikromjedisin shoqëror, me veprime devijuese dhe joedukative në sjelljen e tyre;

- ◆ **Prindër – të alkoolizuar** janë në gjendje të shkaktojnë trauma të papritura për shkak të ndryshimeve të paparashikuara në gjendjen e tyre shpirtërore. Në situata të tilla, tek të miturit krijohet bindja, se janë të vetmuar dhe të braktisur. Që këtu rruga drejt devijimeve dhe delikuençës bëhet më e lehtë;

- ◆ **prindër joshës /mashtues/** – pa dashur nxisin tërheqjen e të miturve drejt seksit tjetër, nëpërmjet stimulimit me përkëdhelje të ndryshme përjetimesh erotike. Një gjë e tillë mund të shkaktojë dëshira dhe synime në moshë shumë të hershme me të gjitha rreziqet dhe pasojat përkatëse për zhvillimin e mëtejshëm të tyre si individë;

- ◆ **prindër, që braktisin fëmijët e tyre,** janë të prirur drejt braktisjes së tyre fizike dhe emocionale. Një gjë e tillë shkakton zemërim, lidhje kompensuese me rrethe të dyshimta, varësi e hershme prej njerëzve, jashtë familjes;

- ◆ **prindër tejet të ndërgjegjshëm** synojnë të kursejnë të gjitha zhgënjimet e mundshme të fëmijës, madje dhe me çmimin e zhgënjimit dhe rrënimin të vet. Të rriturit në mjedis të tilla nuk e shtynë në kohë realizimin e dëshirave të tyre konkrete, madje nuk durojnë as kërkesat dhe kufizimet e arsyeshme. Kjo reflektohet negativisht në socializimin e tyre dhe mund të krijojë premisa për shkelje të normave morale dhe ligjore;

- ◆ **fëmijë nga prindër të divorcuar** shpesh e konsiderojnë zgjidhjen e martesës si fundin e botës. Ofezat reciproke, lufta midis babait dhe nënës, pjesë e së cilës është dhe fëmija, shkaktojnë zemërim, faje, shqetësime dhe pasiguri. Këto përjetime të brendshme janë në gjendje të shkaktojnë sjellje devijuese dhe delikuede. (Stajnbek, 1991, 38).

Nga studimet e kryera në psikologjinë kriminale është konstatuar, se në familjen ku mungon harmonia ekziston indiferentizmi ndaj fëmijës. Shpesh një gjë e tillë bëhet shkak për ofendime dhe dënime. Prindërit e akuzojnë fëmijën për mëkate të ndryshme dhe të gjitha veprimet e tij shkaktojnë kritika të ashpëra. E gjitha kjo e shtynë fëmijën drejt vetizolimit dhe largimit.

Gjithashtu është përcaktuar, se nevrozat dhe çrregullimet psikike të prindërve ndikojnë negativisht tek të miturit (Ratter, 1986, 88). Shpesh një gjë e tillë çonë në çrregullime emocionale dhe deri akte agresive. Nevrozat e rënda apo vuajtje të torta psikike privojnë prindërit nga mundësia e përkujdesjes së plotë të fëmijëve. Sëmundjet psikike rrisin mundësinë e dis-harmonisë në martesë, mosmarrëveshje dhe shpërthime në marrëdhëniet bashkëshortore. Prishja e lumturisë familjare çon në çrregullime psikike dhe tek të miturit.

Çrregullime serioze emocionale lindin tek të miturit dhe nën ndikimin e prindërve me sjellje amorale dhe antiligjore. Armiqësia dhe ftohja në këto familje është faktor shumë frenues lidhur me socializimin e tyre. Shpesh tek ata formohen dhe veçori dalluese të cilat shpejtojnë dhe lehtësojnë përfshirjen e tyre dhe në kryerjen e veprimeve devijuese dhe të kundërligjshme. Ata bëhen jovetëm

të vështirë në përshtatjen me ndryshimin e kushteve në mjedisin shoqëror, por dhe të papërmbajtur e agresiv në situata kritike dhe konfliktuale.

Rastet tipike të paraqitura të çrregullimeve të mikroklimës në familje dhe të lidhjes emocionale midis prindërve dhe fëmijëve, janë objekt i një vëmendje të veçantë jo vetëm në veprat penale, por dhe në organizimin dhe zbatimin e punës preventive profilaktike. Në mënyrë të pakundërshtueshme është përcaktuar, se çrregullimet e theksuara më tepër lindin në rastet e mëposhtme:

- tek prindër me nivel të ulët arsimor dhe me një kulturë e sjellje tejet primitive;
- tek, prindër që bëjnë një jetë parazitare, të kombinuar dhe me abuzimin me alkool;
- tek, prindër që lejojnë në familje arrogancën, cinizmin dhe dhunën;
- tek, prindër tek të cilët mungon sistemi dhe vazhdimësia e mënyrave të sjelljes lidhur me fëmijët (Haris, 1991, 56).

Përveç çrregullimeve emocionale, të cilat më tepër janë të lidhura me marrëdhëniet me prindërit, një rol në nxitjen e angazhimit kriminal tek të miturit luajnë pasionet dhe pikëpamjet. Më shpesh ato formohen nën ndikimin “bashkësive subkulturore”. Zakonisht ato janë joformale, por kanë ndikim shumë të madh dhe afatgjatë tek të miturit.

Kryesisht në psikoatmosferën e këtyre bashkësive formohen prirje të ndryshme lidhur me abuzimin me alkoolin dhe narkotikët. Ato luajnë një rol shumë të rëndësishëm dhe për konsolidimin e hedonizmit (synimi ndaj argëtimit) si fillim udhëheqës në sjelljen dhe mënyrën e jetesës së të miturve.

Nga studimet e zhvilluara deri tani me të mitur kundër shkeljes së ligjit konstatohet, se në komunikimin e tyre me bashkësi subkulturore, përveç pasioneve, krijohen premisa dhe për dehumanizimin e marrëdhënieve të tyre ndaj njerëzve të tjerë. Ata bëhen jo vetëm të papërmbajtur dhe arrogant, por dhe më agresiv. (Grigorov, 1973,42).

Psikoklima në bashkësitë subkulturore të të miturve është shumë e favorshme për formimin tek ata të pikëpamjeve asociale dhe antisociale, zakone, shprehi, prirje dhe qëndrime. Ajo është shumë e favorshme dhe për deformimin e sistemit të tyre disponibël. Të gjitha këto janë premisa të favorshme psikologjike, që lehtësojnë dhe ndihmojnë angazhimin e tyre kriminal.

Çrregullimet e theksuara emocionale, pasionet dhe qëndrimet tek të miturit – shkelës të ligjit ndikojnë si në destabilizimin e sjelljes së tyre, ashtu dhe për përfshirjen e tyre më të lehtë në mënyrën e jetës kriminale. Ato luajnë rol në “përsheptuesit psikik” për motivimin e akteve të tyre kriminale.

Si kriminalistët dhe psikologët janë kategorik në atë, se ndikimi i “përsheptuesve psikik” në angazhimin kriminal të të miturve, zakonisht zhvillohet në sfondin e deformimeve të dukshme në vetëdijen e tyre juridike. Kryesisht ato luajnë një rol vendimtar në përfshirjen e tyre të qëndrueshme në mënyrën e jetës kriminale. Ato i pengojnë të miturit t'i bëjnë një vlerësim objektiv sjelljes tyre, lidhur me respektimin e kërkesave të normave juridike.

Realisht, siç thekson kriminalisti bullgar B.Stankov, deformimet në vetëdijen morale dhe juridike, dhe “përsheptuesit psikik” formohen dhe realizohen në një mjedis jo të favorshëm social. Në një mjedis të tillë lindin dhe deformimet në sistemin e vlerave të tyre dhe në qëndrimin e tyre moral ndaj realitetit. (Stankov, 1981, 32).

Sipas B. Panev “kriminelit” është individ, i rritur në marrëdhënie jo të favorshme me mjedisin, bartës i qëndrimeve më pak ose më shumë të theksuara antishoqërore, i të metave në vetëdijen morale dhe juridike, i cili ka kryer një akt të kundërligjshëm dhe të dënueshëm. Veçoria më dalluese e individit kriminel nuk qëndron në tërësinë matematike të një apo më shumë tipareve apo cilësive negative, gjë që takohet më shpesh tek kriminelët, por në ndikimin e tyre të ndërsjellët e të kushtëzuar. (Panev, 1977, 27).

Siç del nga pikëpamjet e autorëve të cituar, në angazhimin kriminal të të miturve dhe të rriturve, përveç deformimeve në vetëdijen morale dhe ligjore, i kushtohet rëndësi prirjeve dhe pasioneve të ndryshme. Personaliteti i kriminelit në kriminalistikë dhe në psikologjinë juridike shtjellohet si tërësi e cilësive, të cilat objektivisht ndodhen në thelbin psikosocial dhe natyror të njeriut, që e karakterizojnë si anëtar të shoqërisë, por krahas kësaj pasqyrojnë dhe disa veçori negative, që e dallojnë atë nga qytetarët e tjerë.

Zgjidhja praktike e këtij problemi tek të miturit – shkelës të ligjit, dikton që të përdoret informacioni i

pasur empirik, që përfshihet në veçoritë e tyre social-demografike dhe social-psikologjike. I nevojshëm është një informacion i saktë si për statusin e tyre social, për lidhjet dhe marrëdhëniet sociale, ashtu dhe mekanizmat social-psikik, që kanë luajtur një rol vendimtar për marrjen e eksperiencës kriminale dhe formimin e prirjeve dhe qëndrimeve kriminale. Një informacion i tillë është mjaft i domosdoshëm dhe për sqarimin e premisave kryesore objektive dhe subjektive për përfshirjen e tyre të qëndrueshme në mënyrën e jetës kriminale.

Krahas me mundësit e paraqitura dhe të analizuarat për ndikimin e mëtejshëm negativ të mjedisit shoqëror, në lindjen e çrregullimeve në vetëdijen morale dhe ligjore, në pasionet dhe qëndrimet e të miturve – shkelës të ligjit gjatë 2-3 dekadave i kushtohet një vëmendje e veçantë dhe ndikimit negativ të mjeteve të informimit masiv – mediave elektronike. Disa studiues theksojnë, se në rrethana të veçanta rol kriminal mund të luajnë filmat me tematikë kriminale që transmetohen nëpër televizione. (Malecke, 1994, 29).

Disa studiues të këtij fenomeni theksojnë, se filmat me tematikë kriminale janë burim specifik informacioni për marrjen e përvojës kriminale nga ana të miturve. Sipas F.Uerthënm ndikimi shumë i madh negativ i filmave, që transmetohen nga kanalet televizive, në të cilët demonstron dhunë, egërsi dhe sadizëm. Përveç asaj, që tërheqin vëmendjen e të miturve drejt një përvoje të deformuar shoqërore, ata mund të sjellin dhe çrregullime serioze në drejtimin e mënyrës së jetës tyre. Nën ndikimin e këtyre filmave tek ata mund të formohet një pikëpamje armiqësore ndaj njerëzve të tjerë (Schramm, 1964, 54). Natyrisht ka dhe psikolog, të cilët nuk kanë një pikëpamje të tillë. Ata theksojnë, se demonstrimi i dhunës nga ekrani i televizionit mund të ndikoi pozitivisht mbi psikikën e të miturve, mbasi ai mund të luaj dhe rolin e një valvule shkarkimi agresiviteti, d.m.th. të ndihmoi në dobësimin e qëndrimeve të tyre agresive. Ata nënvizojnë, se ndikimi negativ është i mundur sidomos tek të miturit, në gjendje frustrimi ose që janë të zhgënjyer nga mjedisi i shëndosh shoqëror. (Breton, Ph.S. Proulx, 1996, 62).

Studimet e kryera mbi ndikimin negativ të filmave me tematikë kriminale tek të miturit – shkelës të ligjit tregojnë, se ky është më i theksuar tek dy grupe prej tyre:

➤ tek ata, që nuk janë të kënaqur nga jeta e tyre dhe vazhdimisht kërkojnë një mënyrë të lehtë për të dalë nga kjo gjendje;

➤ tek ata që janë të prirur drejt retrizmit – largim nga jeta, vetizolim, lidhur dhe me abuzimin me alkool dhe narkotik. Këta janë të rinjë fatkeq, të cilët me vështirësi mund të përshtaten me atë, që pranohet nga shoqëria, me vështirësi mund të pranojnë dhe standartet e bashkësive shoqërore të kriminalizuara.

Shoqërimi i vazhdueshëm me bashkësitë e kriminalizuara, që shpesh ndodh tek të miturit – shkelës të ligjit, luan një rol kryesor në formimin e qëndrimeve kriminale. Gjatë viteve të fundit, ky problem ka qenë shumë aktual si për psikologjinë juridike, ashtu dhe praktikën ligjore.

Zgjidhja është gjendja e gatishmërisë për një aktivitet të caktuar, nëpërmjet të cilit mund të përmbushet një apo një tjetër nevojë. Si gjendje ajo është jo vetëm më e qëndrueshme, por dhe shumë më e komplikuar dhe e kushtëzuar. Ajo përfshinë si mendimin dhe ndjenjën, ashtu dhe motivin specifik për veprim. Në këtë rast, vet subjekti zakonisht nuk është i vetëdijshëm, se veprimet e tij janë shumë të ndikuara nga një zgjidhje e caktuar. D. N. Uznadze thekson, se “Zgjidhja është gjendja dinamike tërësore e subjektit në një situatë përkatëse objektive”. (Uznaxe, 1985).

Zgjidhjet paracaktojnë marrëdhëniet me tërheqjen ose shtytjen, magjepsjen ose neveritjen, ndjeshmërinë e individit ndaj një ngjarje të caktuar. Nëpërmjet tyre garantohet shpejtësi dhe një drejtim i reaksioneve të sjelljes, e cila nganjëherë është shumë e padëshirueshme dhe e rrezikshme, mbasi lehtëson dhe ndihmon procesin e angazhimit të individit në kryerjen e krimeve konkrete.

Duke analizuar rolin e qëndrimeve, L. Festinger thekson, se “njeriu mund të kryej gjëra të ndryshme, madje nganjëherë të çuditshme për arsyen e shëndoshë, për të zvogëluar mospërputhjet midis besimeve, bindjeve dhe veprimeve”. (Stamatov, & Minçev, 2003, 335) Ai gjithashtu ofron shpjegimin, e njohur si “teoria e dizoncës kognitive.”

Kjo dukuri shpesh mund të konstatohet dhe tek angazhimi kriminal i të miturve. Bëhet fjalë për prani të mospërputhjes midis bindjeve dhe veprimeve të tyre, përmes të cilave shkelen normat ligjore.

Në veprimet kriminale të adoleshentëve realisht përfshihen mendimet, ndjenjat dhe pasionet kriminogjen, të cilat jo gjithnjë përputhen me bindjet e tyre reale për një apo një tjetër detyrim të

individit. Siç argumentojnë psikologët kriminalist, në situata kritike dhe konfliktuale ata më tepër janë nën pushtetin e ndjenjave të veta, sesa të vlerësimit gjakftohtë të asaj që ndodhë. (Grigorov, 2003, 59).

Komunikimi i vazhdueshëm me një mikromjedis social të angazhuar kriminal luan një rol themelor lidhur me stabilitetin e qëndrimeve kriminale të adoleshentëve dhe forcimin e rolit të tyre stimulues në angazhimin kriminal. Ato lehtësojnë realizimin e angazhimeve kriminale, mbasi në aktualizimin e tyre, kufizohen seriozisht funksionet kontrolluese të vetëdijes.

Do të ishte shumë gabim, nëse „stimulatorët psikik” e paraqitur (përsheptues të adoleshentëve) shqyrtohen të izoluar njëri nga tjetri. Ndikimi i tyre mbi sistemin motivues të adoleshentëve – shkelës të ligjit, gjithnjë është i kondicionuar reciprokisht. Ndikim shumë të madh kanë dhe deformimet që ndodhin në vetëdijen e tyre morale dhe juridike.

Jo veç e veç, por gjithë kompleksi i pasioneve dhe qëndrimeve kriminale përshepton dhe lehtëson procesin e kriminalizimit të sjelljes së adoleshentëve. Këta janë raste, ku ata jo vetë që përsërisin krimet e tyre, d.m.th. recidivojnë, por në mënyrë të qëndrueshme përfshihen në mënyrën e jetës kriminale. Angazhimi kriminal gradualisht bëhet pa alternativë për formimin shoqëror dhe suksesin në jetë.

Bibliografi

- Breton, Ph.S., Proulx.(1996). *L'explosion communication*. Paris.
- Begeja, S. (1999). *Kriminalistika*. Tirane. p.78.
- Cazeneuve, J. (1976). *Le communications de masse*. Paris
- Dragoti, E.(2007). *Psikologji ligjore e kimit*. Tirane. p.17,148.
- Grillo, K.(2011). *Psikologji e komunitetit*. Elbasan. p. 60.
- Grigorov, I. (1973). *Mjedisi i ngushtë shoqëror dhe aktet antishoqërore të nxënësve*. Sofie
- Haris, T. (1991). *Unë jam i mirë ti je i mirë*. Sofie.
- Ibrahimi,L. (2011). *Psikologji e sjelljes devijante*. Elbasan. p. 169.
- Panev, B. (1977). *Vetëdija juridike dhe kriminaliteti*. Sofie.
- Malecke, G. (1994). *Psikologjia e komunikimit masiv*. Sofie.
- Ratter, M. (1986). *Në ndihmë të fëmijëve të vështirë*. Moske.
- Panev, B. (1977). *Vetëdija juridike dhe kriminaliteti*. Sofie.
- Uznaxe, D. (1985) *Orientimi, sjellja, veprimtaria*. S.
- Schramm, W. (1964). *L'influence de la television sur les enfants et les adolescents*. Paris.
- Stankov, B. (1981). *Adoleshenti dhe kriminaliteti*. Sofie.
- Stajenberg, Xh. (1986). *Në lindje të Parajsës*. Sofie.

Sistemi juridik shtetëror. Raporti i akteve normative.

Prof. As. Dr. Ilir Berhani
Universiteti i Shkodrës “L.Gurakuqi”
Fakulteti i Drejtësisë

Abstrakt

Sistemi juridik shtetëror përbëhet nga një kompleks normash rregulluese, që vendosen nga shteti përmes akteve normative rregulluese. Aktet normative juridike janë të shumëllojta dhe kanë fuqi të ndryshme. Por, sistemi juridik shtetëror, është homogjen. Aktet normative të sistemit juridik shtetëror janë të lidhura e të ndërvarura dhe nuk mund të jenë në konflikt me njëri tjetrin. Aktet normative, në sistemin juridik shtetëror, i nënshtrohen një hierarkie të fuqisë juridike, që është përcaktuar nga ligji themelor i shtetit. Në këtë punim do të shqyrtohen llojet e akteve normative, që vendosin normat rregulluese shtetërore, vendi i akteve rregulluese dhe fuqia juridike e këtyre akteve në sistemin juridik shtetëror.

Çështje të parë punimi trajton aktet normative me fuqi të përgjithshme, që kanë fuqi në të gjithë territorin e shtetit: kushtetuta, marveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligji dhe aktet normative të ekzekutivit. Një analizë e hollësishme i bëhet të drejtës ligjvënëse të ekzekutivit. Tipareve të pushtetit ligjvënës të ekzekutivit, veçanërisht akteve normative të ekzekutivit me fuqinë e ligjit. Vendi i aktit normativ me fuqinë e ligjit në sistemin juridik shtetëror, bazuar në të drejtën tonë kushtetuese dhe në kushtetutat e shteteve të tjera. E drejta e ekzekutivit për të nxjerrë akte me fuqinë e ligjit, si e drejta përjashtimore ligjvënëse. Jurisprudenca e gjykatës kushtetuese mbi të drejtën e qeverisë për të nxjerrë akte me fuqinë e ligjit. Çështje të dytë punimi trajton llojet e akteve normative nënligjore të ekzekutivit, për zbatimin dhe ekzekutimin e ligjeve dhe aktet normative, me fuqi juridike specifike, të ministrave dhe të organeve qendrore të ekzekutivit, që bëjnë pjesë në nivelin e dytë të burimeve të së drejtës së shtetit dhe u nënshtrohen akteve të rendit të parë. Çështje të tretë punimi trajton aktet me fuqi juridike territoriale domethënë aktet administrative të organeve të qeverisjes vendore ose aktet e nivelit të tretë. Këto akte e u nënshtrohen akteve normative juridike të rendit të parë dhe të dytë të burimeve të së drejtës. Normat rregulluese të qeverisjes vendore nuk mund të jenë në kundërshtim me normat juridike rregulluese, që përbëjnë rendin e parë e të dytë në hierarkinë juridike të sistemit të së drejtës së shtetit.

Fjalë kyçe: kushtetuta, ligji, akti normativ, dekretligjet, aktet normative specifike, aktet normative të organeve vendore.

Hyrje

Normat rregulluese mbi të cilat bazohet veprimtaria e shtetit dhe individëve, subjekteve e personave janë rregulla juridike që vendosen nga shteti, përmes veprimtarisë së organeve shtetërore. Vetëm shteti, me anë të organeve të veta të përcaktuara, ka të drejtë të nxjerrë dhe mund të shpallë norma rregulluese juridike. Shpallja e normave rregulluese juridike me fuqi të përgjithshme bëhet duke nxjerrë akte normative. Numri i madh dhe shumëllojshmëria e mardhënieve juridike në shoqëri, numri i madh i raporteve ndërmjet individëve dhe subjekteve në shtet, sjell si pasojë numër të madh dhe të shumëllojtë të akteve normative, që rregullojnë këto mardhënie dhe raporte. Pra, veprimtaria shtetërore rregullohet përmes normave rregulluese të përgjithshme, të cilat vendosen me anë të akteve normative juridike. Aktet juridike, që dispijlojnë veprimtarinë shtetërore, janë aktet normative, që nxirren nga organet e shtetit, në bazë të funksioneve dhe të kompetencave që ato zotërojnë. Këto akte normative juridike përbëjnë të drejtën e shtetit që është baza dhe kufiri i veprimtarisë shtetërore (RSH Kushtetuta, 1998/ 4,1.) “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit” Aktet normative, duke qenë vendosin rregulla të përgjithshme, për të gjithë anëtarët e shoqërisë, bëhen burim i së drejtës së shtetit. Aktet normative janë të ndryshme dhe të shumta dhe hyjnë në fuqi kur formulohen dhe shpallen në formën e përcaktuar. Në shtetet e sotme hasim burime të shumta dhe të variuashme të akteve normative, me anën e të cilave shtetet vendosin norma rregulluese dhe për rrjedhin strukturojnë sistemin juridik të shtetit. Organet e shtetit, të cilat brenda funksionit dhe kompetencës së tyre, nxjerrin akte normative, janë të shumta dhe të ndryshme. Aktet normative

janë të disallojshme dhe diferente. Por, aktet normative, formojnë një sistem aktesh të lidhur e të ndërvarur, të grupuar dhe të vendosur në një hierarki juridike. Rregulli për qëndrueshmërinë dhe për mirëfunksionimin e sistemit juridik shtetëror është moskontradiksioni dhe ndërvarësia e akteve normative. Në parim aktet më të ulta rregulluese u nënshtrohen akteve normative më të larta dhe duhet të përputhen me to.

Aktet normative me fuqi të përgjithëshme

Sipas kushtetutave të shteteve, aktet me fuqi të përgjithëshme, që shtrijnë fuqinë e tyre juridike në të gjithë territorin dhe për të gjithë subjektet, janë zakonisht kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti, ligjet dhe aktet normative të ekzekutivit. Në Shqipëri, bazuar në ligjin themelor të shtetit, aktet normative klasifikohen në: **a-** akte me fuqi të përgjithëshme, kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet, aktet normative të këshillit të ministrave; **b-** akte me fuqi specifike, aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve qendrore; **c-** akte me fuqi territoriale, aktet normative të organeve të qeverisjes vendore (RSH Kushtetuta, 1998/116, 1/2/3) 1. *“Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin .. / janë: a) kushtetuta, b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, c) ligjet, ç) aktet normative të KM. 2. Aktet ... pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial”. 3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve ... të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin... brenda sferës së juridiksionit të tyre”.* Por, në sistemin juridik shtetëror, aktet normative të të gjitha llojeve, aktet me fuqi të përgjithëshme, me fuqi specifike dhe me fuqi territoriale të kufizuar, janë në korrelacion ndërmjet tyre, duke siguruar që sistemi juridik të mos karakterizohet nga konflikte ndërmjet këtyre normave të së drejtës. Prandaj në Kushtetutë krahas klasifikimit të mësipërm përcaktohet dhe raporti ndërmjet këtyre akteve normative juridike, si një raport përputhje, në të cilin aktet më të ulta normative juridike u nënshtrohen akteve më të larta duke qenë në përputhje me to. Në Kushtetutën nga pikpamja e fuqisë juridike rendi i renditjes së akteve, duke filluar nga akti më i lartë është: kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet, aktet e ekzekutivit, aktet specifike të organeve qendrore dhe në fund aktet e organeve të qeverisjes vendore.

1.2. Kushtetuta, akti normativ themelor i shtetit

Akti normativ fundamental i shtetit dhe me fuqinë më të lartë juridike është Kushtetuta. (RSH Kushtetuta, 1998/116/1) Kjo e bën kushtetutën burimin e parë dhe më të lartë normativ juridik. Për rrjedhim normave të kushtetutës u nënshtrohen të gjitha normat e tjera juridike të përcaktuara nga aktet e tjera normative të shtetit. Çdo akt normativ, çdo normë e së drejtës së shtetit, duhet të jetë në përputhje me këtë akt normativ themelor, fundamental, me kushtetutën.

1.3. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara

Normat e së drejtës ndërkombëtare, edhe pse bëjnë pjesë në sistemin e jashtëm të burimeve juridike, i bashkohen sistemit të brendshëm juridik të shtetit, duke u bërë pjesë e sistemit të së drejtës së shtetit. (RSH Kushtetuta, 1998/122) *“Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik...”* Në hierarkinë normative, të së drejtës së shtetit, marrëveshjet ndërkombëtare janë nën kushtetutën dhe mbi gjithë aktet e tjera juridike normative të shtetit. (Kushtetuta e RSH 1998/122/2) *“Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.* Kjo përcaktohet për faktin se vetë shteti, në ligjin themelor, ka parashikuar të drejtën të përfshijë në sistemin e brendshëm juridik akte normative të së drejtës ndërkombëtare, pasi i ka ratifikuar ato, dhe njëkohësisht kushtetuta parashikon një dispozitë që detyron zbatimin e drejtpërdrejtë të drejtës ndërkombëtare të detyrueshme. (RSH Kushtetuta, 1998/5). *“Republika e*

Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”.

1.4. Ligji akti kryesor normativ

Në tërësinë e akteve normative, që organet shtetërore nxjerrin, ligji është akti kryesor normativ, që shteti përdor më shumë, për të vendosur rregullat e sjelljes dhe veprimet të individëve dhe subjekteve, por jo akti i vetëm normativ i së drejtës. Ligjet janë akte normative të organit ligjvënës, por ligjet nuk janë akti normativ me fuqinë më të lartë. Ligjet kanë fuqi juridike poshtë kushtetutës dhe marveshjeve ndërkombëtare. Ligjet nuk mund të jenë në kundërshtim me kushtetutën dhe me marveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Ligjet në kundërshtim me këto dy akte normative më të larta shfuqizohen. Në vendin tonë këtë funksion e kryen Gjykata Kushtetuese. (RSH Kushtetuta 1998 /131/a.) *“Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit ,e kushtetutën dhe me marveshjet ndërkombëtare”*

Ligji është akti i pushtetit shtetëror. Aktet normative, të cilat nuk janë nxjerrë nga shteti, si aktet e së drejtës zakonore, megjithëse kanë fuqi të përgjithëshme, nuk janë ligje. Vetëm shteti, nëpërmjet organeve ligjvënëse, vendos ligje. Në vendin tonë organi ligjvënës është Kuvendi. Aktet normative të nxjerra nga organet e tjera të shtetit, në ushtrim të funksionit të tyre, nuk janë ligje. Ligji është akt normativ, që vendos një të drejtë të re, një normë të re të përgjithëshme. Nisur nga pozita e ligjit në hierarkinë e akteve normative shtetërore, ligji është akti normativ me fuqi juridike të posaçme dhe si rregull, ligji mund të shfuqizohet ose të ndryshohet vetëm me një ligj tjetër. Në hierarkinë e akteve normative ligji është me fuqi mbi të gjitha aktet normative të ekzekutivit (përfshirë veçanësisht aktet normative të ekzekutivit me fuqinë e ligjit). Për konsekuencë, aktet normative të ekzekutivit, nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin, por përkundrazi duhet të jetë në përputhje me ligjin. Aktet normative të organeve të ekzekutivit, dukeqenëse këto organe nuk kanë kompetenca ligjvënëse, nuk janë ligje, sidoqë të jetë përmbajtja e tyre, edhe kur ato vendosin rregulla të përgjithëshme. Duke mos qenë ligje, aktet e organeve të ekzekutivit, në rastin kur vendosin rregulla të përgjithëshme, janë akte normative juridike dhe janë burim i së drejtës së shtetit. Megjithatë akte të tilla gjithnjë janë nën ligjin dhe emërtohen akte nënligjore.

1.5. Aktet normative të Kryetarit të Shtetit dhe të Ekzekutivit

Në ligjin themelor të shtetit, përcaktohen organet që zotërojnë të drejtën për të nxjerrë akte normative, rregulluese. Përveç organit ligjvënës, zotërojnë të drejtën të nxjerrin akte normative kryetari i shtetit, qeveria, ministrit dhe organet e qeverisjes vendore. Format e akteve normative që përcaktojnë rregulla të reja juridike janë të ndryshme dhe specifike. Kjo formë përcaktohet nga organi që miraton / që nxjerr aktin normativ.

a- Dekretet e kryetarit të shtetit.

Ka mjaft kushtetuta të cilat parashikojnë të drejtën e kryetarit të shtetit për të nxjerrë akte normative, akte rregulluese me karakter të përgjithshëm. Akti me anën e të cilit, kryetari i shtetit përcakton normat e reja juridike është dekreti me karakter normativ. Në vendin tonë kjo e drejtë kryetarit të shtetit, presidentit të shtetit ju njoh me ligjin “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”. Kjo kushtetutë e përkohëshme kishte përcaktuar që Presidenti i Republikës mund të miratonte, në kushte të përcaktuara nga ky ligj themelor i përkohshëm, dekrete me karakter të përgjithshëm. Por, Presidenti nxjerr dekrete normative vetëm në raste emergjente / të ngutëshme dhe këto dekrete duhet të paraqiten për miratim në Kuvend në sesionin më të afërt legjislativ. (Ligji 7491 1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”/28.) *“...dekrete e nxjerra nga kryetari i shtetit / presidenti mund të përmbanin dhe norma të përgjithshme...”*

Ndërsa Kushtetuta e Shqipërisë në vitin 1998, i hoqi të drejtën Presidentit të Republikës për të nxjerrë dekrete me karakter normativ. Presidenti i Republikës ka të drejtë të nxjerrë dekrete, vetëm me karakter individual. (RSH Kushtetuta, 1998 / 93)

b- Aktet normative të Ekzekutivit.

Kushtetuta e vitit 1998 ia heq Presidentit të drejtën për të nxjerrë akte normative dhe ia njeht ekzekutivit. (RSH Kushtetuta/116) Ekzekutivi, në veprimtarinë e vet, ka të domosdoshëm dhe të pashmangshëm nxjerrjen e akteve normative në urdhërim dhe në zbatim të ligjit. Vetë ligjet përcaktojnë detyrimin e ekzekutivit të nxjerrë akte. Këto aktet normative të ekzekutivit, në urdhërim dhe zbatim të ligjit, janë nën ligjin dhe konsiderohen akte nënligjore. Forma kryesore e akteve të ekzekutivit janë vendimet dhe udhëzimet. (RSH Kushtetuta,/100/5) *“Këshilli i ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime”* Aktet normative të qeverisë nuk janë të barabarta me ligjin në hierarkinë juridike. Së pari: sepse ato nuk janë akte të organit ligjvënës. Ato nuk plotësojnë kushtin e parë formal për t’u konsideruar ligje ose të barabarta me ligjin. Së dyti: edhe pse janë të ngjashme me ligjin sepse janë akte normative, që krijojnë një të drejtë të re, nuk janë të barabarta me ligjin, sepse ato urdhërohen nga ligji dhe dalin në urdhërim dhe për zbatimin e ligjit. Këto akte në gjuhën juridike emërtohen akte nënligjore dhe janë gjithnjë objekt i rishikimit gjyqësor.

c- *Akti normativ me fuqinë e ligjit*

Krahas akteve nënligjore, në kushtetutat e mjaft shteteve, është parashikuar e drejta e qeverive të nxjerrin akte normative me fuqinë e ligjit, të barabarta me ligjin, e drejta e qeverisë të nxjerrë norma që mund të ndryshojnë ose shfuqizojnë dispozita ligjore ekzistuese ose të vendosin norma krejt të reja. Kjo nuk çënon të drejtën ligjvënëse të organit legjislativ. Ligjvënësia mbetet prerogative, e drejtë ekskluzive, e parlamentit. Aktet normative me fuqinë e ligjit, qeveritë mund t’i nxjerrin rrallë, vetëm në raste emergjence, dhe vetëm për situata të jashtëzakonshme, dhe janë akte me fuqi të përkohëshme, deri kur të mblidhet organi ligjvënës për t’i miratuar ose jo dhe mbeten në fuqi dhe shtrijnë fuqinë e tyre, që nga momenti i shpalljes, vetëm në qoftë se miratohen nga organi ligjvënës. Në të kundërt shfuqizohen që në momentin e miratimit. Në praktikë qeveritë e shteteve të sotme janë legjislatorë si dhe parlamentet, megjithëse me ndonjë kufizim. (Omari L. 2011,33) Edhe kushtetuta jonë parashikon të drejtën e Këshillit të Ministrave të nxjerrë norma të përgjithshme, me fuqinë e ligjit, të barabarta me ligjin, vetëm në raste urgjence, për marrjen e masave të përkohëshme, akte që e humbasin fuqinë e tyre në qoftëse nuk miratohen brenda 45 ditëve nga kuvendi. (RSH Kushtetuta /101) *“Këshilli i Ministrave në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative, që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohëshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda pesë ditëve nëse nuk është i mblledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga kuvendi brenda 45 ditëve”*. Megjithëse parimi bazë i organizimit të shtetit është ndarja e pushteteve. (RSH Kushtetuta /7) *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe ballancimin e pushteteve”* në shtetet e sotme vërehet qartë interferimi i ekzekutivit në ligjvënësi, me të drejtën të nxjerrë akte të barabarta me ligjin. Kushtetutat parashikojnë pushtet ligjvënës ekzekutiv, të nxjerrë vetë drejtpërdrejt “ligje”, ose akte me fuqinë e ligjit, që sjellin të njëjtat konsekuenca juridike si ligjet. (Vignocchi G, Ghetti G. 1999, 301-302) Këto akte normative të ekzekutivit emërtohen të barabarta me ligjin sepse për të siguruar efektshmërinë e ligjit formal duhet më pas ndërhyrja e vullnetit të legjislativ. (Vignocchi G, Ghetti G.1999. 301) Aktet normative me fuqinë e ligjit janë norma abstrakte të përgjithshme si edhe ligji; përfshijnë shfuqizimin e ligjeve ose të akteve të barabarta me to, shfuqizimin e pjesëve ose dispozitave të ligjeve në fuqi. Këto akte janë ligje, pavarësisht nga emërtimi që marrin për t’i dalluar nga ligjet dhe aktet e tjera normative, që nxjerrin organet qeverisëse. Në vende të ndryshme është përhapur gjërësisht praktika, ku vetë kushtetuta e pranon, në rast urgjence ose kur e vendos parlamenti nëse e quan oportune dhe nëse kushtetuta nuk e ndalon, që qeveria të autorizohet të nxjerrë... norma që edhe mund të ndryshojnë ose të shfuqizojnë dispozitat ligjore ekzistuese ose të vendosë norma krejt të reja. Por në këto raste është normale që qeveria të ketë një kufizim kohor dhe që aktet e miratuara prej saj të marrin edhe konfirmimin legjislativ nga parlamenti. Në mungesë të këtij konfirmimi, pas një afati të caktuar, aktet normative të vendosura nga qeveria shfuqizohen.” (Omari L.2011,34-35)

Mjaft shtete kanë parashikuar pushtet legjislativ të ekzekutivit. Shpesh këto “ligje” emërtohen

dekretligje ose dekrete legjislative ose ligje të nivelit të dytë, për shkak se për të siguruar efikasitetin e ligjeve formale duhet t'i nënshtrohen menjëherë vullnetit të parlamentit. Vetëm kur parlamenti jep pëlqimin, me ose pa modifikim për këto lloje aktesh ligjore, ato sigurojnë fuqinë definitive, përfundimisht. (Vignocchi G, Ghetti G. 1999, 301)

E drejta e ekzekutivit të nxjerrë akte ligjore ose të barabarta me ligjin, të cilat e humbin fuqinë e tyre që nga fillimi, në rastin kur nuk miratohen nga organi ligjvënës, brenda afatit të përcaktuar në kushtetutë, është parashikuar në kushtetutën e Italisë, (Kushtetuta e Italisë / 77.) . *“Qeveria nuk mund, pa delegimin e Dhomave, të nxjerrë dekrete që kanë vlerën e ligjit të zakonshem. Kur, në rast të jashtëzakonshme domosdoshmerie dhe urgjence, Qeveria, nën përgjegjesinë e vet, merr masa të perkohshme që kanë fuqinë e ligjit, duhet po atë ditë t'ua paraqite për t'i kthyer në ligj Dhomave, të cilat, edhe po të jene të shperndara, thirren enkas dhe mblidhen brenda pese diteve. Dekret e humbasin fuqinë që nga fillimi, në rast se nuk kthehen me ligj brenda 60 diteve që nga botimi i tyre. Megjithatë Dhomat mund të rregullojnë me ligj marrëdhëniet juridike të lindura mbi bazën e dekreteve të pakthyer në ligj.”*, në kushtetutën e Francës, (Kushtetuta e Francës / 38) *“qeveria për realizimin e programit të saj mund t'i kërkojë parlamentit autorizimin për të marrë me anë urdhërësash, brenda një kohe të kufizuar, masa të cilat normalisht do të përfshiheshin në kompetencat e ligjit. Këto urdhëresa vendosen nga Këshilli i Ministrave, pasi merret mendimi i Këshillit të shtetit. Ato hyjnë në fuqi me botimin e tyre, por shfuqizohen në qoftëse projektligji për ratifikimin e tyre nuk i paraqitet Parlamentit përpara datës së caktuar nga ligji i autorizimit. Me mbarimin e afatit për të cilin bëhet fjalë në paragrafin e parë të këtij neni, urdhëresat mund të ndryshohen vetëm me ligj.”*, në kushtetutën e Greqisë, (Kushtetuta e Greqisë / 44) *“Në rast të jashtëzakonshme të një nevojë shumë të ngutëshme e të paparashikuar, presidenti... me propozim të kryeministrit, mund të nxjerrë akte me përmbajtje legjislative. Këto akte i parashtröhern Dhomës së Deputetëve për ratifikim.... Brenda 40 ditëve që nga nxjerrja e tyre ose brenda 40 ditëve që nga thirja e dhomës në sesion. Nëqoftëse nuk i parashtröhern Dhomës në afatet e mësipërme ose nëqoftëse nuk ratifikohen prej saj brenda tremuajve që nga paraqitja e tyre, ato humbasin fuqinë për të ardhmen.”*, në kushtetutën e Rumanisë, (Kushtetuta e Rumanisë / 114 / 4) *“Delegimi ligjvënës. “Në rast të jashtëzakonshme qeveria mund të nxjerrë urdhëresa urgjente. Këto hyjnë në fuqivetëm pas depozitimit në parlament me synim që të miratohen. Nëqoftëse parlamenti nuk është në sesion, ai do të mblidhet vetiu”*. si dhe në kushtetuta të tjera.

c- Jurisprudenca e gjykimit kushtetues për aktet me fuqinë e ligjit.

Në botë dhe në vendin tonë ekziston jurisprudencë kushtetuese e zhvilluar, për të drejtën ligjvënëse të ekzekutivit. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë e drejta e qeverisë për të nxjerrë akte me fuqinë e ligjit është një normë lejuese. (Gjykata Kushtetuese vendim 24, 2006) Kushtetuta këtë të drejtë e shikon si përjashtim në procesin e ligjvënies. Madje akti normativ i qeverisë është nul, nëse ai nuk miratohet nga organi ligjvënës. Efektet e këtij akti janë të perkohshme me një afat shumë të shkurtër. Ky akt për të qëndruar në fuqi detyrohet t'i nënshtrohet kontrollit të parlamentit. Gjykata Kushtetuese vlerëson se aktet normative janë instrumente ligjore që përdor qeveria, për të zgjidhur situata të veçanta, por gjithnjë janë subjekt i mbikëqyrjes së rreptë parlamentare.

Nxjerrja e akteve normative me fuqinë e ligjit duhet të justifikohet, në çdo rast me praninë e rrethanave të veçanta, që bëjnë të nevojshëm miratimin e aktit, dhe që përcaktojnë legjitimitetin kushtetues të këtyre akteve. Rrethanë e veçanta, sipas jurisprudencës kushtetuese nënkupton devijim nga e zakonshmja, një situatë faktike objektive, e përcaktueshme, e pavarur nga vullneti i qeverisë, e cila vë në rrezik interesin publik. Situata e veçantë duhet të jetë objektive, ajo nuk duhet të varet nga vullneti i qeverisë, i cili, në të tilla rrethana, kushtëzohet nga nevoja e reagimit të menjëhershëm, më qëllim mbrojtjen e interesit publik, me anë të akteve normative me fuqinë e ligjit, kurse urgjenca e këtyre rregullimeve mund të rezultojë nga justifikimet e paraqitura nga qeveria në debatet parlamentare mbi ligjin që miraton aktin qeveritar. (Gjykata Kushtetuese vendim 5.,2014)

Jurisprudenca kushtetuese vlerëson se, nisur nga natyra përjashtimore e kompetencës së Këshillit të

Ministrave në nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, në respekt të hierarkisë së burimeve të së drejtës, të kërkesave që burojnë nga parimi i ndarjes dhe balancimit midis pushteteve dhe vlerave mbi të cilat bazohet shteti i së drejtës, para së gjithash, kufijtë e diskrecionalitetit që ka qeveria, në vlerësimin e situatës së jashtëzakonshme dhe të nevojës urgjente, përcaktohen dhe i nënshtrohen kufizimeve kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar Aktin normativ të Këshillit të Ministrave të datës 30 shtator 2013, konstatoi se nuk janë respektuar kriteret dhe kufizimet kushtetuese procedurale dhe lëndore. Kjo përbën një të metë të legjitimitetit kushtetues të qeverisë për nxjerrjen e aktit normativ dhe, po ashtu, një të metë të ligjit që ka miratuar Kuvendi. (Gjykata Kushtetuese vendim 5, 2014) Akti normativ me fuqinë e ligjit është ligj në kuptimin material, por jo në kuptimin formal sepse ai rregullon mardhënie që janë lëndë e ligjit. Kushtetuta parahikon të drejtën e ekzekutivit, në kushtet e nevojës dhe urgjencës, të rregullojë lëndën përkatëse me akt normativ, i cili nëse miratohet nga parlamenti kthehet në ligj formal. Akti normativ ka fuqi të përkohëshme deri në miratimin e tij nga parlamenti. Sipas kushtetutës sonë ai duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga parlamenti brenda 45 ditëve, ndryshe ai është nul që nga dita kur është miratuar nga qeveria. Gjykata Kushtetuese vlerëson se Kuvendi disponon tagre të plota për ta miratuar ose jo aktin normativ ose për të mos u shprehur për aktin brenda afatit kohor të përcaktuar nga kushtetuta. (Zaganjori Xh, Vorbsi A, Biba D. 2012, 235-236) Ndërsa sipas kushtetutës italiane ai duhet të miratohet brenda 60 ditëve. (Vignocchi G, Ghetti G.1999, 302)

2. Aktet normative me fuqi specifike.

Në ushtrim të kompetencave ekzekutive qeveria dhe ministrat, në ushtrim të veprimtarisë së tyre ekzekutive, nxjerrin akte të shumta e të shumëllojshme, me fuqi nën ligjin, që ndryshe njihen akte nënligjore. Sipas lëndës që rregullojnë, dallojmë aktet normative për ekzekutimin, e plotësimin e ligjeve (përfshihen aktet për çeshtje që u janë rezervuar kompetencave të organeve rajonale dhe vendore); aktet normative në mungesë të ligjit, (gjithnjë nëse çështja nuk është objekt i rezervës së zakonshme të ligjit); aktet normative për organizimin dhe funksionimin e administratës publike, dhe aktet normative që rregullojnë organizimin e mardhëniet e punës. Ndërsa sipas subjektit, që nxjerr aktin normativ, nënligjor, dallojmë aktet normative të qeverisë; aktet normative të ministrave dhe aktet e autoriteteve më poshtë ministrit. Aktet normative të qeverisë të ministrave dhe të organeve të tjera qëndrore, për të hyrë në fuqi, duhet të përfshihen në përmledhjen zyrtare të ligjeve dhe dekreteve të republikës dhe të publikohen në gazetën zyrtare. (RSH Kushtetuta / 112 / 1) *“ligjet, aktet normative të KM, të ministrave, të institucioneve të jera qëndrore, marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”*.

Aktet normative të ekzekutivit dhe pse ngjasojnë me ligjin për faktin se vendosin norma të reja, nuk janë të barabarta me ligjin, janë akte për ekzekutimin e ligjit, për lëndë që janë të rregulluara nga ligji, për rrjedhim janë akte nënligjore. Madje edhe aktet e pavarura, që i besohen pushtetit ekzekutiv, për lëndë, që nuk janë të rregulluara nga ligji, janë akte nën ligjore. Akte nënligjore janë dhe aktet e deleguara të ekzekutivit nga pushtetit legjislativ, përmes të cilave ekzekutivi në bazë të një norme të shprehur, ka autorizimin për të kaluar kufijtë e vendosur nga pushteti ligjvënës. Nisur nga ky raport që kanë me ligjin, këto akte normative të ekzekutivit konsiderohen si akte të nivelit të dytë, nën ligjin. Fuqia normative e këtyre akteve të ekzekutivit, që konsiderohen akte normative administrative, haset me dy kufizime themelore: kufizimit lëndor “të rezervës së ligjit”, të cilat nuk i përkasin veprimtarisë rregulluese administrative të ekzekutivit, kufizimi i fuqisë juridike, domethënë asnjë akt normativ administrativ i ekzekutivit nuk mund të abrogojë ose të modifikojë ligjet formale ose aktet normative të barabarta me ligjet. (Vignocchi G, Ghetti G. 1999, 308)

3. Aktet normative të organeve vendore të pushtetit.

Rregulla të përgjithshme, që përcaktojnë sjelljen dhe veprimtarinë e individëve dhe të personave juridikë, kanë të drejtë të vendosin edhe organet vendore të pushtetit. Por në diferencë me aktet e ekzekutivit dhe në diferencë me ligjin aktet e organeve vendore të pushtetit, brenda kompetencave të

tyre, janë norma, që nxiren për ekzekutimin e ligjeve, që në mënyrë të shprehur i atribuojnë organeve një pushtet të tillë rregullues, normativ. Për konsekuencë aktet e organeve vendore janë subjekt i kontrollit administrativ dhe i rishikimit gjyqësor. Këto norma kanë ose karakterin e rregullave të autorizuar që mbushin boshllëqet legjislative, ose janë norma që bëjnë pjesë në autonominë e këtyre organeve të pushtetit. Në këto norma hyjnë të gjitha ato rregulla që ligjet ia atribuojnë në kompetencë organeve vendore. Aktet e organeve vendore duke qenë akte administrative i nënshtrohen qoftë kontrollit administrativ për ligjshmëri qoftë kontrollit gjyqësor. Qoftë normat e provincave dhe ato të komunave, si akte administrative dhe nga ana formale dhe nga ana materiale, janë subjekt i kontrollit të zakonshëm nga komitetet rajonale të kontrollit dhe i shqyrtimit gjyqësor nga gjykata administrative. (Vignocchi G, Ghetti G. 1999,308)

Përfundime

Nga analiza e akteve normative të sistemit juridik shtetëror arrihet në përfundimin se dy janë parimet bazë që sigurojnë qëndrueshmërinë dhe funksionimin e sistemit juridik të shtetit: kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Këto janë parime të pranishme në organizimin e sistemit juridik shtetëror që në shfaqjen e shtetit liberal. Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë jo vetëm përcaktohen dhe parashikohen në ligjin themelor të shtetit, por kushtetutat e sotme kanë parashikuar garanci normative juridike, institucionet dhe organet që sigurojnë zbatimin e tyre. Normat rregulluese të sistemit shtetëror janë të ndërvarura, të lidhura dhe i nënshtrohen raporteve plotësisht të përcaktuara në lidhje me fuqinë e tyre juridike. Kushti i parë parimor është që normat rregulluese duhet t'i nënshtrohen kushtetutës. Çdo normë, për rrjedhim çdo akt normativ që vjen në kundërshtim me aktin themelor normativ, kushtetutën, shfuqizohet. Organet dhe mënyrat e kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve janë të ndryshme. Shqipëria kontrollin kushtetues të akteve normative e realizon përmes një gjykate të specializuar, gjykatës kushtetuese. Ndërsa parimi i dytë kërkon që aktet normative të nivelit të dytë dhe aktet normative të nivelit të tretë të përputhen me ligjin. Kontrolli i ligjshmërisë së akteve normative nënligjore realizohet nga gjyqësori. Këto akte, duke qenë akte nënligjore, duhet t'i nënshtrohen ligjit dhe të jenë në përputhje me të. Për konsekuencë të gjithë këto norma janë të kontrollueshme në gjykatë, duke qenë subjekt i rishikimit gjyqësor.

Referencat

- Omari Luan (2011) "Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese". Tiranë
- Vignocchi Gustavo, Ghetti Giulio (1999) "Corso di diritto pubblico" Milano
- Omari Luan (2007) "Parime dhe institucione të së drejtës publike". Tiranë
- Amatto XH. (1962) "Raporti fra norme primarie e norme secondarie Milano
- Omari Luan (2004) "Shteti i së drejtës". Tiranë
- Fromont Michel (2009) "Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës" Tiranë
- Zaganjori Xhezair, Anastasi Aurela (2010) "E drejta Kushtetuese" Tiranë
- Zaganjori Xhezair, Anastasi Aurela, Methasani Eralda. (2012) "[Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë](#)" Tiranë
- Atto normativo voce in Enciclopedia, diritto, vol IV, (1999) Milano
- Zaganjori Xhezair, Vorbsi Arta, Biba Denar. (2012) "Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese" Tiranë
- Carlassare (1960) "Regolamenti dell' esecutivo e principio di legalita" Padova
- Berhani Ilir (2011) "E drejta Publike" Shkodër
- Kushtetuta e RSH (1998)
- Kushtetutat (1995) Albin Tiranë
- Ligji 7491 datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

Instituti i Enfiteozës në Legjislacionin Shqiptar

Evarist Beqiri MND, Doktorant
Kryetar i Degës Juridike; Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH)

Saimir Shatku MND, Doktorant

Abstrakt

Në këtë punim paraqitet në mënyrë të detajuar trajtimi juridik që i ka bërë legjislatori shqiptar institutit të enfiteozës. Duke shfrytëzuar literaturën më të mirë juridike kemi nxjerrë në pah karakteristikat thelbësore të këtij instituti. Analiza përfshin periudhën që nga Kodi Civil i vitit 1929 deri te Kodi Civil aktual. Nëpërmjet këtij artikulli lexuesi mund të evidentoj veçoritë e kontratës së enfiteozës por edhe evoluimin që ka karakterizuar këtë institut në vazhdimësi. Instituti i enfiteozës është një nga më antikët e së drejtës, origjina e tij i ka fillesat në të drejtën romake, në këtë mënyrë edhe studimi i tij paraqet interes të veçantë për studiuesit.

Fjalë kyçe: *Enfiteoza, Kodi Civil i vitit 1929, Kodi Civil i vitit 1994, Të drejta reale mbi sendin e huaj.*

Hyrje

Enfiteoza dhe superficia janë të drejta reale mbi sendin e huaj, të konceptuara në një këndvështrim të tillë në fazën e fundit të së drejtës post-klasike, por nuk u përmblohdhën nga bizantinët nën konceptin e servituteve personale.

Motivi i një përjashtimi të tillë duhet të kërkohej në shtrirjen e tyre që përthith pothuajse plotësisht ushtrimin e pronësisë mbi sendin, duke i dhënë enfiteozëmarrësit dhe superficiemarrësit pothuajse të gjitha të drejtat që i përkisnin pronarit, kështu që nuk mund të hiqet një paralele midis këtyre të dyjave dhe servituteve prediale, përmbytja e të cilave konsiston thjesht në kufizimin e disa veprimeve të caktuara të pronarit. Enfiteoza dhe superficia kanë si objekt drejtpërdrejt tokën: mungon ajo lidhja me titullarin e së drejtës që përben thelbin dhe karakteristikën kryesore të servituteve personale. Një tjetër ndryshim përben edhe fakti që enfiteoza dhe superficia janë të drejta të tjetërsueshme dhe të transmetueshme (Voltera, 1993, 425).

Enfiteoza në Kodin Civil të vitit 1929

Në legjislacionin civil shqiptar institutin e enfiteozës e gjejmë të pasqyruar për herë të parë në Kodin Civil të vitit 1929 (Kodi Civil i Zogut). Rregullimi që i bën Kodi Civil i vitit 1929 kontratës së enfiteozës është hartuar duke iu referuar kryesisht legjislacionit Italian dhe atij francez.

Kodi Civil i 1929, neni 1530, parashikon: *"Enfiteosi asht një kontratë, me të cilën i koncedohet një personi (enfiteomarrësit) një pronë, me detyrim që ta përmirësojë dhe të paguajë një prestim të përvitshëm, që quhet kanon dhe që caktohet në të holla ose drithna".*

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë palët për të qenë subjekte të kontratës së enfiteosit në mënyrë që të bëjnë të mundur vlefshmërinë e kontratës janë parashikuar shprehimisht, në nenin 1532: *"Enfiteosi mund të lidhet vlefshëm vetëm prej atyne, që kanë të drejtë jetërsimi, edhe me ato kondita dhe forma që lypen për jetërsim.*

Pronat që zotnojnë të mitunit mund të jepen me enfiteos mbas një vendimi të këshillit familjar ose të tutorisë të homologuem prej gjykatës shk. 1.

Rregullat e caktueme për jetërsimin ose hipotekimin e pronave dotale aplikohen edhe për dhënien e tyre në enfiteos".

Në Kodin Civil të vitit 1929, neni 1531, gjejmë të parashikuar afatin e kohëzgjatjes së kësaj kontrate: *"Enfiteosi mundet me u kontraktue për një kohe jo me pak se tetëmbëdhjete e jo me shumë se nantëdhjetë e nantë vjet; nuk mund të përtërihet heshtësisht".*

Ky nen është ndërtuar duke iu referuar ligjit francez të 25 qershorit 1902, mbi kontratën enfiteotike.

Pra, në këtë mënyrë respektimi i këtyre afateve përbën një nga kushtet thelbësore për vlefshmërinë e kontratës enfiteotike.

Neni 1531 i Kodit të Zogut, përcakton se, kontrata e enfiteosit nuk mund të përtërihet në mënyrë të heshtur.

Subjekte te kontratës së enfiteosit janë enfiteomarrësi, i cili është personi që i jepet prona në mënyrë që ai ta përdor dhe gëzoj njëlloj si pronari, përveç nëse ekzistonte ndonjë klauzolë e kundërt në kontratë, me detyrimin që të paguajë shpërblimin periodik. Subjekti tjetër është pronari ose enfiteodhënësi, i cili e jep sendin në përdorim.

Personi që e jep pronën në enfiteos duhet që të zotëronte një titull për këtë qëllim. Thënë ndryshe, si i tillë mund të paraqitet pronari ose një person që në bazë të ligjit apo ndonjë kontrate ose të një akti administrativ i është dhënë e drejta që ta jap këtë pronë në enfiteos.

Në rolin e enfiteomarrësit mund të jetë një subjekt juridik ose një subjekt fizik. Ai mund të kontrakttojë me persona të tretë, por vetëm me kusht që forma e kontratës apo marrëveshjes së lidhur të kishte formën e kontratës së sipërmarrjes, porosisë apo të ndonjë kontrate tjetër të përafërt me to. Enfiteomarrësi ishte i detyruar të vepronte në këtë mënyrë, mbasi ai nuk mund të lidhte kontratë nën enfiteos. Ky ndalim është i parashikuar shprehimisht në paragrafin e dytë të nenit 1544 ku thuhet: *"Nen enfiteosi nuk permetohet"*.

Sipas Kodit Civil të vitit 1929 palët kishin mundësinë që ta rregullonin vetë përmbajtjen e kontratës sipas vullnetit të tyre, neni 1533: *"Enfiteosi rregullohet simbas konvencionit të palëve dhe, kur nuk ka konvencion, rregullohet simbas dispozitave që vijnë."*

Të drejtat dhe detyrimet e enfiteomarrësit dhe enfiteodhënësit janë parashikuar në nenin 1534 e vijues të Kodit Civil të vitit 1929.

Një karakteristikë tjetër e institutit antik të enfiteozës, që vazhdon ende të ruhet e paprekur në Kodin Civil të 1929, është ajo sipas së cilës enfiteomarrësi nuk mund të kërkojë që të zvogëlojë masën e shpërblimit (kanonit) enfiteotik, as kur i humbin frytet për shkak të rastit fator (forcës madhore), as kur shterojnë frytet e nxjerra nga sendi.

Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 1534: *"Enfiteomarrësi nuk mundet me kerkue zbritjen e kanoneve enfiteotike as për shkak shterpimi, as për shkak humbjeje të fryteve prej rastit fator"*.

Shkaqet e shuarjes së marrëdhëdhënies kontraktore parashikohen në nenin 1536 të Kodit Civil ku thuhet: *"Në rast që enfiteomarrësi nuk paguan kanonin e dy vjetëve rresht dhe refuzon me pague edhe mbas komunikimit të një kujtesjeje, konceduesi ka të drejtë me kerkue prej gjyqtarit zgjidhjen e enfiteosit. Konceduesi mundet më kerkue zgjidhjen edhe në rast që enfiteomarrësi nuk plotëson konditat e kontratës ose cenon randë pronën. Megjithëkëtë, gjyqtari mundet me i akordue një afat, simbas cirkostancave."*

Enfiteomarrësi nuk mund të kryejë në pronë asnjë ndryshim që do të kishte pasoja negative në vlerësimin e saj. Për sa iu përket përmirësimeve ose ndërtimeve që ka kryer enfiteomarrësi, të cilat kanë sjell një rritje të vlerës së pronës. Enfiteomarrësi nuk mund t'i heq apo të kërkojë ndonjë shpërblim për ato. Këto rregulla ishin parashikuar literalisht në nenin 1538 të Kodit Civil të vitit 1929: *"Enfiteomarrësi nuk mund të bajë në pronë asnjë ndryshim, që i pakëson kësaj vleftën. Nëqoftëse enfiteomarrësi ka ba mbi pronën përmirësime ose ndërtime, që i shtojnë vleftën, nuk mund t'i prishë këto, as të kërkojë ndonjë shpërblim"*.

Ndërsa në nenin 1539 të Kodit Civil përcaktohet se: *"Barrët prediale dhe gjithë barrët e tjera që ngarkojnë pronën, janë mbi enfiteomarrësin."*

Enfiteomarrësi detyrohet me ba dhe gjithë ndreqjet e çdo lloj në ndërtesat që ekzistojnë në kohën e kontratës, si dhe në ato që janë ngritë për ekzekutimin e kushteve të kësaj; por nuk obligohet me rindertue godinat, nëqoftëse provon që këto janë shembë për shkak rast fati ose force madhore, ose kanë humbe nga shkak i një vesi të ndërtimit, i cili ves ekzistonte para kontratës. Enfiteomarrësi asht përgjegjës për zjarrin si qiramarrësi".

Enfiteomarrësi kishte të drejtë që të fitonte servitute aktive në dobi të pronës, dhe ta ngarkonte me shkresë me servitute pasive, me kufizimin që servitutet pushojnë me pushimin e enfiteosit. Detyrimi i enfiteomarrësit për të lajmëruar enfiteodhënësin që parashikohet në nenin 1540 të Kodit Civil të 1929, nuk i referohet rastit të fitimit të servituteve aktive në dobi të pronës enfiteotike por vetëm rastit kur do ta ngarkojë pronën enfiteotike me servitute pasive. *"Enfiteomarrësi mundet me vetesue në"*

dobi të pronës servitute aktive, dhe me e ngarkue me shkresë me servitute pasive për një kohë që nuk e kalon atë të enfiteosit dhe duke qenë i detyruem me lajmue konceduesin”.

Servitutet e fituara prej enfiteomarrësit në favor të pronës enfiteotike nuk pushojnë me shuarjen e enfiteosit, por servitutet me të cilat enfiteomarrësi ka ngarkuar pronën, pushojnë (neni 1015).

Enfiteomarrësi për të mbrojtur servitutin mund të ushtronte padinë konfesore (papia pohuese) mbasi edhe ai, gëzon të drejtat e servitutit po si vetë pronari. Meqenëse ky kishte të drejtë të fitonte definitivisht një servitut aktiv, padine pohuese e ushtronte jo në emër të pronarit por në interesin e tij ekskluziv.

”Enfiteomarrësi përfiton, për gjithë kohën sa vazhdon enfiteosi, nga e drejta e akcedimit”(neni 1541 i Kodit Civil të 1929). Kuptimin e nocionit juridiko-civil të institutit të akcedimit e jep neni 801 i Kodit të vitit 1929: *”Zotërimi i një sendi të luajtëshëm ose të paluajtëshëm atribuon të drejtë mbi çka prodhon sendi, ose mbi çka bashkohet natyrisht ose artificialisht me të; kjo e drejtë quhet e drejtë e akcedimit”.*

Kodi Civil i 1929, neni 1542, parashikon edhe mënyrën se si do të zgjidhej situata, në rast se shteti do të vendoste të kryente shpronësime për dobi publike: *”Në rast shpronësimi për dobi publike, enfiteodhanësi detyrohet me ba të dituna të drejtat e enfiteomarrësit. Shpërblimi i shpronësimit u akordohet enfiteodhanësit dhe enfiteomarrësit në pjesë që cakton gjyqtari”.*

Në varësi të llojit të pronës enfiteotike, enfiteomarrësi mundej të gëzonte edhe të drejtën e gjuetisë të peshkimit ose shfrytëzimit të minierave. Këto i parashikon neni 1543 i Kodit të 1929: *”Vetëm enfiteomarrësi ka të drejtën e gjuajtjes dhe të peshkimit, dhe sa për minierat e zotënueshme prej privatëve, ushtron gjithë të drejtat e uzufektuarit”.*

Enfiteoza sipas Kodit Civil të vitit 1994

Kodi Civil i vitit 1994, ka ndjekur traditën e Kodit Civil të Zogut duke mos e rregulluar superficjen (e drejta e sipërfaqes), e cila përben një shmangie nga parimi latin *superficie solo cedit*, sipas të cilit gjithçka që qëndron përmbi ose nëntokë i përket pronarit të tokës.

Në nenet 784-800 të Kodit Civil të 1994, gjejmë të disiplinuar përsëri kontratën e enfiteozës si një kontratë të veçantë.

Enfiteoza është një kontratë, më të cilën një personi i jepet e drejta të përdorjeshme dhe të përmirësoj një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë (Neni 784 i Kodit Civil). Kohëzgjatja e enfiteozës caktohet në kontratë (neni 785 i Kodit Civil). Në këtë mënyrë çdo afat i vendosur nga palët është i vlefshëm dhe duhet të respektohet nga ato.

Sa i takon formën së kontratës, është e nevojshme të bëhet në formën që kërkohet për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme (Neni 786 i Kodit Civil).

Duke qenë se Kodi Civil e parashikon si një kontratë formale *ad substantium*. Ajo duhet të bëhet patjetër me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrat publik, sepse në të kundërt është e pavlefshme.

- Të drejtat e detyrimit e pronarit dhe të enfiteozëmarrësit parashikohen në nenet 787-800 të Kodit Civil.

Enfiteozëmarrësi e gëzon sendin sikurse dhe pronari, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në kontratën për krijimin e enfiteozës. Megjithatë ai nuk mundet që pa pëlqimin e pronarit të përdor sendin në një destinacion tjetër (Neni 787 i Kodit Civil).

Enfiteozëmarrësit i përkasin frytet natyrore të ndara, frytet civile, që janë bërë të kërkueshme gjatë enfiteozës dhe të drejtat e përdorimit të nëntokës në kufijtë e parashikuar në ligj, përveçse kur është parashikuar ndryshe në kontratë (Neni 788 i Kodit Civil).

Kur prona e dhënë në enfiteozë humbet tërësisht, enfiteoza shuhet dhe enfiteozëmarrësi shkarkohet nga detyrimi përkatës për të ardhmen.

Kur prona nuk humbet tërësisht por dëmtohet në mënyrë të dukshme dhe të rëndësishme, aq sa nuk mund të sigurohen të ardhura sa të shlyhet shpërblimi i caktuar në kontratë, atëherë enfiteozëmarrësi ka të drejtë të kërkoj:

- uljen e vlerës së shpërblimit të caktuar në kontratë ose

- prishjen e kontratës së enfiteozës, duke shlyer palët detyrimet reciproke.

Kjo kërkesë duhet të bëhet brenda një viti nga dita që ka ndodhur humbja ose dëmtimi i pronës së dhënë në enfiteozë.

Enfiteozëmarrësi nuk mund të kërkoj shkarkimin nga detyrimi për pagimin e shpërblimit ose uljen e tij, për shkak mos prodhimi ose humbje të fryteve, qoftë edhe për rast fator (Neni 789 i Kodit Civil). Kodi Civil përdor termin “rast fator”, i cili në disa raste përdoret në kuptimin e forcës madhore dhe në disa raste të tjera në kuptimin e dëmit të rastit. Nga pikëpamja juridike “rasti fator” është më afër forcës madhore sesa dëmit të rastit.

Dhënia e pronës në nënenfiteozë nuk lejohet (Neni 790 i Kodit Civil).

Enfiteozëmarrësi mund të kërkoj në çdo kohë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Enfiteozëdhënësi mund të kërkoj zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës kur:

- enfiteozëmarrësi nuk ka shlyer detyrimin përkatës për dy periudha rresht;
- enfiteozëmarrësi e dëmton pasurinë e marr në përdorim;
- enfiteozëmarrësi nuk e mirëmban atë;
- enfiteozëmarrësi nuk përmbush në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga kontrata (Neni 791 i Kodit Civil).

Tatimet dhe detyrimet e tjera që rëndojnë mbi pronën janë në ngarkim të enfiteozëmarrësit, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Kur në kontratë këto detyrime janë lënë në ngarkim të pronarit, ato mund të kalojnë shpërblimin e caktuar për enfiteozën (Neni 792 i Kodit Civil).

Në rast tjetërsimi të enfiteozës, enfiteozëmarrësi i ri dhe ai përpara tij, detyrohen solidarisht për shpërblimin e papaguar të enfiteozës, përveç kur enfiteozëmarrësit të mëparshëm i është njoftuar akti i tjetërsimit prej enfiteozëdhënësit.

Në rast tjetërsimi të një të drejte të tillë prej pronarit, fituesi nuk mund të kërkoj përmbushjen e detyrimeve nga enfiteozëmarrësi përpara se atij t'i njoftohet akti i tjetërsimit (Neni 793 i Kodit Civil). Ky nen lë shteg për diskutime dhe keqinterpretime.

Sa i përket fatit të shtesave ose të përmirësimeve që i bëhen sendit, tek kontrata e enfiteozës është e drejtë e enfiteozëmarrësit t'i heq dhe t'i marr ato, por pa e dëmtuar pronën në mënyrë që t'i kthehet pronarit në gjendjen që është marr në dorëzim, përveç kur në kontratë nuk parashikohet ndryshe. Ndërsa kur këto shtesa nuk mund të shpëruhen dot nga pasuria, enfiteozëmarrësi ka të drejtë të kërkoj vleftën e tyre të llogaritur në kohën kur bëhet kthimi i sendit (Nenet 794-795 të Kodit Civil). Enfiteozëmarrësi ka të drejtë të mbaj sendin e dhënë në enfiteozë, deri në shlyerjen e kredive që rrjedhin prej saj. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Pronari ka të drejtë të mbaj sendet që i takojnë enfiteozëmarrësit deri në shlyerjen e detyrimeve ndaj tij (Neni 796 i Kodit Civil).

Enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryej të gjitha ndreqjet e zakonshme në pronën e dhënë në enfiteozë. Ndërsa ndreqjet e jashtëzakonshme janë në ngarkim të enfiteozëdhënësit, prandaj ky i fundit duhet të vihet në dijeni menjëherë për riparimin e nevojshëm (Neni 797 i Kodit Civil).

Mund të ndodh në praktikë që e njëjta pronë t'u jepet në enfiteozë dy ose më shumë enfiteozëmarrësve në të njëjtën kohë. Në këtë rast, sipas nenit 798 të Kodit Civil, enfiteozëmarrësit qëndrojnë kundrejt njeri-tjetrit si debitor solidar. Solidariteti shprehet në pagimin e shpërblimit të çmimit të enfiteozës si dhe në çdo shpenzim tjetër që është në ngarkim të tyre.

Kur prona e dhënë në enfiteozë ndahet dhe ato gëzojnë pjesë të saj, secili përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga enfiteoza, proporcionalisht me vleftën e pjesës që gëzon.

Është e mundur që enfiteozëmarrësi të fitoj në dobi të pronës servitute aktive dhe ta ngarkoj atë me servitute pasive, për një kohe sa parashikohet në kontratë, por duke njoftuar gjithnjë enfiteozëdhënësin me shkresë (Neni 800 i Kodit Civil).

Edhe kur enfiteoza gëzohet nga një ose disa persona juridik do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë kontratën e enfiteozës, përveçse kur një gjë e tillë ndalohet nga ligji (Neni 799 i Kodit Civil).

Konkluzione

Sipas Kodit Civil të vitit 1929, me anë të kontratës së enfiteosit i jepej një personi (enfiteomarrësit) për një periudhë relativisht të gjatë (18-99 vjet) një pronë bujqësore kryesisht me detyrimin për ta përmirësuar dhe të paguaj një shpërblim të përvitshëm që quhet kanon dhe që caktohet në para ose drithëra. Objekt i kësaj kontrate mund të ishin vetëm sendet e paluajtshme (pronat), këtu përfshihen tokat bujqësore ose jobujqësore, ndërtesat etj. Një veçori përbën edhe vendosja e limiteve kohore, sa i përket kohëzgjatjes së kontratës. Gjithashtu enfiteomarrësi, nëse ka bërë mbi pronën përmirësime ose ndërtime që i shtojnë vlerën, nuk mund t'i prish as të kërkoj ndonjë shpërblim. Enfiteozëmarrësi nuk mund të lidh as kontratë nën enfiteoze.

Në legjislacionin civil të periudhës komuniste enfiteoza nuk disiplinohet në vendin tonë.

Në Kodin Civil të 1994, enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorë e të përmirësoj një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë. Në shekujt pararendës, enfiteoza ka qenë mjaft e përhapur, ndërsa në kohët moderne po shkon drejt zhdukjes. Kjo vjen edhe si pasojë e legjislacionit të ri, i cili nuk duket se e favorizon përdorimin e kontratës enfiteotike.

Literaturë

1. Benussi B., 1931, *Sendet, Zotënimi dhe Modifikimet e Tija, Komentari i Kodit Civil*, Tiranë.
2. Ferrini C., 1953, *Manuale di Pandette*, Milano.
3. Grosso G., 1965, *Storia Del Diritto Romano*, G. Giappichelli, Torino.
4. Voltera E., 1993, *Instituzioni di Diritto Privato Romano*, La Sapienza Editrice- Roma.
5. Maria Pia Baccari, 1996, *Cittadini popoli e comunione nella legislazione dei secoli IV-VI*, G. Giappichelli, Torino.
6. Shehu A., 2000, *Pronësia*, Albin, Tiranë.
7. Mandro A., 2001, *E drejta romake*, Tiranë.
8. Omari L., 2004, *Parime dhe institucione të së drejtës publike*, botimet "Elena Gjika", Tiranë.
9. Semini M., 2002, *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave (Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme)*, Tiranë.

Mbrojtja juridiko penale e mjedisit në legjislacionin shqiptar – Sfidat drejt të ardhmes

Dr. Sokol Mëngjesi, Dr. Klodjan Skënderaj
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Me anë të këtij punimi synohet të evidentohet roli i mjedisit për të garantuar cilësinë dhe vazhdimësinë e jetës në planetin tonë. Nga ana tjetër evidentohet domosdoshmëria gjithmonë e në rritje për mbrojtjen e mjedisit, për shkak të rreziqeve që përditë e më shumë i kanosen mjedisit, si pasojë e zhvillimit të teknologjisë. Është tashmë i njohur disproporcioni mes zhvillimit dhe mjedisit. Në këtë situatë të krijuar nuk është i rastësishëm fakti që ligjvënësit, në pothuajse të gjitha vëndet e botës i kushtojnë një rëndësi të veçantë mbrojtjes së mjedisit. Në nivel botëror ekziston një numër i konsiderueshëm aktesh ndërkombëtare që synojnë të realizojnë këtë mbrojtje dhe të kufizojnë shfrytëzimin e mjedisit, duke e limituar në parametra racional. Ky prioritet i rëndësishëm strategjike reflektohet padyshim edhe në legjislacionin shqiptar, i cili është i gjerë, i shumëllojshëm dhe deri diku efektiv, megjithëse gjithmonë ka vend për përmirësim dhe perfeksionim. Për mbrojtjen e mjedisit ligjvënësi shqiptar e ka përdorur të gjithë arseanlin e sanksioneve që ka në dispozicion, duke nisur që nga sanksionet civile dhe administrative, për të përfunduar në raste ekstreme dhe të domosdoshme deri tek sanksionet penale. Pikërisht në këtë punim ne do të angazhohemi dhe do të analizojmë veprat dhe sanksionet penale në fushën e mjedisit. Legjitimimi i sanksioneve penale për të garantuar mbrojtjen e mjedisit është një realitet i pakontestueshëm dhe doktrinalisht i saktë, pasi efektet negative të disa shkeljeve në dëm të mjedisit arrijnë deri në ato nivele sa mundet të kenë pasoja katastrofike dhe të pariparueshme për ambientin natyral ku zhvillohet e gjithë jeta në planetin tonë. Në këtë kuadër ne do të analizojmë veprat penale në fushën mjedisore, duke e parë në një këndvështrim analitik nga njëra anë dhe kritik nga ana tjetër, në mënyrë që të japim propozime konkrete për rregullimin dhe përafrimin e legjislacionit tonë të brendshëm me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin evropian në fushën mjedisore. Përafrimi dhe perfeksionimi i legjislacionit tonë të brendshëm për mbrojtjen e mjedisit më shumë sesa një detyrim është ndërgjegjësimit dhe sfidë për të ardhmen.

Fjalë kyçe: mjedisi, vepër penale mjedisore, sanksione, legjislacion mjedisor, zhvillim

Hyrje

Në këtë punim merret në studim legjislacioni penal shqiptar në fushën e mjedisit. Fillimisht bëhet një vështrim i përgjithshëm i veprave penale që mbrojnë mjedisin dhe një kategorizim i tyre, duke përdorur si kriter komponentin specifik të mjedisit që mbron secila vepër. Më pas vijohet me analizën e benefitit juridik “mjedis” dhe analizën e veprave penale konkrete kundër mjedisit. I tejkalon kufijtë e këtij punimi një analizë e hollësishme e secilës vepër penale, për këtë arsye evidentohen vetëm pikat më delikate të secilës vepër, duke evidentuar rast pas rasti avantazhet apo disavantazhet e mënyrës konkrete të penalizimit të sjelljes së caktuar. Kjo bëhet me qëllim që të parapërgatisim konkluzionet për efektivitetin apo jo të legjislacionit penal që mbron mjedisin në vendin tonë dhe nëse ekziston ndonjë sygerim konkret për përmirësimin e legjislacionit në mënyrë që të perfeksionohet në të ardhmen. Në përfundim jepen konkluzionet dhe rekomandimet me qëllim përmirësimin dhe modernizimin e legjislacionit penal shqiptar në fushën e mjedisit dhe përafrimin e tij me legjislacionin bashkëkohor evropian, që përbën detyrim, por njëkohësisht dhe domosdoshmëri për mbrojtjen e këtij benefiti juridik të një rëndësie të veçantë (Kiss, A.C., Shelton, D., 1997, 69).

Një vështrim i përgjithshëm i veprave penale që mbrojnë mjedisin

Në kreun IV të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal shqiptar janë të parashikuara veprat penale kundër

mjedisit. Në këtë kre të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal janë të parashikuara si vepra penale mbrojtja e ajrit (neni 201 KP), transportimi i mbeturinave toksike (neni 202 KP), ndotja e ujrave (neni 203 KP), peshkimi i ndaluar (neni 204 KP), prerja e paligjshme e pyjeve (neni 205 KP), prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë (neni 206 KP), shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor (neni 206/a KP), shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor (neni 206/b KP) si dhe shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve (neni 207 KP).

Me të gjitha këto vepra penale mbrohet mjedisi, i cili përbën benefitin juridik që mbrohet specifikisht nga ligjvënësi penal. Mjedisi si benefit juridik përbëhet nga katër komponentë, toka dhe nëntoka, hapsirat ujore, atmosfera si dhe bota bimore dhe shtazore (Bell, S., McGrillivray, D., 2008, 57).

Duke u nisur nga katër komponentët përbërës të benefitit juridik “mjedisi”, ne mundet të kategorizojmë veprat penale të parashikuara në këtë kre në katër kategori (Çiçolli, E., 2008, 26).

Në kategorinë e parë futen veprat penale që mbrojnë atmosferën. Këtu futet më specifikisht vepra penale e mbrojtjes së ajrit, parashikuar nga neni 201 KP.

Në kategorinë e dytë futen veprat penale që mbrojnë tokën dhe nëntokën. Këtu futet më specifikisht vepra penale e transportimit të mbeturinave toksike, parashikuar nga neni 202 KP.

Në kategorinë e tretë futen veprat penale që mbrojnë hapsirën ujore. Këtu futet më specifikisht vepra penale e ndotjes së ujrave, parashikuar nga neni 203 KP.

Në ketegorinë e katërt futen veprat penale që mbrojnë botën bimore dhe shtazore. Këtu futen më specifikisht veprat penale të peshkimit të ndaluar, parashikuar nga neni 204 KP, e prerjes së paligjshme të pyjeve, parashikuar nga neni 205 KP, e prerjes së drurëve dekorativë dhe frutorë, parashikuar nga neni 206 KP, të shkatërrimit me zjarr të pyjeve dhe të mjedisit pyjor, parashikuar nga neni 206/a KP, të shkatërrimit nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, parashikuar nga neni 206/b KP, si dhe të shkeljes së karantinës së bimëve dhe kafshëve, parashikuar nga neni 207 KP.

Duhet të theksojmë se kjo ndarje nuk është absolutisht e saktë, me kuptimin që me veprat penale të cilat i kategorizojmë në njërën apo tjetrën kategori mbrohen edhe elementë të tjerë të mjedisit dhe kjo vjen si pasojë ndërveprimit dhe lidhjes së ngushtë të komponentëve të mjedisit me njëri tjetrin, tokë – ujë – atmosferë – botë bimore dhe shtazore (Elezi, I., 2008, 233).

Benefiti juridik “mjedisi”

Vetë titulli i kreut IV të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal na udhëzon dhe na drejton në përcaktimin e benefitit juridik që mbrohet me veprat penale që janë të parashikuara në këtë kre. Është e qartë dhe thuajse e vetkuptueshme se benefiti juridik i mbrojtur specifikisht nga këto vepra penale është mjedisi.

Sipas nenit 3 paragrafi 1 të ligjit nr. 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” me “mjedisi” kuptohet bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotike dhe jobiotikë, që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, të tokës, të ujërave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgimitë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore. Mjedisi si term i përgjithshëm ndahet në mjedis natyral apo fizik dhe mjedis kulturor. Në këtë kre që ne po marrim në analizë mbrohet vetëm ambjenti natyral, apo e thënë ndryshe mjedisi fizik. Nga ana tjetër për sa i përket mjedisit kulturor konstatojmë se ligjvënësi penal nuk i ka kushtuar ndonjë kre apo seksion të veçantë në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal. Kjo nuk do të thotë se ligjvënësi e ka lënë të pambrojtur mjedisin kulturor, por thjesht e ka lidhur mbrojtjen e mjedisit kulturor me mbrojtjen e pasurisë apo të pronësisë, duke integruar veprat penale që mbrojnë mjedisin kulturor në seksionet përkatëse që mbrojnë pronën apo pasurinë.

Ndarja e mjedisit në natyral dhe kulturor na tregon se ambjenti natyral përbën një benefit juridik unik me disa dimensione, të cilat nga ana e tyre reflektojnë dhe përfaqësojnë elementët përbërës të mjedisit natyral, të cilat siç u theksua edhe më sipër janë toka, uji, atmosfera si dhe bota bimore dhe shtazore.

Në shkencën penale dy kanë qënë rrymat kryesore që janë mbështetur për të justifikuar legjitimitimin e mbrojtjes së mjedisit, rryma antropocentrike dhe rryma ekologjike (Bell, S., McGillivray, D., 2008, 107).

Mbështetësit e rrymës antropocentrike i evidentojnë shkaqet e mbrojtjes së mjedisit në nevojën, apo domosdoshmërinë e mbrojtjes së jetës apo të shëndetit të njeriut, duke e parë mjedisin si ambientin natyral dhe kushtin e domosdoshëm fizik për mbrojtjen e këtyre benefiteve juridike. Mbështetësit e rrymës ekologjike i evidentojnë shkaqet e mbrojtjes së mjedisit në domosdoshmërinë e mbrojtjes së benefittit juridik shoqëror “mjedis” si mbrojtje autonome, pavarësisht faktit të referencës së mbrojtjes edhe të njeriut si pasojë e mbrojtjes së mjedisit.

Duhet theksuar se rryma antropocentrike duket më e saktë doktrinalisht, për arsye se mjedisi nuk përbën një benefitt juridik që mbrohet thjesht dhe vetëm për të mbrojtur këtë vlerë në vetvete, por si një vlerë në shërbim të njeriut, si ambientin natyral ku zhvillohet e gjithë veprimtaria njerëzore në të gjitha dimensionet e veta. Mbrojtja e mjedisit është gjithashtu parakusht për të garantuar cilësinë e jetës dhe vazhdimësinë e saj në planetin tonë.

Mbrojtja e ajrit (neni 201 KP)

Në nenin 201 KP ku parashikohet kjo vepër penale është parashikuar si kusht që ndotja e ajrit përbën vepër penale vetëm në rastin kur kjo ndotje nuk përbën kundërvajtje administrative. Në nenin 82 paragrafi 2 pika h) të ligjit 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” parashikohet se tejkalimi i kufijve të lejuar të lëndëve ndotëse përbën kundërvajtje administrative. Duke krahasuar nenin 201 paragrafi 1 KP dhe nenin 82 paragrafi 2 pika h) të ligjit 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” arrijmë në konkluzionin se neni 201 paragrafi 1 KP në mënyrën sesi është i formuluar nuk ka fushë zbatimi, përderisa të gjitha ndotjet e ajrit hyjnë në kuadrin e kundërvajtjeve administrative. Në këto kushte në mënyrë që të ketë fushë zbatimi vepra penale e ndotjes së ajrit do të duhet të bëhet një nëndarje, ose e thënë ndryshe një kategorizim i shkalljes së ndotjes dhe ndikimit të tij në nivelin e ndotjes së ajrit.

Në paragrafin e dytë të nenit 201 KP është parashikuar rrethana rënduese e kësaj vepre penale, kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve. Siç u theksua edhe më sipër edhe ky paragraf e mbart problematikën e paragrafit të parë, për arsye se nuk parashikon një vepër penale autonome, por vetëm rrethana rënduese, kështu që problematikën që mbart vepra penale në vetvete mbarten edhe këtu (Mëngjesi, S., 2011, 389).

Transportimi i mbeturinave toksike (neni 202 KP)

Në paragrafin e parë të këtij neni është parashikuar se transportimi tranzit apo depozitimi në territorin shqiptar të mbeturinave toksike dhe radioaktive dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Nocioni i mbetjeve jepet në nenin 3 paragrafi 7 të ligjit 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Nocionet “transport” dhe “depozitim” në këtë vepër penale kanë kuptimin që ka përmbajtja e këtyre nocioneve në zhargonin e përditshëm.

Për të patur konsumim të kësaj vepre penale, ashtu siç rezultojnë qartë nga përmbajtja e kësaj dispozite nuk nevojitet ardhja e ndonjë pasoje, d.m.th. realizim i ndotjes së mjedisit, ç’ ka do të thotë se kjo është një vepër penale rrezikimi. Pra kjo vepër penale e dënon këtë sjellje për arsye sepse sipas konceptit të ligjvënësist është e rrezikshme për mjedisin dhe për këtë arsye është e dënueshme penalisht, pavarësisht nëse në rastin konkret kemi ose jo ndotje të mjedisit si pasojë e kësaj veprimtarie të paligjshme.

Nocioni i territorit shqiptar jepet në nenin 5 KP. Kjo vepër penale nuk mundet të kryhet me mënyrën e depozitimit të mbeturinave toksike dhe radioaktive në ajër, sepse në këtë rast do të duhet që këto mbetje të kenë trajtë tymi apo gazi dhe në këtë rast bëhet fjalë për ndotje të ajrit, që trajtohet nga neni 201 KP.

Duke analizuar ligjin 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” konstatojmë se transportimi tranzit i mbeturinave në territorin shqiptar lejohet në kushte të caktuara, që do të thotë se kemi këtë vepër penale vetëm në rastin kur transporti tranzit kryhet pa leje të organeve përkatëse ose në shkelje të kushteve të lejes së dhënë.

Ndotja e ujërave (neni 203 KP)

Në nenin 203 KP parashikohet se ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrejtit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substancave të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, dënohet me burgim nga një gjerë në pesë vjet.

Nocioni i ndotjes definohet nga vetë ligjvënësi në nenin 3 paragrafi 3 të ligjit 8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Si problematikë të kësaj vepre penale mundet të konstatojmë nocionin “substancë të tjera”. Themi që ky term përbën problematikë të kësaj vepre penale për arsye sepse është një term mjaft i gjerë dhe parashikimi i termave kaq të gjerë në veprat penale përbën një shkelje të parimit të ligjshmërisë që përbën një aksiomë bazë të të drejtës penale dhe e përshkon të drejtën penal nga skaji në skaj (Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M., 2012, 27). Në këtë aspekt termi “substancë të tjera” duhet të interpretohet ngushtë, në mënyrë që të futen në këtë kategori vetëm substancat që shkaktojnë prishje të ekuilibrut ekologjik, duke qënë se ligjvënësi kërkon ardhjen e kësaj pasoje që të konsumohet kjo vepër penale. Në këtë mënyrë duket se ligjvënësi ka përdorur këtë term disi të gjerë për standartin e të drejtës penale me qëllim që të përfshijë të gjitha rastet e psishjes së ekuilibrut ekologjik. Kjo ndodh për arsye se çdo lloj substance në kushte, rrethana dhe masa të caktuara mundet të shkaktojë prishje të ekuilibrut ekologjik. Prishje të ekuilibrut ekologjik kemi në të gjitha rastet kur kemi çrregullim të ekosistemit, i cili për shkak të sjelljes së paligjshme të autorit nuk funksionon më në kushte normale. Në këto kushte për ardhjen e pasojës, prishjes së ekuilibrut ekologjik nuk është domosdoshmërisht e nevojshme ardhja e ndonjë pasoje të dukshme, por mjafton edhe influencimi negativ në funksionimin natyral të ndërveprimit të faktorëve të florës dhe faunës, në mënyrë që të ndërpritet zhvillimi dinamik i ekosistemit.

Si rrethanë rënduese e kësaj vepre penale është parashikuar rasti kur janë shkakuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Peshkimi i ndaluar (neni 204 KP)

Kjo vepër penale është një vepër penale me subjekt të përgjithshëm. Për të konsumuar këtë vepër penale nuk ka rëndësi nëse autori ka apo nuk ka leje peshkimi. Kjo vepër penale kryhet akoma edhe në rastin kur autori ka leje peshkimi, por e ushtron këtë aktivitet në kundërshtim me rregullimet ligjore të nxjerra specifikisht për të rregulluar këtë aktivitet, pra kur e kryen këtë aktivitet në kohë, në vend apo me mënyra të ndaluara.

Si sjellje e paligjshme parashikohet peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara. Për të përcaktuar kohën, vendin, mjetet apo mënyrat e ndaluara është nxjerrë ligji 7908 datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”. Për të rregulluar këtë aktivitet janë nxjerrë gjithashtu edhe një sërë aktesh normative në zbatim të ligjit të sipërpërmendur.

Duhet specifikuar se autori i peshkimit të ndaluar përveç përgjegjësisë penale ka edhe përgjegjësi administrative, pasi të gjitha rastet e peshkimit të ndaluar përbëjnë gjithashtu edhe shkelje administrative dhe dënohen edhe me sanksione administrative në bazë të ligjit 7908 datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”.

Si rrethana rënduese janë të parashikuara në paragrafin e dytë rastet kur peshkimi kryhet me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj. Duhet theksuar se edhe në këtë rast ligjvënësi e lë të hapur mundësinë e përdorimit të mjeteve të rrezikut të përbashkët. Gjithsesi pavarësisht se kjo mënyrë nuk është edhe teknika më e mirë legjislative sidomos në legjislacionin penal, mundet të themi se nuk përbën ndonjë problematikë shqetësuese për shkak se ligjvënësi i ka përcaktuar në një

farë mënyre mjetet e rrezikut të përbashkët të ndaluara për t' u përdorur në peshkim në nenin 38 të ligjit 7908 datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, që do të thotë se kemi të bëjmë vetëm në dukje me një farë paqartësie, por që thelbësisht nuk ndodh kështu.

Prerja e paligjshme e pyjeve (neni 205 KP)

Në nenin 205 KP është parashikuar se prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje penale dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Nocioni i pyllit jepet në nenin 2 paragrafi 21 të ligjit 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. Në aspektin e pronësisë pyjet ndahen në pyje publikë dhe privatë dhe për pasojë objekt i mbrojtjes së kësaj dispozite janë të dyja kategoritë e pyjeve, sepse ligjvënësi nuk i mbron pyjet si aspekt pronësie, por si komponent të natyrës dhe të mjedisit.

Prerja e pyjeve në përgjithësi është e lejueshme kur bëhet sipas kriterëve të caktuara dhe përfiton karakter të paligjshëm dhe të dënueshëm penalisht vetëm në rastin kur bëhet pa leje ose në kohë dhe vend të ndaluar.

Nocioni i dëmtimit të pyllit është i parashikuar në nenin 2 paragrafi 2 të ligjit 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”.

Më përpara ligjvënësi i mbronte pyjet vetëm në rastet e parashikuara në këtë vepër penale, d.m.th. në rastin e prerjes së paligjshme apo në rastin e dëmtimit. Në këtë kohë ligjvënësi kishte lënë jashtë rrezes së tij të veprimtimit një gamë shumë të rëndësishme sjelljesh, tepër të dëmshme kundër pyjeve, siç është zjarrëvënia. Që prej vitit 2008 kjo neglizhencë serioze është rikuperuar dhe si vepra penale në ditët e sotme dënohet edhe shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, madje jo vetëm kur kjo bëhet me dashje (neni 206/a KP), por edhe në rastin kur kjo ndodh nga pakujdesia (neni 206/b KP). Kjo ndërhyrje e ligjvënësit ishte e domosdoshme dhe konsiderohet si një hap tepër pozitiv për të garantuar një mbrojtje efektive të pyjeve nga një fenomen tepër shqetësues, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në shumë vende të tjera të botës (Ministria e Mjedisit, 2007, 43).

Konkluzione

Nga analiza e këtij punimi ne mund të nxjerrim si konkluzion se legjislacioni penal shqiptar në fushën e mjedisit është i mjaftueshëm. Ka parashikuar ligjvënësi ynë penal vepra penale që mbrojnë të katërt komponentët e benifitit juridik “mjedis”, atmosferën, tokën dhe nëntokën, hapsirat ujore si dhe botën bimore dhe shtazore. Probleme vërehen në disa raste jo në dimensionet e mbrojtjes, por më tepër të themi në mënyrën e gabuar në disa raste të këndvështrimit të trajtimit të problemit. Mundet të përmendim këtu si më tipik ndoshta, rastin e ndotjes së ajrit, ku ngatërrohen nga ligjvënësi kufijtë midis kundërvajtjeve administrative dhe veprës penale (Petrela, I., Revista Shqiptare për Studime ligjore, Vol. 2, 2011, fq. 113 – 126). Një aspekt tjetër që në mendimin tonë duhet të ndryshojë është edhe masa e dënimeve, të cilat besojmë se duhet të jenë disi më të ashpra, në mënyrë që të garantohet një mbrojtje më e madhe e mjedisit dhe komponentëve të tij përbërës (Hysi, V., 2005, 225).

Literaturë

Bell, S., McGillivray, D. (2008) *Environmental Law*. Oxford University Press

Çiçolli, E. (2008) *Veprat penale në fushën e mjedisit*. Tiranë

Elezi, I., (2008) *Komentari i Pjesës së Posaçme të Kodit Penal*. Tiranë

Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M. (2012) *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (Pjesa e Përgjithshme)*. Tiranë

Hysi, V. (2005) *Kriminologjia*. Tiranë

Kiss, A.C., Shelton, D. (1997) *Manual of European Environmental Law*. Cambridge University Press

Mëngjesi, S. (2011) *Interpretimi sistematik i Pjesës së Posaçme të Kodit Penal shqiptar krahasuar me doktrinën*

penale greke. Athinë

Ministria e Mjedisit (2007) *Strategjia Ndërsektorale e Mjedisit (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim)*. Tiranë

Petrela, I. *Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë europian në mbrojtje të mjedisit*, Revista Shqiptare për Studime ligjore, Vol. 2, 2011, fq. 113 – 126.

Zajmi, I., Bishaj, A., *Doktrina e Gjykatës Europiane të Drejtësisë mbi zbatimin e së drejtës së BE-së*, revista Jeta Juridike, nr. 1, 2011, fq. 39 – 52.

Arbitrazhi Ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë

Dr. Anjeza Liçenji

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Jola Sado

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Arbitrazhi Ndërkombëtar është një nga format alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ndoshta ndër një nga format më të mira. Avantazhet e arbitrazhit Ndërkombëtar janë të shumta dhe kanë të bëjnë pikërisht me shpejtësinë, efikasitetin, konfidencialitetin, privatësinë, fleksibilitetin, më pak procedura burokratike dhe pse jo ndonjëherë arbitrazhi është edhe më pak i kushtueshëm sesa një proces i gjykatave të zakonshme (marrja e një vendimi në një gjykatë shtetërore mund të zgjasi për vite të tëra të cilat e bëjnë atë më të kushtueshëm).

Ky punim është realizuar për të dhënë një kuptim sa më të mirë të Arbitrazhit Ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se Arbitrazhi Ndërkombëtar në këtë vend rregullohet vetëm nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara si: Konventa e New York-ut, Konventa e Gjenevës, etj.

Në mungesë të një ligji për Arbitrazhin Ndërkombëtar, i cili është në punim e sipër, sigurisht që problemet që ndeshen janë të shumta. Një ndër problematikat ka të bëjë me kundërshtimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Ne mund ta njohim, mund ta ekzekutojmë një vendim të huaj por kurrsesi nuk mund ta kundërshtojmë atë pasi nuk kemi një ligj që të na mundësojë një të drejtë të tillë.

Në këtë punim synohet të trajtohen dhe t'ju jepet përgjigje pyetjeve të tilla si: Çfarë është arbitrazhi ndërkombëtar dhe cilat janë instrumentat rregullative më të rëndësishme? Sa e rëndësishme është marrëveshja e arbitrazhit dhe a janë të detyrueshme "IBA Guidelines for Drafting International Arbitration Clauses"? A është gjithmonë procesi i arbitrazhit konfidencial? A mund të jepet një vendim arbitrazhi tej afatit të parashikuar nga palët?

Pavarsisht gjithçkaje, arbitrazhi mbetet një formë hibride e zgjidhjeve ndërkombëtare të mosmarrëveshjeve, pasi në vetvete përmban elementë të së drejtës civile dhe të procedurës civile duke ju lejuar palëve në mënyrë të konsiderueshme hartimin e rregullave më të favorshme për ta.

Fjalw Kyçe: Arbitrazh Ndërkombëtar, Konventë, vendim, mosmarrëveshje, proces.

Hyrje

Arbitrazhi në vetvete apo dhe ai ndërkombëtar është institucioni nëpërmjet të cilit një i tretë zgjidh mosmarrëveshjet midis dy ose më shumë palëve, duke ushtruar misionin gjyqësor, të cilin ia kanë besuar këto të fundit. Në ditët e sotme dhe në bazë të praktikës aktuale, arbitrazhi shikohet si një nga format më të mira të mundshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Evolimi i tij është realizuar për t'ju lejuar palëve, nga vende me prejardhje të ndryshme kulturore, gjuhësore dhe ligjore zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre në mënyrë të prerë e detyruese në sajë të rregullave uniforme, duke shmangur kështu edhe formalitetet e rregullave proceduriale të sistemeve të tyre ligjore (www.international-arbitration-attorney.com).

Arbitrazhi ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë pavarsisht se nuk është rregulluar akoma me një ligj të veçantë nuk nënkupton se kjo fushë e së drejtës është i parregulluar. Sigurisht që për rregullimin e tij vlejnjë marrëdhëniet dy palëshe që ka nënshkruar Shqipëria, Konventat e ndryshme, Ligji "Për të drejtën ndërkombëtare private", nr. 10428, datë 02.06.2011 (është ligji relevant në fushën e arbitrazhit pasi është ligji bazë në të drejtën Shqiptare për përcaktimin e konfliktit të ligjeve dhe për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, për aftësinë e personave fizikë apo juridikë të huaj për tu paraqitur përpara gjykatave konvencionale apo arbitrare në Shqipëri dhe gjithashtu aftësia e personave shqiptarë fizik apo juridik për t'ju nështruar një juridiksioni të huaj apo arbitrar) dhe në disa raste edhe dispozitat e kodit të procedurës civile, ndër të cilat do të përmendim dispozitat për njohjen e një vendimi të huaj (Neni 393-398 K.Pr.C.).

Instrumentat ndërkombëtarë

Ndër instrumentat më të rëndësishëm për arbitrazhin ndërkombëtar, të cilat dhe Shqipëria i ka ratifikuar janë: Konventa e New York-ut “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, Konventa Europiane e Arbitrazhit (Konventa e Gjenevës), Konventa “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare”, etj.

Mirëpo një individ në marrëveshjen etijka të drejtën për të zgjedhur për aplikim rregulla të mirënjohura të arbitrazhit ndërkombëtar si: rregullat e Ligjit të Tregtisë Ndërkombëtare (UNCITRAL), rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), rregullat e Qendrës Ndërkombëtare të Bankës Botërore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve (ICSID) si dhe të tjera rregulla të mirënjohura të arbitrazhit ndërkombëtar. Nëse palët zgjedhin aplikimin e një prej këtyre rregullave sigurisht që janë të detyruar t'i zbatojnë ato.

Konventa e New York-ut është konventa më e rëndësishme për sa i përket njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të një shteti të huaj ose të arbitrazhit ndërkombëtar. Ajo është e detyrueshme për shtetet që e kanë ratifikuar atë dhe ajo parashikon të drejtën e shteteve për të bërë rezerva të karakterit gjeografik në lidhje me zbatimin e saj. Si konventë ka hyrë në fuqi në 7 qershor 1959 dhe Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 2000 (Ligji nr. 8688, datë 09/11/2000).

Në kuadër të legjislacionit shqiptar do të përmendim vetëm një problematikë e cila mund të ndeshet në praktikë. Si ligji shqiptar ashtu dhe Konventa e New York-ut kanë dispozita për njohjen e vendimeve të huaja, atëherë lind pyetja kush do të zbatohet nga këto të dyja? Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), Konventa e New York-ut qëndron në një rang hierarkik më të lartë se Kodi i Procedurës Civile, mirëpo po të analizojmë vetë konventën, ajo në nenin VII/1 i jep të drejtë subjektit të interesuar të zgjedhë si të drejtë të aplikuashme ligjin e brendshëm si më të favorshëm se dispozitat e konventës. Pra, në këtë aspekt sanksionohet parimi i së drejtës më të favorshme ndaj si rrjedhojë palët mund të zgjedhin për aplikim për njohjen e vendimit të huaj ose dispozitat e Kodit të Procedurës Civile ose dispozitat e Konventës.

Çështje për ilustrim: Vendi i arbitrazhit është zgjedhur Viena. Konflikti është midis shtetasit gjerman dhe atij shqiptar. Vendimi është marrë kundër Republikës së Shqipërisë. Ekzekutimi i vendimit do të bëhet në Shqipëri. Shtetasi gjerman për njohjen e vendimit që më pas do ekzekutohet, do kërkojë të zbatohet ose Konventa e New York-ut ose Kodi i Procedurës Civile.

Konventa e Gjenevës është firmosur në Gjenevë në 21 prill 1961 dhe është ratifikuar nga shteti shqiptar në vitin 2000 (Ligji nr. 8687, datë 09/11/2000). Është Konventa ajo e cila ka si qëllim eliminimin e barrierave që mund të pengojnë zgjidhjen me arbitrazh të konflikteve të tregtisë ndërkombëtare midis personave fizikë dhe juridikë të vendeve të ndryshme të Europës.

Konventa për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare është miratuar në Hagë në 1971 dhe ka hyrë në fuqi në 20 gusht 1979. Ajo është miratuar nga Republika e Shqipërisë në 2009. Kjo Konventë nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimet e arbitrazhit por u referohet aspekteve dytësore që lidhen me procesin e arbitrazhit (Malltezi, Rustemaj, Plelinku, 2013, 547).

Marrëveshja e arbitrazhit

Për të shpjeguar rëndësinë e marrëveshjes së arbitrazhit mjafton të shkruhen vetëm tre fjalë: “pa marrëveshje nuk ka proces arbitrazhi”. Në bazë të legjislacionit shqiptar për arbitrazhin forma e shkruar e marrëveshjes është kusht për vlefshmërinë e saj (Neni 404 K.Pr.C.). Forma e shkruar përfshin edhe dokumentin e shkruar ashtu si telegram, teleteksti si dhe çdo mjet tjetër që përbën provë shkresore. Marrëveshja mund të jetë thjesht një klauzolë e kontratës kryesore mbi bazën e të cilës ka lindur apo mund të lindë konflikti në të ardhmen ose ajo mund të jetë një dokument i ndarë nga kontrata kryesore. Pyetja që shtrohet në këtë aspekt është nëse pavleshmëria e kontratës kryesore do të sillte pavlefshmëri të marrëveshjes së arbitrazhit? Secila prej tyre si kontrata kryesore ashtu edhe marrëveshja e arbitrazhit kanë një jetë të ndarë nga njëra-tjetra, ndaj pavleshmëria e kontratës kryesore nuk do të na sillte pavlefshmëri të marrëveshjes së arbitrazhit. Palët mund të

lidhin një kontratë tjetër të vlefshme midis tyre po me të njëjtat klauzola arbitrazhi apo po me të njëjtën marrëveshje arbitrazhi. Rastet e pavlefshërisë së një marrëveshje jepen nga legjislacioni i brendshëm.

Për të hartuar një marrëveshje arbitrazhi do të na vinte në ndihmë “IBA Guidelines for Drafting International Arbitration Clauses”. Ky dokument jep udhëzimet e duhura për hartimin e marrëveshjes së arbitrazhit. Qëllimi i këtyre udhëzimeve është që të sigurojnë një përjasje të vlefshme për hartimin e dispozitave të arbitrazhit ndërkombëtar. Dispozitat e dobëta të arbitrazhit mund të jenë të pazbatueshme dhe mund të shkaktojnë kosto të panevojshme dhe vonesa (IBA Guidelines for Drafting International Arbitration Clauses, 7).

Udhëzimet e detyrueshme që paraqiten në këtë draft janë si: palët duhet të zgjedhin ose arbitrazhin institucional ose atë ad-hoc, palët duhet të zgjedhin një model rregullash arbitrazhi, mungesa e rrethanave të veçanta nuk mund të kufizojë qëllimin e mosmarrëveshjeve të palëve në arbitrazh por kufizimi i këtij qëllimi duhet parë më gjerë. Palët duhet të zgjedhin vendin e arbitrazhit, duhet të përcaktojnë numrin e arbitrave, duhet të përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes dhe të zëvendësimit të arbitrave dhe kur është zgjedhur arbitrazhi *ad hoc* palët duhet të zgjedhin autoritetin kryesues dhe palët duhet të përcaktojnë gjuhën e arbitrazhit (IBA Guidelines for Drafting International Arbitration Clauses, 7-19). Keto udhëzime në bazë të këtij drafti janë të detyrueshme, por ka dhe udhëzime të tjera opsionale që ai paraqet duke i shpjeguar me detaje.

Lind pyetja nëse është i detyrueshëm ky draft në legjislacionin Shqiptar apo edhe më gjerë?

Drafti nuk është i detyrueshëm nëse palët nuk e kanë zgjedhur për ta zbatuar, por nëse e zgjedhin atëherë ai bëhet i detyrueshëm. Për analogji mund të përmendim, ashtu si dhe IBA, Guidelines for Taking Evidence. Ajo rekomandon një paragraph në klauzolën e arbitrazhit “*përveç rregullave të zgjedhura nga palët, këto të fundit bien dakort që arbitrazhi të zhvillohet sipas rregullave të IBA-s për marrjen e provave*”. (Malltezi, Rustemaj, Plelinku, 2013, 556) Pra, në këtë moment këto rregulla bëhen të detyrueshme dhe jo se janë të detyrueshme pa u zgjedhur nga palët. E njëjta gjë vlen dhe për draftin për udhëzimet për hartimin e marrëveshjeve të arbitrazhit. Do të ishte shumë mirë të zbatoheshin modele të tilla, sidomos në rastin e Shqipërisë që ende nuk e ka ligjin për arbitrazhin ndërkombëtar. Mjafton të hapësh këtë draft dhe mund të hartosh marrëveshjen e arbitrazhit duke evituar kështu pavlefshmërinë e saj.

Konfidencialiteti

Ndryshe nga sistemi gjyqësor shtetëror i cili funksionon mbi bazën e parimit të gjykimit me dyer të hapura, në sistemin e arbitrazhit është e kundërta pasi gjykimi si rregull bëhet me dyer të mbyllura. Fakti që gjykimi zhvillohet me dyer të mbyllura dhe pa praninë e palëve të tjera, të padëshiruara në proces, është element i privatësisë, i cili shërben për të garantuar konfidencialitetin. Konfidencialiteti ka të bëjë me faktin se vendimi nuk duhet të publikohet, madje edhe publiku nuk duhet të jetë fare në dijeni që po zhvillohet një procedurë arbitrazhi për një çështje të caktuar. Gjithashtu, konfidencialiteti ka lidhje dhe me pamundësinë e bërjes publike apo të përdorimit të vendimit të arbitrazhit në një procedurë tjetër arbitrazhi apo në një procedurë gjyqësore si dhe me pamundësinë për të nxjerrë dokumenta, prova dhe informacione të tjera të cilat kanë lidhje me procedurën e arbitrazhit (Noussia, 2010, 26 dhe 68)

Parimi i konfidencialitetit nuk mund të prezumohet, por vetëm nëse palët parashikojnë se procesi i arbitrazhit do të jetë konfidencial atëherë ky proces do të jetë konfidencial. Ky rregullim është jo vetëm ndërkombëtar por edhe rregullorja e qëndres Medart (Qendra Shqipëtare e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit tregtar) në nenin tre të saj parashikon ruajtjen e fshehtësisë dhe të konfidencialitetit të arbitrazhit. Në çështjen *Esso v Plowman* (*Esso Australian resources Ltd et al. v Plowman et al* 183 CLR 10, 128 ALR 391), Gjykata e Lartë e Australisë ka hedhur poshtë detyrimin për njohje apriori të konfidencialitetit të dokumentave dhe informacioneve të dhëna gjatë dhe për qëllim të arbitrazhit në arbitrazhin ndërkombëtar.

Pyetja që lind është nëse nga palët parashikohet ruajtja e konfidencialitetit a mbetet gjithmonë ky parim i pacënueshëm? Në rastin kur vendimi i gjykatës së arbitrazhit ankimohet në një gjykatë shtetërore, atëherë parimi i konfidencialitetit e humbet kuptimin e tij pasi nuk respektohet më.

Gjykata shtetërore ka për detyrim publikimin e vendimit dhe gjykimin me dyer të hapura ndaj dhe kemi cënueshmëri të konfidencialitetit në këtë rast. Mirëpo ky parim mund të çënohet dhe kur ka inters publik, me pëlqimin e palëve apo dhe për mbrojtjen e interesave të ligjshme të palës tjetër (Çështja Dolling-Baker v Merreti).

Vendimi i arbitrazhit tej afatit të parashikuar nga palët

Afatet për dhënien e një vendimi arbitrazhi mund të parashikohen ose jo në varësi të legjislacioneve të ndryshme. Shumica e legjislacioneve nuk përcaktojnë afate për dhënien e një vendimi arbitrazhi duke përfshirë këtu dhe ligjin model UNCITRAL. Në bazë të Kodit të Procedurës Civile (Neni 413) kemi afatin 6 muaj brenda të cilit duhet të jepet një vendim arbitrazhi. Legjislacioni Italian parashikon parashikon afatin 180 ditor për dhënien e një vendimi të tillë. Nëse ky afat përfundon a mundet që gjykata të marr një vendim tej këtij afati edhe nëse palët nuk kanë bërë kërkesë për zgjatje afati më përpara? Ka legjislacione që e konsiderojnë si të vlefshëm marrjen e një vendimi në rrethana të tilla dhe të tjera që e konsiderojnë të pavlefshëm një vendim të marrë tej këtij afati. Në bazë të Konventës së New York-ut dhënia e vendimit tej afatit të përcaktuar me ligj përbën një nga shkaqet për të kundërshtuar njohjen e vendimeve të arbitrazhit. Duke analizuar më tej arrihet në përfundimin se pavarishtë se afati për dhënien e vendimit vërtet mund të përfundojë por kjo nuk do të thotë që marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme. Me përfundimin e afatit thjesht ka përfunduar mandati i atij paneli gjyqtarësh apo i gjyqtarit të vetëm që po shqyrton çështjen. Ndaj çështja nuk duhet të kalojë automatikisht për gjykim në gjykatën shtetërore, por palëve duhet t'u jepet mundësia për t'ia dhënë çështjen për shqyrtim një paneli tjetër të arbitrazhit.

Rekomandime dhe konkluzione

Duke u mbështetur në instrumentat ndërkombëtarë, si dhe në mangësitë aktuale, vlejné për tu përmendur rekomandime të vlefshme që i shërbejnë ligjit për arbitrazhin ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Rekomandimet kanë të bëjnë me: parashikimin në legjislacion të mundësive të gjyqtarit për të vepruar në një procedurë arbitrazhi si *amiable compositer* apo si *ex aequo bono* (Neni 5 i Konventës së New York-ut), me përcaktimin e më shumë kriterëve për kualifikimin për të qenë gjyqtar në një gjykatë arbitrazhi, të përcaktohet afati për kundërshtimin e zbatimit të një vendimi arbitrazhi, të përcaktohen me ligj tarifat për një procedurë arbitrazhi si dhe të parashikohet e drejta për tu rivendosur në afat për kundërshtimin e një vendimi arbitrazhi pasi nuk e kemi të rregulluar. E drejta për të vepruar si *amiable compositer* (gjyqtari në momentin që do të marr vendimin mos të ngelet ngushtësisht tek e drejta materiale që palët kanë zgjedhur) apo si *ex asque bono* (gjyqtari që autorizohet të veprojë në këtë mënyrë mundet të mos zbatoj fare normat ligjore të zgjedhura nga palët por ai mund të zbatojë ato norma që i konsideron më të përshtatshme për palët) mund t'i jepet gjyqtarit në bazë të klauzolave të marrëveshjes që palët lidhin midis tyre dhe nuk mund të prezumohen. Ato, kurrsesi, nuk duhet të bien ndesh me rendin publik ndërkombëtar.

Në Kodin e Procedurës Civile (Neni 407) parashikohet se: “për të qënë arbitër duhet të jesh person fizik me zotësi juridike për të vepruar”. Mirëpo, kjo klauzolë është shumë e cunguar e cila nuk përmban kërkesa minimale në lidhje me emërimin si arbitër. Ndër këto kërkesa mund të jenë si pasja e një diplome në fushën e drejtësisë apo ekonomisë, vite experience si gjyqtar si dhe kriterë të tjera të cilat nuk duhet të mungojnë. Ky nuk është vetëm një problem i ligjit tonë ekzistues por dhe i legjislacioneve të tjera, p.sh. si në atë Rus. Një nga rekomandimet që i jepet Ruisë (Ndryshimet e propozuara për ligjin mbi arbitrazhin ndërkombëtar Rus, 13 Qershor 2014) ka të bëjë pikërisht me vendosjen e kriterëve minimale për emërimin si arbitër.

Tarifat duhet të përcaktohen për të mos pasur abuzime, gjithmonë duke pasur parasysh llojin e çështjes dhe shkallën e saj të vështirësisë.

E drejta për tu rivendosur në afat për kundërshtimin e një vendimi arbitrazhi nuk është e rregulluar aktualisht, por ne kemi vetëm një vendim gjyqësor (Gjykata e Apelit, Tiranë nr. 78 datë 06.03.2013) i cili shprehet se gjykata e arbitrazhit nuk ka një kompetënce për rivendosjen e palëve për

kundërshtimin e vendimit të arbitrazhit. Legjislacione e huaja e rregullojnë duke vendosur afate si 18 ditë (legjislacioni anglez) apo të tjera afate më të shkurtra.

Si përfundim është e rëndësishme që të theksohet se Republika e Shqipërisë do të ketë një ligj shumë të mirë për arbitrazhin ndërkombëtar, duke qënë se në kemi radifikuar konventa, zbatojmë rregullore ndërkombëtare si dhe kemi një harmonizim shumë të mirë me instrumentat ndërkombëtarë. Ajo që pritet është vetëm dalja e këtij ligji, pse jo për të sheshuar të gjitha problematikat e ngritura dhe për të sjellë atë që quhet tërësia e normave dhe rregullave në kuadër të rregullimit të arbitrazhit ndërkombëtar. Rekomandimet e dhëna duhet të merren parasysh pasi do ta plotësonin më së mirë këtë ligj.

Sigurisht që në lidhje me arbitrazhin ndërkombëtar ka një sërë çështjesh të tjera të rëndësishme për tu diskutuar qoftë në lidhje me marrjen e provave, në lidhje me masat e sigurimit dhe çështje të tjera, të cilat mbeten për tu trajtuar dhe pse jo mund të sjellin debat.

Literatura

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ndryshuar.

Kodi i Procedurës Civile, ligji nr.7850, datë 29/03/1996, “Për Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.

Malltezi, A. Rustemaj, J. Plelinku, L. (2013), Aspekte të së Drejtës së Biznesit në Shqipëri, Mediaprint.

Konventa e New York-ut.

Ligji Model i UNCITRAL.

IBA Guidelines for Drafting International Clauses, adopted by a resolution of the IBA Council 7 October 2010 International Bar Association.

Vendimi nr. 78, datë 06.03.2013, Gjykata e Apelit Tiranë.

Esso Australian resources Ltd et al.v.Plowman et al 183 CLR 10,128 ALR 391(1995).

Noussia, K. (2010), Confidentiality in International Commercial Arbitration.

Doulling Baker v Merreti, (1990), W.R.L.1205.

http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/electcom/06-57452_Ebook.pdf

http://www.uncitral.org/en/uncitral.texts/arbitration/NYConvention_implementation.html

www.jus.uio.no/lm/italy.arbitration/doc.html

<https://www.international-arbitration-attorney.com/sq/tag/international-commercial-arbitration/>

Hyrja e shtetasve të vendeve të treta në territorin komunitar për qëndrime afatshkurtra, një e drejtë individuale?

Phd candidate Ervis Moçka
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Abstract

Në dhjetor të 2010 me anë të Rregullores (BE) nr. 1091/2010 liberalizohen vizat për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën duke kompletuar liberalizimin e vizave për vendet e Ballkanit perëndimor. Rregullorja në fjalë e cila modifikon Rregulloren nr. 539/2001, nuk bën gjë tjetër përveç se liston në njërin anë Shtetet, shtetasit e të cilëve kanë detyrimin e posedimit të një vize për të hyrë në hapësirën Schengen dhe nga ana tjetër Shtetet, shtetasit e të cilëve nuk kanë detyrimin për të poseduar një vizë në momentin e kalimit të kufijve të jashtëm. Por Rregullorja nuk përcakton dispozita në lidhje me kontrollet që duhet të zbatohen në kufijtë e jashtëm në momentin e kalimit të tyre. Pra përveç detyrimit apo jo të posedimit të vizës nuk përcakton kushtet e tjera që duhet të plotësojë një shtetas i vendeve të treta për të hyrë në hapësirën Schengen, për qëndrime afatshkurtra (3 mujore brenda një periudhë 6 mujore). Këto dispozita i parashikon Rregullorja (KE) nr. 562/2006 e Palamentit evropian dhe Këshillit e cila krijon një kod komunitar në lidhje me regjimin e kalimit të kufijve nga ana e personave, e njohur dhe si "kodi kufijve Schengen". Objektivi këtij punimi është analiza e këtyre kushteve për ti dhënë përgjigje pyetjes nëse shtetasit e vendeve të treta që i plotësojnë këto kushte i përket automatikisht një e drejtë individuale hyrje në territorin e Shteteve anëtare apo jo?

Key words: Schengen border code, third country nationals, imigration, EU legislation, conditions, individual right.

Hyrje

Rregullorja 562/2006¹ e cila krijon një kod komunitar në lidhje me regjimin e kalimit të kufijve nga ana e personave, e njohur dhe si "kodi kufijve Schengen" ka thjeshtuar në një farë mënyre kuadrin ekzistues të normave dytësore në lidhje me kalimin e kufijve, i cili rezultonte mjaft i fragmentuar. Objektivi Rregullores është konsolidimi dhe zhvillimi mëtejshëm i komponentit legjislativ të politikës së menaxhimit të integruar të kufijve, duke qartësuar rregullat mbi kalimin e kufijve të jashtëm. Rregullorja bën një ndryshim të *acquis* ekzistues në lidhje me kontrollet e personave në kufij dhe kontribuon në uniformimin e normave materiale dhe proceduriale të aplikueshme në disiplinë.

Rregullorja 562/2006 ka shfuqizuar dispozitat e Konventës së zbatimit të Marrveshjes Schengen, në lidhje me kushtet për hyrjet afatshkurtra (nenet nga 2 në 8) si dhe disa vendime të Këshillit (midis të tjerave Rregulloret 790/2001 dhe 2133/2004) dhe të Komitetit ekzekutiv, ndërkohë që kanë ngelur në fuqi normat e Konventës së zbatimit të Marrveshjes Schengen në lidhje me vizat si dhe disa Rregullore të Këshillit të miratuara për të zbatuar parashikimet e nenit 62.2 shkronja b) edhe këto në lidhje me disiplinën e vizave (LICASTRO, 2006, 587).

Më konkretisht krahas Rregullores 562/2006 e cila qëndron në qëndër të disiplinës në diskutim, janë pjesë e kornizës legjislative që rregullojnë disiplinën dhe nenet nga 9 në 18 të Konventës së zbatimit të Marrveshjes Schengen të cilët rregullojnë disiplinën e vizave me një afat kohor deri në tre muaj; Udhëzimi përbashkët konsullor¹²¹ i cili përmban kushtet e nevojshme për lëshimin e një

¹Regulation (ec) no 562/2006 of the european parliament and of the council of 15 March 2006 establishing a Community Code on the rules governing the movement of persons across borders (Schengen Borders Code) në Official Journal of the European Union L 105/1 date 13.04.2006. Kjo rregullore ka pësuar disa ndryshime, nga Rregullorja (KE) nr. 296/2008 e Parlamentit evropian dhe Këshillit e 11 marsit 2008; Rregullorja (KE) nr. 81/2009 e Parlamentit evropian dhe Këshillit e 14 janarit 2009; Rregullorja (KE) nr. 810/2009 e Parlamentit evropian dhe Këshillit e 13 korrikut 2009; Rregullorja (BE) nr. 265/2010 e Parlamentit evropian dhe Këshillit e 25 marsit 2010 dhe së fundmi nga Rregullorja (BE) nr. 610/2013 Parlamentit evropian dhe Këshillit e 26 qershorit 2013.

vize uniforme për të gjithë Palët nënshkruese të Marrveshjeve Schengen si dhe disa Rregullore të Këshillit. Këto të fundit mund ti klasifikojmë në dy kategori: në kategorinë e parë bëjnë pjesë aktet të cilat i japin aplikim kompetencës së parashikuar nga neni 62.2, shkronja b), pika i), në lidhje me hartimin e një liste të shteteve të treta, shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë një vizë në momentin e kalimit të kufijve të jashtëm dhe të atyre, shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga ky detyrim. Bën pjesë në këtë kategori Rregullorja nr. 539/2001² e cila ka pësuar disa modifikime³ një ndër të cilët dhe nga Rregullorja nr. 1091/2010⁴ e cila liberalizon regjimin e vizave dhe për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën duke kompletuar liberalizimin e vizave për vendet e Ballkanit perëndimor. Rikujtohet gjithashtu se kjo kompetencë është parashikuar më përpara nga neni 100C i Traktatit të Maastricht dhe Këshilli i kish dhënë zbatim nëpërmjet Rregullores (KE) 574/1999⁵. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë aktet të cilat krijojnë një model uniform vize, kompetencë edhe kjo e parashikuar nga neni 100C TKE, të cilës Këshilli i ka dhënë zbatim në fillim me Rregulloren 1683/1995⁶ më pas modifikuar nga Rregullorja (KE) 334/2002⁷ e 18 shkurtit 2002. Kompletjnë kornizën legjislative disa akte të cilat disiplinojnë tematika të karakterit operativ ku ndër më të rëndësishmet mund të veçohet, Rregullorja 415/2003⁸ në lidhje me lëshimin e vizave në kufij, përfshi lëshimin e vizave detare në tranzit, Rregullorja 2007/2004⁹ e cila krijon Agjensinë europiane për administrimin dhe bashkëpunimin operacional në kufijtë e jashtëm të Shteteve anëtare (FRONTEX), Direktiva 2004/82/KE¹⁰ në lidhje me detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat e pasagjerëve.

Kushtet e hyrjes për qëndrim afatshkurtër

Rregullorja 562/2006 në nenin 5 të saj (siç është modifikuar nga neni 1 pika 5 e Rregullores (BE) nr.

²Dokumenti (2005/C 326/01) në Gazetën Zyrtare të Be nr. C 326/1 datë 22.12.2005.

³COUNCIL REGULATION (EC) No 539/2001 of 15 March 2001 listing the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement, në *Official Journal EC L81/1 datë 21.03.2001*.

⁴Modifikuar nga: Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 2414/2001 e 7 Dhjetorit 2001; Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 453/2003 e 6 Marsit 2003; Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 851/2005 e 2 Qershorit 2005; Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1791/2006 e 20 Nëntorit 2006; Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1932/2006 e 21 Dhjetorit 2006; Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1244/2009 e 30 Nëntorit 2009; Rregullorja (BE) Nr. 1091/2010 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 24 Nëntorit 2010; Rregullorja (BE) Nr. 1211/2010 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 15 Dhjetorit 2010; Rregullorja (BE) Nr. 517/2013 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 13 Maj 2013; Rregullorja (BE) Nr. 610/2013 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 26 Qershorit 2013; Rregullorja (BE) Nr. 1289/2013 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 11 Dhjetorit 2013; Rregullorja (BE) Nr. 259/2014 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 3 Prillit 2014.

⁵REGULATION (EU) No 1091/2010 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 24 November 2010 amending Council Regulation (EC) No 539/2001 listing the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement, në *Official Journal of the European Union L 329/*, datë 14.12.2010.

⁶COUNCIL REGULATION (EC) No 574/1999 of 12 March 1999 determining the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders of the Member States, in *Official Journal of the European Communities L 72/2* of 18.3.1999.

⁷COUNCIL REGULATION (EC) No 1683/95 of 29 May 1995 laying down a uniform format for visas, në *Official Journal L 164*, 14/07/1995 P. 0001 – 0004.

⁸COUNCIL REGULATION (EC) No 334/2002 of 18 February 2002 amending Regulation (EC) No 1683/95 laying down a uniform format for visas, në *Official Journal L 53*, 23.02.2002, p. 7–8.

⁹COUNCIL REGULATION (EC) No 415/2003 of 27 February 2003 on the issue of visas at the border, including the issue of such visas to seamen in transit në *Official Journal of the European Union L 64/1* of 07.03.2003.

¹⁰COUNCIL REGULATION (EC) No 2007/2004 of 26 October 2004 establishing a European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union në *Official Journal of the European Union L 349/1* e 25.11.2004.

610/2013¹¹ e 26 qershorit 2013) përcakton kushtet e hyrjes për një qëndrim në territorin e Shteteve anëtare që nuk i kalon 90 ditë brenda një periudhe 180 ditore. Kushtet që duhet të plotësohen janë si më poshtë:

- a) personi i interesuar duhet “të jetë në posedim të një dokumenti udhëtimit të vlefshëm i cili lejon kalimin e kufirit”;
- b) të jetë në posedim “të një vize të vlefshme nëse kërkohet në bazë të Rregullores nr. 539/2001¹², përveç rastit nëse personi interesuar posedon një leje qëndrimi;
- c) “të justifikojë qëllimin dhe kushtet e vizitës si dhe të disponojë mjete financiare të mjaftueshme për periudhën e qëndrimit si dhe për kthimin në vendin e origjinës apo për tranzitin në një vend tjetër në të cilin pranimi është i lejuar, ose të jetë në gjendje që legalisht ti prokurojë këto mjete”;
- d) nuk duhet të jetë i sinjalizuar në Sistemin e Informacionit Schengen (SIS) me qëllim refuzimin e hyrjes;
- e) “nuk duhet të konsiderohet si një kërcënim për rendin publik, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrdhëniet ndërkombëtare të ndonjërit prej shteteve anëtare”

Për sa i përket kushtit të parë që duhet të plotësohet, janë dy Vendime¹³ të Komitetit ekzekutiv të Schengenit të cilët përcaktojnë dokumentat e vlefshëm të udhëtimit mbi të cilët mund të vendoset një vizë. Bazuar në nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores 562/2006, rojet kufitare duhet të kontrollojnë nëse përmbushet ky kusht duke verifikuar që dokumenti udhëtimit mos të jetë i skaduar dhe të paraqesë shenja falsifikimi. Ky kusht së bashku me kushtin e dytë bëjnë pjesë në formalitetet e tipit administrativ që zakonisht çdo Shtet përdor për të kontrolluar hyrjet në territorin e vet (DE LOBKOWICZ, 1994, 412).

Si dhe është theksuar shtetasit e disa vendeve të treta duhet të posedojnë një vizë në momentin e hyrjes në zonën Schengen. Ky detyrim vlen për shtetasit e Shteteve të cilët janë të listuar në shtojcën 1 të Rregullores 539/2001 e ndryshuar së fundmi nga Rregullorja (BE) nr. 259/2014. Rregullorja në fjalë përdor sistemin e listës negative dhe pozitive. Kriteret në bazë të cilëve formohen listat janë ilustruar nga Komisioni në një Komunikatë¹⁴ të tijën dhe janë rimarrë nga Rregullorja në Preambulën e saj. Për shtetasit e vendeve të treta të cilët listohen në shtojcën I bashkëngjitur Rregullores, neni 1 parashikon detyrimin e posedimit të një vize në momentin e kalimit të kufirit, ndërsa për shtetasit e vendeve të treta të cilët janë të listuar në shtojcën II të Rregullores, neni 2 parashikon se nuk kanë detyrimin e posedimit të një vize për qëndrime që nuk i kalojnë 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh. Për këta të fundit neni 7, paragrafi 3, shkronja a) pika iii) parashikon se rojet kufitare duhet të kontrollojnë vulat e hyrjes dhe të daljes për të verifikuar nëse personi nuk ka tejkaluar afatin e

¹¹COUNCIL DIRECTIVE 2004/82/EC of 29 April 2004 on the obligation of carriers to communicate passenger data, në *Official Journal of the European Union* L 261/24 e 06.08.2004.

¹²REGULATION (EU) No 610/2013 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 June 2013 amending Regulation (EC) No 562/2006 of the European Parliament and of the Council establishing a Community Code on the rules governing the movement of persons across borders (Schengen Borders Code), the Convention implementing the Schengen Agreement, Council Regulations (EC) No 1683/95 and (EC) No 539/2001 and Regulations (EC) No 767/2008 and (EC) No 810/2009 of the European Parliament and of the Council, në *Fletoren Zyrtare të BE*, L 182/1 datë 29.06.2013.

¹³COUNCIL REGULATION (EC) No 539/2001 of 15 March 2001 listing the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement, në *Official Journal* L 081, datë 23.03.2001, i modifikuar së fundmi nga Rregullorja (BE) Nr 1289/2013 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 11 Dhjetorit 2013 e cila ka krijuar një mekanizëm sigurie me qëllim pezullimin e liberalizimit të vizave për një Shtet të caktuar në rast urgjence si dhe ndryshon mekanizmin ekzistues të reciprocitetit.

¹⁴Vendimi Komitetit ekzekutiv nr. 56 i 16 dhjetorit 1998, në lidhje me përpunimin e një manuali mbi dokumentat mbi të cilët mund të vendoset një vizë, në *Fletoren Zyrtare* L 239 të 22 shtatorit 2000, fq. 207., dhe Vendimi Komitetit ekzekutiv nr. 14 i 28 prillit 1999, mbi manualin që përcakton dokumentat mbi të cilët mund të vendoset një vizë, në *Fletoren Zyrtare* L 239 të 22 shtatorit 2000, fq. 298.

qëndrimin të autorizuar në territorin e Shteteve anëtare.

Për sa i përket shtetasve të vendeve të treta të cilët kanë detyrimin e vizës, neni 7 paragrafi 3 shkronja a) bis¹⁵, përcakton se kontrolli plotë, përveç verifikimit të identitetit të titullarit të vizës parashikon edhe verifikimin e vërtetësisë së vizës nëpërmjet konsultimit të sistemit VIS, konform nenit 18 të Rregullores 768/2008¹⁶.

Në fund shkronja b) e paragrafit 1, të nenit 5 parashikon një përjashtim nga detyrimi për vizë për ata shtetas të vendeve të treta të cilët janë të paisur me leje qëndrimi. Duhet theksuar se kjo mund të jetë leje qëndrimi e lëshuar në bazë të legjislacionit të BE si për shëmbull në bazë të Direktivës 2003/86 mbi bashkimin familjar, apo mund të jetë një leje qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kombëtare të një Shteti anëtar në bazë të legjislacionit të vet.

Vlersimi i “mjeteve financiare të mjaftueshme” duhet bërë në bazë të kohës dhe qëllimit të qëndrimit siç parashikohet në paragrafin 3 të nenit 5 i cili përcakton mënyrën e vlersimit të mjeteve financiare të nevojshme. Njëkohësisht neni 34 i Rregullores, parashikon detyrimin për Shtetet anëtare që ti komunikojnë Komisionit shumat e referimit të kërkuara për kalimin e kufijve të jashtëm, të fiksuara çdo vit nga autoritetet kombëtare. Një specifikim i tillë çon në një zbatim jo uniformë të këtij kriteri për shkak se shumat e kërkuara mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme midis Shteteve anëtare.

Përveç shumave të parave dhe kartave të kreditit si provë e disponibilitetit financiar mund të shërbejë dhe letra e garancisë e lëshuar nga personi i cili fton shtetasin e vendit të tretë.

Rojet kufitare gjithashtu në bazë të parashikimit të paragrafit 2, mund tju kërkojnë shtetasve të vendeve të treta dokumenta mbështetës të cilat parashikohen në një listë jo shteruese (Shtojcën 1), me qëllim verifikimin e respektimit dhe qëllimit dhe kushteve të vizitës. Shtojca 1 parashikon se:

- për udhëtime pune mund të kërkohet ftesa nga ana e një sipërmarrje apo nga ana e organizatorëve të një konference apo panairi;
- në rast udhëtimi për motive studimi mund të kërkohet çertifikata e regjistrimit ose tesera e studentit;
- në rast udhëtimi për turizëm apo privat mund të kërkohen: i) dokumenti që justifikon qëndrimin dhe fjetjen, i cili mund të jetë ftesa nëse qëndrohet në banesën e një personi ose prenotimi apo dokument tjetër vërtetues nëse qëndrohet në një strukturë e cila ofron një shërbim të tillë dhe ii) dokumenti që justifikon kthimin, i cili mund të jetë bileta e kthimit apo bileta vajtje – ardhje.
- në rast udhëtimi për arsye, shkencore, kulturore, sportive apo fetare, mund të kërkohen biletat e hyrjes, ftesat, regjistrimi etj.

Kërkesa nga ana e autoriteteve për të dokumentuar qëllimin dhe kushtet e vizitës ngre disa dyshime në lidhje me pajtueshmërinë e saj me respektimin e të drejtës së privatësisë, e njohur si një prej të drejtave themelore dhe e mbrojtur shprehimisht dhe nga neni 8 i KEDNJ, pasi dhënia e një informacioni të tillë mund të çojë lehtë në një ndërhyrje në jetën personale të personit (MEIJERS, 1991, 66).

Sinjalizimi në Sistemin e Informacionit Schengen (SIS) lidhet me ruajtjen e rendit publik. SIS është një sistem i përbashkët elektronik i mbledhjes së të dhënave, i themeluar nga Shtetet palë të Marrveshjeve Schengen, disiplinuar nga titulli IV i Konventës së zbatimit, nenet nga 92-119. Me anë të Rregullores 1104/2008¹⁷ të Këshillit dhe Vendimit të Këshillit nr. 2008/839¹⁸ është bërë i mundur

¹⁵COM (2000) 577 definitiv, e 21 shtatorit 2000.

¹⁶Shtuar nga Rregullorja (KE) nr. 81/2009 e Parlamentit dhe Këshillit e 13 korrikut 2009 e cila modifikon Rregulloren 562/2006, në *Fletoren Zyrtare L 35/56, të 04.02.2009*.

¹⁷REGULATION (EC) No 767/2008 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 9 July 2008 concerning the Visa Information System (VIS) and the exchange of data between Member States on short-stay visas (VIS Regulation), në *Official Journal of the European L 218/60, 13.08.2008*, ndryshuar nga Rregullorja (KE) 810/2009 e Parlamentit dhe Këshillit, datë 15.09.2009 e më pas nga Rregullorja (BE) 610/2013 e Parlamentit dhe Këshillit, datë 29.06.2013.

¹⁸COUNCIL REGULATION (EC) No 1104/2008 of 24 October 2008 on migration from the Schengen Information System (SIS 1+) to the second generation Schengen Information System (SIS II), në *Official Journal of the European Union L 299/1, datë 8.11.2008*, i ndryshuar nga COUNCIL REGULATION (EU) No 541/2010 of

zëvendësimi Sistemit SIS i cili ka funksionuar që prej vitit 1995, me sistemin SIS II, i krijuar nga Rregullorja 1987/2006¹⁹ e Parlamentit evropian dhe Këshillit.

Me qëllim ruajtjen e rendit publik dhe aplikimin e dispozitave në lidhje me qarkullimin e personave i njihet e drejta çdo Shteti të zonës Schengen që pas një vendimi të autoriteteve të tij administrative apo gjyqësore, të raportojë të dhënat mbi shtetasit e vendeve të treta të cilëve ju është refuzuar hyrja apo qëndrimi. Neni 21 i Rregullores përcakton rregullin e proporcionalitetit sipas të cilit, para sinjalizimit të një personi, Shteti anëtar verifikon nëse rrethanat dhe rëndësia e rastit justifikojnë sinjalizimin. Një sinjalizim mund të ndërmerret nga autoritetet kombëtare në rastin kur vendimi i marrë nga autoritetet administrative apo gjyqësore është i bazuar mbi një rrezik për rendin publik, sigurinë publike apo kombëtare. Kjo situatë verifikohet kur shtetasi vendit të tretë është njohur fajtor për një veprë penale për të cilën parashikohet një dënim mbi një vit burgim, apo kur mbi të ka “baza serioze për të besuar se ka kryer një krim të rëndë, ose nëse ekzistojnë tregues të qartë mbi qëllimin për të kryer një veprë të tillë”. Mund gjithashtu të sinjalizohet në rastin kur mbi shtetasin e vendeve të treta është marrë një masë dëbimi, refuzimi hyrje apo largimi e cila nuk është shfuqizuar apo pezulluar.

Mekanizmi SIS II parashikon se vendimet e autoriteteve kombëtare me qëllim sinjalizimin mund të ankimohen në bazë të legjislacions të tyre kombëtar.

Nje kritikë e cila mund të ngrihet ndaj funksionimit të sistemit, është se ai nuk ka mundur të harmonizojë plotësisht kushtet e sinjalizimit të personave, ose më saktë ka mundur të krijojë vetëm një harmonizim të pjesshëm. Kjo për shkakun se termat “baza serioze për të besuar” dhe “tregues të qartë mbi qëllimin” përdorur në nenin 24 paragrafi 2 shkronja b), nuk kryejnë një përcaktim të qartë por u lejojnë një diferencë të madhe diskrecioni autoriteteve kombëtare. Në këtë mënyrë, një shtetasi të vendit të tretë mund të mos ti lejohet hyrja në zonën Schengen në bazë të një sinjalizimi të bërë në bazë të kritereve të vlersimit të njërit prej Shteteve palë, pavarësisht se këto kritere janë të ndryshme me ato të Shteteve të tjerë.

Kushti i fundit i parashikuar nga neni 5 paragrafi 1 i Rregullores 562/2006 që duhet të plotësojë shtetasi i vendit të tretë për të hyrë në zonën Schengen është se ai “nuk duhet të konsiderohet si kërcënim për rendin publik, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrdhëniet ndërkombëtare të ndonjërit prej Shteteve anëtare. Kërcënimi për shëndetin publik nuk parashikohet nga Marrveshjet Schengen dhe është një parashikim shtesë i bërë nga Rregullorja 562/2006 e cila në paragrafin 19 të nenit 2 jep dhe përkufizimin e termit të përdorur²⁰.

Kushtet e hyrjes parashikuar në shkronjat d) dhe e) të nenit 5 si dhe neni 7, paragrafi 3, shkronja a), pika vi) i cili parashikon si një pre elementëve të kontrollit të plotë, verifikimin nëse personi apo mjete i tij i transportit nuk përbëjnë një rrezik për rendin publik, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrdhëniet ndërkombëtare të ndonjërit prej Shteteve anëtare, nuk krijojnë një sistem kontrolli uniform (homogjen), pasi pozicioni personit të kontrolluar merret në konsiderat në bazë të kritereve kombëtare, të cilët ndryshojnë nga Shteti në Shtet (CELLAMARE, 2006, 123).

Paragrafi 4 i nenit 5 të Rregullores 562/2006 parashikon rastet kur Shtetet mund të shmangin kushtet e parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 5 dhe të lejojnë shtetasin e vendit të tretë të hyjë në territorin e tyre pavarësisht se nuk i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara. Në këtë mënyrë, një shtetas i vendit

3 June 2010 amending Regulation (EC) No 1104/2008 on migration from the Schengen Information System , në *Official Journal of the European Union L 155/19, datë 22.06.2010.*

(SIS 1+) to the second generation Schengen Information System (SIS II)

¹⁹COUNCIL DECISION 2008/839/JHA of 24 October 2008 on migration from the Schengen Information System (SIS 1+) to the second generation Schengen Information System (SIS II), në *Official Journal of the European Union L 299/43 datë 8.11.2008*, ndryshuar nga COUNCIL REGULATION (EU) No 542/2010 of 3 June 2010 amending Decision 2008/839/JHA on migration from the Schengen Information System (SIS 1+) to the second generation Schengen Information System (SIS II), në *Official Journal of the European Union L 155/23 datë 22.6.2010.*

²⁰REGULATION (EC) No 1987/2006 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 20 December 2006 on the establishment, operation and use of the second generation Schengen Information System (SIS II), në *Official Journal of the European Union L 381/4 datë 28.12.2006.*

të tretë i cili pavarisist se nuk i plotëson të gjitha kushtet por që posedon një leje qëndrimi, apo një vizë afatgjatë të një Shteti palë, lejohet të hyjë me qëllim kalimi tranzit për të harritur territorin e Shtetit i cili ka lëshuar lejen e qëndrimit apo vizën. Mund gjithashtu ti lëshohet viza në kufi në bazë të Rregullores 810/2009 dhe ti lejohet në këtë mënyrë hyrja, shtetasit të vendit të tretë i cili plotëson të gjitha kushtet e tjera përveç atë që parashikon detyrimin e posedimit të vizës përcaktuar në shkronjën b) të paragrafit 1. Në fund parashikohet se një Shtetet anëtar për motive humanitare, interes kombëtar, apo për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, mundë të autorizojë hyrjen në territorin e tij për shtetas të vendeve të treta të cili nuk plotësojnë një apo disa nga kushtet e paragrafit 1.

Hyrja, një e drejtë individuale?

Pas shqyrtimit të kushteve të hyrjes që duhet të plotësojë shtetasi i vendeve të treta për të hyrë në zonën Schengen, problemi që shtrohet është nëse Rregullorja 562/2006 i njeh apo jo të huajt një të drejtë individuale hyrje?

Problemi që shtrohet lind nga ekzistenca e një diferencë në formulim midis dy normave, nenit 5 të Konventës Schengen dhe nenit 5 të Rregullores 562/2006 e cila e ka zëvendësuar. Neni 5 i Konventës parashikonte që me plotësimin e kushteve të huajt “mund ti lejohet” hyrja në territorin e Palëve nënshkrues²¹, ndërkohë që neni 5 i Rregullores limitohet të parashikojë vetëm kushtet e hyrjes që i huaj duhet të plotësojë. Norma e Konventës me termin “*may be granted*” u njeh mundësinë palëve nënshkruese për të limituar hyrjen e të huajt në territorin e tyre me plotësimin e kushteve të tjera përveç atyre të parashikuara nga vetë norma. Pra, të huajt që pavarisist se plotëson të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 5 i Konventës, nuk i njihej një e drejtë individuale hyrje në territorin Schengen, pasi kjo mbetet gjithmonë në diskrecionin e Shteteve nënshkruese. Ndryshe nga norma e Konventës, neni 5 i Rregullores 562/2006 i cili e ka zëvendësuar, nuk parashikon një liri veprimi për Shtetet por limitohet në shprehjen “për hyrje që nuk i tejkalon 90 ditë në harkun kohor prej 180 ditëshkushtet e hyrjes janë si më poshtë”, pra duke eliminuar shprehjen “*may be granted*”. Në këtë drejtim duhet të konsiderohet dhe neni 13 i Rregullores i cili parashikon se i refuzohet hyrja shtetasit të vendit të tretë i cili nuk plotëson një nga kushtet e nenit 5 paragrafi 1. Neni 13 në paragrafin 3 parashikon të drejtën e personit të cilit i është refuzuar hyrja që të paraqesë një ankim, në bazë të legjislacionit kombëtar të vendit të cilit i ka refuzuar hyrjen.

Mungesa e shprehjes “mund të lejohet” në nenin 5 e cila eliminon pushtetin diskrecional të Shteteve nga njëra anë dhe e drejta e ankimit parashikuar nga neni 13, çojnë në konkluzionin se Shtetet anëtare nuk mund të refuzojnë hyrjen e të huajt që përmbush të gjitha kushtet e nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores 562/2006. Pra Rregullorja në fjalë i njeh të huajt një të drejtë individuale hyrje në zonën Schengen.

Megjithatë duhet shtuar se në lidhje me personat të cilët kanë nevojë për një vizë për të hyrë në zonën Schengen, nuk ekziston ndonjë normë komunitare e cila detyron Shtetet anëtare të lëshojnë një vizë të tillë. Në fakt e drejta komunitare përcakton rastet se kur një vizë uniforme është e nevojshme, por në asnjë rast nuk përcakton detyrimin për Shtetet anëtare që të lëshojnë një vizë të tillë. Ngelet në diskrecionin e këtyre të fundit vendimi për të lejuar një person për të hyrë apo jo në zonën Schengen²².

Shtetet anëtare gjithashtu kanë dhe një marzh të lartë veprimi për sa i përket vlersimit të kushtit të

²¹Konsiderohet si “kërcënim për shëndetin publik” çdo sëmundje e konsideruar si potencial për përhapje epidemie nga Rregullorja ndërkombëtare e shëndetësisë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, apo sëmundje të tjera infektive të cilat janë subjekt i dispozitave mbrojtëse të aplikueshme për shtetasit e vendeve anëtare.

²²Article 5 of the Convention Applying The Schengen Agreement Of 14 June 1985: “For visits not exceeding three months entry into the territories of the Contracting Parties *may be granted* to an alien who fulfils the following conditions:

(a) in possession of a valid document or documents permitting them to cross the border, as determined by the Executive Committee;

(b) in possession of a valid visa if required;

(c) if applicable, submits documents substantiating the purpose and the conditions of the planned visit and has

parashikuar nga neni 5, paragrafi 1 shkronja e) i cili i referohet nocionit të rendit publik, sigurisë së brendshme, shëndetit publik apo marrdhënieve ndërkombëtare.

Në konkluzion vihet re se, nëse në rastin kur plotësohen të gjitha kushtet e nenit 5 paragrafi 1 i Rregullores 562/2006 shtetasit të huaj nuk i duhet refuzuar hyrja, por mundësia që u lihet Shteteve anëtare për të vlersuar plotësimin e këtyre kushteve pengon formimin e një të drejte individuale pranimit në territorin Schengen.

Konkluzione

Rregullorja 562/2006 e njohur dhe si Kodi kufijve Schengen, përcakton kushtet e hyrjes për një qëndrim në territorin e Shteteve anëtare që nuk i kalon 90 ditë brenda një periudhe 180 ditore. Në këtë mënyrë Rregullorja në fjalë ka harritur të krijojë një harmonizim të disiplinës komunitare në lidhje me hyrjet dhe qëndrimet afatshkurtra të shtetasve të vendeve të treta. Shtetasi i vendit të tretë që kërkon të hyjë në territorin komunitar duhet të plotësojë pesë kushtet e përcaktuara në nenin 5 të Rregullores. Shtetasit të vendeve të treta që i refuzohet hyrja i njihet e drejta e ankimit në bazë të legjislacionit kombëtar të vendit të cilit i ka refuzuar hyrjen. Kjo e drejtë dhe fakti që në ndryshim nga neni 5 i Konventës së zbatimit të Marrveshjes Schengen, Rregullorja nuk përdor termin “mund ti lejohet hyrja”, çon në idenë së të huajt që i plotëson kushtet e nenin 5 të Rregullores i përket një e drejtë individuale hyrje në territorin Schengen.

Por pavarësisht harmonizimit të kushteve të hyrjes, nga një analizë e detajuar e tyre, sidomos e kushtit të pestë konkludohet se ngelet gjithmonë në diskrecion të Shteteve palë vlersimi final nëse i huaj i plotëson këto kushte apo jo. Në veçanti përcaktimi nëse shtetasi i vendeve të treta konsiderohet si një kërcënim për rendin publik, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrdhënieve ndërkombëtare të ndonjërit prej Shteteve anëtare, bëhet gjithmonë nga ana e Shteteve palë. Pikërisht këto arsye pengojnë krijimin e një të drejte individuale të shtetasit të huaj për të hyrë në territorin Schengen.

References

ASTRID EPINEY/ANDREA EGBUNA-JOSS, “Regulation (EC) No 562/2006 of the European Parliament and the Council of 15 March 2006 establishing a Community Code on the rules governing the movement of persons across borders (Schengen Borders Code)”, in: Kay HAILBRONNER., “EU Immigration and Asylum Law”. Commentary, München 2010.

CAGGIANO G., “Le nuove politiche dei controlli alle frontiere, dell’asilo e dell’immigrazione nello Spazio unificato di libertà, sicurezza e giustizia”, in “Studi sull’integrazione europea” n.1, 2008.

CASTELLAZZI S., “Nuove regole comunitarie in tema dell’attraversamento delle frontiere”, in Il diritto dell’economia, 2006.

CELLAMARE, G. (2006). “La disciplina dell’immigrazione nell’Unione Europea”. Giappichelli.

CELLAMARE G., “I diversi regimi applicabili all’ingresso e al soggiorno degli stranieri nell’Unione Europea in base alla cittadinanza degli stessi”, in Ennio TRIGGIANI (a cura di) “Le nuove frontiere della cittadinanza europea”, Bari 2011.

LICASTRO. (2006). Il “Codice frontiere Schengen”. *Diritto comunitario e degli scambi internazionali*.

LOBKOWICZ, W. D. (1994). “Vers une politique vis-à-vis des ressortissants d’Etats tiers?”. *Actualités du droit*.

MEIJERS, H. (1991). “Schengen Internationalisation of central chapters of the Law of Aliens, Refugees, Privacy, Security and the Police”. Alblasterdam, Utrecht: Luwer Law and Taxation.

sufficient means of support, both for the period of the planned visit and to return to their country of origin or to travel in transit in a Third State, into which their admission is guaranteed, or is in a position to acquire such means legally;

(d) has not been reported as a person not to be permitted entry;

(e) is not considered to be a threat to public policy, national security or The international relations of any of the Contracting Parties.

Qasja aktuale e sistemit evropian të patentave në lidhje me patentimin e programeve kompjuterike

Mr. Faton Shabani
State University of Tetovo

Abstract

A patent is a form of legal protection given to individuals who create an invention or process. Still, even developed countries differ on which inventions should be patentable, especially when it comes to recent technology. Software is not an exception: while the United States has opened the doors for patents of business methods and mathematical algorithms (as long as they have a useful application) other countries are divided. Japan and Asia in general seem to follow the U.S.'s lead, while Europe is still more conservative on the issue. There has been an ongoing argument among the legal community and software industry regarding to computer programs whether they are excluded from the protection of patent due to article 52 of the European Patent Convention (EPC). The wording of this article that excludes the patentability of programs for computers "as such" has prevented many inventors in software-related technologies from filing patent applications in Europe for a long time. However, since 1987, the Boards of Appeal of the EPO has steadily developed a broader interpretation of article 52. Therefore, the granting of patents for software-related inventions has long been a matter of some controversy. One example of this was the rejection by European Parliament of the proposed Directive on the patentability of computer-implemented inventions (CII) on 6 July 2005. Legally speaking, the rejected CII directive was an attempt to clarify the issue of software patents in EU member states. Accordingly, the number of software based inventions routinely has been granted patent by the EPO to the present time. Decisions of EPO show that there is no exclusion for computer programs provided that the requirement of novelty and inventiveness is fulfilled.

Keywords: patent, software, European Patent Convention.

Patenta e programeve kompjuterike

Patenta paraqet një të drejtë të së drejtës së pronësisë industriale me të cilën mbrohet shpikja si produkti i materializuar i punës inventive të një individi apo të një grupi njerëzish, nëse i përmbush kushtet e parapara me ligj (Поленак et al., 2004, 97). Patenta kështu, si e drejtë me histori të gjatë të ekzistimit (Schwabach, 2007, 12), paraqet një të drejtë subjektive që i takon personit fizik apo juridik nëse shpikja e tyre i përmbush kushtet e parapara ligjore, si ato materiale ashtu edhe formale, prandaj edhe titullari i patentës fiton disa të drejta për territor të caktuar (parimi i territorialitetit) dhe për kohën e caktuar (kufizueshmëria e mbrojtjes juridike) (Besarović, 2005, 65). Si formë e mbrojtjes së shpikjes, patenta thuhet të jetë kontratë midis shoqërisë dhe shpikësit, me ç'rast i jepet monopol një shpikjeje. Në interes për të nxitur inovacionin, shoqëria bie dakord të ofrojë mbrojtjen e shpikjes nga cenimi apo përdorimi i paautorizuar i së njëjtës nga personat e tretë, ndërsa si kundërshpërblim shpikësi duhet të ofrojë detajet e shpikjes dhe shpikjen ta zbatojë në praktikë (Whory, 2008, 10).

Pyetja se çfarë mund të patentohet, është ndoshta pyetja më e rëndësishme që i preokupon ligjvënësit kur vihen në pozitë që duhet të marrin vendim për miratimin e dispozitave të reja apo ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave juridike ekzistuese, për rregullimin e çështjeve nga fusha e patentave. Kjo, njëkohësisht është edhe çështja e cila ka shkaktuar më tepër debat, si në shkallë kombëtare ashtu edhe në atë ndërkombëtare, sidomos kur duhet vendosur për kategoritë e lëndëve që do të konsiderohen të patentueshme nga legjislacioni kombëtar apo nga ndonjë akt ndërkombëtar mbi patentën, objekti i së cilës po zgjerohet nga viti në vit dekadat e fundit. Në këtë drejtim, vështirësi dhe qëndrime kundërtënëse janë hasur dhe vazhdojnë të hasen për fushën e bioteknologjisë (ndonjëherë të quajtur edhe si patentë të jetës) dhe së dyti patentat softverikë.

Derisa shpikjet që kanë të bëjnë me hardverët kompjuterikë, kënaqnin qartë kërkesat e legjislacioneve dhe akteve ndërkombëtare, kjo nuk ishte kështu fillimisht duke vazhduar të mos jetë edhe më tej në disa vende (veçanërisht të pjesës së Evropës), kur bëhet fjalë për softverët apo programet

kompjuterike (Stobbs, 2004, 9). Softverët kompjuterikë, si produkte apo zbulime të kontributit inventiv janë rreth 50 vite të vjetër, por kërkesa për mbrojtje nëpërmjet të drejtës së pronësisë industriale e këtyre produkteve, konkretisht me anë të patentave për softverë, është relativisht e re. Kur bëhet fjalë për të përkufizuar kuptimin e patentave softverikë apo patentave të programeve kompjuterike, legjislacionet kombëtare dhe aktet ndërkombëtare e shmangin një gjë të tillë, duke ia lënë të njëjtën ta bëjë teoria që studion të drejtën e patentave apo organizatat e ndryshme që mbrojnë aspekte të caktuara të patentave softverikë. Edhe përkundër faktit që përkufizimet janë të pakta, përsëri nuk ekziston një përkufizim përgjithësisht i pranuar. Si përkufizim më i plotë konsiderohet ai që e jep Fondacioni për Infrastrukturë të Lirë Informativ (Foundation for a Free Information Infrastructure - FFII), sipas të cilit, patenta softverike është: “patentë për mbrojtjen e ndonjë performance të kompjuterit të realizuar me anë të programit kompjuterik.” Ky lloj i patentës kërkon që shpikja e cila është paraqitur për t’i dhënë mbrojtje patentore, qoftë produkt apo proces, të jetë e mishëruar me udhëzimet që ekzekutohen nga kompjuteri. Me këtë rast patenta nuk lëshohet mbi vetë softverin, por, për shpikjen e cila përdor softverin e caktuar inventiv për të prodhuar rezultat të dobishëm, konkret dhe të prekshëm (Elias and Stim, 2004, 331).

Çështja e patentave softverikë, mbetet një çështje e mprehtë, veçanërisht për ligjvënësit e BE-së. Në këtë mënyrë, softverët janë të patentueshëm në SHBA, derisa kjo nuk është e qartë se deri në çfarë mase janë të patentueshëm sipas Konventës Evropiane të Patentave (European Patent Convention, 1973, München), gjegjësisht thelbi i debatit në Evropë është jo fakti se softverët janë të patentueshëm ose jo, por a duhet të jenë softverët kompjuterikë objekt i patentimit apo jo? (Dutfield and Suthersanen, 2008, 263). Juridiksioni i vendeve të Evropës, por edhe vetë BE-ja, kanë një ose më tepër arsye për këtë refuzim të dhënies së patentave softverikë, edhe pse kohës së fundit si pasojë e kundërshtimeve të mëdha që bëhen nga përkrahësit e këtyre llojeve të patentave, këta juridiksione që *de iure* ndalojnë dhënien e patentave softverikë, megjithatë janë “të detyruar” të ofrojnë rrugë dhe mënyra tjera alternative deri te patentimi i softverëve kompjuterikë, duke e afruar “rreth” objektit të patentueshëm.

Sistemi evropian i patentave

Edhe pse, zhvillimin më të madh patentat softverikë e shënuan dhe vazhdojnë ta shënojnë në SHBA, si në aspekt të përhapjes së dhënies së tyre në praktikë, ashtu edhe në aspektin e rregullimit të tyre juridik, megjithatë, patenta e parë për program kompjuterik në kuptimin modern, mendohet të jetë dhënë jo në SHBA, por në Evropë. Kështu, më 21 maj të vitit 1962, është paraqitur aplikacioni për patentë i titulluar “A computer arranged for the automatic solution of linear programming problems”, ndërsa patenta për të njëjtin aplikacion me shifër GB1039141, u dha më 17 gusht të vitit 1966. Megjithëse, patenta e parë u dha për një program kompjuterik në Evropë, trajektorja që pati më pas zhvillimi patentave softverikë është krejtësisht e ndryshme nga ajo që ishte dhe vazhdon të jetë në praktikën e SHBA-së.

Në Evropë, sot pyetja më e shpeshtë që parashtrohet është, çka duhet të llogarisim si të drejtë patentore evropiane? Më afër të së vërtetës, është të konsiderojmë se si burime të së drejtës patentore evropiane, duhet të përfshijmë me patjetër: a) Konventën Evropiane të Patentave; b) Direktivën e 1998 për bioteknologji (Directive 98/44/EC of the European Parliament and of the Council of 6 July 1998 on the legal protection of biotechnological inventions); c) Rregulloren për licencimin e detyrueshëm të produkteve farmaceutike për eksport me vendet me probleme të shëndetit publik (Regulation (EC) No 816/2006 of the European Parliament and of the Council of 17 May 2006 on compulsory licensing of patents relating to the manufacture of pharmaceutical products for export to countries with public health problems); gjithashtu edhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; të drejtën e rastit të krijuar nga vendimet e Bordit të Apelit të Zyrës Evropiane për Patentë; por edhe të drejtën e rastit të gjykatave kombëtare të shteteve evropiane, e cila derisa të zëvendësohet (nëse do të ndodhë ndonjëherë një gjë e tillë) nga një gjykatë evropiane, siç parashikohet në diskutimet dhe propozimet lidhur me patentat e Komunitetit Evropian; na ofrojnë një pasqyrë se çka në të vërtetë është e mbrojtur në aspekt të shpikjeve dhe çka jo (Spinello and Bottis, 2009, 60).

Përmbajtja e Konventës Evropiane të Patentave lidhur me programet kompjuterike

Shpikja e patentuar para një zyre kombëtare të një shteti evropian, nuk vlen edhe në shtetet tjera. Për të shmangur cenimet e patentave të fituar në një shtet në shtetin tjetër, disa shtete evropiane vendosën të nënshkruajnë Konventën Evropiane të patentave (KEP), me anë të së cilës u themelua edhe Zyra Evropiane e Patentave (ZEP), e cila mundësoi që nëse fitohet patentë nga ZEP, atëherë praktikisht ajo patentë është e vlefshme në të gjithë shtetet që e kanë nënshkruar KEP. Duhet nënvizuar se, KEP nuk paraqet traktat të BE-së, por traktat i 38 shteteve të cilat deri më sot e kanë nënshkruar atë, e që nënkupton faktin që edhe ZEP nuk paraqet institucion të BE-së.

Derisa nuk ekziston një ligj i "përbashkët" për patentë të vlefshëm në të gjithë Evropën, dispozitat thelbësore juridike janë harmonizuar me miratimin e KEP, kështu që, për qëllime praktike janë të mjaftueshme të merren parasysh dispozitat e KEP, të cilat janë pasqyruar edhe në ligjet kombëtare të shteteve anëtare të KEP. Dispozita kyçe në këtë drejtim është neni 52(1) i KEP, ku përkufizohet se çka do të mund të mbrohet me patentë: *"Patentat evropiane duhet të jepen për të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që ato të jenë të reja, të përfshijnë një hap inventiv dhe të jenë të zbatueshme në industri."* Konventa thekson se, me të mbrohen shpikjet, por nuk përkufizon se çka paraqet shpikja. Ekziston vetëm kuptimi i përgjithshëm se shpikja e patentueshme duhet të jetë teknike. Neni 52(1) është plotësuar dhe sqaruar më tej në mënyrë plotësuese me nenin 52(2), duke dhënë të dhëna se çka nuk do të konsiderohet shpikje në kuptimin e paragrafit 1: *"Zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore; krijimet estetike; skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e akteve mendore, metodat biznesore dhe programet kompjuterike."* Është paksa e habitshme që KEP kufizon në këtë mënyrë fusha të patentimit, që ofron listë, por jo edhe teori arsyetuese për këtë listë; se pse objekte të caktuara janë përjashtuar nga patentimi. Teoria e ndjekur nga e drejta e rastit të ZEP, që është bazuar në nocionin e "teknologjisë": të gjithë çështjet dhe vetëm ato duhet të jenë të patentueshme, me kusht që të përmbushin edhe kriteret e tjera të parapara për patentim.

Qëndrimi i Zyrës Evropiane të Patentave ndaj kërkesave për patentim të programeve kompjuterike

Fakti i përjashtimit të programeve kompjuterike nga ana e KEP, nxiti debat, i cili debat asesi të ndalohet edhe sot e kësaj dite. Gjatë konferencës themeluese të KEP, në vitin 1973, disa delegacione ishin kundër kufizimeve që përjashtonin nga patentimi të gjitha shpikjeve fizike që kanë të inkuorporuar programe kompjuterike. Negociatat rezultuan me shtimin e paragrafit 3, që do të bëjë të sigurt se paragrafi 2 nuk do të keqpërdoret, sipas të cilit paragraf: "paragrafi 2 do të përjashtojë patentimin e objektit apo aktivitetit si të tillë". Duhet pritur deri në vitin 1998, që ZEP të vendosë për interpretimin e ri të nocionit "si të tillë". ZEP vendosi që programi kompjuterik si i tillë është *"nëse, kur operacionalizohet në kompjuter, ai prodhon një efekt teknik më tej i cili shkon përtej ndërveprimit normal midis programit (softverit) dhe kompjuterit (hardverit)."* Vendimet e ZEP ishin në kundërshtim dhe të paqarta për shkak të bazës juridike për dhënien e mbrojtjes dhe kjo sugjeron se një program kompjuterik nuk do të përjashtohet nga mbrojtja nëse programi përfshin një "karakter teknik", por nuk ka dhënë përkufizim se çka nënkupton me "karakter teknik". Në mesin e viteve 80-ta, ZEP në vendimin *Viacom*, mbajti qëndrimin se shpikja në fjalë ka karakter teknik dhe kështu është e patentueshme. Në këtë rast, kërkesat ishin drejtuar te kompjuteri që vepron në përputhje me udhëzimet në programin kompjuterik për të prodhuar efekt teknik (rritjen e fotografisë dixhitale në bazë të një metode matematikore). Ky rast u pasua nga rastet tjera të njohura, si: *IBM*, *COMVIK*, apo *Hitachi*, të cilët u refuzuan nga ZEP, duke mos u dhënë patentë shkaku i mungesës së karakterit teknik.

Dështimi i miratimit të Propozimit për Direktivën CII

Duke qenë të vetëdijshëm se, ndryshimi i një traktati si ai i Konventës, i nënshkruar nga një numër i konsiderueshëm i shteteve, është i vështirë, zgjidhja për të inicuar ndryshime në aspekt të

përmirësimit të pozitës së softverëve kompjuterikë për mbrojtjen me patentë, u gjend në përgatitjen e një direktive e cila shihej si më e lehtë për të arritur ndryshimin e legjislacionit të patentave në Evropë. Kështu, në vitin 2002, Parlamenti dhe Komisioni Evropian inicuan propozimin për një direktivë (*Proposal for a Directive of the European Patent and of the Council on the patentability of computer-implemented invention (CII) / COM/2002/0092 final-COD 2002/2247*) për të kodifikuar dhe harmonizuar ligjet e ndryshme kombëtare evropiane për patentë dhe për të përforcuar politikën e ZEP për dhënien e patentave për shpikjet e programeve kompjuterike. Propozuesit ndryshuan emërtimin në kërkesën e tyre, dhe në vend ta quanin softver, atë për të cilën kërkonin mbrojtje e quajten "shpikje e zbatuar kompjuterike". Shpikja e zbatuar kompjuterike, është përkufizuar si: "shpikje, zbatimi i së cilës përfshin përdorimin e kompjuterit, mjetet kompjuterike apo aparatit tjetër të programueshëm; shpikje e cila ka një apo më shumë karakteristika për t'u realizuar tërësisht apo pjesërisht nga ana e programit kompjuterik."

Vitet në vijim ishin të karakterizuara me debate, propozime, rezoluta e qëndrime kontradiktore rreth Direktivës dhe patentimit të softverëve kompjuterikë. Direktiva u refuzua nga Parlamenti përfundimisht në vitin 2005. Kjo Direktivë, megjithatë ka ndezur një ndër betejat më të mëdha lobuese të viteve të fundit në Evropë. Korporatat e mëdha kishin tendencë të lobonin nëpërmjet shoqatave të tilla si: UNICE (Federata evropiane e punëdhënësve), Comp TIA (Industria ndërkombëtare e TI), EFICTA (Shoqata e teknologjisë së lartë evropiane), dhe North America BSA (Aleanca e biznesit softverik). Ndërsa, fushata më e dukshme kundër patentave softverikë, është organizuar nga FFII. Kundërshtarët e Direktivës, pohonin se, ajo paraqiste një patentim të të gjithë softverëve, respektivisht është një zgjerim i sferës së patentueshmërisë e jo vetëm harmonizim, kjo edhe për faktin se idetë që kërkonin të patentohen tashmë mbrohen në mënyrë adekuatë nga e drejta e autorit. Mbështetësit, megjithatë argumentonin se, nëpërmjet këtij propozimi nuk pretendohet të zgjerohet fusha e patentueshmërisë, por kërkohet patentim vetëm për ato programe kompjuterike që japin kontribut teknik.

Hedhja poshtë e Propozim-Direktivës, pati si efekt që ligjet kombëtare mos mund të harmonizohen kur bëhet fjalë për patentueshmërinë e softverëve kompjuterëve. Si pasojë, legjislacionet kombëtare mund të vazhdojnë të miratojnë ligje që do të lejojnë dhënien e patentave për shpikje të zbatuara kompjuterike, gjë të cilën edhe vazhdojnë ta bëjnë. Mirëpo, shpikësit kanë gjetur zgjidhje dhe kanë bërë që edhe pse teksti i KEP qartë thekson se nuk janë të mundshme patentat për programe kompjuterike, të detyrojnë ZEP të japë siç raportohet më tepër se 30,000 patenta për të ashtuquajturat shpikje të zbatuara kompjuterike (Spinello and Bottis, 2009, 60). Shpikësit këtë e bëjnë duke mos pretenduar për shpikje si program kompjuterik dhe në vend të programit kompjuterik, kërkojnë patentë për shpikje e cila vihet në funksion duke përdorur program kompjuterik.

Përfundim

Është dëshmuar se patenta përbën formën më komplekse të mbrojtjes së pronësisë industriale sot. Për të fituar patentë, shpikësi hyn në një *quid pro quo* me qeverinë e një vendi. Shtetet kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin patentë për sektorë dhe fusha të shumëllojshme të shoqërisë. Mirëpo, përkundër kësaj harmonie të mbrojtjes me patentë, kur bëhet fjalë për dhënien e patentave për shpikjet në fushën e teknologjisë informative, siç janë mbrojtja e programeve kompjuterike me patentë, atëherë një pjesë dërrmuese e shteteve, ende janë skeptike, në radhë të parë pjesa e vendeve të Evropës. Diskutimi në këtë punim zbulon që gjetja e ekuilibrit ndërmjet objekteve të patentueshme dhe jo të patentueshme preokupojnë ZEP që nga themelimi i saj, dhe çështja se deri në çfarë mase mbrojtja patentore do të jetë në dispozicion për shpikjet softverike mbetet ende një çështje e diskutueshme. Edhe pse, në nenin 52 është përcaktuar se programet kompjuterike si të tilla nuk konsiderohen si shpikje brenda kuptimit të KEP; dhe se qëndrimi parimor i KEP është që nëse programi kompjuterik sjell efekt teknik përtej asaj që pritet nga ndërveprimi normal i softverit dhe hardverit, atëherë nuk duhet të ekzistojë arsye një program tillë të mbrohet me patentë; nga e drejta e rastit e ZEP, mund të rrjedhë se neni 52 dhe përjashtimi i saj si i tillë gjithnjë e më pak përbën pengesë për programet kompjuterike të mund të jenë të patentueshme. Sot, është me rëndësi të vendoset se si të interpretohen kriteret tjera të patentshmërisë, si: risia, hapi inventiv, zbatueshmëria industriale

dhe karakteri teknik. Në veçanti, karakteri teknik qëndron në qendër të shumë diskutimeve, që janë nxitur nga qëndrimet e ndryshme të ZEP duke vendosur në lidhje me këtë kusht. Refuzimi i Propozimit të Direktivës CII, si përpjekje për të zgjidhur problemet lidhur me patentshmërinë e programeve kompjuterike, la të hapur debatin e gjetjes së një mënyre si zgjidhje për të dalë nga pasiguria juridike ekzistuese në këtë fushë.

Referencat

- Поленак, М. et al. (2004), *Интеллектуална сопственост I (Индустриска сопственост)*, Shkup.
- Besarović, V. (2005), *Intelektualna svojina (industrijska svojina i autorsko pravo)*, Beograd.
- Schwabach, A. (2007), *Intellectual Property: a reference handbook*, Santa Barbara-California.
- Whory, T. (2008), *Intellectual Property: everything the digital age needs to know*, Chicago.
- Elias, S. and Stim, R. (2004), *Patent, copyright & trademark*, Berkeley – CA.
- Dutfield, G. and Suthersanen, U. (2008), *Global Intellectual Property Law*, Cheltenham.
- Spinello, R. and Bottis, M. (2009), *A defense of Intellectual Property Rights*, Cheltenham.

Conference of Ambassadors in London and boundaries of Albania

Ma.sc.Ardian Jashari (*Director of school*) & Ma.sc.Skender Ferati (*Prof. History-MS.*)

Abstract

For Albanians First Balkan War was a new risk of disintegration of the Albanian territories that affect the strategy and tactics of the war on the Albanian national liberation. Request prevailing Albanian National Movement was that of administrative-territorial autonomy Albania supposed to be the best way to face the risk of fragmentation of Albanian lands between neighbors and not full independence of the country and its separation from the Ottoman Empire, as occurred on 28 November 1912, where the entire Albanian National Movement came to a peak and held until the First Balkan War, the majority of the Albanian territories declared independence of Albania. Once the Albanians declared independence Ambassadors Conference convened in London to end the Balkan War, which ended with the defeat of the Ottoman Empire and reduce Albania's land before 1912, the Assembly of Vlora which proclaimed independence of all Albanian lands, and not modern Albania.

Key Words: Conference of Ambassadors in London, the Albanian issue, the borders of Albania.

Introduction

With the agreement of the six Great Powers of the time was called the Conference of Ambassadors in London, which was held with the following composition: five ambassadors of Great Powers and the Foreign Minister of Britain, which hosted the conference. Austro - Hungary was represented by its ambassador in London, Mensdorf, Germany with Lihnovski, Italy with Imperial, France with Kambon, Bekendorf from Russia, and Britain with its Foreign Minister Eduard Gray. (*Puto,2003,92*), (*T.Zavalani,1999,226-227*). The conference did not participate directly concerned countries; nor the Balkan allies, nor Albania. Sublime Porte was officially entitled to formulate their demands (especially territorial), in an other conference held simultaneously in London, at the Peace Conference between Turkey and the Balkan states. Only Albania voice was not heard, because the formula of independence still wasn't important and Vlora government could do much from the outside, without engaging at all Conference and participating Powers. (*History of albanian people III, 2002,20*).

Ambassadors Conference, convened precisely to give a solution to all problems arising from the Balkan War, she focused precisely on the Albanian question, and this was at the center of diplomatic war between two power blocks of the time. At the opening of the Conference ambassadors had decided that its proceedings were held in secret, avoiding publicity, however, does not appear to have made this conference in regular practice throughout the development of its proceedings. (*Puto, 1978,142*), (*Puto, 1978,16*).

As representatives of the entire Albanian people was the Provisional Government of Vlora and its two delegations, one sent in December 1912 under the chairmanship of Rasih Dinos and the other in April 1913, led by Ismail Qemali. As in the Memorandum sent its delegation presented the President of the Conference of London, Edward Gray, on January 2, 1913 and in meetings Ismail Qemali had with different personalities in London states, the Provisional Government defended legitimate demands of the Albanian people to have their national state of the union. In this document stated: "The Albanian people as an ethnic group more compact, more homogeneous and more important in the Balkan Peninsula, has the right to have its own state of the national united". Vlora government asked the Great Powers, who along with complete independence "to Albania should be recognized its foreign homogeneity, its natural limits ... as early resident of these territories" and return to the were left Albania all Albanian territories occupied by Serbia, Montenegro and Greece, such as Kosovo, Debar and other territories east of Albania and south of the country Chameria. (*Prifti, 2008,25 - 26*), (*Puto, 1978,17*). We must know that the Conference of Ambassadors in London are

the main decisions for the Albanian issue, although these decisions are further perfected formally being met with approval at the highest level of government.

Diplomatic History of the Albanian question in the period of imperialism is among the problems of Albania's history that has suffered more distortions and this precisely because it is not shown due attention not only to Albanian sources, but also for the documents of the cabinets. (*History of albanian people III, 2002,18 - 19*). States interested in the Albanian question were: Austro - Hungary, Italy and Russia. The first two, much like his best Albanian issue, while Russia had another thought, it is known that she supported the Slavic states - Orthodox toward Albanian lands and trying to extend its influence in the Balkans by increasing the Slavic states. For Vienna, Albania was a fence that would impede the extent of slavism in the Balkans and as a bridge to come in Thessaloniki, while Italy as a base for further penetration of the East. Government of Vienna gathered again great forces at the border with Serbia, threatening it with war. Concerned for the fate of the "European peace", stationary Great Powers held secret talks to bring together the views and acceptable solutions. It is during these talks in the background were defined, in general, the election of compromise through mutual concessions. Thus, Russia gave up its plan for sharing all Albanian lands through its Balkan allies and agreed with the idea of forming the state. She also admitted to not insist on Serbia's territorial exit to the Adriatic, but be delighted with its economic output. In turn, Vienna joined the request of St. Petersburg, actively supported by France, to create an autonomous Albanian state dependent on Turkey. Besides that, Vienna promised that in determining the borders of Albania to bear in mind the "right of territorial compensation" of the Balkan allies, like winning states in the war. The agreement reached between the two opponents (Austria and Russia.), main in Albanian issue during previous meetings, created support for a joint diplomatic action six Great Powers against Balkan allies. Now not only Austria and its allies Tripartite League, but also the Entente states, they began to press the Balkan states, which have altered their intentions to Albanian lands. Facing these circumstances, the Balkan states were forced to accept the autonomy of Albania. (*Puto, 1978, 152 - 158*).

London Ambassadors Conference began its work on December 17, 1912 under the chairmanship of Edward Grey, the British foreign minister. Since the first day, the Conference took into consideration the Albanian issue, which was discussed in its two main aspects: the political future of Albania and delimitation. On the first point Ambassadors decided to "create" an autonomous Albania "under the sovereignty of the Sultan", that he be put "under warranty and exclusive control of the Six Powers" and declared "neutral".(*Duka,2007,29*), This decision, though failing chauvinistic plans of neighboring states to complete dismemberment of Albania, was a step backwards in comparison with the decisions of the Assembly of Vlora. While the Assembly of Vlora had declared independence and secession of the country from Turkey, while London Conference decided to leave Albania still under Turkey, knowing just the right internal autonomy. However, after several months Conference announced its final decision on 29 July 1913 and recognized Albania as a sovereign, fully independent from the Ottoman Empire. (*Zhak,373*). Ambassadors decided formation of "A hereditary Sovereign Principality and under the Guarantee Neutral Powers", which were responsible also for the supervision of its neutrality. (*Smirnova, 2004, 65*).But it was decided that it was ruled by a prince chosen by them. Also, in London, was appointed an "International Control Commission for Albania", consisting of a representative from the six Great Powers and by an Albanian. The Commission's task will be to distribute the Provisional Government headed by Ismail Qemali, then should elaborate a "Organic Statute". This committee will oversee the organization of the Albanian government, finance and administration for a period of ten years. Dutch officers were charged with organizing the gendarmerie. But conference charged Vienna and Rome to design and present a more detailed project organizing autonomous Albanian state. In regard to the boundaries , in its first session,the Conference took only general decisions. It decided in principle that autonomous Albania limited northern Montenegro and south to Greece. It had its good, because Serbia is close to an exit route to the Adriatic. But the old demand of Serbia, which had an outlet on the Adriatic, was not completely blown down. Ambassadors of Serbia recognized the right to have a commercial outlet to the sea through an Albanian scaffold "free and impartial". The pier will be used by an international railway under European control and supervision of a special task force to freedom of transit for

all kinds of goods, including those of war. This was the first denial to Albanian state sovereignty. (*History of albanian people III, 2002,20 - 26*). In December 1913 agreed, that in Albania to put a prince; this was Wilhelm von Wied (1876-1845). He was not encouraged by the Kaiser, in order to become king of the Albanians. On March 7, 1914 he arrived in Durres, with a warship Austro - Hungarian, accompanied by Italian units, English and French. (*History of albanian people III, 2002, 20 - 26*) He would remain on the throne six months.(ASHAK. Microfilms found , sig. III/1-6)

The borders of Albania and neighbors

When Albania declared its independence, the Albanian lands were occupied by foreigners, the then capital of Albania, Vlorë, was surrounded by Serb troops in the north, Turkish and Greek in the south east, and west through blockade , then foreigners and foreign country's territorial boundaries determined Albania (London) without the presence of an official representative of Albania. On December 23, 1912, Memet Konica was sent to London, with two others as official representatives of the Provisional Government of Albania. On May 30 Ismail Qemali with two other officers went through the sea to appeal to London and other European capitals to Albanian territorial integrity and maritime blockade opening. This mission was not a great success. Member of the delegation was also Isa Boletini. The most difficult decision for the Conference of Ambassadors was delimitation of new Albanian state. (*Zhak,377*).

During its work, until 1913, with decisions dictated by the resumption of the Balkan War, the London conference dealt almost entirely with the issue of borders of Albania. Since the end of December 1912 to early January 1913 governments of the Allied states of Balkan presented their views to Conference on territorial changes that should be made in the peninsula after the war. Greece sought areas of southern Albania (the sainthood of Ioannina), inhabited by Albanians, whose compactness is not undermined by small groups of Greek speaking districts Delvinës groups of Drupollit. To annex these Albanian territories Serbian diplomacy and press shovenist developed an extensive campaign inside and outside Greece. Then Serbia, included in its list of requirements also Kosovo Albanian provinces and territories inhabited by Albanians in Macedonia. Also Montenegro insisted, as before, the annexation of Shkodra with the surroundings and wanted bordered with Albania's appointment Mat River, or at least Drini , to his shed in the Adriatic.

Vlorë government submitted a memorandum to London Conference. Where were taken up legal requirements for Albania's borders with Montenegro then and would include, along with the respective districts, Peja, Mitrovica, Pristina, Presevo, Kumanovo, Skopje, Tetovo, Gostivar, Debar, Bitola, Kastoria, Mecovën and Janina . In the south would hold existing borders (with Turkey) to Preveza. Vlorë government presented its maximum territorial claims to be able then to maintain adequate space for the inevitable compromises that will be needed during the conference traktativave. The memorandum concluded by rejecting the thesis of the Balkan allies that Albania was associated with Turkey and Albanian territories would serve as "territorial compensation" for the Allies won the war. (*History of albanian people III, 2002,20*).

As for the Albanian issue entirely, as well as for determining the boundaries of Albania, diplomatic struggle at the conference held between Austro - Hungary and Russia. Austria tried to hide his intentions in the Balkans coming to the defense of the rights of Albanians. Vienna quickly made it clear that it was not a sheer application point to point ethnic acceptance. Austrian representative in London, said in late December 1912 that "the lands inhabited entirely Albanian population should not secede Albania", while the regions where Albanians could constitute the majority of the population, could be object of a compromise between power and can be used to meet the aspirations of the Balkan states for expansion. Their ideas for the delimitation Austro - Hungary made clear on a project - map of Albania, which he submitted to the Conference at the request of the latter to have as a basis for discussion. Under this project, the north boundary line running along the Buna, following the direction of the old Montenegrin border with Turkey to close Rzhanicës. From here continue semicircular and, passing to the south of Gucia of Plav, take direction to the affinities of Peja, Gjakova and Prizren and included in Albania. From Prizren border came down to the south and reaching the mountains between Lake Ohri and Prespa, including the cities of Dibra and Ohri

within the Albanian lands. Further, just south of the southeast limit left Korqa and joannina side of Albania and finally watch the river Kalamas, to appear in the Ionian Sea, south of the island of Corfu, obviously, the project itself Austro - Hungarian leave ethnic principle to the detriment of Albanians, as well as to the detriment of southern neighbors. But, as had pronounced himself diplomats in Vienna, it was not without purpose. A second project - map was presented to the Conference by Russia, which provided an even greater curtailing Albanian land. Under this project, the boundary line heading north from the Adriatic Sea, near the river Drin, leaving abroad Shkodra and the whole area, northern Albania to the border with Montenegro, and took the lead in the east to the unification of White Drin with Black Drin River, follow the flow of the Black Drin leaving abroad of Albania all cities - lands populated of Kosovo Vilayet and Manastir, and reached up to lake Ohri. Further, the border came down to the south, nearly straight, turn right then west to exit in the Ionian Sea to Cape Qefali, leaving abroad Gjirokastra, Saranda and Korca, Delvina the Chameria. London Conference rejected the ethnic principle as the basis for selecting the borders of Albania, even in partial form that took him to the Austrian proposal.

By the end of March meetings of the ambassadors were more northern and north-eastern borders. Representatives of Austria and Russia strove for any city or a province to the north. Shkodra was the fulcrum of the entire issue in the north. The application of Vienna, that Shkodra remain within Albania encountering Russian opposition, supported by France, England, at this point also from Italy. In these circumstances, Austria - Hungary announced other powers would quit at the London conference, if no agreement is reached to relinquish Shkodra in Albania. This had resulted see Italy to change the attitude on the issue of Shkodra and the rows on the side of Austria. But the talks showed that it was necessary to make concessions on both sides. Russia announced that it can be reconciled with the idea that Shkodra be left Albania, but require them to leave to Montenegro all Shkodra Lake and Mountain Tarabosh, to Serbia Gjakova, Dibra and Luma. Since this was opposed by the League tripartite Conference of Ambassadors remained in a deadlock. For more than a month talks took place outside the Conference. To resolve the issue, the two sides issued spun. Russia renounced the requirements for Shkodra lake, Tarabosh and Luma, and Austria - Hungary, concerned about the fate of Shkodra, decided to sacrifice the Gjakova. (*History of albanian people III, 2002, 22 - 23*). In March 1913 London Conference announced belligerents that Shkodra belonged Albania. Serb forces respected notice and withdrew grudging from Shkodra. While Montenegrins continued the siege set. Esat Pasha Toptani, secretly agreed with the Montenegrins passing the castle, but withdrew its troops in Tirana. Strict objection of the Great Powers, especially Russia, who were allies, Montenegro forced to withdraw troops from Shkodra on May 13, 1913. In May the great powers urged Serbia and Montenegro to remove its troops from northern and central Albania, so they reluctantly withdrew from the limits set by the Conference of London. (*Zhak, 378 - 380*).

On March 22 conference was convened to sanction the final agreement with the northern borders. In defiance of the principle of nationality and the willingness of local populations, from Albanian trunk was separated Kosovo and Albanian lands of the East (called Western Macedonia). (*History of albanian people III, 2002, 24*).

In this context, there may be penalties such as: *"the closure of one or more activities or structures of the legal person; establishment of a legal person in controlled management; prohibition to participate in the procurement procedures of public funds; removal of access or use of licenses, authorizations, concessions or subsidies; prohibition to seek public funds and financial resources; removal of the right to exercise one or more activities or operations; obligation to publish the court decision"* (Law No. 9754, 2007, 2319).

Another feature of the Albanian law on criminal liability of legal persons is the fact that the punishments provided above, do not apply to units of local government, public legal persons, political parties and trade unions. The law stipulates that in any case, punishments are executed together with the main sentence, what means that the punishments cannot be implemented separately. So, in the case of conviction of a legal person, secondary punishment is accompanied by a principal punishment (Likmeta & Treska, 2014, 299).

The fine in terms of Albanian law means paying money to the state (Law No. 9754, 2007, 2319). Thus, the Albanian law states: *“For crimes that according to the Criminal Code, a sentence is provided of at least, not less than fifteen years of imprisonment or life imprisonment, a legal person shall be punished by a fine of twenty-five million lek to fifty million lek”*; *“For crimes that according to the Criminal Code are provided a minimum penalty, not less than seven years to fifteen years imprisonment, a legal person shall be punished by a fine of five million to twenty-five million lek”*, and: *“For crimes that according to the Criminal Code are provided a maximum penalty, less than seven years, the legal person shall be punished by a fine of five hundred thousand up to five million lek”* (Law No. 9754, 2007, 2319). While in the case of liability of legal persons for commission of a criminal offense, the legal person is punishable by a fine from three hundred thousand up to a million lek (Law No. 9754, 2007, 2319). The three key moments the Albanian law (Law No. 9754, 2007, 2319) estimates in order to sanction the closure of the legal person are:

- a) when a person is established in order to commit the offense;
- b) when a person has used most of its operations to serve the offense;
- c) when serious consequences have resulted from the commission of the offense.

As above we say that the punishment of a legal person is important and plays an important role as nurtures the development of monitoring clean and virtuous systems oriented towards the development of a legal culture within companies (Bozheku & Elezi, 2012, 163).

Rules concerning the punishment of legal persons and their rehabilitation

Albanian law also provides the mitigating circumstances for legal persons. In this context, we say that a legal person benefits from mitigating circumstances such as: *“when fully repays the damage and eliminates the harmful of dangerous consequences of the criminal act; when organizational deficiencies that caused the offense are eliminated, through the implementation of organizational models, suitable for the prevention of crime; and also when the legal person has provided income for the purpose of confiscation”* (Law No. 9754, 2007, 2319).

The legal person is called unpunished if it has not committed another criminal offense during the five years from the date of full repayment of the fine, in the case of a fine, and three years from the date of their execution, in the case of other penalties (Law No. 9754, 2007, 2319).

The law on criminal liability of legal entities doesn't define the meaning of the rehabilitation institute. While the doctrine tells us that rehabilitation means the denial of the facts of the criminal offense resulting in the restoration of all the previous rights and freedoms of the legal person convicted (Fana, 2008, 57). This institute of law aims to correct the of legal persons, in order to provide opportunities to equalize with other subjects of this law (Fana, 2008, 58).

Conclusions

Criminal liability of legal persons became one of the most debated topics, especially after 1990, when the United States and Europe faced a number of offenses against the environment, fraud, corruption and financial crimes that involved legal persons such as corporations. The reaction against this criminal phenomenon was the creation of laws that may hinder and punish crimes in corporates and the wrongdoing of legal persons (Shkira, 2013).

In the fight against terrorism, economic crime and corruption, special attention should be given to offenses committed by legal persons, by strengthening and at the same time combating this category of offenses.

We believe that the law no. 9754, dated 14.06.2007 “On the criminal liability of legal persons” due to interferences in criminal law, should be approved in application of Article 81, second paragraph, of the Constitution, and as such is not approved by the required majority (Constitutional Court of Albania, 2013, No, 38).

The Albanian lawmaker in the exercise of their legislative activity should be careful and rigorous

regarding the obeisance of legal norms in force and in any case, the principles of the rule of law. This due to the fact that there is already a consolidated practice about the obeisance of the formal and material criteria that are established by the Constitution, which must be respected during the legislative procedure (Constitutional Court of Albania, 2013, No, 38).

References

- Bozheku, E., Elezi, I., *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Botimet TOENA, Tiranë, 2012.
- Fana, N., “Përgjegjësia penale e personave juridikë”, Universiteti Tiranës, Fakulteti Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Penale, *Mikrotezë masteri*, Tiranë, 2008.
- Fuga, J., *E drejta civile, pjesa e përgjithshme*, shtëpia botuese Ilar, Tiranë, 2000.
- Galgano, F., *E drejta private*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, 1999.
- Kondili, V., *E drejta civile I*, shtëpia botuese “Geer”, 2008.
- Likmeta, E., Treska, T., “Një vështrim krahasues mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë”, University “Academy of Bussines” Albania, *Proceedings of 2th Annual International Scientific Conference*, “Global Economic and legal Impact, Tirana, April 29, 2014, Publishing House: “Erik” Publisher.
- Mandro, A., *E drejta romake*, Tiranë, 1998.
- Shegani, A., Kambellari, E., *E drejta penale avancuar 2*, Cikël leksionesh.
- Shkira, Elidiana, Criminal Liability of Corporations: A Comparative Approach to Corporate Criminal Liability in Common Law and Civil Law Countries (July 8, 2013).
- Ligj, Nr.7850, Dt.Aktit:29.07.1994, Dt.Miratimit:29.07.1994, Flet.Zyrtare Nr.11, Faqe:491.
- Ligj, Nr.9754, Dt.Aktit:14.06.2007, Dt.Miratimit:14.06.2007, Flet.Zyrtare Nr.77, Faqe:2319.
- Vendim Nr.1110 ,datë 07.11.2012, Gjykata e ApelitTiranë.
- Gjykata e Lartë, Vendim Nr.337 ,datë 12.12.2012.
- Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 38, datë 25.07.2013.

Faqe web

- <http://ssrn.com/abstract=2290878>,
- <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2290878>,
- www.gjykataeapelitirane.al/.../1354311013-ALBONO,
- <http://www.gjykataelarte.gov.al/>,
- <http://www.gjk.gov.al/>.

Roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Pavarësinë e Gjyqësorit

Mgj. Fildeze Kasemi
Shkolla e Magjistraturës

Abstrakt

Sistemi i drejtësisë ka një rol të veçantë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore që shtetasve u janë garantuar nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacioni në fuqi. Pa dashur të paragjykojmë gjithë veprimtarinë e këtij pushteti, është tashmë një fakt i njohur se ai prej kohësh përballet me probleme dhe sfida të rëndësishme, kapërcimi i të cilave përbën disa nga prioritetet për vendit tonë, në kuadër të procesit integruar në Bashkimin Evropian (BE).

Garancitë që ofron ky organ në pavarësinë e pushtetit gjyqësor, kanë qenë për një kohë të gjatë, në qendër të debatit kushtetues dhe në ditët e sotme debati më i nxehtë publik vërtitet pikërisht rreth këtij argumenti. U bënë mbi njëzet vjet që flitet e përlitet për një reformë në drejtësi që duhet të fillojë nga maja e gjyqësorit. Reformat e ndërmarra nuk kanë dhënë ende rezultatet e pritshme në këtë sektor kyç të shtetit. Çdo forcë politike që vjen në qeverisje ankohet për drejtësinë e munguar që la qeverisja e mëparshme.

Pyetjet që shtrohen herë pas here janë : A është realisht e pavarur KLD ? A është në gjendje KLD-ja me këtë formulë përbërjeje e me atributet që ka, të qeverisë gjyqësorin duke garantuar paanshmërinë dhe sistemin e karrierës bazuar në meritokraci ? A ka realisht mundësi përmirësimi situata në sistemin e drejtësisë me mënyrën se si funksionon organi që e qeveris atë?

Në këtë punim do përpiqem t'i jap përgjigje të shkurtra këtyre pyetjeve duke bërë një analizë të shkurtër juridike të rolit të KLD në qeverisjen e sistemit gjyqësor dhe mundësisë për një reformë të mundshme të këtij institucioni kushtetues.

Fjalë kyçe – sistem drejtesie, keshilla gjyqësore, reformë, pushtet i pavarur, qeverisje e gjyqësorit

Hyrje

Neni 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht se: *“E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë”*. Një nga parimet më themelore të shtetit të së drejtës është *“Ndarja dhe balancimi i pushteteve”*. Ky parim nënkupton pushtete të ndara dhe të pavarura, kjo shmang përqëndrimin e pushtetit në duart e një individi ose grupi individësh të vetëm (Zaganjori & Anastasi & Methasani, 2011, 176). Por nga ana tjetër këto pushtete interferojnë me njëri-tjetrin dhe kjo njihet me termin balancim (*check and ballance*). *“Parimi i shtetit të së drejtës në lidhje me atë të ndarjes së pushteteve nënkupton garantimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut, nëpërmjet një gjyqësori të pavarur e të paanshëm. Në këtë kontekst, ky gjyqësor, duhet kuptuar e pranuar si një gjyqësor që vetëqeveriset, vetëkontrollohet e vetëkorrigjohet”*. (Vendim i Gj.K. të RSh 11/2004.)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka krijuar institucionin e KLD-në si një mekanizëm kushtetues për të garantuar një pozicion autonom dhe të pavarur të pushtetit gjyqësor nga pushtet e tjera. Misioni i parë dhe kryesor i KLD-së është *“garantimi i pavarësisë së gjyqësorit”*. KLD është *i është i vetmi institucion kushtetues që ka kompetenca ekskluzive në lidhje me karrierën e gjyqtarëve, prandaj mënyra sesi formohet KLD-ja është thelbësore për të garantuar pavarësinë e këtij pushteti shtetëror*. (Omari, 2011, 82)

Por përpara se të sigurojë pavarësinë e gjyqësorit, institucioni i KLD-së duhet të jetë vetë i pavarur. Faktori kryesor që ndikon në garantimin e pavarësisë së gjyqësorit nga pushtetet e tjera e veçanërisht nga pushteti ekzekutiv është Vetëqeverisja e KLD-së.

Gjithmonë janë shtruar për diskutim çështje të përbërjes së KLD-së dhe statusit të anëtarëve të saj (Zaganjori & Anastasi & Methasani, 2011, 183). Gjithë ky debat lind për faktin se vetë sistemi i drejtësisë ka shqur probleme të mëdha. Në Komunikatën që Komisioni Evropian i paraqiti Këshillit dhe Parlamentit Evropian më 9 nëntor 2010 lidhur me kërkesën e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, theksohet ndër të tjera se *“Në tërësi, Shqipëria ka bërë disa përmirësime në*

reformën gjyqësore falë miratimit të disa politikave për përmbushjen e prioriteteve kyçe. Vazhdon të ketë hendek të thellë mes kuadrit ligjor dhe zbatimit të legjislacionit. Nevojitet reformim i mëtejshëm kushtetues.” (Progres - Raporti Për Shqipërinë, 2013, 56-57). Një konstatim i tillë do të thotë që formula e zgjedhur prej nesh për qeverisjen e gjyqësorit nuk po funksionon siç duhet.

I. Vendi i KLD-së në Ngrehinën Institucionale

Mënyra e kompozimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Shqipëri (neni 147 Kushtetutës së R.SH) i përfaqëson modelin të Europës Jugore dhe ka shumë ngjashmëri me Këshillat Gjyqësorë të Portugalisë (Conselho Superior da Magistratura), të Spanjës (El Consejo General del Poder Judicial), të Italisë (Consiglio Superiore della Magistratura) dhe të Francës (Conseil Supérieur de la Magistrature). Sipas këtij modeli Këshilli Gjyqësor ka vetëm kompetenca *këshillimore* sepse në këshill marrin pjesë përfaqësues të ekzekutivit dhe legjislativit. Për emërimin e anëtarëve të gjyqësorit dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarëve vendos presidenti me propozim të këshillit gjyqësor. (Voermans & Albers, 2003, 9)

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është një organ kushtetues, i pavarur, *sui generis*, nuk bën pjesë në asnjë nga pushtetet, është i ngjashëm me pushtetin gjyqësor sepse shërben si organ qeverisës për sistemin gjyqësor por nuk jep drejtësi si gjykata. (Vendimi i Gj.K 14/2006). Fakti që KLD qeveris një prej tre pushteteve kryesore që përbëjnë pushtetin shtetëror tregon rëndësinë e mirë funksionimit të këtij organi (Omari & Anastasi, 2010, 398). Nëse çalon organizimi dhe funksionimi i KLD patjetër pasojat do të bien mbi sistemin gjyqësor. Nëse ky organ kushtetues funksionon siç duhet dhe brenda kompetencave të parashikuara në Kushtetutë do të na ofrojë një gjyqësor eficient, të bazuar në meritokraci dhe në parimin e ofrimit dhe shërbimit sa më të mirë për publikun, gjë e cila do të çonte në forcimin e shtetit të së drejtës.

Kjo është arsyeja se pse Kushtetuta jonë e pozicionon KLD-në jashtë sistemit gjyqësor por me funksione aktive dhe të rëndësishme në lidhje me pushtetin gjyqësor, si një garanci për pavarësinë e këtij pushteti. Këshilli i Lartë i Drejtësisë parashikohet dhe rregullohet shprehimisht në Kushtetutë në mënyrë që KLD-ja të ketë stabilitetin e nevojshëm sepse ndërhyrjet në kushtetutë kërkojnë një shumicë të cilësuar dhe konsensus të gjerë të forcave politike. (Panda, 2010 ,6)

II. Raporti i KLD-së me Pushtetet e tjera

“Gjyqësori në Shqipëri është një organizëm që përbëhet nga disa elemente (apo pjesë), të cilët nuk kanë lidhje organike me njëri-tjetrin. Dhe për më tepër, po të mungojë vullneti i personave drejtues, ndërveprimi i këtyre elementeve bëhet gati inekzistent dhe rezultati i pritsëm shkon drejt zeros” (Panda, 2010, 5). Në përbërjen e KLD kemi përfaqësues të tre pushteteve por dhe Presidentin e Republikës si një organ kushtetues i pavarur, i cili është njëkohësisht kryetari i KLD-së. Gjithashtu në KLD merr pjesë ex-officio Ministri i Drejtësisë si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv dhe tre anëtarë që zgjidhen nga votat e parlamentit dhe përfaqësojnë pushtetin legjislativ. Kjo formulë e kompozimit të KLD mishëron më së miri parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve duke i vendosur në raporte bashkëpunimi dhe kontrolli reciprok përfaqësuesit e tre pushteteve (Omari, 2011, 93-94).

a) Raporti i KLD-së me Presidentin

Presidenti i Republikës është ex-officio njëkohësisht anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (neni 147/2 Kushtetuta e R.SH). Në zbatim të këtij funksioni, Presidenti zë vetëm një pozicion *primus inter pares*, duke pasur disa detyra të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj. Sidoqoftë, presidenti ka të drejtë vote të barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë të KLD-së. Sipas CCJE –së “Anëtarët e Këshillit Gjyqësor, qofshin gjyqtarë ose jo, nuk duhet të jenë politikanë aktivë, anëtarë të Parlamentit, të pushtetit ekzekutiv, apo të administratës. Kjo do të thotë se as Kryetari i Shtetit, nëse ai/ajo është edhe kryetari i qeverisë dhe as ministrat nuk mund të jenë anëtarë të këshillave gjyqësorë. Secili shtet duhet të miratojë rregulla ligjore të veçanta në këtë drejtim” (Opinion no.10 of the CCJE 2007, 4). Në parim pjesmarrja e presidentit tonë në përbërjen e KLD vjen në kundërshtim me Rekomandimin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europian. Por, të paktën formalisht, për shkak të formës së

qeverisjes së vendit tonë dhe pozicionit të Presidentit në piramidën shtetërore, pjesmarrja e tij në KLD nuk e çënon pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kjo për faktin se Presidenti sipas Kushtetutës tonë nuk është kryetari i qeverisë, ai nuk bën pjesë në asnjë parti politike dhe ka kompetenca honorifike. (neni 86)

Gjithsesi, sipas Këshillit të Europës, për të siguruar një gjyqësor të pavarur, nga pjesëmarrja në këshillat gjyqësorë duhet të përjashtohen gjithashtu edhe përfaqësues të tjerë të organeve të zbatimit të ligjit. As presidenti i shtetit dhe as ministri i drejtësisë nuk duhet të kryesojnë këshillin. Puna e këshillit gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përfaqësues të ekzekutivit apo legjislativit (Rekomandimet e Kievit, 2010, 4).

Tashmë me ndryshimet kushtetuese ky pozicion i presidentit të Republikës nuk duket aq asnjë dhe aq apolitik. Fakti është që sipas nenit 87/ 3 (të ndryshuar) , “... Në votimin e katërt dhe të pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit” (ligj Nr.9904, datë 21.4.2008). Ky ndryshim lejon që Presidenti të jetë një figurë politike dhe e njëanshme dhe të jetë në të njëjtin kah apo në kah të kundërt politik me anëtarët e tjerë të KLD që kanë ngarkesa politike siç janë anëtarët e zgjedhur nga Parlamenti apo Ministri i Drejtësisë. Një gjë e tillë brenda KLD mund të çojë në situata vendimmarrjesh partiake në rastin e parë apo konfliktuale dhe bllokuese në rastin e dytë. Gjithsesi, emërimi në detyrë i gjyqtarëve mbetet një kompetencë thelbësisht e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe formalisht e Presidentit të Republikës. Nëse Këshilli i Lartë i Drejtësisë këmbëngul në përmbajtjen e aktit të miratuar prej tij, presidenti i Republikës nuk mund të refuzojë t’u nënshkruajë atë.

b) **Raporti i KLD-së me Parlamentin**

Në përbërje të KLD-së janë tre juristë që zgjidhen nga Parlamenti. Gjykata Kushtetuese në interpretimet e saj ka arritur në përfundimin se tre juristët që zgjidhen nga Kuvendi nuk duhet të jenë gjyqtarë. Neni 147/1 parashikon shprehimisht se nëntë anëtarë duhet të jenë gjyqtarë ndërsa për tre anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, Kushtetuta nuk vë kufizime. Kjo ka sjellë që në përbërjen e KLD-së të kishte më shumë se nëntë gjyqtarë dhe humbi përfaqësimi i pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe i personaliteteve të tjerë të shquar në fushën e së drejtës (Vendimi i Gj. K. 14/2006). Nëse përbërja e KLD-së është mikse, shumica duhet të jenë gjyqtarë dhe pjesa tjetër duhet të mos jenë gjyqtarë, përbërja e tij duhet të pasqyrojë diversitetin shoqëror. (Opinion no.10 of the CCJE 2007, 4).

Është e vërtetë që përbërja e KLD duhet të pasqyrojë diversitetin e pushteteve dhe frymën e bashkëpunimit dhe të konsensusit, por Kushtetuta dhe ligji nuk kanë vendosur kufizime në lidhje me tre anëtarët e KLD-së që zgjidhen nga Kuvendi, duke mos iu përjashtuar rekomandimeve të CCJE sipas të cilit “anëtarët e KLD-së jo gjyqtarë, nuk duhet të jenë anëtarë të Kuvendit. Ata nuk duhet të jenë persona përfaqësues të pushtetit politik sepse ndryshe do të çënohej qëllimi i nenit 147 të Kushtetutës, për të përçuar në KLD zërin e shoqërisë civile”.

I vetmi parashikim, i cili me interpretim dhe në mënyrë të tërthortë kënaq pritmeritë e CCJE duket se është ligji që rregullon veprimatrinë e KLD-së, përfshirë dhe ndryshimet e bëra me së fundmi, i cili parashikon shprehimisht papajtueshmërinë e detyrës së anëtarit të KLD-së me anëtarësinë, veprimtarinë ose ushtrimin e funksioneve në partitë politike; dhe me funksionin politik në administratën shtetërore (ligjin nr. 101/2014 ku neni 5 parg. c dhe ç). Por ky parashikim është ligjor dhe është i pamjaftueshëm, ligjet ndryshohen lehtësisht nga parlamenti. Do të ishte e domsdoshme që një parashikim i tillë të ngrihej në nivel kushtetues.

Nga zhvillimet e ditëve të fundit duket se roli i këtyre anëtarëve përfaqësues të pushtetit legjislativ brenda KLD-së, është përforcuar. Sipas nenit 12 Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar duke i dhënë një rol të paracaktuar dhe një mundësi kontrolli mbi anëtarët e tjerë të KLD që vijnë nga gjyqësori apo ex-officio.

Meqenëse Zëvendëskryetari i KLD –së, ka funksione kyçe brenda këtij organi të qeverisjes së drejtësisë (neni 12 dhe 13 i ligjit për KLD), krijohet një mundësi hipotetike që politika duke zgjedhur me shumicë të thjeshtë, persona që mund të kenë ngarkesa politike, mund të vërë në

mënyrë indirekte, nën kontroll pushtetin gjyqësor. Kjo vjen dhe për shkak të një një mangësie tjetër që del gjatë analizës së dispozitave sepse Kushtetuta dhe ligji nuk përcaktojnë shumicën e nevojshme për zgjedhjen e anëtarit të KLD-së nga Parlamenti. Kjo i lë hapësirë shumicës parlamentare që të zgjedhë anëtarë të KLD persona me ngarkesa të forta politike. Do të ishte një garanci shumë e mirë e pavarësisë së gjyqësorit përcaktimi shprehimisht në ligj i një shumicë e cilësuar për zgjedhjen e anëtarit të KLD-së. Konsensusi politik për zgjedhjen e tij, do të bënte që përfaqësuesi i parlamentit të përçonte në KLD frymën e bashkëpunimit dhe të pavarësisë.

c) Raporti i KLD-së me Qeverinë

Pjesmarrja e Ministrisë të Drejtësisë në KLD dhe pushteti i tij i vecantë kanë ngjallur debate lidhur me mundësinë e pushtetit ekzekutiv për të ndikuar tek pushteti gjyqësor. Ministri i Drejtësisë është anëtar ex-officio në KLD. Ai përveç të drejtës së votës gëzon dhe një pushtet tjetër, atë të propozimit për marrjen e masave disiplinore dhe inicimin e procesit administrativ kundrejt gjyqtarëve. (Neni 34/1 i Ligjit Nr.9877/2008) “Ndryshe nga vullneti i Kushtetutës, janë parashikimet ligjore ato që i njohin Ministrisë të Drejtësisë, funksione të cilat sipas standardeve evropiane e atyre kushtetuese u takojnë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. ...pushteti i inspektimit të dyfishtë dhe ekskluziviteti i procedimit disiplinor në duart e Ministrisë të Drejtësisë, eventualisht, mund të shërbejnë si mjete intimiduese për gjyqtarët” (Hoxha, 2011, 151)

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar fort pavarësinë e gjykatës në mënyrën e marrjes së vendimit bazuar në prova e në ligj, por ka justifikuar këto kompetenca të ministrit në emër të parimit “*chec and ballance*”. Kjo Gjykatë mbron fort parimin e pavarësisë së gjyqësorit kur thekson se “vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, ...asnjë organ tjetër, qoftë edhe KLD apo Ministri i Drejtësisë, nuk kanë të drejtë të kontrollojnë e vlerësojnë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mos përfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes”. Por nga ana tjetër ajo shprehet se “Parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush...dy inspektoratet kanë të drejtë të kontrollojnë jo dhënien e drejtësisë, por administrimin e saj nga gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit.” (Vendim i Gj.K. të RSh 11/2004.)

Pavarësisht justifikimit që i bën Gjykatës Kushtetuese pushtetit të Ministrisë të Drejtësisë në KLD, në një shoqëri ku sundon ligji nuk është e pranueshme, që ekzekutivi të përfshihet dhe të ketë rol kaq determinant në çështje që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe me karrierën e gjyqtarëve. Kjo bie ndesh me vetë qëllimin e krijimit të KLD-së që është krijimi i një mekanizmi të pavarur i cili shërben për të shmangur ndërhyrjen e pushteteve të tjera dhe veçanërisht të ekzekutivit, në pushtetin gjyqësor (Panda. 2012, 60). Pjesmarrja e Ministrisë të Drejtësisë në KLD mund të përlligjet me nevojën e mbajtjes së lidhjeve midis KLD-së dhe ekzekutivit por duke parë zhvillimet e kohëve të fundit zgjidhja më e mirë në këto kushte do të ishte që Ministri i Drejtësisë mos të kishte të drejtën e votës në KLD dhe aq më pak të drejtën për të inspektuar dhe propozuar masa disiplinore ndaj gjyqtarëve. Kjo do të vinte në përputhje dhe me rekomandimin e Komisionit të Venecias se “Kontrolli i veprimtarisë së gjyqtarëve është kompetencë vetëm e KLD-së, ndërsa kontrolli i Ministrisë së Drejtësisë mund të përqëndrohet vetëm në veprimtarinë administrative të gjykatave”. Vlerësimi dhe promovimi i pavarur i gjyqtarëve është kusht thelbësor për pavarësinë e gjyqësorit (Opinion no.10 of the CCJE 2007, 9)

a) Raporti i KLD-së me Gjyqësorin

Qëllimi i nenit 147 të Kushtetutës është të krijojë një organ të pavarur nga pushtetet e tjera për të vendosur për karrierën e gjyqtarëve. Kriteret për vlerësimin profesional të gjyqtarëve janë përcaktuar me vendim të KLD-së. Për të pasur gjyqtarë profesionistë dhe të pavarur duhet që vlerësimi të bëhet në bazë të kriterëve të mirëpërcaktuara dhe të jetë sa më objektiv. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë përsa i përket statusit të gjyqtarit dhe menaxhimit sa më të suksesshëm të drejtësisë, parashikon se “çdo vendim që ndikon në përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose pushimin e funksioneve të një gjyqtari/eje, statuti parashikon ndërhyrjen e një

autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që marrin pjesë të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, duke ndjekur metoda që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit” (Opinion no.10 of the CCJE 2007, 3). Në përputhje me sa rekomandon CCJE, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka në përbërjen e vet 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Kështu KLD-ja është e përbërë në pjesën dërrmuese të saj nga gjyqtarë, të cilët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si të tillë, ushtrojnë lidhjen e këtij organi me korpusin gjyqësor (Zaganjori & Anastasi & Methasani, 2011, 184). Nuk ka asnjë papajtueshmëri apo konflikt interesi me atë të gjyqtarit në detyrë. “...Kushtetuta ka bërë përjashtim për sa i përket veprimtarisë jo permanente të tyre në KLD, në të cilin ata përfaqësojnë trupën e gjyqtarëve që i ka zgjedhur në këtë organ kushtetues (Vendimi i Gj.K nr.75/2002, nr.14/2006) Duke pasur parasysh se KLD është promotori dhe qeveria e vetë gjyqësorit themi se askush më mirë se sa vetë gjyqtarët nuk e njeh aq në detaje se si funksionon sistemi gjyqësor, ku çalon ai, dhe se si duhet përmirësuar. Por përbërja prej 10 gjyqtarësh, nga 15 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë që të shfaqet mendimi se gjyqtarët janë të prirur për të mbrojtur njëri-tjetrin nga procedimet disiplinore. Mendimi i mësipërm është rezultat i komentimit të disa vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku janë rrëzuar kërkesat e Ministrit të Drejtësisë për marrje masash disiplinore ndaj gjyqtarëve të ndryshëm (Panda 2012, 59). Ky mendim përforcohet dhe nga fakti se vendimet në KLD merren me shumicë të thjeshtë, se mbledhjet e KLD mbahen me dyer të mbyllura dhe se vendimet që dalin nga këto mbledhje nuk janë të arsyetura, siç sugjerohet nga ndërkombëtarët (Opinion no.10 of the CCJE 2007, 6).

III. Konkluzione

Reforma në drejtësi është një çështje parësore, jo vetëm për drejtësinë në vetvete, por dhe për vetë zhvillimin e vendit në të gjitha fushat e tjera. Autoritet duhet të sigurojnë që përzgjedhja dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve të kryhet gjithmonë në bazë të meritës.

KLD duhet të jetë përgjegjëse jo vetëm për karrierën e gjyqtarëve por edhe për administrimin e drejtësisë. Duhet të jetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë organi kompetent për iniciimin e procedimeve disiplinore për gjyqtarët dhe Ministri i Drejtësisë të mos jetë më i përfshirë në këto procedime. Duhet forcuar më tej pavarësia e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet ndryshimeve legjislative, të cilat do të mundësonin votimin me shumicë të cilësuar nga parlamenti për zgjedhjen e anëtarëve të KLD.

Do të ishte më efektive që nënkryetari i KLD-së të zgjidhej nga radhët e anëtarëve gjyqtarë, për arsye se ai e njeh akoma më mirë funksionimin dhe pikat e forta e të dobëta të sistemit të drejtësisë, gjithmonë duke prezumuar që ai do të jetë gjyqtar karriere.

Që të rritet besimi tek pavarësia dhe paanësia, vendimet e KLD duhet të jenë të arsyetuara dhe vendimmarrja duhet të jetë sa më transparente dhe e mbështetur në kritere objektive dhe lehtësisht të matshme.

Bibliografi

- ☞ Opinion no.10(2007) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) to the attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Council for the Judiciary at the service of society, Strasbourg
- ☞ Nils Muižnieks (2014) Raport nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, Strasbourg
- ☞ Komisioni Europian, (2012) Progres- Raporti për Shqipërinë, Bruksel
- ☞ Komisioni Europian, (2013) Progres- Raporti për Shqipërinë, Bruksel
- ☞ Organization for Security and Co-operation in Europe (2009) Pavarësia e Gjyqësisë – Analizë juridike, Shkup
- ☞ OSBE- ODIHR & Max Planck Minerva (2010) Rekomandimet për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin jugor dhe Azinë Qëndrore, Kiev
- ☞ Voermans È & Albers P (2003) Këshillat Gjyqësorë në Vendet e BE-së Laiden/Hagë
- ☞ Omari L. & Anastasi A.(2010) E Drejta Kushtetuese, Tiranë
- ☞ Zaganjori Z. & Anastasi A. & Methasani E. (2011) Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e

Republikës së Shqipërisë, Tiranë

- ☞ Omari L. (2011) Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese, Tiranë
- ☞ Hoxha A. (2011) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe garantimi i Pavarësisë së pushtetit gjyqësor, kumtesë, botuar në proceedings book, Studime Juridike, Tiranë
- ☞ Panda I. (2010), Organizimi Gjyqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kumtesë e botuar në “Gjeopolitika”, Prishtinë
- ☞ Panda I. (2012) Reforma Gjyqësore si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritit të Shqipërisë në BE - Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Tiranë
- ☞ Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- ☞ Ligji Nr.9904, datë 21.4.2008 Për Disa Ndryshime Në Ligjin Nr. 8417, dt 21.10.1998
- ☞ Ligji Nr. 8811 datë 17.5.2001 Për Organizimin dhe Funkcionimin e K L D
- ☞ Ligji Nr. 9877, datë 18.2.2008 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Gjyqësor
- ☞ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr 75 dt .19.04.2002
- ☞ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr 11 dt. 27.05.2004
- ☞ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr 14 dt. 22.05.2006.

Analizë krahasuese e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri, me vende të Europës Juglindore

Doktorante Elona Saliaj

Notere

Prof. Asoc. Dr. Enkelejda Olldashi

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë; Universiteti New York Tirana

Abstrakt

Ky referim synon të trajtojë nëpërmjet krahasimit, sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (*tokë*) në Shqipëri në raport me vendet e Europës Juglindore, me qëllim evidentimin dhe pasqyrimin e avantazheve dhe disavantazheve të sistemit tonë.

Në përmbajtje të temës paraqitet një analizë krahasuese e mënyrës së funksionimit të zyrave publike të ngarkuara për regjistrimin, menaxhimin dhe përpunimin e pasurive të paluajtshme. Në thelbin e analizës krahasuese është mënyra e krijimit dhe organizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në këto vende, problematikën e mbartura nga aplikimi i sistemeve të vjetra, si dhe përqsja e vendeve post komuniste me sistemin e ri të regjistrimit të pasurive. Vendet të cilat janë marrë në analizë të trajtimit krahasues, janë vende fqinjë të Europës Juglindore të cilat ngjasojnë me vendin tonë për nga historia e trajtimit të pasurive të paluajtshme, për nga mënyra e zgjedhjes dhe aplikimit të sistemit të ri të regjistrimit të pasurive dhe trajtimi i problemeve praktike në regjistrim. Kalimi nga një sistem i unifikuar dhe i centralizuar i pasurive të paluajtshme, në një sistem regjistrimi të lirë të tregut privat, solli edhe vështirësi në menaxhimin e saktë të regjistrimit dhe disponimit të pasurisë së paluajtshme; trajtimi i të cilave nuk ishte i njëjtë nga të gjitha vendet.

Si rrjedhim, mënyra e regjistrimit dhe aplikimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, trajtimi i problemeve për zgjidhjen e të drejtës së pronësisë në lidhje me pozitën juridike të pronarëve të mëparshëm, problemet praktike në lidhje me ndërtimet informale dhe reformat e vazhdueshme me qëllim përmirësimin e legjislacionit; na ndihmojnë të nxjerrim edhe konkluzione përkatëse për mënyrën e menaxhimit sa më të mirë të pasurisë së paluajtshme. Qëllimi i këtij referimi me natyrë krahasuese është rritja e efikasitetit në administrimin e pasurisë së paluajtshme dhe garantimi i sigurisë juridike në disponimin e tyre.

Fjalët Kyçe: Sistem i regjistrimit të pasurive të paluajtshme; aspekte krahasuese; unifikim; institucion; reformë ligjore.

Hyrje

Çështjet e të drejtave të pasurisë së paluajtshme mbeten një nga sfidat kryesore në rajon, e cila përcakton zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Eksperienca Shqiptare nuk është e vetmja në këtë sfidë. Pasuritë e paluajtshme, përbëjnë sot asetin kryesor të zhvillimit ekonomik të një vendi. Vëmendje të veçantë u kushtohet vendeve të cilat janë në zhvillim dhe synojnë integrimin në Bashkimin Europian¹. Shqipëria, ashtu si edhe vende të tjera fqinje të ish sistemit socialist pas viteve '90, pësoi një transformim të dukshëm në trajtimin e pasurive të paluajtshme, të cilat kërkonin reforma të thella dhe të vazhdueshme ligjore në këtë fushë.

Analiza krahasuese midis Shqipërisë dhe vendeve të cilat ngjasojnë për nga historiku i trajtimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, na ndihmon në reflektimin për të arritur reforma të mëtejshme ligjore, me qëllim përmirësimin e titujve juridik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Institucioni publik i cili regjistron, përpunon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme (*tokë*), ka nevojë për analizë krahasuese me vende të tjera të ballkanit (*vendet e Europës Juglindore*), e cila sjell si pasojë sygjerime për reforma ligjore të cilat synojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e këtij institucioni. Pas viteve '90, së bashku me ndryshimet e sistemit politik, vendet e Europës Juglindore u përballën me situatë

¹Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Italiane Nr.129/1991.

emergjente për të përballuar mënyrën e menaxhimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Situata e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (tokë) deri në vitet '90 në Europën Juglindore

Para viteve '90 në vendet e Europës Juglindore sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka qenë i dyzuar, sepse ka ekzistuar sistemi kadastral dhe sistemi hipotekor. Prona ishte e shtetëzuar. Regjistrimi i pasurive (*në ato pak raste kur kishte transaksione*) mundësohej nga gjykatat e secilit rreth. Sistemet e regjistrimit administroheshin nga autoritetet administrative përkatëse, por me një rol pasiv sa kohë nuk ekzistonte iniciativa e lirë private. Shqipëria ka njohur një sistem të rreptë të cetralizimit të pasurisë së paluajtshme, ku njohja e pronës private dhe transaksioni i pasurive të paluajtshme ka qenë në nivele shumë të ulta, përveç shtëpive të banimit kryesisht në fshat dhe pjesërisht në zonat urbane. (David & Jazo, 2008, 25). Ndërkohë në vende të tjera të Europës Juglindore, kryesisht në Kosovë, Mal i Zi, Serbi, Bosnje & Hercegovinë është njohur prona private, kryesisht në zonat rurale (*tokat bujqësore*) dhe janë lejuar transaksione mbi të. Ndryshe nga vende të tjera socialiste, në Serbi pronat private nuk u shua krejtësisht. Kosova, krahasuar me vende të tjera të Europës Juglindore, e ka njohur pronësinë private dhe nuk ka patur kufizime për transaksionin e pasurive të paluajtshme, të cilat kanë vijuar rregullisht. Në Kosovë nuk ka ekzistuar libër toke (*Land Book*), ashtu siç është njohur në vende të tjera të Europës Juglindore. Në Kosovë ka ekzistuar vetëm Zyra Kadastrale Komunale (ZKK), e cila mbante informacione mbi të dhënat e pronësisë në të ashtuquajturat "*Listat e Posedimit*", por janë informacione të cinguar. Në përmbajtje të saj, paraqitet informacion vetëm për hartat kadastrale, mungon informacioni mbi të dhënat juridike të pasurisë së paluajtshme.

Ndërtimi/Krijimi i Sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (tokë) në vende të Europës Juglindore

Në Shqipëri, reformat mbi pronësinë dhe sistemin e regjistrimit kanë qenë më dinamike krahasuar me vende të tjera të Europës Juglindore. Sistemi kadastral dhe ai hipotekor i cili funksiononte para viteve '90, u unifikuan dhe u krijua sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme (*Ligji nr. 7843/13.07.1994; Ligji 33/2012*), i cili administrohet nga Zyra qendrore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nëpër rrethe. Edhe Kosova është një nga vendet të cilat në kuptimin e sistemit të administrimit të pasurive të paluajtshme ka qenë i stabilizuar, në të ka ekzistuar vetëm Zyra Komunale Kadastrale. Por të dhënat mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme, kanë qenë të pasakta. Sistemi i regjistrimit në Kosovë tashmë është i unifikuar dhe mbështet nga Agjensia Kosovare e Kadastrës. Ndërkohë në të gjitha vendet e tjera të Europës Juglindore të cilat janë marrë në shqyrtim në këtë referim, reformimi mbi sistemin e regjistrimit ka filluar me vonesë dhe si rrjedhim janë ende në proces. Sistemi i regjistrimit në Kroaci, në Bosnje & Hercegovinë, në Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi bazohet në sistem të dyzuar të regjistrimit të pronës, përkatësisht në sistemin kadastral (*kadastra e pasurive të paluajtshme*) dhe sistemin hipotekor (*libri i tokës*).

Të gjitha vendet e Europës Juglindore, ashtu si Shqipëria po synojnë drejt unifikimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në një sistem të vetëm. Në Kroaci, që nga viti 2003 e në vazhdim, me ndihmesën e bankës botërore, është duke u kryer reforma për unifikimin e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, proces i cili ka vijuar normalisht, por ende nuk ka përfunduar. Në Kroaci po punohet për të patur një sistem të vetëm të regjistrimit të tokës, i quajtur sistem i bashkimit të informacioneve (*joint information system - JIS*). Gjithashtu, në Bosnje & Hercegovinë reformat përkatëse për unifikimin e sistemit të regjistrimit filluan në vitin 2002 dhe janë ende në proces. Në Maqedoni, deri në vitin 2005 nuk ka pasur një sistem regjistrimi të mirëfilltë dhe shtetasit nuk ishin të sigurt në të drejtat e pronësisë, si rrjedhim refuzonin të regjistronin pasuritë që përfitonin.

Përvoja në të gjitha këto vende, përfshirë ish-Jugosllavinë, ka treguar se regjistrimi i pronësisë është një nga pikat kyçe i cili kërkon jo thjesht përditësim të të dhënave, por duhet të rikonstruktohet tërësisht i gjithë informacioni i pasurive të paluajtshme, në mënyrë që të sigurohet besueshmëria në mënyrën e administrimit të saj. Edhe Mali i Zi ka patur një sistem të dobët dhe jo të besueshëm

për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Në Mal të Zi reforma e tokës ka filluar në vitin 2009, si një mbështetje e projektit LAMP (*Land Administration & Management Project*) dhe Bankës Botrore. Nga të gjitha vendet e Europës Juglindore, vetëm në Shqipëri është ndërtuar sistemi i unifikuar i regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Por problematika kryesore në Shqipëri, mbetet kryesisht procesi i tejzgjatur i regjistrimeve fillestare të pasurive, proces që nuk ka përfunduar totalisht. Ndërkohë një shembull i mirë për t'iu referuar është Kroacia, reformat e së cilës filluan në vitin 2005 dhe në një kohë rekord deri në vitin 2010, është bërë saktësimi dhe hedhja e të dhënave fillestare të të gjitha pasurive të paluajtshme. Gjithashtu sistemi i regjistrimit është lehtësuar ndjeshëm, është mundësuar ulja e kostos e shërbimit dhe është rritur besimi i qytetarëve.

Problematikat e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Shqipëri dhe vendet të Europës Juglindore

Problematikat kanë të bëjnë kryesisht me këto komponentë:

- **Procedura e regjistrimit të titullit të pronësisë:** Serbia dhe Mal i Zi, janë vendet të cilat marrin më tepër kohë në regjistrimin e pronësisë, e cila shkon nga 30-180 ditë. Maqedonia para viteve 2005 mernte kohë nga 2- 6 muaj, ndërkohë sot regjistrimi i titullit të pronësisë bëhet brenda 5 ditëve. Shqipëria ka të përcaktuar një afat ligjor 15 ditë për regjistrimin e pasurisë, por nuk respektohet ky afat. Si rrjedhim, procedura në praktikë për regjistrimin zgjat më shumë, e cila shkon edhe në 2 muaj. Në vitin 2012 Serbia ka arritur të shkurtojë regjistrimin e pronës nga 60 ditë në 7 ditë. Në Kroaci procedura e regjistrimit është për 7 ditë. Bosnje & Hercegovina, pas vitit 2007 ka përsosur shërbimin duke regjistruar pronësinë në vetëm 5 ditë. Ndër të gjitha vendet e shqyrtuara, vetëm Serbi & Mal i Zi mbeten shumë mbrapa dhe kërkojnë reforma urgjente mbi procesin e sistemit të regjistrimit.

- **Dixhitalizimi i të dhënave të pronës.** Sistemi “one stop shop” i synuar nga të gjitha vendet e rajonit ekziston pjesërisht vetëm në Shqipëri (*pëkatësisht në Tiranë dhe Durrës*). Në të gjitha vendet e tjera janë në përpjeke për ta instaluar një proces të tillë. Megjithatë të gjitha këto vende duke qenë në proces regjistrimi të pronësive ekzistuese, do të mundësojnë fillimisht hedhjen e të dhënave në formë dixhitale të të gjithë informacionit mbi pasuritë dhe më pas nëse është e mundur do të aplikohet sistemi “one stop shop”. Nga të gjitha vendet vetëm Kroacia ka tashmë të dixhitalizuar të dhënat e pronësisë, por nuk ekziston sistemi “one stop shop”. Në Kroaci regjistrat që ishin manual tashmë janë të dixhitalizuar. Serbia, Kosova, Maqedonia, Mal i Zi dhe Bosnje & Hercegovina nuk kanë të përcaktuar regjistrin elektronik. Shërbimi Noterial tashmë ekziston në të gjitha këto vende. Vendi i parë që e ka përfshirë këtë shërbim pas viteve '90 është Shqipëria, ndërsa vendi i fundit është Serbia, përkatësisht në Gusht të vitit 2014.

- **Trajtimi ligjor i pozitës juridike të pronarëve të mëparshëm:** Në Shqipëri ka patur disa procese për kthimin e pasurive të paluajtshme pronarëve privatë, apo shpërndarjen e pronave poseduesve të tyre. Ky proces i tejzgjatur, shoqëruar me reforma të vazhdueshme ligjore dhe institucionale ka sjellë probleme të shumta në identifikimin e saktë të titullit juridik. Në vendet e Europës Juglindore nuk ka qenë kaq problematike sa në Shqipëri, për faktin se një proces i tillë është njohur më vonë në kohë dhe për faktin se shteti nuk i shpërndau të gjitha pronat në pronësi private, por i mbajti në pronësi shtet. Procesi i shpërndarjes së pasurive u bë gradualisht dhe i kontrolluar. Por e gjithë kjo inisiativë ligjore dhe institucionale në të gjithë Europën Juglindore ka rezultuar problematike, çka ka penguar dhe krijimin e një sistemi të besueshëm të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në Serbi procesi i kthimit të pronave filloi të shqyrtohet pas vitit 2004, proces që ende nuk ka përfunduar dhe rezultoi të jetë mjaft problematik. Në Mal të Zi në vitin 2002 u miratua ligji për kthimin e pronave, por zbatimi i tij hasi në vështirësi praktike, duke u bërë një sistem i dyshimtë. Bosnjë & Hercegovina filloi me procesin e shqyrtimit të kthimit të pronave në vitin 1996, më pas ndryshoi ligjin në vitin 2000, por duke qenë se u reflektuan probleme në trajtimin e të drejtave të pronësisë, atëherë të dyja legjislacionet u pezulluan. Kroacia i mori në shqyrtim problemet e kthimit të pronave në vitin 1996 dhe pastaj në vitin 2002, me ndryshimet ligjore që përcaktoi për trajtimin e tyre. Megjithatë, ishte një proces i cili nuk hasi shumë problematika. Kosova bën përjashtim nga vendet e shqyrtuara sepse është i vetmi vend që nuk ka njohur probleme të pretendimeve për njohjen e kthimit të të

drejtave mbi pasuritë e paluajtshme, sepse edhe para viteve '90 pronësia private ishte e legjitime dhe lejoheshin transaksionet midis individëve. Rreth 90 % e të gjitha pasurive të paluajtshme në Kosovë ishin në pronësi private. Kosova ka patur problematikë për sa i përket regjistrimit të titullit të pronësisë, sepse kanë ekzistuar akte private të shitblerjes midis shtetasve Kosovarë dhe atyre Serbë, për faktin se pas 1989 Qeveria Jugosllave e ndalonte me ligj shitblerjen e pronave mes popullatës me kombësi të ndryshme. (Tawil, 2009, 7)

• **Legalizimi i ndërtimeve informale.** Është problematikë që ndodh jo vetëm në Shqipëri. Si rrjedhim, në Serbi ky problem është i mbartur. Informaliteti ekzistoi si shkak i paaftësisë së sistemit për një planifikim të qartë, në mënyrë që të përballonte ndryshimet e shpejta në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit. Për këtë arsye, Serbia konsiderohet si një nga vendet që është në tranzicion. Ndërtimet informale, të cilat ekzistojnë edhe në vende të tjera si në Mal të Zi, në Kroaci, në Bosnje & Hercegovinë e kanë dëmtuar sistemin e pasurive të paluajtshme. Asia e madhe e ndërtimeve informale, sidomos në Mal të Zi e bën të pamundur krijimin dhe pregatitjen e vendit për zhvillimin e infrastrukturës. Legalizimi i ndërtimeve pa leje është ende në proces në të gjitha vendet e Europës Juglindore. Ndërkohë edhe në Serbi presin që të legalizohen rreth 780,000 prona; Në Kroaci, Bosnje & Hercegovinë rreth 200,000 prona; ndërsa në Mal të Zi rreth 100,000 prona. (Dode, 2014, 402).

Konkluzion

Pavarësisht hapave ligjorë dhe institucionalë të ndërmarrë nga autoritetet përkatëse në secilin vend të Europës Juglindore, procesi i sistemit të regjistrimit të pronësisë në këto vende mbetet ende problematikë. Në këtë mënyrë, vendet e marra në analizë në këtë punim, janë në një proces të vazhdueshëm reformimi me qëllim krijimin e stabilitetit juridik dhe institucional të pasurive të paluajtshme (*tokë*). Mirëmbajtja e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme është cilësuar si proces i vështirë që kërkon kohë dhe kosto të lartë financiare, për shkak të problematikave të mbartura ndër vite. Një nga pikat kyçe ku regjistrimi i pronës është thelbësor ka të bëjë me sigurinë juridike të ofruar, me qëllim lehtësimin e investimeve vendase apo të huaja në këtë sektor. Ndër vendet e analizuara, Shqipëria është e para që ka njohur reformat e thella dhe të vazhdueshme mbi pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu, Shqipëria është i vetmi vend që ka krijuar më herët një sistem të unifikuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ka njohur dhe aplikuar sitemin e dixhitalizuar të pronësisë dhe së fundi pjesërisht edhe sistemin “one stop shop” për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme. Por panvarësisht kësaj, krahasuar me vende të tjera të Europës Juglindore, Shqipëria mbetet ende në standarte të ulta për shkak të procesit të ngadaltë të përthithjes së reformave si dhe problemeve praktike ende të pazgjidhura. Trajtimi juridik i pronarëve të mëparshëm si dhe ndërtimet informale të cilat trajtohen ende nga institucione të posaçme, kanë sjellë bllokimin dhe tejzgjatjen e procedurave për krijimin e një sistemi eficient mbi regjistrimin e pasurive e paluajtshme.

Megjithatë, objektivat kryesore që synohen në regjistrimin e pasurive të paluajtshme në vendet e Europës Juglindore, janë:

- krijimi i një sistemi unik dhe të sigurt për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (*tokë*), ku të pasqyrohet në mënyrë të qartë informacioni ligjor dhe ai teknik mbi to;
- mundësimi i krijimit të të dhënave dixhitale të pasurive të paluajtshme dhe pas kësaj krijimi i një sistemi të vetëm për regjistrimin e pronësisë, i njohur si sistemi “one stop shop”. Regjistrimi on-line i pasurive të paluajtshme do të sjellë zgjidhjen përfundimtare në lehtësimin e mbledhjes së taksave për pasuritë e paluajtshme dhe do të minimizojë informalitetin në këtë sektor.
- procesi i trajtimit juridik të pronarëve të mëparshëm si dhe përfundimi i procesit të trajtimit të zonave informale duhet të përfundojë sa më shpejt;
- të ketë koordinim dhe fleksibilitet midis institucioneve të cilat trajtojnë çështjet e pronësisë, në mënyrë që të shmangen mbivendosi dhe titujve të pronësisë;
- ulja e afatit kohor për regjistrimin e titullit të pronësisë; siguri juridike në dokumentat e pronësisë dhe transparencë në procesin e administrimit të të drejtave të pronësisë;
- trajnimi i vazhdueshëm i specialistëve që administrojnë dhe përpunojnë të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme, me qëllim rritjen e efikasitetit në punë.

Referenca

Edward, T., (2009), Property Rights in Kosovo: A haunting legacy of a society in transition, Internacional Center for transitional Justice;

Zagreb nekretnine d.o.o., (2009), Real Estate Market Study in the Republic of Croatia, Nova Ves 17 – 10 000 Zagreb; Republic of Croatia Ministry of Justice, State geodetic administration;

Dode, S., (2014), The Crucial Issues About The Legalization Legislation on illegal constructions in Albania. What can we Learn from the balcanic experience; Mediterranean Journal of Social Sciences; MCSER Publishing, Rome-Italy;

J. von Schuckmann (2003), Expert opinion about the regulations on legal rules of land registration in the current “Law on State Land Survey, Cadastre and Registration of Rights on Real Property”. Part of the GTZ project “Advice on the Legal Reform in Serbia and Montenegro”;

Wessely, R., Jetzinger, D., Marosan, S. and other authors, (2004) Comparative Analysis and Review of Real Property registration and Cadastre Systems i Eastern and South-Eastern Europe - Serbia. Center of Legal Competence (CLC), Wien;

Andersson, B. (2002), ‘Reforming the Cadastre and Land Administration in Kosovo’, resented to the FIG Conference, in Washington, D.C.,

Bosnia and Herzegovina, (2012) Real Estate Registration Project Framework Environmental Management Plan 2012;

ARCOTRASS, (2006), Consortium Study on the State of Agriculture in Five Applicant Countries; Bosnje Hercegovina Coutry report;

RAMA A., (2013), “Të drejtat e pronësisë në Shqipëri: Sfida dhe perspektiva”; Tiranë Shqipëri, Friedrich EBERT STIFTUNG;

Stanfield, J. D. & Jazo, S. (2008), Report “The evolution of immovable property registration in Albania, Terra Institute Reports;

Global Legal Group Ltd, (2014), The International Comparative Legal Guide to real estate, Londër; www.iclg.co.uk;

Stanfield, J. D. & Jazo S., (2008), Report The evolution of immovable property registration in Albania, terra Institute Albania Reports, Land Tenure Center.

Latest developments in the private international law of Contracts

Dr. Ervis Çela

nënkuptojmë ato rrethana që duhet të plotësohen kumulativisht, që subjekti përgjegjës të mund të përgjigjet. Përcaktimi i këtyre kushteve zë vend të rëndësishëm edhe në trajtimet teorike. Në kontekst të kësaj, duhet të potencojmë se kushtet e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar nuk janë unike, por ato dallohen në rastet kur përgjegjësia krijohet sipas bazës së përgjegjësive subjektive dhe në rastet kur përgjegjësia krijohet sipas bazës objektive. Përgjegjësia jashtkontraktore dhe kontraktore dallojnë nga përgjegjësia penale dhe administrative, edhe pse në raste të caktuara konkurojnë njëra tjetrën. Që të lindin detyrime nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të konkurojnë disa kushte së bashku, këto janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit, dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Poashtu, edhe me rastin e shkaktimit të dëmit nga detyrimet kontraktore, është e nevojshme që në mënyrë kumulative të plotësohen disa kushte për lindjen e përgjegjësive kontraktore, që janë: a) ekzistenca e një fakti të paligjshëm, që është në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga kontrata, që do të thotë shkelje të së drejtës pasurore të një kreditorit; b) ekzistenca e dëmit (supozimi për ekzistimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi, ekzekutimi i vonuar i detyrimit apo përmbushja joadekuate), c) ekzistenca e lidhjes kauzale midis faktit të paligjshëm të debitorit dhe pasojës së kreditorit, d) fajësia (culpa) e personit që kryen faktin paligjshëm, përveç rasteve kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme apo ushtrimi i veprimtarive të rrezikshme, pasi këtu përgjegjësia lind edhe pa faj. Lidhur me kushtet e përgjegjësive subjektive theksohen: aftësia deliktore, shkaktimi i dëmit, lidhja kauzale, veprimi i kundërligjshëm dhe faji. Për dallim nga kjo, për të ekzistuar përgjegjësia për të tjerët duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet dëmi, dëmin ta shkaktoj personi që është në lidhje të veçantë juridike me personin përgjegjës, të ekzistojë lidhja kauzale midis veprimit që është ndërmarrë dhe dëmit të shkaktuar si dhe dëmi të shkaktohet nga lëshimet eventuale të personit përgjegjës. Ndërkaq, për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga baza objektive, duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet dëmi, dëmi të jetë shkaktuar nga përdorimi i sendit të rrezikshëm ose ushtrimit të veprimtarisë së rrezikshme, të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet veprimit të sendit të rrezikshëm ose veprimtarisë së rrezikshme dhe efekteve të dëmit si dhe duhet të ekzistojë kundërligjshmëria.

Shkaktimi i dëmit

Shkaktimi i dëmit është kushti me rëndësi për lindjen e detyrimeve nga shkaktimi i dëmit. Ai është vendimtar për krijimin e përgjegjësive juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rezultojnë të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit, si fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve. Termi dëm përdoret edhe për të treguar dëmin që i bëhet pasurisë edhe për të treguar dëmin që i bëhet personave, dinjitetit, nderit të tij. Dëmi paraqitet edhe si fakt juridik edhe si kusht kryesor për lindjen e marrëdhënies detyrimeore, dhe se dëmi paraqet humbjen e masës pasurore të të dëmtuarit. Që të konsiderohet i dëmshëm veprimi i subjektit të caktuar, nuk mjafton të ndodh vetëm cënimi i të drejtës, por duhet të dëmtohet edhe ndonjë e mirë materiale apo personale nga ai veprim. Nga ana tjetër, edhe pakësimi i vlerës së sendeve në të cilat, vërtetë, personi i dëmtuar akoma nuk ka të drejtë, por ka interes të mbrojtur me ligj. Kuptimin e dëmit e kanë përkufizuar edhe shumë legjislacione civile të huaja. Sipas Ligjit për marrëdhënie të detyrimeve të Maqedonisë "Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm real) dhe pengim i rritjes së saj (fitim i munguar), si dhe shkaktimi i ndonjë dhimbje fizike apo shpirtërore apo frike (dëm jomaterial)". Nga ky definicion vërejmë dy kuptime për dëmin: kuptimin ekonomik dhe kuptimin juridik. Në kuptimin ekonomik, me dëm nënkuptohet humbja e pasurisë, pavarësisht nga rrethanat që kanë çuar te kjo humbje, ndërsa në kuptimin juridik, me dëm nënkuptohet humbja e ndonjë të drejte subjektive apo ndonjë interesi juridik të mbrojtur nga legjislacioni në fuqi. Pra, në të dyja kuptimet bëhet fjalë për humbje. Humbjet mund të qëndrojnë në pakësimin e një vlefte materiale që bën pjesë në pasurinë e një personi dhe që quhet dëm pozitiv. Humbjet mund të qëndrojnë edhe në mosrealizimin nga ana e të dëmtuarit të një interesi pasuror, të cilin do mund ta realizonte sikur të mos ishte kryer veprimi i kundërligjshëm nga shkaktuesi i dëmit, dhe kjo paraqet fitimin e munguar. Për të njëjtën humbje, por me emërtime të tjera, si dëm i vërtet dhe fitim i munguar i gjejmë të trajtuar edhe në veprat e autorëve tjerë. Dëmi si kusht i përgjithshëm, është në marrëdhënie korrelative me veprimin e dëmshëm, pasi në marrëdhënien detyrimore si shkak paraqitet veprimi i dëmshëm, kurse fakti i

dëmit paraqitet si pasojë e shkakut. Pala e dëmtuar, që nga momenti i shkakimit të dëmit, fiton të drejtën e shpërblimit nga i njëjti, duke supozuar në shkeljen e një të drejte subjektive.

Lidhja shkakësore

Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjesisë për dëmin e shkakuar, është edhe lidhja shkakësore që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkakuar. Lidhja shkakësore paraqet një rrethanë të komplikuar pasi në praktikë mund të ndodh që një shkak i vetëm të shkaktojë disa pasoja apo disa shkaqe të shkaktojnë një pasojë të vetme. Lidhja kauzale paraqet raportin e ndërsjelltë, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit. Përgjegjësia civile lind vetëm nëse konstatohet lidhja shkakësore ndërmjet veprimit apo mosveprimit të personit, apo pasjes së sendeve të rrezikshme apo marrjes me veprimtari të rrezikshme dhe, shkakimit të dëmit, pa pasur nevojë që të ekzistojë faji i subjektit përgjegjës, për dallim nga përgjegjësia penale, e cila lind vetëm atëherë kur të kontatohet lidhja shkakësore dhe fajësia e subjektit përgjegjës.

Faji

Për dallim nga përgjegjësia penale ku faji paraqitet si kusht i domosdoshëm për ekzistimin e përgjegjesisë, pa të cilin nuk ka dhe sanksion penal, te përgjegjësia civile faji nuk paraqet kushtin e domosdoshëm të lindjes së përgjegjesisë për dëmin e shkakuar, sepse te përgjegjësia civile ekzistojnë situata kur përgjegjësia lind edhe pa faj, siç është rasti me përgjegjësinë objektive, që ndryshe quhet përgjegjësia pa faj (përgjegjësia për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme). Faji, paraqet elementin e brendshëm subjektiv të përgjegjesisë për dëmin e shkakuar, pasi kjo është një marrëdhënie në mes të vullnetit të dëmtuesit, veprimit të dëmshëm dhe pasojave që shkaktohen nga veprimi i personit. Në nenin 141 të Ligji për marrëdhëniet edetyrimeve në Maqedoni vetëm kalimthi përmendet çështja e fajësisë, ku thuhet: “Ai i cili do t’i shkakton dëm tjetrit është i detyruar që ta zhëdmoj, përderisa nuk është në gjendje ta dëshmon se dëmi është shkakuar pa fajin e tij”. Në këtë ligj përjashtohen rastet kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, ku subjekti përgjigjet edhe pa faj. Edhe Kodi Civil I Shqipërisë në nenin 644 thotë “Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkakuar, ka pasur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogaris në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin

Aftësia deliktore

Aftësia deliktore e personit fizik paraqitet si kusht i përgjithshëm i përgjegjesisë jashtëkontraktore. E theksojmë në mënyrë të veçantë vetëm përgjegjësinë jashtëkontraktore, pasi te përgjegjësia kontraktore, aftësia e palëve përveç se paraprakisht nënkuptohet (nuk mund të jenë palë në kontratë personat me pa zotësi veprimi), dhe se të drejta dhe detyrimet lindin vetëm për subjektet e kontratës – inter partes, ku si subjekte, personat fizikë munden të jenë vetëm të moshës madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar. Në të kundërtën, duhet të jenë të përfaqësuar nga persona me zotësi të plotë për të vepruar. Aftësia deliktore paraqet aftësinë e personit fizik që të përgjigjet vet për pasojat e veprimeve të tij, në qoftë se me këto veprime i ka shkakuar dëm personit tjetër, pavarësisht nëse lind edhe përgjegjësia penale apo vetëm ajo civile. A do të përgjigjet personi për shkakimin e dëmit, kjo varet nga mosha dhe aftësia e të gjykuarit. Aftësia deliktore arrihet me fitimin e zotësisë së veprimit, do të thotë, me arritjen e moshës madhore.

Veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm

Veprimi i kundërligjshëm konsiderohet ai veprim apo mosveprim i njeriut me të cilin çënohet normat juridike imperative apo rregullat e moralit në një shoqëri të caktuar. Me veprim apo mosveprim të kundërligjshëm mund të çënohen edhe interesat të karakterit material edhe interesat të karakterit personal, dhe kjo mund të ndodh si te personat fizik ashtu edhe te ato juridik. Veprimi i kundërligjshëm konsiderohet ai veprim i personit që është në kundërshtim me të drejtën objektive, që ndryshe thuhet se është veprim i ndaluar, për shkakun se personave të tjerë në komunikimin juridik i’u shkaktohet dëm, si dhe për dëmin e shkakuar parashihet sanksioni i zhëdmtimit të palës së dëmtuar. Gjatë komunikimit juridik subjektet janë të detyruara që mos të bëjnë veprime të kundërligjshme me të cilat subjektetve të tjera u shkaktojnë dëm, pasi shkelin dispozitat e ligjit me të cilat ndalohet apo urdhërohet një veprim i caktuar, dhe se secili është i detyruar që të përmbahet

nga këto veprime. Kjo nuk nënkupton që personi të përmbahet dhe të mos ndërmer vetëm veprime aktive, por të përmbahet edhe nga qëndrimi pasiv (mosveprimi), në qoftë se me këtë mosveprim mund të kontribuon në shkaktimin e dëmit apo rritjen e pasojave të dëmit. Në disa raste mund të ndodhë në praktikë që të shkaktohet dëmi, por të mos lind përgjegjësia për subjektin, autorin e dëmit. Kjo ndodh për faktin se veprimi apo mosveprimi i palës nuk konsiderohet si veprim i kundërligjshëm, element që duhet të ekzistojë si kusht në rastin e shkaktimit të dëmit. Si raste të përjashtimit të kundërligjshmërisë, sipas doktrinës juridike përmendën: mbrojtja e nevojshme, vetëndihma e lejuar, pëlqimi i të dëmtuarit për t'iu shkaktuar dëm, kryerja e të drejtës së vet, kryerja e detyrës zyrtare dhe nevoja ekstreme.

Përgjegjësia juridiko-civile

Përgjegjësia krijohet për shkak të fajit të tyre dhe rrezikut të krijuar. Mirëpo, kemi raste kur përgjegjësia civile mund të krijohej edhe pa fajin e subjektit përgjegjës. Rastet kur faji nuk meret parasysh janë të shumta dhe ekzistojnë kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme ose veprimtaria e rrezikshme si dhe kur dikush përgjigjet për fajin e tjetrit. Vetë fakti i shkaktimit të dëmit, krijon përgjegjësinë juridike civile, me çka krijohet dhe detyrimi i kompensimit të dëmit. Qëllimi i përgjegjësisë juridike civile është mbrojtja e subjektit dhe pasurisë së tij nga pasojat e veprimeve të dëmshme dhe kundërligjore të personave që janë përgjegjës. Me vetë faktin e lindjes së kësaj përgjegjësie si rezultat i shkaktimit të dëmit, krijohet dhe marrëdhënia e re e detyrimeve, e cila më parë as që ekzistonte si e tillë mes këtyre palëve. Edhe te përgjegjësia kontraktore, sikurse te ajo jashtkontraktore, si bazë e përgjegjësisë paraqitet kryesisht faji dhe, vetëm përjashtimisht, përgjegjësia kontraktore lind pa fajin e palëve. Në periudhën e lashtë të së drejtës romake, me rastin e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore, debitori përgjigjej objektivisht, pa marrë parasysh shkaqet që kan shtyrë në mos përbushje të detyrimit. Rregullat e përgjegjësisë subjektive për mospërbushje të detyrimeve kontraktore për herë të parë filluan të paraqiten që në periudhën klasike të së drejtës romake, të cilat bënë zëvendësimin e përgjegjësisë subjektive me përgjegjësinë objektive. Në bazë të rregullave të përgjegjësisë objektive, debitori përgjigjej vetëm kur mospërbushja e detyrimeve kontraktore kishte ardhur si rezultat i fajit apo lëshimeve të debitorit, jo edhe kur mospërbushja e detyrimit kishte ardhur pa fajin e tij apo nga fuqia madhore. Zbatimi i parimit të fajit mund të konsiderohet si pasojë e botëkuptimeve të shekullit XIX. Sipas nenit 1147 të Kodit Civil të Francës të 17 shkurtit të vitit 1804, thuhet: "Debitori detyrohet të shpërblejë dëmin, qoftë për shkak të mospërbushjes së detyrimit, qoftë për shkak vonesës së përbushjes kur nuk arrin ta dëshmojë se mospërbushja e detyrimit ka ardhur nga ngjarjet e jashtme që nuk mund t'i atribuohen atij, edhe pse ai nuk ishte në keqbesim." Sipas kësaj mënyre të të menduarit, bazuar në natyrën e gjërave, sanksioni apo detyrimi për të kompensuar një dëm mund të jetë vetëm pasojë e sjelljes së fajshme. Parimi kryesor ishte «nulla indemnitas sine culpa», ska dëmshpërblim pa faj. Mirëpo kishte të tjerë shkencëtarë që mendonin se baza e përgjegjësisë mund të lindë edhe pa faj. Sot, për këtë çështje ka një mendim të unifikuar nga e drejta ndërkombetare dhe e drejta e jonë, sikurse praktika gjyqësore, që njohin dy baza për krijimin e përgjegjësisë civile për shkaktimin e dëmit Detyrimet kontraktore lindin kur debitori nuk e përbush prestimin obligator, kurse kreditori, nga ky moment fiton të drejtën që me mjete juridike shtrenguese ta detyrojë përbushjen e prestimit obligator. Ndërsa, detyrimi jashtkontraktor lind në momentin e shkaktimit të dëmit (pasojës). Në bazë të kësaj, përgjegjësia juridike civile si e tillë mund të jetë dy llojesh: si përgjegjësi kontraktore (e cila sajohet si rezultat i mospërbushjes së kontratës, apo përbushjes jo të rregullt të saj) dhe si përgjegjësi jashtkontraktor (e cila sajohet me rastin e shkaktimit të dëmit). Marrë për bazë faktin se personi që ndërmer veprime të kundërligjshme me të cilat tjetrit i shkaktan pasoja të natyrës pasurore apo personale, krijon përgjegjësi juridike civile për dëmin e shkaktuar, me çka dhe duhet të përcaktohen dhe arsyet se pse ai duhet të përgjigjet. Faji, apo vetë shkaktimi i dëmit, në çështjen e të konceptuarit të arsyes për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, në teorinë e së drejtës civile, krijon dy lloje themelore të përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar: përgjegjësi subjektive (përgjegjësia me faj) dhe përgjegjësi objektive (përgjegjësia pa faj).

Përgjegjësia kontraktore dhe jo-kontraktore

Përgjegjësia jashtkontraktore edhe përgjegjësia kontraktore janë përgjegjësi civile, por dallojnë për nga çasti i krijimit dhe të drejtat e detyrimit që dalin për palët. Përgjegjësia jashtkontraktor lind

me rastin e shkakimit të dëmit. Vetë fakti i shkakimit të dëmit krijon detyrimin për shpërblimin e tij nga ana e shkakuesit të dëmit. Dëmi që shkaktohet me veprimin ose mosveprimin e njeriut, krijon përgjegjësinë për dëmin e shkakuar, respektivisht përgjegjësinë deliktore dhe nga këtu pala e dëmtuar fiton të drejtën që të kërkojë shpërblimin qoftë të dëmit material apo atij jomaterial. Gjithashtu, edhe kur dëmit krijohet nga përdorimi i sendeve apo ushtrimi i veprimtarisë së rrezikshme, të cilat paraqesin burim të shtuar të rrezikut, lind përgjegjësia jashtkontraktore për të mos shkakuar dëm. I dëmtuari, me rastin e shkakimit të dëmit, është në pozitën e kreditorit, pasi për këtë lind e dreja që të kërkojë kompensimin e dëmit, kurse subjekti përgjegjës është në pozitën e debitorit, pasi ai duhet të bëjë zhdëmtimin. Detyrimi për zhdëmtim paraqitet si detyrim primar dhe i vetëm i debitorit me rastin e shkakimit të dëmit. Kurse, përgjegjësia kontraktore lind me rastin e mospërmbushjes së kontratës apo përmbushjes jo të rregullt të saj. Kështu, në çastin e cënimit të kushteve të kontratës, debitori, përveç se detyrohet që ta përmbushë kontratën që është detyrimi kryesor i tij, për këtë gjithashtu, lind dhe detyrimi që të zhdëmtojë edhe dëmin nga mos përmbushja e kontratës apo përmbushja jo e rregullt e saj, që është detyrim sekondar në këtë marrëdhënie juridike. Që të ekzistojë përgjegjësia kontraktore, duhet të ekzistojë kontrata e plotëfuqishme ndërmjet kreditorit dhe debitorit, me të cilën debitori ka kryer përmbushjen e detyrimit kontraktor. Me rastin e shkakimit të dëmit, mund të përgjigjen shumë persona si: shkakuesi i dëmit, përfutuesi, ndihmësi, nxitësi, pronari apo kryerësi i veprimtarisë së rrezikshme, varësisht nga shkalla e përgjegjësive dhe aftësia deliktore që kanë. Në bazë të numrit të pacaktuar të personave përgjegjës, mund të thuhet se përgjegjësia deliktore vepron erga omnes. Kurse, me rastin e cënimit të kontratës, përgjigjen vetëm subjektet e kontratës, eventualisht edhe pasardhësit e tyre. Nëse nuk kemi të bëjmë me kontrata intuitu in personae, kjo do të thotë se këtu efekti është inter partes. Në përgjegjësinë deliktore autori përgjigjet sipas fajit, me përjashtim të rastit kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaritë e rrezikshme. Por, nëse autori vërteton se nuk ka qenë fajtor për dëmin që është shkakuar, atëherë mund të lirohet nga përgjegjësia. Te përgjegjësia kontraktore cënuesi i kontratës përgjigjet sipas fajit të supozuar. Rregullat e përgjegjësive kontraktore janë dispozitive (ius dispositivum), për arsye se palët kontraktuese këto rregulla, me anë të kontratës, mund t'i përjashtojnë, t'i kufizojnë ose t'i zgjerojnë. Këtu vjen në shprehje autonomia e vullnetit të palëve. Rregullat e përgjegjësive jashtkontraktor janë imperative (ius imperativum) dhe nuk mund të përjashtohen, zgjerohen apo kufizohen, por duhet të zbatohen ashtu siç janë në ligj. Meqenëse te përgjegjësia jashtkontraktor dallojmë edhe përgjegjësinë për të tjerët, veçanërisht për dëmin e shkakuar nga personat e mitur apo personat me aftësi të kufizuar të veprimit, kjo do të thotë se edhe këto subjekte mund të paraqiten në cilësinë e shkakuesit të deliktit civil, dhe, në situatë të caktuara, edhe të përgjigjen për pasojat e dëmit, nëse kanë qenë të vetëdijshëm në momentin e shkakimit të tij. Kurse, përgjegjësia kontraktore, nuk mund të shkaktohet nga të miturit apo personat me aftësi të kufizuar të veprimit. Kjo për faktin se këto nuk mund të paraqiten si palë në kontratë. Të miturit dhe personat me aftësi të kufizuar të veprimit, gjithmonë i përfaqësojnë prindërit apo kujdestari, si palë në kontratë. Nëse ndodh që dëmin ta shkaktojnë më shumë persona, sipas rregullave të së drejtës së detyrimeve, këto do të përgjigjen në mënyrë solidare, varësisht nga shkalla e fajit dhe kontributi i çdonjërit në shkakimin e pasojës. Te përgjegjësia kontraktore, kur dëmi shkaktohet nga më shumë subjekte, do varet se si i kanë paraparë palët në kontratë detyrim për zhdëmtim, pasi këtu nuk mund të përgjigjen solidarisht, po që se nuk e kanë kontraktuar ashtu. Të drejtën e saj pala e dëmtuar për kompensim të dëmit mund ta realizojë duke iu drejtuar gjykatës themelore me kompetencë të përgjithshme, pasi të jenë plotësuar kushtet e parapara për zhdëmtim. Për sa i përket parashkrimit, për rregullat e përgjegjësive jashtkontraktor parashihen afate më të gjata se sa për rregullat e përgjegjësive kontraktore. Te përgjegjësia deliktore afati i parashkrimit fillon të ecë që nga momenti i shkakimit të dëmit, kurse te përgjegjësia kontraktore (tek detyrimet që konsistojnë në bërje), afati i parashkrimit fillon të ecë që ditën e parë, pas ditës kur kreditori fiton të drejtën të kërkojë përmbushje e detyrimit dhe, prej kur të njëjtin mund ta realizojë me mjete juridike. Ndërsa në detyrimet që konsistojnë në mos bërje (non facere), afati i parashkrimit fillon të ecë që nga dita e parë, pas ditës kur debitori është sjellë në kundërshtim me detyrimet kontraktore. Në të drejtën krahasuese, afatet e parashkrimit paraqesin problem gjatë dëmeve të shaktuara në transportin ndërkombëtar. Kjo pasi, jo të gjitha legjislacionet e vendeve parashohin afate të njëjta.

Bibliografia

1. Rregullorja Roma II;
2. Proposal for a Regulation of the European Parliament and the Council On the Law Applicable to Non-Contractual Obligations (“ROME II”), (presented by the Commission);
3. Pleading and Proof of Foreign Law – a Comparative Analysis, *Prof. Dr. Rainer Hausmann*;
4. The Rome II Regulation: On the way towards a European Private International Law Code, *GarcimartínAlfárez, Francisco J., 2007*;
5. Commentary on the Title of the Digest Ad Legem Aquiliam (IX.2): with an Introduction to the Study of the Corpus Juris Civilis”, New Jersey, 2004;
6. Alan Calnan, “The fault(s) in negligence law”, Southwestern Law School, November, 2007;
7. François Givord, “La Reparation du prejudice moral”, Paris;
8. Kodi civil i Francë;
9. Kodi civil i Austrisë;
10. Kodi civil i Gjermanisë;
11. Kodi civil i Maqedonis;
12. Chase Manhattan Bank NA vs Israel-British Bank (London) Ltd;
13. Arab Monetary Fund vs Hashim and others, 1961;
14. Case “Bisbal”, 1959.

Mbrojtja e mjedisit në raport me të drejtën e pronës dhe zhvillimin urban

Magjistrat Olgert Rumnici
Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat
Avokat Sokol Mara
Avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë

Abstrakt

Zhvillimet e shekullit të XXI e kanë kthyer gjithmonë e më tepër vëmendjen në raportin që njeriu ka krijuar me natyrën, mënyrën e shfrytëzimit të saj dhe kostot sociale, ekonomike e shëndetësore që sjell me vete prishja e ekosistemeve natyrore.

Problemet që sjell dëmtimi i mjedisit në cilësinë e jetesës dhe kushtet e zhvillimit ekonomik po bëhen gjithmonë e më tepër prezent edhe në vendin tonë. Tirana, kryeqyteti i vendit, mbetet një nga qytetet më të ndotura në botë. Zhvillimi urban i vendit ka krijuar probleme të mprehta urbanistike, dështim të shtetit në kontrollin e territorit, ndotje të lartë për shkak të mbeturinave urbane, inerteve, ujërave të zeza, rritjes së erozionit për shkak të gërryerjes së lumenjve dhe prerjeve të pyjet, etj, probleme të cilat në analizë të fundit përkthehen në kosto ekonomike e sociale jo vetëm për brezat e tashëm por edhe për ata të ardhshëm.

Problemet e mësipërme e kanë shtyrë ligjvënësin shqiptar të marrë një sërë nismash të finalizuar me ratifikimin e konventave ndërkombëtare për çështje të ndryshme mjedisore, miratimin e ligjeve dhe hartimin e strategjive, të cilat kanë krijuar një korpus normativ, që synon garantimin e një mbrojtjeje të përshtatshme të mjedisit.

Por, paralelisht me mbrojtjen e mjedisit, organet shtetërore janë të detyruar të garantojë edhe respektimin e të drejtave të tjerave themelore të njeriut, të cilat jo në të gjitha rastet qëndrojnë në të njëjtën linjë me angazhimet në drejtim të mbrojtjes së mjedisit. Një prej këtyre të drejtave është padyshim edhe e drejta e pronës.

Pikërisht, trajtimi i raportit që krijohet midis të drejtës së pronës dhe mbrojtjes së mjedisit, do të jetë fokusi kryesor i punimit. Trajtimi i këtij raporti do të realizohet nëpërmjet pasqyrimin të parimeve kryesore mbi të cilat bazohet mbrojtja e mjedisit dhe dhënien e kuptimit të së drejtës së pronës, sipas përkufizimit që kësaj të drejte i jep neni 1 i Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat të Njeriut.

Në përpjekje për të përcaktuar se ku qëndron ekuilibri midis mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të pronës do të referojmë në praktikën e krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Vendimet e përzgjedhura të GJEDNJ-së mund të cilësohen si ndër vendimet më klasike lidhur me marrëdhënien e trajtuar.

Pjesë e punimit do të jetë edhe pasqyrimi i politika pro-mjedisore në planifikimin urban të territorit duke e parë këtë të fundit në kuadër të së drejtës së shtetasve për të zhvilluar pronën e tyre.

Në përmbllje të punimit do të jepen edhe përfundimet përkatëse.

Fjalët kyçe: *Mbrojtja e Mjedisit, E Drejta e Pronës, Planifikimi Urban.*

Hyrje

E drejta e brezit të ardhshëm për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm përbën detyrimin më madhor për brezin e sotshëm që të marrë masat e domosdoshme për të rikthyer vendin në normalitetin e ekosistemit natyror të para viteve 1990. Rëndësia që po merr në ditët e sotme mbrojtja e mjedisit dhe ndikimi i saj në opinion shoqëror kuptohet më qartë nëse sjellim në vëmendje reagimin e shoqërisë civile përsa i përket dy nismave të qeverive shqiptare, ajo lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe nisma e fundit mbi refuzimin e asgjësimit të armëve kimike siriane.

Kushtetua e Republikës së Shqipërisë në Kreun e saj mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nuk sanksionon një të drejtë themelore të mjedisit sikurse shprehet qartë për të drejtat e tjera më të prekshme, të tilla si e drejta e jetës apo liria e shprehjes. Megjithatë kjo nuk do të thotë se mbrojtja e mjedisit dhe e drejta e shtetasve për t'u informuar mbi gjendjen e tij, është lënë jashtë vëmendjes dhe mbrojtjes së kushtetutbërësit. Neni 56 i Kushtetutës sanksionon se: "*Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij*". Ndërkohë në kuadrin e objektivave sociale neni 57 i Kushtetutës parashikon se: "*Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: (...) d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;*"

Natyrisht, këtu duhet të bëhet dallimi se të drejtat dhe liritë e njeriut dallojnë nga objektivat sociale, pasi këto të fundit janë shprehje e qëllimeve të shtetit dhe parimeve të politikave të hartuara prej tij për orientimin e veprimtarisë shtetërore në përgjithësi dhe për rrjedhojë realizimi i tyre është i lidhur ngushtësisht me kushtet, mjetet dhe mundësitë financiare të shtetit. Të njëjtën situatë vërejmë edhe nëse analizojmë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut adoptuar në vitin 1950. Edhe ky akt themelor përsa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive natyrore të njeriut nuk shprehet në lidhje me mjedisin. Megjithatë edhe këtu nuk mund të dilet në konkluzionin që problemet mjedisore dalin jashtë sferës së mbrojtjes që garanton KEDNJ. Është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila ka krijuar një praktikë të konsoliduar sipas të cilës Konventa në vetvete është një instrument i gjallë që duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale jetësore. Shtetet kanë detyrimin të rregullojnë dhe të kontrollojnë problemet mjedisore që ndikojnë në ushtrimin e të drejtave të Konventës duke siguruar zbatueshmërinë e ligjeve. Mbrojtja e mjedisit përbën një qëllim të ligjshëm, i cili në raste të përshtatshme mund të justifikojë kufizimet e disa të drejtave si e drejta e jetës private apo e drejta e pronës. *GJEDNJ kur kërkon të gjejë një baraspeshë midis shqetësimeve mjedisore përkundrejt të drejtave të Konventës, i ka njohur autoriteteve shtetërore një hapësirë të gjerë vlerësimi për të marrë vendime mbi çështje mjedisore, që zakonisht kanë vështirësi sociale dhe aspekte teknike duke dhënë në parim diskrecion të gjerë* (Boyle, 2007, 14). Por edhe këtu duhet theksuar se mbrojtja e mjedisit është parë gjithmonë në funksion të ushtrimit të të drejtave të tjera themelore të garantuara nga KEDNJ.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit

Përpos analizës në rrafshin kushtetues, aktualisht shteti shqiptar ka ndërmarrë një sërë nismash legislative, të cilat kanë kontribuar në krijimin e një kuadri të plotë ligjor lidhur me masat parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimet. Në këtë drejtim meriton një vëmendje të veçantë Konventa e Aarhusit, e cila është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr.8672, datë 26.10.2000. Objektivi i kësaj konvente, me qëllim që të kontribuojë në mbrojtjen e së drejtës së çdo individi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, është të detyrojë shtetet që të garantojnë të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit.

Në nivelin kombëtar kuadri normativ përbëhet nga ligji Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi Përgjegjësinë Mjedisore, Parandalimin dhe Riparimin e Dëmeve mbi Ambientin” të ndryshuar. Në këtë akt janë përcaktuar parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Objektivat sociale të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë janë pasqyruar me forcën e duhur edhe në dispozitat e ligjit Nr.10431/2011, ku mbrojtja e mjedisit nga ndotja apo dëmtimi paraqitet si përparësi kombëtare dhe e detyrueshme për t'u përmbushur nga çdo banor i Republikës së Shqipërisë, nga të gjitha organet shtetërore, si dhe personat fizikë e juridikë, vendas a të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përsa i përket parimeve mbi të cilat realizohet mbrojtja e mjedisit, ligji kuadër përcakton si të tilla: Parimin e zhvillimit të qëndrueshëm; Parimin e parandalimit dhe marrjes së masave paraprake; Parimin e ruajtjes së burimeve natyrore; Parimin e zëvendësimit dhe/ose kompensimit; Parimin e qasjes së integruar; Parimin e përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit; Parimin e nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit; Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut; dhe Parimi “ndotësi paguan”.

Ligji kuadër për mbrojtjen e mjedisit shoqërohet nga një sërë ligjesh të tjera sektoriale të cilat rregullojnë aspekte të caktuara të strategjisë së mbrojtjes së mjedisit, duke përmendur këtu, si më të rëndësishmit: Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011 «Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis» i përafuar plotësisht me direktivën 85/337/KEE të Këshillit Evropian, datë 27 qershor 1985 “Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin”, të ndryshuar; Ligjin Nr. 91/2013 «Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor» i përafuar plotësisht me direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve

dhe programeve të caktuara”; Ligjin Nr.9115, datë 24.07.2003 «Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura»; Nr.8094, datë 21.03.1996 «Për Largimin Publik të Mbeturinave». Këto akte për vetë specifikën e temës nuk do të jenë objekt trajtimi i këtij punimi.

E Drejta e pronës dhe raporti me mjedisin

Në raport me “të drejtën mjedisore”, “e drejta e pronës” gëzon një mbrojtje të shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 41, Prg.1 dhe Prg.2 i Kushtetutës sanksionon se:

1. *Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.*

2. *Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj.*

Ndërkohë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë (Vendimi nr. 28, datë 27.05.2010) në jurisprudencën e saj ka theksuar **se forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës**. Koncepti i pronësisë zhvillohet më tej edhe në Kodin Civil, në nenin 149 të tij, sipas të cilit, pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji. Si tagër i veçantë i së drejtës së pronësisë, gëzimi i pronës përfshin edhe të drejtën e zhvillimit të saj. Çdo subjekt ka të drejtën ta përdorë pronën e tij dhe të nxjerrë përfitime prej saj. Por, sigurisht, që sikurse çdo e drejtë, edhe e drejta e përdorimit të pronës, ku përfshihet edhe zhvillimi i saj nuk është një e drejtë absolute. Në nenin 1 të Protokollit Shtesë Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikohet se: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. **Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera**”.

Nën dritën edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, neni 1 i Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNJ-së përmban tre rregulla mbi bazë të të cilave bëhet kontrolli nëse kemi të bëjmë me cenim të së drejtës së pronës. Kështu, rregulli i parë lidhet me gëzimin e lirë të pronës në paqe; rregulli i dytë lidhet me kufizimin e së drejtës së pronësisë sipas kushteve të caktuara dhe **rregulli i tretë u njeh shteteve të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm duke vënë në zbatim ligje që i gjykojnë të nevojshme për këtë qëllim. Të tre këto rregulla i përgjigjen të njëjtit qëllim: garantimin e pronarit nga ndërhyrje të tilla të shtetit që mund të arrijnë deri në atë pikë sa të rrezikojnë ekzistencën e veprimtarisë fitimprurëse që ai ushtron (GJEDNJ, James kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1996; Spjorrong dhe Lannorth kundër Suedisë, 1982).**

Për sa më sipër konkludohet se, e drejta e gëzimit të pronës është subjekt i kufizimeve ligjore, duke pasur efekt të drejtpërdrejtë social. Ashtu, si çdo veprimtari tjetër njerëzore, edhe e drejta e përdorimit të pronës ku përfshihet zhvillimi i saj, aq sa ka natyrë private ka edhe natyrë publike. *E drejta e zhvillimit të pronës vendoset në një marrëdhënie midis shoqërisë (territorit) dhe hapësirës natyrore* (Macchi, 1993, 2). Kështu, në mënyrë të padiskutueshme veprimtaria e zhvillimit të pronës ka efekt në “mjedis” si çdo veprimtari tjetër njerëzore.

Politikat mjedisore dhe planifikimi urban

Me termin “mjedis” nënkuptohen përbërësit natyrorë si: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu (Neni 5, Pika 1/7 e ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”).

Në raport me të drejtën e zhvillimit të pronës, parimet mbi të cilat udhëhiqen politikat pro-mjedisore në planifikimin urban mund të përmbledhen në tri drejtime (Margherita, 2001) si:

- Reduktimi drastik i hapësirave të reja për t’u urbanizuar,
- Përputhshmëria mjedisore dhe ekologjike e sistemeve infrastrukturore
- Aplikimi i parimeve të rigjenerimit ekologjik me të gjitha transformimet urbanistike.

Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” në nenin 1, në kuadrin e qëllimeve përfshin: zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore; vlerësimin e potencialit aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel

kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për: **i) mbrojtjen e burimeve natyrore si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet, etj.** Ndërkohë në kuadrin e parimeve të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, Ligji Nr. 107/2014 parashikon si të tilla, ndër të tjera: zhvillimin e qëndrueshëm me qëllim garantimin e nevojave të brezave për barazi sociale, zhvillim ekonomik dhe **mbrojtje të mjedisit**; harmonizimin me qasjen e Bashkimit Evropian në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, si edhe lidhur me **kriteret mjedisore, ruajtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura.**

Parimi i mbrojtjes së mjedisit nuk mund të kuptohet i shkëputur nga parimi i zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit, i cili nënkupton përmirësimin e mjedisit jetësor. *Kjo nënkupton se është me rëndësi të sigurohet një mjedis i shëndetshëm, i cili mund të jetë i përdoret sot dhe nga brezat e ardhshëm* (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Kosovë, 2006, 6).

Gjithashtu, në një akt ndërkombëtar si Deklarata e Rios (Konferenca e Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin e vitit 1992) pohohet parimi sipas të cilit e drejta për zhvillim duhet të bëhet në një mënyrë që të kënaqë nevojat lidhur me mjedisin dhe zhvillimin e brezave të sotëm dhe të ardhshëm. *Për të paraprirë zhvillimin e qëndrueshëm mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit dhe nuk mund të vlerësohet e ndarë nga kjo* (Rapicavoli, 2010, 1).

Sa më sipër konkludohet se, e drejta e zhvillimit të pronës është në një konflikt potencial me të drejtën e mjedisit. Konflikti mes këtyre dy të drejtave është bërë edhe objekt shqyrtimi nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (GJEDNJ). Neni 1 i Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNJ-së, sikurse e përmendëm më sipër garanton të drejtën e gëzimit të qetë të pronës, por kjo e drejtë nuk është absolute dhe disa kufizime janë të lejueshme. Në këtë kuptim, interesi i përgjithshëm publik në mbrojtjen e mjedisit mund të përbëjë një kufizim të justifikueshëm për autoritetet shtetërore rreth të drejtës individit për zhvillim të pronës së tij. Çdo kufizim në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës duhet të bëhet në interesin e përgjithshëm që mund të jetë mbrojtja e mjedisit. GJEDNJ për këtë pikë ka theksuar se planifikimi rajonal dhe politikat mbrojtëse të mjedisit kur janë mbizotëruese, i japin shtetit një hapësirë vlerësimi më të gjerë sesa kur të drejtat civile ekskluzive të privatëve janë nën vlerësim. Konkretisht, përsa i përket zgjidhjes së konfliktit midis të drejtës së pronës dhe asaj të mjedisit do të parashtrijmë më poshtë disa raste nga praktika e GJEDNJ-së.

Jurisprudenca e GJEDNJ-së

Në rastin *Fredin kundër Suedisë* (1991), GJEDNJ vlerësoi se një kufizim në përdorimin e pronës është i justifikuar sipas paragrafit të dytë të nenit 1 Protokollit Shtesë Nr.1 i Konventës. Kjo çështje kishte të bënte me **revokimin e një licence për shfrytëzim të një gropë zhavorri** të vendosur në tokën e aplikuesit bazuar mbi parashikimet e Aktit Mbrojtës të Natyrës në Suedi. GJEDNJ vlerësoi se heqja e licencës ndërhynte në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës nga ana e aplikuesit. Megjithatë, ajo theksoi se kishte një bazë ligjore referuar Aktit të sipërpërmendur të vitit 1964 dhe i shërben interesit të përgjithshëm në mbrojtjen e mjedisit. **Si rrjedhim neni 1 i Protokollit Shtesë Nr.1 nuk ishte shkelur.**

GJEDNJ në çështjen *Pine Valleys Developments Ltd dhe të tjerë kundër Irlandës* (1991) i referohet anulimit të lejes së ndërtimit prej Gjykatës së Lartë të Dublinit duke e deklaruar të pavlefshme. Aplikuesit, në këtë çështje kishin blerë edhe tokë për të zbatuar lejen e ndërtimit. Në këtë vendim, GJEDNJ vlerësoi se **vendimet e autoriteteve shtetërore përfshiheshin në kuadrin e kontrollit të përdorimit të pronës.** Gjykata vlerësoi se **ndërhyrja kontrolluese e autoriteteve ishte e ligjshme, pasi ishte e bazuar në ligjin kombëtar dhe njëkohësisht qëllimi i saj ishte mbrojtja e mjedisit.** Sipas GJEDNJ, ky qëllim, i ndjekur nga autoritetet shtetërore kur vendosën për anulimin e lejes ishte i ligjshëm dhe njëkohësisht në përputhje me interesin e përgjithshëm. Në rastin *Pine Valleys Developments Ltd dhe të tjerë kundër Irlandës*, ndërhyrja ishte drejtuar për të siguruar zbatimin korrekt të planifikimit dhe legjislacionit mjedisor jo vetëm në çështjen e aplikuesit, por edhe për këdo tjetër që do të ndërtonte në atë zonë. Ndalimi i ndërtimit ishte një mënyrë e përshtatshme, por jo e vetme për t'i shërbyer legjislacionit në fjalë, i cili ishte mbrojtja e brezit të gjelbër. GJEDNJ arriti në përfundimin se anulimi i lejes ndërtimore si masë nuk mund të konsiderohet shpërpjesëtimor me qëllimin e ligjshëm të ruajtjes së mjedisit. **Si rrjedhim, edhe në këtë rast nuk kishte shkelje të**

nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Në çështjen, *Hammer kundër Belgjikës (2007)*, GJEDNJ u përball me rastin e shkatërrimit të një shtëpie pushimi ndërtuar më 1967 nga prindërit e aplikuesit, **por pa një leje ndërtimi**. GJEDNJ, në rastin konkret pranoi se autoritetet shtetërore kishin ndërhyrë në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës sipas nenit 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës. Por, ndërhyrja e realizuar ishte në përpjesëtim me qëllimin e ligjshëm të ndjekur. **GJEDNJ lidhur me përpjesëtimin e masave të ndërmarra, vuri në dukje se mjedisi është një aset mbrojtja e të cilit është një çështje që ngjall interesin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të publikut dhe autoriteteve shtetërore.** Autoritetet shtetërore kanë një përgjegjësi, e cila duhet të rezultojë në praktikë në veprime në kohën e përshtatshme për të siguruar efektivitetin e dispozitave ligjore mbrojtëse të mjedisit. **Sipas GJEDNJ disa të drejta themelore duke përfshirë edhe të drejtën e pronës nuk duhet t'i jepet përparësi mbi mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht kur shteti ka adoptuar legjislacion në lidhje me këtë çështje.** *Kufizimet ndaj të drejtës së pronës mund të lejohen me kushtin e vetëm që të mbahet një baraspeshë e drejtë midis interesave kolektivë dhe individualë në fjalë.* Sipas GJEDNJ, masat e ndërmarra nga autoritetet shtetërore kishin ndjekur **qëllimin e ligjshëm për të mbrojtur një zonë pylli ku ndërtimet ishin të ndaluara.**

Gjithashtu, GJEDNJ edhe në gjykimet *Depalle kundër Francës (2010)* dhe *Brosset-Triboulet dhe të tjerët kundër Francës (2010)*, nënvizon se ndërhyrjet në të drejtën e pronës mund të justifikohen përmes mbrojtjes së mjedisit. Në të dyja çështjet, GJEDNJ nuk gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit të 1 të KEDNJ-së. Të dyja këto çështje i referohen urdhrave kundër aplikuesve për të shkatërruar shtëpitë e tyre, të cilat ishin ndërtuar në bregdet ku nuk ekzistonte një e drejtë formale pronësie ose një drejtë e zënies së përkohshme. Kjo kishte ndodhur vetëm si pasojë e vendimeve të njëpasnjëshme “ad hoc” ku pronarët ishin autorizuar rreth gjysmë shekulli më parë të zinin digën afër bregdetit dhe të ndërtonin aty shtëpi përkohësisht. Por, asnjë prej vendimeve të autoriteteve shtetërore nuk kishte pasur pasojën e njohjes së drejtës së pronësisë mbi pronën publike të shtetit.

Autoritetet shtetërore urdhëruan aplikuesit të rikthenin vendqëndrimin në gjendjen e tij të mëparshme duke shkatërruar ndërtimet e bëra në pronën publike me shpenzimet e tyre dhe pa kompensim. **Vendimet ndaj tyre u morën në kontekstin e zbatimit të një politike aktive për mbrojtjen e mjedisit.** Për shkak se nuk debatohej se qëllimi i ndjekur nga autoritetet ishte i ligjshëm, roli i GJEDNJ ishte të siguronte se një baraspeshë e drejtë ishte siguruar midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit (mbrojtje e mjedisit, akses i lirë ndaj bregdetit) dhe atyre të aplikuesve, që kërkonin të mbanin shtëpitë e tyre. GJEDNJ, në përcaktimin nëse kjo kërkesë plotësohej njohu se shteti gëzon një diskrecion të gjerë në vendimmarrjen e tij, veçanërisht lidhur me planifikimin rajonal dhe politikat e mbrojtjes mjedisore ku interesi i përgjithshëm i komunitetit ishte i madh. **Sipas GJEDNJ, ndërhyrja e realizuar nga autoritetet shtetërore ishte pjesë e zbatimit rigoroz dhe të qëndrueshëm të ligjit referuar përputhshmërisë me planin rregullues dhe rritjes së nevojës për të mbrojtur brigjet detare dhe përdorimin e tyre nga publiku.** GJEDNJ shtoi se mungesa e kompensimit nuk mund të shihej si shpërpjesëtimore, referuar masës së përdorur për realizimin e një interesi të përgjithshëm. Parimi se nuk jepej asnjë kompensim, i cili e kishte origjinën në rregullat qeverisëse të pronës publike, u deklarua në çdo vendim që autorizonte zënien e përkohshme të pronës publike ndaj aplikuesve nëpër dekada.

GJEDNJ në *Valico S.R.L kundër Italisë (2006)* trajtoi rastin e një vendimi të autoriteteve publike që gjobiste një kompani sepse nuk kishte respektuar rregullat e ndërtimit, të cilat ishin parashikuar për të mbrojtur peizazhin dhe mjedisin. GJEDNJ e vlerësoi rastin sipas nenit 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ. Gjithashtu, GJEDNJ vlerësoi se masa ndëshkuese objekt mosmarrëveshje ishte e parashikuar nga ligji dhe ndiqte një qëllim të ligjshëm për të mbrojtur peizazhin dhe zhvilluar pronën në mënyrë të arsyeshme në përputhje me interesin e përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit. GJEDNJ theksoi se baraspesha midis interesit të përgjithshëm dhe nevojës për të mbrojtur të drejtat themelore të aplikuesit të kompanisë ishte siguruar në rastin konkret. Gjykata theksoi se fakti i thjeshtë i dështimit për të respektuar kushtet e kërkuara nga ana e autoriteteve përgjegjëse për planifikimin hapësinor dhe zhvillimin, kishte përbërë një shkelje të rregullimeve ligjore kombëtare që kishin rëndësi. Pra, në rastin konkret kishim shkelje nga ana e aplikuesve edhe pse ndryshimi i vendit të ndërtimit, i pa autorizuar nga autoritetet nuk e kishte dëmtuar mjedisin. Për më tepër,

ndërsa ndëshkimi i vendosur ndaj kompanisë së aplikuesit mund të dukej në pamje të parë i tepërt, **ndryshimi në zbatimin e ndërtimeve kishte ndryshuar thelbësisht planet originale**. Si një projekt me shkallë të gjerë edhe rreptësia e ndëshkimeve duhet të ishte në përputhje me rëndësinë e shkëljes. Gjithashtu vlen të theksohet si rrethanë kyçe se nuk kishte urdhër për të shkatërruar ndërtesat në fjalë nga ana e autoriteteve shtetërore. Për sa mësipërm, GJEDNJ vlerësoi se autoritetet italiane kishin gjetur balancën e drejtë midis interesit të përgjithshëm nga njëra anë dhe respektimit të së drejtave të pronës së të kompanisë aplikuese nga ana tjetër. Në përputhje me rrethanat, GJEDNJ rrëzoi kërkesën e aplikuesit duke vlerësuar se ndërhyrja nuk kishte vendosur një barrë të tepërt sa e bënte shpërpjesëtimore ndaj qëllimit të ligjshëm të ndjekur.

Në një çështje tjetër, *Papastavrou dhe të tjerët kundër Greqisë (2003)* aplikuesit dhe autoritetet shtetërore greke ishin në mosmarrëveshje rreth pronësisë së një ngastrë toke. Me vendimin e prefektit u vendos se zona ku qëndronte mosmarrëveshja mbi ngastrën duhet të ripyllëzohej. Aplikuesit në mënyrë të pasuksesshme kundërshtuan këtë vendim përpara gjykatave kombëtare dhe e sollën çështjen në GJEDNJ. Ata argumentuan se vendimi i prefektit nuk ishte marrë në përputhje me interesin publik duke pretenduar se karakteristikat gjeologjike të asaj zone e bënin të papërshtatshme për ripyllëzim. GJEDNJ vuri në dukje kompleksitetin e çështjes në fjalë dhe faktin që vendimi i prefektit ishte bazuar vetëm në vendimin e Ministrisë të Bujqësisë dhënë rreth 60 vjetëve më parë, pa u bërë një vlerësim i ri i situatës. Gjithashtu, GJEDNJ theksoi se ligji grek nuk garantonte të drejtën e marrjes së një kompensimi. Si rrjedhim, GJEDNJ arriti në përfundimin se autoritetet shtetërore nuk kishin vendosur një baraspeshë të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave të aplikuesit. Si rrjedhim, kishte një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ.

E veçantë paraqitet çështja *Z.A.N.T.E.- Marathonisi A.E kundër Greqisë (2009)* që lidhet me të drejtën e zhvillimit të pronës lidhur me një ishull të vogël, të cilin kompania aplikuese e kishte blerë. Kompania që kishte blerë ishullin Marathonisi dhe do të ndërtonte një kompleks turistik, por u ndal nga autoritetet kompetente me arsyen e ndërtimit morfologjik të truallit dhe bimësisë pyjore. GJEDNJ, në këtë rast theksoi edhe njëherë hapësirën e gjerë të vlerësimit që i njihet shteteve kur zbatojnë politikat e planifikimit hapësinor. GJEDNJ u shpreh se ndërhyrja në të drejtat e pronësisë të kompanisë së aplikuesit i përmbushte kërkesat e të qenit në interesin e përgjithshëm. *Megjithatë, aplikuesi u zhvesh nga e drejta e pronësisë, brenda të cilës përfshihej edhe e drejta e zhvillimit të saj*. Meqenëse, autoritetet kompetente e kishin ndaluar të ndërtonte, ato kishin ndërmarrë masa që e kontrollonin të drejtën e përdorimit të pronës. GJEDNJ vlerësoi se kompanisë aplikuese, i takonte një kompensim referuar humbjeve pasurore që kishte pësuar. Në lidhje me kompensimin, GJEDNJ vlerësoi se autoritetet shtetërore greke kishin argumentuar gabim se ishte e pamundur që ndalimi i ndërtimeve të cenonte të drejtat e mbrojtura të pronësisë, duke qenë se ndërtimi në tokën në fjalë ishte për nga natyra e tokës i pamundur. GJEDNJ, për rrjedhojë theksoi se autoritetet shtetërore kishin zbatuar një prezumim të pakundërshtueshëm që nuk mori parasysh veçoritë e dallueshme të çdo pjese toke të pa përfshira në zonën urbane dhe së bashku me të mungesa e kompensimit përbënin shkak për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ.

Përfundime

E drejta e pronës dhe zhvillimi i saj janë në një konflikt potencial me mbrojtjen e mjedisit. Ky pohim nga ana tjetër nuk mbron faktin që mund të gjendet një ekuilibër i drejtë midis dy të drejtave. Kjo kërkon që politikat e zhvillimit dhe planifikimit hapësinor të marrin parasysh mbrojtjen e mjedisit për sot dhe të ardhmen. Por, e drejta e pronës nuk është një e drejtë absolute, por është subjekt i kufizimeve edhe për një qëllim të ligjshëm siç është edhe mbrojtja e mjedisit. Në çdo rast në realizimin e kufizimeve apo masa të ndërmarra ndaj të drejtës së pronës, përveç qëllimit të ligjshëm duhet të verifikohet edhe nëse është mbajtur një ekuilibër i drejtë midis masave dhe qëllimit të ndjekur. Në këtë pikë duhet theksuar se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i ka njohur autoriteteve shtetërore një diskrecion më të gjerë në problemet e planifikimit dhe zhvillimit të pronës.

Nga rastet e parashtruara më sipër objekt shqyrtimi në GJEDNJ, vihet re se mbrojtja e mjedisit ka përparësi ndaj të drejtës së pronës kur i referohemi:

- Rastit të një shfrytëzimit të pronës private nëpërmjet një leje që bie në kundërshtim me

ligjin mjedisor vendas.

- Rastit të anulimit të një leje ndërtimi dhënë jashtë kompetencave për një kompani, e cila do të ndërtonte në një zonë të planifikuar për zhvillimin e bujqësisë.
- Rastit të ndërtimit pa leje të një shtëpie pushimi në një zonë pyjore ku ndërtimet ishin të ndaluara, pavarësisht kohës së kaluar nga ndërtimi i saj.
- Rastit të shpronësimit të një ngastre toke në një zonë pyjore, por në këmbim të shpërblimit.
- Rastit të zhvillimit të një ishulli, për shkak të ndërtimit morfologjik të tokës dhe bimësisë pyjore, në këmbim të kompensimit.

Gjithashtu, e njëjta mbrojtje mjedisore garantohet dhe merr përparësi ndaj të së drejtës së pronës dhe zhvillimit të saj pranë brigjeve detare, pronë publike.

Bibliografia dhe Literatura

- Silvia Macchi, Il rapporto ambiente/sviluppo nella pianificazione del territorio. http://ëëë.dau.uniroma1.it/cv_docenti/Macchi/Macchi_1993_AISRE.pdf
- D'Itria Margherita, Nuove strategie di programmazione urbanistica. Il caso Benevento, Tesi di Laurea, Università degli Studi di Napoli Federico II, A.A. 2000 – 2001. <http://ëëë.calidone.it/Tesi/DItria/Tesidef.pdf>
- Dott. Carlo Rapicavoli, Il primato dell'ambiente nella pianificazione urbanistica, Responsabilità e tutela – l'attuale assetto delle competenze in materia – le criticità - l'esperienza della Provincia di Treviso. <http://ëëë.diritto.it/docs/30261-il-primato-dell-ambiente-nella-pianificazione-urbanistica-responsabilit-e-tutela-l-attuale-assetto-delle-competenze-in-materia-le-criticita-l-esperienza-della-provincia-di-treviso>
- Alan Boyle, Human Rights or Environmental Rights? A Reassessment. http://ëëë.laë.ed.ac.uk/includes/remote_people_profile/remote_staff_profile?sq_content_src=%2BdXJsPÈh0dHALM0ElMkYIMkZ3d3cyLmxhdY5lZC5hYy51ayUyRmZpbGVfZG93bmxvYÈQIMkZèdÈJsaÈNhdGlvbnMIMkYèXzEyMjFfaHVtYÈ5yaÈdodHNvcmVudmlyb25tZÈ50YÈXyaÈdodHNhcmVhc3Nlcy5èZGYmYÈxsPTE%3D
- Raport mbi gjendjen e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor dhe urban në komunat e Kosovës, Prishtinë, Mars 2006, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përgatitur nga Departamenti i Planifikimit Hapësinor. <http://ëëë.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/MMPH%20raporti%20shq%201.pdf>
- Manual on human rights and the environment, Botim i Këshillit të Europës.
- Konventa e Aarhusit
- Ligji nr. 8890, datë 23.01.2003 “ Për vlerësimin e ndikimit në mjedis , i përditësuar.
- Ligjit Nr. 8934, date 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit .
- Ligji nr. 8890, datë 23.01.2003 “ Për vlerësimin e ndikimit në mjedis .
- Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut
- Vendimi Fredin k. Suedisë (No.1) datë 18 shkurt 1991 i GJEDNJ, aplikimi nr.12033/86.
- Vendimi Pine Valleys Developments Ltd dhe të tjerët k. Irlandës, datë 29 Nëntor 1991 i GJEDNJ, aplikimi nr. 12742/87.
- Vendimi Hamer k. Belgjikës, datë 27 nëntor 2007 i GJEDNJ, aplikimi nr.21861/03.
- Vendimi Depalle k. Francës, 29 Mars 2010 i GJEDNJ, aplikimi nr. 34044/02.
- Vendimi Brosset-Triboulet dhe të tjerët k. Francës, datë 29 Mars 2010 i GJEDNJ, aplikim nr.34078/02.
- Vendimi Valico S.R.L k. Italisë i datës 21 Mars 2006 i GJEDNJ , aplikimi nr. 70074/01.
- Vendimi Papastavrou dhe të tjerët k. Greqisë, datë 10 Prill 2003 i GJEDNJ, aplikimi nr.46372/99.
- Vendimi Z.A.N.T.E.- Marathonisi A.E k. Greqisë datë 28 Maj 2009, aplikimi nr.14216/03.

Depolitizimi i administratës shtetësore në Republikën e Kosovës 2014

Msc.Besard Belegu, PhD candidate

Ligjërues i rregullt në Fakultetin Juridik të Universitetit AAB në Prishtinë

Abstrakt

Depolitizimi i administratës shtetërore është një sfidë bashkohore e shoqërive demokratike, e veçmas vendeve në forcim e sipër të demokracive të tyre. Edhe shoqëria kosovare po ballafaqohet me këtë sfidë në kuadër të reformimit të administratës. Administrata shtetërore në kohën aktuale duhet në vazhdimsi ti realizoj tendencat bashkohore për rritjen dhe diferencimin e saj, për profesionalizmin e saj dhe për zvoglimin e forcës dhe participimin më të madh të qytetarit në qeverisje. Andaj në kuadër të këtyre tendencave bashkohore të njohura për të drejtën administrative, ndihet nevoja edhe për depolitizimin e administratës shtetërore dhe profesionalizmin e saj, paanshmërinë e saj. Ky punim do të synoj të trajtojë argumentet e pranueshmërisë së politizimit të administratës shtetërore në Republikën e Kosovës qoftë nga aktet ligjore, qoftë nga praktikat institucionale, dhe ofrimin e ideve apo alternativave të mundshme për reduktimin e politizimit të administratës apo luftimin e kësaj dukurie negative për shoqërinë bashkohore demokratike. Përveç këtyre, punimi do të synojë të trajtojë edhe kulturën politike të udhheqjes me administratën shtetërore nga krerët e nivelit qendror dhe lokal, si dhe vetdijen e qytetarëve mbi rolin dhe punën e administratës shtetërore, dhe të drejtat dhe obligimet në raport të ndërsjellt me organet e administratës shtetërore. Ky punim shpresoj që jetë pikënisje për punë të vazhdueshme edhe nga studiuesit e tjer potencial, dhe që të hap shtigjet e reja hulumtuese për të trajtuar këtë dukuri negative në mënyrë sa më profesionale dhe efikase në shoqërinë kosovare në shtetin me të ri të botës, Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: Depolitizimi, profesionalizmi, paanshmëria, kultura politike dhe praktika institucionale.

1. Njoftime themelore

Në vendet me demokraci të brishtë, të mendosh se mund të arrihet në tërësi depolitizimi i administratës shtetërore, do të ishte një mendim i gabuar. Së paku jo pa u zhvilluar një reformim i tërësishëm i administratës, e kjo do të na ipte sinjalin që nuk mund të ndodhë mbrenda një kohe të shkurtër, pasi që reforma është proces i ngadalësuar i ndryshimeve që nuk mund të vërehen lehtësisht nga syri i njeriut të rëndomt. Kjo, për arsye se depolitizimi i administratës shtetërore nuk mund të jetë një proces statik ku vie një moment që t'i vihet pikë, por është një proces apo përpjekje e vazhdueshme, pra është një proces dinamik dhe permanent.

Kur jemi të rëndësia e Administratës shtetërore të depolitizuar, demilitarizuar, meritore profesionalisht dhe të paanshme, mund të nxjerrim shumë ide dhe hipoteza për të nënkuptuar një Shtet të fortë dhe efikas edhe si shërbim publik për qytetarët e atij Shteti. Figura më e shquar e teorisë së administratës, i cili i pari specifikoi ndarjen e administratës nga politika, ishte ish-Presidenti amerikan Woodrow Wilson i cili në veprën e tij "Studime mbi administratën" të vitit 1887, ka theksuar se administrata duhet të jetë e ndarë nga politika dhe e kthyer kah qytetari. Kjo teori e tij shërben edhe në ndërtimin e parimit të funksionimit të organeve të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës¹.

Me të drejtë ekziston ajo bindja që "prapa një Shteti të fortë qëndron administrata efikase". Këtë shprehje mundemi t'a arsyetojmë dhe t'a forcojmë si bindje, nga ana e aspektit shkencor, teorik, ku sipas autorit Esat Stavilecit dallimi në mes të punës qeverisëse dhe asaj administrative qëndron në atë që, puna administrative në esencë ka të bëjë me organizimin drejt realizimit të politikës publike, ndërsa puna qeverisëse përveç tjerash, përcakton politikën publike.

Pa dyshim se ashtu siç e përmendim një grup teoricientesh të së drejtës kushtetuese, depolitizimi i administratës shtetërore është njëra ndër elementet e shtetit ligjor të cilat janë; ndarja e pushteteve,

¹Vendet të cilat janë marrë në analizë në këtë punim janë vende që i përkasin Europës Juglindore: Shqipëria, Maqedoni, Mal i Zi, Kosova, Kroaci, Bosnja & Hercegovina dhe Serbi.

parimi i kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, gjyqësori i pavararur, barazia para ligjit dhe parimi i mosdiskriminimit, liritë dhe të drejtat themelore të qytetarit, mbrojtja e pronës dhe pasurisë së qytetarit, shoqëria civile, etj.

2. Baza kushtetuese dhe ligjore për depolitizimin e administratës shtetërore në Republikën e Kosovës

Baza kushtetuese dhe ligjore e shtetit ligjor gjithnjë aludon në paanshmërinë dhe profesionalizimin e administratës shtetërore, siç i njohim parimet që i proklamonte Kushtetuta të cilat shërbëjnë si bazament për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore, siç janë; parimi i kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, i barazisë para ligjit, etj.

Në Republikën e Kosovës ekziston baza juridike që nënkupton në depolitizimin, demilitarizimin e administratës shtetërore, dhe që thërret në paanshmërinë dhe profesionalizimin e administratës shtetërore dhe asaj publike, si profesione meritore në administratën shtetërore, në rekrutim të punonjësve të administratës në bazë të kritereve burokratike (teknike dhe profesionale) juridike.

Organet e Administratës Shtetërore i themelon Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me ligjin. Administrata Shtetërore në punën e saj, në suaza të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, është transparente, profesionale, efikase dhe efektive, e pavarur dhe e paanshme. Organet e Administratës Shtetërore, në përputhje me aktin e themelimit, kanë statusin e personit juridik². Pra, sipas Ligjit mbi Administratë Shtetërore të Republikës së Kosovës organet e Administratës Shtetërore themelohen në bazë të ligjit, dhe me akte themeluese të tyre marrin statusin e personit juridik, që nënkuptojnë organe të themeluara në mënyrë ligjore dhe burokratike, e kurrsesi demokratike.

Ligji në fjalë, në mënyrë shprehimore ndalon politizimin e organeve të administratës shtetërore, duke cituar se ndalohet çfardo forme e manifestimit, organizimit dhe veprimit të aktiviteteve politike ose të animit apo favorizimeve në baza politike të punonjësve të administratës.³ Më saktësisht, neni 18 i Ligjit në fjalë proklamonte parimin që struktura organizative e administratës shtetërore të Kosovës, siguron që mes tjerash, administrata të veprojë në mënyrë të paanshme, apolitike dhe e orientuar nga qytetarët.

Me këtu nuk përfundon baza ligjore e depolitizimit të administratës shtetërore në Kosovë. Sipas Ligjit mbi vetqeverisjen lokale të Republikës së Kosovës të vitit 2008, zgjedhjet për kuvendin e komunës nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesve civil⁴. Një dukuri që vlen të theksohet tek administrata shtetërore komunale në Republikën e Kosovës është çështja e emërimit dhe e shkarkimit të drejtorëve. Sipas ligjit në fjalë, administrata komunale organizohet në drejtorate dhe drejtorët komunal emërohen dhe shkarkohen nga kryetari i komunës⁵. Siç e shohim, zgjedhja e drejtorit është në kompetencë ekskluzive e kryetarit pa kaluar në asnjë procedurë formale dhe kriteresh burokratike pasi që një gjë e tillë nuk është e paraparë me ligj. Kjo situatë sjellë mundësinë e emërimit të drejtorëve nga militantët partiak apo të emërimit të njerëzve jo të shquar profesionalisht për t'a menaxhuar drejtorinë përkatëse komunale.

Në Kosovë është bërë traditë emërimi i drejtorëve komunal nga rradhët e partisë politike të kryetarit të zgjedhur. Shembullin aktual e kemi tek Komuna e Prishtinës, ku me ardhjen në pushtet të partisë politike "Vetvendosje" pjesa më e madhe e drejtorive janë emëruar drejtorë aktivistë partiak, siç janë; drejtorja e urbanizimit, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit, drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, drejtorja e infrastruktures lokale, drejtorja e inspektionit dhe drejtorja për arsim⁶. Për mendimin tim, edhe pse e kanë këtë mundësi kryetarët e komunave në Kosovë, duhet të jenë më të ndergjegjshëm dhe t'i thonë "JO" drejtorive militariste. Hiç më mire nuk qëndron as administrata qendrore dhe ato komunale të qyteteve të tjera në zona të ndryshme të Kosovës.

Në vendet me sistem parlamentar administrata shtetërore është e prirur të jetë me e politizuar, për

² Shih nenin 18 të Ligjit mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës i vitit 2010.

³ Ligji mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës i vitit 2010, neni 8 paragrafi 1, neni 9 dhe neni 10 paragrafi 1.

⁴ Po aty, neni 12.

⁵ Ligji mbi vetqeverisjen lokale të Republikës së Kosovës i vitit 2008, neni 65 paragrafi 3.

⁶ Po aty, neni 66 paragrafi 1.

faktin se kur bëhet fjalë për kontrollin e punës së administratës, nga kontrolli parlamentar, kontrolli politik i punës së organeve të administratës është më i zbehtë, për arsye se ka ndikim të drejtpërdrejt Kryeministri i Shtetit, ngase barra e përgjegjesisë kolektive të administratës shtetërore e prek esencialisht edhe atë.

Ndërkaq, sipas autorit Agur Sokolit në veprën e tij “Kontrolli i punës së administratës dhe përgjegjësia e saj politike” kontrolli parlamentar i administratës funksionon më mirë në sistemin presidencial sepse ai mendon që në sistem presidencial përgjegjësia e qeverisë para parlamentit nuk ekziston. Autori në fjalë e arsyeton këtë mendim me kontrollin politik të administratës në SHBA, ku kongresi amerikan është mjaftë efektiv në kontrollin e drejtëpërdrejt ndaj organeve të administratës shtetërore, veçanërisht, në rradhë të pare me të drejtat buxhetore ku kongresi mund t’ua refuzojë mjetet buxhetore organeve të administratës, pastaj kongresi mund të zbatojë anketa nëpërmjet komisioneve të veçanta në fusha të caktuara administrative. Dhe krejt në fund, kontrollin politik efikas ndaj organeve të administratës e arsyeton edhe me të drejtën e Senatit të Kongresit amerikan që të ngrisë “impeachmentin” kundër funksionarëve civilë të administratës amerikane për çështjet e korrupsionit, tradhtisë etj.

3. Definimi i problematikës së shtruar

Nuk mund t’a gjejmë një definicion statik dhe përfundimtar rreth këtij problemi social nga i cili derivojnë një mori çështjesh negative të ndërlidhur me problemin fillestar të shtruar, me “POLITIZIMIN” e administratës shtetërore. Me të drejtë mund t’a etiketojmë politizimin e administratës shtetërore si metaproblem. Depolitizimi i Administratës është një çështje aktuale e shoqërisë kosovare, që fillet e saja i ka qysh në pasluftën që nga viti 2000 e këndejmë. Kësisoj, debatet nuk kanë munguar në institucionet edukuese arsimore, në organizatat joqeveritare e në përgjithësi në shoqërinë kosovare.

Si rezultat i kësaj, në vazhdim do të marrim për të analizuar anketimin e qytetarëve rreth besueshmërisë së tyre ndaj administratës shtetërore, se a është administrata shtetërore e Kosovës e politizuar, a ofronë shërbime të paanshme, a është profesionale dhe efikase. Kampionin e kemi zgjedhur në tre qytetet që bëjnë pjesë në tre zona apo rajone të Kosovës, qytetin e Gjakovës që bënë pjesë në rrafshin e Dukagjinit, qytetin e Ferizajit një skaj tjetër i Kosovës kah zona e anamoravës dhe kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, ku qytetarët e këtyre vendeve janë anketuar për të vlersuar besueshmërinë e tyre ndaj administratave komunale të vendeve të tyre.

Në komunën e Prishtinës qytetarët të cilët u deklaruan në anketë, rreth 71% e tyre besojnë që administrata komunale është e politizuar, ku nga këta të cilët besojnë një gjë të tillë 55% prej tyre besojnë bindshëm që administrata komunale në Prishtinë është e politizuar, ndërsa 45% prej tyre besojnë pjesërisht që administrata komunale është e politizuar.

Edhe në komunën e Ferizajit kemi shkallë të lartë të mosbesueshmërisë së qytetarëve ndaj administratës komunale të këtij qyteti, ku 65% e të anketuarëve besojnë që administrata komunale është e politizuar, e nga këta 77% prej tyre besojnë plotësisht në politizimin e administratës.

Në komunën e Gjakovës qytetarët besojnë më shumë në administratën e depolitizuar në krahasim me dy vendet e lartpërmendura. 53% prej tyre besojnë që administrata komunale e qytetit nuk është e politizuar dhe 48% nga ata 47% që besojnë që administrata është e politizuar, besojnë vetëm pjesërisht.

Ekspertët të cilët mendojnë se si të depolitizohet administrata në Kosovës siduket ende nuk kanë arritur një strategji konkrete, ngase është metaproblem që kërkon trajtim të shumë anshëm të administratës deri tek konkretizimi në ofrimin e zgjidhjes së këtij problemi, si një sfidë bashkohore e Shtetit dhe qytetarëve të saj.

4. Ofrimi i politikës publike që zgjedh problemin e parashtruar

Për të arritur deri tek caku në këtë problematikë të shtruar, është e sigurt që nevojitet për një politikë më gjithëpërfshirëse, angazhimi i një numri më të madh i ekspertëve të analizave dhe hartimeve të politikave publike, dhe një vullnet i lartë i pushtetit ekzekutiv centralist, në mënyrë që të ofrojnë

një strategji konkrete që e sfidon politizimin e administratës në kuptim të reduktimit të saj, ose të eliminimit në tërësi të saj. Ofrimi i zgjidhjeve të mundshme duke marr parasysh edhe aktualitetin në vendet perendimore me demokraci të zhvilluar, do të ishin disa nga këto:

- Vetdijsimi i qytetarëve me broshura e fletushka mbi rolin dhe punën e administratës komunale dhe mbi të drejtat që kanë ata në raport me administratën komunale;
- Publikimi i rezultateve të arritura njëvjeçare të komunës duke filluar nga buxheti e deri tek vendimet më me rëndësi;
- Vetdijsimi publik i kryetarëve komunal që të kenë moral më të lart politik në mosemërimin militarist të drejtorëve të drejtorive komunale, ose kriterizimi ligjor për postet e drejtorëve në drejtorit komunale zgjedhja e tyre sipas një tërësie kriteresh profesionale duke u rekomanduar nga komisionet e veçanta tek kryetari i Komunës ;
- Iniciativa nga pushteti legjislativ i vendit për emërimin e komisionerëve profesionist si komisione të përhershme për kontrollin e punës së administratës, poashtu edhe komisionet të ekzistojnë në nivel komunal.

Këto janë qëllimet e politikës për ofrimin e mundsive për zgjidhje të mundshme të problematikës së shtruar, por konkludoj edhe në atë që nuk mjafton vetëm të kërkojmë formalizime procedurale për të qenë efikas ndaj kësaj sfide, por që shoqëria civile kosovare (OJQ-të) të jetë më kreative në participim të qytetarit në qeverisje lokale.

5. Pritëshmëritë e politikës së zbatuar

Nga zbatimi i politikës së zbatuar pritet të:

- Aktualizohet çështja e krijimit të një praktike të re institucionale drejt krijimit të një tradite të mirë emërimeve drejtorëve komunal jomilitarist;
- Reduktimi i politizimit të administratës shtetërore në masë të madhe deri tek ç'rrenjosja e saj në tërësi;
- Përbërja e administratave komunale të jetë profesionale dhe e paanshme në shërbim për qytetarët;
- Krijimi i komisioneve të përhershme parlamentare në nivel të Kuvendit të Kosovës dhe kuvendeve komunale që hulumtojnë dhe anketojnë vazhdimisht oportunitetin e punës së organeve të administratës shtetërore dhe demilitarizimin e saj;
- Krijimi i konotacionit pozitiv të administratës shtetërore dhe rritja e besimit të qytetarëve ndaj organeve të administratës shtetërore.

Literatura :

Agur Sokoli, *Kontrolli i punës së administratës dhe përgjegjësia politike e saj*, Prishtinë 2014
Esat Stavileci, *Hyrje në shkencat administrative*, Prishtinë 2004
Jonuz Abdullai, *Politika dhe politikat publike*, Tetovë 2011
Woodrow Wilson, *Studime mbi administratën*, SHBA 1887

Akte ligjore :

Ligji mbi administratën shtetërore i Republikës së Kosovës
Ligji mbi procedurën administrative i Republikës së Kosovës
Ligji mbi shërbimin civil i Republikës së Kosovës
Ligji mbi vetqeverisjen lokale i Republikës së Kosovës

Burime nga interneti :

<https://kk.rks-gov.net/prishtina/Home.aspx>, 16.11.2014.

SHTOJCA

**Pyetësori mund të plotësohet nga të gjithë qytetarët
(Ju lutemi klikojeni njëren nga përgjigjet)**

Gjinia	M	F
--------	---	---

Mosha	0-16	17-20	30-45	45-50	Mbi 50
-------	------	-------	-------	-------	--------

o **Vendi : Prishtinë**

Me cilën nga deklaratat e mëposhtme pajtoheni ?	
1. Administrata shtetërore komunale (drejtoritë komunale) në qytetin tuaj është e politizuar.	Pajtohem pjesërisht Pajtohem Pajtohem plotësisht Nuk pajtohem
2. Administrata shtetërore komunale në qytetin tuaj ofronë shërbime të paanshme.	Pajtohem pjesërisht Pajtohem Pajtohem plotësisht Nuk pajtohem
3. Administrata shtetërore komunale në qytetin tuaj është profesionale.	Pajtohem pjesërisht Pajtohem Pajtohem plotësisht Nuk pajtohem
4. Administrata shtetërore komunale në qytetin tuaj është efektive dhe efikase.	Pajtohem pjesërisht Pajtohem Pajtohem plotësisht Nuk pajtohem
5. Në qytetin tuaj komuna është e korruptuar	Pajtohem pjesërisht Pajtohem Pajtohem plotësisht Nuk pajtohem
6. Në komunën e qytetit tuaj ka nepotizëm (të punësuar në komunë nga rrethi familjarë)	Pajtohem pjesërisht Pajtohem Pajtohem plotësisht Nuk pajtohem

Mosha për përgjegjësi penale dhe dënimi me burgim i të miturve në Shqipëri në periudhën kohore 2006-2012

Msc. Edvin Bica
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Të studiosh dhe të analizosh sistemin e drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri has në shumë vështirësi, pasi ka një sërë komponentësh që funksionojnë sëbashku sic janë temat që kanë të bëjnë me ligjin dhe standardet e tij, me strukturat, institucionet përgjegjëse, niveli i aftësive, përgjegjshmëria e tyre, burimet njerëzore etj. Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri mund të jetë më tepër i rëndë nga ana shoqërore, ku mund të dëmtojë cilësinë e jetës në vazhdim, sesa e parë në kuadrin ligjor. Studimi i kryer analizon moshën për përgjegjësi penale dhe dënimin me burgim të të miturve si dhe zhvillimin e sistemit të drejtësisë për të miturit në Shqipëri kronologjikisht që prej periudhës komuniste, e deri në periudhën aktuale, duke marrë në konsideratë kryesisht politikën, praktikën dhe kuadrin ligjor. Ky studim gjithashtu analizon arritjet dhe problemet e sistemit të drejtësisë për të mitur në Shqipëri, në kuadër të zbatimit të strategjisë kombëtare për fëmijët në përafrim me konventat, udhëzimet dhe rekomandimet ndërkombëtare. Studimi shqyrtohet përmes situatës së dënimeve të të miturve në Shqipëri, fakteve dhe shifrave, nivelit arsimor dhe kulturor, si dhe nga faktorët të tjerë që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve. Në studim paraqiten edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) për të dënuar të miturit në Shqipëri, sic është IEVP Jordan Misja në Tiranë, IEVP Korçë, IEVP Lezhë e Vlorë. Së fundmi studimi mbyllet me disa rekomandime për përmirësimin e drejtësisë për të miturit, krijimin e një kuadri ligjor specifik të drejtësisë për të miturit në Shqipëri, si dhe zbatimin e programeve konkrete parandaluese dhe riintegruese.

Fjalët kyce (key words): vepër penale për të mitur, përgjegjësi penale, krim, kundërvajtje penale.

Hyrje

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme të politikave shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Në themel të këtyre politikave janë parimet themelore të kushtetutës, të konventave të OKB-së dhe instrumentëve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Një vëmendje e veçantë në këtë kuadër është treguar ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme sistemin e drejtësisë për të miturit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Metodologjia

Metoda e përdorur në kryerjen e këtij studimi është ajo cilësore. Rasti studimor është Shqipëria. Si lloje të metodës cilësore të përdorura në këtë studim janë: *analiza e përmbajtjes* (legjislaclionit përkatës, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale), si dhe ajo *historiko-arkivore*. Studimi i përket periudhës kohore 2006-2012.

Zhvillimi historik në Shqipëri për moshën e përgjegjësisë penale

Në periudhën deri në fund të vitit 1944, kur në Shqipëri u vendos qeveria komuniste, legjislaclioni penal në përgjithësi ka qenë i orientuar drejt vendeve që kishin ndikim mbi vendin tonë. Konkretisht në vitet '20, kanë qenë në zbatim ligjet penale të Turqisë, për vetë rrethanat historike të kohës, ku vendi ynë ishte pjesë e Perandorisë Otomane, deri në vitin 1912.

Me shpalljen e Republikës në vitin 1925 me President Ahmet Zogun dhe në vitin 1928 me vendosjen

e monarkisë, legjislacioni penal u orientua drejt vendeve të Evropës Perëndimore. Në kodin penal të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928, ndjekja penale parashikohej mbi 10 vjeç, por nëqoftëse faji i kryer dënohej me vdekje, burgim të përjetshëm, burgim të rëndë ose me burgim jo më pak se një vit, gjykata me kërkesë të prokurorit mund të urdhëronte vendosjen e fajtorit në një institut edukimi dhe përmirësimi, nëse ekzistonin të tilla. Në rregulloren e burgjeve të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në 18 shtator 1933, parashikohej mbajta e të rinjve deri në moshën 21 vjeç në dhoma të ndara nga të rriturit, si dhe vendosja e tyre në burgjet e prefekturave, edhe nëse ishin dënuar më pak se një vit. Po kështu parashikoheshin përparësi në arsimimin dhe trajnimin e tyre.

Në periudhën 1945-1990 legjislacioni penal në përgjithësi drejtohej kah vendeve komuniste dhe kryesisht drejt ish Bashkimit Sovjetik. Kjo deklarohet qartazi nga ish udhëheqës të qeverisë komuniste që e konsideronin atë vend si i vetmi model i zhvillimit dhe qeverisjes. Në kodin penal të 1952 (ribotim) më 1959 në nenin 6, parashikohej mosha për përgjegjësi penale. Ka përgjegjësi penale personi që ka kryer krimin dhe ka mbushur moshën 14 vjeç. Kundër personit që për shkak të moshës nuk ka përgjegjësi penale mund të merren masa edukonjëse. Në masa edukonjëse parashikohej:

- Dorëzimi i të miturit në kujdestarinë e prindërve, të adoptuesve, të kujdestarëve, të të afërmve, nëqoftëse këta kanë mundësi ta mbajnë, ose nën kujdesin e personave të tjerë ose të institucioneve;

- Mbyllja në një institucion të posaçëm edukimi dhe mjekimi; Kodi penal parashikon rastet e përjashtimit të të miturve nga dënimi penal dhe ndalonte dënimim me vdekje për personat në moshën 18 vjeç.

Këto dispozita janë ruajtur të njëjta dhe në kodin penal të vitit 1977, i cili është miratuar sipas kushtetutës të vitit 1976, por ka disa ndryshime të vogla të cilat pasqyrojnë situatën politike dhe ideologjike në të cilën ndodhej sistemi. Kështu tek masat edukuese që mund të zbatoheshin ndaj të miturve parashikohej:

- Vënia e të miturit në një institucion edukimi;

- Lënia e personit për edukim kolektivit dhe organizatave shoqërore.

Në vitin 1957 deri në vitin 1969, në Shqipëri ka funksionuar një qendër për të miturit e cila emërtohej "Kolonja e edukimit".

Ndryshimet gjatë periudhës post-komuniste

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin 8417, datë 21.10.1998, të ndryshuar, botuar në fletoren zyrtare, viti 1998, nr. 28 (i ndryshuar), ka parashikuar dispozita të veçanta në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve. Gjithashtu Republika e Shqipërisë ka ratifikuar ose aderuar në konventat ndërkombëtare sic janë:

- Konventat e Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e fëmijëve", miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 20 nëntor 1989, ratifikuar me datë 27.02.1992.

- Konventa Europiane "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore", ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

- Konventa e Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8624, datë 15.06.2000, botuar në fletoren zyrtare, viti 2000, nr. 18, faqe 872.

- Konventa nr. 182 "Për format më të këqija të punës së fëmijëve" dhe rekomandimi nr. 190 "Për format më të këqija të punës së fëmijëve", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8774, datë 23.04.2001, botuar në fletoren zyrtare, viti 2001, nr. 23, faqe 708.

- Karta Social Europiane e ndryshuar, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002, botuar në fletoren zyrtare, viti 2002, nr. 75, faqe 2087.

- Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj: Protokollin e Palermos, i vitit 2000 "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanarisht të femrave dhe fëmijëve", në plotësim të konventës së OKB-së "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin

nr. 8920 datë 11.07.2002, botuar në fletoren zyrtare, viti 2002, nr. 41, faqe 1195.

- Konventa Europiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9259, datë 24.03.2005, botuar në fletoren zyrtare, viti 2005, nr. 28, faqe 1063.
- Konventa e Hagës “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005, botuar në fletoren zyrtare, viti 2005, nr. 97, faqe 3096.
- Konventa e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005, botuar në fletoren zyrtare, viti 2005, nr. 96, faqe 3067.
- Protokolli opsional i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve, mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007, botuar në fletoren zyrtare, viti 2007, nr. 165, faqe 4933.
- Protokolli opsional i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, “Për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007, botuar në fletoren zyrtare, viti 2007, nr. 165, faqe 4929.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 10071, datë 09.02.2009, botuar në fletoren zyrtare, viti 2009, nr. 21, faqe 1353.
- Konventa e Këshillit të Europës, ”Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, botuar në fletoren zyrtare, viti 2006, nr. 132, faqe 5169.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimat të trafikimit”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006, botuar në fletoren zyrtare, viti 2006, nr. 63, faqe 1731.

Institucionet që mbikqyrin drejtpërsëdrejti dhe vleresojnë mënyrën e realizimit të të drejtave të fëmijëve sipas programeve të mirëqënies shoqërore (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje shoqërore) janë:

- Komiteti ndërministror për të drejtat e njeriut
- Sekretariati teknik për fëmijët (STF)
- Institucionet e nivelit qendror
- Strukturat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.

Kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë për moshën për përgjegjësi penale dhe dënimin e të miturve janë në dispozitat e kodit penal dhe kodit të procedurës penale, të cilat kanë të parashikuar një sërë rregullash, lidhur me moshën për përgjegjësi penale; për caktimin e masës shtrënguese ndaj të miturit që akuzohet për kryerjen e një veprë penale kundërvajtje apo për kryerjen e një krimi, për gjykimin e të miturve, për ndihmën që i jepet të miturit gjatë procedimit penal, për llojin dhe masën e dënimit apo për rastet e përjashtimit nga dënimi i të miturve që kanë kryer veprën penale, qoftë krim apo kundërvajtje.

Kodi Penal

Kodi penal ka parashikur në nenin 12 të tij moshën për përgjegjësi penale ne rastet e kryerjes së një krimi dhe ne rastet e kryerjes së kundërvajtjes penale:

- Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç;
- Personi që kryen kundërvajtje penale ka përgjegjësi penale kur ka mbushur moshën gjashtëmëdhjetë vjeç.

Lidhur me dënimin, llojin e dënimit dhe mënyrën e vuajtjes së dënimit për të miturit, Kodi Penal garanton se:

- Së pari, dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç (neni 31);
- Së dyti, të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta ng atë rriturit (neni

33);

- Së treti, dënimi i të miturve, nëpërmjet masave edukuese, të cilat mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Kjo kryhet nëpërmjet vendosjes së të miturit në një institucion edukimi (neni 46);

- Së katërti, të miturit, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer (neni 51). Aktualisht, gjykatat shqiptare e aplikojnë nenin 51 në të gjitha rastet kur personat që gjykohen janë nën moshën 18 vjeç;

- Së pesti, të miturit, mund të përjashtohen nga dënimi. Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit mund të aplikojë nenin 52 të Kodit Penal, i cili e parashikon përjashtimin e të miturit nga dënimi. Në këto raste gjykata vendos dërgimin e të miturit në një institucion edukimi. Aktualisht, gjykatat në vlerësimin e provave, rrethanave, fakteve dhe nisur nga rrezikshmëria e vogël e veprës penale, për të cilën është akuzuar i pandehuri i mitur, nga sjellja e mëparshme e të miturit aplikojnë nenin 52 të Kodit Penal.

Lidhur me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale:

Në nenin 31 të tij janë përcaktuar gjykatat penale të shkallës së parë dhe përberja e tyre. Sipas këtij neni, gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rrethëve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit.

Në nenin 35 është parashikuar ndihma që i jepet të pandehurit të mitur. Kështu, të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin 1, vetëm kur një gjë e tillë është në interesin e të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit.

Verifikimi i moshës së të pandehurit jepet në nenin 41 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit në çdo gjendje dhe shkallë procedimi, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedurës bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin. Kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur.

Ndërsa verifikimet për personalitetin e të pandehurit të mitur përcaktohen në nenin 42 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit:

- Organi procedues merr të dhëna për kushtet e jetesës, familjare dhe shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit, si dhe të caktojë masa të përshtatshme penale.

- Organi procedurës mbledh informacione nga personat që kanë patur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve.

Neni 49 i Kodit Penal garanton mbrojtës të caktuar në rastet kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.

Lidhur me procedurën e gjykimit, për sa i përket kompetencës së gjykatës që do të gjykojë çështjen penale në nenin 81 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar qartë kufijtë e bashkimit në rastin e veprave penale të kryera nga të miturit, e konkretisht në dy raste:

- Kur disa nga procedimet e lidhura ndërmjet tyre i përkasin kompetencës së gjykatës së zakonshme dhe të tjerat gjykatave që shqyrtojnë çështjet me të mitur, kompetencë për të gjitha procedimet është kjo e fundit, përveç rasteve kur gjykata çmon se ato duhen veçuar.

- Kur i pandehuri në kohën e gjykimit është madhor, por një ose disa vepra i ka kryer kur ka qenë i mitur, çështja gjykohet nga gjykata që shqyrton çështjet me të mitur.

Një rëndësi, Kodi i Procedurës Penale i ka kushtuar edhe faktit të ndalimit të publikimit të gjeneraliteteve dhe fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të

dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkon interesi i të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç (neni 103 i Kodit të Procedurës Penale). Po kështu, nuk mund të jenë dëshmitarë për të vërtetuar përmbajtjen e një akti procedural të miturit deri katërmbëdhjetë vjeç (neni 108 i Kodit të Procedurës Penale).

Ligjvënësi nëpërmjet dizpozitave të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me arrestimin, ndalimin, apo dhe me vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj të miturve ka përcaktuar rregulla ndryshe nga rastet kur arrestimi dhe ndalimi ndaj personave madhore që kanë kryer vepra penale.

Neni 230 Kodi i Procedurës Penale “Kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg”, në pikën 4 të tij parashikon se të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale. Ndërsa neni 255 i Kodi i Procedurës Penale “Detyrat e policisë gjyqësore në rastet e arrestimit ose ndalimit”, në pikën 3 dhe në pikën 4 të tij parashikon se:

- Kur i arrestuari ose i ndaluar është i sëmurë ose i mitur, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të ruajtur;
- Policia gjyqësore, me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët. Kur i arrestuari ose i ndaluar është i mitur lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari.

Raste të gjykimit me autor të kryerjes së veprave penale për të mitur:

Referuar të dhënave statistikore të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë më poshtë janë pasqyruar të dhënat për kriminalitetin e të miturve në Republikën e Shqipërisë, si vijon:

Të dhënat statistikore për kriminalitetin e të miturit, krahsuar me vitet 2006, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, pasqyrojnë një rritje të theksuar të fenomenit (Tabela 1).

Të dënuar të mitur gjatë vitit 2012 janë 883, nga të cilët 826 të dënuar për krime dhe 57 të dënuar për kundërvajtje penale. Nga këto kategori të dënuarish, në vitin 2006 ishin 268 (238 për krime dhe 30 për kundërvajtje penale), në vitin 2007 ishin 211 (198 për krime dhe 13 për kundërvajtje penale), në vitin 2008 ishin 407 (356 për krime, 51 për kundërvajtje), në vitin 2009 ishin 411 (362 për krime, 49 për kundërvajtje), në vitin 2010 ishin 656 (594 për krime, 62 për kundërvajtje) dhe në vitin 2011 ishin 683 (610 për krime dhe 73 për kundërvajtje penale).

Veçori është se edhe këtë vit 94% e të dënuarve të mitur janë për krime. E parë nga ana tabelare mund të thuhet se në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011, numri i të dënuarve për krime ka pësuar një rritje prej 216 të dënuarish. Duke pasur parasysh raportin e numrit total të të dënuarve të mitur (883 të dënuar) me numrin e të dënuarve të mitur për krime (826 të dënuar) për vitin 2012, në krahasim me raportin e numrit total të të dënuarve të mitur (683 të dënuar) me numrin e të dënuarve të mitur për krime (610 të dënuar) në vitin 2011, arrihet në përfundimin se numri i të dënuarve për krime ka pësuar rritje (nga 89% në vitin 2011 në 94% në vitin 2012). Përsa i përket kundërvajtjeve penale krahsuar po me këtë vit, numri i të dënuarve është në zbritje. Duke krahasur këtë me të dënuarit në shkallë vendi (8679), të dënuarit e mitur janë 10% e tyre.

Tabela 1: Të dhënat statistikore për kriminalitetin e të miturve

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Për Krime	238	198	356	362	594	610	826
Për Kundërvajtje	30	13	51	49	62	73	57
Totali	268	211	407	411	656	683	883

Grafiku 1: Numri i të dënuarve të mitur për krime dhe kundërvajtje nga viti 2006-2012

Janë bërë objekt i monitorimit dy prej gjykatave, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Institucione të ekzekutimit të vendimeve penale për të dënuar të mitur:

Në baze të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (i ndryshuar), Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka në varësi institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, ku përfshihen paraburgimet dhe institucionet e vuajtjes së dënimit. Në nenin 17 të po këtij ligji, bëhet fjalë për institucione të veçanta për të mitur që vuajnë dënimin. Aktualisht në Republikën e Shqipërisë janë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), konkretisht: IEVP Jordan Misja Tiranë, IEVP Korçë, IEVP Lezhë, IEVP Vlorë, në të cilat trajtohen në seksione të veçanta të miturit e paraburgosur. Duke filluar nga muaji tetor 2009, është vënë në funksion Institucioni i të Miturve Kavajë, si një qendër rehabilitimi dhe edukimi për të miturit në konflikt me ligjin nga mosha 14-18 vjeç. Ky institucion u realizua me një investim dhe sipas një projekti të financuar nga Bashkimi European. Instituti përmbush çdo standart të Bashkimit European dhe ka kapacitetin e nevojshëm infrastrukturor dhe njerëzor për të pritur të miturit në konflikt me ligjin. Ngritja e këtij instituti në Kavajë u bë për shkak të disa faktorëve favorizues, ndër të cilët mund të përmendin afërsinë nga kryeqyteti dhe qendrat urbane me të populluara, kushtet klimaterike të favorshme etj. Nga ana tjetër, në Ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, Institucioni i Shërbimit të Provës trajton dhe mbikqyr zbatimin e dënimeve alternative. Në rastet e dënimeve të të miturve nga gjykata me një vendim alternativ është Institucioni i Shërbimit të Provës që ndjek ecurinë dhe zbatimin e vendimit të gjykatës për të dënuarit e mitur. Trajtimi i të miturve në sistemin Penitenciar bazohet në principet dhe standartet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, rregullat dhe standartet minimale për administrimin e drejtësisë për të miturit, rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve me liri të kufizuar, si dhe një sërë ligjesh dhe paketa ligjore vendase. Mbikqyrja e respektimit të të drejtave të personave të mitur realizohet nga institucione dhe struktura të specializuara brenda apo jashtë sistemit të burgjeve. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit të egër, ç’njerëzor ose poshtërues, si strukturë e specializuar e ngritur pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ka një rol të veçantë në monitorimin e gjithë sistemit të burgjeve, në çdo kohë dhe pa kufizim. Gjithashtu, në çdo institucion janë afishuar numra kontakti falas për të kontaktuar Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Avokatin e Popullit. Konceptimi i vendeve të vuajtjes së dënimit, si mundësi rehabilitimi për të miturit në konflikt me ligjin, përpos një numri të konsiderueshëm programesh dhe aktiviteteve, ka ecur në mënyrë të njëtrajtshme me përmirësimin e disa procedurave dhe mekanizmeve, siç është përmirësimi i mekanizmit të kërkesë ankesave, mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialë, si dhe parametrave të përgjithshëm të institucioneve ku mbahen të mitur. Një marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fokus të veçantë mbrojtjen nga diskriminimi i personave të mitur. Transparenca dhe bashkëpunimi me OJQ-të, që promovojnë dhe monitorojnë respektimin e të drejtave të miturve, ka qenë një nga prioritetet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Ajo ka krijuar dhe konsoliduar bashkëpunimin me UNICEF, Save the Children, Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve, dhe shumë organizata të tjera. Bashkëpunimi është përqëndruar në zhvillimin e programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit për të miturit në konflikt me ligjin.

Aktualisht gjatë vitit 2014, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka planifikuar masa shtesë për trajtimin e grupeve vulnerabelë në sistemin e burgjeve, me fokus të veçantë të miturit, për ngritjen e një sistemi motivimi për sjellje pozitive të të miturve dhe forcimin e sistemit të monitorimit të brendshëm për trajtimin e personave me liri të kufizuar.

Në funksion të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve”, gjatë muajit korrik 2014, u organizua trajnimi i stafit të nivelit të mesëm, ku u synua njohja me metodat e zgjidhjes së konfliktit dhe teknikat e ndërmjetësimit, nocionin e drejtësisë restauruese dhe çështje të tjera të cilat lidhen me administrimin e sistemit të drejtësisë për të mitur. Përdorimi i masave alternative dhe devijimit nga procedimi penal për të miturit në konflikt me ligjin, format alternative të trajtimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe konflikteve, zgjidhjet gjyqësore me arbitrazh, administrative, zgjidhja me ndërmjetësim, përdorimi i masave alternative dhe devijimit

nga procedimi penal për të miturit në konflikt me ligjin.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në vijim të masave të marra për krijimin e një sistemi efektiv rehabilitues për personat me liri të kufizuar, ka planifikuar hartimin e një draft marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë mbi çështjet e rehabilitimit, përgatitjes për lirim dhe ri-integrimin. Në themel të marrëveshjes së bashkëpunimit është zbatimi i kuadrit ligjor dhe krijimi i mundësive për rehabilitim dhe ri-integrim të suksesshëm të personave me liri të kufizuar, duke vënë në lëvizje të gjitha hallkat dhe strukturat e nevojshme.

Për reformimin e sistemit të drejtësisë për të miturit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në funksion të hartimit të Strategjisë së Drejtësisë për Fëmijët 2014-2020, ka përcaktuar prioritetet dhe angazhimet që do të ndërmerren gjatë kësaj periudhe. Theksi i reformës është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të suksesshëm për trajtimin e të miturve, integrimin e tyre dhe parandalimin e sjelljeve recidiviste.

Bibliografia

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 "Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore"
- Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007 "Për të drejtat e fëmijëve"
- Ligji nr. 9359, datë 24.03.2005 "Mbi marrëdhëniet me fëmijët"
- Ligji nr.8328, datë 16.04.1998 "Për trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Ligji nr.8331, date 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale"

Ligji Penal i BE-së dhe Traktati i Lisbonës

Emira Kazazi
Albtelecom sh.a, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim trajton modifikimet në kompetencat e Bashkimit Europian pas Traktatit të Lisbonës për të harmonizuar të drejtën penale dhe kompetencat vendimmarrëse të lidhura me drejtësinë dhe çështjet e punëve të brendshme. Ai trajton ndryshimet ndërmjet ish-Traktatit të Bashkimit Europian dhe Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Europian: Neni 82 dhe 83 të cilat trajtojnë të drejtën penale materiale dhe procedurale. Për më tepër, ky punim analizon efektin e kompetencave të reja në vendimet e ardhshme të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian në çështjet e subjektit penal dhe përfshirjen e mundshme të përkufizimeve të reja të Bashkimit Europian dhe të parimeve të së drejtës penale.

Fjale Kyce: Kompetencë, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian, Ligji Penal, Harmonizimi, Traktati i Lisbonës

Hyrje

Ka shumë mundësi që Traktati i Lisbonës i krahasuar me Traktatet e mëparshme, ka krijuar revolucionin më të madh brenda Ligjit të Punëve të Brendshme dhe Drejtësisë (që këtej e tutje referuar si "JHA"), fakt ky që ngre shumë çështje dhe tema me rëndësi të madhe për sovrenitetin, identitetin dhe traditat kombëtare. Të gjithë Shtetet Anëtare janë në dijeni të faktit që ligji penal ka një rol të rëndësishëm jo vetëm për mbrojtjen e fizikut të përgjithshëm të njeriut por edhe në ruajtjen e stabilitetit ekonomik të të gjithë shoqërisë gjithashtu.

Përveç përpjekjeve të BE-së, ka një histori të bashkëpunimit ndërkombëtar mbi harmonizimin e ligjit penal, pasi shtetet janë dakort të merren vesh lidhur me traktatet që i detyrojnë ato të harmonizojnë ligjin e brendshëm përta të përket disa krimeve të veçanta dhe të rënda, të cilat mund të krijojnë probleme midis kufijve. Aseti kryesor i një ligji të harmonizuar penal është heqja e barrierave midis shteteve dhe thjeshtimi i perforcimit të drejtësisë. Bashkimi Europian tashmë ka nisur të ndërtojë një mjedis stabil dhe të adaptojë pozicione të shumta, kuadro vendimesh apo pozicione të përbashkëta kundër krimit të organizuar (Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/842/JHA) apo trafikut njerëzor (Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/629/JHA).

Bashkimi Europian iu është përgjigjur dimensionit në rritje të krimit ndërkombëtar me vendosjen e organeve të tilla si Europol (Vendimi i Këshillit 2009/391/JHA) apo EUROJUST (Vendimi i Këshillit 2002/187/JHA). Për më tepër, që kur Traktati i Maastricht hyri në fuqi, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian (që këtej e tutje duke iu referuar si "Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian" dhe/ose "Gjykata") ka luajtur një rol madhor në zhvillimet e parimeve të ligjit penal të BE-së.

Nuk është habi që ligji i BE-së, si sistem ligjor i gjallë dhe në zhvillim, në një fare kohe të caktuar, arriti në përfundimin që funksionimi i një harmonizimi të ligjit penal të Bashkimit Europian, në një fare niveli duhet të jetë i domosdoshëm. Gjithsesi, duhet të mbajmë parasysh se ligjet dhe procedurat penale ndodhen në zemër të traditave ligjore të çdo Shteti Anëtar dhe ato reflektojnë themelet historike, politike dhe kushtetuese. Shtete Anëtare e kanë ruajtur juridiksionin e tyre si pjesë të trashëgimisë dhe sovranitetit dhe u paralajmëruan seriozisht se cilat kompetenca duhej t'i përmbaheshin BE-së. Ashtu siç e ka permendur edhe Prof. Peers (fq 508) se të gjithë shtetësimet kombëtare legjitime duhet të balancohen ndaj nevojës për një verpim efektiv të BE-së dhe të gjitha ndryshimeve nga Traktati i Lisbonës përta të përket harmonizimit të ligjit penal i cili duhet të jetë subjekt i kufizimeve të rëndësishme.

Gjithsesi, qëllimi i këtij artikulli është që të hedhë dritë mbi qëllimin e Neneve përkatëse të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Europian (që këtej e tutje referuar si "TFEU") në lidhje me ndryshimet në kompetenca të BE-së, përta të përket harmonizimit të ligjit penal. Në të njëjtat nene, reflektohet dhe

Bashkëpunimi rajonal filloi të marrë një rol më të rëndësishëm jo vetëm për vëndet e rajonit por edhe për vetë BE me krizën ekonomike të vitit 2008. Krizës ekonomike i bashkëngjitej edhe ajo politike mbi statusin e Kosovës. Në këtë mënyre Komisioni European shprehu hapur nevojën urgjente të bashkëpunimit rajonal. Në fjalët e ish - Komisionerit për zgjerim Olli Rehn shprehet hapur rëndësia që BE i kushton bashkëpunimit rajonal: *...më shumë se gjithnjë, perspektiva e antarësimit dhe bashkëpunimi rajonal janë thelbësore për të ndihmuar vëndet e rajonit të dalin jashtë spirales ekonomike negative. Si një gur themeli i axhendes europiane, bashkëpunimi rajonal është i një rëndësie primare dhe themelore për të përballuar krizën* (Rehn, 2009).

Funksionimi i bashkëpunimi rajonal varet nga bazat solide dhe qëllimet politike të përbashkëta e të koordinuara mirë. Kështu në rradhë të parë realizimi varet nga mirëkuptimi politik i vëndeve të rajonit, qëllimet e të cilëve janë të ndryshme ashtu si dhe marrëdhëniet e tyre me BE.

Një nga karakteristikat kryesore të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor është natyra e tij, e udhëhequr nga jashtë. Për faktin se bashkëpunimi rajonal është një parakusht për aderimin në BE u bë i rëndësishëm për të gjithë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Ky parakusht u mendua nga BE në vitin 1996 kur ende mungonte termi “Ballkan Perëndimor” (Delevic, 2007, 11,16) për të bashkuar shtetet e Ballkanit me njëri-tjetrin në një kornizë të ngushtë të lidhjeve dypalëshe, duke konsideruar faktin e marrëdhënieve të tensionuara midis tyre në të kaluarën.

Termi Ballkan Perëndimor shpreh distancat e rajonit nga një e kaluar e lidhur gjithmonë më një konotacion negativ të rajonit, që nga trashëgimia turke e deri në “fuci baruti” me të cilat tashmë asnjë shtet nuk do të identifikohet. Përgjatë historisë kjo pjesë e Europës dhe shtetet e saj kanë qënë gjithnjë të përfshirë në entitete politike më të mëdhaja si Perandoria Osmane, ajo Austro-Hungareze, epoka sovjetike, shtetet e pa-angazhuara dhe duke arritur në kohet e sotme ku të gjitha shtetet e rajonit kanë një objektiv të përbashkët si integrimi në BE por si objektiv për tu arritur në mënyre individuale nga secilit shtet (Anastasakis dhe Bojicic-Dzelilovic, 2002, 39). Për arsye të rrethanave historike, në rajon nuk pati një proces afërsie midis shteteve por ngelën të ndarë midis perandorive, feve, civilizimeve, dhe së fundmi midis *in* dhe *out* nga BE. Të gjitha këto arsye cuan në mos krijimin e një tradite të bashkëpunimit rajonal. Në këtë mënyre duke mos pasur në brëndësi të rajonit një unitet në përkufizimin e vet, përkufizimi erdhi nga aktorë të jashtëm si BE, e cila ushtroi fuqinë e vet të joshjes dhe gjithashtu u perceptua si i vetmi aktor i aftë për të krijuar stabilitet në një rajon tradicionalisht të paqëndrueshëm (Bechev, 2006, 28).

Termi Ballkan Perëndimor u konsolidua me Procesin e Stabilizimit-Asocimit në 1999, i cili theksoi nevojën e shteteve për tu angazhuar në bashkëpunimin rajonal. Bashkëpunimi si para kusht për integrimin europian pritej të sillte një stabilitet më të madh ekonomik dhe politik në Ballkanin Perëndimor, duke promovuar jo vetëm integrim më të shpejtë për rajonin por në të njëjtën kohë duke u përpjekur për të evituar mbartjen e problemeve të këtyre shteteve brenda BE (Delevic, 23). Ashtu si vetë emri i “pagëzimit” të rajonit u krijua nga aktorë të jashtëm ashtu dhe iniciativat e para për bashkëpunim erdhën nga jashtë të nxitura nga aktorë si BE, NATO, dhe Institucionet financiare të cilët kishin interes për stabilitetin ekonomik të rajonit.

Iniciativat e para për bashkëpunimin rajonal erdhën menjëherë pas luftës së Bosnjës si mënyrë transformimi në aleatë të palëvë luftuese, iniciativë e nxitur nga Franca dhe e miratuar nga BE: Procesi Royaumont mbi Stabilitetin dhe Fqinjësinë e mirë në Europën Juglindore me praninë e pesë shteteve të Ballkanit Perëndimor, BE, SHBA, Rusinë, Këshillin e Europës dhe OSBE (Komisioni European, 1996).

Por edhe pse procesi i bashkëpunimit është një proces i udhëhequr nga jashtë “*externally driven*”, dhe i nxitur nga aktore të jashtëm, zhvillimi i bashkëpunimit rajonal i shërben qëllimit të rindërtimit të marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet fqinjëve, si dhe ndihmon për të ri-zbuluar pikat e përbashkëta (Mameli, 2011, 8). Në këtë mënyrë shtetet e Ballkanit filluan të promovojnë iniciativa të udhëhequra nga vetë ato duke i dhënë jetë fillimit të Procesit të Bashkëpunimit në Europën Juglindore, një forum ku merrnin pjesë vetëm shtetet e Ballkanit, si initiative jo e prodhuar nga aktorë të jashtëm por nga impulse brenda rajonit, i zëvendësuar më vonë nga Pakti i Stabilizimit. Pakti i Asocim-Stabilizim rezultoi i suksesshëm sepse për herë të parë u krijua një strategji e menduar posacërisht

mbi Ballkanin Perëndimor dhe e drejtuar kundrejt nevojave të këtyre shteteve për të bërë realitet faktin se shtetet e Ballkanit duhet të jenë pjesë e Bashkimit Europian, për të realizuar unifikimin dhe paqen në kontinent.

Impulsi i fortë mbi antarësimin në BE funksionoi si një faktor shtytës për të krijuar një rrjet të gjërë lidhjesh midis shteteve të Ballkanit Perëndimor, por në të njëjtën kohë u krijuan disa dyshime mbi antarësimin në BE të këtyre shteteve si dhe mbi momentin e antarësimit sepse gjithnjë e më tepër brenda BE po flitet mbi *enlargement fatigue*.

Ekziston edhe një kontradiktë midis bashkëpunimit rajonal ku është bazuar Procesi i Stabilizim-Asocimit, i cili i shtyn shtetet e rajonit të gjejnë pikat e përbashkëta nëqoftëse duan të arrijnë antarësimin në BE, dhe antarësimit në BE, e cila është një marrëveshje e drejtuar ekskluzivisht nga BE dhe secili shtet në mënyrë individuale. Nga këndvështrimi i vëndeve të Ballkanit Perëndimor, kjo kontradiktë *in termini* i bën marrëdhëniet bilaterale me BE më të rëndësishme se ato me shtetet e rajonit, dhe akoma më të rëndësishme se marrëdhëniet e gjithë rajonit si një entitet i vetëm me BE (Giligorov, 2004, 2).

Kjo paqëndrueshmëri midis qëndrimit rajonal dhe bilateral të BE përkundrejt Ballkanit Perëndimor krijon disa dyshime tek vëndet e rajonit, të paktën në fillim, nëq integrimi europian ishte një alternativë e vërtetë apo thjesht një mirazh për ti bërë shtetet të bashkëpunonin midis tyre (Giligorov, 2004, 2).

Kjo panoramë e krijuar në rajon i vendosi të gjitha shtetet përballë një qëllimi të përbashkët, por për ta thënë me fjalët e ish-Presidentit kroat, *Stipe Mesic*, progresi i tyre ishte i lidhur me “*regatta principle*” – cdo shtet integrohet atëherë kur është gati – dhe jo “parimi i karvanit” – të presësh deri sa shtetet e tjera të jenë gati (Delevic, 32). Ky parim gjithashtu rrezikon edhe krijimin e kompetencionit midis shteteve të rajonit, sidomos në vitet e fundit ku BE edhe në sajë të krizës ekonomike po kalon një krizë ekzistenciale të vetën ku duket se është humbur entuziasmi në projektin e përbashkët, por mbi të gjitha qëndrimi negativ i shteteve që përbëjnë bërthamën e fortë të BE, ndaj integritit të shteteve të reja.

Mos aprovimi me referendum i kushtetutës në 2004 nga Franca dhe Irlanda si dhe kriza aktuale ekonomike bënë që gjithnjë e më tepër nga zgjerimi i vitit 2004 të flitet për *enlargement fatigue* ku vihet re mos aprovimi i opinionit publik mbi zgjerimin e mëtejshëm. Kështu aktualisht edhe pse Kroacia u bë antare e BE, Bosnja-Hercegovina është ende në pritje të statusit të vendit kandidat duke konsideruar edhe problemin e aftësive së përthithjes nga ana e BE ndaj vëndeve të reja qoftë kjo e lidhur me probleme të brendshme të shteteve aspiruese por edhe me problem institucionale dhe organizuese të BE (Balfour dhe Stratulat, 2012).

Kështu integrimi në BE nuk varet vetëm nga vëndet candidate por edhe nga faktorë të jashtëm e të brendshëm të BE, duke rrezikuar që bashkëpunimi rajonal si para kusht aderimi të pësojë frenim në varësi të fazës së procesit ku gjendet secili shtet kandidat. Por ana tjetër integrimi i jep një impuls të ri të bashkëpunimit rajonal, vendet e rajonit për ti bërë ballë krizës ekonomike janë përfshirë në një serë iniciativash të cilat kanë për qëllim një përgjigje efektive ndaj krizës ekonomike por edhe kohezion brenda rajonit.

Iniciativat e Bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor: Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

Por me përjashtim të problemeve duhet të përmenden hapat që ky bashkëpunim ka bërë mbi të gjitha pas vitit 2000. Kështu një sërë iniciativash, forumesh, tavolinash të rrumbullakta janë zhvilluar në 15 vitet e fundit në fusha të ndryshme, duke përcaktuar në këtë mënyrë një dialog rajonal dhe duke i paraprirë trazirave politike.

Disa nga fushat më të rëndësishme dhe iniciativat janë:

- Marrëevshja e Europës Qëndore për tregëti të lirë – e krijuar në 2006 me qëllimin liberalizimin e marrëdhënieve tregtare midis Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës;
- Reformat në Administratën Publike: Procesi i Punësimit i Bukareshtit i cili ndihmon në zhvillimin e politikave të punësimit në rajon;
- Iniciativa Elektronike në Europën Juglindore (eSEE) – e krijuar brenda kuadrit të paktit

të Stabilitetit me ndihmen e BE dhe UNDP, për të promovuar futjen e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit në segmented kryesore të administratës publike (Rakovic, 2010, 149).

Iniciativat e lart përmendura janë shumë të rëndësishme për rajonin por më e rëndësishmja është krijimi i Këshillit mbi Bashkëpunimin Rajonal si mekanizëm për të zgjidhur problemin e mungesës së një mekanizmi të udhëhequr brenda rajonit dhe jo më nga jashtë. Këshilli u krijua me qëllim për të përforcuar stabilitetin, sigurinë si dhe dialogun në rajon, duke vepruar si një interlokutor kyc mbi të gjitha në kuadër të instrumentit IPA te pre-aderimit si dhe për të kordinuar mbështetjen politike, teknike dhe financiare.

Ky Këshill përfaqëson thelbin e iniciativave të bashkëpunimit rajonal, duke qënë përfaqësues i vetëm në të gjitha forumet rajonale që veprojnë në rajon si dhe duke qënë nje interlokutor i privilegjuar nga Brukseli. Por që ne fillim të veprimtarisë së vet ne 2008, ky mekanizem u ballafaqua me dy element (Mameli, 19) të cilët rrezikonin të ndalnin ecurinë e procesit:

1. Problemet ekonomike të cilat ishin të lidhura me krizën botërore por mbi të gjitha me përhapjen e saj në Greqi filluan të jepnin efekt dhe në rajonin e Ballkanit;

2. Shpallja e pavarisë së Kosovës – pjesëmarrja e shteteve të cilat nuk njohin pavarinë e Kosovës në të njëjtin forum krijonte mosmarrëveshje midis pretendimeve nga pala kosovare për të marre pjesë si shtet i pavarur dhe këtyre shteteve të cilët pretendonin përfaqësimin e saj nga UNMIK.

Duke konsideruar rëndësinë e këtij mekanizmi si dhe atë të bashkëpunimit rajonal si proces, BE dhe në mënyre specifike Komisioni u adresua me disa pika kryesore mbështetëse për të shprehur rëndësinë që puna e këtij Këshilli ka për BE (Komisioni, 2009). Mbështetja e hapur e BE-së evitoi rrezikun politik të kërcënimit të stabilitetit në rajon. Me anë të kësaj komunikate Komisioni shprehu rëndësinë që Kosova të mos ngelet prapa në procesin e integritit dhe mbi të gjitha në procesin e bashkëpunimit rajonal.

Me anë të deklaratave nga BE ndaj çështjes së Kosovës dhe zgjidhjes së saj u ripërsërit rëndësia e funksionimit të Këshillit mbi Bashkëpunimin Rajonal dhe veprimtarisë së tij për të arritur objektivat e caktuara në 2010 nga BE dhe të rikonfirmuara edhe në strategjinë “Europe 20” ([ëëë.rcc.int](http://ec.europa.eu/ecc/int)).

Si përfundim, në perspektivën e këtij artikulli, si pasojë e krizës ekonomike dhe si pasojë e pasigurive politike pas shpalljes së pavarisë së Kosovës dhe statusit të saj, bashkëpunimi rajonal rrezikonte të pësonte një frenim. Duke u përballur me këtë rrezik, BE dërgoi sinjale të shumta duke i kërkuar mbi të gjitha Këshillit mbi Bashkëpunimin Rajonal sa më shumë efikasitet dhe përfshirje të Kosovës në kornizën e bashkëpunimit rajonal.

Mos funksionimi i Këshillit do të ravijëzonte një kërcënim rreth qëndrueshmërisë së strategjisë së BE në rajon, si pasojë e mbështetjes së kësaj strategjie mbi kushtin e bashkëpunimit rajonal.

Ndërkohë që BE konfirmoi interesin jo vetëm mbi rajonin por edhe duke zgjedhur Këshillin si përfaqësuesin kryesor, kjo u shoqërua dhe me krijimin e një strategjie konkrete duke garantuar I efikasitet mandatisi si dhe në të njëjtën kohë duke kërkuar një zgjidhje për të përfshirë Kosovën në një numër sa më të madh iniciativash.

Por ajo cka vazhdon të ngelet si një nga mangësitë e bashkëpunimit rajonal është mungesa e mos konfrontimit mbi çështje politike të kaluara të cilat vazhdojnë të ngelen tabu për arsye të mungesës së kurajos politike.

Duke qënë se Këshilli përfaqëson një interlokutor të privilegjuar të BE, i cili përfaqëson bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor të shteteve midis tyre, duhet të zhvillojë edhe një rol kryesor në koordinimin e iniciativave rajonale, për të evituar në këtë mënyre humbjen e risurseve njerëzore dhe ekonomike si pasojë e mbivendosjes së iniciativave.

Lidhja midis bashkëpunimit rajonal dhe BE duhet të fokusohet mbi përmbushjen e nevojave rajonale të bazuara mbi argument dhe analiza dhe të organizuara në një rënditje të prioriteteve të rajonit.

Përfundime

Bashkëpunimi rajonal është një proces i rëndësishëm jo vetem për integrimin në BE por mbi të gjitha për të ri-zbuluar lidhjet midis shteteve në një rajon të etiketuar si Ballkan Perëndimor. Ri-zbulimi i këtyre lidhjeve nuk duhet të jetë vetëm midis atyre shteteve të cilat kanë mbetur pa u integruar në BE,

duke i konsideruar si shtetet “e mënjauara” por edhe me shtete si Kroacia e cila tashmë është pjesë e Bashkimit Europian.

Këshilli i Selanikut në 2003 konfirmoi rëndësinë e integritit të këtyre shteteve dhe pikërisht ky integrim duhet të kalojë nëpërmjet bashkëpunimit rajonal. Bashkëpunimi rajonal i cili fillimisht nxitet dhe udhëhiqet nga vetë BE duke e bërë këtë proces të udhëhequr nga jashtë por jo të nxitur nga brenda pas viteve 2000 bën hapa të rëndësishme përpara në krijimin e iniciativave individuale të bashkëpunimit.

Kështu ajo që mund të konsiderohej si kontradiktë e brendshme e procesit që vinte nga natyra ngushtësisht bilaterale e procesit të antarësimit të secilit shtet, superohet në praktikë duke treguar në forume të ndryshme dhe me krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal se procesi i bashkëpunimit nuk ec përpara thjesht për të arritur objektivin e shumë kërkuar, integritin.

Ka qënë pikërisht ky proces i cili i krijoi mundësi vëndëve në konflikt endemik midis tyre të gjenin mundësinë e një dialogu në forume të përbashkëta kështu impulsi i këtij procesit rritet pas konfliktit në Bosnjë-Hercegovinë. Përsëri brenda Këshillit mbi Bashkëpunimin Rajonal Komisioni Europian i bëntë thirrje Serbisë dhe shteteve të tjera të cilat nuk njohin Kosovën si shtet të pavarur të bëjnë hapa përpara drejt zgjidhjes së konfliktit sepse është rrënjësore për paqen dhe stabilitetin në rajon por edhe në gjithë Europën përfshirja e këtij shteti te sapo formuar në dialogun rajonal.

Nëpërmjet procesit të bashkëpunimit rajonal shtetet e Ballkanit Perëndimor në shumë raste tregojnë se nuk ndajnë vetëm hapësirën por edhe kohën midis tyre.

Megjithatë edhe pse hapa të rëndësishme janë bërë në vazhdimësi edhe falë punës dhe impulsit të BE, akoma disa probleme politike mbeten të pa trajtuara në kuadër të bashkëpunimit dhe vazhdojnë të jenë objekt i marrëdhënieve dy-palëshe. Probleme si njohja e shtetit të Kosovës, bashkëpunimi i Serbisë me Gjykatën mbi Krimet në sh-Jugosllavi vazhdojnë të jenë pika ndarëse midis shteteve të rajonit, ndoshta edhe për mungesë kurajo politike.

Si përfundim bashkëpunimi rajonal i cili edhe pse fillon për arsye të integritit sot vazhdon për interesa të përbashkëta të shteteve të rajonit. Këto shtete pavarisist stadi të tyre në procesin e integritit, edhe si pasojë e probleme të brëndshme të vetë BE përfitojnë në mënyrë të ndërsjelltë nga bashkëpunimi në përbalimin edhe të krizës ekonomike e cila përfshiu pothuajse të gjitha shtetet e Europës duke u përhapur më vonë edhe në Ballkan duke deshmuar edhe njëhere për rëndësinë e zhvillimit me tej të këtij procesi.

Referenca

Anastasakis Othon dhe Vesna Bojicic-Dzelilovic, (2002), Balkan Regional Cooperation and European Integration, *The Hellenic Observatory*.

Bechev Dimitar, (2006), Carrots sticks and norms: the EU and regional cooperation in Southeast Europe, *Journal of Southern Europe and the Balkans 1*.

Delevic Milica, (2007), Regional Cooperation in the Western Balkans, Institute for Security Studies, *Chaillot Paper, 104*.

Gligorov Vladimir, (2004), Southeast Europe: Regional Cooperation with Multiple Equilibria, *Integrating the Balkans in the European Union: Functional Borders and Sustainable Security (IBEU Research Project)*, Working Paper n.4.

Mameli Simona, (2011), Regional Cooperation in Western Balkans in Times of Political and Economical Uncertainty, *PECOB's Papers Series*, n.8.

Rakovic Alessandra, (2007), eSEE – a not so easy challenge for South Eastern Europe, *From Stabilization to Integration. The Stability Pact for South Eastern Europe*,

Stratulat Corina dhe Balfour Rosa, (2012), *The enlargement of the European Union – Discussion paper*, European Policy Center,

Dokumenta

Buletini i Bashkimit European – Janar – Shkurt 1996, Bruksel

Mandati i krijimit të Këshillit mbi Bashkepunimin Rajonal në www.rcc.int

Komisioni (Drejtorja e Përgjithshme mbi Zgjerimin), *Drejt një efikasiteti më të lartë të Këshillit mbi Bashkepunimin Rajonal*, dokument i mbledhjes 168/2009, 20.10.2009

Birësimi- forma më e përshtatshme e mirërritjes për fëmijët pa kujdes prindëror

Msc. Jonida Dalipaj
Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë

Abstrakt

Fëmijët, derisa të arrijnë moshën madhore, janë grupi më shumë i ekspozuar ndaj rrezikut. Për këtë arsye ata kanë nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje të veçantë nga ana e familjeve të tyre, shoqërisë dhe institucioneve shtetërore. Por ka raste kur të miturit mbeten jashtë këtij përkujdesi për faktorë natyral, social apo ligjor. Për këtë grup fëmijësh birësimi është një nga trajtat më të plota dhe më komplete të mbrojtjes familjare ngaqë ai respekton plotësisht parimin e interesave më të mira të fëmijës, duke njohur të drejtën e tij për t'u rritur në një mjedis familjar dhe shoqëror, që e pranon dhe e sheh atë të barabartë në çdo aspekt. Birësimi nuk ka rëndësi vetëpër fëmijët, apo për personat që nuk mund të themelojnë dot familje në mënyrë natyrore por edhe sepse në mënyrë të organizuar sigurohet mbrojtja familjare e fëmijëve pa kujdesin prindëror. Në këtë punim do të jepet raporti i fëmijëve të braktisur me fëmijët e birësuar, dinamika e birësimeve dhe ndryshimi në kohë të tyre. Struktura e birësimeve në favor të birësuesve shqiptarë në krahasim me të huajt, perspektiva e fëmijëve të birësuar, etj.

Në hartimin e këtij studimi janë shfrytëzuar blloku i ligjeve në fuqi, raportet, dokumentet strategjike kombëtare dhe lokale për fëmijët jashtë kujdesit prindëror. Është përdorur metoda e analizës dhe sintezës, krahasimit dhe përshkrimit. Konkluzioni është i thjeshtë: shqiptarët kanë filluar të bëhen më njerëzor në fushën e birësimeve. Ky është një tregues tepër pozitiv për shkallën e civilizimit të tyre dhe të qasjes ndaj Evropës.

Fjalë kyçe : birësim, fëmijë jashtë kujdesit prindëror, interesi më i lartë i fëmijës, birësime vendase, birësime ndër-vendase.

Hyrje

Familja është mjedisi më i mirë për mbrojtjen dhe mirërritjen e fëmijës. Por ka raste kur të miturit mbeten jashtë këtij përkujdesi për faktorë natyrale, sociale apo ligjore. Si shkaqe që fëmijët mbeten jashtë kujdesit prindëror mund të përmendim: problemet sociale dhe ekonomike të familjes; divorcet e prindërve dhe mospranimi i fëmijës nga asnjë prej prindërve ose pamundësia e mbajtjes së fëmijëve nga njëri prind; vdekja e prindërve ose e njërit nga prindërit dhe pamundësia financiare e mbajtjes së fëmijëve nga prindi tjetër; papunësia dhe vështirësitë tepër të mëdha ekonomike të prindërve për t'u kujdesur për fëmijët; papërgjegjshmëria e prindërve për t'u kujdesur për fëmijën e tyre; mungesa e strehimit; dhuna në familje; numri i madh i fëmijëve në familje; paaftësia fizike apo mendore që mund të ketë fëmija; shtatzënitë e hershme të vajzave të cilat nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e rritjes së fëmijës apo për arsye të mentalitetit detyrohen t'i braktisin.

Fjala birësim buron nga fjala latine "ad optio", që do të thotë zgjedh ose zgjedhje. (Oruci, 1994, fq 179). Birësimi është një institucion që ka rëndësi të shumëfishtë. Për fëmijët që kanë ngelur pa kujdesin prindëror, birësimi është një nga trajtat më të plota dhe më komplete të mbrojtjes familjare. Fëmijët pa kujdesin prindëror, dmth pa familje, u sigurohet tërë kujdesi në familjen e adoptuesit. Nga ana tjetër birësimi ka rëndësi edhe për personat që e adoptojnë, ngaqë me birësim atyre u mundësohet plotësimi i një nevoje natyrore-të kenë fëmijë dhe në këtë mënyrë të ushtrojnë të drejtën prindërore mbi të. Pra, personat të cilët nuk mund të themelojnë familje në mënyrë natyrore-me lindjen e fëmijës, u mundësohet themelimi i familjes në mënyrë artificiale-me birësim. Birësimi ka dhe rëndësi të përgjithshme shoqërore, sepse në mënyrë të organizuar sigurohet mbrojtja familjare e fëmijëve pa kujdesin prindëror.

Parashtrohet pyetja, se cila është mbrojtja më e përshtatshme dhe më e sigurt e cila mund t'u ofrohet fëmijëve të privuar nga mundësia që të përjetojnë ngrohtësinë e familjes?

Duke i dhënë prioritet kujdesit dhe dashurisë që mund t'ua ofrojnë çiftet që nuk kanë fëmijë dhe jo vetëm, pa dyshim, birësimi është rruga më e sigurt që një fëmijë të ndjehet pjesë e një familje, të ketë

siguri nga personat me të cilët jeton dhe të ndjejë sinqeritetin e dashurisë prindërore. Në Shqipëri gjithnjë e më shumë po vërehen tendencat e birësimit të fëmijëve prej qytetarëve shqiptarë dhe më pak prej të huajve. Fenomeni më i ri në shoqërinë shqiptare tashmë është birësimi i fëmijëve nga persona publike, gra të njohura në karrierë dhe me një buxhet të mirë financiar kanë birësuar një fëmijë pa patur nevojën e një partneri. Në zyrat e komitetit shqiptar të birësimit, sapo janë mbyllur 5 raste ndërsa 4 janë në proces birësimi. Ky është një tregues se edhe shqiptarët po i përshtaten gjithnjë e më shumë mentalitetit evropian në lidhje me familjen.

Vështrim mbi birësimin në Shqipëri

Birësimi në Shqipëri është një fenomen i njohur historik por i përhapur gjerësisht në vitet e fundit. Janë një numër faktorësh që pengojnë realizimin e përshtatshëm të të drejtave të fëmijës përfshirë mungesën e një politike sociale parandaluese dhe mbështetëse, mungesën e një legjislacioni të plotë, mangësitë e shërbimeve sociale të ngritura mbi komunitet si dhe mungesën e standardeve dhe strukturave mbikëqyrëse në shërbimet ekzistuese të kujdesit për fëmijët.

Në bazë të një marrëveshjeje të brendshme, ndërmjet aplikantëve birësues dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve, për një periudhë 2 vjeçare realizohen çdo 6 muaj raporte për periudhën pasbirësuese. Megjithatë kapacitetet monitoruese për mirëqenien e fëmijës mbas birësimit janë të kufizuara. Tashmë periudha e pritjes së çifteve për finalizimin e birësimit është rreth 6 muaj, në një kohë që më parë pritshmëria varionte minimalisht në 12-15 muaj.

Gjendja reale e tyre dhe dinamika e zhvillimit tërësor të shoqërisë në vend, nxjerrin nevojën e ndërhyrjes shumë planëshe shtet-shoqëri, për të siguruar një mjedis ku fëmijët e nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata, kanë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues.

Fëmijët dhe të rinjtë që kanë humbur kujdesin prindëror, vuajnë nga diskriminimi dhe shumë disavantazhe, si pasojë e mosfrimit të shërbimit dhe vëmendjes nga strukturat publike shtetërore. Kuadri aktual ligjor kërkon përmirësime për sa u përket të rinjve që largohen nga përkujdesja, duke adresuar sfidat e tyre, për të zhvilluar strategji më të mira dhe shërbime të tjera për ta. Statusi i përkujdesjes në institucionet rezidenciale vështirëson të ardhmen e të rinjve që largohen nga përkujdesja dhe thekson disavantazhet dhe vulnerabilitetin e tyre. Statusi ligjor i fëmijëve në përkujdesje të moshës 16-18 vjeç nuk është i rregulluar.

Vendi ynë nuk ka një sistem ligjor të mjaftueshëm që mbulon nevojat e të rinjve që janë në përkujdesje apo që dalin nga përkujdesja, veçanërisht të atyre që largohen shumë më herët. Për këtë arsye, është i nevojshëm krijimi i shërbimeve pas përkujdesjes, qëndrimi në përkujdesje deri në përfundim të shkollës së mesme, ngritja e qendrave ditore pritëse që ofrojnë shërbime për të rinjtë (16-18 vjeç) dhe implementimi i politikave të trajnimit profesional dhe punësimit për kategoritë e të rinjve që janë larguar nga përkujdesja.

Birësimi është alternativa më e mirë për kujdesin që shtrihet në fëmijë të braktisur ose jetimë, ngaqë ai respekton plotësisht parimin e interesave më të mira të fëmijës, duke njohur të drejtën e tij për t'u rritur në një mjedis familjar. Në procesin e birësimit i kushtohet vëmendje e veçantë shëndetit të fëmijës dhe mirëqenies së tij emocionale, duke gjetur për të një mjedis familjar që të mund t'i ofrojë fëmijës sa më shumë dashuri, siguri, ushqim, kujdes mjekësor dhe arsimim që të jetë e mundur. Është një institucion që ka rëndësi të shumëfishtë. Për fëmijët që kanë ngelur pa kujdesin prindëror, birësimi është një nga trajtat më të plota dhe më complete të mbrojtjes familjare. Fëmijët pa kujdesin prindëror u sigurohet tërë kujdesi në familjen e adoptuesit. Nga ana tjetër birësimi ka rëndësi edhe për personat që e adoptojnë, ngaqë me birësim atyre u mundësohet plotësimi i një nevoje natyrore të kenë fëmijë dhe në këtë mënyrë të ushtrojnë të drejtën prindërore mbi të. Birësimi ka dhe rëndësi të përgjithshme shoqërore, sepse në mënyrë të organizuar sigurohet mbrojtja familjare e fëmijëve pa kujdesin prindëror. Qenia jetim i një fëmije lë pasojë të pariparueshme psikologjike, të cilat mund të riparohen apo reduktohen vetëm në një mjedis të ngrohtë familjar dhe shoqëror, i cili e pranon dhe e sheh atë të barabartë në çdo aspekt.

Raporti i fëmijëve të braktisur me fëmijët e adoptuar anon nga fëmijët e braktisur. Kërkohet më

shumë sensibilizim dhe më shumë ndërgjegjësim. Rastet e braktisjes së fëmijëve janë të ndjeshme ndërsa birësimi i tyre është ende i pakët, por duket sikur ka një përmirësim. Shërbimi Social Shtetëror bën me dije se gjatë vitit 2012 janë braktisur 117 fëmijë. Problemet sociale janë arsyet kryesore se përse janë braktisur 76 fëmijë, ndërsa 41 janë fëmijë janë braktisur që në momentin e lindjes. Vetëm 46 fëmijë të braktisur kanë mundur të gjejnë një familje të dytë. Pra mund të thuhet se pjesa më e madhe e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror janë fëmijë socialë dhe pjesa tjetër jetimë biologjike.

Qëllimi dhe rëndësia e birësimit, natyra juridike

Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve, neni 20.1 thekson se “ Qëllimi kryesor i birësimit është t'i ofrojë fëmijës një familje dhe një shtëpi ku ai të ndjehet si në të tijën dhe jo ti ofrojë një familje një fëmijë”. Birësueshmëria nuk është një situatë ekskluzivisht juridike. Ajo duhet të marrë parasysh disa elemente psikologjike, sociale, mjekësore e juridike.

Birësimet praktikoheshin edhe para vitit 1990; ato realizoheshin përmes gjykatave. Por një pjesë e këtyre birësimeve rezultonin problematike (si për fëmijët ashtu dhe për prindërit birësues), meqë mungonte një vlerësim i vërtetë i familjes birësuese nga punonjësit socialë dhe psikologët.

Numri i madh i familjeve shqiptare ose të huaja që mund të aplikojnë i japin mundësi Komitetit Shqiptar të Birësimeve të zgjedhë ato familje që janë në gjendje t'i plotësojnë më mirë nevojat e fëmijës. Birësimet ndërshtetërore bëhen vetëm me vendet të cilat e kanë ratifikuar Konventën e Hagës. Aktualisht Shqipëria ka lidhur marrëveshje birësimesh me 5 shtete: Italinë, Francën, Kanadanë, Maltën dhe SHBA. Disa organizma janë autorizuar nga shtetet e tyre respektive që të mbulojnë veprimtari ndërshtetërore birësimesh me Shqipërinë, përfshirë *AiBi*, *Sant'Egidio* dhe *SPAI* në Itali, *Medicins du Monde* në Francë, *Bethany Christian Services* dhe *International Children Alliance* në SHBA si dhe Departamentin e Çështjeve Sociale e Familjare në Maltë.

Birësimi ka për qëllim të ofrojë familjen më të përshtatshme, duke iu përgjigjur nevojave të saj, një minori që ka përjetuar situata traumatizuese (paaftësi ose pamundësi e familjes së tij të origjinës për tu përkujdesur edhe pse i përket asaj) e nganjëherë është mbartës ndryshimesh kundrejt shoqërisë që do të presë. Familja birësuese duhet pra të jetë paraprakisht e njohur si e kualifikuar dhe e përshtatshme për të siguruar, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, mbrojtjen dhe respektin e një fëmije me këtë të kaluar dhe me këto karakteristika. Një studim psiko-mjeko-social i një familje të tillë duhet pra realizuar para se të ndërmerret praktika e birësimit. Ky studim duhet për të konfirmuar ose për të mohuar aftësitë birësuese të familjes, aftësi këto që duhet të jenë objekt i një vërtetimi zyrtar.

Konventa ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), është ratifikuar nga qeveria shqiptare në shkurt 1992, hyri në fuqi në mars 1992. Detyrimet që rrjedhin prej kësaj konvente përsa u takon respektimit të të drejtave të fëmijës udhëhiqen prej parimit të respektimit të “interesave më të mira të fëmijës”. Sipas KDF fëmija ka të drejtë të gëzojë një standard të pranueshëm jetese, sigurimi i të cilit është përgjegjësi e shtetit dhe e prindërve. Konventa e Hagës (1993) “Mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimet ndërkombëtare” u ratifikua me ligjin nr. 8624, datë 15 qershor 2000. Kodi i ri i Familjes (ligji nr. 9062, datë 8 maj 2003) specifikon detyrimet institucionale të shtetit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe mënyrën se si duhet të trajtohen ato. Në Kodin e Familjes “fëmijë pa kujdes prindëror” konsiderohen të gjithë këta fëmijë: prindërit e të cilëve kanë vdekur; prindërit e të cilëve janë shpallur të panjohur; prindërit e të cilëve janë shpallur të humbur; që janë braktisur nga prindërit; prindërit e të cilëve janë privuar nga e drejta e tyre prindërore në bazë të një vendimi përfundimtar gjykate. (*Kodi i Familjes (2003) fut një teknologji të re, bashkëkohore. Këtu përdoret termi “fëmijë pa kujdes prindëror” në vend të termit “jetim”. Ky përkufizim e zgjeron grupin e fëmijëve që përfitojnë, duke përfshirë këtu edhe fëmijët që janë pa kujdes prindëror ndonjë prindërit e tyre jetojnë.*

Dinamika e birësimeve në Shqipëri

Përpara periudhës së tranzicionit Shqipëria konsiderohej si një vend me nivel të ulët braktisjeje dhe shpërfilljeje të fëmijëve. Shndërrimet ekonomike dhe sociale gjatë periudhës së tranzicionit në vitet

'90 e rritën mjaft numrin e fëmijëve të rrezikuar. Varfëria, papunësia dhe nivelet e larta të emigrimit po gërryejnë kohezionin e familjes shqiptare, duke çuar në rritje të numrit të fëmijëve të braktisur, të shpërfillur ose të abuzuar nga prindërit e tyre.

Raporti i fëmijëve të braktisur më fëmijët e adoptuar anon nga fëmijët e braktisur por duket sikur ka një përmirësim. Vetëm në 9 muajt e parë të këtij viti janë realizuar 47 birësime, ose sa 100 % e birësimeve për gjithë vitin 2013. Që prej funksionimit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve në 1993 e deri në prill të 2014 janë birësuar rreth 1500 fëmijë të braktisur. Gjatë vitit 2012 deri në prill 2013 janë realizuar 79 birësime ndër këto: 49 janë birësime vendase dhe 30 janë birësime ndërvendase. Gjatë vitit 2011, janë birësuar 27 fëmijë nga këta 19 fëmijë janë birësuar brenda vendit dhe 8 të tjerë jashtë vendit . Nëse më parë, shtetasit shqiptarë, të cilët birësonin një fëmijë, ishin të pakët ose birësimet bëheshin kryesisht nga prindër të cilët nuk mund të bëjnë fëmijë, duket se kjo situatë tashmë ka ndryshuar. Përpos birësimeve që kryhen nga shtetas të huaj, qytetarët shqiptarë tashmë përbëjnë numrin më të madh të prindërve birësues.

Nga të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror rezulton se në 5 Shtëpi Foshnjash (Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Durrës), 1 Shtëpi fëmijë parashkollor (Shkodër) dhe 3 Shtëpi fëmijë shkollor 6-14 vjeç (Tiranë, Shkodër, Sarandë) marrin shërbim 289 fëmijë . Më poshtë kemi dhënë një tabelë mbi kërkesat për birësim në Republikën e Shqipërisë, sa janë në Tiranë dhe sa prej tyre janë përfunduar. Tabela Nr. 1 Kërkesat për birësim 2004-2011

Emërtimi	Kërkesa për birësim	Të përfunduara	Kërkesa për birësim në Tiranë
2004	104	97	22
2005	109	105	22
2006	72	66	23
2008	100	96	27
2009	62	58	13
2010	62	50	20
2011	65	52	6

Burimi: Ministria e Drejtësisë , Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Fig. Nr. 1 Kërkesat për birësim

Në Tiranë kërkesat për birësim kanë ardhur në rritje. Nga të dhënat Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2003-2013 kemi këtë panoramë:

Viti	2013	2012	2011	2010	2009	2008	2007	2006	2005	2004	2003
Kërkesa për birësim në Tiranë	29	27	6	20	13	27	22	23	22	22	23
Të përfunduara	26	22	6	16	12	27	21	23	21	20	23
Të papërfunduara	3	5	0	4	1	0	1	0	1	2	0

Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Adaptimi nuk është vetëm një proces i fushës sociale por edhe i lidhur ngushtësisht me ekonominë familjare, sepse jo çdokush mund të birësojë një fëmijë. Mund të birësojë një familje që përveç kushteve të tjera ka edhe kushte të mira ekonomike sepse çdo birësim ka edhe një kosto të caktuar. Çiftet shqiptare paguajnë në favor të buxhetit të shtetit 20 000 (njëzet mijë lekë të reja) në përfundim të procedurës, ndërkohë që për shtetasit e huaj tarifa është 1000 (një mijë) dollarë për shtetasit që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit Europian; ose 700 (shtatëqind) euro për shtetasit që vijnë nga vendet e Bashkimit Europian. (Udhëzim Nr. 383/8, datë 29.4.2013 Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e Komitetit Shqiptar të Birësimeve). Vlen për t'u theksuar se Shqipëria është ndër të paktat vende që kanë një institucion shtetëror të ndërmjetësisimit dhe kryerjes së procedurave të birësimit, pasi në shumë vende të botës kjo procedurë kryhet nga agjensi private dhe tarifa e një birësimi

kushton 50-60 mijë dollarë.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve, gjatë rasteve të studiuara nuk merret thjesht me moshën e fëmijëve, por bën edhe përputhje të moshës së tyre me atë të prindërve birësues. Sipas të dhënave të marra nga ky institucion rezulton se kërkesat më të mëdha në vendin tonë për birësime kanë qenë për fëmijët e seksit femër dhe me moshë kryesisht nën 4 vjeç. Birësimi është relativisht i vështirë për t'u arritur në rastet e fëmijëve që janë mbi 3 vjeç, të sëmurë ose të paafatë. Birësimi është një situatë ligjore, e cila i ndryshon rrjedhën e jetës fëmijës jo vetëm nga këndvështrimi shoqëror por dhe juridik, duke arritur ti ndryshojë kështu dhe identitetin (marrja e mbiemrit të familjes që e birëson etj.)

Përfundime

Në institucionet e kujdesit social nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme për të lehtësuar kthimin e fëmijëve në familjet e tyre biologjike, ose ta lehtësojnë birësimin në një periudhë të shpejtë kohore pas braktisjes ose shpërfilljes. Në institucionet rezidenciale dhe sidomos në institucionet rezidenciale publike, cilësia e shërbimeve të ofruara është nën standardet që do të siguronin mbrojtjen e zhvillimin normal të fëmijëve. Institucionet rezidenciale nuk janë në gjendje t'i përgatisin fëmijët për një të ardhme të sigurt. Ata vuajnë nga pasojat e jetës në institute, çka del në pah në zhvillimin e fëmijës, në vlerësimin e ulët për vetveten, në rezultatet e dobëta në mësim si dhe në shanset e pakta për t'u bërë të pavarur pas periudhës së adoleshencës. Abuzimi me këta fëmijë nis me braktisjen e tyre dhe vazhdon me vendosjen e tyre në botën e veçuar të institucioneve. Në përgjithësi në qendrat e shërbimit social dominojnë shërbimet rehabilituese në raport me shërbimet parandaluese dhe integruese.

Deri në fillim të viteve '90 pjesa më e madhe e fëmijëve të vendosur në institucionet publike të kujdesit social ishin jetimë biologjikë; sot jetimët socialë përbëjnë kontingjentin më të madh.

Në 8 deri 15 vitet e fundit janë bërë një numër ndërhyrjesh që kanë ndihmuar të përmirësohen shërbimet dhe cilësia e jetës brenda institucioneve rezidenciale publike për fëmijët pa kujdes prindëror. Ka pasur gjithashtu përmirësime të tjera në sistemin e kujdesit social, përfshirë ngritjen e një numri institucioneve rezidenciale të drejtuara nga organizata jofitimprurëse dhe zhvillimin e formave alternative të kujdesit (përfshirë birësimin, rikthimin e marrëdhënieve fëmijë-prind, kthimin e fëmijëve në familjet e tyre biologjike, kujdesin e tutorëve dhe kujdesin në shtëpitë familjare).

Gjatë periudhës 1994-2006 u birësua një numër i madh fëmijësh (rreth 1000) pa probleme të pasbirësimit. Numri i birësimeve do të kish qenë edhe më i madh sikur legjislacioni që trajton problemet e birësimit të mos linte shteg për një keqinterpretim ligjor (që ka të bëjë me interesimin e vazhdueshëm prindëror), çka pengon ose ngadalëson birësimin për një numër të madh fëmijësh të vendosur në institucione rezidenciale.

Shtëpitë familjare strehojnë 17 për qind të fëmijëve që aktualisht ndodhen në sistemin formal të kujdesit social. Ky shërbim është një alternativë që ndihmon rritjen e shëndetshme të fëmijëve, që u ofron atyre një mjedis familjar me një nënë, vëllezër dhe motra, një shtëpi individuale dhe një komunitet që është afër tyre.

Rekomandime

Familja është mjedisi më i mirë për mbrojtjen dhe mirërritjen e fëmijës. Konventa e të Drejtave të Fëmijës sanksionon që familja është kujdestari kryesor për fëmijën; që kjo situatë mishëron interesat më të mira të fëmijës; dhe kurdo që është e mundur fëmijët duhet të rriten në familjen e tyre. Në qoftë se një fëmijë privohet përkohësisht ose përherë nga kujdesi i familjes së vet biologjike, atëherë duhet të veprojnë alternativat joinstitucionale, përkatësisht birësimi si forma më e më e përshtatshme e mirërritjes për fëmijët pa kujdes prindëror pasi .

Respektimi i KDF kërkon që të merren masa për të parandaluar vendosjen e fëmijëve në institucione; ose për ata që janë ndërkohë në institucione, të largohen prej aty sa më shpejt që të jetë e mundur. Për këtë qëllim nevojiten një numër veprimesh afatshkurtra e afatgjata:

*Duhet hartuar një politikë sociale bashkëkohore për të mbrojtur interesat e fëmijëve të privuar

nga kujdesi prindëror, duke zhvilluar forma alternative të kujdesit për fëmijën të cilat u sigurojnë fëmijëve një kujdes të qëndrueshëm në një mjedis familjar dhe duhet reformuar kuadri ligjor me qëllim që të trajtohen problemet me të cilat përballen fëmijët pa kujdes prindëror (të përmirësohet legjislacioni për birësimin, të zhvillohet legjislacioni për shërbimin e kujdesit tutorial dhe të hartohet një legjislacion për shërbimet sociale të ngritura mbi komunitet me synim kujdesin për fëmijët).

*Duhet të ngrihet Gjykata për të Miturit, e cila do të merrej me raste që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës.

*Duhet të ngrihet një sistem kombëtar i mbështetur mbi komunitetin për shërbimet sociale që u drejtohen fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, bazuar ky në një legjislacion të aktualizuar që përfill klasifikimin e fëmijëve, vendosjen e tyre nën kujdes dhe të drejtat e tyre, gjithashtu format e financimit, të mbikëqyrjes e të vlerësimit, si dhe besueshmërinë e sistemit.

* I duhet kushtuar një vëmendje më e madhe periudhës të pasbirësimit (Në shumë raste familja birësuese emigron duke e bërë të pamundur mbikëqyrjen pas birësimit. Legjislacioni aktual nuk parashikon sanksione ndaj këtyre shkeljeve të ligjit)

*Duhet të ngrihet e të përforcohet brendapërbrenda strukturave aktuale të shërbimit social një sistem informacioni i mbështetur mbi komunitet, me qëllim identifikimin (përfshirë identifikimin e hershëm) të fëmijëve që janë në rrezik braktisjeje ose shpërfilljeje.

Literatura

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar në vitin 1998.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, viti 2003.
- Ligji Nr. 9695, date 19. 03. 2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”,
- Raport studimor “Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror” financuar nga UNICEF 2005
- Oruci, G. (1994). E drejta familjare. Prishtinë.
- <http://www.drejtësia.gov.al/>
- <http://www.sociale.gov.al/>
- <http://www.sherbimisocial.gov.al/>
- <http://www.gjykatatirana.gov.al/>

Directors' "employment" in a corporation: Labor Law versus Company Law?

Dokt. Mirela Fana
Supreme Court of the Republic of Albania

Dr. Arnisa Gorezi
Supreme Court of the Republic of Albania

Abstract

The relationship between a corporation and its directors, as a classical agency conflict problem, has traditionally been at the center of legal debates on corporate governance around the world. In Albania however, discussions on legal aspects of corporate governance have remained, as of yet, at an underdeveloped stage.

Recognizing the academic and practical need to fuel such discussions, this paper focuses exactly on an analysis of the Albanian regulation of directors' "employment" in a corporation. It raises the question of whether company law can be applied beyond the hiring and dismissal procedures of directors and whether it can substitute the application of legal protections offered under labor law. Quite importantly, the paper also devotes special attention to the question of directors' definite term contracts and the legal consequences of a dismissal prior to the end of such term.

From a methodological perspective, the paper combines interpretation of relevant legal norms with a critical assessment of their application in various court cases. In terms of jurisdictions covered, while the paper's primary focus remains Albanian legislation, there will also be an inclusion of various examples from other jurisdictions, using the comparative functional method in order to highlight the way directors' employment in a corporation is regulated.

Keywords: corporate, governance, directors, labor, law.

Introduction: A theoretical framework of the position of executive directors in corporations

Historically speaking, the agency conflict in corporations with dispersed ownership has traditionally been at the center of legal debates in corporate governance. The conflict refers to the contradictions between the interests of the "owners" of the corporation, the shareholders and those in control of a corporation (the management or the appointing authority of the management) (Berle & Means, 1968, 23). Albeit from this perspective, corporate governance finds its theoretical origin from the concept of agency and trusts, it has developed as a separate discipline beyond the limits of the latter legal concepts (Zingales in: Newman, 1998, 497). As a separate area of law, corporate governance encompasses norms from various disciplines, such as corporate law, bankruptcy law, labor law and so on (Zingales in: Newman, 1998, 498).

The legal position of executive directors in a corporation should be theoretically structured in two categories.

The first one refers to the body of legal norms applicable regarding the appointment and removal of the executive directors as well as the provision of their functions and competencies.

The second category, which constitutes the focus of this paper, refers to those legal norms that regulate claims for unfair dismissal prior to the end of the director's term.

Regarding the first category, Albanian Law No. 9901 of 14th of April 2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (hereinafter Law 9901/2008) thoroughly details the applicable norms. For instance, article 95 of the above law regulates the nominating and removal procedures for executive directors (known also as administrators) in a limited liability company. An executive director is nominated for a period of no longer than 5 years with the right of reappointment, by a resolution of the General Assembly of the Shareholders. The same article, starting from paragraph 3 onwards, provides the core competencies of an executive director. The latter consist of what are known as internal management competencies, (referring to the day-to-day business of the company) and external management competencies (referring to the power of an executive director to represent

the company towards third parties) (Malltezi, 2011, 51). The removal of an executive director in a limited liability company can be done at any time by the appointing authority, the General Assembly of the Shareholders.

As regards public corporations, quite similar legal provisions are found in article 158 of the Law 9901/2008. The difference in regulating the position of an executive director between a limited liability company and a public corporation, refers mainly to the application of a different, shorter time limit for the term of the director, that is no more than three years with the right of renewal and the fact that depending on the provisions of the public corporation's statute, the executive director might be nominated and removed by the Board of Directors or by the general Assembly of the Shareholders directly, as provided in article 135/2 point c) of the above-mentioned law. The members of the Board of Directors should not be confused with executive directors (administrators), for under article 158/1 of Law 9901/2008, the Board of Directors is composed of executive and non-executive directors, provided also that a Board member can also be an executive director, as long as the majority of members of the Board are independent non-executive directors.

In similar fashion as with the case of limited liability companies, the competencies of the executive directors in a public corporation are listed in the same article 158/1 of the above law, from paragraph 3 onwards, while their removal by the Board of Directors is regulated in paragraph 7 of the same article. Furthermore, if the nominating and removing authority is the General Assembly of Shareholders, the same rule is applicable as per article 135/2 point c) of the law.

Regulating claims of unfair dismissal of an executive director

As provided in the above analyses, the technicalities for appointing and removing directors in public corporations and limited liability companies, as well as their core competencies and functions are to be found in the specific commercial law No. 9901/2008. Meanwhile, what is of utmost importance for our discussion, concerns the regulation of claims raised by executive directors in cases of unfair dismissal by a company prior to the end of their term. In other words, the main question raised with regards to the analyses of Albanian law at this point, is the identification of the law applicable with regards to the lawsuits that derive from a breach of the contract that covers the relationship between an executive director and the company, when the breach is caused by the latter.

As opposed to the detailed provisions provided for the methods of appointing and removing directors, as well as for their core functions, when it comes to regulating the above claims, the specific commercial law No. 9901/2008 offers no regulation.

Both article 95/6 and article 158/7 of the above law contain a general referral, according to which, lawsuits regarding remuneration of the executive director, stemming from his contractual relationship with the corporation, are regulated by the legal provisions in force. It is exactly this reference that brings the conclusion that the specific Albanian commercial law, does not intend to regulate the consequences of the unfair dismissal of an executive from a corporation.

Given that the commercial law does not cover such claims, the next logical question is identifying the applicable norms covering such possible lawsuits. If we analyze the relevant labor law provisions on the scope of application of the Albanian Labor Code as per the subject matter of the legal conflict, namely article 5 of this Code, we see an exclusion from its scope of application of the activity of members of a company board, that is limited only in the exercise of such functions (functions of a board member). *Prima facie*, this article appears to expressly exclude from the scope of application of the Labor Code the activity of company board members. However, bearing in mind the principle of interpreting legal norms in a harmonized fashion, in order to properly identify the intent of the legislator, another article of the Labor Code, namely article 4 provides that, albeit the employment regulated via specific laws is excluded from the scope of application of this law, special provisions of the Labor Code are still applicable, when the specific law provides no solution for problems regarding the employment relationship. This catch-all provision corresponds to the intent of the legislator to consider provisions of the Labor Code as a framework that will provide the necessary regulation when specific laws contain gaps on given aspects of an employment relationship (Malltezi, 2011, 51).

It is exactly the above article 4 of the Labor Code that identifies the law applicable in cases of claims raised by executive directors for unfair dismissal prior to the end of their term. While the specific commercial law covers matters such as appointment, removal and competencies of the executives, given that it does not provide specific regulation of claims for unfair dismissal of an executive as a typical form of a contractual claim between the executive director and the corporation, the relevant provisions of the Labor Code will be applicable. It is due to the legal gap identified in the commercial law, due to the reference made by the latter itself and due to the gap-filling nature of the norms contained in the Labor Code, that such Code will be applicable to cover lawsuits for unfair dismissal of an executive director.

Reaching the above conclusion derives not only from the integrated interpretation of the legal provisions of both, the commercial law and the labor law, but also as a result of the analyses of the very nature of the relationship between an executive director and the company. The executive director exercises his or her functions in the realm of managing the day-to-day business of the company and representing the latter in relations with third parties (Malltezi, 2011, 51). According to the Albanian commercial law, these two categories of competencies can be combined or separated, depending on what the statute of a company provides. In both categories of the competencies, however, there is an element of dependence from the company, meaning that their exercise is conducted in conformity with the orders of the company and under the supervision of the latter. This latter element of dependence and supervision is a typical feature of an employment relationship, as provided in article 12 of the Albanian Labor Code, where the employee exercises his or her duties under the orders and supervision of the employer, who, on the his part, provides remuneration for the work rendered. It is evident therefore that the essence of the contractual rapport between an executive director and the corporation is essentially of an employment nature (Malltezi, 2011, 51).

At this point of the discussion, there is another aspect worth mentioning, which consists in strongly opposing the idea that the relationship between an executive director and the company, should be regulated as any other agency relationship based on the Albanian Civil Code.

As elaborated previously in the opening theoretical discourse section of this paper, it is true that from an abstract point of view, the agency conflict stays at the center of most corporate governance debates (Berle&Means, 1968, 23). Certainly, while this theory has served as a starting point for conceptualizing the main problem of corporate governance, it still refers to an abstract concept of representation of the interests of the corporate "owners" and not to a direct legal representation relationship between shareholders and executive directors. At the same time, corporate governance as a discipline has evolved beyond the classical concepts of agency and trust, so that the relationship between the executive directors and the company (and through the latter, the indirect relationship with the shareholders, consisting in exercising executive functions in the best interest not only of the corporation, but also of the corporate shareholders), while conceptually it corresponds to an agency relationship, legally it goes beyond such categorization (Malltezi, 2011, 53). This means that the central conflict of corporate governance, cannot and is not indeed regulated via the general rules applicable to typical agency relationships contained in the Civil Code.

As a matter of fact, Albania, just like most other jurisdictions regulate such conflicts not by applying the provisions of the Civil Code on typical agency conflicts, but via other specific laws, such as commercial laws when they have stipulations regarding unfair dismissals, or labor laws in case of an absence of the former (Hopt&Leyens, 2004, 4). This is so for two main logical reasons.

First, the relationship of the executive is legally, as well as functionally a relationship with the corporation and not a direct agency relationship with the shareholders of a corporation. This means that, while the abstract concept of agency envisions the opposition between the shareholders and the executives, legally there is no direct agency relationship between the two, despite of the fact that more often than not, the shareholders have a direct say in nominating and removing said directors, via their votes in the General Assembly of the Shareholders.

Second, the fact that an executive director can represent the company in relations with third parties, should not cause the labeling of the contractual relationship between the executive and the company itself, as a typical agency contract. Not only does the executive exercise internal management functions apart from representation functions, but even in the case where such activity was to be limited only

in exercising external executive powers of representing the company, claims arising from unfair dismissal of an executive director would not have been regulated by the Civil Code articles on agency contracts, due to the fact that the relationship is a typical employment relationship (Malltezi, 2011, 51). This means that in the absence of specific regulation provided in the commercial law, the application of the Civil Code would still not be possible, because while the *lexspecialis* that is the commercial law provides no regulation of such claims, but makes reference to the applicable relevant laws, even within such reference, we are bound to apply the well-known principle of *lexspecialisderogatgeneralis*.

While the Civil Code serves as a *lexgeneralis* in its broad sense, its application would be possible only in cases where there is no other *lexspecialis*, different from the commercial law, to govern such contractual claims between the company and its executive directors. Identifying the applicable law is an escalated process in itself, meaning that when a specific law does not cover given claims, we will exhaust the next available specific laws and only in the absence of regulation by the latter, may we aim to apply the general law. Applying the *lexspecialisderogatgeneralis* principle in this escalated process, means that labor law, as the specific law covering such claims in a thoroughly comprehensive manner, stands in a preferential application order as opposed to the general norms of the Civil Code and leaves no room for the application of the latter to the relationship between a company and its executive directors.

The above analyses can also be found in other jurisdictions, where due to the fact that the default rules applicable in cases of commercial laws not covering such claims will be the highly protective labor law provisions, many corporations have implemented practices of signing special service contracts with their executives (Song& Wan, 2014, 10).

Given the high employee protection nature of various labor laws across different jurisdictions, signing a service contract right after the appointment of an executive director, avoids exactly the stringent indemnities provided under labor laws for cases of unfair dismissals of executives. As a matter of fact, such practices are quite common in commercial companies in jurisdictions such as Germany, the UK and the US (Hopt&Leyens, 2004, 4).

Albanian Court Cases

The same stance advocated in our paper with regards to the application of labor law provisions to claims for unfair dismissal of a corporate executive director, prior to the end of his term, in the absence of specific regulation by commercial laws (and of course in the absence of specific service contracts signed by the parties), is also applied in relevant Supreme Court cases in Albania. More specifically, the Supreme Court of the Republic of Albania has maintained such approach in the case of *V.B. vs. "Intersig" sh.a.*, where it dismissed the defendant's claim that the legal consequences of the dismissal of the executive director by the company, could not be regulated by the Labor Code. Contrary to such claim, the Civil Bench of the Supreme Court, reasoned that:

"...[T]he decision for removing the director from his functions, is nothing else but the very act of ending the employment relationship between the claimant and the defendant corporation... the absence of a formal contract signed by the parties, as well as the absence of specific provisions in the Albanian commercial law regulating the consequences stemming from such void acts, bring the court to the application of the relevant legislation in force, that regulates exactly the consequences of the dissolution of the employment relationship, namely articles 4, 143, 144, 145, 155 of the Labor Code...In the case at hand, the law on Commercial Companies does not provide specific regulation, covering the legal consequences for the dissolution of the employment contract between the executive director of a public corporation and the corporation itself and as a result, in order to regulate such consequences, reference shall be made to the Labor Code in force..."

The same position was maintained by the Supreme Court of the Republic of Albania also in the case of *K.M. vs. "Albkrom" sh.a.* concerning the dismissal of a liquidator in a company that was undergoing liquidation procedures. The Supreme Court was of the opinion that:

"...[T]his Bench considers the claim raised by the defendant "Albkrom" sh.a. (under liquidation) in its appeal to this court, that Law no. 9901 of 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies"

should govern the regulation of the consequences for the dismissal in this case, as unsustainable. Regarding the above, the absence of specific provisions in our commercial law, regulating the consequences of the dissolution of the labor relationship of a liquidator with the company, brings the court to the application of the labor law in force, namely articles 4, 143, 144, 145, 153 and 155 of the Labor Code. Such a conclusion derives from the application of the provisions of Law no. 9901 of 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" itself, namely article 193/2 of this law, according to which, claims related to indemnities of the liquidator, based on his contractual relationship with the company, are regulated by the applicable law in force, which in the concrete case refers to the relevant provisions of the Labor Code..."

Regarding the latter case, although it analyzes the dismissal of a company liquidator, the arguments remain the same, because not only does a liquidator take the same position of an executive director in the specific scenario when a company is undergoing a liquidation procedure, but also article 193/2 of Law No. 9901/2008 provides the exact same reference to the applicable law in force as in the case of executive directors.

In both the above decisions of the Supreme Court of the Republic of Albania, there is a clear tendency to clarify via interpretation the intent of the legislator in providing such references within the commercial law provisions, which is to guarantee the minimum protection standards offered by labor law to executive directors and liquidators in a company. Such aim was also highlighted in the Unified Decision of the Joint Benches of the Supreme Court No. 7 of 01.06.2011, where the court stipulated specifically that: *"...In the second paragraph of article 4 of the Labor Code, we have a reference of utmost value in the framework of legal guarantees of the position of employees, irrespective of where they work, be it the private or the public sector, they are guaranteed that their rights will be protected, even when the specific law does not provide for such protection or for a solution aimed at respecting their rights..."*

It is quite evident that the conclusion reached in the above case, is highly important also for regulating the claims arising out of the employment relationship of an executive director with the company. As long as the Albanian commercial law does not specifically regulate such claims, their regulation is to be found in the relevant labor law provisions.

Lastly, a final note on the uniqueness of the employment relationship of an executive with the company, is due here. Given the stipulation in the commercial law of fixed term mandates (maximum time limits that can be altered via statute provisions, of 5 years for limited liability companies and 3 years for public corporations), such employment contracts should be considered as definite term contracts. Given the above, the employment contract of an executive director will normally end at the end of his term, without prior dissolution as per article 149 of the Labor Code. If it is to happen prior to the completion of such term, it can be carried on without being considered as a case of unfair dismissal, only if such dismissal is for good cause. In the latter case, the law requires only the following of the respective dismissal procedure, provided in article 144 of the Labor Code, while in all other cases of unfair dismissals prior to the end of the executive's term, the company in the capacity of the employer, will have to bear the legal consequences of such dismissal, in the form of damages as per the relevant provisions of the Labor Code.

Conclusions

This article has analyzed the regulation of executive directors' employment in commercial companies in Albania, focusing mainly on the legal consequences of an early dissolution of the contract between the two and identifying the law applicable to such claims. It has briefly presented the theoretical discourse on the application of labor law versus commercial law with regards to unfair dismissal claims by corporate executives, explaining why the 'agency doctrine' remains unsuitable for properly covering such claims.

Furthermore, employing methods such as harmonized legal interpretation of relevant provisions from commercial and labor law, critical analyses of relevant theoretical perspectives and analyses of court cases, the article has concluded that, given the absence of specific provisions regulating

the consequences of an executive director's dismissal prior to the end of his term, such contractual relationship claims will be regulated by the relevant labor law provisions in force.

References

Books and Articles

Berle, A. & Means, G. (1968), *The Modern Corporation and Private Property*, (rev.ed.).New Brunswick-London: Transaction Publishers.

Hopt, K. J. & Leyens, P. C. (2004), *Board Models in Europe - Recent Developments of Internal Corporate Governance Structures in Germany, the United Kingdom, France, and Italy*. ECGI Law Working Paper No. 18.

Malltezi, A. (2011), *E Drejta Shqiptare e Shoqërive Tregtare*, (1st ed.). Tirana: Mediaprint.

Song, W.-L. & Wan, K.-M, (2014) *Explicit Employment Contracts and CEO Compensation*, Social Science Research Network Publication, <http://ssrn.com/abstract=2514823> (last visited on December 11th 2014).

Zingales L. in: Newman, P. (ed.) (1998), *The New Palgrave Dictionary of Economics and the Law*, New York: Macmillan, 497-503.

Laws and Court Decisions

Civil Code of the Republic of Albania, Law No. 7850 of 29.07.1994 (as amended).

Constitution of the Republic of Albania, approved by Law No. 8417 of 21.10.1998 (as amended).

Labor Code of the Republic of Albania, Law No. 7961 of 12.07.1995 (as amended).

Law No. 9901 of 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (as amended).

Decision No. 02 of 03.02.2010 of the Constitutional Court of the Republic of Albania.

Decision No. 501 of 09.10.2014 of the Supreme Court of the Republic of Albania.

Decision No. 59 of 07.02.2012 of the Supreme Court of the Republic of Albania.

Unified Decision No. 7 of 01.06.2011 of the Joint Benches of the Supreme Court of the Republic of Albania.

E drejta për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme

PhD. Cand. Milot Krasniqi
Agjencia kundër Korrupsionit, Prishtinë

PhD. Cand. Albulena Hajdari
Kolegji Universitar "Iliria" Prishtinë

Ma. Sc. Adnan Bucolli
Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, Prishtinë

Hyrje

E drejta për gjykim të drejtë dhe nëafat të arsyeshëm është njëra ndër parimet më të rëndësishme në drejtësi. Parimet procedurale penale kanë rëndësi jetike për zhvillimin e drejtë dhe të ligjshëm të procedurës penale në përgjithësi dhe për mbrojtjen e të drejtave të pandehurit nëveçanti.

Kosova si shtet i ri, synon të ndërtoj sistem të pavarur të drejtësisë, të bazuar në parimet dhe standardet demokratike. Me Kushtetutën e Kosovës (më tej: KRK), janë paraparë një mori parimesh të natyrës procedurale penale, të cilat janë garantë e frymës së humanizmit, drejtësisë dhe barazisë së qytetarëve. Në pajtim me parimin e hierarkisë juridike, çdo akt juridik duhet të jetë në pajtim me frymën e parimeve që janë të proklamuar në kushtetutë, përfshirë edhe Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale (më tej: KP dhe KPP). Lidhshmëria e Kushtetutës me KPP dhe KP është e pashkëputshme dhe e varur reciprokisht, sepse pothuajse çdo cenim ose shkelje e parimeve kushtetuese rezulton me kryerje të veprës penale, me çka krijohen kushtet ligjore që kryerësi të ndiqet penalisht dhe të dënohet.

Qëllimi i punimit është që të paraqes një studimpër të drejtënjë gjykimtë drejtë dhe në kohë të arsyeshme në procedurë penale. Gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme është parakusht për zhvillimin e drejtë dhe të ligjshëm të procedurës penale dhe se që të jetësohet ky qëllim, në çdo rast ky parim duhet që të respektohet.

1. Kuptimi i parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme

Në drejtësi parimet janë rregulla themelore dhe udhërrëfyese në bazë të të cilave ndërtohet dhe funksionon një institucion i së drejtës (Krasniqi, 2013, 2). Parimet si rregulla të përgjithshme udhëzuese parashihen me Kushtetutë si dhe me KPP. Ato kanë rëndësi të madhe në zhvillimin e procedurës penale sepse janë garantëe lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe pengesë e veprimeve abuzive, arbitraritetit dhe tejkalimit të autorizimeve ligjore nga gjykatat, me rastin e zhvillimit të procedurës penale.

KRK në mënyrë parimore parasheh edhe parimet e natyrës juridike penale, të cilat përcaktojnë kufizimin e pushtetit represiv të shtetit si dhe garantojnë ndërmarrje të veprimeve të ligjshme gjatë zhvillimit të procedurës penale. "E drejta për gjykim në afat të arsyeshëm është garanci për mbrojtjen e të drejtave të pandehurit nga zvarritja a paarsyeshme e procedurës penale (Zendeli, 2009, 3)"Ky parim vepron në dy rrafshë, së pari mbron interesin e të pandehurit dhe së dyti, krijon siguri tëpërgjithshme juridike. Procedura penale e mbështetur në këtë parim, ka karakter të drejtë dhe të ligjshëm, kursemungesa e tij atë e shndërron në procedurë arbitrarë dhe shkelëse të të drejtave të pandehurit dhe kësisoj shkakton pasiguri tëpërgjithshme juridike.

Sipas praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (më tej: GjEDNj), gjykimi brenda afatit të arsyeshëm nuk është kategori fikse e përcaktuar në mënyrë strikte, por një standard të cilin gjykata e vlerëson në mënyrë të veçantë në çdo rast konkret. Nëse një afat është i arsyeshëm, ose jo, vlerësohet nga rasti në rast. Afat i arsyeshëm përfshinë kohën nga inicimi i procedurës penale

e deri në përfundimin e saj në instancën më të lartë të mundshme (Zendeli, 2009, 3, Sadiku, 2009, 65 & Abdiu, 2012, 4.) GjEDNj për mosrespektimin e parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, përgjegjëse i bën shtetet si subjekte të së drejtës ndërkombëtare, e jo institucionet shtetërore konkrete. Shteti në këtë rast përgjigjet jo vetëm për gjykatat por për të gjitha institucionet e tij.

2. Qëllimi i parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme

Qëllimi i parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme është arritja e drejtësisë ligjore dhe efikase. **Drejtësia ligjore** nënkupton verifikimin e fakteve relevante dhe zbatimin e drejtë të normave procedurale dhe materiale në procedurë penale, ndërsa **drejtësia efikase** synon që këto qëllime të ligjshmërisë të arrihen në afat sa më të shkurtër, në mënyrë që i pandehurit të drejtat e tij t'i realizojë sa më parë. Shpeshherë në praktikë ligjshmëria dhe efikasiteti nuk shkojnë së bashku, megjithatë, instituti i gjykimit në afat të arsyeshëm paraqet një të arritur juridike të botës së civilizuar i cili i përgjigjet sigurisë juridike të çdo qytetari.

3. Elementet e gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme

E drejtapër gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme në praktikë është i kushtëzuar nga disa parime procedurale penale, të cilat do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

3.1. Qasja e barabartë në drejtësi

Qasja efektive dhe e barabartë në drejtësi është element i gjykimit të drejtë dhe një standard i drejtësisë bashkëkohore i cili ju mundëson të gjithë qytetarëve mundësi të barabarta që t'i përfaqësojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre në procedurë gjyqësore, veçanërisht në procedurë penale. Qasjen e barabartë në drejtësi e mundëson shteti, edhe në rastet kur i pandehuri nuk ka mundësi që të angazhojë avokat mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave të tij. Në këto raste shteti ka obligim që të ofrojë ndihmë juridike falas për të pandehurin, në mënyrë që gjendja e tij jo e mirë financiare dhe mosnjohja e drejtësisë të mos jenë pengesë për qasje të barabartë në drejtësi. Në nenin 31 të KKK është garantuar qasja në drejtësi, përmes ndihmës juridike falas, e cila i mundësohet çdo qytetari i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të paguar shpenzimet e procedurës gjyqësore, kur ndihma e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi (Krasniqi, 2013, 2-3). Ndihmën juridike falas e njej dhe e garanton Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (më tej: KEDN) në nenin 6 (paragrafi 3, pika c), sipas të cilit çdo person i akuzuar ka të drejtë të mbrohet vet ose nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij ose në mungesë të mjeteve për të shpërblyer mbrojtësin, atij i mundësohet ndihma juridike pa pagesë kur këtë e kërkon interesi i drejtësisë.

3.2. Prezumimi i pafajësisë

Prezumimi ose supozimi i pafajësisë është njëra nga garancitë më të rëndësishme të sigurisë juridike në të drejtën penale dhe pjesë e pandashmë e gjykimit të drejtë. Ky parim është inkorporuar në nenin 31 (paragrafi 5) të KKK, me të cilin përcaktohet se çdo person i akuzuar për veprë penale, konsiderohet i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij, me vendim përfundimtar nga gjykata kompetente, në pajtim me ligjin. Prezumimi i pafajësisë e lehtëson pozitën procedurale të të pandehurit në procedurë penale dhe e ngarkon Prokurorin e Shtetit (më tej: PSh) për vërtetimin e pretendimeve të akuzës, përkatësisht barrën e të provuarit. KPP në nenin 3 (paragrafi 1), e parasheh Prezumimin e pafajësisë, sipas të cilit çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Parimi i prezumimit të pafajësisë duhet të respektohet në të gjitha fazat e procedurës penale. Për organin e procedurës, personi nën hetim duhet të konsiderohet i pafajshëm edhe pse është marrë si i pandehur dhe ndaj tij është caktuar ndonjë masë sigurimi. Asnjëherë nuk duhet të paragjykohe

për fajësinë e personave të dyshuar, arrestuar apo të akuzuar për vepra penale, pasi që praktika ka dëshmuar në shumë raste se shumë persona që akuzohen për vepra penale në fund dalin të jenë të pafajshëm, andaj një person do të konsiderohet fajtor vetëm pasi që aktgjykimi dënues me të cilin gjykata e ka shpallur fajtor të këtë marrë formën e prerë (Krasniqi, 2014, 9458). Në çdo rast kur organi i akuzës nuk arrin të vërtetojë pretendimet e akuzës, i pandehuri duhet të lirohet. Sipas këtij parimi çdo çështje e ngritur në shqyrtim gjyqësor që nuk mund të vërtetohet me prova të besueshme, shkon në favor të të pandehurit sipas parimi *In dubio pro reo* (neni 3, paragrafi 2i KPP).

3.3. E drejta për t'u mbrojtur

E drejta për t'u mbrojtur është njëra nga të drejtat themelore të të pandehurit në procedurë penale dhe element i pandashëm i gjykimit të drejtë. Sipas nenit 11 (paragrafi 2) të KPP, i pandehuri ka të drejtë të mbrohet personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit i cili është anëtar i Odës së Avokatëve, sipas zgjedhjes së tij. “E drejta nëmbrojtje ushtrohet nga vet i pandehuri e në rastet më të shpeshta nga mbrojtësi i tij” (Mahonye, 2004, 125).

Gjykata ose organi kompetent i cili e zhvillon procedurën penale detyrohet ta njoftojë të pandehurin për të drejtën e tij në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të parë, ashtu siç parashihet me KPP. Në parim, i pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta e mbrojtjes përmbushet me angazhimin e të paktën një mbrojtësi (neni 55, paragrafi 2i KPP). Për shkak të ndjeshmërisë dhe seriozitetit që ka procedura penale, i pandehuri zakonisht angazhon avokat mbrojtës. Kjo qasje vlerësohet si pragmatike për faktin se të pandehurit në shumicën e rasteve ju mungon përgatitja juridike, andaj mbrojtësi ju ndihmon që të përgatisin në mënyrë profesionale mbrojtjen. Fakti i mosnjohjes së drejtësisë nga i pandehuri nuk duhet të jetë pengesë që ai të mos i realizojë të drejtat e tij në procedurë penale.

3.4. Barazia e palëve në procedurë penale

Sipas nenit 9 të KPP, palët në procedurë penale (PSh si paditës i autorizuar dhe i pandehuri, ndaj të cilit është adresuar akuza), konsiderohen si palë të barabarta, nëse me dispozitat e KPP nuk parashihet ndryshe. Barazia e palëve në procedurë penale është parim themelor procedural i cili ju mundëson palëve pozitë juridike të barabartë me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre dhe përfaqësimit të interesave të tyre, duke ju dhënë të drejta dhe autorizime të njëjta, siç është propozimi i dëshmitarëve, dhënia e propozimeve për prova, shikimi i shkresave të lëndës e tjera (Sahiti&Murati, 2013, 106). Barazia e palëve duhet të vijë në shprehje në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës penale, më së shumti gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, në të cilin palët i ballafaqojnë provat dhe faktet që disponojnë, dëshmitarët dhe ekspertët si dhe pretendimet tjera në lidhje me çështjen penale. Megjithatë, në praktikë PSh si përfaqësues i shtetit, ka pozitëtejet autoritative në procedurë penale.

3.5. Ekzistimi i Gjykatave të pavarura dhe të paanshme

Shtetet demokratike i karakterizon parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror dhe i kontrollit reciprok ndërmjet tyre (checkandballance). “Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e pavarura, si subjekt themelor të procedurës gjyqësore, përgjegjëse për ushtrimin e funksionit të gjykimit përkatësisht dhënies së drejtësisë ndërmjet palëve procedurale” (Hajdari, 2013 I, 111). Pushteti gjyqësor në Kosovë organizohet dhe funksionon mbi bazën e Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat (më tej: LGJ). Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, kurse gjyqtarët janë të pavarur dhe të paanshëm (neni 102 i KRR).

MeL Gjnjë mënyrë të detajuar rregullohet organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave në Kosovës. Ai vendos bazat e një gjyqësie të pavarur dhe të paanshme, shumetnike, jo diskriminuese, efikase dhe në parim, me mundësisë që opinioni publik të përcjell veprimtarinë e gjykatave (Hajdari, Ibrahim & Hajdari, 2014, 231). Bazuar në këto fakte, del se Kosova ka ndërtuar sistem të pavarur

dhe të paanshëm gjyqësor, të garantuar me Kushtetutë dhe ligj, si njëra ndërgarancitë e gjykimit të drejtë, mirëpo sistemi i drejtësisëaktualisht është duke u sfiduar nga pavarësia dhe depolitizimi, numri i lëndëve të shumta të pagjykuara dhe të pa ekzekutuara, përballja me krimin e organizuar, korrupsionin dhe format tjera të rënda të kriminalitetit si dhe mundësitë e vogla të përfshirjes së gjeneratave të reja nësistemin e drejtësisë.

4. Rregullativa juridike e parimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është një nga problemet kyçe të drejtësisë penale në Kosovë, andaj edhe mbrojtja e të drejtës në gjykim brenda afatit të arsyeshëm, aktualisht, është një nga çështjet më të rëndësishme juridike. Gjykimi i drejtë dhe në kohë tëarsyeshmeështë paraparëmeKRRK, KPP si dhe me KEDNj.

4.1. Gjykimi i drejtë dhe në kohë tëarsyeshme sipas Kushtetutës së Kosovës

Në nenin 31 (paragrafi 2) të KRRK, përcaktohet se çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet, ose për çdo akuzë penale që ngritet kundër tij, brenda afatit të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. Në kuptim të kësaj dispozite parimore, **gjykimi i drejtë** nënkupton faktin se vetëm gjykatat e pavarura do të vendosin për fajësinë ose pafajësinë e secilit individ, ndaj të cilit ngritet ndonjë akuzë penale, bazuar në respektimin e dispozitave të cilat garantojnë mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, kurse **gjykimi në kohë të arsyeshme** nënkupton se në çdo rast kur ndaj kujtdo ngritet ndonjë akuzë penale, sa më shpejt që është e mundur duhet të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe të zgjidhet çështja penale, duke e arritur efikasitetin në procedurë penale.

Në funksion të jetësimit të parimit të gjykimit të drejtë dhe të arsyeshëm, KRRK me nenin 32 i garanton secilit person që të përdorë mjetet juridike, në rastet kur konsideron se i janë shkelur ose mohuar të drejtat e caktuara. Për shkak të ashpërsisë së sanksioneve penale, e drejta për mjet juridik ka rëndësi të veçantë në shqyrtimin e aktgjytimeve penale të shkallës së parë (Hasani&Cukalovic, 2013, 112). Ky parim shërben si korrektor i punës së gabuar ose të padrejtë që mund të bëjnë gjykatat (Krasniqi, 2014, 9462).

Në zhvillimet bashkëkohore, liritë dhe të drejtat e njeriut nuk konsiderohen vetëm çështje e brendshme e shteteve, por vlera të njerëzimit të cilat mbrohen me të drejtën ndërkombëtare, e cila është detyruese për shtetet. Në nenin 22 të KRRK është paraparë zgjidhja sipas të cilës në Kosovë janë të zbatueshme drejtpërdrejt një mori e akteve ndërkombëtare, me të cilat mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut, përfshirë edhe KEDNj e cila e garanton parimin e gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

Në nenin 113 (paragrafi 7) të KRRK si dhe në nenet 47-49 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, është rregulluar çështja e adresimit të kërkesave individuale në lidhje me shkeljen e të drejtave të mbrojtura me KRRK. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike kur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Individu mund ta parashtrojë kërkesën vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, duke specifikuar të drejtat dhe liritëqë janë cenuar si dhe aktin konkret të autoritetit publik të cilin parashtroesi e konteston. Për dallim nga Gjykata Kushtetuese, gjykatat e rregullta nuk i mbrojnë liritë dhe të drejtat si kompetencë të posaçme, por përmes zgjidhjes së kontesteve në lëmi të ndryshme të së drejtës, ato vendosin për këto të drejta.

4.2. Gjykimi i drejtë dhe në kohë tëarsyeshme sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisëpër të Mitur

Sipas nenit 5 (paragrafi 1) të KPP, çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale, ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme. Në kuptim të këtij parimi, gjykimi i drejtë nënkupton që asnjë person i pafajshëm të mos dënohet kurse fajtorit t'i caktohet dënimi meritor. Gjykatat duhet kushtuar kujdes të veçantë posaçërisht masave me të cilat kufizohet

liria e personave, që ato të zgjasin vetëm për aq kohë sa është më se e domosdoshme në mënyrë që të mbrohen liritë dhe të drejtat e të pandehurit. Gjykatat duhet të kenë kujdes veçanërisht për çështjet që ndërliken me afate në mënyrë që të pandehurit të mos e humbin ndonjë të drejtë si pasojë e mosrespektimit të afatit nga ana e gjykatës.

Jetësimit të parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme i kontribuon edhe parashikimi i afateve kohore brenda të cilave duhet të përfundojë procedura penale. Në nenin 314 të KPP, janë parapara afatet kohore brenda të cilave duhet që të përfundojë shqyrtimi gjyqësor. Nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, si rregull ai duhet të përfundojë brenda 90 ditësh, kurse nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, ai si rregull duhet të përfundojë brenda 120 ditësh. Me nenin 153 të Kodit nr. 03/L-193 të Drejtësisë për të Mitur është garantuar gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme edhe në procedurën penale për të mitur. Si rregull në procedurë penale për të mitur gjykata dhe organet tjera janë të obliguara që të veprojnë me urgjencë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të të miturit të pandehur.

4.3. Gjykimit i drejtë dhe në kohë të arsyeshme sipas të drejtës ndërkombëtare

Neni 6 (paragrafi 1) i KEDNJ, parasheh se në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile ose ndaj akuzës penale, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit. “Në praktikë nuk ka ndonjë afat kohor të përcaktuar strikt se sa është kohëzgjatje e arsyeshme për të proceduar një rast gjyqësor, por kjo varet nga rrethanat e çdo rasti konkret. GjEDNJ në shumë raste ka konstatuar se vonesat e paarsyeshme të gjykimeve, përbejnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit juridik vendor (Sadiku, 2009, 65).

Kur palët me sjelljet e veta i kontribuojnë zvarritjes së procedurës gjyqësore apo kur kemi ndërlikueshmëri të rastit, atëherë nuk kemi të bëjmë me shkelje të këtij parimi. Shtetet veç e veç duhet të kujdesen që të respektohet në përpikëri parimi i gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, në të kundërtën, çdo cenim i këtij parimi vërteton thënien e njohur se “Çdo drejtësi e vonuar, është drejtësi e mohuar”. “Në lidhje me gjykimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme vlen edhe shprehja “Koha është flori”. Vlerësimi nëse një proces është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm ose jo, vlerësohet duke marrë në parasysh ndërlikueshmërinë e çështjes; Sjelljen e kërkuesit; Sjelljen e autoriteteve përkatëse dhe Llojin e kontestit (Kuijer, 2013, 781-782; Abdiu, 2012, 1)”.

Të drejtën në gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme e garanton edhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut në nenin 11 (paragrafi 11) dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 14 (paragrafi 3, pika c). Edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës në nenin 40 (paragrafi 2, pika iii), përcakton se procedura penalendaj të miturve zhvillohet pa vonesë, nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose ndihmës tjetër të përshtatshme, dhe kur konsiderohet se kjo është në interesin e fëmijës, sigurohet edhe praninë prindit ose përfaqësuesit të tij ligjor.

5. Rëndësia e parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme

Parimet si rregulla të përgjithshme udhëzuese, kanë rëndësi të madhe në zhvillimin e procedurës penale. Parimet janë garantëe lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe janë pengesë e veprimeve abuzive, arbitraritetit dhe tejkalimit të autorizimeve ligjore, me rastin e zhvillimit të procedurës penale. Parimet kushtetuese kanë rëndësi të veçantë sepse vendosin kufijtë e pushtetit represiv të shtetit, ndalojnë tendencat e veprimeve abuzive, arbitraritetit të bartësve të pushtetit gjyqësor ndaj qytetarëve si dhe garantojnë se veprimet procedurale të ndërmarra nga këto subjekte janë të ligjshme dhe të drejta.

Vonesat e paarsyeshme e dëmtojnë gjykimin e drejtë, krijojnë ankth tek palët, rezultojnë me humbje ose shkatërrim të provave materiale, gjykimet e vazhduara për një kohë të gjatë e të paarsyeshme paraqesin kohën në mes të “drejtësisë së vonuar” dhe “drejtësisë së mohuar”, andaj me të drejtë mund të themi se “Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar” (Hoxha, 2012, 118).

6. Përfundime

Gjykimi i drejtë dhe në kohë tëarsyeshmeështë parim themelor i drejtësisë në përgjithësi dhe asaj penale në veçanti. Ky parim është një e arritur e shteteve demokratike, i cili i obligon gjykatat vendore që të kujdesen exofficio që të procedojnë sa më shpejt qëështë e mundur rastet penale, në mënyrë që i pandehurit të mos i shkelen të drejtat për shkak të vonesave të panevojshme tëpalëve në procedurë penale.

Parimi i gjykimit të drejtë dhe në kohë tëarsyeshmeështë i garantuar shprehimisht me Kushtetutë, KPP edhe me LGj. KPP në mënyrë shprehimore ka paraparë edhe afatet kohore brenda të cilave duhet që të përfundojë procedura penale. Parashikimi i afateve i kontribuon jetësisht të parimit të gjykimit në kohë të arsyeshme dhe është në funksion të mbrojtjes të të drejtave të pandehurit në procedurë penale.

Në lidhje me cenimin e parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, palët kanë të drejtë qëçështjen ta referojnë në institucionet përkatëse. Në Kosovë secili që i shkelet e drejta në gjykim të drejtë dhe në kohë tëarsyeshme mund t'i referohet GjK e si mundësi të fundit t'i drejtohen edhe GjEDNj. Në praktikë shumica e rasteve të cilat referohen në GjEDNj ndërlidhen me shkeljen e parimit për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Përveç GjEDNj e cila merret ekskluzivisht me interpretimin e KEDNj, në lidhje me vlerësimin e jetësisht të parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë tëarsyeshme vepron edhe Komisioni Europian për Eficiencën e Drejtësisë (KEED).

Në praktikën gjyqësore shtyrja e shpeshtë e seancave gjyqësore për një kohë të pacaktuar në gjykatat e Republikës së Kosovës i kontribuon shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

Reformimi i sistemit gjyqësor në Kosovë ka krijuar mundësi më të mëdha që të jetësohet parimi i gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Riorganizimi i gjykatave, rritja e numrit të gjyqtarëve si dhe përmirësimi i kushteve të punës në gjykata, pritet që të ndikojë në efikasitetin e punës së gjykatave edhe në lidhje me jetësimin e parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

Referencat

I. Libra dhe artikuj shkencorë:

- Abdiu, F. (2012), Mbi gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, Gazeta Java, datë 10.06.2012, Tiranë.
- Craen, G. V. & Gatti, E. (2010), Koha e arsyeshme, Avokatura, nr. 9, Prishtinë.
- Hajdari, A. (2013, I), Bazat e sistemit gjyqësor, Prishtinë.
- Hajdari, A. Ibrahim, Sh. & Hajdari A. (2014), Reforming of the Judicial System of Kosovo based on the Law no. 03/L-199 on Courts and its challenges, Iliria International Review, no. 2014/1, Prishtinë.
- Hoxha, M. (2012), Gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme si element themelor i sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës, Avokatura, nr. 13, Prishtinë.
- Krasniqi, M. (2014), The importance of implementation of constitutional principles in criminal procedure, European Academic Research [EAR], Vol. II, Issue 7, Bucharest.
- Krasniqi, M. (2013), Sistemi i ndihmës juridike falas në Republikën e Kosovës, Drejtësia Shqiptare, nr. 2, Tiranë.
- Kuijjer, M. (2013), The right to a fair trial and the Council of Europe's efforts to ensure effective remedies on a domestic level for excessively lengthy proceedings, Human Rights Law Review, no. 13, Oxford.
- Mahonye, P. (2004), Right to a fair trial in criminal matters under Article 6 ECHR, Judicial Studies Institute Journal, Volume 4, no. 2, Dublin.
- Mole N. & Harby, C. (2006) The right to a fair trial, Strasbourg.
- Rexhep, M. (2006), Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë.
- Sadiku, I. (2009), E drejta për një proces të drejtë, publik, brenda një kohe të arsyeshme, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në dritën e nenit 6 të KEDNj dhe legjislacionit në Republikën e Kosovës, Justicia, nr. 1, Prishtinë.
- Sahiti, E. & Murati, R. (2013) E drejta e procedurës penale, Prishtinë.
- Zaganjori, Zh. Anastasi A. & Çani, E. (2011), Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,

Tiranë.

Zendeli, E. (2009), E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, Revista Shqiptare për Studime Ligjore (RShSL) nr. 4, Tiranë.

II. Akte normative:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, [10.12.1948], Prishtinë, 2012.

Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur, [Gazeta Zyrtare nr. 78, datë 20.10.2010].

Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, [Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 13.07.2012].

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, [Gazeta Zyrtare nr. 37, datë 28.12.2012].

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, [04.11.1950], Prishtinë, 2005.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 44/25, datë 20.11.1989.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.

Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat [Gazeta Zyrtare nr. 79, datë 24.08.2010].

Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës [Gazeta Zyrtare nr. 46, datë 15.01.2009].

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 2200 A (XXI), datës 16.12.1966.

III. Burime tjera:

Grup autorësh, (2002), Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), (2013), Drejt drejtësisë - Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, Tiranë.

Organization for Security and Co-Operation in Europe (OSCE), (2012), Legal digest of international fair trial rights, Warsaw.

E drejta e tubimit publik - aspekte kushtetuese

PhD.cand. Flamur Hyseni

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Abstrakt

Freedoms and human rights are now in focus and international state except him. Respect for and protection of fundamental freedoms and human rights in some countries still remains the main challenge of consolidating democracy. In this regard the difficulties in protecting the rights and freedoms are as individual freedoms as well as collective freedoms.

Further on freedom of expression continues to be among the freedoms that are defines the level of democratic development of countries. In this respect the right of public assembly in many cases is determining the degree of democratization of the country.

The Republic of Kosovo on questions about guaranteeing and protecting the right of public assembly, has set these entitlements in the Constitution of 2008, Article 43, freedom of assembly. Organization of public meetings is regulated by Law no. 03 / L-118 for public gatherings.

Even the international aspect of the right of public assembly presents a major challenge to the consolidation of democracy and the commitment of the state to guarantee and protect the fundamental human rights as freedom.

Key words: public rally, protest, demonstration, freedom, freedom of expression, state, police.

Hyrje

Zakonisht e drejta e tubimeve publike manifestohet përmes organizimit të protestave të ndryshme për të kërkuar dhe shprehur ndonjë paknaqësi kolektive në raport me zhvillimet e ndryshme në shtet dhe shoqëri. Në Kosovë ekzistojnë praktika të ndryshme të shfrytëzimit të lirisë së tubimit publik, si para ashtu edhe pas luftës.

Përmes këtij punimi synojë që të studiojë bazën ligjore të lirisë së tubimit publik dhe qasjen e institucionve shtetërore lidhur me organizimin e protestave të 14 dhe 22 janarit 2012 në Merdare dhe Dheu i Bardhë të organizuara nga Lëvizja Vetvendosje lidhur me aplikimin e masave të reciprocitetit nga ana e Qeverisë së Kosovës për mallrat e serbisë që do të hynin në tregune Kosovës.

Në punim kam analizuar të drejtën e etubimit publik në mënyrë krahasuese mes Kosovës dhe Shqipërisë, bazën ligjore për organizimin e tubimit publik dhe raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me protestat e 14 dhe 22 janarit 2012 të organizuara në Merdare dhe Dheu i Bardhë.

Si për çdo punë kërkimore shkencore dhe analitike që kërkohet shfrytëzimi i metodave të ndryshme për arritjen e objektivave sa më të sakta edhe në këtë punim kam aplikuar metodën normative, analitike, historike, narrative, krahasuese.

E drejta e tubimit publik, e drejtë kushtetuese e qytetarëve

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e veçanërisht e drejta e tubimeve publike është trajtuar edhe në aspekt teoriko – juridik dhe shkencor, sidomos në tekstet e lëndëve si e drejta kushtetuese të fakulteteve juridike të të gjitha universiteteve.

E drejta e tubimeve publike si një nga të drejtat themelore dhe e cila përcakton bazën e një shoqërie demokratike. Kjo e drejtë përfshinë takimet private dhe publike, në vendet publike. Kjo e drejtë mund të njihet edhe si liria e tubimit dhe e grumbullimit publik.

Liria e tubimit publik mund të kuptohet edhe si e drejtë e shtetasve që lirisht të tubohen dhe publikisht, në mënyrë të organizuar, të mbajnë fjalime dhe të shprehin mendimet e tyre lidhur me

çështjet e tyre. Është e njohur edhe liria e grumbullimeve publike, e cila njihet si liri politike, është e drejtë e shtetasve me pikëpamje identike që të grumbullohen në vende të përshtatshme publike dhe publikisht të shprehin bindjet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështje të ndryshme politike. Nga trajtimet teorike kushtetuese që janë bërë lidhur me të drejtën për lirinë e tubimit publik, del se, janë edhe disa kufizime pastaj të përcaktuara me kushtetuta dhe me ligje, ndërsa me ligj janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar edhe kufizimet edhe çështjet tjera të organizmit të një tubimi publik.

E drejta e lirisë së tubimit publik ka një rëndësi, sepse ajo shpesh here është kusht për ushtrimin e lirive tjera, si lirisë së mendimit, mësimdhënies, kultit e tjera. Ka shumë rëndësi të dihet se kur domosdoshmërisht duhet të merret leja për tubim publik dhe kur tubimi publik, qoftë ai edhe privat mund të bëhet edhe pa leje të tilla. Leja duhet të merret paraprakisht dhe duhet njoftuar organet e rendit, atëhere kur tubimi publik do të mbahet në vende të caktuara publike, ndërsa për aktivitete tjera në të cilat mund të jenë tubime private dhe të hapura për publikun nuk ka nevojë për marrje të lejes nga organet e rendit.

E drejta e tubimit publik, si e drejtë themelore e qytetarëve dhe e drejtë kushtetuese është e garantuar me kushtetuta të shteteve edhe në nivel ndërkombëtar.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, është akt ndërkombëtar që garanton të drejtën e tubimit publik të të gjithë qytetarëve, duke përcaktuar se, “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor”. Nga ky përkufizim del se pa asnjë dallim Deklarata u njuh të gjithëve të drejtën e lirisë së tubimit publik dhe mbledhjes së tyre dhe bashkimit paqësor.

Në kontinentin evropian, është Konventa Evropian për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore e cila garanton të drejtën e lirisë së tubimit publik, duke e përcaktuar se, “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerët të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij”, nga ky përkufizim del se, Konventa garanton të drejtën e një lirie më të zgjeruar të të gjithëve për tubime paqësore dhe organizime tjera, duke ju referuar edhe të drejtës së themelimit të sindikatave për të mbrojtur interesat e tyre. Konventa përcakton edhe disa kufizime tjera lidhur me ushtrimin e të drejtës për lirinë e tubimit publik dhe paqësor, duke përcaktuar se, “Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”

Në aspekt kushtetues, liria të drejtës së tubimit publik është e rregulluar me kushtetuta e shteteve përkatëse, dhe kjo liri është pjesë e lirive tjera themelore që garantohen me kushtetutë.

Kushtetuta e Republikës së Koosvës (2008), në kuadër të kapitullit të dytë, përcakton këtë të drejtë si “liria e tubimit”, duke përcaktuar shprehimisht se, “Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.”

Nga ky përkufizim del se, në kuadër të lirisë për tubim Publik, të gjithëve u njihet e drejta e lirisë për të organizuar protesta dhe demonstrata dhe të drejtën e të gjithëve për të marrë pjesë në këto organizime. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, për interesa të përgjithshme ka përcaktuar edhe kufizimin e kësaj lirie me ligj, në rastet kur duhet të sigurohet rendi Publik dhe kur ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kufizimin e disa të drejtave dhe lirive themelore Kushtetuta e Republikës së Kosovës, shprehimisht përcakton se, “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.” Nga përkufizimi i tillë del se, Kushtetuta duke përcaktuar këtë lloj kufizimi dëshiron të arrijë një

qëllim tjetër kushtetues dhe demokratik.

Në aspekt të kufizimit të disa të drejtave dhe lirive themelore, Kushtetuta përcakton disa detyra për institucionet publike në rastet e kufizimeve të tilla, duke përcaktuar shprehimisht se, “Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.”

Kushtetuta garanton edhe mos mohimin e të drejtave të garantuara edhe në rastet e kufizimit të tyre. Në këtë aspekt del se, kufizimi është masë e përkohshme e ndalimit të ushtrimit të disa të drejtave, në asnjë aspekt tjetër mohim i ushtrimit të tyre nuk mund të ndodhë. Kjo është një garanci kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998), njeh lirinë e tubimeve publike, duke e përcaktuar shprehimisht se, “Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.”

Edhe kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton shprehimisht parimin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, por kjo mund të bëhet vetëm me ligj. Për dallim nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, shprehimisht e përcakton se, kufizimet nuk mund të tejkalojnë kufizimet të cilat i parashikon Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore është i përkufizuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë se, “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, njeh lirinë e tubimit publik, të cilën e përcakton si të drejtë për tubim publik. Në Kushtetutë kjo e drejtë përcaktohet shprehimisht, duke e përcaktuar se, “Shtetasit kanë të drejtë në mënyrë të qetë të tubohen dhe të shprehin protestë publike pa paraqitje paraprake dhe pa leje të veçantë. Shfrytëzimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.”

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë për dallim nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, ka një gjuhë tjetër të përkufizimit të të drejtës së tubimeve publike, duke e përcaktuar se, qytetarët kanë të drejtën e tubimeve publike pa paralajmërim dhe pa leje të veçantë.

Baza ligjore për realizimin e të drejtës për tubime publik në Kosovë

Edhe në ligj vërehet realizimi i lirisë së shprehjes përmes të drejtës për tubime publike, ligji ka përkufizuar shprehimisht, duke përcaktuar se, “me këtë ligj rregullohet e drejta për tubime publike, e fjalës së lirë në tubime publike, protestave, manifestimeve publike, koha dhe mënyra e lajmërimit, detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve.”

Në kuptim të kësaj dispozite del se, ligji njeh të drejtën edhe të lirisë së fjalës në tubime publike, të drejtën e protesatve, të drejtën e manifestimeve publike, por përcakton edhe disa kufizime nga organizatorët e tubimeve publike, si kohën e lajmërimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Ligji njeh edhe disa lloje të tubimeve publike, por edhe saktësisht të drejtën për tubime publike. Lidhur me të drejtën për tubim publik dhe kush mund të marrë pjesë në tubim publik, shprehimisht është përcaktuar se, “çdo qytetar i Republikës së Kosovës pa asnjë dallim gjinie, race, ngjyre, gjuhe, besimi, përkatësisë nacionale, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, ose të çdo lloj rrethane tjetër vetjake, ka të drejtë të organizoj dhe të marr pjesë në tubimet publike, sipas rregullave të përcaktuara me këtë ligj.”

Nga përkufizimi i tillë ligjor vërehet se janë respektuar disa standarte të barazisë së të gjithëve për të realizuar një të drejtë, të drejtën për tubime publike. Në këtë përkufizim ligjor nuk ka ndonjë përcaktim, apo saktësim rreth moshës së atyre që duhet të marrin pjesë në një tubim publik, apo

ligjëvënësi e ka përkufizuar në baza të përgjithshme një gjë të tillë, e cila mund edhe të nënkuptohet se, ata që janë nën mosh relativisht të re, nën 16 vjeç, përkatësisht 14 vjeç nuk duhet të ushtrojnë të drejtën e tubimit publik. Me vet faktin e mos përcaktimit me ligj, mund edhe të nënkuptohet se të drejtën e tubimit publik mund ta realizojnë të gjithë pa asnjë dallim në moshë, p.sh. mund ta realizojnë të drejtën e tubimit publik edhe fëmijët 5 vjeçar edhe të moshuarit 95 vjeçar. Ky mund të jetë aspekti pozitiv i realizimit të një lirie. Realisht, për maksimumin e moshës nuk do të duhej të vendosej kufizim, sepse është në konsiderim edhe pjekuria, por për moshën e ulët mendojë se do të duhej të ekzistonte kufizimi, dhe atë në moshën 14 vjeçare. Në përkufizimin ligjor do të duhej të ishte edhe rregullimi se, "...mund të marrin pjesë në tubime publike të gjithë ata që kanë mbush moshën 14 vjet". Kategoria e tillë janë ende në shkollim fillor dhe përkujdesi familjar ndaj tyre është më i shtuar dhe mund të mbahen në kontroll nga ata që përkujdesen për këtë kategori të qytetarëve. Ky mund të jetë aspekti negativ se, ka kufizim të ushtrimit të një lirie themelore e cila po kushtëzohet me arritje të një moshe të caktuar.

Tubimet publike janë të klasifikuara në disa lloje, si: tubimet; manifestimet; parakalimet; protesta; kremtimet publike; përkujtimet e qeta; manifestime dhe organizime të natyrave të ngjashme në të cilat pjesëmarrësit shprehin lirisht dhe në mënyrë paqësore pikëpamjet e tyre për çështjet që u interesojnë; demonstrata. Si tubime publike konsiderohen edhe me karakter të shfaqjes kulturore, sportive, humanitare, fetare dhe argëtuese. Nga klasifikimi i tillë, vërehet se të gjitha përkufizohen me një emërtim si tubime publike, por nga mënyra e ushtrimit të tyre ato dallojnë, nga qëllimi i tyre dallojnë shumë. Në këtë kuptim p.sh. për demonstrata do të duhej të ekzistonte kufizimi në moshë, se nga praktika kemi raste kur pjesmarrja e të rinjëve (fëmijëve) në një demonstratë ka qenë e dëmshme si për shëndetin e tyre ashtu edhe për personalitetin e tyre.

Nga organizimet e protestave në mbarë botën, dhe pjesmarrja e fëmijëve në ato protesta rezulton shpesh me humbjen e jetëve të tyre. Raprtet e UNICEF-it tregojnë se nga protesta e organizuar në Jemen më 2011, kanë humbur jetën 26 fëmijë.

Kufizimi i të drejtës për tubime publike

E drejta për tubime publike mund edhe të kufizohet, por në aspekt kushtetues kjo e drejtë nuk mund të mohohet. Kufizimet e tilla në përgjithësi lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë edhe çështje rregullimi edhe të kushtetutave.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton një kufizim të till, edhe Kushtetuta e Republikë së Shqipërisë përcakton një kufizim të till. Edhe gjuha e kushtetutës është e tillë që përcakton se, kufizimet e tilla mund të bëhen vetëm me ligj.

Kufizimet e të drejtës për tubime publike sipas ligjit mund të jenë: "rrezikojnë rendin, qetësinë dhe sigurinë publike, sa i përket lirisë, dhe të drejtave të njerëzve të tjerë, moralit dhe shëndetit publik". Kufizime të tilla ka edhe lidhur me lirinë fjalimie në tubimet publike, kufizimi i tillë mund të jetë në këto raste: "E drejta e pjesëmarrjes dhe e fjalimit në tubimet publike ndalohet në rastet kur tubimet publike shërbejnë për të thirr apo nxitur, dhunën, urrejtjen ndërnacionale, religjioze, apo nxitje të tjera të ndaluara me ligj." Me ligj është vendosur edhe një kufizim gjeneral, ku përcaktohet shprehimisht se, "Asnjë tubim publik nuk mund të mbahet kur ndalohet nga organet e policisë përveç kur me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe."

Në përgjithësi janë disa praktika që këto përjashtime ekzistojnë në fushata zgjedhore të partive politike.

Në Kosovë, ligji ka parapa edhe detyrimet për paralajmërimin e mbajtjes së tubimeve publike. Gjuha e ligjit e parasheh si lajmërim për tubimin e "qetë" publik, duke e përcaktuar shprehimisht se, "lajmërimi për organizimin e tubimit të qetë publik për qëllimin, vendin dhe kohën e organizimit bëhet para policisë së Kosovës në vendin ku mbahet tubimi," ndërsa për kohën sa paraprakisht duhet të lajmërohet mbajtja e tubimit publik, shprehimisht është përcaktuar se, "lajmërimi bëhet më së voni shtatëdhjetedy (72) orë para se të mbahet tubimi i qetë publik." Ndërsa për raportet e organizatorit dhe organeve të rendit publik lidhur me koordinimin e mbajtjes së tubimit publik, me ligj është përcaktuar shprehimisht se, "Policia e Kosovës duhet që më së voni dyzetetë (48)

orë para mbajtjes së tubimit publik të lajmëroj organizatorin për lejimin apo ndalimin e tubimit publik. Nëse në afatin e paraparë nuk shpallet vendimi i ndalimit, tubimi konsiderohet i lejuar.”

Nga kjo del se, nëse Policia e Kosovës nuk ka përgjigje brenda 48 orëve para se të mbahet tubimi publik, konsiderohet se tubimi publik është lejuar të mbahet.

Me rastin e organizimit të tubimit publik, sipas rregullimit ligjor, organizatori ka për obligim të bëjë lajmërimin, i cili duhet të përmbajë: qëllimin, vendin ditën dhe kohën e mbajtjes së tubimit publik; kohëzgjatjen e tubimit të qetë publik; të dhënat e organizatorit apo të përfaqësuesit të tij; të dhënat mbi udhëheqësin e tubimit publik; numrin e kujdestarëve dhe numrin e përafërt të pjesëmarrësve.

Ligji kategorikisht ndalon mbajtjen e tubimeve publike në hapsirat brenda një institucioni publik.

Në rastet kur një tubim publik mund të ndalohet, Policia e Kosovës ka autorizime ligjore të ndërmarrë një veprim të tillë. Në ligj është përcaktuar se, Policia e Kosovës mund të ndalojë një tubim të qetë publik kur konsideron se, “tubimi publik nuk është lajmëruar në mënyrë të rregullt; është paraparë të mbahet në vendin që është ndaluar me këtë ligj; kur qëllimet e tubimit nxisin ose thërrasin për përdorimin e dhunës, urrejtës ndërnacionale, fetare, racore, politike; se ekzistojnë arsye të konsiderueshme se tubimi do të mund të përdorej për dhunë.”

Është interesante se, ligji përcakton shprehimisht edhe ndalimin e mbajtjes së tubimeve publike në rastet kur ato organizohen në mënyrë spontane dhe nuk dihet organizatori i këtyre tubimeve publike.

Në organizime të tubimeve publike nga organizatorët e tubimit publik kërkohet të kenë edhe përgjegjësi. Përgjegjësinë për organizimin e tubimeve publike e ka parapa ligji për tubimet publike duke përcaktuar se, “Organizatori duhet që të ndërmerr të gjitha masat për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në tubimin publik.” Nga ky përkufizim i tillë del se, e tërë përgjegjësia e organizimit të tubimit publik bie mbi organizatorin e tubimit publik. Ndërsa është parapa edhe situata në rastet kur edhe Policia e Kosovës mund të të jetë pjesë e mbajtjes së rendit publik. Një situatë e tillë me ligj është përcaktuar se, “me kërkesën e organizatorit, Policia e Kosovës mund të bashkëpunojë për mbajtjen e rendit dhe të marrin masat për ndalimin e personave të cilët veprojnë në kundërshtim me ligjin.”

Nga kjo del se, Policia e Kosovës mund të jetë pjesë vetëm pas kërkesës së organizatorit, kur një situatë e tillë vlersohet se mund të dal jashtë kontrollit dhe Policia është ajo e cila ndal veprimet e tilla që bien në kundërshtim me ligjin.

Baza ligjore për realizimin e të drejtës për tubime publike në Shqipëri

Në Republikën e Shqipërisë, baza ligjore për realizimin e të drejtës për tubime publike është ligji nr. 8145, i datës 11 shtator 1996 për të drejtën e tubimeve. Për dallim nga Republika e Kosovës që ligji është emërtuar si ligji për tubimet publike, ligji në Republikën e Shqipërisë është emërtuar si ligji për të drejtën e tubimeve. Në aspekt të emërimit, del se emërtimi i ligjit në Republikën e Shqipërisë si, “ligji për të drejtën e tubimeve” është emërtim më i sakt dhe më i kuptueshëm që direkt ndërlidhet me njëren prej të drejtave, siç është e drejta për tubime, që edhe në përkufizime kushtetuese e gjejmë si “e drejta për tubime publike”, apo si “liria për të drejtën e tubimit publik.”

Gjuha ligjore e ligjit për të drejtën e tubimeve nuk dallon shumë nga gjuha ligjore e ligjit për tubimet publike në Kosovë, sa i përketë asaj se, kush mund të organizohet në tubime publike. Në ligjin për të drejtën e tubimeve përcaktohet shprehimisht se, “në Republikën e Shqipërisë gjithë shtetasit, pa asnjë dallim për shkak të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, përkatësisë prindërore ose të çdo lloj rrethane tjetër vetjake, kanë të drejtë për tubime publike.”

Thuajse i njëjti përkufizim është, edhe në këtë ligj nuk e kemi të përcaktuar moshën e atyre që marrin pjesë në tubime publike, do të thotë nuk ka ndonjë dallim nga ligji i Kosovës për tubimet publike i cili nuk e parasheh fare moshën e atyre që marrin pjesë në tubimet publike.

Përmes ligjit është përcaktuar edhe kuptimi i tubimeve, duke përcaktuar se, “në zbatim të këtij ligji me tubim do të kuptojmë grumbullimet, manifestimet, mbledhjet, procesionet dhe parakalimet, në të cilat pjesëmarrësit shprehin lirisht dhe në mënyrë paqësore pikëpamjet e tyre për çështjet që u interesojnë.”

Nga përkufizimi i tillë del se, në kuadër të të drejtës për tubim hyjnë edhe grumbullimet, manifestimet, mbledhjet, parakalimet, por edhe garantohet që pjesëmarrësit mund të shprehin lirisht

pikpamjet e tyre lidhur me çështjet që u interesojnë.

Për të drejtën e organizimit të ndonjë tubimi, ligji ka parapa disa procedura, si kërkimin e lejes, për tubimet që do të mbahen në hapësira publike, duke përcaktuar se, “Për tubimet në vendet publike organizatorët detyrohen të kërkojnë lejen me shkrim të shefit të komisariatit të policisë, në territorin e të cilit do të zhvillohen, jo më vonë se tri ditë përpara,” ndërsa janë parapa edhe rastet kur nuk duhet të kërkohet leja nga Komisarati për organizimin e një tubimi publik, duke e përcaktuar se, “kur tubimet zhvillohen në “vende të hapura për publikun”, si stadione, salla kinemaje, teatri e të tjera mjedise të këtij lloji, nuk nevojitet leja me shkrim nga organet e policisë.”

Dallimi esencial qëndron lidhur me kërkimin e lejes sepse për tubimet në vende publike duhet kërkuar leja nga organet e policisë, ndërsa për vendet publike të hapura për publikun nuk duhet të kërkohet një leje e tillë.

Në aspekte tjera edhe te ligji për të drejtën e tubimeve në Republikën e Shqipërisë janë të njëtat parime sikurse të ligji për tubimet publike në Republikën e Kosovës, te dy ligjet kanë qëllimin e njëjtë, të njohin të drejtën e të gjithëve për tubime publike.

Rasti i protestave të 10 shkurtit 2007

E drejta e protestave është e garantuar me kushtetuta dhe ligje të shteteve përkatëse, por edhe me akte ndërkombëtare. Janë situata të caktuara kur gjatë zhvillimit të protestës dhe realizimit të drejtës për të protestuar, apo demonstruar nga një grup i caktuar lidhur me ndonjë padrejtësi eventuale, në disa raste vie shpesh në shprehje edhe përdorimi i forcës nga ana e organeve përgjegjëse për ta ruajtur rendin dhe qetësinë publike.

Te rasti i protestave të 10 shkurtit 2007, të organizuar nga Lëvizja “Vetvendosje,” për ta kundërshtuar Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, në një moment të caktuar pati një ndërhyrje të organeve policore që quheshin Policia e UNMIK-ut ndaj protestuesve ku u përdor forca dhe si pasojë e përdorimit të kësaj force, mbetën të vdekur dy nga pjesëmarrësit në protestë dhe disa të tjerë mbetën të lënduar rëndë dhe lehtë.

Në kohën kur ndodhi organizimi i protestave, Kosova ishte ende nën administrimin ndërkombëtar të OKB-ës dhe ishte e vendosur me kompetenca ekzekutive administrata e UNMIK-ut, pjesë e së cilës ishte edhe Policia e UNMIK-ut ku së bashku me të bashkëushtroin kompetencat në fushën e rendit dhe sigurisë publike edhe Shërbimi Policor i Kosovës.

Raporti i Ombudspersonit sipas detyrës zyrtare nr. 008/2007 Lidhur me ngjarjet që ndodhen gjatë protestës së lëvizjes “Vetëvendosje” të datës 10 shkurt 2007, Drejtuar: z. Joachim Rücker - Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), trajton ngjarjen në detaje duke u mbështetur në hetimin e menaxhimit të protestës dhe nese janë tejkaluar kompetencat e organeve përgjegjëse të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike.

Qëllimi kyq i raportit është se nëse janë shkelur të drjetat dhe liritë themelore të njeriut me rastin e zbatimit të ligjit nga ana e Policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-ës me rastin e ndërhyrjes së tyre ndaj protestuesve. Poashtu raporti i Ombudspersonit trajton edhe çështjen se nëse janë shkelë parimet ndërkombëtare dhe aktet ndërkombëtare lidhur me ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si “e drejta për të protestuar,” si e drejtë themelore e njeriut e garantuar edhe me akte ndërkombëtare.

Lidhur me trajtimin e rastit të protestave të 10 shkurtit 2008, raporti I Ombudspersonit trajton edhe çështjen se a ka pasur shkelje të drejtës për jetë sepse në protestë kanë humbur jetën dy persona dhe a ka shkeljetëaktevendërkombëtare të drejtave të njeriut, siq është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Raporti, duke trajtuar rastin e protestave të 10 shkurtit 2007, e shfrytëzon si burim edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Strasburgut lidhur me rastet që kanë të bëjë me mbrojtjen e jetëve të njerzve nga ana e shtetit, duke ofruar si shembuj disa aktgjykime të nxjerra pikërisht për raste të tilla, si p.sh. aktgjykimin e datës 28 mars 2000, Kiliç kundër Turqisë; aktgjykimin e datës 8 korrik 1999, Cakini kundër Turqisë; aktgjykimin e datës 6 korrik 2005, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë.

Shqyrtime përfundimtare

Lidhur me të drejtë tubimit publik si e drejtë kushtetuese themelore e qytetarëve janë bërë shumë studime dhe analiza si teorike ashtu edhe praktike duke trajtuar raste të caktuara të shkeljes së të drejtës së qytetarëve për tubim publik paqësor nga ana e shtetit dhe keqpërdoriminë të drejtës së tubimit publik paqësor nga ana e protestuesve. Tani ekzistojnë të dy praktikat.

Edhe në Republikën e Kosovës ka raste të shumta të shfrytëzimit të së drejtës së tubimit publik për të shprehur pakënaqësitë për ndonjë veprim të institucioneve shtetërore ose pakënaqësitë për ndonjë proces të caktuar shoqërorë.

Rasti i protestave të 14 dhe 22 janarit 2012 të organizuara nga Lëvizja Vetvendosje për të kundërshtuar hyrjen e mallrave serbe në tregun e Republikës së Kosovës dhe për të zbatuar masat e reciprocitetit nga qeveria e Kosovës të cilat janë miratuar në Kuvend, u shfrytëzua e drejta e tubimit publik për të shprehur pakënaqësitë e cila përmes një proteste të filluar në mënyrë paqësore dhe të paralajmëruar si të tillë në një moment të caktuar eskaloi nga kontrolli dhe përdorimi i tepruar i forcës nga ana e Policisë bëri që protestuesit të revoltohen dhe protesat doli nga kontrolli me të filluar arrestimet e pa nevojshme nga ana e Policisë. Në kë rast ishte Policia ajo që “provokoi” eskalimin e situatës në protestë. Nga kjo del se Policia nuk përfilli rregullat e përcaktuara me ligj se kur protesta është me motive paqësore dhe nuk ka eskaluar situata nga kontrolli është e panaevojshme çdo ndërhyrje.

Ndërsa në rastin e protestave të 22 janarit 2012 protesta është organizuar pa paralajmërim dhe pa ndonjë komunikim paraprak me Policinë nga ana e organizuesit të protestës, sikurse që kishte ndodhur me rastin e protestave të 14 janarit 2012 ku organizatorët e protestës kishin njoftuar Policinë paraprakisht për protestën. Nga kjo del si përfundim se, në dyja rastet kemi pasur shkelje apo mos përfillje të rregullave të tubimit publik të përcaktuara me ligjin për tubimet publike dhe me aktet ndërkombëtare, sepse në rastin e parë protesta është paralajmëruar nga protestuesit ndërsa ka pasur ndërhyrje të pa nevojshme nga ana e Policisë duke bërë arrestime të pa nevojshme të disa protestuesve paqësor dhe me këtë është shkaktuar irritim i protestuesve që ka dërguar në atë se eskalimi i situatës në protestë të dal i paparashikueshëm.

Në rastin e dytë, organizatorët e protestës kanë vendosur të mos kenë asnjë komunikim me Policinë, përveq kur janë paraqitur në një konferencë për media më 15 janar 2012 dhe kanë paralajmëruar se protesta e radhës do të jetë më 22 janar 2012 te Dheu i Bardhë dhe në Merdare. Nga kjo del se, organizatorët e protestës nuk kanë përfillur ligjin për të njoftuar zyrtarisht Policinë për organizim të protestës, me arsyetimin se ishte përdorur forcë e pa nevojshme me rastin e protestave të 14 janarit 2012.

Edhe nga raporti zyrtarë të Institucionit të Avokatit të Popullit del se, esenciale ka qenë mos përfillja e rregullave të përcaktuara në ligjin për tubimet publike nga dyja anët, si nga Policia ashtu edhe nga organizatorët e protestave.

Literatura

- Bajrami, A. *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011*
- Saliu, K. *E drejta kushtetuese, libri I, botimi katërt, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004*
- Martines, T. *E drejta Kushtetuese, 2011*
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948*
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore Kushtetuta e Republikës së Kosovës*
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*
- Ligji nr. 03/L-118 për tubimet publike në Republikën e Kosovës*
- Ligji nr. 8145, datë 11 shtator 1996, Republika e Shqipërisë*
- Palko v. Connecticut, Vendim i Gjykatës Supreme të SHBA-ve, 1937*
- Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 59, 14 dhjetor 1946*
- <http://www.telegrafi.com/> 16 janar 2013
- <http://www.kohaditore.com>, 20 shkurt 2013. *Ligjvënësit e partive opozitare kanë qenë kundër masës dhe e kanë quajtur antikushtetuese*
- <http://www.idividi.com.mk/Shqip/Bote/678885/index.htm>.
- Raport sipas detyrës zyrtare nr. 008/2007 Lidhur me ngjarjet që ndodhen gjatë protestës së lëvizjes “Vetëvendosje” të datës 10 shkurt 2007, Drejtuar: z. Joachim Rücker - Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), pika 4*
- Raporti Ex-officio i Ombudspersonit, nr. 28/2012, lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar 2012*
- Venice Commission, Study no. 581/2010, Strasbourg - Warsaw, 9 July 2010, par. 113*

E drejta e Konkurrencës në Bashkimin Europian

Jonida Lamaj
Universiteti Marin Barleti

Abstrakt

Në ekonomitë e tregut, garantimi i konkurrencës dhe mënyra e ndërveprimit të firmave në treg janë faktorët kryesorë që ndikojnë në çmimin, cilësinë dhe risitë e një produkti. Në përgjithësi është konkurrenca ajo që përcakton rezultatin e një shërbimi apo produkti në treg, por aty ku ajo është e brishtë ka nevojë për një rregullim të përshtatshëm ligjor.

Ky punim synon të analizojë zhvillimin historik të ligjit të konkurrencës në Bashkimin Europian, Traktatet kryesore të BE, rregulloret dhe direktivat, të cilat garantojnë mbrojtjen e të drejtës së konkurrencës në komunitetin Evropian. Rëndësi të veçantë u kushtohet nenit 101 dhe 102 të Traktatit për Funkzionimin e BE lidhur me marrëveshjet e ndaluara, bashkimet midis shoqërive tregtare dhe abuzimi me pozitën dominuese.

Autoritetet kombëtare të konkurrencës në vendet anëtare të BE janë ngarkuar të zbatojnë nenin 101 dhe 102 të Traktatit për Funkzionimin e BE për të garantuar këtë të drejtë në vendet respektive. Gjykatat e vendeve anëtare mund të aplikojnë gjithashtu drejtëpërdrejtë nenet e këtij traktati në rast se shkelen të drejtat e individëve të komunitetit. Legjislacioni i konkurrencës së vendeve anëtare të BE duhet të ketë përafrim me legjislacionin e komunitetit.

Ky punim do të trajtoj gjithashtu disa çështje të praktikës gjyqësore të BE lidhur me marrëveshjet për bashkimin e shoqërive tregtare dhe pozitën dominuese në treg.

Fjalë kyçe: E drejta e konkurrencës, Traktati për Funkzionimin e BE, ekonomia e tregut, bashkimi i kompanive, tregu relevant

Hyrje

Sipas arsyetimit të teorisë ekonomike, shpeshherë tregjet dështojnë në arritjen e rezultateve optimale nga pikëpamja shoqërore. Rastet më tipike të dështimit të tregut konstatohen kur shfaqet Monopoli apo Oligopoli; thënë ndryshe, gjendja e përshkruar si konkurrencë e kufizuar.

Në një treg shumë konkurrues prodhuesit nuk e kanë lirinë për të caktuar çmimin, pasi konkurrentët e tyre do ta ulnin çmimin deri në pikën kur ulja e mëtejshme e tij do të rezultonte në humbje. Por një firmë Monopoli apo Oligopoli ka fuqi tregu për të vendosur - plotësisht në rastin e parë dhe pjesërisht në rastin e dytë - çmimin, duke ndryshuar sasinë e prodhimit. Në rastin e Oligopolit, firmat mund të formojnë kartele dhe të sillen sikur janë në situatë Monopoli, çka i lejon të vendosin një çmim më të lartë, çmim monopol.

Nëse vërehet dominim i firmave me fuqi tregu, përgjithësisht, u takon qeverive të përpiqen në uljen e barrës së humbjeve shoqërore duke ua kufizuar këtë fuqi. Masa më radikale është ndarja e firmës (firmave) me fuqi tregu e për rrjedhojë, rritja e konkurrueshmërisë në treg. Pikërisht këtë gjë bëri qeveria e SHBA-së në 1984 me gjigantin e telefonisë AT & T, duke e ndarë në shtatë kompani rajonale. Ndër masat më të zakonshme të qeverive përfshihet ndalimi i firmave Oligopol për të formuar kartele apo për të bashkëpunuar në vendosjen e çmimeve. Apo ndërhyrja për të mbajtur çmimin brenda tregut në një nivel të caktuar, sa më afër atij që do të mund të ishte në rast të një konkurrence perfekte. Rasti i Monopolit natyror - i cili gjendet në industri si: elektriciteti, uji, gazi dhe hekurudhat - përbën një sfidë të veçantë. Në këto industri, mundësia e shërbimeve nga shumë ofrues, secili me rritjen e vet (si p.sh. tubacionet e ujit apo hekurudhat), rrit kostot e prodhimit aq shumë sa monopoli është varianti më efikas. Në këto raste Qeveria mund të krijojë shoqëri tregtare me kapital shtetëror dhe ta ushtrojë biznesin sikur nuk është Monopol. Ose një mënyrë tjetër: Qeveria mund të lejojë Monopolin nga një firmë e sektorit privat, por të kontrollojë sjelljen me çmimet, duke balancuar çmimin me kostot mesatare.

Ligji mbi konkurrencën në BE

Përgjatë shekujve, përpjeket për rregullimin e tregjeve konkurruese të të mirave materiale dhe shërbimeve kanë ndikuar në lindjen dhe pasurimin e instituteve të së drejtës, që janë baza e sotme e ligjeve moderne të konkurrencës. Lindja e shkollës klasike ekonomike dhe rritja e rëndësisë së tregtisë i dha tjetër hov zhvillimit të doktrinës dhe praktikës në këtë fushë. Terma të ndryshëm të përdorur për përshkrimin e kësaj fushe të ligjit, si “kufizimet e tregtisë”, “praktikat kufizuese”, “aktet e kombinimit” etj., datojnë që në shekullin XVIII (Papadopoulos, 2010, 9 –10).

Teoricienët e së drejtës i lidhin fillimet e legjislacionit modern të konkurrencës me miratimin në SHBA të ligjeve: Sherman Act (1890) dhe Clayton Act (1914). Këto dy statute bënë kodifikimin e parë të qëndrimeve të mëparshme të ligjit mbi kufizimet e tregtisë. Këto dy statute patën një influencë të konsiderueshme në tregtinë botërore.

Ligji i konkurrencës së BE-së e ka origjinën te Traktati European i Qymyrit dhe Çelikut (1951). Neni 65 i këtij traktati ndalonte kartelet, ndërsa neni 66 caktonte masa për përqendrimet, për bashkimet, si dhe për abuzimin me pozitën dominuese nga kompanitë (Papadopoulos, 2010, 12–13). Me këtë rast, për herë të parë parimet e një ligji konkurrence u përfshinë në një marrëveshje rajonale shumëpalëshe, duke themeluar modelin transeuropian të ligjit të konkurrencës. Në vitin 1957 rregullat e konkurrencës u përfshinë në Traktatin e Romës, i njohur ndryshe TKE, që themeloi komunitetin ekonomik evropian (EEC). Traktati i Romës e vuri ligjin e konkurrencës në qendër të synimeve të tij, nëpërmjet “ngritjes së një sistemi që siguron se konkurrenca në tregun e përbashkët nuk shtrembërohet”. Dispozitat qendrore mbi ligjin e konkurrencës së BE-së mbi kompanitë u parashikuan në nenin 85, i cili ndalonte marrëveshjet që shkelin konkurrencën, përjashtimet nga rregulli, si dhe në nenin 86, që ndalonte abuzimin me pozitën dominuese në treg. Traktati themeloi parimet e ligjit të konkurrencës për shtetet anëtare. Neni 90 përfshin sipërmarrjen publike, ndërsa neni 92 mbulon parashikimet e ndihmës shtetërore. Rregullimet mbi bashkimet nuk u parashikuan sepse vendet anëtare nuk arritën të gjenin konsensusin në atë kohë (Papadopoulos, 2010, 14)

Aktualisht, Traktati i Lisbonës ndalon marrëveshjet që çenojnë konkurrencën në Nenin 101(1), duke përfshirë caktimin e çmimit. Sipas nenit 101(2), çdo marrëveshje e tillë është automatikisht e pavlefshme. Neni 101(3) përfshin përjashtimet, nëse marrëveshjet e fshehta përdoren për inovacionin teknologjik apo të shpërndarjes, si dhe u mundëson konsumatorëve një “pjesë të drejtë” të përfitimeve. Neni 102 ndalon abuzimin me pozitën dominuese, si diskriminimin me çmimet dhe marrëveshjet ekskluzive. Neni 102 lejon rregulloren e Këshillit të BE-së të drejtojnë bashkimet midis firmave (rregullorja aktuale është Rregullorja 139/2004). Nenet 106 dhe 107 sigurojnë se e drejta e shteteve anëtare për të mundësuar shërbimet publike nuk mund të pengohet, por që kompanitë publike duhet t’u përmbahen të njëjtave parime të konkurrencës si kompanitë private. Neni 107 parashtron një rregull të përgjithshëm, që Shteti nuk mund të mbështesë apo subvencionojë palët private në shtrembërimin e konkurrencës së lirë dhe të mundësojë përjashtime për bamirësitë, për objektiva të zhvillimit rajonal si dhe në rastet e fatkeqësive natyrore.

Në Bashkimin European, Rregullorja e Modernizimit 1/2003 (Council Regulation (EC) No 1/2003) parashikon që Komisioni European nuk është më i vetmi institucion i zbatimit të ligjit të BE-së. Kjo është hartuar për të lehtësuar një zgjidhje të shpejtë të hetimeve mbi çështjet e konkurrencës. Në vitin 2005 Komisioni paraqiti një Letër të Gjellbër mbi *Veprimet e dëmshme për shkeljen e rregullave të Anti trustit të BE-së*, që sugjeronte mënyra konkrete më të zhdërvjellta për të pretenduar zhdëmtim privat ndaj karteleve (European Commission Green Paper on damages actions for breach of EC Treaty anti-trust rules).

Praktika gjyqësore

Parësore është të përcaktohet: nëse firma është në pozitë dominuese, apo nëse sillet “në një shkallë të konsiderueshme pavarësie ndaj konkurrentëve, klientëve dhe konsumatorëve” (C-27/76 United Brands Continental BV v. Commission [1978] ECR 207). Zotërimi i kuotave të larta të tregut krijon

përshtypjen që një firmë është dominuese, gjë që është e gabuar (C-62/86 AKZO Chemie BV v. Commission [1991] ECR I-3359). Kur një firmë është në pozitë dominuese, atëherë ekziston një “përgjegjësi e veçantë për moslejimin e sjelljes për cënimin e konkurrencës në tregun e përbashkët” (C-322/81 Michelin v. Commission [1983] ECR 3461). Në përputhje me marrëveshjet e fshehta, kuotat e tregut përcaktohen duke pasur pikë reference një treg të vecantë, në të cilin produktet shiten. Megjithëse listat paraqiten rrallë të mbyllura, (C-6/72 Continental Can v. Commission [1973] ECR 215), disa kategori të sjelljes abuzive janë të ndaluara nga legjislacionet kombëtare. Për shembull, kufizimi i prodhimit në një port anijesh duke mos lejuar rritjen e shpenzimeve dhe përmirësimin teknologjik mund të jetë abuziv (C-179/90 Mercati convenzionali porto di Genova Spa v. Siderurgica Gabrielli SpA [1991] ECR I-05889). Lidhja e një produkti me shitjen e një produkti tjetër gjithashtu mund të konsiderohet si abuzim, pasi e kufizon zgjedhjen konsumatore dhe i nxjerr konkurrentët nga tregu. Një gjë e tillë u ngrit në çështjen *Microsoft v. Commission* (T-201/04 R Microsoft v. Commission, Order of 22 December 2004), që çoi në një gjobë milionash për përfshirjen e Windows Media Player me platformën e Microsoft Windows. Refuzimi për të mundësuar lehtësitë, çka janë të domosdoshme për çdo biznes që tenton të konkurrojë, mund të përbëjë abuzim. Me një shembull të tillë mund të ilustron çështja që përfshiu një kompani farmaceutike, të quajtur Commercial Solvents. (C-6-7/73 Commercial Solvents v. Commission [1974] ECR 223). Kur ajo themeloi konkurrentin e vet në tregun e ilaçeve të tuberkulozit, Commercial Solvents u detyrua të vazhdonte të furnizonte një kompani të quajtur Zoja me lëndë të parë për barnat. Zoja ishte i vetmi konkurrent tregu dhe pa detyrimin e furnizimit nga gjykata, gjithë konkurrenca do të ishte eliminuar. Format e abuzimit të lidhura drejtpërdrejt me caktimin e çmimit përfshijnë shfrytëzimin. Është e vështirë të përcaktohet qartësisht se në ç’pikë çmimet e një firme dominuese bëhen “shfytëzuese” dhe kjo kategori abuzimi rrallë evidentohet. Në një rast, një shërbim funerali francez u gjykua të kishte kërkuar çmime shfrytëzuese, çka përpikëj ta justifikonte me argumentin krahasues të shërbimeve funerale jashtë rajonit (C-30/87 Corinne Bodson v. SA Pompes funèbres des régions libérées [1987] ECR 2479). Një çështje akoma më të ndërlikuar përbëjnë Çmimet Grabitqare. Kjo është praktika e uljes së çmimit për një produkt në atë vlerë, sa që një konkurrent më i vogël nuk mund të mbulojë kostot dhe të dalë jashtë tregut. Në çështjen *France Telecom SA v. Commission* (T-340/03 France Telecom v. Commission [2007] ECR II—107) një kompani e shpërndarjes së internetit u detyrua të paguajë miliona për uljen e çmimeve të veta nën koston e prodhimit. Kjo firmë nuk kishte asnjë arsye në aplikimin e këtyre çmimeve përveçse eliminimit të konkurrentëve nga tregu, ndërkohë që subvencionohej për të kapur pjesën e luanit të një tregu në rritje. Një kategori tjetër e abuzimit me çmimin është diskriminimi i çmimit. Një shembull i tillë është ofrimi i uljes së çmimit ndaj klientëve industrialë që eksportojnë sheqerin e kompanisë tuaj, por jo ndaj konsumatorëve që shesin të mirat material e në të njëjtin treg me ju (T-228/97 Irish Sugar v. Commission [1999] ECR II-2969).

Konkuzione

Një bashkim apo një përvetësim përfshin, nga perspektiva e ligjit të konkurrencës, përqendrimin e fuqisë ekonomike në më pak duar se më parë. Kjo do të thotë se një firmë blen plotësisht aksionet e një tjetre. Arsyet e mbikëqyrjes së përqendrimit ekonomik nga shteti janë të njëjta me arsyet që kufizojnë firmat abuzuese me pozitën dominuese në treg, vetëm se rregullat e bashkimit dhe përvetësimit synojnë të trajtojnë problemin para se ai të lindë, parandalimi *ex ante* i dominimit të tregut (T-102/96 Gencor Ltd v. Commission [1999] ECR II-753). Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rregullimet e bashkimeve mbuloohen nga Clayton Act, ndërsa në Bashkimin Europian nga Rregullorja e Bashkimeve 139/2004 (e njohur si “ECMR”). Ligji i konkurrencës u kërkon firmave që propozohen për t’u bashkuar, të marrin autorizim nga autoriteti përkatës kompetent. Me anë të bashkimit kostot e transaksionit mund të ulen në krahasim me veprimin në treg të hapur nëpërmjet kontratave të dyanshme. Shpeshherë firmat përfitojnë nga rritja e fuqisë së tyre të

tregut dhe ulja e numrit të konkurrentëve, e cila mund të ndikojë negativisht në ofertën që marrin konsumatorët. Kontrolli i bashkimeve lidhet me parashikimin e asaj se si mund të jetë tregu, dhe jo mbi njohjen apo dhënien e gjykimit. Prandaj parashikimi kryesor, sipas ligjit të BE-së, shprehet se nëse një përqëndrim do të ndodhte, a do të “pengonte ndjeshëm konkurrencën efektive, në veçanti si rezultat i krijimit apo fuqizimit të pozitës dominuese” (Art.3(1), Regulation 139/2004, the European Community Merger Regulation). Ndërkaq, parashikimi korrespondues, sipas ligjit antitrust, në SHBA shprehet: “Asnjë person nuk duhet të marrë, në mënyre direkte apo indirekte, të gjithë apo një pjesë të stokut apo pjesë tjetër të kapitalit, të asetëve të një apo më shumë personave të angazhuar në tregti apo aktivitet tjetër që prek tregtinë, kur efekti i këtij përvetësimi, të këtij stoku apo asetesh, ose nga përdorimi i këtij stoku për votimin apo mundësimin e autorizimeve ose ndryshe, mund të jetë thelbësor në uljen e konkurrencës, ose i prirur për të krijuar monopol” (Clayton Antitrust Act of 1915 Section 7, codified at 15 U.S.C).

Ajo që përbën një rënie të madhe të konkurrencës ose ndalim domethënës të saj është përgjithësisht e shpjeguar nëpërmjet studimit empirik. Pjesa e tregut të kompanive që bashkohen mund të vlerësohet dhe mblidhet, megjithëse kjo lloj analize shërben vetëm për të ngritur prezumime, jo përfundime. Indeksi Herfindahl-Hirschman përdoret për të vlerësuar “dendësinë” e tregut, ose çfarë lloj përqëndrimi ekziston. Përveç kësaj, është e rëndësishme të mbahet parasysh produkti në fjalë dhe shkalla e inovacionit teknik në treg (C-68/94 France v. Commission [1998] ECR I-1375). Një problem më vete është dominimi kolektiv, apo oligopoli nëpërmjet “skillseve ekonomike” (T-68/89, T-77/89 and T-78/89 Società Italiana Vetro SpA and Others v. Commission, [1992] ECR II-1403, paragraphs 341-345), që mund të ngrihen, përmes të cilit tregjet e reja bëhen më të prirur ndaj marrëveshjeve të fshehta. Me rëndësi është shkalla e transparencës së tregut, sepse një strukturë më e koncentruar nënkupton që firmat mund të koordinojnë sjelljen e tyre më lehtësisht, nëse firmat nxjerrin pengesa dhe nëse firmat janë të sigurta nga reagimet e konkurrentëve dhe konsumatorëve (T-342/99 Airtours plc v. Commission [2002] ECR II-2585, para 62). Hyrja e firmave të tjera në treg dhe çdo barrierë, me të cilën ato mund të përballen, doemos duhet të mbahet parasysh. Nëse firmat gjykohen se po krijojnë përqëndrim jokonkurrues, në SHBA ato mund të justifikohen që po krijojnë shumë efikasitet në treg, ndaj ia vlen kjo para çdo lloj pengimi. E njëjta referencë është përdorur edhe për “progresin ekonomik dhe teknik” të përmendur në Nenin 2 të ECMR. Një formë tjetër mbrojtjeje mund të jetë ajo, që një firmë dominuese është gati të dështojë apo të falimentojë dhe blerja nuk shkakton një gjendje më pak konkurruese se çdo të ndodhte në të kundërtën (C-19-20/74, Kali und Salz AG v Commission [1975] ECR 499). Bashkimet vertikale në treg përbëjnë rrallëherë një shqetësim, megjithëse në rastin AOL/Time Warner Komisioni Europian kërkoi që një sipërmarrje e përbashkët me konkurrentin Bertelsmann të ndalohej paraprakisht. Autoritete e BE-së janë fokusuar së fundi në efektet e bashkimeve të konglomerateve, ku kompanitë blejnë një portofol me produkte të ngjashme, megjithëse në dukje pa zotërimin e kuotave dominuese në asnjë treg individual (Case IV/M.938 – Guinness/Grand Metropolitan, OJ L228/24, [1998]).

Referenca

- Papadopoulos, Anestis S (2010). The International Dimension of EU Competition Law and Policy. Cambridge University Press.
- Council Regulation (EC) No 139/2004 of 20 January 2004 on the control of concentrations between undertakings (the EC Merger Regulation).
- Council Regulation (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty
- C-27/76 United Brands Continental BV v. Commission [1978] ECR 207
- C-62/86 AKZO Chemie BV v. Commission [1991] ECR I-3359
- C-322/81 Michelin v Commission [1983] ECR 3461
- C-6/72 Continental Can v Commission [1973] ECR 215
- T-201/04 R Microsoft v. Commission, Order of 22 December 2004 1062 n.78

C-6-7/73 Commercial Solvents v Commission [1974] ECR 223
C-30/87 Corinne Bodson v. SA Pompes funèbres des régions libérées [1987] ECR 2479
T-340/03 France Telecom v Commission [2007] ECR II—107
T-228/97 Irish Sugar v Commission [1999] ECR II-2969
T-102/96 Gencor Ltd v. Commission [1999] ECR II-753
T-342/99 Airtours plc v. Commission [2002] ECR II-2585, para 62
C-19-20/74, Kali und Salz AG v Commission [1975] ECR 499
Case IV/M.938 – Guinness/Grand Metropolitan, OJ L228/24, [1998]

Kontrata e qirasë financiare në legjislacionin shqiptar

Uarda Roshi, PH.D. Candidate
Tiranë

Abstrakt

Qiraja financiare në Shqipëri, është një kontratë relativisht e re në qarkullimin juridik dhe në trasaksionet tregtare. Qëllimi kryesor i kësaj kontrate është financimi i investimeve të bizneseve dhe individëve, në funksion të zhvillimit dhe fuqëzimit të aktivitetit të tyre edhe kur këta nuk zotërojnë të gjithë likuiditetin e nevojshëm. Në fakt, nga njëra anë u jep mundësinë bizneseve për të përdorur pajisjet më të avancuara kundrejt një pagese periodike, nga ana tjetër u jep mundësinë e zgjedhjes që në përfundim të perjudhës së qearsë të ushtrojnë opsionin e blerjes, të vazhdojnë ti mbajnë me qera për një afat tjetër apo tja kthejnë ato qiradhënësit. Në këtë mënyrë bizneset vecanërisht ato të vogla dhe të mesme mund të përditësojnë të mirat materiale për të qënë sa më konkurues në treg pa bllokuar kapitalin.

Qiraja financiare është një nga mardhëniet juridike që ka marrë prioritet dhe është zhvilluar me ritme të shpejta jo vetëm në vendet e zhvilluara por edhe në ekonomitë në tranzicion dëshmi e këtij fakti janë një numër i konsiderueshëm biznesesh por edhe persona fizik që kanë zgjedhur këtë instrument si një nga metodat e financimit. Krahasuar me trendin e zhvillimit, në vendin tonë leasing është ende në hapat e parë të zhevillimit dhe ka gjetur zbatim kryesisht në tregun motorik dhe imobilar.

Qëllimi për të cilin u zgjodh trajtimi i kësaj kontrate ka të bëjë me faktin se duke qënë një kontratë relativisht e re, për shkak të natyrës së vecantë juridike dhe karakteristikave që paraqet lë vend për shumë diskutimeKy punim ka për qëllim trajtimin teorik të kontratës së qirasë financiare në legjislacionin Shqiptar, llojet e saj, elementët, vecoritë, si dhe avantazhet që e karakterizojnë.

Fjalët çelës: Kontratë,leasing, qiraja financiare e drejtëpërdrejtë, furnizues.

Hyrje

Për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe transformimeve të thella dhe të shpejta që po karakterizojnë kohët tona nevojat e biznesevekanë ndryshuar thellësisht gjatë këtyre viteve. Për të plotësuar dhe për ti bërë ballë nevojave të tregut dhe marrëdhënieve ekonomike në ndryshim po shfaqen forma të reja të marrëdhënieve kontraktore. Në këtë kuptim edhe kontrata e qirasë financiare lindi nga praktikat tregtare dhe u shëndrua në një instrument të rëndësishëm financimi. Origjinat e kontratës së qirasë financiare i gjejmë në të drejtën anglosaksone dhe vetëm në shekullin e XX është njohur dhe ka marr zhvillim edhe në vendet e evropës kontinentale.

Kontrata e qirasë financiare në Shqipëri për herë të parë është rregulluar nga kodi civil i vitit 1994 dhe konkretisht në nenin 849 dhe më pas në mënyrë më të detajuar nga Ligji nr. 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” i azhurnuar me: Ligjin Nr.9823, datë 29.10.2007 & Ligjin Nr.9966, datë 24.7.2008

Në thelb qiraja financiare (leasing) është një kontratë me natyrë financiare e konceptuar për tui përgjigjur nevojave të tre paleve që marrin pjesë në këtë marrëdhënie juridike e përkatësisht: interesit të qiramarrësit (për të përdorur një të mirë), interesit të qiradhënësit (për të përfitur një dobi ekonomike nga financimi i blerjes) dhe interesit të furnizuesit (që përfiton nga shitja e sendit). Realizimi i kontratës së qirsë financiare kalon në disa faza :

1. Qiramarrësi i ardhshëm hyn në kontakt me një furnizues dhe identifikon sendin për të cilin ka nevojë duke specifikuar të gjitha karakteristikat dhe vecoritë që bëjnë të mundur dallimin e tij dhe negociacion për cmimin.

2. Pasi ezaurohet kjo fazë qiramarrësi kontakton me një subjekt tjetër që ushtron veprimtari të qirasë financiare të quajtur qiradhënës dhe i kërkon këtij të fundit blerjen e sendin të zgjedhur prej tij pranë furnizuesit dhe dhënien e tij me qera. Kjo kërkesë merr vlerën e një propozimi kontraktor i cili përmban të gjitha elementet thelbësorë të kontratës dhe prodhon efekte juridike vetëm pas pranimit nga ana e qiradhënesit. (Albanese & Zeroli, 2012, 27). Në këtë rast qiradhënësi e vlerëson në

komplek propozimin e qiramarrësit dhe nëse bie dakort për të gjitha kushtet kjo fazë konkretizohet me hartimin dhe lidhjen e kontratës së qirasë financiare mes tyre. Në kontratë specifikohet kushtet bazë të saj.

3. Qiradhënësi me pas njofton ma shkrim furnizuesin për blerjen e sendit për qiramarrësin dhe lidh me furnizuesin kontratën e furnizimit.

4. Pas lidhjes së kontratës së furnizimit sendi i dorëzohet qiramarrësit nga furnizuesi në vendin, kohën dhe mënyrën e caktuar në kontratë e furnizimit. Përjashtimisht palët me marrëveshje mund të parashikojnë që dorëzimi i sendit të bëhet nga qiradhënësi. Gjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë financiare qiramarrësit i kalojnë të gjitha rrisqet dhe përfitimet e lidhura me sendin, ndërkohë që qiradhënësi ruan të drejtën e pronësisë. Në përfundim të afatit të kontratës qiramarrësi mund të zgjedh të ushtrojë opsionin e blerjes, të vazhdojnë ta mbajnë sendin me qera për një afat tjetër apo tia kthejnë atë qiradhënësit.

Në legjislacionin shqiptar kontrata e qirasë financiare parashikohet në dispozitat e kodit civil që rregullojnë kontratën e qirasë. Kur flasim për lloje të vecanta të kontratave të qirasë do të kihet parasysh që për to do të zbatohen dispozitat e qirasë dhe vetëm për ato pjesë që rregullohen në mënyrë të ndryshme nga kushtet e përgjithshme të saj do të zbatohen dispozitat e posacme të secilit lloj. (Tutulani - Semini, 2006, 65) Në këtë linjë arsyetimi nëse do ti referohemi dhe terminologjisë së pëdorur në ligjin specifik (kontratë qiraje, qiradhënësi, qiramarrës etj) do të konkludonim se në legjislacionin shqiptar kontrata e qirasë financiare klasifikohet si qira dhe si e tillë pjesë në grupin e kontratave që shërbejnë për kalimin e nëndorësisë dhe të përdorimit të një pasurie. Nga ana tjetër ligji për qiranë financiare ka bërë një trajtim të detajuar të kontratës madje shkon me tej kur parashikon se në rastin kur qiramarrësi është person fizik jo tregtar do të zbatohet rregullat e përgjithshme të kontratave. Rrjedhimisht lind pyetja a është i drejtë ky klasifikim nga kodi civil apo duhet që kontrata e qirasë financiare të parashikohet si një kontratë *sui generis*? Per tui pergjigjur kësaj pyetje duhet më parë të analizojmë qëllimin në vetvete të kontratës së qirasë financiare si dhe lidhjet e saj me kontratat e ngjashme të parashikuara në kodin civil, për të përcaktuar shkallën e ngjashmërisë dhe faktin nëse mund të klasifikohet si një prej tyre apo nëse duhet të klasifikohet si një kontratë më vete. Kështu në ndryshim nga kontrata e qirasë, qiradhënësi limitohet vetëm me vendosjen e sendit në dispozicion të qiramarrësit por nga ky moment me pranimin e sendit nga qiramarrësi të gjitha rreziqet që lidhen me sendin i kalojnë qiramarrësit. Një tjetër ndryshim thelbëor është se qiramarrësi në përfundim të afatit të kontratës mund të ushtroj të drejtën e blerjes së sendit. Dallon nga kontrata e shitjes me rezervë pronësie, për arsye se kalimi i pronësisë në përfundim të afatit të kontratës përbën një eventualitet dhe qiramarrësi mund ta ushtroj ose jo këtë të drejtë. Gjithashtu në rast se kontrata zgjidhet para afatit për faj të qeramarrësit pagesat e qirasë nuk do të trajtohen si këste blerje dhe shlyerja e tyre nuk krijon të drejta pronësie.

Pra pavarësisht ngjashmërive me kontratat e tjera të parashikuara në kodin civil kontrata e qirasë financiare për shkak të karakteristikave të saj unike diferencohet nga secila prej tyre.

Vecoritë e Kontratës së Qirasë Financiare

Qiraja financiare është një marrëdhënie juridiko-ekonomike komplekse e konkretizuar në dy kontrata të lidhura në mënyrë funksionale dhe kronologjike mes tyre përkatësish :

- **Kontrata e qirasë** nëpërmjet së cilës qiradhënësi i kalon qiramarrësit të drejtën e përdorimit të një sendi të zgjedhur nga qiramarrësi në të gjitha karakteristikat për një afat që zakonisht mbulon pjesën më të madhe të jetës ekonomike të sendit kundrejt pagesave periodike. Në thelb kontrata e qirasë i përgjigjet interesit të qiramarrësit për të përdorur një të mirë pa qenë e nevojshme të investoj kapitalin e duhur për blerjen e saj dhe interesit të qiradhënësit për të përfituar një dobi ekonomike nga ky investim.

- **Kontrata e furnizimit** (e lidhur me furnizuesin dhe qiradhënësin) nëpërmjet së cilës qiradhënësi fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin e përzgjedhur nga qiramarrësi. Furnizuesi në çdo rast duhet të jetë vënë në djeni nga qiradhënësi, paraprakisht ose në castin e nënshkrimit të kontratës se sendi blihet me qëllim për t'ia dhënë me qera qiramarrësit.

Nëpërmjet kontratës së qirasë financiare qiramarrësi i kalohet e drejta e përdorimit të një sendi për

një afat të caktuar. Qiramarrësi detyrohetta përdor sendin sipas destinacionit dhe qëllimit për të cilin është dhënë me qira dhe siaps rastit të kryej të gjitha riparimet me qëllim mirëmbajtjen e tij në atë gjendje qëështë marrë në dorëzim.(normailisht duke llogaritur edhe amortizimin nga një përdorim normal i tij). Ndërkohë qëqiradhënësi ruan të drejtën e pronësisëgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe nuk zhvishet në asnjë moment nga titulli i pronësisë. Në përfundim të afatit të kontratës si rregull qiramarrësit i jepet mundësia ta blej sendin megjithatë edhe në këtë rast ligji “Për qiranë financiare” ne nenin 9 pika 2 ka parashikuar një përjashtim,kështu nësëkontrata zgjidhet para afatit për faj të qiramarrësit pagesat e qirasë nuk do të konsiderohen si këste blerje dhe sendi rimeret nga qiradhënësi

Kontrata e qirasë financiare është një kontratëme afat. Palët në castin e lidhjes së kontratës parashikojnë në mënyrë të shprehur një afatillestar i cili varion në varësi të natyrës së sendit të dhënëme qera ose jetës ekonomike të tij dhe në cdo rast duhet të jetë brenda kufijëve minimum të parashikuar nga legjislatori. (përshembull për sendet e luajtshme me afat konsumimi deri ne pesë vjet parashikohet një afat minimal të paktën një vjekar, për sendet e luajtshme me afat konsumimi mbi pesë vjet parashikohet një afat të paktën dy vjekar dhe një afat të pakten tre vjekar për sendet e paluajtshme).Sic mund të shohim zakonisht sendet e paluajtshme jepen në qira financiare për një afat më të gjatë se sendet e luajtshme. Kohëzgjatja e kontratës së qirasë financiare shtrihet nga dita e pranimit të sendit nga qiramarrësi deri në likujdiminin e plotë të vlerës së tij. (Vasili, 2009, 24) Në përfundim të afatit të kontratës nëse sendi është në gjendje tëplotësoj nevojat për të cilat është marr me qera,qiramarrësi ka të drejtë të zgjedh ta përtërij kontratën dhe për një afat tjetër e në këtë rast do tëaplikohet njëtarifë periodike më e ulët se ajo fillestare.

Përsa i përket formës së kontratës së qirasë financiare, ndërsa kodi civil nuk parashikon ndonjë formë ligjore të detyrueshme, ligji për qiranë financiare parashikon formën shkresore për efekt provueshmërie.Duke pasur parasysh qëkontrata e qirasë financiare rregullon kryesisht marrëdhëniet e subjekteve me natyrë tregtare, forma shkresore është më e përshtatshme për të lehtësuar provueshmërinë e palëve në rast konfliktesh. (Tutulani - Semini, 2006, 45). Megjithatë ligji ka parashikuar përjashtime, kështu nëse në kontratë janë parashikuar kushte për rimarrjen jashtëgjyqësore të sendit në rastet e zgjidhjes së kontratës para afatit për faj të qiramarrësit kontrata duhet të bëhet me akt noterial sepse në të kundert është e pavlershme.Në të njëjtën kohë nëse kontrata e qirasë financiare parashikon mundësinë e blerjes së pasurisë së paluajtshme duhet të rregjistrohet në rregjistrat e pasurive të paluajtshme. Po ashtu, nëse objekti është një send i luajtshëm ky i fundit duhet të rregjistrohet në rregjistrin e barrëve siguruese. (neni 42 &43 i ligjit “Për qiranë financiare”) Kontrata e qirasë financiare parashikohet si një kontratë me shpërblim. Cmimi caktohet me marrëveshje të palëve dhe likujdohet nga qiramarrësi në mënyrëperiodike. Shpërblimi në këtë rast përfshin :

- Pagesat periodike të qirasëqë paguan qiramarrësi gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Secila prej pagesave periodike përfshihen vlerën e amortizimit të sendit, interesin për kapitalin e investuar, shpenzimet administrative, qëndrimin ndaj inflacionit monetar gjatë kohëzgjatjes së kontratës etj. (Vasili, 2009, 18)Në rast të lidhjes së kontratës për njëafat të dytë përfitohet një skonto në favor të qiramarrësit dhe pagesat e qirasë do të jenë më të ulta se ato fillestare.

- Cmimi i blerjes që përfshin tarifën e paracaktuar në kontratë nëse qiramarrësi vendos ta blej sendin në përfundim të afatit të qirasë.

Karakteristikë e vecantë e kontratës së qirasë finciareështë fakti seme pranimin e sendit nga qiramarrësi të gjitha rreziqet që lidhen me sendin i kalojnë qiramarrësit. Në nocionin e rezikut përfshihet cdo ngjarje atmosferike, natyrore apo sociale që sjell dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose humbjen e parakohshme të përdorshmërisë së tij. Si rregullqiramarrësi detyrohet të siguroj objektin material të qirasë financiare ndaj cdo lloj dëmtimi që mund ti kanoset në të ardhmen. Qiradhënësi përjashtohet gjithashtu nga përgjegjësia në rast vdekjeje, dëmtimesh trupore, ose dëmsh jopasurore që vijnë prej sendit. (neni14 pika 4 e ligjit “Për qiranë financiare”)

Karakteristikë tjetër e kontratës së është lidhja e kontratës së nënqirasë financiare e parashikuar. Sipas këtij rregulli qiramarrësi pasi ka marrë pëlqimin paraprak të qiradhënësit ka të drejtë të lidh kontrata të nënqirasë financiare për të tërë sendit apo për pjesë të tij me një person të tretë. Këto kontrata lidhen për një afat jo më të gjatë se afati i parashikuar në kontratën e qirasë

financiare dhe qiramarrësi përgjatë gjithë kohëzgjatjes së saj vazhdon të mbetet përgjegjës kundrejt qiradhënësit. Qiradhënësi ka të drejtë të rimarrë sendin drejtëpërdrejt prej nënqiramarrësit në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore nga qiramarrësi ose nga qiradhënësi. (neni 34 i ligjit “Për qiranë financiare”)

Kontrata e qirasë financiare është titull egzekutiv për sa i takon rimarrjes së sendit objekt i kontratës së qirasë dhe vihet në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor pas lëshimi të urdhërit të ekzekutimit nga Gjykata. Në këtë rast kontrata si titull egzekutiv duhet të jetë nga pikpamja e formës e rregullt dhe duhet të përmbahet në një akt të shkruar në të cilin duhet të jenë vënë nënshkrimet e nevojshme të palëve që e kanë nënshkruar (A.Lamani, 1962, 264)

Elementet e kontratës së qirasë financiare

Objekti i kontratës mund të jenë të gjitha sendet qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme me kusht që të jenë individualisht të përcaktuar dhe të pakonsumueshëm, për arsye se në përfundim të afatit të qirasë nëse qiramarrësi nuk ushtron të drejtën e blerjes, i njëti send i jepet me qira për një afat tjetër ose i kthehet qiradhënësit. Në ligjin e qirasë financiare kur flitet për sende me afat konsumimi i referohet konsumueshmerise juridike dhe në asnjë rast nuk duhet të ngatërohet me sendet e konsumueshme. Konsumueshmërisë juridike i nënshtohen të gjitha sendet që vjeterohen me përdorim, psh veshjet etj por sende te tilla janë të pakonsumueshme. (Shehu, 2000, 11). Nëse kontrata përmban kushte për fitimin e pronësisë, ose mundësinë së blerjes së këtyre sendeve nga qiramarrësi, objekt i kontratës mund të jenë vetëm sendet e tregtueshme, pra vetëm ato sende që mund të shiten ose të tjetërsohen. Si objekt material të kontratës së qirasë financiare mund të jenë: si automjete, mjete prodhuese, anije, avionë, banesa, fabrika etj në ndërtim apo të ndërtuara.

Subjektet e kontratës së qirasë financiare

Në lidhjen e kontratës së lisingut financiar operojnë tre palë kontraktuese të lidhur mes tyre në një marrëdhënie komplekse funksionale:

1. Qiradhënësi është një person juridik i pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së qirasë financiare, i cili investon kaplitalin e tij për të blerë një send, të drejtën e përdorimit të së cilit ia kalon një subjekti tjetër përkundrejt pagesave periodike. Subjekte që ushtrojnë veprimtari të qirasë financiare janë:

- Bankat dhe institucionet e tjera jobankare, të themeluara sipas legjislacionit në fuqi, të licencuar për të kryer veprimtari të qirase financiar.

- Shoqëritë tregtare që kanë objekt vetëm veprimtari të qirasë financiare me kapital themeltar jo më të vogël se 20000000 leke.

2. Qiramarrësi mund të jetë një person fizik apo juridik që merr sendin në përdorim për një afat të caktuar kundrejt pagesave periodike në përputhje me kushtet e kontraktuara në kontratën e qirasë financiare. Kur qiramarrësi është person fizik i parregjistruar për zhvillimin e veprimtarisë tregtare, kontrata e qirasë financiare i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të kontratave dhe vlerësohet si jotregtare. (neni 5 i ligjit “Për qiranë financiare”)

3. Furnizuesi është një person fizik ose juridik i cili i shet qiradhënësit sendit që i jepet me qera qiramarrësit. Furnizuesi mund të jetë prodhues me shumicë, tregtar, dhe kushdo tjetër që është zgjedhur nga qiramarrësi për të furnizuar me sendin përkatës.

Marrëdhënia mes qiramarrësit dhe furnizuesit nuk konkretizohet me një kontrate, megjithatë egziston një lidhje e ngushtë funksionale mes tyre. Kështu furnizuesi zgjidhet nga qiramarrësi i cili negocion me të kushtet e kontratës së furnizimit, karakteristikat e sendit, kohën, vendin dhe menyren e dorëzimit të tij. Në këtë rast qiradhënësi paraqitet në rolin e një ndërmjetesi financues dhe cdo detyrim i furnizuesit ndaj tij është dhe detyrim ndaj qiramarrësit. (Albanese & Zeroli, 2012, 57) Sipas kësaj llogjike qiradhënësi përjashtohet nga përgjegjësia për furnizimin e sendit të kontraktuar në përputhje me kushtet e kontratës dhe është furnizuesi ai që përgjigjet ndaj qiramarrësit përdorëzimin e sendit si dhe shpërblimit të dëmit në rast të mospërmbushjes me korrektësi të këtij detyrimi. Ky rregull nuk do të zbatohet nëse qiradhënësi ka ndëryrë në procesin e përzgjedhjes së sendit ose të furnizuesit, në këtë rast qiradhënësi dhe qiramarrësi do të jenë përgjegjës si bashkërisht edhe

individualisht ndaj qiramarrësit përpara qiramarrësit.(neni 19 i ligjit “Për qiranë financiare”)

Detyrimet kryesore të qiradhënësit :

- Qiradhënësi kaose fitontë drejtën e pronësisë mbi sendin e kërkuar në qira financiare. Në rastine kontratës së qirasë financiare me furnizues qiradhënësi detyrohet të njoftoj furnizuesin para lidhjes së kontratës ose në castin e nënshkrimit të saj se sendi blihet me qëllim për tia dhënë me qira qiramarrësit. Cdo ndryshim i mëvonshëm i kontratës së furnizimit ndërmjet qiradhënësit dhe furnizuesit nuk prek të drejta e qiramarrësit, përveç rastit kur këto ndryshime janë miratuar prej tij shprehimisht.

- Qiradhënësi është përgjegjës ndaj shqetësimeve ligjore që i bëhen qiramarrësit dhe detyrohet të garantoj gëzimin e qetë dhe të plotëgjatëgjithë kohëzgjatjes së kontratës. (neni 23 i ligjit “Për qiranë financiare”) Në hipotezën e egzistencës së pretendimeve nga persona të tretë mbi sendin e dhënë me qira qiramarrësi lajmëron qiradhënësin dhe i kërkon këtij të fundit të marr të gjitha masat e nevojshme për clirimin e sendit nga të tilla pretendime brenda një afati të arsyeshëm. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e qiradhënësit i jep të drejtën qiramarrësit të zgjidhë kontratën ose të kërkoj uljen përpjestimore të pagesave të qirasë. Në këtë rast nëse qiramarrësi provon se nuk ka pasur djeni për pretendimet e personave të tretë në castin e lidhjes së kontratës ka të drejtë të kërkoj dhe dëmshperblim.

Cdo klauzolë në kontratë që kufizon apo përjashton përgjegjësinë e qiradhënësit për defektet ligjore të sendit është e pavlershme

Detyrimet kryesore tëqiramarrësit

- Pranon sendine dorëzuar nga furnizuesi pasi ka verifikuar më parë mungesën e të metave dhe përputhjen e tij me përshkrimin e bërë në kontratën e qirasë financiare. Nëse qiramarrësi edhe pse ka pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të kontrolluar sendin dhenuk ka njoftuar mospranimin e tij nuk ka të drejtë as ta kundërshtoj sendin e furnizuar as të kërkoj zgjidhjen e kontratës.

- Qiramarrësi përdor sendin sipas destinacionit dhe detyrohet ta mirëmbaj në gjendjen e nevojshme për të shërbyer sipas qëllimit për të cilin është dhënë me qira financiare. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës qiramarrësi kryen të gjitha riparimet e domosdoshme dhe të nevojshme për këtë qëllim, gjithashtu detyrohet të sigurojë sendin nga çdo lloj dëmtimit mundshëm. Ky i fundit përgjigjet për çdo humbje të shkaktuar sendit nga përdorimi në kundërshtim me kontratën, apo në kundërshtim me qëllimin e saj;

- Një ndër detyrimet kryesore të qiramarrësit është të paguaj në kohën, vendin dhe mënyrën e përcaktuar në kontratëpagesat periodike të qirasë

Llojet e kontratës së qirase financiare

Leasing financiar si një kontratë e lindur nga praktikat dhe nevojat tregtare shfaqet në forma të ndryshme(Vasili, 2009, 13)

Llojet kryesore të kontratave të parashikuara nga legjislacioni ynë janë :

- Qiraja financiare me furnizues.Në këtë kontratëoperojnë tre palë kontraktuese të lidhur mes tyre në një marrëdhënie komplekse funksionale sipas së cilës një subjekt (që ushtron veprimtari të qirasë financiare) financon blerjen e një sendi duke u bërë pronar i tij dhe ia jepatë me qira një personi tjetër kundrejt pagesave periodike, me opsionin e blerjes në përfundim të periudhës së qirasë. Këstet e qirasë janë të përcaktuara në mënyrë të tillë, që totali i pagesave gjatë periudhës së qiramarrjes të mbulojë koston e aktivitetit bashkë me interesat dhe fitimin e qiradhënësit.

- Qiraja financiare e drejtëpëdrejtë ka si vecori kryesore të saj mungesën e furnizuesit.Në këtë rast sendet janë në pronësi të qiradhënësit dhe është ky i fundit që bën furnizimin e drejtëpëdrejtë të qiramarrësit. Në dallim nga qiraja financiare me furnizues qiramarrësi ka më tepër liri a zgjidhë kontratën para afatit me njoftim paraprak dhe qiradhënësi krahas dorëzimit të sendit ofron edhe shërbime ndihmëse e mirëmbajtjeje. (neni 2 i ligjit “Për qiranë financiare”)

- Qiraja financiare vendase mund të jetë qira financiare me furnizues ose qira financiare e drejtëpëdrejtë dhe karakteristika bazë e saj është se sendi mbahet me qira në Republikën e

Shqipërisë, dhe si qiradhënësi, ashtu edhe qiramarrësi kanë banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;

- Qiraja financiare ndërkombëtare. Në ndryshim nga qira financiare vendase në atë ndërkombëtare qiramarrësi dhe qiradhënësi kanë shtete të ndryshme. Ky lloj trasaksioni është shfaqur si një mjet i rëndësishëm për zhvillimit ekonomik në tregun global, dhe preferohet kryesisht për investime për qëllime komerciale. (WANG, 2011, 136)

Konkluzione

Qiraja financiare është një kontratë jo tipike e konceptuar për t'u përgjigjur nevojave të tre paleve që marrin pjesë në këtë marrëdhënie juridike e përkatësisht: interesit të qiramarrësit (për të përdorur një të mirë), interesit të qiradhënësit (për të përfituar një interes ekonomik nga financimi i blerjes) si dhe interesit të furnizuesit (për të përfituar nga shitja e sendit). Për shkak të natyrës dhe karakteristikave të saj unike pavarësisht ngjashmërive diferencohet nga kontratat e tjera të parashikuara në Kodin Civil.

Qiraja financiare është një formë investimi moderne dhe aktuale e ideuar si për plotësimin e nevojave të individëve si konsumator ashtu edhe për zhvillimin e aktivitetit tregtar. Rëndësia e saj qëndron jo vetëm për aspektin financiar, por gjithashtu për faktin se përbën një instrument të rëndësishëm për zhvillimin dhe rritjen e bizneseve, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme që nuk mund të sigurojnë garancitë pasurore të nevojshme për financimin e aktivitetit.

Krahasuar me trendin e zhvillimit, në vendin tonë qiraja financiare është ende në hapat e parë si të trajtimit teorik ashtu dhe të aplikimit në praktikë dhe ka gjetur zbatim kryesisht në tregun motorik dhe imobilar.

Referenca

- Nuni, A. (2009). "E drejta Civile". TIRANË.
- Tutulani - Semini, M. (2006). "E drejta e detyrimeve dhe e kontaktave" Pjesa e Posacme. TIRANË.
- Tutulani - Semini, M. (2006) "E drejta e detyrimeve dhe e kontaktave" Pjesa e Përgjithshme. TIRANË.
- Lamani, A. (1962). "Procedura civile e Republikës së Shqipërisë". TIRANË.
- Shehu, A. (2000) "Pronësia". TIRANË.
- M, Albanese & A, Zeroli. (2012). "Leasing e Factoring". MILANO.
- L, WANG. (2011). "Une Analyse Juridique Sur Le Crédit-Bail"
- J, Vasili. (2009). "Kontrata Civile Jotipike". TIRANË.
- www.cscanada.net

Legjislacioni

- Convention on International Financial Leasing in 1988 Ottawa: International Institute for the Unification of Private Law (UNIDROIT)
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare" i azhurnuar me: Ligjin Nr.9823, datë 29.10.2007 & Ligjin Nr.9966, datë 24.7.2008.
- Ligj nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".
- Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Përgjegjësia ligjore e menaxherëve dhe aplikimi i ligjit të punës në bizneset e Komunës së Gjilanit

Autor1. Ma.sc.Zymer Tafaj

Forca e Sigurisë së Kosovës, Isniq-Deçan

Autor2.Ba.sc.Fatos Turkaj

Senator në Universitetin “Haxhi Zeka” – Pejë, Dubrav-Deçan

Abstrakti

Ky punim shtjellon temën e qëndrimit të njerëzve që menaxhojnë bizneset në Komunën e Gjilanit mbi përgjegjësinë e tyre ligjore gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre, si dhe zbatimin e obligimeve ligjore në praktikë. Biznese këto që shpesh anashkalojnë këtë përgjegjësi dhe afirmojnë interesa tjera në kundërshtim me ligjin.

Qëllimi i punimit është që të pasyrohen qëndrimetdhenjohuritë teorike të menaxherëve të bizneseve në Komunën e Gjilanit rreth përgjegjësisë ligjore të tyre si dhe përpjekjet dhe angazhimin e tyre për aplikimin e obligimeve ligjore në praktikë, pra zbatimin e ligjit të punës si obligim ligjor.

Punimi është bërë në dy faza. Faza e parë i referohet mbedhjes së të dhënave nga literatura të cilat janë të lidhura me temën dhe gjen zbatim metoda deduktive. Ndërsa faza e dytë ka të bëjë me të dhënat e mbledhura në teren dhe gjen zbatim metoda induktive. Metodologjia e përdorur është kualitative dhe të dhënat e mbledhura në teren janë cilësore ku janë intervistuar 15 menaxherë, për të pasqyruar qëndrimin e tyre rreth përgjegjësisë ligjore dhe 15 punëtorë të bizneseve në Komunën e Gjilanit për të pasqyruar zbatimin e obligimeve ligjore në praktikë.

Ndër gjetjet kryesore të punimit janë se menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit janë të vetëdijshëm për obligimin dhe përgjegjësinë ligjore qëkanënë aspektin teorik mirëpo shumica nga ata nuk i zbatojnë obligimet por afirmojnë interesat e tyre për arritje të rezultateve më të mëdha duke shkelur ligjin. Gjendja që mbizotëron në bizneset e kësaj Komune sa i përket këtij aspekti nuk është për tu dëshiruar.

Fjalët kyqe: menaxherët, përgjegjësia ligjore, ligji i punës, biznesi.

Hyrje

Bizneset në Komunën e Gjilanit që nga pas lufta po ballafaqohen me probleme të shumta, edhe pse kohët e fundit vërehen përmirësime prapë problemet dhe veshtirësitëjanë evidente sa i përket mënyrës së bërjes biznes. Këto biznese në të shumtën e rasteve gjatë veprimtarisë anashkalojnë elemente të domosdoshme duke i neglizhuar ato, dhe duke favorizuar fitimin, si element që shpesh lehet anash është edhe përgjegjësia ligjore, pra mos zbatimi i ligjeve që janë të detyrueshme dhe bizneset duhet të japin përgjigje për një gjë të tillë. Punimi e shtjellon temën e përgjegjësisë ligjore dhe zbatimin e ligjit të punës nga ana e bizneseve në Komunën e Gjilanit, kur dihetqëllimi kryesor i çdo biznesi është fitimi, dhe shpesh neglizhohen objektivat jo financiare të bizneseve, objektiva këto që pengojnë ose ngadalësojnë fitimin në shumë raste, mëgjithatë janë të domosdoshme për zbatim dhe ndikojnë për të arritur deri tek stabiliteti dhe bashkëpunimi i ndërsjellë mes biznesit dhe shoqërisë.

Përmes këtij punimi synojmë që të paraqesim gjendjen momentale të bizneseve në Komunën e Gjilanit sa i përket përgjegjësisë ligjore dhe aplikimit të ligjit të punës. Qëllimi i hulumtimit (punimit) është: që të pasyrohen qëndrimet dhe njohuritë teorike të menaxherëve të bizneseve në Komunën e Gjilanit rreth përgjegjësisë sociale dhe ligjore të tyre, si obligim i detyrueshëm si dhe përpjekjet dhe angazhimi i tyre për aplikimin e obligimeve ligjore në praktikë, pra zbatimin e ligjit të punës si obligim ligjor.Punimi përbëhet nga dy pjesë: pjesa teorike dhe empirike,kurse metodat e përdorura në punim janë deduktive dhe induktive. Në pjesën teorike të punimit që mbështetet në të dhëna dytësore dhe terciare të marra nga literatura përkatëse dhe interneti përdoret metoda deduktive. Ku nga e përgjithshmja arrijmë deri tek faktet e veqanta dhe duke përdorur metodën përshkruese do të japim përgjigje në pyetjen se çështë biznesi, menaxhimi, përgjegjësia sociale dhe ligjore si dhe

obligimi ligjor?

Në pjesën e dytë empirike të punimit që mbështetet në të dhëna primare të mbledhura në teren përmes intervistës, përdoret metoda induktive ku nga fakte të veçanta arrijmë deri të rezultatet e përgjithshme. Për të marë përgjigje në pyetjet hulumtuese: Cilat janë njohuritë dhe qëndrimet e menaxherëve ndaj përgjegjësisë ligjore dhe obligimit ligjor si dhe sa izbatojnë ata këto njohuri në praktikë, pra sa e zbatojnë ata ligjin e punës si një obligim i detyrueshëm ligjor, përdoret metoda kualitative, cilësore, ku janë intervistuar 15 menaxherë dhe 15 punëtorë të bizneseve në Komunën e Gjilanit. Edhe metoda analitike dhe krahasuse gjejnë zbatim gjatë punës tonë kërkimore.

Mostra nga merren të dhënat janë menaxherë dhe punëtorë, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme dhe në bazë të përgjigjeve të tyre do të arrijmë deri tek konkluzionet dhe rekomandimet. Si gjetje kryesore është se shumica e menaxherëve të bizneseve në Komunën e Gjilanit posedojnë njohuri të mira rreth përgjegjësisë ligjore dhe thonë se mundohen në maksimum që të përmbushin detyrimet e tyre ligjore, mirëpo realiteti është ndryshe sepse shumica nga ata zbatojnë ligjet vetëm në minimumin e nevojshëm duke afirmuar më shumë objektivat ekonomike. Kurse si rekomandim është se rruga kryesore për të pasur një biznes të suksesshem është që ata ti kushtojnë vëmendje përgjegjësisë sociale e në kuadër të saj edhe asaj ligjore dhe ta aplikojnë atë në praktikë e jo vetëm në minimumin e obliguar.

2. Biznesi, mjedisi i biznesit dhe menaxhimi

Biznesi është një grup njerëzish të cilët punojnë së bashku për të zhvilluar, prodhuar ose shpërndarë mallra apo shërbime (Ingram, Albright and Baldwin, 2003, fq. 5). Biznesi është njëri ndër institucionet që ka kontribuar shumë në përmirësimin e cilësisë së jetës njerëzore, renditet krahas shkencës, artit dhe edukimit (Çela, 2006, fq.15). Biznesi krijohet për të arritur fitimin. Pra biznes është çdo lloj veprimtarie ekonomike, zakonisht private, që ka për qëllim fitimin, në një mënyrë me biznes kuptohet edhe një ndërmarrje ose organizatë tjetër ekonomike (Skënderi, 2010, fq.29). Ndërmarrjet, kompanitë ose firmat janë organizata që përmes tregut punojnë për klientët, dhe presin të marrin atë që duan, me çmimin që ata do të paguajnë (Jones, Parker and Rene ten Bos, 2005, fq. 10). Një firmë biznesi është një organizatë që është ndërtuar me qëllim sigurimin e fitimit për pronarët e tyre, duke prodhuar të mira apo shërbime të vlefshme në treg për konsumatorin (Uruçi, 2004, fq.184). Funkzioni kryesorë i biznesit është identifikimi dhe plotësimi i nevojave të klientëve duke ju shërbyer mirë atyre, një biznes mund të mbijetojë e lulëzojë me kalimin e kohës (Jones, Parker and Rene ten Bos, 2005, fq. 10). Ai është një aktivitet tregtar në përgjithësi si tregti, shitje, blerje dhe prodhim (Konini & Peçi , 1997, fq. 45).

Të gjitha organizatat të vogla apo të medha, private apo publike, të orientuara në fitim ose jo, e pavarësisht nga fusha ku e ushtrojnë aktivitetin e tyre kanë një gjë të përbashkët: nevojën për tu menaxhuar (Llaci, 2002, fq.12). Menaxhmenti paraqet procesin e orientimit të vetëdijshëm të aktiviteteve njerëzore kah realizimi i qëllimeve të caktuara, përkatësisht mundësinë e ndërlikur të pesë funksioneve: planifikimit, organizimit, personelit, udhëheqjes dhe kontrollit (Ramosaj, 2007, fq.21). Menaxhimi është procesi i realizimit të punëve në mënyrë efektive dhe efçente, përmes dhe me persona të tjerë (Robbins & DeCenzo, 2011, fq.34). Menaxherët janë bartës të menaxhimit, Pa menaxher nuk ka punë organizative, ndërsa menaxherët janë të nevojshëm gjithherë kur njerëzit dëshirojnë të punojnë bashkërisht ashtu që të realizojnë ndonjë qëllim, pra menaxheri është një person që mbikëqyrë punën e personave tjerë (Ramosaj, 2007, fq.21).

Realizimi i qëllimeve të vendosura në çdo organizatë është nën presion të vazhdueshëm të rrethinës (Zeqiri,2006, Fq.59). Rrethinat nuk janë të njëjta dhe dallohen nga shkalla e papërcaktueshmërisë së tyre dhe ndahen në dy dimensione: shkalla e ndryshimeve dhe shkalla e ndërlikimit, udhëheqja e biznesit duhet të ketë në konsideratë faktorët e mjedisit të cilët njihen si(Mustafa, 2004, fq.37): faktorët e makromjedisit, mikromjedisit dhe mjedisit të brendshëm.

Gykar në bazë të spektrit të faktorëve të jashtëm të rrethinës që ndikojnë në organizata dallojmë rrethinën (Zeqiri, 2006, fq.59):

- Rrethinë e përgjithshme (që përfshinë faktorët: ndërkombëtar, teknologjik, social-kulturor,

ekonomik dhe politiko-ligjor).

- Rrethinë afariste (që përfshinë: konsumatorët, konkurentët, furnitorët dhe oferta e punëtorëve).

- Rrethina e brendshme (që përfshinë: punëtorët e punësuar, menaxhmentin, kulturën organizative etj).

Njëra nga shkaqet se pse për biznesin është e rëndësishme rrethina, është ajo se ai është sistem i hapur social, i cili vazhdimisht konsumon resurse nga rrethina (Koleci, Reçica & Turkeshi, 2008, fq.95). Mjedisi i biznesit ndikon fuqishëm në numrin e bizneseve që krijohen dhe që falimentojnë (Mustafa, Kutllovci, Gashi & Krasniqi, 2006, fq.44). Rrethina si sistem i rangut më të lartë është burim i mundësive për organizatën e cila shfaqet në formë resurcesh kryesore dhe tregjesh, por në të njëjtën kohë është burim i kërcënimeve dhe rreziqeve që shfaqet në formë të pasigurisë dhe kufizimeve (Zeqiri, 2006, fq.66).

3.Përgjegjësia sociale dhe ligjoree biznesit

Përgjegjësiasociale e njëbiznesiështë detyrimi përtej asaj çka i kërkon ligji, dhe ekonomiksi, që të jepet pas qëllimeve afatgjata që janë me përfitim për shoqërinë (Robbins & DeCenzo, 2011, fq.96). Përgjegjësia shoqërore përfshinë obligimet e menaxhmentit që të marë vendime dhe të ndërmarrë aksione në të cilat do ta rrisë pasurinë dhe interesin e shoqërisë si dhe të organizatës (Zeqiri, 2006, fq.66).Ekzistenca, mbijetesa dhe rritja e biznesevaret nga pranimi i shoqërisë dhe mjedisit të saj, prandaj bizneset duhet të kenë përgjegjësi sociale, sepse pa të ato do të vdesin (Çela, 2006, fq.15).

Bizneset përveq objektivave financiare kanë edhe objektiva të rëndësishme jofinanciare të cilat ndikojnë apo e kufizojnë arrijten e objektivave financiare e këto objektiva kanë të bëjnë me maksimizimin e satisfaksionit dhe etikën në biznes (Mustafa, 2007, fq.44). Sipas Carroll (1979), përgjegjësia sociale e biznesit përfshinë: përgjegjësinë ekonomike, ligjore, etike dhe filantropike, të vendosura nga shoqëria mbi biznesin në një kohë të caktuar (fq.497–505).

Përgjegjësia ligjore u mundëson bizneseve të veprojnë në mënyrë ligjore dhe të arrijnë misionin e tyre brenda kornizave ligjore sepse mbajnë përgjegjësi për normat ligjore dhe duke i respektuar ato veprojnë drejt (Zeqiri, 2006, fq.94).Secili biznes duhet të veprojë në bazë të ligjeve dhe rregulloreve, nga ata pritet të përmbushin qëllimet ekonomike brenda kuadrit ligjor qëështë i imponuar nga këshillat komunale lokale,dhe ligjvënësit e shtetit, bizneset që më dashje shkelin ligjin janë interpretuese të dobëta të përgjegjësis ligjore(Carroll, 1979, fq.497–505).

Për dallim nga përgjegjësia sociale detyrimi social i një biznesit është detyra për të plotësuar vetëm përgjegjësitë ekonomike dhe ligjore, pra zbatimin në minimum të kërkesave të ligjit pra plotësohen vetëm ato qëllime sociale që kontribuojnë në qëllimet ekonomike (Robbins & DeCenzo, 2011, fq.96). Një ndërmarrje e përgjegjshme biznesi është ajo që vazhdimisht e përmirëson performancën e biznesit të saj, ka fitim dhe e rritë mirëqenien e komunitetit (Departamenti i tregtisë së SHBA-së, 2007, fq. 178). Kjo ndodh përmes përmbushjes së pritshmërive të arsyeshme të të tretëve. Teorikisht koncepti përgjegjësi shoqërore e biznesit kuptohet si plotësim i obligimeve të biznesit ndaj shoqërisë (Havolli, 2005, fq. 60). Ndërsa reagimi social është aftësia e biznesit për tu përshtatur kushteve tëndryshme shoqërore (Robbins & DeCenzo, 2011, fq.96).

Kosova një vend i dalë nga lufta kishte një infrastrukturë të dobët ligjore që nga themelimi i institucioneve të shtetit e deri më tani, organet legjislative dhe ekzekutive kanë miratuar shumë ligje dhe janë munduar që ti ekzekutojnë ato në praktikë. Në mbështetje të nenit 65 (1) dhe nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të ekonomisë së hapur dhe të tregut të punës, me qëllim të krijimit të një baze ligjore funksionale, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për marrëdhënien e punës, Kuvendi i Kosovës në dhjetor të vitit 2010 miraton ligjin e punës. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj.

Ligji i punës përbëhet nga 12 paragrafe: dispozitatthemelore, themelimi i marrëdhënies së punës, sistemimi i të punësuarit në vendin e punës, pushimet dhe mungesat nga puna, mbrojtja

dhe siguria në punë, paga dhe beneficionet e të punësuarve, ndërprerja e marrdhëniës së punës, procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, organizatat e të punësuarve dhe të punëdhënësve, dispozitat ndëshkimore, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare . Këto paragrafe kanë gjithësej 100 nene.

4. Rezultatet e hulumtimit - Analizimi i të dhënave

Për të pasqyruar një situatë më reale rreth përgjegjësisë ligjore dhe aplikimit të ligjit të punës në bizneset e Komunës së Gjilanit si dhe për të arritur konkluzionet e duhura dhe për të shprehur rekomandime sa më të plota, u hartuan dy pyetësor, të fokusuar në këtë problem. Të dhënat e mbledhura në teren janë cilësore ku janë intervistuar 15 menaxherë me qëllim që të pasqyrohet qëndrimi i tyre rreth përgjegjësisë ligjore dhe 15 punëtorë me qëllim që të pasqyrohet zbatimi praktik i ligjeve të detyrshme gjatë punës biznesore. Kampioni i menaxherëve dhe punëtorëve që udhëheqin dhe punojnë në bizneset e Komunës së Gjilanit u zgjodhën në mënyrë rastësore.

Në këtë pjesë të punimit përdoret metoda kualitative, dhe ajo induktive me qëllim që rezultatet e përfituara nga këto intervista të përgjithësohen dhe deri diku të përshkruajnë se cili është qëndrimi i menaxherëve rreth përgjegjësisë dhe obligimeve ligjore si dhe zbatimi i tyre gjatë punës në praktikë. Metoda analitike dhe e krahasimit gjenë zbatim në punim.

Në vazhdim paraqiten rezultatet e intervistës së bërë me menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit.

1. A mendoni së biznesi duhet ti kushtoj kujdes përgjegjësisë sociale e në veçanti përgjegjësisë ligjore?

Rezultatet e Fig .1. tregojnë se 100% e menaxherëve të intervistuar kanë deklaruar se nuk mund të ketë biznes të suksesshëm pa marrë në konsideratë përgjegjësinë sociale e sidomos atë ligjore, sepse ajo është një detyrim dhe obligim për ata.

2. A përmbushë biznesi që ju menaxhoni detyrimet ligjore ndaj shtetit dhe të punësuarve?

Rezultatet e Fig .2. tregojnë së 100% e menaxherëve të intervistuar kanë deklaruar së biznesi që ata menaxhojnë i përmbushë të gjitha obligimet ligjore si ndaj shtetit ashtu edhe ndaj të punësuarve, sipas tyre ata përmbushin kriterin ligjor.

3. Konkretisht a gjenë zbatim ligji i punës gjatë veprimtarisë tuaj biznesore?

Rezultatet e Fig .3. tregojnë së 100% e menaxherëve të intervistuar kanë deklaruar se biznesi që ata menaxhojnë zbaton ligjin e punës dhe çdo ligj tjetër ekzistues në vendin tonë më konkretisht ligji i punës sipas tyre zbatohet gjatë aktivitetit të tyre biznesor.

Për të pasqyruar realitetin e zbatimit të ligjit të punës në praktikë u intervistuan edhe 15 punëtorë biznesesh, më poshtë po paraqesim rezultatet e arritura:

4. A keni kontratë pune dhe a bën biznesi ku ju punoni pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore?

Rezultatet e Fig .4. tregojnë se 53% e punëtorëve të intervistuar nuk kanë kontrata pune ndërsa 47% kanë kontrata pune, 53%e tyre kanë deklaruar se nuk paguajnë kontribute dhe detyrime ndërsa 47% e tyre kanë deklaruar se paguajnë kontribute dhe detyrime pra shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit nuk kanë kontrata pune dhe se biznesi ku ata punojnë nuk paguan kontribute dhe

detyrime për ata.

5. A punoni më shumë së 40 orë në javë dhe a shpërbleheni për punë shtesë?

Rezultatet e Fig .5. tregojnë se shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit punojnë mbi 40 orë në javë dhe se shumica nga ata nuk shpërblehen për punë shtesë pra 73% e punëtorëve të intervistuar kanë deklaruar së punojnë mbi 40 orë në javë, kurse 27% thonë së punojnë vetëm 40 orë në javë, pjesa e punëtorëve që punojnë me shumë së 40 orë në javë pra 11 të intervistuar, 73% e tyre kanë deklaruar se nuk shpërblehen, ndërsa 27% e tyre kanë deklaruar se shpërblehen për punën shtesë.

6. A shfrytëzoni pushime ditore, javore ose vjetore, dhe a ju lejohen mungesat më pagesë në rast martese, vdekje, pushimi mjekësor, lindje të fëmijës të parapara në ligjin e punës?

Rezultatet e Fig .6. tregojnë se shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit nuk i shfrytëzojnë pushimet ditore, javore dhe vjetore sipas ligjit pra 53% e tyre thonë se nuk i shfrytëzojnë, kurse 47% e tyre thonë së i shfrytëzojnë sipas ligjit. Kurse sa i përket mungasave me pagesë në rast, vdekje, martese, pushim mjekësor etj, shumica nga të punësuarit ose 53% e tyre thonë së nuk ju lejohet të shfrytëzojnë pushime të tilla, ndërsa 27% e punëtorëve të intervistuar thonë së shfrytëzojnë pushime të tilla.

7. A e dini se ekziston ligji i punës dhe se ju mund të ankoheni për moszbatimin e tij, dhe a jeni të gatshëm të ankoheni?

Rezultatet e Fig .7. tregojnë se shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit kanë njohuri për ekzistimin e ligjit të punës, pra 93% e tyre, ndërsa vetëm 7% e punëtorëve nuk e dinë së ekziston një ligj i tillë dhe se vetëm 27% e punëtorëve janë të gatshëm të ankohen kur kemi shkelje të ligjit ndërsa pjesa tjetër 73% nuk do të raportojnë një gjë të tillë sepse friksohen se mund të ndëshkohen nga eprorët e tyre.

5. Konkluzionet dhe rekomandimet

Konkluzionet

Menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit thonë se nuk mund të ketë biznes të suksesshem pa marrë në konsideratë dhe kushtuar vëmendje përgjegjësisë sociale e sidomos asaj ligjore që njëherit është obligim i detyrueshëm për ata.

Shumica e menaxherëve në Komunën e Gjilanit deklarojnë se biznesi që ata menaxhojnë i përmbushë të gjitha obligimet ligjore si ndaj shtetit ashtu edhe ndaj të punësuarve, pra ata thonë se e përmbushin kriterin ligjor.

Menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit deklarojnë se biznesi që ata menaxhojnë zbaton ligjin e punës dhe çdo ligj tjetër ekzistues dhe së ligji i punës sipas tyre zbatohet në përpikëri gjatë aktivitetit të tyre biznesor.

Shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit nuk kanë kontrata pune dhe se biznesi ku ata punojnë nuk paguan kontribute dhe detyrime për ata. Pra shumica e bizneseve shkelin ligjin e punës konkretisht tek paragrafi i themelimit të mardhënies së punës.

Shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit punojnë mbi 40 orë në javë dhe se shumica nga ata nuk shpërblehen për punë shtesë pra punojnë më orare të stërzgjatura deri në 12 orë në ditë dhe nuk shpërblehen për punën e bërë, ketu del në pah shkelja e ligjit tek paragrafi i orarit të punës.

Shumicës së të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit nuk ju lejohet të shfrytëzojnë pushimet ditore, javore dhe vjetore sipas ligjit, si dhe nuk kanë të drejtë në mungesa më pagesë në rast, vdekje,

martese, pushimi mjeksorë dhe lindjes së fëmijës. Edhe ketu kemi të bëjmë me shkeljen e ligjit të punës nga ana e bizneseve të Komunës së Gjilanit më konkretisht tek paragrafi i pushimeve dhe mungesave nga puna.

Shumica e të punësuarve në bizneset e Komunës së Gjilanit e dinë së ekziston ligji i punës mirëpo nuk kanë guxim dhe gadishmëri për ankesë ose raportim të shkeljes së tij nga ana e praporëve të tyre sepse frikësohen nga ndëshkimet.

Si përfundim i përgjithshëm është së menaxheret e bizneseve në Komunën e Gjilanit teorikisht e dinë rëndësinë e zbatimit dhe aplikimit të aspektit jo financiar gjatë punës se tyre pra përgjegjësinë sociale që ata kanë dhe atë ligjore si obligim i tyre mirëpo në praktikë këto njohuri nuk i praktikojnë dhe në vazhdimësi e shkelin ligjin e punës pra shumica nga ata as në minimum nuk zbatojnë obligimet e tyre ligjore.

Rekomandimet

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që të kenë kujdes ndaj përgjegjësisë sociale dhe ligjore sepse është ajo që ju japë jetëgjatësi, emër dhe suksese bizneseve të tyre, dhe nëse duan përfitime më të mëdha nga kjo veprimtari nevojitet kujdes më i madh në këtë aspekt.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që të përmbushin të gjitha obligimet ligjore në maksimum si ndaj shtetit ashtu edhe ndaj të punësuarve, sepse ky është veprim i domosdoshëm dhe i rëndësishëm.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që të zbatojnë ligjin e punës dhe çdo ligj tjetër ekzistues sepse askush nuk është mbi ligjin dhe do të japin përgjegjësi për shkeljet apo neglizhimin e tyre.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që gjatë themelimit të mardhëniës së punës të lidhin kontrata me të punësuarit dhe në to të specifikojnë kushtet e nevojshme sepse është kjo është pjesë e kërkuar nga ligji i punës si dhe të paguajnë kontributet dhe detyrimet për punëtorët sepse për neglizhim të këtij veprimi do të ndëshkohen.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që mos ti ngarkojnë punëtorët më punë shtesë të tepruar sepse punëtorët për të qenë më produktiv ju nevojitet edhe kohë e lirë pra përveq aspektit profesional ata kanë nevoja humane edhe nese ndodh ndonjë angazhim i tepërt në punë ai duhet kompenzuar patjetër.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që të fillojnë aplikimin e pushimeve ditore, javore dhe vjetore sipas ligjit të punës sepse një gjë e tillë është e obliguar gjithashtu rekomandohet edhe aplikimi i mungesave me pagesë në rast martese, lindje, vdekje ose smundje në të kundërtën për shkelje të ligjit do të dënoheni.

Rekomandohen punëtorët e bizneseve në Komunën e Gjilanit që ta analizojnë ligjine punës dhe në momentin që shkelen të drejtat e garantuara më këtë ligj, ata ta marin guximin dhe gadishmërinë për ankesë ose raportim të shkeljes sepse vetëm kështu mund të mbrohen të drejtat e tyre dhe të jetësohet ligji i punës.

Si rekomandim i përgjithshëm është së menaxherët e bizneseve në Komunën e Gjilanit njohuritë dhe qëndrimet teorike që i kanë ti zbatojnë në praktikë sepse qëndrimi pozitiv ndaj përgjegjësisë ligjore në teori dhe mosaplikimi i saj në praktikë realisht është asgjë.

Referencat

1. Carroll, B. A., (1979): "A Three-Dimensional Conceptual Model of Corporate Social Performance", *Academy of Management Review*.
2. Çela, H., (2006): "Etika e Biznesit", Tiranë, albPAPER.
3. Departamenti i tregtisë së SHBA-së, *Administrata e Tregtisë Ndërkombëtare*, (2007): "Etika e Biznesit", Kosovë, Ribotuar nga Zyra e SHBA-së në Prishtinë.
4. Havolli, Y., (2005): "Etika e Biznesit", Prishtinë, Universiteti i Prishtinës.
5. Ingram, R., Th. Albright, and B. Baldwin, (2003): "Kontabilitet Financiar", Mason, Ohio USA, Thomson

South-Western.

6. Jones, C. Parker, M. and Rene ten Bos, (2005): "For Business Ethics", London and New York, Routledge Taylor & Francis Group.
7. Koleci, B., F. Reçica, N. Turkeshi (2008): "Menaxhment", Prishtinë, AAB.
8. Konini, M., I. Peçi, (1997): "Fjalor Ekonomik", Tiranë, CIVET.
9. Mustafa, I., (2007): "Menaxhmenti financiar", Prishtinë, Riinvest.
10. Mustafa, I. (2004): "Udhëheqja efiçenca dhe efektiviteti", Prishtinë, RIINVEST.
11. Mustafa, M., E. Kutllovci, P. Gashi, B. Krasniqi, (2006): "Biznesi i vogël dhe i mesëm", Prishtinë, Adnan Rezniqi CO.
12. Ramosaj, B. (2007): "Bazat e Menaxhimit", Prishtinë, Universiteti i Prishtinës.
13. Robbins, S., D. DeCenzo, (2011): "Bazat e Menaxhimit", Tiranë, UET/Press.
14. Skenderi, N. (2010): "Fjalor Ekonomiko-Social", Prishtinë, AKB.
15. Uruçi, E. (2004): "Mikroekonomia", Tiranë, Toena.
16. Zeqiri, I. (2006): "Menaxhmenti", Tetovë, Tringa Design.
17. <http://www.kuvendikosoves.org>

Legislative response and current challenges in tackling customs offences

Dr. Evisa Kambellari
University of Tirana, Faculty of Law
Department of Criminal Law

Abstract

This paper tries to provide a full picture of criminal acts in the field of customs and their economic implications. The overall framework of customs offences is going to be illustrated by combining theoretical aspects with real examples and the relevant case law.

It is emphasized that the controlling of illegal import or export of goods it is important not only for maintaining stable income deriving by the correct application of customs fees, but also for preventing other illegal practices that might affect the whole economic and social well-being. In this perspective, is analysed how such a criminal activity might affect tax revenue and other situational consequences that can be encountered due to the entrance into the country of prohibited or uncontrolled goods.

Special attention has been paid to the fact that the smuggling activity is to be traced in each stage of its consumption, from customs services to private intermediaries, sellers, purchasers, that might represent the final link of the chain. To do that, is necessary to build not only a common strategy of cooperation among related institutions but also a real culture of good communication, understanding and assistance in the activity of their staff members.

Offences in the field of customs are carried out with different goods, by applying several smuggling schemes, which operation is sometimes facilitated due to the involvement of customs officers. Thus, tackling the problem may present a complex task, that requires as much in terms of legal means as of operational, technical or financial means.

Keywords: *smuggling, economic and social costs, criminal activity, prevention and control*

Introduction

With the collapse of the communist regime of before '90s and the liberalization of foreign trade Albania changed radically its trade patterns. Starting from the year 1991, quantitative restrictions on imports and exports underwent a reduction and elimination process. The trade liberalization processes escalated significantly by the accession of Albania in WTO in the year 2000 (Mançellari, 2005, 5). The economic opening was intensified further by the ratification of the stabilization and association agreement in 2006, which opened up the way for the country engagement in the stabilization and association process with the EU. Since the beginning of the market based economy regime, the illegal activity of smuggling started to flourish. Such an activity was facilitated because of the large traffic of foreign goods passing through Albanian borders. At that time national borders were turned into a leading redistributing mechanism of national wealth due to the small capacity of the national economy (Hajdinjak, 2002, 6).

Another factor contributing in the illegal import/export activities had to do with the low monitoring capacities of customs officials. Foreign scholars do also address the problem with the involvement of former state officials themselves. They speak about the participation of numerous former security agents (which lost their jobs under the new democratic regime and were appointed as the leading figures of the customs and tax authorities) in oil smuggling to Yugoslavia and especially to Montenegro (Hajdinjak, 2002, 18).

Since then smuggling activities have been constantly present in Albania experiencing new actors, new objects and channels but the nature of the problem remained the same.

The protected interest

Generally speaking, the reasons of criminalization of illegal import/export of goods have to do with the protection of financial interests of the state, protection of national economy from unfair competition, ensuring of public health and public order as well as fighting infringements of intellectual property rights.

First, illegal acts in the field of customs might affect seriously the economic stability of the country. Smuggling activities cause significant loss of state income due to the avoidance of custom fees, which make up an important voice of the state budget.

Furthermore, smuggling channels can be used for the transport of hazardous substances and dangerous items, which might endanger the environment or/and public health or the overall public security. The entering of large quantities of smuggled goods in the domestic market, discourages the domestic production of food items and industrial products because local manufacturers can not afford the unfair market price distortion created from smuggled goods.

Smuggling is also seen as an indispensable activity in facilitating further distribution and trade of counterfeit goods. 'Counterfeit goods' include any goods bearing without authorization a trademark which can not be distinguished in its essential aspects from the trademark registered for such goods and as such may mislead the buyer or a third person (Staake & Fliesch, 2008, 17). Producing and trading counterfeit goods violates Intellectual Property law because such activities unlawfully deprive the trademark owner from the exclusive use of its rights. Smugglers use to transport and sell such goods through countries that have weak mechanisms of protection of IP rights. The first barrier to overcome in order to enter the territory of one country are customs control points. In this perspective, the proper performance of control tasks by customs officials would be very important for breaking the chain of fake goods smuggling. Being not able to pass the state borders, smugglers could not get to their destination market.

Last but not least, smuggling offenses might be related to the protection of public moral from obscene materials. In this view, import or export of child pornography materials are not only illegal activities but also reprehensible acts which go against basic moral values and shared norms of the society.

Economic and social costs of smuggling

Usually the illegal activity of smuggling is primarily addressed as an economic phenomenon. Under this view, smuggling is strictly related to the avoidance of import/export fees for having eventual financial advantages. It is specified as the resort of those who want to evade existing national and international controls and limitations on commerce and criminal behavior (Prezelj & Gaber, 2005, 1). In fact, the economic interests protected by the customs activity go beyond the mere aim of collecting tax revenue. The normal application of customs fees is used as a valuable tool for the protection of the domestic economy and the equalization of the commercial balance with foreign countries.


Such an activity, on one hand might affect seriously the financial interests of the state and on the other hand might lead to the decrease of domestic production of goods (Elezi, 2007, 273). For example the smuggling of tobacco or of alcoholic drinks is a factor that may discourage local manufacturing firms due to the lower demand for domestic brands of the related goods.

The smuggled goods unfairly compete the domestic goods in terms of the final market price and such a disbalance would be reflected in the customer choice. Local farmers or manufacturers cannot compete with the low prices of smuggled goods and their sales decline.

In addition smuggling of goods violates import restrictions imposed over foreign goods in order to protect domestic production or to decrease/eliminate a trade deficit (Grant & Vidler, 2003, 148). Such restrictions refer to quantitative limits or quotas on physical amounts of particular goods that can be imported during a specified time period, usually measured by volume but sometimes by value (Folsom & Gordon, 1995, 691). The quota may be applied on a 'selective' basis with varying limits for different countries of origin or on a general basis which only specifies the total limit of

imports in a given period (Folson & Gordon, 1995, 691).

Due to unfair competition local firms might be forced to close their activity and this would increase unemployment rates. Given that, the state would have to cover up another burden of providing social assistance to a number of unemployed people. Moreover, these individuals or legal entities would not be subject to taxes applied over their economic activity anymore (i.e tax on personal income deriving from employment, tax on business profit or Value Added Tax). Then, if a firm closes, it could affect the raw material suppliers too. Thus, the negative influence posed by the unfair competition of smuggled goods would represent a spiral process, which would cost the state constant loss of income. A schematic explanation of the process is shown in figure 1:



Another problem that is increasingly brought to the attention of customs authorities is the protection of intellectual property rights. Smuggling of counterfeit goods results in loss of customs duties to cover investigations on fraud related to intellectual property rights. In order for fake goods produced outside the country to take place in the domestic market, it is necessary to pass customs control points. If this activity would be traced by customs authorities, counterfeit good would normally be seized because their production and sale constitutes serious violation of IP law. Therefore, smugglers try to deny the fact of their transportation by using specific concealing methods or make misleading statements about the origin, nature and quantity of goods being transported.

Counterfeiting goods is not a victimless crime of intellectual property rights. Scholars argue that in addition to the harm to legitimate business, consumers and governments at all levels are duped and adversely impacted by counterfeiters (Roffe & Seuba, 2014, 275). In Albanian open markets are freely traded a large number of fake goods such as clothing items, bags, fake branded cigarettes, food items et cetera. According to the Albanian Consumer Association, the domestic markets are massively filled with counterfeit goods, imported mainly from Turkey and China.

Në kushtet e ekonomisë bashkëkohore të tregut, mjetet juridike për sigurimin e kërkesave luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Gjatë krijimit të raporteve juridike ndërmjet subjekteve në qarkullimin juridik të mallrave dhe shërbimeve, e veçanërisht te ndarja e huave është më se evidente pasiguria e kreditorit, sa i përket faktit, se a do t'i përmbushet kërkesa që buron nga raporti juridiko-detyrimor. Dinamika e raporteve detyrimore që krijohen me kontratë, determinohet me kërkesën, që kontrata të lidhet, të prodhojë efektet e duhura dhe të shuhet. Mirëpo, në praktikë, ndodh që debitori të mos përmbush kërkesën në mënyrë vullnetare, dhe për pasojë të shtrohet nevoja e realizimit të dhunshëm të saj (Georgiev 1985, 301). Edhe pse kontrata është e siguruar me sanksionin juridik, i cili e autorizon kreditorin që të kërkojë realizimin e dhunshëm të kërkesës, nëse ajo nuk përmbushet vullnetarisht, edhe pse kreditori parimisht mund të shpërblehet me pasurinë e tashme dhe të ardhshme të debitorit të tij, (përveç rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe), megjithatë, ka raste kur kreditorit nuk i mjafton ky sigurim, shpesh nuk ka besim në palën tjetër, ose ngase nuk e njeh sa duhet atë, kërkon që me anë të mjeteve të tjera shtesë të sigurojë kërkesën e vet.

Mjetet juridike për sigurimin e kërkesave mund të jenë: personale dhe sendore (reale). Në vargun e këtyre instrumeneteve hipoteka (hipothec) paraqitet si një ndër mjetet më të rëndësishme juridiko-sendore për sigurimin e kontratave.

Nocioni i hipotekës

E drejta e hipotekës është mjet juridiko-sendor për sigurimin e kërkesave. Hipoteka paraqet një të drejtë të krijuar në favor të kreditorit hipotekor, me të cilën ngarkohet paluajtshmëria e caktuar e debitorit hipotekor. Kjo e drejtë e autorizon kreditorin hipotekor që të realizojë kërkesën e vet nga vlera e kësaj paluajtshmërie, nëse ajo nuk i përmbushet me kohë nga debitori hipotekor.

E drejta e hipotekës krijohet për të siguruar një kërkesë të caktuar në të holla të kreditorit hipotekor (kërkesa hipotekore). Pra, hipoteka është e drejtë aksesore e cila nuk lind dhe nuk egziston për vetveten, por krijohet për sigurimin e kërkesës së caktuar të kreditorit hipotekor.

Me ngarkimin e paluajtshmërisë me hipotekë, rritet siguria e kreditorit se do të realizojë kërkesën e vet, në krahasim me sigurinë që kishte kur debitori e siguronte me personalitetin e vet,

me dorëzani, ose me sigurim tjetër personal.

Mirëpo, megjithatë, me krijimin e së drejtës së hipotekës në një objekt të caktuar të debitorit, nuk pushon përgjegjësia personale e debitorit, si dhe përgjegjësia eventuale e dorëzantit. Nëse kërkesa nuk përmbushet me të arritur, atëherë kreditori do t'i ketë në disponim të dy përgjegjësitë, prandaj nga vullneti i tij do të varet se nga cili prej tyre do të realizojë kërkesën e vet (Gavella, 1998, 730)

Me krijimin e së drejtës së hipotekës, siguria e kreditorit hipotekor është më e madhe. Përveç të drejtës për të realizuar kërkesën nga pasuria e përgjithshme e debitorit hipotekor, ai tani fiton një të drejtë sendore mbi paluajtshmërinë e huaj (të debitorit hipotekor), e drejtë kjo që nuk pushon edhe nëse kjo paluajtshmëri pushon të jetë pjesë përbërëse e masës pasurore të debitorit hipotekor (Vedrish & Klariç 2006, 341). Kjo lidhet me faktin se e drejta e hipotekës ka karakter *-erga omnes-* (ndaj të gjithëve), dhe për pasojë, kreditori hipotekor ka të drejtë që të realizojë kërkesën e vet nga vlera e paluajtshmërisë edhe nëse në ndërkohë paluajtshmëria është bartur në persona të tretë.

Nuk mund të vihet në dyshim fakti se e drejta e hipotekës është një e drejtë sendore e pavarur. Ajo nuk paraqet thjeshtë një autorizim të shkëputur nga e drejta e pronësisë, por, një të drejtë autonome, që tek e fundit edhe e kufizon të drejtën e pronësisë për kohën sa egziston vetë (Statovci, 1988,47).

Subjektet e hipotekës

Në marrëdhënien juridike-hipotekore, si edhe në çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile takojmë dy subjekte: kreditorin hipotekor si bartës i të drejtës dhe debitorin hipotekor, si bartës i obligimit. Kreditor hipotekor mund të jetë çdo person fizik dhe juridik, i cili ka një kërkesë të caktuar në të holla ose që mund të shëndrohet në holla, ndaj debitorit të vet, i cili obligohet që mbi paluajtshmërinë e vet të lejojë krijimin e hipotekës në favor të kreditorit.

Në cilësinë e kreditorit mund të paraqiten më shumë persona në formë të kreditorëve të përbashkët ose bashkëkreditorëve (Weirich, 1996, 397).

Duke u nisur nga parimi i aksesoritetit që e karakterizon këtë të drejtë, konstatojmë se kreditori hipotekor është njëkohësisht edhe kreditor personal në marrëdhënien juridike-detyrimore, kërkesa e të cilit ndaj debitorit sigurohet me hipotekë.

Debitor hipotekor, sipas rregullit është pronari i paluajtshmërisë me të cilën sigurohet kërkesa. Mirëpo, debitori hipotekor dhe debitori personal mund të jenë persona të ndryshëm (Neni 13, Ligji për pengun e kontraktuar)

Debitori hipotekor është personi që ka për obligim (borxh) shumën e caktuar të të hollave ose ndonjë obligim tjetër që mund të shëndrohet në të holla ndaj kreditorit hipotekor, me të cilin është në marrëdhënie të caktuar detyrimore ose marrëdhënie tjetër juridike. Në këtë rast debitori hipotekor është njëkohësisht edhe debitor personal.

Debitor hipotekor mund të jetë edhe personi i tretë, respektivisht pronari i paluajtshmërisë, i cili nuk ka kurfarë borxhi ndaj kreditorit, por përgjigjet me anë të paluajtshmërisë së vet për borxhin e debitorit personal (Weirich, 1996, 397).

Objekti i hipotekës

Në të drejtën moderne e drejta e hipotekës ngritet dhe qëndron vetëm mbi paluajtshmëritë, ndërkohë që, nga e drejta romake e kemi të njohur se hipotekën dhe pengun e dorës-*pignusini-* i dallonte vetëm emri. Prej atëherë kur hipoteka dhe *pignusi* morrën rrugën e vet, si objekt i hipotekës paraqiten vetëm paluajtshmëritë. Ishte Grotius, ai që hipotekën përfundimisht e vendosi mbi paluajtshmëritë (Statovci, 1988 262).

Rendi ynë juridik përjashton mundësinë e konstituimit të hipotekës mbi tërë masën pasurore të debitorit (hipoteka gjenerale), prandaj, si objekt i të drejtës së hipotekës mund të paraqiten vetëm sendet e caktuara individualisht. Ky fakt paraqet edhe esencën e njërit nga parimet më të rëndësishme të drejtës së hipotekës, parimit të specialitetit. Mbi paluajtshmërinë është e mundur të krijohet e drejta e pengut vetëm në formë të hipotekës me regjistrim në librin publik.

Për shkak të objektit të saj hipoteka ka disa specificitete, që e bëjnë të dallohet nga pengu i dorës. Specificitetet që kanë të bëjnë me objektin e hipotekës janë:

- Objekt i së drejtës së hipotekës është paluajtshmëria, pjesët përbërëse dhe pertinencat e saj, gjersa kanë atë cilësi, pastaj frutat gjersa mos të ndahen. Tek hipoteka, debitori pengor ka të drejtë të disponojë me frutat deri në fillimin e procedurës së realizimit të dhunshëm të hipotekës, pas këtij momenti ato i takojnë kreditorit.

- Mund të ndodhë që pasi të jetë konstituuar e drejta e hipotekës, paluajtshmëria të rritet ose shtohet, qoftë në mënyrë natyrore, ose në mënyrë artificiale. Në këtë rast e drejta e hipotekës do të përfshijë të gjitha risitë dhe përmirësimet e sendit. Këtu bëhet fjalë për të ashtuquajturin -ekstensivitet të hipotekës - (Gams 1976, 194).

- Me të drejtën e hipotekës mund të përfshihen më tepër paluajtshmëri. Nëse për të njëjtën kërkesë është krijuar e drejta e hipotekës mbi disa paluajtshmëri e ashtuquajtura hipotekë e përbashkët (simultane), atëherë secila paluajtshmëri përgjigjet për tërë kërkesën. Kreditori ka të drejtë që realizimin e kërkesës ta kërkojë, sipas dëshirës, nga cilado prej tyre qoftë pjesërisht qoftë në tërësi (Gams 1976, 194).

- E drejta e hipotekës mund të krijohet edhe mbi një pjesë bashkëpronësore (alikuote) të paluajtshmërisë. (Winter, 1983, 24).

- Nëse paluajtshmëria e hipotekuar merret nëpërmjet të ekspropriimit, arondimit, ose në ndonjë mënyrë tjetër të ngajshme, me të cilën shlyhet hipoteka, dhe në vend të saj jepet një paluajtshmëri tjetër, hipoteka e mëparshme vendoset mbi paluajtshmërinë e re -subrogacioni real- (Gams, 1976, 170). Nëse në vend të paluajtshmërisë jepet shuma e caktuar e të hollave, kjo shumë shërben në vend të paluajtshmërisë së mëparshme.

- Edhe tek e drejta e hipotekës mund të egzistojë i ashtuquajturi debitor „real“. Në këtë kontekst, egziston mundësia që në vend të paluajtshmërisë së debitorit personal nga marrëdhënia detyimore përkatëse, të vëhet në hipotekë paluajtshmëria e një personi të tretë, i cili përgjigjet me paluajtshmërinë e tij për borxhin e debitorit personal. Ky është debitori hipotekor i cili nuk i detyrohet kreditorit, por përgjigjet (Weber 1997, 199).

- Egzistojnë sende që për nga natyra e vet mund të jenë objekt i së drejtës së hipotekës, por, për shkaqe të veçanta janë përjashtuar nga mundësia e vënies nën hipotekë. Të tilla janë tokat bujqësore dhe ndërtesat ekonomike të bujqëve, deri në vëllim të nevojshëm për mbajtjen e vetvetes dhe anëtarëve të familjes së tyre të ngushtë, si dhe personave tjerë që me ligj janë të detyruar t'i mbajnë (Vedrish & Klariç 2006, 331). Paluajtshmëritë që janë jashtë qarkullimit dhe për pasojë nuk janë të afta për ekzekutim nuk mund të jenë objekt i hipotekës, si të tilla janë p.sh.: paluajtshmëritë që janë në përdorim të përgjithshëm, pasuritë minerale si dhe pasuritë e tjera natyrore, objektet e armatimit të dedikuara për mbrojtje shtetërore dhe publike etj.

-Objekt i hipotekës, përjashtimisht, mund të jenë edhe anijet dhe fluturaket, të cilat edhepse për nga natyra janë sende të luajtshme, megjithatë nuk jepen në peng, sikurse edhe sendet e tjera të luajtshme, por mbi to konstituohet hipoteka. E drejta e hipotekës mbi anijet dhe objektet e tjera lundruese regjistrohet në Regjistrin e veçantë për regjistrimin e anijeve të cilën e udhëheq Kapitenia e limanit me qendër në Ohër. E drejta e hipotekës mbi fluturaket regjistrohet në librin kryesor të Regjistrin në të cilën regjistrohen fluturaket. Sa i përket procedurës së krijimit, egzistimit, pushimit dhe realizimit të hipotekës mbi fluturaket në vendin tonë nuk është nxjerë ligj i ri, por në bazë të Kushtetutës, si ligj republikan zbatohet ligji i ish RSFJ-së, si dhe dispozitat e Lligjit për pengun e kontraktuar. Me krijimin e hipotekës, anija ose objekti tjetër lundruar, si edhe fluturakja edhe mëtej ngel në posedim të debitorit hipotekor, në ndërkohë, ai ka mundësi që të shfrytëzojë këto objekte dhe në këtë mënyrë të rrit aftësinë kredituese të tij.

Në realitetin aktual në Republikën e Maqedonisë, respektivisht, në komunën e Tetovës vërehet se objekte më atraktive për krijimin e hipotekës janë: lokale afariste, të cilët udhëheqin me 60% të rasteve (Agjencia e Katastrës - Tetovë).

Mënyrat e fitimit të hipotekës

E drejta e pengut mbi paluajtshmëritë (hipoteka), fitohet njëllor si edhe e drejta e pengut mbi sendet

e luajtshme (*pignusi*). Presupozime për fitimin e kësaj të drejte janë baza juridike (*iustus titulus*) dhe mënyra e fitimit (*modus acquirendi*).

Bazë juridike për fitimin e të drejtës së hipotekës mund të jetë: veprimi juridik (hipoteka kontraktore), vendimi gjyqësor (hipoteka gjyqësore), dhe ligji (hipoteka ligjore) (Neni 61, al.2. Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore).Ndërsa, mënyra për fitimin e të drejtës së hipotekës është regjistrimi në librat publik (Statovci 1988, 286).

Hipoteka kontraktore

Kur bazë juridike për fitimin e hipotekës është veprimi juridik (kontrata hipotekore), atëherë kemi të bëjmë me hipotekën vullnetare, ose hipotekën e kontraktuar e cila është rregull në qarkullimin juridik.

Kontrata hipotekore lidhet ndërmjet kreditorit hipotekor dhe debitorit hipotekor. Ajo sipas rregullit duhet të përmbajë të gjitha ato elemente që e bëjnë kontratën të vlefshme, si: palët kontraktuese; objektin e caktuar individualisht të hipotekës (paluajtshmërinë); lartësinë e kërkesës; pëlqimin shprehimor të pronarit të objektit të hipotekës -*clauzula intabulandi*-, dhe nënshkrimin e pronarit të objektit të hipotekës. Pra, kontrata duhet të marrë formën e një dokumenti.

Me anë të kontratës hipotekore autorizohet kreditori hipotekor që nga vlera e paluajtshmërisë së ngarkuar të realizojë kërkesën e tij të siguruar me hipotekë, para kreditorëve që mbi këtë send nuk kanë hipotekë, dhe para kreditorëve të tjerë që këtë të drejtë e kanë fituar pas tij. Këtë të drejtë kreditori do ta realizojë pa marrë parasysh se në ndërkohë mund të jetë ndëruar pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar me hipotekë. (Statovci 1988, 286)

Deri në nxjerjen e Ligjit për hipotekën e kontraktuar, krijimi i hipotekës bëhej me lidhjen e kontratës së hipotekës përpara gjykatës. Në këtë aspekt Ligji për hipotekën e kontraktuar dhe më pas Ligji për pengun e kontraktuar kanë sjellur risi, kështu, kreditori hipotekor dhe debitori hipotekor kanë mundësi që kontratës së hipotekës t'i japin cilësinë e dokumentit ekzekutiv para ose pas regjistrimit të hipotekës në librin publik. Kjo arrihet me vërtetimin e nënshkrimit të tyre nga ana e noterit, si dhe me dhënien e deklaratës, sipas të cilës janë dakord që kontrata e hipotekës të ketë cilësinë e dokumentit ekzekutiv(Neni 22, al.1 dhe 2 Ligji për pengun e kontraktuar) dhe se në bazë të këtij akti, pas arritshmërisë së kërkesës mund të zbatohet realizimi i dhunshëm (Neni 42, al. 1; Ligji për kryerjen e punëve materiale).

Për dallim nga pengu i dorës, tek hipoteka paluajtshmëria e hipotekuar edhe më tej ngel në detencion të debitorit hipotekor.Gjithashtu, këtu kreditori hipotekor nuk ka mundësi që ta përdorë dhe shfrytëzojë objektin e hipotekës, siç ishte rasti tek *pignusi*, por, pushteti i tij qëndron në realizimin e kërkesave të veta nga vlera e objektit të hipotekës. Realizimi i kësaj të drejte arrihet nëpërmjet autorizimit që të disponojë me sendin, e që manifestohet me të drejtën, që të kërkojë shitjen e tij nën kushtet e caktuara me ligj (Statovci 1988, 267).

Për krijimin e hipotekës së vlefshme nuk mjafton vetëm -*iustus titulus*-, kontrata në rastin tonë, sepse me lidhjen e kontratës ende nuk është krijuar e drejta e hipotekës, por, kreditori ka fituar vetëm të drejtën të realizojë kërkesën e tij me shitjen e sendit.(Statovci 1988, 288).Për krijimin e hipotekës nevojitet, siç cekëm edhe më herët edhe -*modus acquirendi*-os mënyra e fitimit. Gjersa, te *pignusi* mënyrë e fitimit ishte dorëzimi i sendit (Neni 3,Ligji për pengun e kontraktuar), mënyrë e fitimit të hipotekës është regjistrimi i së drejtës së hipotekës në librin publik. Kështu, pasi, tek hipoteka sendi nuk bartet në detencion të kreditorit hipotekor, vetëm fakti i regjistrimit të së drejtës së hipotekës në librat publik i njofton subjektet që kanë interes juridik me egzistimin e të drejtës përkatëse. Me regjistrim hipoteka jo vetëm që bëhet publike, por edhe vepron ndaj të gjithëve -*erga omnes*-, duke përfshirë këtu edhe vetë pronarin e paluajtshmërisë (Statovci 1988, 288).

Kontrata e hipotekës lidhet në formë të shkruar. Kontrata e cila nuk është lidhur në formë të shkruar nuk prodhon efekte juridike (Neni 21, al.1 dh 2, Ligji për pengun e kontraktuar). Egzistojnë edhe qëndrime të kundërta që konsiderojnë se kërkesa që kontrata e hipotekës të lidhet në formë të shkruar, nuk është kusht për vlefshmërinë e kontratës së hipotekës, por kusht për realizimin e saj, sepse pa dokumentin përkatës nuk mund të bëhet regjistrimi në librin e tokës (Buçkovski, 2001,146.Mirëpo, mendimi që dominon, dhe ai i pranuar nga legjislacioni ynë, është se kontrata e hipotekës, vetëm e lidhur në formë të shkruar prodhon efekte juridike.Ajo duhet të marrë formën e një dokumenti

libërtokësor dhe të nënshkruhet nga palët që obligohen me të. Kontraktuesi që nuk din shkrim lexim vendos shenjë e gishtit të vërtetuar para dy dëshmitarëve ose para gjykatës, respektivisht organit tjetër që ushtron autorizime publike (Neni 6, Ligji për marrëdhënie të detyrimeve).

Regjistrimin e hipotekës, si mënyrë të fitimit të saj e kanë njohur edhe sistemet juridike të mëparshme, (Neni 64, al.1, Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore) por edhe Ligji për pengun e kontraktuar përmban një formulim të njëjtë ligjor, ku thotë se: „e drejta e hipotekës fitohet me lidhjen e kontratës së hipotekës dhe me regjistrim në librin publik, në mënyrë dhe kushte të parapara me ligj” (Neni 17, al.1, Ligji për pengun e kontraktuar). Regjistrimi në librat publik bën implementimin e parimit të publicitetit, ndërkohë që me regjistrim hipoteka bëhet edhe e drejtë sendore në sendin e huaj.

Nga vështrimet e mësipërme rezulton e qartë, se presupozimet për krijimin e hipotekës janë: 1/ marrëveshja e debitorit hipotekor dhe kreditorit hipotekor, sipas të cilës një paluajtshmëri e caktuar duhet të sigurojë një kërkesë të caktuar në të holla. Marrëveshja e tillë duhet të jetë në përputhje me dispozitat ligjore, 2/ regjistrimi i kësaj marrëveshje në librin publik, 3/ pajtimi i vullnetit të palëve duhet të egzistojë edhe në momentin e regjistrimit, 4/ palët duhet të jenë të autorizuar, 5/ marrëveshja e palëve dhe regjistrimi duhet të konsistojnë në kërkesën e siguruar. (Alpmann, 1994, 44).

Hipoteka gjyqësore

Përveç kontratës, bazë juridike për fitimin e së drejtës së hipotekës është edhe vendimi gjyqësor (hipoteka gjyqësore). Mirëpo, për krijimin e hipotekës gjyqësore nuk mjafton vetëm vendimi gjyqësor si bazë juridike (*iustus titulus*), por, nevojitet edhe mënyra e fitimit (*modus acquirendi*) e paraparë me ligj. Në bazë të vendimit gjyqësor hipoteka fitohet me regjistrim në librin publik, ose në mënyrë tjetër përkatëse të caktuar me ligj (Vedris & Klariç, 1988, 337).

Regjistrimi i së drejtës së hipotekës në bazë të vendimit gjyqësor, bëhet në mbështetje të dokumentit përmbarues (ekzekutiv), pra, kërkesa për të cilin lejohet hipoteka gjyqësore është e përmbarueshme (ekzekutueshme) (Statovci, 1988, 292).

Dokument përmbarues (*titulus executionis*) është dokumenti i cili e përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet egzistimi i kërkesës (kredisë). Nga dokumenti përmbarues rezulton detyra e përmbaruesit privat që sipasqë sipas propozimit të kreditorit hipotekor të caktojë dhe zbatojë përmbarimin (Ligji për përmbarim (tekst i spastruar) Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 59/2011). Dokumenti përmbarues është i përshtatshëm për përmbarim nëse në të janë treguar: kreditori, debitori, objekti, vëllimi dhe koha e përmbashjes së detyrimit. (Brestovci 2000, 325). Me kërkesë të kreditorit gjykata mund të vendosë që në librat e tokës të shënohet përmbarueshmëria e kërkesës. Regjistrimi i së drejtës së hipotekës dhe shënimi i përmbarueshmërisë ka efekt veprues ndaj të gjithëve. Pra, kreditori hipotekor mund të kërkojë përmbarimin e dhunshëm mbi sendin, me qëllim të realizimit të kërkesës së vet, ndaj çdo personi që më vonë e ka fituar sendin në pronësi. Nëse mbi paluajtshmërinë, tanimë veç është regjistruar e drejta e hipotekës në librat publik, hipoteka e dhunshme mund të fitohet me mbiregjistrim. (Vedris & Klariç, 1988, 338). Te hipoteka e dhunshme pëlqimi i pronarit me rastin e regjistrimit të hipotekës nuk është i nevojshëm (Statovci, 1988, 293).

Në vendet, ku librat e tokës dhe ato publik nuk janë konstituuar, ndërkohë që përmbarimi duhet të kryhet mbi një paluajtshmëri që nuk është e regjistruar në librat e tokës, ose në librat publik, e drejta e hipotekës krijohet me regjistrim në librat e intabulacionit, ose në libra të tjerë.

Kur sendi i paluajtshëm nuk është i regjistruar as në librin e tokës, e as në ato të intabulacionit, atëherë hipoteka gjyqësore e dhunshme do të mund të fitohej ngajshëm me atë si fitohet pengu gjyqësor mbi sendet e luajtshme, (Statovci, 1988, 293) me regjistrim në regjistrin e sekuestrimit.

Hipoteka ligjore

Bazë juridike për fitimin e së drejtës së pengut mbi sendet e paluajtshme (hipotekës) është edhe ligji. Mundësia e krijimit të hipotekës ligjore është përcaktuar shprehimisht në dispozitën ligjore, ku thuhet se: e drejta e hipotekës mund të krijohet edhe në bazë të ligjit (Neni 61, al.2, Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore). Hipoteka ligjore krijohet në atë moment kur ndodhin faktet e caktuara, për të cilat dispozita ligjore lidh krijimin e hipotekës. Kuptohet, ky fakt nuk guxon

të jetë as kontrata, e as vendimi gjyqësor.

Hipoteka ligjore krijohet me përmbushjen prezumimeve që parashih ligji përkatës, pra, hipoteka ligjore lind sipas fuqisë së ligjit. Pasi fuqinë e nxjer nga ligji është e logjikshme se për krijimin e saj nuk merret pëlqimi i pronarit të paluajtshmërisë. E drejta e hipotekës ligjore nuk regjistrohet në librat publik. Mirëpo, edhe përkundër faktit se nuk regjistrohet në librat publik dhe personat e tretë nuk kanë mundësi të njihen me egzistimin e saj, konsiderohet se hipoteka ligjore ka përparësi para hipotekës kontraktore dhe asaj gjyqësore (Stankoviç & Orliç, 1986, 357). Si shembull të hipotekës ligjore janë rastet e krijimit të hipotekës mbi paluajtshmëritë e kujdestarit për të siguruar interesat e personave nën kujdestari (Gelevski Sllavko, 2002, 508)

Përfundimi

Në sistemin tonë juridik e drejta e hipotekës, si mjet juridik për sigurimin e kërkesave u riafirmua me kalimin nga ekonomia kontraktuese në ekonominë e tregut. Me riafirmimin e saj u shtrua edhe nevoja e përcaktimit të natyrës së saj juridike, ashtuqë në bazë të natyrës juridike të përcaktohet mënyra e trajtimit të saj.

Risitë që solli Ligji për pengun e kontraktuar sa i përket rregullimit të hipotekës, në rradhë të parë kanë për qëllim të ngrej në shkallë më të lartë sigurinë e kreditorëve, e në anën tjetër të favorizojnë edhe debitorët, të cilët me mbajtjen e sendit në posedim nuk ndërprejnë veprimtarinë e tyre ekonomike, kështu që krijohen kushte për kreditim më solid.

Kjo formë e sigurisë që ofron e drejta e hipotekës është e një rëndësie të veçantë për ekonominë bashkëkohore të tregut sepse rrit ofertën e kredive si një segment shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik, në planin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Në literaturën tonë juridike shumë pak është përpunuar tematika e hipotekës. Kjo nga shkakun se për një kohë të gjatë ekonomia është zhvilluar sipas parimeve të ekonomisë së planifikuar dhe asaj të kontraktuar, ku, nuk ka pasur nevojë për sigurim hipotekor të kërkesave. Prandaj është më se e nevojshme që të kopjohen përvojat e sistemeve të zhvilluara në këtë lëmi. Në praktikë duhet të ndërtohet një formë fleksibile e financimit nëpërmjet të institucioneve të posaçme, bankave hipotekore. Me këtë rast do të merreshin parasysh edhe kushtet individuale të kreditimit edhe kornizat ligjore.

L i t e r a t u r a

- Alpmann, J.(1994), Sachenrecht, band 2, Grundstücksrecht, Münster,
Brestovci, F. 2000, E Drejta procedurale civile, I, Prishtinë,
Buçkovski, V.(2001) Početoci na sovremenoto zalozhno pravo, Zbornik, Skopje,
Gams, A.(1976), Bazat e drejtës reale, Prishtinë,
Gavella, N. (1998), Zalozhno pravo, Zagreb,
Gelevski, S. (2002), Zakon za sopstvenost i drugi stvarni prava so komentar i sudska praktika, Shkup,
Georgiev, D.(1985), E drejta e detyrimeve, Shkup,
Statovci, E.(1988), E drejta e pengut, Aspekte komparative, Prishtinë,
Vedrish, M.&Klariç, P.(2006), Gradjansko pravo, opći dio, stvarno, obvezno i nasljedno pravo, Zagreb,
Weber, H, 1997, Kreditsicherheiten, Recht der sicherungsgeschäfte, München,
Weirich, A.(1996), Grundstücksrecht, Systematik und Praxis der materiellen und formellen Grundstückrechts, München,
Winter, G. 1983, Das Recht der Hypotheken und Grundschulde, Bremen,
Stankoviç, O& Orliç M.(1986), Stvarno pravo, Beograd,
Statovci, E.(1988), E drejta e pengut, Aspekte komparative, Prishtinë,
Ligji për pengun kontraktuar („Gazeta zyrtare e RM“, nr.5/2003)
Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore („Gazeta zyrtare RSFJ, nr.6, 1980)
Ligji për kryerjen e punëve noteriale („Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 59/ 96, 25/98)
Ligji për hipotekën e kontraktuar, („Gazeta zyrtare e RM“, nr.59/2000)
Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve („Gazeta zyrtare e RM“, nr.18/2001)
Ligji për përmbarrim (tekst i spastruar) Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 59/2011)
Agjencija e Katastrës - Tetovë

Vështrim historik mbi politikën e konkurrencës në Bashkimin Evropian

Stela Meçaj
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Abstrakt

Konkurrenca e lirë është element i rëndësishëm i ekonomisë së tregut të hapur. Ajo ndikon në performancën ekonomike evropiane, mbron konsumatorët nga praktikat antikonkurruese dhe promovon transparencën. Politika e konkurrencës në Bashkimin Evropian siguron zbatimin e konkurrencës në tregun e brendshëm, nëpërmjet zbatimit të rregullave të ngjajshme për të gjitha kompanitë, që veprojnë në të. Ekonomia e tregut nuk mund të funksionojë pa rregullat e sanksionuara me ligj, që përcaktojnë sjelljen në treg, si dhe zhvillimin e një konkurrence të lirë dhe të ndershme. Çështja e përcaktimit të tregut dhe vlerësimi i konkurrencës është ndër çështjet më të rëndësishme, që trajtohet në legjislacionin evropian. Ligji kombëtar duhet të plotësohet nga rregullat evropiane për të mbuluar rastet, të cilat ndikojnë në tregtinë ndërmjet shteteve anëtare. Në kontrast me politikat kombëtare të konkurrencës, politika e përbashkët e konkurrencës ka si objektiv integrimin e tregut, unitetin e tregut të përbashkët, shmangien e monopolizimit të tregjeve të caktuara, duke parandaluar kompanitë e mëdha nga abuzimi me pozitën e tyre dominuese. Tregu i lirë dhe konkurrenca efektive janë parimet bazë të zhvillimit të ekonomisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Fjalët kyçe: *politika e konkurrencës, antitrustet, kontrolli i përqëndrimeve, ndihma shtetërore.*

Hyrje

Politika e konkurrencës në Bashkimin Evropian ka një histori gjashtëdhjetëvjeçare. Historia e politikës evropiane të konkurrencës është e ndarë në tri faza kryesore: themelet e politikës së konkurrencës në Bashkimin Evropian (1950-1962); dështimi i dinamikës neofunksionaliste (1962-1985) dhe forcimi i mëvonshëm vendimtar i kësaj politike (1985-1991). Fillimisht, vendimarrja institucionale ka qenë e centralizuar në mënyrë drastike. Gjatë kësaj kohe ishte Komisioni, që u jepte prioritet politikave dhe vendoste në rastet, që kanë të bëjnë me praktikat antikonkurruese, pa ndonjë marrëveshje paraprake nga shtetet anëtare ose të Parlamentit Evropian. Komisioni përfitonte nga burime të pavarura të informacionit dhe në bazë të kufijëve, mund të përcaktonte nivelin e gjobave, sipas prioriteteve të veta. Komisioni është kompetent për të luftuar kartelet dhe praktikat kufizuese tregtare, por gjithashtu ka fuqinë për të rishikuar ex ante, bashkimet dhe ndihmat shtetërore potencialisht të dëmshme. Gjithashtu, vlen për t'u theksuar, se politika evropiane e konkurrencës është më e fortë se shumica e politikave kombëtare të konkurrencës evropiane. Shtetet anëtare nuk kanë vendosur për të koordinuar ose për të transferuar një nga politikat e tyre publike në nivel evropian, por ishte kryesisht Komisioni, i cili ka zhvilluar një fushë të re të veprimit dhe ka vendosur politikën e konkurrencës. Përveç kësaj, Komisioni ka kompetenca më të gjera në politikën e konkurrencës, se sa ka në çdo fushë tjetër (Warloutet, 2010, 1).

Politika e konkurrencës në vitet (1950-1962)

Më 9 maj 1950, Ministri francez i Punëve të Jashtme Robert Schuman lëshoi me Deklaratën e njohur Schuman, një konceptim të ri të integritimit evropian (Schuman, 1950). Fjalimi i Shumanit vendosi dy ide të reja dhe të ngjajshme. Nga pikëpamja institucionale, ai braktisi metodën federaliste. Schuman shpalosi një vizion që mbështetet në proceset neofunksionaliste (Haas, 1958). Hapi i parë ishte për të nisur një projekt të integritimit evropian në një zonë të kufizuar (qymyri dhe çeliku), por vendimtare në mënyrë, që të krijojë një "solidaritet de facto" mes Francës dhe Gjermanisë dhe partnerë të tjerë të gatshëm. Në aspektin ekonomik, krijimi i një tregu të përbashkët për qymyrin dhe çelikon solli nevojën për të krijuar një autoritet publik për të rregulluar këto tregje, të cilat ishin shtrembëruar rëndë nga barrierat tregtare, kartelet dhe diskriminimi i çmimeve gjeografike.

Si rezultat, Traktati i Parisit krijoi Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ), përfshirë dispozitat antitrust. Neni 65 i marrëveshjes ndalonte kartelet dhe neni 66 përmbante dispozita për përqëndrimet, shkrirjet dhe abuzimin me pozitën dominuese nga kompanitë (Papadopoulos, 2010, 12-13). Kjo ishte hera e parë, që parimet e ligjit të konkurrencës janë përfshirë në një marrëveshje shumëpalëshe rajonale dhe krijuan modelin transevropian të ligjit të konkurrencës.

Këto dispozita janë të lidhura me dy parime të rëndësishme. Së pari, fuqia vendimmarrëse i është dhënë një institucioni mbikombëtar (Autoriteti i Lartë), që ishte zyrtarisht i pavarur nga qeveritë e shteteve anëtare. Së dyti, Komisionit i është dhënë kompetenca për të rregulluar një gamë të gjerë të praktikave tregtare, pra mandati i tij shkoi përtej kartelit (marrëveshje kufizuese dhe të pajustificuara në mes të kompanive të pavarura) dhe format e tjera të mundshme praktikash çrregulluese tregtare (në mënyrë të veçantë për t'u marrë me diskriminimin e çmimeve). Megjithatë, ka pasur një kontrast të thellë midis këtyre dispozitave të forta ligjore dhe politikës së dobët, që ishte vënë në praktikë nga Autoriteti i Lartë i KEQÇ. E meta kryesore ishte mungesa e pavarësisë nga shtetet anëtare, të cilat pengoheshin vazhdimisht nga vendimet e Autoritetit të Lartë. Përvoja e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut la tre trashëgimi për politikën evropiane të konkurrencës: (i) përfshirjen e rregullave të konkurrencës në një Traktat, i projektuar për të filluar një proces të integritimit evropian, nëpërmjet hapjes së tregjeve; (ii) një kuadër zyrtarisht të fortë institucional dhe (iii) zbatimimi i dobët (Warloutzet, 2010, 8).

Traktati i Romës (1957)

Komuniteti Ekonomik Evropian është krijuar me Traktatin e Romës, i cili u nënshkrua më 25 mars 1957 dhe ka hyrë në fuqi më 1 janar 1958. Traktati i Romës parashikonte miratimin e ligjit të konkurrencës, si një nga qëllimet kryesore, nëpërmjet “institucionit, që siguron se konkurrenca në tregun e përbashkët nuk është shtrembëruar.” Dy dispozitat qendrore mbi ligjin e konkurrencës të BE-së për kompanitë u krijua me nenin 85, i cili ndalonte marrëveshjet anti-konkurrese, në varësi të disa përjashtimeve dhe nenin 86, që ndalonte abuzimin me pozitën dominuese.

Një studim i Traktatit të negociatave të Romës tregon ndikimin e dy dinamikave. Nga njëra anë, rrjeti gjerman ordoliberal kishte një interes të veçantë në zhvillimin e një politike të fortë të konkurrencës. Nga ana tjetër, përvoja e KEQÇ, pikat e forta, si dhe dobësitë e saj ishin të rëndësishme në debate (Warloutzet, 2007, 525-532; Warloutzet, 2010, 274-276). Një tjetër aspekt i rëndësishëm i negociatave është, që modeli amerikan kishte më pak ndikim dhe amerikanët ishin më pak të përfshirë.

Ordoliberalizmi është një doktrinë gjermane bazuar në liberalizmin politik dhe ekonomik (Gerber, 1998, 237-252). Sipas kësaj doktrine, ndërtimi i një Gjermanie të fortë dhe të re pas përvojës naziste, me një rend të ri të bazuar në sundimin e ligjit dhe respektimin e lirive individuale ishte thelbësore. Kështu, shteti dhe kompanitë më të fuqishme duhet të vepronin në përputhje me kërkesat e ligjit, në të dy fushat politike dhe ekonomike. Në të njëjtën kohë, autoritetet publike kishin për të kufizuar ndërhyrjet e tyre në ekonomi, në mënyrë që të nxinin një dinamikë të tregut të lirë. Gjermanët mbështetën një politikë të fortë kundër karteleve dhe ata patën sukses në sigurimin e përfshirjes në mesin e dispozitave të tjera, nenin 85 të KEE. Megjithatë, gjermanët gjithashtu kishin për të marrë në konsideratë qëndrimet e delegacioneve të tjera, duke përfshirë në veçanti atë të negociatorëve francezë.

Debati politik kishte vetëm një rëndësi të dorës së dytë në kontekstin më të gjerë të negociatave të KEE, veçanërisht për zyrtarët francezë (Warloutzet, 2010, 271-4). Kjo ishte pjesërisht për shkak të rëndësisë së çështjeve të tjera (balancën e pushtetit midis institucioneve, tregut të përbashkët, territoret jashtë Francës, bujqësia), por kjo ishte edhe për shkak të përvojës së KEQÇ. Nën dritën e ndikimit të dobët të ligjit të konkurrencës sipas Traktatit të Parisit, regjimit të konkurrencës në KEE i është dhënë relativisht pak vëmendje. Në lidhje me kartelet, Neni 85 (1) i KEE mund të interpretohet ose si një ndalim i drejtpërdrejtë i karteleve (interpretimi gjerman) ose mund të shihet, si krijimi i një parimi më tolerant të «shpërdorimit». Disa zyrtarë gjermanë do të kishin preferuar një ndalim më të qartë të karteleve. Gjithashtu, në lidhje me abuzimin e dominimit ka pasur pasiguri në lidhje me interpretimin e nenit 86 të KEE (Schweitzer, 2008, 128). Në të dy rastet, ndarja vertikale e kompetencave nuk ishte përcaktuar në Traktat, por u la e hapur për legjislacionin e ardhshëm.

Rregullorja 17/62

Me qëllim, që të zbatoheshin rregullat e konkurrencës në Traktatin e Romës ishte e nevojshme

zgjdhja e dy çështjeve kryesore: e kompetencave, që do të caktohen për Komisionin dhe prioritetet e zbatimit. Neni 87 i KEE kishte përcaktuar, që brenda tre vitesh, Komisioni duhet t'i propozonte një rregullore Këshillit për të zbatuar nenet 85 dhe 86. Rregullorja 17/62 (Këshilli KEE, 1962a) ishte një përgjigje e qartë për të dyja këto çështje.

Një studim i detajuar i Rregullores 17/62 në 1960-1961 tregonte ndikimin vendimtar të ordoliberalistëve gjermanë dhe dështimin e qartë të kundërshtarëve të tyre (Warlouzet 2010, 322-324). Ata ishin të bashkuar nga vlerat e përbashkëta ordoliberales, objektivat (Seidel, 2010, 165-6) dhe kishin zhvilluar një projekt ekonomik global, që përfshinte kartelet, por edhe ndihmat shtetërore dhe harmonizimin ligjor (Hambloch 2009).

Ky rrjet ordoliberal ka pasur sukses në sigurimin e miratimit të Rregullores 17/62. Karakteristikat e saj kishin një ndikim afatgjatë në politikën evropiane të konkurrencës. Një nga karakteristikat kryesore të Rregullores ishte sistemi i njoftimit: në thelb, të gjitha marrëveshjet ndërmjet kompanive, që vepronin në kuadër të KEE, në atë masë, që ato kufizonin konkurrencën brenda kuptimit të nenit 85 (1) duhet të deklaroheshin te Komisioni. Një kualifikim i rëndësishëm ishte se, siç shihet më lartë, Traktati i KEE nuk kishte parashikuar rregullat e bashkimeve dhe si pasojë në bazë të Rregullores 17/62 bashkimet nuk duhet të njoftoheshin.

Komisioni mund të zgjidhte për të kryer një hetim (në bashkëpunim me autoritetet e shtetit anëtar), në qoftë se dyshonte, se kompanitë ishin angazhuar në praktika antikonkurrese. Një komitet këshillimor i përbërë nga delegatë të shteteve anëtare, do të jepnin mendimin. Në një hap të fundit, kjo ishte për Komisionin vetëm për të vendosur për shkatërrimin e rastit. Kështu, Komisioni fitoi një monopol virtual të pushtetit, si në aspektin e informacionit dhe të vendimmarrjes. Në kushtet e doktrinës, interpretimi rigoroz ordoliberal i nenit 85 u pasua: praktikisht të gjitha marrëveshjet kufizuese të rëndësishme u ndaluan, përveç atyre që janë autorizuar nga Komisioni.

Në vitet 1950-1962 u vendosën bazat e politikës evropiane të konkurrencës në aspektin e ideologjisë dhe institucioneve: Informacioni ka qenë i centralizuar, vendimet janë marrë nga Komisioni dhe prioritet i është dhënë luftës kundër marrëveshjeve kufizuese. Ky projekt është bazuar në një parim të fortë, që rrjedh nga KEQÇ: nevoja për këtë politikë publike për të arritur qëllimin e krijimit të një tregu të përbashkët, një ambicie, e cila qëndron në themel të procesit të integritimit evropian.

Propozimi i Rregullores së Bashkimit (1962-1981)

Rregullorja 17/62 i atribuonte kompetenca të forta, por edhe një shkallë të lartë të përgjegjësisë Komisionit. Formalisht, Rregullorja i kërkonte Komisionit të merrte vendime në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjeve të njoftuara, në mënyrë që t'u ofronte kompanive të përfshira një mjedis të sigurt legal.

Monitorimi i këtij lloji të marrëveshjes ishte një shqetësim i veçantë për vendimmarrësit francezë. Në mënyrë paradoksale, ndërsa qeveria franceze ishte kundërshtari kryesor i Rregullores 17/62 (siç është perceptuar se i kishte dhënë shumë kompetenca Komisionit dhe ishte shumë ordoliberal), ajo ishte në favor të një sistemi të rreptë të rregullimit të marrëveshjeve të shpërndarjes (Warlouzet, 2010, 292-293, 322-323). Në të vërtetë, vendimmarrësit francezë ishin shumë të etur për të modernizuar sektorin francez të shpërndarjes për të kontrolluar inflacionin. Fokusi i politikës së konkurrencës në Francë nuk ishin kartelet ose shkrirjet, por praktikata e tjera tregtare. Zyrtarët francezë miratuan një politikë tepër të rreptë në lidhje me marrëveshjet e shpërndarjes. Në nivelin e KEE, procedura e njoftimit themeluar me Rregulloren 17/62 nuk ishte e detyrueshme për marrëveshjet e shpërndarjes. Megjithatë, Franca siguroi se neni 22 përcaktonte, se brenda një viti të hyrjes në fuqi të Rregullores, Këshilli (me propozim të Komisionit) kishte për të shqyrtuar mundësinë për të bërë procedurën e njoftimit të detyrueshme për lloje të caktuara të marrëveshjeve (dmth, marrëveshjet e shpërndarjes sipas preferencave të francezëve). Në vitin 1962, interpretimi i Rregullores 17/62 ka qenë i paqartë për zyrtarët dhe për organizatat e biznesit. Në veçanti, më shumë qartësi ishte e nevojshme në lidhje me trajtimin e duhur ligjor të marrëveshjeve të shpërndarjes. Në mënyrë për të zgjidhur këtë problem, Komisioni kërkoi të inkurajonte njoftimin e marrëveshjeve të tilla. Për këtë qëllim, ai miratoi Rregulloren 153/62, e cila futi një procedurë të thjeshtëzuar të njoftimit për marrëveshje të caktuara ekskluzive (Këshilli KEE, 1962b) dhe ajo publikoi një komunikatë për subjektin e njoftimit

(Komisionit KEE, 1962).

Për të përfunduar në zbatimin e Rregullores 17/62, dështimi kryesor mund t'i atribuohet një strategjie të metë të Komisionit. Kjo strategji u mbështet në dy mjete plotësuese: centralizimin e informacionit përmes sistemit të njoftimit dhe përjashtimet bllok për të rregulluar rrjedhjen e informacionit. Megjithatë, ndërsa u vu re suksesi në aktivizimin e dinamikës së parë në vitin 1962, nuk u arrit miratimi nga Komisioni i përjashtimeve bllok deri në vitin 1967. Për Komisionin, kjo mospërputhje kronologjike ishte shkatërruese. Është shumë e mundshme të ketë kontribuar në dështimin e Komisionit për të realizuar potencialin e tij të plotë, si një zbatues efikas i ligjit të konkurrencës. Të dyja këto dobësi duhet të shihen në kontekstin e mjedisit të përgjithshëm të pafat: politika e konkurrencës ishte ende shumë e re në Evropë dhe nxitja për të njoftuar marrëveshjet ishte fillimisht e pamjaftueshme.

Politika e Konkurrencës (1981-1991)

Në vetëm pak vite, nga 1981 deri 1991, politika evropiane e konkurrencës është forcuar në fusha të shumta. Për të shpjeguar këtë kthesë do t'i referohemi faktorëve të jashtëm, por fuqia e tyre shpjeguese është e pamjaftueshme. Në vitin 1980, kontekstet ideologjike dhe politike ishin në mënyrë të qartë më të përshtatshme për zhvillimin e politikës së konkurrencës. Zhvillimi i ideve neoliberalë, në bazë të kufizimit të shtetit për rolin e gjyqtarit në një ekonomi të shtyrë vetëm nga dinamika e tregut të lirë, përhapet me shpejtësi.

Në aspektin politik, Komisioni përfitoi nga një periudhë shumë dinamike 1985-1992, nën presidencën e Jacques Delors (Presidenti 1985-1995). "Rinisja Delors" është bazuar nga ndryshimi i kontekstit ekonomik (Defraigne 2008, 71-74), mbështetja e institucioneve mbikombëtare (GJED, Parlamenti Evropian), aktorëve jo-shtetërorë (kompani shumëkombëshe) dhe shteteve anëtare, sidomos pas zgjidhjes së çështjes britanike. Procesi i vendimmarrjes është lehtësuar nga një përdorim në rritje i votimit me shumicë të cilësuar, pas Aktit Unik Evropian (1986) edhe në qoftë se, ky Traktat nuk ndikon në rregullat e konkurrencës të përcaktuara në Traktatin e Romës.

Numri i pazgjidhur i marrëveshjeve kufizuese, që kërkojnë vëmendje u poshtërua me miratimin e përjashtimeve të shumta bllok, duke përfshirë në veçanti një regjim që rinovohet për marrëveshjet e shpërndarjes (Goyder, 1993, 211-235). Në ndjekjen e politikës së tij, Komisioni miratoi një qasje pragmatike. Ai ra dakord për të arritur një kompromis në mes të një qasje formaliste dhe nevojave të kompanive për të bërë thirrje për një mjedis ligjor, që ofron siguri më të madhe për biznes dhe investime. Një pasojë e këtij kompromisi ishte braktisja e pjeshme e një qasjeje të frymëzuar nga teoria ordoliberalë. Në frontin e bashkimeve, Komisioni më në fund arriti të marrë miratimin e Këshillit të KEE-së për një rregullore të re në dhjetor 1989.

Traktati i Lisbonës

Sot, Traktati i Lisbonës ndalon marrëveshjet antikonkurrese në nenin 101 (1), duke përfshirë edhe fiksimin e çmimeve. Sipas nenit 101 (2), marrëveshje të tilla janë automatikisht të pavlefshme. Neni 101 (3) përcakton përjashtime, nëse marrëveshja e fshehtë është për risi shpërndarëse ose teknologjike, duke i dhënë konsumatorëve një "ndarje të drejtë" dhe nuk përfshin kufizime të paarsyeshme, që rrezikojnë konkurrencën. Neni 102 ndalon abuzimin me pozitën dominuese, të tilla si diskriminimi i çmimeve dhe lejon rregulloret e Këshillit Evropian për të qeverisur bashkimet mes firmave (rregullorja aktuale është Rregullorja 139/2004/KE). Nenet 106 dhe 107 sigurojnë, që e drejta e shteteve anëtare për ofrimin e shërbimeve publike nuk mund të pengohet, por që ndërmarrjet publike duhet të përmbahen në të njëjtat parime të konkurrencës, si kompanitë. Neni 107 përcakton një rregull të përgjithshëm, se shteti nuk mund të ndihmojë ose të subvencionojë palët private në deformimin e konkurrencës së lirë dhe ofron përjashtime për organizatat bamirëse, objektivat e zhvillimit rajonal.

Konkluzione

Konkurrenca e pandershme krijon hapësira për keqpërdorime duke dëmtuar tregjet, pjesëmarrësit në të, por edhe ekonominë e vendit. Politika e konkurrencës zë një vend mjaft të rëndësishëm në politikat ekonomike të shteteve të zhvilluara dhe për këtë arsye trajtohet në mënyrë të veçantë.

Kontributi, që politika e konkurrencës të BE-së ka sjellë për zhvillimin ekonomik nuk është vetëm nëpërmjet zbatimit të rregullave antitrust dhe rregullave të bashkimeve. Praktika ka treguar, se ka shumë raste në të cilat problemet e konkurrencës janë rrënjësor aq thellë, sa zbatimi i thjeshtë i rregullave antitrust, që synojnë sjelljen antikonkurrese të firmave individuale nuk do të jenë të mjaftueshme për të siguruar konkurrencë të fuqishme për përfitim të konsumatorëve.

Në Bashkimin Evropian, Komisionit iu dhanë mjete të fuqishme për zgjidhje pro-konkurrese, në veçanti fuqia për të marrë iniciativa rregullatore dhe për të mbështetur masat rregullatore, që janë të detyrueshme për shtetet anëtare. Komisioni në të kaluarën ka përdorur fuqitë e tij për të forcuar politikën e konkurrencës në një treg plotësisht të integruar evropian. Kjo ka prodhuar përfitime të mëdha për konsumatorët dhe kompanitë evropiane. Ekspozimi i kompanive të BE-së për konkurrencë më të fuqishme brenda tregut të brendshëm dhe një zbatim i përpiktë i antitrusteve, bashkimeve dhe ndihmës shtetërore ka një ndikim pozitiv në kompanitë në BE, sepse kjo i detyron ato që të bëhen më produktive dhe më konkurrese në tregjet botërore.

Bibliografia

The Rise of European Competition Policy, 1950-1991, A Cross-Disciplinary Survey of a Contested Policy Sphere, L. Warloutet, EUI Working Paper RSCAS, 2010.

Papadopoulos, Anestis S (2010). *The International Dimension of EU Competition Law and Policy*. Cambridge University Press, ISBN 978-0-521-19646-8.

Arkivat e Fondation nationale des sciences politiques (FNSP, Paris), 2DE12, shënim i 23 shtatorit 1959 dhe 15 tetorit 1959.

The Gesetz gegen Wettbewerbsbeschränkungen, (GWB), adoptuar më 27 korrik 1957.

Buch-Hansen, Hubert (2008), *Rethinking the history of European level merger control. A critical political economy perspective*, Ph.D, supervisor: Morten Ougaard, Copenhagen Business School (CBS), 2008.

Buch-Hansen, Hubert, and Wigger, Angela (2009), "Revisiting 50 years of market-making: the neoliberal transformation of European competition policy", in *Review of International Political Economy*.

Cini, Michelle, and McGowan, Lee (1998), *Competition Policy in the European Union*, The European Union Series, London, Macmillan Press.

Schuman, Robert (1950), *The Schuman Declaration*, Paris, 9 May 1950, available on www.ena.lu.

Swann, Dennis (1983), *Competition and Industrial Policy in the European Community*, London, Methuen.

Seidel, Katja (2008), "DG IV and the origins of a supranational competition policy: Establishing an economic constitution for Europe", in Wolfram Kaiser, Brigitte Leucht, Morten Rasmussen (eds), *The History of the European Union. Origins of a trans- and supranational polity, 1950-1972*, London, Routledge, 2008.

Përafrimi legjislativ në fushën e barazisë gjinore

Juliana Marko

Ligji i vitit 2008, procesi i miratimit

Abstrakt

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe një vlerë e përbashkët e vendeve të BE, e drejtë që gjithashtu synohet të përfshihet në kuadrin ligjor të vendeve candidate apo aspiruese për antarësim. Përveç CEDAW (Konventa e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundrejt grave) dhe Kushtetutës, Shqipëria ka hartuar një sërë ligjesh, strategjish dhe planesh veprimi në lidhje me barazinë gjinore si edhe disa strategji kundër trafikimit të qenieve njerëzore (përfshirë gratë dhe vajzat), kundër dhunës në familje si edhe planet përkatëse për veprim. Duke pasur parasysh situatën paraekzistuese dhe nismat e ndërmarra, kam zgjedhur të paraqes këtu një analizë mbi procesin e miratimit të Ligjit Nr.9970, datë 24.7.2008 “Mbi barazinë gjinore në shoqëri”. Ky është një rast mjaft përfaqësues i mënyrës si politika dhe shoqëria shqiptare përballen me përafrimin e legjislacionit në përgjithësi dhe me çështjet e barazisë gjinore në veçanti.

Fjalë kyçe: barazi gjinore, përafrim legjislativ, strategji kombëtare, kuota të pjesëmarrjes

Hyrje

Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe mekanizma që synojnë të nxisin barazinë gjinore. Shtyllat kryesore të këtij legjislacioni mbështeten në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundrejt grave (CEDAW). Sipas kësaj konvente të nënshkruar në vitin 1993, Shqipëria duhet të marrë masa dhe të ndërtojë të gjithë mekanizmat e duhura për zbatimin e saj.

Përveç CEDAW dhe Kushtetutës, Shqipëria ka hartuar një sërë ligjesh, strategjish dhe planesh veprimi në lidhje me barazinë gjinore si edhe disa strategji kundër trafikimit të qenieve njerëzore (përfshirë gratë dhe vajzat), kundër dhunës në familje si edhe planet përkatëse për veprim.

Barazia gjinore si vlerë europiane

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe një vlerë e përbashkët e vendeve të BE-së. Raporti i Komisionit Europian i vitit 1998, në Seksionin 5 “Barazia gjinore dhe zgjerimi i BE” përcakton qartë se dimensionin social është një element thelbësor për Komunitetin dhe barazia gjinore e mundësitë e barabarta janë pjesë integrale e dimensionit social. “Nuk ka anëtarësim pa mundësi të barabarta për gratë dhe burrat”¹, thuhet në këtë seksion. Raporti i përmendur ka si pikënisje konstatimin e mungesës së një ekuilibri gjinor në aspekte kyçe të jetës ekonomike, sociale e politike, si në vendet anëtare ashtu edhe në vendet candidate për anëtarësim. Duke u bazuar tek Nenet 2 dhe 3 të Traktatit së Amsterdimit ku kërkohet barazi ndërmjet dy gjinive si një nga aktivitetet më të rëndësishme të Komunitetit, është marrë si çështje parësore dhe detyrim ligjor integrimi gjinor në të gjitha fushat. Në lidhje me vendet candidate, KE ka përmbledhur këshilla dhe çështje me interes (në një udhërrëfyes sugjerimesh praktike) lidhur me integrimin gjinor nën politikën e Memorandumit të Përbashkët për Pjesëmarrjen Sociale (Joint Memoranda on Social Inclusion). Qeveritë e këtyre vendeve, duke ratifikuar konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, janë të detyruara të raportojnë periodikisht për ligjin e vendit dhe praktikatat në fushën përkatëse.

Problemi më i madh i vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore sipas Anita Seibert, përfaqësuese e një grupi të OJQ-ve të këtij rajoni, mbetet ri-strukturimi i tregut të punës, pasi është vënë re se ka

¹ 1998 Report of the Commission on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union, f. 28.

rënë ndjeshëm shkalla e përfshirjes së grave në ekonomi gjatë periudhës së tranzicionit.² Në vendet në zhvillim, lloji i përjashtimit shoqëror mund të jetë aktiv ose pasiv dhe zakonisht nevojat dhe interesat e grave zakonisht neglizhohen pasi ato janë të përjashtuara nga shumë sfera të jetës siç është arsimi, punësimi, aksesimi ndaj ligjit, zbatimi i të drejtave të pronësisë, etj³

Përafrimi legjislativ

Hapa pozitivë janë ndërmarrë vitet e fundit sidomos me kalimin e Ligjit “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe me hartimin e strategjisë kundër dhunës në familje dhe barazinë gjinore (2007-2010). Gjithsesi, të dhënat mbi përhapjen e fenomenit të dhunës vazhdojnë të jenë të kufizuara. Kështu komisariatet e policisë, zyrat juridike, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ato të shërbimeve sociale nuk janë të detyruara me ligj të grumbullojnë dhe prezantojnë të dhëna mbi dhunën. Shqipëria është një nga vendet e pakta në Europë që zyrtarisht nuk regjistron, publikon dhe prezanton rregullisht të dhëna mbi përmasat dhe përhapjen e këtij fenomeni.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim, kam zgjedhur të paraqes këtu një analizë mbi procesin e miratimit të Ligjit Nr.9970, datë 24.7.2008 “Mbi barazinë gjinore në shoqëri”. Ky është një rast mjaft përfaqësues i mënyrës si politika dhe shoqëria shqiptare përballen me përafrimin e legjislationit në përgjithësi dhe me çështjet e barazisë gjinore në veçanti. Ky ligj rregullon çështjet themelore të problemeve të barazisë gjinore, duke kërkuar “trajtimin e barabartë të grave dhe burrave dhe mundësi dhe shanse të barabarta në ushtrimin e të drejtave në të gjitha fushat e jetës shoqërore⁴. Fushat e përfshira në këtë ligj janë: pjesëmarrja e barabartë në procesin e vendimmarrjes, trajtimi jodiskriminues në marrëdhëniet e punës, trajtimi i paanshëm në arsim e kualifikim si edhe trajtimi i barabartë në media.

Pas një periudhe të gjatë konsultimesh dhe diskutimesh, ligji në fjalë u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me 74 vota pro dhe 6 abstenime.

Faza e konsultimeve dhe debatimeve është mjaft interesante, pasi në çdo rast dëshmon kulturën politike dhe mënyrën se si një shoqëri raportohet me ligjin, institucionin legjislativ dhe tematikën specifike. Në rastin e ligjit të vitit 2008, vihet re një proces i gjatë (për standartet shqiptare) i diskutimit dhe konsultimeve, çka është e lidhur drejtpërdrejtë me përpjekjet e grupeve të interesuara (kryesisht OJQ vendase, por jo vetëm) për ta shoqëruar iterin ligjor me një debat sa më publik të ishte e mundur.

Më 13 mars 2008, institucioni i Avokatit të Popullit ka dërguar zyrtarisht mendimet për projektligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”, shumica prej të cilave kishin karakter teknik në lidhje me mirëpërcaktimin e organeve përgjegjëse për kontrollin apo raportimin e ecurisë së procesit të ekuilibrit në statusin gjinor në shoqëri.

Nxitësit kryesorë për miratimin e këtij projektligji kanë qenë organizatat joqeveritare dhe duhet theksuar se në Shqipëri, vetëm në fushën e promovimit të barazisë gjinore ka mbi 100 subjekte të tilla të regjistruara deri në vitin 2008⁵. Kështu, një koalicion OJQ-sh do të organizonte në muajin prill një procedurë nënshkrimi publik të letër-kërkesës drejtuar përfaqësuesve në Parlament dhe qeveri në mbështetje të miratimit të projekt-ligjit për barazi gjinore në shoqëri, si finalizim i një fushate sensibilizimi dyjavore në të gjithë Shqipërinë. Kjo nismë u pasua edhe nga një seancë dëgjimore në Parlament, me nën-komisionin e ligjeve, gjatë së cilës u diskutua përse ishte i rëndësishëm miratimi i këtij projektligji nga Kuvendi.

Debati publik u pasqyrua e pati jehonë në media ku konstatohet një mbulim i gjerë (nga ana sasiore), në periudhën mars – korrik 2008, konkretisht duke iu referuar katër prej subjekteve kryesore të

² “Barazia gjinore kusht për integrimin europian”, Aleanca gjinore për zhvillim, Tiranë 2008, f.34

³ Amartya Sen in Rogers, Jalal, Boyd “An Introduction to Sustainable Development”, Glen Education Foundation, New York 2008

⁴ Fletore Zyrtare 2008, Ligji Nr. 9970, 28/7/2008

⁵ Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, *Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, 2007 – 2010*, Pegi: Tiranë 2008

shtypit të shkruar. Nga ana tjetër, ka disa parregullsi logjike në mënyrën e zhvillimit të debatit: duke qenë se ky ishte rasti i një projektligji i cili gëzonte mbështetje trasversale të forcave politike parlamentare, atëherë motivimi i kuptueshëm i mediatizimit do të duhej të kishte dy synime kryesore: informimin mbi përmbajtjen e pasojat e projektligjit dhe krijimin e një klime publike mbështetëse për zbatimin e tij. Asnjë nga këto objektiva nuk arrin të realizohet përmes procesit mediatik. Pjesa qendrore dhe më e rëndësishme e projektligjit, duke u bazuar në rekomandimet specifike dhe në studime të zhvilluara prej aktorëve të interesuar, synonte të përmirësonte situatën e barazisë gjinore në tregun e punës: në rradhë të parë kjo ishte një ndër mangësitë më të rënda të realitetit shqiptar dhe së dyti, mendohet se strategjia më e efikase për të pasur një përfaqësim gjinor të ekuilibruar në një shoqëri është e lidhur fort me statusin e barabartë ekonomik të qytetarëve. Pavarësisht përparësisë së deklaruar në projektligji për barazinë gjinore në tregun e punës, i gjithë debati publik përqendrohet në një pikë të vetme të ligjit mbi barazinë gjinore: nënën që i drejtohet përfaqësimit të barabartë (si tendencë) në organet politike vendimmarrëse ku përcaktohet si politikë e përkohshme vendosja e kuotave në nivel 30% për përfaqësimin e grave në procesin e vendimmarrjes. Në shumicën dërrmuese të rasteve ka një keqinformim, pasi ligji përcakton kuotat për praninë e grave “në organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor, si edhe në institucionet e tjera publike”.⁶ Vërehet gjithashtu një keqkuptim e rremujë midis aksionit pozitiv ligjor, përmbushjes së standarteve të integritetit dhe zbatimit të rregullit të kuotave, standart i cili nuk mund të konsiderohet europian duke qenë se mungon në shumicën e vendeve europiane.

Probleme dhe veçanti

Procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve brenda partive në përgjithësi kanë pasur vështirësi në zbatim, por sidomos në rastin e procedurave për mundësi të barabarta, ka pasur një sërë problemesh lidhur me efektivitetin e tyre. Vetëm pas hyrjes në fuqi të Kodit Zgjedhor u bë e qartë se interpretimi i Ligjit për barazinë gjinore do të mund të interpretohej duke e zhveshur atë nga çdo lloj brendie apo fryme që nisma ligjore kishte pasur. Përveç situatave kur këto mund të kenë favorizuar kandidatët të veçantë, në përgjithësi raportohet përqindjet e parashikuara në programet e partive se nuk janë respektuar. Disa studime (ACER dhe ASET, 2009) kanë treguar se edhe kur listat e kandidatëve nuk përmbushin kërkesat e kuotave dhe refuzohen prej KQZ-së, partitë bëjnë rregullimet duke shtuar më tepër kandidate femra në fund të listave të tyre. Po sipas këtij studimi, në Shqipëri, një parti mund të ishte teknikisht në përputhje me ligjin e kuotave, pa vendosur fare gra në vendet fituese brenda listës së kandidatëve. Në mënyrë të ngjashme, raporti i monitorimit të zgjedhjeve nga OSBE (2009), theksoi se teorikisht, listat e kandidatëve me 30 % të grave të radhitura në fund, në pozicione me shumë gjasa jofituese, do të kualifikoheshin.

Përbën interes edhe mënyra si publiku shqiptar informohet dhe reflekton në lidhje me procesin legjislativ e konkretisht për rastin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij ligji, pas fushatës së komunikimit publik të përshkruar më lart. Në raportin studimor të publikuar në vitin 2011, “Monitorimi i hapave të Shqipërisë drejt barazisë gjinore”, faktorët që mund të identifikohen si ndikues në zbatimin e kuotave gjinore mund të grupohen në dy kategori, kulturorë dhe politikë. Faktorë kulturorë mund të klasifikohen ato qëndrime shoqërore tradicionale ndaj përfshirjes së grave në politikë në përgjithësi, që përfshijnë të konsideruarit e politikës si fushë vetëm e burrave, dhe mosbesimin ndaj aftësive të grave si politikane.⁷ Përgjithësisht vihet re një indiferencë (e të dyja gjinive) për t’i perceptuar të drejtat e grave si pjesë integrale e të drejtave të njeriut apo përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje si çështje të përfaqësimit demokratik. Ndër faktorët politikë mund të përmendim karakteristikat e legjislatimit zgjedhor në Shqipëri, rregullat dhe praktikat e vendimmarrjes brenda partive politike, mungesën e impaktit dhe koordinimit të përfaqësuesve femra në pozicione pushteti, etj. Në përfundim, mund të nënvijëzojmë disa prej tipareve që karakterizojnë mënyrën si aktorët politikë dhe shoqëria shqiptare përballen me përafrimin

⁶ http://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf

⁷ Dragoti, Tahsini, Dhëmba, Ajdini, *Monitorimi i hapave të Shqipërisë drejt barazisë gjinore; Rasti i kuotave gjinore në politike*, Tiranë 2011, f.10

legjislativ në kuadrin e procesit të integrimit europian. Një karakteristikë pozitive mbetet dëshira për të mbështetur procesin e integrimit nga një shumicë që vazhdon të jetë më e larta ndër vendet kandidatë apo të asociuara për anëtarësim. Nga ana tjetër, kjo dëshirë nuk pasqyrohet në vullnetin për të njohur thellësisht dhe për të brendësuar procesin e integrimit dhe pasojat e tij. Gjithashtu mungon një mendim kritik, si në nivel politik ashtu edhe në gjirin e shoqërisë për të vlerësuar dhe për të përshtatur, kur është e mundur, normat europiane me traditat e kulturën politike vendase. Harmonizimi midis trupit të së drejtës dhe kulturës në të cilën ajo vepron mbetet mënyra më efektive për të zbatuar e jo thjesht shkruar rregulla, norma e ligje.

Referenca

1998 Report of the Commission on Equal Opportunities for Women and Men in the European Union
Aleanca gjinore për zhvillim (2008) "Barazia gjinore kusht për integrimin europian", Tiranë
Amartya Sen in Rogers, Jalal, Boyd (2008) "An Introduction to Sustainable Development", New York
Fletore Zyrtare 2008, Ligji Nr. 9970, 28/7/2008
Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (2008), *Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, 2007 – 2010*, Tiranë
Dragoti, Tahsini, Dhëmbo, Ajdini (2011), *Monitorimi i hapave të Shqipërisë drejt barazisë gjinore; Rasti i kuotave gjinore në politike*, Tiranë

The best techniques of informative speech during police procedure

Doc.Dr. Qebir Avziu¹ State University of Tetovo

In this paper we will talk about the weight of informative speech talks during the police procedures and the best techniques that science of Criminalistics has risen to achieve good success to lightening crime. Each investigators who has worked a little bit in the police practice, know that's to provide investigations, especially at the beginning its very hard. To have a clear overview of that what happened about criminal act and to know the episode about criminal issue, need to talk with someone who has seen or heard about the story. Therefore is very important to have a informative talks with neutral witnesses. Of course interview with suspect ist very basic, but the interviewing skills are very similar to the skills needed to gather information from victims and witnesses. The aim of interviewing suspects is not specifically to get a confession from them, but to enable the suspect to give their account of the incident, their explanation of what happened.

Key words: informative speech, police procedure, investigations etc.

1. Hyrje

Në këtë punim do të bisedojmë për rëndësin e bisedave informative gjatë zhvillimit të procedurave policore, veçanërisht rëndësi do t'ju kushtohet teknikave dhe metodave më të mira që ka ngritur shkenca e kriminalistikës gjatë zhvillimit të bisedave. Çdo hetues që ka punuar sado pak në praktikë, e dinë se punë më të vështirë se të zhvillosh hetime nuk ka, sidomos në fillim të hetimeve kur organi thuaj se nuk ka asnjë provë mbi atë se si është zhvilluar ngjarja. Të ngrisësh një pasqyrë të qartë, mbi epizodat e ngjarjes, mbi atë se si ka vepruar kryesi, padyshim që kërkojnë prova të shumta të cilat në të shumtën e rasteve sigurohen gjatë zhvillimit të bisedave me dëshmitarët, me të dëmtuarin dhe në disa raste edhe me vetë autorin e veprës. Kuptohet se biseda me të dyshuarin është me rëndësi jetike gjatë zhvillimit të hetimeve, pasi ai është personi që më së miri e dinë se si është kryer vepra penale. Prandaj hetuesi vetëm pas bisedës me të dyshuarin do të mund të kompletojë mozaikun e ngjarjes penale dhe të gërshetoj me provat tjera materijale. Kuptohet që biseda me të pandehurin zhvillohet vetëm me pëlqim të tij, kjo s'do të thotë që ai të pranoj autorësin dhe fajshmërin e veprës penale. Por duhet të dihet se i dyshuari, dëshmitari, por edhe viktima nuk janë mësuar të bashkëpunojnë me policinë, andaj në këto rrethana të reja, pak është e besueshme se menjëher do të arrijmë rrezultate të shkëlqyera. Kriminalistika ka ngritur një sërë rregullash dhe metodash, përdorimi i të cilëve mundëson arritjen e rrezultateve të sukseshme gjatë zhvillimit të bisedave, duke u bazuar në psikologjinë e njeriut. Biseda informative është metodë themelore në punën e policisë dhe një nga veprimet dhe masat e rëndësishme operative. Sigurisht që sot, provat materijale kanë rëndësi jetike në zbardhimin e së vërtetës mbi çështjen penale, por përsëri gjurma materijale nuk ka gojë që të flaës, prandaj është shumë e rëndësishme që organi të ketë siguruar dëshmitarë, me ndihmën e të cilëve do të mundë të kuptojë më lehtë mekanizimin e shkatimit të gjurmëve dhe kështu edhe lidhjen kauzale në mes shkakut dhe pasojës. Ligji mbi policinë i RM-së (neni 43, gazeta zyrtare 114/06), jep kompetencë këtij organi që të zhvillojnë biseda me qytetarët.² Qytetarët sipas rregullativës ligjore, nuk kanë obligim ligjor që të paraqiten para këtij organi, por sigurisht që është mirë të bashkëpunojnë me policinë lidhur me ndriçimin e veprave penale. Po të kishte qytetari obligim ligjor të bashkëpunoj me policinë, atëher kjo do të nëkuptonte se vetë ligji obligon qytetarët që të bëhen bashkëpunëtor të policisë, që në shoqërit demokratike nuk mund të lejohet. Poashtu duhet bërë dallimi në mes bisedave me qytetarët dhe bisedave informative (zyrtare)

¹ Autori ka punuar një periudhë të gjatë në polici, ku ka ushtruar funksione të ndryshme si inspektor kryesor në departamentin e krimit të organizuar, udhëheqës i kontrollit të brendshëm pranë SPB-Tetovës dhe Gostivarit etj.

² Shumica e qytetarëve të thirur në polici, mendojnë se kanë detyrim ligjor të vijnë para organit policor dhe të dëshmojnë mbi atë që kanë parë ose dëgjuar ose të pyeten në cilësinë e të dyshuarit.

me të dyshuarin. Në rastin e parë, fjala është për bisedat me qytetarët e zakonshme, nga të cilët mund të meren të dhëna të vlefshme për ndriçimin e veprave penale dhe kryesit të saj.³ Sigurishtë që këta persona më vonë mund të paraqiten edhe si dëshmitarë,⁴ gjatë procedurave gjyqësore. Në rastin e dytë (biseda informative), fjala është për bisedë me personin i cili dyshohet si autor i veprës penale dhe kundër tij ekzistonë dyshimi bazuar, se është kryes i veprës penale.⁵ I dyshuar në kriminalistikë definohet si “personi ndaj të cilit ekzistojnë bazat e dyshimit se ka kryer vepër penale”. Pra kundër këtij personi ende nuk zhvillohet procedurë penale, e as që është ngritur kallzimi penal, pasi organi ka grumbulluar disa të dhëna të zbehta lidhur me autorësin e tij. Në këto raste i dyshuari nuk mund të arrestohet, e as të shoqërohet në stacionet policore. Në këtë fazë, me të dyshuarin eventualisht mund të kontaktohet jashtë objekteve policore edhe atë në bazë të vullnetit të lirë. Me këtë rast dëshiroj të përmend se praktika e policisë në vendet tona, që i dyshuari kundër të cilit ekziston vetëm bazat e dyshimit, të thiren në stacionet policore që të zhvillohen biseda me të, është tepër negative, prandaj duhet ndjekur praktika e shteteve tjera, sidomos SHBA Anglisë, Gjermanisë etj.. Në këto vende policija me qytetarët kontakton jashtë objekteve policore, (në shtëpit e tyre, vendet e punës etj.) dhe kjo mënyrë e punës është më e preferuar. Nga ana tjetër, thirja e të dyshuarit në stacionin policor, mbi bazat e dyshimit, implikon që ai të ndjehet i poshtuar. Kjo është kështu pasi çdo njëri që ftohet në stacionin e policisë, me rastin e pranimit të thirjes, fillon të ndjehet i tishuar i pasigurtë, emocionalishtë i shokuar, që mund të ndikoj personi gjatë zhvillimit të bisedave me hetuesit të japë të dhëna kundër vetvetes. Kjo në shkencën e kriminalistikës nuk është e lejuar, pasi organi duhet të ketë siguruar provat dhe faktet relevante, para se të thirret në stacionin policorë. Prandaj në fillim, kur ekzistojnë vetëm bazat e dyshimit, me të dyshuarin mund të kontaktohet jashtë objekteve policore edhe atë vetëm në cilësin e qytetarit, pa asnjë formalitet dhe obligim ligjor. Në qoftë se gjatë këtyre bisedave, i dyshuari në bazë të vullnetit të lirë, tregon provat, atëherë sigurishtë që ata mund të shërbejnë për të akuzuar atë. Është i madhë numri i palëve me të cilat komunikojnë punëtorët e policisë për pengimin, zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit dhe shkeljen e rendit dhe të qetësisë publike. Kategoritë më të shpeshta dhe shumë të rëndësishme të palëve janë të dyshuarit, personat e dëmtuar, dëshmitarët dhe paraqitësit, e pastaj bashkëpunëtorët, bashkëpjesëmarrësit, informatorët dhe kategoritë e tjera. Hetuesi duhet të ketë parasyshë që ata mund të jenë të gjinive dhe të moshave të ndryshme, të profesioneve, të nivelit arsimor dhe kulturor, të statusit material dhe social, si dhe të nacionaliteteve të ndryshme. Ajo që është me peshë të madhe gjatë zhvillimit të bisedave është vënja e kontaktit psikologji, apo njohja e karakterit dhe temeramentit të të pyeturit. Kështu dallohen katër lloje temperamenti: sanguine, flegmatik, kolerik dhe melankolik. (Begeja, 2004,415). Prandaj taktika dhe teknika e zhvillimit të bisedave nuk mund të jetë e shabllonizuar dhe e njëjtë me të gjitha kategorit. Të zhvillosh bisedë me të dyshuarin apo me dëshmitarët, nuk është një punë administrative që thjeshtë kërkon mbushjen e formulareve, por këtu nga hetuesi kërkohet që të jetë fleksibil, elsatikë, të jetë i zoti, të ketë sjellje të mirë dhe qëndrim stabil. Me një fjalë nga hetuesi modern nuk kërkohet që të dalloj që përveç ngjyrës së bardhë dhe të zezë, ka edhe ngjyra tjera, por nga ai kërkohet që të dalloj nuansat e shumta të të njejtës ngjyrë. Qëllimi primar i bisedës me të pandehurin, dëshmitarët dhe të dëmtuarin është zbardhimi i rrethanave në të cilën është kryer vepra penale. Në këtë drejtim, biseda është provë e rëndësishme, pasi me marjen e tyre kompletohet mozaiku i provave.

Por duhet ditur se këto prova nuk mund të grumbullohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë njerëzit, secili ka botën e vete psiqike dhe vetëdijen individuale, prandaj bisedat nuk mund të jenë

³ Në praktik të gjithë të thyrurit në polici në tërë teritorin e RM-së qoftë si dëshmitarë, i dëmtuar apo i dyshuar, posa hyjnë në polici, menjëher ju jepet e drejta e mbrojtjes. Vetë plotësimi formularve dhe nënshkrimi tyre, mbi të drejtën e mbrojtjes-avokatit, tek dëshmitarët dhe dëmtuarit shkaktonte revolt të madhe pasi ndjehen sikur janë të thyrur në cilësin e të dyshuarit.

⁴ Kur qytetari ftohet nga ana e gjykatës si dëshmitarë, në këtë rast LPP-ja parasheh obligimin e dëshmisë.

⁵ Në praktikë i dyshuari thirret kur ekziston bazat e dyshimit, që nga biseda me të organi të mësoj se ku janë provat dhe kështu të ngrisë bazat e dyshimit, në dyshim të bazuar, që nuk është e lejueshme ligjërishtë, sepse askush nuk është i obligueshëm që të japë të dhëna kundër vetvetes.

të shabllonizuara. Kështu dikush është më i prirur dhe ka kapacitet që më mirë të përceptojë atë që ndodhë para tij, e dikush këtë aftësi e ka më të kufizuar. Disa njerëz njëkohësisht mund të shikojnë, dëgjojnë, nuhatin, por sigurisht që askush nuk është në gjendje që plotësisht të fiksojë të gjitha rrethanat që manifestohen në botën e jashtme dhe pastaj gjithë atë që ka parë të riprodhojnë. Se sa do të jetë vëllimi i perceptueshmërisë dhe pastaj riprodhimit të saj, varet nga aftësia e njeriut që psikologët e emërtojnë si kapacitet simultan (Latifi, 2006, 127). Nuk ka dy njerëz, që në mënyrë plotësisht të njëjtë perceptojnë dhe riprodhojnë sendet që janë manifestuar para tij. Kështu me fjalë tjera në procesin e dëshmisë marin pjesë tri faza të rëndësishme : perceptimi, kujtesa dhe riprodhimi.⁶ Në punën hetimore, interes të veçant paraqesin perceptimet profesionale, të hapsirës kohës dhe lëvizjes. (Hysi, 2007) Perceptimi profesional, buron nga përvoja e njeriut në punë, kështu që tek kjo kategori njerëzish ekziston mundësia që gjatë perceptueshmërisë disa rrethana që nuk i kanë vërejtur ti plotësojnë me përfytyrime. Por edhe asnjë njeri i zakonshëm nuk mund të perceptojë të gjithë rrethanat e ngjarjes, kështu ata më vonë plotësohen në mënyrë të pavetëdëshme me ndihmën e përvojës. Prandaj është shumë e rëndësishme që hetuesi gjatë bisedave të mund të caktoj qartë kufirin në mes të vërtetës dhe përfytyrimit. Në saktësinë e perceptimit, rëndësi të madhe ka edhe vëmendja, sa më me koncentrim të perceptohet objekti apo sendi, perceptueshmëria është më e saktë dhe anasjelltas. Mirëpo duhet ditur se me rastin e kryerjes së veprës penale, dëshmitarët (dhe i dëmtuari), si zakonisht janë të përqëndruar në ndonjë objekt tjetër që në atë moment ka pasur interes për të, por me rastin e kryerjes së veprës penale (psh: shkrepa me armë) personi papritmas orienton perceptimin drejt këtij rasti, por tani disa rrethanat dhe hollësi që mund të jenë vendimtare për zbardhimin e rastit, fare të mos jenë vërejtur, për të cilat dëshmitari nuk por që ai do ti mbush me ndihmën e përvojës apo përfytyrimit dhe për këtë nuk do të jetë i vetëdëshëm.⁷ Poashtu me rëndësi të madhe është edhe kujtesa. Haresa dhe kujtesa janë dy procese të gërshtuara njëra me tjetrën. Kështu sado qoftë perceptimi saktë, përsëri nuk mund të riprodhohet në tërësi ajo që është perceptuar. Kjo ndodhë përshkak të procesit të haresës e cila fillon menjëher pas perceptueshmërisë. Kujtesa është e lidhur edhe me kalimin e kohës. Kështu sa më shumë që kalon kohë nga ngjarja, aq më shumë janë shanset që të zbehet dhe të harohen rrethanat të rëndësishme, prandaj preferohet që me dëshmitarët të bisedohet menjëher pas ngjarjes. (Vodineliq, 1985, 78). Pastaj nga çështja penale, dëshmitari dhe viktimia mund të kenë pësuar trauma të forta, që nevojitet dhënja e këshillave të veçanta, që shumë hetues nuk janë të edukuar.

2. Kushtet që duhet plotësuar nga hetuesit

a) njohja e normave ligjore; hetuesi duhet të jetë njohës i mirë i normave ligjore, kjo do ti mundëson inspektorit që gjatë zhvillimit të bisedës, të mos dalë jashtë kornizave ligjore. Njohja e normave ligjore, poashtu do të ndihmojë punëtorët përgjegjës për zbatimin e ligjit, që të formulojnë pyetje që orientohen drejt fakteve relevante, si dhe të mos parashtrojë pyetje të pavlefshme (Angeleski, 2007, 27).

b) analizimi i materijalit operativ; hetuesi para se të fillojë me bisedën, hollësisht duhet të njihet me materijalin operativ që është grumbulluar gjatë kontrollit dhe përpunimit kriminalistik. Në zhvillimin e bisedave, kur nuk duhet marë pjesë hetuesi i cili nuk ka njohuri me faktet që janë siguruar deri në atë moment, mbi ngjarjen penale. Në praktik, është vërejtur se në rastet kur bisedën e ka zhvilluar hetuesi i papërgatitur, pa mos u njohur mirë me çështjen penale, suksesi që në fillim ka qenë thuaj se zero. Është interesant se në këto rastë kemi vërejtur se bashkëbiseduesi ka një sensor

⁶Një edukim mbi teknikat e zhvillimit të bisedave që organizohej nga OSBE-së në Shkup, për punëtorët e policisë, tregoi se elementet që perceptonin hetuesit nga një vizatim i varur në murë, asnjëherë nuk riprodhoheshin në mënyrë të plotë.

⁷Në një rast, një person dëshmonte se kishte parë veprën penale të vrasjes me thikë. Ai dëshmoi se kishte parë autorin se si nga trupi viktimës-stomaku, nxjerte thikën dhe pastaj ishte larguar nga vendi ngjarjes. Mbi këtë dëshmi si dhe thikën që u gjetë në shtëpinë e kryesit, ai u dënua me 15 vjet burg. Pas 10 viteve, një person shkoi të rrëfëhet tek prifti dhe i tregoi se kryesi i vërtetë i kësaj ngjarje ishte ai dhe pas kësaj përshkak të shtypjes psikologjike ishte dhënë pas alkoholit që të zbusë dhimbjet shpirtërore. Pas ndriçimit të plotë të të gjitha rrethanave u pa se personi që kishte nxjerur thikën nga trupi viktimës, nuk ishte edhe personi që kishte futur thikë. Ai ishte afëruar viktimës me qëllim të dhënjës së ndihmës, por ky ishte moment kritik kur u pa nga dëshmitari.

natyrorë që menjëher e vëren dhe krijon bindjen se organi nuk ka njohuri lidhur me veprën penale, prandaj vijnë deri tek izolimi tij dhe mos bashkëpunimi me organin hetues.

c) njohja e personalitetit të personit, me këtë nuk nënkuptohet që hetuesi të grumbullonë të dhëna vetëm nga evidencat policore lidhur me veprimtarin apo karrierën kriminale (recidivizmin) në të kaluarën, por në rend të parë nënkuptohet edhe njohja e rrethanave të ndryshme siç janë tiparet e karakterit, arsimit, kultura, sepse vepra penale është pasqyra e personalitetit të kryesit e manifestuar në botën e jashtme. Sigurishtë që biseda do të zhvillohet në një nivel më të lartë, kur para hetuesit qëndron një intelektual dhe ndryshe kur fjala është për një person që nuk është i arsimuar.

d) hartimi planit- që biseda të jetë e sukseshme, hatuesi duhet të hartojë një planë ku do të bëjë konceptin e pyetjeve. Këtu duhet të formulohen pyetjet që kanë të bëjnë me faktet dhe rrethanat që duhet sqaruar si dhe pyetjet që kanë të bëjnë me provat dhe faktet që organi i ka grumbulluar, të cilat në mënyrë graduale mund ti tregohen personit, me qëllim të kapitullimit të shpejtë gjatë intervjustë etj.

e) biseda zhvillohet në mënyrë sy në sy- shpeshëher parashtrohet pyetja se si është më mirë të zhvillohen bisedat, të jetë i pranueshëm në zyrë vetëm një hetues apo më shumë hetues. Këtu mendimet në mes autorëve ndryshojnë, disa janë të mendimit se kur bisedohet me dëshmitarin dhe viktimën, më mirë është që në zyrë të jetë vetëm një hetues, ndërsa të tjerët mendojnë se duhet të ketë më shumë hetues dhe këtë e aryestojnë me faktin se një hetues duhet të bisedojë, kurse tjetri duhet të marrë shënime dhe të regjistrojë gjithë atë që thotë i dëshmitari. Nga praktika kemi vërejtur se marja e shënimeve gjatë zhvillimit të bisedave, ndikon negativishtë mbi dëshmitarin, prandaj është më mirë të mos meren shënime deri sa zhvillohet biseda. Hetuesi gjatë gjithë kohës duhet me kujdes të dëgjoj atë që thotë i dëshmitari.

3. Biseda me Dëshmitarët

Dëshmitari është person nga i cili ekziston besueshmëria se do të japë të dhëna të rëndësishme për veprën penale, kryesin dhe rrethana tjera të çështjes penale. Para se të fillohet me bisedën me dëshmitarët, hetuesi duhet të njihet hollësishtë me lëndën dhe provat e grumbulluara deri në atë moment. Biseda e *shpejtë* dhe pa përgatitje paraprake është e dëmshme, ajo nuk jep rrezultate të mira, prandaj fillimishtë hetuesi në mënyrë të kujdesshme krijon një plan që përmban disa pika bazë (koncept) të zhvillimit të bisedave që kanë të bëjnë me rrethana relevante të çështjes. Është mirë që në zyrën ku do të zhvillohet biseda të krijohet një ambient i qetë, të mos ketë shumë njerëz apo hetues nga departamentet e ndryshme, siç është praktikë në vendet tona. Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që dëshmitari të pres në korridor, deri sa hetuesit të pinë kafe brenda. Pasi dëshmitari arrinë në vendin ku do të zhvillohet biseda, në mënyrë njerëzore përshëndetet dhe ftohet që të ulet. Pas kësaj menjëher i afrohet ndonjë kafe apo ndonjë lëng. Është gabim i madhë në qoftë se hetuesi fillonë menjëher bisedat lidhur me çështjen penale, sepse kështu mund të krijoj përshtypje tek dëshmitari se biseda duhet të zhvillohet me urgjenc që vërtet ndikon negativishtë mbi suksesin e dëshmisë. Prandaj fillimishtë hetuesi duhet të relaksojë dëshmitarin, duke tentuar që të gjejë tema të lira nga jeta e përditshme (sport, film, muzikë etj) tema që janë me interes për të. Por është mirë që paraprakishtë, hetuesi të ketë rregulluar zyrën ashtu që tek dëshmitari të lërë përshtypjen e një institucioni serioz, mundësishtë karrikja ku do të ulet dëshmitari të jetë e kthyer në atë mënyrë që ai të ketë shikim kah dritarja, e jo kah dera. Hetuesi nuk duhet të bëjë lëvizje me trup, me dorë, me këmbë, por duhet të qëndrojë i qetë. (OSBE, 2009, 15). Pas një bisede të shkurtë, hetuesi në mënyrë graduale fillon të njoftoj dëshmitarin me shkakun e thyrjes së tij dhe mundohet që të forcojë vullnetin dhe vendosshmërin e tij që të flasë të vërtetën. Hetuesi mundohet të bindë dëshmitarin se dëshmia e drejtë është hyjnore, është e shejtë, pasi mundëson të mbrohet i pafajshmi dhe të paramendojmë sikur ne të ishte në pozitën e viktimës. Ska dyshim se fillimi mirë është sukses i madhë dhe nga kjo varen fazat e më vonshme të bisedave (Pavisiq & Modly, 2006,406). Pas kësaj ftohet dëshmitari që të tregoj gjithë atë që dinë lidhur me ngjarjen. Nuk është mirë që dëshmitari të ndërpritet gjatë bisedës së tij, ai duhet të tregoj në kontinuitet atë që ka parë. Këtu parashtrohet pyetja, a duhet hetuesi të mbajë shënime deri sa dëshmitari jepë deklaratë si dhe sa duhet të jetë numri hetuesve të pranishëm në zyrën ku zhvillohen bisedat. Lidhur me çështjen e parë, nuk ka dyshim se duhet të shënohet e gjithë ajo që tregon dëshmitari, por kjo do të jetë e mundshme nëse në zyrë janë të pranishëm dy

hetues, kështu njëri me vëmendje dëgjon dëshmitarin, kurse tjetri merë shënime. Nëse biseda zhvillohet vetëm nga një hetues, atëher është mirë që hetuesi me kudes të dëgjojë atë që thotë dëshmitari, pastaj të hudhën në letër dëshmin e tij. Praktika, deri më tani ka treguar se dëshmitarët më mirë ndjehen kur në zyrë ka vetëm një hetues edhe ai mundësisht të jetë i veshur me kostum. Pra me rëndësi të madhe është edhe pamja fizike e hetuesit. Ska dyshim se hetuesi që ka pamje të vrazhdë, i veshur në mënyrë jo serioze, do të jetë më pak i sukseshmë gjatë zhvillimit të bisedave se sa hetuesi që ka pamje të butë dhe i veshur me kostum. Hetuesi gjithmonë duhet të ketë parasyshtë kohën që ka kaluar nga ngjarja dhe aftësit e dëshmitarit të riprodhojë atë që ka parë. Në shkencë ekzistojnë disa autorë (Finkenbindor 1913, Strong 1913, Luh 1922, Van Ormer 1932) që kanë tentuar të llogarisin kohën dhe shpejtësin e harresës pas ngjarjes. Kështu sipas tyre, haresa fillon me shpejtësi të madhe menjëher pas ngjarjes, sidomos në orët e para (58%), dhe pastaj harmonizohet duke u ngadalësuar sidomos gjatë ditës së dytë dhe të gjashtë. Pra, pas disa ditësh, personi ka humbur shumë rrethana të rëndësishme të cilët mund ti zavendëson me përfytyrime. Kështu edhe Grassberger konkudon se dëshmitari në përfundimin e ditës së dytë, pas ngjarjes kriminale mund të riprodhojë vetëm 1/5 e përjetimit të parë. Kurse pas një jave arrihet qëndrueshmëria relative me 10% nga ky përjetim (Latifi, 2009,141). Edhe tek riprodhimi koha është jetike, kështu sa më shpejt që bëhet riprodhimi nga ngjarja, aq më e plotë do të jetë ajo. Por nga kjo rregull ka një përjashtim, kjo vlenë tek të dëmtuarit dhe dëshmitarët, që nga rasti kanë përjetuar tronditje emocionale. Tek ata riprodhimi do të jetë më i mirë pas një ose dy dytësh. Ky fenomen njihet si dukuri e *reminiscencës* që nënkupton çlodhjen e qelizave mendore, të cilat janë goditur nga reagimi emocional i personit. Por edhe nëse dëshmitari për rrethana të ndryshme nuk e thotë të vërtetën, por gjatë qëndrimit me hetuesin krijojnë përshtypje se ai është një person që ka tipare të fuqishme të karakterit, të cilit mund ti besohet, atëher mund të ndodhë që hetuesi shumë shpejtë të thuret nga ana e dëshmitarit dhe në një bisedë joformale të tregojnë të vërtetën mbi ngjarjen. Prandaj, gjithmonë në fund të bisedës edhe nëse kemi mbetur të pakënaqur nga dëshmitari, duhet të ndahena në mënyrë njerëzore, këtu me rëndësi është që para se të ndahemi të ndrojmë kontakt telefonat, apo të japim dëshmitarit visit kartelën me shpresë që të paraqitet në një të ardhme të shkurtë. Në rastet kur dëshmitarë është fëmija, atëher hetuesi duhet të ketë një qasje krejtë më të ndryshme dhe të njohë psikologjinë e fëmijës. Nga hetuesi kërkohet që të jetë i aftë të gjejë gjuhën e përbashkët me fëmijët, e cila do ti mundësojë që ai të pranohet nga fëmija dhe të futet në botën e fëmijës, të bëhet shokë me të. Mirëpo, që të arrihet kjo, hetuesi duhet të dalë nga mosha e tij dhe të kthehet në moshën e fëmijës, pra të bëhet si ai, të luaje me lodra, me kukulla, të përkdhel atë, vetëm në këtë mënyrë do ti afrohet fëmijës. Përveç kësaj kërkohet që zyra ku do të zhvillohen bisedat, të ketë një atmosferë të këndshme për fëmijë, që ai posa të futet brenda të ndjehet i lirë dhe të shohë një numër të madhë të lodrave, që të fillojë të luaj me ato. Kjo zyra nuk duhet të jetë në thellësi të objekteve policore, ku arrihet pas kalimit të korridoreve të gjata, apo lavirinteve të shumta, sepse fëmijë do ti mbeten në kujtime gjatë gjithë jetës, prandaj është mirë që të adaptohet zyra e cila është në fillim të objektit. Në SHBA në rastet e pedofilisë dhe dhunimit të fëmijëve, FBI posedon zyrat e posaçme të adoptuara në mënyrë shumë të mirë, me lodra dhe kukulla të shumta, me të cilat fëmija posa futet brenda ndjehet i kënaqur dhe menjëher fillon që të luaje me ta. Bashkë me fëmijën luan edhe hetuesi i cili nëpërmjet të lojës, në mënyrë graduale, krijojnë miqësi me fëmijën. Më vonë hetuesi gradualisht fillon të pyes fëmijën, por gjithmonë duke e kthyer kah kukulla, që fëmija vetë të tregojnë psh: vendet ku e ka prek kryesi ose vendet ku e ka goditur kryesi. Këtu fëmija nuk e tregon me gojë, por vetëm orienton gishtin kah pjesët e kukullës, kurse videokamera vazhdimisht inçizon dhe kjo më vonë shërben si provë në procedurën penale. Por hetuesi duhet të ketë parasyshtë edhe moshën e fëmijës. Fëmijët prej moshës 7 deri 9 vjeç, mund të jenë dëshmitarë të shkëlqyer. Kurse pas kësaj moshe, e rëndësishme është gjinia, djemtë në këtë moshë 10 vjeç, janë shumë të interesuar për të gjitha aktivitetet jetësore, ata i tërheq çdo gjë që tregojnë gjallëri, që ka dinamik e motorik, që është avanturiere dhe që kërkon shpirt aktiv. Në këtë moshë fëmija nuk dinë të gënjeje ai është shpirt i pastërt. Por çështja mund të jetë ndryshe tek vajzat në këtë moshë, tek ato që herët zhvillohet shenjat e pubertetit dhe nuk është shumë e interesuar për botën se sa për vetveten. Ajo në këtë moshë është egocentrike dhe më tepër rëndësi i kushton vetvetës se sa objekteve që e rrethojnë, prandaj nuk janë të mira për dëshmitarë.

4. Biseda me të dyshuarin

Për dallim nga dëshmitari, i dyshuari është personë kundët të cilit zhvillohet procedura paraprake dhe ekzistojnë bazat e dyshimit se është autor i veprës penale. Sigurishtë që rregullat që i përmendëm më lartë, lidhur me sjelljen e mirë gjatë zhvillimit të bisedës me dëshmitarin vlejnë edhe për të dyshuarin. Në asnjë mënyrë nuk duhet ofenduar e poshtuar i dyshuari, e as të lehet jashtë në korridor qëndrojë në praninë e policit. Poashtu është mirë që gjatë qëndrimit të të pandehurit në zyrën e hetuesit, të mos qëndrojë i lidhur me pranga. Praktika ka treguar se në ato raste kur i dyshuari i arrestuar, ka qëndruar i lidhur me pranga për kasafortën apo për gypat e nxemjes qëndrore i shtrirë në dysHEME, nuk janë arritur rrezulltate të mira. Hetuesi duhet të trajtoj të dyshuarin në mënyrë njerëzore, të rrespektojë dinjitetin e tij, prandaj sa herë që është e mundur, duhet hequr prangat që ai të ndjehet i lirë dhe komot. Hetuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për thënjën se “*Më shumë miza kapen me sheqer se me acid*”, ose “*Fjala e ëmbël hapë edhe dyert e hekura*”. Në jetën e përditshme, të gjithë neve na ka ndodhur që dikush të na thrasë gabimishtë me emër tjetër dhe menjëherë ndjehesh i hutuar, po atëher të paramendojmë kur dikush na thëret me emër të atillë që të na fyejë apo ofendojë, prandaj hetuesi duhet të ketë kujdes që drejtë dhe saktë në emër të thrasë të dyshuarin, që të arrijë kredibilitetin e tij. I dyshuari nuk duhet të rrespektohet më pak se dëshmitari apo viktima, bile rrespekti mbi minimumin që përcakton ligji mund të sjellë dobi. Hetuesi duhet të kujdeset edhe për atmosferën në zyrë, ajo duhet të jetë mirë e rregullua, kurse karrikja ku do të ulet i dyshuari të jetë e kthyer në atë mënyrë që ai të ketë shikim kah dera. Shikimi nga dera mundëson që ai shpejtë të japë të dhëna për ngjarjen dhe të ikë nga kjo zyrë. Poashtu është mirë që në mes të dyshuarit dhe hetuesit të mos ketë asnjë pengesë, në fakt të mos ketë byro, sepse në këtë mënyrë biseda është më e lirë dhe më pak formale. Ka raste kur i dyshuari lidhet për kasaforte apo për gypat e nxemjes qëndrore që le një pamje poshtuese, shumë të keqe. Shpeshëher thuhet se bisedat nuk mund të jenë *unikate*, por hetuesi gjithmonë duhet të jetë objektiv dhe i paanshëm dhe në fillim të bisedës, duhet të njoftojë të dyshuarin me provat që janë grumbulluar kundër tij, që ai të jetë i njohur me shkaqet e thirrjes. Kjo s’do të thotë që i dyshuari të njihet me të gjitha provat që ka grumbulluar organi, prandaj hetuesi këtu mund të seleksionon se cilët prova do ti zbardhojë. Por asnjëher nuk duhet haruar se i dyshuari është personi i cili më së miri i ka të njohura të gjitha rrethanat lidhur me çështjen penale. Nuk janë të ralla rastet kur i dyshuari ka qëndrim armiqësorë, fillon të bërtasë dhe të dalë nga kontrolli, por kjo nuk duhet menjëher apriori të pranohet si një symptom i fajshmërisë. Në këto raste hetuesi duhet të qëndrojë gjakftohtë, i qetë, të sillet me profesionalizëm, në të kundërtën biseda mund shpejtë të përfundojë pa sukses. Por ende në praktikë, hetuesit ndonjiher ndjekin disa metoda psikologjike që të frikësojnë dhe detyrojnë të dyshuarin që të flasë mbi veprën penale. Si metodë përdoret mënyra që disa hetues, kalojnë në zyrën tjetër dhe fillojnë të godasin murin apo byrot duke lëshuar kështu edhe zëra sikur dikush vajton, me qëllim që i dyshuari, të frikësohet dhe të japë deklaratë mbi pranimin e fajsisë.⁸ Nëqoftë se në fillim i dyshuari refuzon të bashkëpunojë me hetuesin, atëher nuk duhet menjëher të heqim dorë nga puna e mëtutjeshme. Në këtë kontekst, vullneti dhe dëshira e punëtorit operativ që të zbardhojë çështjen penale janë jetike, kështu hetuesit që janë parazitë në punë, ata vazhdimishtë mendojnë se si të kryejn punën shpejt dhe shkurtë (shkel e shko), dhe të ikin në shtëpi. Nga këta hetues shumë pak mund të pritet të arrijnë rrezultate të mira në punë. Parimi këmbëngulësisë në punën operative është me domethënje të madhe, rrezultatet nuk vijnë menjëherë si rrufeja, por ata duhet të grumbullohen pika pika, vetëm në këtë mënyrë do të arrihen rezultatet hetimore dhe të ndriçohet rasti.

4.1 Teknika e dëgjimi dhe ndjekjes së lëvizjeve të dyshuarit

Që të mund punëtori operativ të zhvillojë bisedë informative të sukseshme, ai duhet të jetë i përgatitur dhe të ketë mjaftë të dhëna mbi ngjarjen penale. Pasi i dyshuari pritet mire, menjëherë duhet të njoftohet me të drejtat ligjore. Kur bisedohet me të dyshuarin, për dallim nga dëshmitari, duhet të jenë të pranishëm dy hetues. Hetuesit paraprakishtë duhet të bëjnë përgatitjet e nevojshme: të

⁸Për fatë të keq edhe shteti më demokratik i botës SHBA, gjatë zhvillimit të bisedave me të burgosurit në Guantanamo dhe Abu Graip, ka përdorë metoda të torturës dhe sjelljeve poshtuese.

zgjedhin vendin se ku do të zhvillohet biseda dhe të përmbushë kushtet që përemndëm më lartë.⁹ Punëtorët operativ duhet të jenë të organizuar dhe të koordinuar, ata duhet të kenë ngritur koncept të pyetjeve që duhet të sqarohen gjatë bisedave, të jepet përgjigje në pyetjet e arta të kriminalistikës. Pasi fillon biseda, njëri nga hetuesit i cili zhvillon bisedën, me kujdes dhe koncentrim të plotë e dëgjon të dyshuarin, kurse tjetri shkruan atë që thotë i dyshuari. Nuk duhet shkruar e gjitha, por vetëm kuptimi përmbajtësor. Njëri nga hetuesit vazhdimishtë e shiqon të dyshuarin dhe i përcjell ndryshimet psikike-reaksionet që ndodhin tek ai deri sa flet mbi ngjarjen. Fajtori si zakonishtë mundohet të ruaje ndjenjën e fajshmërisë dhe gjatë bisedës ka një reagim më të butë, ai në asnjë mënyrë nuk dëshiron të hidhëroj hetuesin dhe gjatë bisedave si zakonishtë shikimin e mban jo kah hetuesi, por në vende tjera. Për dallim nga fajtori, i dyshuari i pafajshëm, shpeshherë shpreh mllëfin e vërtet dhe gjithmonë shiqimin e mban kah hetuesi. Këtu duhet patur kujdes rastet kur i dyshuari disa herë e përmendë se nuk është fajtor, kështu tek ai mund të përforcohet bindja e tillë dhe pas kësaj shanset janë të vogla që të pranoj fajin, prandaj hetuesi në këto moment duhet të reagoj dhe ti japë bisedës kahje tjetër. Pas kësaj fajtori do të ndërrpres të flasë, kurse i pafajshmi vazhdonë të bisedojë më hetuesin duke tentuar të bindë në pafajshmërin e tij. Nëse hetuesi edhe më tej vazhdon me akuzat ndaj të pafajshmit, atëher mund të ndodhë që ai të ngrihet në këmbë, të filloj të bërtas, ndodhë edhe ti afrohet hetuesit deri në afërsi duke nxjerë hidhërimin e vet ndaj akuzave të pabazuara. Kurse i dyshuari i vërtet, tërhiqet, izolohet dhe mbrohet me heshtje. Hetuesi që zhvillon bisedën informative, duhet të ketë parasyshë lëvizjet që bënë i dyshuari, kështu nëse gjatë të folurit shpesh kollitën, prekën gishtat, kafshon buzët, këto janë janë shenja që ai gënjen. Fajtori, thuaj se pandalë i përsëritë këto gjeste, kuptohet pavetëdije sepse këto lëvizje ju ndihmojnë që të stabilizohen dhe të fitojnë në kohë, deri sa të përfundojnë me gënjeshtren e tyre. Hetuesi, poashtu duhet të vërej edhe lëvizjen e këmbëve tek i dyshuari, nëse ai lëvizë pandalë me këmbët, i luhatën me ritëm të shpejtë, nuk është stabil, këto janë simptome që hetuesi duhet ti ketë parasyshë si tregues të gënjeshtres. Por nëse gjatë zhvillimit të bisedave, i dyshuari tre herë ndron pozitën e këmbëve, hudhën njërën përmbi tjetrën këmbë, pastaj përsëri kthen në gjendjen e mëpërparshme, kjo është indikacion i fuqishëm që ai gënjen, sepse njeriu që nevrifikoset përshkak të renës, ai nuk është i rahatshëm, andaj nuk mund të qëndroj i qetë. Karakteristikë tjetër që hetuesi duhet të ketë parasyshë është nëse i dyshuari gjatë bisedës prek hundën, atëher hetuesi duhet që në atë pjesë të bisedës të ketë kujdes dhe të mare me rrezervë, sepse i dyshuari në atë mënyrë dëshiron të jetë më bindës, duke tentuar të bëjë një pamje naive të fytyrës. Poashtu me interes është edhe nëse pandalë prek syrin, ai kështu mundohet që t'ju dekoncentroj nga biseda dhe të jenë më pak të interesuar për të vërtetën. Praktika ka treguar se gjatë zhvillimit të bisedave, është mirë që para të dyshuarit të vendoset një stylolaps ose ndonji send vogël, kështu fajtori menjëher do ta marë dhe do të fillojë që të rrotullojë nëpër gishtat, përshkak të jostabilitetit shpirtëror, kurse i pafajshmi mund ta prek dhe thjeshtë ta largojë anash. E gjithë kjo që u përmend më lartë, kuptohet vetëm mund ti ndihmojë hetuesit që të ketë një orientim më të mirë, por asnjëher nuk mund lëvizjet e të dyshuarit të shërbejnë si prova. Praktika në mënyrë shumë bindëse na ka mësuar se nuk ka të dyshuar i cili nuk përgatitet për bisedë, për atë se çka do të thotë para organit, për këtë fakt hetuesi duhet të jetë i vetëdëshëm, por sado që të përgatitet i dyshuari, përsëri nuk mund të jetë ideal, kur njeriu gënjen dhe krijon diçka që nuk është, atëher truri tij harxhon shtesë energji dhe sado që të mundohet të sqaroj rrethanat në mënyrë bindëse, përsëri do të vërehen gabime teknike, taktike dhe logjike. Prandaj në disa raste edhe vetë i dyshuari i vërenë palogjikshmërit dhe tenton të kthehet që ti përmirësoj gabimet e bëra. Këto momente lehtësisht mund të vërehen nga hetuesi dhe mund të shërbejnë si kapitullim i të dyshuarit para hetuesit. Në fund dua të përmend se në këtë punim, shkurtimishtë është bërë fjalë mbi metodat e pyetjes së të dyshuarit dhe dëshmitarëve, shpersojmë që mbi bisedat me fëmijët si dëshmitarë, viktimat e tregtisë me qenje njerëzore që kanë të keqtrajtuara, të miturit si tv dyshuar dhe kategorive tjera, do të bisedojmë në një konferencë tjetër.

⁹Nëse në vendin ku do të zhvillohet biseda ka zhurmë atëher ajo nuk do të jetë e sukseshme.

Perfundimi

Sigurishtë që në zhvillimin e bisedave ndikojnë shumë faktorë, prandaj bisedat nuk mund të jenë unikate. Por nëse hetuesi dëshiron të arrijë rrezultate të mira gjatë zhvillimit të bisedës, patjetër fillimishtë duhet të krijojë mirëbesimin mes tij dhe dyshmitarit apo të dyshuarit. Nëse dëshmitari apo i dyshuari, krijojnë mirëbesimin tek hetuesi, si një njeri serioz, stabil, me karakter të fortë, të cilit mund ti besohet, atëher bashkëpunimi i mëtutjeshëm nuk do të jetë problem i madhë. Por hetuesi gjithmonë duhet të ketë parasyshtë të drejtat ligjore të të pandehurit dhe fuqishëm ti përjashton metodat e torturës gjatë zhvillimit të bisedës me të pandehurin. Hetuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se i dyshuari gjatë zhvillimit të bisedave informative, ka të drejtë të gënjej, të heshtë dhe për këtë nuk mund të ketë asnjë pasojë, i dyshuari nuk ka obligim që të thotë të vërtetën dhe të tregojë vendin se ku ka fshehur provat. Është e logjikshme dhe njerëzore që njeriu të mos japë të dhëna kundër vetvetes, këto të dhëna mbi të cilat do të mund të akuzohet i dyshuari më vonë, duhet të zbulohen dhe grumbullohen nga hetuesi, por ligjërishtë ekziston mundësija që edhe i dyshuari të kontribuojë në zbardhimin e së vërtetës. Ne jemi dëshmitarë që edhe sot e kësaj dite, një numër i konsiderueshëm i hetuesve gjatë zhvillimit të bisedave informative, përdorin metodat e ndaluara të torturës dhe sjelljeve poshtuese. Mandej shpeshëher mund të dëgjojmë se ligji më shumë mbron të dyshuarin se sa viktimën, por pavarësishtë nga këto qëndrime, hetuesi nuk mund të mendojë në këtë mënyrë, ai është profesionist dhe e dinë që në asnjë mënyrë nuk duhet shkelet dinjiteti njerëzorë, pamarëparasyshtë dëmet dhe pasojat që ka shkaktuar. I dyshuari duhet të respektohet njëjtë si edhe dëshmitari

Literatura

- Angeleski M., (2006), Kriminalisticka Taktika, Shkup.
- Aleksi Z., (1982), Kriminalistika, Beograd.
- Ainsworth P., (2000), Psychology and Crime, Longman.
- Aleksi Z., (Skuliq), 2004, Kriminalistika, Beograd.
- Begeja S., (2004), Kriminalistika, Tiranë.
- Bosković, M., 2005, Metodika Kriminalistike, Beograd.
- Vodinelic, V., (1984) Otkrivanje i Dokazivanje, Shkup.
- Latifi, V., (2009), Kriminalistika, Prishtinë.

Integrimi Evropian i Ballkanit Perëndimorë

Prof.Ass.Dr. Bashkim Zahiti (LL.M.)¹
Universiteti i Prizrenit

Abstrakt

Vështrimi empirik ka dëshmuar se e ashtuquajtura „Ide Evropiane” ka lindur si nevojë për të siguruar primatin gjeostrategjik evropian, edhe pse fillimisht e motivuar vetëm mbi baza religjioze të krishterimit, kundrejt popujve joevropian. Me kalimin e kohës motivet për afrim të popujve evropian në mes veti janë zgjeruar edhe në aspektin ekonomik, politik dhe shoqërorë. Kjo rrjedhimisht ka imponuar në aspektin normativ një kontinuitet të sendërtimit të kriterëve të integrimit evropian në përgjithësi dhe kushtimisht atyre lidhur me Ballkanin Perëndimorë, kriterë këto të cilat pasqyrojnë specifikën rajonale të integrimit evropian duke marrë parasysh të kaluarën e vendeve të Ballkanit Perëndimorë. Krahasimi normativ i kriterëve për integrim evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimorë ka dëshmuar se këto kriterë përmbajnë në njërin anë standarde të përgjithshme të cilat janë të vlefshme për të gjitha vendet (e Ballkanit Perëndimorë) dhe në anën tjetër kanë specifika të ndryshme për gjithsecilin vend të Ballkanit Perëndimorë, varësisht nga rrethanat dhe zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore që ka kaluar vendi përkatës.

Fjalët kyçe: Integrimi Evropian, Ballkani Perëndimorë, Bashkimi Evropian, Kriteret e Kopenhagës, Specifikat e Ballkanit Perëndimorë.

1. Fillet e Integrimit Evropian

Ideja për një integrim (lidhje, bashkim, aleancë) evropian ka lindur qysh në Mesjetë ku si motiv kryesor ishte aspekti gjeostrategjik. Fillimisht kjo ide ishte e lidhur ngushtë me idenë e kryqëzatave e më vonë me rreziqet që vinin nga jashtë, posaçërisht nga Perandoria Osmane. Pra ideja integruese nuk është një shpikje e Shekullit të XX-të por si e tillë ka lindur qysh në Mesjetë dhe fillet e sajë e kanë burimin në idetë e Kryqëzatave. Në këtë kontekst politikani, juristi dhe publicisti francez **Pierre Dubois** propozon në librin e tij „*Ripushtimi i Tokës së Shenjt*” të Vitit 1306 krijimin e një „Lidhje të Shteteve Evropiane” me qëllim që kështu „*Tokën e Shenjt*” ta çlirojë nga duart e „*të pafëve*”. Ideja e tij ishte e ndikuar sidomos nga dështimi i Kryqëzatave për pushtimin e Jerusalemit në Vitin 1187 dhe 1291. Një shekull më vonë - me rastin e pushtimit të Konstantinopolit (Stambollit) nga ana e Perandorisë Osmane në Vitin 1453 - frika e madhe nga ekspansioni i turqve në Evropë i detyrojë shumë faktorë të rëndësishëm politik, ushtarak dhe religjioz, ndër ta edhe **Papa Piusi i II-të**, të kërkojnë që kundër Perandorisë Osmane të luftohej së bashku. Megjithatë duhet të theksohet se jo vetëm mbrojtja nga jashtë ka dominuar idenë e integrimit evropian, sepse me kalimin e kohës motivet për afrim të popujve evropian në mes veti janë zgjeruar edhe në aspektin ekonomik, politik dhe shoqërorë. Në këtë kontekst filozofi dhe poeti italian **Dante Aligheri** (1265-1321) planifikonte krijimin e një lidhje shtetesh me një gjykatë arbitrazhi në krye të së cilës do të ishte perandori (Ziegenhofer-Pretenthaler, 2004, 14). Po ashtu një prej ideve më të hershme për një „*Bashkim të Evropës*”, i cili nuk do të shërbente vetëm për qëllime ushtarake dhe strategjike, vjen nga juristi britanik **William Penn** (1644-1718) i cili në elaborimin e tij propozonte një lidhje, bashkim apo aleancë evropiane e cila nuk do të shërbente vetëm për sigurimin e paqes por edhe do të ndikonte në zhvillimin e tregtisë dhe kështu të mirëqenies sociale në tersi (Ziegenhofer-Pretenthaler, 2004, 19). Në këtë lidhje evropiane do të gjenin vend të gjitha shtetet evropiane, ku ndikimi në vendimmarrje do të përcaktohej sipas fuqisë ekonomike përkatëse të shteteve. Edhe iluministi francez **Viktor Hugo** (1802-1885) një shekull më vonë kishte një vizion të ngjashëm, i cili parashihte krijimin e „Shteteve të Bashkuara të Evropës”. Me rastin e hapjes të Konferencës së Paqes në Paris me 21 Gusht 1849 ai shprehet kështu: „*Një ditë do të vijë, kurë plumbat dhe bombat do të zëvendësohen me fletëvotime, me*

¹Autori është Profesor i Fakultetit Juridik dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Prizrenit „Ukshin Hoti”.

të drejtën e përgjithshme të popujve për zgjedhje, me vendimet e një senati të madh sovran, i cili do të ketë atë domethënie për Evropën, të cilën e ka Parlamenti për Anglinë apo Asambleja Nacionale për Francën. Kjo ditë do të vijë pa kaluar 400 vite” (Piepenschneider, 2008, 1). Në fakt mjaftuan të kalojnë 100 vite që ky vizion i madh të bëhet realitet me nënshkrimin e traktateve të Romës. **II.**

Kriteret e Integritimit Evropian

Ideja Evropiane qysh në fillim ka paraparë përafrimin e të gjithë popujve evropian gjë që e bënë Bashkimin Evropian një organizatë ndërkombëtare gjysmë të hapur (Oppermann/Classen/Nettesheim, 2011, 689). Në bazë të nenit 49, paragrafi i parë, fjalia e parë, të Traktatit mbi themelimin e Bashkimit Evropian çdo shtet evropian i cili i respekton parimet themelore të përcaktuara në nenin 6, paragrafi i parë, i të njëjtit traktat mundet të paraqet kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Se kurë kemi të bëjmë me një shtet evropian është për t'u gjykuar në bazë të kriterëve gjeografik, historik, kulturorë dhe politik (Lenz & Borchardt, 2012, Art. 49) Nga kjo rrjedhë që apriori janë të përjashtuar nga drejta për të parashtruar kërkesën për anëtarësim ato shtete të cilat as në aspektin gjeografik e as në aspektin kulturor-politik nuk i përkasin Evropës (Streinz, 2003, Art.49). Këtë kërkesë vendi përkatës duhet t'i parashtrrojë Këshillit. Këshilli pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë pëlqimin e Parlamentit (pëlqim të cilin Parlamenti Evropian duhet ta marrë me dy të tretat e votave vendosë një zërit për kërkesën. Kërkesës për anëtarësim rregullisht i paraprinë Marrëveshja e Asocimit e cila ka qenë e përcaktuar në nenin 310 të Traktatit mbi themelimin e Bashkësisë Evropiane, respektivisht tash në nenin 217 të Traktatit mbi Mënyrën e Punës të Bashkimit Evropian. Në fillim të viteve të 90-ta Bashkësia Evropiane përballet me ndryshimet politike në Evropën Lindore si pasojë e rënies të sistemit monist dhe rrjedhimisht me kërkesën për anëtarësim të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian. Duke pasur parasysh se nga `farë rendi politik, juridik dhe ekonomik këto vende kanë dalë dhe pasi që vendimi për anëtarësimin e një shteti evropian në Bashkimin Evropian është një vendim politik, Këshilli Evropian në vitin 1993 në Kopenhagë ka formuluar tri grupe të kriterëve, të ashtuquajturat „*Kriteret e Kopenhagës*“, të cilat shtetet candidate për anëtarësim duhet ti plotësojnë. Kriteret e Kopenhagës paraqesin një zgjerim të parakushteve për anëtarësim të përcaktuara në neni 6 të Traktatit themelues të BE:

1. Kriteret e Kopenhagës

Kriteret e Kopenhagës ndahen në *politikë, ekonomikë* dhe *acquis communautaire*:

- **Kriteret politikë** përfshijnë stabilitetin institucional, rendin demokratik të shtetit ligjor, respektimin e të drejtave themelore të njeriut si dhe mbrojtjen dhe respektimin e pakicave. Pra, kriteret politikë përfshijnë kryesisht vlerat themelore të përcaktuara në nenin 2 të „KBE”. Është esenciale për një shtet evropian që pretendon të anëtarësohet në Bashkimin Evropian që paraprakisht t'i plotësoj në tërësi kriteret politikë, gjegjësisht që në këto fushëlëmi të ketë standarde të larta sikurse këto zakonisht i hasim tek shtetet anëtare. Lidhur me këtë është për t'u theksuar se me stabilitet institucional nënkuptojmë që të gjitha institucionet demokratike të shteti funksionojnë në mënyrë të efektshme. Funksionimi i efektshëm i institucioneve është i mundur vetëm nëse këto institucione respektohen nga qytetarët. Sa i përket rendit demokratik të një shteti ligjor ky kriter është i përmbushur atëherë kur pushteti puron nga vullneti i popullit dhe ushtrohet në mënyrë të pavarur nga organet legjislative, ekzekutive dhe judikative. Sa i përket mbrojtjes të drejtave të njeriut dhe respektimit të pakicave nacionale, ky kriter është i plotësuar kur shteti që pretendon të anëtarësohet e garanton një standard po aq të lartë sa këtë e hasim zakonisht tek shtete anëtare të Bashkimit Evropian.

- **Kriterët ekonomikë** përfshijnë një ekonomi funksionale të tregut si dhe aftësinë që të përballojë presionin e konkurrencës ekonomike brenda tregut të përbashkët. Duke pasur parasysh krizën ekonomike të viteve të fundit bëhet më e qartë se sa është e rëndësishme që një shtet anëtar të ketë një ekonomi funksionale të tregut e cila është në gjendje t'i përballoj presionit të konkurrencës në koherencë me globalizmin ekonomik.

- **Acquis communautaire** (që ndryshe njihet edhe si kriteri juridik) përfshin aftësinë e një shteti anëtar që detyrimet dhe synimet që sjell me veti anëtarësimi në Bashkimin Evropian të merren përsipër, çka do të thotë përvetësimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian që përfshinë diku rreth

85.000 faqe me akte juridike. Bisedimet për anëtarësim përfshijnë 35 kapituj të fushëlëmime të ndryshme që duhet të harmonizohen në mënyrë që kështu shteti kandidat të e plotësoj kriterin *Acquis communautaire*. Pra, siç shihet me formulimin e „Kritereve të Kopenhagës“ është bërë edhe një zgjerim i parakushteve për anëtarësim në Bashkimin Evropian pasi që kriteri ekonomik edhe ai „acquis“ nuk janë të përcaktuar shprehimisht në nenin 6 të Kontratës mbi themelimin e Unionit Evropian.

2. Specifikat e Integritit të Ballkanit Perëndimorë

Duke marrë parasysh zhvillimin e konflikteve në territorin e ish-Jugosllavisë në vitet e 90-ta Bashkimi Evropian ka hartuar një koncept strategjik për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor në kuadër të cilit vendeve të regjionit të Ballkanit Perëndimor nën kushte të caktuara ju ofrohen mundësinë për pjesëmarrje në një asocim me BE. Nocioni *Ballkani Perëndimor* është emërtim politik i cili përfshinë të gjitha vendet që kanë dalë nga ish- Jugosllavia (me përjashtim të Sllovenisë) dhe Shqipërinë. Ndërsa me *asocim* është për t'u nënkuptuar në aspektin juridik një lidhje apo një detyrim kontraktual siç parasheh shprehimisht edhe neni 217 i Traktatit mbi Mënyrën e Punës të Bashkimit Evropian. Në kuadër të këtij koncepti për herë të parë në Konferencën e BE në Köln në vitin 1999 me propozim të Komisionit (Evropian) janë paraparë për herë të parë marrëveshje e stabilizim-asocimit. Marrëveshjet e stabilizim-asocimit janë paramenduar si një lloj mekanizmi cili do të shërbente për përgatitjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor për një anëtarësim të mëvonshëm në Bashkimin Evropian. Procesi i stabilizim-asocimit është i ndërtuar mbi katër parime (Zahiti, 2008, 118):

- *Ofertën për stimulime në sferën ekonomike dhe politike, përfshirë perspektivën e integritit në strukturat e BE,*
- *Obligimin e vendeve të Ballkanit Perëndimorë që të reformohen,*
- *Intensifikimin e bashkëpunimit rajonal dhe*
- *Bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës.*

Vendeve të përfshira në procesin e stabilizim-asocimit Këshilli (i Bashkimit Evropian) në Konferencën e *Santa Maria da Feira* në Qershor të Viti 2000 ju ka njohur ***statusin e kandidatit potencial*** për integrim në BE. Si qëllim kryesor i zhvillimit të procesit të stabilizim-asocimit është që vendeve të Ballkanit Perëndimor të ju ndihmohet që të sigurojnë paqen, demokratizimin dhe mirëqenien sociale. Procesi i stabilizim-asocimit ngërthen në vete një bashkëpunim të gjithanshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE duke përfshirë këtu përafrimin e sistemeve juridike, liberalizimin e tregut dhe krijimin e zonave të tregtisë së lirë (si p.sh. CEFTA) si dhe koordinimin në çështjet politike, ekonomike si dhe në luftën e përbashkët kundër korrupsionit e krimin të organizuar. Fillimisht para se të fillojnë bisedimet për përfshirjen në marrëveshjen e stabilizim-asocimit Komisioni (Evropian) në një studim të fizibilitetit hulumton gatishmërinë për integrim të vendit përkatës. Në përgjithësi duhet të theksohet këtu se i gjithë procesi i stabilizim-asocimit ka për qëllim implementimin e Kritereve të Kopenhagës nga vendet përkatëse dhe varësisht nga përparimet e bërë në këtë drejtim Bashkimi Evropian mundet të e dozoj ndihmën e tij për shtetin përkatës. Lidhur me këtë Bashkimi Evropian mundet të shërbehet me të ashtu quajturën „*Direktivë e Kondicionalitetit*“ (Bull. EU 4-1997, Ziff.2.2) e cila më vonë është definuar gjerësisht në nenin 5 të Rregullores (EG Nr. 2666/2000) e cila ndryshe joformalisht njihet edhe si „***politika e karotës dhe shkopot***“. Në bazë të parimit të kondicionalitetit Bashkimi Evropian varësisht nga implementimi i detyrave të shtetit kandidat potencial për anëtarësim mundet të e përdor „karotën ose shkopot“, çka do të thotë se ndihmat financiare mundet të zvogëlohen ose ndërpriten fare kur një shtet anëtar dështon, heziton ose refuzon të implementoj detyrat e veta të përcaktuara gjatë procesit të stabilizim-asocimit, ose anasjelltas përkrahja financiare mundë të rritet kur dëshmojnë përparime dhe përkushtim në këtë aspekt.

III. Zhvillimi i Integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor edhe pse për një periudhë kohore kanë jetuar në një shtet të përbashkët (me përjashtim të Shqipërisë) kanë dallime të mëdha sa i përket rendit shoqëror e kulturor i cili padyshim që është ndikuar nga proceset historike që kanë përcjell këto vende gjatë

historisë. Padyshim ky fakt është reflektuar edhe gjatë zhvillimit të procesit të integritetit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

- **Kroacia** historikisht për dallim nga të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor ishte vendi i demarkacionit të ballafaqimit në mes të kulturave të lindjes dhe perëndimit si për shembull në mes Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungarisë dhe rrjedhimisht që ishte „*shteti më evropian*” nga gjithë të tjerët, gjë që është dëshmuar edhe me anëtarësimin e saj dukshëm më të hershëm nga të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Padyshim se ky anëtarësim do të ishte shumë më i hershëm sikurse Kroacia nuk do të përballej me një luftë të përgjakshme për pavarësi dhe ruajtje të integritetit territorial në fillim të viteve të 90-ta. Bisedimet e anëtarësimit në BE janë definuar me një konsensus të gjerë si një prioritet themelor shtetërorë. Me 21. Shkurt 2003 Kroacia ka bërë kërkesën për anëtarësim të plotë në BE dhe në lidhje me këtë me 18. Qershor 2004 ka marrë zyrtarisht statusin e kandidatit për anëtarësim në BE. Mirëpo bisedimet për anëtarësim kanë filluar tek me 4. Tetor 2005 mbas konstatimit të Kryeprokurores së Tribunalit të Hagës se Kroacia bashkëpunon me plotësisht me Tribunalin, konstatim ky që ishte kusht për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit në BE. Paraprakisht me 1. Shkurt 2005 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kroacisë. Në Qershor të Vitit 2011 Kroacia ka përmbyllur të gjitha bisedimet lidhur me anëtarësimin dhe me 1. Korrik 2013 është bërë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian. Me anëtarësimin e Kroacisë në BE gjuha kroate është bërë një nga 24 gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian. Si shtet anëtar i ri Kroacia është e obliguar që të marrë pjesë në Unionin Valutor Evropian (EURO) kurë t'i plotësoj kushtet e përcaktuara monetare. Me anëtarësimin e Kroacisë Bashkimi Evropian shprehimisht ju ka sinjalizuar vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor se me një vullnet për reformim dhe përqafim të vlerave evropiane anëtarësimi në BE lehtë mund të bëhet realitet.

- **Mali i Zi** është vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor nga Ish-Jugosllavia i cili nuk është prekur drejtpërdrejt nga luftërat ndëretnike në Ish-Jugosllavi, përjashtuar këtu sulmet ajrore të NATO-s. Përkundër këtij fakti nuk mund të thuhet se procesi i integritetit evropian ka kaluar më rrjedhshëm se në vendet tjera, kjo për vetë faktin se Mali i Zi deri në Vitin 2006 ishte pjesë e Jugosllavisë, respektivisht Unionit Serbi – Mal i Zi. Me 15. Dhjetorë të Vitit 2008 Mali i Zi ka bërë kërkesën për anëtarësim në BE. Nga 17. Dhjetori 2010 Mali i Zi është zyrtarisht kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Me 26. Qershor 2012 Këshilli (i Bashkimit Evropian) ka vendosur fillimin e bisedimeve me Malin e Zi për anëtarësim në BE. Paraprakisht në Tetor të 2007 është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me BE e cila mbas ratifikimit ka hyrë në fuqi në Maj të 2010. Në Dhjetor të Vitit 2009 Mali i Zi është pranuar në të ashtu quajturën listë e bardhë e Shengen-it, e cila mundëson lëvizjen pa viza të qytetarëve malazez në BE për qëllime turistike. Në përgjithësi kushtet kryesore (të ashtuquajturat „*benchmarks*”) që janë kërkuar nga ana e BE-së lidhur me implementimin e procesit të anëtarësimit të Malit të Zi në BE kanë të bëjnë lidhur me rendin dhe ligjin, reformat në administratë dhe drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, lirinë e shtypit, mbrojtjen e pakicave nacionale dhe reformimin e ligjit të zgjedhjeve. Në Raportin e Progresit të Tetorit 2013 Komisioni Evropian konfirmon një implementim të mjaftueshëm nga ana e Malit të Zi të kritereve politike dhe ekonomike për anëtarësim mirëpo përmend edhe disa mangësi. Përafërsisht një konstatim të njëjtë e gjejmë edhe tek Raporti i Progresit të Vitit 2014 me një përmirësim të lehtë lidhur me pozitën e Komunitetit romë dhe LTGBI. Për dallim nga vendet tjera nga Ish-Jugosllavia Mali i Zi nuk kishte ndonjë problem lidhur me bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës.

- **Bosnja dhe Hercegovina** si vendi më i përgjakur i Ballkanit Perëndimor nga Luftërat në ish-Jugosllavi ka po ashtu një perspektivë të Integritetit Evropian dhe rrjedhimisht është trajtuar që nga Viti 2000 si një kandidat potencial i aderimit në BE. Bosnja dhe Hercegovina është inkuadruar në Procesin e Stabilizim-Asocimit që nga Nëntori i Vitit 2000 i cili shërben si mjet për afrimin hap mbas hapi të vendeve kandidate drejtë BE-së. Në kuadër të “*Reform Process Monitoring*” (RPM) BE shqyrton që nga Viti 2006 rregullisht rrjedhën e zhvillimit të reformave në vend. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit në mes të BE-së dhe Bosnja e Hercegovinës është nënshkruar me 16 Qershor 2006 mbas një periudhe tri vjeçare të bisedimesh. Në përgjithësi mund të thuhet se problemi kryesor i Bosnjës dhe Hercegovinës sa i përket Integritetit Evropian është i natyrës politike. Diversiteti i

madh etnik dhe ndasitë e krijuara gjatë Luftës në vitet e 90-ta janë sprovë permanente për unitetin e vendit i cili në fakt është arritur të mbahet vetëm në bazë të trytnisë së përhershme ndërkombëtare. Në këtë kontekst në vazhdimësi BE ka kritikuar unitetin e vendit si pasojë e politikave përçarëse të bazuara në baza etnike të politikanëve kryesorë në vend. Krijimi i një kulture politike unifikuese do të jetë parakusht për anëtarësimin e Bosnja dhe Hercegovinës në Bashkimin Evropian, sepse një shkapërderdhje e vendit si duket do të përjashtohet me çdo kusht nga faktorët ndërkombëtar në radhë të parë për shkak të pasojave për Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

- **Serbia** padyshim se është vendi me peshën më të lartë gjeostrategjike për BE-në nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor si një vend trashëgimtar i Ish-Jugosllavisë dhe një vend mik i pansllavizmit rus. Ndërprerja e ndikimit rus apo të pretendimit rus për ndikim në Ballkan në përgjithësi është e mundur vetëm nëpërmjet të anëtarësimit të plotë të Serbisë në BE, natyrisht paraprakisht nëpërmjet të jetësimit të reformave integruuese në këtë vend. Serbia dallon dukshëm nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor për shkak të refuzimit të gjerë shtetërorë për integrim në BE, refuzim ky që në Vitin 2002 përfshinte 68% të qytetarëve në Serbi, ndërsa në Vitin 2012 vetëm 41% (Zahiti, 2013, 196). Kjo rënie padyshim është rezultat i implementimit të reformave integruuese gjatë viteve të fundit në Serbi. Fillimisht Serbia në rrugën e vetë integruuese në BE ishte e ballafaquar me refuzimin absolut për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, refuzim ky që është shfaqur nëpërmjet të fshehjes dhe mosdorëzimit të kërkuarve për Krime të Luftës. Përkundër disponimit të gjerë shoqëror kundër integritimit në BE Qeveria e Serbisë ka filluar bisedimet lidhur me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit që në Vitin 2005, bisedime këto që përfunduan me sukses me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asocimit me 29 Prill 2008 e cili ka hyrë në fuqi tek me 1 Janar 2013. Që nga 19 Dhjetori 2009 Serbia ka hyrë në listën e bardhë të Shengenit, e cila mundëson lëvizjen e lirë të qytetarëve në BE pa viza. Me 22 Dhjetor 2009 Serbia ka bërë kërkesën formale për anëtarësim në BE. Vlerësimi politik për plotësimin e kushteve të anëtarësimit në BE do të varet në radhë të parë nga përmirësimi i marrëdhënieve të Serbisë me Kosovën, i cili duhet të kulmojë me njohjen e Pavarësisë së Kosovës. Kjo kërkesë e mëhershme joformale është duke u parashtruar kohëve të fundit edhe shprehimisht nga faktorët relevant brenda BE-së dhe shteteve anëtare!

- **Maqedonia** përveç problemeve ekonomike dhe juridike në rrugën e vetë drejtë BE-së ballafaqohet me çështjet politike në sferën e jashtme dhe të brendshme. Në sferën e brendshme politike Maqedonia nuk i ka përmbushur në shumë segmente obligimet e dala nga Marrëveshja e Ohrit e që kanë të bëjnë me të drejtat legjitime të Popullit shqiptar, realizimi i të cilave është kusht për ruajtjen e unitetit të këtij vendi. Ndërsa në sferën e jashtme Maqedoni ballafaqohet me problemin e çështjes së emrit, problem i cili deri më tani ka bllokuar anëtarësimin në NATO si pasojë e vetos të Greqisë e cila ka kërcënuar se po ashtu do të bllokojë edhe anëtarësimin në BE nëse nuk rregullohet paraprakisht çështja e emrit. Maqedonia është vend kandidat për anëtarësim që nga Viti 2005.

- **Shqipëria** dallon nga të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor për vetë faktin se nuk ka dalë nga Ish-Jugosllavia dhe rrjedhimisht duke qenë edhe më herët subjekt i drejtës ndërkombëtare në sferën e jashtme politike nuk ballafaqohet me ndonjë problem që do të ishte pengesë për integrimin evropian. Problemet integruuese të Shqipërisë janë kryekëput të brendshme që burojnë nga rendi shoqëror i cili deri tani shumë pak ka dëshmuar aftësi reformuese në kuptimin e integritimit evropian. Populli shqiptar (dhe jo vetëm ai brenda kufijve të Shqipërisë) në raport me të gjithë popujt tjerë të Ballkanit Perëndimor përkrah në shkallën më të lartë Integrimin evropian, ndërsa në realizimin faktik të vlerave evropiane ka ngecjen prej më të lartën në rajon.

- **Kosova** sa i përket çështjes të integritimit evropian është vendi i Ballkanit Perëndimor me raportin më të veçantë (*sui generis*) me Bashkimin Evropian. Para Luftës për çlirim 1998/99 raporti i Bashkimit Evropian, respektivisht i Bashkësisë Evropiane, me Kosovën është definuar nëpërmjet të marrëdhënieve me Jugosllavinë. Ndërsa përfundimi i luftës kishte imponuar një ndryshim rrënjësor të raportit të Bashkimi Evropian ndaj Kosovës për vetë faktin se Kosova tashmë kishte përmirësuar esencialisht pozitën e vet në sferën ndërkombëtare në aspektin gjeostrategjik. Qysh në Qershor të Vitit 1999 në Konferencën e Këshillit Evropian në Köln të Gjermanisë Bashkimi Evropian kishte nënvizuar nevojën e vendosmërisë për të marrë një rol udhëheqës në rindërtimin e Kosovës. Lidhur me këtë disa javë më vonë Komisioni (Evropian) kishte dërguar një Task-

Force (KOM 2005/156) për rindërtimin e Kosovës detyrat e të cilës ishin në radhë të parë krijimi i një institucioni të përkohshëm i cili do të merrej me menaxhimin e ndihmës humanitare. Në këtë mënyrë u krijua një vijueshmëri në mes të ndihmës humanitare emergjente dhe Programit afatgjatë për Zhvillim të Agjencionit Evropian për Rindërtim. Në këtë aspekt Bashkimi Evropian kishte ndarë gjatë vitit 1999 gjithsej 127 milion EUR për të ofruar ndihmën e nevojshme për të garantuar kushtet elementare për jetës para fillimit të dimrit. Më pastaj në shkurt të vitit 2000 ishte themeluar Agjencioni Evropian për Rindërtim („European Agency for Reconstruction”) i cili deri në vitin 2008 kishte menaxhuar programin e Bashkimit Evropian për Zhvillim i cili buronte nga të ashtuquajturit CARDS-Programme („Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation”). Qëllimi i CARDS-Programme ishte që nëpërmjet të ndihmës ekonomike të Bashkimit Evropian vendet e Evropës Lindore të inkuadroheshin ngadalë në procesin e stabilizim-asocimi. Agjencioni Evropian për Rindërtim ka administruar në Kosovë nga viti 2000 deri në 2006 një buxhet prej 1.1 miliardë EUR (Zahiti, 2008, 118). Po ashtu me vendim të Këshillit të Bashkimit Evropian në Vitin 2008 është themeluar *European Union Rule of Law Mission in Kosovo* (EULEX) me qëllim që të përkrah Kosovën në rrugën e sajë drejt integritimeve evropiane (Zahiti, 2008, 201). Përkundër kësaj ndihme nga ana e BE gjendja faktike sa i përket jetësimit të vlerave evropiane në Kosovë lë shumë për të dëshiruar. Në këtë kontekst në raportin e parë të Komisionit (Evropian) për përmbushjen e obligimeve nga Udhërrëfyesi për liberalizim vizash nga ana e Kosovës pos tjerash thuhet se: „Mosluftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar, shkeljet e të drejtave të njeriut, mosimplementimi i ligjeve, si dhe zhvillimet legjislative dhe institucionale në Kosovë, sipas Komisionit Evropian, *përbëjnë rrezik për sigurinë e brendshme të Bashkimit Evropian*, gjegjësisht për heqjen e regjimit të vizave; Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida të mëdha në parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

IV. Rezyme

Kriteret e Kopenhagës janë sfida të përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e integritimit evropian. Varësisht nga e kaluara historike, shoqëroro-politike dhe përkushtimi ndaj çështjes së integritimit në BE, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nivele të ndryshe të arritjes së jetësimit të vlerave evropiane. Padyshim që në këtë mes pozitën më të vështirë e ka Kosova, e cila ballafaqohet me një refuzim të (pesë shteteve anëtare të) BE (dhe Serbisë) për njohje të subjektivitetit ndërkombëtar gjë që është parakusht për hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare qoftë kjo në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-asocimit apo të Marrëveshjes së Aderimit. Kjo pozitë do të ndërroj rrënjësisht tek mbas njohjes së subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës nga ana e (pesë shteteve anëtare të) BE dhe Serbisë.

Literatura

- Bleckmann, Albert*: Europarecht, das Recht der Europäischen Union und der Europäischen Gemeinschaften, 6., neubearbeitete und erweiterte Auflage, Köln-Berlin-Bonn-München 1997. *Piepenschnieder, Melanie*: Das Europäische Parlament – Vom Beratungsorgan zum Mitgestalter, Berlin 2008.
- Oppermann/Classen/Nettesheim*: Europarecht, 5. Auflage, München 2011.
- Lenz/Borchardt*: EU-Verträge Kommentar, 6., Auflage, München 2012.
- Streinz, Rudolf*: Europarecht, 9., Auflage, Heidelberg-München-Landsberg- -Hamburg 2012.
- Streinz, Rudolf (Hrsg.)*: Kommentar zu EUV/EGV, München 2003.
- Zahiti, Bashkim*: E Drejta Evropiane, Botimi i tretë, Prishtinë 2013.
- Zahiti, Bashkim*: Verfassungsrechtliche Entwicklung des Kosova unter Berücksichtigung der EU-Beitrittsperspektive, Graz 2008.
- Ziegenhofer-Pretenthaler, Anita*: Europäische Integrationsgeschichte. Unter Berücksichtigung des österreichischen Weges nach Brüssel. Innsbruck 2004.

CISG-General Principles

Dr. PhD (Uni Graz) Mag. Iur (Uni Graz) Endri Papajorgji
Dean of the law Faculty of Tirana Business University

Abstract

The economic and technological development of the past two decades, has accelerated the exchange relations between states. In this point of view, states have paid particular attention to the standardization of laws around the world, in order to unify and facilitate relations in various fields. A uniform legal environment is thus a key contribution to the improvement of international trade thereby contributing to economic growth. Uniform commercial law, after being approved by the states, has become part of domestic legislation in view of the judicial system but also of any entity interested such as a natural or legal person (Weatherill, 2005, 25). For this reason CISG provides a suitable environment with a complete set of uniform rules in the design and implementation of international sales contracts, thus providing a solid basis for the parties. Tools that are used by states to standardize norms are international agreements, which include conventions. One of them is the Convention on the International Sale of Goods (CISG), which was adopted by an increasing number of countries with different legal traditions and different levels of economic development. In October 2010, the CISG has been ratified by 76 countries, presenting a successful example of uniformity of law on the sale of goods. Clive M. Schmitthoff supported the thesis that the CISG should not only belong to the western countries with a more developed economy. But it should be “a common platform for practitioners of East and West ... facilitating cooperation between capitalist and socialist countries.” (Schmitthoff, 2000,27). The main purpose of this article are the analysis of the general principles of CISG.

Keywords: CISG, Reform, Economy, Law, Principle.

Introduction

Convention on the International sale of goods (CISG) drafted by UNCITRAL (United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods, the United Nations Convention on Contracts of the International Sale of Goods) in Vienna on 11.04.1980 was approved through a diplomatic conference and entered into force on 01.01.1988. CISG is classified as a harmonized international Law, which means that it is ratified by member status, not transformed but it is taken as full-text and has direct effect.

This Convention does not refer to conflicting rules, but for fair sale-purchase materials. Concretely this means that in all countries which are member states that have ratified the CISG, the same rules apply to the content of the international sale of goods. In this way CISG has achieved due to a very large number of members a historical reconciliation of international trade rules. It is the most important example of approximated law (harmonized).

At the present time, 72 states have ratified and two others have signed this agreement, but not yet ratified it. Albania has signed the Convention, which entered into force on 01.06.2010. Among the member states that have ratified CISG the most powerful economic countries are: China, Germany, Japan, Canada, Russia and the USA. Among the important economies, which have not yet ratified the convention are Brazil and UK (Papajorgji, 2013, 27).

2. General principles of CISG

The Unification of international law is a difficult and long process, because not all issues can be taken into consideration during the drafting of the Convention. This can happen due to the complexity of the case, different economic systems, different legal structures or different policy backgrounds. Analysed in this perspective, the importance of general principles lies in the need to fill “gaps” which are caused by the inability to forecast every possible conflict situation. The terminology used has a

crucial importance for the uniform interpretation and application of the Convention. Among the most important principles I would mention:

- The autonomy of parties

The most important general principle is the autonomy of the parties, prescribed in Article 6 of CISG. The principle of autonomy of the parties is widely known in the doctrine and the jurisprudence of the courts. According to this principle, the parties are free to choose the law applicable to the contract. The Convention does not specify clearly the method by which the contracting parties can determine the law applicable to adjust their contractual relations. Due to the ambiguous wording of Article 6, a debate has arisen regarding the exclusion of the application of the Convention in two directions: if implicitly excluded or explicitly excluded.

According to the first group, CISG as a uniform set of rules, allows the exclusion of the implementation of the Convention only if this clause is clearly expressed (Murphy, 2010, 525). The first argument given by the members of this group is that the only exception to the application of the Convention, expressed in clear form, can guarantee uniform application of the CISG and, therefore assure the success of the Convention (Micklitz, 2009, 235).

The second argument in favor of the exclusion stems from Article 7 of the Convention, according to which issues relating to the matters governed by this Convention which are not expressly settled in it must be in accordance with the general principles. Some authors support the exclusion explicitly, only for pragmatic reasons (Enderlein & Maskow, 2003, 23). According to them, the expressed exclusion of the application of the Convention will give greater security to the contracting parties.

According to the second group, the exclusion of the implementation of the Convention implicitly relies on these arguments (Murphy, 2010, 554):

The first argument derives from the strict interpretation of Article 6, under which, if the drafters of the Convention would have had to allow only the exception explicitly expressed, would have drafted the text of this article otherwise, including in it an indisputable manner in which they should be the exception and that the choice of law. Because such a specification has not entered into force, then the Convention leaves space for the application of the exemption implicitly expressed.

According to the second group, the exclusion of the implementation of the Convention implicitly relies on these arguments:

Because such a specification is not in force, the Convention allows for the application of the exemption expressed implicitly (implicit exclusion).

The second argument in favor of the implied exclusion is based on the practice of international trade, which also confirms the possibility of excluding the application of the Convention expressly or implicitly (Murphy, 2010, 554).

The main purpose of the principle of the autonomy of the parties, is not the exclusion of the application of the Convention, but the free exercise of freedom of contracting parties to choose the law applicable to their contractual relationships. In this regard, what is important is the degree of freedom of choice of the contracting parties.

- Adhering to the principle of mutual trust

Adhering to the principle of mutual trust is one of the general principles of the Convention, including Article 7 of the first paragraph: "In the interpretation of this Convention, attention should be paid to its international character and the need to promote standardization in its application and the observance of good faith in international trade". Other aspects of this principle are: Prohibition of inconsistent behavior (*venire contra proprium factum*), the obligation to cooperate and the obligation to provide all information necessary for the execution of the contract. CISG presents some rules to specify what we mean good faith in certain situations and constitutes more specific regulation, concentrating on a single type of contract.

Personally I think that respecting confidentiality is a very important principle and plays an essential role in the contractual security of parties. This principle is a commercial habit which has its origins from the *lex mercatoria*. In my view, the respect of confidentiality, is considered more as an internal

moral obligation, rather than as a principle of internal good faith.

- “The preservance” of contract

One of the most popular general principles, which derives from several articles of the Convention is the “preservance” of contract (favor contractus). The setting of these pre-conditions is explained by the fact to avoid high costs resulting from transportation of goods due to the cancellation of the contract. The seller can avoid these costs by selling goods at the buyer’s country, but it only causes various problems such as storage costs until delivery or the problem to find a different buyer in countries that do not have a developed commercial network (Papajorgji, 2012, 44).

- Freedom of contract form

According to Article 11 of the Convention: “A sales contract doesn t need to be concluded or evidenced by writing and is not subject to any other requirement as to form. It can be proved by any means, including witnesses”. Moreover, Article 29 (1) CISG provides that the contract may be modified or terminated only by agreement of the parties. This general principle can be limited only by Article 12 CISG. For this reason a cancellation statement, a statement of the price reduction, a notice of lack of conformity and other types of statements or reports do not need to follow any form.

The obligations of the seller as of the CISG

CISG contains a set of rules that govern the obligations of the seller (Article 30 CISG). The main obligation of the seller is, the delivery of the item, the delivery of documents transferring the ownership of the property. If in the sales contract the place of bid is not defined, then Article 31 CISG contains subsidiary rules. Ther rules for the delivery timare regulated in Article 33 CISG. However, it comes to the determined time specified in the contract. If the contract provides a timeline, then the item should be delivered within this timeframe. In the event that there is no timeframe or space limits, then the item should be delivered within a time considered appropriate. The accuracy of the item bid in terms of quantity, quality, type and packaging or content, should be made based on the contract of sale and purchase. If the agreemenets are not approved, then Article 35 para. 2 CISG stipulates that the goods are determined basen on the contract when:

- It will be used for purposes or goods of the same type (point a).
- It will be used for a specific purpose, which would be known by the seller (item b)
- Corresponds to a test or sample
- It is the properly packaged in the same form specified in the contract.

The seller is responsible for the irregularity of goods, while the risk passes to the buyer after delivery and inspection of goods. The seller must deliver the goods under Article 41 CISG, to which third parties do not have any right or claim.

Article 38 of the CISG provides that the buyer must inspect the goods within a specified time, in order to check the validity of the offer (obligacion of control). In case the buyer decides that the goods are not in the same form as defined in the contract, then seller should specify it before the ending of the deadline, and also the deficiencies. In case the buyer within a 2 years term does not know the deficiency, then he can not ask for the fulfilling of the contract. These obligations do not exist, if the seller knew or should have not recognized the violation of the contract.

In case of breach of contract by the seller, the buyer has a list of legal instruments. These legal instruments are set out in Articles 46-52 CISG, while compensation is defined in Articles 74-77 CISG. At the same time, you should consider whether the breach is too “important” to the other party under Article 25 CISG.

Under this rule, there is a “significant” contractual violation, if it causes a disadvantage to the other party, that it does not fulfill what was stipulated in the contract.

At the same time the buyer may require to the seller the completion (fullfillment) of the contract.

Delivery of another item may be required only in cases where it exists a significant breach of contract under Article 25 CISG. Overall, the buyer may require from the seller subsequent improvement, as long as it is reasonable. In this case, the sellers sets a deadline justifiable under Article 47 para. 1 CISG.

In the case of a significant breach of contract, the buyer may request termination of the contract. This happens in case of non-delivery of the item, even if the seller after an additional period of time has not delivered the property. In case of non-delivery by the seller of the property under contract, Article 50 CISG provides that the buyer may reduce the price.

In addition to remedies under Article 46 the buyer in the event of contract failure, may seek damages. "As compensation for breach of contract by one party, including the estimated profit loss caused not fulfillment of the obligations".

The obligations of the buyer under the CISG

Article 53 of the CISG defines the obligations of the buyer. The main task of the buyer is to pay for the goods and take it over. In the event that a valid contract and real estate price does not contain a written or mentioned price, then the buyer must pay the price "that must be paid upon signing of the contract for such items." In the event of the failure of the payment of the contractual price, the buyer shall pay the price at the headquarters of the seller. In case of agreement, which stipulates that the purchase price will be paid against the award of an item or document set, then the place of payment is the place where the item will be delivered.

Article 61 CISG provides that the seller in the event of a breach of contract from the buyer, it can use legal instruments to Articles 62 and 65 CISG, as well as compensation (articles 74 to 77 CISG). Generally the seller may require from the buyer the payment and receipt of the item price, thus fulfilling the contract. He must also decide on a subsequent deadline for the completion of tasks justified under Article 63 para. 1 CISG.

Seller may declare the termination of the contract, as long as the buyer has committed an important breach of the contract under Article 25 CISG. Also he can be breach the contract, if the buyer does not complete the contract within a specified period.

At the same time there is the possibility for the seller, to claim damages from the buyer in the event of a delayed payment of the price.

Conclusions

Uniform law means common interpretation in various legal systems that have adopted the convention and have made it part of their intrnal legal system. The main objective of an international convention is the unification of legal rules in different states. Although, even when external uniformity is achieved after the adoption of a text, the uniform application of the rules adopted is in no way guaranteed, and in practice different countries inevitably interpret differently the same question.

CISG is an important legal document, because it creates a uniform code of legal rules governing the formation of contracts for the international sale of goods, the obligations of the buyer and seller, remedies in case of breach of contract, and other aspects of the contract. As stated in its preamble, CISG was created "for the removal of legal barriers in international trade and promote the development of international trade." To meet the objectives of the Convention, it is essential that its provisions be interpreted properly. CISG is a uniform law for buyers and sellers, who come from different legal cultures, to establish the basic rules and principles. Uniformity in the application of the Convention, however, is not guaranteed. The approval or ratification of the Convention by various sovereign states is only a necessary preliminary step toward the ultimate goal of unifying the law on the international sale of goods. If on the contrary, national courts and national laws interpret

the text of the Convention solely as a single unit, then this Convention will not last.

Personally I think that the success of a uniform codification of the law that aims to connect party transactions worldwide, depends on creating an international community of people who regard themselves as bound together and governed by a legal system and choose common ways on issues of verification and continuous development

This achievement is the creation of an “international community,” a sort of international legal consensus, considered by some as the real fundamental key of CISG and its ultimate triumph or otherwise its failure.

References

Enderlein & Maskow, (2003), *International Sales Law*, London.

Micklitz, H.-W. (2009), The Targeted Full Harmonisation Approach: Looking Behind the Curtain, in: *Geraint Howells/Reiner Schulze (ed.), Modernising and Harmonising Consumer Contract Law*.

Murphy, C. (2010), Changing Contract Practices in the Light of the United Nations Convention: A Guide for Practitioners, *Journal of International Law and Policy* p..525–554.

Papajorgji, E. (2012), *E drejta ndërkombëtare tregtare dhe e biznesit*. Tiranë.

Papajorgji, E. (2013), *Privatisierung von Unternehmen in Albanien und Mazedonien im Rechtsvergleich*. Saarbrücken.

Schmitthoff M.C (2000), *The Unification of the Law of International Trade*” *American Journal of Comparative Law*, London.

Weatherill, S. (2005), *EU Consumer Law and Policy*, Cheltenham.
Convention on the International Sale of Goods.

Një vështrim panoramik i personave me problem të shëndetit mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

Dr. Eglantina Dervishi
Departamenti i Psikologjisë, Albanian University, Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Ky studim synon të japë një tablo mbi personat me probleme të shëndetit mendor të cilat popullojnë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Shqipëri. Të dënuarit hasin një sër vështirësishë në përshtatjen me kushtet e izolimit, dhe rregullat e reja, duke shkaktuar një diskonfort psikologjik dhe nxitjen e kushteve për zhvillimin e problemeve me natyrë psiko-fizike (Smyth, Dorer, 2011, 323). Në të njëjtat kushte ndodhen edhe personat me probleme të shëndetit mendor të cilët janë pjesë e këtyre institucioneve.

Metoda. Me qëllim që të kishim një panoramë të plotë dhe gjithëpërfshirëse për sa i përket çrregullimeve që hasen më shpesh në popullatën e personave të privuar nga liria, jemi bazuar në statistikat të marra nga Qendra Spitalore e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë, duke përfshirë periudhën kohore 2010-2014.

Rezultatet: Në mungesën e një fushate gjithëpërfshirëse për evidentimin e problematikave të shëndetit mendor tek të dënuarit që popullojnë sot sistemin e burgjeve rezultojnë që numri i personave me probleme të shëndetit mendor është i konsiderueshëm, gjithashtu që një pjesë e tyre janë të përfshirë në vepra penale me rrezikshmëri të lartë si vrasjet brenda familjes dhe vrasje. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Shqipëri kanë mjaft probleme për sa i përket mënyrës së trajtimit dhe kushteve të jetesës së personave me probleme të shëndetit mendor. Diagnozot dominuese nisur nga vlersimet psikiatrike për një pjesë të rasteve të cilat i janë nënshtruar një trajtimi psikiatrik paraqiten me predominim të skizofrenisë dhe të çrregullimeve të personalitetit.

Fjalë çelës: probleme të shëndetit mendor, diagnozë psikiatrike, të dënuar, institucione të ekzekutimit të vendimit penal.

Hyrje

Sot flitet për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale si mjedise që synojnë të korrektojnë sjelljen problematike të personave që nuk respektojnë rregullat dhe ligjet e shoqërisë. Gjithnjë e më tepër në kushtet aktuale në vendin tonë po kërkohen që të dënuarit që popullojnë burgjet të trajtohen me dinjtet njerëzor dhe duke respektuar të drejtat e tyre. Këto të drejta janë prioritare edhe në rastet e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, ku trajtimi i tyre sipas standarteve ndërkombëtare vazhdon të jetë një sfidë jo vetëm për vendin tonë por edhe për shumë vende të Evropës perëndimore. Këto vitet e fundit janë realizuar ndryshime rrënjësore në drejtim të reformave të infrastrukturës psiko-sociale, ekonomike dhe mjeko-ligjore në përmirësimin e kushteteve të institucioneve të paraburgimit dhe bugjeve.

Pavarsisht kushteve në përmirësim të vazhdueshëm këto institucione në vetvete krijojnë kushte që tek individit të lindin dhe të zhvillohen një sër problemesh psikologjike si rezultat i izolimit (Secker, Loughran, Hejdinrych, Kent, 2011, 51). Jeta e të dënuarve në burg ndryshon në shumë drejtime:

- ngritja me orare në mëngjes sjell për një farë kohe nervozizëm dhe një gjendje fizike jo të mirë si këputje e përgjumje (Saraceno, Dua, 2009, 259).
- orari i konsumit të vakteve ndryshon nga ai që ka patur më parë, këto sjellin në disa raste shqetësime në stomak dhe nervozizëm të lehtë (Van Ginneken et al., 2013, 149).
- ritmi dhe mënyra e takimeve me familjarët, sipas grafikut sjellin pasiguri, mall.
- pamundësia për të takuar lirshëm miqtë që kanë përzemër sjell ndjenja turpi, pasigurie për të ardhmen që shoqërohen me nervozizëm dhe agresivitet ose me mbyllje në vetvete.
- mungesa e pavarisë për të organizuar aktivitete me ata që dëshirojnë dhe në ambjentin që dëshirojnë sjell tek të dënuarit agresivitet në rritje, ky i shprehur ndaj vetes ose ndaj të tjerëve.
- pasiguria e theksuar se çfarë do të bëhet më tej me të, sjell humbjen e shpresës (Breuer,

2014, 15) se do të lirohen, do kthehen pranë familjes një ditë, duke çuar edhe në një rezistencë të vet të dënuarve për tu adaptuar me kushtet e burgut.

- mungesa e familjarizimit dhe njohurive mbi ambientin dhe komunitetin e burgut, rregullat e pashkruara e të shkruara, sjellin ankth dhe stres.

Lind pyetja në çmënyrë do të realizohet përshtatja e të dënuarve me problem të shëndetit mendor në këto institucione, kur edhe personat pa probleme shfaqin probleme psikologjike si rezultat i ndryshimit të stilit të tyre të jetesës?

Metodologjia

Ky studimi është realizuar duke iu referuar të dhënave statistikore të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe nga Qendra Spitalore e Burgjeve. Këto të dhëna përfshirjnë statistika numerike të personave që janë evidentuar me shqetësime në sjellje për të cilat është ndërmarrë një trajtim psikiatrik. Këto evidenca statistikore nuk u morën për të gjitha institucionet nën varësi të drejtorisë së përgjithshme të burgjeve por për një pjesë të tyre, për të cilat disponoheshin të dhëna. Kjo mungesë e evidencave gjithëpërfshirëse mund të konsiderohen si një e metë e këtij studimi e cila nuk të jep mundësinë e përgjithsimit të këtyre rezultateve. Megjithatë kjo është një përpjekje për të dhënë një pasqymir të pjesshëm të situatës në përgjithësi. Një tjetër element që vlen të merret në konsideratë lidhet me faktin se diagnozat e përcaktuara janë vendosur nga mjeku psikiatër dhe më pas i janë nënshtruar një trajtimi me medikamente.

Rezultatet

Sipas një raporti të 2003 të Human Rights Watch në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbi 70.000 të dënuar në vëndet e vuajtjes së dënimit janë të diagnostikuar si psikotik dhe çerek milionë vuajnë nga çrregullime mendore të tilla si skizofreni, çrregullimi bipolar, depresion madhor etj. Në burgjet tona popullata e personave me problem të shëndetit mendor është 3 herë më e lartë se ajo që trajtohet në spitalet psikiatrike civile. Duke iu referuar të dhënave statistikore të marra nga disa burgje e paraburgime vihet re (shih tab.1) një predominancë e lartë e çrregullimeve psikologjike, prezente tek të burgosurit dhe të paraburgosurit. Një tjerët kategori vuajnë nga çrregullime të rënda psikiatrike. Të dhënat e mëposhtme janë referuar nga statistikat në rregjistra të stafit mjekësorë të këtyre institucioneve, por sigurisht ne besojmë që numri i tyre do të ishte më i madh nëse do të ishte ndërmarrë ndonjë fushatë mbi depistimin e personave me probleme të shëndetit mendor që popullojnë sot burgjet tona.

Tabela 1. Numri i të dënuarve më problem të shëndetit mendor në disa Burgje

Burgjet	Krujë	Lezhë	Peqin	Tepelenë	Burrel	Vaqar	Lushnjë	Tiranë
Diagnoza	nr 44	17	42	3	15	6	10	21
Skizofreni	25%	11,7%	21,4%	33%	13%	-	-	-
1. Çrreg skizoafektiv	4,5%	5,8%	-	13%	-	10%	9,5%	
2. Çrreg deluzional	13,5%	17,6%	-	13%	-	9,5%		
3. Çrreg personalitetit	25%	17,6%	-	13%	-	28,5%		
4. Çrreg afektive/								
bipolare psikotike	16%	11,7%	64%	33%	-	-	10%	9,5%
5. Çrreg depressive/								
6. bipolare	11%	11,7%	-	26,6%	50%	40%	23,7%	
7. Neurozë	4,5%	23,5%	-	33%	-	16,6%	30%	
8. Epilepsi	-	-	14%	-	33,3%	-	-	
9. Çrregullime ankizioze	-	-	-	-	13%	-	10%	28,5%
10. Pseudodemencë reaktive	-	-	-	-	6,6%	-	-	

Të dhëna të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Ajo afarë duket qartë dhe nga të dhënat, është një predominancë e gjëndjeve të humorit, ku 50% e të

dënuarve shfaqin crregullimin depresiv/bipolar, në nivele të konsiderueshme janë edhe kategoria e epilepsisë dhe neurazave ku përfshihen crregullimet e ankthit. Një vëmendje të vecantë duhet ti kushtojmë edhe pranisë së crregullimit të skizofrenisë e cila ka dhe përqindjen më të lartë në një pjesë të burgjeve në vend. Sigurisht që një situatë e tillë parashtron nevojën për vëmendje të vecantë ndaj të dënuarve përsa i përket përmirësimit të kushteve që lidhen me konfortin psikologjik.

Tabela 2. Numri i të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në paraburgime

Gjithsej 14 pacientë		Tiranë	Vlorë
Diagnoza		nr %	nr %
1.	Prapambetje mendore	1 - 7%	1 - 7%
2.	Çrregullime te personalitetit	1 - 7%	-
3.	Çrregullime depresive	3 - 21,4%	1 - 7%
4.	Çrregullime të ankthit	1 - 7%	1 - 7%
5.	Çrregullime psikotike	3 - 21,4%	2 - 14%

Të dhëna të marra nga D.P.Burgjeve

Në këtë aspekt është e rëndësishme që sektori mjeksor dhe ai psiko-socila të bashkëpunojnë sëbashku për të lehtësuar nivelin e përjetimit emocional të simptomave problematike dhe të realizuar në mënyrë të plotë procesin rehabilitues (Jacob KS et al., 2007).


Tabela 3. Numri i pacientëve me probleme të shëndetit mendore në Qendrën Spitalore të Burgjeve

Gjithsej 71 pacientë	Gjithsej 14 pacientë me	
	me M-D	shtrim të përkohshëm
Diagnoza	Nr %	Nr %
1.	Skizofreni	3 - 21,4%
2.	Çrreg skizoafektiv	3 - 21,4 %
3.	Çrreg deluzional	1 - 7%
4.	Çrreg afektiv/ bipolar psikotik	1 - 7%
5.	Çrreg personalitetit	1 - 7%
6.	Prapambetje mendore	6 - 42,8%
7.	ÇSPT	1 - 7%

Të dhëna të marra nga Q.S.Burgjeve

Shumëllojshmëria është një parim që ka marrë rëndësi të veçantë në jetën e sotme. Shumëllojshmëria kulturore, gjinore, moshore, gjuhësore, metodologjike, teknologjike, organizative zhvillon fleksibilitetin, rrit kapacitetet për ndryshim. Shumëllojshmëria mundëson baraspeshën, krijimtarinë, gjerësinë dhe thellësinë. Këndvështrimet e ndryshme nxisin eksplorimin e pikëpamjeve të ndryshme dhe të menduarit divergjent zhvillon dialogun real. Shumëllojshmëria ka një ndikim pozitiv në kapacitetin për të nxënë dhe për të ndryshuar sipas nevojave të situatës. Institucionet që nxisin shumëllojshmërinë mbështetin në fakt vetaktualizimin e anëtarëve të vet. Shumëllojshmëria e mban sistemin dinamik fleksibël dhe koherent. Zbatimi i këtij parimi në arsimin parauniversitar nënkupton praninë dhe ndikimin e shumëllojshmërisë në nivel institucioni dhe individ, burimesh, procesesh, strukturash, programesh, metodologjish, teknologjish, produktesh, rezultatesh.

Zhvillimi

Parimi i zhvillimit nënkupton se duhet të krijohen kushtet që të zhvillohen potencialet e sistemit dhe të individëve. Duke qenë se arsimi parauniversitar është masiv, i normuar dhe tenton të bëhet deri në moshën 18 vjeç i detyruar ka një rëndësi të pazëvendësueshme për zhvillimin kulturor, shoqëror dhe ekonomik të vendit, kërkohet që të arrihet një zhvillim i balancuar i burimeve materiale dhe njerëzore. Mjafton t'i referohemi Majkëll Fullanit, Dekan i fakultetit të edukimit në Universitetin e Torontos në librin e tij prestigjioz "*Kuptimi i ri i ndryshimit në Arsim*"³ dhe argumentetve që ai parashtron për të kuptuar se nga Parimi i zhvillimit në menaxhimin e arsimit është themelor për arritjen e cilësisë.

Cilësia

Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave edhe të pritshmërive të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Përcaktimi i këtyre pritshmërive dhe idealeve do të ndryshojë nga konteksti në kontekst, varësisht nga qëllimet e vëna. Zbatimi i parimit të cilësisë kërkon shërbimet e vlerësimit dhe të akreditimit duke synuar përmirësimin, ndryshimin dhe përparimin. Duke dashur ta trajtoj pak më jatë këtë parim thelbësor për temën që trajtojmë na duhet të theksojmë se megjithëse kuptimi i cilësisë ka rëndësi për çdo njeri, nuk ka një përkufizim përfundimtar botëror, përkufizimi është i vështirë dhe kërkon përpjekje të vazhdueshme. Sipas Deming "*Cilësia është kënaqësia e nevojave të klientit*" "Kënaqshmëria e klientit mund të shprehet nga "*Kënaqësia e çastit dhe nga pritshmëria*." I pari që përcaktoi përkufizimin e cilësisë ishte *Walter Shewhart (1931)* duke thënë se *cilësia është se sa i mirë është një produkt*. Me këtë kuptim, "cilësia është e njohur në gjithë botën, cilësia nuk mund të ketë një përkufizim përfundimtar por ajo është e domosdoshme dhe e

³Majkëll Fullan, "*Kuptimi i ri i ndryshimit në Arsim*"CDE, botimi i 3-të, Tiranë 2001, fq. 408

pranishme kudo. Sipas Buhner, “...kërkesat e klientit vendosin për cilësinë e produktit” Dhe klientët tanë janë nxënësit dhe prindërit e tyre, nëse ata janë të pakënaqur nga produkti shkollor, kjo do të thotë se cilësia e produktit lë për të dëshiruar. Po marrim një rsat. Nga nxënësit e shkollave “Hasan Tahsini” (gjimnaz i përgjithshëm) dhe “Antoni Athanas” (profili ekonomike dhe të hoteleri turizëm) të viteve 93-99 rreth 80% e nxënësve vazhduan arsimin e lartë. Nga këta rreth 27 ekonomistë me bazë arsimin tonë të mesëm profesional punojnë në banka, këtu në Sarandë, ndërsa disa të tjerë punojnë në recepsione hotelesh apo punë të tjera hoteliere. Kjo do të thotë se produkti arsimor ishte mjaft i mirë. Prurjet e sotme të kësaj shkolle janë në rënie për shkak të rënies së cilësisë së kontigjentit të nxënësve që frekuentojnë shkollën, por edhe për neglizhencat manexhariale të stafit pedagogjik dhe drejtues.

Efektshmëria dhe eficientia

Këto parime janë të një rëndësie të veçantë. Një sistem ose institucion i efektshëm funksionon në një mënyrë të tillë që çon drejt realizimit të rezultateve ose objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që gjërat të bëhen sipas një skeme të parashikuar. Një sistem ose institucion quhet eficient kur ai funksionon dhe punon mirë dhe siguron rezultate të mira me kosto të pranueshme për shoqërinë. Ai i bën gjërat në mënyrë korrekte dhe i përdor burimet njerëzore, materiale dhe mjetet në mënyrë optimale. Ky është një parim që ka pas vetes një kosto financiare e cila ndodh të përdoret pa mend apo të shpërdorohet. Ngritja e shkollave të mëdha në qendra banimi pa perspektivë zhvillimi, në ven të përdorimit të burimeve atje ku ak ardhmëri të dukshme do të ishte e domosdoshme.

Liria pedagogjike dhe autonomia institucionale

Parimi i lirisë pedagogjike dhe i autonomisë institucionale janë sa të lidhura aq edhe të veçanta. Liria pedagogjike nënkupton lirinë e renditjes së temave lëndore, të zgjedhjes së modeleve, metodave dhe teknologjive mësimore, përfshi edhe mjedisin brenda ose jashtë klasës; por ajo nënkupton edhe mungesën e ndërhyrjes nga jashtë, të censurës dhe të barrierave në praktikën e veprimtarisë shkollore, brenda dhe jashtë orës së mësimin. Ajo vështrohet si një parakusht për mendimin kritik, eksperimental dhe krijues si dhe për avancimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual. Autonomia institucionale i referohet shkallës së vetërregullimit dhe të pavarësisë administrative për përbushjen e detyrave pedagogjike dhe arsimore.

Përgjegjshmëria publike

Parimi i përgjegjshmërisë publike për mësuesit dhe drejtuesit e arsimit në aspektin menaxherial, por dhe në gjerë nuk qëndron vetëm në marrjen e vendimeve dhe në shpenzimin e fondeve, por edhe në cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe cilësinë e produktit substancial që del nga shkolla për të hyrë në universitet apo sistemuar në punë. Dhe më tepër se kaq është parimi që e lidh përgjegjshmërinë arsimore edhe me anën tjetër të rëndësishme të saj, me cilësinë e dukimit të vlerave atdhetare, qytetare, demokratike dhe humane. Ky parim kërkon që individët ose institucionet duhet të demonstrojnë veprime të përgjegjshme kundrejt publikut. Së dyti, ai kërkon që individët ose institucionet që marrin fonde publike duhet të raportojnë se si dhe sa mirë i kanë shpenzuar fondet. Arsimi synon të mbështet në këto parime dhe do t'i mbajë parasysht ato në menaxhimin e cilësisë së arrijve shkollore, në zbatimin e reformës dhe në vlerësimin e progresit. *Arsimi i mirë*, theksojnë specialistët tanë të arsimit, *nuk ka të bëjë vetëm me inputet fizike, si klasat, mësuesit dhe tekstet mësimore, por edhe me stimujt që çojnë tek një mësimdhënie sa më të mirë. Por, nisur nga nevojat e jashtëzakonshme për kapacitete menaxheriale, teknike dhe financiare të shtetit, si shërbim, arsimi është mjaft kompleks për të qenë efektiv nëse mbetet i organizuar në mënyrë qendrore. Ndërsa vendimmarrja lokale dhe decentralizimi fiskal mund të kenë efekte pozitive në rezultatet e shkollës, testimet, provimet e lirisë dhe maturës, duke i bërë shkollat të përgjegjshme për rezultatet që prodhojnë.* Ndaj gjithmonë kur flitet për shkollën dhe komunitetin si dy sisteme të ndërvarura thuhet se pjekuria e qytetarit nuk mund të paramendohet të arrijë stade të dëshirueshme zhvillimi nëse shoqëria nuk krijon kushte dhe favorizime për shkollën. Shkolla kurrë nuk do të jetë në gjendje të prodhojë qytetarë të ditur nëse nuk ka mbështetje, përkrahje dhe stimulohet shoqëria Vetëm kështu *Shkolla cilësore* do të jetë në gjendje që të minimizojë pengesat, çorganizimin dhe në anën tjetër të rritë efikasitetin në shumë

fusha veprimi. Shkolla cilësore minimizon pengesat si: papunësinë, korrupsionin, krimin, trafikimin e dukuri tjera negative. Shkolla është përfshirëse, cilësore, lëvizëse etj., për aq kohë sa ecën përpara. Është naive të mendosh se shkolla mund të arrijë cakun dhe po aq naive është të mendosh se shkolla nuk mund të ec. Krejtësisht varët nga shoqëria, sa është e organizuar ajo, që t'i bëj të mundur shkollës që të ec përpara, drejt cakut imagjinar, sfidues, kurrë të arritshëm. Udhëtimi drejt atij caku edhe pse është një sfidë, ndaj shkolla nuk duhet të pushojë së ecuri duke kërkuar në vazhdimësi ide e praktika bashkëkohore dhe për të ndodhur kjo është shumë i nevojshëm partneriteti. Partneriteti u ofron shkollave një proces përkrahës të vetë shqyrtimit dhe të zhvillimit, që del nga këndvështrimet e punëtorëve të arsimit, nxënësve, prindërve apo kujdestarëve, si dhe të anëtarëve tjerë të bashkësive përreth. Partneriteti stimulon për ecje përpara. Partneriteti është jeta dhe shpirti i shkollës.

Përfundime

Arsimi është koherent, pra proces në ndryshim të përhershëm, që dikton nevojën për vlerësimin dhe matjen e cilësisë së standarteve të tyre. Në thelb e gjithë kjo duhet të bazohet në parimet e menaxhimit të cilësisë, për të pasur rezultate të frytshme dhe sukses.

Parimet bazë të menaxhimit të cilësisë në sistemin arsimor parauniversitar, si: paaënësia, demokratizimi, barazia, shumëllojshmëria, zhvillimi, cilësia, efektshmëria dhe efienca, liria pedagogjike, autonomia institucionale dhe përgjegjshmëria publike kanë kuptimësi polivalente.

Prioriteti i një parimi në raport me të tjerët varet nga rasti konkret, nga shkolla dhe popullata e saj, nga prioritetet qeverisëse dhe dëshirat e komunitetit që përbën klientelën e shkollës. Vetë fleksibiliteti i brendshëm i çdo parimi e bën atë parësor, ndaj duhen mbajtur qëndrime të hapura ndaj ndryshimit.

Por fleksibiliteti lind variacionin, ndaj duhet të mbajmë parasysh se Edëards Deming *ka vërejtur se të gjitha proceset janë të rrezikuara nga humbja e cilësië përmes variacionit; prandaj menaxhmenti duhet të jetë i vetëdijshëm për këto dhe t'i menaxhojë nivelet e mundshme të variacionit në mënyrë që ato të zvogëlohen dhe të rritet cilësia*. Ai rekomandoi një qasje të thjeshtë por praktike të kontrollit të cilësië të njohura si cikli i menaxhimit të: planifikimit, implementimit, kontrollit dhe veprimit.

Cilësia përbën shenjëzimin e kahershëm, të derisotëm dhe të ardhmen e arsimit. Po ashtu ajo përfaqëson dhe investimin dhe projektin më të rëndësishëm të së tashmes dhe së ardhmes arsimore. Cilësia e shkollës dhe e arsimit në shoqërinë e sotme globale të dijës, e cila mbështetet në disa shtylla kryesore, si: demokracia, drejtësia, toleranca, mobiliteti dhe barazia, natyryshment mbart përgjegjësi dhe sfida për të gjithë punëtorët e arsimit. Cilësia në arsim është një nocion kompleks, i cili është i lidhur para së gjithash me cilësinë e produktit arsimor, por gjithnjë e më tej me cilësinë e qytetarit aktiv, që dijet e nxëna i investon në dobi të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Bibliografia

- 1.“Administrimi & Menaxhimi i Arsimit” Instituti i studimeve pedagogjike, Nr,5, Tiranë, 2003, f,44.
- 2 .Burt Nanus, Visionary Leadership-Lidershipa vizionare fq. 27
3. Gardner, H., “Mendja e disiplinuar “ ISP , TIRANË 2003., fq. 235, 236, 237, 238, 239, 243-248.
4. Gentiana Zagoridha: REFORMAT NË ARSIMIN SHQIPTAR ... - Dituria) E hanë, 15 Gusht 2011 16:07
- 5.<http://www.yllpress.com/17222/menaxhimi-ne-baze-shkolle-po-perfshin-edhe-shqiperine.html>
- 6.IKT, Mësuesi dhe cilësia e arsimit sfidë globale e shekullit XXI, Tiranë 2009
- 7.James E. Means, Leadership in Christian Ministry-Lidershipi në shërbesën e Krishterë, fq.32
- 8.Kurrikulat, bazat, parimet dhe problemet, ISP, Tiranë 2003, fq,396
- 9.Majkëll Fullan, “Kuptimi i ri i ndryshimit në Arsim”CDE, botimi i 3-të, Tiranë 2001, fq. 408
- 10.MASH . Strategjia Kombetare e Arsimit 2004-2015
- 11.MASH, P.Vladimir, Revista Mësuesi, nr .6.Qershor 2011. Fq.23-24
- 12.MASH. Udhëzues për Kurrikulën e re të gjimnazit. IZHA. Tiranë Dhjetor 2010. Fq.11,12
- 13.Max De Pre, Leadership is an Art-Udhëheqja është Art. Fq. 11
14. Mina , 1986:82
- 15.Ministria_ E_ Arsimit_ Strategjia_e_ Al pdf, fq-15-17
- 16.Myqerem Tafaj ,Plani i integruar i Ministrise 2010
- 17.Panariti, S.. “Manaxhimi i operacioneve” Botimi 3-të, UT, ADELPRINT sh.p.k. Tiranë 2008, fq, 322
- 18.Prof .dr. Adrian Civici . Arsimi perballe sfidave të zhvillimit.
- 19.Prof.ass.Dr. Baki KOLECI Prof.ass.Dr. Fetah REÇICAMr.sc. Neritan TURKESHI 20.(Bazat e menaxhimit) Prishtinë 2008 f.22
- 21.QTKA,” Mësimdhënia me në qëndër nxënësin”, I,Tiranë Dhjetor 2005, fq,9,10,
- 22.Revista Mësuesi nr, 8. Tetor, 2010 P, Elisabeta . fq, 12-13-14
- 23.Revista pedagogjike 2012, IZHA. F.98
- 24.Rustemi,J., Drejtuesi si lider shkollor, “M&O,Instituti i studimeve pedagogjike, nr 4, Tiranë,2003, fq,80
- 25.Vlerësimi i nxënësve. IKT. Tiranë 2009, fq.33.
26. www.monitor.al/cilesia-nje-investim-dhe-strategji-biznesi/

Impakti i rrjeteve sociale në komunikimin politik dhe në formimin e opinionit publik

PhD. Liçenji Lorena
Universiteti European i Tiranës

Abstrakt

Zhvillimet e fundit në fushën e mediave dixhitale kanë mundësuar që aktorët politikë të komunikojnë me qytetarët në mënyrë të pavarur dhe të lirë nga mediat tradicionale. Pikërisht, nëpërmjet rrjeteve sociale, aktorët politikë dhe qytetarët mund të ridimensionojnë rolin ndërmjetësues të televizionit dhe mediave të tjera tradicionale.

Para analizimit të rolit të rrjeteve sociale si instrumente të komunikimit politik është e rëndësishme të kujtojmë se interneti përbëhet nga një larmi formatesh mediatike duke mundësuar aksesin e prodhuesëve të ndryshëm të informacionit si: qytetarët e thjeshtë, subjektet politike dhe mediat tradicionale. Nëpërmjet rrjeteve sociale si Facebook dhe Twitter qytetari mund të jetë subjekti ose marrësi i informacionit por edhe prodhuesi ose shpërndarësi i informacionit. Në Shqipëri, përdorimi i rrjeteve sociale nga subjekte politike ka luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në shpërndarjen e mesazheve politike gjatë fushatave zgjedhore, por edhe në prodhimin dhe shumëfishimin e tyre.

Ky punim fokusohet tek format e reja të komunikimit politik të përdorur nga aktorët politikë shqiptarë dhe impakti i rrjeteve sociale si instrumente stimuluese për transformimin e rolit të qytetarit nga spektator pasiv në aktor aktiv të arenës politike.

Gjithashtu, synohet të trajtohen dhe t'ju jepet përgjigje pyetjeve të tilla si: Përdorimi i rrjeteve sociale në kontekstin e politikës së mediatizuar shqiptare a ndikon tek marrëdhënia ndërmjet mediave tradicionale dhe politikës? Si ndryshon marrëdhënia qytetar-politikan me përhapjen masive të rrjeteve sociale? A ndihmojnë rrjetet sociale në njohjen e temave politike dhe në formimin e opinionit publik?

Fjalët kyçe: Rrjetet sociale, komunikimi politik, audienca, opinioni publik, media tradicionale.

Hyrje

Tashmë është i njohur gjerësisht roli i rëndësishëm i luajtur nga interneti në zhvillimin e shoqërive moderne. Duke u shndërruar në një mjet komunikimi masiv ai gjen përdorim të gjerë jo vetëm nga njerëzit e thjeshtë, por edhe nga organizatat, administratat, figurat politike, etj. Kjo bën që interneti të mundësojë krijimin dhe kultivimin e marrëdhënieve sociale, politike dhe ekonomike. Shumëllojshmëria e formateve mediatike të pranishme në rrjet mundëson aksesin e prodhuesve të ndryshëm të informacionit si: qytetarët e thjeshtë, subjektet politike dhe mediat tradicionale.

Platformat në rrjet konsiderohen sociale, pasi ofrojnë informacione që janë produkt i marrëdhënieve sociale (Fuchs, 2008, 62). Karakteristikë e tyre është se, ndryshe nga mediat e tjera tradicionale si: gazeta, radio, televizioni, ato mundësojnë krijimin e një raporti të drejtpërdrejtë midis prodhuesit dhe marrësit të mesazhit.

Studiuesit bashkëkohorë konstatojnë se falë avantazheve dhe lehtësive në përdorimin e tij, përhapja e internetit është pritur me entuziazëm si nga audienca e gjerë ashtu edhe nga subjektet politike (Baylon & Mignot, 2005, 305). Pikërisht, për këtë arsye fenomeni i mediave sociale është transformuar në një praktikë profesionale dhe objekt të lakmuar studimi nga akademikët e fushës.

Studimet ndërkombëtare, njëkohësisht venë theksin tek fakti që pikërisht nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale, si një nga format më të preferuara të komunikimit në internet, si nga politikanët ashtu edhe nga qytetarët, ridimensionohet roli i luajtur nga televizioni dhe mediat e tjera tradicionale në përcjelljen e mesazheve politike (Castells, 2009).

Raporti i krijuar midis mediave te reja dhe atyre tradicionale

Sikurse përmendëm edhe më sipër, rrjetet sociale mundësojnë njëherazi, shpërndarjen e informacionit dhe formësimin e opinionit publik. Nga ky këndvështrim, ato i konsiderojmë një instrument të rëndësishëm për realizimin me efikasitet të debatit politik publik, kjo për arsye se subjektet politike synojnë jo vetëm të jenë të pranishëm në rrjet por njëkohësisht edhe të installojnë një lidhje midis sistemit mediatik tradicional dhe atij modern për të përforcuar rolin e tyre si formësues të opinionit publik (Castells, 2007, 6).

Kanë qënë pikërisht zhvillimet e fundit në fushën e mediave dixhitale ato që kanë bërë të mundur që subjektet politike të komunikojnë me qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur nga mediat tradicionale, duke u transformuar në profesionistë të komunikimit.

Është e vërtetë që mediat tradicionale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në demokracitë moderne, por janë instrumentet teknologjike ato që mundësojnë komunikimin horizontal dhe të pavarur nga ndërmjetësuesit tradicionalë të informacionit.

Nëse më parë fluksi i komunikimit politik funksiononte sipas modelit “top-down”, duke nënkuptuar që axhenda politike zhvillohej vetëm në ambientet politike dhe më pas transmetohej tek publiku, sot, me përhapjen masive të teknologjive dixhitale, qytetarit i ofrohet mundësia e të qenurit aktiv dhe pjesë e procesit të vendimmarrjes (Kallciu, 2007, 77).

Nëse përdoret në mënyrë korrekte, komunikimi politik në rrjetet sociale, mund të përforcojë efikasitetin e informacionit të transmetuar nëpërmjet mediave tradicionale dhe mund të realizojë krijimin e axhendës politike jo vetëm nga gazetarët por edhe nga audienca. Në këtë këndvështrim mund të verifikojmë ndryshime të rëndësishme jo vetëm në sasinë por edhe në cilësinë e informacionit që qarkullon në rrjet.

Eksperiencat e fundit ndërkombëtare, si ajo e fushatës elektorale të Obamës, vërtetojnë rëndësinë në rritje që kanë pasur rrjetet sociale në organizimin e informacionit politik dhe në përcjelljen e këtij informacioni edhe në mediat tradicionale, veçanërisht gjatë zhvillimit të fushatës elektorale (Vacarri, 2012, 62). Presidenti Obama, në zgjedhjet e 2008, falë përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale, arriti të depërtonte tek një audiencë që deri atëherë konsiderohej indiferente ndaj mesazheve të transmetuara nga mediat tradicionale.

Komunikimi politik në rrjetet sociale

Të dhënat statistikore konfirmojnë që, edhe pse televizioni është kanali kryesor nëpërmjet të cilit informohen qytetarët, vitet e fundit është rritur me rritme të shpejta edhe përdorimi i internetit si instrument përcjelljes i mesazhit politik. Avantazhet e përdorimit të rrjeteve sociale nga subjektet politike dhe nga qytetarët janë të shumta por, mund të përmendim disa prej tyre si:

- Nëpërmjet rrjeteve sociale qytetari mund të njohë preferencat politike të “miqve” të tij.
- Mund të publikojë informacione me përmbajtje politike.
- Mund të deklarojë preferencat dhe sjelljen e tij politike.
- Mund të shërbejë si mjet informimi mbi politikën e ndërmarra nga aktorët politikë.

Nëpërmjet rrjeteve sociale si Facebook dhe Twitter mundësohet zhvillimi i komunikimit interaktiv dhe horizontal duke transformuar audiencën në prodhues dhe shpërndarës të informacionit (Cioni, & Marinelli, 2010, 32).

Njëkohësisht teknologjitë dixhitale favorizojnë lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet problemit dhe zgjidhjes së tij, rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e komunikimit politik.

Revolucioni dixhital u ka ofruar subjekteve politike forma dhe mundësi të reja për prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe ka mundësuar shkëputjen e raportit të varësisë ndërmjet politikanit dhe gazetarit (Blumler, 1999, 57).

Zhvillimet e fundit teknologjike janë reflektuar edhe tek format e komunikimit të politikanëve

shqiptarë, të ndërgjegjësuar për risitë, ndryshimet dhe mundësitë e krijuara nga përdorimi me efikasitet i internetit.

Krahasuar me format e mëparshme të komunikimit, përhapja e rrjeteve sociale ofron përdorimin e metodave dhe instrumentave të reja për të komunikuar me publikun dhe vendos në dispozicion të aktorëve politikë mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë të votuesit me të votuarin.

Qasja e politikës shqiptare ndaj risive teknologjike

Edhe pse internet është ende një territor i pa eksploruar për pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare, mediat e reja konsiderohen plotësuese të ofertës komunikative tradicionale. Të dhënat mbi përdorimin e internetit në Shqipëri konfirmojnë një rritje të tendencies për përdorimin e tij jo vetëm nga qytetarët por edhe nga politikanët.




Fig 1. Numëri i përdoruesëve të internetit për 100 banorë
Burimi: Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve

Në Shqipëri, ashtu si në Maqedoni e Mal të Zi, 90% e popullsisë që është aktive në internet ka edhe një adresë në Facebook. Përdoruesit e internetit në 2011 arrijnë shifrën e 1,3 milion banorëve dhe 1,05 milion prej tyre janë përdorues të rregullt të facebook-ut.

Ashtu sikurse ilustron edhe në tabelën e mësipërme, në fillim të vitit 2011 rezultonte 43,5% popullata që kish mundësinë e përdorimit të internetit. Në kontekstin Shqiptar duhej pritur viti 2013 për të verifikuar qasjen e aktorëve politikë ndaj ndryshimeve teknologjike. Ata kanë përdorur rrjete sociale, jo vetëm për shpërndarjen e mesazheve politike gjatë fushatës zgjedhore, por edhe për prodhimin, shumëfishimin dhe pasurimin e ofertë elektorale

Komunikimi politik postmodern, i përdorur gjerësisht edhe nga aktorët politikë shqiptarë, karakterizohet nga elementët strukturues të fushatës elektorale “permanente”, si profesionalizimi i informacionit dhe fragmentarizimi i publikut (Norris, 2002, 6).

Gjatë studimit të komunikimi politik në rrjetet sociale hasen edhe format e popullarizimit të politikës, të konsideruar si aspekte karakterizuese të fazës së tretë të komunikimit politik (Blumler, & Kavanagh, 1999, 213). Pikërisht, koncepti i popullarizimit të politikës na ndihmon në interpretimin e informacionit që qytetarët dhe politikanët publikojnë, lexojnë dhe ndajnë në rrjetet sociale.

Studiuesit e fushatave elektorale konsiderojnë të sukseshëm strategjinë e komunikimit të drejtpërdrejtë dhe interaktiv të përdorur nga aktorët politikë. Ata shprehen optimistë për shumëfishimin e strumenteve të informimit, por mbeten skeptikë për sa i përket mundësisë që kanë të gjithë qytetarët për të përdorur këto teknologji.

Impakti i gjerë që mediat sociale mendohet të kenë tek votuesit ka bërë që një pjesë e klasës politike shqiptare të përdorë masivisht Facebook dhe më pak Twitter, si media efikase për të komunikuar jo vetëm me qytetarët por edhe me gazetarët. Politikanët shqiptarë kanë përdorur platformën dixhitale

kryesisht për të shpërndarë mesazhe elektorale dhe për të stimuluar pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje, për të komunikuar aktivitetin e tyre institucional, për të shprehur opinione dhe komente në kohë reale mbi ngjarjet e ditës dhe njëkohësisht për të ruajtur marrëdhëniet me mediat tradicionale. Karakteristikë e kontekstit shqiptar është një qasje tradicionale edhe ndaj përdorimit të teknologjive moderne si interneti. Lidërshipi shqiptar shfaq tendencën të flasë, të artikulojë politikën e ndërmarra, por rrallë herë mund të dëgjojë kërkesat e qytetarëve apo të ndërveprojë me ta. Shpesh herë rrjetet sociale përdoren për të komunikuar me kundërshtarët e tyre politikë dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me publikun.

Në kontekstin shqiptar rezulton se teknologjitë e reja të komunikimit dhe rrjetet sociale arrijnë të integrohen me mjetet e informacionit dhe ato të komunikimit tradicional, por jo të luajnë një funksion plotësisht zëvendësues.

Dy figurat politike kryesore në fushatën elektorale të 2013, Rama dhe Berisha, kanë përdorur rrjetet sociale për të dhënë më shumë vizibilitet politikave të ndërmarra prej tyre, për të organizuar fushatën elektorale, dhe shpesh herë, edhe për të kontrolluar përmbajtjen e informacionit të transmetuar në mediat tradicionale, për të rritur pjesëmarrjen elektorale apo për të mobilizur elektoratin.

Në kontekstin shqiptar konstatohet një ndërthurje e modelit të komunikimit *top-down* me atë *up-down*. Shpesh herë verifikohet edhe një shpërndarje horizontale e informacionit në momentin kur individët aktivë në rrjetet sociale mobilizohen për të shpërndarë informacionet politike në faqet e miqve të tyre.

Pavarësisht mbizotërimit të rrjetit në procesin e komunikimit, klasës politike shqiptare i mungon kultura e përdorimit të rrjetit për të krijuar dhe konsoliduar konsensusin politik. Studimet empirike konfirmojnë që aksesin në teknologjitë dixhitale dhe informimin e qytetarëve nëpërmjet rrjeteve sociale mund të ndikojë pozitivisht në pjesëmarrjen elektorale, por shpeshherë që informacioni i marrë nëpërmjet internetit të konsiderohet me impakt tek qytetarët dhe mbi qytetarët, duhet të bëhet pjesë e informacionit të transmetuar nga mediat tradicionale (Castells, 2007).

Janë pikërisht rrjetet sociale ato që paraqesin një raport të ri ndërmjet komunikimit masiv dhe atij ndërpersonal duke influencuar perceptimin që ne kemi si individë mbi rolin e komunikimit tonë në shoqëri (Boccia Artieri, 2012).

Rrjetet sociale dhe formimi i opinionit publik

Prej më shumë se një dekade pyetja që shtrojnë studiuesit e komunikimit fokusohet tek impakti që mund të ketë interneti në sferën publike dhe në formimin e opinionit publik. Si pasojë e zhvillimeve të rrjeteve sociale konsolidohen arsye të qenësishme për të mirëpritur format e reja të formimit të opinionit publik.

Sfera publike është ajo hapësirë e dallueshme diskutimesh e cila përmban në thelb institucionet komunikuese të një shoqërie, përmes të cilave qarkullojnë faktet dhe opinionet dhe me anë të të cilave ngrihet një rezervë e përbashkët njohurish që do të shërbejë si bazë për aksionin kolektiv politik (Mc Nair, 2009, 32). Por cilat janë aspektet pozitive dhe negative të përdorimit të rrjeteve sociale nga lidërshipi politik?

Përdorimi i rrjeteve sociale favorizon krijimin e një kontakti të drejtpërdrejtë midis politikanit dhe publikut, qytetarëve të thjeshtë u mundësohet pjesëmarrja aktive në debatin publik dhe politik. Mundësohet vetëpërfaqësimi i aktorëve politikë si dhe informacionet politike mund të shumohen dhe të ripërtërihen në hapësirë dhe në kohë, gjithashtu krijohet një hapësirë e re diskutimi për çështje të interesit publik.

Ndër aspektet negative mund të përmendim dobësimin e institucioneve përfaqësuese tradicionale dhe qasjen ndaj rrjetit si një strukturë e decentralizuar dhe pluraliste, e cila sjell me vete fragmentarizim dhe paqartësi të informacionit të transmetuar (Norris, 2002, 224).

Sipas skemës tradicionale të komunikimit politik, mediat duhet të kryejnë funksionin e “*guardianit*” të fluksit të informacionit dhe të mundësojnë krijimin e opinionit publik. Me përhapjen në masë të

rrjeteve sociale, “*guardianët*” e informacionit hasin vështirësi në realizimin e misionit të tyre, për arsye se individët kanë gjithnjë e më shumë akses të drejtpërdrejtë në burimet e informacionit, që më parë filtroheshin për ta nga gazetarët (Maigret, 2010, 230).

Konkluzione

Përgjatë studimit të mësipërm identifikojmë një interes në rritje të aktorëve politikë shqiptarë për përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe në veçanti në përdorimin e rrjeteve sociale. Pikërisht, nëpërmjet rrjeteve sociale, aktorët politikë mundësojnë krijimin e hapësirës të nevojshme edhe në mediat tradicionale dhe i përqasen formimit të opinionit publik.

Në shtjellimin e mësipërm konstatojmë se aktorët politikë shqiptarë i përdorin teknologjitë e reja dixhitale për të komunikuar aktivitetin e tyre institucional, për të shprehur komente mbi ngjarjet e ditës dhe njëkohësisht për ruajtur marrëdhëniet me mediat tradicionale.

Analiza e kontekstit shqiptar na sygjeron të përqëndrohemi jo vetëm tek përdorimi i rrjeteve sociale por edhe tek mënyra se si ato përdoren nga aktorët politikë. Nëse elitat politike, jo vetëm ato shqiptare por edhe ato ndërkombëtare, do të vazhdojnë të konsiderojnë internetin si alternativë komunikimi dhe jo mundësi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me qytetarët, efikasiteti i tij do të vihet në dyshim. Nëse komunikimi politik përdoret në mënyrë korrekte, ai mund të përforcojë efikasitetin e informacionit të transmetuar nëpërmjet mediave tradicionale në rrjetet sociale dhe mund të ndihmojë në formimin e shumëanshëm të opinionit publik.

Sot, revolucioni mediatik, falë përdorimit të teknologjive të informimit dhe komunikimit duhet të nisë nga njerëzit. Rrjetet sociale duhet të shndërohen në arenë e debatit politik dhe publik. I gjendur ndërmjet botës reale dhe asaj virtuale, rrjeti duhet të përfaqësojë një model mbi të cilin duhet të orientohen edhe analizat e mjeteve të tjerë komunikues.

Literatura

- Baylon, C. & Mignot, X. (2005), *La Communication*. Paris, Colin, p. 305.
- Blumler, J. G. & Kavanagh, D. (1999), *The Third Age of Political Communication. Influences and Features*, in *Political Communication*, vol. 16.
- Boccia Artieri, G. (2012), *Stati di connessione. Pubblici, cittadini e consumatori nella network society*. Milano, Franco Angeli.
- Campus, D. (2008), *Comunicazione politica, le nuove frontiere*. Roma-Bari, Laterza.
- Castells, M. (2007), *Comunicazione, potere e contropotere nella network society*, *International Journal of Communication*, Annenberg School of Communication, University of Southern California, p. 6.
- Castells, M. (2009), *Comunicazione e potere*. Milano, Egea-Università Bocconi.
- Cioni, E. & Marinelli, A. (2010), *Le reti della comunicazione politica. Tra televisione e social network*. Firenze, Firenze University Press, p. 32.
- Fuchs, C. (2008), *Internet and Society. Social Theory in the Information Age*. New York, Routledge, p. 62.
- Kallciu, N. (2007), *Media dhe Komunikimi politik*. Tiranë, p. 77.
- Maigrete, E. (2010), *Sociologjia e komunikimit dhe mediave*. Tiranë, Papirus, p. 230.
- McNair, B. (2009), *Hyrje në komunikimin politik*. Tiranë, Uet Press, p. 32.
- Norris, P. (2002), *Il circuito politico-mediale. L'impatto di partiti e mezzi di informazione sulla partecipazione politica nelle campagne postmoderne*. Roma, Rubbettino.
- Vaccari, C. (2012), *La politica online*. Bologna. Il Mulino, p. 61-67.
- Vaccari, C. (2013), *Come si vincono le elezioni. Elementi di comunicazione politica*. Roma, Carocci.

Peizazhi dhe fustanella shqiptare në pikturën e Eugène Delacroix dhe Edward Lear

Msc. Ph.D. (kand). Oltsen Gripshi
American College "Woodrow Wilson" of Tirana

Abstrakt

"Peizazhi dhe fustanella shqiptare në pikturën e Eugène Delacroix dhe Edward Lear" është një temë, e cila ka frymëzuar jo vetëm këto dy artistë të mëdhej evropian, por dhe shumë të tjerë si; Jean-Léon Gérôme, Jean-Baptiste Camille Corot. Kjo temë kaq e ndier për kulturën tonë kombëtare ka joshur dhe ndjeshmërinë time kritike për t'i analizuar këto dy zhanëre nëpërmjet këtij kërkimi shkencor. Temë, e cila nga aspekti cilësor kërkoj të ndriçoj e rivlerësoj krijimtarinë e këtyre dy artistëve, të cilët na paraqesin Shqipërinë e shek. XIX-t. Kërkimi në vetvete mbart vlera historiko-kulturore e estetiko-semiotike, që mund të jetë një kontribut shumë i rëndësishëm për historinë e artit dhe antropologjinë kulturore bashkëkohore shqiptare. Në rrafshin horizontal ky kërkim shkencor është i dobishëm për studiuesit e historisë së artit, antropologjisë kulturore, estetikës, dhe institucioneve si: Fakulteti i arteve, Fakulteti i historisë e filologjisë, Qendra e Studimeve Albanologjike etj.

Qëllimi i temës: Kryerja e një analize estetiko-semiotike dhe antropologjiko-historike e pikturave me peizazhet dhe fustanellën shqiptare të shek. XIX. Nxjerrja në pah e vlerave artistiko-stilistike të këtyre veprave jo vetëm në kontekst historik, por më tepër si një fenomenologji shqiptare, e cila la një gjurmë të pakrahasueshme në artin figurativ evropian të shek. XIX. Evidentimi i fustanellës së jugut që nga bukuria e saj prrallore do ta bënte Shqipërinë e asaj periudhe qendrën e Universit për artistët nga mbarë Evropa. Sikurse do të citonte në shkrimet e tij poeti anglez George Gordon Byron; "FUSTANELLA SHQIPTARE ËSHTË VESHJA MË MADHËSHTORE NË BOTË QË UN KAM PARË NDNONJËHERË" ose përshkrimi që një tjetër shkrimtar anglez Edward Gibbon do t'i bënte peizazhit; "SHQIPËRIA, NJË MREKULLI E NATYRËS, TIBETI I EVROPËS, E CILA SHIKOHET NË HORIZONT NGA ITALIA SI NJË TOKË MË MISTERIOZE SE SA VETË BRENDËSIA E AFRIKËS QENDRORE".

Metodat e hulumtimit: Analizë, teori.

Rezultatet: Rezultati i këtij kërkimi solli krahasime, konfirmime mbi subjektet shqiptare. Kunsultimin e një literature të huaj, evidentimin dhe njohjen e figurave historike të portretizuar në tablot e këtyre dy artistëve evropian me temë shqiptare etj.

Përfundime: Kërkimi shkencor mbi peizazhin dhe fustanellën shqiptare do të ishte për mua një kodifikim vlerash artistike, datash, ngjarjesh dhe vendesh për historisë e artit shqiptar në periudhën e "Gran Tuor".

Parimet e hulumtimit: Harmonia, uniteti, kompozimi, balanca dhe lëvizja.

Fjalët çelës: Analizë, lexim ikonografik, estetikë, semiotik, komunikim pamorë

Hyrje

Pasioni dhe pasuritë artistike evropiane dhe peizazhi i bukur nuk janë një produkt i industrisë moderne të turizmit: duke filluar nga shekulli XVII një numër i madh njerëzish të kulturuar kanë pasur si pika të preferuara të udhëtimit të tyre vendet e Evropës qendrore dhe lindore (veçanërisht Italinë, Francën, Mesdheun dhe afër Lindjes). Udhëtime për kënaqësi, por që kushtonin shumë, dhe që mund të ndërmerreshin vetëm nga ata që i kishin mundësitë për të bërë zhvendosje kaq të gjata dhe të parehatshme, madje, në disa raste, edhe të rrezikshme. Gjithsesi, këto karakteristika nuk e demoralizonin udhëtarin, përkundrazi i shtonin "Gran Tour-it" (siç u quajt në atë kohë rrugëtimi i ndërmarrë nga fisnikët dhe borgjezët e pasur) stimulim e zbulimit të gjurmëve të qytetërimeve mijërvjeçare, në një kohë kur po lulëzonte dhe po përhapej interesimi për historinë antike dhe arkeologjinë. Përveç këtij aspekti udhëtari kishte mundësinë të shijonte peizazhin e mrekullueshëm që ofronte rrugëtimi (shumë i gjatë dhe i ngadaltë, duke parë edhe mjetet e komunikimit të kohës), por edhe të krijonte një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me banorët e zonave të ndryshme, duke u njohur me zakonet e tyre.

Ekspriencat e udhëtimit të zhvilluara në të kaluarën gjatë "Grand Tour-it" mund të ofrojnë sot

mundësi të reja për zhvillimin kulturor dhe turistik në zonat e lagura nga Adriatiku: kthimi në gjurmët e udhëtarëve të Shtatëqindës ose të Tetëqindës mund të jetë stimulues për turistin e kulturuar që mund të ketë dëshirë që të shijojë bukurinë artistike dhe natyrore të Shqipërisë.

Peizazhet, kostumet dhe traditat e Shqipërisë në dëshmit dhe botimet e udhëtarëve anglezë në gjurmët e Grand Tour-it

Vala kulturore evropiane që u manifestua në Shtatëqindën preku bregun lindor të Adriatikut vetëm në mënyrë sipërfaqësore: pikat e preferuara të udhëtarëve ishin kryesisht vende turistike dhe qendrat e mëdha të artit ku ruheshin kryeveprat e pikturës dhe skulpturës. Në këtë perspektivë, Shqipëria duket se nuk gjeti hapësirë. Duke lënë mënjanë rastin e udhëtarit të parë të huaj për të cilin ka dëshmi që vërtetojnë kalimin e tij në këto territore (venciani Lorenzo Bernardo, që në 1591-in përshkoi rajonin për të shkuar në Stamboll, duke e dëshmuar këtë në librin e tij *Viaggio di un ambasciatore veneziano. Da Venezia a Costantinopolo nel 1591 (Udhëtimi i një ambasadori venecian. Nga Venecia në Kostandinopojë në 1591)*, Stabiliment tipografik Vëllezërit Vicentini, Venecia, 1886), mes “pionerëve” të parë duhen kujtuar mjeku dhe natyralisti anglez Edward Brown, që në 1699-ën ka ardhur edhe në Shqipëri, siç dokumentohet në librin *A brief account of some travels in divers parts of Europe (Një tregim i shkurtër i disa udhëtimeve në vende të ndryshme të Evropës)*; ndër të tjera, Jacob Spon dhe Geroge Wheler, autorë të *Voyage de Dalmatie, de Grece et de Levant (Udhëtim në Dalmaci, Greqi e Levante)*, vepër e publikuar në 1689-ën, ku përshkruhen disa qytete të bregdetit si Durrësi dhe Vlora; teologu nga Oksfordi Richard Chandler, i cili në 1776-ën publikoi *Travels in Greece (Udhëtime në Greqi)*, duke përmendur këtu edhe takimin me shqiptarët (Peroni, 1994, 122). Megjithatë, në të vërtetë, vetëm në të Tetëqindën Shqipëria u vu më shpesh në kontakt me udhëtarët evropianë, kryesisht anglezë, të cilët janë integruar edhe në shoqërinë vendase. Arsytet e zbulimit të kësaj krahi ishin kryesisht arsye që bazoheshin tek aspekti artistik dhe kulturor, mes të cilave ishte interesimi për panoramën ekzotike dhe “piktorese” të natyrës dhe të vendit: në Tetëqindën u zhvilluar një tip i ri i pikturës së peizazheve natyrore dhe të qyteteve, që privilegjonte male, liqene, ultësira, kështjella dhe arkitektura të ndryshme, të cilat ishin shumë tërheqëse në territorin e Shqipërisë dhe që shpesh riprodhoheshin nga piktorët që shoqëronin udhëtarët. Për më tepër, evolucioni shkencor i hulumtimeve mbi gjuhët indoevropiane shtyu studiuesit që t'i kushtonin vëmendje edhe gjuhës së veçantë që përdorej nga populli shqiptar. Por nuk kanë munguar as arsyet politike dhe historike (Alberotanza, 2007, 50-58). Në historinë e Shqipërisë (që në atë kohë i përkiste Perandorisë Osmane dhe ishte një provincë e Turqisë evropiane, duke përfshirë Epirin antik dhe Ilirinë, e cila shtrihej nga kufinj të veri-perëndimor të Greqisë deri në Malin e Zi dhe nga bregu lindor i Adriatikut deri në Maqedoni e Thesali (Selaniku i sotëm), dhjetëvjeçarët e parë të Tetëqindës u karakterizuan nga hapja e kufijve diplomatikë me Anglinë që u bë e mundur nga zgjuarsia e guvernatorit të vendit, Ali Pasha. Mes udhëtarëve më të rëndësishëm anglezë që në Tetëqindën vizituan Shqipërinë duhet përmendur padyshim shkriktari i madh George Gordon Byron (Londër, 1778 – Mesolongji, 1924) dhe miku i tij John Cam Hobhouse (Bristol, 1786 – Bristol, 1869), të cilët, në fund të shtatorit të 1809-ës, zbankuan në qytetin më jugor të Shqipërisë, Prevezë, etapë e një turi të gjatë në Mesdhe që zgjati dy vjet. Prej aty dy anlgezët u futën në territorin shqiptar, duke prekur rrënojat e Nikopolis-it, kryeqyteti i krahinës së Janinës dhe Tepelenës, ku janë pritur në mënyrë madhështore nga Ali Pasha (Scianatico, 2007, 33-40). Përshtypjet e tyre nga Vendi i Shqiponjave, peizazhi, banorët dhe traditat janë dokumentuar në veprat bajroniane *Childe Harold's pilgrimage (Pelegrinazhi i të riut Harold, Londër, 1812, prej ku kujtohen fjalët e famshme: “Land of Albania! Let me bend mine eyes/on the, thou rugged nurse of savage men!”)*, *The Giaour (Gjauri, Londër, 1813)* dhe në librin e Hobhouse të titulluar *A journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople: During the years 1809 and 1810 (Udhëtim në Shqipëri dhe provinca të tjera të Turqisë në Evropë dhe Azi, deri në Kostandinopojë, në vitet 1809 e 1810)*, i publikuar në Londër nga James Cawthorn në 1813-ën. Veçanërisht, itinerari i dy miqve mund të

dokumentohet dhe rindërtohet falë një letre të gjatë që Lord Byron i dërgoi mamasë së tij Catherine Gordon nga Preveza, më 2 nëntor 1809. Bëhet fjalë për një dëshmi të çmuar, që besojmë se është e drejtë ta citojmë në mënyrë më të gjerë, kryesisht në ato pjesë që lejojnë rindërtimin e itinerarit të ndjekur nga Autori i *Childe Harold's pilgrimage*:

E dashur nënë,

Ndodhem prej pak kohësh në Turqi: ky vend ndodhet buzë detit, por unë kam përshkuar pjesën e brendshme të këtij vendi ku kam vizituar edhe Pashain.

Jam larguar nga Malta me një "Spider", anije luftime, më 21 shtator dhe brenda tetë ditëve kam mbërritur në Prevezë. Prej aty kam shkuar në Tepelenë, rreth 150 milje më larg, në pallatin e Madhërisë së tij në fshat, ku kam qëndruar tri ditë. Emri i pashait është Ali dhe konsiderohet një burrë me aftësi të jashtëzakonshme, drejton gjithë Shqipërinë (Iliria antike), Epirin dhe një pjesë të Maqedonisë; djali i tij Veli Pashai, për të cilin më ka dorëzuar disa letra, qeveris Morean dhe ka shumë influencë në Egjipt; me pak fjalë, është një nga njerëzit më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane. Kur kam mbërritur në Janinë, kryeqyteti, mbas një udhëtimiti tri ditor mes maleve duke përshkuar një prej vendeve më piktoreske, kam zbuluar se Ali Pashai ishte bashkë me ushtrinë e tij në Iliri ku kishte vënë nën rrethim Ibrahim Pashain në kështjellën e Beratit. Kishte mësuar se një anglez i rangut të lartë ndodhej në vendin e tij dhe i kishte dhënë urdhër në Janinë komandantit që të më ofronte një vend ku të qëndroja dhe komoditete të tjera, falas; edhe pse kam patur lejen që t'i bëja dhurata sklleverve etj. nuk më ka lënë të paguaj asgjë nga ato që kam konsumuar në shtëpi. Kam shëtitur me kuajt e vezirit dhe kam parë pallatet e tij dhe ato të nipërve. Janë të shkëlqyer, por të mbingarkuar me mëndafsh dhe punime në ar. Më pas kam shkuar drejt maleve në Zitza, një qytezë ku ndodhet një manastir grek (ku kam fjetur në kthim), vendi më i bukur që kam parë ndonjëherë (gjithmonë duke përjashtuar Sintrën e Portugalisë). Në harkun e nëntë ditëve kam mbërritur në Tepelenë. Rrugëtimi është zgjatur për shkak të përrënjeve që kishin zbritur nga malet dhe kishin bllokuar rrugën. Nuk do ta harroj kurrë skenën që kam parë kur mbërrita në Tepelenë në orën pesë të mbasdites ndërsa dielli po perëndonte: më solli në mendje (por veshja ishte pak më e ndryshme) përshkrimin e Scott-it të kështjellës Branksome në baladën e tij dhe sistemin feudal. Shqiptarët dhe veshjet e tyre (më të bukurat në botë; janë fundet e gjatë dhe të bardhë, me një pelerinë të punuar në ar, një xhaketë dhe një jelek kadife të kuq me zbukurime në ar, pistoleta dhe thika të argjendta), Tartarët me çallmat e tyre të gjata, turqit me pelicet e tyre të mëdha, ushtarët dhe sklleverit e zinj me kuajt e tyre, të parët të shpërndarë në grupe në një galeri të madhe të hapur para pallatit, të dytët të vendosur në një lloj oborri në pjesën e pasme, dyqind kuaj luftime të veshur për paradë, korrierë që hynin dhe dilnin, muzika në sfond, djem të rinj që lajmëronin orën nga minarja e xhamisë, e gjitha kjo, bashkë me pamjen e veçantë të ndërtesës, formonte një spektakël të ri dhe të jashtëzakonshëm për një të huaj. [...] Sot kam parë rrënojat e qytetit të Axios (qytet në Epirin e lashtë), vend pranë të cilit Mark Antoni humbi botën në një gji aq të vogël ku me vështirësi mund të qëndronin dy fregata; një mur i rrënuar është e vetmja gjë që ka mbetur. Nga ana tjetër e gjirit ndodhen rrënojat e Nikopolis-it, e ndërtuar nga Augusti në nder të fitores së tij. Dje mora pjesë në zhvillimin e një martese greke, por për këtë dhe për mijëra gjëra të tjera nuk kam kohë as hapësirë të të flas. Nesër do të shkoj, i shoqëruar nga pesëdhjetë njerëz në Patras të Moreas, dhe prej aty do të shkoj në Athinë ku do të kaloj dimrin. Dy ditë më parë për pak u mbyta me një anije luftime turke, për shkak të injorancës së kapitenit dhe ekuipazhit sepse stuhia nuk ishte shumë e fortë. Fletçer bërtiste dhe thërriste emrin e gruas, grekët i luteshin të gjithë shenjtorëve, myslimanët Allahut, kapiteni shpërtheu në lot dhe u fut me vrap nën kuvertë duke na thënë t'i luteshim Zotit. Velat ishin thyer, nata kishte rënë dhe shpresa jonë e vetme ishte të zbarkonin në Korfuz që është nën zotërimin e francezëve ose (siç tha Fletçer me terma patetikë) të përfundonim në një "varr të lagësht". Bëra sa munda për të ngushëlluar Fletçer-in, por mbas një farë kohe hoqa dorë, u mbështolla me pelicën time shqiptare dhe u shtriva në anije duke pritur më të keqen; kam mësuar të jem pak filozof gjatë udhëtimit të mia, por edhe nëse nuk do të kisha mësuar do të kishte qenë gjithsesi e kotë të ankohesha. Fatmirësisht era u pakësua dhe na ndihmoi të dilnim në bregun e Sulit ku zbarkuam dhe prej ku vazhduam udhëtimin drejt Prevezës me ndihmën e vendasve;

nuk do të kem më besim te marinarët turq në të ardhmen. Edhe pse Ali Pasha kishte urdhëruar një nga anijet e tij të luftës që të më çonte në Patra, vendosa të shkoja në Misolungji nga toka dhe nga aty do të kaloj një gji të vogël për të arritur në Patra. [...] Më pëlqejnë shumë shqiptarët, jo të gjithë janë turq; disa tribu janë të krishtera, por feja e tyre nuk ndikon aspak në zakonet apo mënyrën e jetesës; konsiderohen si trupat më të mira në shërbim të turqve. Kam marshuar për dy ditë të tëra pa pushim dhe më pas kam kaluar tri ditë në një kazermë në Salora dhe nuk kam qenë kurrë në shoqërinë e ushtarëve kaq zemërgjerë dhe të durueshëm. Kam qenë edhe në zona të tjera ushtarake në Gjibraltar dhe Maltë dhe jam shoqëruar me trupat spanjolle, franceze, siçiliane dhe angleze, por shqiptarët janë të vetmit që përveçse nuk më vodhën asgjë shpesh më fuan të ndaj me ta ushqimin e tyre dhe qumështin e tyre (Scianatico & Ruggiero, 2007, 488-493).

Udhëtarë të tjerë që kanë ardhur nga ishulli britanik kanë ndalur në tokën shqiptare në gjysmën e parë të shekullit të XIX. Mes tyre, mbahet mend veçanërisht William Martin Leake (1777 – 1860), i cili, duke filluar nga viti 1904 është dërguar disa herë nga qeveria angleze si përfaqësues diplomatik dhe ka qëndruar në Vlorë, Janinë, Tepelenë, Sul, Berat dhe qytete të tjera të Shqipërisë. William Martin Leake eksperiencën e tij e ka përshkruar në një vepër me katër vëllime, *Travels in Northern Greece (Udhëtime në Veri të Greqisë)* e publikuar në Londër nga John Rodwell në 1835. Ndër të tjera, kanë dhënë kontributin në njohjen e kësaj toke, që në atë kohë ishte pothuajse e panjohur për botën, edhe mjeku Henri Holland, i cili ka vizituar Shqipërinë mes viteve 1812 dhe 1813; në 1813 në Shqipëri ka ardhur edhe kleriku Thomas Hughes, i shoqëruar nga piktori Charles Robert Cockerell ilustrimet e të cilit janë shfaqur në librin *Travels in Sicily, Grece and Albania (Udhëtime në Siçili, Greqi dhe Shqipëri)* i publikuar nga shtëpia botuese londineze Mawman në vitin 1820. Për t'u cituar në këtë vazhde publikimesh mbi Shqipërinë janë edhe politikani dhe gazetari i "Daily Neës" David Urquhart, i cili publikoi *The spirit of the East. Turkey and its resources. England, france, Russia and Turkey*, London, Henri Colburn Publisher, 1839 (*Shpirti i Lindjes. Turqia dhe resurset e saj. Anglia, Franca, Rusia dhe Turqia*, Londër, Henri Colburn Publisher, 1839), si dhe kapiteni Best, i cili publikoi një libër mbi gjuetinë me titull *Excursions in Albania. Comprising a description of the ëild boar, deer and ëoodcock shooting in that country; and a journey from thence to Thessalonica & Constantinople and up the Da nube to Pest*, London, H. Allen & co., 1842 (*Eskursionë në Shqipëri. Përmbledhje e një përshkrimi për derrin e egër dhe drerin, të gjetur rrugës duke vajtur për gjueti në atë vend; dhe një udhëtimi nga Shqipëria në Selanik dhe Kostandinopoj e nën Danub deri në Pest*, Londër, H. Allen & co., 1842).

Peizazhi dhe fustanella shqiptare mes Eugène Delacroix dhe Edward Lear

Luftërat ballkanike të shek. XIX për liri dhe pavarësi nga pushtimi asimilues katërqind vjeçar i Perandorisë Osmane, kulmoi në vitin 1821 me shpalljen e Pavarësisë së Greqisë, ku bashkëluftëtarë për çlirimin dhe përzënie nga territoret e pushtuara nga osmanët në të gjithë Ballkanin ishin edhe shqiptarët, por në veçanti spikatën ato të Çamërisë, duke qenë se pikërisht në atë periudhë të gjithë popujt e Ballkanit ishin të përfshirë në të njëjtën hapësirë gjeo-politike. Në simetri kohore, por në një asimetri të plotë social-kulturore me pjesën tjetër të Evropës perëndimore (Masiello, 2006, 88) . Dinamika e zhvillimeve shumëplanëshe kishte arritur horizonte të reja, të paimagjinuara e të paprekura nga vendet e Evropës juglindore, të cilat luftonin për të mbrojtur identitetin e tyre antropologjik kundrejt një përplasjeje të pashmangshme me filozofinë shtypëse dhe mohuese të Sulltan Selimit të III-të. Një zhvillim i tillë historik nuk la indiferent ndjeshmërinë e artistëve përtej Alpeve, të cilët vërshuan drejt Ballkanit për të qenë protagonistët e drejtpërdrejtë në sheshbetejat e popujve të lagur nga Adriatiku (Hobhouse, 1855, 203). Kjo do të shënonte në mënyrë jokoshiente atë që do ta konsideronim dhe përkufizonim si *Gran Tour (Udhëtimet e Mëdha)*, ku pjesë e këtij fenomeni, i cili ndodhte për herë të parë në historinë e artit ishin: Jean-Baptiste Camille Corot, Jean-Léon Gérôme, William Turner, Paja Jovanovic, Rudolf Otto von Ottenfeld, Walclaw Pawliszak,

Johann Frankenberg, Pietro Luchini, Ary Scheffer.

Dimë shumë mirë që në Francë kishte lulëzuar një frymë e re artistike gjatë rrëzimit nga fronti të Luigjit të XVI-të, që njihet ndryshe si Revolucioni Francez i vitit 1791. Kjo lindje e re ishte *Romantizmi*, një lëvizje artistike, e cila përmbante të gjitha elementet e doktrinës së dashurisë për atdheun dhe patriotizmin, elemente që do të përcilleshin rrufeshëm edhe në shtete të tjera si Italia, nën monarkinë e Viktor Emanuelit të I-rë (Vittore Emanuele II), por rëndësia e veçantë për këtë kërkim shkencor nuk janë datat e zhvillimeve politike, por se si kanë ndikuar ato, në përjasjen e artistëve kundrejt temave sociale dhe kombëtare në atë periudhë. Është joshja dhe frymëzimi që sjell piktorët më në zë të Romantizmit Evropian si, Eugène Delacroix dhe Edward Lear, ku nëpërmjet penelit të tyre gjenial do të përjetësonin skena luftimesh, ushtarë në poza format fotografie, vajza shqiptare të veshura me kostume kombëtare, peizazhe dhe monumente qytetesh të një Shqipërie fantastike shumëngjyrëshe. Por, ajo që të bie më shumë në sy në këto tablo është fustanella e meshkujve, me drapezhin e saj të bardhë magjepsës, jelekun e qëndisur mjeshtërisht në flori mbi një të kuqe të purpurt si gjaku krenar shqiptar, kostum i një bukuri mahnitëse, ose ndryshe, veshja më madhështore në botë, kështu do ta përshkruante në letrat e dërguara nënës së tij nga Pashallëku i Janinës shkrimtari dhe poeti anglez Lord Byron. Mbërritja e piktorëve romantikë në Shqipëri do të përcillte dhe do të ngrinte në majën e kullës së fildishtë famën e kostumeve kombëtare shqiptare, traditat dhe luftën e tyre heroike, bashkë me figurat më të lavdishme patriotike si:

Marko Boçari, Kiço Xhavela, Llambro Xhavela, Teodor Kollokotroni, Ali Pashë Tepelena, Bubulina Laskarina, etj (Leake, 1835, 43-58). Interesante dhe plot kureshtje është fakti se si këta dy artistë të mëdhenj kanë paraqitur me kaq mjeshtëri piktoriale dhe me një gjuhë po aq sa dinamiko-poetike, gati-gati, duke mishëruar një epos të vërtetë imazhesh të Shqipërisë së 1800-ës. Në këndvështrimin analitiko-estetik të temave të trajtuara në pikturat e Eugène Delacroix dhe Edward Lear, gjendemi përballë elementeve tipike të një stili romantik, që do të thotë : marrja e subjekteve nga e vërteta, realizimi dhe përshkrimi i personazheve historiko-heroik me veshje kombëtare shqiptare, ashtu si në tërësi pikturat janë të veshura plot simbolika duke filluar nga trajtimi i ngjyrës, e cila futet në dimensionet e reja shprehëse. Elemente arkitektonike fetare si: xhamitë, teqet dhe kishat ortodokse të cilat plotësojnë një harmoni perfekte shumëplanëshe në horizontet e peizazheve tipike të Shqipërisë së Jugut, duke mos anashkaluar dhe pasqyrimin e traditave artistiko-kulturore të jetës së shqiptarve (Hughes, 1820, 100-105). Ku të gjendurit përballë disa skenave si, valles së Pirros, loja në çifteli dhe e cylave dyjare të barinjve në hapësirat e blerta plot dritë, të krijojnë natyrshëm një dialog mes teje dhe pikturave, që të shpien në përfundimin se ambasadorët më të shkëlqyer të Shqipërisë së 1800-ës në Evropë ishin pikërisht këta dy artistë.

Rrugëtimi dhe kontakti i parë i vërtetë i shkrimtarit dhe akuaelistit anglez Edward Lear filloi në vitin 1837. Me ndalesën në Romë, midis 1842 dhe 1846, ai shkoi disa herë për të vizituar krahinën qendrore të Italisë Abruzzo, (ku dhe do të kishte kontaktet e para me koloninë shqiptare të arbëreshëve të Villa Badessa, një fshat në periferi të Peskaras). Kontakti me shqiptarët e Italisë , zakonet, traditat, folklorin dhe kostumet e tyre do të frymëzonin udhëtimin e parë të Edward Lear në Shqipëri në vitin 1848, një udhëtim kaq mbresëlënës sa që do ta rikthente përsëri në vendin e shqiponjave një vit më pas në 1849. Edward Lear me përshtypjet e tij do të publikonte në Angli një libër me ilustrime të shumta të cilat do të dëshmonin udhëtimin e tij në Shqipëri titulluar *“Ditarët e një piktori peizazhist në Shqipëri, 1851”*, botuar nga shtëpia botuese Richard Bentley. Lear vizitoi territoret shqiptare dy herë gjatë jetës së tij: hera e parë në maj të 1848-ës, dhe i dyti në nëntor të vitit të 1849-ës (Lear, 1851, 70-73). Me vizitat që bëri në Shqipëri, Lear solli në Evropën perëndimore jo vetëm përshtypjet e shkruara për zakonet e jetës shqiptare, por mbi të gjitha pasuroi nëpërmjet skicave, vizatimeve, peizazheve me akualet imazhin e një vendi që nuk njihet gati fare nga popujt e tjerë të Evropës. Fokusi në pikturat e Edward Lear ishin kryesisht kostumet, peizazhet dhe rrënojat arkeologjike në disa qytete të Shqipërisë si:

Elbasani, Berati, Tirana, Shkodra dhe disa fshatra të Rivierës Jonijane, Dhërmiu, Drimadha, Himara dhe Dukati. Entuziasmi i Edward Lear për bukuritë e kulturës vendase hidhen magjishëm me shkrimet që bën në përshkrimin e natyrës, larmia e kreshtave krenare të maleve që shkrihen harmonishëm me gjarpërimin e lumenjve, të cilët derdhen si vena gjaku në ujërat e ëmbël të

liqeneve (Lear, 1851, 23-29). Akuarelet e realizuara në vendin e shqiponjave, përmbajnë vlera të rralla etno-kulturore e socialo-antropologjike, sepse janë të vetmet dëshmi të Shqipërisë së shek. XIX. Kompozimet variojnë nga ai i një peizazhi shumëplanësh, me hapësira dhe çarje në horizonte pa kufi, deri tek ato të cilat kufizohen në pikturimin e një peme të veçantë apo paraqitja në plan të parë të një monumenti si në akuarelin me xhaminë e Tiranës dhe atë të Ohrit të 1848-s. Në fakt, peizazhi shqiptar përkthehet në filtra të reja interpretimi artistik, ku poezia vizive dhe estetika e përshkrimit të natyrës nëpërmjet përdorimit të ngjyrave të ujit, u jep atyre një freski aq sa natyrale, por dhe romantike (Curzon, 1849, 424).

Në akuarelet e Edward Lear vërehet një zhdërvjelltësi vizatimi, gjë që na bën të kuptojmë intensitetin e tij emocional në momentin e realizimit të pikturave. Ai gati-gati, kalon në nuanca impresioniste për nga njollat dhe kampiturat e ngjyrave, hedhur larmishëm dhe impulsiviteti mbi letër. Ashtu si përshkrova më sipër, pikturat e Edward Lear kanë një shtrirje të gjerë në përmbajtjen e tyre, sepse në to gjejmë pasqyrimin me një mjeshtëri piktoreske edhe të monumenteve kulturore si: Ura e Baçallëkëve në Shkodër apo kështjella të ndryshme si ajo e Gjirokastrës, Krujës, Beratit dhe Shkodrës, ku përveç saktësisë dhe vërtetësisë së vizatimit, për t'u theksuar është dhe fenomeni dritë (Holland, 1815, 551). Në të gjitha pikturat e Edward Lear rol kyç dhe që i bën të identifikueshme si vepra të tij, është grafika që krijohet me një lojë të përkryer dritëhijesh. Në zbërthimin dhe interpretimin psikostetik të veprave të artistit anglez janë pozat virile dhe heroike të luftëtarëve, veshjet kombëtare të Shqipërisë qendrore dhe jugore, ku mbretëresha e padiskutueshme është fustanella, një element etnografik që ka shoqëruar shqiptarët që nga krijimi i tyre me origjinën pallazge, ilire dhe deri në ditët tona (Murray, 1854, 460). Fustanella ishte ajo që nëpërmjet pikturave të Edward Lear dhe Eugène Delacroix do t'i tregonin botës qytetërim e hershëm fisnik të popullit shqiptar. Edward Lear ishte aq i mahnitur nga fustanella, sa që e ka trajtuar atë me një delikatesë dhe ekspresivitet maksimal. Në të gjitha kompozimet e tij janë të pranishëm persona të veshur me fustanellën e bardhë, e cila rrezaton paqe dhe krenari. Fustanella në kontekstet historike të asaj periudhe merr një simbolikë të rëndësishme, bëhet shenjë dalluese e etnisë shqiptare. Pjesë përbërëse e fustanellës që variojnë me gjatësinë e saj nga ajo që përdorej në Shqipërinë qendrore, e gjatë poshtë gjurit dhe ajo e shkurtër dhe me një drapëz të ngjeshur në Shqipërinë e jugut dhe krahinës së Çamërisë, janë armët e pasura me dekore të punuara me një rafinaturë dhe mjeshtëri artistike në pikturën figurative të Edward Lear (Lear, 1851, 222).

Një tjetër eksponent i themelimit të Romantizmit Evropian që do të trajtonte me mjeshtëri befasuese fustanellën dhe skena nga luftimet për liri të popullit shqiptar ishte Eugène Delacroix. Befasuese piktura e Eugène Delacroix në krahasim me pikturën e Edward Lear dallohet së pari nga teknika e përdorur që nuk ishte ajo e ngjyrave të ujit, por e ngjyrave të vajit mbi pëlhurë. Piktura e Delacroix karakterizohet nga një dinamizëm kompozicional dhe tonalitete energjike, ku në akuarelet e Edward Lear mbizotëronte paqja dhe ndjenja e lirisë përballë një peizazhi të egër dhe të paeksploruar, në pikturën e Delacroix, tonalitete grafike të ashpra dhe prerjet dramatike marrin një përparësi në përshkrimin e jetës shqiptare të 1800-ës. Dramaticiteti i skenave të përleshjeve pasqyrohen nëpërmjet një vizatimi të lirshëm, të fortë dhe një ndriçimi teatral, ku subjekti izolohet në një hapësirë të limituar. Delacroix ashtu si dhe Edward Lear ishte i mahnitur nga bukuria dhe madhështia e fustanellës, sepse Shqipëria ofronte për të dhe për të gjithë artistët romantikë një ekzotizëm të pasur me motive folkloristike vendase (Noakes, 1979, 359). Shqiptarët në tablotë e Eugène Delacroix serviren heroikë, fisnikë dhe fitimtarë, por dhe jo vetëm si të tillë, sepse gjuha artistike e përdorur e vendos figurën e shqiptarit në luftrat ballkanike, në qendër të universit si dërguesit e Zotit për të shpëtuar Evropën përtej Adriatikut nga pushtimet shekullore të Perandorisë Osmane (Hobhouse, 1813, 1152). Nëpërmjet dritëhijeve dhe mbizotërimit të kampiturave të errëta që gati na sjellin në kujtesë pikturën baroke të Caravaggio-s, spikat trajtimi në forma dhe këndvështrime të larmishme të fustanellës, ky element etnografik që do të tërhiqte vëmendjen e shumë artistëve të tjerë romantikë si Leon Gérôme, që me pikturat e tij të realizuara në Egjipt në periudhën e mbretërimit të monarkisë shqiptare me në krye Mehmet Aliun do të ngrente në kulminacion bukurinë e fustanellës dhe kostumeve shumëngjyrëshe shqiptare (Urquhart, 1839, 432-435). Në të gjithë këtë analizë dal me konkluzionin që këto dy artistë jo vetëm pasqyruan traditat, zakonet dhe jetën sociale të Shqipërisë dhe shqiptarëve të shek. XIX, por krijuan një fenomenologji të vërtetë nëpërmjet influencës së tyre

në veprat letrare, si ajo “*Childe Harold*” të Lord Byron dhe peizazhet e realizuara “*en plein air*”.

Përfundime

Në rrugëtimin përgjatë këtij kërkimi shkencor, arrita të shtjelloj elemente të rëndësishme shqiptare si; fustanella dhe peizazhi. Kërkimi në vetvete nëpërmjet analizës ikonografike dhe historiko-antropologjike arriti të nxirrte në pah se si shiheshin dhe përshkruheshin peizazhet, kostumet dhe traditat e Shqipërisë së shek. XIX. Ajo ç’ka këta dy artistë sollën me tablot e tyre për Shqipërinë, nuk ishte thjesht njohja e traditave dhe bukurive të kësaj province të Perandorisë Osmane (sikurse konsiderohej asaj kohe), por përcjellja e vlerave të verteta. Shqipëria shihej si mishërimi i një bashkëjetese të përsosur fetare, kulturore dhe mikpritëse, siç do t’i përshkruante në letrën dërguar nënës së tij poeti anglez Lord Byron. Në fakt kulminacionin ky kërkim e arriti me krahasimet estetiko-semiotike që bëhen mes veprave të Eugène Delacroix dhe Edward Lear, të cilët trajtuan më shumë se kush do tjetër artist subjekte nga Shqipëria. Shqipërinë të njohur në të gjithë Evropën përveç shumë piktorëve, do ta bënte edhe vepra letrare e poetit Lord Byron me titull “*Childe Harold*”, e cila ambientohet e gjitha në jugun e Shqipërisë. Analizimi i veprave të këtyre artistëve nëpërmjet këtij kërkimi me argumenta shkencore, më bënë të arrijë në konkluzionin se Shqipëria sado që në vitet e para të 1800-s nuk njihej aspak nga vendet e Evropës perëndimore, ajo pas mbërritjes së piktorëve më të njohur evropian të shek. XIX si: Jean-Baptiste Camille Corot, Jean-Léon Gérôme, William Turner, Paja Jovanovic, Rudolf Otto von Ottenfeld, Walclaw Pawliszak, Johann Frankenberger, Pietro Luchini, Ary Scheffer të kthehej në oazin më të shkëlqyer të pikturës romantike Evropiane.

Literatura

- Alberotanza, R. (2007), “*Gli itinerari del Consiglio d’Europa*”, *Questioni odeporiche. Modelli e momenti del viaggio adriatico*, Palomar Editore, Bari, f. 50-58.
- Curzon, R. (1849), *Visits to Monasteries of the Levant*, Lewiston NY: Edwin Mellen, London, f. 424.
- Hobhouse, J. C. (1813), *A Journey through Albania and Other Provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during the Yers 1809 and 1810*, James Cawthorn Publisher, London, f. 1152.
- Hobhouse, J. C. (1858), *Travels in Albania and Other Provinces of Turkey in 1809 and 1810*, II ed. John Murray, London, f. 203.
- Holland, H. (1815), *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia etc., during the years 1812 and 1813*, Longman, Hurst, Rees, Orme & Brown, London, f. 551.
- Hughes, T. (1820), *Travels in Sicily, Greece and Albania*, J. Mawman, London, f. 100-105.
- Leake, W. M. (1835), *Travels in Northern Greece*, J. Rodwell, London, f. 43-58.
- Lear, E. (1851), *Journals of a Landscape Painter in Albania, Illyria*, Richard Bentley, London, f. 23-29, 70-73, 222.
- Masiello, V. (2006), *Viaggiatori dell’Adriatico. Percorsi di viaggio e scrittura*, Palomar Editore, Bari, f. 88.
- Murray, J. (1854), *Handbook for Travellers in Greece, Describing the Ionian Island, the Kingdom of Greece, the Islands of the Aegean Sea, with Albania, Thessaly and Macedonia*, John Murray Publishing, London, f. 460.
- Noakes, V. (1979), *The Painter: Edward Lear*, Newton Abbot: David & Charles, f. 359.
- Peroni, G. (1994), *Marketing turistico*, Franco Angeli Editore, Milano, f. 122.
- Scianatico, G. (2007), *Scrittura di viaggio. Le terre dell’Adriatico*, Palomar Editore, Bari, f. 33-40, 488-493.
- Urquhart, D. (1838), *The Spirit of the East, Illustrated in a Journal of Travels through Roumelia during an Eventful period*, London, f. 432-435.



Eugène Delacroix, *Selimi dhe Zuleika, bojra vaji në pëlhur*, 1857.



Eugène Delacroix, *Dy ushtarë suliot, bojra uji në letër*, 1826,
Musée du Louvre, Paris, Francë.



Edward Lear, *Liqeni I Butrintit*, bojra vaji në pëlhur, 1872.



Eugène Delacroix, *Dyluftim mes shqiptarit dhe turkut*, bojra vaji në pëlhur, 1826, Musée du Louvre, Paris, Francë.



Edward Lear, *Lumi i Vjosës, bojra uji në letër*, 1848.



Thomas Phillips, *Lord Byron me veshje kombëtare shqiptare, bojra vaji në pëlhur*, 1813, National Gallery, Londër, Angli.

Administrimi i trashëgimisë kulturore në Luginën e Drinos, Gjirokastër

Prof.dr. Bektash Mema
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

Abstrakt

Përgjatë dekadës së fundit, një sërë institucionesh, universitare dhe vendore, shqiptare dhe të huaja, përmes projekteve me objekt hulumtimin, gërmimimin dhe studimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në arealin e Luginës së Drinos Gjirokastër, kanë hedhur hapa standartizues për menaxhimin e pasurisë arkeologjike me funksion parësor turizmin kulturor.

Në një sërë projektesh ndërinstitucionale, kryesisht shqiptare dhe italiane, që kanë shoqëruar njëra-tjetër, është trajtuar shkencërisht një territor i caktuar, në epiqendrën e të cilit gjenden të depozituara rrënojat e një prej qendrave më të rëndësishme urbane antike, që sipas dëshmive historike dhe arkeologjike, ka mbajtur emrat Hadrianopol dhe Justinianopol.

Në rezultatet e këtyre projekteve, çështja e pasurisë kulturore në Luginën e Drinos është sjellë: si mesazh i një filozofie të re në menaxhimin e pasurive kulturore (lidhjet komunitet-territor); me vlerësime integruese historike-kulturore dhe pejsazho-ambientaliste; si areal i prodhimit të kulturës, të argëtimit e të eksperiencave sociale; si mundësi potenciale për shfrytëzimin ekonomik dhe administrimin e ambientit; si analizë e ambientit në moment trasformimesh të vullshme e kaotike; si zhvillim i procesit të përgatitjes së burimeve të reja njerëzore; si evidentim i raporteve të ndërsjellta midis komponentëve përbërës të territorit; me marrjen në konsideratë të politikave të zhvillimit rajonal etj.

Fjalë kyçe: *administrimi pasurisë kulturore; Lugina e Drinos; vlerësime historike kulturore; vlerësime pejsazho-ambientaliste; administrim i ambientit.*

Hyrje

Gjatë dekadës së fundit janë hedhur hapa të vlerësueshëm për administrimin trashëgimisë kulturore në Luginën e Drinos, e cila gjithnjë e më shumë po trasformohet në një laborator natyror, ku studentët dhe studiuesit ballafaqohen me një trashëgimi të pasur kulturore, që nga prehistoria e hershme dhe deri në mesjetën e vonë.

Në funksion të këtij objekti, prej vitesh, në qarqet studimore universitare si dhe në qendra kërkimore-shkencore, që kanë patur për objekt studimor trashëgiminë kulturore, është shtruar pyetja kërkimore që areali i Luginës së Drinos të marrë statusin e një parku arkeologjik.

Mbështetur në rezultatet studimore, ideja e parkut arkeologjik për këtë luginë është sjellë: si mesazh i një filozofie të re në menaxhimin e pasurive kulturore (lidhjet komunitet-territor); me vlerësime integruese historike-kulturore dhe pejsazho-ambientaliste; si areal i prodhimit të kulturës, të argëtimit e të eksperiencave sociale; si mundësi potenciale për shfrytëzimin ekonomik dhe administrimin e ambientit; si analizë e ambientit në moment trasformimesh të vullshme e kaotike; si zhvillim i procesit të përgatitjes së burimeve të reja njerëzore, për të vënë në lëvizje pasurinë kulturore të Luginës së Drinos; si evidentim i raporteve të ndërsjellta midis komponentëve përbërës të territorit; me marrjen në konsideratë të politikave të zhvillimit rajonal etj.

Territori, ambienti, peisazhi apo mjedisi i luginës, spjegohen si hapësira tokësore, kufijtë e së cilës janë përcaktuar nga marrja në konsideratë e vlerave të caktuara kulturore dhe ambientale; si hapësira me tërësinë e kushteve ku jeton dhe zhvillon veprimtarinë njeriu dhe çdo qenje tjetër e gjallë, me tërësinë e kushteve shoqërore që veprojnë në një komunitet të caktuar njerëzor, i cili mund të jetë me përkatësi të njëjtë apo të ndryshme nacionale, fetare, arsimore kulturore, me tërësinë e kushteve (rrethanave) që ndikojnë në gjendjen shpirtërore të njeriut; me tërësinë e kushteve ku ndodhet i instaluar një objekt apo zhvillohet një dukuri; me tërësinë e elementëve që bashkëjetojnë dhe bashkëveprojnë tek objekte të caktuara etj.

Pra, territori i parë në tërë këto këndvështrime mund të jetë kompleks e me vlera të llojeve të ndryshme si: tokësore, ajrore, ujore, bimore, ekologjike, urbane, historike, arkeologjike, muzeale, arkitekturore etj.

Në disa projekte që kanë shoqëruar në mënyrë integrale njëra-tjetër, ku është përfshirë Universiteti “Eqrem Cabej”, Universiteti i Maceratës (Itali), Instituti Arkeologjik (Tiranë) është trajtuar shkencërisht një territor i caktuar në luginën e Drinos (Gjirokastrë), në epiqendrën e të cilit gjenden të instaluar rrënojat e një prej qendrave të rëndësishme urbane antike, që sipas dëshmimeve historike (FESH II, 2008, 875), ka mbajtur emrat Hadrianopol dhe Justinianopol (sipas emrave të perandorëve Hadrian dhe Justinian). Përmenden për here të parë përkatësisht në *Tabula Peutingeriana* dhe nga *Prokopi i Cezaresë* (shekujt V-VI)

Hapësira territoriale e përmendur, bazuar në procesin e kërkimit dhe studimit, është kryesisht një pejsazh i dominuar nga objekte që mbartin vlera arkeologjike dhe historike. Sipas studimeve gjeofizike, pjesa dërmuese e qytetit antik ndodhet ende në brendësi të tokës. Atje, padyshim mbijetojnë objekte me vlera të rralla. Ato, nën veprimin e faktorëve ekologjik abiotikë, të tillë si vetitë kimike e fizike të tokës, të ujit etj., kanë fituar një ekuilibër të caktuar mbijetese. Zbulimi i tyre gjatë procesit të gërmimit krijon marrëdhënje të reja me ambientin e hapur ku veprojnë faktorë ekologjik abiotikë si temperatura, lagështira, drita etj. Veprimi i tyre, në se nuk realizohet procesi i konservimit në kohën dhe kushtet e caktuara, mund të çojë në dekompozimin e përshpejtuar të materialit arkeologjik. Po bëhet kujdes që zbulimet të realizohen hap pas hapi, për të përballuar me sukses proceset konservuese, restauruese dhe rikonstruktuese.

Në projektet e kërkim-studimeve në Hadrianopol (pranë fshatit Sofratikë) është tentuar në shmanjjen e kufizimeve që mbartin kërkimet tradicionale. Ato nuk i kushtonin vëmendjen e duhur lidhjeve dhe vendosjes së raporteve ekzistuese midis komponentëve të ndryshëm të pejsazhit. Edhe pse pjesërisht janë bërë objekt kërkimi, kanë vuajtur nga dozat empirike. Të tilla konstatime ndeshen në temën e pasurive kulturore, vecanërisht në pasuritë arkeologjike.

Përgjithësisht studimet tradicionale nuk janë bazuar në hartimin e programeve të përshtatshme, të bazuara në principet e “Planit dhe Projektit”. Në rastin e Sofratikës, respektimi i një plan-projekti të standartizuar, mundësoi një vlerësim të drejtë të pasurisë arkeologjike, si dhe të elementëve të tjerë të pejsazhit që karakterizojnë këtë territor në transformim e sipër. Projekti në zhvillim po tenton të nxitë politikën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të territorit.

Vëmendja parësore, pas shpalljes së parkut arkeologjik të Antigonesë u përqëndrua tek qyteti antik i Hadrianopolit, i cili së bashku me qytezën antike të Melanit (pranë fshatit Nepravishtë) filluan të menaxhohen si pjesë integrale e parkut të përmendur.

Nisur nga interesimi i madh i turistëve dhe sidomos të huajve për të vizituar Teatrin e Hadrianopolit dhe rrënojat e zbuluara të qytetit të ndërtuar nga perandori bizantin, pas marrjes në administrim të këtyre dy sive të njohura, Zyra e Administrimit të Antigonesë ka organizuar veprimtarinë edhe për mirëmbajtjen dhe promovimin e Hadrianopolit dhe së Melanit, ku ndodhet e instaluar dhe një teqë bektashiane.

Vëmendja parësore e studiuesve, për vite të tëra, është përqëndruar te qyteti antik i Hadrianopolit. Institucionet kryesore shkencore që janë përfshirë në veprimtaritë kërkimore-studimore, kryesisht me projekte bilaterale, kanë qënë Universiteti i Maceratës (Departamenti i Shkencave Arkeologjike dhe Historike për antikitetin) nën drejtimin e Prof. Gianfranco Paci, Instituti Arkeologjik Shqiptar (Departamenti i Antikitetit) nën drejtimin e Prof. Neritan Ceka, Universiteti i Gjirokastrës (Departamenti i historisë), Universiteti i Kamerinos (Departamenti i Gjeomorfologjisë).

Prej tetorit 2005 filloi një ekspeditë komplekse kërkimore arkeologjike dhe gjeologjike, në afërsi të fshatit Sofratikë. Ekspedita u konceptua si një etapë parapërgatitore, për të filluar kërkime më të thelluara e sistematike, të finalizuara me realizimin e një projekti organizimi dhe menaxhimi për zbulimet arkeologjike të pranishme në zonën e Sofratikes (Rajoni i Dropullit-Shqipëri), 14 km në jug të Gjirokastrës (Projekti TAU, 2005).

Zona arkeologjike gjendet e vendosur në një terren luginor plotësisht të rafshët, me kuotë mesatare rreth 200 m mbi nivelin e detit, e kufizuar prej dy vargjeve malore me kuota më të larta se 1400 m mbi nivelin e detit.

Gjithë siti është plotësisht e mbuluar nga një shtresë aluvionale me trashësi rreth 2 metra, me përjashtim të teatrit, që del prej saj (edhe si rrjedhojë e gërmimeve arkeologjike). Zona e sinit përshkohet nga një mori kanalesh drenazhimi (që janë përdorur në të kaluarën e afërt dhe pjesërisht edhe aktualisht), me qëllimin për të evituar kënetëzimin, që është pasojë e grumbullimit të ujërave të shiut.

Lugina përshkohet nga lumi Drino, normalisht me prurje ujore të vogla, por që në periudha të papritura karakterizohet nga përmytje të fuqishme, të cilat ndërpriten nga periudha të gjata thatësire. Gjatë këtyre të fundit, kalohet në një tharje të plotë të shtratit të lumit. Aktualisht, shtrati i lumit Drino gjëndet rreth 300 metra larg zonës në studim.

Struktura më prezantuese dhe tashmë e njohur të ky sit arkeologjik, është padyshim teatri monumental. Ky element, së bashku me zbulimet me të fundit (përgjithësisht të rastësishme), lejuan të hipotezohet (Budina, 1975, 364-365; Bace, 1983, 255-256; Murray, 1994, 807) se kjo zonë korispondon me qytetin antik të *Hadrianopolis*. Ky qytet përmendet edhe në *Tabula Peutingeriana*, e cila e vendos atë përgjatë rrugës që lidhte *Apolloninë*, *Amantian* (Halil, 1998, 5-9; Murray, 1997, 750; Ceka, 2005, 283), *Hadrianopolis*, *Ilion* (Philippon-Kristen, 1956, 667; Hammond, 1967, 197, 696) dhe *Nikopolis*. Ishte një nga degëzimet kryesore të Rrugës Egnatia (*Via Egnatia*), që përshkonte edhe luginën e Drinos (Hammond, 1967, 694-696, 698-700; Pritchett, 1965 III, 278-288; Ceka-Korkuti, 1998, 382, 387, 408-410; Budina, 1975, nr. 8). Ajo lidhte me bregdetin një hapsirë që në pjesën më të madhe të saj ishte malore (Giorgi, 2004, 188; Giorgi, 2003, 96-97).

Midis gjetjeve që kanë kontribuar në identifikimin e zonës së Sofratikës, si vendndodhjen e qytetit romak Hadrianopolis, vlen të përmenden gjurmët e një nekropoli i vendosur në afërsi. Fillimisht ky nekropol është datuar për periudhën helenistike, por më vonë, në saje të gjetjeve dhe sontazheve të vogëla, është datuar në periudhën midis shek. IV para Kr. dhe shek. I pas Kr (Budina, 1975, 694-695; Bace, 1983, 256; Cabanes, 1986, 119).

Në krahun e kodrës, midis fshatrave Dhuvjan dhe Sofratikë, janë zbuluar mbetje varresh të periudhës helenistike dhe romake, elementë këta, që çuan në hipotezën e pranisë së një vendbanimi helenistik në afërsi të Sofratikës. Në afërsi të këtij fshati, më 1973, u zbulua një nekropol në të cilën, përveç objekteve që i perket periudhës bizantine, u gjetën ornamente të periudhës romake perandorake.

Gjatë hapjes së një kanali drenazhimi në vitin 2003, u kontaktua me struktura të tjera arkeologjike (Ceka, ATSH, 2003). Nëpërmjet interpretimit të tyre u sollën argumenta deçizive, në mbështetje të hipotezës për lokalizimin e qytetit romak të Hadrianopolis.

Tërësia e provave të përmendura, duke përfshirë dhe ato toponomastike konvergojnë në hipotezën e themelimit, ose të rithemelimit të një qendër urbane, me shumë mundësi për periudhën e Hadrianit. Për datimin e themelimit të kësaj qendër urbane, deri tani nuk disponohen të dhëna që të shkojnë përtej shek. II pas Kr.

Sipas dëshmive, midis periudhës së Traianit dhe Hadrianit, zona e *Epirit* (Sakellariou, 1997, 74-89) u shkeput nga provinca *Achaia*, në të cilën bënte pjesë. Ky ndryshim mund të ketë çuar në një riorganizim të kuadrit administrativ të zonës dhe parapëlqim të ultësirave për ndëtime urbane, të cilat ishin të lidhura më mirë me rrjetin rrugor rajonal dhe mbi të gjitha, ishin më afër hapësirave të shfrytëzueshme nga këndvështrimi bujqësor (Giorgi, 2004, 183-191).

Në periudhën e Dioklecianit, si pasojë e riorganizimit të sistemit të provincave, qyteti i Hadrianopolis kaloi nën *Epirus Vetus*, sikundër përmendet nga Hierokli (Hieroklis *Synecdemus* 651, 8), ndërsa zonat perëndimore të të njëjtës krahinë formuan *Epirus Novus* bregdetar.

Prokopi (Procop de Aes. IV 1, 36) na kujton ndryshimin e emrit të qytetit në periudhën e sundimit të Justinianit në *Ioustinianoupolis*. Ndërsa, pas themelimit të qendrës episkopale, emri i qytetit ndryshoi në Drinopoli (Not. Episc. III, 550).

Objekti më monumental i zbuluar deri tani është padyshim teatri i Sofratikës. Kanstatimet më të hershme për këtë teatër i përkasin arkeologut austriak K. Prashniker, i cili gjatë Luftës së Parë Botërore, sinjalizoi gjurmët e monumentit, që në atë kohë ndodhej ende nën tokë. Më pas ishte N.G.L. Hammond, i cili, edhe pse i interpretoi gjurmët mbi terren si ato të një amfiteatri, e solli monumentin në vëmendjen e komunitetit shkencor. Teatri doli në dritë vetëm në fillim të viteve '70 nga arkeologu A. Baçe. Nën drejtimin e tij u zhvillua faza e parë e punimeve, e cila rezultoi me nxjerrjen në dritë të teatrit.. Deri në vitin 2002, këto ishin strukturat e vetme arkeologjike të njohura

në Sofratike (Bace, 1973, 135).

Zbulimi i teatrit, shtoi vëmendjen e studiuesve për këtë sit arkeologjik. Bashkë me nevojën imediate për ta shndërruar në fitimprurëse këtë zonë, në kuadrin e sistemit arkeologjik shqiptar u stimulua mendimi shkencor për të përgatitur projekte vlerësimi të pasurive arkeologjike. Në vitin 2003, në kuadër të projektit komunitar Intereg III, Rajoni i Markeve, në bashkëpunim me bashkitë e Urbisaglias dhe Faleronës, Provincat e Maçeratës dhe Ascoli Picenos, Rajonit të Gjirokastrës si dhe Institutit Shqiptar të Monumenteve të Kulturës, promovuan një Projekt vlerësimi të quajtur TAU (Teatrot e Bashkuara Antike). Qëllimi: vlerësimi me anë të studimit, të zonave arkeologjike të paisura me struktura teatrore dhe amfiteatrore antike, për të bërë të mundur edhe zhvillimin e spektakleve teatrore. Universitetit të Maçerates (Departamenti i Shkencave Arkeologjike dhe Historike të Antikitetit) iu besua detyra e koordinimit shkencor të punimeve.

Në përmbajtje, të njëjtin synim kishte projekti dypalësh Shqipëri-Itali, "Studimi dhe menaxhim i pasurisë arkeologjike të luginës së Drinos", me kordinator Prof. Ganfranco Paci (Universiteti i Maceratës) dhe Prof.as.dr. Bektash Mema (Universiteti i Gjirokastrës).

Gjatë misionit të parë, të përfunduar në fundin e vitit 2005, u kryen procese që kishin për qëllim realizimin e të gjitha aktiviteteve parapërgatitore, të lidhura me organizimin e studimit si dhe me ndërmarrjen e ekspeditave të mëvonshme të gërmimeve.

Në morinë e proceseve të kësaj faze duhen përmendur:

- a. Realizimi i rilevimit arkeologjik të teatrit për t'i paraprirë studimit arkitektonik dhe mensiokronologjik të mureve, si dhe të nivelit të konservimit të vlerave
- b. Kontrolli i kërkimeve rastësore
- c. Realizimi i prospekteve gjeosizmike funksionale me qëllimin për t'u vënë në shërbim të studimeve të ardhshme.
- d. Kryerja e studimit gjeologjik të luginës së Drinos, në vecanti të zonës arkeologjike të Sofratikes, e lidhur kjo me nevojën e sistemit hidrologjik të kësaj hapësire, e cila është objekt i përmbytjeve periodike.

Të gjitha fazat e punimeve, që nga realizimi i rilevimit të monumentit dhe pozicionimit të tij në terren e deri në rilevimin e fushës, kanë qënë të shoqëruara me analiza telerilevimi (imazhe satelitore dhe fotografi ajrore) multispektrale dhe multikohore. Në studimet gjeologjike, vëmendja u përqëndrua në analizat e modeleve dixhitale të relievit dhe të dhënave klimatologjike të periudhave të ndryshme, për të cilat u përdorur metodologjia statistikore e ndyshimeve.

Tërësia e të dhënave (bazë, rrethanore, të pjesshme dhe përfundimtare) u grumbulluan mbi bazën e të dhënëve gjeoreferenciale, u menaxhuan nëpërmjet sistemeve informative gjeografike dhe u trasformuan më pas në formën më të përshtatshme hartografike.

Bazuar në pasurinë e trashëgimisë kulturore në gjithë shtrirjen e arealit të luginës (sipas studimeve të realizuara) rekomandojmë që kjo luginë të marrë statusin e parkut arkeologjik dhe njëherazi sugjerojmë që në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal të ndërmerren studime të mëtejshme dhe të bëhen investime infrastrukturore në funksion të turizmit kulturor.

Literatura

Bace, A. (1973), *Monumentet*, 4, Tiranë

Bace A. (1981), *Iliria*, XI, Tiranë

Bace A. (1983), *Iliria*, XIII, Tiranë

Budina, (1975), *Iliria*, V, Tiranë

Cabanes P. (1986), *Recherche Archéologiques en Albanie 1945-1985*, in "Revue Archéologique".

Ceka N. (2005), *The Illyrians to The Albanians*, Tirana.

Ceka N. (2003), "Adrianopoli një zbulim i madh", ATSH, Tiranë.

Ceka-KorkutI (1998), *Arkeologjia*, Tirana.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Vëllimi II, (2008), Tiranë.

Fosolo, M. (2003), *La via Egnayia*, Roma.

Giorgi 2003, *Il rilievo della tomba di Jorgucat, nella valle del Drino*, in De Maria, S. – Gjongeca, J. S. (edd),

Phoinike II, Bologna.

Giorgi 2004, *Agri Centuriati*.

HALIL 1998, *Albania archeologica*

Hammond, N. (1967), *Epirus. The geography, the ancient remains, the history and the topography of Epirus and adjacent areas*. Oxford University Press..

Hammond, (1983), N., *Travels in North Epirus and South Albania before II War*, in " Ancient World, 8.

Mucaj-Obdari, (2006), *Projektet dypaleshe Shqiperi-Itali, 2005-2007*, Gjirokastër.

Murray È. M., (1994), *Barrington Atlas of the greek and Roman Eorld, II*, Princeton.

Philippson-Kirsten, (1956), *Die Griechischen Landschaften. Eine Landeskute*, Band II, teilen I und II, Frankfurt Main, Ernst Kirsten.

Pritchett È. K., (1965), *Studies in ancient greek topography*, Amsterdam.

Sakellariou M. B., (1997), *4000 years of greek history and civilization*, Athens.

Teknika, tematika, simbolika e semiotika, sintezë autentike në krijimtarinë e Adem Kastratit

Shpresa Tolaj-Gjonbalaj
Doktorante pranë Qendrës së Studimeve
Albanologjike Tiranë, Shkolla Doktorale e Historisë së Artit

Abstrakt

Përzgjedhja e kësaj teme konsiston në spikatjen e vokacionit të krijuesit inventiv Adem Kastrati, i cili veprën artistike e artikulon përmes një teknike unike; përmes përdorimit të ngjyrave të dheut, si mjet e material piktural, pa përzjerje artificiale, duke vënë theks edhe në aplikimin e strukturës pikturale specifike, e cila deri tani konsiderohet të jetë e papërsëritshme në historinë e Artit Shqiptar..

Qëllimi:

Punimi ka për qëllim të ofroj një vështrim analitik mbi autenticitetin në teknikë dhe tematikë, në simbolikë e në semiotikën që përshkon artin e Kastratit, ku krijuesi në saje të remihencës së shtresuar në subkoshiençë që nga koha e fëmijërisë, me përkushtim atdhetarie, insiston ta lartësojë narracionin artistik të së kaluarës e traditës shqiptare, të jetës tokësore, truallit, njeriut, e trashëgimisë materiale e shpirtërore të vendlindjes.

Tendenca e piktorit që të krijojë art të kuptueshëm për të gjithë, përmes artikulimit të gjuhës së qartë figurative zë hapësirë të konsideruar në punim, sikundër zë vend edhe analiza e transmetimit të mesazhit të krijuesit tek receptuesi, në referencë të gjendjes psikologjike-shpirtërore.

Metodologjia:

Gjatë punës hulumtuese janë përdorë metoda standarde kërkimore-shkencore. Punimi bazohet në burimet primare dhe sekondare, analiza e drejtpërdrejtë e veprimtarisë së autorit dhe materiale e botime të ndryshme.

Rezultatet:

Sa i takon idesë, teknikës, tematikës, gamës së shenjave dhe simboleve të pasqyruara, piktori në universin e vlerave artistike të artit piktural cilësohet si shumë origjinal, ndaj zë vend të rëndësishëm në kulturën tonë kombëtare. Rrjedhimisht ky shkrim pasqyron një panoramë të veçantë të sintetizimit të specifikave autentike që e karakterizojnë veprimtarinë e krijuesit.

Konkluzioni:

Si rrjedhojë, përmes kësaj trajtese, krahas vlerësimit të krijimtarisë, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen edhe për një përkujdesje më të madhe nga Institucionet gjithëkombëtare shqiptare, ndaj veprave me vlera të çmuara kombëtare të piktorit të njohur Adem Kastratit, arti i të cilit u prezantua në 50 ekspozita individuale e kolektive nëpër vende të ndryshme të botës.

Fjalë kyçe: Kastrati, autenticiteti, simbolika, semiotika, mesazhi.

Hyrje

E vërteta mbi etnogjenezën se **“I lirët qëndrojnë në krye të historisë së popullit shqiptar”** (Buda,1978 ,11) dhe se **“Kultura e tyre ka përcaktuar trashëgiminë historike e kulturore të shqiptarëve të sotëm”** (Buda,1978,9) ka motivuar edhe piktorin Adem Kastrati, i cili përmes stilit të veçantë artistik, me një teknikë e tematikë të papërsëritshme, arrin të evidentojë thelbin e etnosit dhe të kulturës sonë kombëtare.

Në rrëfim këtyre gjurmëve të së kaluarës, me elemente e dukuri nga periudha ilire, në shpërfaqje të veçorive identitare, të mbijetesës, qëndresës dhe të zhvillimit të qenies sonë, me theks në arealin etnokulturor, është formësuar i gjithë opusi krijues i Adem Kastratit.

Transfigurimi i të vërtetës jetësore, në të vërtetën e artit piktural, si rezultat i përjetimit dhe perceptimit të shpirtit sublim, përgjatë ravijëzimit të krijimtarisë së artistit shënon vlera shumë dimensionale.

Trajtimi mjeshëtor kompozicional i tablove, është arritur si përpjekje e vazhdueshme e mishërimit dhe përjetësimit të çdo çasti që kishte lënë gjurmë në mbamendjen e tij. Si rrjedhojë, shëmbëllimi i kohës përkatëse, motivet identitare si dhe përshkrimi i mjedisve karakteristike kombëtare, ngelën

burim i pashtershëm frymëzues për këtë artist.

Ngjyrë dheu, veçanti, stil e teknikë unike

Gjuha shprehëse e piktorit e përvijimi ideo-tematikë, derivon nga forca e jashtëzakonshme shpirtërore. Ndaj duke pasqyruar tërë potencialin krijues në stil, teknikë e tematikë, ku çdo detaj realizues mban vulën shqiptare ai jep krijim unik.

Autenticiteti i tij spikat posaçërisht në përdorimin e ngjyrave të dheut, si mjet e material pa përzierje artificiale, por edhe në aplikimin e strukturës piktorale specifike.

Si kërkimtar i së bukurës, të madhërishmes dhe të veçantës, ai përzgjodhi pikërisht koloritin e tokës së vendlindjes, duke përvijuar kështu lidhjen e pashmangshme të së shkuarës dhe së tashmes, lidhje kjo që u përjetësua në sajë të aplikimit të artit të tij të veçantë.

Duke qenë se **kreativitetin e gjeti në dheun e Kosovës dhe duke menduar në këtë veçanti, përherë mbeti idili i shprehjes së tij**, nga kritika e deritanishme është thënë se **“Kjo shprehje, nuk është vetëm e veçanta e tij, por mbeti edhe e veçanta jonë në përgjithësi** (Aliu,2014,34)

Në kontekst të së veçantës individuale e kolektive, shquan përshkrimi etno-emocional si forcë e veçantë shprehëse, që nxit artistin drejt eksplorimit të së vërtetës kombëtare, për të shpërfaqë madhësitinë e autoktonisë si vlerë e veçanti e përbashkët e qenies sonë etnike. Duke vlerësuar lidhjet shpirtërore të piktorit me çdo gjë shqiptare, Sinan Gashi në shkrimin “Dheu i Kosovës është pikturë” shprehet se nga ato tablo krijohet përshtypja se autori **sikur kërkon që gjithçka në krijimin e tij të jetë autoktone, të jetë nga e jona, të jetë Kosovë. Edhe arti, edhe ideja, materiali e tematika**” (Gashi,2003,20).

Ndërsa piktori Zeni Ballazhi, në raport me stilin shpërfaqës në tërësinë krijuese dhe teknikën unike të Kastratit shprehet: **“Të bluash tokë(gurë) dhe të pikturosh me ngjyra dheu, duke treguar një realitet, një dramë të thellë nuk është e lehtë, aty vërehet një evoluim teknik dhe unik, një sofistikim i mjeteve shprehëse dhe tentativë për filozofim”** (Ballazhi, 2014,4).

Megjithatë pavarësisht vështirësive në gjetjen e teknikës unike, artisti në sajë të invencionit e mendimit filozofik, guximshëm gërmon dheun e tokës së atdheut, duke ngërthyer kështu ndërthurjen e teknikes unike, stilit dhe individualitetit krijues, si vulë e shprehjes së tij origjinale.

Originaliteti artistik shenjohet edhe përmes trajtimit të gamës koloristike. **Ngjyrat jo ekspansive të dheut, të tërhjekura e disi të shuara në vetvete, pos që na bëjnë të ndjehmë prezencën e kohërave të shkuara** (Sylejmani,2005,17) identifikojnë vetitë qenësore të qenies sonë kombëtare.

Tërësia e ngjyrave dhe nuancave në realizimet kompozicionale, domosdoshmërisht mundëson të kuptuarit esencial të thellësisë së mëmëdheut, si përvijim i ngrohtësisë së tokës me ngjyrë dheu, krejt të veçantë, pa përzierje artificiale, që duke sjellë kualitet të lartë të mrekullon. Dhe vërtetë **ngjyra e Kastratit ka erë dhe shije dheu , ngase ajo është njëmend nga dheu, ka për simbolikë thjeshtësinë e njeriut që është i lidhur me tokën** (Goqi, 1988,18).

Retrospektivë ideo-tematike mbi të vërtetën etnike

Eksplorimi i kujtesës popullore që ngërthen tërësinë e fizionomisë etnike; rite, ceremoni, doke, zakone, kostumografi tradicionale, traditë, epos legjendar, valle, lojëra e legjenda mitike gjer në burimin pagan, pos që mbetet përkushtim pankronik i mendësisë së Kastratit në krijimtari, në mënyrë të qartë shpërfaqë universin e njohurive të tij historiografike, folkloristike, etnografike, etnologjike, filozofike, sociologjike, kulturore e jetësore të mjedisit shqiptar.

Sekuenat jetësore të vendlindjes, shtresuar në vetëdijen e autorit, krahas shprehjes së tipareve psikologjike, sjellin atmosferën e kohës, në rrjedhat e retrospektives aluduese, duke sinkretizuar figuracionin, peizazhin magjepsës, traditën specifike, mitiken, epikën, tematikat sociale e identitare, që ravijëzojnë realitetin e së kaluarës shqiptare, përmes transfigurimit artistik, ku përmes shprehjes figurative me vlerat që transmetojnë, marrin formë, frymë e shpirt.

Edhe tragjikja, drama, dhembja, klithja pashmangshëm përshkrijnë veprat artistike, që rezultojnë si shpërthim i shpirtit të trazuar të artistit. Ai përmes shprehjes figurative shpreh revoltën përballë

rrethanave shtypëse të kombit, sikundër që reagon ndaj katrahurave, udhëkryqeve, frikës e dilemave ekzistenciale.

Me theks në tematikat e eksodit, shfaqet kuptimi i vërtetë i dhembjes së përjetuar. Figurat e sendërtuara, përmes formës, ngjyrës e ritmit, rrëfejnë, klithin e akuzojnë. Artisti duke shpreh fuqishëm shpërthimin e revoltës ndaj tragjedisë së popullit tonë, kërkon frymëmarrje e liri në kompozicionet piktorale.

Konceptimi revoltues i artit të Kastratit korrespondon me sentencën filozofike të Albert Kamy, i cili thotë “**Arti është revoltë, ngacmim i ekzistencës, dhe në çdo revoltë zhvillohet kërkesa për një botë tjetër**”.

Gamë e simboleve dhe shenjave autentike në krijimtarinë artistike

Sikundër e shquan koncepti ideo-tematik, stili e teknika unikalë, artin e Kastratit e karakterizon edhe pasuria e shenjave e simboleve, estetika, përmbajtja, mesazhi dhe komunikimi, që duke bashkëvepruar, përvijojnë stilin, fizionominë e autenticitetin e tij artistik.

Krijimtarinë e tij përgjithësisht e spikatë; transformimi i fenomenit estetik në kode të kthyerë në simbole, artikulumin e qartë figurativ, piketimin sugjestiv të shenjës, afinitetin për sintetizimin e njeriut dhe hapësirës, të formës dhe përmbajtjes, të mendjes dhe shpirtit në ekuilibrin harmonik.

Jeta tokësore, trualli, njeriu, trashëgimia materiale e shpirtërore e vendlindjes, shtresuar në subkoshiençën e piktorit, krahas narracionit shpiejnë edhe tek interpretimi semiotik, meqë **një vepër arti është njëkohësisht shenjë, strukturë dhe vlerë** (Mukarovsky, Çapaliku,2014,162)

Galeria e pasur e personazheve dhe portretizimi i tyre në gjendje të ndryshme psikologjike, veç se shquan karakterin konvencional të bashkimit të imazhit mendor me atë vizual (pamor), trajton me vëmendje formën dhe përmbajtjen, duke krijuar një sistem të tërë shenjash dhe simbolesh, përderisa nuk mungojnë as funksionet e dalluara të Jakobsonit, qoftë ai referencial, shprehës,estetik apo edhe bindës.

Maksima e Getes se “**Arti është ndërmjetësues i të pathënës “(Maximen und Reflexionen)**, (Sulejmani, 1971,164) shoqëron artistin gjatë gjithë krijimtarisë. Ndaj duke krijuar figurën në imagjinatë ai krijoj artin dhe të pathënën në art. Përmes karakterit të vijave, trajtave, ritmit e raporteve formale estetike, si shprehje origjinale, shenjëzohet brendia e tij, fryma e kohës dhe e hapësirës.

Piktori përmes kreativitetit artistik synon t'i ngjis në shkallë më të lartë arti, figurat nga toka e qielli, qofshin ato mitike, nga përditshmëria, apo tradita kombëtare e folklorike. Ai po ashtu lartëson simbolet e metaforat, personifikimet e shenjëzimet. Dhe duke përçarur mesazhe të veprave të krijuara, tenton të ndërtojë komunikim standard me receptuesin e veprës. Prandaj kjo tentativë lehtësisht kuptohet ngase artisti duke përdor gjuhën e qartë figurative, krijon art të pëlqyeshëm për të gjithë.

Gjersa analizojmë krijimtarinë e Kastratit, krijohet përshtypja se piktori i qëndron besnik citatit të *Auguste Rodin, i cili thoshte “Arti është veprimtaria më e përsosur e njeriut, sepse është shprehja e mendimeve që tenton ta kuptojë botën, edhe të tjerëve t’ua mundësoj ta kuptojnë atë”* (Sulejmani, 1971,164).

Përgjatë gjurmimit semiotik në artin e Kastratit, kuptojmë se shenjëzimi dhe simbolika, nis që nga teknika e pikturimit, e cila deshifrohet si vokacion i dëshmitë të superstrukturuara të autoktonisë së lashtë të trojeve shqiptare.

Teknika e tij përmban edhe kode tjera të veçanta, sepse dheu simbolizon tokën. Dhe simboli tokë është i lidhur fort me ekzistencën njerëzore. **Toka është organizëm i gjallë thotë Stipçeviç** (Stipçeviç,2014,504) ai po ashtu sqaron se **Mendimin për tokën si organizëm të gjallë e hasim në Antikitët, ku Platoni dhe autorë të tjerë “Nënës Tokë” i dhanë emrin Përendesha Geja “e gjallë”** (Stipçeviç,2014,505).

Nocionin tokë shpesh e hasim të lartësuar gjer te personifikimi *Nënë*. Dhe figurë qendrore në krijimtarinë e Kastratit mbetet pikërisht personazhi i gruas *Nënë*. Dhe *Nëna* arrin të shprehë tërësi kuptimesh, ndaj luan rol semiotik të shumëfishtë.

Artisti në vepra artistike shpërfaq botën shpirtërore të subjektit *Nënë*, ai shpreh atë që syri nuk e

sheh, por shpirti e përjeton, pra të brendshëm amnore.

Duke strukturuar ndjeshmërinë emocionale, si vlerë shpirtërore që derivon nga nocioni “ndjenjë amnore”, ai ndërthen të gjitha komponentët substanciale që sublimojnë tërësinë e nocionit të akcentuar; dashurinë, përkushtimin, gëzimin, ndjesinë, delikatesën, lumturinë, dhembjen, gjer në sakrificë e vetëflim për qenien e saj. Pra janë vijat, format, ngjyrat mënyrë konceptimi, nga përjetimi artistik, që shprehin të pathënën dhe të padukshmen, duke imponuar si mendim, dhembje, dashuri, dramë, estetikë, vërtetësi shpirtërore.

Figura e nënës përgjithësisht përfaqëson edhe riprodhimin, vazhdimësinë, bukurinë dhe simbolin femëror.

Përshkrimi thuaja analog në rrafshin semiotik, i tipizon edhe figurat tjera femra që vijnë si pjesë kompozicionale e veprave artistike. Ato i gjejmë të përkushtuara në shtëpi, në arë, në fushë, në ceremoni familjare e kudo që kërkohet. Disproporcioni i gjymtyrëve shënon refleksionin e jetës së mundimshme të gruas shqiptare.

Semiotikën e figurës femër e interpretojmë edhe me shquarjen e virtyteve esenciale që e karakterizojnë femrën tonë si: vigjilenca, madhështia, krenaria, dinjiteti, sakrificë. Përderisa gruaja pos si simbol i riprodhimit dhe begatisë, shenjëzohet edhe si simbol bukurie në aktet femërore që paraqesin rrëfime intime të artistit, në referencë të njohjes të së vërtetës së jetës dhe paraqitjes së hedonizmit estetik dhe bukurisë.

Marrë në tërësi, Kastrati në mënyrën e vet shquan poetikën dhe tiparet e gruas shqiptare. Ajo shfaqet si krijesë e bukur dhe e shëndetshme me të gjitha atributet fizike që e madhësojnë atë. Ndaj krijuesi krahas invencionit e nervit estetik për të ndërjet të bukurën, mjeshtërisht artikulon qartësinë e të shprehurit të drejtpërdrejtë në figura, simbole, shenja dhe komponente tjera.

Po ashtu piktori paraqet tiparet e burrit shqiptar, që si shtyllë e familjes qëndron pak kërrusur dhe hijerëndë. Autori shenjëzon vlerat e traditës e kulturës sonë kombëtare, me theks në virtytet më të larta që shquajnë burrin shqiptar. E figura e tij në veprën artistike, simbolikë ka burrërinë, trimërinë, heroizmin, qëndresën, besën e nderin.

Atë e gjejmë në ballë të sakrificës ekzistenciale, sikundër edhe në ballë të betejave duke ju përgjigjur thirrjes së atdheut. Në tablo të shumta e ndeshim edhe **në ceremoni dhe veprime për tu argëtuar; këngë, valle, lojëra, skena humoristike** (Tirta,2004,22).

Është e njohur se tematikë bazë e krijimtarisë së Kastratit mbetet bujqësia blegtoria, tiparet e kulturës shqiptare, veshjet tradicionale, ritet, ceremonitë familjare, veprimet argëtuese, kënga, vallja, lojërat, format e arkitekturës kombëtare, interieri me orendi- si thesar i trashëguar i kulturës materiale e shpirtërore.

Ky sintetizim i së kaluarës sonë, i përvijuar në formë fragmentare, duke qëndruar si konvencionalitet artistik në kompozicionet piktorale, ndonëse synohet të jepet në forma të drejtpërdrejta, prapë se prapë përmban shumë shenja të kthyer në simbole që kanë domethënie të veçantë.

Si aspekt semiotiko-simbolik mbeten ritet që kanë të bëjnë me ciklin e jetës, lindjen martesën dhe vdekjen, ku shquan posaçërisht kontrasti i fuqishëm i ritualit të dasmës dhe vdekjes, që thelbin e kanë në kulturën e lashtë ilire. **Mjaft interesant është riti i martesës me prikë dhe pajë, i praktikuar gjerësisht ndër shqiptarë. Filledën e vet ky rit duket se e ka tek Ilirët** (Lici, 2014,3).

Megjithatë edhe riti i vdekjes ka veçantësinë e vet, posaçërisht te interpretimi semiotik i vajtimit, si refleksion i aktit tragjik, ku pasqyrohet vajtimi i të vdekurit që shfaq fatqësinë njerëzore, si rit i traditës sonë kulturore, rrënjët e të cilit të çojnë në kohërat parahistorike.

Veshjet popullore janë pa dyshim një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato janë trashëguese e transmetuese të shumë elementeve që vijnë nga lashtësia dhe nga koha e mesme (Gjergji,2010,6).

Veshjet karakteristike tradicionale kanë simbolikën e vet në panteonin e veshjeve, të cilat kanë bërë një rrugë të gjatë nga Ilirët (Lici, 2014,3). Ndaj duke qenë njohës i spikator i traditës shpërfaq me shumë dashuri veshjet tipike popullore, për të gjitha gjinitë dhe grupmoshat, të cilat domosdoshmërisht sintetizojnë veçantitë simboliko-semiotike.

Element i rëndësishëm që njihet si vula jonë e lashtësisë, është **“Plisi i bardhë”**.

Pellazgo –ilirët e vendosnin poshtë helmët, ndërkaq në kohë paqeje vendosej për tu mbrojtur

nga shiu dhe të ftohtit. **Plisi pos që është simbol i lirisë, kthjelltësisë dhe pastërtisë shpirtërore të kombit shqiptar** (Anastasi,2013) është element i rëndësishëm i veshjeve kombëtare për meshkuj. Në veprën e Kastratit jo rrallë ndeshim **“Diellin”** si kult qendror, që u ruajt pa shkëputje nëpër kohë ndër Iliro-Shqiptarët. Nga mbijetojat e kulteve të lashtësisë është ruajtur kultu i diellit. **Kulti i diellit ka lidhje me kultin e zjarrit, vatrës-si burim drite e ngrohtësie, si dhe kultet bujqësore e blegtorale, sepse jeta e çdo gjallese në tokë varet nga dielli** (Gjergji,2010,4).

Galeria e plotë e simboleve dhe ruajtja e karakterit të brendshëm të pjesëve të mozaikut, gurët e mureve të kullës dhe elemente të tjera, pasqyrojnë një organizim të sintetizuar që korrespondon rrjedhshëm si në formë, ashtu edhe në referencë.

Autori sjell simbolikën e **“Kullës”** që përveç se si objekt banimi, mbetet simbol i rezistencës dhe qëndresës shqiptare.

Element i rëndësishëm i traditës së shtresuar, dhe që identifikohet me kullën, është **“Guri”**, që shquhet si simbol i forcës e qëndrueshmërisë. Po ashtu simbolizon pandryshueshmërinë.

Objektet materiale përgjithësisht dominojnë interierin e kullave. Trajtimi artistik i **Vatrës** pasqyrohet **si simbol i komunitetit familjar dhe sinonim i shtëpisë** (Dajaka,1962,110).Vatra ka funksion për ngrohje dhe ushqim, dikur edhe si burim drite.

Element i rëndësishëm padyshim mbetet **“Sofra”** - që **pos që shtrohet për të ngrënë ka simbolikën e virtyteve shqiptare - bujarinë** (Dajaka,1962,120).

Rol të rëndësishëm në ciklin e jetës luan **“Djepi”** që në të shumtën e gjejmë në tablotë artistike. Djepi **që përdoret si shtrat për fëmijë të vegjël, në origjinë dhe në kohën primitive përdorej si mjet transporti** (Dajaka,1963,74) por shenjzot edhe simbolikën e rritës, jetës së re, ninullave, etj. Enët e baltës, drurit, veglat bujqësore, instrumentet muzikore, kafshët si veçanti dhe si tërësi shënojnë vlera të përhershme dhe shumë dimensionale.

Gjatë interpretimit të simboleve dhe kodeve të narracionit në krijimtarinë e Kastratit përkufizojmë se i gjithë kompozicioni figural, gama dhe elementet strukturore në vetvete janë shenja, të cilat janë transformuar në simbole dhe bazë domethënëse.

Si rrjedhojë, meqë **vepra e artit mendohet të jetë ndërmjetëse mes krijuesit dhe komunitetit** (Mukarovsky, Çapaliku,2014,162) nga pozicioni receptiv, kuptojmë gjendjen psikologjike-emocionale, mendësinë filozofike dhe mesazhet domethënëse, që Kastrati i përçon përmes interpretimit të shenjave dhe simboleve, për t'i dhënë artit të tij kuptimësinë e shumë anshme.

Ndaj duke qëndruar përballë veprave të tij, përgjatë deshifritit të botës kuptimore të pikturës të cilën gjurmojmë, duke vënë theks në qenien e shenjës dhe simbolit, arrijmë në përfundimin se kompozicionet pikturale, krahas mundësisë së përjetimit të thesarit tonë të çmuar popullor, na ri nxisin t'i përjetojmë edhe ngjarjet e momentet e krijuara përgjatë të kaluarës sonë historike kombëtare.

Përfundim

Në saje të prirjes, talentit, punës së vazhdueshme, përkushtimit, autenticitet tekniko-tematik, piktori Adem Kastrati zë vend të veçantë në historinë e artit Shqiptar.

Përgjatë gjithë krijimtarisë Kastratin **e gjejmë të mishëruar me promovimin e vlerave tona, në nxitim të ndriçimit dhe përjetësimit të tyre në pikturë, nga frika se mos i zë harresa** (Sylejmani,2005,17).Ndaj pikërisht ky mishërim, e veçantia e shprehjes figurative që përvijon fizionominë etnike të kombit, bëri që arti i tij gjithnjë të flasë shqip.

Pra, **ai solli individualitetin, e pikërisht ky individualitet e bëri gjithmonë interesant, karakteristikë e tejet vizionarë në shprehjen autokton** (Aliu,2014,34).

Është e rëndësishme të theksohet se Adem Kastratin përgjatë gjithë jetës artistike asnjëherë nuk e ndeshim të preokupuar me trendet e stileve avanguardë, apo me ngarendjen pas pozicionimit elitare, por e gjejmë gjithnjë besnik kundrejt individualitetit të tij krijues.

Duke qenë se vokacioni artistik i piktorit u identifikua për autenticitet, veprimtaria e tij pikturale jo rrallë nxiti kritikën e kohës drejt shkrimeve analitike, Analiza këto që e renditën krijuesin në suazat

e krijimtarisë naive figurative. Mbase në referencë të shprehjes artistike të piktorit pa ndërmjetësues dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo aplikimit të elementeve të lehta naive si ravijëzim në vizatim e dekor.

Megjithatë bazat teorike, produkt i kualifikimit akademik të Kastratit, dëshmojnë **se si artist ai jetoj aktivisht të gjitha lëvizjet e mëdha piktorale të shekullit tonë, simbolizmin, fovizmin, kubizmin, dadaizmin, surealizmin dhe abstraksionizmi** (Ballazhi, 2014,4). Ndaj pavarësisht njohurive universale artistike **duke parë veprat e tij kupton se ai nuk ndryshon pikëpamjet e veta artistike e piktorale. Por vazhdon të njëjtën udhë deri në fund të jetës** (Ballazhi,2014,4). Si rrjedhojë përcaktimin e apostrofuar e vlerësojmë si joadekuatë dhe të kushtëzuar.

Se Kastrati del të jetë njohës i spikatur i të gjitha rrymave e drejtimeve artistike, dhe se për të shpalosur individualitetin artistik tipik shqiptar (pa u ngarkuar me huazime të formave shprehëse të të tjerëve) zgjodhi rrugën unike, e argumenton edhe vet piktori në një intervistë në fillim vitet e tetëdhjeta:

Është shumë keq që njeriu të ndjekë ndonjë drejtim verbërisht **dhe të bëhet rob i formës, stileve, drejtimeve** (Konushevc,1983,25). **Ndoshta në pikturën time hetohen elemente realiste, por hetohet edhe dimension i thelluar psikologjik. Piktura ime pos që ka karakter të theksuar autokton ka domethënie të caktuar simbolike. Prandaj kam të drejtë kur them se nuk i takoj artit naiv** (Konushevc,1983,25).

Edhe në intervistat e mëvonshme, i bindur për stilin e tij individual, ai shprehet: **“Unë nuk i takoj plotësisht asnjërit drejtim, nuk më interesojnë stilet, ndaj pikturoj në mënyrën time** (Sylejmani,2005,17).

Marrë në përgjithësi në mungesë të nocionit të përcaktuar përfundimtar, formën e krijimtarisë së tij, në stil, teknikë, e tematikë, e determinojmë si **“Kastratiane”**. Ngase kemi një stil të formuar që mund të quhet **“Stil i Kastratit”**. **Ndaj jemi të bindur se në historinë e pikturës sonë, në të ardhmen do të quhet teknikë e Kastratit** (Ndoci, 1973 ,16)



Dhe vërtetë krijimtaria e tij origjinale, legjitimon fuqishëm identitetin e lartë artistik të Adem Kastratit. **Ai mbetet Krijues që me origjinalitetin dhe stilin e tij të papërsëritshëm bëri epokë në fushën e pikturimi** (Sylejmani,2005,7)

Referencat

- ¹Buda, Aleks (1978) *Ilirët e Jugut si problem i Historiografisë, Studime Ilire I*, Prishtinë, Rilindja, fq.11.
- ²Po aty, fq.9.
- ³Aliu, Bislim (2014) *Kritikë arti –Kreativiteti i lartë në pikturën e Adem Kastratit*, Prishtinë, Gazeta -Kosova sot, fq.34.
- ⁴Gashi, Sinan (2003) *Dheu i Kosovës është pikturë*, Prishtinë ,Gazeta Bota sot, fq.20.
- ⁵Ballazhi Zeni (2014)*Katalog i ekspozitës personale të Adem Kastratit* , Prishtinë,Galeria e Ministrisë së Kulturës,fq.4.
- ⁶Sylejmani, Fatmir (2005) *Katalogu Adem Kastrati -Retrospektivë*, Shkup, NGM, fq.17.
- ⁷Goqi, Regjep (1988) *Piktura-Arti Bashkëkohor i Kosovës*, Prishtinë GAK,fq.18.
- ⁸Mukarovsky ,Jan (2014) *Arti si fakt semiotik, Çapaliku,Stefan,Estetika moderne dhe lexime tjera*, Tiranë ,Albas,fq.162.
- ⁹Sulejmani Sefedin (1971)*Filosofia dhe Artet*, Prishtinë,fq.164.
- ¹⁰Sulejmani Sefedin (1971)*Filosofia dhe Artet*, Prishtinë,fq.164.
- ¹¹Stipçevci,Aleksander,*Aktet, Vol.III.Nr.4*)www.alb-shkenca.org,Revistë shkencore e Instittit Alb, Tiranë,fq.504.
- ¹²Stipçevci,Aleksander, *Aktet, Vol.III.Nr.4*)www.alb-shkenca.org,Revistë shkencore e Instittit Alb, Tiranë, fq.505.
- ¹³Tirta, Mark (2004) *Mitologjia ndër Shqiptarë*, Tiranë, Mësonjëtorja, fq.22.
- ¹⁴Lici, Majlinda (2014) *Kultura shpirtërore dhe materiale, pjesë e qenësishme e identitetit kombëtar*,Tiranë, (<https://ëëë.academia.edu/>),fq.3.
- ¹⁵Gjergji, Angromaç, (2010) *Kultura tradicionale në Shqipëri*, Tiranë (<http://www.arberiaonline.com/>),fq.6.
- ¹⁶Lici, Majlinda (2014) *Kultura shpirtërore dhe materiale, pjesë e qenësishme e identitetit kombëtar*,Tiranë, (<https://www.academia.edu/>), fq.3.
- ¹⁷Gjergji Anastasi (2013)*Dita e plisit për të gjithë shqiptarët*, Tiranë, (<https://www.facebook.com/illyria.al/>).
- ¹⁸Gjergji, Angromaçi, (2010) *Kultura tradicionale në Shqipëri*, Tiranë (<http://www.arberiaonline.com/>), fq.4.
- ¹⁹Dajaka, Abaz (1962) *Enë dhe orendi të Dukagjinit*, Etnografia Shqiptare I, Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Sektori i Etnografisë, fq.110.
- ²⁰Dajaka, Abaz, po aty, fq.120
- ²¹Dajaka, Abaz (1963) *Enë dhe orendi të Labërisë*, Etnografia Shqiptare II, Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Sektori i Etnografisë, fq.74.
- ²²Mukarovsky, Jan (2014)*Arti si fakt semiotik, Çapaliku, Stefan Estetika moderne dhe lexime tjera*, Tiranë ,Albas, fq.162
- ²³Sylejmani, Fatmir (2005) *Katalogu Adem Kastrati -Retrospektivë*, Shkup, NGM, fq.17.
- ²⁴Aliu, Bislim (2014) *Kritikë arti –Kreativiteti i lartë në pikturën e Adem Kastratit*, Prishtinë, Gazeta -Kosova sot, fq.34.
- ²⁵Ballazhi Zeni (2014)*Katalog i ekspozitës personale të Adem Kastratit*, Prishtinë,Galeria e Ministrisë së Kulturës,fq.4.
- ²⁶Ballazhi Zeni,*Po aty*.
- ²⁷Konushevc, Abdulla (1983)*Piktura e vatrës, Bisedë me Adem Kastratin*,Prishtinë, Gazeta “Rilindja”,fq.25.
- ²⁸Konushevc, Abdulla, *Po aty*.
- ²⁹Sylejmani, Fatmir (2005) *Katalogu Adem Kastrati -Retrospektivë*, Shkup, NGM,fq.17.
- ³⁰Ndoci, Naxhi (1973) *Stil dhe teknikë e vetme piktorale*, Shkup,Gazeta “Flaka e Vëllazërimit”,fq.6
- ³¹Sylejmani, Fatmir (2005) *Katalogu Adem Kastrati -Retrospektivë*, Shkup, NGM, fq.7.

Literatura

- Buda, Aleks (1978) *Illirët e Jugut si problem i Historiografisë, Studime Ilire I*, Prishtinë
- Aliu, Bislim (2014) *Kritikë arti –Kreativiteti i lartë në pikturën e Adem Kastratit*, Prishtinë, Gazeta –Kosova.
- Gashi, Sinan (2003) *Dheu i Kosovës është pikturë*, Prishtinë ,Gazeta Bota sot.
- Ballazhi Zeni (2014)*Katalog i ekspozitës personale të Adem Kastratit* , Prishtinë,Galeria e Ministrisë së Kulturës.
- Sylejmani, Fatmir (2005) *Katalogu Adem Kastrati -Retrospektivë*, Shkup, NGM.
- Goqi, Regjep (1988) *Piktura-Arti Bashkëkohor i Kosovës*, Prishtinë GAK.
- Mukarovsky, Jan (2014) *Arti si fakt semiotik, Çapaliku,Stefan,Estetika moderne dhe lexime tjera*, Tiranë.
- Sulejmani Sefedin (1971) *Filosofia dhe Artet*, Prishtinë.
- Stipçeviç,Aleksander,(*Aktet, Vol.III.Nr.4*)www.alb-shkenca.org,Revistë shkencore e Institutit Alb,Tiranë.
- Tirta, Mark (2004) *Mitologjia ndër Shqiptarë*, Tiranë, Mësonjëtorja.
- Gjergji, Angromaq, (2010) *Kultura tradicionale në Shqipëri*, Tiranë (//http://www.arberiaonline.com/).
- Lici, Majlinda (2014) *Kultura shpirtërore dhe materiale, pjesë e qenësishme e identitetit kombëtar*,Tiranë, (<https://www.academia.edu/>).
- Gjergji Anastasi (2013)*Dita e plisit për të gjithë shqiptarët*, Tiranë, (<https://www.facebook.com/illyria.al/>).
- Dajaka, Abaz (1962) *Enë dhe orendi të Dukagjinit*, Etnografia Shqiptare I, Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Sektori i Etnografisë.
- Dajaka, Abaz (1963) *Enë dhe orendi të Labërisë*, Etnografia Shqiptare II, Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Sektori i Etnografisë.
- Konushevc, Abdulla (1983)*Piktura e vatrës, Bisedë me Adem Kastratin*,Prishtinë, Gazeta “Rilindja
- Ndoci, Naxhi (1973) *Stil dhe teknikë e vetme piktorale*, Shkup,Gazeta “Flaka e Vëllazërimit.



Identiteti, media dhe globalizmi

(PhD c) Rexhep Suma

Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Me globalizmin përsheptues të pesëdhjetë viteve të fundit janë rritur lidhjet midis jetës personale të tipit më intim dhe mekanizmave çrënjësorësh (të marrëdhënieve shoqërore nga kontekstet lokale të ndërveprimit). Mediet e komunikimit masiv kanë arritur kulmin e zhvillimit teknologjik dhe me këtë zhvillim sikur identitetet dhe kulturat që janë jashtë korporatave gjigante mbetet të izoluara dhe jo konkurruese në tregun global.

Përmes ndërveprimit shoqërorë, individi e mëson domethënien e fesë dhe e përjeton ndjenjën e identitetit personal dhe grupor. Njeriu në kontekstin social e përjeton fenë në mënyrë subjektive. Ai ndikohet prej kuptimeve të formësuar dhe të mësuara nga shoqëria.

Në kushtet dhe rrethanat e demokracisë së tanishme liberale, që Ballkani Perëndimor asnjëherë në historinë e vetë nuk i ka shijuar, identitetet kolektive në numër më të madh, duhet patjetër ta zvogëlojnë karakterin e vetë autoritarë (ngaqë, ai nuk konsiderohet si burim i lirive dhe i drejtave) dhe se përmes koncepteve neoliberalë ai duhet të na sigurojë të drejtat e barabarta. Raportet e reja shoqërore, sipas këtij principi janë të mundshme vetëm përmes sistemit politik – pra decentralizimit, rajonizimit dhe subrajonizimit.

Sot, në botë janë duke ndodhur procese të atilla, që sugjerojnë se në të ardhmen procesi i stabilitetit do të jetë shumë i diskutueshëm poqëse nuk ushtrohet procesi i decentralizimit.

Është sugjeruar shpesh se mediat kanë efekte potencialisht të thellë në formimin e identitetit social të të rinjve.

Rrjetet sociale në përgjithësi konsiderohen si një “zgatje e jetës së përditshme dhe një mjet i ndryshimit kulturor. Kështu, formimi i identitetit, si një koncept shoqëror, është duke u transformuar në mënyra të reja dhe madje edhe me përmasa globale.

Mediat në kohën e globalizmit pak hapësirë japin apo tregojnë respekt për traditën. E gjithë ideja e traditave fjala për të duket mjaft e çuditshme. Nga ata shpeshëherë lind pyetja se pse do të duam të bëjmë të njëjtën gjë si gjeneratat e mëparshme? Çfarë është kaq e madhe në lidhje me të kaluarën? Mediet e popullarizuara nxisin dëshirën për të krijuar mënyra të reja të jetës - brenda kontekstit të sistemit kapitalist.

Edhe pse çështja e identiteteve dhe trajtimi i tyre në mënyrë të duhur në media në shkallë globale mbetet një dëshirë që ekziston ndër popuj që do të duhej të kishin ndikim dhe peshë të respektimin dhe njohjen e identiteteve periferike.

Fjalë kyçe: *media, globalizmi, identiteti, subrajonizmi, korporata*

Hyrje

Nocioni globalizëm tashmë ka përfshirë çdo fushë të jetës, dijës dhe zhvillimeve të ndryshme. Epoka në të cilën jetojmë njihet si epoka e globalizmit. Ky nocion fillimisht u përdor si një përshkrim neutral i një procesi të qenësishëm në ndikimet botërore të revolucionit teknologjik. Një përkufizim ndihmës u dha në vitin 2000 nga profesori Çarls Doran, i cili e shpjegoi fenomenin si “ndërveprim i teknologjisë informative dhe i ekonomisë globale. Ai dallohet në sensin e intensitetit, fushës, volumit dhe vlerës së transaksioneve ndërkombëtare në sferat informative, financiare, tregtare dhe administrative anekënd botës. Një rritje e theksuar në përqindjen e këtyre transaksioneve në dekadën e fundit, rrjedhimisht edhe në nivelin e tyre, është manifestimi më i matshëm i procesit të globalizimit”. (Doran, 2000, 6).

Një nga pasojat e modernitetit është globalizimi

Ky është më tepër sesa përhapja e institucioneve perëndimore anembanë botës, ku shkatërrohen kultura të tjera. Globalizimi, i cili është një proces i zhvillimit të pabarabartë, që fragamentalizohet ndërsa ndërlihdet, paraqet forma të reja të ndërvarësisë botërore ku, për ta thënë edhe një herë, nuk

ekzistojnë të "huajt". Këto ndërvarësi krijojnë, në të njëjtën kohë, forma të reja të riskut dhe rrezikut, por nxisin edhe mundësi më të mëdha për sigurinë globale. As globalizimi i jetës shoqërore nuk janë procese që janë përmbyllur. Në botë ndodh që mundësohet shumë lloje përgjigjesh kulturore si një i tërë. Lëvizjet përtej "modernitetit" ndodhin në një sistem global, i cili karakterizohet nga pabarazi të mëdha të pasurisë dhe të pushtetit, të cilat ndikojnë vetvetiu këto lëvizje. (Giddens, 201,176)

Teknologjia moderne po e eliminon ndikimin e distancës gjeografike, ndërkohë që po shumëfishon llojshmërinë e mjeteve, sferën e shkatërrimeve dhe numrin e pjesëmarrësve të aftë për të planifikuar dhunë. Në të njëjtën kohë, reagimi kundër globalizimit e përqendroi zemërimin te Shtetet e Bashkuara si caku më i qartë. Në këtë mënyrë globalizimi universalizon cenueshmërinë, madje duket sikur e përqendron armiqësinë tek Amerika. (Brezinski, 2004, 24)

Në botën moderne ngjeshja e globalizuar është rrjedhim i sistemeve të komunikimit dhe teknologjive që krijojnë një menjëhershëri që para tre dekadave ishte e paimagjinueshme. Duke e shkruar këtë kapitull, kemi pasur mundësi që përmes "postës" elektronike të bisedojmë me shumë kolegë evropianë dhe amerikanë-jugorë, me qëllim që t'i marrim parasysh shkrimet e tyre të fundit. Imazhet e televizionit ato të internetit dhe të medias së shkruar, ua mbjellin njerëzve anekënd botës vetëdijes për një botë më të madhe. Shumë grupe që po i bëjnë ballë perëndimizimit, e kuptojnë se ngadhënjimi nga teknologjitë moderne mediatike e vështirëson pamazë izolimin e tyre prej ndikimeve globale. Ngjeshja moderne është fryt i globalizimit të veprimtarisë ekonomike. Përderisa në të kaluarën jo shumë të largët veprimtaria ekonomike kryesisht ka qenë lokale dhe rajonale, sot gjithnjë e më tepër horizonti i ndërvarësisë ekonomike është i zgjeruar, ai i përfshinë të gjitha shoqëritë, të gjitha kontinentet dhe së fundi, gjithë botën. Spektri i gjendjes ekonomike globale vështirë të imagjinohet. Ai do të thotë se vendimet e marra në vende të largëta nga njerëzit e fuqishëm e të panjohur ndikojnë në shumë aspekte të jetës ekonomike të përditshme të njeriut. (McGuire, 2007, 472).

Zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë

Identiteti gjithmonë nënkupton që individi të gjejë vend në një kolektiv shoqërorë më të madh: së pari kolektivi duhet ta pranojë këtë pozitë në mënyrë që individi të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë, e cila është e një rëndësie të madhe për vetëdijen e tij për vetveten dhe për mënyrën e sjelljes në situata të ndryshme në botë. Kjo zhvillohet në rrafshin simbolik dhe në këtë mënyrë krijohet ndjenja e përkatësisë shoqërore, njëherit edhe baza për vetëdijen për vetveten dhe për solidaritetin e mundshëm mes individëve dhe anëtarëve të kolektiviteve shoqërore, mes të cilave ekziston ndjenja e lidhjeve shpirtërore. (Castells, 2002b, 24).

Fundamentalizmi modern në të gjitha kulturat ka arritur sukses të pashembullt në politizimin e dallimeve kulturore, edhe përkundër faktit që edhe ai vetë në skena të ndryshme ku ka arritur fuqinë paraqet në forma jashtëzakonisht të ndryshme, mu sikurse edhe modernizimi kundër të cilit shpreh revoltën. Prandaj, ai nuk është një formë e re e fesë, por vetëm e fuqisë/ pushtetit. Në të shihet se edhe kultura politike që e karakterizon identitetin modern evropian nuk mund ta gjejë vendin e vet (pavarësisht se në çfarë tradite bazohet dhe çfarë forme të shpëtimit iu ofron besimtarëve të vet) nëse e respekton kornizën të cilën nuk mund vetë ta përcaktojë. Ndër të tjera edhe për faktin se kur është fjala për të tanishmen dhe të ardhmen, krishterimi nuk mund të jetë bazë e identitetit të Evropës. (Meyer, 2009, 98).

Identiteti luan rol kyç në komunikimin ndërkulturorë dhe ndër identitar duke shërbyer si urë lidhëse midis kulturës dhe komunikimit. Vitet pas Luftës së ftohtë qenë dëshmitare të fillimit të ndryshimeve të befasishme në identitetin e popujve e të simboleve të këtyre identiteteve. Politika globale nisi të riformësohej duke iu përshtatur vijave kulturore (Huntington, 2004, 17).

Krijimi i identitetit

Për dikë identiteti tingëllon si detyrim, derisa për të tjerët është ngushëllim. Ku me vetëdije thuhet

se identiteti-pasi që bart me vete pohimin përcjellës të përkatësisë në çdo rreth socio-kulturor- në njëfarë mënyre e përcakton jetën e njerëzve, si zakonisht mungojnë udhëzimet, se si ta vendosim, definojmë dhe ta mbajmë identitetin në shoqërinë moderne (si formë sociale që do t'i lidhë shumë shoqëri) dhe në fund të fundit, prej çka do të përbehej ai. Kalimet nga identiteti shoqërorë, kulturor dhe politik, kryesisht bëhet fluide dhe jo të përcaktuara, sikurse që shprehja e identitetit i lidh të gjitha këto aspekte, veçmas kur bëhet fjalë për Evropën . Kjo nuk është rastësisht kështu. Tema e identitetit evropian ka herë paraqet sfidë si për diskursin politik ashtu edhe për atë sociologjik. (Meyer, 2009, 9)

Të pretendosh se perceptimi nuk është realitet do të thotë të sugjerosh se imazhi subjektit është gënjeshtër. Duket qartë se nuk është gjithmonë kështu dhe shpresohet të jetë rrallë kështu. Është detyra e personave që merren me marrëdhëniet publike ta ndërtojnë dhe t'i rikthehen kësaj pike. Jo vetëm që detyra e krijimit të një imazhi pozitiv duhet të jetë përparësi absolute, por me këtë detyrë duhet të koordinohet edhe përgjegjësia e vlefshmërisë së faktit se imazhi nuk bazohet mbi tym dhe pasqyra, numra shpejtësie ose klishe të tjera që supozojnë mashtrime e marifete. Imazhi poashtu është është edhe sinonim i *reputacioni* , një term që lë të kuptohet një nivel vërtetësie, ndërsa *imazhi* merr një konotacion më sipërfaqësorë, ndoshta edhe iluziv. Këto dallime nuk janë të rëndësishme. Megjithatë, agjencitë kombëtare të marrëdhënieve publike është krijuar praktika të “menaxhimit të reputacionit” për t'i dhënë rëndësinë e duhur seriozitetit të kësaj çështje. Por askush nuk ka krijuar ende një praktikë të individëve, është e vërtetë se *veprat flasin më shumë se fjalët*, por fjalët kanë rëndësi në krijimin dhe ruajtjen e reputacionit. (Marconi, 2010, 70)

Ashtu siç e definojnë edhe komunikologu Rachel, pikërisht përmes komunikimit tonë (nganjëherë kompleks) me të tjerët, familjen tonë, miqtë dhe personat nga kultura dhe identitete të ndryshme ne arrijmë të kuptojmë vetveten dhe identitetin tonë. Gjithashtu, nëpërmjet komunikimit ne arrijmë të shprehim dhe përçojmë identitetin tonë të tjerëve. Njohja e identitetit tonë është mjaft e rëndësishme në ndërveprimet kulturore.

Themelimi për sëpari i vetëdijes së identitetit, hapësirës dhe kohës në kornizën e përvojës historike dhe të të vërtetave në veprim, është kushti *sine qua non*, i ekzistencës brenda historisë dhe mundësisë për të kontribuar në përvojën e njerëzimit. Është e pamundur të shpëtosh nga pasiviteti gjersa mendësia strategjike të mos jetë mbështetur në një pretendim ekzistencial... Ndërsa popujt të cilët rreñojnë vetëdijen e tyre të identitetit duke përjetuar një fraksion radikal në mendësinë strategjike, e vënë në rrezik ekzistencën e tyre historike, popujt të cilët e ngrijnë këtë mundësi duke e parë si mjet përjashtues ndaj popujve të tjerë, shpëputen nga vetëdija njerëzore e përbashkët dhe përjashtohen vetë. (Davutogllu, 2010, 50).

Globalizimi

Në librin e tij, të kthyer tashmë në klasik, “Çështje globalizimi” (1997), Ulrich Beck, sociologu më i madh evropian mbi këtë temë, pohon se globalizimi, në tërësinë e vet paraqitet si një proces në vazhdim të të cilit shtetet nacionale dhe sovraniteti i tyre kushtëzohen dhe lidhen në mënyrë të tërthortë nga aktorët ndërnacionalë, nga format e pushtetit, nga orientimet, identiteti dhe rrjetet e tyre... Në këtë kuptim, “specifika e globalizimit sot (e sigurisht edhe në të ardhmen) konsiston në shtrirjen, densitetin dhe stabilitetin, të spikatura empirikisht të rrjeteve, të lidhjeve reciproke rajonale-globale e të vetëpërcaktimit të tyre masmedior, ashtu si edhe të hapësirave sociale e të flukseve të tyre të imazhit në nivel kulturor, politik, financiar, ushtarak dhe ekonomik...”

Ndonëse përvijohet një ide e përgjithshme se era globale do t'i shkrijë kufijtë dhe dallimet midis kombeve, kulturave, njëlloj si tregjet dhe monedhat, është pikërisht e kundërta ajo që na mësojnë mendimtarët modernë. Identitetet kulturore në kushtet e globalitetit, nëse janë të forta e të thellë-rrënjësura, e veçanërisht nëse arrijnë të kultivohen, spikasin dhe kanë shumë më tepër mundësi të dalin në pah, se sa më parë. Shqipëria, qoftë me historinë, kulturën fetare, juridiko-zakonore, me krijuesit dhe heronjtë e saj, i ka të gjitha mundësitë ta lulëzojë identitetin e vet të spikatur edhe në këtë epokë të “fluiditetit” të shumë gjërave.(Kulla, 2010).

Të gjitha gjallesat krijojnë lidhshmëri me rrethin me anë të perceptimit dhe reagimit. Njeriu është

lloji i vetëm i gjallesave që reagimet çliron nga hegjemonia e perceptimeve. Sjellja e njeriut nuk janë të kufizuara me perceptimin e botës së jashtme dhe reagimin ndaj saj në momentin përkatës, sepse njeriu, bile edhe pas humbjes së trupave dhe ngjarjeve nga plani i perceptimit, mund të vazhdojë t'i përfytyrojë të njëjtit (trupa) në mendjen e vet. Njeriu me operacionet mendore mbi projektionet simbolike të trupave dhe ngjarjeve jep gjykime dhe merr vendime në lidhje me veprat që do t'i bëjë. Njeriu, me veprat që i bën sipas sipas vendimeve të tij jashtë ndikimit të stimuluesve konkretë të humbur nga plani i perceptimit, ngritët në një nivel më të lartë të sjelljes nga ai i të gjitha gjallesave të tjera. (Ozakupënar, J. (2009, 15)

Shumë shkencëtarë dhe politikanë socialë kanë një tendencë ta paraqesin islamën si një element të pakompromentueshëm përkundrejt konsensusit të përgjithshëm të komunitetit global. Konkluzioni i mëposhtëm i Fukajamës është një shembull i mirë e kësaj qasjeje: "Por, tani jashtë botës islame, duket se ka një konsensus të përgjithshëm që pranon kërkesën për një demokraci liberale që të jetë forma më racionale e qeverisjes, që është shteti, i cili realizon më së shumti, si dëshirën racionale ashtu edhe e njohjen racionale". (Fukajama, 1992, 212).

Mënyrë kategorizimi në vijën e "ne"- "ata" bazuar në dallimet kulturore të njerëzve dhe grupeve shoqërore. Për të kuptuar problemin e identitetit kulturor është e domosdoshme të studiohet funksioni i identifikuesit, gjegjësisht marrëdhënia mes identitetit dhe identifikuesit që më shpesh kanë të bëjnë me gjuhën, besimin, traditat, artin, dhe në përgjithësi faktet që e përbëjnë një sistem vleror.

Sipas Erving Goffman-it identiteti kulturor u mundëson grupeve shoqërore që në kontaktet mes vete të vetëpërcaktohen, t'i përcaktojnë grupet e tjera dhe të marrin qëndrim lidhur me to. Teoricieni amerikan S.Huntigton pohon se është identiteti kulturorë - e jo ideologjitë politike ose ndarjet ekonomike-faktori përkufizues i çintegritimit shoqërorë dhe konflikteve në epokën e pas Luftës së Ftohtë (Siljanovska, 2007, 27-28; Atanasov, 2003,13).

Në Evropë njerëzit janë mësuar që të jenë model për pjesën tjetër të botës. "Globalizmi evropian" është maja më e latë e kësaj shprehie. Me këtë rast shpeshherë harrohet se shoqëritë vetëm në kohë krize mësojnë të kalojnë në një faqe të re, prandaj edhe Evropës iu deshën shekuj të tërë të luftërave fetare, e më pastaj edhe dy luftërave botërore shkatërruese, me miliona njerëz të vdekur, për të parë se insistimi i vjetër në shtet nacionale e çoi në rrugën qorre dhe të tregojë gatishmëri që mbi vete të marrë rrezikun e rrugëtimit të paprovuar të bashkimit transnacional, që më vonë u konstatuan se paraqet shans të madh. Edhe përkundër suksesit të deritanishëm, që paraqet precedent historik, Evropa më askujt nuk i mban leksione. Aq më tepër që risitë që vijnë me modernitetin dhe globalizmin nuk mund të kapërcehen përmes metodave të vjetra dhe të provuara. Pasi që në mbarë botën diversiteti kulturor po bëhet gjithnjë e më i madh, edhe vetë Evropa duhet të mësojë shumë nga ky fakt, në realitet jo nga i gjithë rendi si tërësi, por gjithsesi nga disa fusha të rëndësishme. Për shembull Azia Juglindore, si një regjion që në procesin e unifikimit politik është shumë mbrapa Unionit evropian, por në mënyrën e bashkëjetesës shumëshkullore të pjesëtarëve thuajse të të gjitha religjioneve të botës, paraqet shembull, pra, respektimi i ndërsjellë i diversitetit, pa dominim dhe pa kulturë primare.

Evropa nuk është model i mirë, dhe i vetëm deri diku mund të shërbejë si shembull. Të gjitha religjionet botërore duhet të kontribuojnë në procesin e globalizimit pozitiv. Ky duhet të jetë proces i formimit të identitetit qytetar kozmopolit, nëse synojmë të ndalojmë zhvlerësimin gjithnjë më të madh të të drejtave dhe fuqisë vepruese të qytetarisë politike, e cila është kushtëzuar nga globalizmi negativ. Identiteti qytetar evropian mund të jetë pjesë e këtij kozmopolitizmi, por jo si diçka e veçantë që ka përparësi mbi të gjithë të tjerët, por si diçka e veçantë që ka përparësi mbi të gjithë të tjerët, por si i barabartë në mesin e të barabartëve ose në radhë të parë, si vetëdije dhe përgjegjësi e aktorëve lidhur me atë se bota ka nevojë të zhvillohet në këtë drejtim. (Meyer, 2009, 230)

Media rformatizon identitetin personal

Por në rrafshin media shohim se mediet sociale janë agjenci më të shtrira tani që i shërbejnë edhe riformatizimit të identitetit personal, pasi duke luajtur rolet në një fushë të mjegullt, me mundësinë

edhe të paraqitjes së vetvetes ashtu si dëshmojnë të jenë dhe jo ashtu siç janë, individit fillon të ndryshojë nga brenda emocionalisht dhe po kështu gjykon se këtë ndryshe e përcjellë edhe të bashkëkomunikuesit, numër të madh i të cilëve as i njeh dhe as do t'i njohë ndonjëherë. Mosnjohja i jep më shumë kreativitet po edhe konfuzitet emocional dhe po kështu edhe agresivitet psikik, duke e shndërruar nga një subjekt real në një subjekt virtual. Mashtrimi paraqitet kur një përdorues aktiv i faacebook-ut apo edhe i rrjeteve të tjera sociale, nga komunikimi simbolik, mendon se është tashmë një njeri shumë i popullarizuar, i respektuar, me profil të veçantë që i hap rrugën për veprime reale. Një formë e këtij komunikimi të diskutueshëm janë edhe shkrimet që mund të mos jenë të autorit në adresën elektronike. (Berisha, 2014, 65).

Konkluzion

Në përfundim, mund të thuhet se identiteti kulturor është në thelbin e imagjinatës bashkëkohore po aq sa edhe globalizimi me gjithë konsekuencat e tij.

Si rrjedhojë e saj, mediet dhe studimet mbi komunikimin e sidomos në sferën e shkencave sociale duhet të intensifikoj betejën në një fushë që është jo vetëm e gjerë dhe pjellore, por ka një sërë sfidash si aspekti konceptual, metodologjik, teorik edhe empirik.

Studimet mbi mediet dhe komunikimin nuk mund të kufizohet vetëm në mediet dhe teoritë e komunikimit, por që gjithashtu vazhdimisht duhet të vëhet në pah pasohu edhe fuqia e fushës së sociologjisë, historisë, politikës dhe studimeve kulturore që nga një aspekt i dhuron gjerësi dhe thellësi në korpusin e tyre të njohurive për të arritur tek analizat e shëndosha dhe interpretimet empirike reale.

Thënë në terma operativ, kjo do të thotë është tejet me rëndësi pasi që duhet kapur jo vetëm ato proceset dhe kushte që mund të shpjegohet lehtësisht në drejtim të homogjenizimit, heterogjenizimit apo edhe hibridizimit, por ne kemi nevojë për të zgjeruar dhe thelluar imagjinatën tonë edhe më për të kuptuar pasojat e papritura të globalizimit.

Në këtë mënyrë, ne hapim vetes liri veprimi më të gjerë dhe gatishmërinë në kërkimin dhe analizën tonë që do të pasuruar korpusin tonë të njohurive të shoqërive dhe komuniteteve, përkatësisht kulturës dhe identitetit të tyre që duket të jetë burim i pafund për imagjinatën bashkëkohore në këtë botë shumë të globalizuar.

Referencat

- Berisha, I. (2014), *Mediakultura*, PEN Qendra e Kosovës dhe Kolegji Universitar AAB, Prishtinë.p.65
- Brzezinski, Z. (2004), *The Choise: Global Domination or Global Leadership*, p.24.
- Castells, M.(2002b) *The Construction of European Identity* in, Rodrigues, Maria ban (Hag.), *The Knoëledge Economy in Europe*, Cheltenham, Nortempton.
- Davutogllu, A. (2010), *Thellësia strategjike*, Logos –A, Shkup, f.50-51
- Doran F. Charles. (2000), *Globalization and statecraft*”.p.6.
- Giddens, A. (2013), *The Consequence of Modernity*, përkthyer nga grup autorësh, Uet Press, p. 176, Tiranë.
- Huntigton, S. (2004), *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botërorë*. Logos –A, Shkup,p.17
- Kulla, N. (2010),<http://www.kosova-sot.info/> , gazetë e përditshme kosovare, 28 qershor, Prishtinë.
- Marconi, J. (2010), *Marrëdhëniet publike*. Uet Press, Tiranë, p.70.
- Meredith B. McGuire (2007).*Religjioni konteksti shoqërorë*. Shkup,Logos-A,p.472.
- Meyer, Th. (2009) *(Die Identität Europas:Der Eu eine Seele?* Suhrkamp Verlag, Fraknfurt am Main., përkthyer nga Skënder Latifi.
- Ozakupënar, J. (2009), *Kultura dhe qytetërimi një teori e qytetërimit*. Logos-A, Shkup, p.15
- Pajaziti, A. (2009), *Fjalor i Sociologjisë*, Logos-A, Shkup. p.253

Mënyrat e reja për të reflektuar ndaj realitetit

Mr. Zeni Ballazhi
Galeria Kombëtare e Kosovës

Abstrakt

Kemi të bëjmë me një fragment nga kati me i ri i artit te viteve te fundit që po zhvillohet në Kosovë. Mendoj që edhe tek ne është bërë një zgjidhje, dhe jemi te bindur se arti nuk është një çështje shijeje të përgjithshme, por një çështje zgjidhjeje personale. Zgjidhja kërkon kurajo dhe vendosmëri, ndërsa shija mbetet përherë e papërcaktuar dhe e pavendosur .

Arti që flet në këtë nivel është një instrument që ndërjegjëson për bashkëshoqërimet historike, që bën të ngjasin plot gjera, që ngre emocione që kërkon vlerësim, arti i cili nuk i drejtohet ndërjegjes se transfiguruar metafizike, por heton ne kushtet e ekzistencës tokësore dhe prandaj na provokon që t'i shohim gjerat ne një mënyre te re. Koncepti për artin formulohet vetë në kohën dhe vendin ku jetohet, si rezultat i intensitetit te veçante për filozofinë dhe artin bashkëkohorë, kërkohen mënyra më të reja për te reflektuar ndaj këtij realiteti që e jetojmë me intensitet.

Historia e artit si një tension më origjinal i gjuhës përmes një realiteti të jashtëm, e pareduktuar në një kronikë të thjeshtë por përkundrazi në një varge ngjarjesh domethense, bëhet kufi ndares ndërmjet shumë lloje të artit. Tani interesimi është për fenomenologjinë e objektit si edhe për atë të stileve të artit. Nga ana tjetër, sistemi i artit që përfshin artistin, kritikun atë të galerisë, koleksionistin, atë të muzeut, masmedian dhe publikun është bërë shtrati në të cilën zhvillohet produkti krijues. Arti perdoret jo vetem për të shtruar një problem mbi vetë artin por edhe për sistemin e artit, domethën për botën.

Një përshkrim jo për t'u çuditur i skenës "globale" në bajrak me botën e zhvilluar do t'i vendosë shumë krijues virtualisht diku mes ekstazës së katastrofës dhe terrorit të simulakrumit; duke pasë parasysh kontekstet e tyre: etnike, religjioze, linguistike, temperamentale, neurotike.

Fjalë kyçe: Arti, Koncepti, reflektuar, realiteti, Kosovë.

Hyrje

Shpesh në skenën e artit të këtij shekulli shfaqen artistë të cilët reagojnë në mënyrë "ikonoklastike" ndaj realitetit, mund të përmendim *surrealistet, neo-dadaistet, popsteret, neo-realistet, konceptualistet, neo-konceptualistet* etj. Për t'u bërë pjesë në këtë kornizë duhet të jesh artist i kompletuar, që e njeh mirë traditën realiste dhe që me sukses je në gjendje të riprodhosh natyrën.

Por si rezultat i intensitetit të veçantë për filozofinë dhe artin bashkëkohor kërkohen mënyra të reja për të reflektuar ndaj realitetit dhe për t'u futur në thelb të realitetit fenomenal.

Ambienti fizik dhe kulturor influencon në sjelljen shpesh që të shohim dhe kuptojmë se kush jemi ne në lidhje me vendin ku jetojmë. Artistët e rinj kanë vështrime të ndryshme mbi "botën", dhe ashtu i interpretojnë rrethanat kontekstuale-artistike të situatave të veçanta kulturore dhe duke u bazuar në këtë, këta artistë ridërgojnë motivacionet e tyre drejt reagimeve bashkëkohore, si për shembull, kërcënimin e shkatërrimit ambiental; apo aplikimeve teknologjike multimediale në përmasa ekstreme, shembulli tjetër. Të ndërtojnë, të tërheqin vëmendjen dhe të formulojnë aq sa momentet jetuan në një lidhje pothuajse shpirtërore me ambientin, është një tentativë për këta artinstalues quaji të rinj.

Në ekspozitën e të rinjve "NE" 2002, në Galerinë Kombëtare të Kosovës.

Shfaqja e këtyre art-punimeve nuk dëshironte të nxisë ndonjë drejtim apo rrymë, e as ndonjë situatë gjithëpërfshirëse; përkundrazi aspiroi të tregojë aksesibilitetin brenda kontekstit artistik në fluks konstant rekonfiguracionesh dhe ndërrimesh të vlerave kulturore, ose referencave të ndryshme. Njëri nga qëllimet ishte që të pranojmë artet sa të jemi të aftë të marrim pjesën tonë në rrafshin e diskutimit bashkëkohor që "bëhet sot në botë". Le të vazhdojmë të ushqehemi me ndjenja dhe të reflektojmë këta artistë dhe e vetmja matje për ta të jetë..."gëzuar".

Konkursi i parë i artistëve të rinj "Artistët e së nesërme 2002" që u organizua në Galerinë

Kombëtare të Kosovës ka sjellë këtë ekspozitë finale me gjashtë artistë të rinj. Ata si grup, dhe secili veç e veç, u prezantuan me një energji të re, dëshmuar se arti i Kosovës do të ketë ardhmëri dhe perspektivë, se po ecën me kohën. Dëshira e këtyre të rinjve ishte që të krijojnë vepra me vlerë dhe të kenë edhe prezantime sa më të denja të artit të tyre. Ekspozita ofroi qasje dhe vlera të ndryshme, prej atyre më tradicionale, deri te format e reja të shprehjes. Por, këto dallime të natyrshme për artin bashkëkohor, nuk janë edhe dallime në sensibilitet. Të gjithë ata ishin përfaqësues të një brezi që reflektoi problemet reale të kohës dhe mjedisit, me një ndjesi të njëjtë ose shumë të ngjashme ndaj proceseve shoqërore, dhe të pasqyrimin të tyre në artet pamore. **Koncepti i ekspozitës** “*Artistët e së nesërme 2002*” është korrespondues me këtë sensibilitet të artit të ri që krijohet në Kosovë, ngase projekti është suportues si për artin cilësor në mediumet tradicionale të shprehjes, ashtu edhe për çdo lloj risie dhe eksperimenti.

Për të transmetuar figurativisht mesazhe sociale, një art të ngrohtë emocionalisht ose për të strukturuar një materie më organike të jetës së përditshme, artistët e rinj paraqitën një koncept të ri, që i kthen në vlerë arti materialet dhe objektet fare ordinare e të zakonshme. Një hap më tej i dha këtij drejtimi organizimi i ekspozitës “*NE*” 2002 po ashtu me artistë të rinj dhe Ekspozita “*JU*” 2003 në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Krijimet apo veprat e artistëve të rinj duket sikur zyrtarizuan plotësisht ekzistencën e artit bashkëkohor në tokën kosovare. Ekspozita “*JU*” ishte një koncept, ide dhe pozicion i ndryshëm artistik i dhjetë artistëve të rinj nga Kosova në vitin 2003. Këtu nuk kemi të bëjmë me rryma të reja, por do të thosha me prurje të reja në artin tonë, të cilat vijnë si rezultat i lëvizjes së artistëve nëpër botë. Arti i këtij grupimi shfaqet si kundërvënie e artit të mëparshëm. Koncepti “*JU*”, në përgjithësi, ishte një provokim i fuqishëm dhe nëpërmjet tij këta artistë edhe e zgjerojnë idenë e artit. Nëpërmjet art-instalimeve të dhjetë krijuesve të rinj paraqiten pozita interesante dhe tipike të skenës së re artistike kosovare. Artistët e rinj përdorën një metodë të përbashkët artistike, e cila është konceptuale, ku në një art-instalim ideja ka më shumë rëndësi sesa paraqitja e saj fizike, ku më shumë përqendrohet në intelektin sesa në pamje. Në këtë moment artisti përfiton nga *JU*, edhe *JU* nga artisti. Ndoshta prirje, pra për të shikuar artin si komoditet është edhe një reagim i ashpër viteve të fundit në Kosovë. Mirëpo, marrëdhëniet ndërmjet veprës dhe konceptit *JU* ishin mjaft organike ku edhe ndihet një tendencë e pranueshme dhe një tendencë për ta zgjeruar dimensionin e artit bashkëkohorë në Kosovë. Madje, kjo veçori individuale e këtyre artistëve të rinj në këtë ekspozitë e shtoi edhe më shumë interesimin e vizitorëve. Këtë pozitë e karakterizon një organizim, përgatitje e survejuar e punimeve të këtyre artistëve në një mënyrë mjaft të qëlluar, që na ofroi larmi formash, përshëndetjesh dhe të panjohura të pafundme ku gjejnë shprehje hapësira dhe mendime të lira. I vetmi kriter vlerësimi për të nesërmen ishte realizimi artistik dhe paraqitja e tyre në botën e artit bashkëkohor.

Konkursi i artistëve të rinj “*Artistët e së nesërme 2007*” që organizohet në GKK erdhi me një koncept të ri “*Ideja se arti transformon dhe modifikon*”. Ky koncept kishte tendencën e krijimit të hapësirave të plota në mbështetjen e artistëve të rinj, të cilët me fantazinë dhe inteligjencën e tyre pamore, ndjeshmërinë dhe emocionin provokues shfaqën një art bashkëkohor drejt një realiteti të ri si një marrëdhënie e re artistike të grupuar në këtë ekspozitë, ku kishin një rast publikimi dhe ku kishin mundësi të ofrojnë tërësisht të rejat në artin e tyre.

Ne e përqendruam gjykimin tonë në prezantimin e veçantë të kësaj ekspozite.

Ekspozita “*Artistët e së nesërme*” u bëri jehonë përpjekjeve më të spikatura të artistëve të rinj për të gjetur shtigje të reja të daljes tek e nesërmja që u shpresua se do t'i bashkojë një ditë me botën e madhe të artit bashkëkohor dhe do të jetë në të njëjtën kohë një homazh ndaj të gjitha atyre përpjekjeve që u bënë për lindjen dhe mbajtjen gjallë të kësaj shprese qysh prej krijimit të artit e deri në ditët tona. Ata u nisën nga kjo vetëdije duke pranuar të punojnë nëpërmjet gjuhës specifike të artit, por edhe duke u përpjekur që ta reklamojnë këtë specificitet si projekt të transformimit të realitetit dhe duke e nënkuptuar artin si model të sjelljes alternative, prandaj edhe trokitën në dyert e botës së madhe të artit dhe të artistëve me përvojë. Këta jo vetëm propozuan përvojën e tyre si ndihmë në hapat e parë të kolegëve të rinj, por edhe mirëpritën eksperiencat e reja.

Fusha e veprimtarisë rrethohet nga zona e gjuhës së përdorur “*arti si art*”.

Punimet e vendosura në këtë ekspozitë ishin metafora të fuqishme të këtij realiteti që e jetojmë

me intensitet. Dëshira e këtyre të rinjve pjesëmarrës të këtij edicioni për të nesërmen ishte që të realizojnë një paraqitje sa më të veçantë dhe sa më të përafërt me vlerat artistike të dukshme dhe të pëlqyeshme.

Disa nga këta artistë fituan konkurse të ndryshme për të qenë pjesë edhe në ekspozita me karakter ndërkombëtar dhe me koncepte të veçanta si Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi Muslim Mulliqi” 2008 të organizuar nga GKK në një hapësirë të mbikëqyrur. Ajo që i bashkoi të gjitha projektet e ekspozuara ishte pjesëmarrja vizive në problemet e territorit urban, ku inteligjenca krijuese e autorëve ka konverguar nëpërmjet mjaft gjetjeve origjinale, që përbën dhe të veçantat e këtij ekspozimi. Aty u ndje që artistët ishin pjesë e problematikës disiplinore; ata me përdorimin e mjeteve vizuale kërkuan vazhdimisht të emancipojnë shoqërinë ku jetojnë, dhe kjo ishte një formë e re e disiplinimit. Kjo dukuri te shumë artistë u konsiderua si një cenim i lëvizjes në hapësirat publike, keqpërdorimet e informacioneve personale dhe shumë raste të tjera të cilat mund t'i quajmë forma të disiplinimit publik. Në originalitetin dhe individualizmin e kulturës ballkanike ndërhy mentaliteti evropian, ku afirmimi i individit lind nga siguria e një barazimi dhe përshtatjeje me një model jete të standardizuar. Për ta shfaqur më mirë këtë fotografim, disa artistë vendosën midis vetes dhe botës diafragmën e kamerës dhe aparatit fotografik, ku përmes objektivit mundësuan asgjësimin e çdo shfaqjeje individuale, e çdo dyshimi për privatësinë e individit. Ajo çka nxirret në pah ishte gjesti i stereotipizuar, i bërë publik si i tillë dhe i destinuar për konsum. Hapësira publike si shfrytëzim kohor i ambientit ku u ndërtua një mbështjellje hapësinore ndjek harmoninë, përpjesëtimin dhe simetrinë, përmasa që janë të banueshme në mënyrë metafizike jo nga njeriu, por nga hija e tij. Duke ndërhyrë nëpër hapësira publike të cilat janë të mbikëqyrura me anë të mjeteve të reja mbikëqyrëse, artisti ka zhvilluar një punë dimensionimi dhe reduktimi të hapësirës natyrale, duke përdorur mjete të reja të ofruara nga teknologjia bashkëkohore, si kërkesë në fillimin e epokës së teknologjisë. Veprimet e kësaj ndërhyrjeje në hapësirën publike të qytetit mbeten të ankoruara në vlerën e improvizimit që dëshiron t'ia kundërvë të jetuarit sistematik dhe të standardizuar një rreze të lirisë së menjëhershme. Brenda kësaj poetike ekziston edhe antropologjia e individit, arti që jeton në kontakt me hapësira të pastra dhe të painfektuara, i cili me ndërhyrjen e tij modifikon natyrën. Ndërhyrjet realizohen përmes mjeteve teknologjike bashkëkohore të këtyre artistëve pjesëmarrës ku e përballojnë ballafaqimin me sasinë e hapësirës që duhet përbaluar dhe realizohet një prekje, një përvojë me një hapësirë të pastruar dhe të lirë nga çfarëdo kushtëzimi, nga të gjitha aksidentet ndjesore të të jetuarit.

Çdo njeri mbikëqyr njeriun; Çdo njeri mbikëqyret nga njeriu; Çdo mbikëqyrje mbikëqyret nga njeriu.

E veçanta e edicionit të vitit 2009 tek “*Artistët e së nesërmes 2009*” në GKK, ishte ndryshimi i të kuptuarit ndryshe.

Ky ndryshim do të mbillet dhe do të rritet duke ndikuar konceptualisht tek shumë krijues te rinj të cilët do të kemi rastin t'i kemi prezentë edhe në vitet e ardhshme.

Galeria e Arteve e Kosovës këtë vit ka pasur nderin të ftojë kryetar jurie, artistin tonë bashkëkohor të njohur ndërkombëtarisht *Sislej Xhafa*, për përzgjedhjen e 6 finalistëve dhe fituesin e këtij edicioni. Ishte një nder për të gjithë ne po ashtu edhe për artistët e rinj ku shpresuam që këta të rinj t'i bashkëngjiten rrugës së suksesit të dëshmuar nga ky artist, e cila është një rrugë e gjatë me premtime dhe risi pambarim. Shumica (nëse jo të gjitha) e formave të kësaj rruge janë versione ekstreme të ndjenjave dhe sjelljes, të cilat shumë nga ne i kalojnë me eksperiencë.

“Ndoshta ju jeni zgjuar në mes të një ëndrre dhe për një moment të vogël nuk e dini cila është e vërtetë dhe cila është ëndërr. Imagjinoni të mos jeni të aftë të ndaloni ëndërrimin pasi ju jeni zgjuar. Kjo do t'u japë juve disa ide se si duket kur eksperimenton psikozat: një gjendje e mendjes në të cilën njerëzit nuk mund të ndajnë ndërmjet asaj që është e vërtetë dhe asaj që ndodhet në imagjinatën e tyre. Shpesh ajo që ata imagjinojnë është fiksuere dhe u shkakton atyre sjellje në mënyra të çuditshme. Kur ndjenjat tona janë shqetësuese dhe të papranueshme për ne dhe të tjerët, neve mund të na thonë se jemi të shqetësuar mendërisht”.

Është vështirë të klasifikosh diçka komplekse siç është sjellja njerëzore dhe, çdo përpjekje është destinuar të jetë e ashpër.

Dhe pikërisht këto çështje i trajton ekspozita Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor “NET/RRJET” 2011, e hapur në Galerinë “Expoart.40”, në Prishtinë. Ky ishte edicioni i dytë i kësaj ekspozite që për koncept ka temën “Teknologjia sociale” *Media art – Art media = pushtet social*, që ishte koncept global medialo-artistik, ku u prezantuan video-projeksionet, fotografitë, instilacionet dhe disiplinat të tjera konceptuale. Kjo ekspozitë pra ka për qëllim të provojë se mekanizmi informativ përkatësisht mediumi i mediave është përsosur, është fuqizuar aq shumë sa është shndërrua në energji, që drejtpërdrejt atakon qenien njerëzore, që madje mund të përmbysë edhe qeveritë, qeveritarët. Prandaj Norber Wiener, i quajtur baba i kibernetikës, sot me siguri nuk do të thoshte me aq komoditet e siguri se informata nuk është materie e as energji. Dhe pikërisht se informata mediale është energji e materializuar, *Milloseviqi* e aplikoi në politikën e tij gjenocidiale kundër shqiptarëve, duke e rrënuar në tërësi sistemin e gjykimit logjik dhe të arsyeshëm të popullit të vet. Struktura e medias mund të kontribuojë dukshëm në demokratizimin e shoqërisë, duke ndryshuar përmbajtjen dhe ristrukturimin e mediave. Teknologjia sociale është një përpjekje për t’ia përcaktuar kuptimin ambivalent mediave të reja ose teknologjive të reja drejtuar nga artistët që punojnë me këto media apo teknologji për të mbajtur pushtetin. On the one hand they are asking how much these media are being used for social conditioning, expressed in limitations, restrictions, surveillance and access control. Sa këto media janë duke u përdorur për të kondicionuar socialen? - a janë të kufizuara në shprehje, mbikëqyrje dhe kontrollimit të qasjes? - At the same time they are examining how much these media can be used to create new public and social links and structures and thus can be turned into their opposiSa këto media mund të përdoren për të krijuar lidhje të reja publike në strukturat sociale dhe kështu si mund të shndërrohen në të kundërtën e tyre. Here utopias involving a social function for media are directed mainly at alternative channels independent of the mass media. [[more](#)] [Joseph Beuys](#) is perhaps the best post-1960s example of an artist whose work changed sociePas viteve 1960 është ndoshta shembull më i mirë i [Joseph Beuys](#), puna e të cilit ka ndryshuar një pjesë të madhe të shoqërisë. Rather than adopting a perception of art that is formal and aesthetic only, his concept of «social sculpture» includes «the kind of human action that is directed at structuring and shaping society—Beuys calls it the «social organism».» [2] When seen in this way, art is not just a material artifact: it is also, and above all, action designed to have social consequences. Në vend të miratimit të një perceptimi të artit që është formale dhe vetëm estetike, koncepti social i tij në një skulpturë përfshin llojin e veprimit të njeriut, që ka strukturimin dhe formimin e shoqërisë, ku ai e quan atë organizëm social. Kur shihet në këtë mënyrë, arti nuk është vetëm një Objekt material - mbi të gjitha kjo është gjithashtu dhe veprim i projektuar që të ketë pasoja sociale. Beuys’ idea of relating plastic creativity to socio-political activities took up the social utopias of the historical avant-garde. Ideja e *Beuys* e bën krijimtarinë plastike në aktivitetet socio-politik, mori utopike sociale të avangardës historike. Beuys was not primarily interested in including and using media in this context, but many post-1960s artists have both addressed media explicitly, and also used them to pursue concrete socio-political aims. *Beuys* nuk ishte kryesisht i interesuar duke përfshirë përdorimin e mediave në këtë drejtim, por shumë postartistë kanë adresuar në mënyrë eksplicite në të dy mediumet, duke përdorur dhe duke ndjekur qëllimet konkrete socio-politike. They start by assuming that in a society increasingly influenced by media, an (artistic) change of media content or media structures can contribute significantly to democratizing society.

Over the past 150 years the audio-visual media (photography, film, radio, TV, multimedia) have gradually taken over an area of human perception that used to be reserved for the classical arts and their various genres (painting, music, theater). Pse artistët përdorin mediet?

Motivi i parë është një fakt, që është ndier thellësisht ndikimi i gjerë në humbje të artit modern dhe është e njohur në mënyrë të qartë Since the emergence of the avant-garde in the late nineteenth century, and at the latest in the early twentieth century with the arrival of abstraction and Cubism, advanced art ceased to be generally acceptable to the contemporary population’s aesthetic «common

sense.» The use of new technologies like film and radio, which are potential mass media, is associated with the hope that the avant-garde can be released from its self-imposed isolation so that «art and the people can be reconciled with each other,» as Guillaume Apollinaire put it in 1912 in the conclusion of his book on Cubism. [2]që nga dalja e avangardës në fund të shekullit XIX, dhe më së largu në fillim të shekullit XX me ardhjen e abstraksionizmit dhe kubizmit / arti i avancuar për kuptime estetike ka pushuar të jetë gjithmonë i pranueshëm në jetën bashkëkohore. Përdorimet e teknologjive të reja si filmi dhe radio, të cilat mediet masive janë të mundshme, është i lidhur me shpresën se avangarda mund të lirohet nga izolimi i vetë-imponuar në mënyrë që arti dhe njerëzit të mund të pajtohen me njëri-tjetrin. Këtu a (« [La Radia](#) » 1930).rti në masë të madhe bëhet një program politik nën të tilla ideologji krejtësisht të kundërta si të Revolucionit rus, gjerman dhe fashizmit italian. Walter Benjamin's epoch-making 1936 essay « [The Work of Art in the Age of Mechanical Reproduction](#) » [3] also addresses the social and political ineffectuality of the avant-garde and for the first time provides an all-embracing theoretical basis for a concept of art that is changed by the media: art should get over the limited quality of the manually produced original by using technical media, thus reaching a new audience and mobilizing that audience socially. Arti duhet të marrë cilësinë origjinale të prodhuar me dorë, duke përdorur teknikën e medieeve, duke arritur një audiencë të re dhe që audiencia shoqërore të mobilizohet. These basic ideas, communicated when they were revived in the 1960s in media-theory essays from Marshall McLuhan to Hans Magnus Enzensberger, greatly influenced the development of media art. [4] they act as leitmotifs for the pioneering days of video art, experimental film and audio art. Këto ide themelore, kanë komunikuar atëherë kur ata u rigjallëruan në vitet 1960 në teorinë e medieeve nga Marshal McLuhan me Hans Magnus Enzensberger, ndikuar në masë të madhe në zhvillimin e artit të medieeve.

The second central motive for artistic work with audio-visual media lies in their aesthetic potential to create image and sound experiences that have never been seen or heard before, in other words art forms that go beyond all known genres. Motivi i dytë qëndron në potencialin e tyre për të krijuar imazhe estetike, për punën artistike me mediet audio-vizuale dhe përvojat e tyre të shëndosha që nuk janë parë apo dëgjuar më parë, që shkojnë përtej të gjitha zhanreve të njohura. Thus in 1919 These new approaches to media aesthetics were conceived from the outset as a reaction to the increasingly technological nature and media acceleration of everyday perception. [7] This second motive also continues today in artists' analyses and deconstruction [8] of mass media. Këto qasje të reja estetike në mediet ishin konceptuar që nga fillimi si reagim ndaj natyrës teknologjike, gjithnjë e më të përshpejtuara në perceptimin e së përditshmes. Ky motiv vazhdon edhe sot e kësaj dite në dekonstrukcionin e medieeve dhe Examples extend from [William Burroughs'](#) literary cut-up via [Nam June Paik's](#) remix of TV images to [Dara Birnbaum's](#) systematic analizat e artistëve. Ne jemi duke parë një aleancë të re në mes të artit, teknologjisë dhe shkencës; Artistë që publikojnë raporte mbi programet e tyre të reja ose shfaqjen e modeleve në revista të specializuara dhe të pranishëm për diskutim në mbledhjet shkencore. Arti multimedial është duke krijuar fusha shumë të ndryshme, për shembull: artin e tele-prezencës, artin biocybernetic, artin robotik, Net artin, artin e hapësirës, eksperimente në nanotechnology, artificial or A-life art [7], creating virtual agents and avatars, datamining, mixed realities and database-supported art. nano-teknologji, duke krijuar kështu agjentët virtualë dhe avatars, datamining, realitetet të përziera dhe të mbështetur nga arti i të dhënave bazë. These specialist disciplines can be roughly assigned to the fields of telematic, genetic or immersive-interactive art, and subsumed under the generic term «virtual art». Këto disiplina të specializuara mund të caktohen përafërsisht në fushën e artit telematik, gjenetik apo immersive-interaktive dhe të përfshirë nën termin art.

Pikërisht këtë medium e trajtojnë shumë artistët nga Kosova si pjesëmarrës vendorë. Përndryshe në këtë ngjarje të rëndësishme artistike, pos autorëve nga Kosova, morën pjesë edhe artistë të njohur ndërkombëtar.

Kombinimi i mjeteve kritike dhe teknike në tranzicion vjen në ekspozitën ndërkombëtare të radhës “[NET/RRJET 2012](#)” në Galerine EXPOART40, e cila ofroi një mundësi të pashembullt për të punuar në kufijtë e artit, shkencës dhe teknologjisë, ku kanë lindur forma të reja të artit dhe mundësi

për të shpikur mediet e reja shprehëse. Një kombinim i mjeteve kritike dhe teknike për të përgatitur role udhëheqëse në art.

NET RRJET përfshin koncepte të ndryshme kulturore, teknologjitë audiovizuale, art abstrakt, rrjet teknologjik, kompjuterik, nanoteknologji, fizika dhe materiale shkencore. Edicioni i katër “NET RRJET 2012”, tregon se si teknologjia audiovizuale në bazë kërkimore ishte transformuar. Gjithashtu në masë të madhe dëshmohet që NET RRJET është i ndërthurur me shkencën - dhe si arti mund të luajë një rol të madh në zbulimin kundër trafikimit sipas shumë artistëve pjesëmarrës të cilët prekin tema aktuale nga më të ndryshmet.

Lëvizje moderne kundër trafikimit

Problemi i trafikimit modern mund të jetë rrënjësor, por është i zgjidhshëm. Ne duhet të ridyfishojmë përpjekjet tona për të luftuar skllavërinë moderne. Numrat mund të vazhdojnë të rriten, pasi kriza globale ekonomike ka bërë që një numër më i madh grash të jenë të ekspozuara ndaj rekrutuesve. Ne duhet të ridyfishojmë përpjekjet tona për të luftuar skllavërinë moderne.

Informacione komplekse

Evropa Juglindore në dy dekadat e fundit kalon nëpër ndryshime shumë dinamike. Ato mund të përshkruhen si një zinxhir në të cilin statusi politik i situatës dhe gjendjes ekonomike përcakton dhe ndikon në qasjen teknologjike të artit. Ky fakt shkakton vështirësi në përcaktimin e arteve të reja multimediale. Ne jemi një vend i vogël dhe mjaft të varfër në një situatë ku shumica e “krijuesve të kulturës” duhet të jenë vetë në gjendje të suksesshme. Nga ana tjetër kjo situatë e varfërisë na bën që të jemi më krijues, që të bashkëpunojmë jashtëzakonisht shumë rreth formave dhe ideve të reja. Jeta në shoqëri të vogla na jep shumë përfitime në punë grupore në marrëdhëniet e njëri-tjetrit. Gjithë njerëzit kudo që janë meritojnë të jetojnë të lirë, të punojnë me dinjitet dhe të ndjekin ëndrrat e tyre.

Koncepti kuratorial “TRANS-NET”, vjen në ekspozitën ndërkombëtare të radhës “NET/RRJET 2013” në Modelarium të Fakultetit të Ndërtimitarisë e organizuar nga “EXPOART40”.

Sot sistemet sociale janë nën stres të jashtëzakonshëm.

Personat e sotëm mesatar kalojnë shumicën e kohës së tyre në një lloj realiteti virtual. Kultura fizike dhe shoqëria ekzistojnë ende – por shumica e shmangin atë, në favor të aftësive hyjnore që ata mund të kenë një ekzistencë online. Sot për tu ndeshur drejtpërdrejt me një person, mik ose koleg është bërë shumë e rrallë. Në fakt, sot ndeshemi me më shumë forma të intelegjencës artificiale se sa me një frymëmarrje të gjallë njerëzore.

Interneti ka evoluar në atë që quhet si një mendje gjigante globale...

Teknologjia po ndryshon gjithçka, elimonon sëmundje të ndryshme, elimonon nevojën për luftë, monitoron nga afër shumë shtete të zhvilluara etj. Sot çdo burim i dëshiruar praktikisht me anë të teknologjive në dispozicion mund të sintetizohet automatikisht dhe në çast edhe nga shtëpia. Në vend të linjave telefonike tradicionale, këto lidhje janë bërë nëpërmjet internetit. P.sh. thirrjet e lira telefonike PC-me-PC mund të bëhen kudo në botë, në çdo kohë. Ky zhvillim i ideve dhe të informacionit në thelb sot është funksioni kryesor i ekonomisë globale. Ajo që ka rëndësi sot është informacioni prapa sendeve, sesa vetë sendet.

Një tjetër avantazh është transportueshmëria.

Interneti është një telefon i vogël dhe dritë e mjaftueshme për të marrë me vete kudo. Të dhënat personale të tilla si fotot digjitale, dokumente dhe dosje të tjera gjithashtu mund të transmetohen gjatë thirrjeve.

Bota e viteve 2050 do të jetë një botë e kontrasteve dhe paradokseve. Nga njëra anë, në përgjigje të krizave në zhvillim, shkenca dhe teknologjia kanë vazhduar për të avancuar sfidat dhe mundësitë. Kjo ka krijuar transformime radikale në gjenetikë, nanoteknologji, bioteknologji dhe fusha të ngjashme. Nga ana tjetër, shumë prej këtyre teknologjive të njëjta kanë qenë aq shqetësuese sa që ka çuar në një botë të paparashikueshme më të frikshme dhe kaotike se kurrë më parë. Njerëzimi tani është në një udhëkryq që do të përcaktojë rrugën e vet të ardhshme për shekuj me radhë - mbijetesë

ose shkatërrim, kolaps ose prosperitet.

“Save As”

Mjedisi fizik dhe kulturor ndikon në sjelljen tonë dhe influencon për të parë dhe kuptuar se kush jemi ne në raport me vendin ku jetojmë. Kufizimi shoqëror dhe ambiental si një e kaluar historike ruhet në kujtesë dhe sot ekspozohet për ta parë edhe të tjerët dhe ta ruajnë në kujtesë egoizmin. Pranimi i të dhënave të këtij realiteti transformohen në të dhëna konceptuale në të cilën përmbledhet një sasi fizike e hapësirës, duke e pastruar atë nga të gjithë aksidentet ndjesore, të të prekurit, të të dëgjuarit, të të nuhaturit me të cilat zakonisht jemi në kontakt, duke e çuar atë në kushtëzimin fenomenologjik të një mbështjelljeje e cila përforcon, thjeshtë për shkak të izolimit të vetvetes, perceptimin psikosensual të spektatorit. Natyra organizohet në një ligjeratë rituale që i kushtohet komunitetit, ku elementi natyral transformohet edhe në një çlirim të inkoshientit dhe të përdorimit shoqëror.

Çlirim nga përgjegjësia për të përshkruar botën si fakt ishte në edicionin e gjashtë të ekspozitës ndërkombëtare të artit bashkëkohorë “*NET/RRJET 2014*” e cila u mbajtë në Galerinë e Fakultetit të Arteve në Prishtinë.

E gjitha kjo është një rrugë e gjatë e cila na premtton originalitet dhe novacion pambarim.

Literatura

Oliva, A. B. (1996). *Arti deri në vitin 2000*. Tiranë: Marin Barleti.

Mulliqi, L. (2005). *Kosova Fenix*. Prishtinë: Galeria e Arteve e Kosovës.

Dukagjini, L. & Ballazhi, Z. (2008). *Mbikëqyrja dhe disiplinimi në hapësirën publike*. Prishtinë: Galeria e Arteve e Kosovës, 20-21.

Gombrich, E. H. (1991). *The Story of Art*

Lucie-Smith, E. (1995). *Art Today*, Phaidon.

Fillimet e teatrit të baletit në Shqipëri

Prof. Asoc. Roberta Ndokaj
Universiteti i Arteve – Tiranë

Abstrakt

Arti i baletit në Shqipëri është i vonshëm për shkaqe të njohura historike. Zanafillat e tij, në forma rudimentare dhe ende të pakultivuara, nisin diku në vitet '30 falë disa vallëtarëve të pasionuar që nëpërmjet kurseve private dhanë mësim për një kërcim të kultivuar e modern, kryesisht me nxënësit e gjimnazeve, studentët si dhe elitën e vendit, më së shumti në lloje kërcimesh të thjeshta e të një gjuhe ndërkombëtare si vals, tango, fox-trot etj. Fill pas çlirimit të vendit, në sajë të një politike nxitëse të shtetit, u krijuan grupet e vallëtarëve, ai i vallëtarëve në Pallatin e Pionierëve në Tiranë dhe ai i vallëtarëve të rritur në Pallatin e Kulturës Tiranë. Për ta ngritur në nivele profesioniste u kërkua ndihmë nga institucionet e artit nga Bashkimi Sovjetik e vende të tjera të “demokracive popullore” të Lindjes. Ishte koreografi i njohur rus Georgi Perkun, i cili vuri në skenë për herë të parë disa pjesë me një koncept tërësor koreografik duke i dhënë mundësi trupës të përvetësuar teknikat e kërcimit klasik.

Premiera e parë e baletit shqiptar është quajtur “Vëllazërimi i popujve”, 1950, si kurorëzim artistik i grupit të valleve të Filarmonisë Shqiptare. Si shfaqje fillimtare e përruruese ajo ishte një mix me valle shqiptare dhe valle nga popuj të ndryshëm të “demokracive popullore” dhe të Bashkimit Sovjetik.

“Shatrivani i Bahçisarajit”, nga veprat më të mëdha të baletit rus dhe atij botëror, me një subjekt bazuar mbi poemën e njohur të poetit të shquar rus Aleksandër Pushkin, arriti të sublimojë përvojën e deriatëkohshme dhe të realizojë një nivel mjeshtërie të domosdoshme në ekzekutimin dhe interpretimin artistik të valles. Premiera u dha më 29 prill 1951 me rastin e festës së 1 Majit.

Ndërsa baleti “Zhurale”, 3 shkurtit 1952, ishte një himn mbi njeriun, mbi forcën dhe idealet e tij të pastërta. Megjithatë të rinj artistët i dhanë publikut një shfaqje të bukur e të një niveli të lartë artistik, përfshi solistët, orkestrën dhe gjithë trupën e balerinëve dhe artistëve të tjerë. Kjo shfaqje u pasua më 31 mars 1952 me premierën “Flamuri i paqes”, një suitë vallesh popullore të trevave të ndryshme folklorike të vendit, e cila u vlerësua si një hap i parë i suksesshëm nga format e ulëta popullore koreografike drejt formave të përpunuara e të larta, ku baleti shfaqet tanimë si art i kultivuar, tërësor dhe i përshkuar nga linja, ide, konflikte e subjekte dramatike.

Fjalëkryçe: baleti, art, shqiptare, koreografi, valle

Hyrje

Arti i baletit në Shqipëri është i vonshëm për shkaqe të njohura historike. Zanafillat e tij, në forma rudimentare dhe ende të pakultivuara, nisin diku në vitet '30 falë disa vallëtarëve të pasionuar që nëpërmjet kurseve private dhanë mësim për një kërcim të kultivuar e modern, kryesisht me nxënësit e gjimnazeve, studentët si dhe elitën e vendit, më së shumti në lloje kërcimesh të thjeshta e të një gjuhe ndërkombëtare si valcer, tango, fox-trot etj. Fill pas çlirimit të vendit, në sajë të një politike nxitëse të shtetit, u krijuan grupet e vallëtarëve, ai i vallëtarëve të vegjel në Pallatin e Pionierëve në Tiranë dhe ai i vallëtarëve të rritur në Pallatin e Kulturës Tiranë. Për ta ngritur në nivele profesioniste u kërkua ndihmë nga institucionet e artit nga Bashkimi Sovjetik e vende të tjera të “demokracive popullore” të Lindjes. Ishte koreografi i njohur rus Georgi Perkun, i cili vuri në skenë për herë të parë disa pjesë me një koncept tërësor koreografik duke i dhënë mundësi trupës të përvetësuar teknikat e kërcimit klasik. Në këtë kumtesë ne do të qëndrojmë në tri shfaqjet e para, që luajtën edhe rolin promovues të Baletit Shqiptar si institucion profesionist.

1. Premiera e parë e baletit shqiptar është quajtur “Vëllazërimi i popujve”, 1950, kurorëzim artistik i grupit të valleve të Filarmonisë Shqiptare. Ishte një mix me valle shqiptare dhe valle nga popuj të ndryshëm të “demokracive popullore” dhe të Bashkimit Sovjetik, një fantazi koreografike si dhe vallja finale “Vëllazërimi i popujve” si potpuri vallesh të të gjithë popujve. Paçka se nuk e kishte formatin e një baleti me libret dhe muzikë enkas të kompozuar, ajo vlerësohet si shfaqje fillimtare e përruruese. Ideja që e përshkonte që ajo e forcimit të dashurisë së gjithë popujve, një utopi e manipuluar fort nga propaganda komuniste për efekte politike, përfshi vullnetin për mbrojtjen e paqes në botë, mbrojtjen e atdheut etj. Lëvizjet dhe mizanskena e valleve, të kompozuar nga koreografi Perkun, krijoi figura

të bukura, imazhe dinamike e lëvizëse plot gjallëri dhe finesë, ku shprehej shpirti i popujve të ndryshëm, ajo çka e dallonte çdonjërin syresh, shenja kombëtare, karakteristika antropologjike e gjithkujt dhe në tërësi sjellja e një mozaiku koreografik shumëngjyrësh. Sa i përket ansambllit të vallëtarëve shqiptarë, u vërejt përpjekja për përvetësimin profesional të lëvizjes, kërcimit, harmonisë së gjestit me mimikën, të ritmit me elegancën plastike, ku sipas shtypit të kohës, filluan të spikatën talentet e rinj si p.sh. Melushe Bebeziqi, Ganimet Vendresha, Besa Morina, Mellania Terca e Adivije Sharofi, në vallet me karakter lirik “Juroçka”, “Julla”, “Suitë vallesh ruse”, “Ngopak” dhe në shumë fragmente të valles “Vëllazërimi i popujve”. Bashkë me elegancën, ritmin, vijat e bukura, plastikën, gjestin ekspresiv balerinat i dhanë valles edhe diçka nga e tyrja, krejt origjinale, diçka nga e brendshme që buronte vetiu nga dhuntitë e tyre natyrale, nga përvetësimi i ashtit etnik kombëtar të vallëzimit popullor, nga kujdesi për rritjen e cilësisë artistike dhe përpunimin me mençuri të materialit koreografik burimor shqiptar dhe atij të popujve të tjerë, çka e gjitha u reflektua në bukurinë dhe fuqinë e shprehjes artistike koreografike. Po këtu spikatën edhe valltarët e rinj Sadik Batku, sidomos Agron Aliaj në interpretimin e valles rumune “Julla”. Në vallet heroike “Presin me tagana” dhe “Martina” spikatën për një interpretim epiko-heroik valltarët Fatmir Struga, Agron Aliaj e Mehmet Myftiu, po kështu kërcyen bukur Zoica Haxho, Xhemil Xhelali dhe i vogli Gëzim Kaceli, që u vlerësua për lirshmërinë dhe harenë e sjellë në skenë. Koreografi Georgi Perkun pati meritën se ravijëzoi, përpunoi dhe inskenoi disa nga vallet popullore më të njohura shqiptare siç qenë “Kërcimi i logut”, “Presja me tagan”, “Matina”, “Devollçija”, “Dadoja”. (Jakova, 1950) “Vallja që entuziazmoi gjithë spektatorët, - shkruante Kolë Jakova për shfaqjen “Vëllazërimi i popujve”, - dhe që qe një gjë fare e papritur për të gjithë, për madhështinë dhe bukurinë e kompozicionit dhe për kuptimin e saj të lartë, qe vallja “Vëllazërimi i popujve”. Ajo zgjati 25 minuta, por për spektatorin ajo qe një valle që filloi, u rrit dhe mbaroi pa u kujtuar njeri se sa zgjati. Kjo rrjedh nga zotësia e kompozicionit të valles dhe rrugës së drejtë dhe të bukur që i jepet asaj”.(Jakova, 1950)

Vlerë shfaqjes i shtoi edhe kostumografia, e cila krijoi hijeshi dhe begati ngjyrash, prerjesh, stiles. Orkestrina e grupit të valleve, ndonëse e re në përbërje dhe me pak eksperiencë, ndonëse e pakompletuar dhe me mungesa në disa instrumente, arriti megjithatë të krijojë atmosferën e domosdoshme, falë një përcjellje melodike korrekte, falë një strukture instrumentale funksionale si dhe falë një përpunimi osketral, të cilat mundësuan rritjen e ndjeshmërisë së shfaqjes në tërësi.

2.Më 31 mars 1952 u shfaq premiera “Flamuri i paqes”, e konceptuar si një suitë vallesh popullore të trevave të ndryshme folklorike të vendit me pjesëmarrjen e grupit të valleve, të orkestrës simfonike, orkestrinës popullore dhe korit, duke përzgjedhur syresh ato më karakteristike.

Afërmendsh se si përpjekja e parë serioze në fushën e baletit, shfaqja “Flamuri i paqes” u vlerësua pikërisht si një hap i parë i suksesshëm nga format e ulëta popullore koreografike drejt formave të përpunuara e të larta, ku baleti shfaqet tanimë si art i kultivuar, tërësor dhe i përkshuar nga linja, ide, konflikte e subjekte dramatikë. Grupi i vallëtarëve sollti një shumësi vallesh karakteristike të krahinave të ndryshme të vendit, ku spikatën vallet korçare gorarçe, e dulës, e Pogradecit, vallet myzeqare të dados, ngjalës, trimit, ato të minoritet grek në Shqipëri, posaçërisht vallet dropullite si pogonishte, e zoçkës, limonve, fisunit, vallet elegante të rrethit të Shkodrës, vallet plot energji të krahinës së Matit e Dibrës, burrash e grash, ajo e lodrës, vallja Bezmishte, e Sofikës, e Gjikës. Më tej u vijua me vallet e Kuksit, Elbasanit. Pjesën e parë e mbyllnin vallet entuziaste e të gëzueshme të rrethit të Tiranës. Sipas shtypit të kohës “në pjesën e parë të programit kanë pasur sukses ekzekutimi i valles së “Sofikës” dhe ajo e “Gjikës” nga V. Lipe dhe S. Batku, që me një shije artistike kanë mundur t’i japin gjallërinë që karakterizon vallet tona popullore”. (Miqësia, 1952)

Përpos këtyre valleve, në pjesën e dytë është sendërtuar një subjekt i mirëfilltë koreografik, i përbërë nga pjesët: *Partizania e pamposhtur* (e ekzekutuar nga M. Terca, prologu E. Tërshana & M. Myftiu), *Kujtime partizane, Vallja e flamurit* (e ekzekutuar nga T. Papa), *Dita e lumtur* (e ekzekutuar nga L. Kape, S. Batku) si dhe *Betimi i Popullit*. Ky krijim koreografik ka në qendër qëndresën e një partizaneje trime përballë torturave të pushtuesve nazi-fashistë, e cila bëhet shembull frymëzimi e guximi për partizanët e tjerë, pasi ajo ruan dhe e mban lart flamurin e lirisë e të fitores dhe më pas të gjithë së bashku, në një lëvizje dorë për dorë, nuk e lënë që ai flamur të bjerë në dorë të armiqve. Fundi i subjektit vjen në tone optimiste dhe entuziaste, falë një valleje masive ku shprehet besimi dhe mobilizimi për të mbërritur në fitoren e shumëpritur dhe për ta ruajtur atë me gjak. Më tutje

skena mbushet nga valltarët që festojnë ditët e reja të çlirimit, të punës dhe të nevojës për mbrojtjen e fitores dhe ndërtimin e jetës së re. Padyshim, e gjitha kjo është brenda klisheës optimiste politike të kohës, me shprehje të vullshme të entuziazmit dhe betimit solemn përpara liderëve të rinj të pushtetit komunist.

“Edhe në këtë premierë, - shkruhet në revistën “Ylli”, - u pa gjallëria në interpretimin nga kërcimtarët Mellani Terca, Sadik Batku, Mehmet Myftiu, Ëngjell Tërshana, Vita Lipe, Lumturi Kapo etj, si soliste dhe nga gjithë kërcimtarët, të cilët, duke pasur ndihmën e baletmaestrit sovjetik Georgi Perkun, arritën në një realizim të mirë” (Ylli, 1952). Po ashtu duhen përmenduar edhe vallëtarët Timoleo Papa, Fatmir Struga, Ikbal Morina, Skënder Selimi, Adivie Sharofi.

Përveç valleve, shfaqja shpalosi bukurinë e kostumeve, ku spikatën ato të rrethit të Korçës, Myzeqesë, minoritetit maqedon të Prespës, minoritetit grek të Dropullit, Shkodrës, Matit dhe Dibrës. Sipas S. Kasapit, në dosjen KD4, Arkivi artistik, Programe dore, zarfi 3, premiera “Flamuri i paqes”, 31 mars 1952: “Mbas “Vllazërimit të popujve” premiera “Flamuri i paqes” është një shfaqje folkloristike, e cila ishte e veshur me një përmbajtje, gjë që bëri të mundshëm të bashkojë formën me përmbajtjen. Ky hap i grupit të valleve të Filarmonisë Shqiptare është një sukses i artit koreografik në vendin tonë, që do t'i çeli rrugën krijimeve në lëmin koreografik për shfaqje të një forme më të lartë artistike” (Arkivi TOB, 1952).

Koreografi sovjetik Georgi Perkun, sipas sintezës që ai mundi të realizojë në premierën “Flamuri i Paqes” krijoi diçka të re, jo thjesht për trupën e baletit shqiptar, por edhe në përgjithësi për evidentimin dhe ruajtjen e visareve të folklorit koreografik shqiptar, për paraqitjen e tyre në një formë më të përpunuar, më estetike e më të epërme, duke çelur nga ana tjetër, një rrugë të re për grupin e valleve të Filarmonisë për realizimin e shpejtë të formave më të larta e më të ndërlikuara koreografike. Përveç muzikës popullore të shoqëruar nga orkestra e Filarmonisë, për 25 minuta shfaqja u shoqërua edhe nga orkestra simfonike “e cila i dha një karakter të lartë artistik” (Kasapi, 1952). Meritë tjetër që ia vlen të theksohet ishte muzika e kompozuar enkas nga kompozitori Mustafa Krantja për pjesën e dytë, gjegjësisht subjektit të saj. “Ajo e ngriti shfaqjen në një gjendje më të lartë artistike dhe bashkoi në një kompleks artin muzikor, instrumental, koreografik dhe vokal”, shkruhet në materialin përmbledhës të saj. (Kasapi, 1952).

Dirigjenti dhe kompozitori Mustafa Krantja, nëndrejtor i asaj kohe i Filarmonisë shqiptare, në një shkrim të tij bënte me dije: “Kjo vatrë e madhe artistike, në të cilën talentet më të mirë të dalur nga gjiri i masës tonë punonjëse japin mundin dhe artin e tyre në dobi të popullit tonë... ecën drejt një aktiviteti më të gjerë, drejt një objektivit të shënuar, drejt një t'ardhme të shkëlqyer për të mbijetë në çfaqjet operistike, gjë që do të ndimojë e do të shpejtojë krijimin e operës nacionale në vendin tonë. Grupi i valleve i Filarmonisë i posa ngritur, bazë e baletit tonë t'ardhshëm, që sot ka në aktivin e vet një numër të madh suksesesh si brenda shtu dhe jashtë atdheut, edukohet nga dora e sigurt e baletmaestrit sovjetik shokut Georgi Vasiljevoic Perkun, i cili nuk asht kursye kurrë për të ngritë e pajisë anëtarët e kolektivit me teknikën e lartë tradicionale të baletit sovjetik. Jo më pak se ky kanë kontribuar edhe shokë të tjerë, profesorat Boris Skablof dhe Jurin, të cilët pa u lodhë kurrë përgatisin kuadrot e reja t'orkestrës tonë nacionale”. Krantja, 1952, 26). Vlerësime për trupën e re të baletit jepte edhe dramaturgu Kolë Jakova, në gazetën “Zëri i Popullit” të majit të vitit 1951, ku ndër të tjera shkruante: “Çfaqja ka entuziazmuar spektatorët, si çfaqje e një kualiteti të mirë, plot art, jetë dhe gjallëri... Ne sot mund të themi se kemi një grup vallesh, i cili ka perspektiva për të ardhmen... E them me bindje se arti koreografik është një nga artet më të dashura nga masat. Ai i entuziazmon, i kënaq dhe i çlodh masat. Çdo çfaqje baleti është pritë mirë nga publiku...” (Jakova, 1950).

3. “Shatrivani i Bahçisarajit”, nga veprat më të mëdha të baletit rus dhe atij botëror, me një subjekt sa historik aq dhe baladesk, bazuar mbi poemën e njohur të poetit të shquar rus Aleksandër Pushkin, arriti të sublimojë përvojëm e deriatëkohshme dhe të realizojë një nivel mjeshtërie të domosdoshme në ekzekutimin dhe interpretimin artistik të valles. Premiera u dha më 29 prill 1951 me rastin e festës së 1 Majit. Baleti është më katër akte, një prolog dhe një epilog. “Për herë të parë në vendin tonë, - shkruhej në shtypin e kohës, - u vu në skenë një balet klasik nga më të bukurit dhe më të komplikuarit e artit koreografik, me famë botërore.” (Avrazi, 1951).

Për përgatitjen e baletit, sikurse njoftohet nga gazeta “Zëri i Popullit” e datës 27 prill 1951, u desh një punë mjaft e madhe dhe plot entuziazëm nga gjithë pjesëmarrësit e ansambllit të valleve, nga

orquestra dhe në mënyrë të veçantë nga nismëtari dhe baletmaestri i talentuar Georgi Vasiljeviç Perkun. Mustafa Krantja si dirigjent brenda një kohe të shkurtër përgatiti partin muzikor dhe e ekzekutoi atë me sukses. Nga baletet më të suksesshme të kohës, ajo u zgjodh nga koreografi për bukurinë, elegancën, plotësinë dhe formën interesante, tejet e pëlqyer nga publiku, sikurse, nga ana tjetër, si një premisë për t'u dhënë mundësinë balerinëve të rinj shqiptar ende të pakualifikuar që të bëjnë përpjekje për përmirësime e rritje të konsiderueshme cilësore e profesionale, duke përballuar detyra të vështira artistike. Baletmaestri u kujdes që balerinët ta ndjenin mirë personazhin që do të interpretonin, ta njihnin mirë karakterin e tyre, të ishin sa më të saktë e të vërtetë në jetësimin e veprimit të tyre dramaturgjik duke iu shmangur artificeve dhe elementeve skajshmërisht formale. Ai gjeti një barazvlerë artistike, plastike, mimike dhe karakteriale midis personazheve dhe balerinëve për të krijuar përshtatshmëri plastiko-ritmike të sakta në mishërimin e figurave, sikurse qenë Melani Terca në rolin e Zaremës, Ikbal Morina në rolin e Maries, Mehmet Myftiu në rolin e Vaclavit, Skënder Selimi në rolin e Nuraliut. (Zëri i Popullit, 1951).

Koncepti dhe ideja koreografike e Perkunit i dha këtij baleti të shumënjohur jo thjesht aspektin baladesk e poetik, por edhe atë historik e shoqëror, duke i mëshuar shpirtit të bukur human, dimensionit njerëzor, dashurisë si fuqi përtëritëse dhe besnikërisë si komponente bazike e vetëdijes morale të Maries etj., sikurse, nga ana tjetër, ai arriti të krijonte një shtresim të fortë e të ashpër social e politik kundër tiranisë dhe tiranëve, kundër shfrytëzimit, spekulimeve dhe teprisë së të drejtës që ata e keqpërdornin, kundër robërisë dhe shkeljes së lirisë së zgjedhjes në dashuri, kundër veseve të këqija, bjerrjes morale, zvetënimit të natyrës njerëzore, vrazhdësisë dhe karakterit barbar të pushtetit sulltanor, kundër skllavërisë dhe shtypjes mizore. Tri komponentet bazë të baletit, poema e Pushkinin nga merret subjekti gjithë kureshtje dhe mahnitje baladeske, muzika e ëmbël dhe origjinale e kompozitorit Asafjev, si dhe koncepti koreografik i Georgi Perkun, mundësuan më tutje mishërimet interesante të balerinëve shqiptarë që realizuan figura mbresëlënëse, ndonëse shumë syresh ishin fare të rinj. Spektatori s'mund të bënte dot dallim nëse në skenë ishin balerinë të vegjël apo të rritur e me përvojë profesionale. Kjo u mundësua përpos të tjerave edhe nga metoda e punës artistike që aplikoi baletmaestri rus. Ai ndoqi rrugën e demonstrimit, sikurse atë të përthellimit të balerinëve në botën e brendshme të personazheve të tyre, duke i futur në rrethanat e caktuara ku ata vepronin, gjendeshin, duke u përpjekur të fuste po aq elementet e aktrimit, të një ndjeshmërie të lartë, e cila jetësohej falë teknikës së futjes “në lëkurën e personazhit”, të jetuarit sa më me vërtetësi të jetës së brendshme të tyre. Në këtë mënyrë aplikimet e parimeve aktoriale të metodës realiste të regjisorit dhe reformatorit të madh të teatrit rus dhe atij botëror Kostandin Stanislavskit krijuan premisat e një interpretimi, ku emocionin fitonte përparësi dhe bota psikologjike e personazheve harmonizohej me nivelet psikike refleksive të balerinëve. Nga fragmentet më të bukura qenë tablotë kur luhet vallja poloneze në pallatin e princit Potovci në aktin e parë si dhe vallja e haremit të aktin e dytë, sikurse edhe në aktet e tjera, ku balerinët interpretuan me forcë artistike duke gërshetuar lëvizjet e gjetura e domethënëse me gjestet shprehëse dhe mimikën. Një nga skenat e punuara me shije dhe origjinalitet ishte vallja e tartarëve si në pjesën e parë, ashtu dhe në atë të fundit, ku u dallua figura e Nuralit, ndihmësit të Hanit, e interpretuar nga artisti i ri Skënder Selimi. Rolin e Zaremës e interpretoi Melania Terca, e cila paraqiti para spektatorëve vajzën e bukur e tunduese, yllin e haremit të Khanit.

Ikbal Morina në rolin e princeshës së vogël polake Marie jetësoi vajzën e re të nderhme e plot hire, me një integritet moral të lartë. Theksi romantik i interpretimit të personazhit të saj ishte një gjetje e menduar nga ana e balerinës, në bashkëshoqërim ideor me konceptin e koreografit.

Rolin e princit polak Vaclav e luajti balerini Mehmet Myftiu.

Panajot Kanaçi, ani pse një balerin me prirje përgjithësisht lirike, arriti të japë figurën e një tirani të zymtë, të vrazhdët, gjakatar e sundues të pamëshirshëm siç ishte Khani i tartarëve Gironi. Sakaq duhet shtuar edhe fakti se Panajot Kanaçi, veç detyrës si balerin solist, luajti edhe rolin e asistentit të koreografit Georgi Perkun duke dhënë ndihmesën e tij të pazëvendësueshme.

Në artikullin përcjellës të shfaqjes dirigjenti dhe muzikanti Gaqo Avrazi do të pohonte: “Baleti “Shatirvani i Bahçisarajit” është një vepër monumentale që do të mbetet për shumë kohë në repertorin e ansambllit tonë koreografik. Ai shënon hapin e parë të madh të këtij ansambli në rrugën për të krijuar një art koreografik profesionist. Pra është një kthesë në artin e baletit.” (Avrazi,

1951). Ndërsa në shkrimin redaksional të gazetës “Zëri i Popullit” shkruhej: “Kërcimet e bukura të vajzave dhe kalorësve, gjallëria e ngjyrave dhe gjithë kompleksi i kostumeve, dekoreve dhe skenave krijuan në spektatorin një përshtypje të madhe, entuziazëm dhe admirim. Kjo është një gjë e re për skenën tonë. Spektatori i ynë, ndjeu kënaqësi dhe respekt për punën krijonjëse të filizave të reja që ekzekutonin rolet e tyre, si ansambël dhe veçanërisht si solistë, me dëshirë dhe plot harmoni. Sa herë që në këtë çfaqje sipari mbyllesh, duartrokitjet vazhdonin për disa minuta papushim. Kjo ishte mirënjohja dhe dashuria e spektatorëve ndaj artistëve të rinj që po e shpien artin tonë përpara në një rrugë të shkëlqyer.” (Zëri i Popullit, 1951). Vlerësimet entuziaste të kritikës së kohës regjistronin kështu një sukses të merituar të baletit shqiptar në fillesat e tij, duke u çmuar si një ngjarje me rëndësi të veçantë në zhvillimet e pritshme të trupës profesioniste drejt përsosjes artistike dhe komunikimit sa më aktiv me audiencën e vet. (Zëri i Popullit, 1951).

Referenca

Jakova, K. (1950), Një sukses i madh në lëmin e artit, Grupi i valleve të Filarmonisë shqiptare çfaq premierën “Vëllazërimi i popujve”, *Zëri i Popullit*, 1. 05.

(1952), Çfaqje folklorike, “Flamur i Paqës”, *Revista “Miqësia”*, nr. 5, Maj.

(1952), Flamuri i Paqes, *Revista “Ylli” (Mars-Prill)*, nr. 3-4.

Arkivi i TOB. (1952), *Dosja KD4, Arkivi artistik, Programe dore, zarfi 3, Premiera “Flamuri i paqes”*, premierë 31 mars.

Kasapi, S. (1952), Premiera e “Flamurit të paqes”, *Gazeta “Bashkimi”*, 9 prill.

Krantja, M. (1952), Filarmonia shqiptare, *Revista Ylli*, nr. 2, f. 26.

(1951), Përpara çfaqjes së baletit “Shatrivani i Bahçisarajit”, Një sukses i math i artit tonë koreografik, *Zëri i Popullit*, datë 27. 04, nr. 100 (805).

Avrazi, G. (1951), Fitore e shkëlqyer e baletit tonë, Me rastin e çfaqjes “Shatrivani i Bahçisarajit”, Kthesë e madhe në artin tonë koreografik, *Zëri i Popullit*, 3. 05. nr. 105 (910)

(1951), Baleti “Zhatrivani i Bahçisarajit” korri sukses të madh, *Zëri i Popullit*, nr. 103 (808), 1. 05.

Group Pressure in Youngsters' Dangerous Behaviour

Dr.Doc. Mimoza Çarka
University "Eqrem Çabej", Gjirokastë, Albania

Abstract

Unintentional injury is the leading cause of death and disability in children. Many injuries to school-aged children occur during unsupervised peer activities, but peer influences on risky behavior in preadolescence remain under-investigated. We examined peer context effects on reported risk-taking, identified predictors of peer influence, and compared peer influence in high- and low-social-functioning groups. Forty-one boys aged 8-10 years listened to scenarios in which they encountered opportunities for risk-taking with their best friends, with "cool guys", with disliked peers, and alone. They rated the likelihood that they would engage in risky behavior in each condition for each scenario. Children also completed measures of friendship satisfaction, peer orientation, and socially desirable responding. Children reported more risk-taking with positive peers than alone, and less with negative peers than alone. Children in the high social competence group showed larger peer influence, and indicated a preference for risk-taking with best friends over cool guys. Results are discussed in terms of improving injury prevention efforts by reconceptualizing "peer pressure" as a developmentally adaptive aspect of child functioning.

Keywords: preadolescence, cool guys, peer pressure, risk behavior, injury

Unintentional Injury

Unintentional Injury constitutes an enormous threat to the health and welfare of children. In this country, twenty two million children are injured every year (Boyce & Sobolewski, 1989). Prevention of unintentional injuries to children should be considered a high priority for researchers, policy makers, and society at large. Unintentional injuries, although often seen as random and unavoidable (as the term "accident" implies), are in actuality predictable and controllable. However, determining effective prevention strategies requires a detailed understanding of the process of injury that transcends epidemiological data.

The processes that lead to unintentional injuries by children are complex and multi-deterministic; an exclusive focus on child factors ("internal determinism") or on environmental factors ("external determinism") is insufficient and overlooks the reciprocal, transactional nature of injury events. Injuries result from specific behavior-environment interactions, and many if not all injuries require a failure or break-down at multiple levels of the system in which the child is permanently embedded. Thus "injuries are the product of avoidable environmental and behavioral forces that together produce an unfortunate outcome" (Peterson, Farmer, & Mori, 1987, p. 33) Whether investigation occurs at an epidemiological or child motivations and behavior patterns (Jaquess & Finney, 1994), parental supervision beliefs and practices (Valsiner & Lightfoot, 1987), and structural considerations in the immediate and broader environment (Rivara & Mueller, 1987).

Socio-cognitive development

Injury is a developmental and cultural phenomenon; injury risks and outcomes vary with child age and with socio-cultural features of the child's environment. Interpersonal relationship and cognitive functioning are intimately related; in order to understand children's risk-taking decisions, an understanding of the relational basis of cognition is a necessary prerequisite. From before birth, children are embedded inexorably in their culture; all development proceeds from within this context (Rogoff, 1990).

Children are active agents in seeking the interactions necessary for their own development, and their learning is guided by shared thinking with caregivers, and participation in the ongoing activities of their culture. Social relationships proceed from early experiences of shared attention and co-

regulation with caregivers, through the construction of shared meanings with peers in dramatic play, through negotiation of joint problem -solving requiring perspective-taking, to the establishment of intimate friendship and a peer culture based on shared expectations and interpretations (Rogoff, 1990). Thus, children are always constructing their world in the context of their relationships with others. Together, people construct cultural contexts for their interactions, in which there are “standing rules for behavior appropriate to a particular socially assembled situation”-these rules vary depending on the context of the situation, but members of the same culture will generally agree on what they are.

“To understand the role of peer interaction in cognitive development, it is necessary to examine situations in which children are in charge of their own activities” (Rogoff, 1990, p.173)

Social development and injury risk in middle childhood

There is little consensus on what level of supervision is appropriate for children in middle childhood in high-risk situations (Peterson, Ewigman, & Kivlahan, 1993). Peterson and her colleagues (1993) found that in evaluating the need for supervision of 9 and 10-year-old children in neighborhoods containing common environmental hazards (e.g., creeks, busy streets), parent’s responses varied widely, but that many parents indicated that it would be appropriate for children of this age to play in the neighborhood unsupervised for more than a few minutes if at all (Peterson, et al., 1993). Others have similarly suggested that during preadolescence the range of independent behavior increase, there is a decrease in direct adult supervision, and peers take on increased importance as socialization partners. It is also important to note that when in outdoor environments with opportunities for risky behavior, children behave more safely when aware of being observed by adults than when these observations are made unobtrusively. Additionally, there is evidence that 8 to 11-year children perceive fewer situations as hazardous and perceive situations as less hazardous than do either younger or older children.

In particular, they often disagree with their parent’s perceptions of what risks are too great for their abilities (Christensen & Morrongiello, 1997) and frequently base their disagreement on an overly optimistic evaluation of their own competence in preventing injury to themselves (Hyson & Bollin, 1990).

Adolescence is popularly considered to be a time when peers take over as the primary socialization source in children’s lives, and there has been ample examination of peer influences on youthful risk-taking behaviors that threaten long-term health (e.g., cigarette smoking, illegal drug use). Little is known, however, about the influence of peers on risky decision-making in middle childhood. The middle school years (approximately ages 11-14) appear to be a particularly dangerous time in childhood; children in this age group are more frequently injured, and are disproportionately represented among “accident-repeaters” (i.e., children incurring multiple injuries over time). Further, it has been reported that many injuries to school-aged children are incurred in the presence of peers.

Although little work has examined the influence of peers on the risk-interpersonal influences of each other in situations that do not involve risk-taking. There is ample evidence that even very young children can effectively influence one another’s behavior. Trawick-Smith (1992) found that persuasive children can be identified before the beginning of elementary school, and tend to use markedly different strategies than less successful persuaders; the successful influencers used positive persuasive strategies like friendly demands, were generally socially skilled, and used fewer aggressive or angry strategies to induce compliance with their requests. The number of persuasive tactics employed, and the complexity of these strategies, although not necessarily the overall success of the influence attempt, increase with age, and children’s strategies for effecting interpersonal influence are sophisticated and well-developed by middle childhood. It should be noted that most of the work in this area has focused on identifying successful persuaders and examining the persuasive techniques they use; in contrast, there is little information available on the children being persuaded, and we know very little about individual differences in “influence ability” in children.

Social Competence and Peer Influence

Children's activities in peer culture situations have little attention, in part because of the difficulty adult researchers have in accessing such situations; as a result, we know little about how children behave when on their own together or how they construct their shared meanings in the absence of adult models, guides, and restrictions (Rogoff, 1990). It is important never to overlook the child's active role in constructing these environments and subjectively experienced contexts; children are purposive and goal-oriented, and their behavior in different socially assembled situations will be based on their current goals and abilities. In peer-culture situations, one common goal will be to construct shared experiences and viewpoints in order to build relationships based on a group identity. This goal is congruent with the tendency to conform to others' demands and beyond is correlated with the tendency to conform to others' demands and be cooperative –these characteristics should be desirable to peers intent on coming to a shared understanding of experience.

Establishing a shared identity with a group of peers may be a more important goal for some children than for others. Dodge and Richard (1985) assert that children have widely differing social goals and motivations; some children consider friendship secondary to other social goals, while others value peer relationships more than their own self-protection. Ollendick and Schmidt (1987) included this consideration in their examination of the utility of social learning constructs in predicting peer interaction patterns. Peer reinforcement value is a measure of how important peer relationships are to a child, or how much he values interactions with other children. Placing a high value on peer interactions is related to having positive peer relationship; many children who report placing heavy emphasis on peer interactions have positive relationships with their peer. Socially skilled children are thus both more likely to be peer-oriented and to achieve positive peer relationships, and children are more likely to be influenced by peers with whom they have positive relationships.

Peer pressure and risk-taking may be seen as active behavior choices that encourage the establishment of a group identity through shared risk-taking. Thus, Lightfoot (1992) describes risk-taking behavior as “a culture-creating device employed for the purpose of organizing self-other relationships. There were two fundamental differences between these two conceptualizations of peer pressure: a- the consequences of conformity or independence were not explicitly stated (as in the oft-presented “What are you, chicken?” version of peer pressure); and, b-shared risk-taking was seen as a proactive mechanism for creating important group experiences and advancing as an externally imposed opportunity to prove one's worth or avoid the criticism of aggressive or antagonistic peers (the latter being assumed in the educational focus on “Just Say No” and other resistance based admonitions). If participation in peer-sanctioned risk behavior is considered a mechanism for improving and maintaining positive peer relationships, children who are more socially competent may be more likely to engage in these behaviors: socially competent children are more likely to have positive peer relationships (in which the influence valence is likely to be stronger), to determine accurately the social context demands of peer situations, and to act cooperatively in order to competently establish a shared perspective with their peers.

Many peer-pressure programs focus on increasing children's social skills in order to protect them from peer bids for dangerous behavior. This implies that is a lack of social competence that encourages peer-sanctioned risk-taking. A positive relationship between social competence and peer influence is congruent with the conceptualization of “peer pressure” and shared risky behavior as active, effective behavioral choices made by competent children intent on establishing, and maintaining positive peer relationships.

Peer Context, Risk-taking, and Social Competence

Based on the considerations presented above, the current study was designed to investigate pre-adolescence children's decisions to engage in shared risky behavior based on the presence of an established peer group (i.e., “some of your best friends”), a new, desirable peer group (i.e., “some cool guys at school who aren't your close friends yet but you want them to like you”), or a disliked

peer group (“some kids you don’t like to play with”). The risk-taking situations used as stimuli in this investigation were derived based on information about the types of serious injuries most common in middle childhood. Using responses to these risk-taking measures designed for this study. Using responses to these risk-taking scenarios and considering relationship quality, peer orientation, parent-reported social competence, and socio-demographic variables, this study (a) examined pre-adolescent children’s socially contextual decisions to engage in shared risky behavior; (b) identified predictors of peer influence; and, (c) compared peer influence patterns in children with high and low social competence. When considered overall, our results indicate that boys in middle childhood reported more risky behavior in positive peer group situations than when they were alone.

Further, these boys reported that they generally were less likely to engage in risky activities with children whom they disliked than they were by themselves. Two interpretations are possible; both concern the motivation of the boys for performing these behaviors. It could be that risk-taking behaviors in particular are influenced by peer context. However, it could be that children would generally prefer to participate in activities with their friends than by themselves regardless of the riskiness of the behavior.

However, many of the alone condition scores for the scenarios measure indicate that the children were unlikely to participate in the risky activities described without their peers. This could be because the activities sounded unattractive without their friends, or it could be that the children chose not to perform these behaviors alone because the risk involved was considered too great without the opportunity to abstain peer socialization benefits.

Discussion

When considered overall, our results indicate that boys in middle childhood reported more risky behavior in positive peer group situations than when they were alone. Further, these boys reported that they generally were less likely to engage in risky activities with children whom they disliked than they were by themselves. Two interpretations are possible; both concern the motivation of the boys for performing these behaviors. It could be that risk-taking behaviors in particular are influenced by peer context. However, it could be that children would generally prefer to participate in activities with their friends than by themselves regardless of the riskiness of the behavior. However, many of the alone condition scores for the scenarios measure indicate that the children were unlikely to participate in the risky activities described without their peers. This could be because the activities sounded unattractive without their friends, or it could be that the children chose not to perform these behaviors alone because the risk involved was considered too great without the opportunity to obtain peer socialization benefits. From previous research and these results, it seems plausible that boys in middle childhood take risks with their friends because doing so cements shared perspectives and other relationship variables critical for socio-cognitive development. Nonetheless, when opportunities to meet these goals via shared risk-taking experiences present themselves, many boys who reported that they would be unlikely to take such risks alone indicated that they would perform the same dangerous behaviors with their friends. Determining what types of alternative group activities could equally meet the peer socialization goals driving shared dangerous behavior, and providing children with access to these activities, could be one strategy for reducing behaviors that place children at risk for unintentional injury.

This study bears a number of important limitations

First, we measured children’s report of what they would be congruent with their behavior in the real world. Conclusions regarding peer influence on children’s risky behavior could be strengthened by observing overt behaviors in analog or (even better) naturalistic settings. Second, our sample was constricted in many respects: it was small, excluded girls, and was comprised almost entirely of white, upper-middle-class children from well-educated two-parent families living in a suburban college setting.

Conclusion

One important caveat to interpreting the application of these results to real-life risk-taking situations is that while socially competent children indicated that they were unlikely to take risks alone but more likely to do so when encouraged to participate in these behaviors with their friends, it is unknown to what extent the child's friends would encourage risky behavior (especially given that they, too, might report similar reluctance to participate in these risks alone), or to what extent the child would expect his friends to encourage risky behavior. The dynamic interplay between children's risk-taking decision-making in group contexts is not represented here, so it is unknown to what extent these children should be expected to encounter in daily life the type of peer encouragement described here.

More sophisticated investigations could include an examination of the correspondence between a child's perceived likelihood that his friends would encourage particular risk-taking behaviors and his reported likelihood of performing these behaviors. Reducing child injuries is an important social goal worthy of resource investment. However, the apparent effect of social context on children's risky behavior suggests that strategies for reducing child injuries during peer activities must be designed that accommodate peer socialization goals. This is especially critical given our evidence that socially competent children report greater increases in risk-taking with their friends than do their less socially competent counterparts. That highly functioning children show this pattern suggests that it is likely a skilled, functional behavior.

Small groups of pre-adolescent boys with positive peer relationships are likely to take physical risks together, and programs aimed at reducing the danger associated with this behavioral pattern should respect the social competency of the children making these decisions. Being susceptible to "peer pressure" in middle childhood, now a behavior adults stigmatize, in itself clearly should not be considered dysfunctional. For highly socially adapted boys, choosing to participate in peer sanctioned risky activities is unlikely to be the result of unskilled contextual decision-making. As active agents in their own development those most vulnerable to counter-developmental influences. Programs designed to reduce "peer pressure" are unlikely to succeed with socially incompetent children by providing them with social (since these would likely increase peer influence, not the opposite).

And they are unlikely to succeed with socially competent children until they acknowledge that for these children the need to build peer relationships over-rides admonitions against dangerous behavior, and that is a functional behavioral choice. For parents and adult society, the cost-benefit analysis in risky peer pressure situations dictates that prevention of serious harm to the child supersede any perceived benefits in the form of fun or peer culture acceptance. However, recognizing that "peer pressure" is a developmentally adaptive aspect of child functioning will be a prerequisite to impacting behaviors judged by adults to represent too great a risk to the child's health.

Reference

- Boyce, W.T., & Sobolewski, S. (1989). Recurrent injuries in schoolchildren. *American Journal of Diseases of Children*, 143, 338-342.
- Christensen, S., & Morrongiello, B. A. (1997). The influences of peers on children's judgments about engaging in behaviors that threaten their safety. *Journal of Applied Developmental Psychology*, 23, 33-44.
- Dodge, K.A., & Richard, B. A. (1985). Peer perceptions, aggression, and peer relations. In J.B.Pryor & J.D.Day (Eds.), *The development of social cognition* (pp. 35-58). New York: Springer-Verlag.
- Hyson, M.C., & Bollin, G.G. (1990). Children's appraisal of home and neighborhood risks; Questions for the 1990s. *Children's Environments Quarterly*, 7, 50-60.
- Jaquess, D., & Finney, J.W. (1994). Previous injuries and behavior problems predict children's injuries. *Journal of Pediatric Psychology*, 19, 79-89.
- Lightfoot, C. (1992). Constructing self and peer culture: A narrative perspective on adolescent risk taking. In L.T.W. a.J. Valsiner (Ed), *Children's development within social context, Vol 2: Research and methodology* (pp. 229-

- 245). Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum associates, Inc.
- Ollendick, T. H., & Schmidt, C. R. (1987). Social learning constructs in the prediction of peer interaction. *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 16, 80-87.
- Peterson, L., Ewigman, B., Kivlahan, C. (1993). Judgments regarding appropriate child supervision to prevent injury: The role of environmental risk and child age. *Child Development*, 64, 934-950.
- Peterson, L., Farmer, J., & Mori, L. (1987). Process analysis of injury situations: a complement to epidemiological methods. *Journal of Social Issues*, 43, 33-44.
- Rogoff, B. (1990). *Apprenticeship in thinking: Cognitive development in social context*. New York: Oxford University Press.
- Trawick-Smith, J. (1992). A descriptive study of persuasive preschool children: How they get others to do what they want. *Early Childhood Research Quarterly*, 7(1), 95-114.
- Valsiner, J., & Lightfoot, C. (1987). Process structure of parent-child-environment relations and the prevention of children's injuries. *Journal of Social Issues*, 43, 61-72.

Përprojekjet për krijimin e federatës ballkanike dhe Shqipëria

Elisabeta Luli

Ministria e Energjisë dhe Industrisë; Sektori i Burimeve Njerëzore

Abstrakt

Ideja për krijimin e Federatës Ballkanike u zhvillua dhe u kristalizua në fillim të vitit 1943, me synimin për krijimin e një Komande të Përbashkët (Shtabit Ballkanik) të lëvizjeve partizane të Jugosllavisë, Greqisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë. Krijimi i Shtabit Ballkanik do të koordinonte luftën partizane të popujve të këtyre vendeve si dhe krijimin e Konfederatës Ballkanike. Shqipëria ishte strategjikisht jetësore për konfederatën e Jugut, me pozicionin e saj të rëndësishëm në Adriatik. Në vitet 1944-1945 ishte i padiskutueshëm ndikimi i faktorit sovjetik në Shqipëri, Bullgari, Rumani dhe Jugosllavi. Pala sovjetike kishte jo pak mundësi për të ushtruar ndikim sepse në shumicën e vendeve, përveç Shqipërisë, ndodheshin njësitë e Ushtrisë së Kuqe dhe në vendet e çliruara funksiononin komandat ushtarake sovjetike. Përsa i përket perspektivës projekti për bashkimin e Jugosllavisë me Bullgarinë dhe Shqipërinë, konsiderohej i domosdoshëm. Duke jureferuar faktit se kushtet e politikës së jashtme nuk ishin të përshtatshme, u ra dakort të lidhej Traktati për Aleancë midis Jugosllavisë dhe Bullgarisë madje qëllimi kryesor mbeti krijimi i Federatës së Sllavëve të Jugut, me udhëzimin, të mos flitej, nëse federata do të ishte dualiste apo e përbërë nga shtatë anëtarë. Pavarësisht rrethanave, statusin e "Vëllait të madh" ndaj Shqipërisë, Jugosllavia nuk kishte ndërmend t'ia linte Bashkimit Sovjetik. Shqipëria e sapodalë nga lufta ishte ndërmjet dy alternativave të projektuara nga jugosllavët: Ose konfederate ose bashkim me Jugosllavinë. Shqipëria do të kalonte nëpër skenat dramatike deri sa të dukej drita e tynelit, në vitin 1948, kur ndodhi çarja në marrëdhëniet sovjetë - jugosllave.

Fjalë kyçe: Federata Ballkanike, Blloku sovjetik, Traktati për Aleancë, Konfederata e sllavëve të jugut.

Në darën hermetike të luftës së ftohtë

1-Intermexo: Çfarë thotë në "Kritikën historike" Ali Hadri?

Ali Hadri është një studiues i njohur i historisë nga Kosova. Në "Kritikën Historiografike" ai ka dhënë dy studime: Vlera e veprës së Dimitrie Tucoviçit "Serbia dhe Shqipëria" dhe "Vështirim kritik mbi memoarët e Svetozar Vukmanoviç Tempos".

Ajo që të bie në sy është fakti se qëndrimet e socialistit demokrat Dimitrie Tucoviçit janë shumë më të larta, më paqësore dhe më humane për të ardhmen e popujve ballkanik se sa një eksponent i partisë komuniste të Jugosllavisë siç ishte Tempua.

Pikëpamjet dhe qëndrimi i drejtë i Tucoviçit ndaj çështjes shqiptare, mund të kuptohen ashtu siç duhet vetëm nëse shihet në reciprocitet të pandashëm më çështjen ballkanike dhe atë lindore në përgjithësi...

...Dimitrie Tucoviç (1881-1914) kryevepra e të cilit është libri "Serbia dhe Shqipëria" ka qënë një nga socialistët më të spikatur të Serbisë, Ballkanit dhe të Europës në fillim të shekullit të njëzetë.

Po për Tempon çfarë thotë Ali Hadri? - Për të çmuar në mënyrë objektive memoarët e përmendur, do të hiqim një paralele krahasuese midis asaj që Tempo ka vënë në dukje në kohën e luftës, asaj që thekson në librin e botuar si dhe të asaj që shikojmë në dokumentet historike në lidhje me çështjet e shtruara... (Hadri, 1976: 58-72)

Duke parë vektorët e këtyre paraleleve, duket qartë se ndryshe flet Tempua në kohën e luftës, krejt ndryshe në kujtimet dhe akoma me ndryshe flasin dokumentat për qëllimet e Tempos dhe të drejtuesve të tij të cilet kanë vetëm një qëllim: Aneksimin e Shqipërisë në Jugosllavi.

2-Në shpellën e Polifemit

Në vitet 1944-1955 ishte i padiskutueshëm ndikimi i faktorit sovjetik në Shqipëri, Bullgari, Hungari, Rumani, Jugosllavi etj.

Pas Luftës së Dytë Botërore, situata në Ballkan dallohej për specifikën e saj: Pala sovjetike kishte jo pak mundësi për të ushtruar ndikim sepse në shumicën e vendeve, përveç Shqipërisë, ndodheshin

njësitë e Ushtrisë së Kuqe dhe në vendet e çliruara funksiononin komandat ushtarake sovjetike, ndërsa në vendet ish pjesmarrëse të "Boshtit" si në Bullgari, Hungari dhe Rumani në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të aleatëve, rolin vendimtar e luanin përfaqësuesit sovjetik si dhe vepronin aktivisht misionet, përfaqësitë dhe ambasadat diplomatike sovjetike të cilat ishin qëndra të formimit të sistemeve të këshilltarëve politikë, ekonomikë dhe ushtarakë. Për rregullimin e jetës shoqërore në një sërë vendesh përdorëshin grupet operative që kishin kompetenca të mëdha.

Në një dokument "Tepër Sekret", dokument nr. 1, datë 10 janar 1944, me titull "Promemorie e drejtuesit të Komisionit të Komisarariatit të Popullit për punët e Jashtme të B.R.S.S., (Promemoria është përpiluar nga I.M. Majska) midis të tjerave thuhet: "Duke kaluar në fatet e vendeve të vogla të Europës, është e domosdoshme të theksojmë se nuk është në interes të BRSS, të paktën në periudhën e parë të pasluftës, të përkrahim krijimin e llojeve të ndryshme të Federatave si psh: të Danubit, të Ballkanit apo të tjera, për të cilat tani flasin kaq shumë në perëndim. Prandaj linja jonë për këtë problem duhet të mbetet negative." (Europa Lindore në dokumentet Ruse, 1999: Doc nr.1)

Kjo "Promemorie" për Komisararin e Popullit për punët e jashtme V.M. Molotov, eventualisht ka një qëndrim të prerë për federatat në përgjithësi e për atë ballkanike në veçanti.

Po në këtë "Promemorie" midis të tjerave thuhet: "Jugosllavia pas përfundimit të luftës (por mundet edhe më shpejt), në rast të forcimit të elementëve që grupohen tani rreth Titos, me gjasë, gjithashtu dëshiron të lidhë me BRSS, Paktin e Ndihmës Reciproke me afat të gjatë, Bashkimi Sovjetik duhet të përkrahë këtë dëshirë të forcave demokratike të Jugosllavisë.

Problemi për Greqinë është pak i vështirë. Bashkimi Sovjetik është i interesuar për Greqinë shumë më pak se për vendet e tjera ballkanike, ndërsa Anglia përkundrazi, për Greqinë është jashtëzakonisht e interesuar. Prandaj në lidhje me Greqinë, Bashkimi Sovjetik duhet të respektojë veçanërisht një kujdes të madh...

...Greqia gjithashtu mund të rivendoset në kufinj të saj të mëparshëm dhe përveç kësaj, të marrë Dodekanezin, të cilin ajo e meritoi plotësisht në luftën e saj heroike kundër Italisë ashtu edhe kundër Gjermanisë. (A.P. Jashtme Ruse, 1999: Part 23, 29, 31).

Bullgaria duhet t'i kthejë Jugosllavisë dhe Greqisë tokat që ka aneksuar prej tyre, ndoshta me përjashtim të Dedeagaçit, sepse mbajtja e Dedeagaçit prej Bullgarisë do të mund të paraqesë interes për BRSS, në rast të lidhjes së Paktit të Ndihmës Reciproke sovjetiko-bullgare. Kompesim i mjaftueshëm i Greqisë për Dedeagaçin do të ishte Dodekanezi.

Problemi për kufirin ndërmjet Bullgarisë dhe Rumanisë duhet të zgjidhet në përputhje me interesat e BRSS.

Problemi për Shqipërinë dhe Maqedoninë kërkon një shqyrtim të veçantë. Programi i skicuar i masave në Ballkan është një çështje e vështirë dhe delikate që kërkon kujdes në zbatimin e tij. Më kot Ballkani gjithnjë e deri më sot ka qenë një nga qoshet më shpërthyes të Europës. Përveç kontradiktave ndërbalkanike, këtu duhet të kemi në vëmendje politikën e shteteve të mëdha, në radhë të parë të Anglisë.....

Prologu dhe epilogu i kësaj "Promemorie" duhet analizuar me një kujdes të posaçëm, pasi siç e vume re edhe më sipër, krijimi i çdo lloji federate, sikunder edhe ajo ballkanike shihet me dyshim në Bashkimin Sovjetik. Duke qene se ajo mirëpritet në perëndim, në kuptimin figurativ, mund të thonim se ishim miq në shpellën e Polifemit dhe për të shpëtuar do të thërrisnim si Odisea, i cili e quante veten "askushi"... Pikërisht në këtë mënyrë do të trajtohej në qarqet diplomatike kjo çështje. Bashkimi Sovjetik do t'ia linte Jugosllavisë tutelën për Shqipërinë, ndërsa vetë do të parapëlqente rolin e arbitrit.

Në një raport të atyre viteve të Sekretariatit të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, Eduard Kardel, në informacionin ndërkombëtar shkruan për Komitetin Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, një raport të titulluar "Për situatën politike në Jugosllavi". "Përsa i përket perspektivës, ne e konsiderojmë të domosdoshme që Jugosllavia të lidhet ngushtë me Bullgarinë dhe Shqipërinë".

Me tej për Shqipërinë në këtë raport flitet edhe për bashkimin me Jugosllavinë: " Por ende nuk janë pjekur kushtet e politikës së jashtme... Pothuajse njëlloj qëndron problemi me Shqipërinë, ku kushtet e brendshme politike tashmë janë pjekur plotësisht për bashkimin dhe Shqipëria vetë nën udhëheqjen e Partisë komuniste, nuk ka rrugë tjetër përveç se asaj që në mënyrë më të ngushtë

të mbështetet tek Jugosllavia. Duke i referuar faktit se kushtet e politikës së jashtme nuk janë të përshtatshme, ne rrethojmë me Shqipërinë, që të lidhim me të Paktin për Ndihmen Reciproke, i cili mund të nënshkruhet brenda një kohe të shkurtër" (Kardel, 1945:137).

Por në shpëllën e Polifemit centimetër më centimetër mund të përfundojë në gojën e përbindëshit dhe Shqipëria e sapodalë nga lufta ishte ndërmjet dy alternativave të projektuara nga jugosllavët: Ose konfederatë ose bashkim me Jugosllavinë. Shqipëria do të kalonte nëpër skena dramatike-tragjike deri sa të dukej drita e tunelit në vitin 1948, kur marrëdhëniet midis Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavisë do të do të merrnin të çarën e madhe. Megjithatë deri më atëherë do të kalonin shumë prova dhe sfida të njëpasnjëshme.

3- Një takim kokë më kokë dhe Vlora

Më 22 prill 1946, ambasadori sovjetik në Jugosllavi A. I. Llavrentjev, takohet me Kryetarin e Këshillit të Ministrave të Jugosllavisë, marëshallin J.B.Tito.

Biseda zhvillohet për kërkesat e Greqisë, pretendimet territoriale të Jugosllavisë si dhe planet e Federatës Ballkanike.

Historia, jeta shpesh herë paraqitet më e larmishme se imagjinata e çdo shkrimtari apo historiani: Josif Broz Tito i cili në heshje me gjithë forcat kërkoi që ta përfshijë Shqipërinë brenda Jugosllavisë, pikërisht për këtë ngrihet kundër kërkesave të Greqisë për të marrë troje shqiptare dhe sidomos Vlorën.

Është kjo një shtrirje apo roli i një feudali, i cili kërkon që tokat të gllabërojnë për vete?

"Tito me këmbëngulje theksoi se Vlora (Valona), në asnjë mënyrë nuk duhet të jepet Greqisë. Rëndësia e saj është jashtëzakonisht e madhe pasi Vlora është një pikë kyçe e rëndësishme strategjike. Nëpërmjet Valonës, duke e lidhur atë me hekurudhën e Jugosllavinë, më vonë mund të eksportojmë dhe të importojmë të gjitha mallrat. Vlora fiton akoma më shumë përparësi atëherë kur Trieste nuk do të futet në përbërje të Jugosllavisë". (D.P.Jashtme, Beograd, 1946: 280-281; Llavrentjev. 1946: 280-281).

Titoja këtu flet si zot i tokave shqiptare e mbi të gjitha për një port të tillë jetik siç është Vlora për Shqipërinë. Këtë pazarllëk ia thotë ambasadorit sovjetik.

Kjo bisedë me tone të tilla ku Shqipëria shihej si një plaçkë tregu, që nuk i duhej dhënë Greqisë, por Jugosllavisë, bëhet pikërisht në atë kohë kur qeverisja jugosllave njihje botërisht qeverinë shqiptare nëpërmjet një deklaratë të tillë:

"Qeveria demokratike e Jugosllavisë federative me anë të misionit ushtarak jugosllav në Tiranë, komunikoi zyrtarisht se një qeverinë demokratike të Shqipërisë". (ASHQ, Tiranë, 1945).

Pas kaq vitesh lufte të ashpër dhe heroike, pas sakrificave mbinjerëzore që bëri për të shpëtuar atdheun nga thonjtë e monstrave fashiste, populli kishte të drejtën e plotë të priste nga fuqitë e bllokut antifashist, njohjen e qeverisë së tij demokratike.

Populli shqiptar kishte njohur dhe kishte çmuar me kohë ndihmën e madhe të popujve të Jugosllavisë në luftën kundër armikut të përbashkët italian dhe gjerman, një dhe çmon më shumë se kurrë përprjekjet që po gjen në qeverinë e marshallit Tito, një dhe çmon me mirënjohje të thellë gjestin e madh të qeverisë demokratike të Jugosllavisë që ngre e para zërin për të njohur solemnisht një të drejtë të pamohuar të popullit shqiptar.

Konsekuenca e vëllazërimit lindi dhe u forcua në luftën e madhe të përbashkët kundër një armiku të vetëm, fashizmit.

Jo vetëm kaq, por edhe në politikën e jashtme, do të ndihej presioni dhe patronati jugosllav ndaj Shqipërisë së asaj kohe.

Në telegramin e Hysni Kapos, atëherë ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Jugosllavi, drejtuar Koxi Xoxes për bisedimet me Kardelin rreth marrëdhënieve diplomatike me anglo-amerikanët, ky i fundit u shpreh se: "Interesi i Shqipërisë është që të jenë të stabilizuara marrëdhëniet diplomatike me anglo-amerikanët para se të bëhet Traktati i Paqes...

...Kardeli dëshiron që të ketë kopjen e akordit të nënshkruar nga regjimi i Zogut dhe amerikanët si dhe tekstin e letrës së qeverisë angleze për heqjen e mandatit" (Radiogram, Beograd, 1946:31)

Përse këto kërkesa? Përse i duhet Eduard Kardelit ti ketë këto dokumenta?

Mendoj se takimi kokë më kokë i ambasadorit sovjetik në Jugosllavi, A.I. Llavrentjev me Josif Broz

Titon ishte thelbësor për qëndrimin që do të mbahej deri në vitin 1948, vit ky në të cilin mardhëniet sovjeto-jugosllave u përçanë.

Enver Hoxha, në Plenumin e dytë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, i cili u mbajt në Berat, kishte kaluar në ferrin e kritikës dhe prapaskenës jugosllave. Ky plenum ishte me të vërtetë një prapaskenë e luftës së heshtur por të ashpër ndërmjet përfaqësuesit jugosllav Velimir Stojnić dhe bashkëpunëtorëve e veglave të tij. Enver Hoxha e kishte kuptuar tanimë dhe priste kohën e duhur mes vetëtimave dhe gjëmimeve të një deti të trazuar dhe plot të papritura. (Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Social-Politike, 1948: 625 - 636).

4-Një det në stuhi

U pa qartë se Moskë në atë periudhë e bazonte veprimtarinë e vet në Ballkan nëpërmjet Beogradit, por gjithnjë pa e lëshuar rolin e vet të arbitrit.

Sipas dokumentave të kohës, Moskë e konsideronte të panevojshëm kontaktin e drejtpërdrejtë me Partinë Komuniste (Levitin, 1995: 18).

Ky patronat i heshtur partiak, pothuajse i ligjëruar dhe shtetëror do të kalonte në disa faza:

Kështu, viti 1946 u bë viti i krijimit formal të bashkëpunimit Jugosllkavi - Shqipëri.

Më 9 korrik 1946 u nënshkrua Traktati për Miqësinë, Bashkëpunimin dhe Ndhimën Reciproke me afat veprimi 20 vjet, duke shtuar këtu edhe mundësinë e zgjatjes automatikisht për pesë vjet.

Neni i parë i këtij traktati "miqësie", fliste për bashkëpunimin e ngushtë e të gjithanëshëm, ndërsa neni i tretë kalonte tek dhënia e ndihmës ushtarake të menjëherëshme në rast të sulmit të njëjës prej palëve.

Po në këtë vit, u nënshkrua edhe Traktati për Shkëmbimin e Mallrave dhe Pagesave.

Më tej ai për Bashkëpunim në Fushën e Kulturës dhe të Arsimit si edhe dy protokolle shtesë.

Në total, gjatë vitit 1946 u lidhën 21 marrëveshje ndërsa viti pasardhës, 1947, u pasua nga marrëveshje të tjera.

Në një takim të ambasadorit sovjetik në Jugosllavi, Llavrentjev me Enver Hoxhën, ai do të theksonte se "Orientimi i Shqipërisë në afrimin me Jugosllavnë do të thotë orientim i Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Ky i fundit do të jap çdo mbështetje, por kjo nuk duhet afishuar kurrsesi në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet Shqipëria." (A.P.Jashtme, Moskë, 1999: 93-144, 269). Faza e fundit ishte një shkëndijë shprese për bashkëbiseduesin.

Sipas një studimi të Jurij Pavlovec, "Në kufijtë e Luftës dhe të Paqes", detyrë kryesore e Moskës në Europë në përputhje me interesat kombëtare e shtetërore të Bashkimit Sovjetik, ishte krijimi përgjatë kufijve sovjetik të "Brezit të Sigurisë", i aftë ta mbrojë atë nga përtëritja e një agresioni të mundshëm, në radhë të parë ndaj atij gjerman.

Bazë për formimin e bllokut sovjetik të shteteve juglindore duhej të ishin Jugosllavia dhe Shqipëria. Në këto dy vende, menjëherë pas çlirimit nga pushtuesit, krijuan qeveritë komuniste, të cilat i dhanë mundësinë Moskës për mbështetjen e saj në Gadishullin Ballkanik.

Gjithashtu, duke e përfytyruar mirë raportin e potencialeve të B.R.S.S dhe botës kapitaliste, Stalini nuk ndante iluzione të mëdha lidhur me mundësinë e fitoreve të shpejta në arenën ndërkombëtare.

Sipas mendimit të tij, të shprehur në Kremlin gjatë takimit me udhëheqës të Partisë Komuniste Jugosllave me në krye Titon, në prill të vitit 1945, atij i duhej të priste patjetër fillimin e luftës ndërmjet B.R.S.S dhe vendeve kapitaliste pas 15-20 vjetësh. (Anikejev, 2002:79)

Në sfondin e kësaj pritjeje ndodhi edhe forcimi i strukturave të bllokut sovjetik, i bazuar në sistemin e lidhjeve reciproke dypalëshe të B.R.S.S me secilin prej vendeve të demokracive popullore.

Po sipas këtij studimi, aleanca e krijuar ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet e luftës, para së gjithash ishte aleancë e dy partive të krijuara me inisiativën e krerëve partiak.

Deri në vitin 1946, bashkëpunimi realizohej vetëm në nivel politik dhe ushtarak, ndërsa shumë dokumenta programorë të partisë komuniste shqiptare ishin thjesht të përkthyer nga serbo-kroatishja.

Por me ofensivën e forcave sovjetike dhe daljen e tyre jashtë kufinjve të Bashkimit Sovjetik, ndikimi i Moskës si në Jugosllavi dhe në Shqipëri filloi të rritet, e cila u shpreh jo vetëm në rritjen e ndihmës ushtarake, ekonomike dhe politike, por edhe në forcimin e punës ideologjike në këto vende.

Pavarësisht rrethanave, statusin e "vëllait të madh" ndaj Shqipërisë, Jugosllavia nuk kishte ndër mend

që t'ia linte Bashkimit Sovjetik.

Në partinë komuniste të Jugosllavisë synimi për afrimin e Shqipërisë, shpjegohej me atë që në këtë vend (pra në Shqipëri), kushtet e brëndshme politike tashmë ishin pjekur plotësisht për realizimin e bashkimit. Në të njëjtën kohë, situata e jashtme ende nuk e lejonte Beogradin që të zgjidhte në mënyrë të pavarur problemet politike të jashtme pa i konsultuar me Moskën... (Plasari & Malltezi, 1996: 440 - 447).

...Në vitin 1948 ndodhi çarja në marrëdhëniet sovjet - jugosllave. Si përfundim diplomacitë me këto vende u ndërpre në menjëherë. Vendin e Jugosllavisë në botën komuniste e zuri Bullgaria, ndërsa Shqipëria i ishte nënshtruar plotësisht kontrollit komunist në Moskë.

Në kushte të tilla krijimi në shtator 1947 i Byrosë Informativë ndërsa në janar 1949 formimi i KNER, u krijua etapa e re për krijimin e bllokut sovjetik dhe si rjedhojë edhe Shqipëria.

5-Retrospektivë

Në këtë det plot stuhi dhe rreziqe, nëse nuk do të kishte ndodhur ftohja dhe çarja e marrëdhënies midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe asaj të Jugosllavisë, atëherë nuk do të mund ta mendonim dot fatin e Shqipërisë. Në cilin port do të kishte ankoruar anija e saj e batuar dhe e shkatërruar?

Përmendëm pak më lart llojet e marrëdhënies ekonomike, ushtarake, kulturore dhe arsimore që u lidhën aq lehtësisht, në një kohë të shkurtër midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, por për ta parë më thellë dhe më qartë se si precipituan në këtë mënyrë, kur situata e lirisë dhe e pavarësisë së Shqipërisë ishte në rrezik, le të japim një retrospektivë të marrëdhënies të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë që në vitet e luftës.

Sipas një relacioni të kohës, proceset që ndodhën në Shqipëri dhe në Jugosllavi në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ishin shumë të ngjashme dhe u gërshetuan më njëra-tjetrën duke lënë gjurmë në politikën e ndjekur nga njëra apo nga tjetra palë.

Dihet se në fillim të vitit 1939, në Ministrinë e Punëve të Jashtme Jugosllave, lidhur me përgatitjet e Italisë për të pushtuar Shqipërinë dhe bisedimet e kryeministrit jugosllav Stojadinoviç me Ministrin e Jashtëm Italian, Konti Ciano, flisnin për hartimin e detajuar të aksionit të përbashkët për ndarjen e Shqipërisë.

Me rënien e kabinetit të Stojadinoviçit, të gjitha planet jugosllave u përmbysën sepse Duçja nuk e shihte më Jugosllavinë si aleat të domdoshëm për këtë problem...

...Në Shqipëri, në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe më rritjen e luftës antifashiste në Jugosllavi, u vu re afrimi i forcave politike me qëllim krijimin e frontit të përbashkët të rezistencës.

Në literaturën jugosllave theksohet në mënyrë të veçantë ndihma e dhënë nga jugosllavët lëvizjes nacional-çlirimtare shqiptare dhe PKSH-së, që nga fundi i vitit 1941 deri në vjeshtë të vitit 1944, ishin anëtarët e Komisionit Rajonal të PKJ për Kosovën dhe Metohinë, Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha, të cilët ndihmuan në lëvizjen antifashiste shqiptare. Puna më efektive u zhvillua prej tyre në fushën organizative, nga e cila nxorrën udhëzimet e para për formimin e celulave të partisë dhe rekrutimin e anëtarve të parë.

Po sipas këtyre burimeve në shtator të vitit 1942, në Shqipëri mbërriti delegati jugosllav Bllazho Ivanoviç, i cili i dha Partisë Komuniste Shqiptare letërën e partisë komuniste Jugosllave me udhëzime dhe sqarime të ndryshme.

Duhet vënë në dukje se ndërmjet P.K Jugosllave dhe asaj Shqiptare, u vendosën lidhje të ngushta por është e domdoshme të theksojmë se aleanca e krijuar midis tyre në vitet e luftës, ishte para së gjithash një aleancë ndërmjet dy partive, e krijuar me inisiativën e liderve përkatës, deri në vitin 1946. Ngjarje e rëndësishme ishte plenumi i II-tëi Beratit, i KQ të PPSH. Në literaturën shqiptare përfundimet e plenumit vlerësohen si rezultat i presionit të ashpër të KQ të PKJ, vetë Plenumin si përpjekje për ta drejtuar shqipërinë në rrugën e "bashkimit me Jugosllavinë në Konfederatë dhe bile më shumë se kaq". Në Plenum "u miratuan direktiva dhe vendime që ishin në kundërshtim me interesat e partisë dhe të popullit shqiptar". Shkak i këtij qëndrimi mjaft negativ ndaj Plenumit është ajo se aty miratimi i shumicës mbajti linjën e K.Xoxe, i mbështetur nga përfaqësuesi i ri i PKJ, Velimir Stojnic, që kishte zëvendësuar M. Popovicin. (Hoxha, 1982: 121, 150-167)

Në plenumin e jashtëzakonshëm të Beratit, Enver Hoxha u kritikua ashpër nga emisarët jugosllavë

dhe veglat e tyre për pozicionin e tij ndaj Ballit Kombëtar.

...Të gjitha këto përbëjnë nga njëra anë, një labrinth të presioneve dhe diktateve jugosllave për ta futur plotësisht në tutelë, Partinë Komuniste Shqiptare dhe liderin e saj që në kohën e luftës, gjë që nuk e arritën plotësisht. Ndërkohë që nga ana tjetër, parulla për Konfederatën Ballkanike, iu shërbeu si taktikë për të arritur strategjinë e tyre: Përfshirjen e Shqipërisë në Jugosllavi.

Referencat

- Anikejev.A.S . 2002. *Jugosllavia , BRSS dhe SHBA në periudhën fillestare "të Luftës së Ftohtë"*, Moskë.
- A.P.Jashtme Ruse.1945. *Faktori sovjetik në Evropën Lindore (Sekret, Raport i Sekretarit të KQ të PKJ, E. Kardel)*, Moskë.
- A.P.Jashtme Ruse.1999. *Faktori sovjetik në Evropën Lindore."Promemorie e drejtuesit të Komisionit të Komisarimit të Popullit për punët e Jashtme të B.R.S.S, Moskë.*
- A.P.Jashtme Ruse.1999. *Faktori sovjetik në Evropën Lindore. "Konkluzione të Pjesës 23, të pikës 8 e 12"*. Moskë.
- Arkivi Shtetëror Rus i Historisë Social-Politike.1948. *Letër politike e D.S. Çuvahinit drejtuar V.M. Molotovit, për situatën në Partinë komuniste të Shqipërisë*, Moskë.
- D.P.Jashtme, Beograd,1946: F-06, L 19-23; Llavrentjev.1946.
- Faktori sovjetik në Evropën Lindore.Vol.1. 1999. Moskë.
- Hoxha, Enver.1982.Titistët , Tiranë; Shtëpia Botuese "8 Nëntori".
- Hadri Ali. 1976.*Kritikë historiografike*, Shtëpia Botuese "Prishtine".
- Gazeta "Bashkimi". 1945.*Marre nga gazeta shqiptare në ASHQ.*
- O.L.Levitin. 1995. *Problemet e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare të periudhës së pasluftës*, Moskë .
- Plasari, Ndreci &Malltezi, Luan. 1996 *.Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*,Tiranë.
- Radiogram.1946. *Hysni Kapo, Ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Beograd.*

Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në mediet informative publike, me vështrim Radiotelevizionin e Kosovës

Dr. Ferid Selimi
K.K. Preshevë

Metodologjia e hulumtimit shkencor

Për të përpiluar këtë punim shkencor, kryesisht jam shërbyer me metodën e vëzhgimit dhe të përshkrimit të standardeve profesionale të etikës gazetareske nga dokumenti i RTK-së, dhe të dokumenteve të tjera, si dhe literaturës që bën fjalë për mediet.

Fjalët çelës: medium, RTK, standardet, parimet etike, saktësia, paanshmëria, resurs informacioni, etj..

Hyrje

Duke pasur parasysh rolin e medieve në shoqëri, e të televizionit publik në veçanti, vendosja e rregullave dhe përcaktimi i dimensioneve të së drejtës për informim dhe të lirisë së fjalës së lirë, mbetet detyrë prijatë e tyre. E gjithë kjo për të siguruar një informim të drejtë, të paanshëm dhe me kohë. Gjithnjë, duke pasur për bazë etikën e gazetarisë, Bordi i televizionit publik ka miratuar një dokument intern, ku janë përfshirë standardet profesionale, e që paraqet një udhëzues për punonjësit e informacionit, përfshirë edhe sjelljen e tyre gjatë kryerjes së detyrave të përcaktuara.

Shqyrtime të përgjithshme

Mbështetur në rëndësinë që ka informimi, këto standarde, janë më tepër rregulla etike për krijimin e programit sesa që kanë të bëjnë me rregulla ligjore, dhe janë vendosur në vitin 2005, ku vend të posaçëm zënë profesionalizmi, drejtësia, dhe objektiviteti. Pa dashur që të hymë në thellësinë e veprimtarisë të RTK, do të përmend që, RTK si resurs informativ mund të konsiderohet i karakterit të dyfishtë:

Nën një: paraqitet si resurs informacioni, dhe

Nën dy: paraqitet në formë të transformuar dhe të pikëpamjeve të ndryshme të potencialit shoqëror.

Standardet profesionale të gazetarisë

Çfarë përfshijnë dhe çfarë paraqesin standardet?

Së pari: përfshijnë detyrat, obligimet, të drejtat, dhe detyrimet e punonjësve të medieve.

Së dyti, paraqesin udhëzuesin për punonjësit e medieve, pa lënë anash sjelljen e tyre, gjatë kryerjes së detyrave të përcaktuara.

Tani do të bëjmë fjalë për standardet profesionale dhe etike të gazetarisë të RTK-së, që nis me saktësinë e përfundon me balancat e informacionit.

Gazetari obligohet që të vjel të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me një ngjarje, të cilën e përcjell, ose për të cilën raporton. Dhe gjatë këtij procesi të jetë i kujdesshëm që t'i verifikojë të dhënat, dhe t'u kushtojë kujdesin përkatës për t'i prezantuar më vonë në transmetimin e RTK-së, gjithnjë duke pasur për bazë variantin letrar të gjuhës shqipe apo të gjuhës së minoriteteve vendore. Paanshmëria është vlerë themelore e të gjitha programeve të RTK-së, i cili, duke qenë transmetues publik, ka për mision informimin objektiv të publikut. Lajmet e emetuara për auditorin, jo që vetëm nuk bën të jenë të pavërteta, por nuk duhet as të plasohen në atë mënyrë dhe me atë qëllim.

Raportimi, duhet bërë qetë, i gjerë dhe mirë i informuar. Faktet dhe pikëpamjet që prezantohen në cilindo emision të RTK-së, do të duhej të transmetoheshin dhe të prezantoheshin në mënyrë të baraspeshuar dhe raportimi ka për detyrë që të marrë parasysh të gjithë personat, institucionet, çështjet dhe ndodhitë, në mënyrë të paanshme dhe etike.

Paanshmëria në programet e bazuara në fakte të bëhen duke u dhënë përparësi atyre pikëpamjeve që duken që janë më të drejta. Kujdes të veçantë duhet kushtuar raportimit, e ai gjithnjë t'i shmanget

rrethanave që do të shkaktonin dyshime të paanshmërisë së gazetarit apo të transmetuesit publik. E sidomos duhet pasur kujdes të mos krijohet bindja që gazetari apo transmetuesi ishin, janë ose ndikohen nga ndonjë grup i caktuar interesi. Në të njëjtën kohë, të punësuarit dhe mysafirët nuk mund të fshehin, e as të mos përfillin informacionin, me të cilin, mbase ata nuk do të pajtoheshin.

Gazetarët dhe redaktorët e RTK-së, sipas standardeve profesionale dhe etike duhet të respektojnë rregullën themelore profesionale, sipas së cilës të gjitha faktet duhet të verifikohen para se të emetohen. Përndryshe, janë të obliguar që të tregojnë burimin, po që se nuk e kanë verifikuar faktin. Ekziston një lehtësim për redaktorët, ose gazetarët që nuk duan të shpalosin burimin informativ. Në këtë rast, do të duhej të përdornin fjalitë, siç janë: “nga burime të besueshme”, “prej burimeve të verifikuara”, “nga burime të mirinformuara”, “nga burime diplomatike”, “nga burime të afërta me...”, (www.rtklive.com. Standardet profesionale dhe etike të gazetarisë në programet e Radiotelevizionin e Kosovës. Faqe 8) etj. Gazetarëve dhe redaktorëve të RTK-së, u është sugjeruar që t'i shmangen fjalive, si: “është thënë”, “fjala është për”, “kemi dëgjuar”, (www.rtklive.com. Standardet profesionale dhe etike të gazetarisë në programet e Radiotelevizionin e Kosovës. Faqe 8) etj..

E posaçërisht do të duhej të kishin kujdes përdorimin e burimeve të paautorizuara nga Interneti, sepse një informacion i tillë mund të shpie në dhënie e informacionit të gabuar. Prandaj kërkohet që para emetimit të materialit të paautorizuar nga Interneti, të verifikohen të gjitha faktet. Përndryshe, po të shfrytëzohet një burim i tillë, atëherë do të duhej që të tregohet qartë.

Shikuar pak më gjerë, dhe krahasuar me mediumet e tjera në vend dhe në shtetet e tjera demokratike, gazetarët dhe redaktorët e RTK, do të duhej t'i shtronin vëmendjen profesionit që kryejnë, që me të, të fitojnë besueshmërinë, sepse kjo është një nga vlerat themelore të transmetimit publik, sidomos në ato shtete dhe shoqëri demokratike.

Në qoftë se, RTK e konsideron veten si një vlerë shoqërore që ndihmon në zhvillimin e shoqërisë, përfshirë edhe demokracinë, atëherë, gazetarët e RTK-së, duhet të jenë të pavarur në punën e tyre, dhe duhet të ruajnë autonominë e profesionit të gazetarit.

Kur flitet për këto gjëra, mbase në dukje të vogla, por shumë të rëndësishme, programet e lajmeve do të duhej, që gjatë shërbimeve të veta informative të ofronin shpjegime përkatëse të ngjarjeve dhe të çështjeve që do t'i mundësonin auditorit të Radios dhe të Televizionit të krijojnë përshtypjet e veta. Besueshmëria, do të arrihej vetëm atëherë, kur secili kontribuues i programeve të RTK-së, t'i shmanget shprehjes së hapur të përkrahjes publike të çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga partitë politike apo nga shoqatat, grupet shoqërore dhe grupet e tjera të interesit.

Po ashtu, nuk duhet lejuar që, marrëdhënia familjare e dikujt nga stafi punues në RTK, të ndikojë në programet e RTK-së.

Vjelja dhe emetimi i lajmeve, a informacioneve të ndryshme në çdo medium bëhet për të siguruar një qasje më të gjerë. Nisur nga ky fakt, qëllimi kryesor i punonjësve të RTK-së është po ashtu që gjatë vjeljes dhe emetimit të një informacioni t'u mundësojë shfrytëzuesve të krijojnë një opinion për një çështje të caktuar. Kjo është përgjegjësi e tyre. Përgjegjësia gjithashtu përfshin edhe ndjeshmërinë dhe mbajtjen e një distance të caktuar ndaj materialeve që përhapen nga agjenci të ndryshme informacioni, po qenë edhe private, që, për ndonjë përfitim financiar, politik, ekonomik, a familjar, do të krijojnë një imazh dhe reputacion për personalitete të veçanta, pavarësisht fakteve, që mbase flasin ndryshe. Prandaj, do të duhej pasur kujdes, që këto informacione a lajme të verifikoheshin, e pastaj të plasoheshin në publik.

Pavarësisht asaj, që puna e gazetarit duhet të jetë e pavarur, megjithatë, veprimtaria gazetareske meqë është publike, nuk duhet larguar prej disa rregullave. Ata duhet që të punojnë në parim, duke pasur parasysh gjithnjë rregullin, që puna e tyre të jetë transparente dhe në të, të ketë qasje publiku. Pra, gazetari duhet të refuzojë çdo shtrëngim që vjen nga ndonjë institucion apo individ në kufizimin e qasjes së publikut ndaj punës së tij. Po ashtu nuk do të duhej të lejonte dhe duhet të refuzojë edhe shfrytëzimin e punës së tij nga ana e ndonjë institucioni a individi për interesa të veta personale, e që nuk do të ishte në përputhje me parimet e lirisë dhe të pavarësisë së profesionit të gazetarit. Po ashtu duhet të ketë kujdes dhe të respektojë ruajtjen e burimit informativ, ashtu si rekomandohet edhe nga Këshilli i Evropës, me përjashtim të ndonjë rasti që ka të bëjë me sigurinë e individëve të përfshirë. Kështu gazetarët dhe redaktorët e RTK-së do të tregojnë profesionalizmin që i kërkohet një punonjësi informativ publik.

Parimi i autonomisë dhe i pavarësisë së programeve të RTK-së, po ashtu ka një domethënie të madhe për punën e një mediumi.

Prandaj, gazetarët duhet të tregohen të kujdesshëm, që gjatë raportimeve të respektohen të drejtat e personave, si dhe integriteti dhe intimiteti i tyre. RTK, si medium publik dhe punonjësit do të duhej të kishin kujdes që të mos bëjnë lëshime të tilla, që do të binin ndesh me dokumentin e miratuar nga Bordi i Drejtorëve i RTK-së.

Gjuha është mjeti me të cilin raportohen informacionet në RTK. Prandaj, si transmetues publik, sugjerohet që të kenë kujdes në përdorimin e saj. Ndërsa gjatë moderimit të përdorin gjuhën e përditshme standarde.

Nuk ndalohej përdorimi i dialekteve të gjuhës shqipe, ose të gjuhëve të minoriteteve, por ato mund të përdoren vetëm nga personat që nuk janë të punësuar në RTK. Sa i përket shprehjeve jo të mira, atyre vulgare, parimisht RTK është kundër tyre dhe nuk i lejon, sikur që nuk lejon as përdorimin e gjuhës që nuk është në përputhje me normat e mirëqenies sociale.

Gazetaria hulumtuese është shumë e rëndësishme si metodologji e gazetarisë, mirëpo kjo metodë kërkon aftësi të mëdha si dhe aplikim të standardeve të saktësisë. Ky lloj gazetarie duhet të kryhet me burime adekuate dhe me kohën e nevojshme për hulumtim deri në fund. Në përputhje me parimet e saktësisë, integritetit, drejtësisë dhe të gjithëpërfshirjes, programet duhet të bazohen në hulumtim shumë të detajuar dhe të drejtë. Ato duhet të marrin parasysh të gjitha faktet relevante të mundshme dhe të njohin edhe spektrin e mendimeve në lidhje me çështjen në fjalë.

Parimet etike në Radiotelevizionin e Kosovës

Hulumtimi i përmbajtjes së programeve dhe i emisioneve në të, si dhe paramendimi i proceseve të reja, të cilat nën ndikimin e veprimit të informatës ngjallin interesim në suaza të zhvillimit të shoqërisë, janë ndër detyrat kyçe të çdo menaxheri a redaktori të një mediumi, e të mos flasim për një gazetar terreni.

Prandaj, gjithnjë e më tepër është në kërkim, objekti i studimit, e që do të thotë një proces i formimit të informatave në sistemin e raporteve shoqërore, pastaj, lënda e studimit, që nënkupton tërësinë e raporteve, që paraqiten në procesin e formimit dhe të shfrytëzimit të informatave si faktor i sigurimit të rritjes së besueshmërisë dhe të shikueshmërisë, e me të edhe të etikës së gazetarisë, që ndikojnë në krijimin e konkurrencës mediatike në shoqëritë e ndryshme.

Bordi i Drejtorëve i RTK-së, i shtyrë nga nevoja e kohës dhe e informimit sa më të drejtë dhe më të saktë, ka miratuar standardet profesionale, në mënyrë që të ndahen të drejtat si të raportuesve dhe informuesve, ashtu edhe të publikut, duke mos e cenuar shprehjen e fjalës së lirë, por as duke mos e cenuar të drejtën e publikut, ose të drejtën objektit ose të subjektit për të cilin raportohet.

Prandaj të vetëdijshëm për këtë, me kohë është kuptuar që në suaza të raporteve të ndërsjella paraqiten mosmarrëveshje dhe rreziqe, ku para së gjithash vjen deri te ballafaqimi me problemin e mbrojtjes së të drejtave të autorit, respektivisht mbrojtjen e të drejtës në produktin e informacionit, gjersa kufizimet aktuale artificiale të transmetimit të lirë të produkteve të informacionit dhe të shërbimeve krijojnë domosdoshmërinë e rregullimit sa më të efektshëm të rregullimit të veprimtarisë së informacionit nga ana e mediumit.

Gazetarët e RTK-së duhet të kenë kujdes dhe të kufizojnë veten në fakte të rëndësishme, duke shmangur përgojimet. Ato informata që emetohen duhet të jenë të rëndësishme dhe të vërteta. Raportet etike në mes të gazetarit dhe burimit të informacionit bazohen në dy parime kryesore. E para, obligimi moral dhe e dyta, besueshmëria. Luis Alvin Dej, në librin e tij *Etika në medie* thekson që *“publikimi i sekretit duhet të jetë përjashtim e jo rregull”*. (Dej. A, 2008:216)

RTK ka për detyrë të përpiket të sigurojë që sjelljet asociale, ose kriminale, të paraqitura në programe të mos kopjohen dhe një kujdes i veçantë duhet kushtuar kur flitet për teknikën kriminale. Edhe pse *“do të ishte pakuptueshme dhe joreale të fshihet përmbajtja e tërë kontraverze, edhe atëherë kur efektet në publik do të ishin të paparë”*, (Dej. A, 2008:216) por megjithatë, do të duhej pasur kujdes që ato pamje ku paraqitet dhuna ose diçka tjetër asociale të mos duket si diçka sensacionale, ose si diçka që do të duhej të imitohej nga shikuesit a dëgjuesit.

Përfundim

Gazetarët, prezantuesit e Radios dhe të Televizionit dhe redaktorët obligohen që të respektojnë parimet profesionale e standarde e etike të gazetarisë, dhe të komunikojnë me publikun në mënyrë korrekte dhe me respekt. Por, kjo nuk do të thotë që ata nuk mund t'u shtrojnë të intervistuarve të tyre pyetje të hapura dhe të detajuara dhe të kërkojnë përgjigje të qarta.

Personeli që paraqitet në emisionet e RTK-së, si dhe ekuipazhi që operon në publik, janë të obliguar të kujdesen për dukjen e tyre. Kur ata mbulojnë ngjarje formale (sesione të kongresit, ekspozita) dhe kur udhëheqin debate në studio, prezantuesit dhe gazetarët obligohen të paraqiten me veshje formale. Kur mbulojnë ngjarje jashtë ndërtesës ose pika të krizave, kodi i veshjes nuk ka nevojë të respektohet në mënyrë strikte.

Gazetarëve, redaktorëve si dhe prodhuesve e tjerë të programeve të RTK-së u rekomandohet të mos përdorin pozitën e tyre apo të veprojnë kundër saktësisë, paanshmërisë dhe kredibilitetit të programeve të RTK-së, e që me angazhimin e tyre publik dhe politik të rrezikojnë reputacionin e individëve ose të institucionit në tërësi apo të tradhtojnë besimin e shikuesve dhe të dëgjuesve. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse në këtë mënyrë mbrojnë jo vetëm besueshmërinë e mediumit, por edhe autoritetin e tyre. Sipas, Luis Alvin Dej, gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm, sidomos kur janë në ndonjë lidhje dashurie ose në bashkëshortësi me ndonjë individ që është burim potencial i informacionit.

Punëtorëve të rregullt të këtij mediumi nuk u lejohej të kenë detyra, punë apo angazhime afariste të tjera që bien në kundërshtim me mediumin ku punojnë. Kur keqpërdoret ky provizion, atëherë konsiderohet si shkelje flagrante e këtij Kodi. Përrjashtim ka vetëm në raste të veçanta (për nevoja shkencore, artistike, shkollore apo sportive) edhe atë lejohej vetëm nga ana e Drejtorit Gjeneral të RTK-së.

Literatura

- Claude-Jean, Bertrand. Deontologjia e medieve. ISHM. Tiranë, 2007
- Dej, A. Luis. Etika u medijama. Klub plus. Beograd, 2008
- Dominick, R. Joseph. Dinamika e komunikimit masiv. UETPRESS, Tiranë, 2010
- Duhamel, Oliver. E Drejta Kushtetuese. Logos - A: Shkup, 2004
- Dhima, Dh. Aleksandër. Hyrje në Antropologji. Botim i tretë. Ideart, Tiranë, 2010
- Djorgjeviç, Toma. Teorija informacija. SITJ. Beograd, 1989
- Djorgjeviç, Toma. Komunikacija i vlast. VEI. Beograd, 1988
- Ismaili, Hilmi & Fatmir Sejdiu. Historia e Shtetit dhe e së Drejtës. Prishtinë, 2002
- Ismaili, Osman: Fillet e së Drejtës, Prishtinë, 2004
- Ismaili, Osman: Filozofia e së Drejtës. Prishtinë, 2006
- Kasimati, Mimoza & Mimoza Manxhari. Sjellje Organizative. SHBLU. Tiranë, 2005
- Kuhn, Tomas. Struktura e Revolucioneve Shkencore. CEU PRES. Dukagjini. Pejë, 1997
- K. Spiker. Komunikimi organizativ. Përktheu: Belina Budina. UET/ PRESS. Tiranë, 2009
- Ligji Nr. 02/L-47 Për Radiotelevizionin e Kosovës. www.gazetazyrtare.com
- Mcnaair, Brian. Hyrje në komunikimin politik. UETPRESS (Botim i katërt). Tiranë, 2009
- Papa, J. Michael e Tom D. Daniels & Barry K. Spiker. Komunikimi organizativ. Përktheu: Belina Budina. UET/ PRESS. Tiranë, 2009
- Popper, Karl. Mjerimi i historicizmit. Onufri. Tiranë, Pa vit botimi.
- Rachels, James. S. Rachels. Elementet e filozofisë morale ISP&Dita. Tiranë, 2000
- Ramadani, Ibrahim. Mjedisi jetësor. Vatra. Prishtinë, 2011
- .Sartori, Gjovani. Çështë Demokracia. Tiranë, 1998
- Timotiç, Milan. Metode merenja auditorijuma radija i televizije. RTS. Beograd, 1998
- Weber, Max. Politika si profesion. Asdreni. Shkup, 2006
- Veljanovski, Rade. Javni RTV servil u sluzbi gradjana. Clio. Beograd, 2005
- www.rtklive.com. Standardet profesionale dhe etike të gazetarisë në programet e Radiotelevizionin e Kosovës. 2005.
- Dzouns, Stiven. Virtuelna kultura. KO. Beograd, 2001

Karakteristikat e të lexuarit si dhe kuptimi i të lexuarit nga nxënësit më paaftësi dëgjimi të klasave VI-VIII

PhD.cand.Mustaf Morina 1,

PhD.cand.Hazir Elshani 2

Q.B."Nene Tereza"& Qeap-Heimerer, 2.DASH

Abstrakt

Të lexuarit e mirë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve më dëmtim dëgjimi, gjithashtu të lexuarit në mënyrë të eksplicite është një nga faktortë kryesorë të cili ndikojnë në zhvillimin e gjuhës orale të fëmijëve me dëmtim dëgjimi. Forma dhe mundësia më e mirë e përvetësimit, zhvillimit të gjuhës orale, zhvillimit të komunikimit, marrëveshjeve të informatave, diturive, ideve mbi botën që e rrethon, është të lexuarit, kur rruga e perceptimit auditiv është e dëmtuar të lexuarit është i dobët. Dëmtimi i dëgjimit shkakton mjaftë problem në zhvillimin të personalitetit të fëmijëve më dëmtim dëgjimi në këto fusha; në zhvillimin e dobët të fjalëve-fjalorit, cilësinë e dobët të leksikut të atij/asaj, cilësinë e dobët e fjalive, dhe çrregullim në artikullim e kështu me radhe.

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të vërtetojë këto çështje:

1-Shpejtësinë e të lexuarit e fëmijëve më dëmtim në dëgjim

2-Numrin e gabimeve në të lexuar

3-Llojet e gabimeve gjatë të lexuarit

4-Të kuptuarit e tekstit në kontekstin e shkollës së dëmtimit të dëgjimit, moshës (klasës) suksesit në shkollë dhe gjinisë.

Ky studim teoriko-eksperimental është bërë me nxënësit e dy shkollave; të shkollës speciale "Nënë Tereza" në Prizren dhe të Shkollës fillore "Elena Gjika" në Prishtinë (klasë të bashkangjitur). Në hulumtim kanë marr pjesë gjithsej 32 nxënës,(respondent) 27 nxënës(respondent) nga shkolla special "Nënë Tereza" në Prizren dhe 5 nxënës të shkollës fillore "Elena Gjika" të Prishtinës,(nxënësit e një klase të bashkangjitur) të gjithë këta nxënës kanë qenë me dëmtim dëgjimi. Nga 32 nxënës të përfshirë në hulumtim, 23 janë meshkuj dhe 9 femra. Hulumtimi është bërë duke aplikuar një tekst të fabulës "Dhelpra dhe korbi" e shikuar dhe analizuar në aspektin tredimensional. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar se nxënësit me dëmtim dëgjimi kanë probleme të konsiderueshme në shumë aspekte; në aspektin e shpejtësisë së të lexuarit, nxënësit me dëmtim dëgjimi kanë ngecje në krahasim me bashkëmohatarët e tyre në raport 8/1. Në aspektin e të leximit me gabime kanë ngecje të konsideruara të pakrahasuara. Në aspektin e të kuptuarit të tekstit nxënësit me dëmtim në dëgjim ka ngecje në krahasim me bashkëmohatarët e tyre në 8/1.

Dallime të rëndësishme egzistojnë edhe mbrenda grupit të nxënësve të shurdhër në të tri aspektet e studimit bazuar në tekstin tredimensional të tekstit, edhe sa i përket shpejtësisë së të lexuarit, ekzistojnë dallime të theksuara po ashtu në manifestimin e gabimeve dhe në të kuptuarit e tekstit. Dallimet janë evidente edhe për nga aspekti i shkallës së dëmtimit të dëgjimit, në aspektin e moshës dhe të gjinisë brenda për mbrenda grupit të të shurdhëve, kjo domethan se karakteristikat individuale të nxënësve paraqesin faktë të rëndësishëm .

Fjalët kyçe: Paaftësi në dëgjim, dëmtimi i dëgjimit, moshë e dëmtimit, periudha e dëmtimit.

Hyrje

Të lexuarit përbënë një nga format më të rëndësishme të të mësuarit, si dhe komunikuarit në botën bashkëkohore. Ndërkaq të lexuarit për fëmijët me dëmtim dëgjimi është edhe më i rëndësishëm sepse përmes të lexuarit nxënësit më dëmtim dëgjimi përfiton njohuritë bazë (themelore) mbi botën, shoqërinë, shkencën, kulturën, përmasat të lexuarit fëmijete shurdhër vijnë në kontakt më të mirë të mundshëm me botën në të cilën jetojnë dhe vepron. Të lexuarit për fëmijët me dëmtim dëgjimi përbënë çështjen kryesore, në aspektin e zhvillimit të aftësisë e të kuptuarit të koncepteve gjuhësore, dhe zhvillimit të aftësisë së të folurit etj.

Procesi i të lexuarit, karakteristikat, format, kodimi dhe dekodimi i shkronjave, tingujve, rrokjeve,

fjalëve fjalive dhe periudheve janë vetëm disa nga vështirësit që ballafaqohen çdo ditë fëmijët me dëmtime në dëgjim gjatë procesit të mësuarit të të lexuarit. Sipas Woodworthi (1950)“ Të lexuarit e mirë më shumë kushtëzohet nga të dëgjuarit e mirë se sa nga të pamurit e mirë”. Aspekti vizuel tregon korelacionin e ultë pozitiv të thelbit të të lexuarit, elementi akustik në të lexuar është më domethënës si në ritëm, theks, melodi dhe artikulum.

1. Të lexuarit, definicioni dhe elementet

Të lexuarit në kuptimin më të thjeshtë të fjalës d.m.th. njohja e shkronjave në formë të shtypur dhe të shkruar, shqiptimi i drejtë i shkronjave, kuptimi i lidhshmërisë së shkronjave, rrokjeve, fjaleve, fjalisë dhe periudhës, në të kuptuar dhe artikulluar (kuptimi gjuhësor).

Të lexuarit në kuptimin tjetër është vetëdijësim i kuptimit të lidhshmërisë të çfarëdo simboli apo të sistemit të tërësishëm të simboleve gjuhësore si dhe të kuptuarit e domethënies, porosisë, mesazhit(kuptimi psikologjik). Të lexuarit si proces ngërthen në vëtë të kuptuarit tekstual me çka nxënësi në këtë mënyrë krijon kuptimin e shkronjave, shenjave, simboleve, ritmit, melodisë, rrokjeve, intonacionit, fjalëve dhe fjalive (kuptimi pedagogjik). Sipas Goodmonit dhe Nilesit “Të lexuarit është proces psiko-linguistik me çka ndikon në masë të madhe në interaksioni në mes të kuptimit dhe të shprehurit gjuhësor”. Të lexuarit është proces dinamik psiko-linguistikë përmes të cilit lexuesi nxjerr porosinë nga shkronjat e shkruara në formë grafike”¹⁾(Goodmon. K 1971) Procesi i të lexuarit për nxënësit me dëmtim në dëgjim është peoces më i ndërlikuar që kërkon qasje tjetër, përkushtim dhe aktivitet të dendur në Feed Back.

Përceptimi vizuel i shkronjave (grafema), përceptimi auditiv i shkronjave (fonema), të theksuarit e shkronjave (artikulema) janë vetëm disa nga sfidat, problemet që ballafaqohen nxënësi me dëmtim në dëgjim. Në mënyrë natyrore procesi i të lexuarit është proces kompleks, ndërsa për nxënësit me dëmtim në dëgjim, të lexuarit jo vetëm për shkak të pamundësisë së komunikimit me rrethin shoqëror, për shkak të deprivimit auditiv por edhe për shkak të bazës së paformuar kognitive dhe linguistike, gjë që ndikon në procesin e të lexuarit dhe në të kuptuarit të asaj që lexon. Elementet bazë që ndikojnë në të lexuarit janë:-Analizatori vizuel (forma, madhësia, kjarhtësia, thellësia, ngjyra, ngjajshmëria e shkronjës, simbolit).-Analizatori auditiv (theksi, intonacioni, melodia, ngjyra auditive e shkronjave, fenomeneve, rrokjeve, fjalëve dhe fjalive, zhvillimi i kuptimit dhe vetëdijësimit fonemik dhe fonologjik).-Të folurit dhe gjuha (fonema dhe grafema).

Zhvillimi i artikulimi të nxënësit me dëmtim dëgjimi më së shumti varet nga teknikat e përceptimit vizuel (përdorimi i pasqyrës, dorës nën mjekër, leximi i buzëve etj) se sa teknika kognitive apo auditive sepse këto baza nuk janë të zhvilluara, sidomos baza psiko-linguistike është e ultë. Prandaj me të drejtë mund të konkludojmë se të lexuarit është proces integrues në mes të përceptimit vizuel të shkronjave, organeve të të folurit (përceptim auditiv, nën kontrollin e analizatorit dëgjimor).

1.2. Të lexuarit e nxënësit me dëmtim dëgjimi

Rrugët e zhvillimit gjuhësor dhe të lexuarit te fëmijët me dëmtim dëgjimi janë të ndryshme nga rrugët e zhvillimit të të lexuarit të fëmijët me zhvillim normal. Zhvillimi i të lexuarit dhe të gjuhës të fëmijëve me dëmtim dëgjimi është specifike, i tërthortë (indirekte) nga ai normale dhe natyrore. Zhvillimi jo i rregullt, anormal i gjuhës në fazën e fëmijërisë e pamundëson krijimin e bazës linguistike të fëmijëve me dëmtim dëgjimi. Si pasoj e dëmtimit të dëgjimit kjo kategori e fëmijët kanë deficit në zhvillimin të aftësive kognitive, gjuhësore, në të mësuar dhe në të lexuar. Nga një numer i madh i studiuesve qe jane marr me studimin e të lexuarit të fëmijëve me dëmtim dëgjimi do të veçonim , Piter dhe Patterson në gjurmimin e bër me fëmijët me dëmtim dëgjimi të moshës 14 deri 16 vjeçare, me një test të njëjtë, ata kanë arritur në përfundim se fëmijët e kësaj kategorije kanë arritur rezultatin e një niveli të fëmijës 7 vjeçar të shkollës normale.

Normen kombëtare për shpejtesin e të lexuarit e fëmijëve me dëmtim dëgjimi në SHBA e kanë dhën Wrihston, Arnow dhe Moskowitz(1963) ata kanë testuar 5307 nxënës me dëmtim dëgjimi të moshës 10 deri 16 vjeçare, bazuar ne këto hulumtime mund të konkludojm, se fëmijët me dëmtim

dëgjimi i duhet 5 vjet për të përmirësuar, përvetësuar të lexuarit krahas bashkëmoshatoreve të tyre më zhvillim normal të cilit i duhet vete një vjet domethan diferenca në mes të fëmijëve me zhvillim normal dhe atyre më dëmtim dëgjimi është 5/1.

Një studim më eksplisit të bër nga Di Françeska (1972) më 17000 nxënës të moshave nga 6 deri 21 vjeç në një subtekt të zgjedhur (Stanford Achievemnt test) ka arritur këtë përfundim, fëmijët me dëmtim dëgjimi për një vitë shkollor kanë arritur të përvetsojn 20 % në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre që dëgjojnë. Në disa studime të bëra nga Sektori për Studime Demografike të nxjerra nga Trybus dhe Karchmer (1977) në të cilin hulumtim kanë marr pjesë 6871 fëmijë me dëmtim dëgjimi të moshës 20 vjeçare ata kanë konkloduar se sukseksi ekuivalent i të lexuarit i personave më dëmtim dëgjimi arrin nivelin e një nxënësi të klasës së IV dhe V të shkollës së rregullt fillore.

Në një studim të zhvilluar nga Brimerit (1972) i cili ka zhvilluar një hulumtim më 467 nxënës të Anglisë dhe Uellsit të moshës 15 – 16 vjeçare, të cilin e ka cituar Konrad (1979) konstatojn se nxënësit me dëmtim dëgjimi të mosh 15-16 vjeçar kanë lexuar si një nxënës 9 vjeçar i shkollës së rregullt. Ndërsa rezulltat më të mirë kanë treguar gjurmimet të bëra në Danimark, Suedi dhe Zelandën e Re. Ekuivalenca ka qenë fëmija 16 vjeçari i shurdhër ka lexuar sa një fëmijë 10 vjeçar jo i shurdhër.

Sipas Mykelbust (1960) bëri të ditur se nxënësit me dëmtime në dëgjim kanë ngecje në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, dallimi është evident në të dhënat statistikore për të gjitha grupmoshat e të dy gjinive. Shkalla e ngecjes sipas Mykelbust rritet nga viti në vit, ndërsa te bashkëmoshatarët e tyre që dëgjojnë egziston tendenca e kundërt. Se sa ndikojnë negativisht pasojat e dëmtimit në dëgjim tregojnë të dhënat statistikore se nxënësit me dëmtim dëgjimi në moshëm 9 vjeçare kanë arritur shkallën standarde 3.21, kurse bashkëmoshatari i tyre që dëgjon 21.37, në moshën 15 vjeçare nxënësit e shurdhër kanë arritur shkallën mesatare 11.32 ndërsa bashkëmoshatari i tyre që dëgjon ka arritur shkallën mesatare 63.30. Përparimi i përgjithshëm për të shurdhër ka qenë 8.11 ndërsa për nxënës që dëgjojnë 41.93. Bazuar në studimet e bëra te cileve ju referuam mund të konstatojmë se nxënësit me dëmtim në dëgjim përparojnë mjaftë ngadalë në të lexuar. Kur nxënësi i shurdhër kryen shkollën fillore ngec prapa nxënësve me zhvillim normal në aspektin e të lexuarit në nivel 7 - 8 vjet. Woodworth konkludon se shpejtësia e të lexuarit është individuale. Ai në gjurmimin e tij që e ka bërë në lidhje me shpejtësin e të lexuarit, të zgjedhur nga një roman interesant ka konkluduar “shpejtësia mesatare e të lexuarit me zë është 3.6 fjalë në sekond, dallimet individuale 2.2 deri në 4.7 fjalë në sekond, shpejtësia maksimale 4.6 fjalë në sekond, dallimi individual 2.9 deri 6.4 fjalë në sekond në të lexuarit në vete”. Në leximin e zakonshëm mesatarja 5.6 fjalë në sekond, dallimet individuale 2.5 deri 9.8 fjalë në sekond.

II. Metodologjia e hulumtimit

2.1. Qëllimi i gjurmimit

Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë përcaktimi i raportit ndërmjet të lexuarit , shpejtësia e të lexuarit, gabimet në të lexuar si dhe kuptimi i të lexuarit të nxënësve me paafteksi dëgjimi.

1. Shpejtësia e të lexuarit, shkalla e dëmtimit të dëgjimit, sukseksi në mësim, mosha dhe gjinia.
2. Paraqitja e gabimeve në të lexuar, shkalla e dëmtimit të dëgjimit, sukseksi, mosha dhe gjinia
3. Llojet e gabimeve, shkalla e dëmtimit të dëgjimit sukseksi, mosha dhe gjinia.
4. Kuptimi i tekstit, shkalla e dëmtimit të dëgjimit, sukseksi, mosha dhe gjinia.
5. Konstatimi i llojit të gabimeve në të lexuar, në kontekstin e shkallës së dëmtimit të dëgjimit, sukseksi, mosha dhe gjinia.
6. Konstatimi i shkallës së kuptimit të tekstit, në kontekstin e dëmtimit të dëgjimit, sukseksi, mosha dhe gjinia.

3. Te gjeturat shkencore


3.1. Shpejtësia e të lexuarit

Ngecja esenciale të fëmijëve me dëmtim dëgjimi konsiderojmë se vjen si pasoj e dëmtimit të

dëgjimit, pastaj sistemi tradicional i arsimit, kurikuli fragmentar (i pamodifikuar sipas nevojave, dhe mundesive akceptuese), metodat joadekuate, strategjit e vjetëruara, mungesa e mjeteve të konkretizimit, mungesa e mjeteve teknike ndihmëse si dhe shumë faktor tjerë.

Struktura e dëmtimit të dëgjimit të 32 nxënës (respondenteve). Me dëmtim dëgjimi total kanë qenë 15.62 % (ose 5 nxënës), me dëmtim dëgjimi të rëndë 31.25 % (ose 10 nxënës), me dëmtim dëgjimi të mesëm 25 % (ose 8 nxënës) ndërsa me dëmtim dëgjimi të lehtë 28.12 % (ose 9 nxënës). Nxënësit të cilët kam marrë pjesë në hulumtimin mbi shpejtësinë e të lexuarit në dy rrahë të testimit të të lexuarit, herën e parë dhe herën e dytë pas 6 muajve kanë dhënë këto vlera, rezultate në shpejtësinë e të lexuarit. Nxënësit e klasës së VI-të 103 fjalë në testimin e parë i kanë lexuar mesatarisht për 199.05 sekonda ndërsa në testimin e dytë pas gjashtë muajve mesatarisht për 191.58 sekonda, ndryshimi në përparim në të lexuar nga testimi i parë në të dytin është mesatarisht për 7.92 sekonda. Nxënësit e klasës së VII-të në testimin e parë mesatarisht 103 fjalë i kanë lexuar mesatarisht për 176.65 sekonda ndërsa në testimin e dytë për 171.79 sekonda. Ndryshimi në përparimin e të lexuarit nga testimi i parë në të dytin është mesatarisht për 4.86 sekonda. Nxënësit e klasës së VIII-të në testimin e parë 103 fjalë i kanë lexuar mesatarisht për 141.15 sekonda, ndërsa në testimin e dytë për 135.48 sekonda. Ndryshimi në përparimin e të lexuarit nga testimi i parë në të dytin është mesatarisht për 5.67 sekonda. Mesatarja e të lexuarit për nxënësit e klasës së VI në testimin e parë ka qenë një fjalë për 1.71 sekonda, ndërsa në testimin e dytë një fjalë e kanë lexuar mesatarisht për 1.66 sekonda. Nxënësit e klasës së VII-të në testimin e parë e kanë lexuar mesatarisht një fjalë për 1.37 sekonda ndërsa në testimin e dytë një fjalë e kanë lexuar për 1.31 sekonda. Nxënësit e klasës së VIII-të në testimin e parë kanë lexuar mesatarisht një fjalë për 1.20 Rezultati individual më i mirë ka qenë 103 fjalë për 60.91 sekonda.

Shpejtësia e të lexuarit për sekonda




Grafikoni nr 1.(Paraqitja aritmetike e pasqyrës së shpejtësisë Grafikoni nr 2.) Pasqyrimi grafik i hapësirës aritmetike të dëmtimit të dëgjimit lexuarit sipas klasave) shpejtësia në të leximit

Karakteristika e përgjithshme të shpejtësisë të të lexuarit të nxënësve më aftësi të kufizuar dëgjimi është në rritje nga klasa VI në klasën e VII deri në klasën e VIII. Gjithashtu edhe brenda intervalit kohorë prej gjashtë muajve kemi rritje të shpejtësisë rritjen më të ndjeshme kanë treguar nxënësit e klasës VI, përparimi është mesatarisht për 103 fjalë 7.92. sekonda pas gjashtë muajsh. Klasa e VII kanë rritur shpejtësinë mesatare në të lexuarit për 4.86 sekonda ndërsa klasa VIII ka ngritur shpejtësinë mesatarisht për 5.67 sekonda. Në grafikoni nr.2 konstatojmë se dëmtimi i dëgjimit është një nga shkaqet kryesore të ngecjes në të lexuarit, respektivisht të shpejtësisë në të lexuarit. Në hulumtim nxënësit i kemi ndarë në 4 grupe, në grupin e parë bëjnë pjesë nxënësit me dëmtime dëgjimi të total mbi 120 dB. Në këtë grup janë 5 nxënës. Shpejtësia e të lexuarit të nxënësve të këtij grupi është mesatarisht si vijon: Në testimin e parë 103 fjalë i kanë lexuar për 289.44 sekonda, në testimin e dytë 103 fjalë i kanë lexuar për 238.31 sekonda, përparimi në testimin e dytë është për

51.15 sekonda. Në grupin e dytë bëjnë pjesë nxënësit me dëmtim dëgjimi të rend 71-91 dB. Në këtë grup ka pasur 10 nxënës shpejtësia e të lexuarit mesatarisht ka arritur në testimin e parë 217.77 sekonda për 103 fjalë, kurse në testimin e dytë 103 fjalë mesatarisht i kanë lexuar 103 fjalë për 217.33 sekonda. Në grupin e tretë kemi nxënësit me dëmtim dëgjimi-mesem 56-70 dB, në këtë grup kanë qenë 8 nxënës. Shpejtësia e të lexuarit e këtij grupi në testimin e parë ka qenë mesatarisht, për 103 fjalë i kanë lexuar për 175.83 sekonda kurse në testimin e dytë pas gjashtë muajve, 103 fjalë i kanë lexuar për 175.68 sekonda. Në grupin e katërt janë nxënësit me dëmtim dëgjimi të lehtë 41-55 dB, në këtë grup kanë qenë 9 nxënës. Shpejtësia e të lexuarit e këtij grupi mesatarisht në testimin e parë 103 fjalë i kanë lexuar për 118.25 sekonda, kurse në testimin e dytë 103 fjalë i kanë lexuar për 118.11 sekonda. Në grafikonin shihet se sa ndikon, shkalla e humbjes së dëgjimit në shpejtësin e të lexuarit. Në këtë grupe dallim në mes të nxënës të klasave VI,VII dhe VIII, nuk janë esenciale, dallimet në grupe janë evidente sepse shkalla e demtimit të dëgjimit paraqet faktor crucial i cili ndikon në shpejtësin, respektivisht në të lexuar.

Shpejtësia e të lexuarit matur për sekonda



Grafikoni nr.3 –treguesi artimetik (suksesit i nxënësve në Grafikoni nr.4- treguesi grafik (shpejtësia në të lexuar sipas gjinive) mësimet dhe shpejtësisë në të lexuar)


Në grafikonin nr.3 japim pasqyrën e suksesit të nxënësve në lëndën e gjuhës dhe shpejtësin e të lexuarit të bazuar në rezultatet në mësimet. Nxënësit janë ndarë në 4 grupe, nxënësit më sukses të shkëlqyeshëm gjashtë nxënës, nxënësit më sukses shumë mirë shtatë nxënës, nxënësit më sukses të mirë dhjetë nxënës dhe të mjaftueshëm nëntë nxënës. Në grupin e parë janë nxënësit e shkëlqyeshëm (6 nxënës). Rezultatet e treguar nga testimi i parë dhe në të dytin janë; Nxënësit më sukses të shkëlqyeshëm 103 fjalë, mesatarisht në testimin e parë i kanë lexuar për 110.25 sekonda, ndërsa në testimin e dytë 103 fjalë mesatarisht i kanë lexuar për 107.11 sekonda. Në grupin e dytë janë të përfshirë nxënësit më sukses shumë të mirë (7 nxënës). Rezultatet që kanë arritur në shpejtësin e të lexuarit mesatarisht ky grup në testimin e parë dhe të dytë për 103 fjalë të lexuara janë: 170.83 sekonda në testimin e parë dhe 168.30 sekonda testimin e dytë. Në grupin e tretë kanë qenë nxënësit me sukses të mirë (10 nxënës). Rezultatet e arritura në shpejtësin e të lexuarit mesatarisht ky grup në testimin e parë dhe të dytë janë, 103 fjalë i kanë lexuar për, 207.35 sekonda në testimin e parë dhe 205.10 sekonda në leximin e dytë. Në grupin e katërt kanë marrë pjesë nxënësit me sukses të mjaftueshëm (9 nxënës). Rezultatet që kanë arritur në shpejtësin e të lexuarit mesatarisht ky grup, në testimin e parë 103 fjalë i kanë lexuar për 280.10 sekonda dhe në rreth të dytë për 275.80 sekonda. Duke i analizuar të dhënat mund të konstatojmë se rezultat më të mirë kanë treguar nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm, si në testimin e parë ashtu edhe në testimin e dytë, kurse rezultat më të dobët kanë treguar natyrisht nxënësit më sukses të mjaftueshëm. Dallimi

nga testimi i parë në të dytin të bërë pas 6 muajve është si vijon: nxënësit e shkëlqyeshëm kanë lexuar mesatarisht 103 fjale më shpejtë në testimin e dytë për 6.86 sek. se në testimin e parë. Kurse nxënësit e mjaftueshëm kanë përparuar në shpejtësinë e të lexuarit për dallim nga testimi i parë për 4.03 sek. Diferenca e shpejtësisë mesatare e të lexuarit në mes grupit të nxënësve më sukses të shkëlqyeshëm dhe të mjaftueshëm për të lexuar 103 fjalë ka qenë në testimin e parë për 169.85 sekonda më shpejtë se nxënësit me sukses të mjaftueshëm, kurse në testimin e dytë shpejtësia e të lexuarit ka arritur në 168.69 sekonda në krahasim më nxënësit e mjaftueshëm. Norma mesatare e të lexuarit e nxënësve që dëgjojnë është 3 - 4 fjalë në second. Ndërsa nxënësit e shkëlqyeshëm me dëmtim dëgjimi, kanë arritur që një fjalë ta lexojnë për 1.038 sekonda ndërsa nxënësit me sukses të mjaftueshëm mesatarisht kanë lexuar një fjalë për 2.67 sekonda. Nga kjo shihet se sa është ngecja në mes të nxënësve që kanë dëmtim dëgjimi me bashkëmoshatarët që dëgjojnë. Nxënësi me dëmtim dëgjimi më sukses të shkëlqyeshëm në mësim ka ngecje në të lexuar nga nxënësi që dëgjon për një fjalë për 5.52 sekonda, ndërsa nxënësi me dëmtim dëgjimi më sukses të mjaftueshëm në mësim ka ngecje në të lexuar e një fjale nga bashkëmoshatarit i tij që dëgjon për 10.68 sekond. Në grafikun nr.4- jan të pasqyruar rezultatet e shpejtësisë së të lexuarit të ndara në gjini. Në grupin e meshkujve kanë marrë pjesë 23 nxënës të testuar në dy teste, në grupin e femrave janë testuar 9 nxënës gjithashtu të testuara në testimin e parë dhe në testimin e dytë. Në testimin e parë nxënësit meshkuj 103 fjale mesatarisht i kanë lexuar për 194.49 sekonda kurse në testimin e dytë 103 fjalë i kanë lexuar për 187.09 sekonda. Dallimi në mes të testimit të parë dhe të dytë është për 07.40 sekonda, në testimin e dytë është shënuar një përparim i vogël në krahasim me testimin e parë. Nxënëset vajzat kanë arritur këtë rezultat, 103 fjale i kanë lexuar për 180.25 sekonda në testimin e parë kurse në testimin e dytë 103 fjalë i kanë lexuar për 180.10 sekonda. Dallimi në rezultat nga testimi i parë është vetëm 00.15 sekonda. Dallimet në mes të testimit të parë dhe të dytë të meshkujt përparimi është më i madh në arritjen e shpejtësisë së të lexuarit ndërsa të femrat përparimi është më i ulët, kurse dallimet në shpejtësinë e të lexuarit në mes të meshkujve e femrave, femrat kanë arritur rezultat më të mirë si në testimin e parë ashtu edhe në të dytin. Në testimin e parë femrat 103 fjalë i kanë lexuar më shpejtë se meshkujt për 14.24 sekond kurse në testimin e dytë për 10.99 sekonda më shpejtë se meshkujt.

3.2. Gabimet në të lexuar

Dëmtimi në të dëgjuar fëmijëve u shkakton shumë pengesa në zhvillimin e të lexuarit, të folurit, në krijimin e fondit të fjalëve, në krijimin e njohurive gramatikore, në krijimin e strukturës së fjalisë në zhvillimin semantike dhe fonologjike të gjuhës, në artikulum si dhe është shkaktar themelor i të lexuarit në mënyrë të gabuar.


Numri i gabimeve në 30 fjale



Grafikoni nr 5. treguesi grafik i mjedisit artimetik (dëmtimi Grafikoni nr.6- treguesi grafikë (suksesi në mesime dhe gabimet në lexim) i degjimit dhe gabimet në lexim).

Në grafikonin nr.5- janë paraqitur gabimet në të lexuar të nxënësit me dëmtim dëgjimi janë të konsiderueshme, në të gjitha aspektet, numri i gabimeve shkonë duke u rritur nga klasa në klasë për shkak kompleksitetit të teksteve nga klasa e ulta në klasët më të larta. Në korelacion me shkallën e dëmtimit të dëgjimit edhe numri i gabimeve është më i shprehur. Te nxënësit me dëmtim dëgjimi total është shprehur numri më i madh i gabimeve në krahasim me shkallën e dëmtimit të dëgjimit të lehtë. Në grupin e dëmtimit të dëgjimit total mesatarja e gabimeve është shprehur në 18.68 gabime, në grupin e dytë të dëmtimit të rëndë të dëgjimit 17.30 gabime, në grupin e tretë të dëmtimit të dëgjimit, dëmtimi i mesëm kanë bërë 10.83 gabime dhe grupi i katërt i dëmtimit të dëgjimit, dëmtimi i lehtë kanë shkaktuar 7.18 gabime të gjitha këto gabime janë konstatuar në 30 fjalë të lexuara. Në grafikonin nr. 6 do të pasqyrojmë rezultatin e arritur duke krahasuar suksesin në mësim dhe gabimet në të lexuar, gabimet më të mëdha i kanë shkaktuar nxënësit me sukses të mjaftueshëm në krahasim me nxënësit me sukses të mirë, kurse ata me sukses shumë mirë kanë treguar numër më të madh të gabimeve se nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm në të dy rathët e testeve. Nxënësit me sukses të mjaftueshëm kanë shkaktuar 19.50 gabime në rrethin e parë ndërsa 22 në rrethin e dytë të testimit. Nxënësit me sukses të mirë kanë bërë 17.05 gabime në testimin e parë ndërsa 19.08 gabime në testimin e dytë. Nxënësit me sukses shumë të mirë kanë bërë 14 gabime në testimin e parë ndërsa 17 në testimin e dytë. Kurse nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm në testimin e parë kanë bërë 14 gabime në të dytin 17 gabime.

Numri i gabimeve ne 30 fjalë



Grafikoni nr.7 treguesi grafik i mjedisit aritmetik Grafikoni nr. 8 treguesi grafikë i mjedisit aritmetik numri i gjinia dhe numri i gabimeve) gabimeve të shkaktuar në testin e lexuar sipas klaseve

Në grafikonin nr. 7 do të pasqyrojmë të dhënat e arritura nga rezultati i të lexuarit të ndarë në dy grupe gjinore. Në bazë të gjurmimit të bërë mund të konkludojmë se meshkujt kanë bërë më shumë gabime se sa femrat, por të dhënat nuk tregojnë diferencë të thellë domethënëse as në testimin e parë as në testimin e dytë. Në grafikonin nr. 8 do të japim pasqyrën e treguesit të mesit aritmetik të gabimeve të shkaktuara si pas klasëve, klasa e VI-të në rrethin e parë të testimit ka shkaktuar 19.10 gabime, kurse në testimin e dytë 18 gabime. Klasa e VII-të në rrethin e parë të testimit kanë shkaktuar 18.50 gabime ndërsa në rrethin e dytë 17 gabime. Klasa e VIII-të në testimin e parë ka shkaktuar 15.30 gabime ndërsa në testimin e dytë 16.10

3.3. Llojet e gabimeve

Gjatë leximit të tekstit nga nxënësit kemi konstatuar këto lloje të gabimeve: Tabelar i treguesit të gabimeve në të lexuar për të gjithë nxënësit.

Nr.	Llojet i gabimeve	Testimi i parë	Testimi i dytë
1.	Vështirësi në lidhjen e shkronjave	2.52	2.10
2.	Të lexuarit e shkronjave të përbëra ndaras	0.60	1.18
3.	Përsëritja e shkronjave të lexuara	2.77	2.05
4.	Humbja e rreshtit në tekst	1.18	0.90
5.	Vështirësi në leximin e fjalëve shumëërrokshe	3.55	3.10
6.	Substitucioni-ngatritimi i shkronjave p.sh.p-q	0.61	0.51
7.	Inverzioni-ngatritimi i vendit gjatë leximit	0.25	0.15
8.	Leximi i numrave	9.03	8.89

1. Vështirësi në lidhjen e shumë shkronjave në fjalë numri i gabimeve është shprehur në 23 fjalë në të cilët kanë pas vështirësi në të lexuar gabime më të mëdha kanë bërë në këto 5 fjalë: dhelpa-10.26 %; mirëmëngjesi-14.58 %; kënduar-11.88 %; lavdëruese-13.5 %; menjëherë-12.96 %. 2. Në të lexuarit e dyshkronjësheve ndaras një numër i vogël i nxënësve nuk kanë ditur t'i dallojnë se këto dyshkronjështa paraqesin nje shkronjë. 3. Përsëritja e shkronjave është pothuaj se i pandjeshëm, në 10 fjalë kanë përsëritur vetëm nje shkronjë të parë të një fjale. 4.Humbja e rreshtit në të lexuar, nga 32 nxënës vetëm 2 nxënës kanë humbur rreshtin. 5. Vështirësi në leximin e fjalëve shumëshkronjëshe dhe fjalëve abstrakte kanë paraqitur 10.92 % të nxënësve.


6. Substitucioni, gabime duke i ngatërruar shkronjat në fillim të fjalës 5 nxënës,11 nxënës ne mes të fjalës, 3 nxënës kanë bërë zëvendësimin e shkronjave p -q, d-b etj, dhe 13 nxënës nuk kanë pasur probleme të tilla.


3.4. Kuptimi i tekstit të lexuar

Shikuar nga aspektin psikologjik i të kuptuarit te tekstit, i cili si proces është më i ndërlikuar për nxënës me dëmtim dëgjimi, si till përbënë dy komponente të analizës dhe sintezës. Në të kuptuarit e tekstit pos tjerash ndikojnë edhe këta faktorë: përmbajtja e ngjajshme e tekstit me diturit dhe përvojën lidhshmëria dhe të kuptuarit e fjalëve në tekst si dhe kompozicioni i tekstit.

Shih grafikonin nr.9-Rezultat më të mirë në të kuptuarit e tekstit kanë treguar nxënësit e klasës së tetë VIII, në rethin e parë të testimit kanë kuptuar 41 % te tekstit të lexuar ndërsa në rrethin e dytë të testimit të lexuarit e testit të njejtë 43.10 %. Pastaj vijnë nxënësit e klasës së VI me 29.20 % testimi i parë, 30.10 % testimi i dytë në të kuptuarit e tekstit të lexuar. Ndërsa nxënësit e klasës së VII kanë arritur këtë rezultat në rrethin e parë të testimit 26 % ndërsa në testimin e dytë të testimit 27.9 %.

Kuptimi i fjalëve ne tekst






Grafikoni nr.9. kuptimi i tekstit shprehur në % sipas klasave. Grafikani nr.10 shurdhimi dhe kuptimi i tekstit % sipas nivelit të demtimit të dëgjimit)

Shih grafikoni nr.10- shikuar në kontekstin e shkallës së demtimit të të dëgjuarit dhe të kuptimit të tekstit rezultate më të dobta kanë treguar nxënësit me dëmtim total të dëgjimit në të dy rathët e testimit, ndërsa rezultat më të mirë kanë treguar nxënësit me dëmtim të lehtë në të dëgjuar. Shih grafikoni nr.11-shikuar në aspektin e suksesi në mësim dhe të kuptuarit e tekstit rezultate me të mira kanë treguar nxënësit e shkëlqyeshëm, kurse rezultat më të dobte kanë treguar nxënësit me sukses të mjaftueshëm në të dy rathët e testimit, dallimi është i konsiderueshëm në mëstë nxënësve me sukses shkëlqyeshëm dhe atyre shumë të mirë, të mirë edhe të mjaftueshëm. Shih grafikoni nr.12- sa i përket dallimit gjinor dhe të kuptuarit e tekstit egziston një dallim jo domethënës në rrethin e parë kurse në rrethin e dytë femrat dominojnë në mënyrë domethënëse në krahasim me meshkujt.



Kuptimi i tekstit % Gjinit dhe kuptimi i tekstit




Grafikoni nr.11 sukcesi ne mësim dhe kuptimi i tekstit Grafikoni nr.12 dallimet gjinore dhe kuptimi i tekstit

4. Konkluzionet

Është vërtetuar se të dëgjuarit, sukcesi në mësim ndikojn në shpejtësin e të lexuarit, kurse nuk ekzistojn diferenca të medha statistikore në relacionin, shpejtësia në të lexuar në mes të gjinive, gjithashtu është vëretuar se shkalla e dëmtimit në dëgjim ndikon në shpejtësin e të lexuarit. Dallimi shkon nga 5-8 here me e vogel, se bashkëmoshataret e tyre që dëgjojnë varsishtë nga shkalla e humbjes së dëgjimit. Nuk ekzistojn dallime esenciale sa i perket numrit të gabimeve në të lexuar nga testimi i parë dhe dytë. Ekzistojn dallime esenciale sa i perket gabimeve në të lexuar ne mes gjinive. Nuk ekzistojne dallime esenciale sa i perket kuptimit të tekstit nga testimi i parë dhe dytë.



Grafikoni nr.13 Gabimet në të lexuar testimi parë dhe dytë grafikoni nr.14 Shpejtësia në të lexuar testimi parë dhe dytë



Grafikoni nr.15 Suksesi dhe gabimet në të lexuar

5. Bibliography

- Anderson R.(1981)A proposal to center for the study of reding(tech. proposal 4 vols)
 Brestovci. B.(1988), Belbëzimi, Rilindja, Prishtinë
 Becker. R.(1979), Disleksia i Disortografia s'logopedskog aspekta, Nolit, Beograd
 Quigley S.King C.(1982), Language development of deaf children and youth, W. Erlbaum.
 Goodman K.(1973), Psycholinguistik niversals in the reding process, New York
 Ewoldt C.(1978), Reding for the hearing impaired: A single process, American Annals of the Deaf,123.
 Myklebust H.R.(1964),The psychology of deafness, New York
 Vasić S. (1977), Govor u razredu, Nolit, Beograd,
 Vladisavlević S. (1977) "Poromeçaji govora u školske i predškolske dece" Beograd
 Vudrov R.(1959), Eksperimentalna Psikologija, Noli, Beograd
 Dimić N.(1995), Razumevanje pročitnog teksta slušnoštećnih dece, Beograd
 Jakobson R. (1965), Linguistika i poetika, Nolit, Beograd
 Kostić Đ. (1980), Govor i slušno oštećene dece, Gorni Milanovac
 Matić.M. (1954), Čitanje u školli gluvonemih, Nolit, Beograd
 Savić. L. (198) , Metodika učenja govora gluve dece, Nolit, Beograd

Gjeopolitika e Ballkanit rrugët dhe Korridoret

Dr.sc. Ramadan Mazrekaj -Inxh.Dipl
Road Infrastructure & Transport Planer

Abstrakt

Gadishulli Ballkanik ka pozitë të rëndësishme gjeografike ku janë ndeshur interesat gjeopolitike dhe gjeostrategjike të fuqive të mëdha për të kontrolluar pikat gjeostrategjike të Gadishullit Ballkanik. Prirja për dominim rajonal nuk përfundon me korridorin tetë apo dhjetë, por është duke u parë dhe forcuar edhe me projekte të tjera siç janë tubacionet e gazit natyror të quajtur “Rryma Jugore”, dhe “TAP”. Dështimi i korridorit tetë për të lidhur shtetet e rajonit nga Deti i Zi deri në Adriatik, përkrah korridorit dhjetë, veçse tregoi hapur se në çfarë lidhjeje gjeopolitike janë duke qëndruar vendet e Ballkanit. Disa vende ballkanike për të forcuar pozitat gjeostrategjike, dhe për të ndryshuar kursin rajonal, kanë luajtur një rol të dyfishtë në parandalimin dhe realizimin e korridoreve apo degëve të korridoreve PAN Europiane në vendet tjera : ndërtimi i autostradës Egnatia në pjesën veriore të Greqisë, korridorit VIII (vetëm në pjesë të caktuara), dhe korridorit X, fut territoret mbare Shqiptare në “xhep” duke ndikuar dhe pamundësuar zhvillim e rrjeteve rrugore, hekurudhore, si dhe duke ndikuar në pengimin e funksionalizimit të Porteve Detare shqiptare. Këtij izolimi gjeopolitik të shqiptarëve në Ballkan i ka ndihmuar edhe politik bërja e dobët Shqiptare. Rreziku i dëmtimit të interesave shqiptare në rajon është dukë u rritur për shkak të lidhshimit jo karizmatik shqiptarë, për të hetuar prirjet rajonale të izolimit të përhershëm, përkrah zhvillimeve që janë dukë ndodhur në Euroazi.

Fjalët kyçe: Gjeopolitika, Ballkani, rrugët dhe korridoret

Hyrje

Zhvillimi i korridoreve rrugore është faktor i rëndësishëm për intensifikimin e bashkëpunimit mes shteteve ballkanike në sektorin transportit. Ndërtimi i rrjeteve automobilistike moderne për të lidhur më shpejtë shtetet e Ballkanit perëndimorë me ato të BE-së dhe ndërtimi i rrjeteve nëntokësore të linjave të gazit natyrorë nga Kaspiku, Kaukazi e deri në Adriatik dhe më gjerë, u ka dhënë shkas faktorëve rajonal dhe global për tu futur në lojëra gjeopolitike me korridoret. Përveç Bashkimit Europian, zhvillimi dhe shtrirja e korridoreve Pan Europiane dhe degëve të saj në Ballkan ka ngecur, mjafton të shikohet harta e korridoreve Pan Europiane dhe realizimi i projekteve dhe sheh se ato nuk kanë shtrirje të barabarte në të gjitha vendet, përderisa vendet e rajonit përfitojnë nga shtrirja e se paku një korridori Pan European, në Kosovë nuk shtrihet asnjë korridor apo dege e korridoreve Pan Europiane, por edhe në pjesën e Shqipërisë ka ngecje në ndërtimin e korridorit VIII Pan European. Zhvillimi dhe shtrirja jo e barabarte e korridoreve ngre dilemën e plotësimit apo pengimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit sidomos në Ballkan.

1. Korridoret Pan Europiane

Termi 'korridor' lidhet me faktin se ndërtimi i infrastrukturës së transportit, nuk përfshin vetëm thjesht rrjetin rrugor, por dhe atë hekurudhor, ajror, portual dhe sistemet e kontrollit të navigimit

Në kuadër të bashkëpunimi politik dhe ekonomik, roli i Transportit është njohur si i një rëndësie të madhe për arritjen e qëllimeve të përbashkëta të Bashkimit Evropian dhe vendeve në tranzicion, dhe mbi bazën e konvergimit të interesave të vendeve të rajonit, lindi Konferenca Pan Europiane e transportit, nën mbështetjen dhe koordinimin e Komisionit Europian. E organizuar për herë të parë në Pragë në vitin 1991, ajo përcaktoi linjat e përgjithshme të projektit të zhvillimit të rrjetit Pane European të transportit. Në takimin e dytë të mbajtur tre vjet më vonë në Kretë në vitin 1994 u përcaktuan linjat e përgjithshme strategjike të projekteve, të ashtuquajturat ‘Korridore Pan Europiane’ që gjithsejtë janë 10.



Fig. 3. Rrjeti i korridoreve Pan-Europiane

Duke parë që rrjeti i përcaktuar i korridoreve nuk kishte një shtrirje të gjere, takimi i tretë i mbajtur në Helsinki (1997) e zgjeroi skemën e korridoreve të transportit, duke shtuar dhe lidhjen e korridoreve rrugore të quajtura 'linjë kryesore' me disa linja lidhëse të quajtura 'degë' me ato rajone te vlerësuara qe ishin ekonomikisht më të prapambetura.

10 Korridoret Pan-Europiane te transportit të parashikuar nga BE-ja përfaqësojnë zgjerimin e rrjetit TEN-T ne drejtim të Europës Qendrore dhe Lindore, në përgatitje për zgjerimin e Bashkimit European. Qëllimi i 10 korridoreve TEN-T, është që të sigurojë një rrjet multi-modal duke ndërlidhur shërbimet e transportit në gjithë kontinentin European.

1.1. Loja gjeopolitike me korridoret

Zhvillimi gjeopolitik dhe dominimi rajonal, nuk përfundon me korridorin tetë apo dhjetë, por është duke u parë dhe forcuar me projektin Rus të tubacionit të gazit natyrorë që do të lidhte shtetet pro-ruse të Ballkanit, me ato të BE-së.

Presionet e vazhdueshme të Moskës, për të ndikuar në politikat qeveritare të Maqedonisë, Serbisë, Bullgarisë, Ukrainës dhe shteteve tjera për tu futur nën ombrellën e sigurisë së Kremlinit dhe nga ana tjetër dëshirës së shteteve të BE-së për të krijuar një sistem të ri të sigurisë pa Amerikanët në bashkëpunim me Rusinë, ka ndikuar në vendimet qeverive ballkanike për të rforcuar pozitat gjeostrategjike dhe të ndryshojnë kursin rajonal.

Realizimi i projekteve të mëdha Infrastrukturore Europiane, dominimi në shfrytëzimin e donacioneve ndërkombëtare kryesisht nga linja e Bllokut „Greqi-Maqedoni–Serbi-Rumani“, te përkrahura edhe nga Rusia, si dhe ngecja e shtrirjes së projekteve të rëndësishme Europiane siç janë korridoret apo degët e tyre në Kosovë dhe Shqipëri (vende Aleate të SHBA-ve), është pjesë e lojës së „Bllokut“ për dominim në Ballkan, në dem të vendeve tjera që llogariten si „Jo aleate“.

Ky zhvillim në Ballkan ka dimension edhe me të gjere, përveç ndikimit në infrastrukturë rrugore, hekurudhore, dhe në tubacionet e gazit dhe naftës ka pasoja gjeostrategjike dhe gjeopolitike, kjo me se miri shihet në hezitimin e njohjes së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran kryesisht nga vendet e këtij Blloku.

Se dominimi i „Bllokut“ ka ndikim të madh në organizmat me të rëndësishëm European, kjo me se miri shihet nga harta e shtrirjes së korridoreve.

Lidhur me bashkëpunimin dhe përzgjedhjen e partnerëve rajonal dhe global „Blloku“ shfaqet me standarde të dyfishta përball qendrave të vendosjes ndërkombëtare, shpeshherë shtete anëtarë të këtij „Blloku“ kanë dëshmuar se në situata të caktuara bëjnë zgjidhje strategjike, përmes forcimit të bashkëpunimit me Rusinë.

Këto lëvizje të shteteve kryesisht të linjës së „Bllokut“, bëhen nisur nga fakti i zvogëlimit të pranisë amerikane në Evropë dhe Ballkan, për shkak të shkurtimeve të buxhetit Amerikan. Këtë situatë po

e shfrytëzojnë edhe disa shtete Europiane, dukë përfshirë edhe disa nga Ballkani, te cilat po bëjnë kalkulime gjeostrategjike në dëm të vendeve tjera.

1.2 Rëndësia e korridoreve ne pozicionin dominues ne Ballkan

Vendet e rajonit krahas zhvillimit të rrjeteve rrugore të tyre dhe lidhjen me korridoret Europiane një rëndësi të madhe po i kushtojnë investimeve në rrjetet Hekurudhore nisur nga fakti që në 20 vitet e ardhshme transporti i mallrave do të rritet për 60% në Europë, dhe pjesa më e madhe e transportit të mallrave do të shkojë nga Azia në Europë.

Ballkani nga pozita e sajë mund të ketë përfitime të mëdha, por që pa rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore do të behet fyt i ngushtë të cilën transportuesit mund ta anashkalojnë. Disa vende si Rusia, Azerbejxhani, Turqia, dhe Gjeorgjia po përgatiten për rritjen e transportit të mallrave duke investuar në shtimin e kapaciteteve të tyre hekurudhore.

2. Dominimi i rrugës Egnatia mbi korridorin VIII Pan European

2.1. Korridori VIII Pan European

Korridori VIII bën pjesë në 10 korridoret e transportit të përcaktuar nga Konferenca Pan Europiane e transportit. Është vendosur që Italia të luajë rolin e koordinatorit të këtij projekti.

Linja kryesore e këtij korridori është: nga portet Italiane të Bari/Brindizit drejt Durrësit/Vlorës – Tiranë – Pogradec – Shkup – Sofie – Plovdiv – Burgas/Varna.

Pozicioni i Maqedonisë në raport me korridorin VIII - Në vazhden e trendëve rajonale, një rol të dyfishtë në parandalimin e realizimit të korridorit tetë ka luajtur Maqedonia e cila investimet i drejtoi kryesisht përgjatë korridorit dhjetë, për të modernizuar dhe integruar një pjesë të rajonit duke lënë të pazhvilluar pjesën tjetër ku ka shtrirje kryesisht korridori VIII Pan European në pjesën e sajë Maqedonia nuk tregoi ndonjë interes më të gjerë për të bashkëpunuar me Tiranën dhe Prishtinën në drejtim të forcimit të lidhjeve ndër fqinjësore.

Pozicioni i Shqipërisë në raport me korridorin VIII - Shqipëria me pozitën e sajë gjeografike të përshtatshme në gadishullin Ballkanik paraqet urën lidhëse me të përshtatshme ndërmjet Detit të Zi dhe Detit Adriatik dhe rrugën (natyrale) me të shkurtër. Mirëpo edhe përkundër këtij fakti në Shqipëri nuk ka përfunduar ndërtimi i Korridorit VIII Pan European, kjo vonese lidhet me pengimin e shteteve me ndikim apo grupit të vendeve të cilat në një mase po diktojnë rregullat e lojës në ndërtimin e projekteve të mëdha Infrastrukturore në Ballkan.

Pozicioni i Bullgarisë në raport me korridorin VIII - Sikurse edhe Shqipëria, po ashtu edhe Bullgaria ka pozitë të mire gjeografike në Detin e Zi, me dy portet Detare të saja; portin e Varnas dhe Burgas ajo natyrshëm paraqet pikënisjen me të përshtatshme në linjën nga Deti i Zi në Detin Adriatik e që është korridori VIII Pan European. Sikur për Shqipërinë edhe për Bullgarinë është me interes jetik ndërtimi sa më parë i këtij korridori, edhe pse Bullgaria ka shtrirje edhe të korridoreve tjera Pan Europiane, prapë se prapë korridori VIII përben arterien me të rëndësishme gjallëruese për ekonominë e Bullgarisë por edhe të rajonit.

Pozicioni i Greqisë në raport me korridorin VIII - Është mese e qarte se Greqia e shihet korridorin VIII Pan European si rivalin kryesor të Autostradës së sajë „Egnatia“. Nisur nga fakti i zhvillimit dhe shtrirjes së korridoreve Pan Europiane në Ballkan nuk do të mendohet se Greqia duke qenë antare e Bashkimit Europian, përfitojë mese shumti projekte të cilat me ndihmen dhe perkrashjen e BE-se, dhe institucioneve financiare ndërkombetare i realizojë në pjesën e sajë. Greqia duke qenë antare e BE-se, si vend me privilegjuar në Ballkan ndikojë mjaft dhe po ndikon në ritmin e zhvillimeve të projekteve të mëdha infrastrukturore në Ballkan kjo me se miri shihet nga harta e korridoreve dhe dehjeve të korridoreve Europiane, ku Greqia është lideri kryesor.

Pozicioni i Italisë në raport me korridorin VIII - Pikënisja e korridorit VIII Bari dhe Brindisi janë si pikënisje e korridorit VIII, dhe jo Porti i Durrësit dhe i Vlorës kjo nënkupton sigurimin e financimit në kuadrin e këtij projekti për dy portet e tyre si urë lidhëse mbi Adriatik. **Italia** lidhjet e saja i siguron edhe përmes linjave të shumta Detare drejt Lindjes përmes lidhjes me portet në rajon (Kopër, Rjeka, Durrës dhe Patra/Igumenicë).

2.2. Rruga e Mëndafshit

Studimi i fizibilitetit i lidhjes ndërmjet Evropës dhe Azisë (TEN e TRACECA) ka ringjallur interesimin për rrugën e lashtë të quajtur “rruga e mëndafshit”, e cila lidhë Europën me Azinë përmes Ballkanit, konkretisht: portit të Poti (Gjeorgji) në Kaukaz-portit të Varnës (Bullgari) në Ballkan, ndërsa pjesë e rrugës që kalon neper Ballkan është korridori VIII i miratuar në Helsinki në vitin 1997 si korridor Pan European me dalje në portin e Durrësit në Detin Adriatik.

2.3 Rruga “Egnatia” dhe “PATH”

Në vitin 1994 në Essen në samitin e shefave evropianë Greqia përfitoi dy projekte të rendësishme: projektin e rrugës Egnatia dhe projektin PATHE. Projekti i quajtur PATHE (shkurtim për Patra-Athinë-Selanik): bën lidhjen e Patrës me Athinën dhe, në vazhdim, me Selanikun. Projekti përfshin një gjatësi rrugore (rehabilitim të rrjetit rrugor ekzistues) prej 860 km.

Rruga Egnatia, me një gjatësi prej 780 km, realizon lidhjen e Portit të Igumenicës dhe përkshon gjithë Greqinë e Veriut deri në Aleksandropulos (kufiri me Turqinë), si dhe ka degëzimet me Bullgarinë dhe Shkupin (pjesë e korridoreve Pan Europiane). Ajo qëndron në paralel të Korridorit VIII që pritet të përkshojë Shqipërinë me drejtim Shkupin (Maqedoni) deri në portet Detare Varna/Burgas (Bullgari).



Figura 3. Gjurmja e re e rrugës “Via Egnatia” **Figura 4.** Gjurmja e lashtë e rrugës „Via Egnatia“

Ndërtimi i këtyre dy rrugëve të përkrahura nga BE, i mundëson Greqisë të jete lider me numrin me të madh të projekteve të korridoreve dhe degëve të saj në Ballkan, kjo i mundëson asaj jo vetëm forcimin e pozicionit dominues në rajon, por ka për efekt ndikon në zhvillimin dhe funksionalizimin e Porteve të saja Detare, kryesisht Portit të Igumenicës me qellim zhvendosjen e gjithë aktivitetit tregtar të pritshëm përmes porteve dhe korridoreve të sajë.

3. Krahasimi i distancave rrugore dhe detare nga Deti i Zi në Detin Adriatik

Duke iu referuar distancave nga portet detare e Konstancë, Varna dhe Burgas në Detin e Zi, si dhe porteve të Durrësit, Bar - Mali i Zi dhe Igumenicë - Greqia në Detin Adriatik, Shqipëria paraqet distancën më të shkurtër rrugore:

- Distanca nga Porti i Konstancës në Durrës (përmes rrugës 7) është për 150 km më shkurtër në krahasim me Portin e Barit (Mali i Zi), 97 km më shkurte se Porti i Igumenicës, 36 km më shkurt

se korridorit VIII Pan Evropian nëpërmjet Shkup.

- Distanca nga porti i Varnës në Durrës (përmes rrugëve 6 dhe 7) është për 178 km me shkurtër në krahasim me Portin e Barit (Mali i Zi), 61 km me shkurtër në krahasim me Korridorin 8 përmes Shkupit, dhe 122 km më të shkurtër në krahasim me Portin e Igumenicës.

- Nga porti i Burgasit në Durrës (përmes rrugëve 6 dhe 7) për 157 km me shkurtër në krahasim me portin e Barit (Mali i Zi), 40 km më të shkurtër në krahasim me Korridorin 8 përmes Shkupit, 101 km më të shkurtër në krahasim me portin e Igumenicës .



Figura 4. Rrugët dhe korridoret e transportit ne Ballkan

Distancat rrugore dhe detare janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Distanca rrugore dhe detare ne km

Nr	Linja	Lloji	Distanca ne km
1	Konstanta –Nish-Pristinë-Durrës	Rrugor	1215
2	Konstanta –Nish-Pristinë-Bar (M.N)	Rrugor	1365
3	Konstanta-Sofie-Selanik- Igoumenitsa	Rrugor	1312
4	Konstanta-Sofie-Shkup-Durrës	Rrugor	1251
	Linja	Lloji	Distance km
1	Varna–Sofie-Nish-Pristinë-Durrës	Rrugor	960
2	Varna-Sofie-Nish-Pristinë-Bar (M.N)	Rrugor	1138
3	Varna-Sofie-Shkup-Durrës	Rrugor	1021
4	Varna-Sofie-Selanik- Igoumenitsa	Rrugor	1082
	Linja	Lloji	Distance km
1	Burgas-Sofie-Nish-Pristinë –Durrës	Rrugor	910
2	Burgas-Sofie-Nish-Pristinë-Bar (M.N)	Rrugor	1067
3	Burgas-Sofie-Shkup-Durrës,	Rrugor	950
4	Burgas-Sofie-Selanik-Igoumenitsa	Rrugor	1011
	Linja	Lloji	Distance km
1	Durrës-Bari (Italy)	Detar	220
2	Bar (Montenegro)–Bari (Italy)	Detar	247
3	Igoumenitsa - Bari (Italy)	Detar	380

4. Konkluzione

Gadishulli i relativisht i vogël i Ballkanit është vend me zhvillim historik dhe ekonomike të komplikuar, mungesa e bashkëpunimit ballkanik në sektorin e transportit dhe të energjisë për shkak të luftërave dhe armiqësive shekullore nuk po arrijnë të lirohet nga paragjykimet historike, dhe mosbesimi reciprok etj.

Në kontekstin e tanishëm historik dhe politik, edhe pse është lehtësuar shumë komunikimi, vendet e Ballkanit ende nuk po mund të gjejnë mënyra të përbashkëta të bashkëpunimit, kjo është dëshmuar nga rivalitetet mbi rrugët e projekteve të mëdha të energjisë dhe të transportit. Në vend që projektet e mëdha infrastrukturore të miratuara nga BE të shërbejnë për të ndihmuar integrimin ekonomik, politik dhe kulturor të hapësirës post-komuniste në sistemin euroatlantik të vlerave të përbashkëta, korridoret e transportit dhe të energjisë u kthyen në objekt rivaliteti të ashpër mes vendeve të Ballkanit.

Ketë me se miri e dëshmon vete harta e korridoreve të transportit dhe shtrirja e tyre në Ballkan, ku dominojnë shtete apo "Blok" shtetesh mbi vendet tjera, shembull; Greqia, Bullgaria, Serbia, Rumania, dhe Maqedonia. Ndërsa anashkalohen vende tjera, kryesisht Shqipëria dhe Kosova.

Literatura

1. Mazrekaj R: PhD thesis, study of Integration of Kosovo's road network in Pan European network aimed at sustainable development of transport in the Balkan region
2. SEETO-s "Comprehensive network Development Plan 2012 – Multiannual Plan 2012-2016"
3. Transport Infrastruktura Regional Study (TIRS) in the Balkans. LOUIS BERGER SA. 2001
4. Technical Assistance: Support in the implementation of the transportation community agreement, Prishtinë 2012.
5. Feasibility Study and Environmental Assessment for Two Main Road Axes in Kosovo (Road VI and VII), 2007
6. Mazrekaj R: Magistrates theme, An investigation of the possibility that the link road VI and VII through the port of Shengjin with the Pan European Corridors VIII and X, 2010
7. Mazrekaj R: Magistrates theme, An investigation of the possibility that the link road VI and VII through the port of Shengjin with the Pan European Corridors VIII and X, 2010
8. Report: Development of the Sea Transport in the Black Sea Region: problems and prospects 2009.
9. Ministry of Public Works and Transport General Directorate of transport policies and planning-Tirana, p4,2010
10. Corridor VIII, Pre-feasibility study on the development of the railway axis, p 88, Final report September 2007

Internet:

www.oecd.org/cem/
www.iru.org/
www.tinavienna.at/
www.unece.org/trans/

Bekim Fehmiu - Aktor i hapësirave ballkanike dhe ndërkombëtare

Prof. Ass. Hazir HAZIRI
Universiteti i Prishtinës «Hasan Prishtina»
Fakulteti i Arteve

Abstrakt

Kumtesa ime ben fjale per aktorin e shquar shqiptar Bekim Fehmiu, i cili shkelqeu ne ekranin e madh te kinemase Jugosllave, por gjithashtu ishte i kerkuar ne oferten e kinemase evropiane, sidomos asaj italiane dhe projekte ne Hollivud. Do te nxirren ne spikame jo thjesht rolet e tij me mbreselenes, por do te kryhet edhe nje analize e thelluar e krijimtarise se tij e vendosur ne kohe e ne hapesine, e krahasuar me stilin zoterues te interpretimit ne vitet '60-'80 ku eshte edhe ndihmesa e tij me e madhe e rolet me te shumte. Sakaq do te jete e pranishme edhe nje qasje krahasuese e artit te tij me figura te njohura aktoresh ne rang boteror, dimensionin e tij nderkombetar, raportin me popullin dhe vendin e tij Kosoven, sikurse edhe mendimi i tij estetik lidhur me artin e kinemase vecanerisht dhe artet e kulturen pergjithesisht. Angazhimi dhe procesi i punes ne projekte madhore, perkushtimi i tij. Do te paraqiten ne forme te sintetizuar vecori te aktrimit te tij, tipi kombetar i shqiptarit krenar e me personalitet, figura e heroit dhe qasja e dramatikës, tragjikës, sublimes dhe te madherishmes. Duke e çmuar artin e tij ne nivelet me te larta te aktrimit, pjese e talentit dhe gjenise krijuese te popullit shqiptar, nga ana tjetere do te behet me dije edhe ai qendrim e mendim i tij i perparuar per marredhenie e interferime idesh, kulturash ne nje shoqeri globale dhe te çliruar me ne fund nga paragjykimet nacionaliste dhe kufizimet e llojeve te ndryshme, pasi arti qe ai beri ishte pikerisht i tille: nje art kosmopolitan.

Keywords: Bekim Fehmiu, actor, ballkanike, nderkombetar, artist kosmopolitan

Hyrje

Vështrimi historik mbi veprat artistike, apo më mirë të themi vështrimi i disa veprave të artistëve që thyen barrierat lokale, me apo pa dashjen tonë, do detyrohemi të bëjmë një shpallje historisë kinematografike të shteteve që përbënin ish Jugosllavinë. Me këtë rast ne do të hasim në emra të përvecëm, të cilët ishin pjesë përbërëse e nismës së procesit krijues dhe pastaj zhvillimit të saj nëpër vite. Ish jugosllavia e atëhershme ishte e përbërë nga kombe dhe kombësi, të cilat, në ditët e sotme, shumicën prej tyre ekzistojnë si shtete të pavaruara. Pas Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia si Republikë Federative Popullore, udhëhiqej dhe zhvillohej sipas logjikës institucionale të politikës komuniste dhe si e tillë kishte krijuar komitetin për kinematografi, i cili ishte me qendër në Beograd, dhe kishte nënqendra në gjashtë Republikat e federatës jugosllave. Këto të fundit qenë të organizuara më vonë si shtëpi filmike shtetërore, si: Avala Film në Beograd, Jadran Film në Zagreb, Vardar Film në Shkup, Sutjeska Film në Sarajevë, Zeta Film në Budva.

Me këtë rast, Kosova ishte lënë anash për vetë faktin se atë kohë nuk gëzonte të drejtë ligjore shtetformuese, ajo bënte pjesë nën juridiksionin e Serbisë si njësi autonome. Nga kjo pikëpamje Kosova dhe arti filmik kosovar ishin të hendikepuara, si në prodhimtari filmike, ashtu edhe në përgatitjet, apo formimin e kuadrin profesional.

Shteti i atëhershëm jugosllav, i udhëhequr nga politikatat komuniste, medoemos si mjet të domosdoshëm qeverisjeje do të synonte që përmes mediave dhe artit të bënte strukturimin dhe shtrirjen e propagandës, kësajsoji një pjesë të madhe të buxhetit ia dedikoi artit, duke seleksionuar projekte filmike, apo edhe duke kontrolluar dhe udhëhequr vetë qendrat kinematografike.

Pas luftës së dytë Botërore, gjejmë edhe hapjen e Fakultetit të Arteve Dramatike në Beograd, i cili fillimisht nisi punën me pedagogët që ishin kthyer nga studimet e tyre në vendet e ndryshme të botës, duke u nisur nga ish Bashkimi Sovjetik, Europa dhe më gjërë. Kontributi i atyre kuadrove filloi të ndihej edhe në filltet e para të kinematografisë profesionale. Qysh në krye të viteve '50 kemi edhe projektet e para filmike të asaj kohe, me staf produksioni të kombinuar edhe nga jashtë vendit, kryesisht në ato pozicione kreative apo ekzekutive te sektorët e filmit, në të cilat mungonte kuadri, sillnin artistë nga jashtë. Kinematografia jugosllave, pas viteve '50 e përdorte çdo mjet, formë apo

mundësi me qëllim që të rriste nivelin e profesionalizmit. Si republikë federative, mund të ishte e vetmja në botë e cila gëzonte status të favorshëm bashkëpunimi me Lindjen dhe Perëndimin. Politika e udhëheqësit të jugosllavisë, Josif Broz Tito, vërtet ishte për t'u studiuar: raporti i hapur ndaj të gjithëve dhe bashkëpunues me të gjithë, i mundësonte kinematografisë ura të ngushta bashkëpunimi si në bashkëprodhim, ashtu dhe në shpërndarje, brenda dhe jashtë vendit ku krijoheshin veprat kinematografike. Kësisoj filmi jugosllav depërtoi në festivalet më në zë të botës, korri suksese, gjithashtu u distribuua nëpër shumë vende. Për tre dekada të tëra, kinematografia jugosllave do të sillte yje botërore të asaj kohe, për të luajtur partizanë, herojë të luftës Nacional-Çlirimtare. Ndër yjet botërore që luajtën në filma partizan ishin: Orson Welles, Yull Brinner e Franko Nero në filmin "Bitka na Neretva" (beteja e Neretves), i cili ishte njëherit i nominuar si filmi më i mirë i huaj në Oskar; vijuan aktorët: Richard Burton në filmin "Sutjeska", për të cilin flitet se ishte i preferuari i Titos, për të luajtur rolin e tij në atë Beteje, më vonë hasim edhe shumë produksione të Hollivudit, të cilët përdornin territorin jugosllav si vend për të xhiruar filmat e tyre.

Artisti Kosovar

Në atë periudhë, në Kosovë, si pjesë nën juridiksionin e Serbisë idea për të punuar projekte filmike mbetej vetëm në nivel dëshire. Tek artistët shqiptar (kosovar) atëbotë më tepër mbretëronte niveli entuziast dhe organizimi i tij kryhej më së shumti në formën e grupeve teatrore, të cilat ishin kryesisht amatore, por që më vonë do të bëheshin burimi dhe baza e profesionalizmit, qoftë sa i takon Teatrit Kombëtar, qoftë sa i takon kinematografisë kosovare. Arsimimi universitar në gjuhën shqipe ishte i pamundur dhe si i tillë s'kishte fare mundësi për edukimin e brezave të ri, të cilët mund kishin prirje dhe qenë të interesuar për artin në përgjithësi. Mundësia e vetme për ndjekjen e studimeve universitare ishte kqyeqendra e Jugosllavisë së atëhershme (Beogradi) dhe më vonë edhe qendrat e tjera të Republikave Federative.

Si republikë federative, ish Jugosllavia gëzonte një territor të madh, andaj grupet teatrore udhëtonin cep më cep me shfaqjet e tyre si për prezantim, ashtu edhe për konkurim në ndonjë festival garrues. Gjuhë zyrtare në Kosovë ishte atë kohë edhe gjuha serbo-kroate, pra artistët shqiptarë mund të flisnin dhe të luanin në gjuhën e 22 milion banorëve dhe si të tillë mund të pëlqeheshin nga audiencia apo dhe nga regjisorët e kohës, të cilët targetonin fytyra dhe aktorë me potencial të veçantë. Rreth viteve '50 në Kosovë kemi edhe kastën e parë të aktorëve, të cilët tashmë kishin ndjekur, le ta quajmë, "shkollën e përvojës aktoriale" dhe dita-ditës po hidhnin themelet e një profesionalizmi të shëndoshë mbi artin e shtatë kosovar. Në këtë brez aktorësh themeltarë veçohen aktorët e shquar Istref Begolli, Abdurrahman Shala, Shani Pallaska, Malo Gami, Melihate Ajeti, Muharrem Qena etj., etj¹

Artisti i hapsirave ndërkombëtare

Në anën tjetër, mundësia për studime e të rinjve shqiptar do t'u krijohej diku nga fundi i viteve '50 e më tutje. Ishte koha kur universitetet jugosllave do të mbusheshin me të rinj shqiptarë, në profile të ndryshme studimi duke u deleguar kryesisht nga Institucionet e caktuara, të cilët ishin në mungesë kuadri profesional. Fakulteti i Arteve Dramatike në Beograd do të pranonte si studentë të parë në Aktrim, Bekim Fehmiu, pastaj Faruk Begollin, të cilët më vonë do të bëhen themeluesit e shkollës së aktrimit në Prishtinë. Mbase jo e zakonit dhe shumë e çuditshme për kontekstin politik të asaj kohe, por duhet pohuar se brenda emrave të parë në kinematografinë jugosllave hasim pikërisht shqiptarët nga Kosova, të cilët do të jenë pastaj për 30 vite bartës të roleve kryesore në kinematografi.

Bekim Fehmiu, biri i atdhetarit të shquar shqiptar, mesues, I agazhuar në edukimin e brezave të asaj kohe, përshkak të verprimtarisë së tij kombëtare familja e tij debohohet nga Kosova ne Sarajevo. Bekimi Fehmiu I lindur me 1936 ne Sarajevë, me pas I kthyer me familjen e tij ne Prizren, ku mbaron shkollën në gjuhën shqipe. Në vitin 1956, I jepet bursë studimi nga Teatri I Prishtinës, për studime, me crast zhvendoset në Beograd, ku pranohet në Akademi për aktrim në klasën e regjisorit

¹Sokoli, Qemajl (2006). *Monografia e Teatrit Kombëtar të Kosovës* (in Albanian). Prishtine: Mehmet Zhushi, Hysen Haxholli. p. 445. ISBN 978-9951-8717-0-9.

të famshëm Mate Miloshevi, me kushtin që ta mësoi gjuhën serbo kroate. Aktori Fehmiu l'a doli me sukses të mbaroi studimet për aktor, ai diplomoi në vitin 1960. Menjëher pas diplomimit, Bekim Fehmiu punësohet në Teatrin popullor (Drama Jugosllave) në Beograd, duke luajtur shumë role, aty punon deri në vitin 1967, ku ai vendosi ta lë punën përshkak të keqtrajtimit dhe si I tillë vendosi t'I përkushtohet karrierës së tij si artist i pavaruar, kështu duke luajtur kryesisht në filma artistik vendor dhe ndërkombëtar.

Në filmin "I Even Met Happy Gypsies (mbledhësi I puplave)" viti 1967, paraqitet në rolin kryesor, nga sukseset e filmit, vecojmë cmimin special të jurisë në Festivalin e Kanës dhe nominimi për oskar si filmi më i mirë i huaj në vitin 1968.² Fehmiu deri te roli I Borës tek ky film do të lunate disa role në filma të tjerë të asaj kohe si: "tu ne tueras point", "Sasha", "pod istom nebo", " the girl", " the enemy", kryesisht filma me përmbajtje social realiste, që I shërbenin udhëheqësisë së atëhershme yougoslave dhe propagandës së tyre karshi opinionit.

Roli I Borës do ta sfidonte Fehmiun si aktor dhe në anën tjetër do ti jepte mundësinë jetike në profesionin e së ardhmës.

Filmi I ndërtuar mbi jetesën e komunitetit rom, si probleme universale, trajtim ky mjaft I vecantë I regjisorit Petrovic, sjell vështirësitë përballë kënaqësive, sfidat përballë mundësive të atij komuniteti, filmi pati suksesin e tij në Festivalin e Kanës dhe kritika e vecoi rolin e Borës. Kësisoi Fehmiu duke u mishëruar me jetën e romëve, përjetoi dhe përcolli rolin e Borës tek publiku, duke u bërë kështu si një nga personazhet më të dashura të kohës. E vecantë tjetër pa dyshim është edhe loja e tij në gjuhën rome, të cilën ai në film e flet rrjedhshëm, krahas partnereve të tij në film, të cilët ishin yje të kinemasë së asaj kohe, si Bata zhivojnovic, Fehmiu shfrytëzon shansin dhe shkëlqen me lojën e tij maestrale. Pas suksesit me rolin e Borës, angazhohet në serialin televiziv L'Odisea, si koproduksion italian, Francez, Gjerman dhe Jugosllav, një produksion gjigant I asaj kohe, I rëndësisë së vecantë për aktorin e ri, të cilit, për fatin e tij të mirë karrera filloi ti ngritej, L' Odisea nën regjinë e Franco Rossi, Piero Schivazzapa dhe Mario Bava. Ketu aktori shqiptar realizoi sukseshmëm rolin kryesor të odiseut duke mishëruar atë edhe me pamjen e tij prej ballkani, kështu luajti bashkë dhe sfidoi aktorët e famshëm evropian e botëror, duke vecuar partnerën e tij në ate serial filmik Irena Papas dhe aktorët tjerë, të cilët vinin nga kinemaja franceze dhe gjermane, Marina Berti, Barbara Bach etj. Ne nje intervistë të dhënë kohët e fundit nga djali I Bekim Fehmiut, Uliksi, I cili ka trashëguar profesionin e të tatit, ai përmend faktin pikërisht në vitin 1969 se si I ipet roli kryesor ne filmin "The Adventureres", I regjisorit Lewis Gilbert, me produksion Paramount Pictures ne Holivud, me crast I vihet kusht që ta mësoi gjuhën angleze, ai përfiton nga rasti I periudhës së paraproduksionit dhe e mëson gjuhën e rolit për dhjetë javë. Më vonë do ti happen dyert në produksione të tjera, në hollivud dhe evropë. Fehmiu filloi dhe u bë për shumë të rinj shqiptar idhull, tek ai gjetën burimin e inspirimit, duke ndjekur rrugën e tij, por jo secili pati fatin e tij të mirë. Projektet filmike si "Odisea", "Aventurieri", "Deserteri", "The last snow of Spring", "il gloco de la verita", "deps", "silence the witness" etj, I dhanë atij kulmin e karierrës.

Në vitet '70 ta kur ishte yll I filmave Botëror, në Kosovë l'u bë ftesa nga Kosovafilmi (shtëpi shtetërore për prodhimin e filmave e sapo themeluar në atë kohe 1969), të punonte si regjisor dhe të lunate në filmin "kur pranvera vonohet", ai pranoi ftesën me kënaqësi, erdhi dhe punoi tërë fazën e paraproduksionit, mirëpo për shkaqe të panjohura u tërhoq dhe nuk e realizoi atë projekt.

Në nje arkivë të Televizionit të Prishtinës, në vitin 1972,³ Aktori Bekim Fehmiu, paraqitej në rolin e gazetarit në një intervistë të improvizuar me aktorin Faruk Begolli, ku e lavdëron tejmase punën e tij dhe njëkohësisht tregon për talentin dhe angazhimin e Begollit edhe jasht Jugosllavisë së atëhershme, kësioji rrëfejnë edhe momentet e bashkëpunimit shumë të mirë të tyre në filmin "partizanske eskadrole", në të cilin film Fehmiu është në rolin kryesor, kurse Begolli në rol të dytë, përmes kësaj interviste shohim edhe dëshirën dhe vullnetin e madh të Aktorit Bekim Fehmiu, për të mbështetur bashkombasit e tij në cilëndo formë të ishte e mundur, duke e ditur se atëbotë botëkuptimi mbi Shqiptarin e suksesshem vështirë ekzistonte, edhe kësioji me dashurinë më të madhe mburrej me

²(Festival de Cannes: I Even Met Happy Gypsies". *festival-cannes.com*. Retrieved 2009-03-10. [The 40th Academy Aëards \(1968\) Nominees and Èinners". *oscars.org*. Retrieved 2011-11-12.](http://www.festival-cannes.com/en/40thAcademyAwards(1968)NomineesandWinners)

³Pa skenar, RTP, 1972 https://www.youtube.com/watch?v=5PkNk0MH_WA

angazhimin e kolegut të tij më të ri, aktorit Faruk Begolli, I cili gjithashtu ndoqi rrugën e tij të sukseshme.

Nga fundi I viteve 80'ta Fehmiu do të angazhohej sërish në produksione Jugosllave, duke qenë ylli I kinemasë. Ai njëkohësisht do të luante edhe role ne Teatër dhe në filma Jugoslav, por kësaj radhe I kthyer me tretman krejtsish tjetër, I respektuar tej mase si nga komuniteti artistik, gjithahstu shume I dashur dhe I adhuruar edhe nga publiku.

Për cdo aktor, varësisht sukseseve që mund të ketë në kinema në nivel vendi apo ndërkombëtar, varësisht nga fama dhe të ardhurat që mund ti ketë, aktori me cdo cmim me dëshirën më të madhe do ti qëndroj besnik lojës dhe magjisë së teatrit. Kësisoj, aktori Fehmiu I'u rikthye Teatrit të dramës Jugosllave, për të shijuar pulsën e publikut, që me ëndje e ndiqte aktorin me famë në skene. Teatri popullor ishte vendi ku nisi karrierën e tij profesionale dhe po aty e përfundoi. Për shkak të propagandës anti Shqiptare të regjimit Jugoslav- serb të asaj kohe, gjatë shfaqjes Madam Kollontay nga Agnete Pleijel, *lëshoi sallën* përplot me publik, ai I kërkoi falje publikut dhe e sqaroi protestën e tij, nga ajo ditë Aktori Fehmiu qëndroi besnik protestës së tij, duke mos u angazhuar askund. Njerëz të afërt me Aktorin Fehmiu, miq të tij, të cilët patën rastin ta njohin nga afër, kryesisht mujve të verës kur qëndronte në Prishtinë, do ta përshkruanin si njeri shumë të ngritur, parimor dhe profesionist I rrallë, vecmas kësaj, ai ishte I apasionuar pas leximit, të gjitha këto I mundësonin një kulturë të lartë intelektuale, dhe shumë njerëz hezitonin ti afroheshin, pikërisht nga madheshita e tij. Ai shijoi famën e sukseseve të tij nëpër projekte madhore dhe qëndroi në qetësi artistike, duke ndenjur I tërhjekur deri në shuarjen e tij. Aktori Bekim Fehmiu u gjet I vetrarë në banesën e tij ne Beograd me 15.6.2010. Trupi I tij u dogj dhe hiri I tij u hodh në lumbardhin e Prizrenit sipas porosisë së tij të fundit, porosi kjo e kuptuar mirë nga të gjithë që e kanë njohur, për këmbngulësinë dhe krenarinë e tij prej shqiptari I cili me protestën e tij "luftoi" për të drejtat e bashkëkombasve të tij. Publiku vendor, ballkanik dhe ndërkombëtar, do ta kujtoi Aktorin Bekim Fehmiu që la gjurmë në kinema gjithashtu edhe për faktin se ai foli gjuhën e roleve të tyre, duke luajtur mjeshtërisht në, gjuhe angleze, serbo-kroate, gjuhë rome, turke, spanjolle, frënge,italiane, e shqipe.

Referenca

1. Sokoli, Qemajl (2006). *Monografia e Teatrit Kombëtar të Kosovës* (in Albanian). Prishtine: Mehmet Zhushi, Hysen Haxholli. p. 445. ISBN 978-9951-8717-0-9.
2. [Festival de Cannes: I Even Met Happy Gypsies?](http://festival-cannes.com). *festival-cannes.com*. Retrieved 2009-03-10.
3. <https://filozofskimagazin.wordpress.com/2014/11/23/uliks-fehmiu/>
4. [The 40th Academy Awards \(1968\) Nominees and Winners?](http://www.oscars.org). *oscars.org*. Retrieved 2011-11-12.
5. Pa skenar, RTP, 1972 https://www.youtube.com/watch?v=5PkNk0MH_WA

The new Pensions reform in Italy

Msc. Greta Alikaj
Specialist at the Ministry of Urban Development and Tourism.

Dr. (PhD Uni Graz) Endri Papajorgji
Dean of the Law Faculty of Tirana Business University

Abstract

The reform of social security systems and particularly the public pension system will remain the focus of political debate in the coming years in Italy. Reasons for emphasizing this issue are the known: social security systems are being faced, constantly and inevitably, with difficulty in financing and sustainability of the schemes benefiting. These systems have been unable to adapt, in order to increase the demographic, economic and social changes, which have occurred in the recent years. Two main factors for the imbalance of the pension systems, in industrialized countries, are: (a) demographic trends, aging of its population significantly and a birth rate generally low; and (b) Decrease of the workforce, through most of the older groups, or even increase unemployment (Prinz, Stanovnik & Stropnik, 2000, 5).

Considering the fact that the pension system in Italy, is based on a three pillar system, but with high importance of the first pillar (Pay-As-You-Go), current pensions are funded by the income (contributions) of the workers, that means that a decrease in the workforce will reduce incomes from contributions, and as a consequence it will have a negative impact in the pension scheme. Social policy is one of the most sensitive elements of the political system, thereupon, it will be on the focus of the public interest, as an issue that affects all of us.

Key words: Social insurance, Pensions, Scheme *Pay As You Go*, Retirement, Multi-Pillar pensions scheme.

Introduction

Beginning in the 1970s, the Italian pension system came under political and scholarly scrutiny. Pension benefits were extremely generous, especially for civil servants. Policy analysts and policy-makers started to worry about the system's growing financial difficulties due to the maturation of the PAYG schemes, the rapid process of demographic aging, mounting unemployment and slow economic and wage growth. During the 1980s, little political action was taken. Political actors began to recognize both demographic and pension expenditure problems. They established various commissions to tackle the problem, thus stocking the pension reform debate. But no important measures were adopted and the decade was characterized by policy stalemate (Schulze, 2007, 396). By contrast, the post-1980s period has witnessed several important reforms, within a wider effort to improve Italy's battered public finances. Five different governments have attempted pension reform; four of these succeeded (at least partly) making the necessary improvements. The enacted reforms of 1992-1993, 1995, 1997 and 2004-2005 fundamentally altered the structure of the Italian public pension system, stabilizing costs for its benefits and facilitating its administration (Schulze, 2007, 396-397).

Factors that led to the reform of the pension system

Order of pension reforms in Italy prompted a reconfiguration of the pension system, relying on the two main components: (i) reduction of the role of the first (public) pillar in old age provision; (ii) the rapid development of the funded supplementary pensions (Schulze, 2007, 398). In other words, in a relatively short period of time, Italy embarked on a delicate transition from a single-pillar pension system towards a multi-pillar configuration (Botta, 2011). As we shall see, the transition is far from complete. The significance of these changes stands out if we consider the point of departure, like

economic, policy and demographic conditions.

a) **Changes of economic conditions**

The economic and policy situation of the early 1990s was not particularly conducive to switching to a multi-pillar pension system. Public debt was extremely high. During this period of time unemployment rate increased while economic growth was slow (European Commission, Pension Schemes and Projection Models in EU-25 Member States, 2007). Supplementary funded schemes were virtually unknown. Italian system should have faced enormous difficulties in establishing a second pillar because of the notorious “double payment” problems (Schulze, 2007, 397).

b) **Demographic trends and social changes**

The aging population in Italy was a problem for the pension system. Demographic trends were unfavorable regarding distribution of revenues (Schulze, 2007, 397). In these circumstances, considering economic and social factors and increase of unemployment rate, there was an emergent need on reforming pension system.

Transformation of a Bismarckian pension scheme is very difficult. However, the transition towards a multi-pillar configuration was facilitated by the presence of a peculiar social policy institution –the so called- *Tfr* (*Trattamento di fine rapporto*). The Tfr is severance pay that firms must pay their employees, either when they retire, or when they leave the company for any other reason¹. It is financed through payroll taxes and operates as a defined-benefit scheme. Benefits are calculated as the sum of 1/13,5 of the annual earnings for each year of employment, revalued at a fix interest rate of 1.5 percent plus 75 percent of the inflation rate (Schulze, 2007, 417). The portability of the accumulated amount is not allowed if the worker changes company or if he/she is fired.

Current pension system

The pension topic in Italy, as in other countries, is object of frequent debates between experts and policymakers. In the last years, pensions have assumed a prevalent role, in various aspects: in financial aspect, for example, pensions constitute one of the major items with high expenditure on public balance system (Botta, 2011, 6).

Eligibility requirements have been subjected to various transformation. The legal-institutional framework of the Italian public pension system has been heavily reformed since 1990s (Botta, 2011, 6). Italian pension system is entirely composed of a compulsory, public component that is financed as a pay-as-you-go system. Transformations led to a multi-pillar scheme (European Commission, Pension Schemes and Projection Models in EU-25 Member States, 2007, 161).

The first pillar is compulsory for all the employees and is based on Pay-As –You-Go model. The benefits goes to those who has a minimum of insurance of 40 years (Law no 335/95, art 1/25b). In the first pillar are insured all persons employed in the public sector, the private sector and self-employed. Also, there are specific benefits for specific categories of employees such as police forces, military, officials of the Bank of Italy, etc.

This pillar is financed on a Pay As You Go basis, through workers’ contributions shared between workers (1/3) and employers (2/3) (Botta, 2011). Italian pension system insures workers for specific period of times, such as: maternity, temporary inability to work, loss of family caregiver (Segretariato Europa, Nr. 15, 2005).

The second pillar, voluntary, is based on capital funded scheme. This pillar was reformed on 1993 and is based on two options: *closed funds* and *open funds*. Closed funds are established and managed by the social partners. These funds are created in institutions and are available only for the workers of the institution. Open funds are not destined to a specific category, but are open to anyone who will participate and are run by banking institutions or social insurance institutions (Segretariato Europa, Nr. 15, 2005). Generally these funds are oriented towards financial markets stock to provide greater benefits, but of course are exposed to risk, which in the long run is smaller. Both funds

¹This payment exists for those employees, that has entered in the labour market before 1993, or those who do not benefit from supplementar pension schemes.

are administered by COVIP (Commissione di Vigilanza sui Fondi Pensione), ie by a supervisory commission of pension funds (Schulze, 2007).

The third pillar is voluntary and allows individuals through contributions made in certain accounts, increase the amount of retirement benefit. This pillar appears to have increased its funds, in 2003, constituted 0.1% of GDP (Segretariato Europa, Nr. 15, 2005).

Italian pension system has gone under important reforms that entered into the force in January 2012, regarding benefit criteria like retirement age and insurance period. Since 2012, the amount of pensions is not based in the last years contributions, but on contributions paid during all years².

For the first time, we will see an unification of retirement age for both genders which thought it would be achieved within 2018. Since January 1st 2014, women will retire at 62 years, and is projected that up to 2018 this age will be extended by 4 years, then reached the age of 66 years³. For woman workers of independent professions, current retirement age of 63 years and six months will be extended to 66 years, within the same period of time (2018). Woman employed in the public sector, which benefit of Exclusive pension funds, since January 2012, retire at 66 years⁴.

Men, either the public or private sector, employed or the self-employed, from January 2012, retire at age of 66.

As for women, as well as for men minimum insurance period is 20 years. Minimum contributions period is extended from 40 years to 41 years and one month. Discouraging measures are taken for those who wants to benefit from the premature pension before the age of 62. Pension amount is reduced by one percent a month⁵.

Furthermore, in the frame of this transforming reform on italian pension system, it is provided the blocking of inflation adapt for pensions that in 2011 were higher than 1402 euro⁶.

Administration

The fragmentation of the system is revealed by its administrative structure. There are three different institutions that administrate pension funds. INPS (Istituto Nazionale della Previdenza Sociale), National Institute of Social Care is dedicated to private sector employees; FPLD (Fondo Pensioni Lavoratori Dipendenti) Dependant Workers Pension Fund dedicated to farmers, artisans and merchants etc; INPDAP (Istituto Nazionale di Previdenza per i Dipendenti dell' Amministrazione Pubblica), National Institute of Providence for Employees of Public Administration was created in 1994 and has two major fund for central government employees, local government employees, law officers, doctors and teachers (Law no 335/95, art 2/22).

Conclusions

Pension system in Italy have been subject of various transformations, as a consequence of different factors such as economic, demographic, social and political. Since the reconfiguration towards a multi-pillar system, the scheme has passed under several modifications, which affected directly eligibility criteria such as age and insurance period.

The new reform gradually increases insurance period, from 40 years to 41 years and 1 month and the retirement age for women and men aiming the unification for both genders by the year 2018. This is an alternative to the sustainability of the scheme. This method is followed by other western countries as well in order to prevent pension system crisis, which are exposed to risks deriving from

²<http://www.inps.it/portale/default.aspx?sID=%3b0%3b7661%3b&lastMenu=7661&iMenu=1&p3=2&bi=22&link=La%20riforma%20delle%20pensioni> (10.09.2014).

³<http://www.inps.it/portale/default.aspx?sID=%3b0%3b7661%3b&lastMenu=7661&iMenu=1&p3=2&bi=22&link=La%20riforma%20delle%20pensioni> (10.09.2014).

⁴<http://www.inps.it/portale/default.aspx?sID=%3b0%3b7661%3b&lastMenu=7661&iMenu=1&p3=2&bi=22&link=La%20riforma%20delle%20pensioni> (10.09.2014).

⁵<http://www.inps.it/portale/default.aspx?sID=%3b0%3b7661%3b&lastMenu=7661&iMenu=1&p3=2&bi=22&link=La%20riforma%20delle%20pensioni> (10.09.2014).

⁶<http://www.inps.it/portale/default.aspx?sID=%3b0%3b7661%3b&lastMenu=7661&iMenu=1&p3=2&bi=22&link=La%20riforma%20delle%20pensioni> (10.09.2014).

high unemployment rate in European Union⁷, because of economic crisis. Unemployment rate in Italy is relatively higher than European Union (13,2 %)⁸.

However, there is still a lot to do. The third pillar that is voluntary is still unconsolidated and the revenues from it are lower than expected. As ILO recommended for Italy modifying financial system and effective employment programs are the alternatives to a sustainable pension system (ILO, 2012).

The most important is reducing the level of unemployment, especially among the young age population. As a country with a population of young age, Italy would successfully affront many challenges, by promoting employment, especially for youth through and public investments, which in the first half of 2014 were lower (International Monetary and Financial Committee Thirtieth Meeting, 2013). Employment policies may play an important role in the promotion and restoration of working.

Literature

Schulze, I. (2007). *The Handbook of West European Pension Politics*. Oxford.

Prinz, C., Stanovnik, T., Stropnik, N. (2000), *Economic Well-Being of the Elderly*. European Centre Vienna, Austria.

European economy-occasional papers, Pension Schemes and Projection Models in EU-25 Member States, European Commission, No.35, November 2007.

Eurozone Job Crisis, Trends and Policy Responses, ILO, July, 2012.

International Monetary and Financial Committee Twenty-Eighth Meeting, Statement by Fabrizio Saccomanni, Minister of Economy and Finance, Italy On behalf of Albania, Greece, Italy, Malta, Portugal, San Marino. Washington, October 11-12, 2013.

International Monetary and Financial Committee Thirtieth Meeting, Statement by Fabrizio Saccomanni, Minister of Economy and Finance, Italy On behalf of Albania, Greece, Italy, Malta, Portugal, San Marino. Washington, October 11, 2013.

Pietro M. (2011), *Sistemi di Welfare: un'analisi comparata sui alcuni specificita dei paesi Italia, Svezia, Germania, Regione Piemonte*.

Segretariato Europa, *L'architettura del sistema pensionistico italiano*, Nr. 15, 2005.

Valeria Botta, *Il sistema pensionistico Monti-Fornero*, L'articolo 24 del D.L., 2011.

World of Work Report 2013, Snapshot of Italy, ILO 2013.

Legge 335/95

Internet sources

www.cgil.it/segretariatoeuropa

<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/>

www.europa.eu

www.ilo.org

www.imf.org

www.inps.it

www.istat.it

www.pmi.it/tag/pensioni

⁷Unemployment has reached 11.5 % , according to the Eurostat: <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home/>

⁸www.istat.it (26.11.2014)

Siguria e qytetareve ne Republiken e Kosoves, zonat Urbane

PhD.Mensut Ademi
Lecturer in University AAB Pristina
Leaders in Association Kosovo Criminology

Avdi Berisha Msc.Candidat
Zyrtar Policor PK

Msc.Qazim Reka
Zyrtar Policor PK

Abstrakt

Me kete hulumtime arrime të vlersojmë se si do të ndikonte (pa)siguria te qytetaret e Kosoves.

Gjithashtu tek hulumtimi mundohemi te arrijme nje tregues se si është e mundur rritja e kualitetit të jetës në komunat ku jetojmë. Ne kete punim hulumtues identifikohen edhe disa gjetjet kryesore të analizuar në një hulumtimi të ndërmarrë në vitin 2011.¹

Ne jemi munduar te pasqyrojm ndjenjen e siguris te banorete e Kosoves, se si ata e perceptojne sigurinë individuale dhe kolektive; sigurinë dhe mjedisin ku jetojnë; besueshmerija ndajë Policisë së Kosovës (PK) si dhe agjencioneve tjera per zbatimin e ligjit; marrëdhënjeve në komunitete dhe marrëdhënjeve ndëretnike.

Në hulumtim gjithashtu analizon pikat më të forta dhe problematike si sfidat me të cilat ballafaqohet banori i Kosovës, si dhe identifikohen një numër rekomandimesh, për të fuqizuar punën e Agjencive te zbatimit te ligjit në të ardhmen.

Ky punimë hulumtues ka pasur një ndikim të rëndësishëm në çështjet e sigurisë dhe rritjes së kualitetit të jetës tek banoret e Kosovës, sidomos ne komunat ku është implemetuar hulumtimi , dhe prej nga veqohen sfidat që paraqiten para shoqërisë kosovare.

Punimi kryesisht mundohet te pergjigjet ne pyetjet:

1. Se cilat janë kushtet dhe shkaktarët të cilët sjellin deri tek dukuria ose zhvillimi i sjelljeve kriminale në një shoqëri në kohën e caktuar ?

2. Në cilën mënyrë të largohen kushtet dhe shkaktarët e sjelljeve kriminale?

Megjithatë, ky punim thekson nevojën për përkushtim të plotë nga autoritetet komunale dhe palët tjera të interesit në mënyrë që të arrihet një përmirësim i qëndrueshëm në nivelet e sigurisë te banoret e Kosovë.

Duke përfshirë anëtarë të komuniteteve të ndryshme në përbërjet e tyre dhe duke punuar me komunitetet joshqiptare gjatë implementimit të projektit ne kemi arritë të ndërtojnë partneritete të besueshme dhe bashkëpunuese ndrmjet banoreve dhe komuniteteve, duke përmirësuar nivelet e besimit në komunen e Prishtines,Prizren, Gjakov dhe Ferizaj.

Fjalet kyce: Frika nga kriminaliteti, Agjencionet e zbatimit te ligjit, Viktima, Shkollimi

Hyrje

Siguria është një prej parakushteve fundamentale për ekzistencën e bashkësisë shoqërore. Në çdo shoqëri të konsoliduar interesat politike, të sigurisë e të tjera të qytetarëve ndryshojnë e transformohen nga dita në ditë dhe fitojnë përmbajtje të reja, në pajtim me transformimin e përgjithshëm të civilizimit. Në këtë rrugë shfaqen sfida të ndryshme dhe forma të ndryshme të destruksionit, burime të ndryshme të rrezikut të cilat marrin karakter global dhe vënë në pikëpyetje jeten socio-ekonomike të njerëzimit. Përveç kësaj, format dhe instrumentet e ndryshme të dhunës nëpërmjet terrorizmit, krimit të organizuar, narkomanisë, mjeteve për zhdukje dhe shkatërrime masive,delikuenca,etj, pa dyshim shprehin gjithë kompleksitetin e qenies së sotme njerëzore. Në fund të shekullit 20 dhe fillimi i shekullit 21, kërkesat e shoqërisë për sisteme të sigurisë janë bërë

¹www.universitetiaab.com/QSJKS/FJU/BPrAL AAB dhe ASKK,Asociacioni i kriminologeve dhe kriminalisteve te Kosoves.

shumë komplekse dhe qartë të formësuara, sa për shkak të gjitha të papriturave aq edhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve të sigurisë.

Krijimi i shoqërive bashkëkohore e transparente kërkon edhe një baraspeshë përkatëse midis nevojave për mbrojtjen e rendit politik dhe juridiko-kushtetues në njërin anë, dhe parimeve të shtetit juridik mbi respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve në anën tjetër. Koncepti i sigurisë, përmbajtja e tij dhe funksioni shoqëror mund të kuptohen vetëm në qoftë se ky fenomen vështrohet në mënyrë inter-disiplinare. Vetë zhvillimi i sigurisë, kushtet e shfaqjes së tij si dhe format e ndryshme të organizimit, janë kushtëzuar nga zhvillimi i shoqërisë njerëzore. Përveç shqyrtimit të perceptimeve të publikut për rendin dhe sigurinë dhe identifikimit të trendëve përkatëse në këtë fushë. Ky punim fokusohet në atë se sesi banorët e Kosovës i perceptojnë ofruesit e sigurisë dhe institucionet tjera përgjegjëse për krijimin të politikave dhe moskëqyrjes së çështjeve të sigurisë. Çdo hulumtim duhet të ketë edhe metodat e veta të hulumtimit, në kete raste hulumtimi është implementu në fushen e Kriminologjisë, Viktimologjisë, të cila si shkenca e aplikojnë metodat e përgjithshme dhe ato të veqanta, por në kriminologji bashkohore përdoren metoda të përgjithshme teorike dhe metoda të mbledhjes së fakteve dhe të dhënave ose si quhen metoda empirike. Metodatat të cilat janë përdorur janë ato krahasuese me të cilat metoda është bërë një krahasim i nivelit të sigurisë nga niveli qendror deri te ai lokal pastaj metodatat analitike dhe modeli i anketës, si studime është perdore studimi i Veteparaqitjes dhe Viktimizimit, si instrumente janë përdorur pyetsore të standardizuara nderkombetarisht. Synimi i punimit është që të identifikojë se cilat institucione ofrojnë përgjegjësi për ofrimin e rendit dhe të sigurisë në Kosovë. Po ashtu, janë analizuar të dhëna të raporteve të agjencioneve të zbatimit të ligjit si, Policija, Prokurorija dhe Gjykatat, janë përdorur edhe inpute të punëtorëve të organizuara nga Asociacioni i Kriminologëve dhe Kriminolistëve të Kosovës. Bazë e veçantë e marrjes së informatave kanë qenë edhe Gazeta Zyrtare, shërbimet gjyqësore, prokuroriale, policore, KPPK, OJQ-të, etj.

Agjencionet për zbatimin e ligjit

Agjencionet për zbatimin e ligjit kanë për detyrë mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe të nxirret numri i “erret” dhe numrin e “perhimte” i veprave penale. Duke analizuar rastet e caktuara praktike kemi mundësi që të verifikojmë vlefshmërinë e mbështetjeve të caktuara teorike të metodave taktike dhe të mjeteve teknike duke i ofruar në këtë mënyrë materialin e duhur empirik masat preventive kundër aktivitetëve devijuese. Agjencionet e zbatimit të ligjit duhet të ndërmarrin aktivitetet në luftë kundër kriminalitetit, të përpunojnë metoda e mjete shkencore për zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e veprave penale, duhet që të hetoj tërë veprimtarinë represive dhe preventive e cila ka për qëllim luftimin e kriminalitetit. (*Teorit e sistemit të sigurisë/ prof.dr.R.Maslesa-fq-12,15*)

Preventiva institucionale duhet të përsosë metodatat dhe mjetet ekzistuese, duhet të përpunohet të gjejë metodatat dhe mjetet të reja preventive (*Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit/prof.dr.M.Abazoviq-fq 4,23*)

Duhet theksuar se kur është fjala për metodatat e marra nga fushat e tjera ato bëhen kriminalistike edhe për shkak të specifikave të objektit të trajtuar duhet të kenë role të veqante agjencioneve të zbatimit të ligjit të cilat kanë mandate.

Institucionet shtetërore dhe Qendarat Hulumtuese shkencore Universitare duhet të merren me studimin dhe përpunimin në bazë të kodit penal dhe procedural penal, të metodave e mjeteve teknike, taktike dhe të rekomandimeve metodike për kërkimin, gjetjen, fiksimin, këqyrjen dhe vlerësimin e provave me qëllim zbulimi, hetimi, gjykimi dhe parandalimit të veprave penale. Metodatat e mjeteve që studion dhe përpunon shkenca për të nxjerrë informacionin e duhur për mekanizmin dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale grupohen në tri pjesë homogjene (*N.Korailic, D.Muharremi, 2009, Ndërlidhura dhe të pandara si metodatat taktike (taktika kriminalistike), rekomandimet metodike (metodika kriminalistike ose metodika e hetimit)*).

Së këndejmi, në luftë kundër kriminalitetit, së bashku me shkencat e tjera juridike një rol aktiv ka luajtur dhe luan shkenca e kriminalistikës si shkencë juridike (*Kriminologjia aplikative/prof. dr.M.Budimlic/Shkolla e Cikagos/Eurogang*).

Ndjenja e sigurisë të banoret e Kosovës

Perceptimet e përditshme të rendit dhe të sigurisë vazhdojnë të përmirësohen, sidomos në mesin e banoreve të Kosovës. Mirëpo, ende ka zona specifike ku një përqindje e konsiderueshme e njerëzve ndjehen shumë të pasigurt. Një pjesë relativisht e madhe e njerëzve ende kanë frikë nga shpërthimi i ndonjë konflikti të dhunshëm Socjale. Shkaqet kryesore duket të jenë çështjet politike të pazgjidhura, por si problem dominante është ende problemi ekonomike dhe sociale si papunesia dhe këta faktorë janë permanente që të shkaktojnë frustrim dhe tension të percjellura me trazira në R.Kosovës të cilat perceptohen të kenë potencial për të kontribuar në shkaktimin e konfliktit të dhunshëm dhe fenomeneve si Trafikimi me qenjë njerzore dhe Kontrabanda me mallra.

Niveli i lartë i kriminalitetit dhe infrastruktura e aktereve e dobët në Luftimit dhe Parandalimit të kriminalitetit, vazhdojnë të rangohen lart në listën e problemeve në R.Kosovës si nga vlersimet nacionale dhe atyre nderkombetare (Raporti I progresit për Kosoven nga EU).

Problemi i Migrimit në Kosovës dhe mbipopullimi në disa qytete të Kosovës si Prishtina, Mitrovica, Gjilani, Peja etj shkaktojnë probleme urbane ku shfaqen kundër kulturat, Trafikimi, posedimi dhe shperndarja e substancave narkotike, delikuenca e të miturve, prostitucioni, konfliktet familjare, suicidi, divorci etj (R.Halili, Kriminologjia, Prishtine 2011 / S.konstantinovic-Vilic V.Nikolic, Kriminologjia, ISBN 86-7757-032-2, str 259)

Shumica e banoreve të Kosovës thonë se ndjehen të sigurt aty ku ata jetojnë do të thote në rrethin dhe lagjen në të cilën jetojnë me vite ku në atë lagje ka popullim me banoret e migruar nga ndonjë region tjetër i Kosovës; por qytetet nuk ndihen të sigurte në vendbanimet dhe lagjet ku është mbipopull nga qytetet tjera të Kosovës në qytetet siq është Prishtina, Prizreni, Peja, Mitrovica, Gjilani; me këto raste ndjenja e banoreve të cilët jetojnë në këto vendbanime është e pa sigurte sepse kontakti, bashkëpunimi, mirkuptimi, mungonë në mes të banoreve. Perceptimet pozitive janë përmirësuar pakëz që nga viti 2011/12/13 kur është në pyetje besimi dhe perceptimet e publikut për siguri në përgjithësi të minoritetet si: serbët, romet, ashkalinjet e pakicat tjera të Kosovës.

Shifra e errët dhe frika nga kriminaliteti

Frika nga kriminaliteti paraqet instrument kyç për definimin e situatës së krimit dhe dhunës në një qytet, manifestimet e dhunës në vend dhe regjionj, shkaktarët, ndikimet në shoqëri dhe perceptimin e publikut për qështje të siguris individuale (Personale), është poashtu mjet për ngritjen e vetëdijes dhe mobilizimin e palëve të ndryshme të interesuara të cilët mirren dhe dojnë të kontribojnë për një jetë më të mirë dhe të sigurte. Informacionet mund të grumbullohen përmes takimeve apo duke organizuar focus grupe me pjesëmarrjen e palëve të interesuara nga qyteti (autoritetet lokale, policia, sistemi i drejtësisë penale, shoqëria civile, sektori privat dhe institucionet hulumtuese), si dhe përmes hulumtimit dhe analizës, të dhënave të disponueshme egzistuese statistikore nacionale, sic janë dosjet policore, prokurori, Gjykate të dhënat tjera.

Tabela: Paraqet se si mundemi ta dime përqindjen e kriminalitetit në një vend.

Për grumbullimin e të dhënave gjatë implementimit të hulumtimit tone është përdore i një Pyetësori për të identifikuar numrin e errët të veprave penale tek banoret e Ferizait dhe Gjakovës përmes studimit të veteakuzimit dhe viktimizimit.



Perceptimi i frikes nga kriminaliteti duhet te jetë pjesë integrale e Strategjisë së Sigurisë Lokale. Në këtë hulumtim termi Frika nga Kriminaliteti përdoret për të referuar në procesin e grumbullimit të informacioneve të besueshme për zhvillimin e Strategjive të sigurisë dhe planeve për luftimin e kriminalitetit dhe zbulimin e numrit të erret të veprave penale.

Frika nga kriminaliteti dhe Siguria Lokale përfshinë:

- a. Karakteristikat kryesore Socio-ekonomike të qytetit;
- b. Gjendja momentale e sigurisë në lokacione të sakta;
- c. Nivelin e gadishmerisë për nderhyrje dhe marrje të masave represive dhe preventive nga Policia, Prokuroria, Gjykatat, FSK, OJQ, Qeveria etj
- d. Instrumentet ligjore egzistuese, strategjitë, politikat dhe aktivitetet e lidhura me sigurinë;
- e. Raportet fqinjësore.
- f. Viktimizimet eventuale dhe forma, shkaqet e viktimizimit.
- g. Vendet e pa sigurta dhe rreziqet eventuale etj

Evidencat e kriminalitetit janë tregues i aktiviteteve të organeve të drejtësisë, treguesit që analizat e deri atëherëshme të poseduara nga institucionet adekuate.

Por tek frika nga kriminaliteti jemi munduar të identifikojmë shifren e erret të kriminalitetit do të thote për numrin e madh të rasteve të pa regjistruara në statistika zyrtare të cilat kanë vlerë të kufizuar për shkak se plotësohet me njohuritë për kriminalitetin e pa regjistruar .



Rezultatet dhe diskutimet

Me këto të dhëna tregon se mostra e analizuar e të anketuarve kryesisht janë të moshës së re 43,8% më të rinj se 20 vjet dhe 56.2 % me të vjetër se 20 vjete, raportet gjinore (44% meshkuj, 56% e femrave), sipas të dhenave dominuese me arsim të mesëm janë (80,5%), statusi i banimit (78,8%) janë në shtëpi private apo qëndrojnë gjatë në adresën ekzistuese , (22,2%) jetojnë në kohe zgjatje 11 vjet qe do të thote kanë migruar në qytete nga regjionet e ndryshme dhe me këto raste na shfaqet kunderskultura (shikohet në kriminologji Konflikti i kulturave), karakteristike të theksuar është se jetojnë me familjet e tyre (96.3%),Kapacitet financiar vetanë kanë të ulët (34.3%), mesatar (24.2%) dhe (41.5%) më e lartë.

Të dhënat tregojnë se vetëm 7.5% e mostrave të testuara , në të kaluarën kanë qenë të viktimizuar nga një formë të sjelljes delikente (dëme, çështjet private, vjedhje, etj) keto janë të dhëna pas luftes 2000-2013, sepse para dhe gjatë luftes përqindja e viktimizimit ndryshon enorme. Aftësinë e tyre Psikofizike tregon se kanë aftësi për ta vlerësuar rrezikun: mesatare (42.3%) të shkëlqyer (41%) , Shëndeti i tyre në shumicën e rasteve është gjykuar i shkëlqyer (75,5%), vetëm pak më shumë se gjysma e të anketuarve komunikojnë me fqinjët e tyre (59,7%) dhe një numër i të intervistuarve

(58.5%) vizituar miqtë në lagje. Në kontekstin e sjelljes dhe vlerësimit të rrezikut është treguar se një numër i banorëve relativisht i madh shpesh ecin natën vetëm (43.6%), edhe pse (duke pasur parasysh moshën të intervistuarve) pjesa tjetër e banorëve 30,5% e të anketuarve nuk kanë ecur gjatë natës vetëm. Për sa i përket vlerësimit të rrezikut e lokacioneve të caktuara, të anketuarit e perceptuar të rrezikshme në shumicën e rasteve, (shtëpi të braktisura (45.2%) pyjet dhe parqet (32,1%), ndërsa tregu është perceptuar si vendet e rrezikshme (23.8%). Karakteristikat e modelit social-psikologjike të frikës nga krimi të mostrave të referuara, mund të shihet se mostrat e analizuar të anketuarve nuk e perceptojnë veten e tyre si objektiva të viktimizimit të konsiderueshme (29%) e të anketuarve mendonin se njerëzit e këqinjë kërcënojnë ata dhe pronën e tyre, dhe (16, 8%) e të anketuarve besojnë se njerëzit janë xhelozë ndaj tyre. Duke pasur parasysh vetë-perceptimin, ajo është parë se pothuajse karakteristikat seksuale dhe moshën dhe praktika (të anketuarit mendojnë se ai/ajo është në gjendje për të kapërcyer ndalur një sulmues të mundshëm, ndërkohë që më shumë se një e treta e të anketuarve nuk e dinë. Më shumë se gjysma e të anketuarve perceptojnë se me sjelljen e tyre mund të shmangin një rast konflikti (50.4%). Duke pasur parasysh perceptimin vetëm 13.7% e të anketuarve besonin tek njerëzit të cilët si njohin, dhe 51.5% e të anketuarve nuk besojnë se disa njerëz në mjedisin e tyre. Perceptimi hapësirës kriminojgene është relativisht e lartë - mbise 1 / 3 e të anketuarve nganjëherë imagjinojnë se dikush mund ti sulmoj apo ti vjedhë në rrugën, dhe 27.5% të anketuarit, kur do dilnin në rrugë janë të bindur se rruga ka do shkon është e sigurt. Mund të vërehet se niveli më i lartë rreziku është shprehur në këto situata në të cilat ata i përshkruajnë si të mundshme «sulumuesit», grupe institucionale dhe jo institucionale të cilat grupe kanë një lider (78,3%)(Korrupsioni dhe mosbesimi ne institucione), madje edhe një situatë e tillë perceptohet si kërcënim kolektiv.

Perfundime

Kerkimet me te reja kriminologjike theksojne dy menyra origjinale te studimit dhe zbulimit te numrit te erret dhe te perhitur te veprave penale ne evidencat zyrtare nacionale te kriminalitetit. Si metoda me te njohura jane metoda e Studimit mi vetakuzimin (self-report studies), dhe mbi viktimen (Study of Victims).

Pasojat e Frikes nga krimi, respektivisht efektet ekonomike dhe sociale te tij, jane testet serioze per cdo shoqeri. Pesha e pasojave te frikes nga krimi ne ndonje shoqeri konkrete varet nga shume faktorë, Me kriminalizim te shoqrisë, korrupsion, Krimi I organizuar, Nepotizmi,veprave penale te parashikuara ne legjislacionin nacionalë, te cilat sgejrn zbatim ne sistemë te rregullit shoqror per te gjithë njejt. Madje, pasojat varen nga lloji i vepres Penale që dominon në shtetin përkatës. Korrupsioni dhe Krimi I Organizuar prodhon varfëri dhe rënie të përgjithshme ekonomike e shoqëruar me pakënaqësi shoqërore ndaj reformave për zhvillimet demokratike, sjell uljen e efektivitetit të funksionimit të pushtetit shtetëror dhe minimizimin e besimit të qytetarëve te organet e Zbatimit te Ligjit dhe shërbimit publik shtetëror.

Problemet e luftimit dhe të zbulimit të Veprave penale si korrupsionit, Krimi I Organizuar janë shumë të ndërlikuara dhe të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm politikë, juridikë, ekonomikë dhe shoqërorë në përgjithësi. Ligjet gjithmonë kërkojnë zbatim, dhe përderisa kufiri i sjelljes ligjore përgjithësisht është tkurrur me kalimin e kohës dhe ne mast e madhe ligjet ne shtetin ton jane shum pak te zbatueshem per nje Shoqri e cila eshte e detyruar te zbatoj ligjet ne fuqi, lëvizja kohore e cilësisë së zbatimit është më pak e qartë. Zbatimi kërkon një formë të informacionit fillestar rreth veprimit të bashkpunimit të ndersjellt si shembull , korruptues – I raportuar qoftë nga një hetues qeveritar ose nga një palë e tretë – dhe pastaj një veprim ligjor që vepron mbi këtë informacion dhe te jet I perfunduar me nje denim adekuat. Dija publike rreth krimit te organizuar, korrupsionit është bërë e mundur kryesisht nga palët e treta ose nga hetues të disa prej degëve të qeverisë të ndara nga grupet kriminale dhe korruptive aktuale.

Zgjidhja dhe tejkalimi i problemeve të paraqitura si pengesë në zbulimin dhe luftimin e krimit të organizuar e korrupsionit në veçanti arrihet me trajtim kompleks shtetëror dhe shoqëror duke përfshirë: Analizën e gjendjes ekzistuese të kësaj dukurie; Detyrimet e veprimtarisë politike dhe synimeve të përgjithshme në këtë fushë; Masat specifike kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

në veçanti ligjet e veqanta kunder Krimt te organizuar dhe konfiskimin e pasuris te fituar ne menyre te pa ligjshme; Formimi i institucioneve të specializuara anti-korrupsion ku te funksionalizohet Policia Gjygsore e cila eshte e parapar edhe me Kodin e procedures penale dhe ligjin mbi Policin; Bashkëpunimi i plotë i organeve të zbulimit si AKI (Agjencioni i Kosoves per Informim),Intelegjenca e Policis dhe shum organizata qeveritare dhe jo qeveritare te cilat jan te specializuara ne ket fushe, hetime dhe të gjykime me parime dhe etik profesionale; Rregullimi legjislativ i autorizimeve të posaçme të organeve dhe organizatave të caktuara në zbulimin dhe luftimin e korrupsionit; Zbatimi i efektshëm i ligjit dhe masave në kontrollin e institucioneve te ket diciplin institucionale; Qeverisja e mirë, administrimi dhe ligjshmëria e plotë në kryerjen e funksionit të organeve të drejtësisë, policisë, doganave, inspeksioneve, organeve qeveritare të komunave; Qasja shkencore e profesionale e zbulimit dhe luftimit të krimit te organizuar, korrupsionit, edukimi i opinionit dhe mobilizimi i mediave në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në veçanti.

Literatura

- R.Halili, *Kriminologjia*, BprAL AAB,Prishtine, 2011
R.Halili, *Penologjia*, BprAL AAB,Prishtine, 2011
R.Maslesa *Teorit e sistemit të siguris/ prof.dr. -fq-12,15*
M.Abazoviq *Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit/prof.dr. -fq 4,23*
M.Abazoviq, *Politika e luftimit te kriminalitetit, FKN/AAB,Sarajevo-Prishtina,2008*
V.Latifi, *Politika e Luftimit te kriminalitetit, Prishtine, 2012*
M.Budimlic, *Kriminologjia aplikative/prof.dr. 'Shkolla e Cikagos/Eurogang*
D. Muharremi, drN. Korajlic, *Kriminalistika/prof. & Mrsc. -metodika, taktika,teknika*
Vlersim gjat hulumtimit te ASKK dhe rekomandimeve te marra fatbeck nga qytetarët
Strategjia ndërsektoriale e Luftës kundër krimit të organizuar /MPB/20087.ASKK-Rekomandime / www.askk-ks.org /ASKK-Frika nga kriminaliteti Studentet e Kriminalistikes 2006 FKN/AAB-Sarajeva
Fig.1/ Kriminologjia aplikative/prof.dr.M.Budimlic- Nëse bije potenciali i banorëve për ta parandaluar Kriminalitetit si pjes e agjencioneve për zbatimin e ligjit dhe organizatave jo qeverita atëher vije deri te rritja e kriminalitetit. ASKK-Frika nga kriminaliteti Studentet e Kriminalistikes 2006 FKN/AAB-Sarajeva
UNDP-Secure in my community 9.ASKK-Frika nga kriminaliteti Studentet e Kriminalistikes 2006 FKN/AAB-Sarajeva
Analize për gjenezën e siguris në Kosovë pas 1999/ ASKK-Krahasimi i sistemeve të sigursë dhe agjencineve per zbatimin e ligjit
[www.askk-ks.org / cjsfknaab@gmail.com](http://www.askk-ks.org/cjsfknaab@gmail.com) “ Ndjenja e siguris”
[www.askk-ks.org / cjsfknaab@gmail.com](http://www.askk-ks.org/cjsfknaab@gmail.com) / ASKK-“ Ndjenja e siguris”/ *Kriminologjia Aplikative- prof. dr.M.Budimlic*

Pllakati në realizmin socialist

Ma. Rrezeart Galica
Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Në Shqipërinë e viteve '50-ta të cilën e kishte përfshirë fryma e realizmit socialist si një pjesë tjetër e botës gjejmë edhe tendenca të glorifikimit të ideologjisë e udhëheqësve që nuk kanë lënë gur pa lëvizur që këtë propagandë ta shtrijnë gjithandej. Në hapësirën shqiptare ndër mediumet e artit që u përdor si mjet propagandistik ishte edhe pllakati. Medium ky që si veçori ka specifikën e vet përçuese nëpërmjet mesazhit artistik. Poashtu kuadri i artistëve të shkolluar para viteve të '50-ta në Itali e Greqi i ishte bashkuar gjatë viteve '50-ta e tutje edhe pjesa tjetër që ishin të shkolluar apo specializuar në ish vendet socialiste. Kjo kastë artistësh të mëvonshëm me vete sollën me dashje ose pa të edhe frymën e realizmit socialist të cilën e kishin absorbuar gjatë formimit të tyre në ato vende. Sot njohim edhe një kastë të këtyre artistëve të distancuar nga kjo frymë që atëbotë përfshiu Shqipërinë. Sepse artistët shpesh të shtyrë kufijtë e lirisë së mendimit, si rezultat, mendohet nganjëherë të jetë të dalë nga vetvetja¹ por që rrethanat e atëhershme kanë cenuar këtë liri e si rrjedhojë edhe cilësimin për ta. Rreth pllakatëve të zhanreve politik, kulturor, festiv, sportiv etj. të asaj kohe ne njohim si pllakatistë të spikatur si Vlash Prifti, Pandi Mele, Safo Marko, Franc Ashiku, Bashkim Dizdari, Ibrahim Cezmja.² Puna e tyre ishte e lidhur me frymën e apostrofuar më lartë për shkak rrethanash të atëhershme.

Fjalëkyce: Pllakat, Arti, socialist

Hyrje

Fillimet e viteve '50-ta ishin të ndryshme jo vetëm në aspekte tjera të shoqërisë së Shqipërisë së atëhershme por edhe në artin pamor në përgjithësi. Kjo frymë e kësaj epoke filloi ti zinte frymën edhe stileve moderne të artit pamor, si impresionizmi e kubizmi, etj. Siç dihet realizmi socialist është një nënrymë e stilit realist por që vinte në shprehje gjithmonë për të përhapur doktrinën komuniste e socialiste në popullin shqiptar të atyre viteve. Rusi Maksim Gorki si njëri ndër ideatorët e këtij stili me novelën e tij "Nëna" njihet si vepra e parë e realizmit socialist. Motivet që duhej të përdornin artistët ishin të bazuara në rregullat e kësaj fryme, siç ishin: Art proletar, që ka të bëjë me klasën punëtore dhe absorbohet përmbajtësisht prej saj, motive tipike nga përditshmëria e njerëzve të thjeshtë, reflektimi të jetë realist dhe gjithmonë i mbështetur në parimet e shtetit.³ Por si janë aplikuar këto rregulla në artin e Shqipërisë? Sa kanë ndikuar pozitivisht apo negativisht në formimin e artistëve shqiptarë? A kanë të lirë kanë qenë ata në përzgjedhjen e temave do të merremi në vazhdim.

Pllakati politik propagandistik

Beteja me pllakate u zhvillua edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, bile pllakati u bë mjeti më i përdorshëm për informimin e masave i të gjitha taborreve ndërluftuese për atë që do të ndodhte në vendet që ishin përfshirë në këtë luftë.

Pllakati i parë artistik-politik njihet ai i vitit 1938, i realizuar nga artisti Fadil Pëllumbi (1918-1977).⁴ Ky artist kreu shkollën e vizatimit në Tiranë, ndërsa studimet e larta i ndoqi në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë. Me paraqitjet e tij në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare bëri një prezantim dinjitoz të Shqipërisë dhe të universit shpirtëror të popullit shqiptar në botë. Vlen të theksohet se artisti Pëllumbi më 1946 projektoi pavijonin shqiptar në Panairin Ndërkombëtar të Zagrebit,

¹Jenny, Peter. *The artist's eye*. Princeton Architectural Press, New-York 2012, f. 21.

²Velo, Maks. *Grafika e realizmit socialist në Shqipëri*. Botimiparë, Tiranë 2014, f. 8.

³Kongresi i vitit 1934 në Bashkimin Sovjetikishtroizyrtarizoikëtorregulla.

⁴Burimi: <http://www.forumikatolik.net/archive/index.php/t-8289-p-2.html>

Poznanj dhe të Pragës, ekspozitën “Shqipëria e re”, që u hap në Rumani dhe Bullgari. Krijime të ndryshme të tij gjenden në vende të ndryshme të Evropës. Ishte anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve që nga themelimi i saj.

Meqë ky medium vie në shprehje gjithmonë atë e përdori edhe regjimi komunist në Shqipëri për reflektimin e qasjes së tij. Me pllakatën politik të realizëm socializmit në Shqipëri përballemi për herë të parë me rastin e Festës së 1 Majit në vitin 1952. Autor i këtij pllakati është piktori Fadil Pëllumbi. Po të trajtojmë elementet e përdorura në pllakatën e “1 Majit 1952”. Në sipërfaqen e pllakatit përgjithësisht dominon ngjyra e kuqe, në planin e parë të pllakatit spikatet një burrë që ka përvjelur mëngët e që i ka të theksuara apo thuaja se në disproporcion me trupin duart e tij me çka sipas autori i pllakatit ka dashur të reflektojë fuqinë. Personazhi i paraqitur në këtë pllakat mban një flamur të kuq me dorë të majtë në të cilin janë të paraqitura me vija globi dhe një shpend. Kurse në dorën tjetër ky personazh mban lule. Poshtë këtij personazhi një shirit i kuq horizontal mbi të cilin me një tipografi të zakonshme të asaj periudhe ngjyrë të bardhë qartazi shkruan “1 Maj 1952”.



Poster i punuar nga artisti Fadil Pëllumbi me rastin e Festës së “Një Majit”, 1952

Në prapavijën e këtij pllakati shohim një turmë njerëzish që lartësojnë me duart e tyre portretin e Stalinit dhe disa tjerë mbajnë lartë yllin e kuq dhe janë që të gjithë në lëvizje. Tërë këto elemente të këtij pllakati që është bërë me rastin e 1 Majit që njihet ndryshe si Dita e punëtorëve me kërkesën për respektimin e të drejtave të tyre. Në vitin 1889, në Paris u mbajt një kongres i partive socialiste të të gjithë botës, dhe e shpalli 1 Majin e vitit 1890 ditën ndërkombëtare të demonstratave në mbështetje të kërkesës për t’i pasur ditët e punës 8-orëshe. Që nga ky vit, në ditën e 1 Majit punëtorët ngriheshin për të kërkuar të drejtat për kushte më të mira pune.⁵ Pllakati i autorit Pëllumbi për “1 Majin” ngjan në thirrje edhe mobilizim të masës për çuarje përpara të frymës staliniste të asaj kohe. Por ende nuk

⁵<http://wol.jw.org/sq/wol/d/r41/lp-al/102005285>

e kemi të qartë se në çfarë rrethana është bërë ky pllakat, ka qenë i porositur nga shteti apo ndonjë institucion tjetër? Por pavarësisht këtyre vetë rrethanat e asaj kohe nuk lejonin artistin që të dilte jashtë doktrinave të krijuara nga udhëheqësit e asaj kohe. Artistëve në fakt iu ndrydhë edhe fantazia sepse sipas Frojdit, artisti krijon një botë fantazie, të cilën e merr shumë seriozisht, - në të cilën, pra investon një ngarkesë të madhe emotive – dhe e ndan qartësisht nga realiteti.⁶

Tek shohim që artisti nëpërmjet elementeve që ka përdorur në pllakat tendencat e tij për të tjetërsuar natyrën e dedikimit të pllakat nëpërmjet prapavisë janë të dukshme andaj vlen të theksohet me këtë rast Freud se artisti, duke ndryshuar marrëdhëniet mes pjesëve, qëllimisht i ndryshon ato në të njëjtin drejtim, në mënyrë që të theksojë njëfarë veçorie thelbësore të objektit, dhe si rrjedhim, idenë kryesore që krijohet për të.⁷

Në fondin e Universitetit të Arteve gjenden pllakate që janë punuar nga studentët e Institutit të Lartë të Arteve, si detyra ose tema diplomash gjatë viteve 1964, 1970 e deri para viteve 1989. Këto pllakate qartazi reflektojnë ideologjizmin dhe frymën revolucionare. Pjesa dërrmuese e tyre janë krijuar në raste kongresesh, ditësh të shënuara apo në raste përvjetorësh, për shembull “5 Maji”, “30-vjetori i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë (11 shkurt 1945-1975)”, pastaj “Konresi IX i PPSH-së”, “Kongresi IX i BGSH-së” etj. Burra e gra trimëresha, ca me lopata e pushkë, ca me kazma e përparëse të punës me shallin e aksionit pas tyre të shoqëruar me parulla të llojit: “Parti - Enver”, “Mbroymë fitoret, mbroymë socializmin”, “Të shkojmë në Kongresin IX të PPSH-së me detyra të realizuara”, “Gjendja sot i ngjan një vullkani në erupsion, një zjarr që përvëlon, zjarr që përvëlon, zjarr që do të djegë pikërisht klasat shfrytëzuese e shtypëse” dhe shumë të tjerë.⁸

Në Kosovë sipas Sh. Nimanit pllakati politik është pllakati politik i rastit sepse sipas tij pllakatet të tilla kanë shënuar jubiletë e rëndësishme dhe kremtimet e festave: “Dita e Republikës”, “Një Maji”, “Ditës së Fitores”, etj. Sipas tij në fund të viteve ‘70-ta dhe fillim të viteve ‘80-ta filloi të kultivohet më shumë pllakati politik. Si tituj pllakatesh ai përmend “Konferenca XII e LK të Kosovës”, “Aksioni i punës i rinisë Ibër-Lepenci”, “30 vjet të APJ-së”, “Festivali i XII i punës i rinisë së Jugosllavisë”, autorë të të cilëve përmend emrat Fatmir Krypa, Shyqri Nimani dhe Faik Krasniqi.⁹

Bibliografia

- Hippolite-Adolphie, **Filozofia e artit** (Tiranë 2014)
Ferid Hudhri, **Arti i rilindjes shqiptare** (Tiranë 2000)
Shyqri Nimani, **Shqyrtime artistike** (Prishtinë 1990)
Northrop Fraj, **Anatomia e kritikës** (Prishtinë 1990)
Aristoteli, **Poetika** (Prishtinë 1998)
Osvald Hanfling, **Estetika filozofike** (Shkodër 1999)
Stefan Çapaliku, **Estetika moderne** (Tiranë 2006)
Italo Calvino, **Leksione amerikane** (Tiranë 2011)
Kadri Metaj, **Teoria estetike e Gjergj Llukaçit** (Prishtinë 1989)
Sigmund Freud, **Psikanaliza e artit dhe letërsisë** (Tiranë 2000)
Milan Kundera, **Arti i romanit** (Tiranë 2001)
Hermann Hesse, **Lexime të çastit** (Frankfurt 1999)
Osvald Hanfling, **Estetika filozofike** (Shkodër 1999)
Maks Velo, **Grafika e realizmit socialist** (Tiranë 2014)

⁶Segmund, Freud. *Psikanaliza e artit dhe letërsisë*. Dituria 2000, f. 19.

⁷Taine, Hippolyte-Adolphe. *Filozofia e artit*. BotoiIdeart, Tiranë 2004. f. 37

⁸Burimi: <http://www.forumikatolik.net/archive/index.php/t-8289-p-2.html>

⁹Nimani, Shyqri. *Shqyrtime Artistike*. BotoiArs, Prishtinë 1990, f. 80-81

Rendi ekonomiko-shoqëror sipas Kanunit të Labërisë

Doc.Dr. Jaho Cana
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Prof.asoc. Dr. Kozeta Sala
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Abstrakt

Normat e kanunit të Labërisë përcaktojnë në mënyrë fare të qartë se prona private në krahinë ishte e shenjtë dhe e paprekshme dhe si e tillë ajo mbrohet në mënyrë të gjithanshme. Këto norma juridike përcaktojnë në mënyrë të prerë dhe pa asnjë ekuivok edhe format e ekzistencës së pronës private në krahinë, të cilat ishin. Prona e vogël private, ku përfshihet edhe prona individuale, prona e mesme private, prona e madhe private, prona e përdorimit të përbashkët (mushat), prona e institucioneve fetare të quajtura ndryshe edhe vakëfe, prona shtetërore ose “malli belik”.¹ E drejta e pronësisë në krahinë është e sigurtuar nëpërmjet normave të kanunit të cilat garantojnë çdo individ për të gëzuar dhe disponuar lirisht pasurinë dhe veglat e punës për të punuar këtë pasuri brenda territoreve të gjithësecilit. Sipas këtij kanuni me konceptin pronë private përfshihen: Shtëpia, toka, trualli, kopështi, livadhi, bagëtia e imët dhe e trashë, kafshët e dorës (kuaj, gomerë mushka), shpendët shtëpiake, qeni i stanit dhe i shtëpisë, sendet dhe pajisjet shtëpiake, veshëmbathjet personale dhe të gjitha sendet me vlerë. Prona private ndahet në dy kategori në pronë private të lëvizshme (si bagëtitë dhe kafshët e tjera shtëpiake) si dhe në pronë private të paluajtshme (banesat, toka, trualli, pemët drufrutorë).

Fjalë kyçe: Labëri, pronë, norma, e drejte, kanun etj

Hyrje

Ashtu sikurse në të gjitha shoqëritë, edhe në shoqërinë shqiptare, qyshë në kohët më të lashta, kanë ekzistuar rregulla dhe tabu të ndryshme. Këto rregulla apo tabu kanë pasur një rol tejet të veçantë për funksionimin normal të kësaj shoqërie. Natyrisht që shkelësit e tyre dënoheshin shumë rreptë, sepse në rastë se do të tolerohej ndaj tyre do të thotë që të prishej gjithë ekulibri shoqëror. Më së shumti këto norma kontrolloheshin nëpërmjet kodit të moralit primitiv, kod ky i cili ishte i bazuar në filozofinë luftës së përhershme ndërmjet së mirës dhe së keqes². Në fund të fundit ku kod kishte për detyrë që të përcaktonte në mënyrë të qartë se si duhej silleshin individët e kësaj shoqërie.

Me kalimin e kohës vrendin e këtij kodit nderi e zunë zakonet që edhe këto kanë pasur një rol shumë të rëndësishëm për rregullimin e të gjithë aktivitetit ekonomik dhe shoqëror. Me thellimin dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të shoqërisë dhe sidomos me lindjen e pabarazisë ekonomike, doli si dosmosdoshmëri që këto zakone të ktheheshin në norma dokësore apo siç quhen ndryshe në norma të së drejtës zakonore.

Pikërisht duke u mbështetur në këto norma juridike që përshkonin fund e krye kanunin e Lbarisë, ishte ndërtuar edhe rendi ekonomiko- shoqëror i krejt kësaj krahine. Struktura shoqërore e krahinës ishte e ndërtuar duke u bazuar tek disa hallka të rëndësishme të cilat në fakt ishin edhe shtyllat kryesore në të cilat ishte e mbështetur e gjithë ekzistenca e shoqërisë labe. Këto “shtylla” sipas normave juridike të kanunit ishin barku, familja, vllazëria, fafisi, brezat dhe gjinia. Mendojmë se është e domosdoshme, që për të kuptuar më mirë se si funksiononte kjo shoqëri, ti bëjmë një analizë të hollësishme këtyre hallkave të rëndësishme që mbanin të lidhur gjithë shoqërinë labe. Sipas këtij kanuni , çdo njeri që nga lindja e tij dhe deri në vdekje ka aftësi të barabarta për të pasur të drejta dhe detyrime civile. Kjo është një hallkë shumë e rëndësishme dhe një moment tepër delikat, sepse individi pajiset kështu me zotësinë juridike për të trashëguar pasurinë e babait³. Dhe këto të drejta nuk mund të kufizoheshin në asnjë mënyrë, me përjashtim të rasteve kur fëmijët ishin të paftë

¹Elezi, Ismet. Kanuni I Labërisë, Tiranë: TOENA 2006, fq. 138

²Elezi, Ismet. Kanuni I Labërisë, Tiranë: TOENA 2006, fq. 14.

³Elezi, Ismet. Kanuni I Labërisë, Tiranë: TOENA 2006, fq. 135

mendërishtë. Normat e kanunit përcaktojnë në mënyrë fare të qartë se pronat private në krahinë ishte e shenjtë dhe e paprekshme dhe si e tillë ajo mbrohet në mënyrë të gjithanshme. Këto norma juridike përcaktojnë në mënyrë të prerë dhe pa asnjë ekuivok edhe format e ekzistencës së pronës private në krahinë, të cilat ishin.

1. Prona e vogël private, ku përfshihet edhe pronat individuale
2. Prona e mesme private
3. Prona e madhe private
4. Prona e përdorimit të përbashkët (mushat)
5. Prona e institucioneve fetare të quajtura ndryshe edhe vakëfe
6. Prona shtetërore ose “malli belik”⁴

E drejta e pronësisë në krahinë është e siguarur nëpërmjet normave të kanunit të cilat garantojnë çdo individ për të gëzuar dhe disponuar lirishtë pasurinë dhe veglat e punës për të punuar këtë pasuri brenda territoreve të gjithësecilit.

Sipas këtij kanuni me konceptin pronë private përfshihen: Shtëpia, toka, trualli, kopështi, livadhi, bagëtitë dhe imët dhe e trashë, kafshët e dorës (kuaj, gomerë mushka), shpendët shtëpiake, qeni i stanit dhe i shtëpisë, sendet dhe pajisjet shtëpiake, veshëmbathjet personale dhe të gjitha sendet me vlerë. Prona private ndahet në dy kategori në pronë private të lëvizshme (si bagëtitë dhe kafshët e tjera shtëpiake) si dhe në pronë private të paluajtshme (banesat, toka, trualli, pemët drufrutore).

Natyrishtë që më rëndësi nga të gjitha llojet e pronave më rëndësi kishte pronat tokësore. Në bazë të sasisë dhe cilësisë së tokave apo kullotave që ata kishin në zotërimin në fund të fundit përcaktohej edhe pasuria e tyre. Tokat në vartësi të cilësisë së tyre ndaheshin në:

1. Toka të bardha⁵ nën ujë.
2. Toka të bardha mbi ujë
3. Toka me ullinjë, vreshta dhe pemë frutore
4. Toka për kullotë të bagëtitë
5. Toka për kullotë
6. Toka bujqësore në mal
7. Toka bujqësore në fushë.

Përgjithësishtë të gjitha llojet e tokave kishin një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin ekonomik të krahinës prandaj ajo shihej si një gjë shumë e shenjtë dhe mbrohej me një fanatizëm shumë të madh. Duke qënë se pjesa dërrmuese e saj është private dhe shumë pak toka në krahinë ishin pronë shtetërore ajo mbrohej në mënyrë të rreptë edhe nga normat juridike të kanunit.

